

BEN BLUSHI

## Të jetosh në ishull

roman



BOTIMET TOENA  
[www.albsemi.grant.com](http://www.albsemi.grant.com)

1

Ishte një ditë e nxehtë dhe njerëzve nuk u hahej mish. Pazari ishte zgjuar i pari dhe pas tij ishte zgjuar qyteti. Zakonisht, qyteti lodhej në pazar dhe çlodhej në kishë. Por ishte e diel dhe jo të gjithë punonin. Ishte një ditë pazar dhe jo të gjithë shkonin në kishë. Fshatarët kishin ditën e tyre të punës. Qytetarët kishin ditën e kishës dhe të pazarit. Gratë dilnin nga mesha e mëngjesit, shkonin në pazar, ku i frynin trastat si gjinj, dhe pastaj ktheheshin në shtëpi. Kur ato vonoheshin pas gjërave të panevojshme, fëmijët i prisnin me gojë hapur. Burrat pinin duhan në hije dhe shikonin gratë. Kafshët rrinin në diell dhe, duke pritur të shiteshin, shikonin burrat. Ata që kishin vapë freskoheshin në liqen. Por qyteti ishte në mes të maleve dhe jo të gjithë dinin not.

Deri kur u mbyll pazari ai nuk i shiti dot dy delet e tij. Mblodhi paratë që kishte fituar dhe u nis. Xhamia ishte në të dalë të qytetit. Në dimër ajo rrugë ishte e pushtuar nga balta, por atë ditë bënte zheg dhe toka digjte mbi kokë dhe nën këmbë. Dera e xhamisë ishte e mbyllur. Ai trokiti me një gur mbi portën e vogël. Imami u shfaq pas pak duke lidhur tyrben mbi kokën e rruar. Alekum Selam. Mirëdita, i tha ai. Dua të bëhem mysliman. Urdhëro, e ftoi imami. Je i pari që vjen sot. Të krishterët merren me tregti të dielave. U fut brenda dhe pati ftohtë. U ulën të dy përballë njëri-tjetrit mbi një rrogë, i cili në anën e tij dukej më pak i përdorur. Xhamia ishte bosh. Dielli hynte me zor nga katër kamare të vogla, të shpërndara nga një në çdo faqe muri. Në

një cep të errët mezi dukej një tenxhere e madhe dhe pranë saj bukë dhe disa kokrra ullinj. Je në shtëpinë e Zotit, i tha imami, si për t'i thënë mos u habit. A ha Zoti ullinj, qeshi ai duke u përpjekur ta ngrohte xhaminë me shaka. Imamit nuk i lëvizi asnjë muskul. Ullinj të i ha unë. Doktorët thonë se bëjnë mirë për veshkat.

Pse do të vish në Islam, e pyeti thatë imami, pa e lënë të vazhdonte udhëtimin e tij nëpër muret bosh të xhamisë. Aliu iu përgjigj se nuk kishte ndonjë shkak, por mendonte se Islami është një gjë që duhet provuar. Unë fitoj sa për t'u ushqyer, nisi të shpjegonte. Nuk kam ndonjë arsye të veçantë. Islami është feja e Perandorisë dhe unë e respektoj si një shtetas i rregullt. Nga Islami vijnë ligjet, taksat, ushtria dhe drejtësia. E këto nuk mund t'i zbatosh si duhet po nuk njohe burimin e tyre të vërtetë. Shpejt ose vonë, të gjithë do të bëhen myslimanë. Babai më ka thënë që punën e sotme mos e lër për nesër. Unë zgjohem herët në mëngjes, si kafshët që shes dhe shëroj, prandaj nuk e kam vështirë të falem në oraret që përcakton feja juaj. Njoh shumë të tjerë që do të ishin bërë myslimanë në qoftë se do të kishin regjimin e bagëtive.

Sa vjeç je? Tridhjetë e nëntë i mbusha në korrik. Ka myslimanë të tjerë në fshatin tënd? Jo, tha ai, unë do të jem i pari. Njeh ndonjë mysliman tjetër? Kroi kokën dhe u kujtua. Njoh Ali Tepelenën. Ç'është ky, tha imami. Aliu është kusar. I zë pritë karvanëve dhe grabit ushqime, mallra dhe kafshë, që pastaj i shet. Kohët e fundit ka marrë një titull nga Stambolli dhe trimat e tij e thërrasin dervexhi. Tani kontrollon rrugët dhe grykat nga kalojnë karvanët dhe i ka bërë zap gjithë kusarët e tjerë. Askush nuk vjedh dot pa lejen e tij. Para disa muajsh u fsheh në shtëpinë time se e ndiqnin ushtarët e Kurt Pashës për ta vlarë. Kuajt i sjell tek unë për t'i shëruar dhe prandaj jemi njohur. A të ka folur Aliu për Islamin? Po. Njëherë ai më tha se sikur Muhamedi të ishte shqiptar, grekët do ta kishin vlarë atë. Imami nuk lëvizi, por diçka mërmëriti. Në qoftë se Muhamedi do të ishte shqiptar, grekët do të ishin çifutë dhe çifutët nuk e vranë dot Muhamedin. Megjithatë, Muhamedi nuk mund të ishte shqiptar. Të gjithë profetët kanë lindur në shkretëtirë aty ku nuk ka ujë dhe nuk ka dimër. Ne kemi shumë ujë dhe shumë dimër.

Imami futi dorën poshtë rrogosit dhe nxori një libër të verdhë me shkronja të mëdha arabe. Ky është Kurani. Është libri me porosi që Allahu i dha Muhamedit përmes të dërguarit të tij, engjëllit Xhebrail. Këtu tregohet se çfarë duhet të bëjë një mysliman. Dhe po ashtu se çfarë nuk duhet të bëjë. Mos harro se gjërat që nuk duhet të bësh, janë më të rëndësishme se ato që duhet të bësh. Kurani është libri i ndalimit dhe jo i lejimit. Ti nuk mund ta lexosh Kuranin, por unë do të të them disa gjëra, të cilat, nëse i pranon, do të të dallojnë ty nga të tjerët, nga të pafetë.

Islam do të thotë paqe. Paqja mund të mbretërojë mes njerëzve nëse ata i dedikohen Allahut dhe ndjekin rregullat që ai ka përcaktuar. Këto rregulla Zoti ia tha Muhamedit që ky t'ia thoshte njerëzve. Muhamedi shkroi Kuranin, megjithëse deri 40 vjeç nuk dinte as shkrim, as këndim, njësoj si ti sot. Kjo është një nga dëshmitë se ai ishte i dërguar i Allahut, porositë e të cilit për herë të parë i erdhën rreth vitit 610 kur ai jetonte në Mekë, me gruan e tij Hatixhe. Gjatë jetës së tij Muhamedi pati shumë gra të tjera. Kur ai vdiq, në prehrin e gruas së tij më të dashur Aishes, Meka, Medina dhe shumica e Arabisë kishin pranuar Islamin. Kurani i ka njohur të gjithë profetët e tjerë përpara Muhamedit, përfshi Musain, profetin e çifutëve dhe Isain e të krishterëve. Por Muhamedi është profeti i fundit. Prandaj dhe Islami është feja e vetme e Allahut. Qëllimi i profetëve të tjerë ka qenë të paralajmëronin dhe të bënin gati botën për misionin e Muhamedit, kështu që të krishterët e kanë detyrim që të kthejnë fenë e tyre në Islam. Jezu Krishti po të ishte gjallë do t'i bashkohej fesë së Muhamedit.

Imami ndaloi dhe e futi Kuranin nën rrogos. Këto që po them duhet t'i dish sepse të krishterët e fshatit do të të prozvalin dhe do përpiqen të të poshtërojnë kur t'u thuash se je mysliman. Mos u

mërzit. Të gjithë profetët janë sharë nga fshati i vet. Ti më the se do të bëhesh mysliman. Unë të pyeta pse. Më the se Islami është një gjë që duhet provuar sepse herët apo vonë të gjithë do të vijnë në Islam. Kjo është e vërtetë. Një ditë, të gjithë do të bëhen myslimanë. Por jo për arsyet që the ti. Unë do të t'i jap arsyet, ti do t'i jetosh dhe më pas do t'ia japësh të tjerëve.

Islami ka pesë kushte. Nëse ti i pranon, atëherë je mysliman. I pranoj, tha ai me një frymë. Ishte ftohtë dhe drita e diellit nga kamaret e xhamisë kishte nisur të dobësohej. Duro, i tha imami. Do të t'i them një nga një. Ngrihu në këmbë.

Ai u ngrit dhe pas tij u ngrit dhe imami. Gjysma e fytyrës i ndriçohej akoma nga drita e pasdites. Gjysma tjetër po kridhej gradualisht në errësirë. Islami dhe Krishterimi janë si hëna dhe dielli, mendoj ai. Të dyja kanë marrë përsipër të ndriçojnë botën, por kur njëri ikën vjen dita dhe kur ikën tjetri vjen nata. Tani jam në muzg. Dielli me hënën po ndërrojnë vendet si Krishterimi me Islamit në shpirtin tim. Deri në fund të jetës do të përpiqem të kuptoj kush është dielli dhe kush është hëna nga të dy, u zotua ai me vete dhe u përqendrua prapë tek imami, fytyra e të cilit kishte hyrë në hije.

A pranon se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i tij?

Bota është më e qetë tani që e udhëheq vetëm një Zot. Në kohën e grekëve të lashtë kishte shumë zota që bëheshin xhelozë për njëri-tjetrin dhe bota ishte lëmsh. E pranoj, tha ai.

A pranon t'i falesh Allahut, pesë herë në ditë namaz? E pranoj, por ç'më ndodh nëse falem gjashtë herë? Nuk të ndodh gjë, i tha imami, por nuk duhet ta bësh. Në fillim Zoti i tha Muhamedit se myslimanët duhet të faleshin pesëdhjetë herë në ditë, por Musai, profeti i çifutëve i tha Muhamedit t'i kërkonte më pak falje sepse kjo do të ishte e lodhshme për besimtarët. Pas shumë kërkesave që bëri Muhamedi, numri i faljeve u vendos të ishte pesë. Kjo në saje të çifutëve që bëjnë tregti edhe me faljet për Zotin. Ka pasur të drejtë Musai, i tha ai. Pesëdhjetë herë në ditë do të thotë që mos bënim asgjë tjetër, por veç të faleshim. Allahu na i njeh dobësitë tona, prandaj korrigjon ndëshkimet, sqaroi imami dhe vazhdoi.

A pranon të mbash ramazan? Ç'është ramazani, pyeti ai. Ramazani është muaji i nëntë i vitit. Është muaji kur Muhamedit iu shfaq për herë të parë engjëlli me porositë e Allahut. Ky është dhe muaji i agjërimit, muaji kur myslimanët i dedikohen Zotit të tyre, duke mos ngrënë, duke mos pirë dhe duke mos i prekur me dorë gratë e tyre. Ramazani përbën agjërimit kryesor, ndërsa gjatë vitit Islami ka edhe shumë lloje të tjera agjërimesh, si agjërimi i muajit të shabanit, agjërimi i gjashtë ditëve të muajit sherval, që është muaji që vjen pas ramazanit, agjërimi i ditës së ashures, agjërimi i xhumasë, i ditës së premtë etj. këto do t'i mësosh me kohë dhe unë do të të kujtoj herë pas here, por mos harro se agjërimi i ramazanit është kusht për ty si për çdo mysliman tjetër. Gjatë ramazanit as duhet të shash, as të bërtasësh, as të zihesh, as të shpifësh apo të theshmosësh. Nëse të godasin, mos u kthe dorë dhe thuaju se je në agjërimit. Agjërimit është shkëputja e njeriut nga kërkesat e trupit, nga stomaku dhe epshet që ndjellin gratë. Ramazanin do ta nisësh pas disa ditësh, sapo të shikosh hënën e re të muajit shtator. Po në qoftë se ka re si ta dalloj hënën, pyeti ai. Asnjë re nuk mund të ndalojë takimin e një myslimani me Zotin e vet, u përgjigj imami. Të krishterët hanë diçka kur agjërojnë, pyeti prapë ai. Si mund të duroj një muaj pa ngrënë? Të krishterët agjërojnë 40 ditë rresht përpara Pashkës dhe po ashtu gjatë vitit kanë agjërime të tjera. Megjithatë, ti mund të hash dy herë në ditë. Do hash diçka të ëmbël, mundësisht hurma me ujë kur perëndon dielli, dhe ky është iftari. Pastaj do falësh namazin e mbrëmjes. Ndërsa në mëngjes, kur fillon agimi, gjithnjë përpara namazit të parë, mund të fusësh një kafshatë në gojë dhe ky është syfyri. Agjërimit është sakrifica më e madhe që një mysliman bën për të respektuar Zotin e vet. Kur agjëron, ti i thua Allahut se nuk ke ardhur në jetë vetëm për të mbushur stomakun tënd me mish kafshe dhe për të fryrë barkun e sat shoqeje me mish

njeriu. Po lopët, viçat, delet dhe qengjat e mi a duhet t'i detyroj të mbajnë ramazan, tha ai pafajësisht. Imami bëri një ngërdheshje si i bezdisur e megjithatë vazhdoi. Agjërimi është një sakrificë e ndërgjegjshme. Ty nuk të kontrollon kush nëse ha, nëse pi apo nëse kënaq gruan tënde. Gjatë agjërimit je përballë Zotit dhe ndërgjegjes tënde. Kafsha ka shpirt, por nuk ka ndërgjegje, prandaj vetësakrificimi i saj nuk parashikohet në Kuran. As Muhamedi nuk e detyronte devenë e tij, Kasun që të agjëronte. Kafshët e tua nuk do të bëhen myslimane sepse edhe para kësaj dite nuk janë të krishtera, shtoi imami. E pranoj, tha ai. E pranoj ramazanin. Kur t'i them gruas se është një kusht ajo do të më kuptojë, kurse kafshët e mia nuk do kuptojnë asgjë dhe do vazhdojnë të më duan njëlloj. Vazhdojmë, nxitoi imami duke parë diellin që fshihej pas dritareve. Pas pak duhet të jap ezanin.

Kushti i katërt i islamit është dhënia e zekatit. Zekat do të thotë që t'u japësh të varfërve ushqim, rroba dhe t'i ndihmosh. Zekati nuk është lëmshë, por është ndarje pasurie. Muhamedi mendonte se i varfri ka të drejtë të përfitojë nga pasuria e të kamurit. Zakonisht zekati shpërndahet pas sakrificës, pas agjërimit, pra në fund të ramazanit. Mund të japësh edhe para. Ai u mendua një copë herë dhe tha: Në fshat ka shumë të varfër. Nëse unë u jap të gjithëve zekat ç'më mbetet për vete? Ramazani më duket më i arsyeshëm se të detyron të kursesh, kurse zekati paska shumë harxhe. Po a nuk do varfërohesh unë një ditë duke i falur vazhdimisht të tjerëve pjesë nga pasuria ime? Atëherë ti do të jetosh duke u ushqyer nga zekati që do të shpërndajnë të tjerët, u përgjigj imami. Ky është Islami. Jep pasuri që të marrësh paqe. A e pranon këtë kusht? Imami po humbte durimin. Atij iu duk se, sikur të rezistonte dhe pak imami do ta nxirrte jashtë duke mos e përzgjedhur si mysliman. Megjithatë, vendosi të bëjë edhe një përpjekje. Përmbushja e këtij kushti, siç ia kishte përshkruar imami, nuk e bindte. Si mund të falte nga një dele, apo një viç në fund të çdo agjërimi? Ti më the se që të bëhem mysliman duhet të plotësoj kushtet e Islamit, guxoi ai të pyeste imamin. Po, i tha imami, ashtu është. Që unë të bëhem mysliman duhet të jap zekat, apo jo? po, tha imami i çuditur nga ngulmimi. Po ai që përfiton zekat a duhet të jetë mysliman? Besoj se po, u përgjigj imami i hutuar. Në fshat unë jam myslimani i vetëm dhe nuk e di sa kohë do të vazhdojë të jetë kështu. Të gjithë të varfrit e fshatit janë të krishterë. A duhet t'i fal pasurinë që Allahu ma dha mua atyre që nuk i falen Allahut? Imami nuk foli, pro instinktivisht vuri dorën mbi Kuranin e mbuluar me rrogoz. A duhet të përfitojnë zekat të krishterët, këtë dua të them, përfundoi ai kur kuptoi se kishte fituar superioritet logjik që në ditën e parë të abetares islame. Këtë nuk e di, i tha imami që u ndie keq. Ndoshta duhet të presësh derisa në fshat të vijnë myslimanët e tjerë. E pranoj, shpejtoi ai. Pranoj se do filloj të jap zekat ditën që në fshat një i varfër do të bëhet mysliman. E pranoj kushtin. Ka akoma? Edhe një, u çlirua imami.

Duhet të shkosh të paktën një herë në jetë në Mekë dhe të rrotullohesh shtatë herë rreth gurit të Qabesë. Sa larg është Meka, pyeti ai. Meka është në Arabi, tha imami. Ky udhëtim zgjat një muaj, duke kaluar nëpër Stamboll. Çdo mysliman duhet të shkojë një herë atje, në Gurin e Qabesë, që është vend i shenjtë për myslimanët. Ai gur është adhuruar që në kohët e lashta, por Muhamedi e ktheu atë në kërthizën e botës islame. Muhamedi u përzu nga Meka prej çifutëve dhe arabëve paganë dhe atij iu deshën disa luftëra, në të cilat u derdh gjak myslimani, për t'u rikthyer në mekë me kokë të rruar siç duhet të bësh edhe ti kur të shkosh. Kur duhet të nisem? Këtë e vendos ti, tha imami. Para se të vdesësh duhet të shkosh. E pranoj, u qetësua ai. Paskam edhe tridhjetë vjet kohë për të shkuar.

Pas kushtit të pestë ndihej më i sigurt. Xhamia ishte pothuajse e errët dhe jashtë zhurmat e qytetit ishin dobësuar. Ai i kishte pranuar të pesë kushtet dhe po priste që imami ta shpallte vendimin e tij. Ka dhe diçka tjetër, u kujtua imami. Çfarë, u acarua ai. Më the se ishin pesë kushte për t'u

bërë mysliman dhe unë i pranova. Imami dukej i lehtësuar, si një mami. Sot është dita e parë e lindjes së një myslimani dhe ti duhet të kesh një emër që mund ta zgjedhësh vetë. Nuk ka rëndësi, tha ai. Më thirr si të duash ti imam. Ibrahim, tha imami. Do quhesh Ibrahim. Ibrahim nuk ka qenë as i krishterë, as çifut dhe as mysliman. Ai është një nga profetët e mëdhenj që Zoti i mësoi të parashikonte të ardhmen. Në kohën e Ibrahimit, njerëzit jetonin më shumë se sot. Ibrahim rrjedh nga fara e Noes dhe ky rrjedh nga Ademi, që ishte njeriu i parë që Zoti krijoi mbi dhe nga dheu. Nga një brinjë e Ademit Zoti krijoi Havane që është gruaja e parë në këtë botë. Ademi dhe Havaja patën në fillim dy djem Kainin dhe Abelin. Kaini e vrau Abelin dhe kjo është vrasja e parë e njeriut nga njeriu. Më vonë pema e Kainit u shua nga mëkati i tmerrshëm i vëllavrasjes. Ademi dhe Havaja patën një djalë të tretë Sethin, nga trangu i të cilit buron gjithë njerëzimi. Ibrahim është degë e këtij trangu. Nga fara e Ibrahimit rrjedhin myslimanët, çifutët dhe të krishterët. Kurani thotë se Ibrahim pati një fëmijë me skllaven e tij Hagar dhe ky fëmijë u quajt Ismail, që do të thotë i egër dhe fortë. Mirëpo gruaja e tij Sara, që më vonë lindi Isakun, që i dha farë Moisit të çifutëve dhe Jezuit të kaurëve, e zoi skllaven me gjithë Ismailin dhe këta jetuan në shkretëtirë. Ismaili u rrit si njeri i egër në mes të rërës dhe urisë. Dikur, Ibrahim shkoi në shkretëtirë, takoi të birin dhe të dy ngritën Gurin e Qabesë ku u themelua Meka, vendi ku lindi Muhamedi. Sot, ne myslimanët jemi pasues të kësaj fare. Historinë e Ibrahimit e njohin edhe të krishterët nga Bibla. Ata i thonë Ademit, Adam, Havasë, Eva dhe Ibrahimit, Abraham. Më pëlqen, tha ai. Bukur, tha imami. Mirë se erdhe në islam, Ibrahim i Abdullahut. Çfarë është Abdullahu, u nxi ai. Pranova emrin tim të ri, por im atë ka vdekur dhe unë nuk mund t'ia ndërroj emrin pas vdekjes, ndjesë pastë. Abdullah do të thotë rob i Zotit dhe ky mbiemër i jepet gjithë myslimanëve të rinj si ti, baballarët e të cilëve kanë mbiemra të krishterë që Islami nuk i pranon. Jo, tha Ibrahim duke e parë imamin në sy. Pranova emrin tim të ri, por mbiemrin nuk e ndërroj. Abdullah duket si budalla dhe nuk mund t'ia lë peshqesh këtë tallje fëmijëve të mi. Nuk e pranoj sikur ta di se kthehem i krishterë siç isha sot në mëngjes. Imami buzëqeshi, por nuk këmbënguli. Iu afrua dhe e puthi në të dy faqet. Paqja qoftë me ty Ibrahim. Shpresoj të jesh një mysliman i mirë. Do përpiqem, tha Ibrahim dhe u drejtua nga dera e xhamisë. Pa kapërcyer pragun, imami e thirri nga errësira: Ibrahim, ti mund të marrësh deri në katër gra sepse kjo i lejohet çdo myslimani. Është një kusht, pyeti Ibrahim pa u kthyer. Nuk është kusht, por në qoftë se ty të pëlqejnë gratë Islami ta lejon. Do mendohem, tha Ibrahim duke dalë. Natën e mirë imam. Mirupafshim, tha imami. Mos harro të bëhesh synet Ibrahim. Kishte dalë nga xhamia. Nata ishte e gjitha përpara tij.

2

Ibrahimi arriti në të gdhirë në fshat. Gruaja flinte dhe ai nuk e zgjoi. Pranë vatrës gjeti darkën që ajo i kishte lënë gati. Mishi ishte akoma i ngrohtë. E zbrazti shpejt kusinë dhe doli jashtë të pinte ujë pusi. Agimi ishte i freskët. Ngriti kokën lart dhe hëna iu duk si një sy deleje i mbyllur. Pasi piu ujë hoqi këmishën dhe lau sqetullat e barkun. Pastaj zbathi opingat dhe fërkoj këmbët me ujë. Bagëtia ishte zgjuar dhe delet lëvizën nën zhurmën e ujit që derdhej. Ai u afrua te vatha dhe ato u gjallëruan. Një shqerrë ende e përgjumur ishte ulur në gjunjë me kokën përmbys dhe atij iu duk sikur po falej. Iu kujtua imami dhe pesë porositë e tij. Ishte dita e tij e parë si mysliman. U fut brenda në shtëpi dhe u ul në gjunjë të falej, por u kujtua se imami nuk i kishte mësuar asnjë lutje. Ndenji ashtu për pak kohë. Duhet të thoshte diçka. Mblodhi fort gjunjët poshtë barkut dhe me fytyrë të kthyer nga vatra tha me zë të ulët, por të plotë: Zoti im i vetëm. Dje isha pa ty. Sot jam me ty. Nesër do të jem te ty. Dje nuk të dëgjoja. Sot të dëgjoj. Nesër më dëgjo. Unë të zgjedha ty

para të tjerëve dhe kërkoj që ti të më zgjedhësh mua mes të tjerëve. Më bëj mua më të mirin që unë t'i bind të gjithë se ti je më i miri. Jepi ushqim, shëndet dhe bollëk familjes sime. Sa të më japësh do t'i shumoj dhe do t'i kthej prapë ty, se ti je burimi dhe unë jam uji. Ashtu si uji edhe unë kam vetëm një qëllim, që të kthehem prapë në burim më i pastër dhe më i rëndë.

E përsëriti tri herë lutjen që kishte krijuar vetë. Kur pushoi, fytin e kishte të thatë. Ishte lutja e parë dhe atij i ishte dukur shumë e gjatë. Besoj se mjafton, mendoi dhe lëvizi gjunjët për të qarkulluar këmbët e mpira. Nga pas i erdhi një zhurmë e butë. Çfarë të ka ndodhur, i tha e shoqja. Ai u ngrit, u afrua afër vatrës dhe u shtriq. U bëra mysliman, tha. Ajo hapi gojën sikur të përjetonte një mynxyrë, por nuk foli dot. Ta shpjegoj kur të zgjohem, i tha ai. Tani më sill një jastëk se dua të fle. Gruaja ia solli jastëkun dhe para se të mbyllte sytë ai pa qerpikët e saj që dridheshin.

Gjatë gjithë natës kishte ndjesinë se po flinte nën shi. Kur u zgjua kuptoi se kokën dhe qafën e kishte të qullur. Balli i pikonte pa pushim dhe hunda ishte kthyer në një trampolinë nga ku uji i derdhej në gjoks. Gruaja me sy të skuqur e shikonte me pikëllim. Ç'po bën këtu, e pyeti Ibrahimimi. Je sëmurë, iu përgjigj ajo me zë të fikur. Të kam vënë gjithë natën lecka me ujë dhe uthull në kokë për të të qetësuar ethet. Mos lëviz. Do një çaj trëndafili? Jo, i tha ai, dua qumësht. Gruaja u çel dhe nxitoi drejt sepetit. Dora i dridhej kur i dha qumështin. Ai ktheu një gllënjë dhe mbështeti kokën në jastëk. Gruaja e përpinte me sy. Nuk e beson dot e shkreta, mendoi ai. Si mund ta besonte?

E shoqja ishte nga fisi i krishterë i Xhavellave të Sulit. Këta malësorë kishin luftuar prej shekujsh me turqit dhe nuk e kishin pranuar Kuranin as me shpatë, as me ofiqe. Suljotët ishin krenarë për fenë e tyre dhe besonin se ishin garda e krishterë e shqiptarëve. Ata kishin vrarë në disa raste shqiptarë që kishin ndërruar fenë dhe këtë e bënë për të frikësuar të gjithë ata që, sipas tyre, shisnin fenë të turqit. Ekspeditat e këtyre malësorëve në fshatrat e fushës ishin gjithnjë e më të dhunshme. Herën e fundit, përpara disa muajsh, daja i gruas, Llambro Xhavella, në krye të 100 trimave, kishte djegur dhjetë shtëpi myslimanësh të rinj dhe i kishte detyruar ata që ose të mohonin fenë e re, ose çdo shtëpie do t'i rrëmbehej nga një mashkull. Llambro kishte bindur familjet e mëdha të Sulit që të strehonin djem të vegjël të krishterë, të cilët, sipas tij, duhet t'i shpëtonin nga pabesia e baballarëve frikacakë. Djemtë e Ibrahimit shkonin çdo vit për verim te dajat, në malet e Sulit dhe kur ktheheshin tregonin se kolonia e vogëlushëve të rrëmbyer bëhej çdo vit e më e madhe. Dhe janë çdo vit e më të egër, i kishte thënë një herë i biri, a thua se dajë Llambro i ushqen me barut. Nuk mund ta bëjë këtë dhe me fëmijët e mbesës, mendoi dhe pa gruan që nuk ia ndante sytë duke pritur që ai të fliste. Piu dhe pak qumësht, zgjati dorën dhe e afroi gruan nga vetja.

Nuk jam sëmurë, i tha, jam mysliman. E shoqja nuk lëvizi, por ai ndjeu një ngurtësim në lëkurën e saj. Ajo ishte ftohur papritmas dhe Ibrahimimi iu duk sikur po përqafohej me një skelet. Nuk ke pse idhnosesh me mua, vazhdoi të fliste ai. Nuk do ndryshojë asgjë në jetën tonë. Ti je gruaja ime dhe unë do vazhdoj të kujdesem dhe të të mbaj si më parë. Katandia jonë do të shtohet sepse unë besoj se disiplina e Islamit do t'i sjellë mbarësi kafshëve tona. Fshatit do t'i dal për zot vetë dhe ty nuk ka pse të të vijë turp nga unë. Sot, unë jam myslimani i parë në fshat, por do ta shohësh se shpejt shumë të tjerë do të bëjnë si unë. Të krishterët dhe myslimanët kanë një mijë vjet që jetojnë bashkë dhe ne të dy nuk jemi të vetmit që flemë bashkë, por lutemi veç e veç. Kur ika dje në qytet nuk e kisha vendosur dhe prandaj nuk të thashë gjë. U binda kur isha në pazar duke shitur. Shikoja burra dhe gra të krishterë që blinin dhe shisnin me nxitim, a thua se ishin në ditën e fundit të jetës së tyre. Aty pata një ndjenjë përkohshmërie që nuk e kisha provuar kurrë më parë. Këta njerëz e ndiejnë se ajo që po jetojnë është shumë e përkohshme dhe duan ta

shijojnë atë që kanë përpara se bota të ndryshojë. Ata e dinë se era që po fryn nga Lindja do ndryshojë jetët e tyre. Veç t'i kishe parë dje gratë që dilnin nga kishat. Dukeshin si në ditën e tyre të fundit të lirisë. Islami po afron dhe era që fryn mbi qytet po sjell rërë shkretëtire. Islami ka rregulla të tjera për burrat, për gratë dhe në përgjithësi për lirinë. Kjo fe vjen si një ushtri që ka ndërtuar perandorinë më të madhe të botës në Stamboll dhe forca e saj është vetëm në fillimet e veta. Në qoftë se nuk e pranon duhet ta luftosh dhe në qoftë se vendos të luftosh mund edhe të humbësh, e në qoftë se humb ke vdekur. Ne shqiptarët e fshatrave të varfër, nuk i rezistojmë dot asnjë ushtrie, sepse në mijëra vjet kurrë nuk kemi pasur ushtrinë tonë që të na mbrojë nga fetë e ushtrive të tjera. Fati ynë dihet. Ne kemi lindur për t'i shërbyer ushtrive dhe feve që kalojnë nëpër tokat tona. Krishterimi ka mijëra vjet që i ka mësuar shqiptarët me rregullat dhe zakonet e veta. Mos kujton se të gjithë shqiptarët u bënë të krishterë duke qeshur në këto 1700 vjet? Jo. me hell dhe me shpatë janë bërë pagëzimet e para. Sa familje janë shkatërruar dhe janë ndarë kur krishterimi erdhi me ushtritë e veta pushtuese. Ne nuk kemi qenë gjithmonë të krishterë dhe nuk kemi pse të jemi të tillë deri në fund të kohës. Tani është koha e Islamit. Paratë, fuqia dhe shteti e kanë qendrën në Stamboll. Kjo u vendos qysh se turqit pushtuan Kostandinopojën në kohën e katragjyshit tim. Që atëherë Islami nuk është ndalur. Edhe grekët do ishin bërë myslimanë nga frika. Por ata kanë një pakt me turqit, sepse kur i dorëzuan Kostandinopojën u vendos që grekët të ishin kombi më i preferuar pas myslimanëve dhe kështu është akoma. Turqit kanë nevojë për artet dhe dijen e grekëve, ndërsa nga ne nuk kanë çfarë të përfitojnë dhe prandaj do të na detyrojnë me hir apo me pahir të marrim fenë e tyre. Në qytet takova një imam, i cili më shpjegoi islamit. Krishterimi dhe Islami, sipas tij, burojnë nga i njëjti trung. Mijëra vjet më parë dy vëllezër, Ismaili, i madhi dhe Isaku, i vogli, u ndanë sepse nënat e tyre ishin të ndryshme. Babai i tyre zgjodhi të jetonte me gruan e tij të ligjshme dhe me djalin e saj, Isakun. Ismaili jetoj me të ëmën skllave në shkretëtirat e Arabisë, aty ku më pas lindi Islami. Nga pasuesit e Isakut lindi Krishti, ndërsa nga pasuesit e Ismailit lindi Muhamedi. Porositë që Zoti i dha Muhamedit dallojnë myslimanët nga të krishterët. Imami m'i tha të pesë porositë dhe unë i pranova sepse m'u dukën të lehta, të shëndetshme dhe pa harxhe. Unë duhet të falem pesë herë në ditë, duhet të agjëroj më shumë se një muaj në vit, duhet t'i jap ushqim dhe veshje të varfërve dhe në qoftë se kam mundësi të shkoj para se të vdes një herë në Mekë ku është vendi i shenjtë i myslimanëve. E ç'bën tjetër një burrë i krishterë, përveçse falet më pak, agjëron më shumë dhe nuk është i detyruar të shkojë në Mekë. Unë mund të kem edhe tri gra të tjera nëse dua. Ti nuk duhet të kesh turp nga unë. Shpejt do bindesh se unë kam bërë zgjedhjen e duhur. Ndoshta zgjedhja ime nuk sjell më shumë lumturi, por unë besoj se ajo sjell më pak dhimbje. Do isha një njeri me fat sikur babai im të ishte bërë mysliman për të mos ma lënë mua barrën e zgjedhjes. Djemtë tanë do ta kenë jetën më të lehtë, ta dish. Kjo sepse babai i tyre mori përsipër ta përballojë vetë sikletin e ndryshimit të fesë duke mos ia lënë atyre.

Kur foli për djemtë, gruaja nisi të merrte frymë. Skeleti i saj u ngroh dhe ai ndiente se si gjaku i saj gurgullonte nëpër kocka si uji i mëngjesit nëpër tubat e çezmës. Pas pak gruaja lëvizti këmbët e ftohta. U shkëput nga ai dhe u ngrit. Sytë i kishte të fryrë, por të thatë dhe pa lot. Më vjen turp nga fshati, tha ajo. Njerëzit e mi në Sul do të më mohojnë dhe ne do të mbetemi fillikat. As do na hyjë njeri në derë dhe as do na pranojnë nëpër dasma dhe morte. Nuk do na shesin më kripë, as bukë, as vaj dhe do na i helmojnë bagëtitë. Gratë do ndërrojnë rrugën kur ti t'u dalësh përpara, burrat do pështynë në tokë kur t'i takosh. Më vjen të vdes, rënkoj ajo. Të kishe pritur dhe pak. Kisha dëgjuar se Mihali i Zoicës do bëhej mysliman sepse kadiu i qytetit që ai e furnizon me

bulmet ia kishte vënë kusht. Të kishim parë ç' do t'i thoshte fshati Mihalit pastaj të vendosje. Pse duhet të ishe ti i pari?

Ai e piu deri në fund qumështin që ishte ftohur dhe mendoi se ndoshta gruaja kishte të drejtë. Kishte bërë një kapërcim ylberi, por tani nuk mund të kthehej më pas. Nuk e di a duhej të isha i pari, por nuk mund të isha i dyti, tha ai duke u çuar. Atëherë gruaja iu afrua dhe iu ngjiti për trupi. Unë jam martuar me një të krishterë dhe do vdes me një mysliman, u zotua ajo duke ia hedhur krahët rreth belit. M'u beto për Krisht që nuk do t'i bësh djemtë myslimanë dhe nuk do marrësh gra të tjera, siç thotë feja jote. Gruaja i kishte mbështetur kokën në sup dhe atij iu dhimbs. Në fund të fundit ajo ishte si gjithë gratë e tjera, myslimane apo të krishtera. Skeleti i saj ishte dashuria, mishi i saj ishte xhelozia. Vetëm vdekja mund të ndajë xhelozinë nga dashuria, mendoi ai dhe u ndie më i qetë. Sikur gruaja të mos ishte xheloze do ta kisha jetën më të vështirë, ngushëlloi veten. Ta premtoj, i tha ai duke e shtrënguar pas kurmit të vet dhe shtoi: Djemtë që kanë lindur nuk do bëhen myslimanë dhe unë nuk do marr grua tjetër deri ditën që ti do lindësh një vajzë.

Nuk do t'i gëzohem asaj dite, tha gruaja dhe vuri dorën mbi bark sikur po i jepte një urdhër mitrës së vet.

Më quaj Ibrahim, i tha ai. Është emri i profetit të parë që ishte babai i Ismailit dhe i Isakut. Ti mund të më thërrasësh Abraham.

3

Kur prifti hyri në fshat pas tri ditësh, pleqësia e priste e mbledhur. Kolera islame ju hyri në shtëpi, i tha burrave të fshatit pa i përshëndetur. Në qoftë se nuk e izoloni, do t'ju përpijë të gjithëve një nga një.

Lajmi se një nga burrat ishte bërë mysliman e tronditi fshatin.

Gratë ndezën qirinjtë që nuk u shuan për shtatë ditë me radhë. Burrat, të cilët ndiheshin më fajtorë për tradhtinë e një anëtari të gjinisë së tyre, e mbytn hidhërimin e ditëve të para me raki. Dikush betohej se, nëse pleqësia e lejonte, ai do shkonte natën dhe do ta vriste Ibrahimin. Një tjetër tha që shtëpia e myslimanit të rrethohej me një kanal të lartë dhe kështu ai do jetonte në një ishull të pakalueshëm brenda fshatit. Të thërrasim priftin, propozoi një tjetër. Atij i takon të na thotë se çfarë duhet të bëjmë kur delet braktisin vathën e Zotit dhe shkojnë të ushqehen me dorën e turkut.

Kur prifti, që u bënte mesha një herë në katër të diela, erdhi nga qyteti, i lodhur dhe i pluhurosur, shumicën e burrave e gjeti të pirë. Ata filluan të flisnin të gjithë njëherësh dhe në atë rrëmujë priftit iu desh të ndërhynte disa herë për të shuar zënkën mes tyre. E tregonin në mënyra të ndryshme historinë e Ibrahimit, pastaj kundërshtonin versionet e njëri-tjetrit, bërtisnin, akuzonin shoku-shokun dhe pastaj priftin se indiferenca e tij ndaj fshatit do t'i joshte njerëzit avash-avash drejt fesë tjetër.

Pushoni kaurë të dehur, bërtiti prifti që kishte humbur durimin. Një ditë kjo do të ndodhte e ju nuk mund të bënit përjashtim. Islami është një kolerë që ka një mijë vjet që përhapet me majën e shpatës. Miliona njerëz në Lindje jetojnë nën këtë epidemi, por duke qenë të gjithë njëllor të sëmurë nuk kuptojnë se nga se vuajnë dhe as nuk përpiqen ta shërojnë veten. Fshati juaj është një pikë uji në oqeanet e feve të mëdha. Zoti përcaktoi kufijtë mes këtyre oqeanëve dhe ky kufi ishte Kostandinopoja. Myslimanët e shkelën kufirin që Zoti kishte vendosur mes territoreve fetare kur pushtuan këtë qytet grek aty ku takohen oqeanet. Qysh nga ajo ditë ujërat e papastra të Islamit



derdhen në oqeanin tonë dhe sot ato ndotën dhe fshatin tuaj. Kur linda unë, vetëm një në dhjetë shqiptarë ishte mysliman. Tani që jam në mes të jetës, myslimanët bëjnë tre shqiptarë në dhjetë. Shpresoj që kur të vdes të mos e kenë kaluar gjysmën e dhjetës.

Prifti ndaloi dhe mori frymë thellë. Burrat dukeshin më të vegjël nën mjegullën e duhanit që pinin pa pushim.

Ju e dini se çfarë i tha Jezu Krishti Pjetrit natën e fundit, vazhdoi ai. Kur gjeli të këndojë tri herë do më kesh mohuar tri herë. Edhe unë shoh mohues midis jush. Shumë shpejt në këtë fshat do ketë myslimanë të tjerë dhe unë dua të kuptoj pse. Pse, o shqiptarë, e keni kaq të lehtë të mohoni fenë e parë? Mohoni për para, apo mohoni nga frika? Mohoni nga padija, apo mohoni nga varfëria? A e keni pyetur veten pse nuk keni pasur kurrë shtetin tuaj, pse nuk keni pasur kurrë shenjtorët tuaj, pse nuk keni akoma libra në gjuhën tuaj, pse nuk keni shkollat tuaja dhe pse nuk keni flamurin tuaj? Jua them unë pse. Sepse ju nuk e keni besuar Krishtin. Atë e keni pranuar si një nënshtrim ndaj perandorive që ju kanë qeverisur. E keni pranuar fenë si të ishte një taksë shpirtërore, së cilës mund t'i shmangesh me dredhi. Perandoritë, deri ditën kur ra Kostandinopoli, ishin të krishtera dhe ju ishit të krishterë. Tani perandoria juaj është myslimane dhe ju po mbani radhë në Islam. Ju bëheni me fenë e pushtuesit tuaj dhe prandaj nuk do keni kurrë shtetin tuaj sepse kur pushtuesit të ikën, ju do të bëheni me pushtuesin e ri.

Burrat ishin lëshuar në stolat e tyre. Ligjërata e priftit i kishte bërë esëll. Mos na fyej, o grek, i tha dikush. Ne të kemi thirrur të na ndihmohet. Ti po na thua që të bëhemi grekë që të mos bëhemi myslimanë?

Ishe shumë i hidhur hirësi, foli burri më i moshuar që ishte dhe kryetari i pleqësisë. Dhoma ra në qetësi. Zotrote na the se shqiptari nuk është një i krishterë i pastër dhe një ditë mëkati do ta çojë atë në Islam. Unë kam vendosur të jem edhe pak kohë në këtë botë. Gjithë jetën time i jam lutur Zotit që t'i jepte paqe dhe bukë fëmijëve të mi dhe fëmijëve të fëmijëve të mi dhe Zoti shpesh më është përgjigjur. Sa jam gjallë kam pasur bukë, por kurrë nuk kam pasur paqe. Bukën e kam fituar vetë, paqen ma kanë marrë një herë grekët dhe një herë turqit. Ne jemi të krishterë, grekët janë të krishterë dhe paqe nuk ka. Tani po vijmë turqit që thonë se bukën duhet ta sigurojmë vetë, ndërsa paqen do të na e sjellin ata. Turqit thonë se, nëse nuk e pranojmë paqen e tyre, do të na e marrin dhe bukën dhe tokën. E ata me paqe kuptojnë Islamin, apo jo? unë sa të vdes do mbetem i krishterë, siç kam lindur. Turqit thonë se toka është e perandorisë, ndërsa ju grekët thoni se feja jonë është feja juaj sepse unë gjatë jetës janë shkruar në greqisht. Unë nuk do jem gjallë, por di që një ditë stërnipërit e mi do t'i kenë të dya dhe askush nuk do mund t'ua marrë më, as fenë, as tokën dhe as gratë. Prandaj të kemi thirrur, të na thuash se ç'duhet të bëjmë që myslimani i fshatit tonë mos shumohet me vajzat tona dhe mos ushqehet me bukën tonë, megjithëse ti nuk beson se Krishti dhe shqiptari mund të jetojnë në të njëjtin trup, pa e tradhtuar njëri-tjetrin. Plaku pushoi nën vështrimin admirues të burrave të tjerë.

Prifti u mendua një copë herë dhe foli. The atë që mendoj prej disa kohësh, i tha plakut. Shqiptari dhe Krishti nuk jetojnë dot bashkë përjetësisht. Shqiptari beson se është i varfër sepse Krishti nuk kujdeset për të siç kujdeset për grekët dhe prandaj ai e tradhton Krishtin sepse ndihet i tradhtuar. Koha do na e thotë se kush ka tradhtuar i pari ndër të dy dhe atë ditë ky gjykim do jetë ose një ngushëllim i madh, ose një pikëllim i madh për shumë myslimanë shqiptarë. Por sot ne kemi shumë pak fakte për të provuar çka po them. Tradhtia është në ditët e saj të para. Megjithatë, detyra ma do që unë të përpiqem që ajo që besoj të mos ndodhë. Prandaj kam ardhur. Në qytet ka shumë shqiptarë që janë bërë myslimanë. Ne vendosëm që t'i izolojmë dhe prandaj të krishterët nuk janë më gjitonë me myslimanët. Ata jetojnë në një lagje të veçantë, e cila po rritet përditë. Kanë çezmat dhe dyqanet e tyre. Të krishterët po ashtu. Takohen vetëm të dielave

në ditën e pazarit. Fise të tëra janë ndarë sepse një vëlla është bërë mysliman dhe të tjerët kanë mbetur të krishterë. Martesat mes fëmijëve të dy feve nuk lejohen më. Ju thashë se kjo do të ndodhë edhe në fshatin tuaj sepse myslimani ka pas tij kadiun, asqerin, dervexhiun dhe pashain. Sot, ata janë më të fortë. Por ju duhet të jeni më të zgjuar. Turqit kanë shpatën, por të krishterët kanë mendjen. Ky ballafaqim mes shpatës dhe mendjes do bëjë që ju të mbeteni shumicë në fshatin tuaj. Duhet ta izoloni Ibrahimin që të gjithë të kuptojnë se në këtë fshat nuk mund të jetosh dot si mysliman. Por edhe në qoftë se të tjerë do t'i bashkohen Islamit, shumë shpejt ata do kacafyten. Turqit janë si ujë. Pasi shumohen vrasin njëri-tjetrin. Ju duhet ta ushqeni zjarrin që ata kanë në shpirt. Kjo është dredhia që duhet të përdorni.

Do t'ju rrëfej një histori për fëlliqësitë e tyre, tha prifti. Përpara njëqind e tridhjetë vitesh, të parët e fesë myslimane në Stamboll dërguan një dervish për të përhapur islamit ndër shqiptarë. Pasi mori fermanin e Sulltanit, ky u nis për në Berat. Qëndroi një kohë aty, mësoi shqip dhe më pas u vendos në Tepelenë. Aty filloi të ndihmonte jetimët, sakatët dhe të varfrit. Shpërndante ushqim dhe ndihma që turqit ia dërgonin nga Stambolli për të joshur të krishterët. Shumë shpejt emri i Demir Hanit u përhap në të gjithë zonën dhe njerëzit filluan ta besojnë si të ishte shenjt. Madje, ndjekësit e tij, që ai i kishte kthyer në myslimanë, hapën fjalë se Demir Hani bënte mrekullira dhe kishte aftësi të shëronte njerëz, vetëm duke i prekur. Të sëmurë, të gjymtuar dhe gra gdhieshin në radhë që Demir Hani t'i prekte me dorë dhe t'i nxirrte xhindet nga trupat e tyre, siç thoshte ai vetë. Dikur, një bajraktar mysliman, gruaja e të cilit nuk pillte, vendosi të dërgojë të shoqen te Demir Hani. Ajo ishte e re dhe shumë e bukur. Demiri e mbajti gruan një muaj dhe përditë mbyllej me të në dhomat e veta larg syve të dervishëve të tjerë. Pas një muaji, e dërgoi në shtëpi dhe i tha burrit të saj se e shoqja ishte shëruar. Burri i gëzuar ra me gruan e vet dhe pas nëntë muajsh lindi një djalë. E ëma dhe babai kishin qëlluar të dy të verdhë, të gjatë dhe me sy blu si gjithë malësorët shqiptarë, ndërsa djali doli i shkurtër dhe pis i zi. Fshati filloi të përqshte bajraktarin. Gruaja u shastis, ndërsa burri e rrahu dhe e la pa bukë që t'i tregonte të vërtetën. Pas tri javësh pa bukë dhe pa ujë, e rrahur dhe e poshtëruar gruaja tregoi se kur ishte në Tepelenë Demir Hani e kishte detyruar të binte me të duke i thënë se ky është vullneti i Zotit dhe asgjë e keqe nuk do t'i ndodhte asaj. Bajraktari i çnderuar u nis në Tepelenë për të vrarë Demir Hanin. E rrethoi teqenë dhe i bëri thirrje të dilte jashtë që të merte ndëshkimin e merituar. Për dhjetë ditë Demir Hani rezistoi. Teqeja ishte e mbushur me ushqimet që ai ua shpërndante njerëzve. Një natë, Demir Hani e ftoi bajraktarin të takoheshin që t'i shpjegonte çfarë i kishte ndodhur gruas së tij. I përvëlur për të marrë vesh të vërtetën bajraktari u fut në teqe dhe aty Demir Hani e vrau me sëpatë. Viktima ishte njeri me influencë dhe gjithë tepelenasit filluan të flisnin kundër Demir Hanit. Po ashtu gra dhe vajza të tjera, e madje dhe djem të vegjël rrëfyen se kur ata shkolin për t'u shëruar, Demir Hani i prekte me dorë në vende të ndaluara dhe disa prej tyre i kish fëlliqur. Fjala shkoi deri në Stamboll dhe paria myslimane u ankua te Sulltani se Demir Hani po përdhoste Islamit me veprime, të cilat i trembnin shqiptarët që donin të bëheshin myslimanë. Për shkak të turpeve të Demir Hanit shumë myslimanë e braktisën Islamit. Fshati i bajraktarit u mblodh dhe më shumë se 50 burra myslimanë dogjën Kuranin dhe u betuan se kurrë më nuk do tradhtonin Jezu Krishtin. Pas disa kohësh, Sulltani dërgoi një ferman ku ngarkohej një nga dervishët e afërt të Demir Hanit që t'i priste atij kokën. Ky e zbatoi. Thonë se atë ditë Demir Hani vrapoi nëpër teqe deri në mbrëmje duke mbajtur kokën e tij në duar. Muaj më vonë edhe dervishit që vrau Demir Hanin iu pre koka po me urdhër të Sulltanit. U tha se ishte ky që kishte sajuar dhe shpifur gjithë ato histori të fëlliqura që t'i zinte vendin Demirit dhe t'i rrëmbente pasurinë që kishte fituar.

Kur prifti pushoi, burrat dukeshin të lodhur. Kishin tri ditë pa gjumë dhe prifti akoma nuk po iu thoshte se ç' duhej të bënin me Ibrahimin.

Gjatë tri ditëve që ata rrekeshin të gjenin një mënyrë për të përballuar bashkëjetesën me të, Ibrahim vazhdonte jetën e tij qetësisht sikur asgjë të mos kishte ndryshuar. Çdo mëngjes herët ai shtronte një rrogos në oborrin e shtëpisë, ulej në gjunjë dhe falej. Ata që e kishin parë këtë rit tregonin se myslimani falej pa zë. Lutja e tij ishte shumë e shkurtër. Më pas, Ibrahim merrej me kafshët e veta. Ditën e dytë ai kishte shkuar të shihte vëllanë e tij, Vasilin. Ky, në mungesë të një vendimi të pleqësisë, i kishte hapur derën e shtëpisë dhe e kishte pritur. Vasili iu tha burrave të pleqësisë se Ibrahim dukej i qetë dhe në humor. Qetësia e tij e kishte shpërqendruar Vasilin, i cili priste që i vëllai të shfaqësohej për damkën që i kishte vënë familjes. Për një kohë të gjatë, të dy kishin biseduar për thatësinë e gjatë të atij gushti dhe për asgjë tjetër. Pastaj Ibrahim e kishte pyetur se çfarë vendimi kishte marrë pleqësia. Vasili ishte bërë nervoz dhe i kishte thënë se shumë anëtarë të pleqësisë donin ta dëbonin nga fshati. Ibrahim rinte përballë të vëllait dhe nuk fliste. I qetë dhe pa e ngritur zërin i tha: Ti je mbyllur në fshat dhe nuk di ku po shkon bota Vasil. Turqit janë sot fuqia më e madhe që ka parë njerëzia. Shumë shpejt dallga e Islamit do të mbysë fshatrat tona. Ata kanë para dhe asnjë ushtri nuk mund t'iu bëjë ballë. Në Janinë të gjithë e dinë se herët apo vonë turqit do të kenë gjithçka në dorë. Shqiptarët atje çdo ditë bëhen myslimanë. Për ne shqiptarët Islami është e vetmja rrugë për të na dalluar nga grekët. Turqit na kanë me sy të mirë dhe unë besoj se ata do të na e lënë ne në dorë këtë vend, për inat të grekëve. Por që kjo të ndodhë ne duhet të marrim fenë e tyre. Është e vetmja mundësi që ne të bëjmë prokopi dhe pas qindra vjetësh të qeverisim veten tonë dhe grekët. Ky fat nuk troket çdo ditë në derë. Asnjë shqiptar me mend në kokë nuk duhet ta humbë këtë mundësi.

Vasili nuk fliste, por e shihte vëllanë si i ndërkryer. Koha do tregojë nëse kam pasur të drejtë, kishte vazhduar Ibrahim. Ti je vëllai im e unë jam vëllai yt dhe feja nuk mund të na ndajë. Megjithatë, unë jam i vendosur të pranoj çdo vendim që do të marrë pleqësia, por nëse dikush prek familjen time, apo më kërkon të iki nga fshati, ta dini se unë do luftoj. Nuk mund ta shkulësh rrapin nga rrënjët pa gjakosur dorën. Ti mund të vish kur të duash në shtëpinë time dhe unë do të vij nëse më pranon.

Kështu ishin ndarë dy vëllezërit. Kur Vasili ia tregoi priftit dhe pleqësisë së fshatit takimin me Ibrahimin, burrat u xhindosën dhe thanë se ata nuk mund të pranoin kërcënimet e një myslimani prandaj vendimi duhej marrë një orë e më parë. Vasili nuk fliste, por dukej se e vuante gjyqin që fshati po i bënte të vëllait.

Mëkat, tha prifti, pasi dëgjoi shpjegimet e Ibrahimit. Më i zgjuari prej jush qenka bërë mysliman. Nuk do ta keni kollaj ta thjeni këtë njeri. Ç' duhet të bëjmë, e pyeti Vasili që rrinte në këmbë sikur priste një urdhër. Ky njeri nuk mund të mposhtë një fshat, foli prifti. Fuqia e tij qëndron te dobësia juaj. Ju e keni dashur dhe e keni respektuar prandaj sot jeni të përçarë dhe të pavendosur. Betejën e parë me ju sapo e ka fituar. Jam i bindur që ai fle tani i qetë me Zotin e tij të ri, ndërsa ju keni tri ditë që nuk dini çfarë të bëni për të mbrojtur Zotin tuaj. Fol, i thanë burrat priftit. Ç'të bëjmë?

Si në një sallë gjyqi, prifti u çua në këmbë dhe ashtu bënë të gjithë burrat pas tij, përveç kryetarit të pleqësisë.

Ibrahim duhet të vuajë për fyerjen që i ka bërë fshatit, shpalli prifti. Atij as nuk do t'i shitet, as nuk do t'i falet grurë, kripë, bukë, miell, vaj dhe asgjë tjetër që hahet. Askush nuk do të prekë mish nga kafshët e Ibrahimit. Askush nuk do të çojë kafshët e veta për t'i shëruar tek Ibrahim. Askush nuk do të martojë vajzat e veta me djemtë e Ibrahimit. Askush nuk do të ngrejë shtëpi pranë Ibrahimit. Gjithonët do t'i mbyllin dritaret që shohin nga shtëpia e tij. Rruga përpara

shtëpisë së Ibrahimit nuk do të shkelet nga asnjë i krishterë. Atij do t'i mbyllet dera e shtëpisë së të krishterit, përveçse kur ka morte. Gratë e krishtera nuk do t'i japin dorën Ibrahimit. Burrat do ta qëllonjë Ibrahimin vetëm nëse ai do të hyjë në kishë apo në qoftë se ai sulmon një të krishterë. Nëse Ibrahim vdes, ai nuk do të varroset bashkë me të krishterët. Vajzat e Ibrahimit, të krishterët do t'i respektojnë sepse ato janë viktima të tradhtisë së babait. Djemtë e tij do vuajnë ndëshkimin njëjloj si i ati i tyre. Ata zhvishen nga të drejtat për t'u zgjedhur në pleqësi dhe për të ndjekur meshat dhe shkollat e krishtera. Duke filluar nga sot, për dyzet ditë, asnjë i krishterë nuk do t'i thotë Ibrahimit mirëmëngjesi dhe natën e mirë dhe po ashtu askush nuk do t'i flasë gjatë kreshmës. Nuk ka urim për myslimanin.

Kur prifti mbaroi, burrat u panë në sy. Ata prisnin ndëshkime më të rënda. Ishin përgatitur ta dëbonin dhe disa do ishin të gatshëm ta vrisnin myslimanin. Por i vëllai i Ibrahimit ishte aty dhe ata nuk folën për ndëshkime më të ashpra. Prifti e ndjeu se pleqësia mbeti e pakënaqur. Kur njëri prej tyre tha nëpër dhëmbë se kisha po toleronte Islam, prifti i tha: Biri im, myslimanin po e vrave, të vret; po e le pa bukë, të vjedh; po nuk i fole, çmendet. Më mirë një i çmendur se një mysliman.

Duke dalë, Vasili iu afrua priftit. Babai na la një tokë mua dhe vëllait. Ne e kemi punuar bashkë dhe familjet tona kanë ndarë të korrat përgjysmë. Si thua a duhet ta punoj tokën me Ibrahimin tani që ai është mysliman? Prifti ndaloi dhe u përgjigj: Babai juaj e kishte përfutur atë tokë si i krishterë. Ju e keni trashëguar si të bijtë e një të krishterë. Vëllai yt nuk është më i krishterë dhe ajo tokë është e jotja, sa kohë që ti nuk je mysliman.

4

Pleqësia u shpërnda menjëherë dhe prifti e la fshatin. Kjo është nata e tyre e fundit në paqe, mendoi. Çdo gjë do jetë ndryshe nesër. Mbi qytet hëna e re shtrihej si një kumbull mbi një kadife blu. Kur prifti hyri në shtëpi imami kishte filluar të këndonte majë xhamisë. Ishte dita e parë e ramazanit. Ibrahim nuk kishte fjetur gjithë natën duke pritur që Vasili të vinte për t'i treguar vendimin e pleqësisë së fshatit. Por i vëllai nuk u duk. Ulur në oborr vështronte hënën e re. Ishte shenja që lajmëronte ramazanin siç i kishte thënë imami. U ul në gjuhë dhe u fal, pastaj shkoi të flinte vetëm pranë vatrës. Kur u zgjua, e shoqja e pyeti se pse nuk kishte ardhur në shtrat dhe ai i tha se kishte filluar ramazani dhe gjatë këtij muaji myslimani nuk ha, nuk pi dhe nuk e prek gruan me dorë. I mjeri ti, i tha gruaja. Ku e gjete këtë fe që të ndalon gjërat që do më shumë në jetë?

Kur dielli u ngrit mbi çati, një zhurmë e madhe dërrasash dhe gozhdësh që nguleshin mbi to e nxori Ibrahimin me nxitim në oborr. Gjitori i tij, Mihali i Zoicës bashkë me të vëllanë dhe dy të tjerë kishin marrë disa dërrasa të mëdha dhe po ia vinin dritares. Mirëmëngjesi, i tha Ibrahim dhe u afrua. Asnjëri prej tyre nuk u përgjigj. Mirëmëngjesi, i tha ai prapë, ku i keni lënë veshët, or miq? Sërish as Mihali dhe as të tjerët nuk reagues. Ç'ju kam bërë, u çor Ibrahim, ju kam ngrënë bukën? Katër burrat vazhdonin punën. Ibrahim rrinte pa lëvizur dhe i shikonte. Pas pak dritarja e Mihalit ishte e mbyllur. Atë ditë, gjashtë dritare të fshatit që shikonin shtëpinë e Ibrahimit u zhdukën. Nga rruga e tij nuk kaloi askush.

Pasdite, Ibrahim, i lodhur nga agjërimi dhe i mërziur nga poshtërimi, doli të bëjë një shëtitje nëpër fshat. Kushdo që rastisi as e pa në sy dhe as i foli. Dy djem të vegjël që luanin cinglash sa e panë, hodhën shkopinjtë dhe hynë në shtëpi duke thirrur në panik: Nënë myslimani, erdhi myslimani. Dera u mbyll me forcë.

Kur u kthye në shtëpi, e shoqja po qante. Çfarë ke, pyeti ai. Shkova të marr kripë, nuk më dhanë. Kërkova miell për bukë, nuk më dhanë. Kërkova vaj, po ashtu. Ç'po ndodh me ne Ibrahim? Të folën, i tha ai. Më nxinë, jo më folën, rënkoj gruaja. Më thanë se nuk ka bukë dhe vaj për familjen e myslimanit. Renda te Hana, gruaja e tët vëllai dhe më nxori me duar bosh. Yt shoq na ka turpëruar, më tha. Për ju nuk ka ushqim në fshatin tonë. Asnjë vajzë nuk do t'i jepet djemve të tu. Tani toka i përket Vasilit sepse burri yt ka humbur të drejtën e trashëgimisë. Kur e pyeta se kush i ka vendosur gjithë këto, më tha se këtë vendim e ka marrë pleqësia dhe gjithë fshati e ka pranuar.

Ibrahimi mbylli derën e shtëpisë me shul dhe i kërkoi gruas një lugë sheqer. Ka dhe pak për nesër, i tha ajo duke i dhënë sheqerin. Është koha e iftarit dhe imami më tha se duhet të fus në gojë diçka të ëmbël, u justifikua ai. Lëpiu buzët dhe u ul për t'u falur në sy të gruas që e shikonte me dhimbje.

Atë natë i vunë fëmijët për të fjetur më herët dhe secili u shtri në dhomën e vet. Kur u zgjua në mes të natës për t'u bërë gati për syfyrin, ndjeu në hundë erën e diçkaje që digjej. Vatra ishte e pandezur dhe ai hapi portën e shtëpisë. Disa metra jashtë oborrit, në mes të rrugës, digjej një kryq i madh i ngulur vertikalisht në tokë. Ibrahim i frikësua se mos zjarri i merrte drutë që kishte në cep të oborrit dhe u afrua. Katër burra që ishin fshehur pas zjarrit ia dhanë vrapit. Kur u larguan, në një distancë që ai nuk mund t'i shquante, njëri prej tyre ndaloi dhe i thirri: *Ibrahim, o derr, Muhamedi të pret në ferr*. Tre të tjerët e përsëritën si refren disa herë dhe të gjithë bashkë u zhdukën, pas një muri. Ibrahim i u avit kryqit, që kërcente pa ritëm mbi kokën e tij. Mendoj ta shkulte nga toka dhe ta shuante zjarrin, por e tërhoqi dorën dhe nuk e preku. Tymi ngrihej lart dhe pas pak e mbuloi hënën si një perçe gri. Kryqi u dogj i patrazuar deri në mesditë. Kur u zgjuan, djemtë filluan të loznin rreth kryqit. Ibrahim i ndiqte rrotullimet e tyre dhe mendonte me vete se jeta e njeriut duhet të ishte si kjo lojë kalamajsh. I vjen rrotull kryqit gjithë jetës që të mos digjesh në zjarr.

Kur djemtë u futën në shtëpi e pyetën Ibrahim se kush e kishte ngulur kryqin e djegur para shtëpisë së tyre. Fshati, u përgjigj Ibrahim. Djemtë panë njëri-tjetrin të hutuar. Ishte përgjigjja që prisnin më pak. E ka ngulur fshati që të ruhet nga rrufetë e Zotit, shtoi i ati.

Për një javë Ibrahim nuk doli nga shtëpia. Falej në orët e caktuara, nuk hante, nuk pinte, merrej me kafshët e veta dhe kalonte kohën duke biseduar me djemtë. E shoqja shkoi dhe një herë tek e kunata, por ajo sërish e nxori me duar bosh. Fshati i mbeti besnik vendimit të pleqësisë. Askush nuk kaloi përpara shtëpisë së Ibrahimit. Në kohën që Ibrahim falej, kambana e kishës së vogël gjëmonte pa pushim. Çdo natë, katër burrat shfaqeshin përpara shtëpisë, ngulnin një kryq të ri që shkëlqente në errësirë dhe pastaj i vinin flakën. Pas një jave, rruga përpara shtëpisë dukej si varrezë me kryqe të rrëzuar. Ushqimet e tyre pothuajse kishin mbaruar. Gruaja i dha djemve kos dhie dhe mollë të pjekura nga të shtëpisë dhe filloi të qante. Do iki në qytet, tha Ibrahim. Do gjej diçka për të ngrënë. Kthehem në darkë. Thirri djemtë dhe i porositi se pa ardhur ai askush nuk duhej të dilte nga shtëpia. Do vij me ty, i tha djali i madh. Jo, i tha Ibrahim. Sa kohë nuk jam unë, ti je i zoti i shtëpisë, por mos e kalo derën e oborrit pa u kthyer unë. Po nëse ti nuk kthehesh, e pyeti i biri. Ibrahim bëri sikur nuk e dëgjoi dhe u nis.

Kur hyri në qytet, dielli po perëndonte. Frymën e mbajti te xhamia. Imamin e gjeti të ulur mbi rrogoz me një tas hurma përpara. Selam Alekum, Ibrahim. Bujrum në iftarin tim. Ibrahim u ul mori një hurmë dhe goja e tharë nga rruga iu ndez më keq. Fëmijët e mi janë pa bukë, i tha Ibrahim dhe i tregoi javën e tij të tmerrshme. Jam gati të vras për të shuar urinë e tyre. Imami e dëgjoi deri në fund dhe kur mbaroi i tha: Zoti po të vë në provë. Të ka lënë pa bukë, pa miq dhe

pa vëlla që të kuptojë se sa mund të sakrifkosh për të fituar dashurinë e tij të mëshirshme. Muhamedi vuajti 20 vjet, më keq se ti, që të fitonte emrin që i njohim sot. Mbaje ramazanin deri në fund që të pastrosh shpirtin tënd nga urrejtja dhe mëkati. Mos harro se gjatë këtij muaji të shenjtë nuk duhet të mallkosh dhe as të vrasësh njeri. Zoti ka gjithmonë bukë për robtë e tij. Imami u ngrit, shkoi në cep të xhamisë dhe i mbushi një torbë me miell, sheqer, vaj, kripë dhe ullinj. Merri dhe këto hurma që aq shumë i pëlqenin profetit dhe çoja fëmijëve të ëmbëlsohen. Po si mund të vazhdoj kështu, i tha Ibrahim. Këto ushqime nuk zgjasin më shumë se disa ditë dhe djemtë do të m'i marrë prapë uria. Duro, i tha imami. Kur t'i mbarosh këto, Zoti do të të dërgojë një shenjë. Nisu tani se vajti vonë dhe të presin.

Ibrahimi u përshëndet me imamin dhe doli nga xhamia. Pas pak u errësua. Dielli perëndoi dhe u fut në torbën e tij të mbushur. Rrugën e bëri thuajse me vrap.

Në mesnatë, arriti në fshat i rraskapitur, por i çliruar. Një turmë me burra dhe gra ulërinin përpara shtëpisë. Sapo panë Ibrahimin u bënë si të tërbuar. Gratë filluan ta shanin, burrat e shtynë dhe e goditën. Ibrahim nuk ktheu dorë, por shtrëngoi torbën fort dhe eci drejt shtëpisë. Nuk po kuptonte gjë, por mendonte për djemtë dhe për gruan. Duke ecur mes grushteve të burrave dhe mallkimeve të grave i doli përpara i vëllai, Vasili. Edhe ti Vasil, e pyeti Ibrahim. Unë po i mbaj, u përgjigj i vëllai duke mos e parë në sy. Do ishte bërë hataja. Yt bir është çmendur. Thuaji të lirojë Mihalit se ka gjithë natën që e mban brenda dhe thotë se do ta vrasë. Ibrahim nuk donte të dëgjonte më dhe u sul drejt shtëpisë. Gruaja e kishte parë dhe i hapi derën. Pa e lënë të fliste, i tregoi me zë të fikur ç'kishte ndodhur. Katër burrat kishin ardhur në mes të natës për të djegur kryqin. Atë natë, ata duket se kishin pirë sepse qeshnin dhe shanin me të madhe dhe duke bërë shenja në drejtim të shtëpisë këndonin me sa kishin në kokë: *Ibrahim, o qafir, do të zhdukim me pahir, mysliman nga taksirati, nuk ka vend për ty fshati, Muhamedi është synet, Ibrahim është lanet*. Kur kryqi filloi të digjej deri në majë, burrat u larguan si përherë dhe unë u shtriva të fle, tha gruaja. Pas pak, dëgjova të bërtitura në oborr dhe kur dola pushë tët bir, që mbante për zverku njërin nga burrat dhe e tërhoqte për nga shtëpia. Duhet të ketë dalë nga dritarja dhe i është vënë pas nëpër fshat derisa e ka zënë, shtoi ajo. Ku është futur, e pyeti Ibrahim. Në qilar i ke të dy, bëri me kokë ajo.

Kur Ibrahim hyri në qilar, i biri me një thikë në dorë ishte ulur në shesh. Në fund të qilarit, në errësirë, Mihali i Zoicës ishte i lidhur si bagëti nga këmbët. Gomar, i thirri të birit, të thashë të mos dilje nga shtëpia pa ardhur unë. Djali u ngrit në këmbë dhe faqja e njomë iu djersit. I ati e kishte fyer në sy të presë së tij dhe kjo e kishte zhburrëuar. Ibrahim e kuptoi dhe iu drejtua Mihalit. Ç'pate me familjen time, o bukëshkalë? Më liro, iu lut Mihali. Për atë Zot nuk kam më punë me ty. Edhe dritaren që zura me dru do ta hap, le të thotë ç'të dojë pleqësia. Mos e beso baba, i foli i biri nga prapa. Po e lirove, ata do të vijnë prapë nesër të djegin kryqin dhe do të të shajnë ty. Ky të ka sharë qafir në mes të fshatit. Unë nuk duroj dot të më thonë djalë qafiri. Po e lirove ti, unë do ta vras nesër, siç na kanë vrarë këta.

Ibrahimi u ftoh. Kur kishte ikur, djali ishte një kalama, ndërsa tani ai kishte përpara një burrë, i cili i vinte kushte. Ma jep thikën, i tha të birit. I biri rezistoi një çast dhe pastaj, duke e parë në sy të atin, i tha: Po e lirove fshati do mendojë se jemi frikësuar. Ma lër ta ruaj unë këtë kërmë dhe shko të bisedosh me pleqësinë. Në qoftë se ata duan që të na ngordhin për bukë le të vdesë ky para nesh. Ibrahim nuk i besonte veshëve. Nga jashtë të thirrurat e turmës po shtoheshin dhe ai nuk kishte kohë të arsyetonte nëse pjekuria e të birit ishte fryt i moshës apo i urisë së ditëve të fundit. Pemët piqen duke u ushqyer, mendoj, njerëzit piqen nga uria. Më jep thikën dhe shko lart, i thirri. Djali i zgjati thikën. Merre, i tha, kryqe dhe thika gjen sa të duash në fshat. Ibrahim iu afrua Mihalit dhe ia liroi pak litarët. Sonte do flesh këtu, i tha. Liria jote nuk varet më nga unë.

Mos luaj me zjarrin dhe më lër të shkoj në shtëpi, u përpoq ta bindte Mihali. Ka kohë për të ikur, iu përgjigj Ibrahimimi që shoi qiririn dhe e la tjetrin në errësi.

Doli në oborr dhe të bërtiturat e njerëzve që e prisnin pushuan për një çast, por kur e panë vetëm, familjarët e Mihalit nuk u përmbajtën dot. Ibrahimimi ngriti dorën, për t'i lënë të kuptonin se kishte për të thënë diçka, dhe ata pushuan. Mihali do të rrijë në shtëpinë time. Dua të flas me pleqësinë dhe ta zgjidhim gjithçka në paqe, si vëllezër të një fshati.

Turmën e përshkoi një mërmërimë, por askush nuk e sulmoi Ibrahimimin. Qetësia e tij i kishte ngurtësuar të gjithë. Çfarë do nga pleqësia, pyeti dikush nga turma. Unë nuk ika nga fshati dhe djemtë e mi meritojnë të hanë dhe të martohen aty ku kanë lindur. Iknë në shtëpi dhe mos kini merak. Mihalit nuk e gjen gjë në shtëpinë time, por jeta e tij varet nga ju, më shumë se nga unë. Pleqësia të ndryshojë vendimin dhe ne mbetemi gjithnjë siç ishim më parë.

Kaq tha Ibrahimimi dhe u drejtua nga shtëpia. Turma mbeti jashtë si e ngrirë. Myslimani po i vinte kushte fshatit dhe kjo ishte një situatë që askush nuk mund ta përtypte. Vëllai i Mihalit nuk e mbajti dot zemërimin dhe thirri: *Ibrahim, o derr, me dorën time do të ther.* Por të tjerët iu hodhën, e kapën nga krahët dhe e detyruan të pushojë. Mendo për të vëllat, i thanë. Ik qetësohu sonte, nesër mblidhemi në pleqësi. Turma u shpërnda në errësi dhe atë natë fshati nuk fjeti duke menduar për të nesërmen.

Pleqësia u mblodh në mëngjes. Burrat dukeshin të dërrmuar. Plani i tyre nuk kishte ecur. Vëllai i Mihalit i kishte sytë e kuq. Ai u thërriste të gjithëve dhe kundërshtonte çdo propozim që i dukej se e vononte lirin e Mihalit. Të shkojmë tani, ta nxjerrim me forcë. Ibrahimimi dhe kalamajtë e tij nuk mund t'i bëjnë ballë njëzet burrave të armatosur. Burrat dukeshin të heshtur. Frikacakë, i kthehej ai. Im vëllat e ka kokën nën thikë, ju turrni lesh këtu. Menduat se do ta qeronit Ibrahimimin duke e lënë pa bukë dhe pa kripë. Por ai shkoi në qytet dhe myslihanët e tjerë ia mbushën torbën. Por derri nuk zbutet nga uria. Kur ju gërhisnit çdo natë, unë dhe im vëllat shkonim dhe e kërcënonim me zjarr. Ibrahimimi do dorëzohej po të mos e zinte ai kalama Mihalit në mes të natës. i zuri pusi, njëllaj si xhaxhai i të atit atëherë. E priti te dera e shtëpisë dhe i vuri thikën në fyt. Do ta vras atë bir bushtre. Vasili, që deri atë kohë nuk e kishte hapur gojën, nuk duroi dhe kërcëu nga vendi. Mos i hap plagët e vjetra se nuk ndahemi mirë, iu hakërrye ai. Të dy burrat u shanë dhe desh nxorën thikat, për të tjerët ndërhyne për t'i ndarë.

Kryetari i pleqësisë u çua në këmbë dhe mjekra e tij e moçme i bëri të gjithë të heshtin. Ti dhe Mihali nuk keni respektuar vendimin e pleqësisë, tha ai. Ne nuk ju thamë që të digjnit kryqe në oborrin e Ibrahimimit. Tani, ai ta ka marrë vëllanë dhe ti na kërkon ne ta lirojmë sepse e di që vetë nuk ia del dot. Por, edhe sikur t'ia dalësh, ne nuk do të lëmë sepse në fund të këtij shërrri ka gjak. Nuk duhet të derdhim gjak në fshat sepse hasmëria do të zgjerohet si rrathët e ujit dhe pastaj fshati do të priset. Vasil, shko fol me të vëllat dhe na thuaj çfarë kërkon që të lirojmë Mihalit që fshati të qetësohet. Çfarë t'i pretoj, pyeti Vasili. Thuaji se do t'ia falim rrëmbimin e Mihalit. Ai është i lirë të lëvizë nëpër fshat dhe askush nuk do ta prekë me dorë atë dhe familjen e tij. Po bukë, tha Vasili. Ai do kërkohet që fshati t'i shesë bukë si më parë. Nuk kemi bukë të tepërt, u hodhën burrat, por ai mund të shkojë sa herë të dojë në qytet të mbushë torbën e tij dhe ne nuk do ta pengojmë. Po nëse nuk pranon? Nëse nuk e dorëzon Mihalit deri nesër, shtëpia e tij do rrethohet dhe as miza nuk do të hyjë më në atë xhami. Ai nuk do lejohet të shkojë në qytet për ushqim dhe bagëti e tij do ngordhin se ne nuk do t'i lëmë të kullotin. Po qe se nuk pranon, rrethimi fillon nesër në mëngjes dhe ai do dorëzohet që të mos vdesë urie.

Vetëm kaq, pyeti Vasili që nuk dukej i bindur. Premtoji edhe tokën që i ke marrë, tha kryetari i vendosur. Vasili donte të thoshte diçka, por ata nuk e lanë dhe ai u nis. Jashtë kishte zënë shi. Kur hyri në oborr, thirri të vëllanë. Ibrahimimi hapi derën dhe e ftoi brenda. Je lagur, Vasil, tha ai

dhe i kërkoi të shoqes një peshqir. Vasili e mori, fshiu kokën dhe filloi të fliste. Duhet ta liroshe Mihalin, ndryshe ata do të të rrethojnë shtëpinë derisa të dorëzohesh nga uria. Po dole, do të të rrëmbejnë dhe do të të lidhin ty dhe fëmijët. Bagëtinë nuk do ta lënë të kullosë. Duhet ta liroshe deri sot natën. Kaq, pyeti Ibrahim qe rrinte me kokën ulur, ndërsa e shoqja i solli të dyve nga një kafe. Nëse liron Mihalin, pleqësia do të lejojë të lëvizësh nëpër fshat dhe të shkosh në qytet sa herë të duash. Askush nuk ka punë me ty dhe djemtë e tu dhe kurrkush nuk do të djegë më kryqe natën. Nuk mjafton, tha Ibrahim. Ky fshat nuk do gjejë qetësi në qoftë se çdo gjë nuk kthehet si më parë. Im bir, i madhi është rritur për një ditë. Ai nuk harron fyerjen që na kanë bërë dhe unë kam frikë se ai do vrasë këdo që nuk i jep bukë dhe nuk i flet të atit. Në qoftë se ai vret do ta vrasin, tha Vasili. Në qoftë se ata vrasin dhe unë do të vras. Edhe ty do të të vrasin Ibrahim, i tha i vëllai. Po ti Vasil, iu kthye Ibrahim me inat. Do shohësh se si unë dhe djemtë e mi themi si kafshë pa i bërë keq askujt? Unë nuk kam vjedhur dhe nuk kam vvarë, dhe nuk i kërkoi gjë njeriu. Dua të jetoj si gjithë të tjerët. Po ti je mysliman, i tha Vasili dhe kjo i frikëson të gjithë. Prifti thotë se nëse ne lejojmë që djemtë e tu të martohen me vajzat tona, atëherë fara jote do ta kthejë siç ishe më parë, i krishterë? Të gjithë do të ta falin dhe çdo gjë do të kthehet si më parë. Mendohu, i tha Vasili dhe i vuri dorën mbi sup.

E shoqja, që e ndiqte bisedën pa folur, lëvizi për herë të parë dhe Ibrahimit iu duk sikur ajo po e miratonte Vasilin. Ai e pa ashpër në sy dhe ajo nuk e hapi gojën. Gjërat kanë shkuar larg, Vasil. Unë nuk jam më ai që isha dhe fshati nuk është më i pari. Kam një muaj që unë i lutem Zotit tim të ri. Nëse unë kthehem i krishterë siç isha as Zoti i parë që e tradhtova dhe as i dyti që ti më kërkon ta tradhtoj nuk do jenë më me mua. Fshati do të tallet njëllor dhe unë nuk mund t'u lë këtë turp djemve të mi. I thuaj fshatit që Mihali do të lirohet vetëm nëse vendimi i pleqësisë ndryshon. Kush nuk do të më flasë le mos më flasë, por pleqësia nuk duhet të detyrojë askënd të mos më thotë mirëmëngjes. Djemtë e mi do të martohen në fshat aty ku një ditë bashkë me fëmijët e tyre do nderojnë varrin tim. Unë kam lindur shqiptar dhe jo mysliman. Dua që fshati të më respektojë siç kam lindur dhe jo si do vdes.

Vasili dukej i përbotur. Ata nuk do pranohet, tha ai. Mos i bjer murit me kokë, Ibrahim. Do të të kthejë edhe tokën që na la babai. Mos m'u lut, i tha prerë Ibrahim. Thuaj këto që të thashë, përndryshe Mihali do të vdesë këtu bashkë me ne të tjerët. Sa për tokën, nuk po të them faleminderit sepse më ke kthyer atë që e kam pasur. Edhe kur të vdes toka nuk do të jetë e jotja.

Vasili u ngrit të dilte, ndërsa e shoqja kishte mbuluar sytë me duar. Djali i madh, që kishte dëgjuar të gjithë bisedën mes vëllezërve, hyri në dhomë dhe i përqafoi këmbët Ibrahimit.

Pleqësia e priti Vasilin e mbledhur. Nuk pranon, tha ai sa u duk te dera. Ç'të tha, e pyetën burrat. Do që çdo gjë të kthehet siç ishte. Ai ju jep mish dhe fshati duhet t'i japë bukë. Kush do t'i flasë le t'i flasë, por pleqësia nuk duhet të detyrojë askënd që të mos e përshëndesë rrugës. Kërkon po ashtu që mos ndalojmë vajzat të martohen me djemtë e tij. Përndryshe, më tha që Mihali do të vdesë bashkë me të, sepse ai nuk dorëzohet. Burrat rënduan më shumë mbi jastëkët ku ishin ulur. Ata e ndienin se vendimi i tyre tani do të ishte edhe më i rëndë për fshatin.

Nuk kemi rrugë tjetër, tha kryetari duke u ngritur dorën sikur po shpallte luftë. Ibrahim zgjodhi më të keqen. Bëhuni gati për rrethimin. Asnjëri të mos hyjë me forcë në shtëpinë e tij. Nëse Ibrahim apo dikush del nga shtëpia do ta marrim dhe do ta lidhim derisa të lirohet Mihali. Bagëtinë po ashtu.

Burrat nuk pritën të nesërmen, por e rrethuan shtëpinë e Ibrahimit që në mbrëmje. Shiu nuk kish pushuar gjithë ditën dhe ata kërkuan velenxa të mëdha nën të cilat u shtrinë gjatë natës. gratë u



çonin për të ngrënë dhe burrat pinin raki që të duronin lagështinë që i kishte mbërthyer gjymtyrët. Shiu vazhdoi pa pushim.

Të nesërmen në mëngjes burrat dukeshin të lodhur, por të vendosur ta vazhdonin rrethimin. Ibrahim i shikonte nga brenda shtëpisë. I shikonte ashtu të shtrirë në shi dhe mendonte se si i kishte ndryshuar jeta, pasi hyri në Islam. Njerëz me të cilët familja e tij kishte jetuar për qindra vjet, duke ndarë lindje dhe varrime, tani torturoheshin në shi, duke uruar që ai të vdiste sa më shpejt për t'i lënë rehat të ktheheshin në shtëpitë e tyre të ngrohta.

Ditën e tretë të rrethimit shumë nga burrat filluan të kolliteshin dhe të teshtinin. Ibrahim shikonte gratë që vinin dhe i sillnin burrave kupa të nxehura me raki që ata i përpinin për të ngrohur barqet e plevitosura. Shumica ishin ftohur e megjithatë asnjeri nuk e kishte lënë rrethimin.

Ditën e gjashtë shiu vazhdonte. Burrat kishin ndërtuar një tendë me kashtë dhe ishin futur poshtë saj për t'u mbrojtur nga uji që derdhej nga qielli me ibrik. Tenda ishte e vogël dhe nuk i nxinte të gjithë burrat. Ata kishin vendosur ta bënin rrethimin me turne. Kur disa shtriheshin nën tendë, të tjerët i vinin rrotull shtëpisë duke parë me inat nga dritaret e Ibrahimit. Natën ndiznin zjarr, mbi të cilin piqnin gështenja që i pinin me raki. Një natë, Ibrahim hapi derën e shtëpisë dhe burrat brofën në këmbë të alarmuar. Po del, thirrën ata. Kujdes ta kapim. U vunë në pozicion sulmi dhe pritën gjahun. Pas pak një domate kërceu në errësirë dhe u zgërlaq në këmbët e njërit prej burrave. I zënë në befasi, burri u tremb dhe ra përmbys mbi purenë e kuqe të domates. Ibrahim me të birin filluan të qeshin nga brenda. Le të mendojmë se kemi ushqim më shumë se ç'kanë ata durim, i tha Ibrahim të birit që rritej çdo ditë. Po tallet me ne myslimani, thanë burrat dhe filluan të këndojnë për të nxjerrë dufin dhe të ftohtin: *Ibrahim, o lamash, sot ti qesh, nesër do qash. Ibrahim ha domate, je i skuqur me mëkate.*

5

Ditën e dhjetë të rrethimit Ibrahim ra më herët për të fjetur. Ishte dita e fundit e ramazanit dhe ushqimet pothuajse kishin mbaruar. Edhe sikur të mos agjëroja për ramazan përsëri nuk do të kisha ngrënë këtë muaj, mendoi ai para se ta zinte gjumi.

Nga mesi i natës i biri e tundi fort. Ngrihu, i tha, se ç'po ndodh aty jashtë. U afruan të dy te dritarja dhe panë burat që po flisnin me një djalë të ri të armatosur, i cili tundte një kërbaç. Pas tij, dhjetëra burra të hipur në kuaj kishin mbushur rrugën përpara shtëpisë. Zjarret nuk ishin shuar ende dhe djaloshit i dukeshin flokët e verdhë.

Kush është ky, e pyeti i biri. Është Ali Tepelena, tha Ibrahim. Megjithëse binte shi, Aliu rrinte serbes majë kalit. Burrat e pleqësisë e kishin rrethuar dhe duke i bërë shenja me duar nga shtëpia e Ibrahimit diçka mundoheshin t'i shpjegonin. Pa i dëgjuar, Aliu i grahu kalit dhe hyri në oborr. Shokët e tij, në fillim i shtynë, pastaj i goditën burrat, të cilët pa kundërshtuar vrapuan dhe humbën në errësirën e fshatit.

Ibrahim hapi derën dhe doli përpara. Mirë se erdhe në shtëpinë time Ali Tepelena. Pa ia kthyer përshëndetjen Aliu i tha; Ç'donin këta burra nga ty? Duan të më zbojnë nga fshati. Kanë dhjetë ditë që më kanë rrethuar. As më flasin dhe as më japin bukë. E ka vendosur pleqësia.

Ke vrarë njërin prej tyre, pyeti Aliu. Jo, jo, i tha Ibrahim duke e ftuar brenda. Jam bërë mysliman. Aliu u drejtua dhe e pa në sy. Nuk e meriton ky fshat këtë nder, tha. Kush të detyroi? Askush, tha Ibrahim. Bashkë me dimrin po vjen Islami, kjo dihet. Për t'u mbrojtur nga dimri kam dru. Por për t'u mbrojtur nga Islami pyeta imamin. Pranova kushtet e tij dhe u bëra mysliman. Ibrahim u habit dhe vetë nga shpjegimi që i bëri Ali Tepelenës. Gjatë ramazanit ai

ishite menduar shumë të kuptonte se çfarë e kishte shtyrë të shkonte në Islam. Herë pas here mendonte se ditën që ishte bërë mysliman shpirti i tij i rrumbullakët ishte palosur në dysh dhe kishte marrë formën e një gjysmëhëne, që tani varej e paushqyer brenda kafazit të brinjëve të tij. Të kërkoji para imami kur hyre në Islam? Ibrahimimi u habit nga pyetje e Ali Tepelenës. Jo, i tha. Po ti i dhe para imamit? As unë nuk i dhashë. Ai më dha një tas me hurma për kalamajtë. Pse më pyet, Ali? Duhet të kisha paguar para që të hyja në Islam? Nuk ma tha njeri.

Aliu filloi të qeshte. Islami nuk është cirk jevgjitësh, tha ai. Nuk ka nevojë të paguash për të hyrë atje. Kam dëgjuar se imamët u marrin para shqiptarëve që t'i pranojnë në Islam, ndaj të pyeta. Të dy burrat ishin ulur dhe dukeshin më të shpenguar. Ibrahimimi e shikonte. Aliu ishte ulur mbi fustanellë, kindat e së cilës ishin nxirë nga balta. Hoqi shapkën e kuqe që mbante në kokë dhe flokët e lagur iu derdhën mbi jelek. Kur shtriu këmbët, Ibrahimimi pa që mbi kundrat e tij të zeza shkëlqente një kopsë argjendi. I paskan vajtur mbarë kusaritë, mendoi.

Jashtë, në oborr, kuajt dhe shokët e Aliut lageshin në shi. Sonte do të rri këtu, i tha Aliu. Kuajt janë të lodhur. Hoqi jelekun dhe u mbështet pas murit. Këmisha e lagur i ishte ngjitur pas trupit. Ashtu i zhveshur dukej si një fëmijë. Ibrahimimi e shikonte dhe rrinte gojëkyçur. Kam ditë që nuk flas me njeri, i tha si për t'u shfajësuar. Burrat e fshatit nuk më flasin dhe po të rrija dhe ca vetëm, do harroja të bëja muhabet. Ata më thanë se ti ke marrë peng një të krishterë dhe nuk e dorëzon, tha Aliu. Ibrahimimi u skuq dhe filloi të tregonte. Kur e morën vesh se isha bërë mysliman u tërbuan. Pleqësia vendosi që fshati mos më jepte më bukë dhe ushqim. Unë shes mish, por ata nuk e pranojnë më mishin e kafshëve të mia. Kur mbeta pa gjë, shkova në qytet dhe mora ushqim tek imami. Natën që u ktheva në shtëpi im bir nuk i kishte duruar sharjet e tyre, e kishte zënë për gryke njërin, që e kemi dhe gjiton, dhe ata vendosën të më rrethojnë derisa ta liroj. Ka dhjetë ditë që flenë jashtë shtëpisë dhe presin që të dorëzohem kur të më mbarojnë ushqimet. Ke më ushqime, pyeti Aliu. Shumë pak miell për bukë ka mbetur. Nuk kam marrë dot as qumësht nga delet e mia, se po të dilja do më kishin qëlluar. Pse nuk e liron të krishterin? Nuk e liron nëse pleqësia nuk nderon vendimin që kam marrë. Je bërë pishman? Përse, pyeti Ibrahimimi. Që u bërë mysliman. Ibrahimimi u mendua pak. Akoma, tha. Por më duket se fshatin e kam humbur. Asgjë nuk do jetë më siç ka qenë edhe nëse pleqësia e ndryshon vendimin. Nuk je i pari dhe nuk do jesh i fundit, kërkoji ta qetësonte Aliu. Shumë shqiptarë po bëhen myslimanë. Mua më duket se shqiptarët tani e kanë kuptuar se ata nuk mund të jenë në një shtet me grekët dhe që të ndajnë shtetin duhet në fillim të ndajnë fenë dhe pastaj tokat dhe pasuritë. Aliu, i mbështetur pas murit, dukej sikur fliste me vete. Megjithatë, ne shqiptarët duhet të dimë të zgjedhim. Jo çdo lloj islami i shkon shqiptarëve. Ne nuk jemi as turq dhe as arabë, prandaj duhet të gjejmë islamin që na rëndon më pak dhe na kënaq më shumë. Mushka dhe kali janë nga një familje. Por mushka ngarkohet me dru, ndërsa kali ngarkohet me njerëz. Ibrahimimi e shikonte dhe dukej gjithmonë e më i hutuar.

Ç'të tha imami për Islamin? Më tha se që të jem mysliman duhet të falem pesë herë në ditë, të mbaj ramazan, të jap zekat dhe të shkoj në Mekë. Jam falur çdo ditë dhe kam agjëruar. Kafshët nuk duhet të mbajnë ramazan, më tha imami. Mushka dhe kali nuk kanë detyrime përballë Islamit. Të pyeta nëse imami të rrëfeu për historinë e Islamit, u nxeh Aliu. Ibrahimimi mblodhi supet dhe Ali Tepelena vazhdoi:

Islami ka 12 degë që quhen tarikate. Dega më e madhe është ajo e sunitëve. Por mes tyre më e veçanta është dega e bektashinjve. Islam, vërtet do të thotë paqe, por myslimanët nuk e kanë zbatuar kurrë një lloj Islamit dhe për këtë shkak mes tyre nuk ka pasur kurrë paqe. Bektashizmi ka lindur si një degë e jeniçerëve myslimanë. Më shumë se njëqind vjet përpara pushtimit të Kostandinopojës, që është vepër e jeniçerëve, Sulltan Orhani themeloi urdhrin e jeniçerëve. Këta

u betuan se do ishin besnikë deri në vdekje ndaj sulltanit dhe u bekuan nga Haxhi Bektashi, i cili në atë kohë ishte një nga krerët e Islamit. Që nga ajo kohë bektashizmi ka lindur dhe ka udhëtuar nëpër botë bashkë me jeniçerët, të cilët e kanë mbrojtur dhe e kanë ushqyer këtë tarikat. Jeniçerët nuk ishin të gjithë djem të lindur myslimanë. Shumica e tyre ishin fëmijë që turqit ia rrëmbenin familjeve të krishtera ruse, greke, armene apo dhe çifute. Por shumë prej tyre ishin shqiptarë. Ti e di që turqit na quajnë arnaut? A e di ç' do të thotë arnaut? Arnaut, osmanët quanin dikë që nuk di të kthehet prapa. Meqë radhët e jeniçerëve ishin të mbushur me shqiptarë të paepur, të cilët nuk ktheheshin të gjallë pa fitore, ata u quajtën arnautë. Siç të thashë, këta djem edukoheshin për t'u vrarë dhe prandaj trajtimi që u bëhej atyre ishte i ndryshëm. Ata toleroheshin më shumë dhe kishin më tepër liri se gjithë ushtarët e tjerë. Por këta djem kishin nevojë për një besim të ri. Plaçka e luftës dhe besnikëria ndaj Sulltanit nuk u mjaftonte më atyre. Haxhi Bektashi e kuptoi këtë dhe mënyra se si ai e lexonte Islamin u kthye në frymëzim për jeniçerët. Ata mendonin se ishin të ndryshëm në gjithçka në krahasim me njerëzit e tjerë dhe feja e tyre e re e shprehte këtë ndryshim. Kur Haxhi Bektashi iu kaloi atyre bekimin, ai ishte 80 vjeç. Jeniçerët besonin se ai rridhte nga Fatimja, që ishte vajza e Muhamedit dhe kjo i dha më shumë forcë bektashizmit. Kudo ku shkonin jeniçerët merrnin me vete edhe dervishët bektashinj. Në pushimet mes betejave ata ndërtonin teqe. Teqetë e bektashinjve janë gjithnjë 6 orë larg njëra-tjetrës në mënyrë që në fund të çdo rruge udhëtari të çlodhej në një vend që e mban gjithmonë derën hapur. Bektashinjët janë të butë dhe mikpritës. Turqit e sotëm janë të egër dhe mizorë. Ata janë sunitë dhe nuk i pranojnë bektashinjët. Por frika që kanë në Stamboll nga jeniçerët i ka detyruar të heshtin dhe të mos i sikterisin dervishët. Jam i bindur se bektashizmi është myslimanizmi që i shkon më shumë shqiptarëve dhe sidomos atyre që kanë qenë të krishterë. Bektashinjët mund të pinë dhe gratë e tyre mund të dalin zbuluar përpara burrave. Ata besojnë se Jezu Krishti ka qenë i pari që ka predikuar Islamin, dhe, po të mos ishin jeniçerët vetëm për këtë mendim ata do të ishin shkuar të gjithë në hell. Turqit e quajnë bektashizmin si një islam i krishterë dhe prandaj e luftojnë. Skënderbeu ka qenë bektashi dhe prandaj u bë aq kollaj i krishterë për së dyti, megjithëse kishte jetuar shumë vjet si mysliman. Nastradini që tregon histori për të qeshur nga Persia, po ashtu. I pari që e solli bektashizmin ndër shqiptarë ishte Demir Hani. Ky ishte dervish dhe ngrit në Tepelenë teqenë e parë përpara njëqind e kusur vjetësh. Bëri shumë të mira: ndihmoi jetimët, shpërndau para, shëroi njerëz dhe qindra shqiptarë i ktheu në myslimanë. Njerëzit besonin se ai ishte njeri i shenjtë dhe tregonin se e kishin parë që shëronte të sëmurët vetëm duke i prekur. Demir Hani grumbulloi dhe shumë pasuri nga dhuratat që i vinin prej shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë që ai ndihmonte. Pasuria e tij u bë aq e madhe, sa që një dervish tjetër, njeriu që Demir Hani i besonte më shumë, u bë lakmitar dhe mendoi t'i zinte vendin. Ai hapi fjalë se Demir Hani ngacmonte gratë dhe fëmijët dhe se natën merrte djem të rinj ën dyshekët e tij. Me një ferman të Sulltanit Demir Hani u dënua me vdekje. Sulltani ngarkoi dervishin që e spiunoi t'i priste atij kokën dhe ky zbatoi fermanin. Ky dervish ishte vëllai i stërgjyshit tim, Hysenit. Më vonë edhe vëllanë e Hysenit e vranë, por që nga ajo kohë ne trashëguam pak pasuri dhe emër në Tepelenë.

Aliu pushoi pak dhe kontrolloi këmishën me duar. Më është tharë, tha dhe vazhdoi.

Ne shqiptarët nuk besojmë sa duhet, sepse mendojmë më shumë për sot se për nesër. Ne i duam gjërat sot dhe na duket pa kuptim që të falemi gjithë jetën për t'u shpërblyer kur të vdesim. Një fe që të lodh ne e braktisim. Zoti na ka lënë mes grekëve dhe turqve. Këta i vodhën fenë të tjerëve. Grekët ia morën çifutëve dhe turqit ia morën arabëve. Pastaj të dy ngritën perandori për të sunduar popujt e tjerë. Grekët e mbajtën Bizantin një mijë vjet dhe pushtuan turqit, shqiptarët dhe arabët. Tani turqit kanë gati 500 vjet që me perandorinë e tyre po qeverisin grekët, arabët

dhe ne shqiptarët. Shumë shqiptarë bëhen myslimanë se nuk duan të kenë fenë e grekëve. Por ata nuk pranojnë kur grekët u thonë se duke u bërë myslimanë në të vërtetë janë bërë turq. Dhe kanë të drejtë. Shqiptarët nuk e njohin mirë Islamin. Islami është një pjatë ku mund zgjedhësh. Unë kam zgjedhur bektashizmin. Jam shqiptar dhe nuk jam grek. Jam bektashi dhe nuk jam turk. Imami nuk t'i ka thënë gjithë këto, sepse ai nuk i pranon bektashinjtë. Por duke mos të treguar të vërtetën mbi Islamin ai nuk të ka dhënë mundësi të zgjedhësh atë që do. Pa e kuptuar ti ke bërë zgjedhjen që ka dashur imami. Të dha një emër? Si quhesh tani? Ibrahim, u përgjigj ai. E zgjedhe ti apo ta dha ai? Ma dha imami. Do ta mbash? Ibrahim nuk dinte ç'të thoshte. Mbaje, iu përgjigj Aliu. Nuk të beson njeri po të ndërrosh emrin tri herë në muaj.

Të dy mbetën gjatë duke u menduar. Nuk kishin gjumë. Para se të flinin Aliu e pyeti se çfarë do të bënte me të krishterin. Kur të iki unë, i tha, ata do ta rrethojnë prapë shtëpinë po nuk e lirove. Nuk e liroj nëse fshati nuk ndryshon vendimin, iu përgjigj Ibrahim. Mirë, i tha Aliu, nesër njofto pleqësinë. Do shkoj vetë t'i takoj.

Kur u zgjua të nesërmen dhe hyri në dhomën e oxhakut, Ibrahim gjeti aty të birin dhe Aliun. Ky ishte gjysmë i zhveshur dhe kofshët e bardha i kishin dalë nga velenxa. I kishte vënë dorën djalit mbi flokë dhe ky e shikonte si i magjepsur. Djalë trim, i tha Ibrahim. Më tregoi si e kishte zënë për gryke kaurin që të kishte sharë ty. Thanasi u ngrit në këmbë kur hyri i ati dhe mbeti ashtu, pa ia ndarë sytë Aliut që nuk po vishej. Dërgoje Thanasin të lajmërojë pleqësinë. Ata janë shpërndarë, tha Ibrahim, ku t'i gjej? Kush është i pari i tyre, pyeti Aliu. Arianit Komneni, u përgjigj Ibrahim dhe i bëri shenjë djalit. Thuaji që e pret Ali Tepelena, beu i Tepelenës. Thanasi fluturoi. Mbiemër i dëgjuar ky, tha Aliu duke veshur fustanellën. Ibrahim kishte kthyer kokën nga muri që të mos e shihte lakuriqësinë e Aliut. Thonë që familja e tyre është shquar që në kohën e Skënderbeut. Këtu ku jemi sot, të parët e tij kanë pasur zotërimet e veta që ia kanë marrë turqit. Plaku thotë se kur të ikin turqit, atij do t'i kthehen tokat dhe nderet. Pse është kryetar i pleqësisë, pyeti Aliu. Edhe babai i tij, edhe i gjyshi kanë drejtuar pleqësinë. Fshati i ka respektuar dhe u ka njohur drejtimin, tha Ibrahim.

Kur Ibrahim ktheu kokën, Aliu i veshur kishte dalë jashtë. Shiu kishte pushuar pas më shumë se një jave dhe dielli i mëngjesit po i thante pellgjet në oborr. Aliu iu afrua kalit të tij të bardhë që ishte lidhur pranë plevicës dhe nisi t'i shkundte jelet e lagura. Kali llastohej nga dora e të zotit dhe tundte bishtin. Qimet e tij të gjata që bëheshin blu nga dielli i mëngjesit i rrethonin supet e Aliut, si një shall. Aliu nuk ishte i gjatë. Koka e tij mbaronte aty ku niste hunda e kalit. Kur kali nxirrte frymë nga hojëzat, flokët e verdhë të Aliut hapeshin në ajër dhe po të mos kishte mustaqe, ai do dukej si një vajzë. Pasi rregulloi shalën prej lëkure, Aliu i kërceu kalit dhe me shpejtësi doli nga oborri dhe u zhduk pas shtëpisë së Mihalit. Rrugët ishin bosh dhe trokitja e potkonjve të kalit ngjante si një muzikë e luajtur mbi kalldrëm.

Fshatit akoma nuk i kishte dalë frika nga prishja e dhunshme e rrethimit të një nate më parë. Burrat tymosnin nëpër shtëpi pa folur, gratë gatuanin në heshtje, fëmijët luanin pa zhurmë. Pas shumë ditësh, Ibrahim dhe e shoqja dolën të lirë në oborr. Rruga e shtëpisë ishte e mbushur me kryqe të djegur dhe me mbeturinat e burrave që kishin rendur nëpër natë. Gruaja filloi të pastronte. Mblodhi mbetjet e bukëve, kuleçve dhe lakorëve që ishin shpërndarë dhe shkelur nga kuajt e njerëzit dhe ua hodhi bagëtive të uritura. Pastaj thirri Ibrahim dhe të dy bashkë mblodhën kryqet e djegur. Njëri prej tyre nuk ishte shkatërruar dhe gruaja me kujdes ia pastroi blozën që e kishte nxirë deri në majë dhe e mbështeti në murin e shtëpisë. Pjesët e mbetura Ibrahim i mori dhe i hodhi në vatër dhe ndezi zjarr. Gruaja po e shihte nga prapa kurrizit të përkulur mbi vatër sesi i rregullonte copat e druve duke i kryqëzuar njërin mbi tjetrin. Ibrahim e

ndjeu, u kthye nga ajo dhe me ëmbëlsi i tha: Ata për t'i djegur i prunë këta kryqe. Do e ushqejnë mirë zjarrin. Gruaja nuk foli dhe vazhdoi të pastronte oborrin e lagështitur. Balta ishte e butë dhe e mbushur me gjurmë njerëzish. Po t'i ndiqje ato nuk shkoje asgjëkund. Njëlloj si jeta, mendoi gruaja dhe u lut pa zë, ndërsa një kalë i bardhë po afrohej me shpejtësi në drejtim të shtëpisë.

Dita ishte e bardhë dhe gruaja hapi sytë për të kuptuar kush po vinte. Nga larg dukeshin dy figura që kalëronin bashkë. Si dielli dhe hëna mbi kalë, mendoi ajo, kur kali hyri në oborr, gruaja pa të birin që mbante në dorë kapistallet dhe pas tij kokën e verdhë të Aliut që varej mbi supin e Thanasit. Flokët e tyre ishin ngatërruar. Të dy qeshnin dhe Aliu e shtrëngonte Thanasin fort për beli. E gjeta rrugës dhe e mora, i tha ai gruas që vrapoi të ndihmonte të birin për të zbritur.

Pleqësia nuk mblidhet, i tha Aliu Ibrahimit kur hyri brenda. Arianit Komneni i tha tët biri se është i sëmurë dhe nuk mund të ngrihet sot nga shtrati. Burrat e tjerë nuk kanë dalë nga shtëpia. I kemi tmerruar Ibrahim. Janë zhdukur kaurët.

Ibrahimi nuk tha gjë. Thanasi kishte hyrë brenda në shtëpi dhe duke parë të atin sikur të merrte leje iu drejtua Aliut: Ali bej do ikësh? Aliu iu afrua aq shumë Thanasit, saqë dukej sikur po i merrte erë, dhe tha: Nuk shkoj pa u mbledhur pleqësia. Do pres sa t'i thahen kockat e lagura Arianit Komnenit. Shko prapë në shtëpinë e tij dhe i thuaj që dua ta takoj me çdo kusht. Pyete kur më pret në shtëpi.

6

Arianit Komneni e priti Ali Tepelenën të nesërmen. Gjatë ditës, Aliu kishte dërguar shokët e tij nëpër fshat dhe këta kishin marrë bukë, vaj, kripë, sheqer dhe fruta. Burrat e krishterë nuk kundërshtuan dhe shtëpia e Ibrahimit u mbush me ushqime. Pasi kishin ngrënë e kishin pirë, Aliu i tha Ibrahimit se donte të takonte Mihalin në qilarin e shtëpisë. Kur zbritën, Mihali po rrinte i kërrusur. Duart i kishte të lidhura dhe fytyrën shumë të zbehtë. Ngriti kokën dhe pa Aliun drejt në sy. Të ka vënë poshtë mëkati, i tha Aliu. Mihali nuk foli, por dha të kuptonte se nuk e njihte. Aliu u afrua, e zuri nga flokët dhe i tha: Jam Ali Tepelena. Ibrahimi është miku im. Ka qenë miku im edhe kur ishte i krishterë, por tani e kam dy herë mik sepse ka ardhur në rrugën time. Unë do shkoj të takoj pleqësinë. Ata kërkojnë që ti të lirohesh, por, pa ndryshuar vendimin që kanë marrë, ti nuk do dalësh nga ky qilar. Çfarë do t'i them atyre në emrin tënd?

Mihali dukej i pashpresë, por ndiqte me kujdes çdo fjalë të Aliut. U thuaj që në qoftë se nuk ndryshojnë çka kanë vendosur unë do vdes këtu. Jam shumë keq. Më ka hyrë pleviti në palcë dhe këmbët nuk më mbajnë më. Bota ka myslimanë në çdo cep. Edhe nëse unë vdes, prapë do ketë myslimanë. Ndoshta edhe më shumë. Vdekja ime nuk e ndryshon dot përhapjen e Islamit në Shqipëri dhe prandaj do ishte e kotë. Nuk dua të vdes, tha Mihali dhe filloi të qante. Ibrahimit iu dhimbs.

Nuk është e nevojshme të bëhesh mysliman, tha vrazhdë Aliu. Të paktën jo sot. Unë dua që ky fshat të mësohet t'i pranojë myslimanët sepse kështu respekton ekuilibrat e botës. Kjo botë ka të bardhë dhe të zinj, ka të drejtë dhe të shtrembër, ka të djathtë dhe të mëngjër, ka lindje dhe perëndim, ka dimër dhe verë, ka femra dhe meshkuj dhe ka kaurë e myslimanë. Fshati do ishte i pajetueshëm sikur të kishte veç meshkuj që kishin vetëm dorën e djathtë, të kishte vetëm dimër, të kishte vetëm desh dhe të gjithë këta të ishin të zinj. E kupton ç'po të them? Mihali vari kokën dhe tha: Po kush na thotë çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe? E mirë është çdo gjë që na shërben për t'u bërë më të fortë se të tjerët. Po të mos kishte krishterim nuk do kishte myslimanë. Ibrahimi u bë mysliman sepse u ndie i kotë kur shkoi në Pazar dhe pa sesi të gjithë fitonin, por ai jo. sikur në këtë fshat të gjithë të bëhen myslimanë, atëherë punët do jenë më zi se sot. Kjo do të

ndodhë dikur, por ti nuk do t'ia arrish asaj dite, tha Aliu duke dalë. Kali e priste jashtë, por ai vazhdoi në këmbë.

Dielli i pasdites i hynte në kraharor duke e ngrohur të gjithin. Stomaku i mbushur, i shpërndante fuqi kockave të tij të reja, ndërsa zemra i rrihte si një daulle bajrami që lajmëron besimtarët se ka ardhur ora për të shijuar të mirat e kësaj bote. A do bëja të njëjtën gjë, për të mbrojtur një të krishterë nga myslimanët, mendoi me vete dhe i dha vetes përgjigjen që i kishte thënë Mihalit. Ia vlen të bësh çdo gjë që të bën më të fortë se të tjerët.

Ali Tepelena shihte larg. Deri para disa vitesh, ishte një kusar që vidhte bagëti nëpër fshatra dhe sulmonte karvanët. Në qoftë se nuk sulmon, të sulmojnë. Ky ishte predikimi që ai mbante mend nga e ëma, të cilën për këtë arsye e konsideronte si të vetmin profet të dobishëm të jetës së vet. Duke sulmuar, kishte bërë emër dhe pasuri dhe kjo ishte një rrugë nga e cila ai besonte, se mund ta ndalte vetëm vdekja. Vetëm një herë ishte tërhequr Aliu. Në atë kohë nuk ishte më shumë se dhjetë vjeç. Sipas zakonisht, djemtë e vegjël në fshatin e tij luftonin se cila familje do të merrte dashin e madh të ngjyer me bojë të kuqe, të pashkës. Ai i mundi një nga një të gjithë moshatarët e vet, të cilëve ua vinte shqelmin në fyt, derisa ata dorëzoheshin nga mungesa e frymës. Kur të gjithë prisnin që të njëjtën gjë t'i bënte edhe kundërshtarit të fundit ai e fali, i hoqi këmbën nga zverku dhe pastaj djali tjetër e shtriu dhe e poshtëroi në mes të fshatit. Familja e tij e humbi dashin e pashkës atë vit. E ëma e rrahu në shtëpi kur ai i tha se nuk e kishte mundur djalin sepse ishte shumë i bukur dhe atij i kishte ardhur keq. Më vinte ta puthja dhe jo t'i merrja firohen, i tha Hankos që e shikonte si egërsirë. Vish një nga fustanet e sat motre dhe futu në harem, e kishte përqeshur ajo.

Aliu ia njihte këtë dobësi vetes. Atë e ndalte vetëm bukuria. Pushteti dhe paraja e joshnin dhe e ndërsonin. Ku po shkoj kështu, tha me vete të mbroj një mysliman? A kishte vërtet rëndësi për të fati i një myslimani në një fshat të humbur si ky? Iu kujtua Demir Hani që para njëqind vjetësh bridhte fshatrave të Shqipërisë për t'i bërë të krishterët t'i faleshin Muhamedit. Sa pa kuptim e kishte harxhuar jetën Demir Hani. A ia vlen të vdesësh për t'i kthyer njerëzit nga Jezu Krishti te Muhamedi dhe anasjelltas? Dy profetët ishin në qiell: njëri me një gotë qumësht e tjetri me një gotë verë, ndërsa shqiptarët grinden se gota e secilit prej të dyve zbrazet e para. Grinden sepse u mungon dikush, dikush prej mishi dhe kocke, dikush që të mund t'i drejtojë dhe që ata ta shohin me sy dhe ta prekin me dorë. Profetët janë të dobët sa janë mes njerëzve, por ata forcohen kur ngrihen në qiell. E kundërta ndodh me prijësit. Kur janë në tokë ata janë zot, kur ngrihen në qiell, harrohen. Sidomos myslimanët i harrojnë shpejt prijësit e tyre. Kjo sepse fuqia e tyre nuk trashëgohet, por jepet ose merret nga Porta e Lartë. Të krishterët e trashëgojnë pushtetin nga baballarët te bijtë dhe kjo i lidh njerëzit me emrin e të parit të tyre.

Teksa përsiatej kështu i doli përpara një vajzë e vogël me sy të zinj dhe faqe të kuqe. Gërsheti i zi pas koke i varej deri te beli. Rruga ishte bosh dhe vajza nuk po luante me asnjëri.

Si të quajnë, iu përkul Aliu. Sara, u përgjigj vajza. E kujt je ti Sara? Jam e Arianit Komnenit, tha vajza dhe tundi gërshetin siç tundte kali bishtin kur i kujtohej i zoti. Aliu u ngurtësua në fytyrë dhe vajza i tha: Mysliman je ti? Pa kuptuar, Aliu u skuq dhe ndoshta kjo ishte e para dhe e fundit herë në jetë që i erdhi turp të pohonte se ishte mysliman. Sara nuk priti që ai t'i thoshte po. u zhduk pas një dere të madhe druri që dukej si derë kishe. Gërsheti e tërhiqte vajzën si një litar, të cilin Aliu e ndoqi pas. Duke ecur nëpër oborrin e gjatë të shtëpisë iu duk vetja si një njeri që kërkon të lidhë hënën me litar, për ta futur në trup.

Arianit Komneni i mbuluar me një velenxë të kuqe dhe të trashë nuk u ngrit nga vendi kur Ali Tepelena u fut në dhomën e tij. Mjekra e tij e bardhë zgjatej si një njollë qumështi mbi të kuqen e velenxës. Kur Aliu u afrua për ta takuar, Arianiti u kollit fort. Aliu mendoi se plaku u kollit për të mos i uruar mirëseardhjen. Poshtë velenxës fshihej trupi i një burri të gjatë dhe kockëmadh, të cilin pleqëria e tregonte edhe më të madh. Flokët e bardhë dhe të lëshuar i binin mbi fytyrën pa rrudha gjë që të krijonte përshtypjen e një njeriu që mendohet në errësirë. Këtë fytyrë do desha të kem në moshën e tij, mendoi Aliu dhe vendosi të flasë i pari.

Kam ardhur të flasim për Ibrahimin, i tha. Ai është bërë mysliman pa e detyruar kush. Pleqësia ka vendosur ta zhburrërojë ose ta detyrojë të largohet nga fshati. Ai nuk do të largohet sepse këtu ka gjithçka. Ju duhet ta pranoni myslimanin siç e pranon gjithë bota.

Arianit Komneni nuk lëvizti, por velenxa e kuqe u duk sikur u fry kur ai u përgjigj. Pleqësia ka vendosur atë që gjykoji se ishte e drejtë, tha ai dhe u kollit prapë. Fshati nuk i do myslimanët. Ne kemi katërqind vjet që nuk pranojmë Islamin. Burra e gra janë therur nga turqit dhe nuk kanë pranuar të ndërrojnë fenë. Ibrahimin nuk mund të ndryshojë drejtimin e varreve tona. Në qoftë se do të jetojë si mysliman të gjejë një vend tjetër.

Ali Tepelena e kishte menduar më të lehtë bisedën me Arianit Komnenin dhe kur e dëgjoi që foli ashtu ndjeu një flakë që i dogji gjoksën. E nxori pa zhurmë frymën që i digjte kraharorin, por në vend të tij, u kollit Arianiti.

Islami ka një mijë vjet që pushton fshatra dhe qytete dhe miliona burra dhe ushtri janë përpjekur, por të gjithë kanë dështuar ta ndalin, tha Aliu. Mos mendo se je më i fortë se ata Arianit. Një pikë ujë nuk e kthen dot drejtimin e dallgës Skënderbeu i rezistoi Islamit 25 vjet dhe në fund dështoi dhe ai. Jam i bindur që ka vdekur duke menduar se sakrificat e tij ishte e kotë sepse jo vetëm që shumë shqiptarë vdiqën, por se lufta e tij i nxiti turqit të mendojnë se shqiptarët nuk i duan dhe prandaj kemi qindra vjet që përpëlitemi pa ushtri dhe pa shtetin tonë. Në qoftë se Skënderbeu do t'i ishte bindur turqve, shqiptarët nuk do kishin humbur kaq kohë dhe në paqe me islamin do kishin shtetin e tyre tri herë më të madh dhe më të fortë. Në fund të fundit ç'ëndësi ka nëse je mysliman apo i krishterë. Rëndësi ka si jeton. Më mirë një i krishterë i varfër dhe i mjerë apo një mysliman i pasur dhe i fortë? Unë zgjedh të dytën dhe këtë duhet të kishte zgjedhur dhe Skënderbeu e pas tij të gjithë ne të tjerët. Ne shqiptarët nuk kemi ditur të bëjmë paqe me kushtet tona me perandoritë, por si një tufë e përçarë dhe pa bari kemi pranuar një nga një zakonet dhe fenë e tyre. Këtë nuk e kemi bërë me marrëveshje dhe prandaj perandoritë, përfshi dhe Turqinë nuk na e kanë njohur nënshtrimin si pranim të arsyeshëm, por si detyrim të shkaktuar nga frika dhe varfëria.

Arianiti po e ndiqte me të njëjtën qetësi, por Aliu e kuptoi se kjo temë i kishte prekur një tel të fshehtë të shpirtit të tij që ashtu si pamja e tij profetike jetonte në historitë e lashta.

Skënderbeu nuk luftoi Islamin dhe kjo është një nga mashtrimet më të mëdha të historisë sonë, tha plaku qetësisht. Dikur e ka pohuar dhe vetë se nuk luftonte Islamin, por turqit. Duhet të dish se ai luftoi për pushtet, jo për besim. Gjatë gjithë jetës ëndërroi të ishte mbret i Shqipërisë dhe në qoftë se turqit do t'ia kishin njohur mbretërimin ai do të ishte bërë prapë mysliman siç ishte gjatë gjithë rinisë së tij. Skënderbeu, si gjithë shqiptarët deri më sot, besonte se mund të krijonte perandorinë e tij të vogël brenda perandorisë së madhe, por kjo ishte dhe është e pamundur dhe kushdo që do të përpiqet do të dështojë njëllë si ai. Dështimi i Skënderbeut ishte dështim i racës sonë, e cila për fat të keq beson se mund të pasurohesh si turk duke jetuar si i krishterë. Shqiptarët e kanë të vështirë të zgjedhin dhe këtu u ngatërrua edhe Skënderbeu. Ai donte të kishte mbretërinë e tij brenda Islamit, por me kusht që atë ta qeveriste në stilin e evropianëve të krishterë, të cilët i trashëgojnë mbretëritë e tyre brez pas brezi. Por kjo është e pamundur, sepse

Islami nuk ia njuh të drejtën e trashëgimisë njeriut. Islami beson se gjithçka ta jep dhe ta merr Zoti ose ai që përfaqëson Zotin mbi tokë dhe kësisoj shuan çdo ambicie të njeriut për të ndërtuar diçka që ia vlen ta lësh pas vdekjes, që njerëzit ta kujtojnë dhe ta nderojnë, kur ti të mos jesh më mes tyre. Islami e mëson njeriun të mendojë se në këtë tokë ai ka ardhur vetëm për të nderuar Allahun dhe për asgjë tjetër dhe prandaj myslimanët nuk punojnë, nuk pikturojnë dhe nuk kanë art, si të krishterët. Nga myslimanët, vetëm Muhamedi trashëgoi te pasardhësit e tij pushtet dhe pas tij edhe sulltanët e askush tjetër. Skënderbeu e kuptoi me vonesë se kjo e drejtë atij nuk do t'i njihej. Ambicien e tij prej të krishterit të dështuar e kuptuan shpejt edhe venecianët dhe me gjithë lutjet e tij, ata nuk e ndihmuan të krijonte një mbretëri të krishterë në Shqipëri. Venecianët kuptuan se shqiptarët nuk e kanë shqisën e të jetuarit nën një zot dhe nën një mbret të vetëm, të cilit i binden etër e bij. Këtë ata e kishin mësuar nga bizantinët dhe ata e kishin mësuar nga romakët. Më thuaj, çfarë mbretërisht kemi pasur në Bizantin e krishterë, i cili ishte e vetmja perandori e madhe e botës që i lejonte popujt e saj të krijonin mbretëritë e tyre të pavarura. Grekët i patën perandorët e tyre në Bizant. Bullgarët dhe serbët po ashtu. Hungarezët dhe rusët natyrisht. Po shqiptarët pse nuk ndërtuan dot mbretëri gjatë një mijë vjetëve bizantine? Kam gjithë jetën që e mendoj atë që të thashë: shqiptarët nuk dinë të zgjedhin dhe ç'është më e keqja nuk dinë të mbrojnë atë që zgjedhin dhe akoma më keq ata e tradhetojnë shpejt atë që zgjedhin. Ibrahim është një shqiptar i vërtetë, por historia më thotë se duke qenë kaq i vërtetë, ai është i padobishëm dhe madje është i dëmshëm. Prandaj nuk mund ta pranoj në fshat sepse nuk dua që historia të përsëritet duke e shkatërruar fshatin tim. Jetoj me shpresën se derisa të vdes nuk do të lejoj që Skënderbeu të lindë në këtë fshat.

Ali Tepelena u ndie i dobët kur kuptoi se nuk dinte se si ta kundërshtonte Arianit Komnenin. Ai nuk i njihte si plaku historitë e vjetra dhe gjithnjë kishte menduar se sa më pak prej tyre të dinte aq më të lehtë do ta kishte jetën. Nëna i thoshte gjithnjë se historia e jetës së tij duhej të ishte krejtësisht e ndryshme nga historia e jetës së të atit. Por me kalimin e viteve Aliu ishte bindur se nuk mjafton të bësh pikë për pikë të kundërtën e babait për të qenë i pasur dhe i pushtetshëm. Po qe se ky rregull do të ishte i vlefshëm, historia e njerëzimit do të kishte mbetur në vend si një kalë, të cilit i janë lidhur këmbët. Një hap para dhe pastaj një hap prapa dhe nuk shkon asgjekund. Tani që Arianiti e kishte lidhur edhe atë pas fijeve të historisë Aliut iu kujtua e ëma. Ndryshe nga Arianiti ai kishte arsye të mendonte se e vërteta e jetës së njeriut nuk mund të gjendet në të vërtetën e jetës së dikujt tjetër, por ndoshta është më lehtë të tentosh të kundërtën e jetës së dikujt, për të arritur tek e vërteta dhe suksesi. Këtë ia tha edhe Arianitit, i cili e shijonte me modestinë e një ikone të varur në mur habinë që i kishte shkaktuar vizitorit të vet.

Dikush duhet të përpiket të bëjë të kundërtën e Skënderbeut. Përderisa ti mendon se ai dështoi, dikush që bën të kundërtën e tij mund të ketë sukses. Në qoftë se njëri prej nesh bën paqe pa kushte me Islamin në emër të gjithë myslimanëve shqiptarë atëherë mund të arrijmë atë që nuk e kemi pasur kurrë, shtetin tonë, tha ai duke mbyllur sytë kur fliste.

Gabohesh, foli Arianiti. Njeriu nuk e ndryshon dot historinë siç nuk mund të ndryshojë fytyrën e vet. Qindra burra kanë menduar si ti, përfshi edhe Ibrahimin, i cili beson se duke u bërë mysliman mund të mbetet një shqiptar qe e fiton bukën e përditshme në paqe me pushtuesin e vet. Kjo është një paqe e gënjeshtërt që nuk i jep njeriut lumturi, as në këtë botë dhe as në tjetrën, nëse ajo ekziston. Skënderbeu e humbi paqen me veten kur u bë mysliman që i vogël, në oborrin e Sulltanit dhe vuajti edhe më shumë kur u kthye në Shqipëri dhe u bë prapë i krishterë për të bindur shqiptarët e tjerë ta pranonin si mbretin e tyre. Skënderbeu e ndiente se shqiptarët nuk e besonin megjithëse ata iu bindën dhe luftuan bashkë me të duke shpresuar më kot në triumfin e një turku mbi turqit e tjerë. Shqiptarët e kanë parë gjithmonë Skënderbeun si turk prandaj kurrë



nuk e besuan me të vërtetë. Por as turqit nuk e besuan Skënderbeun. Të parët sepse ai u bë mysliman dhe të dytët sepse ai u bë i krishterë. Duke kaluar ylberin e Zotit, Skënderbeu u bë i pabesueshëm. Shqiptarët e dinin se ai luftonte për pushtet dhe kjo është një ambicie që ata i lodh dhe nuk i inkurajon për një kohë të gjatë. Prandaj, qëllimi i tij mbaroi ditën që ai vdiq, sepse nuk kishte krijuar një bindje të trashëgueshme. Sot, shqiptarët mund ta duan paqen me turqit, por turqit nuk e duan më këtë sepse ata e dinë që shqiptarët mund t'i nënshtrosh më kollaj pa i dhënë favoret që garanton paqja. Për faj të Skënderbeut, sot as turqit dhe as evropianët nuk i besojnë më shqiptarët. Në rrugët e historisë sonë gjithmonë kanë ecur burra, të cilët nuk kanë ditur ku shkojnë. Unë mendoj se këtu ka një dorë hyjnore, e cila vendos që shqiptarët të udhëhiqen nga njerëz, të cilët në fund munden nga dilemat e tyre. Ka popuj, të cilëve Zoti nuk i ka dhënë akoma asnjë rrugë, siç janë çifutët. Ka të tjerë, të cilëve ai ua ka përcaktuar rrugën, siç janë të krishterët dhe turqit. Por ka raste kur Zoti vendos të luajë me njerëzit sepse kjo me sa duket i shërben si çlodhje në mes të punëve të shumta që ka.

Kur isha i vogël, unë merrja dy milingona që i vija një hap larg një copë bukë për të kuptuar se kush prej tyre dhe pse do ta gjente rrugën drejt ushqimit. Për çudinë time, të dyja e gjenin bukën me të njëjtën shpejtësi dhe në të njëjtën kohë dhe kurrë nuk më ka qëlluar ndryshe. Milingonat janë një racë, së cilës Zoti i ka dhënë vetëm një drejtim. Por ky nuk është rasti i shqiptarëve. Milingonat kanë më shumë fat se shqiptarët sepse janë më të vendosura. Zoti ka vendosur t'i lërë shqiptarëve dy rrugë dhe argëtohet kur sheh që atje lart se si ata lodhen dhe nuk e zgjedhin dot rrugën që duhet. Deri më sot të gjithë kanë zgjedhur rrugën e gabuar.

Kështu i ndodhi edhe Skënderbeut. Historia do të kishte ecur ndryshe në qoftë se në vend të Skënderbeut do të kishte qenë dikush tjetër, i cili nuk vinte nga oborri i Sulltanit dhe të cilit shqiptarët do t'i kishin besuar bashkë me pushtetin dhe fenë e tyre, deri në atë kohë të papërlyer. Siç tregon historia, edhe venecianët dhe Papa në Romë këtij njeriu i besonin më shumë dhe do ta kishin ndihmuar të krijonte një mbretëri të krishterë, e cila mund t'i rezistonte kohës jo vetëm si kujtim, por si një gjë e gjallë.

Aliu kroi kokën dhe iu duk sikur milingonat e historisë po i vraponin nëpër flokë. Kush ishte ky njeri, pyeti ai.

Ky ishte Arianit Komneni, tha Arianit Komneni. Unë kam emrin e tij. Atij i thoshin edhe Gjergji, por këtë emër e mban im bir i madhi. Aliu nuk pati nevojë t'i kërkojë plakut më shumë sepse ky filloi t'i tregonte për historinë e familjes së vet. Duke dëgjuar, Aliu pati ndjesinë se po jetonte në një kohë tjetër, e cila e ndriçonte kohën e tij ashtu si dielli ndriçon hënën duke perënduar.

Kommenët e kanë qeverisur Perandorinë e Bizantit për më shumë se njëqind e pesëdhjetë vjet. Grekët thonë se ata janë grekë, por unë dua të besoj se janë një racë me shqiptarët që jetojnë sot në Voskopojë. Ata kanë folur dhe kanë shkruar greqisht pa dyshim dhe e kanë drejtuar perandorinë deri kur Kostandinopoja u pushtua dhe u përdhunua nga kryqëzata e krishterë dhe kur Komnenët ikën të përndjekur nga qyteti. Njëri prej tyre, Mihali, i cili ishte nip i Teodorës, vajzës së perandorit të parë Komnen, erdhi në vitin 1204 në Shqipëri dhe u vendos në Janinë. Për shkak të emrit të madh që kishte familja e tij ai u bë princ dhe Janina ishte kryeqytet i kësaj principate dhe unë dua të besoj se kjo është e para mbretëri e pavarur e shqiptarëve. Komnenët e mbajtën principatën e Janinës deri në vitin 1318 me princin e fundit Thoma Komneni, i cili u vra nga djali i motrës së tij. Thoma Komneni, la pas një djalë, i cili, për t'i shpëtuar hakmarrjes së kushërinjve të tij, u fsheh në malësitë që ndajnë Vlorën me Gjirokastrën, në një fshat që quhej Arianit. Aty u martua me një shqiptare nga një derë e mirë e fshatit dhe jetoi pa kërkuar ofiq dhe pushtet derisa vdiq.

Djali i tij, që trashëgoi emrin Arianit, si dhe emrin e fisit, ishte Arianit Komneni, i cili lindi ndoshta në vitin 1400. Ky bëri krushqi me një nga vajzat e familjes së madhe të Muzakajve, të cilët i shtrinin zotërimet e tyre nga Korça deri në Gjirokastrë.

Arianit Komneni ishte prijësi i munguar i shqiptarëve. Në qoftë se Skënderbeu nuk do ta kishte mashtruar me mënyrën tipike turke, shqiptarët do të kishin gjetur tek ai mbretin e tyre, me prejardhje nga perandorët e Bizantit dhe kjo lidhje nuk do t'i kishte ndarë më ata nga krishterimi evropian dhe sot ne do të jetonim në një mbretëri të krishterë. Arianiti ishte një luftëtar i madh. Ai filloi i pari luftën kundër turqve në vitin 1432, dhjetë vjet përpara se Skënderbeu të kthehej si mysliman në Shqipëri për të ndërruar rrjedhën e gjërave. Arianiti nuk humbi asnjë nga betejat e tij me turqit dhe kryengritjet e tij vazhduan gati gjashtë vjet me radhë nga Voskopoja në Tepelenë, nga Gjirokastra në Elbasan, derisa Sulltan Murati u detyrua t'i njohë zotërimet e tij përgjatë lumenjve të Shkumbinit dhe të Vjosës. Kur Skënderbeu erdhi në Shqipëri, Arianit Komneni ishte kryezoti i Shqipërisë dhe pa dyshim princi, të cilin shqiptarët respektonin më shumë. Skënderbeu e kuptoi se pa mbështetjen e tij nuk mund të kishte sukses dhe në fillim ai u vu nën urdhrat e Arianit Komnenit, i cili vendoste për gjithçka. Arianiti besoi se Skënderbeu mund t'i printe luftërave kundër turqve duke qenë i stërvitur prej tyre si një ushtarak i zoti. Besimi që kishte ndaj tij si luftëtar e bindi ta mbështeste si kapedan të parë, kur në Lezhë u mblodhën gjithë princat e Shqipërisë në vitin 1444. Në të vërtetë kjo ishte besëlidhja e Arianitit. Përfaqësuesit e familjeve të mëdha shqiptare erdhën për të shpallur Arianit Komnenin si sundimtar dhe mbrojtës të tyre dhe kërkuan që nën flamurin e tij të luftonin të gjithë bashkë kundër turqve. Por Skënderbeu iu lut Arianitit t'ia ngarkonte atij këtë mision duke i premtuar se në qoftë se do t'i mundnin turqit dhe Shqipëria do të shpallej shtet i pavarur, Arianiti do të ishte mbret i saj. Arianiti pranoi dhe bindi edhe princat e tjerë të vendit, të cilët nuk donin të pranonin një mysliman si Skënderbeu për të parin e tyre. Me ndihmën e ushtrisë që kishte krijuar Arianiti dhe që tani e drejtonte ai, Skënderbeu filloi t'u merrte turqve territore, të cilat më parë kishin qenë në zotërimin e Arianit Komnenit. Ky i kërkoi që këto toka t'i ktheheshin, por Skënderbeu nuk pranoi dhe filloi t'i qeveriste vetëm. Kur Skënderbeu u rrethua herën e parë në Krujë në vitin 1450, ai i kërkoi ndihmë Arianitit. Gjyshi im thoshte se kur të dy burrat u takuan në Durrës, Skënderbeu i kërkoi falje Arianit Komnenit duke i thënë se do t'ia kthente të gjithë tokat dhe sapo të iknin turqit ai do thërriste gjithë princat siç kishin vepruar në Lezhë për ta shpallur Arianit Komnenin mbret të Shqipërisë. Arianiti nuk e besoi Skënderbeun, por megjithatë i premtoi ta ndihmonte me para dhe ushtarë për të përballuar rrethimin. Arianit Komneni në atë kohë nuk kishte djem nga martesat e tij me Maria Muzakën dhe kishte frikë se nëse vdiste apo e vrisnin, askush nuk do të trashëgonte emrin dhe pronat e tij të shumta. Skënderbeu ia dinte këtë dobësi dhe e shfrytëzoi bukur duke i kërkuar dorën e së bijës, Donikës me qëllim që ta zbuste dhe të garantonte aleancën me të. Arianit Komneni i mençur pranoi dhe i tha Skënderbeut: Edhe në qoftë se unë nuk bëhem mbret i Shqipërisë një ditë nipi im do të bëhet. Skënderbeu djallëzor, për shkak të edukatës turke që kishte marrë, ia ktheu: Në qoftë se ti më pengon mua të bëhem Mbret i Shqipërisë djalin tim nuk e pengon dot.

Rrethimi i Krujës u thye dhe po atë vit Skënderbeu u martua me Donikën, por marrëdhëniet me vjehrrin e tij të fuqishëm nuk i përmirësoi. Arianiti e humbi përfundimisht besimin te Skënderbeu kur më vonë mori vesh se ky i kishte ofruar Krujën Venedikut duke kërcënuar se në rast se ata nuk e ndihmonin, ai do t'ua linte atë turqve pa bërë asnjë rezistencë. Ftohja e tyre e dobësoi Skënderbeun, i cili filloi të humbte disa betejat ndaj turqve. Më e rënda ishte ajo e Beratit për të cilën ai akuzoi Moisi Golemin, luftëtarin më të shquar të asaj kohe që ishte nipi i Arianitit dhe që ky e mbante pas dhe e thërriste djalë. Moisiu, që kishte në zotërim Dibrën, i la turqit të

kalonin nëpër tokat e tij dhe këta i ranë pas shpine mbrojtësve të kalasë së Beratit duke e shkatërruar ushtrinë e Skënderbeut. Im gjysh thoshte se Arianit Komneni donte t'i jepte një mësim Skënderbeut, i cili në fund të jetës kishte pranuar se prishja e aleancës me vjehrrin kishte shënuar fillimin e rënies së tij. Por Skënderbeu ishte edukuar si mysliman dhe unë nuk besoj se atë e ka vrarë ndërgjegjja, por është e vërtetë se në qoftë se do t'ia kish mbajtur fjalën Arianit Komnenit, ne sot do të jetonim ndryshe.

7

Ndërsa Arianit Komneni rrëfente historitë e tij, Ali Tepelena nuk kishte lëvizur nga vendi duke menduar se ky plak i krishterë kishte vendosur t'i tregonte rrënjët e familjes së tij njëlloj si një rrap i moçëm që i nxjerr rrënjët mbi tokë pas tërmetit. Ndoshta mendon se madhështia e emrit të tij do të më bindë ta lë të qetë për të zotëruar fshatin, siç kishte bërë me sa duket në gjithë këto vite. Arianit Komneni ishte shumë i zgjuar, por vitet ia kishin humbur praktikitetin. Megjithatë, ky arsyetim nuk e ngopi Aliun. Nuk është llafazan, mendoi, diku do të dalë. Ali Tepelenës i kishin bërë përshtypje sidomos historitë mbi Janinën, një qytet që ai e kishte për zemër. Duke u rropatur të nguliste në mendjen e tij të re ato që kishte dëgjuar nga Arianiti, dera u hap dhe vajza e vogël me gërshet të zi u afrua tek i ati dhe i zgjati një enë të mbushur me arra të mëdha bojëkafë. Vajza doli pa ia hedhur sytë, por Aliut iu duk sikur gërsheti i saj filloi t'ia lidhte jetën me historinë e Arianitëve dhe sidomos me Janinën nga ku e kishte zanafillën historia shqiptare e Komnenëve.

Arianit Komneni e tërhoqi nga këto mendime kur i tha: Jam nëntëdhjetë e dy vjeç. Kam tre djem. I madhi quhet Gjergj si Arianit Komneni i madh. I dyti quhet Mihal si Mihali që ngriti të parën principatë shqiptare të krishterë në Janinë. I treti quhet Gjon dhe ka marrë emrin e djalit të Skënderbeut, nipit të Arianitit dhe që përbën të vetmen lidhje mes dy burrave, të cilët Islami i ndau në fe dhe krishterimi nuk i bashkoi dot në pushtet. Sara është vajza ime e vetme. Është pesëmbëdhjetë vjeç dhe besoj se pas saj nuk do kem më fëmijë.

Mori një arrë të madhe dhe, duke e shtyrë me një thikë të vogël që nxori nga poshtë velenxës, filloi ta hapte pa u ngutur. Merr dhe ti një, i tha Aliut. Arianit Komneni i Madh i kishte qejf dhe luante shumë me to. Një herë hapi një arrë më të madhe se kjo, shumë më të madhe, në dysh dhe duke lexuar fletët dhe rrudhat e saj të njoma i tregoi Skënderbeut se njëlloj si arra edhe truri i njeriut formohet nga dy pjesë. Në qoftë se nuk e di ato quhen hemisfera, i tha me modesti Aliut, i cili nuk bëri asnjë shenjë. As Skënderbeu nuk e dinte, por i tha Komnenit se kur kishte vrarë njerëz gjatë betejave shpesh i kishte rastisur të shihte tru të ndarë më dysh që i ngjanin kësaj arre. Arianiti kishte qeshur dhe i kishte thënë: Ja pra, ky është ndryshimi mes ne të dyve. Ti do ta ndash trurin në dysh, kurse unë dua ta lexoj.

Aliu sërish nuk lëvizi dhe Arianiti vazhdoi:

Arianit Komneni nuk pati asnjë djalë me Maria Muzakën dhe kjo e mërzi shumë derisa u tërhoq nga luftërat, të cilat nuk i jepnin më kënaqësi. Besoj se përveç zhgënjimeve familjare dhe ato që gati nga gënjeshttrat e Skënderbeut, ai nuk besonte më se Shqipëria mund t'i rezistonte pushtimit turk. Me Maria Muzakën u mundua, por ajo i dha njëra pas tjetrës nëntë vajza. Kur humbi shpresat, iku në Itali dhe u martua me një italiane, e cila i dha atij tre djem. Por djemtë lindën kur Arianiti ishte në fund të jetës dhe kur mundësitë për të rivendosur pushtetin që kishte ishin zvogëluar sa nga turqit, po aq edhe nga Skënderbeu. Krushqitë që ai bëri për vajzat e tij tregojnë se ishte jo vetëm një strateg i madh, i cili synonte të zbuste gjithë pretendimet për territore që vinin nga brenda dhe nga jashtë Shqipërisë.

Siç të thashë, njëren vajzë, të madhen, ia dha Skënderbeut. Vajzën e dytë, Vojsavën e martoi me princin e Malit të Zi, Ivan Cernojeviçin, i cili ishte një nga njerëzit më të shquar të kohës së tij. Tri vajza të tjera i martoi në derën e Dukagjinëve, princave të veriut të Shqipërisë duke forcuar kështu aleancën me një nga familjet më të mëdha shqiptare me të cilat nuk kishte lidhje gjaku. Një vajzë tjetër e martoi me Gojko Balshën, edhe ky nip i Gjergj Stres Balshës së madh. Tre të tjera i dha në Itali kryesisht në Venedik dhe Napoli nëpër dyer të mëdha me lidhje politike. Ndërsa Angjelinën, vajzën e tij më të dashur që ai thoshte se i ngjante gjyshes së tij, ia dha Stefan Brankoviçit princit të Serbisë dhe stërnipit të Stefan Dushanit të madh. Kur Stefani u martua, ai sapo ishte qorruar nga Sulltani, të cilin e kishte kunat dhe thonë se Angelina qau kur e pa ashtu dhe deri në fund të jetës e mbajti për dorë.

Krushqitë e Arianit Komnenit ishin krushqi me shije perandori siç ishte në të vërtetë ai. Siç të thashë, vetëm gruaja italiane i dha atij djemtë që i kishin munguar për të mbretëruar Shqipërinë. Ata ishin Kostandini, të cilit Mbreti i Francës i fali një dukat në veri të Italisë, Arianit dhe Thomai. Ky i fundit ishte i vetmi që u kthye në Shqipëri. Me sa duket çdo derë e madhe ka tradhtarët e vet dhe Thomai qëlloi plëngprishësi i Arianitëve sepse u vu në shërbim të turqve, të cilëve u kërkoi pjesë nga zotërimet e shumta që ata i kishin marrë babait të tij. Për t'u bërë më i besueshëm, Thomai u bë mysliman dhe turqit i dhanë Himarën ku ai u bë një sundimtar mizor. Thonë se Thomai natën shkante dhe i merrte me forcë gratë dhe vajzat fshatarëve të bregut dhe pastaj i ndante ato me ushtarët e tij. Një ditë, fshatarët u mblodhën dhe e vranë. Kjo ndodhi në vitin 1486. Djali i vogël i Thoma Komnenit ishte stërgjyshi im.

Ai bashkë me farefisnin dhe të ëmën u fshehën për pak kohë sa të harroheshin zullumet e babait dhe më pas u vendosën këtu ku ngritën këtë fshat, të cilin stërgjyshi e zgjodhi pranë Janinës, duke jetuar me shpresën se kur të ikin turqit ne do t'i kthehemi historisë së Komnenëve shqiptarë, aty ku ajo nisi: në Janinë. Unë nuk e besoj më këtë ëndërr të plakur dhe jam i sigurt se as djemtë e mi nuk do t'ia arrijnë asaj dite. Islami sapo ka ardhur në këto troje dhe dita kur ai të ikë është akoma shumë larg.

Arianit Komneni pushoi, por nuk dukej i lodhur. Pas historive që kishte dëgjuar Ali Tepelena dukej më miqësor se në fillim. Tani ai e shikonte plakun si një libër me shumë faqe dhe me sa duket kjo e zbuti, siç zbutet çdo njeri që lexon mes dy betejave. Kur kishte ardhur ta takonte, Ali Tepelena mendonte se nëse pleqësia do ta kundërshtonte, ai do ta zgjidhte çështjen e Ibrahimit me ndihmën e trimave të tij, të cilët ishin të gatshëm në çdo kohë të masakronin një fshat të krishterë. Por tani Aliu që e kishte ndjekur me vëmendje Arianitin, mendonte se duke e zbutur plakun marrëveshja e tij me fshatin do të mund të ishte më e plotë dhe më e respektueshme nga të gjithë.

Duke marrë arrën e fundit që kishte mbetur, Aliu e pyeti: Po ti Arianit si i ke jetuar këta 92 vjet? Arianiti që duket se e priste këtë pyetje u përgjigj pa u menduar: Kam jetuar si një Komnen dhe po mendoj se si do të vdes si i tillë.

Kur linda unë, fshati kishte dy herë më pak shtëpi sesa sot. Babai drejtonte pleqësinë, e cila kryesisht përbëhej nga kushërinj ose krushqi të tij sepse siç e thashë, ky fshat u themelua nga stërgjyshi im dhe njerëzit e afërt të tij, prandaj shumica këtu jemi të një gjaku. Por babai vuajti gjithë jetën nga frika e shuarjes së fisit tonë, i cili sipas tij do rrezikohej një ditë në qoftë se ne vazhdonim të jetonim të izoluar në këtë vend. Ai pati pesë djem dhe unë isha më i vogli prej tyre. Im atë jetonte gjithë kohën me lajmet që vinin nga betejat mes të krishterëve dhe turqve, por ato vite ishin kohët kur turqit u forcuan shumë dhe pothuajse e pushtuan gjithë Greqinë, Serbinë, Hungarinë dhe shkuan deri në Vjenë falë Kara Mustafa Pashës që ishte shqiptar nga dera e

qyprillinjve. Zoti e desh që ky u mund me turp në Vjenë dhe Sulltani ia preu kokën. Mos ishte për meritë të kryevezirëve shqiptarë qyprillinj Perandoria Turke do të kishte marrë tatëpjetën me kohë e me vakt. Historia do shpjegojë se pse shqiptarët e kanë mbajtur në këmbë Turqinë me jeniçerë dhe vezirë të mëdhenj, të cilët kurrë nuk kuptuan se ky përbindësh me trupin në Azi kishte ardhur të ushqehet në Evropë duke mbajtur me thonj vendin e tyre, pa e lënë të rritej.

Siç të thashë, babai jetonte në fshat, por mendjen e kishte gjetkë. Kur turqit filluan luftën për pushtimin e Kretës, të cilën e mbajtën të rrethuar për 25 vjet, babai mendoi se nëse thyhej ky front, turqit nuk do të ndaleshin më siç po ndodh në të vërtetë edhe sot. Ai ishte i bindur se krishterimi dhe sidomos Venediku, nuk do ta linte Kretën të binte në duar të turqve dhe kërkoi të kishte pjesën e vet në këtë fitore, prandaj dërgoi atje vëllanë tim të madh në krye të dhjetë burrave nga fshati. Asnjëri prej tyre nuk u kthye i gjallë pasi Kreta u pushtua nga turqit në vitin 1669, njëqind vjet përpara. Si për të bindur tim atë se shqiptarët vrasin shqiptarët për një copë dhe të huaj, Kretën e pushtoi një qyprilli tjetër, Fazil Pashai. Im vëlla atë kohë ishte 18 vjeç dhe bashkë me të në Kretë u vra edhe gjyshi i Ibrahimit që sot është bërë mysliman dhe që nuk kupton se eshtrat e të ndjerit, gjyshit të tij, tani po lëvizin atje ku dergjen. Babai u trishtua nga vdekja e vëllait tonë të madh, por besimi se aleanca e krishterimit mund ta detyronte Islamin të tërhiqej në Azi, aty ku Zoti ka parashikuar territoret e tij, nuk iu venit për asnjë çast.

Në vitin 1704 babai vendosi të shkojë në Turqi. Ne nuk e kishim ditur se ai mbante lidhje me një degë tjetër të Komnenëve në Itali. Ata e lajmëruan se në përkujtim të pesëqindvjetorit të rënies së dinastisë Komnene që ndodhi në vitin 1204, të gjithë trashëgimtarët e tyre të shpërndarë nëpër botë kishin vendosur të mblidheshin në Stamboll. Do nisem të takoj kushërinjtë e mi, të cilët, kur turqit të thyhen një ditë, do qeverisin prapë Evropën, thoshte babai dhe kjo ia ktheu gëzimin që kishte humbur prej vitesh. Mirëpo kur po nisej, ai i kishte kaluar shtatëdhjetë vjeç dhe nuk kishte fuqinë e rinisë për të kryer një udhëtim aq të gjatë dhe të vështirë. Nëna këmbënguli që ai të merrte një nga djemtë me vete për ta ndihmuar dhe ai më zgjodhi mua.

Pas dy muajsh arritëm në Stamboll pasi u hodhëm nga Janina në Voskopojë e Kostur dhe prej andej përfunduam në Selanik ku i hipëm një anije tregtare që na çoi në qytetin e shenjtë. Kur anija jonë iu afrua portit, mbi të cilin xhamitë e Stambollit ngriheshin si direkë, sytë jeshilë të babait u errën. Kam ardhur të ta heq perçen e dashur, pëshpëriti babai me vete, sikur t'iu drejtohej një gruajë që e kishte thirrur për ndihmë.

Takimin e Komnenëve e kishte organizuar Gjergj Brankoviçi, i cili punonte si agjent tregtar në një shoqëri angleze, por që në fakt ishte shumë i lidhur me perandorët e Austrisë. Brankoviçi ishte pinjoll i sundimtarëve të Serbisë, të cilët kishin lidhur krushqi me Komnenët, gjë që e bën krushk me ne, por dhe me Skënderbeun, i cili martoi djalin e tij me Irenën, vajzën e princit Llazar Brankoviç. Kur babai ia shpjegoi këtë lidhje, Gjergj Brankoviçi u mrekullua dhe e quajti babanë një vëlla të rigjetur në mes të detit. Është koha për t'u rikthyer në lavdinë tonë, tha ai në fjalimin që mbajti gjatë meshës së kujtimit të Komnenëve në një kishë të vogël greke që shikonte nga deti. Krishterimi humbi përballë turqve për shkak të përçarjeve të veta, por tani ne duhet të bashkohemi nën një flamur të krishterë pavarësisht se jemi shqiptarë apo serbë, apo grekë. Ky ka qenë ideali i Komnenëve të mëdhenj, të cilët ngritën Perandorinë më të madhe dhe më të ndritur të botës. Perandoria e Bizantit ishte e tillë sepse arriti të bashkojë nën një pushtet tre elementë që në rast se pajtohen prodhojnë qenien perfekte: një shpirt grek, një mendje romake dhe një trup mysliman. Ky është ekuilibri më i përsosur që ka parë historia. Çfarë nuk mund të arrijë një njeri që është i fortë si mysliman, i ndjeshëm si grek dhe i mençur si romak? Gjithçka motra dhe vëllezër, kushërinj dhe pinjollë Komnenë. Me këtë koktej pushtetesh, racash dhe dijesh do të ndërtohet Bizanti i ri, themeli i të cilit pa dyshim do të jetë Ballkani dhe çatia e tij do të jetë

Evropa. Ne sot jemi mbledhur këtu në Kostandinopojë për të nisur mbledhjen e gurëve të këtij themeli. Le t'i marrim gurët nga Serbia, nga Moreja dhe Rusia, nga Vjena dhe Venecia, nga Jerusalemi dhe Parisi, nga Athina dhe Janina e t'i bëjmë bashkë sepse kështu shtëpia jonë do ketë vend për të gjithë. Komnenët e mbledhur nga gjithë këto vende u frymëzuan dhe e mbështetën një nga një Gjergj Brankoviçin.

Babai i përlotur tha vetëm dy fjalë: Komnenë të nderuar, mirë se erdhët në ëndrrën time!

Më vonë, Gjergj Brankoviçi na shpjegoi se me ndihmën e perandorëve habzburgë po mendohej organizimi i një kryengritje të madhe të të krishterëve në Serbi, Greqi, Shqipëri dhe Bullgari, e cila duke u mbështetur nga Austria, Venediku dhe më pas edhe nga Rusia, do të synonte rënien e perandorisë së lodhur turke në pak kohë. Në fakt kjo ishte arsyeja e vërtetë e këtij takimi në Stamboll. Të gjithë mendonin se forcimi i Austrisë dhe Ruisë si Fuqi të Mëdha dhe luftërat e brendshme në Perandorinë Osmane e favorizonin ringritjen e krishterimit. Komnenët nisën t'i japin informacione për mundësitë që kishin për të mbledhur para dhe njerëz, ndërsa Gjergj Brankoviçi me një hartë të Ballkanit përpara caktonte me ngjyrë të kuqe pikat ku fillimisht do të ndizeshin zjarret.

Ato kohë në Stamboll takuan Komnenë nga të gjitha vendet përfshi edhe një stërnip të Skënderbeut, i cili quhej Anton Kastrioti që ishte një burrë i shkurtër dhe i hollë dhe që jetonte në Itali. Edhe Skënderbeu ka qenë i shkurtër, i tha ai babait kur u takuan. Por si ai, thirrjes së Brankoviçit i ishin përgjigjur edhe shumë kontë italianë dhe dukeshat bullgare, pasanike greke dhe princa rusë, pinjollë të familjeve mbretërore transilvane, krushq të familjeve mbretërore franceze dhe suedeze si dhe një dukë i gjatë dhe bukurosh, i cili na tha se rridhte nga Huniadi, mbreti i Hungarisë dhe që megjithëse nuk kishte lidhje me Komnenët kishte ardhur të ndihmonte krishterimin. Kur rrinim me këta njerëz, të cilët kishin humbur lavdinë e dikurshme, por sidoqoftë kishin ruajtur pasuritë dhe pronat që i lejonin ta shijonin luksin e Stambollit, mendoja për fshatin tonë të varfër. Po ne pse nuk jemi me tituj si gjithë këta Komnenët e tjerë, pyeta babanë. Në tokën tonë nuk mbin fisnikëria, m'u përgjigj ai, por dukej se kjo diferencë me kushërinjtë e tij nuk e shqetësonte shumë.

Përgjatë një viti, Gjergj Brankoviçi bëri plane për të filluar kryengritjen e tij dhe ndihmat e Austrisë dukej se nuk i mungonin. Në gazetatat austriake Brankoviçi ishte shpallur Kont i Perandorisë së Shenjtë. Ai na tregonte se si njerëz të caktuar nga vetë Perandori po rekrutonin me para luftëtarë në gjithë Ballkanin dhe pritej vetëm të ndizej fitili nga Vjena. Atëherë, i thoshte ai babait me sytë që i shkëlqenin, do të nisemi dhe ne dhe ti do të drejtosh kryengritjen në Shqipëri. Disa muaj më parë kishte ardhur në krye të Turqisë Sulltan Ahmeti, i cili njihej si një njeri që harxhonte shumë para për të zbukuruar xhamitë dhe pallatet e tij në stilin francez. Stambolli ndihej më i lirë nga dhuna e sulltanëve të mëparshëm dhe artistë evropianë me gjithë gratë e tyre të pambuluara bridhnin lirshëm nëpër qytet. Nuk e kam parë kurrë tim atë më të qeshur se ato kohë. Stambolli po kthehej në Kostandinopojë, më thoshte dhe pothuajse përditë shkonte në kishë ku lutej për fatin tonë. Por atë vit bëri një dimër i tmerrshëm dhe Stambolli u mbulua nga dëbora dhe ngricat. Duke mos hequr dorë nga rituali i tij i lutjeve në kishë babai mori një plevit. Gjatë një muaji të vështirë unë i shërbeja dhe i jepja çaj të nxehtë, ndërsa ai fliste për betejat e mëdha të Arianitëve dhe më tregonte vende me emra malesh në Shqipëri, në të cilat fillimisht duhet të shiheshin kryengritësit e Gjergj Brankoviçit sipas planeve që ai hartonte nga krevati i Stambollit. Ai ishte një muaj gjeografie për mua. Mësova me dhjetëra emra malesh, luginash, kodrash, lumenjsh dhe fshattrash, të cilat babai më detyronte t'i përsërisja në formën e një itinerari ushtarak. Shqipëria e vogël m'u duk si një dhomë e madhe në të cilën unë dhe babai i zhvendosnim si mobilie malet dhe kodrat e shumta. Shqipëria është e vogël, por është krijuar

për të fshehur ushtri, thoshte babai, sytë e çuditshëm jeshilë të të cilit filluan të ngatërrojnë gjeografinë e mobilieve nga fundi i muajit. Unë nuk kisha ndenjur kurrë aq shumë me tim atë. Besoj se edhe ai zbuloi ato ditë tek unë një djalë, të cilin ëndrrat e tij nuk i kishin dhënë mundësi ta njihje. Sikur të kisha pasur një vajzë do doja ta martoja me një djalë si ty, më tha para se të vdiste. E varrosa me ndihmën e disa grekëve në varrezat e krishtera të lagjes Fanar të Stambollit. Kur mbeta vetëm, Gjergj Brankoviçi, i cili kish shumë miq me influencë në Stamboll më ndihmoi të punoja si pastrues në shtëpinë e Dragomanit të Madh. Dragomanët janë përkthyesit zyrtarë të Portës së Lartë dhe këtë titull gjithnjë e kanë mbajtur grekët. Ky ishte njeri me influencë dhe me sa duket ishte i përfshirë në heshtje, për shkak të frikës nga turqit në komplotin që Gjergj Brankoviçi donte të organizonte në Ballkan. Aty punova dy vjet dhe mësova turqisht, por arrita të shkruaj edhe greqishten, të cilën e dija shumë pak kur u nisa nga fshati. Ndërkohë, shpresat për t'u kthyer në Shqipëri po më linin. Nuk kisha asnjë lajm nga fshati dhe nuk dija si të lajmëroja vëllezërit dhe nënën për vdekjen e babait. Gjergj Brankoviçi më thoshte se gjërat po vonoheshin për shkak se Rusia, që kishte bërë paqe me Turqinë në dem të Austrisë, po i sabotonte përpjekjet e tij kryengritëse në Ballkan. Një natë, në shtëpinë e Dragomanit u mbledhën në mënyrë sekrete Gjergj Brankoviçi, disa grekë si dhe ambasadori rus, i cili donte të informohej për mundësitë dhe seriozitetin e lëvizjes së Brankoviçit. Paqja mes Ruisë dhe Turqisë ishte vënë në dyshim në Krime dhe rusët kishin nisur të sabotonin stabilitetin e Portës së Lartë. Mirëpo Gjergji, i cili besonte se mund të manovronte mes interesave të Fuqive të Mëdha u gënjye. Rusët e tradhtuan atë të turqit dhe Gjergji u arrestua për gjashtë muaj. Kur u lirua, u kërkuan të largohej si i padëshirueshëm për të mos u kthyer më në Stamboll. Para se të ikte, më tha se rrugës për në Serbi ai mund të kalonte nga Shqipëria dhe në qoftë se doja mund të shkoja me të. Natyrisht që nuk kishte rast më të mirë për mua për t'u kthyer në fshat. U nisëm një ditë të përvëlur korriku kur hurmat djersinin dhe rrushi digjej në pazarin e Stambollit. Unë kisha qarë gjithë natën mbi varrin e babait tim, të cilit i premtova se do të kthehesha ta merrja sa më shpejt. Gjergj Brankoviçi nuk mund të kalonte nëpër territoret e Perandorisë Turke që shtriheshin në tokë nëpër gjithë Greqinë Veriore. Vetëm gadishulli i Moresë ishte akoma nën sundimin venecian dhe fillimisht shkuam atje me një galerë që transportonte pambuk. Brankoviçi kishte miq në More, të cilët i thanë se mund ta ndihmonin të kthehej, por vetëm duke kaluar nëpër Itali pasi rrugët e tjera mund të ishin të pasigurta për një njeri të arrestuar për komplot dhe të padëshirueshëm për turqit. Ballkani i jugut ishte i pasigurt për një komplotist. Kështu që pas disa javësh në More gjetëm një anije që shkonte në Napoli, i hipëm dhe u nisëm. Napoli sapo ishte pushtuar nga austriakët, të cilët kishin ndihmuar Brankoviçin dhe ky u ndie më i qetë nga kjo rrugë. Komandanti i trupave austriake të Napolit e priti mirë Brankoviçin dhe i ha një letër me anë të së cilës ai mund të kalonte territorin italian për të mbërritur në Vjenë. Napoli ishte një qytet që nuk flinte ose më saktë ditën flinin marinarët dhe punonin napolitanët, natën këta flinin, ndërsa marinarët pinin dhe gëzonin.

Në Napoli rashë me një grua për herë të parë. Një natë, Gjergj Brankoviçi u zhduk nga hoteli ku ne flinim dhe në të gdhirë u shfaq i dehur bashkë me një grua rreth të dyzetave, e cila e mbante për krahu. Gruaja i kishte lyer sytë me ngjyrë blu dhe mbante një fund të gjerë që e tregonte shumë të shëndoshë. Këtu te ne kësaj femre nuk do ia hidhte njeri sytë, por në Italinë e Jugut kanë shije tjetër për gratë. Ata i duan gratë të shëndosha, me vithe të dala dhe me pak bark mbi të cilin burrat ndihen si mbi një dyshek. Kjo grua, pasi vuri Gjergj Brankoviçin në gjumë në krevatin ngjitur me timin, hoqi fundin e saj të gjerë dhe u fut në krevatin tim. Atë natë m'u duk sikur më doli një zog nga barku dhe puplat e tij më mbuluan të tërin dhe më vunë në gjumë. Një prift që takova njëherë në More më ka thënë se njerëzit përpara se të vdesin kujtojnë ditën e parë

që kanë hyrë në kishë sepse ky imazh i afron ata me Zotin. Nuk e di sa është e vërtetë, por di që para se të vdes do doja ta kujtoja edhe një herë ngritjen e fundit të asaj gruaje.

Pasi ikëm nga Napoli, unë dhe Brankoviçi kemi fjetur nëpër hanet e Italisë ngarkuar me plaçkat dhe kujtimet e ditëve në Stamboll. Rruga jonë kaloi nëpër Romë dhe duke u endur nëpër kalldrëmet e këtij qyteti kuptova se çfarë e kishte yshtur Arianit Komnenin dhe familjen e tij të linte Shqipërinë dhe të vinin në Itali. Nuk besoj se ishte vetëm frika nga turqit. Italia, dhe mbi të gjitha Roma, është ndoshta i vetmi vend ku mund të jetosh duke ndjekur gjurmët e veprave të mëdha të lashtësisë, por dhe të krishterimit. Natyrisht edhe ato të ndjekin ty. Në Romë mund të kuptosh se si krishterimi ishte lindur për të çuar më tej oreksin për drejtësi të Perandorisë Romake dhe se si kjo perandori nuk do mund të bashkohej me krishterimin në qoftë se nuk do të ishte ushqyer nga pasioni për të bukurën, që kishin grekët e lashtë.

Kur arritëm në Italinë e Veriut, Gjergj Brankoviçi trokiti te disa miq, të cilët na ndihmuan të kalojmë kufirin pasi pritëm tre muaj të shkrinte bora mes alpeve të Italisë dhe Austrisë. Disa ditë i kaluam në Milano në qiellin e së cilës nuk pashë asnjë ditë me diell, por në këtë vend pashë një pikturë për herë të parë në jetën time. Ishte një beze e madhe e vendosur në një kornizë druri të trashë dhe me brazda. Tregonte predikimin e Shën Markut në Aleksandri. Shën Marku ka qenë njëri nga apostujt besnikë të Krishtit dhe ndoshta i vetmi që nuk e vuri në diskutim natyrën e tij hyjnore. Pas vdekjes së Jezuit ai shkroi ungjillin e tij dhe themeloi krishterimin në Aleksandri. Në pikturë ai është gjysmë i zhveshur me flokë të verdhë dhe me një hundë të gjatë dhe flet i hipur mbi një shkallare në mes të një sheshi të madh. Pas tij ka disa burra të heshtur dhe të veshur me kapela të zeza që duhet të jenë grekë, çifutë ose romakë. Ndërsa përpara tij qëndrojnë arabë me çallma të bardha dhe mjekra të gjata. Arabët diskutojnë me njëri-tjetrin me sa duket për ato që thotë shenjti. Në mes të këtij sheshi të gjerë ngrihet madhërisht një tempull i rrumbullakët që i ngjan kishave të sotme, ndërsa pas saj është qyteti i ndërtuar nga arabët e i mbushur me minare të larta. Në cep të sheshit një deve mban kokën lart duke parë nga Shën Marku. E gjithë piktura kishte një ngjyrë pjeshkë, por pasi e pashë me kujdes kuptova se e vetmja ngjyrë që i mungon është jeshilja. Sa do të doja ta kishte parë im atë. Me siguri do ta kishte quajtur: Bota siç duhet të jetë. Myslimanët dhe kafshët mësojnë krishterimin.

Pasi shtymë dimrin atje, arritëm në Vjenë në prillin e vitit 1708, por gjërat kishin ndryshuar. Austria nuk kishte më nevojë për Brankoviçin dhe askush nuk denjoi ta priste. Kërkesave të shumta të Gjergj Brankoviçit për të ngjallur interesin e një lëvizjeje ballkanike, e cila do t'i merrte turqve territoret e pushtuara në favor të tyre, austriakët iu përgjigjën me një fletë arresti. Gjergj Brankoviçi mundi ta zbuste arrestin pasi takoi një kushëri të largët të perandorit, i cili kishte ndërmjetësuar përpara dhjetë vjetësh mes tij dhe austriakëve. Arresti u anulua, por jo dëbimi nga Vjena. Përfunduam në një fshat të humbur të Austrisë ku, pas disa muajsh, Gjergj Brankoviçi dha shpirt i zhgënjyer nga lojërat e Fuqive të Mëdha, të cilat ishin tallur me kryengritjen e tij.

Gjatë kësaj kohe unë kisha mësuar pak gjuhën gjermane dhe duke u njohur me fshatarët, i punova tokën për gati një vit një familjeje, së cilës i kishte ikur djali në ushtri. Ky ishte kapiten këmbësorie në Bosnjë dhe i binte violinës që unë e pashë për herë të parë kur ai erdhi në shtëpi për pak kohë. I ati i mbyllte veshët kur i biri i binte violinës, ndërsa mua ato tinguj m'u dukën si e qara e djalit tim që nuk kishte lindur akoma, por që me sa duket ishte gati në barkun tim. Kapiteni, kur u kthye në shërbim më mori me vete.

Bashkë me ushtrinë austriake u afrova deri në Raguzë. Gjatë ditëve që qëndrova atje mësova notin. Ushtarët austriakë dilnin në breg të detit dhe një peshkatar tullac u mësonte atyre si të



notonin. Kur më tregonte se si t'i përplasja krahët dhe këmbët dhe si të nxirrja frymën mbi ujë për të mos u mbytur, peshkatari më pyeti se nga isha dhe kur i thashë se jam nga Shqipëria më tha: Do ta mësoj notin se ju keni det dhe ju duhet, por ti mos ia mëso këtë gjë gruas dhe as vajzës tënde sepse në qoftë se ato lahen njerëzit do t'i quajnë të përdala. Në Raguzë gratë nuk laheshin. Kur i pyeta ushtarët austriakë ata më thanë se peshkatari nuk ua kishte thënë atyre të njëjtën gjë. Ndoshta ai mendonte se gratë e tyre duhej ta mësonin notin.

Pas disa javësh në Raguzë, më hipën në një anije, e cila më solli në Shkodër. Atje desh vdiqa nga uria sepse nuk gjeta as punë dhe as strehë për një muaj rresht. Shkodra ishte një vend ku turqit i trajtonin të krishterët si skllëvër dhe ku unë pata shumë ftohtë atë dimër.

Që të mos zgjatem, në 1709 përfundova në Janinë dhe erdha në fshat ku të gjithë e kishin humbur shpresën se do të kthehesha. Nëna ishte plakur dhe tre vëllezërit e mi ishin martuar dhe kishin bërë fëmijë. Ashtu bëra dhe unë. U martova me Hënën, një vajzë shumë të bukur, por të imët dhe të dobët, stërgjyshi i të cilës kishte ardhur bashkë me stërgjyshin tim nga bregdeti dhe bashkë kishin ngritur fshatin. Ata nuk ishin Komnenë, por gjithmonë kishin jetuar besnikërisht nën hijen e madhështisë së fisit tonë. Është e bukur si diell, por nuk ka shumë mish dhe do të ketë gjithmonë ftohtë si hëna, thoshte nëna për gruan time. Atë vit lindi Gjergji dhe brenda dhjetë vjetësh Hëna lindi dhe dy djem të tjerë, por ajo thoshte se ne duhet të kishim nëntë djem siç kishte Arianiti i Madh nëntë vajza. Nuk mund t'i ngjaj kaq shumë Arianitit, i thosha unë. Fshati ynë është i vogël dhe nuk do gjejmë nuse për kaq shumë burra. Fshati ishte i qetë në ato vite dhe ne kishim ujë, bukë dhe të mbjellat nuk munguan. Unë i gëzohesha familjes sime që shtoej, ndërkohë që nëna ime zvogëlohej nga mosha dhe hidhërimi i humbjes së babait. Para se të vdiste, ime më më tha se e vetmja gjë që do të donte ishte të shtrihej në një varr me babanë, që unë e kisha varrosur në Stamboll.

Në vitin 1730, kur djemtë ishin rritur, vendosa të kthehem në Stamboll për të sjellë eshtrat e babait në fshat. Shko merre, më tha Hëna, sepse nëna e pret.

U nisa në verë dhe duke kaluar gjithë rrugën që kishim bërë bashkë me babanë përpara 25 vjetësh arrita në Stamboll në shtator, pa e ditur se ç'po ndodhte aty.

Stambolli ishte një ferr. Kishte shpërthyer një kryengritje jeniçerësh dhe gjithë qyteti ishte në flakë. Jeniçerët që ishin rebeluar kundër vezirit të madh vidhnin, përdhunonin gra dhe masakronin nëpunësit e shtetit. Në krye të tyre ishte Halil Patrona, një shqiptar. Halil Patrona që kishte punuar disa kohë në një banjë turke si masazhier, sepse i kishte duart e forta, kishte hyrë në ushtri dhe ishte bërë i pari i jeniçerëve për shkak të egërsisë dhe oratorisë së tij të ashpër frymëzuese. Ditët e para, duke përfutur nga fakti që njihja Stambollin ku kisha ndenjur gati pesë vjet, u fsheha te një familje greke që bashkë me mua kishte punuar për Dragomanin. Një natë jeniçerët e bastisën lagjen dhe na rrahën të gjithëve si të dehur. Unë i thashë se nuk isha grek, por kisha ardhur rastësisht në Stamboll nga Shqipëria dhe kështu më shpunë te Halil Patrona në të gdhirë. Në vitin 1730 unë isha një burrë mbi të pesëdhjetat, i gjatë, me shpatulla të gjera dhe me mjekër të errët dhe shumë të dendur. Halil Patrona ishte më i ri se unë, por dukej shumë më i madh. Ishte i shkurtër, por këmbët e tij të trasha dhe të forta e tregonin më të gjatë. Kokën e kishte të rruar, por ngjyra e mjekrës tregonte se qimja e tij duhej të ishte e kuqe. Halil Patrona ishte kuq. I thanë se i kishin sjellë një shqiptar dhe më pritë në bodrumin e një taverne të madhe nga ku drejtonte gjithë bastisjen e Stambollit që ai e quante revolucion. Çdo minutë atje vinin jeniçerë të zbatuar që sillnin ora muri si dhe argjend e bizhuteri grash që i shtrinin mbi tavolina në mënyrë që Halili të mund t'i shijonte. Më pyeti turqisht në ishte e vërtetë që isha shqiptar dhe i thashë po. nga cili vend je, më tha. I tregova se isha nga një fshat afër Janinës. Unë jam nga

Vlora, më tha. Kam ardhur i vogël në Stamboll. Patrona që ishte tmerri i Stambollit, kishte dy sy të vegjël, por të ëmbël. Mua m'u duk njerëzor kur po fliste për origjinën e tij dhe e pyeta shqip nëse ishte mysliman apo i krishterë. Unë jam jeniçer, ma ktheu turqisht dhe pastaj më pyeti se pse isha në Stamboll. Kur i thashë se unë jetoja në Shqipëri, por kisha ardhur për të marrë trupin e tim eti më tha se edhe ai kishte një djalë, por nuk e dinte nëse i biri do arrinte t'ia gjente trupin kur të vdiste, sepse jeniçerët, tha, nuk kanë varr si gjithë të tjerët, ata ose copëtohen, ose mbeten në fushë të luftës dhe ushtria nuk mund t'i tërheqë dot sepse kur vdes jeniçeri, betejën e ka fituar armiku.

Unë mbeta gati dy javë në bodrumin e Halil Patronës. Megjithëse ishte zot i atij kaosi më tha se nëse dilja në qytet ndoshta nuk do të kthehesha dot i gjallë. As që bëhej fjalë për të zhvarrosur trupin e babait dhe për ta transportuar nga varrezat në port. Ato ditë, duke fjetur mbi një tavolinë të vogël prej druri kuptova se sa e kalbur ishte nga brenda karrigia e Islamit turk, këmbët e së cilës megjithatë kishin qindra vite që na shtypnin. Halil Patrona dhe shokët e tij, kur u lodhën duke grabitur dhe vrarë kaluan në kërkesa të forta ndaj Sulltanit, të nxitur edhe nga disa islamistë fanatikë, të cilët kishin qenë gjatë gjithë kohës kundër stilit evropian dhe artistik të qeverisjes që kishte ushtruar Sulltan Ahmeti. Vitet e fundit, Ahmeti III, siç e quanin, i kishte shtuar shpenzimet për zbukurimin e Stambollit dhe kishte nisur madje të vizatonte portretet e sulltanëve në muret e xhamive, gjë që islamistët e konsideronin një blasfemi të rrezikshme. Ahmeti ishte i dashuruar me lulet dhe për t'u tallur me jeniçerët, të cilët i urrente, i vuri ata të mbillnin kopshtet e Stambollit me tulipanë që ishte lulja që ai dashuronte dhe e quante simbol të sulltanatit të tij gjithë ngjyra. Do t'ia shkull fletët atij tulipani pederast, bërtiste Halil Patrona, sa herë që i thoshin se trupat e qeverisë kishin marrë lagje të ndryshme të Stambollit nën kontroll. Një natë, kur nuk e zinte gjumi, më tregoi se familja e tij kishte qenë e krishterë dhe Halilin e vogël e kishin marrë turqit si devshirme, siç kishin bërë me qindra djem që i marrin dhe sot si taksë nga familjet e krishtera. Atij i kujtohej deti i Vlorës dhe thoshte se ai ishte më i pastër se deti që lagte Stambollin. Llagapin Patrona ai e kishte marrë kur i kishte shërbyer një gjenerali francez, i cili kishte jetuar shumë vjet në Stamboll duke ndihmuar sulltanin të ngrinte armatën e bombardierëve. Ai më mësoi t'i drejtohesha patron dhe kështu më mbeti ky llagap, tha Halili. Ky njeri u soll shumë mirë me mua deri në fund. Nga dita në ditë unë e shihja sesi egërsohej sepse me sa duket po kuptonte se revolta e tij nuk do mund ta rrëzonte shtetin. Vazhdimisht i vinin habere për marrëveshje nga Sulltani, por Halil Patrona i kërkonte shkarkimin e vezirit të madh, të cilin e konsideronte si armik të perandorisë dhe si një njeri të dështuar.

Një ditë në mëngjes më zgjoi nga gjumi dhe më tha të bëhem gati për t'u nisur. Ku të shkoj, i thashë unë. Nisu për Shqipëri, tha ai. Kemi lejuar një anije greke bashkë me konsullin grek që të dalë nga porti, shko dhe ti me ta. Dua të marr eshtrat e tim eti, i thashë, nuk mund të iki duarbosh në fshat. Ik sa nuk është vonë, më tha. Porti do mbyllet dhe unë nuk mund të të strehoj më se duhet të dal dhe të rregulloj ca punë dhe nuk e di a do kthehem më. Kur u ndamë, më dha një nga unazat që jeniçerët e tij kishin vjedhur ato ditë nëpër shtëpitë e qytetit. Unaza ishte shumë e madhe, me fushë të bardhë mbi të cilën skuqte një hurmë prej rubini. Merre këtë, tha, sepse dua që diçka nga unë të kthehej andej nga kam ardhur. Ma futi në gisht dhe iku. Njerëzit e tij më shpunë deri në port dhe pas dy muajsh u ktheva në fshat nga Selaniku dhe Voskopoja. Sulltan Ahmeti dha dorëheqjen për shkak të Halil Patronës pas 27 vjet qeverisje. Sulltani i ri, që erdhi në krye të Perandorisë, në fillim e mashtroi dhe në nëntor të atij viti ia preu kokën Halil Patronës. Por këto unë i mësova kur shkova në Stamboll për herë të tretë.

Kur u ktheva në fshat, njëri nga vëllezërit kishte vdekur. Djemtë m'u dukën më të mëdhenj dhe në mungesën time kishin nisur të punonin tokat tona. Fshati më zgjodhi kryetar të pleqësisë jo vetëm sepse ne e kishim traditë familjare, por edhe sepse si një njeri që kisha parë botën dhe kisha mësuar gjuhë, besonin se unë mund ta drejtoja me urtësi në trazirat që vinin nga të katër anët. Siç të thashë, gjatë udhëtimeve të mia, kisha ndaluar në Voskopojë, ku kisha zënë miq. Në Voskopojë, bashkë me babanë, kishim fjetur në një manastir dhe atje ishim miqësuar me murgun Grigor, i cili më vonë u bë tipografi i parë i shtypshkronjës. Shtypshkronjën unë e pashë vetë kur u nisa për në Stamboll për herë të dytë më 1730. Ajo ishte një makinë e madhe e zezë që Grigori mezi e komandonte me duart e tij të dobëta. Kur fletët me bojë të zezë dilnin prej andej, Grigori dhe ndihmësi i frynin derisa thaheshin dhe pastaj i prisnin me disa thika të posaçme, gjersa ato vinin në madhësinë e një libri. Shtypshkronjën e kishin blerë në Venedik disa pasanikë voskopojarë, për të shtypur librat e Akademisë së tyre. Mirëpo rrugët e tregtisë së Voskopojës, nga Selaniku dhe Rumania filluan të bllokoheshin nga bandat myslimane të Korçës dhe Beratit, të cilat e plaçkitnin herë pas here qytetin, duke grabitur tregtarët dhe karvanët e tyre. Shtypshkronja u bllokua për gjashtë muaj sepse karvanët që sillnin letër nga Rumania u vodhën dhe letra u dogj. Grigori më dërgoi fjalë dhe më kërkoi ta ndihmoja për të sjellë letër nga rruga e Janinës, e cila ishte më e sigurt. Për shumë vjet porosisja letër, e cila vinte nga Venediku në Raguzë dhe prej andej në Durrës nga ku ne e merrnim dhe e nisnim në Voskopojë.

Kur shkova në Raguzë takova në breg të detit sërish peshkatarin që më mësoi notin dhe për disa vjet ai punoi për ne, si agjent në Raguzë, ku siguronte shkarkimin dhe nisjen e letrës prej liri dhe pambuku, të cilën e ruante si shami nga uji. Për gati dhjetë vjet u mora vetë duke ndjekur karvanët që shpesh vidheshin nga kaçakët, por po aq shpesh edhe kuajt ngordhnin apo shkisnin nëpër humnerat e ngrira.

Kur Hëna u sëmur, unë i lashë karvanët dhe me to filloi të merrej im bir Gjoni, që ka një aftësi të madhe për t'u marrë vesh me tregtarët e letrës në Venedik si dhe për të bërë miqësi me hajdutët e rrugëve. Djalin e dytë, kur u ktheva nga Stambolli, e çova në Akademinë e Voskopojës. Ai është akoma atje.

Hëna lëngoi dy vjet në shtrat dhe Gjergji, që gjithmonë kishte qëndruar me të, i shërbeu si një vajzë. E lante, e ushqente, e krihte, e zbukuronte për festa dhe e ledhatonte, por një natë nga ethet e saj, Hëna i thirri: bir kam ftohtë. Djali iu shtri te këmbët për ta ngrohur, por e ëma nuk u kthye më. Kur e varrosëm binte shi. Gjergji nuk qau, por që atë ditë ndryshoi dhe u ftoh me botën sikur të kishte trashëguar dimrin nga trupi i së ëmës. Shkoi në pyll, rrethoi një vend me gurë dhe ndezi një zjarr të madh me shkarpa të thata, sikur donte të thante lotët. Zjarri vazhdoi tri ditë dhe Gjergji duke parë zjarrin qante për të ëmën. Hiri i drurëve të djegur u rrit deri në lartësinë e gurëve dhe atje ka mbetur edhe sot e prandaj atë vend e quajnë Guri i Hirit.

Pasi vdiq Hëna, unë iu kushtova. Drejtua vijën e ujit, ndërtoam disa çezma, shtruam kalldrëm dhe ngritëm një kishë të vogël që prifti e vizitonte një herë në muaj, por që ne na mjaftonte për t'u lutur, për pagëzime, për dasma dhe morte. Gjoni ndiqte karvanët e letrës, Mihali jetonte në Voskopojë, ndërsa Gjergji ngrysej dhe gdhihej duke punuar tokën, si i marrë. U martua me Kostandinën, vajzën jetime me sy jeshilë, që ishte lindur dhe rritur në shtëpinë tonë pasi edhe babai i saj u vra në Kretë. Por as gruaja dhe as toka nuk e ngrohën dhe tim bir dhe vetëm pas shumë vitesh martesë atij i lindi një vajzë që ia vuri emrin Hana në kujtim të nënës që e kishte dashur aq shumë. Vajza që tani është gruaja e Vasilit, vëllait të Ibrahimit, i kishte sytë jeshilë si e ëma dhe flokët e zinj si i ati. Kur shikoja sytë e saj jeshilë mua më kujtohej babai.

Kur Hana mbushi dy vjeç, u nisa për herë të tretë në Stamboll, në vitin 1753. Megjithëse isha gati 76 vjeç ndihesha i fortë dhe besoja se do t'ia dilja një aventure të re sepse Turqia ishte qetësuar në ato vite dhe unë isha më i pjekur dhe më i pasur. Mendoja, pra, se me përvojë dhe me para mund t'i kapërcejja rreziqet që kisha hasur në dy udhëtimet e mia të para.

Në Stamboll qeveriste Osmani III, të cilin njerëzit e konsideronin si një Sulltan të ngathët dhe dembel që i kishte kufizuar liritë e të krishterëve, por edhe ato të myslimanëve. Osmani i kishte ndaluar gratë të dilnin në shëtitorët dhe lulishtet e qytetit dhe Stambolli në ato kohë ishte një qytet i zyrtë burrash. Po ashtu, me një ferman të veçantë ishte ndaluar pirja dhe tregtimi i verës për të gjithë. Mirëpo pranë portit në Stamboll, aty ku mblidheshin marinarët, tregtarët dhe kontrabandistët, mund të gjejë nën banakë verë sa të doje dhe pronarët e tavernave i blinin me bakshishe të mira kontrollat e rrepta të qeverisë. Taverna nga ku, përpara njëzet vjetësh, Halil Patrona drejtoi bastisjen e qytetit, ishte nga më të zhurmshmet. Hija e Halilit të tmerrshëm që rrëzoi Sulltanin e Tulipanëve ishte zhdukur dhe pronari i ri nuk kishte aspak qejf t'ia kujtoje ato ditë terrori. Aty gjeje verë, femra, duhan dhe mund të takoje tregtarë dhe nëpunës të korruptuar me të cilët mund të zgjidhje çdo hall. Një të diel pasdite, me ndihmën e një mbikëqyrësi të varrezave dhe dy turqve të vegjël që pagova për zhvarrosjen, nxora eshtrat e babait, të cilat i pastruam një nga një nga dheu dhe krimbat e viteve. Babai kishte qenë një burrë shtatlartë dhe kockat e tij të gjata mezi u futën në një arkë të vogël të dyllosur dhe të lyer nga brenda me qirinj të shkrirë, të cilën e mbaja poshtë krevatit ku flija. Pa vështirësi, mora një dokument me emrin dhe datën e vdekjes së babait që ishte i domosdoshëm për të kaluar doganën turke. Tani më duhej të gjeja një anije për t'u kthyer. Por Stambolli ishte një qytet që mund t'i falte akoma kënaqësi një shtatëdhjetegjashtëvjeçari të mbajtur dhe të fortë si unë, që e dinte mirë se kjo ishte hera e fundit që vinte në këtë qytet. Prandaj nuk kisha ngut dhe ditën shëtisja në rrugët dhe lagjet e Stambollit, ndërsa natën i jepesha verës së ndaluar dhe miqësive të shpejta, si të gjitha miqësitë që ngjizen në pranverë.

Një nga këto net të gëzueshme u njoha me një tregtar grek, Jorgon Mavromatisin, i cili më tha se kishte ardhur të blinte verë në Stamboll dhe për disa ditë do të nisej bashkë me ngarkesën për në Selanik. Pavarësisht nga konsumi i tavernave të natës, fermani i Sulltanit e kishte kufizuar shumë shitjen e verës dhe tregtarëve të Stambollit i kishin mbetur mijëra fuçi, të cilat kishin nisur t'i shisnin badihava për të zbratur magazinat. Ky ishte një rast i mirë për të udhëtuar aq më tepër që unë kisha lidhur miqësi me grekun dhe gruan e tij çifute Sheba që ai e kishte marrë me vete në një udhëtim që ajo e konsideronte turistik.

U nisëm më 29 maj 1753.

Pikërisht atë ditë, treqind vjet më parë turqit kishin pushtuar Kostandinopojën.

Të tre: unë, greku dhe e shoqja ishim mbi kuvertë kur anija u shkëput nga porti i Stambollit. Shtëpitë e bardha, të shtrira në të dy kodrat mbi Bosfor filluan të zvogëlohen ndërsa minaret e shumta holloheshin në largësi, aq sa dukeshin si shtiza, të cilat gratë i ngulin mbi qëndisjet e tyre, që të mos humbnin nëpër shtëpi.

Çfarë do të mund ta kishte ndaluar Sulltan Mehmetin të mos e pushtonte këtë qytet para treqind vjetësh, thoshte Jorgo, duke parë në horizont. Asgjë, përgjigjej Sheba, që dukej sikur fliste me vete. Kostandinopoja kishte rënë shumë vjet përpara se të vinin turqit, që kur perandorët e saj kuptuan se krishterimi ishte një farë që nuk mund të hidhte rrënjë në Azi. Ata u dembelosën derisa hoqën dorë, siç bën çdo njeri që provon më kot të mbjellë një qiparis në shkretëtirë. Myslimanët, të cilët nuk kërkojnë diell, por vetëm hije, e mbuluan shkretëtirën me çallmën e tyre

dhe një cep i saj kaloi detin dhe mbeti këtu. Në përgjithësi, Sheba i jepte një shpjegim poetik historisë gjë që nuk e bindte burrin e saj, i cili, për shkak të natyrës së tij tregtare, besonte se çdo dështim e ka burimin në paaftësinë për t'i ofruar dikujt një marrëveshje të leverdishme shkëmbimi. Krishterimi dhe Islami mund ta kishin ndarë botën me marrëveshje, këmbëngulte Jorgo, por pas një mijë vjetësh kaluar në qejf dhe intriga, bizantinët ishin aq të lodhur sa ç'është një tregtar, i cili, pas një nate të gjatë me verë dhe femra, në mëngjes ia këput gjumit dhe nuk shkon në Pazar. Po të ishin vendosur fatet e botës në Pazar, siç thua ti, çifutët do kishin një perandori të përjetshme, thoshte Sheba duke psherëtirë dhe rregullonte shallin e verdhë që ia merrte era. Udhëtuam kështu për gati një javë nga Bosfori në Canakala. Deti ishte i qetë dhe brigjet që shtriheshin në të dy anët e anijes sonë të krijonin përshtypjen sikur po lundronin në një lumë të shurdhët. Natën nxirrnim karriget mbi kuvertë dhe pinim verë me havjar dhe fruta të thata dhe arra të vogla të lyera me bojë që Sheba i kishte blerë në Stamboll.

Jorgo dhe Sheba kishin pesë vjet që ishin martuar, por muaji i mjaltit, siç thoshin ata, akoma nuk kishte mbaruar. Ai kishte pasur një histori të shëmtuar me gruan e parë me të cilën ishte ndarë. Jorgo ishte pesëdhjetë e pesë vjeç, ndërsa Sheba i kishte kaluar të dyzetat, por lëkura e saj e zeshkët dhe hunda e vogël e tregonin më të re. Nuk kishin fëmijë dhe vazhdimisht Sheba bëhej nervoze kur i shoqi, për ta qetësuar, thoshte se zakonisht fëmijët lindin pas muajit të mjaltit. Kur të arrijmë në Selanik kjo fara e hurmës do të ketë mbirë në barkun tënd, i thoshte Jorgo duke ndarë një hurmë përgjysmë që ia afronte asaj te goja.

Sa kaluam ngushticën e Canakalasë qielli u prish. Dallgët mbushën kuvertën dhe fuçitë e verës ulërinin si të dehura nga era e tyre. Kapiteni tha se anija ishte shumë e ngarkuar dhe se duhej të ndalonim diku për të pritur përmirësimin e motit. Ishulli më i afërt ishte Lesbosi dhe në mëngjes, pasi kishim lodhur zorrët gjithë natën, ankoruam me vështirësi në qytetin e Mitilinës. Në mes të shiut dhe vetëtimave të Egjeut zbritëm nga anija, të lagur deri në mish. Sheba dhe Jorgo futën paratë e tyre në një qese të vogël, por plaçkat dhe dhuratat që kishin psonisur në Stamboll i rregulluan me kujdes dhe i lanë në anije. Edhe unë e lashë baulen time me të tyret, ndërsa arkën me eshtrat e tim eti e mora me vete. Pasi gjetëm një hotel të vogël, kapiteni i anijes erdhi dhe kërkoi Jorgon. Të duan në port, i tha. Doganierët po kontrollojnë anijen. Jorgo u nis me të shpejtë dhe pasdite Sheba erdhi e irnosur në fytyrë dhe më tha se i shoqi kishte përfunduar në burgun e qytetit. Gjatë kontrollit të anijes, doganierët kishin gjetur ngarkesën e verës. Lesbosi ishte ishull i pushtuar nga turqit dhe fermani i Sulltan Osmanit, që më kishte njohur me Jorgo Mavromatisin, në një tavernë ku pihej verë kontrabandë, ishte në fuqi. Për Jorgon, kapitenin dhe tetë marinarët u lëshuan urdhër arrestet që u zbatuan menjëherë. Anija dhe vera u sekuestruan. Shebën nuk e lanë të merrte as baulët e veta me rroba dhe unë falënderova Zotin që kisha marrë me vete arkën ku prehej babai im. Kur ajo u përpoq t'i bindte autoritetet e limanit se vera ishte nisur për në Selanik dhe jo për në Lesbos ata i thanë se kjo e bënte njëllor fajtor burrin e saj, sepse edhe Selaniku ishte nën hyqmin e Portës së Lartë dhe fermani i Sulltanit vepronte dhe atje. Jorgo Mavromatisi u dënua me tre vjet burg për shkelje të fermanit si dhe për mashtrim me dashje të doganës turke. Të tjerët morën dënime më të vogla pasi dëshmuuan se Jorgo nuk u kishte treguar se fuçitë ishin të mbushura me verë, por me vaj ulliri.

Mitilina ishte një qytet i vogël që shihte nga brigjet aziatike dhe grekët që ishin aty prej kohësh kishin humbur njerëzillëkun dhe ishin bërë mizorë si turqit që i mbanin ata të robëruar. Sheba u trondit nga burgosja e Jorgos, por si një çifute e shkathët, e ushquu veten me shpresën se do të mund ta blinte lirim e tij me para. Pas disa ditësh në hotel, ne vendosëm të banojmë në një shtëpi, në të cilën zumë me qira dy dhomat e katit të dytë, ndërsa të zotët u ngushtuan në të parin.

Për dy muaj, pa u lodhur, Sheba harxhoi një pjesë të parave që kishte, me dhurata dhe bakshishe për të gjithë turqit dhe grekët që ajo mendonte se mund të ndikonin në uljen e dënimit të Jorgos. Grekët i merrnin paratë duke i thënë se ato ia jepnin turqve, ndërsa turqit i thoshin Shebës se ajo duhej të priste dhe pak që fermani i verës të anulohet, pasi edhe në Stamboll ai kishte krijuar shumë pakënaqësi. Bashkë me të, prisja dhe unë, duke fjetur mbi eshtrat e babait që i mbaja poshtë shtratit. Sheba nuk ma kërkoi kurrë, por unë mendoja se do të ishte poshtërsi që ta lija atë grua vetëm në një ishull armiqësor që i kishte marrë burrin. Kur ajo shkonte të takonte Jorgon, të cilit i thoshte se duhej të bënte pak durim sepse fermani mund të zhbëhej nga dita në ditë, unë shkoja buzë detit dhe shikoja anijet që kalonin përballë. Në këtë ishull nuk mund të bëje miq, por mua më dukej se grekët aty ishin mësuar me njerëz si ne, që shpenzonin para duke pritur lirimin e të burgosurve dhe kjo i kishte bërë ata më të pashpirt.

Lesbosi është ishulli i parë, pasi kalon ngushticën e Canakalasë për të dalë në Egje. Edhe Bizanti, edhe Perandoria Turke e kishin përdorur shpesh ishullin si vend internimi. Perandorë të mundur dhe sulltanë të rrëzuar ishin sjellë në Lesbos gjatë shekujve dhe shumë kishin vdekur atje në mjerim dhe harresë. Unë nuk dija asgjë për historinë e këtij vendi. Një natë të nxehtë korriku, duke shëtitur përgjatë bregut të mbushur me gurë të bardhë dhe leshterikë, Sheba më tregoi për Safon, poeteshën e shquar të Greqisë së lashtë, e cila e kishte bërë të njohur Lesbosin. Safoja dashuronte gratë dhe prej emrit të këtij ishulli, një grua që dashuron një grua, quhet lezbike. Pas dy muajsh që kaluam bashkë Sheba ishte më e çlirët. Për shkak të moshës dhe pa e kuptuar, unë kisha fituar aftësinë për të dëgjuar gjë që nuk e kam pasur në rininë time. Sheba më tha se aftësia për të dëgjuar, sipas çifutëve, ishte cilësi e njerëzve që duan të njohin botën. Edhe unë këtë kam bërë, i thashë. Kam njohur botën duke ndjekur babanë tim. I tregova Shebës historinë e familjes sime. I thashë sesi u vendosën Komnenët e parë në Shqipëri, pastaj sesi emigroi Arianit Komneni në Itali bashkë me nëntë vajzat dhe djemtë e tij, pastaj sesi babai im u nis në kërkim të Komnenëve në Stamboll dhe në fund sesi unë vetë u nisa në kërkim të tij. Kur unë flisja, sytë e zinj të Shebës nguleshin fort mbi ballin tim, sikur aty ajo donte të gjente një arsye të veprimeve të mia. Më ndërpriste vazhdimisht dhe më pyeste:

Pse Arianit Komneni i dha Skënderbeut për grua Donikën dhe jo një nga vajzat e tjera, pse njëri nga djemtë e Arianitit u kthye prapë në Shqipëri, pse babai më mori mua me vete në Stamboll dhe jo një nga vëllezërit e tjerë, pse unë nuk i mora eshtrat e babait që kur lashë Stambollin për herë të parë me Gjergj Brankoviçin? Unë nuk kisha përgjigje për pyetjet e saj, por fillova të mendoj seriozisht se sikur Komnenët të mos ishin vendosur në Janinë, por diku tjetër para pesëqind vjetësh, se sikur Skënderbeu të ishte martuar me një nga vajzat e tjera të Arianitit të madh, sikur babai të mos më kishte marrë mua me vete në Stamboll, por një nga vëllezërit e mi, se sikur unë ta kisha kthyer babanë e vdekur në varrezat e fshatit, ndoshta historia ime do të kishte qenë ndryshe. Mund t'i kisha kursyer vetes shumë dhimbje dhe fatkeqësi, i thashë Shebës. Aspak, tha ajo. Mos e ngushëllo veten. Madje edhe takimin me mua nuk do ta kishte shmangur dot edhe sikur në vendin tënd të ishte njëri nga vëllezërit e tu. Besoj se historia është një kalë i bardhë që e zbrit çdo njeri atje ku e ka marrë, por për shkak të shpejtësisë njeriut i duket sikur ndërrohet vend. Ty akoma nuk të ka zbritur dhe unë shpresoj të takohemi një ditë që të më tregosh se ku të la, më tha Sheba duke buzëqeshur me dinakëri si një njeri që di fundin e një përralle dhe që e shtyn një fëmijë që ta gjejë vetë atë duke i bërë pyetje të vështira. Po më fsheh fundin e përrallës sime, i thashë, duke iu përgjigjur edhe unë me një vështrim të ëmbël mosbesues. Fundin duhet ta gresh ti vetë, m'u përgjigj. Por unë besoj se në tregimet çifute të Testamentit të Vjetër gjendet kuptimi i asaj çfarë po jeton bota sot. Testamenti i Vjetër është një histori që tregon sesi janë ndarë popujt e botës dhe që atëherë nuk janë bashkuar dot më. Ndërsa Testamenti i Ri është

një përpjekje naive për ta bashkuar botën, por në të vërtetë, ai e ndan më keq se i pari, pasi përfundon me një vrasje të papritur, të cilën po e vuajmë të gjithë.

Sikur unë të kisha shkruar Testamentet, nuk do t'i shtoja asgjë tjetër përveç një shënimi në fund: këto përralla i tregohen njerëzve jo për t'i vënë në gjumë, por për t'i zgjuar nga gjumi, më tha ajo një ditë, kur, duke u endur nëpër plazhin e Lesbosit, më tregoi sesi familja e saj kishte ikur nga Spanja në vitet 1400 kur inkuizicioni i krishterë atje masakroi me mijëra çifutë. Ata që nuk pranuan të bëhen të krishterë u larguan dhe familja ime që ishte një nga këto u vendos në Selanik.

Gjyshi i saj kishte qenë rabin në sinagogën e Selanikut, ndërsa i ati ishte marrë me tregti. Të dy kishin vuajtur nga një dobësim i trashëguar kockash që kthehet në paralizë kronike dhe ajo si vajzë e vetme i kishte shërbyer të dyve për shumë vjet në shtëpi, duke u privuar nga miqësitë e rinisë që mund t'i jepnin një martesë me dashuri. Jorgo Mavromatisi kishte shërbyer si ndihmës i të atit dhe pas vdekjes së tij kishte ndjekur biznesin e familjes. Për shkak të udhëtimeve tregtare, Jorgo nuk rrinte shumë në Selanik. Një ditë kur ishte kthyer, pa lajmëruar, kishte gjetur në shtëpi gruan e tij greke me vëllanë e tij dhe ishte ndarë. Ai i kërkoi Shebës të martoheshin dhe ajo e vetme, në moshën tridhjeteshtatëvjeçare, nuk kishte pasur zgjidhje më të mirë. Kur e pyeta nëse kishte qenë e lumtur nga martesa me Jorgon, ajo më tha se po të kishin pasur një fëmijë do të kishte qenë edhe më e lumtur. Por në qoftë se Jorgo nuk lirohet shpejt, fëmija im nuk ka për të lindur kurrë, tha ajo, duke fshehur sytë nga unë.

Mbrëmjet tona në Lesbos ngryseshin me biseda për historinë, fetë dhe vendet që kishim parë, ndërsa mëngjeset ishin të mbushura me takimet që Sheba kishte nëpër zyrat e turqve dhe kafenet e ndërmjetësve grekë. Shpresat për lirim e Jorgo Mavromatisit sa vinin e zbeheshin, por kjo nuk e plogështoi Shebën, të cilën ky qëllim e bëri edhe më të devotshme. Nga fundi i tetorit, në ishull zbarkoi dimri. Dallgët nazelie të Egjeut përplaseshin në liman dhe stërkalat e tyre vishnin xhamat e shtëpisë ku banonim. Shëtitjet tona në breg u rralluan, për t'iu kushtuar darkës së thjeshtë që Sheba e gatonte duke fshehur nën leshterikë të pastruar dhe gjethe limoni kufizimet e tepruara të kuzhinës së fesë së vet. Pastaj rrinim ulur të dy, me karriget nga deti, dhe kalkulonim të ardhmen e jetëve tona. Në një nga këto net, ajo mbështeti kokën mbi supin tim dhe për një kohë mbeti ashtu me sy mbyllur. Aty e kuptova se marrëdhënia me këtë grua ishte një ishull ku Zoti më kishte ndaluar për të pasuruar jetën time. Për dhjetë ditë rresht ne e përsëritëm këtë skenë çdo natë dhe në çdo detaj të saj pa ndryshuar asgjë, aq sa një ditë Sheba më tha se po e përsërisnim veten si në lutjen e mbrëmjes. Ndoshta ajo dhe lutej ashtu, ndërsa unë mendohesha nën dritën e një qiri të vendosur mbi dritare, i cili shpesh më dukej si një fanar mbi det. Shikoja dritën e qiriut që zgjatej mbi dallgë dhe përpiqesha të gjeja se në cilin vend do të ndalonte.

I ftohti i nëntorit kapërceu nga deti dhe hyri në dhomën tonë, gjë që na afroi më shumë dhe kur, duke e mbështjellë Shebën me krahun tim, e putha në buzë ajo reagoi siç reagon çdo njeri ndaj një gjëje që e pret prej kohësh.

Atë ditë bëmë dashuri në qetësinë tonë.

Bashkimi i një burri shtatëdhjetegjashtëvjeçar me një grua dyzetetrevjeçare nuk është si bashkimi i zakonshëm dhe i përditshëm i çdo burri dhe çdo gruaje tjetër. Ai i ngjet bashkimit të një gjysme limoni të tharë me një gjysmë portokalli të pjekur, të cilët, pasi ngjiten për një kohë të gjatë nga lëngjet e tyre, nga një anë duken si një diell i kuq në perëndim dhe nga ana tjetër si një hënë e verdhë në agim. Por ngado që ta kthesh këtë rruzull ai fal ngrohtësi. Një varg i pashpjegueshëm i Safos që Sheba e kishte shumë të dashur thoshte: *ti më jep nxehtësi*. Këtë kishim bërë unë dhe Sheba në acarin e jetës sonë. Kishim kërkuar nxehtësi te njëri-tjetri. Kjo nxehtësi po e ngroh akoma dhe sot jetën time.

Natën e krishtlindjeve Lesbosi u zbardh nga dëbora. Unë kisha blerë peshk, karkaleca, zogj deti dhe mish qengji. Sheba më kishte thënë se atë natë do gatuante si greke dhe tavolina jonë ishte më e pasur se kurrë. Po pinim verë me arra duke shijuar dëborën që shkrihej mbi det, kur Sheba më tha se priste një fëmijë. Qau derisa e zuri gjumi, por kur ajo fjeti, pashë që fytyra e saj ishte kredhur në paqe. Unë mbeta zgjuar deri kur u zgjua dhe ajo. E pyeta se çfarë mendonte të bënte me barrën e saj, por ajo ishte e vendosur dhe më tha se nuk e çonte ndër mend të hiqte nga trupi i saj një krijesë, të cilën kishte vite që e priste. Nuk guxova t'i kujtoj rrezikun e martesës së saj me Jorgon, për shkak të fëmijës, sepse ajo më tha se gjithnjë kishte dashur një fëmijë dhe jo një martesë jetime. Jorgo nuk do të lirohet edhe për disa vjet dhe unë nuk mund ta shtyj jetën time duke e pritur e vetme. Kur të lirohet do t'ia shpjegoj dhe ai le të vendosë si të dojë, më tha. Ç' do t'i thuash, e pyeta. Do t'i them se fjala e tij shkoi në vesh të perëndisë. Një farë hurme mbiu në barkun tim, siç e parashikoi Jorgo kur u nisëm nga Stambolli.

Në fund të janarit barku i Shebës filloi të rritej dhe faqet e zeshkëta iu skuqën. I nisëm të vjellat dhe për disa ditë nuk u ngrit dot nga shtrati. Pas disa javësh ajo do të dukej edhe më e shëndoshë dhe barra e saj nuk do mund të fshihej më. Ndoshta duhet të ikim nga Lesbosi, i thashë. Njerëzit këtu e dinë që ne nuk jemi të martuar dhe lidhjen tonë do ta quajnë një turp, gjë që mund të ndikojë edhe në sjelljen ndaj Jorgos. Në Lesbos e dinin se Sheba priste të shoqin e burgosur, ndërsa unë isha prezantuar si xhaxhai i saj. Qyteti i Mitilinës ishte shumë i vogël dhe pa dyshim që fjala do t'i arrinte një ditë Jorgos në burg çka do të ishte një tragjedi e re për të. Për këtë arsye nuk mund të thërrisnim një doktor, i cili mund të kujdesej për barrën e Shebës. Shkojmë në Selanik, i thashë, por ajo më kundërshtoi. Nuk mund të shkoj në Selanik në këtë gjendje në mes të dimrit. Do rrezikoja veten dhe fëmijën. Udhëtimi në det do të më vdesë. Shkojmë në Kretë, i thashë. Është ishulli më i afërt dhe udhëtimi deri atje në mot të mirë nuk mban më shumë se një ditë. Atje kam dhe eshtrat e vëllait të madh. Sheba nuk u mendua shumë. Shkojmë, më tha, atje ka kohë që të presin.

Pas disa ditësh ajo e mori veten dhe koha u përmirësua. Gjeta një anije, mora Shebën dhe arkën me babanë tim dhe u nisëm. Deti nuk e mundoi shumë Shebën, e cila atë ditë ishte e qeshur dhe më tha se me siguri do të lindte një djalë. Nga e kupton, e pyeta. Nga ty, m'u përgjigj me ledhati. Ti i ngjan Abrahamit me këta flokë të bardhë, me trup të drejtë dhe sy të mëdhenj që nguleshin në vendet ku ai u end deri në fund të jetës për të kërkuar një copë tokë për varr. Abrahami në fillim pati vetëm djem. Gruaja e tij Sara vuajti shumë vjet dhe u mbars në moshë të thyer atëherë kur i kishte humbur shpresat. Ti je Abrahami im dhe djalin tonë do ta quajmë Isak si djalin e tij, thoshte Sheba e lumtur duke mbushur flegrat dhe barkun e saj me ajrin e pastër të Egjeut. E di ç' do të thotë Isak? Mbylla sytë për t'i thënë jo. Isak do të thotë i qeshur, në gjuhën që fliste Abrahami, i cili e quajti të birin kështu sepse ditën që mori vesh që mund të lindte një fëmijë, gruaja e tij qeshi shumë gjatë.

Pasdite ullinj të zinj të Kretës u ngritën mbi det. Kreta konsiderohej si Ishulli i Madh dhe askund më shumë se këtu nuk ishin përplasur në shekuj grekët me turqit. Kreta iu mor bizantinëve grekë nga venecianët latinë që në vitin 1204, vit kur Komnenët lanë skeptrin e tyre dhe ikën nga Kostandinopoja. Kreta është vendosur mbi det, në një mënyrë të tillë sa që duket sikur thotë: Nga unë kalon rruga për në perëndim. Turqit e kuptuan se duhej ta pushtonin me çdo çmim për të ecur më tutje. Ata vuajtën njëzetepesë vjet në rrethimin e Kretës, por në vitin 1669 gjetën një Sulltan të zgjuar dhe mizor, që e pushtoi. Ky ishte një shqiptar, Fazil Pasha Qyprilliu. Vëllai im vdiq në mbrojtjen e këtij ishulli sepse babai besonte se rënia e Kretës nuk do t'i ndalte më turqit dhe pati të drejtë. Im vëlla vdiq kur ishte tetëmbëdhjetë vjeç dhe unë nuk kisha lindur



akoma. Ia thosha të gjitha këto Shebës, e cila më ndiqte me vëmendje. Kur mbarova, më kapi dorën dhe më tha: Këtu ke humbur një Komnen, por do të gjesh një Komnen tjetër. Ia afrova dorën te barku dhe m'u duk sikur fëmija lëvizi për të më përshëndetur.

Në kryeqytetin e Kretës, në Kandi, hymë kur dielli po binte në det. Atë natë fjetëm në një hotel pranë portit dhe të nesërmen gjetëm një shtëpi të bardhë me një oborr të mbushur me limona, të cilëve një arrë e madhe ua jepte diellin me kursim. Sheba e rregulloi dhomën tonë, ndërsa unë e futa babanë tim poshtë krevatit prej hekuri, ku flinim.

Ato shtatë muaj ajo ndenji më shumë shtrirë në atë krevat dhe unë blija ushqime dhe gatuaja shpesh për të dy. Grekët e Kretës ishin shumë më miqësorë se në Lesbos dhe Tereza, e zonja e shtëpisë, u kujdes me pasion për Shebën. Ne u deklarua si të martuar dhe ajo bëri kryqin kur i thamë se prisnim një fëmijë pas shumë vjetësh. Doktor i që thirra për të vizituar Shebën më tha se ajo nuk duhej të lëvizte shumë pasi për shkak të moshës, barra e saj nuk ishte ngjitur siç duhet. Sheba nuk u trishtua për asnjë çast e bindur të duronte çdo sakrificë për fëmijën tonë. Kur unë dilja, ajo qëndriste rrobat e djalit me shtizat dhe pëlhurat që ia kishte gjetur Tereza dhe hante arra të thata me mjaltë nga pema e shtëpisë. Këto janë arrat e vjetshme, thoshte Tereza, por kur të lindësh do pikojnë arrat e njoma dhe unë do t'i bëj reçel.

Për gati tri javë unë u enda nga mëngjesi në mbrëmje duke pyetur në qytet dhe në fshatrat rrotull tij për vëllanë tim. Askush nuk dinte se disa shqiptarë kishin ardhur për të luftuar në ishull, derisa një ditë në një kafene afër portit më thanë të takoja një plak, i cili mund të kujtonte ndonjë gjë. E gjeta kollaj shtëpinë e tij që duhej të ishte shumë më e vjetër se i zoti. Plaku më tha se kishte dëgjuar për disa ushtarë shqiptarë që kishin ardhur gjatë luftës në Kretë, por unë duhet të shkoja në një fshat malor nja dy orë nga qyteti me kalë. Një mëngjes e lashë Shebën me qëndisjet e saj dhe u nisa. Mali për ku isha drejtuar ishte një vend i tharë nga dielli aziatik që e rrihte përjetësisht dhe nuk kishte shumë ujë. Nga lartësia deti dukej si gjithësi sepse askund nuk shihje tokë. Fshati kishte pak shtëpi dhe ishte shumë i varfër. Atje më thanë se në një pllajë që binte mbi det ishin disa varre, të cilave askush nuk i kishte dalë për zot. E sigurt ishte se nuk ishin të fshatit. Një nga burrat e paktë që takova erdhi me mua për të më treguar rrugën. Në një cep të pllajës afër një greminë që binte si një vetëtimë mbi det ishin disa gurë për të cilët burri më tha se ishin varre. Ishin dhjetë gurë të zinj që të vendosur një nga një formonin një gjysmëharku si në një valle. Shqiptarët kishin qenë njëmbëdhjetë. Mbi gurin e fundit dalloheshin disa numra të shkruar keq në madhësi të ndryshme, të cilat dukej sikur i kishte gërvishur shpejt e shpejt një dorë që dridhej në panik, 1670. Këto ishin numrat. Gurët e tjerë ishin memecë. Hodha sytë përreth sikur kërkoja një shenjë të vëllait tim, por humnera ishte e shurdhët. Duhet të jetë një datë, foli burri pas kurrizit tim. Ashtu duket i thashë. Por Kreta u pushtua në vitin 1669 nga turqit dhe në 1670-n lufta kishte mbaruar. Ndoshta këto janë varrë të fundit, tha burri.

E vërteta ishte më e frikshme se humnera që kisha afër. Me sa duket grupin e shqiptarëve të ardhur vullnetarisht në ndihmë të Kretës e kishin sjellë të ruante mbi këtë mal, që në atë kohë duhet të ketë qenë pikë strategjike, sepse nga këtu mund të kontrollojë gjithë detin. Në qoftë se turqit do të vinin nga lindja, shqiptarët do përballeshin të parët me ta. Por turqit erdhën nga perëndimi dhe humnera nuk i la të ngjiteshin mbi pllajë për t'i dalë qytetit të Kandisë nga prapa. Që këtu shqiptarët kanë parë anijet turke poshtë në det, por nuk kanë mundur të kuptojnë se kush po e fitonte luftën atje poshtë pasi kur është rrethuar qyteti ata duhet ta kenë humbur lidhjen me grekët. Kandija u pushtua më 1669-n dhe grekët që nuk u vranë, u dorëzuan. Ndoshta dikush prej tyre u tregoi osmanëve se një grup shqiptarësh i priste lart në mal. Lufta mbaroi me kapitullim, por shqiptarët nuk e mësuan dot as kur vdiqën. Ata kanë qëndruar këtu nuk di se sa kohë në acar, në erë, në shi dhe nën zheg duke pritur të bënin atë për të cilën kishin ardhur: të luftonin. Kur

turqit janë ngjitur nëpër mal për t'i kapur dhe i kanë rrethuar nga të tre anët, përveç humnerës, ata e kanë kuptuar se ishin të pashpresë dhe duke luftuar, kanë varrosur njëri-tjetrin ndërsa gurët duhet t'i kishin bërë gati paraprakisht. Asnjëri prej tyre nuk dinte të shkruante dhe prandaj varret i lanë pa gojë. I fundit që ka mbetur prej tyre dhe që nuk mund të varroste dot veten është hedhur në det pasi ka shkarravitur katër numra si për të dëshmuar se shokët e tij u vranë nga turqit, pasi u lanë të vetëm nga grekët. Ku ta dish nëse do të dorëzoheshin po të mësonin se lufta kishte mbaruar, mendova dhe ula kokën. Si ta merrja vesh se cili nga këta të dhjetë ishte vëllai im? Kishte vdekur i pari? Apo i dyti? Apo ishte i gjashti, guri i të cilit ishte më i vogël sepse edhe vëllai kishte qenë më i vogli nga burrat? Apo ishte i dhjeti, ai mbi gurin e të cilit katër numrat ishin shtrirë siç shtrihet çdo ditë veriu, jugu, lindja dhe perëndimi mbi horizontin e botës. Apo ishte vëllai ai që e kishte lënë këtë gjurmë mbi librin e pambaruar të luftërave mes krishterimit dhe islamit, dhe pastaj ishte hedhur në humnerë? Kushdo qoftë prej tyre unë nuk mund ta ndaja nga shokët. I putha gurët një nga një dhe u çova në këmbë si në një varrim. Shkula një grusht bar të njomë dhe e hodha mbi humnerë. Fijet e barit ranë ngadalë në boshllëk dhe mua m'u duk sikur ato ishin njëmbëdhjetë.

Kur mbërrita në shtëpi, në darkë, Sheba po më priste. I tregova i ngashëryer historinë e vëllait tim. Nga të gjithë djemtë vetëm ai kishte trashëguar sytë jeshilë të babait dhe ndoshta prandaj ky e donte mbi të tjerët. Sa do të doja t'i merrja të dy bashkë në fshat, i thashë Shebës. Nuk mund t'i merrje të dy, më tha ajo, duke më përçafuar. Arka që ke poshtë krevatit është e ngushtë për dy burra të mëdhenj. Kur po më mbylleshin sytë nga gjumi mendova se Sheba kishte të drejtë. Arka ishte e vogël për dy burra, fshati ishte i vogël për Komnenët, Shqipëria ishte e vogël për shumë fe dhe bota ishte edhe më e vogël për kaq shumë luftëra.

Doktori na tha se Sheba duhej të lindte në korrik.

Ky muaj në Kretë është një torturë. Deti qëndron me javë pa asnjë dallgë dhe qielli të rri mbi kokë si një çallmë e përvëlur. Megjithëse i mbanim dritaret hapur, Sheba djersinte dhe mezi e rrotullonte barkun e madh në krevat. Një ditë në drekë ajo filloi të bërtiste nga dhimbjet dhe Tereza vrapoi të lajmëronte doktorin, i cili erdhi duke dihatur nga vapa. Të dy, me Terezën u futën në dhomë, ndërsa mua më nxorën jashtë. Një burrë në moshën time i humb emocionet e një babai nervoz dhe e përjeton lindjen e një fëmije si një gjysh i heshtur. Unë u futa poshtë hijes së arrës dhe që atje dëgjoja përgatitjet e doktorit dhe përplasjet e enëve prej bakri që Tereza kishte sjellë nga kuzhina e shtëpisë. Megjithëse nuk kishte erë, klithmat e Shebës arrinin t'i lëviznin gjethet e arrës. Gati një orë mbeta ashtu ngurtë, ndërsa djersa më rridhte si rrëshirë nga trangu im i vjetër. Nuk lëviza as kur një piskamë fëmije zbriti deri tek unë nga dritarja e hapur e dhomës. Fëmija qante shtruar, duke përmbushur me korrektesë detyrën e parë që kishte në këtë botë: të qante. Por zhurmat që vinin nga dhoma nuk pushuan. Dëgjoja doktorin që thërriste fort, lëvizte akoma më fort dhe shtypte shumë më fort sikur donte të disiplinonte lëvizjet e gjymtyrëve të Shebës.

Pastaj u bë qetësi.

Mua m'u duk sikur zhurma e madhe që dëgjoja kapërceu dritaren, rrëshqiti nëpër lëkurën e arrës, kaloi rrugën dhe u zhyt në det pa më folur. Pak më vonë pati prapë një zhurmë, por kjo ishte e qara e fëmijës. Ishte e vetmja zhurmë që mbeti brenda në shtëpi. U ngjita lart dhe trokita në derë me dorën time prej gjyshi. Tereza doli me një fëmijë në krahë që e kishte mbështjellë me një çarçaf rozë. Është vajzë, tha. Të të rrojë. Po e ëma, pyeta unë. Tereza u kthye nga foshnja dhe uli kokën. Pas saj doli doktori, i cili më tha se Sheba kishte vdekur gjatë lindjes. Gruaja jote bëri një sakrificë, më tha. Ishte në një moshë delikate.

Duke varrosur Shebën, mendoja e të gjithë ata që kishin udhëtuar me mua kishin vdekur dhe kjo nuk mund të ishte një rastësi. Kishte vdekur babai që erdhi me mua deri në Stamboll, pastaj Gjergj Brankoviçi, me të cilin shkova deri në Vjenë, më pas gruaja ime që erdhi me mua deri në fshat për të më sjellë tre djem dhe tani Sheba me të cilën erdha në Kretë, te vajza ime. Me sa duket Zoti kishte vendosur që unë ta vazhdoja i vetëm udhëtimin tim, që nuk kishte mbaruar. Sheba e dinte fundin e përrallës sime. Para se të vdiste ajo kishte parë vajzën e saj dhe në mes të kllapisë i kishte thënë Terezës: Abrahami dhe Sara tani janë bashkë.

Sara është vajza që solli arrat, tha Arianit Komneni. U ushqye nëntë muaj me arra në barkun e të ëmës dhe vazhdon t'i ketë qejf. Kur Sheba vdiq, unë vazhdova të rrija në shtëpinë e Terezës. Nuk mund të lëvizja nga ishulli me një foshnjë të sapolindur. Sara kishte nevojë për një nënë, të cilën unë nuk mund t'ia zëvendësoja. Tereza gjeti një vajzë të re, e cila sapo kishte lindur dhe që pranoi t'i jepte qumësht Sarës nga gjiri i vet. Babai i saj ishte venecian i mbetur në Kretë, ndërsa e ëma greke. Vajza vinte çdo ditë dhe ushqente Sarën. Kur ajo ikte, unë e vija në gjumë. Kur qante, e tundja në krahë. Tereza kujdesej për ta pastruar dhe për ta larë gjë që unë nuk e mësova dot. Në shtator, kur era e vjeshtës u kthye në Kretë, e nxorëm për herë të parë Sarën nga shtëpia. Por bota nuk i pëlqeu fare sime bije, e cila filloi të qante e zhgënjyer. E vura nën hijen e arrës ku u qetësua dhe fjeti shumë gjatë. Kur mbushi nëntë muaj Sara filloi të fliste. U lidh shumë me venecianen e re që i jepte sisë dhe një ditë e thirri me emrin e saj. Kur u bë dy vjeç kishte muaj që ecte nëpër shtëpi dhe zbriti vetë në oborr, shkoi tek arra dhe atje e zuri prapë gjumi.

Ndërkohë, unë kisha nisur të mendoja për t'u kthyer në fshat. Vajza ishte rritur aq sa të përballonte udhëtimin nëpër detet e pabesë të Greqisë. Fillova të përgatitem dhe në shtator zura një anije që nisej për Selanik. I shpjegova vajzës se do të hipnim në anijen që ajo shikonte çdo ditë nga dritarja dhe do shkonim në një vend shumë të bukur me pyje dhe zogj. Sarës kjo i pëlqeu dhe natën ëndërronte sikur po nisej në një përrallë. Mblodha plaçkat tona dhe disa nga gjërat më të dashura të Shebës, mes të cilave një çantë të vogël lëkure ku futa një lodër të Sarës, disa arra, si dhe ndërresa për të. Tereza na dha një reçel me arra të njoma që ishte akoma i ngrohtë kur u fut në kutinë e teneqesë. Ia kisha premtuar Shebës, tha ajo, dhe përqafoi vajzën. Kur mora arkën e babait, e cila prej tre vjetësh rrinte poshtë krevatit, Sara më tha: Baba pse nuk më fut mua brenda në arkë dhe kur të shkojmë në pyll ta hapësh që gjithë zogjtë të tremben. Zogjtë nuk frikësohen nga kukullat, i thashë. Po pse do e marrësh me vete arkën atëherë, vazhdoi ajo. Që kur ti të rritesh të më fusësh mua këtu brenda dhe të më marrësh kudo me vete, i thashë. Aaa, u llastua ime bijë. Ti e do arkën për vete prandaj nuk ma jep mua.

U nisëm në fund të shtatorit dhe era e shtyu anijen tonë ngadalë nëpër Mesdhe deri në Selanik. Rrugës, Sara më pyeste për peshqit, për pëllumbat, për dallgët dhe për ishujt e vegjël që takonim rrugës. Natën flinte pranë meje duke shtrënguar një kokërr arre nga të Kretës në grushtin e saj të njomë. Kur kaluam pranë një ishulli shkëmbor, pamë disa njerëz që po lahashin në breg. Ata i gëzoheshin dallgëve, të cilat i ngrinin lart dhe pastaj i zhysnin aq sa Sara frikësohej se mos nuk dilnin më nga deti. Nuk kanë frikë ata se i merr deti baba, më pyeti pa i hequr sytë nga kokat e vogla që dilnin mbi dallgë. Nuk kanë frikë sepse po bëjnë not, i thashë. Çfarë do të thotë not? Not do të thotë të puthesh detin. Po ti di not, ngulmoi ime bijë. Di, i thashë unë. Do ma mësosh dhe mua notin baba? M'u kujtua peshkatari tullac i Raguzës dhe për herë të parë pas katër vjetësh fshati m'u duk më afër se kurrë. Do ta mësoj, i thashë. Do ta mësoj patjetër.

Në Selanik ndenjëm dy javë. Sheba më kishte folur për një kushërirën e vet të afërt, të cilën e gjeta në një dyqan librash të vjetër. Kur dëgjoi për vdekjen e Shebës dhe gjithë historinë tonë ajo

filloi të qante. Nuk mund të ikja pa ju lajmëruar, i thashë dhe i tregova vendin ku e kisha varrosur në Kretë. Gruaja puthi Sarën dhe ne ikëm. Por vajza e kishte dëgjuar gjithë bisedën time duke bërë sikur luante me librat, poshtë një tavoline të madhe me këmbë hekuri. Rrugës më pyeti se kush ishte Sheba. Është mamaja jote, i thashë. Po pse nuk erdhi me ne në pyll, tha vajza. Ajo në pyll është, iu përgjigja unë dhe një lëmsh m'u ngjit në fyt dhe më mori frymën. Sheba është në pyll, i thashë, por asnjëri nuk e di se ku. Do pyesim zogjtë dhe do ta gjejmë. Po si do ta njoh unë mamanë, tha Sara. Do ta njohësh se edhe ajo ashtu si ty, mban në dorë një kokërr arë, i thashë dhe nuk fola më.

Kur arrita në fshat unë isha tetëdhjetë vjeç ndërsa Sara tre. Kur më panë pas katër vjetësh burra, gra dhe fëmijë dolën nëpër rrugët e fshatit për të më përshëndetur. Unë i flisja të gjithëve, por nuk mund t'i takoja dot sepse duart i kisha të zëna. Me një dorë shtrëngoja Sarën që çapitej e hutuar pas meje, ndërsa me dorën tjetër mbaja babanë tim, i cili po kthehej në fshat pas gjysmëshekulli. Askush nuk më pyeti për arkën, por të gjithë shikonin Sarën e vogël me faqe të kuqe dhe flokë të zinj. Është vajza ime, i thosha unë dhe njerëzit qeshnin për të mos më vënë në vështirësi, por me siguri mendonin se unë po tallesha. Sara nuk kishte parë ndonjëherë fshat dhe kur më pyeti se ku ishim i thashë se kishim arritur në pyll. Të nesërmen e nxora babanë nga arka dhe e varrosa pranë nënës sime. Rrini vetëm, u thashë. Unë po iki. Keni kohë të çmalleni derisa të kthehem. Pastaj kalova te varri i Hanës. I vura dorën sipër sikur doja ta ngrohja dhe qëndrova pa lëvizur për një kohë të gjatë. Pas shumë vjetësh e kisha bashkuar familjen time.

Për një javë rresht gjithë fshati erdhi në shtëpi për të uruar kthimin tim. Sara rrinte në dhomë bashkë me mua dhe nuk i fliste askujt, megjithatë të gjithë e përkëdhelnin dhe i jepnin sheqerka që ajo i hidhte në arkën bosh të gjyshit, të cilën unë ia kisha dhënë sipas premtimit. Vetëm një njeri nuk erdhi ta shikonte Sarën, Gjergji, djali im i madh. Kur i thanë se unë u ktheva në fshat me një vajzë të vogël që e kisha lindur me një grua tjetër, ai mori familjen dhe iku nga shtëpia. Sara tani është 15 vjeç, por Gjergji akoma nuk na flet.

9

Arianit Komneni pushoi, mori frymë thellë dhe kaloi dorën mbi mjekrën e zbardhur, sikur kishte harruar diçka pa thënë.

Histori e bukur, por e trishtuar, i tha Ali Tepelena. Sikur ta shkruaje çdo ditë të jetës, fletët do arrinin deri në Stamboll. Disa fletë janë lagur dhe nuk mund të lexohen më, tha Komneni i menduar. Edhe kaq sa lexohet mjafton për të kuptuar se nuk ke lënë gjë pa bërë në këtë jetë.

Kam lënë, u përgjigj qetësisht Arianiti. Nuk kam vrarë.

Ndoshta ke vrarë, por nuk ma tregon mua, e shpëtoi Aliu. Jo, përsëriti Arianiti duke e parë në sy, nuk kam vrarë njeri. Aliut në ato momente plaku iu duk kërcënues dhe e ktheu bisedën me shaka. Ku i dihet! Ti je akoma i fortë dhe jetën e ke përpara. Këtë gjë e di, u përgjigj Arianiti serioz. Jeta më ka mësuar t'i zgjidh gjërat ndryshe dhe prandaj nuk kam nevojë të vras.

Po ti ke vrarë, e pyeti Arianiti. Aliu nuk u zverdh nga frika, por nga mënyra se si e pyeti njeriu që kishte përballë e që atij iu duk tallëse. Vras kur nuk më binden, i tha duke ngritur zërin. Ke ngatërruar fshat, tha Arianiti. Këtu nuk ka burra për të vrarë. Do të thuash që fshati do të më bindet, u përpoq Aliu të kapej pas fjalëve dhe sytë i shndritën. Aspak, vazhdoi Arianiti i përqendruar duke e hequr velenxën e kuqe. Kjo çështje do të zgjidhet në mënyrën time. Pa vrarë. Edhe ti e ke pranuar se vetëm kështu mund të zgjidhet, ndryshe do ta kishe zgjidhur duke vrarë

dhe nuk do kishe ardhur të më takoje. Bukur, tha Aliu i dorëzuar. Kthejini Ibrahimit të drejtat që i hoqi pleqësia dhe le ta quajmë se kjo punë u zgjidh me mënyrën tënde.

Arianit Komneni u mendua pak dhe filloi të fliste. Ky fshat ka pasur sherre gjithmonë, por unë dhe përpara meje babai im, si kryetarë të pleqësisë, i kemi zgjidhur me qetësi duke u përpjekur t'i pajtonim njerëzit. Babai më thoshte se më mirë një fshat i varfër, se një fshat në gjak. Prandaj ka më shumë se gjashtëdhjetë e pesë vjet që këtu nuk ka vrasje. Vrasja e fundit ndodhi, kur xhaxhai i Mihalit vrau vëllanë e vogël të gjyshit të Ibrahimit, sepse të dy donin të martoheshin me të njëjtën grua. Ndoshta unë jam i vetmi që kam parë një vrasje sepse shumica nuk kishin lindur në atë kohë. Që hasmëria të mos vazhdonte, babai vendosi që xhaxhai i Mihalit të dëbohej nga fshati dhe kështu u bë. Dy familjet u qetësuan, por, me sa duket, nuk e harruan gjakun. Për këtë arsye Mihali dhe vëllai i tij e tejkaluan vendimin e pleqësisë dhe, si të shtyrë nga hakmarrja, shkonin çdo natë në shtëpinë e Ibrahimit duke djegur kryqe. Ata gjetën ditën kur i gjithë fshati ishte kundër Ibrahimit dhe e sulmuan. Por djali i Ibrahimit, Thanasi, nuk është i butë si i ati. Ai ka lindur për të luftuar tamam si stërgjyshi i tij, që ishte i egër dhe i fortë dhe që nuk i bënte syri dritë, arsye për të cilën, babai e nisi në Kretë në krah të vëllait tim. Në qoftë se ai do ishte kthyer gjallë nga lufta, asnjë vendim pleqësie nuk do mund ta ndalonte që të mos i merrte hakun të vëllait dhe unë them se fshati e pati një të mirë nga kjo vdekje. Siç kanë rrjedhur ngjarjet kam frikë se, nëse kjo punë nuk mbyllet me urtësi, Thanasi mund ta vrasë Mihalin, jo vetëm se ky i ka fyer babanë, por edhe për t'i marrë hakun e shtëpisë. Jam menduar gjithë këto ditë dhe prandaj nuk doja ta mblidhja pleqësinë sepse mendjet aty janë ende të nxehta dhe një vendim i shpejtuar mund të jetë i pafrytshëm.

Nuk ta tregova kot historinë time. Besoj se e ke kuptuar se gjithë jetën unë, ashtu si babai im, kam menduar se paqja dhe qetësia do të vinin për ne, ditën që Islami do të zbythej në Azi duke ia lënë krishterimit këtë copë qiell ku ne jetojmë prej shekujsh. Mirëpo, kjo nuk ndodhi dhe ne duhet ta pranojmë qiellin që kemi, megjithëse, në më të shumtën, ai është i mbuluar nga retë e Islamit që na e zënë diellin. Bota do vazhdojë të përgjaket si më parë, por unë dua t'ia kursej fshatit këtë sherr, që as perënditë nuk po e zgjidhin dot. Prandaj Ibrahimit dhe ne duhet të jetojmë nën të njëjtin qiell. Ai le të numërojë retë, ndërsa ne do presim me durim kur të dalë dielli.

Dua të them se kam vendosur t'i kërkoj pleqësisë që Ibrahimin ta pranojmë si mysliman në fshatin tonë. Ne do t'i flasim dhe do ta respektojmë. Do t'i japim bukë dhe do t'i blejmë mish. Ne do t'i çojmë bagëtitë tona që ai t'i shërojë, do t'i shkojmë në shtëpi për gëzime dhe do ta ftojme në dasmat tona. Fshati do ketë dy varreza. Një për të krishterët dhe një për myslimanët. Çdo gjë do jetë si më parë me përjashtim të njëres.

Çfarë, tha Aliu që gjithë kohën kishte pritur që plaku dinak të kishte një kusht.

Vajzat e krishtera nuk do martohen me djemtë e Ibrahimit, foli prerë Arianit Komneni, si një gjykatës. Ali Tepelena u përtyp, ngriti dorën dhe tha: kjo është e padrejtë. Ti po i jep bukën, por nuk po i jep gjakun. Kjo është një hile dhe Ibrahimit nuk mund ta pranojë. Ai mezi pret t'i martojë djemtë. Nuk thashë që djemtë e Ibrahimit të mos martohen. Ata mund të marrin gra myslimane nga fshatra të tjera dhe t'i sjellin këtu dhe ne do gëzojmë në dasmën e tyre, u përgjigj Arianiti. Po djemtë e Ibrahimit janë të krishterë dhe gruaja e tij po ashtu, u kujtua Aliu që i erdhi turp nga vetja kur iu duk se po lutej, gjë që nuk e kishte zakon. Megjithëse djemtë mund të mbeten të krishterë çka do të jetë në nderin e tyre, fakti që i ati është mysliman i bën ata njëloj të padëshirueshëm për vajzat e këtij fshati. Ata mund të marrin vajza të krishtera në fshatra të tjerë, në qoftë se ua japin. Por çfarë ndodh jashtë këtij fshati nuk varet nga unë.

Arianit ishte bërë cinik sepse e dinte që në këtë lojë fjalësh, Aliu ishte më i dobët se ai. Ali Tepelena e kuptoi se me marrëveshjen që i kishte afruar, Arianit Komneni kishte pranuar të

shkrinte kufijtë tokësorë dhe ata të hapësirës me myslimanët, por këtë lëshim e kishte bërë për të ndaluar çdo përzjerje të gjakut dhe farës së tij të krishterë me femra apo meshkuj të fesë islame. Me pak fjalë, Komneni i propozonte myslimanëve që tokë dhe qiellin ta ndanin bashkë, por jo trupin dhe shpirtin. Ai donte ta mbante të pastër qelizën e riprodhimit të racës së tij dhe mundësisht ta fuste në arkën e të atit, për ta marrë me vete kur të ikte nga kjo botë. Arianit Komneni vazhdonte luftën e Arianit Komnenit. Por me sa duket ai ndihej më i fortë se binjaku i tij, që kishte lindur treqind vjet përpara. Arianiti i parë kishte lënë tokat dhe kalatë dhe kishte ikur, ndërsa Arianiti i dytë, duke e trajtuar si kala të krishterë historinë dhe emrin e familjes, megjithëse kishte pasur mundësi të ikte, ishte kthyer për ta ruajtur atë të paprekur deri ditën e fundit. Ja pse i kishte treguar historinë e gjatë të jetës së vet dhe, ashtu siç kishte bërë Sheba, me të, ai kishte bërë me Aliun, duke i treguar të gjithë përrallën, përveç fundit.

Ky është i marrë, mendoi Ali Tepelena. Sa të jetë gjallë nuk e lëshon kalanë e racës së vet. Çdo shartim të një trupi të krishterë me një trup mysliman ai do ta konsideronte një pushtim. Por ndërkohë që ky sheh nga qielli, pushtimi ka nisur nga toka.

Si një pushtues i regjur që përpara shpatës provon dredhinë, Ali Tepelena mendoi se duhet të bënte edhe një përpjekje të fundit. Ibrahim i nuk është një mysliman si gjithë të tjerët, tha. Atë nuk e detyroi askush të kthente fenë. Shkoi vetë dhe foli me imamin dhe pasi u bind vendosi.

Arianit Komneni, i cili deri në atë çast kishte qenë i qetë dhe madje, disa herë i ftohtë në cinizmin e tij, u përflak në fytyrë si velenxa e kuqe që mbante te këmbët.

Kujt i thua ti që Ibrahim i nuk e detyroi kush të bëhej mysliman, iu kthye ai me një zë të fortë prehistorik Ali Tepelena. Kush mund t'i besojë këto dokrra? Ka treqind vjet që turqit i detyrojnë shqiptarët me shpatë dhe me taksa që të tradhtojnë krishterimin. Sa familje shqiptarësh kanë paguar taksën e gjakut, devshirmen dhe i kanë nisur djemtë e mitur jeniçerë në ushtrinë osmane? Sa familje të tjera detyrohen sot e mot të paguajnë një të dhjetën e të korrave të tyre haraç, që të mos bëhen turq? Sa të tjerë paguajnë taksën e tokës, xhizven, të cilën taksidarët ua rrjepin të krishterëve? A mund ta mohosh se të krishterëve nuk u merret parasysh padija te kadiu mysliman? A mund ta mohosh se familjet e krishtera detyrohen të japin fëmijët peng, që turqit t'i besojnë atyre dhe kjo quhet taksa e sinqeritetit? A mund ta mohosh se në gjithë vendin, nga Shkodra deri në Elbasan, tregtarët e krishterë nuk lejohen të hapin dyqane në pazarin e qytetit? A mund ta mohosh ti, se fshatarëve të krishterë në Vlorë u grabiten tokat nga bejlerët myslimanë? A mund ta mohosh se vajzat e krishtera detyrohen të vënë ferexhenë që dhjetë vjeç ndryshe nuk i lejojnë të dalin në rrugë? A e di se në Berat një grua e krishterë që nuk mban perçe dhe që nuk i mban duart e mbledhura kur ecën, dënohet si e përdalë nga burrat myslimanë? A e di ti se titujt dhe gradat i jepen vetëm myslimanëve, megjithëse të krishterët jetojnë në të njëjtën perandori me ta? A e di ti se sa familje të mëdha shqiptare në këto dyqind vjet u detyruan të ndërronin fenë se ndryshe do t'i kishin humbur gradat dhe ofiqet e tyre bashkë me pronat? A e di ti se pas vdekjes së Skënderbeut Sulltan Murati nxori një dekret që i detyronte gjithë shqiptarët të bëheshin synet me pahir, për të larë, sipas tij, tradhtinë e Skënderbeut? A e di që para disa vitesh një prift në Mirditë u kap dhe kur nuk pranoi të bëhej mysliman u dënua me vdekje? a e di ti se turqit i japin të drejtë vetes ta shajnë si të duan Krishtin, por po u shave Muhamedin të djegin të gjallë siç bënë me një të krishterë në Korçë?

A e di se çfarë i ndodhi Gjergjit në Janinë? Ta them unë që të kuptosh se pse Ibrahim i u bë mysliman.

Gjergji ishte shërbëtor te një efendi i pasur. Puna e tij ishte që t'i mbante të zotit çibukun dhe rrogozin e faljes. Kur i zoti shkante në xhami të falej, Gjergji e priste te dera sepse si i krishterë atij nuk i lejohej të hynte në xhami. Efendiu, që e thërriste Gjergjin Mustafa, në sy të

muslimanëve të tjerë, një ditë i kërkoi që ta fuste në xhami. Gjergji nuk pranoi, por efendiu e futi me forcë duke e kërcënuar se do ta hiqte nga puna. Kur e morën vesh muslimanët e tjerë, u bënë si të tërbuar sepse e quajtën këtë si fyerje ndaj Islamit. Gjergjin e burgosën dhe duke e torturuar i kërkuan të bëhej musliman. Mirëpo, djali nuk pranoi dhe vdiq gjatë torturave. Por dhimbja e tij nuk mbaroi këtu, sepse turqit kërkuan që fëmijët e tij të bëheshin muslimanë. Por gruaja e Gjergjit nuk pranoi dhe që t'i shpëtonte, deklaroi se fëmijët nuk i kishte me Gjergjin. Dhe natyrisht kopilët nuk meritojnë të bëhen muslimanë, apo jo? kështu shpëtuan fëmijët e shkretë që për të ruajtur fenë e tyre humbën babanë, por dhe nderin e nënës së papërlyer.

Ja, pra, pse u bë Ibrahim i musliman. Sot, çdo burrë i krishterë jeton me frikën e Gjergjit, çdo grua e krishterë jeton me tmerrin e gruas së Gjergjit dhe gjithë fëmijët tanë janë të rrezikuar njëjloj si fëmijët e tyre. Kjo është Shqipëria muslimane. Ibrahimin e ka bërë musliman ankthi se një ditë do t'i merrnin tokën, pastaj se do t'ia nisnin fëmijët ushtarë dhe pastaj se do t'ia vishnin gruan me ferexhe. E megjithatë asgjë nuk e justifikon atë.

Gjithë sa të thashë mund të harroheshin, në qoftë se do ishin raste të veçuara. Por e keqja është se islamizimi është kthyer në detyrim në Perandorinë Osmane. Kjo nisi që në vitin 638 me kushtetutën që Kalifi Omar i dha qytetarëve jomuslimanë të Jerusalemit dhe që sot është kthyer në themel të rendit të ri islamik që po vendoset me dhunë. Ja se çfarë thoshte qitapi i tij: Arianiti zgjati dorën dhe mori një libër të verdhë dhe të hollë, që ishte aty afër bashkë me disa libra të tjerë në përmasa të ndryshme, por që deri në atë çast Aliu nuk i kishte vënë re. Po të ishin armë do ta kisha pikasur më shpejt, mendoi dhe u përqendrua te plaku që kishte nisur të lexonte normën muslimane të Omarit.

Të krishterët nuk duhet të ndërtojnë kisha në territor musliman. Të krishterët duhet t'i mbajnë dyert hapur për muslimanët dhe t'i strehojnë ata falas në shtëpi deri në tri ditë. Të krishterët duhet t'u lirojnë vendin muslimanëve kur këta janë të pranishëm. Ata nuk duhet të mbajnë rroba apo zbukurime të ngjashme me ato të muslimanëve. Ata nuk duhet të përdorin emra muslimanë. Ata nuk duhet të ecin mbi kuaj me shalë dhe me kapistër. Nuk duhet të mbajnë shpata, shigjeta, harqe apo armë të tjera. Nuk duhet të mbajnë kurrë në gisht një unazë me gur të çmuar. Nuk duhet të shesin verë dhe të mos e pinë atë në mexhli. Nuk duhet të blejnë shtëpi në lagjet e muslimanëve. Nuk duhet t'i varrosin të vdekurit në varrezat muslimane. Të krishterët nuk duhet të ankohen kur kanë fatkeqësi apo të derdhi lot kur u vdesin të afërmit. Ata duhet të rrinë në këmbë kur i paguajnë taksat, ndërsa taksidari duhet të rrijë ulur. Rruga e lagjes së të krishterit duhet të jetë e ngushtë. I krishteri duhet të bëjë një shenjë në derën e shtëpisë, në mënyrë që njerëzit ta njohin dhe të mos luten për të. Kalifi nuk u mjaftua me kaq, por ai i dha të drejtë çdo muslimani që të vriste të krishterin që sipas tij i kishte shkelur këto rregulla.

Pse nuk bëhesh një ditë i krishterë që ta shijosh parajsën e Kalifit, Omar? Nejse, ti nuk ke kaq shumë shije. Por më thuaj a e kupton tani se pse u bë Ibrahim i musliman?

Arianit Komneni kishte folur gjatë dhe zëri i ishte ngjitur. Fyti i tij digjte si një muskul i zhveshur nga lëkura. Gjatë atyre orëve, Aliu kishte parë sesi ai ishte shndërruar nga një luan i plakur që ushqehet me kujtimet e gjuetive të veta në një tigër të plagosur që është gati të përdorë thonjtë për të mbrojtur të vegjlit e vet. Duke folur, Arianiti kishte nxjerrë nga poshtë velenxës edhe dorën tjetër dhe Ali Tepelena pa unazën e Halil Patronës që ia shtypte rrudhat mbi lëkurën e gishtit.

Sot, gjërat nuk janë siç thua ti, tha Aliu. Ndoshta muslimanët kanë më shumë të drejta, por të krishterët e kanë rrëzuar prej vitesh kodin e vjetër të Kalifit. Omari ka një mijë vjet që ka vdekur,

por ai jeton në frikën tënde. Për më tepër ti ke marrë rregullat e tij dhe i përdor tani kundër myslimanëve. Je një mijë vjet prapa, Arianit.

Po të ishte kështu, ti nuk do rrije dot ulur në praninë time, tha Arianiti dhe u ngrit në këmbë si për të thënë se biseda kishte mbaruar. Ali Tepelena u drejtua nga dera pa i dhënë dorën.

Kur doli në oborr pa një arkë të vogël në të cilën si në një arkivol, shtrihej një kukull me flokë të bardha që atij iu duk si Arianit Komneni. I ka ardhur dita, mendoi.

Kishte zbardhur, por qielli nuk ishte i pastër. Dielli ishte fshehur pas një reje dhe dukej sikur kishte turp të dilte.

10

Kur arriti në shtëpi, gjeti Ibrahimin që po e shikonte sikur priste ndonjë lajm. Do të t'i kthejnë të gjitha, foli Aliu. Do të të respektojnë, do të japin bukë dhe vend për varr. Do blejnë dhe mish nga kafshët e tua, por me një kusht. Nuk pranojnë që vajzat e tyre të martohen me djemtë e tu. Ibrahim i donte të thoshte diçka që Aliut iu duk si një pranim, por nuk e la të vazhdonte dhe i tha se do flisnin kur të zgjohej.

Ali Tepelena fjeti shumë dhe pa një ëndërr të gjatë në të cilën, Arianiti ecte nëpër Stamboll dhe me një dorë mbante arkën e të atit dhe me tjetrën shtrëngonte nga flokët kokën e tij të verdhë, që ua tregonte kalimtarëve. Ndërsa ai vetë shëtiste nëpër Janinë, pa kokë, kurse Thanasi, djali i Ibrahimit, e mbante për dore dhe i tregonte rrugën. U zgjua i lodhur dhe doli në oborr ku Thanasi po krihte jelet e kalit. Hajde të të mësoj kalin, i tha djalit dhe e mori për dore, si në ëndrrën e tij.

Thanasi ishte dhjetë vjet më i ri se Aliu, por nga shtati vinte i gjatë dhe duart e tij të njoma e mbani kalin fort. Kur u lodhën, u shtrinë të dy pranë e pranë poshtë hijes së një molle të egër dhe Aliut iu faneps fytyra e djalit që kishte dashur ta puthte, kur ishte në fshat. Çfarë të tha Arianiti, e pyeti Thanasi. Më tha që ti nuk do martohesh me vajzë të fshatit. Thanasi qeshi dhe Aliut iu duk sikur djalit i kishte pëlqyer ky vendim, a thua se e kishte shpëtuar nga një detyrim. Unë nuk dua të martohem. Dua të luftoj, tha Thanasi. As Sara nuk do të martohet. Ajo thotë se martesë të pengon të luash. Ti luan me Sarën, e pyeti Aliu. Thanasi i tha po dhe i tregoi se kur ata loznin, Arianiti rrinte në oborr dhe lexonte libra të vjetër. Kur ai e kishte pyetur një herë Sarën se çfarë kishte në ato libra, ajo i kishte thënë se babai aty lexonte se si do ishte fshati pas njëqind vjetësh. Unë i besoj Arianitit, tha djali, sepse ai i ka lexuar të gjitha ato që ndodhin. Njëherë ai më tha se një ditë do të vinte një djalë trim hipur mbi kalë, dhe do më merrte me vete në luftë, siç mori vëllai i Arianitit stërgjyshin tim në Kretë. Kur e pyeta se si do vdes, ai më tha se këtë e kisha në dorë vetë dhe librat nuk mund ta shkruanin. Aliu ngriti kokën lart për të fshehur sytë e tij të habitur nga Thanasi. Dy mollë të egra që ushqeheshin nga e njëjta degë, rrinin ngjitur sikur nuk donin të ndaheshin. Po t'i ndaje, secila do vëshkej në vetmi.

Në drekë u kthyen në shtëpi. Ibrahim i ishte në oborr bashkë me një burrë që Aliu nuk e njohte. Burri kishte një mjekër të dendur, por të shkurtër dhe të zezë dhe një trup mesatar. Dorën e kishte shumë të ftohtë dhe Aliu u pendua që ia dha të vetën. Është Gjergj Komneni, i tha Ibrahim, ka ardhur të bisedojë diçka me ty.

U futën brenda, por burri rrinte i heshtur si një mur. Përse doje të më takoje, e pyeti Aliu. Për tokat e mia, tha Gjergji. Ky fshat është ngritur nga stërgjyshi im. Kur ai erdhi këtu kjo tokë nuk i përkiste askujt. Atij i pëlqeu ky vend sepse ka ujë dhe nuk është shumë larg qytetit. Pjesën më të madhe të tokës e mbajti për vete dhe pjesën tjetër ia ndau në mënyrë të barabartë burrave që erdhën bashkë me të nga bregdeti. Kur turqit bënë regjistrimin, pas vitit 1600, familja ime e pagoi rregullisht taksën e tokës. Por tani kam dëgjuar se turqit kanë filluar t'i marrin tokat dhe



t'ia japin bejlerëve dhe pashallarëve të rinj që ndihmuan me ushtarë dhe para nëpër luftërat e shumta. Në shumë fshatra të tjerë shqiptarëve iu janë marrë tokat dhe ata punojnë si hyzmeqarë në tokat e tyre. Kam dëgjuar se ti je bej në Tepelenë dhe se ke krushqi me Pashallarët e Delvinës dhe të Beratit. Unë dua të më ndihmosh që mos ma marrin tokën. Nuk kam pasuri tjetër dhe jam gati të bëj çdo gjë që mos humb atë që kam.

Gjergj Komneni pushoi dhe ngriti kokën në pritje të Ali Tepelenës. Dukej i qetë dhe nuk i lëvizte asnjë muskul. Nuk i ngjan fare të atit nga fytyra, por përpiqet ta imitojë në burrëri, mendoi Aliu. Babai yt nuk e kishte fare këtë shqetësim, i tha ai Gjergjit. Ai më foli për punë të tjera. E ke takuar tim atë, pyeti Gjergj Komneni si i zënë në befasi. Deri sot në të gdhirë isha në shtëpinë e tij, tha Aliu. E çfarë të tha? Biseduam për shumë gjëra. Pleqësia e ka ndëshkuar Ibrahimin me që u bë mysliman dhe unë shkova t'i kërkoj që ai vendim të ndryshojë. Por ai më foli për udhëtimet e tij të shpeshta si dhe për historinë e Komnenëve që nga koha e Skënderbeut. Më tregoi dhe për historinë e familjes suaj, për vëllanë e vranë në Kretë, për të atin dhe për gjithë fëmijët e tij. Më tha që ti nuk i flet që kur ai u kthye në fshat me vajzën e tij, që nuk është vajza e nënës tënde.

Gjergj Komneni lëvizi kokën dhe sytë i shkëlqyen mbi ballin e tij të errët. Të ka gënjyer, tha. Unë nuk flisja me të edhe përpara se të lindte Sara. Që para vdekjes së nënës. Ai më ka martuar me motrën e vet, por unë këtë e mora vesh shumë vonë. Aliu u habit, por nuk e ndërpreu. Gjyshi im jetonte me idenë se familja jonë, si degë e Komnenëve bizantinë, duhet të merrte pjesë në fitoret e të krishterëve mbi turqit. Ai nisi djalin e vet të madh bashkë me dhjetë burra të tjerë nga fshati në luftën e Kretës, por asnjëri nuk u kthye i gjallë. Mes tyre ishte dhe një burë, i cili la në shtëpi gruan dhe vajzën e tij të vogël. Pas disa kohësh, nëna e kësaj vajze vdiq dhe ajo mbeti e vetme. Vajza ishte pesë vjeç dhe nuk kishte kush kujdesej për të. Gjyshi e mori në shtëpi, në nderim të babait të vranë në luftë dhe vajza u rrit atje. Kur u bë për t'u martuar e kërkuar njëkohësisht dy djem nga fshati. Këta ishin xhaxhai i Mihalit dhe vëllai i gjyshit të Ibrahimit, i cili gjithashtu ishte vranë në Kretë. I takonte gjyshit tim të vendoste se kujt do t'ia jepte dorën e vajzës. Dy djemtë pritën një kohë të gjatë, por gjyshi e shtynte nga viti në vit vendimin, por asnjëri nga djemtë nuk hoqi dorë, përkundrazi rivaliteti i bëri edhe më kërkues. Tani më shumë se dashuri ishte një garë mes të dyve. Dikur në fshat u hap fjala se njëri nga dy djemtë futej natën në dhomën e vajzës, por askush nuk e dinte se cili ishte nga këta të dy. Fjalët i bënë xhelozë të dy djemtë sepse secili mendonte se tjetri po i vidhte të dashurën me pabesi. Një ditë, dy djemtë u ndeshën dhe xhaxhai i Mihalit e vrau vëllanë e vogël të gjyshit të Ibrahimit. Dy familjet u bënë gati për gjakmarrje, por gjyshi, si kryetar i pleqësisë ndërhyri dhe i bindi që shërbëtorët dhe xhaxhai i Mihalit të dëbohej nga fshati për mos shkelur më kurrë këtu. Familjet ranë dakord dhe xhaxhai i Mihalit u largua duke qarë, por njëkohësisht i lumtur që iu kursye jeta.

Ishte viti 1704. disa javë pas ikjes së xhaxhait të Mihalit, gjyshi vendosi të shkonte në Stamboll ku mori me vete dhe babanë tim që ishte djali më i vogël. Pas shtatë muajsh, vajza lindi një vajzë. Ajo nuk e tregoi kurrë se me kë e kishte pasur fëmijën dhe për shkak të historisë së saj të dhimbshme, fshati e mbylli njërin sy. Gjyshja ime e mbajti në shtëpi foshnjën ashtu siç e kishte bërë me nënën e saj. Gjyshi vdiq në Stamboll dhe babai u kthye në vitin 1709, dhe pak më vonë lindi unë. Që kur fillova të kuptoj u lidha me Kostandinën jetime që ishte pesë vjet më e madhe se unë. Ajo më mbante pas dhe unë nuk i ndahesha. Kur u rritëm, të dy e kuptuam se nuk mund të ndaheshim më. U dashuruam dhe vendosëm të martohemi. Nëna ime nuk donte, por unë i thashë se në qoftë se do më ndalonin të martohesha me Kostandinën do ikja bashkë me të nga fshati dhe nuk do shkelja më kurrë këtu. Për gjashtë muaj babai nuk më foli, ndërsa unë prisja miratimin e tij për t'u martuar. Një ditë e nxora Kostandinën jashtë fshatit dhe e zhvirgjërova në pyll. Kur nëna e mori vesh, i tha babait dhe ky e lejoi martesën tonë. Ato vite babai pothuajse

nuk ishte në shtëpi sepse merrej me tregtinë e letrës. Vëllezërit e mi po ashtu kishin ikur, njëri në Voskopojë dhe tjetri pas babait. Unë mbeta me nënën, të cilën e doja shumë. Para se të vdiste e pyeta se pse nuk kishte dashur që unë të martohesha me Kostandinën dhe ajo më tregoi për dyshimet e saj për të cilat tani jam bindur edhe unë. Kostandina lindi me sy jeshilë, por të tillë nuk i kishte pasur as nëna e saj jetime dhe asnjëri prej dy djemve që ishin dashuruar me të. Sy jeshilë në fshat kishte vetëm gjyshi im dhe asnjë burrë tjetër. Kur fillova të interesohem, i shtyrë nga dyshimet e mia përvëluese, mësova se xhaxhai i Mihalit, megjithëse ishte martuar dy herë, nuk kishte pasur fëmijë. Vëllai i gjyshit të Ibrahimit, kishte qenë i shkurtër dhe e shkurtër kishte qenë edhe nëna e Kostandinës, ndërsa kjo u bë e gjatë dhe kockëmadhe. Duke e ndjekur nga pas këtë ngjarje, kuptova se pse im gjysh nuk kishte dashur t'ia jepte askujt për grua, nënën e Kostandinës. Ai, me sa duket, e kishte dashur jetimen. Kur ajo u mbars, duke mos pasur mundësi të dështonte fëmijën, sepse kështu do të merrej vesh, si dhe për të mbuluar gjurmët e mëkatit të vet, duhet të ketë qenë gjyshi im që hapi fjalët se njëri nga djemtë e vizitonte të dashurën natën. Nuk e di a është penduar në fund të jetës për këtë krim. Nëna e Kostandinës vdiq pas gjyshes sime dhe e mori të vërtetën me vete në varr. Babai nuk foli kurrë me njeri për këtë gjë. Ai nuk foli as me nënën time, por unë jam i sigurt se ai e ka kuptuar të vërtetën dhe prandaj hezitoi ta miratonte dasmën time. Ndoshta, po të më kishte thënë se Kostandina ishte halla ime unë nuk do dashurohesha me të, por për këtë nuk jam shumë i bindur. Edhe ime bijë, Hana, i ka sytë jeshilë si nëna e saj dhe si askush tjetër në fshat. Tani ajo është martuar me Vasilin, vëllanë e Ibrahimit dhe akoma nuk kanë fëmijë.

Gjergj Komneni pushoi. Fytyra tregonte pamjen e një njeriu të çliruar Aliu nuk e shikonte dot në sy, por duke lidhur ngjarjet mendonte se si në këtë fshat të vogël ishte përsëritur historia e botës. Dhe akoma nuk ka mbaruar, tha me vete dhe iu kujtua Arianiti që përpara disa orësh i kishte thënë, se disa fletë nga historia e tij ishin lagur dhe nuk mund të lexoheshin. E ka lexuar Gjergji, mendoi dhe duke iu drejtuar e pyeti se kush e dinte tjetër të vërtetën. Unë, Kostandina dhe im atë. Po pse ma tregove mua? Nuk erdha të të them këtë gjë, por kur më the se im atë të kishte treguar historinë e familjes e ndjeva se duhej ta plotësoja gënjeshtrenë e tij. Ti je kalimtar në këtë fshat dhe nuk ke kohë t'ia tregosh njeriu. Tani që më njeh siç jam mendoj se do të më ndihmosh të mos humb tokat që më takojnë. Përpara se të jenë të tuat ato janë tokat e babait tënd, tha Aliu. Duhet t'ia kërkosh atij jo mua. Gjergj Komneni u errësua, por nuk e dha veten. Pas atyre që kishte dëgjuar, Aliu e kuptoi se sa më shumë e shtynte drejt të atit, aq më i egër bëhej i biri. Nuk ishte hera e parë që e bënte këtë lojë me njerëz nevojtarë si Gjergj Komneni. Nuk kam ndër mend t'i flas tim ati derisa të vdes, tha Gjergji. Dhe në qoftë se unë nuk pajtohem me të, të gjitha pasuritë ai do t'ia lërë Sarës. Im atë është njeriu më dinak që mund të njohësh dhe duke e ditur se toka është gjithçka që kam, më mban të lidhur me këtë kërcënim. Atëherë bëj një djalë dhe martoje me Sarën, që të trashëgosh tokat, u tall Aliu.

Gjergj Komneni u çua në këmbë dhe mjekra e tij e shkurtër filloi të dridhej aq sa Aliut iu kujtua tërbimi i të atit një natë më parë. Unë nuk jam Arianit Komneni që marton djalin me motrën e vet. Jetojmë nën të njëjtin qiell dhe do jemi mbi të njëjtën tokë edhe për pak kohë. por mëkati i tij nuk ka Zot dhe Zoti im nuk i fal mëkatet e tij. Duke u dridhur në këmbë, Gjergj Komneni pështyu përtokë, por Aliu ia bëri me dorë si për t'i thënë se ishte një shaka dhe u përpoq ta qetësonte. Në qoftë se nuk pranon t'i trashëgosh tokat nga dora e babait tënd atëherë unë besoj se ke vetëm një rrugë, foli Aliu prerë dhe seriozisht. Po të dëgjoj, tha Gjergji dhe ia nguli sytë. Ndiq rrugën e Ibrahimit dhe bëhu mysliman, i tha duke menduar, se Gjergj Arianiti do të tërbohej më keq dhe do zhdukej duke sharë. Por Gjergji nuk lëvizti nga vendi dhe nuk i ndau sytë nga të tijat sikur donte të lexonte fundin e fjalisë që kishte dëgjuar. Nëse bëhem mysliman a do

m'i japin turqit tokat e mia, e pyeti me qetësi. Pa dyshim. Turqve do t'u vinte mirë që një djalë i një dere të madhe të krishterë merr fenë e tyre, pa ia kërkuar kush. Unë do t'i bind se tokat e Komnenëve të takojnë ty dhe askujt tjetër. Do të më besojnë po t'u them se kur yt atë dhe vëllezërit e tu ikën nga fshati, ti i punove tokat e tyre për gjithë këto vjet dhe duke qenë se familja juaj ka drejtuar gjithmonë fshatin mund të të bëjnë bej.

Në qoftë se ti më jep fjalën se do më ndihmosh e pranoj. Në qoftë se nuk ka rrugë tjetër për t'u shkëputur nga im atë e pranoj dy herë. Në qoftë se Zoti im i ri nuk i fal mëkatet që fal Zoti i tim ati, e pranoj tri herë, tha Gjergj Komneni sikur po betohej dhe sytë që iu lagën, iu thanë prapë, në çast.

Aliu iu afrua, e puthi në dy faqet dhe doli jashtë. Thirri një nga trimat e tij, it ha diçka që Gjergji nuk e dëgjoi dhe hyri prapë brenda në shtëpi. Nisu tani, i tha. Imami do të të presë. Thuaj që të kam dërguar unë. Gjergj Komneni i dha dorën dhe u nis. Ftohtësia e asaj dore e përcëllloi Ali Tepelenën. Pasi i tregoi Ibrahimit bisedën me Gjergjin dhe Arianit Komnenin, Aliu u shtri të flinte herët dhe ëndrra e një nate më parë iu përsërit. Kur u zgjua, pa Gjergj Komnenin që bashkë me Ibrahimin ishin ulur në oborr duke ngrënë hurma. Gjergji dukej si një njeri tjetër. Ishte më i zbutur, por dora e tij ishte njëlloj e ftohtë. Si ta vunë emrin, e pyeti Aliu. Ismail, tha ai, Ismail Abdullahu. Po pse pranove të bëhesh Abdulla, o budalla, e ngacmoi Ibrahim duke i treguar se si e kishte refuzuar të njëjtin mbiemër. Nuk ka nevojë ta ndërrosh mbiemrin, qeshi Aliu. Do quhesh Ismail Bej Komneni. Është më bukur.

Kur Arianit Komneni mësoi se i biri ishte bërë mysliman, mbylli derën e shtëpisë dhe thirri Sarën. Dy ditë ata nuk dolën nga shtëpia. Ditën e tretë, duke u mbështetur në një shkop me gunga, bashkë me Sarën, që mbante arkën e mbushur me libra, shkuan te shtëpia e Hanës. Pavarësisht nga marrëdhëniet mes babait dhe tij, Hana gjithmonë e kishte adhuruar gjyshin e saj. Hapi derën dhe Arianit Komneni iu duk si një profet që ishte nisur për të vdekur. Duhet të iki Hanë, tha ai. Zoti nuk ka dashur që Abrahami dhe Ismaili të rrinë në një fshat. Sara e di ku po shkoj dhe kupton se nuk mund të vijë me mua atje ku do shkoj. Sara do rrijë këtu me ty. Martoje me një njeri të mirë, por vetëm në qoftë se ajo e pranon. I puthi të dyja dhe u nis. Hana qau, ndërsa halla e saj, Sara, filloi të lexonte.

Atë ditë, një erë e kuqe shkretëtire e dogji fshatin. Njerëzit u mbyllën brenda dhe nuk e panë se nga iku Arianit Komneni. Pleqësia nuk u mblodh më dhe të gjitha vendimet që kishte marrë u harruan. Ibrahim i liroi Mihalini e Zoicës dhe ky, pasi hëngri, fjeti tri ditë. Ali Tepelena ishte nisur për në Janinë duke marrë Thanasin me vete.

11

Kur u bë mysliman, Ibrahim kishte katër djem. Thanasi që ishte më i madhi, ishte 15 vjet, ndërsa më i vogli ishte 15 muaj. E shoqja nuk pranoi të ndërronte fenë dhe as t'ia ndryshonte emrat të bijve apo t'i bënte ata synet. Kështu që djemtë vazhduan të thirreshin me emrat e pagëzimit Thanasi, Petro, Jani dhe Niko. Kur imami erdhi në fshat për bajramin e parë dhe dëgjoi emrat e djemve, e pyeti: Sa myslimanë ka kjo familje e krishterë Ibrahim? Megjithëse ai i tha se i kishte bërë një premtim të shoqes dhe nuk mund ta thyente, imami nuk u bind. Në bajramin e dytë, imami ia përsëriti pyetjen dhe Ibrahim i dha të njëjtën përgjigje. Por imami u nxeh dhe për ta vënë në sedër i tha se kjo ishte hera e fundit që vinte në një shtëpi, të cilën e komandonte një grua dhe jo një burrë. Pas ramazanit të tij të dytë, gruaja mbeti shtatzënë. Mrekulli, i tha ai, do lindësh një mysliman. Ajo i kujtoi premtimin, por ai i tha se premtimi ishte dhënë për të gjithë

fëmijët që kishin lindur para se ai të bëhej mysliman, ndërsa për të palindurit, ai nuk ishte në fuqi. Pesë ditë e pesë net e shoqja as piu, as hëngri. Gratë që e vizitonin i thanë se ajo ishte dobësuar dhe kjo nuk i bënte mirë, madje mund t'i rrezikonte jetën.

Ditën e gjashtë ai dërgoi në qytet Vasilin që të thërriste priftin. Çfarë t'i them, it ha Vasili, ti e di që ai nuk të do. Thuaji se duhet të vijë patjetër për t'i shpëtuar jetën një gruaja të krishterë. Në qoftë se nuk vjen kjo do të vdesë, kështu thuaji.

Prifti erdhi të nesërmen dhe ai i tha: Imzot unë u bëra mysliman, por gruaja dhe katër djemtë e mi mbetën të krishterë. Tani ajo është rëndë prapë. Unë i thashë që fëmija që do të lindë do të jetë mysliman, si babai i vet. Por ajo nuk pranon dhe ka shtatë ditë që nuk fut gjë në gojë dhe unë nuk duroj dot që të vdesë bashkë me fëmijën tim në bark. Fol me të dhe i thuaj që unë i dua njëllot fëmijët e mi qofshin të krishterë apo myslimanë. Por nuk mund të pranoj që të jemi i vetmi mysliman në një familje të krishterë. Fol me të dhe më ndihmo, u lut Ibrahimimi.

Prifti u ngrit dhe u fut në shtëpi. Nuk kaloi shumë dhe doli. Rasa e tij e zezë nuk shquhej fare natën. Ai e kuptoi që prifti po afrohej, vetëm kur një duhmë e rëndë prej njeriu që ka ngrënë me tepricë, ia bllokoi hundët. Ajo do vazhdojë të mos hajë dhe të mos pijë në qoftë se ti nuk bën një zotim të ri, tha prifti. Jam gati, tha Ibrahimimi. Do mbaj çdo premtim siç kam bërë deri më sot.

Prifti ngriti kokën dhe tha: Gruaja jote do vazhdojë të jetojë si e krishterë. Katër djemtë e tu po ashtu. Ata do të shkojnë në kishë, do ngjyjnë vezë pashke dhe do hanë mish derri. Askush nuk do t'i shtrëngojë ata të ndryshojnë fenë dhe nëse dikush tenton, ti do ta ndalosh. Ti duhet t'i duash njëllot fëmijët që ke apo ata që do lindin. Pasuria jote do të ndahet në barazi mes djemve të krishterë dhe myslimanë. Gruaja jote do t'i respektojë pa u ankuar të gjitha detyrimet që Islami të ngarkon ty qofshin në ushqim, në udhëtim, në ramazan apo në shtrat. Por ajo nuk detyrohet të mbajë ferexhe apo të ndajë shtratin me gra të tjera. Fëmijët që do lindin pas këtij zotimi do të jenë myslimanë, si ai ati, nëse janë djem dhe të krishtera si e ëma nëse janë vajza.

Prifti uli kokën dhe shtoi: kaq kërkon që të mos vdesë. Atij i ishin mbushur sytë. Kurrë në jetën e vet nuk kishte përjetuar një solemnitë të tillë. Gjatë gjithë këtyre viteve, duke u marrë me kafshët dhe Islamin, nuk kishte kuptuar dot se e shoqja kishte fituar pjekurinë për t'ia disiplinuar jetën njëllot si një institucion, si kadiu, si imami apo si Arianit Komneni në kohën kur ishte kryetar i pleqësisë. E shoqja kishte vendosur barazi mes dy feve nën një çati, gjë që profetët, bashkë me gjithë të urtët e të fortët e botës, nuk ia kishin arritur dot akoma. Ajo e dinte sa e vuante ai që asnjë nga djemtë nuk e kishte ndjekur në Islam. Edhe djemtë ndiheshin keq kur fshati i thërriste: Thanasi i Anës, apo Nikoja i Anës. E si mund t'i quanin ndryshe: Thanasi i Ibrahimit? Shpesh atij i dukej vetja si një deve që ushqehet me vezë pashke. Po mendonte për të gjitha këto, kur prifti e përmendi. Nuk më the a e pranon zotimin? E pse jo, tha ai qetësisht. Që sot nuk do jem myslimani i vetëm në familjen time.

Në majin e vitit 1771 lindi një djalë që ai e quajti Muhamed, me emrin e profetit të tij. Muhamedi lindi synet dhe gjithë fshati u shkul për të parë këtë çudi. Natyrisht që kështu do të ndodhte, thoshte Ibrahimimi duke mbajtur djalin e zhveshur në krahë. Muhamedi është myslimani i parë i vërtetë në këtë fshat dhe nuk mund të pranonte të bëhej synet nga një baba që ka lindur i krishterë. Dy vjet pas Muhamedit lindi një djalë tjetër që Ibrahimimi e quajti Ali, për nder të Ali Tepelenës, ndërsa katër pas tij, u lind Ademi, që megjithëse ishte djali i shtatë i Ibrahimit, mori emrin e njeriut të parë, Adamit, siç i kishte treguar imami.

Bashkë me fëmijët u shtuan dhe kafshët. Pas kafshëve edhe paratë. Ai e zgjeroi shtëpinë nga prapa dhe ndërtoi një dhomë të madhe gjumi për vete dhe gruan. Oborri e zhveshur e mbolli me mollë, ndërsa pranë dritares së dhomës së re mbolli një arrë. Kur ne të plakemi arra do jetë

fëmijë, kur ne të vdesim ajo do jetë bërë grua dhe do mbushet me kokrra, i tha Ibrahimimi së shoqes. Rrugën përpara shtëpisë e shtroi me gurë kalldrëmi të bardhë duke i varrosur një herë e mirë gropat që kishin lënë kryqet e djegur. I nxori të gjitha kafshët nga shtëpia dhe ndërtoi një stallë të madhe me kallama dhe qerpiç jashtë fshatit. Sëmundjet ngjitëse në kafshë u përhapën shumë ato vite, por vetëm Ibrahimimi dukej i kënaqur. Atij i vinin me dhjetëra kuaj, lopë, dhi e dele në javë për të kuruar dhe fshati dukej shumë më i madh, sa herë që tufat e kafshëve të shëruara parakalonin nëpër rrugët e tij, si ushtri. Asnjë ushtri tjetër, që kishte kaluar në fshat, nuk kishte qenë më paqësore.

12

Kur Ibrahimimi mbushi 50 vjeç në fshat ra kolera.

Në qershor, disa ushtarë turq që vinin nga larg për të shkuar në Janinë, ndaluan disa orë për t'u çlodhur. Ata u lanë dhe pinë ujë, duke futur gojët e etura në çezmat prej guri që kishte ngritur Arianit Komneni, në mes të fshatit. Njëri prej tyre e kishte sjellë sëmundjen nga shkretëtira dhe pa e ditur ia kaloi çezmës së Arianitit. Një djali të vogël, që lagu buzët atje, iu fry barku si kacek dhe etet e padurueshme ia shkatërruan sytë dhe veshët derisa vdiq. Tek e njëjta çezmë ishte freskuar edhe Vasili, i cili duke bërëtitur nga dhimbjet i kërkoi Hanës që ta mbështillte me batanije dhe ta digjte të gjallë, për të mbytur mikrobin. Por Hana nuk pranoi dhe Vasili doli në oborr dhe u ngul mbi një sfurk. Pas tij dha shpirt mbesa e vogël e Mihalit dhe e Zoicës, e cila nuk vuajti gjatë, por vdiq në gjumë e mbuluar me të vjellat e veta. Pas saj u shuan me radhë kuantat e vëllait të Mihalit dhe vetë Zoica.

Ashtu si Mihali përpara njëmbëdhjetë vjetësh, kolera kapërceu gardhin që ndante dy oborret dhe hyri në shtëpinë e Ibrahimimit. Ibrahimimi luftoi për shumë ditë duke përdorur gjithë dijen që kishte mësuar nga sëmundjet e kafshëve të tij dhe për pak kohë e zbuti kolerën. Por një natë, pabesisht, kolera u zgjua më e uritur se në fillim dhe, para se të linte shtëpinë e Ibrahimimit, mori me vete Ademin trevjeçar dhe Anën. Ibrahimimi bashkë me djemtë formuan një vig me drurë, e veshën gruan me rroba të bardha dhe i bënë një shëtitje nëpër fshatin e sëmurë, përpara se ta varrosnin në varrezat e të krishterëve. Pastaj morën Ademin e vogël, që nuk kishte nevojë për vig, dhe e varrosën në një vend tjetër jashtë fshatit, aty ku, që nga kohë e Arianitit, ishte caktuar varreza e myslimanëve. Ademi shkoi i pari në atë varrezë siç kishte ardhur i pari në jetë Adami, që i kishte dhënë emrin.

Pas tij vdiq Ismail Komneni që kur e kuptoi se nuk kishte shpëtim shkoi tek e bija Hana dhe pa i dhënë dorën nga frika e kolerës, tha se ia linte asaj gjithë tokat trashëgim. Hana e ndoqi nga pas të atin dhe pa sesi ai shkoi në pyll dhe aty ku ishte bashkuar me gruan e tij, duke u dridhur nga të ftohtët, hapi një gropë të cekët dhe u fut brenda. Hana nuk duroi dot dhe nxitoi ta mbulonte.

Për tre muaj fshati i ngjau një spitali lufte. Dyert e shtëpive rrinin hapur, rrugët mbetën të papastruara, të sëmurët dergjeshin nëpër oborre, varrezat ishin mbushur me gropa bosh që njerëzit i bënin gati për vete dhe të afërmit, çezmat e rrugëve u mbyllën, ndërsa uji i pakët nuk përdorej pa u zier në zjarr. Qentë, macet dhe minjtë e ngordhur shtriheshin të lirë në diell për të ushqyer mizat e pangopura.

Turqit e mbyllën fshatin në karantinë, si në një çark dhe askush nuk hyri dhe nuk doli edhe tre muaj pas kolerës. Kur filluan të mbarojnë ushqimet, të afërm dhe krushq të fshatrave fqinjë i linin ato në një vend të caktuar gjysmë ore larg në këmbë ku, pasi ata iknin, shkante i merrte Petro, djali i Ibrahimimit dhe Aleks, djali i Mihalit. Ushqimet ndaheshin me racion nga Mihali, që

duke qenë më i moshuari në fshat, mori rolin e kryetarit të pleqësisë pas vdekjes së Ismail Komnenit, ndërsa ilaçet jepeshin vetëm me urdhër të Ibrahimit që ishte bërë doktori i fshatit. Karantinën e çau vetëm Thanasi, i cili nuk ishte parë në fshat që kur kishte ikur me Ali Tepelenën. Ai bëri kryqin mbi varrin e së ëmës, por nuk shkoi te varrezat myslimane dhe tha që më mirë që nuk e kishte njohur Ademin, se do qante. Thanasi organizoi një grup djemsh me Petron, Aleksin dhe disa të tjerë dhe iu vu punës për të pastruar fshatin. Larguan kufomat e qenve dhe maceve nga rrugët, vunë regjim për përdorimin e çezmave dhe hapën disa gropa të mëdha në të cilat groposën me dhjetëra kokë bagëti të ngordhura. Thanasi e rregulloi vetë kabanën e kishës që dukej sikur ishte ndryshkur nga kolera dhe filloi ta tundte pas çdo vdekjeje. Ibrahim i rrinte te koka të sëmurve duke u bërë lavazh me çaj mali dhe raki.

Pas dy muajsh, kolera ishte dobësuar, por nuk ishte zhdukur. Nuk kishte asnjë familje pa një apo dy të vdekur dhe ata që mbetën gjallë ishin aq sa burrat dhe gratë që themeluan fshatin dyqind vjet më parë, me në krye stërgjyshin e Arianit Komnenit. Ibrahim i tha Thanasit se nëse vazhdonte kështu, fshati do të shuhej ngadalë për disa muaj. Nuk e besoj, i tha i biri, ky është një mallkim i shkurtër, por po të ishte Arianiti gjallë do të na e thoshte si mbaron kjo histori.

Të nesërmen që pa gdhirë, Thanasi shkoi të takonte Sarën dhe i tha të kërkonte nëpër librat e të atit se çfarë shkruhej për kolerën. I kam parë, tha Sara dhe i tregoi me dhjetëra raste kolerash që kishin shfarosur myslimanë dhe të krishterë në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Mesdheut. Kolera është si era, tha Sara. Të kap në gjumë, e shton vrullin për të mbyllur nga frika në shtëpi, spastron çdo gjë që gjen në rrugë, pastaj futet tinëz nëpër oxhaqe, shuan zjarrin dhe ikën. Duhet të presim edhe pak, sa të ndizen oxhaqet, tha ajo. Edhe sa njerëz do vdesin, e pyeti Thanasi i zhgënjyer nga mënyra poetike me të cilën vajza përshkroi tekat e sëmundjes. Nuk e di, tha Sara, babai e mori me vete librin e vdekjeve.

Pas disa ditësh, qielli u nxi dhe një dëborë e zezë e mbuloi një pëllëmbë fshatin. Por ishte fundi i shtatorit dhe dëborë e parakohshme nuk mbajti gjatë. Kur rrugët u hapën, Ibrahim i kontrolloi një për një të gjitha shtëpitë që i kishin ndezur oxhaqet për t'u ngrohur, por askund nuk pa shenjë kolere. Të sëmurve u ishin skuqur faqet e zbehta dhe barqet me lëngje u ishin shfryrë. U kthye në shtëpi i gëzuar dhe pranë arrës së vogël pa Thanasin dhe Sarën që bisedonin në këmbë. Më duket se shpëtuam, tha dhe u fut brenda.

Sara ishte rritur dhe gërsheti i zi i dukej më i vogël. Thanasi po i tregonte sesi kishte jetuar mbi kalë, për dhjetë vjet duke ndjekur Ali Tepelenën, i cili e kishte zgjeruar pushtetin e tij në të gjitha fshatrat rreth Janinës. Po ti ç'ke bërë gjithë këto vite, e pyeti ai. Kam lexuar, tha vajza, por kur erdhi kolera librat më mbaruan. Po çfarë pret atëherë? Pse nuk martohesh, i tha Thanasi duke i prekur gërshetin. Mund të martohesh me ty, por ti ke qejf burrat më shumë se gratë, u përgjigj Sara duke qeshur. Martohu me babanë tim. Ai është njeri i mirë dhe është akoma i ri, tha Thanasi pa u skuqur.

Kjo nuk mjafton. Ai është mysliman, tha Sara dhe u largua duke tërhequr gërshetin, në një syth të të cilit kishte ngecur një gjethe e vockël arre.

Thanasi e kishte dashur shumë të ëmën, por kur pa se familja e tij ishte shtuar me tre djem, nga të cilët dy ishin shumë të vegjël, mendoi se i ti do ta kishte të pamundur t'i rriste ata, pa ndihmën e një gruaje. Thanasi vendosi të mos largohej nga fshati pa i gjetur një grua Ibrahimit. Shkoi të bisedonte me të dhe i foli për Sarën. Me vajzën e Arianit Komnenit, pyeti Ibrahim i çuditur. Arianit Komneni ishte një burrë kokëfortë dhe i padurueshëm që nuk pyeste për njeri. Sa ishte gjallë, bëri çfarë deshë dhe i trajtoi më mirë kalldrëmet se njerëzit. Kishte dëshirë të ndërtonte

dhe ngriti çezma, hapi rrugë, thelloi kanale dhe ndërtoi kishën. Po të ishte grua, do kishte qenë një amvisë e shkëlqyer. Nuk e di si mund të jetë një Komnene femër. Ta mendoj, tha Ibrahim.

Thanasi e ndjeu se babai mund të pranonte dhe vendosi të takonte prapë Sarën. Për një muaj rresht vajza kundërshtoi. Thanasi u përpoq ta bindte përmes Hanës, të cilën e kishte pasur gruan e xhaxhait, por ajo i tha se Arianiti i kishte lënë porosi që vajza do martohej vetëm po t'i mbushej mendja. Thanasi nuk hoqi dorë dhe shkante përditë në shtëpinë e tyre.

Një ditë, Sara i tha se mund të pranonte të martohej me Ibrahimin, por vetëm me një kusht. Fol, i tha Thanasi duke e parë me dyshim. Pasi vdiq vëllai im Ismaili, që ishte babai i Hanës, nuk kanë mbetur më Komnenë meshkuj në fshat. Unë jam Komnena e fundit, por, po të martohej, duhet të mbaj mbiemrin e burrit dhe Komnenët do zhduken. Do pranoj të martohej me babanë tënd vetëm në qoftë se ai pranon që fëmijët e mi të mbajnë mbiemrin tim. Nuk dua të jem Komnena e fundit, tha Sara. Ky ishte një kusht që Thanasi nuk e kishte pritur. Nuk e di, tha ai i ngrysur, do flas me babanë. Vrapoi në shtëpi dhe ia tha babait. Mendova se do të ishte ndryshe, por nuk i paska lënë gjë të atit, tha Ibrahim. Megjithatë e pranoi. Unë kam gjashtë djem dhe mbiemri im nuk ka rrezik të shuhet.

Ibrahimi dhe Sara u martuan në fillim të nëntorit. Thanasi e tundi trembëdhjetë herë kabanën e kishës atë ditë. Nikoja dhe Muhamedi e mbajtën fustanin e bardhë të Sarës nga kisha deri në shtëpi. Kur pa çiftin e zbukuruar, Hana u përplot. Sara dhe Abrahami tani janë bashkë, tha me vete. Nusja dhe dhëndri fjetën në dhomën e madhe, mbi të cilën arra e re nuk bënte akoma hije.

Për krishtlindje, Sara i tha Ibrahimit se priste një fëmijë, që ajo e lindi në korrik të vitit 1781. ishte vajzë dhe Ibrahim kërkonte që ajo të quhej Ana, si nëna e djemve të tij. Sara pranoi. Sipas premtimit, Ana Komnena mori mbiemrin e nënës.

13

Djemtë e Ibrahimit nuk u mësuan dot shpejt me Sarën, e cila, kur erdhi, e ndryshoi gjithë shtëpinë. Ajo e leu dhomën e oxhakut me ngjyrë rozë dhe i kërkonte Ibrahimit që nga ana tjetër e shtëpisë, aty ku, deri përpara disa vitesh kishin qëndruar bagëtitë, të ndërtonin një dhomë të madhe për djemtë, në të cilën u vunë pesë krevate prej druri me jastëkë të mëdhenj dhe çarçafë të rinj që ajo i qëndisi me ngjyra të ndryshme kur ishte shtatzënë. Dhomën e saj, Sara e veshi me perde të thurura me grep dhe e shtroi me qilima të punuar me dorë, ndërsa nëpër mure vendosi rafte të vogla që i mbushi me libra. Nga shtëpia e Arianit Komnenit solli një krevat të madh prej hekuri me këmbë të vardha, në të cilin kishte fjetur Arianiti me Hënë. Po ashtu, ajo solli sëndukë, qëndisma të vjetra, kortinka të bardha leshi, një orë të vjetër muri, jorganë, velenxa, filxhanë, ibrikë prej bakri dhe shumë enë, të cilat Arianiti i kishte blerë gjatë udhëtimeve të tij. Në fillim, djemtë u argëtuan me gjërat e rralla që vinin nga shtëpia e Arianit Komnenit, por, kur ajo e hodhi krevatin e nënës së tyre në oborr, ata u ftohën dhe iu duk se Sara nuk pranoi të flinte në krevatin ku ata kishin lindur.

Sara ndryshoi dhe regjimin e djemve. Ajo i detyronte të lanin këmbët përpara se të flinin dhe nuk i linte të hynin në shtëpi pa pastruar këpucët nga balta e fshatit, apo e arave ku vraponin. Djemtë, të mësuar të bridhnin gjithë ditën nëpër fshat, tani nuk mund të rrinin jashtë kur errej dhe kjo ishte më e rëndë, sidomos për Petron që ishte gati njëzet vjeç kur Ibrahim u martua. Petro iu afrua një ditë Ibrahimit dhe i tha se nuk i pëlqente që Sara e detyronte të vinte në shtëpi kur donte ajo dhe po ashtu nuk i pëlqente shtëpia e zbukuruar me perde dhe porcelane për shkak të të cilave nuk vrapoje dot si më parë. Një ditë, Sara kishte dënuar të mbyllej gjithë ditën në dhomë Muhamedi, që, duke lozur, kishte thyer një nga filxhanët e Stambollit. Por Ibrahim nuk mërzitej

dhe mendonte se disiplina e Sarës do t' u bënte mirë djemve të tij. Kur Petro u ankua, ai e pa duke qeshur dhe i tha se kur të rritej do ta kuptonte se çdo grua jeton për të rregulluar shtëpinë dhe sidomos krevatin që është themeli i familjes së saj. Kur të martohesh do ta kuptosh, tha Ibrahimimi. Këto janë huqe qyteti, ia ktheu Petro i mërzhitur që i ati nuk e mbështeti. Ne jetojmë në fshat dhe jo në Janinë.

Sara ndryshoi dhe mënyrën e gatimit. Në familjen e Ibrahimimit ushqimi shërbehej në një magje të rrumbullakët e të nxirë vende-vende nga enët e djegura, e cila shtrohej përtokë dhe djemtë bashkë me babanë hanin aty me radhë. Ajo i tha Ibrahimimit të gjente një tavolinë druri për dhjetë veta. Por dhoma ishte e vogël dhe kur e kuptoi se nuk do ta nxinte një tavolinë aq të madhe Sara porositi një më të vogël për gjashtë veta. Ibrahimimi nuk kishte parë ndonjëherë tavolinë dhe Sara e çoi në shtëpinë e Arianitit ku i tregoi një të tillë të zezë, me këmbë të gdhendura, mbi të cilin rrinte një vazo jeshile me lule të thara. Kështu e dua, i tha Sara, duke marrë lulet e thara që i hodhi jashtë, pasi e lau vazon dhe e mbushi me ujë të pastër për ta kthyer prapë aty ku e gjeti. Ibrahimimi u ul në një karrige dhe ndenji një copë herë me duart nën tavolinë, duke mos ditur ku duhet t' i vinte. Por Sara hapi një sënduk dhe mori një pjatë me lules si dhe një lugë të bardhë alumini që ia vuri përpara dhe duke qeshur i tha: Ha tani. Ibrahimimi mori lugën e afroi te pjata, por dorën tjetër e mbante gjithnjë poshtë tavolinës. Se si më duket, i tha i hutuar. Sikur jam në kishë. Aty nuk halet, buzëqeshi Sara. Era e temjanit ta pret oreksin.

Të nesërmen, Ibrahimimi mori një sëpatë dhe bashkë me Petron dhe Janin shkuan në pyll për të bërë dru për tavolinën e re. Zgjodhi një panjë të kuqe, jo shumë të madhe dhe e preu në mes. Panja ishte e bardhë nga brenda dhe përshkohej nga fillimi në fund nga vija të kuqe që dukeshin si enë gjaku. Në qendër të trupit kishte një sy të rrumbullakët, por sy më të vegjël kishte gjithandej. Sikur ndava një njeri në mes, mendoi Ibrahimimi kur e preu pemën vertikalisht, ndërsa djemtë e ngarkuan dhe e sollën në shtëpi. Në fillim, ai bëri katër këmbët e tavolinës që, pasi i sharroi në mënyrë të barabartë, djemtë i fërkuan me gur duke i rrumbullakosur. Fërkojini derisa të lëmohen si këmbë njeriu, i thoshte i ati. Ndërsa ashklat e panjës fluturonin si re pluhuri mbi kokat e tyre. Por disa prej ashklave ishin të gjata dhe të ashpra dhe ia gjakosën djemve duart e pastërvitura. Petro, që e bënte këtë punë pa qejf, i tha një ditë të vëllait se tavolina ishte shumë e vogël dhe nuk do ta nxinte të gjithë familjen. Ndoshta, dikush nga ne nuk do jetë kur ajo të mbarojë, tha Jani.

Ibrahimimi, në krahun tjetër të oborrit, punonte për të bërë syprinën. Ai e preu panjën në gjashtë pjesë të njëjta, nga një pëllëmbë të gjerë secilën, dhe i vuri në tokë ngjitur e ngjitur, për t' i parë. Thirri dhe Sarën, e cila kur i pa ashtu tha se tavolina nuk mund të përbëhej nga gjashtë copa, të cilat do fillonin të lëviznin pas pak kohësh dhe nuk ishin të rehatshme gjatë ngrënies. Ti më the se duhej një tryezë për gjashtë veta dhe unë e ndava në gjashtë pjesë, tha ai i nxehur dhe hodhi sharrën përtokë. Po, iu përgjigj Sara, por ti ke bërë gjashtë stola dhe jo një tryezë për gjashtë njerëz.

Ibrahimimi shkoi për herë të dytë në pyll dhe ia filloi nga e para. Por Sara e ktheu prapë kur pa se njëra nga këmbët kishte dalë më e shkurtër se tre të tjerat.

Ibrahimimi shkoi për herë të tretë në pyll dhe zgjodhi një panjë më të madhe dhe më të vjetër se dy të parat. Panja ishte shumë e rëndë dhe meqë nuk mund ta transportonin dot Ibrahimimi vendosi të punonte në pyll. Për tre javë, bashkë me djemtë shkonin në pyll në mëngjes dhe ktheheshin në mbrëmje. Një ditë ra shi dhe Ibrahimimi mori çarçaf nga shtëpia dhe i mbuloi drunjtë e prerë me sy të kuq. Kur filluan të ngulnin gozhdët e para, për të bashkuar këmbët me syprinën, pylli ushtoi



dhe zogjtë u trembën. Kur nguli gozhdën e fundit, Ibrahimimi e pa drejt në sy tavolinën e kuqe dhe tha: Do Zoti të jesh gjithmonë e ngopur.

Tre burrat e ngritën tavolinën dhe kur kaluan nëpër fshat, gratë dhe fëmijët dolën duke i hedhur sheqer dhe oriz, siç ia hidhnin nuseve për bereqet. Sheqeri dhe orizi u ra të treve mbi kokë dhe mbi supe dhe e mbushi tavolinën plot. Paskeni sjellë sytë, tha Sara dhe hapi derën e shtëpisë që të fusnin tavolinën brenda, por, pasi e provuan, kuptuan se tavolina ishte e madhe dhe dera nuk e nxinte. E rrotulluan nga të gjitha anët, por nuk hynte. Atëherë Ibrahimimi mori një çekiç dhe e prishi qerpiçin anës derës. Kashta e tharë në baltë ra bashkë me derën. Me këtë rast do bëjmë një derë të re, tha Ibrahimimi dhe vazhdoi punën. Pasi e futën tryezën në dhomë dhe e vendosën aty ku e caktoi Sara, kjo i vuri një qëndismë përsipër dhe i tha Ibrahimimit që ishte mbuluar me djersë: Tani duhet të bëni edhe gjashtë karrige.

Ndërsa Ibrahimimi dhe djemtë punonin në pyll për tavolinën dhe pastaj për derën e re dhe karriget, Sara merrej me oborrin. Në fillim i përzuri pulat nga shtëpia dhe e pastroi oborrin nga ndotjet dhe puplat e tyre. Pastaj shkuli gjithë barërat, hithrat, lulet e deles, mëllagat e egra, spërëngat dhe jonxhën që kishin mbirë në liri të plotë. Më pas, hoqi katër rreshta me plloça që i kishte shtruar Ibrahimimi vite më parë dhe dheun e lagësht që doli poshtë tyre e mbolli me majdanoz, me dafina, me borzilok, me xhenxhefil dhe me sherbelë. Ndërsa në një pjesë tjetër të veçuar, ajo mbolli domate, kastravecë, patate, patëllxhanë dhe qepë të gjata. Kur Ibrahimimi erdhi në mbrëmje nga pylli dhe e gjeti akoma në oborr me duart me baltë e pyeti se çfarë po bënte. Po shtroj tavolinën, i tha Sara dhe vazhdoi punën.

14

Të nesërmen ishte duke mbjellë kur dëgjoji një zë të fortë që thërriste: Ana, Ana. U ngrit dhe pa në rrugë një burrë të shkurtër të shëndoshë, me mjekër të kuqe dhe të veshur si malësor. Në kokë kishte një qeleshe të gjatë me majë, dhe nën jelekun e qëndisur pa mëngë, dalloheshin dy pisqolla të bardha. Fustanella e gjatë nuk ia fshihte dot këmbët e trasha gjithë nyje. Ana po fle, i tha Sara duke mbajtur një rrënjë patëllxhani në dorë. Mos është gjë sëmurë, e pyeti burri. Jo, i tha Sara, nuk është zgjuar akoma. Ishte mesditë dhe burrit i lëvizti fustanella, sikur po kërcente nga habia. Po ti kush je, i tha. Jam gruaja e Ibrahimimit, u përgjigj Sara. Mos kam ngatërruar gjë shtëpi, pyeti burri dhe ktheu kokën nga rruga si një njeri që ka humbur adresën. Po zotrote kush je, pyeti Sara. Jam Llambro Xhavella, daja i Anës, tha burri duke u drejtuar. Nuk je ngatërruar, i tha Sara dhe e ftoi të hynte në shtëpinë pa derë. Burri u ul dhe Sara i tha: Ngushëllime, të rroni vetë. Ana ka dy vjet që ka vdekur.

Llambro Xhavella mori frymë thellë dhe mustaqet e kuqe i lëvizën, por nuk foli. Hoqi qeleshen dhe dy pisqollat dhe i la mbi tavolinën e re. Sa i ngjan Halil Patronës, mendoi Sara kur pa kokën e tij të rruar, pas së cilës zgjatej një gërshet i kuq që kishte filluar të thinjej. I dha një gotë ujë dhe i tregoi për kolerën, për humbjet e fshatit, për urinë dhe etjen e atyre ditëve, për vdekjen e Vasilit, të fëmijëve, të bagëtive dhe për Anën dhe djalin e saj të vogël, Ademin që vdiqën njëri pas tjetrit. Pastaj i tregoi sesi pas vdekjes së Anës ajo ishte martuar me Ibrahimimin, por Llambro Xhavella, që rrinte mbështetur pas murit, e ndërpreu dhe i tha se nuk e kishte martuar mbesën me ndonjë Ibrahim. Kur Sara i tregoi se si Ibrahimimi ishte bërë mysliman qysh se Ana ishte gjallë, Llambro tha se jo vetëm mbesa, por dhe i shoqi paskan vdekur. Ku janë djemtë, t'i ngushëlloj për humbjen e prindërve, tha dhe kërkoi me sy nëpër shtëpi. Janë me të atin në pyll, po bëjnë derën e shtëpisë, tha Sara. Një copë herë mbetën të dy në heshtje pa ditur ç'të thoshin. Sara kishte dëgjuar pak për Llambro Xhavellën. Ibrahimimi nuk fliste për të, por Petro i kujtonte me mall ditët

kur e ëma e çonte në Sul, te daja i vet. Që atje lart dukej deti, thoshte Petro, që i mburrej vëllezërve më të vegjël, të cilët nuk e kishin parë kurrë detin.

Njëherë, Llambro kishte marrë Petron dhe Foton, djalin e tij të madh, dhe i kishte çuar në det. Vetë rrinte në breg dhe lante me sfungjer kalin e tij, ndërsa djemve u tha t'i hiqnin rrobat dhe të futeshin në ujë. Nuk dimë not, i kishte thënë i biri, do mbytemi. Futuni, i kishte urdhëruar Llambro Xhavella, suljoti mbytet vetëm me thikë. Duke ecur në majë të gishtave për të shmangur gurët e bregut, dy djemtë ishin hedhur në ujë. Pas disa metrave, aty ku jeshilja bëhej blu, kishin zgjatur këmbët, por në atë thellësi nuk kishte më tokë për t'u mbështetur. Djemtë filluan të bërtisnin dhe të mbaheshin te njëri-tjetri, por kjo i tmerroi edhe më shumë sepse sa herë që njëri rëndonte, tjetri zhytej. Llambro i shihte nga bregu dhe duke qeshur mjekra e kuqe i lëvizte si sfungjer. Pasi i la dhe pak ashtu, të kapur si leshterikë pas flokëve të njëri-tjetrit, Llambro Xhavella i ra kalit fort në ije dhe ky u nis në drejtim të djemve. Kali notonte sikur vraponte dhe u afrua shumë shpejt te djemtë. Ata e kapën fort nga bishti, e pastaj i hipën sikur po e kalëronin. Kur dolën në breg, kali i Llambro Xhavellës u ul dhe dy djemtë zbritën si nga një shkallë anijeje. Kur u qetësuan, Petro e pyeti Llambro Xhavellën: Po ti dajë, a di not? Llambro ktheu kurrizin dhe, duke e fshirë kalin me sfungjer, tha: Unë nuk jam kalë, o biri i Anës.

Po ty si të quajnë, e pyeti pas pak Llambro Xhavella, Sarën. Më quajnë Sara, tha ajo. E kujt je ti Sara? Jam e Arianit Komnenit, tha ajo dhe vuri dorën te gërsheti i zi, siç kishte bërë edhe në vitin 1769 kur kishte takuar Ali Tepelenën, i cili i kishte bërë të njëjtën pyetje.

Llambro Xhavellës i shkëlqyen sytë. E kam njohur Arianitin, tha ai dhe u zgjat për të folur. Kur Martuam Anën, mua më dërgoi babai në këtë fshat për të biseduar me familjen e Ibrahimit. Pasi ramë dakord për datën dhe ceremoninë, unë doja të njoftohej pleqësia për të marrë masa, sepse ne do vinim me shumë krushq nga Suli. Suljotët shkojnë nëpër dasma të armatosur dhe unë kërkova të bisedoj me kryetarin e fshatit për ta lajmëruar dhe për t'i thënë që të mos shqetësohej kur të shikonte një ushtri me krushq të mbathur si për luftë. Pyeta dhe më çuan tek yt atë.

Në vitin 1752 unë isha një djalë 28 vjeç, ndërsa ai një burrë i madh me flokë të bardhë, të cilët atë ditë i kishte mbledhur pas koke dhe mua m'u duk si një prift që drejton një kryengritje. Edhe kur e kam takuar herën e dytë, Arianit Komneni më është dukur sikur bëhej gati për kryengritje, sepse sytë e tij të mëdhenj, shihnin sipër kokës sime dhe fjalët e tij dukeshin si urdhra. Atë ditë, Arianiti ishte në mes të fshatit dhe po i jepte dorën e fundit ndërtimit të kishës. Duart i kishte me pluhur dhe nuk më takoi. I thashë se vija nga Suli për të martuar mbesën time gjashtëmbëdhjetëvjeçare. E di, më tha, keni zgjedhur një fshat të ngrohtë për t'u martuar. Kur i thashë se për dasmë do vinin shumë krushq nga Suli dhe ata do ishin të armatosur, më pa nga koka te këmbët dhe duke qeshur më tha: Në qoftë se i lini armët këtu kur të ikni, ejani sa të doni. Unë doja ta kundërshtoja, por Arianiti më tha se kishte bërë shaka dhe se fshati kishte armë, por, duke qenë i vogël, nuk kishte shumë burra. Uroj që mbesa jote të jetë e shëndetshme dhe t'i shtojë djemtë e këtij fshati, më tha duke më parë me bisht të syrit si çdo njeri që flet për punë grash. Unë e pyeta se kur mbaronte kisha dhe kur më tha se donte dhe nja dy muaj i thashë, si me të lutur, se a mund të shpejtohej pak puna në mënyrë që mbesa ime të martohej në kishë. Nëse ti i sjell krushqit nesër që të punojnë me mua, kisha mbaron për dhjetë ditë, tha Arianiti. Ishte fundi i qershorit dhe ne kishim rënë dakord që dasma të mbahej të dielën e parë të shtatorit. Po nëse e shtyjmë dasmën një muaj, a mund ta mbarosh kishën, e pyeta unë. Besoj se po, tha Arianiti duke parë qiellin e pastër. Të dielën e parë të tetorit kambanorja është gati.

Unë bisedova me familjen e dhëndrit dhe dasma e Anës u shty në tetor. Kur u ndamë Arianiti më pyeti se nga cila familje e Sulit isha. Kur i thashë se isha nga Xhevallat, ai më mori në qafë dhe më puthi. Rron gjyshi, më pyeti. Jo, i thashë, na la, ka pesë vjet. I çuditur, unë e pyeta se a e

kishte njohur gjyshin, por Arianit Komneni më tha që babai i tij e kishte pasur mik dhe më tregoi një histori nga e cila unë dija shumë pak.

Babai i Arianitit, gjyshi yt, vuante sa herë që dëgjonte se turqit pushtonin fshatra dhe shqiptarët ktheheshin në myslimanë. Ai besonte se nëse të gjithë të krishterët grekë, shqiptarë, sllavë, bullgarë dhe të tjerë bashkoheshin, turqit do të thyheshin dhe do zbrapseshin duke e lënë Ballkanin të krishterë. Kur filloi lufta e Kretës, gjyshi yt mendoi se ky ishte rasti për t'i mundur turqit. Rrethimi i Kretës zgjati 25 vjet dhe një herë fitonin turqit e një herë grekët. Nga vitet e fundit, lajmet që vinin nga Kreta thoshin se grekëve po u mbaronin burrat dhe fuqitë e tyre po shteronin. Babai i Arianitit vendosi t'i shkojë në ndihmë të krishterëve atje dhe mblodhi disa djem nga fshati me në krye djalin e tij. Meqë fshati juaj nuk ishte shumë i madh dhe nuk kishte shumë burra, siç thoshte Arianit Komneni, yt gjysh vendosi të thërriste djem edhe nga fshatra të tjerë. Ai shkoi vetë gjithandej, por shumë pak iu përgjigjën sepse fshatrat e fushës kishin shumë frikë nga turqit në atë kohë. Një ditë, ai erdhi në Sul dhe takoi gjyshin tim që sa ishte bërë kryetar i pleqësisë. Gjyshi im i tha gjyshit tënd se fitorja e Kretës duhej të ishte një fitore e krishterimit dhe se Suli, i cili për qindra vjet i kishte luftuar turqit, nuk mund të mos merrte pjesë në këtë betejë. Gjyshi ishte rreth tridhjetë vjeç në atë kohë, por, meqë ishte i martuar dhe ishte zgjedhur kryetar i fshatit, vëllezërit e tij nuk e lanë. Gjyshi kishte dy vëllezër më të vegjël beqarë, të cilët ishin binjakë. Ata i kërkuan që ai të rrinte në fshat, ndërsa ata do shkonin në luftë në emër të Sulit. Bashkë me ta kërkoi të shkonte edhe gjyshi i Ibrahimit, i cili ishte vëlla me njërin nga binjakët dhe nuk donte ta linte atë vetëm. Babai i Arianitit u nis nga Suli një ditë të akullt nëntori të vitit 1667, bashkë me tre djemtë, që gjithë fshati doli t'i përcjellë. Gratë qanin, por acari ua ngriu lotët. Dimri i atij viti bëri shumë i ashpër dhe rrugët u bllokuan gjithandej. Deri në mars, djemtë nuk u nisën dot në Kretë. Ata katër muaj gjyshi yt i mbajti tre djemtë në shtëpinë e tij. Dy binjakët ishin të urtë dhe të heshtur, por gjyshi i Ibrahimit ishte një djalë i hedhur dhe i gojës. Shumë shpejt ai e njohu fshatin dhe ra në dashuri me një vajzë, e cila, duke qenë komshie me familjen e Arianitit, hynte dhe dilte në shtëpinë ku ai rrinte. Djali dhe vajza u dashuruan dhe gjyshi i Ibrahimit i premtoi vajzës se do martoheshin sapo ai të kthehej nga Kreta. Edhe familja e vajzës u bind dhe për disa javë e mbajtën djalin në shtëpinë e tyre, si dhëndër. U nisën në fillim të prillit, por asnjëri nuk u kthye. Vajza kishte mbetur me barrë dhe pas disa muajsh lindi babanë e Ibrahimit. Familja e tyre në Sul e mori vesh disa muaj më vonë që djali ishte vlarë dhe kishte lënë një djalë në fshatin tuaj. Kur mori vesh lajmin, nëna e gjyshit të Ibrahimit erdhi duke ulëritur në shtëpinë tonë dhe e akuzoi gjyshin tim si fajtor për humbjen e të birit. Dy familjet tona u ftohën për disa kohë. Gjyshi ishte kryetar i pleqësisë dhe fshati mori anën e tij. Atëherë stërgjyshi i Ibrahimit mori gruan dhe një vajzë më të vogël dhe erdhi në fshatin tuaj ku ai kishte nipin e sapolindur. Mori gruan e pamartuar të të birit të vlarë, bashkë me nipin që ishte babai i Ibrahimit. Në këtë fshat ai ndërtoi një shtëpi në të cilën shumë vonë atij i lindi një djalë tjetër që edhe ai u vra, siç më kanë thënë. Shtëpia e tyre është kjo dhe këtu ka lindur edhe Ibrahim, ta Llambro Xhavella dhe pasi i hodhi një sy mureve rozë, vazhdoi:

Babai jetim i Ibrahimit u martua shumë vonë, këtu në fshat, por para se të vdiste e ëma i tha se ajo donte që në qoftë se atij do t'i lindnin djem, ata t'i martonte me vajza nga Suli, sepse kështu raca do të vazhdonte. Babai i Ibrahimit ia mbajti amanetin të ëmës dhe një ditë erdhi në Sul dhe kërkoi nuse te babai im. Im atë donte që prishja mes dy familjeve të mbyllej dhe prandaj duke i dhënë dorën e mbesës së vet, Anës, që është vajza e vogël e vëllait tim. Në dasmën e Anës, ne erdhëm me njëqind krushq të veshur bukur, me fustanella dhe jelekë të zinj. Kisha kishte përfunduar. Në krye të dasmës qëndronte babai i Ibrahimit, babai im dhe babai yt. Pasi morën bekimin në kishën e re, që mbante era dru të njomë, Arianit Komneni e nxori Anën dhe

Ibrahimin jashtë, ndërsa ne të tjerëve na tha të mos lëviznim. Ne u hutuam sepse nuk po e kuptonim, por kur pamë Arianitin që ndezi një qiri dhe u ngjit mbi altar nuk folëm. Ju kërkoj të gjithëve të ndizni një qiri dhe të luteni për shpirtrat e djemve që luftuan dhe vdiqën në Kretë, tha ai me një zë të fortë që akoma më bën të dridhem. Ai nuk ishte prift dhe ne nuk ishim kryengritës, por me një fjalë të tij, jam i sigurt se të gjithë do e linim dasmën dhe do niseshim për në Kretë. Por Arianiti nuk dha asnjë urdhër. Ai e ngriti qiriun e tij lart dhe ne të gjithë thamë një lutje pas tij dhe i mbajtëm qirinjtë për një kohë të gjatë mbi kokat tona. Kisha e re rënkoj si njeri. amin, tha Arianit Komneni. Amin, thamë të gjithë pas tij. Tani vazhdojmë dasmën, tha ai dhe filloi të qeshte me babanë tim. Atë natë, gjithë fshati mori pjesë në dasmën e Ibrahimit dhe të Anës. Suljotët qëllonin me pistoleta dhe kërcenin me opingat e tyre të bukura, duke i ngritur xhufkat mbi qeleshet e shokëve. Kur e pyeta Arianit Komnenin për përshpirtjen e shkurtër në kishë, ai më tha se që në fillim kishte menduar ta përuronte Kishën e re, me një meshë për të rënë e Kretës. Ata janë dëshmorët e parë të fshatit dhe kjo dasmë nuk do ishte ngjizur pa trimërinë e tyre. Por ti m'i ngatërrove gjërat, tha Arianiti duke pirë raki. Vure dasmën para meshës dhe mirë bëre, se unë kisha vënë dhjetorin para gushtit. Tani jam më i qetë, më tha, gushti mbaroi dhe unë po pres dhjetorin. M'u duk sikur më tha se po bëhej gati të shkonte në Kretë, si një prift që bekon heronjtë pas vdekjes, përfundoi Llambro Xhavella, duke parë nga Sara.

Babai shkoi në Kretë dy vjet më vonë dhe atje lindi unë, tha Sara dhe i tregoi për Shebën dhe për udhëtimin me Arianitin, i cili i tha se do shkonin në pyll të kërkonin nënën, për ishujt që shihnin nga anija, për Selanikun dhe mbërritjen në fshat. Llambro Xhavella dukej i mallëngjyer, por ai burrë nuk dinte të qante dhe emocionet i dilnin si djersë mbi mustaqet e kuqe. Kur Sara mbaroi, ai i fshiu mustaqet dhe e pyeti: Kur vdiq babai? Ndoshta nuk ka vdekur, akoma, tha Sara duke ulur sytë. Ai iku nga fshati ditën që vëllai im, Gjergji, u bë mysliman. Llambro Xhavella u zgjat nga Sara sikur donte ta pyeste se ku kishte ikur Arianiti, por ajo nuk e la të vazhdonte, e kapi nga dora dhe i tha: Eja të shohësh Anën, duhet të jetë zgjuar.

Kur Ibrahimimi me djemtë erdhën në shtëpi, Sara dhe Llambro Xhavella po loznin me Ana Komnenën. Llambro i vuri vajzës dorën te koka dhe i preku flokët e dendur dhe të zinj. M'i jep një palë balluke t'i çoj në fshat te njerëzit e mi, i tha Sarës, e cila mori një gërshërë, i preu vajzës disa flokë mbi ballë dhe ia dha Llambros. Ky, pasi i mori erë, e futi cullufen në një xhep të jelekut. Ana filloi të qante kur pa që i morën diçka nga koka, ndërsa Llambro doli jashtë si fajtor dhe u ul përballë tavolinës, në kohën që hyri Ibrahimimi.

Mirë se erdhe, iu drejtua Ibrahimimi i habitur kur e pa, ndërsa Petro dhe Jani iu hodhën në qafë. Djemtë e tjerë nuk e kishin parë kurrë Llambro Xhavellën dhe filluan të hapin sytë nga pishqollat që rrinin si të papuna mbi tavolinë.

Unë kam ardhur për gëzim, por mora vesh se i zoti dhe e zonja e kësaj shtëpie paskan vdekur, tha Llambro Xhavella. Ngushëllime. Unë jam Llambro Xhavella, daja i Anës, zonjës së shtëpisë. Ju kush jeni, iu drejtua ai Ibrahimit duke ngritur mjekrën e kuqe si një sqep kërcënues. Llambro Xhavella ishte i ftohtë, sikur kishte takuar një njeri të panjohur në majë të malit. Ibrahimimi u step dhe pa Sarën në sy si të kërkonte ndihmë. Djemtë rrinin në këmbë të shushatur dhe nuk kuptonin në ishte koha e përshtatshme për ta pyetur Llambro, për Sulin, për Foton, për kushërinjtë, për kuajt dhe për detin. Është babai, dajë Llambro, foli Petro me zë të ulët, siç i flitet një njeriu që do ta zgjosh nga gjumi pa e trembur. Derisa në këtë shtëpi shpjegimet i jep i biri, do të thotë që unë kam të drejtë të besoj se babai ka vdekur, përsëriti Llambro Xhavella duke lëvizur pak mjekrën

në drejtim të Petros, si dikush që noton dhe herë pa shere kthen pak kokën për të parë shokun që e ndjek.

Jam unë, foli Ibrahimimi. Nuk mund të mos më njohësh. Ti ke qenë krushk i parë në dasmën time dhe të Anës. Unë doja të martohesha në shtator, por ti e shtyve dasmën në tetor dhe më the se Ana nuk i kishte mbushur akoma 16 vjeç. Nuk mbaj mend t'ju kem takuar në atë dasmë, por mund të më thuash si quhesh, se mbase kujtohem. Unë jam Ibrahimimi, tha Ibrahimimi. Të thashë që nuk njihemi, tha Llambro Xhavella duke parë si fitimtar nga Sara. Në dasmën e mbesës sime nuk u ftua asnjë mysliman. Vajza e mikut tim, Arianit Komnenit më tregoi me shumë dhimbje se si vdiq mbesa ime e shtrenjtë. Por në qoftë se ti Ibrahim do të më tregosh se si vdiq burri i krishterë i Anës unë jam gati të të dëgjoj. Jam bërë mysliman dhe kam ndërruar emrin. Ana e pranoi kur i thashë se nuk do merrja gra të tjera siç thotë Islami, tha Ibrahimimi.

Unë e martova mbesën me një të krishterë dhe djemtë e saj lindën të krishterë, u kthye me një zë të fortë Llambro dhe duke parë nga Petro e pyeti: Ku është Thanasi? Petro pa nga Ibrahimimi de ky e miratoi me kokë, si për t'i dhënë leje. Thanasi ka ikur me Ali Tepelenën në Janinë, tha Petro. Llambro Xhavellës iu fry mjekra dhe koka e tij e rruar u skuq si një domate e plasarit. U ngrit në këmbë, mori pisqollat, i futi në brez dhe tha: Po ta kishte babanë gjallë, ai djalë nuk do shkonte pas një kusari mysliman që vjedh bagëti dhe përdhunon gra të krishtera. Ti paske dëbuar një jetim nga shtëpia dhe ky është mëkat, iu drejtua Ibrahimimi me zë të çjerrë dhe pastaj duke parë nga Petro tha me ton urdhërues: Vishu ti djalë, do vish me mua që mos përfundosh dylber i ndonjë kusari tjetër. Petro nuk lëvizi nga vendi, por pa nga i ati, i cili dukej i humbur. Nisemi, tha Llambro Xhavella, por u kthye dhe iu drejtua Sarës që rrinte si e ngrirë: Babai yt ka qenë njeri i besës. Të lutem t'i mbash këta jetimë si të ishin djemtë e tu. Ndoshta, vij vitin tjetër dhe i marr edhe këta. Llambro Xhavella doli dhe pas tij edhe Petro, të cilit i foli vetëm Muhamedi. Kujdes kur të notosh Petro, se kali i dajë Llambros m'u duk i plakur. Petro kapërceu pragun pa derë, ndërsa Ibrahimimi, i cili gjithë kohën kishte qëndruar në këmbë, u afrua te tavolina dhe mbështeti duart. Mbi syprinën e saj të shkëlqyer vetja iu duk si një njeri tjetër.

Karriget dhe dera e re u bënë pas disa javësh. Ibrahimimi dhe Jani punonin me ngadalë, pasi Petro iku me Llambro Xhavellën. Ibrahimimi sharronte në pjesë të vogla drurët e panjës, ndërsa Jani i fërkonte me shtuf. Niko, Muhamedi dhe Aliu luanin në pyll dhe numëronin këmbët e karrigeve. Derën Ibrahimimi e bëri me dru të fortë lisi. E mban lagështirën, i tha të birit. Shpatullat iu mavijosën të dyve duke sharruar lisin e gjatë me lëkurë të ashpër, që nuk donte të binte dhe prandaj ata thirrën disa burra nga fshati, për ta rrëzuar. Jani i qëroi si peshk luspat e mëdha të lisit dhe ndezi zjarr për të tharë njomësinë që avullonte si frymë njeriu.

Kur karriget rrethuan tavolinën e re dhe Ibrahimimi mbylli derën e shtëpisë, Sara i tha djemve të laheshin dhe filloi të bënte darkën. Preu marule dhe i mbushi me gjizë, poqi patëllxhanë që pastaj i futi në vaj ulliri, ndau në mes gjashtë patate të mëdha dhe i mbushi me mish, zieu oriz që e zbukuroi me pluhur kanelle dhe përgatiti një tavë balte me mëlçi dhe zorrë të grira që kur e pyeti Ibrahimimi ajo i tha se quhej koranik. Sara rrahu kos dhe kur ky u bë si krem ajo i hodhi sipër mjaltë, pastaj preu në feta të vogla gjithë lëng disa hurma, mollë dhe dardha dhe i leu me sheqer e i poqi dhe ato. Nga sëndukët e Arianitit, Sara nxori një takëm me lugë të dredhura dhe thika të gjata, të cilat Ibrahimimi i mprehu duke i fërkuar me ujë dhe me gur, sepse vitet ua kishin thinjur tehun. Ajo pastroi një shandan të pluhurosur me shtatë krahë që Arianitit ia kishte dhënë Sheba dhe në secilën prej kupave të vogla nguli një qiri. Shtëpia nuk kishte qenë kurrë më e ndriçuar. Sara nuk e vuri Anën në gjumë dhe e mori djepin e saj në dhomën e bukës. Ana nuk ia ndante sytë flakës së qirinjve dhe qeshte. Ibrahimimi u ul në krye të tryezës dhe Sara në fund, përballë tij.

Jani dhe Niko u ulën majtas, ndërsa Muhamedi dhe Aliu djathtas. Përpara se të fillonin, Sara tha amen dhe ashtu bënë edhe Jani me Nikon, por dhe Aliu që i imitoi. Ibrahimimi uroi me një gotë raki, ndërsa Muhamedi futi një hurmë të pjekur në gojë. Në fillim nuk folën sepse të gjithë e kishin mendjen tek ushqimet, një pjesë e të cilave ishin të panjohura për ta. Ibrahimimi pinte raki dhe i gëzohej tavolinës e karrigeve të reja dhe u fliste djemve sa herë që këta rrëzonin pilaf dhe copa mishi mbi syprinën e kuqe. Mendova se nuk do na nxinte, tha Ibrahimimi. Po të ishte Petro do dukej më e vogël, tha Jani duke provuar orizin me kanellë dhe mendoi se Sara kishte pasur të drejtë kur kishte porositur një tavolinë për gjashtë veta. Djemtë i zuri gjumi menjëherë, sapo tavolina u zbraz nga ushqimet. Ibrahimimi vazhdoi të pinte raki dhe kur Sara iu afrua për të mbledhur enët, ai e kapi për beli dhe e puthi. Duro të marr shandanin, i tha Sara dhe të dy shkuan në dhomën e gjumit. Ibrahimimi mbante era kanellë, ndërsa Sara e kishte gojën të mbushur me lëng hurme. Qirinjtë u lëngëzuan mbi shandan deri në mëngjes. Para se ta zinte gjumi, Sara mendoi se dhe e ëma duhej ta mbante ndezur atë shandan kur bënte dashuri me Arianitin.

Djemve iu shijoi kuzhina e Sarës dhe çdo ditë i kërkonin gjëra të reja. Ajo piqte bukë dhe kuleç të vegjël që i mbushte me arra dhe i spërkaste me mjaltë ose me reçel. Dhoma e oxhakut mbushej me tym kur kuleçtë digjeshin dhe Sara i tha Ibrahimimit se duhej të bënin një furrë të madhe jashtë shtëpisë. Ibrahimimi pyeti nëpër fshat dhe një ditë filloi të ndërtonte skeletin e furrës në oborr. Mori disa drurë që pasi i kryqëzoi si një kube, i veshi nga lart me baltë dhe i la disa kohë të thaheshin. Balta u forcua dhe u kap fort pas drurëve që mos binte. Por Ibrahimimi i vuri flakën dhe drurët u dogjën të parët dhe ranë si prush në folenë e furrës. Balta u bë si kërcu dhe mbeti aty lart si një tavan i ngrirë. E ke gati, it ha Sarës. Në furrën e re kuleçtë dilnin më të fryrë dhe Sara filloi t'i priste ato në forma të ndryshme që djemve u dukeshin si lodra. Një herë nga furra dilte një ushtri me kuaj, pastaj dilte një tavë me zogj prej brumi, pastaj disa dele apo edhe katrorë e diej të rrumbullakët. Djemtë ia bënin sytë kafshëve me lajthi dhe bajame dhe kur i vinin kafshët të ziheshin me njëra-tjetrën askush nuk fitonte, sepse zënka përfundonte në thërrime të verdha prej gruri. Jani i bëri Sarës një okllai të re dhe të lëmuar me të cilën ajo e shtypte fort miellin dhe pastaj i jepte formën e lodrës, me një thikë të mprehtë. Niko kërkonte vetëm kuaj, Aliu donte katrorë, ndërsa Muhamedi pëlqente kuleç në formë hëne, të cilat i ngjyente në reçel kumbulle. Pas kuleçve të mëngjesit dreka hahej me lakror që Sara e mbushte me gjizë, me vezë dhe me presh. Ibrahimimi donte lakror me petë të holla dhe të mbushur me pllaqi, ndërsa Jani ngrihej herët në mëngjes, shkonte në pyll dhe sillte një thes me hitra që ia përcëllonin duart. Djali i lante hitrat vetë dhe i thoshte Sarës t'ia mbushte me to, pjesën e tij të lakrorit.

Një ditë, kur Ibrahimimi u nis në qytet për të marrë paratë e disa bagëtive që kishte shitur, Sara i tha të blinte peshk. Peshk, pyeti Ibrahimimi i habitur, nuk kam ngrënë kurrë peshk. As unë, tha Sara, por ta provojmë. Pyet si pastrohet.

Ibrahimimi solli tre peshq të mëdhenj që gjithë rrugës kishin rrjedhur gjak dhe i vuri mbi tavolinë. Era e peshkut e mbushi shtëpinë dhe djemtë dolën jashtë duke mbyllur hundët. Edhe Ibrahimimit i vinte ndot duke i treguar Sarës se si pastroheshin. Në Pazar më thanë se i pritet koka, pastaj hapen nga barku dhe i hiqen të gjitha rropullitë. Mbaji në ujë të zier sa t'u dalë era dhe pastaj shtroi në tavë të piqen, tha ai dhe doli nga dhoma. Peshqit rrinin të shtrirë mbi tavolinë dhe kur Sara i ngriti për t'i nxjerrë në oborr, tre gjurmë uji të kuq mbetën mbi syprinë. I preu kokat dhe i pastroi, siç i kishte thënë Ibrahimimi. Pastaj i shtroi në tavë, i mbushi me majdanos dhe i bëri secilit një kurorë me domate dhe qepë. Djemtë vuajtën shumë me halat e peshkut dhe Ibrahimimi mezi e nxori një halë të vogël që i mbeti Aliut në fytyrë. Muhamedi nuk e preku peshkun, ndërsa Jani, pasi

i qëroi halat një nga një, e hëngri me bukë. Është shumë i mirë, tha Sara, por herën tjetër do t'ia pastroj halat dhe do t'ia mbush barkun me patate dhe oriz.

15

Kur Ana mbushi një vjeç e çuan në pyll. Korriku ishte i nxehtë, por pylli ishte i freskët. Sara bëri bukë të bardhë dhe kulaç me reçel, mbushi çantat me mish të pjekur me pllaqi, vuri djathë, domate të reja, kastravecë, mollë dhe limona dhe u nisën. Ibrahimimi mbante Anën në krahë, ndërsa Jani dhe djemtë e tjerë ushqimet. Sara ecte pas tyre me rrobat e Anës. Rugës, Muhamedi, që tërhiqte një trastë me domate, iu afrua, i dha dorën dhe i tha: Kam bërë një vjershë, por mos i thuaj babait. Nuk i them, i tha Sara, po mua do ma thuash? Po, tha Muhamedi dhe ia tha: *Dua hurma dhe në pyll shkoj, Ana rritet, unë fluturoj.*

Sara e pa duke qeshur dhe Muhamedi u skuq. Faqja e tij ishte e zbehtë dhe sytë i dukeshin edhe më të kaltër. Pse do të fluturosh e pyeti Sara. Dua të shoh botën, u përgjigj Muhamedi. Toka është e rrumbullakët si një hurmë dhe nuk e shikon dot të gjithën vetëm duke ecur. Po të ecësh nuk rrëzohesh, ia ktheu Sara duke i shtrënguar dorën. Kush fluturon bie prandaj njerëzit kanë vendosur të ecin.

Si arritën në pyll, zgjodhën një kumbull të egër të mbushur me lule të bardha, që sa kishin çelur, dhe u ulën rrëzë saj. Sara shtroi një çarçaf dhe vuri aty Anën. Djemtë vrapuan duke u fshehur pas drurëve, ndërsa Ibrahimimi filloi të hapte ushqimet. Anën e zuri gjumi dhe lulet e kumbullës ia veshën flokët si një kurorë. Kur u zgjua, Jani i solli një breshkë me kurriz të verdhë, e cila i rrinte Anës përballë, si e trullësuar. Vajza nuk fliste, por përplaste dorën mbi kurrizin e breshkës dhe përpiqej ta ngrinte lart. Kur breshka e kuptoi se fëmija nuk mund t'i bënte keq, filloi të lëvizë nëpër bar dhe Ana e ndiqte duke ecur me duar. Djemtë u lëshuan nëpër pyll dhe erdhën secili me nga një breshkë të vetën. Do bëjmë një garë me breshka, i tha Jani tre djemve më të vegjël. Numëroi dhjetë hapa dhe duke futur një shkop në tokë shënoi një vizë mbi dheun e shkrifët. Breshka e kujt vjen këtu e para ai fiton, tha Jani. Tre djemtë kërkuan pak kohë për t'u përgatitur, këputën bar dhe filluan t'i ushqejnë breshkat që nga frika nuk e nxirrnin fare kokën jashtë guaskës. Aliu u ankua se breshka e Nikos ishte më e madhe se e tij dhe kështu ai do të fitonte, por Ibrahimimi e qetësoi kur i tha se breshka e vogël do ecte më shpejt sepse ishte më e lehtë. Por Aliu nuk u bind dhe filloi të qante. Kush vrapon më shpejt një derr apo një viç, e pyeti Ibrahimimi. Viçi, u përgjigj Aliu duke fshirë lotët. Po pra, i tha i ati, sepse viçi është më i lehtë se derri. Ndërkohë, Nikoja e mori breshkën e tij të madhe, u fsheh pas një peme dhe filloi t'i fliste në vesh. Nuk lejohet t'i flasësh breshkës, i bërtiti Aliu dhe u mërziu prapë. Lejohet, i tha Jani, por varet se çfarë i thua. E çfarë t'i them, pyeti Aliu duke u afruar që të tjerët mos dëgjonin. Thuaji që nëse fiton do ta marrësh në shtëpi. Aliu u fut pas një peme dhe nisi t'i fliste breshkës.

Pasi i ngopën breshkat me fjalë djemtë ishin gati për të filluar, por Muhamedi tha se pavarësisht se breshka e Nikos dukej më e madhe, ato të gjitha ishin njëjloj dhe mund të ngatërroheshin rugës. Mund të fitojë breshka ime dhe do duket sikur ishte breshka e Aliut, tha djali. E rregulloj unë, tha Sara dhe u ngrit duke e lënë Anën të ndiqte breshkën e vet. Mori nga trasta një domate, e ndau në mes dhe e fërkoj fort pas kurrizit të breshkës së Nikos. Kurrizi u skuq dhe breshka ngriti kokën si e plagosur. Pastaj Sara mblodhi disa luledede të verdha i fërkoj në duart e veta dhe ato lëshuan një pluhur të verdhë, që ajo e shpërndau gjithandej mbi kurrizin e breshkës së Aliut. Breshka teshtiu sikur t'i kishte hyrë pluhur në hundë dhe Aliu tha: Fillojmë se po më ftohet breshka. Breshkat nuk sëmuren, tha Sara që këputi një degë të njomë kumbulle mbi të cilën kishte çelur një lule e bardhë dhe ia futi breshkës së Muhamedit poshtë guaskës. Lulja i rrinte

breshkës si një dantellë dhe Muhamedi tha se nuk donte që breshka e tij të ishte femër. Femër është breshka e Anës, i tha Jani që priste me shkop në vijën e garës. Breshka jote është një burrë që ka veshur një këmishë me lulka si ajo e dajë Llambros. Muhamedi nuk foli dhe djemtë i vunë breshkat në një rresht. Nikoja i pari, Aliu i treti dhe në mes lulja e Muhamedit.

Gati, thirri Jani dhe numëroi deri në tre. Nisu. Por asnjëra nga breshkat nuk lëvizi. Djemtë filluan t'i ndërsejnë tre kafshët e tyre, u fishkëllenin, i gjuanin mbi kurriz me thupra, u vinin bar përpara gojës, por ato prapë nuk bënë përpara. Vazhduan kështu për një kohë derisa Aliu i futi gishtin poshtë guaskës breshkës së tij të verdhë, e cila u drodh dhe filloi të ecte. Ashtu bënë edhe Niko me Muhamedin dhe të tre breshkat filluan të zvarriten, por vija e garës dukej shumë larg. Ibrahimimi me Sarën ishin bashkuar me djemtë dhe ngushëllonin me radhë secilin që vraponte i djesitur, rreth breshkës së vet. Në mes të rrugës breshka e Aliut ishte një kumbull përpara dy breshkave të tjera. Aliu filloi t'i thoshte fjalë të ëmbla breshkës së tij që e ruante distancën, ndërsa Nikoja i fuste vazhdimisht gishtin nga prapa breshkës së tij të kuqe. Muhamedi ia hoqi fare lulen e bardhë breshkës nga qafa dhe i tha Sarës se ndoshta ajo e pengonte që të gjente rrugën. Djemtë i rrinin breshkave nga prapa dhe pas tyre edhe Ibrahimimi me Sarën dhe askush nuk e pa Anën që, duke ecur këmbadoras, kaloi përpara breshkave dhe kur arriti te vija e garës u kthye me fytyrë nga ata dhe filloi të qeshte duke përplasur duart. Breshkat u frikësuan nga vajza që u doli përpara, futën kokat nën guaskë dhe asnjëra nuk lëvizi më. Mbaroi, tha Jani, garën e fitoi Ana.

Hëngrën bukë dhe pasdite u kthyen në shtëpi. Ibrahimimi eci përpara me Anën në krahë, ndërsa Sara vinte e fundit me Muhamedin që e pyeste pse toka ishte e rrumbullakët dhe jo katrore. Aliu e mori me vete breshkën e tij dhe tha se kur gara u mbyll, ajo ishte e para. Niko zihej me Janin që e kishte mbyllur garën kur breshka e Aliut ishte pak përpara së tijës dhe nuk pranoi të mbante asnjë nga trastat me ushqimet që tepruan. Para se të shtrihej, Aliu e futi breshkën poshtë krevatit të tij dhe i hodhi bar. Fli, i tha, se do ketë gara të tjera. Ndërsa Ana Komnena sillej me duar e me këmbë mbi shtratin e madh të prindërve dhe nuk fjeti deri vonë, duke e lënë dhe Ibrahimimin pa gjumë. Po iki të fle nga djemtë, i tha Ibrahimimi Sarës dhe u shtri në krevatin që kishte lënë bosh Petro. Shko, i tha Sara, po kujdes mos zgjosh breshkën.

16

Gara e breshkave u përsërit disa të diela. Aliu merrte breshkën e vet shtëpiake, ndërsa Niko me Muhamedin vërtiteshin nëpër pyll dhe sillnin breshka të reja. Një ditë ata u mërzitën nga loja dhe thanë se nuk gjetën më breshka, por Aliu tha se breshka e tij i kishte mundur të gjitha breshkat dhe ato nuk dilnin më nga frika. Ana çapitej nëpër bar, ndërsa Sara ndryshonte format e kuleçve. Kur ktheheshin, Jani merrte dru në pyll, të cilët i përzgjidhte duke i parë lulen dhe lëkurën dhe kur shkante në shtëpi i kthente në zbukurime. Ai filloi të bënte enë druri, shishe për raki, gota, okllai me përmasa të ndryshme, kanistra, rosa, pata dhe trekëndësja të vegjël për Anën.

Një ditë, Jani i thirri tre vëllezërit e tij dhe i tha se do t'u bënte atyre nga një lodër druri, por ata duhet të vendosnin se çfarë donin. Niko i kërkoi një ushtar, megjithëse nuk kishte parë kurrë ushtar me sy. Çfarë ushtari do, e pyeti Jani. Do një turk me çallmë dhe me jatagan në brez, apo një grek me kapelë të vogël dhe me këpucë me xhufka. Niko u mendua dhe i tha se donte një ushtar me jelek dhe me dy pisqolla në brez si Llambro Xhavella. Por nuk e dua tullac. Dua që ushtari im të jetë më i ri se dajë Llambro. E do me çallmë apo me qeleshe, e pyeti Jani prapë. E dua me flokë të gjata që ia merr era, tha Niko.



Aliu që e dëgjoi të vëllanë tha se ai donte një luftëtar mbi kalë si Skënderbeu. Skënderbeu kishte një përkrenare me bri dhie mbi kokë, i tha Jani dhe shpatën e kishte më të gjatë se kalin. Skënderbeu nuk i donte dhitë se ato nuk bëjnë qumësht të mirë më ka thënë babai, u përgjigj i nxehur Aliu. Unë dua që Skënderbeu im të mbajë mbi kokë jo dy, por vetëm një bri të trashë demi që i thyen parzmoret e turqve. Po shpatën, e pyeti Jani. Shpatën e dua të drejtë, por jo më të gjatë se kalin, tha Aliu.

Ndërsa Muhamedi pasi dëgjoi i qetë dy vëllezërit tha se ai donte dy lodra. Jo, i thanë vëllezërit, pse ti dy lodra kur ne do kemi vetëm nga një. Po ato janë pjesë e së njëjtës lodër, u përgjigj Muhamedi, por vëllezërit nuk po e kuptonin. Unë dua një gjë të rrumbullakët në qoftë se toka është e rrumbullakët dhe një katror në qoftë se toka është katror. Është njëlloj si ushtari yt që duket edhe nga përpara, edhe nga prapa, i tha ai Nikos. Mirë, i tha Jani, do ta bëj, se lodrat e tua janë më të thjeshta dhe gdhenden shpejt. Po unë dua që t'i bësh me pyje, me lumenj, me dete, me male dhe me fshatra, i tha Muhamedi. Po njerëz nuk do, e pyeti Jani. Jo nuk dua, tha Muhamedi. Njerëzit janë të vegjël dhe nga lart nuk duken.

Jani punoi një muaj për kukullat e vëllezërve. Shkoi në pyll dhe zgjodhi lis për ushtarin e Nikos dhe Skënderbeun e Aliut, ndërsa tokat e Muhamedit vendosi t'i bënte me qershë sepse ajo vinte si e murrme dhe ai mendoi se toka e parë nga lart kishte atë ngjyrë. Preu me kujdes katër kuti të vogla të barabarta, në madhësinë e një ikone, por u kujtua se shpata e Skënderbeut do të dilte mbi lartësinë e lodrave të tjera dhe preu një kuti më të gjatë. Vizatoi me brisk hekuri mbi secilën kuti, format e tyre të përafërta dhe filloi t'i priste trashë. Ashtu, lodrat dukeshin si gurë që koha dhe erërat i kishin gdhendur rastësisht, pa asnjë qëllim. Pastaj, me një daltë të vogël filloi të nxirrte ngadalë ashklat e drurëve derisa koka e ushtarit të Nikos u duk si një kokë ariu, pa faqe dhe pa hundë. Jani e la ushtarin e Nikos dhe kaloi te Skënderbeu i Aliut derisa edhe ky u duk si një ari i paushqyer. E la dhe atë dhe filloi të merret me kalin. Faqet dhe hundët e ushtarit dhe të Skënderbeut do t'i bëj në fund, tha me vete duke menduar se duhet t'i bënte të dukeshin si njerëz të ndryshëm sepse përndryshe vëllezërit do të ziheshin. Aliu nuk mund të pranojë që Skënderbeu të ketë fytyrë ushtari, qeshi Jani dhe vazhdoi të rrumbullakoste tokën e Muhamedit. Jani nuk kishte parë ndonjë det dhe nuk dinte nëse ai ishte më i madh dhe apo më i vogël se lumi. Në darkë pyeti Sarën dhe ajo i tha se bota kishte më shumë dete sesa pyje dhe lumenj dhe se çdo lumë bashkohej me detin dhe çdo det bashkohej me një det tjetër. Po pyll në mes të detit ka, e pyeti Jani. Ka, tha Sara. Janë ishujt, por ata janë të vegjël dhe nuk duken nga lart. Me përjashtim të Kretës, tha ajo dhe pa nga Ibrahim i që nuk po e dëgjonte.

Jani i gdhendi imët pishqollat e ushtarit, por megjithatë njëra doli pak më e gjatë se tjetra. Ndërsa shpata e Skënderbeut u thye pak në majë dhe Jani ia shkurtoi këmbët e kalit, që t'i sillte në proporcion. Pastaj thelloi lumenjtë që dukeshin si gishta mbi tokën e Muhamedit dhe duke e futur daltën thellë në dru bëri nga të gjitha anët pyje që dukeshin si gjilpëra të ngulura mbi një top leshi. Në mes të një deti të madh, ngriti një gungë të vogël si nishan, që ishte Kreta. Kur mbaroi faqet, hundën dhe sytë e ushtarit dhe të Skënderbeut, njëri dukej si një burrë i hollë me faqe të verdha, ndërsa tjetri si një bullafiqi nën peshën e të cilit kali me këmbë të shkurtra po jepte shpirt.

I pastroi nga pluhuri dhe i hodhi pak ujë që të shkëlqenin. Thirri tre vëllezërit dhe ua tregoi. Në fillim ata u habitën, por pastaj filluan të shikonin me qetësi dhe të krahasonin secili kukullën e tij me dy të tjerat. Pse njëra pishqollë është më e gjatë se tjetra, u hodh Niko. Sepse ushtari yt njërin ia ka marrë një turku dhe tjetrën një greku, tha Jani. Po pse ushtari im është më i dobët se Skënderbeu, vazhdoi Niko. Sepse ushtari shkon në luftë dhe nuk ka kohë të hajë, ndërsa Skënderbeu rri majë kalit dhe nuk lodhet. Skënderbeu ka kalë sepse është komandant, tha Aliu

duke mbrojtur kukullën e tij. Por pasi e pa mirë u hodh dhe ai. Kali i ka këmbët e shkurtra dhe duket si mushkë. Kali i Skënderbeut ishte ndryshe nga të tjerët, tha Jani. Ai ishte shumë i shpejtë dhe prandaj i ka këmbët më të shkurtra. Çfarë është kjo, pyeti Muhamedi duke treguar ishullin me gisht. Kjo është Kreta, tha Jani. Është një ishull. Po pse ma ke vënë Kretën, unë nuk ta kërkoja, tha Muhamedi. Këtë ma kërkoi Sara, tha Jani duke parë nga ajo. Muhamedi u kthye nga Sara, si për t'i thënë se nuk kishte punë me lodrën e tij, por Ibrahim i ndërhyri dhe i tha: Në Kretë është vrarë gjyshi im dhe stërgjyshi yt. Është mirë që e ke futur në botën tënde. Muhamedi nuk foli, por Aliut iu duk se heroizmi kaloi nga shpata e Skënderbeut te bota e Muhamedit dhe duke iu afruar Ibrahimit e pyeti: Me shpatë ka luftuar gjyshi? Po, i tha Ibrahim. Po pisqollë ka pasur, tha Nikoja. Nuk e di, tha Ibrahim, por ndoshta e kanë vrarë me pisqollë.

Kaq duhej që dy djemtë të fillonin luftën. I afruan kukullat e tyre dhe, duke i ngjitur me njëra-tjetrën, i shtynin fort. Ushtari yt nuk i nxjerr dot pisqollat nga brezi, thoshte Aliu dhe i fuste shpatën ushtarit në sy. As shpata jote nuk ia pret dot kokën ushtarit tim, bërtiste Niko duke shtyrë Skënderbeun e shëndoshë. Në fillim u thye briri i përkrenares së Skënderbeut, pastaj ushtari mbeti me një krah dhe me krahun tjetër u hakmor duke i thyer Skënderbeut shpatën. Kështu janë më të bukur, tha Sara, duken si statuja antike.

Djemtë fjetën atë natë duke e futur secili poshtë krevatit heroin e vet të plagosur. Ushtari me një krah humbi ekuilibrin dhe u rrëzua, ndërsa Skënderbeu rezistoi, por breshka e lëpiu gjithë natën. Muhamedi e futi tokën e tij të rrumbullakët poshtë jastëkut, por ashtu nuk mund të flinte sepse koka i dhembte mbi drurin e fortë. E mori dhe e vuri dhe ai poshtë krevatit, tokën e vet. Para se të flinte i tha Janit: Po të ma kishe bërë tokën katrore tani do më kishte zënë gjumi.

Kur u zgjuan në mëngjes, asnjëri nuk e gjeti lodrën poshtë krevatit. Kontrolluan nëpër shtëpi, hapën sirtarët, shkuan në qilar, por nuk i panë kund. Shkuan te dhoma e prindërve, por aty Ana po flinte me një patë në dorë. Dolën në oborr dhe panë që Sara i kishte rreshtuar tre kukullat mbi një plloçe dhe po i shihte. Do t'i lyej, tha ajo kur djemtë e pyetën.

Në fillim Sara leu me të kaltër detet, pastaj i dha një jeshile të errët pyjeve, nxiu lumenjtë dhe malet i bëri me bojë kafe. Po Kretën si do e lyesh, e pyeti Muhamedi. Me të kuq, u përgjigj Sara. Aty është derdhur shumë gjak. Me ngjyrë të kuqe u lye dhe fustanella e ushtarit, ndërsa këmisha e tij dhe kali i Skënderbeut u bënë të bardha. Pisqollat dhe përkrenarja e Skënderbeut u lye me ngjyrë të zezë, ndërsa pjesa e mbetur e shpatës u vesh me një të verdhë ngjyrë ari. Fytyra e shëndetshme e Skënderbeut u lye me rozë, ndërsa pelerina ngjyrë vjollcë. Flokët e gjata të ushtarit u zverdhën, ndërsa faqet dhe hunda u lye me bojë kafe. Ushtari është nxirë nga dielli nëpër luftëra, tha Sara duke lyer me gri shtëpitë e vogla të botës së Muhamedit. Si mbaroi, i vuri mbi plloçe që të thahen. Ushtarin dhe Skënderbeun përballë njëri-tjetrit, ndërsa tokën e Muhamedit në mes të të dyve. Tani kanë arsye të luftojnë për një copë tokë, tha Sara dhe i mori djemtë për t'u dhënë mëngjes.

17

Në dimër ra dëborë. Oborri u zbardh dhe pylli dukej më i zi. Kukullave u ishin zbehur ngjyrat dhe ushtari i Nikos ishte thinjur nga luftërat. Lumenjtë e tokës së Muhamedit ishin tharë, kurse Skënderbeu i kishte zbritur kalit dhe ngrohej si ulok pranë vatrës.

Ibrahimi mbushte oxhakun me dru, ndërsa Sara gatante trahana për djemtë. Muhamedi u ftoh dhe derisa shkriu bora nuk u ngrit nga krevati. Sara e mbështolli me batanije, por ai prapë dridhej nga ethet. Ibrahim flinte në dhomën e djemve dhe natën i vinte leckë me dëborë në kokë. Muhamedi u dobësua dhe sytë e kaltër nuk i shkëlqenin më. Një natë filloi të fliste përçart nëpër

ethe dhe Ibrahimimi zgjoi Sarën dhe i tha se kishte dëgjuar Muhamedin që thoshte: Po fluturoj, po fluturoj. Pastaj pushoi dhe pas pak tha: Nuk ka nevojë të fluturosh, mund të vish tek unë duke ecur.

Sara i hodhi një batanije tjetër Muhamedit dhe i tha Ibrahimimit të merrte një grusht me dëborë të pastër. Ibrahimimi u kthye në çast dhe Sara i mori borën nga duart e tij dhe ia futi Muhamedit në gojë. Muhamedi u gëlltit disa herë në gjumë, ndërsa bora shkrihej ngadalë në fytyrën e tij të zjarrtë. Të nesërmen ishte më i qetë. Sara e pyeti se a mbante mend ndonjë ëndërr dhe ai i tha jo. kujtohu, i tha Sara, ti flisje me vete sikur po takoje një njeri në pyll. Nuk ishte zëri im, tha Muhamedi dhe u kthye nga ana tjetër e fjeti.

Kur u zgjua, mori tokën e rrumbullakët dhe filloi t'ia hiqte bojën e tharë që dimri e kishte plasaritur. Hoqi në fillim të kuqen e Kretës dhe pastaj me radhë blunë, jeshilen e pyjeve dhe grinë e pisët mbi fshatra. Bojërat e ngrira binin si lëkurë mbi çarçaf. Pse po e zhvesh tokën, e pyeti Jani. Kur fluturon lart e gjithë toka ka një ngjyrë, tha Muhamedi. Po ti nuk ke fluturuar, i tha Jani, por Muhamedi nuk u përgjigj dhe vazhdoi të qëronte tokën me thonj. Janit iu duk sikur i vëllai ishte mërzhitur me lodrën dhe i tha se do t'i bënte tokën katrore që i kishte premtuar në vjeshtë. Bëje pa det dhe pa ishuj, i tha Muhamedi. Jani shkoi në qilar ku mbante disa drurë që herë pas here i kthente në pjata për Sarën dhe trekëndëshat për Anën. Zgjodhi një copë qershi, e preu në formë drejtkëndëshi dhe filloi ta gdhendte vetëm në pjesën e sipërme. Bota katrore duhet të jetë si plis, mendoi, nuk duket nga tri anët e tjera. Nuk bëri dete, as lumenj, por gdhendi një pyll me dru të gjatë dhe të shtrembër dhe buzë tij, një fshat me shtëpi të çrregullta. Në mes të fshatit sajoi një kishë që nga lart dukej si tavolinë e vogël me pikë në mes. Rreth kishës ndërtoi shtëpi dhe të gjitha i bëri më të ulëta se kisha. Punoj gjithë ditën në qilar megjithëse duart i dridheshin nga i ftohti. Kur u err, i kërkoi Sarës shandanin me shtatë krahë dhe vazhdoi duke punuar nën qirinjtë që shkriheshin ngadalë. Njëri nga qirinjtë kulloi mbi fshat dhe Jani i veshi gjithë çatitë e shtëpive me dyllin e bardhë që ngriu menjëherë. Në mëngjes ia dha Muhamedit. Pse i ke veshur çatitë me qiri, e pyeti Muhamedi. Është dimër dhe ka rënë borë në fshat, tha Jani. Po pse ky është fshati ynë, pyeti Muhamedi duke e parë me kujdes. Po, tha Jani. Ja ku është pylli, kisha, ja dhe shtëpia jonë, shtëpia e Arianitit dhe me radhë. I ngjan, tha Muhamedi dhe sytë e kaltër i shkëlqyen prapë. Por jo edhe për shumë kohë, se fshati do ndryshojë. E si do ndryshojë, i tha Jani duke buzëqeshur.

Muhamedi e rrotulloi fshatin nga të gjitha anët sikur po shihte fundin e një filxhani, pastaj e ktheu nga i vëllai dhe duke treguar një shtëpi me gisht i tha: Kjo është shtëpia jonë dhe këtu është shtëpia e Mihalit, apo jo? Jani tundi kokën për ta miratuar. Këto dy shtëpi do bashkohen. Këtu ku duket një vend bosh duhet të jetë fusha ku janë varrosur bagëtitë që vdiqën gjatë kolerës. Po, tha Jani. Këtu do ndërtohet një shtëpi dhe ti do shkosh aty, tha Muhamedi. Edhe po të ngjallen bagëtitë nuk do ta ndërtojnë shtëpinë aty ku kanë ngordhur, tha Jani që po i shijonte fshatin e ri, sipas Muhamedit. Nuk do jenë bagëti, por disa njerëz të zinj me çanta do vijnë në fshat dhe do ta ndërtojnë shtëpinë aty, tha Muhamedi i përqendruar dhe vazhdoi:

Kjo kutia e vogël këtu është shtëpia e Hanës, mbesës së Sarës. Kjo shtëpi do shembet dhe këtu do ndërtohet një xhami. Sa do gëzohej babai, tha Jani duke vazhduar lojën. Kurse kjo është shtëpia e madhe e Arianitit, apo jo? po, tha Jani, ajo është. Kjo do bëhet shkollë, tha Muhamedi dhe pastaj do zbrazet. Tani e besoj që paske fluturuar, u tall Jani dhe u çua duke drejtuar jastëkun ku mbështetej i vëllai që i mbante sytë në tavan sikur shikonte fundin e një filxhani.

Pas tri ditësh, Muhamedit iu rritën prapë ethet, por Sara ia mbushi gojën me borë dhe ai u qetësua. Nikoja me Aliun që luanin në oborr një mëngjes panë mbi dëborë disa hapa të vegjël që

nuk i ngjanin hapave të tyre. Na ka ardhur një lepur në shtëpi, tha Ibrahimimi kur djemtë e pyetën. Ku rrinë lepujt, pyeti Aliu. Në pyll, tha i ati, dalin në dimër se i merr uria, kurse në verë ushqehen. Sikur të isha lepur do bëja të kundërtën, tha Niko, do ushqehesha në dimër dhe do luaja në verë.

Në darkë Ibrahimimi i tha Sarës se do dilte për gjah. Kafshët janë të uritura dhe i bien kollaj lakut, tha ai dhe zbriti në qilar për të marrë ç' i duhej. Sara u ngrit herët në mëngjes poqi kuleç, bukë dhe zjeu patate. Mbushi me raki një shishe të vogël druri që e kishte gdhendur Jani dhe i futi të gjitha në një trastë. Do vij dhe unë me ty, i tha Jani të atit. Ti rri në shtëpi, tha Ibrahimimi. Do marr Nikon dhe Aliun se ata nuk kanë parë lepuj. Sara i veshi djemtë trashë, u dha nga një kapuç leshi për të mbuluar veshët dhe u nisën. Ibrahimimi ecte para dhe çante dëborën, ndërsa dy djemtë shkelnin mbi gjurmët e tij të mëdha dhe bora u vinte deri në gju.

Kur shkuan në pyll, aty kishin bërë garën e breshkave, Ibrahimimi nxori dy çarqe të mëdhenj nga trasta dhe filloi t' i rregullonte duke i vënë pak mish të thatë, bukë dhe patate që i kishte marrë me vete. Ha lepurin mish, e pyeti Aliu. Jo, tha Ibrahimimi, por nga era mund të gënjehet dhe i bie çarkut. Po pse e harxhon mishin, vazhdoi Niko. Mund të zëmë ndonjë dhelpër, tha Ibrahimimi. Unë dua lepur, tha Aliu. Mirë, tha Niko, unë po marr dhelpërën se ajo e ha lepurin. Ndërkohë, Ibrahimimi mori njërin çark dhe, duke e mbajtur me kujdes, i tha Aliut ta ndiqte. Ti rri këtu, i tha Nikos, dhe ruaj trastat, nuk vonohemi. Po pe ndonjë dhelpër, më thirr. U nisën duke e çarë me hapa të vegjël dëborën e pashkelur dhe pas pak Niko nuk i pa më. Dielli ishte i fortë atë ditë, por djali i kishte këmbët deri në gju në dëborë dhe nuk ngrohej dot. Filloi të rrotullohej rreth trastave duke numëruar me zë për t' u ngrohur. Kur arriti deri në njëqind ndaloi se nuk dinte të numëronte më tepër. Filloi nga e para, por dëgjoi një zhurmë dhe e ndërpreu numërimin. Po vjen dhelpëra, mendoi dhe u ul mbi trasta, sikur kishte frikë. Ktheu kokën andej nga kishte ardhur zhurma dhe pa një degë të vogël që, duke u thyer nga pesha, ra në këmbët e pemës së kumbullës. U çua prapë dhe vazhdoi të rrotullohej duke numëruar. Kur kishte arritur shtatëdhjetë e gjashtë dëgjoi prapë një zhurmë më të fortë dhe u ul instinktivisht. Ktheu kokën dhe pa Ibrahimimin me Aliun që po vinin duke qeshur. Kishte frikë, i tha Aliu, të pamë. Faqet e Nikos ishin të kuqe nga të ftohtët dhe e skuqura nuk iu duk. U ula që mos më shikonte dhelpëra, tha ai. Po ju a e kapët lepurin? Do ta kapim, tha Aliu. Andej kishte shumë gjurmë dhe patatja do t' i mbledhë lepujt. Ibrahimimi mori çarkun tjetër dhe, pasi e mbushi me mish dhe me patate si të parin, i tha Aliut të qëndronte aty dhe mori Nikon me vete. Morën drejtimin e kundërt me të parin, nga ku pylli ishte më i dendur dhe dëborë më e trashë. Ibrahimimi ecte përpara dhe Niko mezi i ngrinte këmbët për t' i futur në gjurmët e thella të të atit. Aliu hapi trastën dhe nxori një kulaç që filloi ta hante. Kulaçi ishte i ftohtë, por Aliu kafshonte pa e pasur mendjen. Nga pas i erdhi një zhurmë e butë si një peshqir që fërkohej pas trupit. Ktheu kokën dhe pa një lepur të bardhë me bisht të zi që i merrte erë borës. Kur Aliu lëvizti, lepurin ngriti kokën dhe e shikoi nga dora. Sytë i kishte të kuq si xham. Aliu këputi një copë kulaç dhe ia hodhi te këmbët. Lepuri i mori erë dhe pastaj e kafshoi me dhëmbët e vegjël duke lëpirë buzët me gjuhë. Dëborë u mbush me thërrime që lepurin i ndoqi një nga një duke lëvizur vetëm kokën. Do ta kap, mendoi Aliu dhe iu hodh sipër, por lepurin i shkau nën bark dhe vrapoi. Aliu u ngrit dhe filloi ta ndiqte. Lepuri vraponte shpejt mbi dëborë, ndërsa ai zhytej deri në gju dhe mezi ngrinte këmbët. Aliu nuk u dorëzua dhe duke rendur mendonte fytyrën e habitur të Nikos kur t' i tregonte lepurin, që ai do ta mbante nga veshët. Lepuri u fut në pyll dhe ndaloi. Aliu iu afrua, por kafsha kërceu dhe u fut pas një peme. Veshët e gjatë i dilnin jashtë dhe dukeshin si dy gishta që e thërrisnin Aliun, i cili çau nëpër dëborë dhe iu afrua lepurit që kërceu dhe u fsheh pas një peme tjetër. Djali nuk lodhej, ndërsa lepurin, i ngopur me kulaç, luante.

Kur Ibrahimimi u kthye te trasta u frikësua kur nuk e pa të birin. Mos e ka ngrënë ndonjë ujë, tha Niko dhe filloi të dridhej. Ujqit rrinë në male, i tha Ibrahimimi dhe filloi të kontrollonte gjurmët mbi dëborë. Dy herë u rrotullua pas gjurmëve që kishte lënë Nikoja kur numëronte, por pastaj pa disa gjurmë më të freskëta që merrnin andej nga kishte lënë çarkun e parë dhe u nis. Prit këtu dhe mos ki frikë, i tha Nikos. U fut në pyll duke ndjekur gjurmët që kalonin nga një pemë te tjetra, pastaj ktheheshin prapë dhe vazhdonin më thellë nëpër pyll. Duke ecur pas tyre, si pas një gjahu, pa Aliun të ulur në gjunjë, ndërsa dy hapa larg tij rrinte një lepur me bisht të zi. Aliu i fliste dhe lepuri tundte kokën sikur e kundërshtonte. Pastaj lepuri kërcëu dhe Aliu e ndoqi. Ibrahimimi filloi të qeshte dhe duke ecur shkeli pa e parë mbi një degë të hollë, e cila kërcëti dhe u thye me zhurmë nën këmbën e tij. Aliu ktheu kokën, ndërsa lepuri u zhduk pas një peme dhe nuk doli më. Ma trembe lepurin, i bërtiti Aliu duke hequr kapuçin që i ishte lagur nga djersët. Nuk kapet lepuri me vrap, i tha Ibrahimimi. Kapet që ç'ke me të, këmbënguli i biri me inat. Unë sa po e bindja. E çfarë i the, e pyeti Ibrahimimi. I thashë të vinte me mua në shtëpi se do t'i jepja kulaç sa të donte. Ibrahimimi qeshi dhe ia mbathi kapuçin e lagur.

Morën për nga fusha e breshkave, ndërsa Aliu ecte përpara dhe gjithë kohën kontrollonte pas pemëve. Kur u afruan, Ibrahimimi pa që Nikoja nuk ishte aty ku e kishte lënë. Trasta nxinte e vetmuar mbi dëborë. Paskam ardhur për të gjuajtur djemtë e mi dhe jo lepuj, mendoi, dhe gjaku i zjeu në tëmthat e ftohtë. Kontrollloi gjurmët e Nikos, siç kishte bërë herën e parë dhe u nis në atë drejtim. Hajde me mua shpejt, i tha Aliut dhe eci me hapa të mëdhenj. Gjurmët e çuan te çarku. Nikoja ishte përkulur mbi të dhe nuk lëvizte. Kur u afrua, Ibrahimimi pa disa njolla gjaku mbi dëborë, ndërsa patatja ishte ngrënë përgjysmë dhe kishte përfunduar jashtë dërrasës së çarkut. Në thikën e shkrehur varej jetim një bisht i zi. Ishte një lepur, tha Niko i penduar, por e lëshova. Frikacak, i tha Ibrahimimi që nxori thikën dhe e ndau bishtin nga çarku. Është lepuri im, tha Aliu duke marrë bishtin e zi. Donte të hante kulaç dhe jo patate. Nuk ishte lepuri yt, tha Nik dhe i tregoi të atit se si kishte vrapuar në drejtim të çarkut kur dëgjoi një zë kafshe që rënkonte nga dhimbjet. Më erdhi keq kur e pashë që qante si njeri, tha Niko me sytë e lagur. Aliu futi bishtin e zi në xhep dhe i tha të vëllait: Herë tjetër mos i ndiq më lepujt e mi.

Hëngrën kuleçtë që kishte gatuar Sara dhe shkuan dy herë të kontrollonin çarqet, por derisa u errato nuk u mbushën. U kthyen në fshat kur Anën sapo e kishte zënë gjumi. Nikoja fjeti pa i folur askujt, ndërsa Aliu i tregoi Janit për lepurin duke fërkuar bishtin pas faqes. Do ta kisha kapur, i tha, por e trembi babai. Lepuri nuk është breshkë, tha Jani. Ai nuk mund të rrinte poshtë krevatit. Kur u shtrinë, Ibrahimimi i tregoi Sarës se si kishte humbur njërin pas tjetrit, djemtë në pyll. Shkova për kafshë, por zura gjah djemtë e mi, i tha duke parë shandanin që digjej. Tani je bërë një Abraham i vërtetë, tha Sara. Ibrahimimi mblodhi supet nën velenxë për t'i thënë se nuk e kishte kuptuar. Errësira e kishte bërë dhomën më të ftohtë dhe Sara i zgjati këmbët nga Ibrahimimi. Nuk e gjej veten në historinë e Abrahamit, tha Ibrahimimi. Unë shkova të vras kafshë, jo njerëz, ndërsa Abrahami shkoi të vriste djalin e tij dhe vrau një kafshë. Ti je mijëra vjet pas Abrahamit dhe nuk je profet, tha Sara. Perëndia i ka lënë njerëzit të lirë dhe nuk u thotë më se kë duhet të vrasin apo se kë nuk duhet të vrasin. Prandaj bota është bërë kaq e ngatërruar. Por, megjithatë, ti ke edhe një ngjashmëri tjetër me Abrahamin. Çfarë kam tjetër, pyeti Ibrahimimi me zë të butë, i ngrohur nga këmbët e Sarës. Abrahami kishte dy djem me dy gra të ndryshme dhe për shkak të këtyre dy grave bota u nda në të krishterë dhe myslimanë. Të dy palët mendojnë se ishte profeti i tyre ai që Abrahami mori me vete në pyll, për ta vranë. Myslimanët thonë se Abrahami mori për të flijuar Ismailin, ndërsa të krishterët thonë se ai zgjodhi Isakun. Edhe çifutët, që e kanë shkruar të parët këtë histori në librat e tyre, mbështesin variantin e të krishterëve, për Isakun. Myslimanët thonë se përderisa perëndia i kërkoi Abrahamit të flijonte djalin e tij të vetëm, do të thotë se ky djalë

ishite Ismaili, sepse ai ishte i vetëm derisa lindi Isaku. Ndërsa të krishterët thonë se sipas ligjit të perëndisë, Abrahami njihte djalë të vetëm Isakun që e kishte pasur me gruan e tij të ligjshme. Kjo histori e ka përçarë botën për mijëra vjet duke futur në luftë të krishterët me myslimanët. Të dy palët besojnë se feja e djalit të flijuar është feja e vërtetë e perëndisë. Por unë besoj se të dy palët janë të pashpirt, sepse do të donin që profeti i tyre të vuante siç duhet të ketë vuajtur ai djalë kur ka parë thikën e babait të ngritur, mbi kokën e vet. Sikur Abrahami ta kishte vrarë vërtet njërin nga djemtë, e vërteta do ishte e pastër dhe nuk do kishim dy fe, por vetëm një. Ose, sikur Abrahami t'i kishte marrë të dy djemtë në pyll, siç bëre ti, ndoshta bota do ishte më e qetë. Ndoshta kështu do ishte, tha Ibrahimimi dhe u ngjesh më shumë nga këmbët e Sarës. Në këtë pikë ndryshon pak ti nga Abrahami, sepse i more të dy djemtë me vete në pyll. Por, njëlloj si ai, ti ke ndarë djemtë në të krishterë dhe myslimanë. Ibrahimimi nuk foli dhe pas pak Sara ndjeu që e kishte zënë gjumi dhe këmbët e tij ishin ftohur.

Ibrahimimi u ngrit përpara Sarës dhe u nis në pyll. Edhe djemtë flinin, por ai nuk i zgjoi. Kishte rënë dëborë gjatë gjithë natës dhe gjurmët e këmbëve të tij ishin fshirë. Kur arriti në fushën e breshkave, la trastën, ngrehu çarçet dhe i vuri aty ku i kishte vënë të djeshmen. Gjaku i lepurit kishte humbur nën dëborë. U kthye dhe ul mbi trastë duke i mbajtur veshët e gatshëm për të kapur britmën e ndonjë kafshe të zënë në grackë. Retë kishin zbritur mbi majat e pemëve dhe dukeshin sikur shkundnin dëborën. Ai priste dhe mendonte. Jeta e tij kishte ndryshuar që kur ishte bërë mysliman. Ishte më i pasur dhe kishte më shumë djem. Sara i kishte dhënë një vajzë që nuk e kishte pasur dhe ai ishte i lumtur. Megjithatë, shumë vdekje kishte parë që nga ajo ditë. Kishte vdekur gruaja dhe djali i vogël. Kishte vdekur vëllai dhe dhjetëra kokë bagëti. Kolera kishte ardhur si një mallkim. Bota kishte ndryshuar. Njerëzit varfëroheshin njëlloj si më parë, por disa edhe pasuroheshin. Shumë shqiptarë ishin bërë myslimanë. Turqit ishin gjithmonë e më të egër. Ata fitonin, pushtonin dhe i merrnin toka të tjerëve. Por ndoshta të gjitha këto do të ndodhnin edhe nëse ai nuk bëhej mysliman. Të afërmit e tij kishin vdekur për arsye të tjera, nga kolera apo nga plakja, sëmundje që i preknin të gjithë, pavarësisht nga feja. Turqit do ishin njëlloj të egër. Por ndoshta nuk do ishin kaq të fortë sikur ai dhe shumë të tjerë mos bëheshin myslimanë. Ndoshta, mendoi dhe iu kujtua Sara që në krevat i kishte thënë se ai i kishte ndarë djemtë në të krishterë dhe myslimanë. Kishte bërë sikur e kishte zënë gjumi sepse nuk kishte përgjigje për Sarën. Shumë gjëra që ndodhnin në botë ai nuk do mund t'ua ndryshonte drejtimin edhe sikur të kishte mbetur i krishterë.

Por një gjë ishte e sigurt dhe ai nuk mund t'ia fshihte vetes. Djemtë e tij ishin ndarë në të krishterë dhe myslimanë për një dash që nuk ishte shitur të dielën në pazarin e qytetit. Edhe djemtë e Abrahamit ishin ndarë për një dash. Historinë e djemve të Abrahamit ndoshta e kishte caktuar Zoti, por fatin e djemve të tij e kishte vendosur ai vetë. Iu kujtua dita e dasmës me Anën. Krushqit nga Suli deheshin dhe kërcenin. Gratë shihnin nga nusja, ndërsa burrat pinin me doli. Në mes të asaj rrëmuje ai kishte takuar Arianit Komnenin, i cili pinte dhe këmisha e bardhë i ishte hapur në gjoks. Flokët i kishte të lëshuara, ndërsa gjoksin e thinjur dhe me kocka të forta. Je bërë gati, e kishte pyetur Arianiti duke parë nga nusja. Për çfarë, e kishte pyetur ai. Arianiti kishte qeshur dhe gjithmonë duke parë nusen i kishte thënë: Sonte duhet t'ia heqësh bërthamën kësaj kumbulle. Ai kishte mbledhur supet i turpëruar, ndërsa Ana ishte skuqur nën vello. Do djem apo vajza, e kishte pyetur Arianiti. Djem, i kishte thënë ai. Atëherë Arianit Komneni e kishte tërhequr dhe i kishte thënë në vesh: Në qoftë se do djem, kur ta hapësh kumbullën mos i shuaj qirinjtë.

Ana nuk e dëgjoi, ndërsa Arianiti vazhdoi të pinte. Kur ishte mbyllur dasma ai dhe Ana ishin futur vetëm në dhomë. Ai ishte zhveshur dhe pastaj kishte zhveshur dhe nusen. Shuaj qirinjtë se më vjen turp, i kishte thënë ajo duke u mbuluar. Jo, i kishte thënë ai, se ndryshe do lindësh vajza. I mbajti qirinjtë ndezur dhe iu ngjiti trupit të njomë të gruas. Ajo u mblodh dhe lëkura iu bë si peshqir, por mishi në mes të këmbëve të tij mbeti i varur gjatë gjithë natës. gratë i kontrolluan çarçafët të nesërmen dhe Ana i tha se kishte qenë e sëmurë. Një javë rresht gishti i tij i qullët që varej në mes të këmbëve, nuk hyri dot në kumbullën e gruas që shikonte hijet e qirinjve në tavan. Një natë, kur ai ishte shtrirë i djersitur dhe i pashpresë në cep të krevatit, Ana u çua dhe i shoi qirinjtë. Në errësirë ai ndjeu një trup lakuriq që u mbështet pas tij dhe ia thau djersët. Lëkura iu freskua dhe qimet iu rritën. Gruaja ishte hapur dhe ai e mbushi me muskuj boshllëkun që i ndante prej një jave. Muskuli u shty me zor dhe dhimbja e Anës ra si një bërthamë kumbulle nga krevati. Pas nëntë muajsh lindi një djalë. Dhe pastaj lindën edhe gjashtë të tjerë, sa herë që Ana i fikte qirinjtë.

Sara bënte dashuri me qirinj të ndezur dhe atyre i kishte lindur një vajzë. Arianiti ishte tallur dhe shtatë djem ishin rreshtuar pas asaj talljeje. Tani secili pre tyre vraponte si lepur në drejtime të ndryshme. Por në fund të rrugës secilin e priste i njëjti çark, siç i kishte ndodhur lepurit me bisht të zi.

Ibrahimi dëgjoi një britmë dhe ktheu kokën. Ishte një zë kafshe që përpëlitej në dëborë. Nuk donte të mendonte më. U çua dhe vrapoi drejt çarkut. Kur hyri në shtëpi shtriu mbi tavolinë dy lepuj dhe një dhelpter të vogël. Jani ua zhveshi lëkurët të treve, ndërsa Sara e gatoi me uthull dhe pilaf njërin nga lepujt. Kur e provoi, Aliu tha se mishi i lepurit të tij ishte më i shijshëm se lepurit që kishte përpara. Muhamedi nuk u çua nga krevati, ndërsa Nikoja futi bishtin e dhelptës poshtë jastëkut dhe nuk e preku lepurin me dorë.

18

Në fund të dhjetorit bëri stuhi. Dëborë e mbuloi furrën në oborr dhe Jani i pastroi plloçat me lopatë që të hapte derën e shtëpisë. Rrugët e fshatit u zunë dhe Ibrahimi nuk doli më për gjah. Natën e Vitit të Ri Sara gatoi lepurin tjetër që, pasi e kishte mbushur me kripë, e kishte mbuluar me lëkurën e vet dhe e mbante në qilar duke i hedhur akull sipër. U ulën të gjithë të hanin, ndërsa Ana Komnena rrinte poshtë duke luajtur me këmbët e tyre nën tavolinë.

Gëzuar Vitin e Ri, tha Sara. Një vit i mbarë, tha Ibrahimi dhe i dha Janit një gotë raki që ai e piu me një frymë për t'i treguar të atit se ishte bërë burrë. Por fyti i dogji aq shumë, saqë sytë iu skuqën dhe iu mor fryma. I dhanë një gotë ujë dhe u qetësua, por oreksi iu pre dhe u zverdh. Nikoja hëngri vetëm petanik me fasule dhe nuk e preku lepurin, ndërsa Aliu e uli Skënderbeun në tavolinë dhe i uroi Vitin e Ri. Muhamedi hante ngadalë, i mbështjellë me batanije. E ftohura e kishte bërë më të menduar dhe tokën e rrumbullakët e mbante në mes të këmbëve të mbuluar me batanije. Natën e Vitit të Ri ka lindur toka, e pyeti ai Sarën. Toka duhet të ketë lindur në verë, tha Niko, sepse në dimër nuk mbijnë pemët dhe lulet. Lumenjtë ngrijnë dhe kafshët flenë e nuk lindin fëmijë. Toka ka lindur në rrëmujë dhe data e lindjes nuk dihet, tha Sara. E si lindi toka në rrëmujë, pyeti Aliu. Në fillim bota ishte si shtëpia jonë para se ta rregullonim, tha Sara. Krevati, sëndukët, qilimat, pjatat, tavolina dhe qirinjtë nuk ishin aty ku janë tani, por prisnin në oborr që ne t'i vinim në vendin e tyre.

Djemtë nuk po kuptonin dhe Sara filloi të tregonte.

Për shumë kohë, bota jetoi në rrëmujë dhe grekët këtë kohë e quajtën Kaos që do të thotë rrëmujë. Nga Kaosi lindi Gjea që do të thotë tokë dhe nga Gjea lindi Urani që është qielli. Nga

Urani lindi Kronosi që do të thotë kohë dhe i cili luftoi me babanë e tij siç bëjnë të gjithë perënditë. Lufta mes Uranit dhe Kronit vazhdoi gjatë, aq sa nuk mund të matet, por Kroni fitoi dhe u bë Zot i botës.

Atij i lindën tre djem: Zeusi, Poseidoni dhe Hadi. Por Kronosit i kishin thënë se koha e tij nuk do të ishte shumë e gjatë sepse njëri nga djemtë e tij do ta vriste për t'i zënë vendin. Kronosi vendosi të vriste fëmijët e tij, të cilët i hante një nga një. Por gruaja e tij e fshehu Zeusin në ishullin e Kretës dhe në vend të tij i dha Kronosit një gur të mbështjellë me pelena dhe ai e hëngri. Pa e ditur, Kronosi e mori Zeusin si shërbëtor në shtëpinë e tij dhe një ditë ky e helmoi duke i hedhur një bar të keq në gotën e verës. Kronosi u shtri i pafuqishëm dhe Zeusi e sulmoi. Lufta ishte e ashpër dhe bota ishte prapë në buzë të Kaosit, por Zeusi thirri në ndihmë të tij dy vëllezërit e vet, Hadin dhe Poseidonin dhe të tre e mundën babanë. Kur fituan, tre vëllezërit e ndanë botën në tre pjesë: Zeusi u bë perëndia e njerëzve dhe zot i rrufeve, i stuhive, i bubullimave, i nxehtësisë dhe i dritës. Poseidoni u bë mbret i detit dhe ishte shumë hakmarrës. Sa herë që nuk i pëlqente ndonjë gjë ai i përmbyste fshatrat dhe qytetet. Vëllai i tretë Hadi mori mbretërinë e të vdekurve dhe u bë perëndia e vdekjes. Kur Zeusi dhe Poseidoni vendosnin të vrisnin njerëz, ata i merrte vëllai tjetër, Hadi. Kështu që Zeusi mbretëronte në qiell, Poseidoni në det dhe Hadi nën tokë.

Sara nuk kishte mbaruar kur Nikoja, për të mos i lënë vëllezërit të zgjidhnin para tij, tha: Unë jam Zeusi, e zgjodha i pari, dhe pa nga Ibrahim i që po shikonte në fund të gotës së rakisë, sikur maste kohën. Unë jam Poseidoni, tha Aliu, e shkatërroj fshatin kur të dua. Po ti Muhamed çfarë do, e pyeti Jani. Muhamedi që e kishte dëgjuar Sarën duke u dridhur, rregulloi velenxën mbi supe dhe tha: Të gjithë njerëzit do vdesin një ditë dhe do vinë në mbretërinë time. Unë jam Hadi. Po nëse njerëzit sillen mirë do t'i lësh të dalin nga mbretëria jote, e pyeti Sara. Anën do ta lë, u përgjigj Muhamedi, ndërsa për ju të tjerët do mendojem. Mihalit, gjitonit tonë dhe dajë Llambros nuk do t'i jap leje sepse ata janë zënë me babanë. Petro iku pa leje nga shtëpia, por në mbretërinë time ka një derë shumë më të madhe se dera e shtëpisë sonë. Çelësat e kësaj dëre unë i mbaj vetë dhe Petro nuk do largohet më pa lajmëruar. Ali Tepelenën do ta mbaj përgjithmonë në Had, ndërsa Thanasit do t'i them që, nëse do të kthehet mbi tokë gjatë verës, të ndahet nga Ali Tepelena.

Që kur ishte bërë Had, Muhamedi kishte drejtuar trupin dhe nuk shikonte asnjëri në sy, por shtrëngonte fort tokën e rrumbullakët se mos i ikte nga duart. Po Krishtin pse e le të dilte nga Hadi, e ngacmoi Ibrahim duke qeshur. Muhamedi pa nga Sara i hutuar, sepse nuk dinte si të përgjigjej. Një ditë, ajo i kishte thënë se Krishtin e kishin vrarë në kryq dhe pas tri ditësh ai ishte ngjallur prapë dhe asnjëri nuk e dinte ku kishte shkuar. Krishti iku pa leje sepse e ndihmoi Zeusi, por pas tri ditësh e gjeta dhe e futa prapë në Had, tha Muhamedi. Po çfarë bëri Krishti për tri ditë, pyeti Aliu. Ndoshta u kthye të takojë gruan, tha Niko. Krishti nuk ishte i martuar, tha Jani duke e parë Nikon me inat. Ndoshta ishte, tha Sara, por kjo nuk dihet mirë sepse historitë e jetës së tij janë shkruar shumë vjet pasi ai u zhduk dhe ata që i shkruan nuk i dinin të gjitha ose nuk kanë dashur t'i tregojnë të gjitha. Pse nuk kanë dashur t'i tregojnë të gjitha, pyeti Niko. Sara pa nga Ibrahim i që rrinte i menduar në krye të tavolinës dhe shtrëngonte gotën e rakisë në dorë. Sepse po t'i tregonin të gjitha, Krishti do t'i ngjante gjithë burrave të tjerë që lindin nga martesat e prindërve të tyre, martohen me gra, bëjnë fëmijë me to dhe kur vdesin e kanë një varr. Ata donin që Krishti të mos i ngjante asnjë burri përpara tij dhe prandaj ai nuk ka lindur nga babai i tij, nuk është martuar, nuk ka fëmijë dhe nuk ka varr, tha Sara, e cila fliste ngadalë sikur po bënte një meshë. Në qoftë se këto janë të vërteta, Krishti duhet të ketë qenë një njeri shumë i vetmuar, tha Muhamedi, sepse një njeri që nuk ka fëmijë nuk ka si e shtyn kohën. Krishti nuk ishte një njeri si



ne të tjerët, ai ishte biri i Zotit, ndërhyri Jani me zë të rreptë. Zoti e solli në tokë që t'i tregonte njerëzve se çfarë duhet të bënin duke ndjekur rrugën e Krishtit dhe ne duhet ta nderojmë sakrificën e tij. Po, nëse martohesh, nuk je në rrugën e Krishtit, pyeti Niko. Jo, tha Sara, Krishti nuk i tha askujt që nuk duhet të martohet. Edhe unë do martohem, tha Niko, sepse gratë duhen për të bërë bukë dhe fëmijë. Sara qeshi dhe Ibrahim i ktheu pak raki. Djemtë rrinin të menduar, ndërsa Ana i mori Muhamedit tokën e rrumbullakët dhe ai nuk e kundërshtoi.

Po Muhamedi ka qenë i martuar, pyeti Jani duke parë nga Ibrahim. Muhamedi ka pasur shumë gra dhe sillej mirë me to, tha Ibrahim. Shokët e Muhamedit paskan qenë spiunë, tha Aliu. Ata i treguan njerëzve që Muhamedi kishte shumë gra, kurse shokët e Krishtit nuk i thanë njeriu. Muhamedi nuk ishte djali i Zotit, tha Sara dhe atij i lejohej të bënte si gjithë njerëzit e tjerë. Atij i fliste Zoti në vesh dhe i thoshte se çfarë duhet të bëjë një njeri që të quhet i mirë dhe çfarë nuk duhet të bëjë që të mos quhet i keq. Po fëmijë kishte Muhamedi, pyeti Aliu. Kishte dhe djem dhe vajza, u përgjigj Ibrahim. Po varr ka, ngulmoi Aliu. Ka varr si gjithë të tjerët dhe vdiq nga pleqëria, tha Ibrahim duke parë në sy Muhamedin që e kishte mendjen tek Ana, e cila e përplasi fort tokën përtokë. Zoti paska dashur më shumë Muhamedin se Krishtin, tha Niko, sepse Muhamedi ia paska dhënë të gjitha: edhe gra, edhe fëmijë, edhe një varr ku ta qajnë, kurse Krishtin e paska torturuar. Nuk e ka torturuar, por e ka marrë pranë vetes, ndërsa Muhamedin e la në tokë për t'i treguar njerëzve se atë nuk e do sa Krishtin, tha Jani. Përderisa ka një varr dhe ka jetuar si gjithë njerëzit e tjerë Muhamedi nuk e provon dot se Zoti i fliste në vesh dhe i jepte urdhra, tha Muhamedi duke parë nga i ati. Edhe unë mund të bëj sikur dikush më flet në vesh dhe t'ju urdhëroj ju që të më bindeni në emër të Zotit. Ti nuk je gënjeshtar, bëri shaka Ibrahim.

Muhamedit dikush i flet në gjumë, tha Aliu duke u ngritur në këmbë sikur po thoshte diçka me rëndësi. Të gjithë panë nga Muhamedi që nuk u duk i mërzhitur nga fjalët e të vëllait. Kush të flet në gjumë Muhamed, e pyeti Sara. Jam në gjumë dhe nuk ia kam parë fytyrën, tha Muhamedi, por nuk besoj se është Zoti se kur ai më flet unë nuk kam frikë. Edhe në qoftë se është Zoti, nuk duhet të kesh frikë, tha Ibrahim që po e shikonte të birin me sy të ngulur. Njerëzit e kanë frikë Zotin se po të mos e kishin frikë nuk do ta dëgjonin, u përgjigj Muhamedi dhe ul nën tavolinë dhe mori tokën e rrumbullakët. Anën e kishte zënë gjumi mbi qilim. Sara e mori në krahë dhe e çoi në krevat.

Të gjithë në gjumë, tha Ibrahim duke u çuar nga tavolina. Është vonë dhe ka ardhur Viti i Ri. Shkojmë të çlodhemi, tha Muhamedi, këtë vit do ndërtojmë shtëpi. Jani e pa si i hutuar, i tha natën e mirë Ibrahimit dhe shkoi në shtrat duke i marrë vëllezërit me vete. Kur u shtri, Ibrahim e pyeti Sarën se pse i kishte thënë djemve se Krishti mund të kishte qenë i martuar. Ata po rriten dhe nuk kanë pse besojnë çdo përrallë që dëgjojnë, tha Sara. Shuaji qirinjtë, i tha Ibrahim duke qeshur. Nuk të mjaftojnë gjashtë djem, ia ktheu Sara duke e parë me bisht të syrit. U fut nën velenxë dhe trupi i Ibrahimit e ngrohu menjëherë. Qirinjtë u dogjën duke parë njëri-tjetrin, deri në mëngjes.

19

Dëbora e mbajti fshatin të pushtuar deri në fund të shkurtit. Ibrahim shkoi edhe dy herë për gjah, por kafshët ishin mësuar me hilet e çarkut të tij dhe nuk i afroreshin më patateve dhe mishit të ftohtë. Gjatë ditës, djemtë luanin në dhomën e tyre dhe në darkë i kërkonin Sarës t'i tregonte histori me perëndi. Sara i tregoi për Akilin e pavdekshëm që kishte mundur trojanët dhe që ishte vrarë nga një shigjetë në thembër. Po ai ishte i pavdekshëm, pyeti Niko, si iu ngul shigjeta në thembër? Akili ishte bir i perëndisë dhe kur lindi ai e ëma, që e donte shumë, vendosi ta bënte të

pavdekshëm. E çoi në Had dhe e futi në ujërat e lumit të Hijeve, por, kur e zhyti, e mbajti nga thembra që djalin të mos e merrte lumi. Trojanët e dinin që ai mund të vritej vetëm në thembër dhe aty ia ngulën shigjetën.

Akili duhet të ketë qenë me sandale ditën që e vranë, tha Niko. Troja është një vend i nxehtë dhe aty nuk ka dimër si këtu te ne, tha Sara. Dua të jem Akili, thoshte Aliu, por nuk do vesh asnjëherë sandale. Kush e vrau Akilin, pyeti Niko, Akili u vra nga Paridi, u përgjigj Sara, e cila duhet të fillonte një rrëfim të ri sa herë që në rrëfimin e mëparshëm dilte emri i një heroji të ri. Paridi ishte djali i mbretit të Trojës. Para se të lindte, e ëma pa në ëndërr sikur djali që do të lindte do ta shkatërronte Trojën. Kur lindi Paridi, i ati, që e kishte besuar ëndrrën, e dëboi nga qyteti dhe djali u rrit në pyll dhe u bë shumë i bukur. Një ditë tre perëndeshat kryesore greke: Athina – perëndesha e drejtësisë, Afërdita – perëndesha e bukurisë dhe Hera – perëndesha e fuqisë bënë një garë bukurie. Zeusi që i kishte vajza, Athinën dhe Afërditën dhe grua Herën nuk donte të zgjidhte vetë dhe vendosi që burri më i bukur në tokë të përcaktonte kush ishte më e bukura mes perëndive. Burri më i bukur ishte Paridi, të cilit Zeusi i dha një mollë të kuqe.

Kështu, një ditë, të tre perëndeshat shkuan te Paridi dhe i kërkuan mollën. Athina i premtoi se në qoftë se do t'ia jepte asaj atëherë Paridi do t'i fitonte të gjitha luftërat. Hera i premtoi ta bënte mbretin më të madh të botës, ndërsa Afërdita i premtoi gruan më të bukur të botës. Paridit i pëlqeu premtimi i Afërditës dhe ia dha asaj mollën, kurse ajo e martoi me Helenën. Kjo mollë u quajt molla e shërrit sepse pas saj filloi lufta e trojanëve me grekët.

Unë dua të jem Paridi, tha Niko. Do marr gruan më të bukur në fshat dhe do vras Akilin. Aliu, i nxehur, shkoi në dhomë, e mbështolli thembrën e tij me lecka dhe dy djemtë filluan të luftojnë. Ana luante me trekëndësha, ndërsa Muhamedi i mbuluar me batanije rrinte pranë zjarrit. Po Ana ka qenë perëndeshë, pyeti ai Sarën. Ana Komnena ka qenë princeshë, tha Sara. Djemtë i kërkuan t'i tregonte historinë e Anës dhe Sara, pasi i hodhi dru zjarrit, filloi të fliste. Jani zbriti në qilar, ndërsa Ibrahim i u ul në krye të tavolinës dhe dëgjonte.

Ana Komnena ka jetuar në Bizant. Bizanti ishte perandoria më e madhe në botë për një mijë vjet. Bizanti shtrihej në të gjitha tokat e grekëve dhe të shqiptarëve, por edhe në Afrikë dhe Azi. Perandorët e Bizantit në fillim qëndruan në Romë dhe ishin romakë. Por Roma sulmohej nga fise njerëzish të pafe dhe Kostandini, një perandor që kishte lindur në Shqipërinë e asaj kohe, vendosi të ndërtonte një qytet të madh larg Italisë, ku të pafetë nuk shkonin dot. Ai zgjodhi një vend shumë të bukur mbi det ku themeloi qytetin e tij që u quajt Kostandinopojë. Ky qytet tani është Stambolli, sepse turqit kur e pushtuan ia ndryshuan emrin. Përpara një beteje të madhe, Kostandini pa në ëndërr një kryq dhe ai vendosi të bëhet i krishterë dhe pas tij i gjithë Bizanti u bë i krishterë derisa erdhën turqit. Pas Kostandinit, perandoria pati shumë luftëtarë dhe shumë perandorë, Ana Komnena ishte vajza e perandorit dhe ka lindur shtatëqind vjet më parë në vitin 1083, dy vjet pasi babai i saj Aleks Komneni u shpall perandor. Ana mori emrin e gjyshes së saj Ana Dalasena.

Qysh kur lindi, nëna e saj tha se Ana duhej të bëhej perandoreshë e Bizantit. Kur ishte katërmbëdhjetë vjeç prindërit e martuan Anën me një gjeneral të shquar. Ana Komnena e vogël nuk donte të martohej dhe një muaj nuk doli nga dhoma e saj ku qante dhe urrente të atin që e martoi me një plak. Kur babai i saj, Aleks Komneni u sëmur, perandoresha bashkë me Anën menduan të merrnin fronin, mirëpo vëllai i Anës, Jani, u tregua më i zgjuar dhe shkoi në shtratin e babait ku i mori unazën perandorake dhe bekimin për t'u bërë perandor. Ana dhe e ëma u mbyllën në një manastir ku mbetën deri në fund të jetës ku ajo filloi të shkruajë historinë e luftërave të babait të saj dhe ky libër u quajt Aleksjada, sipas emrit të Aleks Komnenit. Ana

Komnena vdiq në ishullin Lesbos, por varri i saj nuk dihet me saktësi. Pesëdhjetë vjet më vonë, Komnenët u larguan nga Kostandinopoja dhe qyteti u pushtua nga kryqtarët në kohën kur perandori ishte një nip i saj. Një Komnen tjetër, nip i Ana Komnenës, shpëtoi nga vdekja në Kostandinopojë dhe erdhi në Janinë ku u bë princ i madh. Nga kjo degë e Komnenëve është Arianit Komneni i Madh, i cili luftoi turqit në vitet 1400 dhe pastaj martoi vajzën e tij Donikën me Skënderbeun. Babai im, Arianit Komneni është stërnip i Arianit Komnenit të Madh.

Unë e mbaj mend Arianit Komnenin, tha Jani që i kishte hedhur dru zjarrit që digjej në flakën e vet. Si ishte, e pyeti Niko. Ishte i madh dhe me flokë të bardha të gjata, tha Jani. Një ditë, Thanasi më mori me vete te shtëpia e tij dhe Arianiti që hante arra të thata në oborr më dha një arrë. Por unë nuk e çaja dot dhe Arianiti e vuri mbi një plloçe dhe e çau duke i rënë me dorë. Po ti baba e ke njohur Arianit Komnenin, pyeti Muhamedi. E kam njohur, tha Ibrahimimi që rrinte i menduar. Po ty çfarë të tha, pyeti prapë Muhamedi. Ibrahimimi pa Sarën në sy sikur ta pyeste në duhej ta vazhdonte këtë bisedë apo jo. mua më mësoi si bëhen djemtë, tha Ibrahimimi. Po pse ti nuk e dije, pyeti Niko. Ibrahimimi vuri buzën në gaz dhe iu kujtua nata e parë e dasmës. Nuk e dija mirë se isha i ri, tha, por Arianiti kishte tre djem dhe e dinte më mirë se unë. E si bëhen djemtë, pyeti Muhamedi. Po ta thashë tani, do ta harrosh. Kur të rritesh do ta mësoj, i tha Ibrahimimi, por Muhamedi u mbështoll fort me batanije dhe tha: Unë e di si bëhen, por mësoja Aliut. Aliu dëgjonte bisedën me vëmendje dhe kur iu përmend emri ngriti kokën drejt Ibrahimimit sikur priste të dëgjonte formulën mashkullore të Arianit Komnenit. Por Ibrahimimi nuk foli dhe Aliu i tha: Po kur lindi Ana ti e kishe harruar atë që të mësoi Arianiti?

Sara filloi të qeshte dhe mori Anën në prehër. Nuk e kam harruar, tha Ibrahimimi. Kur lindi Ana unë kisha gjashtë djem dhe doja një vajzë. Po si bëhen vajzat, kush ta mësoi, vazhdoi Aliu. Nuk ia mësoi asnjëri, tha Sara. Kur do vajza duhet të bësh të kundërtën e asaj që tha Arianiti. Jani rrinte i ngrysur. Ishte më i madhi nga djemtë dhe dinte më shumë nga ata. Biseda po e vinte në siklet sepse Ibrahimimi dhe Sara e dinin që ai nuk bindej nga formula e Arianitit. Ana e ka marrë emrin e nënës sonë, tha Jani duke ndërruar bisedën. Jo, tha Muhamedi, Ana ka marrë emrin e Ana Komnenës sepse edhe ajo quhet Ana Komnena. Të gjithë ne kemi mbiemrin e babait, ndërsa Ana ka mbiemrin e Sarës. Ibrahimimi lëvizi këmbët nën tavolinë. Mbiemri i vajzës gjithmonë e kishte vënë në vështirësi. Kur Ana lindi dhe u regjistrua në kishë, prifti e kishte pyetur për mbiemrin dhe Sara i kishte thënë se vajza quhej Ana Komnena. Nuk do marë mbiemrin e të atit, kishte pyetur prifti me zë të ulët, që dukej se kjo gjë i pëlqente. Ibrahimimi nuk kishte folur dhe prifti e kishte shkruar mbiemrin sipas Sarës. Familja ime nuk po ndahet vetëm në myslimanë dhe të krishterë, por edhe në emra, mendoi me vete, ndërsa djemtë prisnin një përgjigje. Ata e dinin që motra e tyre kishte një mbiemër tjetër, por kurrë nuk e kishin pyetur Ibrahimimin se pse ishte kshtu. Ibrahimimi e pa Sarën me inat dhe iu duk sikur ajo e kishte treguar historinë e Ana Komnenës së Bizantit për ta vënë në vështirësi përpara djemve. Ana ka emrin e nënës suaj, ndjesë pastë, foli Sara duke i parë djemtë me qetësi. Sytë e zinj i shkëlqenin nga zjarri, por Ibrahimimi mendoi se historia e familjes e kishte ndezur edhe më tepër. Nëna juaj ka qenë një grua shumë e mirë dhe e dashur, e cila rriti shtatë djem, por gjithmonë kishte dashur të kishte edhe një vajzë. Ajo u sëmur dhe nuk lindi më dhe unë besoj se ka ikur nga kjo botë duke pasur një brengë, që nuk sollti dot në jetë një motër për djemtë e saj. Babai e ka dashur shumë atë dhe kur lindi Ana më kërkoi që ajo të merrte emrin e nënës suaj. Unë pranova sepse edhe unë e kisha njohur Anën. Kur isha e vogël dhe rrija në shtëpinë e Hanës dhe të xhaxhait tuaj Vasilit, ajo vinte shpesh dhe më mësonte si të qëndisja me grep. Po Ana pse mori mbiemrin Komnena, pyeti Aliu. Kur babai im iku nga fshati unë mbeta e vetmja Komnenë nga dega jonë. Dy vëllezërit e mi kanë ikur dhe

nuk e di në do kthehen më. Unë i thashë babait tuaj se fëmija që do lindë duhet të marrë mbiemrin tim në mënyrë që dera jonë të mos shuhet. Babai pranoi dhe ju sot keni një motër të vogël, tha Sara duke parë Ibrahimin në sy. Po në qoftë se babai nuk pranonte, pyeti Niko. Unë nuk do martohesha me babanë tuaj, tha Sara, dhe tani do kisha ikur të gjeja babanë tim. Po babai do martohet me një grua tjetër, pyeti Aliu, por Sara ngriti supet dhe buzëqeshi. Kur nëna vdiq, ju ishit të vegjël dhe kishit nevojë për një grua që t'ju rriste dhe t'ju ushqente, foli Ibrahim, me sytë ulur mbi tavolinë. Thanasi erdhi një ditë në fshat dhe më kërkoi të martohesha me Sarën, që ai e kishte pasur shoqe kur ishin të vegjël. Unë nuk ia prisha Thanasit dhe ju u bëtë me një nënë dhe me një motër që nuk i kishit. Jani u ngrit të rregullonte zjarrin, ndërsa Aliu iu afrua Ibrahimit dhe iu ul në peqi. Mirë bëre, tha Muhamedi. Sara gatuan shumë mirë dhe na tregon histori që asnjë grua tjetër në fshat nuk i di, sepse gratë nuk lexojnë. Po babai yt ku ka shkuar, pyeti Niko duke u afruar nga Sara. Babai iku nga fshati kur Ali Tepelena mori Thanasin dhe ia ndryshoi emrin vëllait tim Gjergjit që e quajti Ismail. Ai nuk tha ku do shkonte, por më tha që kur të rritesha unë do ta kuptoja vetë se ku ka shkuar dhe do ta gjeja një ditë.

Po tani që je rritur e ke kuptuar, pyeti Muhamedi. Nuk jam rritur akoma aq sa duhet, tha Sara dhe shkoi në dhomë për të vënë në gjumë Ana Komnenën që po kotej në duart e saj. Ibrahim dhe djemtë mbetën vetëm. Baba a do iki Sara të gjejë Arianitin kur të rritet, e pyeti Niko, me zë të ulët që Sara mos ta dëgjonte. Ajo nuk do të iki pa u rritur Ana dhe ju, tha Ibrahim. Por edhe në qoftë se do të iki do të kthehet prapë. Kur djemtë shkuan të flenë, një copë herë nuk i zuri gjumi. Aliu nuk pranoi ta zgjidhte leckën që kishte lidhur pas thembrës, ndërsa Muhamedi tha: Sara do iki sepse ajo e di ku është babai i saj. Do ta marrë dhe Anën me vete, e pyeti Niko.

Jo, tha ai, Ana Komnena do rrijë këtu.

20

Në fillim të marsit dëborë nisi të shkrinte. Akujt u lëngëzuan mbi çatitë që kullonin si çezma. Fshati u mbush me baltë e megjithatë Aliu nuk e hoqi leckën e Akilit nga thembra. Kur hynte në shtëpi, lecka linte një gjurmë kafe pas vetes dhe ai e afronte këmbën pas vatrës që balta të thahej. Sara mezi e bindi një ditë që ta hiqte leckën duke i thënë se Akili i hiqte pajimet e luftës kur flinte. Rrugët u hapën dhe Ibrahim shkoi në qytet për të shitur bagëti. Ai merrte me vete edhe Janin, i cili një ditë i tregoi se në Janinë kishte takuar Thanasin, i cili mbante një pisqollë në brez dhe kur ecte njerëzit e kishin frikë. Pylli ishte kthyer prapë në ngjyrën e tij jeshile dhe zogjtë kishin nisur të zgjonin Anën që në mëngjes. Një natë, kur ata kishin rënë për të fjetur, dera e shtëpisë trokiti fort dhe Ibrahim u ngrit të shihte. Kur u kthye, i tha Sarës se Mihali, komshiu i tyre, kishte vdekur. Qysh se i vdiq gruaja Zoica, Mihali nuk dilte shumë nga shtëpia. I biri i tij, Aleks, merrej me tokat, blinte ushqime dhe Mihali gatuate për të dy. Gjatë muajve të dëborës, Mihali nuk ishte parë fare. Aleks që lajmëroi fshatin për vdekjen e të atit tha se ai kishte marrë një të ftohtë dhe javën e fundit villte gjak. Ditën që Mihali u varros, Aleks i thirri Ibrahimin në oborr dhe i tha se ai donte të ikte në qytet dhe ta shiste shtëpinë. Nuk kam çfarë të bëj më këtu, i tha Aleks Ibrahimit që e shikonte i çuditur. Do shes shtëpinë dhe do shkoj në Janinë të zë një punë dhe një grua. Ibrahim u fut brenda dhe pyeti Sarën. Blije, tha Sara, djemtë po rriten dhe kur të martohen këtu nuk ka vend për katër nuse. I bashkojmë dy shtëpitë dhe bëjmë një shtëpi më të madhe. Pas disa ditësh, Ibrahim u mor vesh me Aleksin për çmimin. Ky mori paratë, bëri të shtatat e Mihalit dhe iku.

Kur hyri në shtëpinë e Mihalit, Sara i mori çarçafët, jastëkët, perdet, rrogzat dhe rrobat e vjetra të Mihalit dhe Zoicës dhe i dogji në oborr. Një qilim të madh që Zoica e shtronte për pashkë në

dhomën e bukës dhe që kishte disa katrorë të verdhë të mbushur me katrorë më të vegjël me ngjyra të tjera, Sara e lau dhe, pasi e shkundi fort me okllai, e nderi të thahej mbi plloça. Ibrahimimi e prishi gardhin që ndante dy shtëpitë dhe dy oborret u bashkuan.

Shtëpia e Mihalit ishte e para shtëpi që shitej në fshat. Familja e Ibrahimit dhe ajo e Mihalit kishin jetuar si gjitonë qysh se stërgjyshi i Ibrahimit erdhi në fshat nga Suli. Ndërsa familja e Mihalit kishte ardhur në fshat nga një fshat tjetër nga i cili i kishin përzënë kur stërgjyshi i Mihalit kishte rrëmbyer një vajzë, me të cilën pastaj ishte martuar. Pleqësia e fshatit tjetër iu lut babait të Arianit Komnenit që të mos e pranonte në fshatin e tij stërgjyshin e Mihalit. Por ishte koha e Kretës dhe babait të Arianitit iu deshën burra për në luftë. Stërgjyshi i Mihalit kishte një vëlla më të vogël që babai i Arianitit ia kërkoi për ta nisur në Kretë. Ai pranoi dhe babai i Arianitit i dha një copë tokë nga të tizat në gjysmën e së cilës stërgjyshi i Mihalit ndërtoi shtëpinë. Aty kishin lindur babai i Mihalit, një vëlla më i vogël dhe një motër. Kur familja e Ibrahimit erdhi nga Suli, stërgjyshit i pëlqeu ai vend në cep të fshatit ngjitur me shtëpinë e Mihalit. Ia kërkoi tokën ngjitur stërgjyshit të Mihalit, por ai nuk dëshoi t'ia jepte. Babai i Arianitit i thirri të dy dhe i tha se, meqë djemtë e të dyve kishin vdekur në Kretë, ata duhej të ishin gjitonë, në kujtim të tyre. Stërgjyshi i Mihalit nuk u bind dhe babai i Arianit Komnenit i kujtoi se tokën ia kishte dhënë ai dhe po ashtu mund t'ia merrte. Megjithatë, stërgjyshi i Mihalit i kërkoi para stërgjyshit të Ibrahimit. Ky ia dha dhe aty ndërtoi shtëpinë. Familjet ishin të ftohura, por kur xhaxhai i Mihalit vrau vëllanë e gjyshit të Ibrahimit, sepse të dy u dashuruan me gjyshen e Hanës, për pak kaluan në gjak. Ndërhyri prapë babai i Arianitit dhe i pajtoi duke e dëbuar përgjithnjë nga fshati xhaxhanë e Mihalit. Gjakrat u ftohën, por nuk u harruan. Familjet nuk shkonin dhe nuk vinin te njëra-tjetra. Pasi Ibrahimimi e liroi Mihalin, ata nuk folën, megjithëse e ndihmuan njëri-tjetrin gjatë muajve të kolerës. Ibrahimimi e kishte ndihmuar Mihalin kur u sëmur Zoica, por nuk pranoi të mjekonte familjen e vëllait të Mihalit, i cili kishte dashur ta vriste kur ai u bë mysliman. Pasi vdiq Zoica, djali i madh i Mihalit, të cilit i kishte vdekur vajza e sapolindur, iku nga fshati. Bashkë me të shkoi edhe vëllai i Mihalit, të cilit i kishte vdekur gruaja dhe jetonte vetëm.

Ibrahimimi nuk kishte hyrë më në atë shtëpi që kur kuronte Zoicën nga kolera. Kur hyri në shtëpinë që kishte blerë, ajo iu duk e vjetër. Ka tre vjet që këtu nuk ka pasur dorë gruaje, i tha Sara që po shkundte gjithë shtëpinë nga pluhurat dhe pezhishkat. Ibrahimimi mori dru, ndezi vatrën dhe u ul përballë zjarrit. Pse e ndeze atë zjarr, e pyeti Sara. Të djeg sëmundjet e kësaj shtëpie, tha Ibrahimimi dhe filloi të mendohej përballë zjarrit që lëpihej mbi muret e ftohta. E kemi blerë dy herë këtë shtëpi, i tha Sarës, një herë stërgjyshi dhe tani unë.

Shtëpia kishte një dhomë buke dhe tre dhoma më të vogla. Sara i pastroi të gjitha dhe i tha Ibrahimit se shtëpitë duhej të bashkoheshin që të dukej si një shtëpi e madhe. Po kur të martohen djemtë, si do t'i ndajnë, e pyeti Ibrahimimi. Do prishim derën që i bashkon dhe do bëjmë një mur, por shtëpia do mbetet një dhe kjo do t'i mbajë vëllezërit të bashkuar, tha Sara. Kur djemtë erdhën të shikonin shtëpinë e re, Aliu i tha Ibrahimit se kjo shtëpi nuk i pëlqente dhe se ai do rrinte gjithmonë në shtëpinë e vjetër. Do t'i bashkojmë, tha Ibrahimimi dhe do bëjmë një shtëpi më të madhe me një dhomë për secilin nga ju. Nuk do kemi dy shtëpi, por një shtëpi të madhe. Unë e dua dhomën time të shtëpia e vjetër, këmbënguli Aliu. Si do t'i bashkosh baba, e pyeti Niko. Do afrojmë pullazet dhe do shtojmë një dhomë në mes të dy shtëpive, tha Ibrahimimi. Atëherë do ketë një dhomë edhe për Thanasin, tha Niko. Unë dua të rri në një dhomë me Thanasin dhe kur ai të flejë unë do mbaj pisqollat poshtë jastëkut. Shtëpia do ketë shumë dhoma dhe ka vend për të gjithë, edhe për Petron, edhe për Thanasin, tha Jani. Të thashë se këto dy shtëpi do bashkohen, i tha Muhamedi. Jani e shikoi me sy të shuar dhe doli jashtë.

Në prill, Ibrahimimi shkoi në një fshat disa orë larg dhe foli me usta Naumin për shtëpinë e re. Naumi kishte punuar me Arianit Komnenin për ndërtimin e kishës së fshatit. Ai i tha Ibrahimimit se deri në fund të majit nuk mund të vinte sepse po punonte në Janinë për të zgjeruar një kishë, buzë liqenit. Unë bëj kisha, i tha Naumi, por tani ndërtohen më shumë xhami dhe puna ka rënë. Ne e kemi një kishë në fshat dhe na duhen shtëpi, i tha Ibrahimimi.

Në fund të majit, Naumi erdhi në fshat bashkë me djalin e tij Andrean. Ibrahimimi i tregoi dy shtëpitë dhe i tha se donte t'i bashkonte për të bërë një shtëpi më të madhe. Kjo shtëpi është më e lartë se shtëpia jote, tha Naumi duke mbledhur një spango me të cilin i biri kishte matur murin, nga rrëza deri në majë të plloçave të çatisë. Duhet ta shkurtoj një rënë ose të zgjas tjetrën që të duket si një shtëpi. Ibrahimimi pa nga Sara. Ne duam ta zmadhojmë shtëpinë dhe jo ta zvogëlojmë. Mbaj lartësinë e shtëpisë së re dhe zgjat shtëpinë tonë, tha Sara. Bëhet, por ka më shumë punë, foli ustai duke parë Ibrahimimin. Sa kohë do, pyeti Ibrahimimi. Në qoftë se nuk bien shira, në shtator mbaron, tha Naumi.

Të nesërmen, Sara i mblodhi të gjitha plaçkat. Sëndukët, qilimat, perdet dhe enët i çoi në shtëpinë e re, ku u vendos të rrinin përkohësisht. Tavolinën e madhe të bukës, dera e shtëpisë së re nuk e nxinte dhe Ibrahimimi me Janin e vunë në oborr dhe Sara e mbuloi me rrogoza të vjetër. Krevatet e djemve u hoqën dhe u futën në dy dhoma, ndërsa në dhomën tjetër Sara solli krevatin e saj të hekurit bashkë me perdet dhe qilimat. Niko tha se donte të flinte me Janin, ndërsa Aliu me Muhamedin morën Skënderbeun, breshkën dhe tokën katrore dhe i strehuan në dhomën tjetër. Oborri filloi të mbushej me plloçat që Andrea dhe Jani i hoqën një nga një nga shtëpia e Ibrahimimit dhe i rreshtuan përtokë. Duhet ta prishim furrën, i tha Naumi, Ibrahimimit, sepse është në mes të dy oborreve dhe na pengon. Andrea i ra me qysqi furrës dhe ajo u thërrmua, si bukë e thekur. Do bëjmë një të re, mendoi Ibrahimimi dhe në hundë i erdhi era e lakrorit me fasule që Sara kishte pjekur atë mëngjes. Naumi dhe Andrea rregulluan një qoshe në dhomën e Sarës dhe Ibrahimimit që shikonte nga arra e vogël dhe fjetën atje. Ata punonin gjithë ditën duke rrëzuar mure, duke matur, dhe duke thyer gurë që Andrea i fuqishëm i mbante me lehtësi në majë të shkallëve, aq sa djemtë habiteshin. Kush është më i fortë, Andrea apo Thanasi, pyeti Niko. Thanasi i përdor muskujt për njerëzit, ndërsa Andrea për gurët, tha Jani duke hipur në majë të çatisë.

Qershori ishte i nxehtë dhe Andrea punonte i zhveshur. Djersët i binin mbi lëkurën e nxirë nga dielli dhe trupi i tij dukej si një statujë bronzi mbi shtëpi. Naumi e drejtonte nga poshtë dhe i thoshte ku duhet të ngulte trarët e rinj, mbi të cilat më pas do viheshin plloçat. Në mes të oborrit, Naumi gërmoi me lopatë një gropë të madhe ku ziente gurë të thërrmuar që i bënte gëlqere. Jani i merrte me një kovë, hipte mbi shkallë dhe Andrea i lyente gurët dhe mbi ta vinte gurë të tjerë.

Perimet që Sara kishte mbjellë një vit më parë në një pjesë të oborrit ishin shkelur dhe Sara i tha Ibrahimimit ta rrethonte me plloça bahçen e saj të vogël që domatet, patatet, qepët dhe kastravecët që mos prisheshin. Kur muri filloi të ngrihej nga perëndimi, një gur i ra Andreas nga dora dhe i theu arrës së vogël një degë të njomë. Ibrahimimi e ngriti si një foshnjë dhe Sara i tha ta vinte në një vazo që kur të mbaronte shtëpia të mbillnin një arrë tjetër në pjesën e djemve. Ibrahimimi mori një enë të madhe balte, e mbushi me dhe, nguli degën e thyer dhe e la në diell.

Në fillim të korrikut muret e dy shtëpive ishin në një lartësi. Ibrahimimi e shikonte shtëpinë si rritej çdo ditë nga pak dhe i tha Sarës se kur të mbaronte kjo do ishte shtëpia më e madhe në fshat. Ke gjashtë djem dhe një vajzë, tha Sara, gjithmonë do të të duket e vogël. Nuk jemi gjashtë djem, tha Muhamedi. Petro nuk do të kthehet se këtu nuk ka det. I ati nuk e dëgjoi, ndërsa Niko e pa

me inat dhe i tha: Ti do që të gjithë ne të ikim dhe shtëpinë ta kesh për vete. Jo, iu përgjigj Muhamedi, ti do ikësh vetë nga kjo shtëpi.

Kur Andrea vendosi plloçat e para mbi skeletin e trarëve, filloi shiu. Sara me Ibrahimin e mbuluan tavolinën me plloça të mëdha, të cilat i shtrinë mbi rrogoz, ndërsa Naumi me Andream u futën në shtëpi dhe mbuluan me katrama vendin ku flinin. Shirat vazhduan dhe të nesërmen dhe puna u ndërpre. Nuk do ta kapim dot shtatorin, tha Ibrahim dhe shkoi të bisedonte me Naumin. Po shkojmë disa ditë në fshat. Kthehemi sa të pushojë shiu, tha Naumi dhe bashkë me Andream u nisën që pa gdhirë. Shtëpia pa çati e fuste ujin nga të gjitha anët dhe natën kur frynte erë, muret ia përcillnin zhurmën njëri-tjetrit si një kor kishe. Oborri, i mbushur me plloça, drurë, gurë të thyer, çekiçë, vegla, mistri, shkallë dhe plot mbeturina që kishin mbetur nga ndërtimi, i ngjante legjendës së Kaosit që Sara u kishte treguar djemve. Shiu u plotësoi rrëmujën e oborrit duke hapur gropa me baltë gjithandej. Ibrahim u mbyll në dhomë dhe prej andej shikonte retë e zeza mbi shtëpi që dukeshin sikur mbanin radhë për t'u hedhur në një pus. Jani shkoi në qilarin e shtëpisë së vjetër, mori një copë dru dhe filloi të gdhendë një shtëpi të madhe që do t'i ngjante dy shtëpive kur ato të bashkoheshin. Shtëpinë e re ktheje nga dielli, i tha Niko. Do ta kthej nga deti që ta shohë Petro, i tha Jani dhe e futi daltën thellë në dru, sikur po kërkonte ujë në tokë. Para se të flinin, Aliu e pyeti Muhamedin se kur do të mbaronte shiu sepse ai donte të kthehej në shtëpinë e vjetër. Shiu do pushojë kur të fillojë shkolla, tha Muhamedi dhe u kthye nga muri duke e lënë Aliun të çuditur. Muhamedi ka filluar të flasë prapë me vete, mendoi Aliu dhe fjeti.

21

Sara u zgjua herët në mëngjes sepse iu duk sikur po e thërrisnin. Hapi derën e shtëpisë dhe pa dy burra që po rrinin nën shi. Ishin lagur dhe rrobat i ishin ngjitur pas trupit. Njëri prej tyre ishte i gjatë, me shpatulla të gjera dhe flokë të bardha, saqë Sarës i kujtoi Arianit Komnenin. Tjetri ishte më i vjetër, i dobët dhe supet i kishin rënë edhe më poshtë nga pesha e shiut. Kur e panë, ata nuk lëvizën dhe Sara u afrua. Ti je Sara, e pyeti burri me flokë të bardha. Po, tha Sara, duke e parë në sy. Unë jam Mihal Komneni, vëllai yt, tha burri dhe duke qeshur i afroi kokën e lagur.

Kur hynë brenda, Sara i dha të dy burrave një peshqir për të fshirë flokët. Mihali ia dha peshqirin burrit tjetër dhe i tha Sarës: Është mësuesi im, Metod Antrakidi. I kanë mbetur pak flokë dhe do ma kthejë peshqirin të thatë. Metodi e mbështolli kokën me peshqir dhe mbeti për një çast i mbuluar, si një grua në xhami. Kur hoqi peshqirin, Sarës iu duk si një njeri tjetër. Sytë i kishte bojë qielli dhe rrudhat e shumta i dukeshin si kanale të gjata mbi një bukë të pjekur fort. Lëkurën e kishte të verdhë dhe flegrat e hundës të mëdha dhe të mbushura me qime të bardha. Pasi fshiu kokën, teshtiu fort për të nxjerrë ujin nga hundët dhe i tha Mihalit: Sara duket sikur është vajza jote. Mihali qeshi i përkëdhelur, por Metod Antrakidi ngërdheshi fytyrën sikur ia kishte hedhur tjetrit dhe shtoi: Në të vërtetë i ngjan më shumë gruas tënde. Por Mihal Komneni nuk u mërzit dhe vazhdoi të qeshte duke parë pa pushim Sarën që i rrinte përballë.

Sara nuk e kishte takuar Mihal Komnenin. Kur ajo kishte ardhur në fshat, ai jetonte në Voskopojë. Arianit Komneni thoshte se Mihali ishte djali që i ngjante më shumë, por, ndryshe nga ai, ishte dembel dhe nuk udhëtonte. Mihali e njihte botën nga leximet në Akademinë e Voskopojës ku kishte ikur kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. Pse jeni futur në shtëpinë e Mihalit, e pyeti ai Sarën. Duhet ta dijë që jam martuar prandaj m'u drejtua në shumë, mendoi Sara. E blemë këtë shtëpi dhe vendosëm ta bashkojmë me shtëpinë tonë. Mihali vdiq dhe i biri e shiti se i duheshin para. Metodi i dhembin kockat dhe kjo do të thotë se shiu do vazhdojë edhe disa kohë. Nuk do hyni dot në shtëpinë e re përpara tetorit, tha Mihali duke parë rreth e rrotull. Kam qenë

në këtë shtëpi. Herën e fundit kam qenë këtu disa ditë përpara se Mihali të martohej me Zoicën. Po Zoica si vdiq, pyeti Mihali. Vdiq nga kolera që ra para tre vjetësh, tha Sara. Në atë kohë vdiq edhe Gjergji. E kam marrë vesh, tha Mihali ftohtë. Do kisha ardhur para tre vjetësh, po të mos mbylleshit në karantinë. I keni gproposur thellë bagëtitë që ngordhën nga kolera, pyeti Metodi Antrakidi. Besoj se po, tha Sara. Burrat e fshatit hapën një gropë të madhe, e spërkatën me disa pluhura, e lyeën me gëlqere dhe atje i hodhën kafshët. Mihali shikonte Sarën dhe ajo priste që ai ta pyeste për Ibrahimin dhe Anën. Përderisa e di që ka vdekur Gjergji duhet të dijë edhe ç'ka ndodhur më pas, mendonte ajo. Por Mihali kishte mbështetur kokën pas murit dhe dukej sikur nuk ishte në dhomë. Metodi Antrakidi, që nuk fliste, rrotulloi sytë nëpër shtëpi dhe pa një kanistër të mbushur me libra. U afrua dhe ngriti njërin. Nxori një palë syze nga xhepi i setrës dhe kur i vuri tha: Aleksia e Ana Komnenës. Di të lexosh, pyeti Sarën. Po, tha Sara. Ka shkollë në fshat, u habit Metodi duke ngritur vetullat mbi syzet e rrumbullakëta. Jo, tha Sara, mua më ka mësuar im atë të lexoj.

Mihali ngriti kokën dhe u përqendrua.

Të tha babai se ku do shkonte, pyeti Sarën me një fytyrë që dukej krejt tjetër nga ajo e mëngjesit. Jo, tha Sara, nuk më tha. Nuk besoj të ketë shkuar në ndonjë manastir megjithëse gjithnjë thoshte se do donte të vdiste në manastir, siç bënin shumica e perandorëve të Bizantit. Babai u hidhërua shumë kur Gjergji u bë mysliman dhe ndoshta ndërroi mënyrën e vdekjes, tha Sara. Arianit Komneni nuk ishte nga ata që ndërronte mendje nga myslimanët, tha Mihali. Edhe po të mos bëhej Gjergji mysliman, ai do gjente një vend të panjohur për të vdekur. Besoj se nuk ka dashur ta shihnin se si do vdiste. Momentet e dobëta të jetës së vet nuk i ka ndarë me asnjeri dhe vdekjen ai e quante një dobësi të pashmangshme. Po ti, e pyeti Sara sikur donte t'i thoshte, a ke ardhur për të vdekur në fshat, por e la pyetjen në mes, sepse Mihali e kuptoi dhe i tha: Unë dhe Metodi kemi ardhur për verim në fshat. Në Janinë bënte vapë dhe erdhëm këtu për t'u freskuar, por nuk e dinim se binte shi. Kur u dogj Voskopoja në 1769, ne ikëm të fundit kur humbën shpresën se do mund ta ringrinim Akademinë dhe mund të rifillonim shtypjen e librave. Nxënësit nuk vinin më në shkollë nga frika dhe tregtarët e pasur firaksën sa në Korçë sa në Rumani dhe Vjenë. Para se të iknim, Metodi ishte i vetmi mësues dhe, kur mërzitej duke folur me vete, më ulte në bankë si para dyzet vjetësh. Ai më pyeste dhe unë përgjigjesha. Për ca kohë shkuam në Korçë, pastaj në Rumani dhe katër vitet e fundit u vendosëm në Janinë. Deri para disa muajsh, Metodi jepte mësim në gjimnazin e qytetit, por e pushuan se u plak.

Fshati nuk ka ndryshuar shumë. Kishën nuk e kisha parë. Sot në mëngjes shkova në shtëpi, por dera ishte e mbyllur. Shkova në shtëpinë e Gjergjit të kërkoja Hanën, por edhe atje nuk kishte njeri. Hana ishte në shtëpinë e burrit. Ajo më tha se kyçet e shtëpisë sonë i mban ti. Do rrini aty, e pyeti Sara. Prandaj kam ardhur, tha Mihal Komneni.

Sara u ngrit e shkoi në dhomën e gjumit. Hapi një nga sëndukët që kishte marrë nga shtëpia e Arianitit dhe mori tre kyçe, të cilët, nga vapa, ishin ngjitur. Kur Sara i nxori në dritë, ata u ndanë nga njëri-tjetri dhe u lëshuan si të çliruar. Ibrahim i që ishte zgjuar, po luante me Ana Komnenën. Ka ardhur njeri, e pyeti. Ka ardhur im vëlla, Mihali. Ibrahim i e pa sikur ta pyeste çne, por Sara i tha të rrinte shtrirë se Mihali do ikte pas pak në shtëpinë e Arianitit. Janë shumë tre kyçe për një shtëpi të braktisur, tha Mihali kur mori kyçet që i dërsitën dorën. I pari është i derës së jashtme, i dyti i derës së brendshme dhe i treti i dhomës së babait, tha Sara. Zgjidh njërin nga të tre, i tha Mihali Metodi Antrakidit, duke ia afuar kyçet në fytyrë. Metodi vuri syzet e rrumbullakëta dhe preku të parin. Të kisha thënë se do flesh në oborr, i tha Mihali dhe filloi të qeshte.

Sara i përcolli deri te gardhi. Metodi eci përpara, ndërsa Mihali ndali hapat dhe i tha Sarës: Nuk e pashë tët bijë. Sarës iu duk sikur fliste me Arianit Komnenin dhe një lëmsh iu mblodh në grykë.



Do vij më vonë t'ju sjell drekën dhe Anën, tha dhe i kapi dorën të vëllait. Mihali i buzëqeshi dhe vazhdoi pas Metodit që ecte ngadalë nëpër kalldrëmin e lagur. Sara i ndoqi me sy derisa iu afruan kishës. Nga larg iu dukën si dy ikona që po dilnin nga kisha për të vizituar fshatin. Kur u kthye në shtëpi, Ibrahim po e priste. Mihali ka ardhur me mësuesin e vet nga Voskopoja, i tha ajo. Të pyeti për mua, tha Ibrahim. Jo, tha Sara, më pyeti për Anën.

Në drekë Sara mori Anën dhe një trastë ku futi lakror, mish të pjekur me pilaf dhe u nis. Shiu vazhdonte dhe dera e madhe e shtëpisë mjaulliu kur ajo e shtyu dhe u fut brenda. Mihal Komneni ishte shtrirë pranë vatrës i mbuluar me një velenxë të kuqe. Flokët e bardhë dhe të lëshuar ishin përzier me thekët e velenxës.

Po të prisja, i tha dhe e mori Anën e ngriti në ajër dhe filloi ta shikonte si një pikturë. Vajza u frikësua nga lartësia dhe e kapi Mihalin fort nga flokët. Është e pasigurt si një çifute dhe e kujdesshme si një myslimane, tha Mihali dhe i puthi hundën. Po unë si jam, e pyeti Sara duke qeshur. Mihali uli Anën në tokë dhe e pa të motrën si një libër. Ti je e heshtur si një e krishterë dhe djallëzore si një Komnene. Kurse ti je cinik si një arianit dhe i dashur si një refugjat, tha Sara dhe filloi të shtronte tryezën e madhe me këmbë të gdhendura.

Më kishte marrë uria, tha Mihali. Metodi po fle në dhomën e babait dhe unë do ha sa të dua. Ka për të dy, tha Sara. Mihali filloi të hante ngadalë dhe shikonte Anën që fshihej e turpëruar pas këmbëve të tryezës. Pilaf i shkëlqyer me erëza, tha Mihali duke shijuar gjellën. Gatuan si nëna jote. Babai më shkruante se u dashurua me atë grua kur e pa si gatuante. Por unë besoj se ai do ta dashuronte njëloj edhe sikur ajo mos gatuante. Më thoshte ashtu sepse kishte qejf t'i gjente një motiv artistik gjërave që bënte. Një herë më tha se fjeti me një grua në Napoli vetëm se fundi i saj me bojëra iu duk si bisht palloi. Gjente arsye të vogla sa herë bënte punë të mëdha. Nuk e kam njohur nënën, tha Sara, por Mihali nuk dëgjoi. Kur më mori me vete në Berat, te Sabatai Zevi, më tha: Hajde të shikosh sesi vdiq si mysliman një profet çifut. Të ka folur për Sabata Zevin? Jo, tha Sara, nuk më ka përmendur këtë njeri. Mihali la pjatën, u shtri pranë vatrës dhe u mbulua me velenxën e kuqe. Duhet ta dish këtë histori sepse kështu do kuptosh pse babai nuk u dashurua me nënën tënde vetëm kur provoi gjellët e saj. Sarës iu bashkuan vetullat e errëta, por Mihali kishte filluar.

Ti je gjysmë çifute dhe duhet ta dish se çifutët janë një popull që e lexojnë të ardhmen në të shkuarën e tyre. Me Testamentin e vjetër ata i kanë dhënë botës djepin e të gjitha feve të mëdha, por jo vetëm kaq. Testamenti është një hartë e ndarjes së botës nga profetët dhe për shkak se njerëzit i besuan shumicës së tyre, kjo ndarje vazhdon edhe sot.

Sabatai Zevi ishte një çifut që bindi miliona njerëz se ai ishte profet, por meqë koha kur ai jetoi nuk ishte si ajo e mijëra vjetëve më parë besimi tek ai nuk solli ndonjë ndarje të madhe, por solli një mënyrë jetese nën një regjim të ashpër islamik. Ai mund të ishte vërtet profet, por kur ai lindi koha e profetëve kishte mbaruar.

Sabatai Zevi lindi në ditën e nëntë të muajit të nëntë çifut në vitin 1626 në Izmir të Turqisë. Që këtu, unë besoj se fati i tij i keq ishte i shkruar sepse Turqia e sotme nuk është një tokë që pjell profetë. Kur ishte i ri, Sabatai jetoi i izoluar dhe pati çrregullime të shpeshta psikike për shkak të të cilave u konsiderua një njeri i çuditshëm dhe po aq i frikshëm. Sidoqoftë, ai duhet të ketë qenë një djalë shumë i bukur, orator i përkryer me një zë të fortë muzikor, të cilin e përdorte për të fanepsur vajzat dhe djemtë e moshës së tij. Në shkollë Sabatai Zevi udhëhiqte shokët e tij çifutë në rituale të disiplinuar fizike të frymëzuara nga Libri i Toras së lashtë siç ishin larjet kolektive në det gjatë dimrit, ecje lakuriq në fushat përreth qytetit, këngë mistike etj. Kur mbushi 18 vjeç, Sabatai Zevi u bë rabin. Deri në moshën 24 vjeçare u martua dy herë dhe të dy herët u nda. Për

disa vjet udhëtoi në Egjipt, Palestinë dhe sidomos në Greqi e më së shumti jetoi në Selanik ku që nga viti 1400 më shumë se gjysma e qytetit ishin çifutë. Në Selanik ai gjeti një bashkësi çifute të trembur nga të krishterët, por edhe nga myslimanët dhe shumë shpejt u bë frymëzues i tyre. Në vitin 1664 Sabatai u martua me një vajzë jetime që quhej Sara. Sara ishte më pak se 20 vjeç dhe prindërit e saj ishin vrarë në masakrën e vitit 1648 në Ukrainë. Duke qenë jetime, vajza kishte udhëtuar nëpër Evropë ku e kishin rritur bashkësitë e ndryshme çifute dhe për këtë shkak ishte e njohur për lirinë e saj seksuale. Sabatai Zevi kishte dëgjuar se Sara kishte thënë se ishte e shkruar se ajo do martohej me Mesian. Dërgoi njerëz në Itali ku ajo jetonte në atë kohë dhe u martua me të në Kajro. Dasma e tij me Sarën bëri zhurmë, por Sabatai Zevi tha se ai kishte vepruar si profeti Osea, i cili shtatëqind vjet para Krishtit ishte martuar me urdhër të Zotit me një vajzë të përdalë. Bashkimi me Sarën e qetësoi për disa kohë Sabata Zevin nga çrregullimet mendore që i përsëriteshin vazhdimisht dhe ai vendosi ta kuronte marrëzinë e tij. Shkoi në Palestinë për të takuar Natanin, që ishte një rabin i njohur për ritet e tij kabalistike, si dhe për të çliruar shpirtat e njerëzve përmes praktikave të çuditshme mistike. Kur u takuan, Natani i Gazës pa një ëndërr në të cilën Sabatai Zevi ishte Mesia që prej mijëra vitesh priste populli çifut. Natani i tha Sabatait se ai nuk vuante nga ndonjë sëmundje njerëzore krizat e së cilës mund të kurohen me ilaçe, por shenjat që ai shfaqte ishin cilësi të një vullneti hyjnor. Natani shpalli se Sabatai Zevi ishte Mesia dhe duke qenë një njeri me influencë njerëzore e besuan. Në maj të vitit 1665 Sabatai Zevi, me bekimin e Natanit, u shpall zyrtarisht Mesia dhe zgjodhi 12 apostujt e tij, të cilët përfaqësonin 12 popujt e Izraelit. Ai shkoi në Jerusalem dhe njëlloj si Jezu Krishti i hipi një gomari mbrapsht dhe u rrotullua shtatë herë për qark mureve të qytetit. Fjalët u hapën në gjithë Evropën për një profet që bënte mrekulli dhe i cili do drejtonte çifutët të përbërë nga tributë e humbura të Izraelit. Rabinët e Jerusalemit u shqetësuan, e shanë dhe e kundërshtuan Sabatai Zevin duke e quajtur një profet të rremë. Pas disa ditësh e dëbuan dhe Sabatai u rikthye në Izmir, në qytetin e tij të lindjes, ku njerëzit ia kishin falur marrëzitë e rinisë. Aty ai u prit si një mbret shpëtimtar dhe dalja e njerëzve në rrugë për të parë Sabatain shkaktoi rrëmujë dhe eksitim kolektiv.

Sabatai Zevi, i ekzaltuar, e udhëhoqi turmën e mijëra çifutëve drejt një sinagoge dhe aty ai filloi të sillej si Mesia duke ia shpërndarë mbretëritë e botës pasuesve të tij. Sabatai caktoi Ditën e Shpëtimit, e cila do të ishte 18 qershori i vitit 1666. tri gjashtat në traditën e krishterë që rrjedh nga hebraizmi janë konsideruar si numri i djallit dhe i shkatërrimit të botës, apokalipsit. Por Sabatai Zevi bënte një interpretim tjetër duke i bindur pasuesit e tij se dita e tri gjashtave ishte dita e madhe e ndryshimit të botës. Ai zgjodhi muajin qershor që është muaji i gjashtë dhe datën 18 që është shuma e tri gjashtave të vitit 1666. në 1 janar 1666 u nis nga Izmiri me një anije në të cilën kishin hipur qindra dishepuj të tij. Udhëtimi i një anijeje me çifutë, kryetari i marrë i të cilëve thoshte se do t'i merrte kurorën sulltanit dhe se do shkatërronte Perandorinë Otomane, natyrisht që i acaroi turqit. Kur anija u afrua në ngushticën e Dardaneleve, turqit e ndaluan dhe e arrestuan Sabatai Zevin. Atë ditë në Stamboll pati përleshje. Mijëra çifutë, kryesisht gra, që kishin dalë në port për të pritur Sabatain u goditën nga turqit. Gratë ulërinin dhe thoshin se ato ishin thirrur nga një zë hyjnor, i cili kishte muaj që u fliste për mbërritjen e Mesias. Asnjë çifut tjetër që nga koha e Moisiut nuk i kishte frymëzuar aq shumë çifutët që sipas Testamentit ëndërronin prej shekujsh shpëtimtarin e Izraelit. Në vitin 1666, kryevezir i Perandorisë Turke ishte një shqiptar, Fazil Qyprilliu, i cili më vonë pushtoi edhe Kretën. Fazil Pasha nuk ishte aq i egër sa i ati, Mehmet Qyprilliu dhe ishte tolerant ndaj arteve dhe lirive fetare. Fazili u mor vetë me çështjen e Sabatai Zevit, të cilin fillimisht e burgosi në Edrene bashkë me pasuesit e tij. Në burg, Sabatait iu la liri e plotë dhe aty ai vazhdonte të predikonte misionin e tij. Në shtator të atij viti, Fazil Qyprilliu e nxori Sabatai Zevin përpara një gjykate perandorake në Edrene duke e

akuzuar për kërcënim të rendit otoman. Me urdhër të Fazil Pasha Qyprilliu, Sabatait iu tha se kishte dy mundësi: ose të vdiste si çifut, ose të jetonte si mysliman. Sabatai Zevi pranoi të dytën. E dërguan përpara Sulltanit dhe u bë mysliman, vuri një çallmë në kokë dhe u quajt Aziz Mehmet Efendi. Dragomani i Madh, në shtëpinë e të cilit jetoi babai kur ishte në Stamboll, i kishte treguar atij se në atë ceremoni konvertimi merrte pjesë edhe Fazil Qyprilliu. Fazili duke qeshur i kishte thënë Sabatai Zevit: Islami e mësoi synetllëkun nga çifutët, kështu që ti u bërë mysliman pa dhimbje. Kishte të drejtë, sepse Sabatai Zevi, si gjithë çifutët, ishte synet dhe prerja e lëkurës iu kursye.

Lajmi se Sabatai Zevi u bë mysliman i tronditi pasuesit e tij në gjithë botën. Shumë prej tyre e mohuan dhe rabinët që e kishin luftuar në Jerusalem, në Selanik dhe Izmir thanë se kjo provoi se Sabatai ishte një mashtrues.

Mirëpo Sabatai nuk hoqi dorë. Ai tha se kishte marrë një porosi hyjnore për të ndërruar identitetin e tij dhe se tani ai do të vazhdonte misionin duke vepruar në zemrën e armikut. Sabatai Zevi, megjithëse mysliman, vazhdonte të shkonte nëpër sinagoga ku ai ndiqte ritet e tij fetare siç kishte bërë gjithmonë. Shumë çifutë që jetonin nën Perandorinë Turke e besuan dhe ndoqën shembullin e tij. Në Selanik, qytet që Sabatai e kishte shpallur të shenjtë, të paktën 400 familje çifute u bënë myslimane. Shumë shpejt lindi një sekt i ri çifutësh të konvertuar, të cilët u quajtën Dönme, që në shqip do të thotë “ata që u kthyen”. Për shumë vjet Sabatai Zevi udhëtoi me çallmë në kokë duke vizituar bashkësitë çifute në shumë qytete të Perandorisë. Ai hiqej si mysliman, por zhvillonte një aktivitet prej çifuti heretik. Sabatai e ktheu në një fe të re Dönmen e tij. Ai i ndryshoi dhjetë urdhëresat e librit të Moisiut, të shenjta për çifutët dhe ndërtoi një urdhër që bazohej në 18 rregulla. Këto rregulla i përfshijnë dhjetë urdhëresat bazë, por disa prej tyre i zbusin si dhe shtojnë disa norma që rregullojnë bashkëjetesën mes sabatistëve, turqve dhe çifutëve. Sabatai Zevi kishte praktikuar gjithmonë praktika seksuale të lira gjatë jetës së vet, për të cilat ai ishte i famshëm. Ndryshe nga dhjetë urdhëresat e ashpra të librit, në rregullat e tij ai nuk e konsideronte tradhtinë bashkëshortore një mëkat që duhej ndaluar. Në Selanik, ku Sabatai ndenji disa vjet pasi u bë mysliman, ai krijoi festën e qengjit, e cila, sipas riteve të lashta, mbahej në pranverë. Në këtë ditë, dy ose më shumë çifte të martuara hanin mish qengji dhe pastaj zhvisheshin dhe përziheshin pa dallim me njëri-tjetrin duke bërë dashuri. Fëmijët që lindnin nga këto bashkime të panjohura konsideroheshin të shenjtë. Në Selanik shumë fëmijë janë ngjizur nëpër këto mbrëmje dhe kur më vonë disa prej tyre kërkuan të bëheshin prapë çifutë, rabinët i kundërshtuan sepse atësia e tyre ishte e pasigurt.

Shumë shpejt Sabatai Zevi u bë i padëshirueshëm për turqit dhe i urryer për çifutët. Të parët e kuptuan se ai nuk e praktikoi dhe nuk e besoi kurrë Islamin, ndërsa të dytët Sabatai i fyente vazhdimisht duke i rekrutuar me praktika të padenja. Turqit dhe çifutët i kërkuan Portës së Lartë të ndalonte veprimtarinë e Sabatait dhe Fazil Qyprilliu e internoi atë në Berat ku dhe vdiq më 1676. Në Berat kishte një bashkësi shumë të vogël çifute, por babai thoshte se Fazil Qyprilliu e degdisi Sabatain në Berat për ta shpëtuar. Shqiptarët nuk ishin as të krishterë dhe as myslimanë të devotshëm dhe asnjëra palë nuk do t’ia kishte kërcënuar jetën Sabatai Zevit. Por në Turqi Sabatai u kthye në një mit, sidomos për të rinjtë e shkolluar myslimanë, të cilët besonin te një shoqëri më e lirë. Për shumë turq të rinj sabatizmi ishte një islam i reformuar, që mund ta ndryshonte shpejt Perandorinë e ndryshkur, duke e afruar me Evropën e kulturuar. Këto rrethe ishin të forta dhe të organizuara në formën e shoqërive të fshehta në Stamboll, kur babai shkoi në vitin 1704. Ai u njoh me disa turq sabatistë që ishin miq të Dragomanit të Madh, në shtëpinë e të cilit ai qëndroi. Dragomani i Madh e kishte takuar vetë Sabatai Zevin dhe njihte shumë nga pasuesit e tij. Arianiti besonte se Sabatai Zevi, në fund të fundit, ishte përpjekur për rrëzimin e

rendit islamik dhe në qoftë se kjo realizohej bota do të ishte më e qetë me një ndarje mes çifutëve dhe të krishterëve, fetë e të cilëve kishin rrënjë të njëjta. Babai tregonte se në ato vite Stambolli ishte një qytet i mbushur me shoqëri të fshehta që frekuentoheshin nga të rinj myslimanë, por edhe nga artistë evropianë dhe çifutë, nga shkrimtarë dhe teologë gjithfarësh. Dragomani e kishte prezantuar babanë si pasardhës të një familjeje fisnike shqiptare dhe kjo i dha atij mundësi të njihej me kapriciot fetaro-kulturore të Stambollit. Njëherë ai ishte ftuar në një prej takimeve të fshehta të sabatistëve, të cilët bënë plane për të rekrutuar sa më shumë myslimanë turq që punonin në administratë dhe sidomos në ushtri. Arianit Komneni u bë edhe më interesant kur sabatistët morën vesh se ai ishte nga Shqipëria, vend në të cilin kishte vdekur Mesia i tyre. Ata i kërkuan babait që kur të shkonte në Shqipëri t'i dërgonte të dhëna për ditët e fundit të Sabatai Zevit në Berat si dhe të pyeste nëse dorëshkrime të tij kishin mbetur gjëkund. Në një nga këto takime, Arianit Komneni duhet të ketë takuar edhe nipin e Sabatai Zevit që jetonte në Selanik, por vinte shpesh në Stamboll i ftuar nga ithtarët e gjyshit të tij. Siç të thashë, Sabatai u martua me Sarën dhe patën një djalë. Kur Sabatai u bë mysliman ai jetoi pjesën më të madhe të kohës në Selanik, ku u rrit i biri. Pas vdekjes së të atit, ai u martua me një çifute greke dhe patën dy djem. Arianiti ka njohur më të madhin prej tyre që nuk ishte bërë rabin si gjyshi, por merrej me tregti. Ky i kërkoi Arianitit që ta ndihmonte për të marrë eshtrat e gjyshit në Berat dhe për ta varrosur atë në Izmir ku varri i tij do të kthehej në një qendër pelegrinazhi për gjithë sabatistët e Perandorisë. Shoqëria sabatiste e Stambollit, me lidhje të forta në shtetin turk, i përkrahte këto plane sepse mendonte se rikthimi i Sabatai Zevit në Turqi do t'i shtonte radhët e sabatistëve. Në këtë mënyrë babai u bë pjesë e dy grupeve të fshehta që vepronin në Stamboll në atë kohë. Njëri ishte një grup Komnenësh me në krye Gjergj Brankoviçin, të cilët kishin shpresë në një kryengritje antiotomane në Ballkan. Shumica e Komnenëve të ardhur nga Evropa ishin nga familje fisnikësh nga Italia dhe Franca dhe një pjesë prej tyre, bashkë me Gjergj Brankoviçin, ishin masonë të rregullt që besonin se bota duhej të drejtohej nga një rreth familjesh të mëdha që kishin lidhje gjaku me njëra-tjetrën.

Grupi tjetër ishin sabatistët, të cilët ishin myslimanë turq dhe çifutë që donin një Turqi më të fortë dhe më tolerante të ngritur mbi normat e Sabatai Zevit. Babai thoshte se këta të dytët ishin më të organizuar, ndërsa të parët ishin më romantikë.

Por të dy grupet ishin kundër Islamizmit të ashpër dhe kjo duhet t'i ketë shijuar Arianit Komnenit. Kur iku nga Stambolli dhe erdhi në fshat, babai duhet të ketë shkuar në Berat dhe ka mbajtur lidhje me sabatistët e Stambollit dhe sidomos me nipin e Sabatai Zevit që jetonte në Selanik. Herën e dytë që babai shkoi në Stamboll ka qenë i ftuar në një mbledhje sabatistësh, e cila nuk u bë për shkak të rebelimit të Halil Patronës. Shumë sabatistë atëherë u burgosën dhe u vranë dhe shoqëria u shpërbë pasi me rënien e Ahmetit III, radikalët islamikë u forcuan dhe vepruan kundër shoqërive të fshehta që kërkonin një islam më tolerant. Gjëja e parë që bënë ata ishte shkulja e tulipanëve që kishte mbjellë në kopshtet e Stambollit, Ahmeti III, për të cilat besohej se ishin një simbol sabatist. Sabatistët e konsideronin veten si masonë myslimanë dhe mënyrën e organizimit dhe simbolet i kishin përshtatur nga ata, duke i ndryshuar. Masonët kishin si simbol të tyre trëndafilin, ndërsa sabatistët zgjodhën tulipanin. Thonë se kishte qenë një këshilltar çifut i Sulltanit, ai që e kishte bindur ta zbukuronte qytetin me tulipanë. Kur u nis në vitin 1730, babai kaloi nga Selaniku dhe bashkë me nipin e Sabatait udhëtuan të dy në Stamboll. Kryengritja e Halil Patronës i kapi në befasi dhe babai shpëtoi duke i thënë jeniçerëve se ishte shqiptar, ndërsa nipi i Sabatait humbi dhe duhet të jetë vrarë në ato ditë rrëmuje.

Ky çifut ishte babai i Shebës, të cilën Arianit Komneni e kishte takuar kur shkoi në Selanik në shtëpinë e mikut të tij, nipit të Sabatai Zevit. Sheba, nëna jote është stërmbesa e Sabatai Zevit.

Velenxa e kuqe i kishte rënë Mihal Komnenit te këmbët dhe kur pushoi ai e ngriti pak. Vetullat e zeza të Sarës ishin kryqëzuar dhe sytë i ishin skuqur. Kur Mihali fliste, ajo mendonte se pse po ia tregonte ai atë histori, por kurrë nuk kishte besuar se fundi i saj ishte ajo vetë.

Nuk e besoj dot, tha Sara, babai do ma kishte treguar. Mihal Komneni buzëqeshi, largoi velenxën dhe u afrua tek ajo. Fytyra e tij ishte e qetë dhe e bardhë. Babai nuk të ka fshehur gjë. Ai të ka thënë se është dashuruar me nënën tënde në Stamboll dhe se babai i saj ishte një tregtar çifut nga Selaniku. Kjo është e vërtetë. Sa të thashë, babai m'i ka treguar kur shkua bashkë në Berat për të gjetur varrin e Sabatai Zevit. Por kjo ndodhi përpara se ai të shkonte në Stamboll për herë të tretë në 1753. ndoshta, kur u kthyem nga Berati ai mund t'i ketë shkruar Shebës, vajzës së mikut të tij, për t'i thënë se nuk arritëm dot ta gjenim varrin mbi të cilin ishin ndërtuar shtëpi dhe shumë pak ishin ata që e mbanin mend, ku ishte varrosur Sabatai përpara shtatëdhjetë vjetësh. Sabatai kishte jetuar në një shtëpi jashtë qytetit, sepse si një i internuar nuk ishte pranuar brenda në Berat. Fshati i tij quhej Bilce dhe ishte pas një kodre që ngrihet mbi lumin që ndan të krishterët me myslimanët e Beratit. Ne nuk e gjetëm dot varrin, por babai mendoi se fshatarët nuk donin të na e tregonin. Myslimanët e Beratit nuk e kishin gëlltitur kurrë faktin që një heretik si Sabatai ishte internuar në qytetin e tyre, i cili gjithmonë kishte pasur grindje fetare. Disa vjet para se të shkonim në Berat, ishte vrarë një murg, i cili më parë kishte qenë mysliman dhe pastaj ishte bërë prapë i krishterë. Të krishterët e konsideronin shenjt Shën Nikodhimin, të cilit iu pre koka pasi refuzoi të mohonte Krishtin. Disa të krishterë thoshin se çifutët donme të Beratit kishin folur kundër tij dhe se Nikodhimi kishte qenë për vete një donme gjatë kohës që ishte një mysliman i martuar me një grua nga fshati ku kish jetuar Sabatai. Edhe të krishterët, edhe myslimanët nuk i honepsnin donmet, të cilët ishin izoluar pas vdekjes së Sabatait. Një plak na tha se Sabatai disa kohë kishte udhëtuar deri në Ulqin, por gjatë kohës që qëndroi në Berat rrinte në shtëpi dhe shkruante. Kur mësuan se ne ishim të krishterë donmet e Bilces u frikësuan dhe nuk na lejuan të hyjmë në shtëpinë ku kishte jetuar Sabatai dhe ku besohet se kanë mbetur disa dorëshkrime si dhe sende të tij. Për të gjitha këto babai duhet ta ketë njoftuar Shebën me letra dhe ajo duhet t'i jetë përgjigjur.

Por siç të thashë, kur ne shkua në Berat, ai nuk kishte asnjë marrëdhënie me Shebën përveçse e kishte parë në shtëpinë e babait të saj në Selanik. Çfarë do ndodhte më vonë ai nuk e dinte. Pasi linde ti, unë bëra lidhjen me ato që dija. Kur e pyeta se si dhe pse u dashura me Shebën, ai më tha se ajo i kishte kërkuar atij ta ndihmonte për të gjetur eshtrat e humbura të babait të saj në Stamboll. Edhe vetë Arianiti e kishte amanet nga nëna e tij, që të sillte në fshat eshtrat e babait të vet dhe kështu vendosi të shkonte me vajzën e mikut të tij. Ajo shkoi në Stamboll bashkë me burrin e saj, i cili administronte biznesin e familjes, gjë që provon se babai dhe Sheba nuk kanë pasur asnjë lidhje mes tyre përpara këtij udhëtimi. Në kohën që ai dhe Sheba kërkonin eshtrat e baballarëve nëpër Stamboll, Jorgo Mavromatisi, burri i saj, u njoh me disa tregtarë turq, të cilët i ofruan atij verë me çmim shumë të lirë. Shitja e verës në atë kohë ishte e ndaluar me një ferman të Sulltanit dhe magazinat e Stambollit ishin plot. Babai i mori eshtrat e gjyshit tonë, ndërsa Sheba nuk gjeti asnjë gjurmë të babait të vet të humbur gjatë revoltës së Halil Patronës. Kur u kthyen, pas disa muajsh, për në Selanik, Jorgon e arrestuan për kontrabandë pijesh të ndaluara në Lesbos dhe atje babai qëndroi me Shebën për të mos e lënë vetëm. Duke pritur lirimin e Jorgos, ata u dashuruan dhe shkuan në Kretë ku linde ti. Aty vdiq dhe nëna jote. Ti i di të gjitha këto me siguri. Babai nuk ta ka treguar prejardhjen e Shebës duke e ditur se ti do ta gjeje vetë një ditë, kur të kërkoje rrënjët e tij. Megjithatë, kjo pjesë nuk ishte shumë e rëndësishme sepse ai nuk u dashurua me stërmbesën e Sabatai Zevit, por me një grua që i pëlqeu, në një ishull ku nuk njihje

asnjeri tjetër. Pavarësisht se mua më tha se u dashurua me një grua që gatuante shumë mirë, ai u dashurua me një grua të palumtur nga martesja e saj, e cila, me sa duket, e gjykonte botën njëlloj si ai. Kur babai iku nga fshati, ti ishe jo më shumë se pesëmbëdhjetë vjeç dhe ai nuk donte të të tregonte anët e errëta, të cilat, vetëm rastësisht, u shfaqën dashurinë e tij me nënën tënde. Hija e Sabatai Zevit do ta kishte prishur shijen e asaj dashurie njëlloj si një piper që prish shijen e një ëmbëlsire. Po ashtu babai nuk të tha se ku do shkonte të vdiste, duke qenë i bindur se kur të rriteshe, ti do të ndiqje udhëtimin e fundit të tij, siç bëri edhe ai me gjyshin tonë dhe siç bëri nëna jote me babanë e saj.

Po nëse nëna ime rrjedh nga Sabatai Zevi, pse nuk duhej të ma tregonte ai këtë gjë, ngulmoi Sara që fliste shpejt duke pritur arsytimin e Mihalit. Sepse ajo nuk është një histori për fëmijë, e dashur motër, tha Mihali. Megjithëse në rininë e tij Arianiti, nën ndikimin e shokëve të tij, mund të jetë ngazëllyer nga aventura e Sabatait, ai mendonte se në fund të fundit Sabatai Zevi ishte një mashtrues dhe nuk donte që ti të ngrije botën tënde mbi këtë model marrëzie. Unë nuk gjej një arsye tjetër. Ose ndoshta babai e ka ditur që një ditë ne do takoheshim dhe unë, si i vetmi njeri që dija lidhjen e tij me sabatistët dhe për shkak të tyre edhe me Shebën, do ta ballafaqoja pjesën time të së vërtetës me tënden.

Ndoshta e ka menduar kështu, tha Mihali Komneni që pushoi pak sikur po mendohej. Kur ta takosh Sarën do kuptosh se një Komnene e mbjellë në një vazo hebraike, del më e bukur se fara që e mbolli. Kështu më thoshte para se të nisej. Tani më duket sikur babai më shtynte drejt një qëllimi: se si të takohesha me ty kur ai të mos ishte më. Ja pse erdha tani. Prita, sa u rrite, sepse doja të shihja një Komnene që ka çelur, pasi im atë e mbolli në një vazo çifute. Tani ke çelur, tha Mihali dhe i vuri Anës dorën mbi kokë, sikur po e ujiste. Po ti ke ardhur ta krisësh këtë vazo, e pyeti Sara që i kishte sytë e përplotur. Aspak, tha Mihali me zë të ëmbël, kam ardhur të të them se nga cila farë ke mbirë. Duke e ditur, do rritesh më e fortë dhe do jesh gati për të ndjekur rrënjët e tua.

Më duket sikur ti e di ku është babai, e pyeti Sara që ishte ngurtësuar dhe kishte mbledhur duart mbi kraharor. Jo, tha Mihali. Ndoshta ai nuk do që ne ta marrim vesh se ku ka shkuar, tha Sara. Mihali Komneni ngriti kokën dhe e pa Sarën sikur donte t'i vidhte një sekret. Erdha mbrëmë në fshat, foli ai. Shtëpia ishte e mbyllur dhe shkova te Hana. Ajo më tha se çelësat e shtëpisë Arianiti t'i kishte lënë ty. Doja të vija që mbrëmë t'i merrja, por kur ajo më tha se yt shoq është bërë mysliman, ndërrova mendje dhe fjeta tek ajo.

Unë nuk e kisha parë kurrë Hanën. Babai e donte shumë dhe luante me të. Por ai thoshte se ndryshe nga gjithë Komnenet, kur ajo humbte, e linte lojën pa u ankuar. Ashtu m'u duk dhe mua. Është shumë e bukur, si nëna e vet, por është pa humor, si i ati. M'u duk sikur e përdor bukurinë që ka si një mobilie për të dekoruar shtëpinë. Nuk mendon shumë dhe kjo e mban ende të freskët. Flet shkurt dhe përgjigjet vetëm kur e pyesin. Kur e pyeta për babanë ajo më tha se ditën që iku ai kishte thënë se ti e dije se ku do të shkonte. Hana është e bindur se ti e di, por nuk e thua. Por ajo beson ato që dëgjon pa u përpjekur të gjejë kuptimin e vërtetë të fjalëve. Hana ka luajtur, por nuk ka biseduar me Arianitin dhe prandaj nuk mund ta kuptoj se çfarë ka thënë ai.

Sipas teje, çfarë ka thënë babai, pyeti Sara. Ka thënë që ti duhet ta zbulosh se ku ka shkuar, duke ecur mbi gjurmët e jetës së tij. Ti më provove se unë nuk i di të gjitha gjurmët, tha Sara. Unë të dhashë një gjurmë dhe ato që kanë mbetur duhet t'i gjesh duke ndjekur shenjat. Unë jam një shenjë, por nuk jam e vetmja dhe as e fundit, tha Mihali. Cilat shenja, pyeti Sara. Shenjat që ai ka lënë mbi njerëzit dhe veprat që krijoi, ia ktheu Mihali. Po më thua të lexoj një nga një gurët e kalldrëmeve që shtroi në fshat, apo të shikoj si rrjedh uji në çezmat pre guri që ndërtoi dhe të përpiqem të kuptoj se në cilin breg të botës mbaroi udhëtimi i Arianit Komnenit, pyeti Sara me

nerv dhe iu kujtua Ibrahim, që thoshte se Arianiti i kishte trajtuar më mirë kalldrëmet se njerëzit. Kaq shpejt u lodhe, e cty Mihali që kishte marrë pamjen e një njeriu që e ka tërhequr gjahun aty ku do. babai të ka treguar për prejardhjen e Komnenëve dhe dashurinë e tij me nënën tënde, por kjo është njësoj si të kënaqesh me rrotullimin e dallëndyshes në një ditë vere, pa e kuptuar se sa shumë rrugë ka bërë për të ardhur mbi qiellin tënd, se nga cilët dimra ka ikur, se si ka humbur shoqet nëpër cikna, se si i ka shpëtuar rrebesheve mbi oqeanë, se si ka plagosur krahët në stuhi, se si i ka dredhuar zogjve grabitqarë, se si në lartësi është dashuruar, duke harruar se mund t'i merreshin mendtë, se si është çlodhur nga dashuria duke u mbështetur mbi krahët e të dashurit, se si e ka ngritur folenë e vet duke i ngjitur tullat e saj me gojë, se si i ka ushqyer të vegjlit duke këputur mish nga mishi i saj, se si ka rënë, është ngritur dhe prapë ka rënë dhe prapë është ngritur, derisa ka vendosur të niset për udhëtimin e fundit, pasi mjeshtërinë e jetës ia ka mësuar edhe foshnjave të veta. Dallëndyshja e di që nuk mund të vdesë pa i rritur fëmijët e vet dhe kur është e sigurt se kjo ka ndodhur zgjedh një vend për të vdekur, të cilin askush nuk e di. Kush më thotë ku është varri i dallëndyshes? Askush. Vetëm të vegjlit mund ta gjejnë atë nga shenjat që ka lënë në ajër, nga aroma e kashtës së folesë, nga puçlat që kanë rënë rrugës, nga drejtimi i erës, nga gjethet e pyllit që imitojnë krahun e nënës së tyre dhe pa dyshim nga nevoja që ka çdo qenie e gjallë për të kuptuar se aty ku mbaron udhëtimi i prindit fillon udhëtimi yt, sepse bota jeton përmes vazhdimësisë së trashëgueshme. Unë erdha që në mëngjes për të fjetur këtu por nuk më lanë shenjat e tij. Hija e babait, gjurma e tij në oborr, shija e arrave që hante, flokët e bardhë mbi velenxë, një cep i përthyer libri, palosja e çarçafit dhe plloça e ciflosur nga këmba e tij nuk më lanë të flija. I ndoqa gjithë ditën për të kuptuar më shumë. Nuhata, shijova, preka, pashë dhe dëgjova. Do isha nisur duke ecur pas këtyre shenjave deri në fund të botës, po të mos e kuptoja se Arianit Komneni nuk më pret mua, por ty. Ai të pret ty, sepse ti i ndryshove drejtimin jetës së tij dhe ai ka vazhduar në atë drejtim, si një dallëndyshe që e di se, po ndryshoi rrugën, të vegjlit që i vijnë pas, do ngatërrohen. Kam kohë që e mendoj, por sot, kur shtriva trupin tim aty ku babai është shtrirë për herë të fundit, kuptova se unë nuk jam udhëtari, por jam shenja. Kam ardhur si një shenjë që ti të më lexosh dhe të vazhdosh rrugën, dallëndyshja ime.

Mihal Komneni kishte marrë një ngjyrë purpuri dhe flokët i ishin shpupuritur, si në një fluturim. I rregulloi me ngadalë me dorën e madhe si krehër dhe e pa Sarën me sy të çmallur. Babai më mësoi të eci, ti po më mëson të fluturoj, tha Sara dhe u ngrit. Do donte të rrinte akoma me të vëllanë, ta përqafonte ashtu siç nuk kishte pasur rast ta bënte kur ishte e vogël, por e dinte që në krahët e tij do qante duke derdhur lotët e gjithë fëmijërisë së vet që kishte kaluar shumë shpejt, duke u mbajtur në krahët e babait që fluturonte nga dimri në verë dhe nga furtuna ën qetësi. Mori Anën për dore dhe, duke dalë, iu duk sikur dëgjoi zërin e Mihalit që thoshte: Dallëndyshja i lë shenjat në ajër. Ngriti kokën lart, por shiu i rrëshqiti mbi faqe. Si lot. Duke ecur, këmba iu pengua në një gur kalldrëmi që ishte më i madh se të tjerët. Nuk jam akoma gati t'i ndjek të gjitha shenjat, tha Sara me vete dhe shtrëngoi fort dorën e Anës që ishte zgjuar drejt saj në errësirë.

Në fillim të korrikut, Ana mbushi dy vjeç. Shiu vazhdonte prej dy javësh dhe oborri ishte mbushur me pellgje jeshile. Shtëpia e tyre dukej si një kazan i hapur nga lart që priste të mbyllje, ndërsa shtëpia e re ishte e çrregullt. Për shkak të shiut, djemtë luanin gjithë ditën brenda dhe

dhomat i ngjanin një depoje në të cilën një herë sënduku fshihej poshtë krevatit dhe pastaj qilimi e mbulonte krevatin si çarçaf. Ta festojmë ditëlindjen e vajzës, tha Ibrahimimi. Këtu është e pamundur, tha Sara që përpiquej më kot të vinte rregull. E festojmë të dielën në shtëpinë e babait. Ftojme Hanën, Mihalin dhe Metodin. Duket si një meshë Komnenësh, tha Ibrahimimi. Kur u martova, Arianiti më nxori jashtë nga mesha e Kretës, por tani nuk më zbon dot më. Do t'i them Mihalit që të mos vishet me rrobat e babait që të të dalë frika, ia ktheu Sara. Po ne si do vishemi, pyeti Aliu. Unë do vishem si Paridi, tha Niko dhe pyeti Sarën: Si vishej Paridi? Në kohët e lashta ishte ngrohtë dhe njerëzit visheshin lehtë, me një këmishë linoje dhe me sandale. Paridi i kishte flokët e gjatë dhe i mbante të kapura me një lidhëse të kaltër. Sandalet i kam, por flokët si t'i zgjas, pyeti Niko duke i ngritur balluket përpjetë. Lyeji me ujë me sheqer dhe do të ngrijnë e do duken më të gjata, i tha Jani duke qeshur. Do t'i lyej, tha Niko, dhe pastaj nuk do t'i pres derisa të më zgjaten si të Paridit. Po ti Muhamed si do vishesh, e pyeti Ibrahimimi. Muhamedi uli kokën dhe duke parë thonjtë e vegjël dhe të bardhë tha: Unë do vë një çallmë që t'i ngjaj Muhamedit. Ibrahimimi pa Sarën në sy, por nuk foli. Ti nuk mund të jesh Muhamedi sepse ai u bë mysliman kur u bë burrë. Sa ishte i vogël ai nuk mbante çallmë, foli Jani duke iu drejtuar Ibrahimimit, sikur i kërkonte të ndërhynte. Kur ishte i vogël Muhamedi nuk e dinte që do bëhej mysliman dhe prandaj nuk mbante çallmë. Unë kam lindur mysliman dhe do sillem si një Muhamed i rritur, tha Muhamedi. Po pse zgjedh Muhamedin që nuk dinte të luftonte si gjithë burrat e tjerë. Po deshe të jap unë Skënderbeun ose Akilin që kanë bërë luftëra dhe jo muhabet si Muhamedi, tha Aliu. Tani nuk kam ç't'i bëj, tha Muhamedi që ngriti kokën dhe pa nga Ibrahimimi. Këtë e ka vendosur babai kur më vuri emrin. Babai ju ka vënë të gjithëve emra shumë të bukur, por ju nuk mund të jetoni si njerëzit që ju keni marrë emrin, tha Sara. Edhe Ana ka emrin e nënës suaj, por kur ajo të rritet njerëzit do ta kenë gjetur ilaçin e kolerës. Edhe unë kështu dua, tha Aliu. Babai më ka thënë se unë kam emrin e Ali Tepelenës, po unë nuk dua t'i ngjaj atij, se dajë Llambro thotë se ai vjedh bagëti dhe gra. Unë dua të kem edhe dele, edhe gra, por duke luftuar, jo duke vjedhur. Po ti baba emrin e kujt ke, pyeti Niko. Ibrahimimi vuri buzën në gaz dhe tha: Unë kam emrin e një burri të mençur, i cili gjithë jetën eci nëpër fusha dhe male duke kërkuar tokë për të ngritur një fshat, për popullin e vet. Po ti nuk ke ecur nëpër male dhe fusha për të gjetur një fshat për ne, sepse fshatin e kishte ngritur babai i Sarës, tha Aliu. Prandaj unë nuk jam ai që më dha emrin dhe po ashtu edhe ju nuk jeni si ata që ju dhanë emrat, tha Ibrahimimi. Megjithatë vishuni si të doni sepse është festa e Anës. Kur u bë kisha e fshatit ishte një ditë feste dhe unë u veshja si dhëndër. Po tani që nuk je dhëndër, nuk shkon më në kishë, pyeti Niko duke parë Sarën. Babai shkon prapë në kishë, por vetëm kur vdesin njerëz, tha Muhamedi dhe doli nga dhoma.

Të dielën që pa gdhirë, Ibrahimimi theri një qengj, i ndau veç këmbët dhe lëkurën, i hoqi të përbrendshmet dhe e shpoi tejprtej me hell. Binte shi dhe ai i tha Janit ta ndizte prushin brenda shtëpisë, aty ku Naumi dhe Andrea kishin sajuar një si kolibe të mbuluar për të fjetur. Jani rrotullonte hellin, ndërsa tymi fluturonte si i çmendur mbi shtëpinë pa çati.

Nga dreka, mishi i qengjit ishte skuqur në hell dhe kishte nisur të pikonte. Është gati, tha Ibrahimimi. Sara i futi ushqimet e ngrohta nëpër trasta që ua dha djemve, Jani mori qengjin që Ibrahimimi e ndau në copa të mëdha dhe u nisën.

Nikoja kishte ngrirë flokët që i mbante me një pe të kaltër, Muhamedi kishte vënë një peshqir mbi kokë që e kishte lidhur si çallmë, ndërsa Aliu me këpucë të zeza, për të mbrojtur thembrën, mbante në brez një shpatë pa majë që Jani ia kishte sajuar duke kryqëzuar dy dërrasa. Djemtë, të ngarkuar, ecnin përpara, ndërsa pas tyre vinte Sara dhe Ibrahimimi që mbanin Ana Komnenën për



dore. Duken sikur po shkojnë në luftë, tha Ibrahim duke i parë. Ashtu duken, tha Sara, princi, hoxha dhe ushtari. Një ushtri e kompletuar që lufton pa shkak dhe fiton pa pasoja.

Kur hynë brenda, tryeza ishte shtruar dhe Mihal Komneni, që kishte veshur një këmishë të bardhë të qëndisur, ishte ulur në krye, me një gotë verë përpara. Mirë se erdhët, tha Mihal. Ka pesëdhjetë vjet që Komnenët nuk mblidhen as për ditëlindje, as për vdekje. Hana filloi të qeshte kur pa djemtë, ndërsa Metodi vuri syzet e rrumbullakëta dhe i drejtoi nga çallma e Muhamedit.

U ulën. Mihal në krye dhe Sara përballë tij, në fund të tavolinës. Në të djathtë Ibrahim, Hana, Jani dhe Metodi, ndërsa majtas, Niko, Muhamedi, Aliu dhe Ana që mori një pirun dhe filloi ta përplaste mbi pjatë. Gëzuar, tha Ibrahim.

Filluan të hanin dhe Mihal i tha Ibrahimit: Ushqimi është feja më e bukur sepse nuk ka kufizime. Të lashtët thoshin se fetë kanë lindur në tavolinë, pasi njerëzit hanin dhe fillonin të bisedonin, tha Metodi. Por meqë njerëzit kishin shije të ndryshme, lindën fe të ndryshme. Dikush nuk e donte mishin, dikush donte vetëm një lloj mishi, dikush donte edhe mishin, edhe verën, dikush nuk donte verën, por donte mishin. Kësisoj, fetë që lindën, kufizuan ushqimin sipas shijeve të njerëzve që i krijuan ato dhe njerëzit u ndanë fillimisht nga ushqimi. Po unë që i dua të gjitha, qeshi Mihal duke ngritur një gotë verë, në cilën fe futem unë? Ty nuk do të të kishin pranuar në atë tavolinë sepse ti do t'ia kishe ngrënë të gjitha dhe sot do kishim vetëm një fe, tha Metodi. Sikur t'ia kishin lënë këtë gjë në dorë Mihalit, sot nuk do kishim as kisha, as xhami, por do faleshim në kuzhinë përpara një pjate mish dhe një gote me verë, tha Sara duke ushqyer Anën. Sa mirë do ishte, tha Hana, ndërsa djemtë filluan të qeshnin.

Si i kanë emrat këta djem, pyeti Mihal. Ky është Jani, tha Ibrahim. Ky këtu ngjitur me ty është Niko, ai është Muhamedi dhe ai është Aliu. Emra të denjë për një tavolinë ku ka çdo gjë, por ku jo çdo gjë mund të hahet, tha Mihal dhe pyeti: Nga i kanë marrë këta emra? Jani ka emrin e babait tim, tha Ibrahim. E kam njohur Janin, tha Mihal. Ai u lind në fshat dhe nuk e njohu babanë e tij që u vra në Kretë. Niko ka emrin e vëllait të gjyshit tim, vazhdoi Ibrahim. Nuk e kam njohur, por thonë se ai ishte një djalë i hedhur që i kishte qejf vajzat dhe prandaj u vra, tha Mihal me një zë të qetë. Unë nuk e kam më emrin Niko, tani quhem Parid, tha Niko që u skuq dhe pa nga Sara. Mihal qeshi fort, ndërsa Metodi picërroi sytë pas xhamave që ishin veshur me avull ushqimesh të ngrohta. Po pse e ke ndërruar emrin Niko, e pyeti Hana. Unë jam Paridi që vrau Akilin, tha Niko. Ai ishte djali më i bukur që caktonte se kush nga perëndeshat ishte më e bukura. Paridi ishte frikacak dhe për një grua e shkatërroi Trojën. Ti je i gatshëm ta shkatërrosh fshatin për një grua, pyeti Mihal. Niko dukej i hutuar, ndërsa Aliu filloi të qeshte. Babai më ka thënë se ne nuk do bëjmë ato që kanë bërë njerëzit që na dhanë emrat, tha Niko. Këtu nuk kanë mbetur më gra për të cilat ia vlen kjo sakrificë, tha Hana duke parë nga Muhamedi që e mbante çallmën të ulur dhe shikonte gishtat e vet. Po ti, Muhamed, kujt ia ke marrë emrin, pyeti Metod Antrakidi. Unë kam emrin e profetit, tha Muhamedi pa e ngritur çallmën. Muhamedi e dinte se çfarë do bënin njerëzit në të ardhmen. Ti çfarë di për ne, e pyeti Mihal. Unë di që Sara do të iki për të gjetur varrin e babait, tha Muhamedi me një zë të ngadaltë që i bëri të gjithë të lënë ushqimin në mes për ta dëgjuar. Dhe ti beson se do ta gjejë, e pyeti Metodi. Një grua që e ka fytyrën të mbushur me rrudha e di dhe ajo do t'ia tregojë Sarës, tha Muhamedi. Të gjithë heshtën, ndërsa Mihal psherëtiu. Në qoftë se kjo është e vërtetë, unë do të të blej një çallmë të re me gurë të çmuar, tha Hana. Nuk dua çallmë, foli Muhamedi duke parë Hanën me sytë e kaltër. M'ia jep paratë për të ndërtuar një xhami për babanë. Xhamia do ta lërë gjithë fshatin pa gjumë se myslimanët falen pesë herë në ditë, tha Metodi. Po të jetë pesë herë në ditë unë nuk do shkoj se duhet të ushqej breshkën, tha Aliu dhe ngriti mbi tavolinë dorezën e shpatës që dukej si kryq. Po ti, shpatar i vogël, emrin e kujt ke marrë, iu drejtua Mihal duke parë nga Ibrahim. Ka emrin e

Ali Tepelenës, që më ndihmoi kur u bëra mysliman, tha Ibrahimimi dhe e pa Mihalini drejt e në sy. Si të ndihmoi, pyeti Metodi që kishte filluar të hante kuleç me djathë. Ibrahimimi u bë gati të përgjigjej, por Mihal Komneni foli i pari. Kur Ibrahimimi u bë mysliman, fshati nuk e pranoi dhe pleqësia vendosi ta dëbonte. Do t'ia kishin arritur, po të mos vinte Ali Tepelena që i rrahu burrat e fshatit dhe e prishi rrethimin që ata i kishin bërë Ibrahimimit. Ali Tepelena bisedoi me babanë, që në atë kohë ishte kryetar i pleqësisë dhe pothuajse ranë dakord që Ibrahimimi të qëndronte në fshat, por me kusht që djemtë e tij të mos merrnin vajza të krishtera për gra. Por të nesërmen Ali Tepelena mashtroi babanë e Hanës, që u bë edhe ai mysliman. Arianit Komneni iku nga fshati dhe pleqësia nuk u mblodh më. Më vonë, Ibrahimimi u martua me Sarën. Apo jo Ibrahim, e pyeti Mihal duke përfunduar. Po, tha Ibrahimimi, kështu është. Ali Tepelena më ndihmoi në një ditë të vështirë dhe unë i vura emrin djalit për nder të tij. Hakmarrje e zgjuar, tha Metodi duke parë nga Sara, i more Arianit Komnenit atë që nuk donte të a jepte. Po pse nuk donte babai i Sarës që ne të martoheshim në fshat, pyeti Paridi. Arianit Komneni mendonte se myslimanët duhet të martohen me myslimanët dhe të krishterët me të krishterët, tha Ibrahimimi. Nuk e kishte keq, foli Mihal Komneni. Pulat martohen me gjelat dhe jo me patat. Po pse gjeli që bëhet mysliman quhet patë, pyeti Aliu.

Të gjithë qeshën dhe Muhamedi tha: Kafshët nuk janë as myslimane, as të krishtera sepse ato nuk flasin. Po memecët çfarë janë, tha Paridi. Memecët janë si një orë që e mat kohën, por i mungon akrepi për ta treguar, tha Metodi. Ndërsa kafshët nuk flasin sepse nuk mendojnë. Perëndia e ka shtëpinë në kokat tona. Në qoftë se ne nuk mendojmë, nuk ka perëndi dhe nuk ka fe. Babai thotë se perëndia është shumë e madhe dhe koka ime nuk e nxë, tha Aliu që dukej i hutuar. Perëndia rri në kokën e çdo njeriu. Po të mos ishin njerëzit, nuk do kishte perëndi, tha Sara që gjithë kohën shikonte Mihal Komnenin që argëtohej me pyetjet e djemve. Njerëzit e kanë krijuar perëndinë apo perëndia ka krijuar njerëzit, pyeti Paridi. Pyetje e vështirë, tha Metod Antrakidi dhe u mbështet në karrige. Kush gjen përgjigjen e pyetjes tënde ka zbuluar kuptimin e botës. Të gjithë njerëzit besojnë se ka perëndi, por askush nuk e di ku është, si është, sa e madhe është, si e ka trupin, a ka trup, a ka flokë, sy, veshë, këmbë dhe duar si ne, ku jeton, me se ushqehet, ku fle dhe a fle. Asnjëri nuk e ka parë perëndinë dhe prandaj shumë njerëz besojnë se perëndia jeton në mendimet e tyre dhe në qoftë se ata nuk mendojnë, nuk ka perëndi. Po në qoftë se unë nuk mendoj, atëherë perëndia vdes, pyeti Aliu. Këtë nuk e bën dot sepse edhe kur nuk mendon, ti mendon se si të mos mendosh, tha Muhamedi. Sara i bëri shenjë Mihal Komnenit, si për t'i thënë se kjo nuk ishte një bisedë që duhej vazhduar, por ai dukej më i përqendruar se djemtë.

Përgjigjja e pyetjes së Paridit është shumë e thjeshtë Metod, tha Mihal duke qeshur. Njeriu dhe perëndia janë si pula me vezën. Veza bën pulën dhe pula bën vezën. Në qoftë se ke njëjërën, i ke të dyja, në qoftë se nuk ke njëjërën, nuk ke as tjetrën. Njeriu është si pula sepse ai ka sy, gojë dhe ecën, tha Aliu. Jo, tha Paridi. Njeriu është si veza, ndërsa perëndia është si pula, sepse veza bën vetëm një pulë, ndërsa pula bën shumë vezë dhe perëndia ka bërë shumë njerëz.

Perëndia nuk është as pulë, as vezë, tha Muhamedi, fytyra e të cilit ishte bërë rozë. Perëndia është vetë njeriu. Njeriu mund të bëjë çdo gjë, ndërsa perëndia nuk bën dot çdo gjë që bën njeriu. Njeriu lind njeriun. Në qoftë se gjithë njerëzit nuk lindin më njerëz të tjerë, si Hana, atëherë një ditë nuk do ketë më njerëz dhe nuk do ketë më as perëndi. Perëndia nuk jeton dot pa njerëz, ndërsa njerëzit jetojnë pa perëndinë. Sara thotë se grekët e lashtë kishin shumë perëndi. Myslimanët dhe të krishterët thonë se ka vetëm një perëndi, por ka edhe njerëz që thonë se nuk ka fare perëndi dhe ata jetojnë si gjithë ne të tjerët dhe nuk iu ndodh asgjë.

Hana ishte ngurtësuar në karrigen e vet dhe duke iu drejtuar Muhamedit i tha: Xhaxhai yt nuk bënte fëmijë, ndërsa unë mund të bëj po të martohem me një burrë tjetër. Edhe Muhamedi këtë tha. Ti nuk je një pulë pa vezë, por je një pulë pa gjel, tha Mihal Komneni për të qetësuar mbesën. Nuk ka më gjela në këtë fshat, tha Hana dhe u çua e doli në oborr. Fustani i bukur vishnjë i rrinte ngushtë dhe format e drejta të trupit të saj u holluan, pas syzeve miope të Metodit. T'i lëmë të vdekurit në punën e tyre, foli Ibrahim. Metod Antrakidi e shihte Muhamedin me kureshtje, ndërsa Sara kishte marrë Anën në prehër dhe po i jepte një copë kek.

Sa vjeç janë djemtë, pyeti Mihal Komneni. Ibrahim rrinte i menduar dhe nuk e dëgjoi. Unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç, tha Jani. Niko është pesëmbëdhjetë, Muhamedi dymbëdhjetë dhe Aliu dhjetë vjeç. Nuk jam Niko, jam Paridi, tha Niko, ta thashë një herë. Jani nuk foli, por e pa të vëllanë me inat, ndërsa Ibrahim u përmend dhe u kthye nga i biri. Ti nuk bëhesh dot Parid, po u solle si Niko. Kur njeriu ndërron emrin, ndërron edhe sjelljen, tha Ibrahim. Unë do ta ndryshoj sjelljen, siç ndryshove ti baba, kur u bërë Ibrahim. Tani je më i urtë dhe e dëgjon Sarën më shumë se nënën tonë. Ibrahim pa Mihal Komnenin që buzëqeshte nga fjalët e Paridit dhe tha: Djemtë na futën në lojërat e tyre dhe tani nuk dalim dot. Edhe ne i kemi futur në lojërat tona dhe ata nuk do dalin dot asnjëherë, ia ktheu Mihali. Ç' do të thuash, e pyeti Ibrahim duke mbledhur vetullat. Dua të them se kur ti u bërë mysliman, solle në fshat një lodër të ngatërruar që i zëvendësoi gjithë lodrat e kalamajve, siç e pe dhe sot, tha Mihal Komneni. Këtë lodër nuk e solla unë. Atë e sollti Turqia, siç sollti ushtrinë, taksat dhe ligjet. Edhe vëllai yt u bë mysliman dhe për këtë nuk e kam fajin unë, tha Ibrahim. Gjergji nuk besonte në Islam. Ai do të bëhej edhe indian sikur ta dinte se kjo e torturonte babanë e vet. Ai kishte arsye të tjera dhe unë besoj se ai u bë mysliman vetëm për t'u hakmarrë ndaj babait, tha Mihali po pse duhej të hakmerrej yt vëlla ndaj Arianit Komnenit, pyeti Metodi. Histori e gjatë, tha Mihali që u shtriq në karrige, ndërsa këmisha e qëndisur i lëvizi si gjethe në trup.

Gjergj Komneni dyshonte se gruaja e tij ishte motra e Arianit Komnenit, tha Jani me zë të ulët. Ibrahim e pa Janin vëngër, ndërsa Sara e lëshoi Anën mbi qilim dhe, duke u zgjatur mbi tavolinë, e pyeti: Kush ta ka thënë ty këtë? Ma ka treguar Thanasi, tha Jani. Atij ia kishte treguar Ali Tepelena, të cilit ia kishte thënë vetë Gjergji, ditën që ata u takuan në shtëpinë tonë. Ali Tepelena është një mashtrues, tha Sara. Po atëherë vajzë e kujt ishte nëna e Hanës, pyeti Jani. Kjo nuk dihet, por tani nuk ka më asnjë rëndësi, tha Mihal Komneni duke dashur ta mbyllte bisedën.

Kjo dihet, tha Hana dhe të gjithë kthyen kokën.

Hana ishte futur në shtëpi dhe askush nuk e kishte parë. Ajo e ndiqte bisedën në këmbë, ndërsa fustani i lagur i ishte ngjitur në trup dhe flokët i pikonin mbi qafën e bardhë dhe të gjatë. Nëna ime ishte vajza e gjyshit të babait tim. Ai e mësoi këtë gjë pasi ata u martuan dhe pasi linda unë. Ditën që vdiq, babai erdhi në shtëpi dhe ma tha duke u dridhur nga ethet e kolerës. Ai u martua me hallën e vet dhe këtë nuk ia fali kurrë Arianitit, i cili e dinte por nuk ia kishte thënë. Është e pamundur, foli Sara dhe pa me ngulm nga Mihal Komneni duke pritur që edhe ai të kundërshtonte. Por Mihali ishte mbështetur fort në karrige dhe nuk fliste. Koka i ishte varur mbi qëndisma dhe flokët e bardhë e kishin humbur krehjen. Është e vërtetë, tha Hana dhe u ul në vendin e saj, përballë Muhamedit. Ngriti kokën lart dhe i drejtoi sytë nga Sara. Në këtë fshat vetëm tre veta i kanë pasur sytë jeshilë. Babai i Arianit Komnenit, nëna ime dhe unë. Nëna nuk mund të ishte vajza e xhaxhait të Mihalit sepse ai ishte shterpë. Por ajo nuk ishte as vajza e vëllait të gjyshit të Ibrahimit sepse përndryshe im atë, që e dinte të vërtetën, nuk do më kishte

lënë të martohesha me Vasilin që ishte nip i tij. Unë jam një Komnene edhe nga babai, edhe nga nëna dhe për këtë më vjen mirë.

Sara nuk fliste dhe e mbante kokën mbi pjatë ku sytë jeshilë të Hana Komnenës mbinin si një gjethe maruleje. Ibrahim kishte afruar Anën pas vetes dhe mendonte se si fatet e dy familjeve ishin pleksur për të mos u ndarë më. Lindja e Anës ishte një fryt i përbashkët i dy pemëve, që prej shekujsh rrinin pranë e pranë, derisa një ditë kishin vendosur të përqafoheshin, për t'u ngrohur nga acari.

Ti je një grua e bukur që nuk duhet të plakesh duke kthyer kokën prapa, tha në mes të heshtjes Mihal Komneni duke e parë me qetësi mbesën e vet. Gratë nuk i plak e shkuara, por mungesa e burrit, tha Hana dhe u përlot. Ti je e re dhe e bukur, tha Sara për ta ngushëlluar dhe e largoi marulen nga pjata e vet. Po të kisha një fëmijë, jeta ime do ishte ndryshe, tha Hana, por me sa duket pulat jeshile të racës sonë nuk bëjnë vezë me gjelat e shtëpisë së Ibrahimit. E provoi nëna ime, e provova dhe unë, por më kot. Ku i dihet, tha Metod Antrakidi dhe Mihal Komneni filloi të qeshte fort dhe u çua nga karrigia e shkoi të përqafonte Hanën. U gabova kur thashë se ti je një grua pa humor, por një Komnene nuk mund të jetë kurrë e mërzitshme, tha ai dhe iu drejtua Ibrahimit: Gëzuar Ibrahim! Mëkatet e tua u lanë ditën që linde një Komnene, e cila sot u bë dy vjeç. Gëzuar, tha Ibrahim duke ngritur gotën e verës mbi kokën e Anës. Mëkatet tona janë si gurë kalldrëmi, po i shkele të tregojnë rrugën. Gëzuar, tha dhe Sara që shkoi të përqafonte Hana Komnenën, e cila e mbante dorën e Mihalit si një gjerdan mbi qafë. Metod Antrakidi hoqi syzet, i la mbi tavolinë dhe i foli Ibrahimit. Urim i mençur, por jo gjithmonë i vërtetë. Rrugët e Voskopojës ishin të gjitha të shtruara dhe aty ku mbaronte kalldrëmi fillonte balta. Por një ditë balta u fut në qytet dhe e mbuloi kalldrëmin. Ne ikëm dhe balta mbeti e mbushur me gjurmët e mëkatit. Po t'i ndjekësh ato gjurmë, vetëm rrugën e barbarisë mund të gjesh.

Çfarë është Voskopoja, pyeti Paridi. Metodit i doli frymë nga gjoksi dhe zhurma e firomës së tij i ngjau një guri që shkëputet nga balta. Ngriti kokën nga Mihal Komneni dhe e pa në sy sikur po i merrte leje. Tregoja, ia bëri Mihali me kokë.

23

Voskopoja ishte një qytet i bukur jo shumë larg fshatit tuaj. Voskopoja ishte një botë e vogël e mbledhur në një dorë malesh. Aty kishte çdo gjë. Kishte ditë, kishte natë, kishte diell, kishte hënë, kishte qetësi, kishte fillad, kishte lule, kishte livadhe, kishte ketra, kishte lepuj, kishte zjarr, kishte vjeshtë, kishte pranverë, kishte pyll, kishte yll, kishte eklips, kishte zogj, kishte dashuri, kishte paqe, kishte nder, kishte falje, kishte ëmbëlsi, kishte jetë, kishte muzikë, kishte violinë, kishte martesë, kishte vdekje, kishte lindje, kishte djem, kishte vajza, kishte mësues, kishte nxënës, kishte shkollë, kishte dyqane, kishte drita, kishte rrugë, kishte hane, kishte kuaj, kishte shtëpi, kishte kisha, kishte priftërinj, kishte kambana, kishte mesha, kishte manastir, kishte libra, kishte germa, kishte shtypshkronja, kishte bibliotekë, kishte ikona, kishte piktura, kishte pemë, kishte dëborë, kishte lugina, kishte kroje, kishte ujë, kishte çezma, kishte pragje, kishte oborre, kishte lulishte, kishte shatërvanë, kishte mullinj, kishte qelq, kishte basma, kishte sëndukë, kishte flori, kishte para, kishte fëmijë, kishte lodra, kishte monumente, kishte mermer, kishte arkitektë, kishte ura, kishte kanale, kishte azil, kishte spital, kishte jetimore, kishte tregtarë, kishte punishte, kishte magazina, kishte pëlhura, kishte mëndafshe, kishte kafe, kishte sheqer, kishte kallaj, kishte xham, kishte kadife, kishte hekur, kishte bakër, kishte plumb, kishte pambuk, kishte atllas, kishte pasqyra, kishte gota, kishte porcelan, kishte lëkurë, kishte ilaçe, kishte tekstile, kishte armë,

kishte pishqolla, kishte vaj, kishte miell, kishte lesh, kishte velenxa, kishte duhan, kishte turistë, kishte marangozë, kishte druvarë, kishte fajdexhinj, kishte shkrintarë, kishte këngëtarë, kishte bujq, kishte kovaçë, kishte samarxhinj, kishte kallajxhinj, kishte jorganxhinj, kishte bravapunues, kishte thikëpunues, kishte oxhakpunues, kishte berber, kishte xherahe, kishte barinj, kishte rrobaqepës, kishte kazanxhinj, kishte bojaxhinj, kishte qemerxhinj, kishte muratorë, kishte gurskalitës, kishte opingar, kishte armëtarë, kishte liri, kishte veri, kishte perëndim, kishte rregull, kishte ligje, kishte shqiptarë, kishte grekë, kishte jevgj, kishte të krishterë dhe prandaj kishte dhe alfabet.

Na lodhe, i tha Sara, më mirë na thuaj se çfarë nuk kishte. Metod Antrakidi mori frymë dhe pa nga Ibrahim sikur t'i kërkonte falje. Nuk kishte myslimanë, tha. Nuk gënjen, ndërhyri Mihal Komneni që rrinte në këmbë duke numëruar sendet e Metodit, por ka harruar të thotë se në Voskopojë kishte edhe Komnenë.

Po syzet e tua kush i bëri, kazanxhiu apo muratori, pyeti Aliu dhe Ibrahim qeshi. Syzet i kam blerë në Venedik dhe kur i vura për herë të parë nxënësit në Voskopojë më quajtën Mektodysz Prapakidi. Kurse unë do të të quaja Me-kto-syz-ëndrra-kishi, tha Hana.

Ti nuk ndryshon shumë nga gratë e Voskopojës që u dashuruan me syzet e Metodit, foli Mihali. Aq sukses patën syzet e tij në qytet, sa që gratë filluan t'u kërkonin burrave apo të dashurve të tyre tregtarë të vinin syze sepse kështu dukeshin më të rinj dhe më të zgjuar. Burrat që filluan të mbanin syze quheshin nga të dashurat me përkëdheli mektosyçka. Njëherë i shkova një zonje të re në shtëpi kur burri tregtar kishte ikur në Rumani. Për t'ia bërë qejfin i mora syzet Metodit. Ajo u kënaq sepse e quajti këtë një shenjë respekti dhe atë natë e ndau vetminë me mua. Ndërsa njëherë tjetër që Metodit i duheshin syzet, unë shkova pa to dhe ajo më zboi dhe më tha: Ik Paktosyçka. Por dikush që më kishte parë i tha burrit të saj se një burrë me syze ia vizitonte gruan kur ai nuk ishte. burri i zuri pritë Metodit në shkollë dhe e rrahu në sy të nxënësve. Faqet iu ënjtën dhe syzet iu thyen derisa i porositëm një palë të tjera pas dy muajsh. Por, kur erdhën syzet, faqet e Metodit ishin akoma të nxira.

Djemtë qeshën dhe Hana e zuri Mihal Komnenin lehtë nga flokët sikur po e dënonte. Mihali gjithmonë i ka gjetur gratë me sytë e të tjerëve, tha Metodi. Po, tha Ibrahim, kur ishte i ri Mihali shikonte Zoicën me sytë e Mihalit. Hana dhe Sara panë nga Ibrahim për të kuptuar se ç'donte të thoshte, por Mihal Komneni i ra Metodit lehtë në sup dhe i tha: Çfarë the se nuk kishte në Voskopojë?

Harrova të them se në Voskopojë kishte shumë myshk. Në pranverë kur shkrinte dëborë livadhet përreth qytetit mbusheshin me një myshk bojë vjollcë që kur dielli e zinte në perëndim dukej blu. Gratë e mblidhnin myshkun dhe bënin parfume për vete dhe ilaçe për fëmijët. Në këtë stinë Voskopoja mbante era myshk dhe gratë mbarseshin duke e mbledhur. Gjnjtë, flokët, sqetullat dhe gjithë trupi ua thithte këtë aromë, që i dehte burrat e tyre. Shumica e fëmijëve të Voskopojës janë zënë në pranverë kur myshku ngrinte petalet e veta të vogla mbi tokë dhe kanë lindur në dimër kur, nën dëborë, myshku ushqehet me lagështi për të nxjerrë prapë kokën në pranverë. Myshku ia lidh barrën grave të dobëta dhe ia qetëson qarkullimin e gjakut burrave të lodhur. Nga myshku i është vënë emri Voskopojës që në kohët e lashta latinët e quajtën Muskopolis, ose Qyteti i Myshkut. Disa të mençur thonë se myshku, përveç aftësive shëronjëse, i dikto trurit të njeriut një dashuri më të madhe për natyrën, për artet, për të bukurën dhe për veten. Kjo mund të jetë e vërtetë sepse voskopojarët kanë qenë artistë të lindur dhe narcizistë të marrë dhe kjo dashuri për veten e ka zbukuruar qytetin. Por, vitet e fundit, tregtarët e mëdhenj, që financonin shkollat dhe librat, nuk pranonin që fëmijëve dhe të huajve t'u mësohej se Voskopoja ishte qyteti i arteve. Ata kërkonin që Voskopoja të mbahej mend si një qytet i ngritur nga tregtarët dhe

kështu vendosi edhe këshilli i të katërmbëdhjetëve, i cili jepte leje për botimet tona. Këshilli përbëhej nga përfaqësues të tregtarëve dhe kur këta u ankuan për një botim të Akademisë që quhej Voskopoja-Qyteti i artit kishtar, libri u ndalua të shitej dhe nuk u fut në bibliotekë. Këshilli vendosi që libri të rishkruhej dhe ai doli pas një viti me titullin Voskopoja, Tregtia, Arti dhe Kishat. Ambroz Gusta, që shkroi këtë histori të shkurtër të Voskopojes, gjeti një të mesme midis tregtarëve dhe priftërinjve dhe kështu libri u shtyp.

Por është e vërtetë se tregtarët kanë dhënë shumë për qytetin. Në qoftë se Voskopoja ishte si një trup i gjallë, tregtarët dhe zanatçinjtë ishin duart dhe këmbët, artistët ishin sytë dhe veshët, ndërsa priftërinjtë ishin truri. Pjesa tjetër ishin gojë që hanin dhe flisnin për tre të parët.

Voskopoja është në mes të udhës që shkon nga Adriatiku në Selanik dhe në Stamboll. Duke qenë midis maleve, ajo i ngjan një magazine natyrore ku karvanët pushonin, mallrat shkëmbeheshin dhe kuajt ndërroheshin. Tregtarët vendosën rregulla të forta për sigurinë e magazinave të tyre, të cilat ruheshin me burra të armatosur që paguheshin shtrenjtë. Mallrat që shkarkoheshin në portet e Adriatikut, tregtarët e Voskopojes i merrnin dhe i shpërndanin në të gjithë Perandorinë Turke dhe prej andej sillnin mallra që i duheshin hungarezëve, austriakëve dhe venedikasve. Tregtarët rrinin gjithë kohën nëpër rrugë dhe nëpër porte e dogana, ndërsa me paratë e tyre zanatçinjtë ndërtonin shtëpi të mëdha, rrugë, ujësjellës, shkolla, kisha dhe lulishte. Gjatë dimrit, kur rrugët bllokoheshin nga dëbora, tregtarët rrinin në qytet me gratë e tyre dhe me fëmijët, duke iu rrëfyer për qytetet që kishin parë dhe për madhësinë e tyre. Fëmijët donin të mësonin më shumë se baballarët dhe këta mblodhën para dhe ngritën shkollat, ku në fillim priftërinjtë u bënë mësues. Por kur fëmijët mbaruan shkollat ata nuk deshën të bëhen të gjithë priftërinj dhe disa u bënë tregtarë si etërit, disa ikën për të vazhduar studimet në shkolla të mëdha në Itali dhe Austri dhe disa mbetën duke u bërë mësues të fëmijëve të tjerë.

Voskopoja u rrit dhe qyteti u nda në trembëdhjetë lagje. Zanatçinjtë u grumbulluan në lagje sipas zanateve të tyre dhe kështu u formua lagjja e bakërxhinjve, arpunuesve, armëtarëve, këpucarëve, bojaxhinjve, ndërtuesve, kazanxhinjve, jorganxhinjve, sapunxhinjve, rrobaqepësve, samarxhinjve, lëkurxhinjve dhe artistëve. Secila nga trembëdhjetë lagjet zgjidhte një herë në vit një përfaqësues në këshillin e të trembëdhjetëve që drejtonte qytetin dhe vendoste për rregullin, për oraret e punës, për ndërtimet e reja, si dhe jepte leje për të ardhurit në Voskopoje. Qyteti u pasurua dhe mjaft fshatarë nga viset përreth, por edhe grekë që vinin për të gjetur punë atje. Në qoftë se këshilli i të trembëdhjetëve nuk e pranonte, të huajt nuk i jepej tokë për të ndërtuar shtëpi dhe lagjet nuk kishin të drejtë ta strehonin. Këshilli zgjidhte një kryetar, i cili drejtonte punimet e tij dhe vuloste vendimet që merrte këshilli.

Në vitin 1712 kryetar i Këshillit të të trembëdhjetëve ishte Johan Vulgari, babai i Eugjen Vulgarit të ndritur që përktheu Volterin dhe që u bë mësues në të gjitha shkollat e mëdha greke nga Kostandinopoja në More. Johan Vulgari vinte nga lagjja e sapunxhinjve. Ai kishte qëndruar dhjetë vjet kryetar i këshillit të të trembëdhjetëve dhe mendonte se ishte i pazëvendësueshëm. Ishte bërë fodull dhe i pasjellshëm. Nuk pyeste shumë për këshillin dhe kishte filluar t'i merrte vendimet në kokë të tij. Në vitin 1706 disa tregtarëve të lëkurëve u ishin mbytur dy anije të mëdha me mall në Durrës. Ata i kishin kërkuar ndihmë Johan Vulgarit që të shkonte bashkë me ta në Durrës për t'u kërkuar autoriteteve të portit që t'u paguanin atyre paratë për dëmin. Por Johan Vulgari nuk shkoi në Durrës dhe tregtarët i humbën paratë e tyre. Në qytet u hap fjala se një natë, duke pirë me shokët e tij Johan Vulgari kishte thënë: Më mirë që u mbyt lëkura në det se era e saj na qelbte qytetin. Që atëherë tregtarët e lëkurës ishin në hasmëri me Johanin dhe votonin gjithnjë kundër tij.

Në 1712 do të bëheshin zgjedhjet për këshillin dhe për kryetarin e ri. Tregtarët e lëkurës u lidhën me përfaqësues të tjerë në këshill dhe arritën të bënin aleatë edhe gjashtë prej tyre. Johan Vulgari e mori vesh se kundërshtarët e tij kishin mbledhur shtatë vota në këshill dhe ai nuk mund të zgjidhej më kryetar i të trembëdhjetëve vetëm me gjashtë votat që kishte. Atëherë, pa pyetur këshillin, Johani vendosi që në Voskopojë të ngrihej një lagje e re me të huaj, e cila do të ishte lagjja e katërbëdhjetëve. Ai firmosi menjëherë kërkesat e shumë fshatarëve që prisnin prej vitesh të bëheshin qytetarë të Voskopojës dhe i dha atyre të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Këshill. Shumica e tyre ishin myslimanë të ardhur nga fshatrat e Kolonjës, Devollit dhe Beratit, të cilët deri atëherë nuk ishin pranuar në qytet. Kundërshtarët në këshill bënë zhurmë dhe u ankuan se Johan Vulgari po ngrinte një lagje me të huaj dhe me myslimanë në Voskopojë dhe çështja i shkoi kadiut të Korçës. Kadiu i dha të drejtë Johan Vulgarit duke thënë se Voskopoja ishte një qytet në Perandorinë Turke dhe myslimanët nuk mund të përjashtoheshin nga asnjë vend dhe se çdo vendim, që nuk i lejonte ata të jetonin ku të donin nuk do të ishte i vlefshëm. Kështu, këshilli i të trembëdhjetëve u bë me katërbëdhjetë vetë dhe kur u votua, Johan Vulgari mori shtatë vota pro dhe shtatë kundër dhe vazhdoi të qëndronte kryetar, por kishte humbur mbështetjen e shumicës së qytetit dhe sidomos të priftërinjve, të cilët u acaruan nga ardhja e myslimanëve. Për t'i zbutur, Johan Vulgari, që ishte një i krishterë dinak i dha atyre para, nga arka e këshillit, për mbaruar katedralen e madhe të Shën Mërisë në qendër të Voskopojës, e cila kishte filluar prej 1696 dhe ende nuk kishte përfunduar. Muret dhe dhomat e katedrales ishin ngritur, por ajo kishte mbetur bosh nga brenda, si një haur i madh. Njerëzit që i zinte nata në Voskopojë e përdornin ndërtesën për të fjetur dhe për të çlodhur kuajt. Johan Vulgari thirri piktorët më të mirë nga Korça dhe Berati dhe këta pikturuan afreske dhe ikona të shkëlqyera dhe të ndritshme me luspa, të cilët e habitën gjithë qytetin. Njëri prej tyre ishte David Selenica. Kur ai pikturonte, hipur mbi skelat e larta, fëmijë, pleq dhe gra mblidheshin duke e kundruar dhe harronin se bojërat e tij u pikonin mbi rroba. Një mëngjes, dy gra që erdhën nga fushat, pasi kishin mbledhur myshk, u ndalën duke parë piktorin që ishte përlyer i gjithi me bojëra dhe dukej si një ylber. Ju pëlqen, i pyeti Davidi që e kishte zakon të fliste me njerëzit kur punonte. E bukur, por e ftohtë, tha njëra nga gratë. Një kishë pa lule është si një shtëpi pa grua. David Selenica e la punën për tri ditë dhe u mendua gjatë për fjalët e gruas. Kur u kthye mbi skelë, sytë i kishin marrë ngjyrë livadhi dhe në thilenë e këmishës kishte vënë një gjethe myshku. Atë ditë, për herë të parë, David Selenica pikturoi në muret e një kishë rrush, grurë, bukë, hardhi, lule me shumë ngjyra dhe myshk bojëvjollce. Murgjit e ngurtë të Voskopojës shkuan te Davidi dhe e pyetën se pse kishte dalë nga korniza e rreptë e pikturës kishtare dhe ai duke qeshur i tha: Engjëjt dhe shenjtorët kanë jetuar në natyrë. Ata janë ushqyer me rrush dhe janë shëruar me myshk prandaj jetojnë akoma.

Katedralja e Shën mërisë përfundoi atë vit, pas trembëdhjetë vite pritje dhe Johan Vulgari i tha këshillit se po të mos ishte zgjedhur kryetar ajo nuk do të mbaronte kurrë. Për të përjetësuar vitin e zgjedhjes së tij Johani i kërkoi gurgdhendësve që në portën e madhe të hyrjes të shënonin vitin 1712 si vit i ndërtimit të katedrales. Për t'i bërë qejfin edhe priftërinjve, por edhe myslimanëve që e ndihmuan të zgjidhej, Johan Vulgari vendosi që data e ndërtimit të gdhendej edhe sipas kalendarit grek edhe sipas atij arab, dhe kështu u bë.

Katedralja u përrua të dielën më datë 2 tetor 1712 dhe më shumë se një mijë veta morën pjesë në meshën e madhe. Kur njerëzit dilnin të mahnitur nga bukuria e katedrales, djem dhe vajza të vogla, të porositur nga Johan Vulgari, i gostitnin besimtarët me rrush dhe kumbulla, të cilat i mbanin në shporta prej kashte.

Por, siç thashë, që nga viti 1712, Voskopoja u bë me katërbëdhjetë lagje, por tani ishin të huaj ata që vendosnin për punët e keshillit. Johan Vulgari u lëshoi të huajve toka të reja për shtëpi dhe iu dha të drejtë fëmijëve të tyre të studionin në shkollat e Voskopojës. Në lagjen e tyre të re u ndërtua edhe jetimorja e Voskopojës ku strehoheshin fëmijët jetimë të ushtarëve të vrarë apo fëmijë të gjetur që filluan të vinin edhe nga Korça dhe fshatrat përreth. Disa nga këta fëmijë, kur u rritën, krijuan më pas banda të armatosura që kërcënonin tregtarët dhe në qoftë se këta nuk u jepnin para ata u merrnin mallin, por edhe i vrisnin. Disa vjet më vonë kur lagja e të huajve u zmadhua, përfaqësuesi i tyre në keshill kërkoi që të ndërtohej një xhami. Johan Vulgari, duke qenë peng i tyre hezitoi, por këtu humbi mbështetjen e përfaqësuesve të tjerë, të cilët u bashkuan dhe e shkarkuan Johanin si kryetar. Keshilli u bë një dhe vendimi për ngritjen e xhamisë nuk u mor kurrë. Për të zbutur myslimanët që ishin shtuar në numër, tregtarët vendosën t'i jepnin atyre para për të rregulluar lagjen me rrugë, me kalldrëme, me çezma dhe mjaft prej tyre i morën në punë për të shoqëruar karvanët.

Në 1730 shkollat e Voskopojës kishin nxjerrë mjaft të rinj të etur për të mësuar dhe disa prej tyre ishin kthyer nga shkollat që kishin bërë në perëndim. Ata kishin studiuar artin dhe filozofinë e italianëve, francezëve dhe gjermanëve dhe kishin mësuar të bënin libra. Por librat e tyre nuk mund t'i shtypnin në Evropë sepse kjo kushtonte, prandaj ata i kërkuan keshillit para për ngritjen e një shtypshkronje, e cila u ble në Venedik dhe shtypi për shumë vjet me dhjetëra libra dhe përkthime dhiatash nga autorët voskopojarë. Ditën që shtypshkronja erdhi me karvanë në Voskopojë, fëmijë, pleq, burra dhe gra, të krishterë e myslimanë, u grumbulluan në sheshin e qytetit duke parë sesi shkarkoheshin nga samarët e kuajve pjesët dhe rrotat e zeza prej hekuri. Ato u morën një nga një dhe u vendosën në një bodrum në themelet e Katedrales së Shën Mërisë. Dy italianë erdhën nga Venediku dhe i bënë pjesët bashkë. Ata sollën bojë dhe letër dhe ditën që nga makina doli faqja e parë në Voskopojë u bë festë.

Kryetari i Keshillit doli përpara njerëzve dhe tha: Voskopojarë, tregtarë, priftërinj dhe zanatçinj, shkrimtarë, nxënës dhe mësues, burra dhe gra. Të gjithë ju tani mund të flini të qetë. Edhe sikur qyteti ynë të digjet dhe të harrohet, kjo shtypshkronjë do t'u tregojë brezave lavdinë tonë. Njerëzit gëzonin dhe fëmijët fusnin kokën nëpër të çarat e bodrumit të kishës për të parë shtypshkronjën që bënte zhurmë, si një kafshë e uritur që përtyp letër. Pasi italianët u larguan, punët në shtypshkronjë i drejtoi Grigor Jeromonaku, një murg i ri i cili flinte në katedrale natë ditë dhe vajrat që i derdheshin në kokë dhe copat e letrës prej pambuku që i mbushnin flokët, bënë që fëmijët ta kishin frikë, sepse dukej gjithnjë si një fantazmë. Grigori i rregullonte fletët prej pambuku dhe i priste, e pastaj murgjit e tjerë i lidhnin me kujdes duke shpuar faqet një nga një me disa thika dhe gërshtë që i kishin sjellë italianët. Grigori i vizatonte kapakët e librave dhe i mbushte me figura shenjtorësh dhe fëmijësh të rrethuar me fletë si dhe kafshë biblike, por shpesh edhe pagane. Kur u shtyp libri i parë që ishte një alokuthi për Teodorën, ose një libër shërbesash, Grigori e zbukuroi kapakun me një vizatim të kalit Pegasus që fluturonte mbi Voskopojë. Kur e pyetën se pse zgjodhi Pegasin, ai tha se dituria është një gjë që vjen dhe ikën njëlloj si ai kalë i bardhë që askush nuk e mban dot, nëse nuk ia pret krahët.

Kur në vitin 1750 u formua Akademia në Voskopojë erdhën shumë të rinj nga qytete të tjera për të studiuar. Ato ishin ditët më të ëmbla të qytetit. Studentë të rinj, të veshur me këmbis të bardha dhe flokë të gjata, ecnin rrugëve të qytetit me libra në duar duke folur për filozofët dhe për letërsinë. Vajzat e Voskopojës dilnin në dyert e shtëpive dhe shikonin djemtë. Këta u flisnin dhe u kërkonin takime. Shumë të rinj u afruan dhe në mbrëmje Voskopoja i ngjante një biblioteke të madhe, ku njerëzit mësonin të lexonin libra për të shkruar pusulla dashurie. Baballarët tregtarë ktheheshin nga udhëtimet e tyre dhe i gjenin vajzat ose djemtë të fejuar.



Tavernat ishin të mbushura me ceremoni fejesash dhe dasmash, kremtimi i të cilave nuk bëhej më vetëm nëpër shtëpi. Krushqitë mbylleshin nëpër këto taverna që në darkë jehonin nga këngët, urimet dhe shkëmbimet e pajave. Studentët kishin vendet e tyre ku plekseshin me njëri-tjetrin në netët e gjata të dimrit dhe pinin duhan që e përzienin me pak myshk të thatë që ta merrte mendjen de që plakat e qytetit zakonisht e përdornin për të nxjerrë një çaj që i qetëson stomakët e lodhur. Në këto taverna, në mbrëmje, mblidheshin këngëtarë, piktorë dhe poetë, të cilët pasi pinin, recitonin poezitë e tyre me vargje të lehta dhe ritmike duke hipur majë karrigeve. Kur poezia pëlqehet, studentët i përplasin gotat e drunjta mbi tavolinë. Këto taverna ishin nëpër rrugicat e ngushta të qytetit dhe shpesh njerëzit ankoheshin nga zhurma e studentëve dhe poetëve të dehur. Njëherë, në një tavernë në lagjen e kazanxhinjve, njëri prej poetëve po festonte ditëlindjen me shokët e tij. Poeti kishte marrë disa muzikantë që i ranë violinave dhe buzukëve deri në mëngjes. Aq zhurmë dhe potere u bë atë natë, sa që kazanxhinjtë dolën nga shtëpitë dhe i kërkuan djemve ta ndalnin festën, por këta u tallën dhe vazhduan të këndojnë. Atëherë kazanxhinjtë morën kazanët e tyre, shkuan te dera e tavernës dhe filluan t'i binin kazanëve me shufra hekuri. Djemtë u shurdhuan dhe ikën me vrap, ndërsa kazanxhinjtë i ndiqnin nga pas duke i sharë dhe duke i rënë kazanëve si daulle. Që atëherë doli fjala se kazanxhinjtë e Voskopojës rrahin kazanët e tyre.

Por jo gjithmonë Voskopoja ishte kaq e virtytshme dhe idilike. Pasuria u shtua, por bashkë me të u rrit edhe zilia. Turqia kishte marrë nën kontroll shumicën e porteve të Adriatikut dhe mjaft tregtarëve iu mbyllën rrugët për në Venedik. Vetë Venediku ishte dobësuar pas luftërave të gjata me turqit dhe porte të tjera si Gjenova, Napoli apo Trieste kishin marrë fuqi në det duke përfutur nga armiqësia e venedikasve me Portën e Lartë. Konkurrenca e fortë që tregtarët kishin me njëri-tjetrin kishte nxitur hasmërinë mes tyre dhe shumë prej tregtarëve mbetën pa punë. Fshatarët, jetimë, myslimanë, çobanë, karvanarë të liruar dhe njerëz të papunë e dembelë kishte plot nëpër qytet. Disa prej tyre kishin krijuar banda të rrezikshme dhe të mëdha siç ishte banda e çobanëve, banda e myslimanëve dhe banda e sevdallinjve që rrëmbente vajza të varfra dhe shiste me para tek udhëtarët e uritur. Zakonisht, bandat krijoreshin mbi bazën e lagjeve dhe në mes të viteve gjashtëdhjetë pothuajse çdo lagje kishte bandën e vet që e mbronte nga bandat e lagjes tjetër. Këta burra të ashpër i zinin pusë njëri-tjetrit natën dhe në Voskopojë njerëzit filluan të kenë frikë dhe të mbyllën në shtëpi pa u ngrysur. Tregtarët detyroheshin t'i paguanin bandat që të mos u grabisnin depot dhe natën, nëpër taverna, banditët pinin dhe ndanin paratë. Zënkat që kishin mes tyre tregtarët e dobësuan këshillin e të katërmbëdhjetëve, i cili e mbyllte njërin sy përballë fuqisë së bandave sepse pa ndihmën e tyre ishte bërë e vështirë të fitoje vota për t'u zgjedhur sërish. Një djalë i fortë dhe qejfi që ishte kryetar i bandës së çobanëve dhe kishte shumë armë sepse ishte formuar në lagjen e armëtarëve, mendoi se kishte ardhur dita që ai të zgjidhej anëtar i këshillit të të katërmbëdhjetëve.

Kur u bënë zgjedhjet në vitin 1764, ai doli nëpër lagje dhe u tha njerëzve se nëse zgjidhej në këshill ai do t'i hiqte taksat për të varfrit dhe do t'i detyronte tregtarët të paguanin më shumë para për të ndërtuar azile për pleqtë dhe spitale të reja për të sëmurët. Marin Kurila ishte i gjatë, i bukur dhe një orator i shkëlqyer. Ai kishte mësuar të lexonte dhe historitë e tij të dashurisë e kishin bërë të famshëm. Kur vendosi të zgjidhej në këshill, Marin Kurila i shkurtoi flokët e zinj, mbathi një palë pantallona shajaku me rrip të trashë, qëndisi dy pisqolla të arta që kryqëzoheshin në këmbë të tij, vari një kryq të bardhë në kyçin e dorës së majtë, lidhi një shall të kuq në qafë dhe shkoi derë më derë të takonte njerëzit. Burrat e kishin frikë, por gratë hutoheshin nga bukuria e tij. Kur ai dilte nëpër lagje në pranverë, njerëzia dilnin nëpër sokakë. Përpara tij ecte një djalë i vogël që e kishin mësuar të bërtiste: Marin Kurila, mbrojtësi i Voskopojës. Marini ndalonte dhe

bisedonte me burrat dhe i hidhte vështrime të ëmbla grave dhe vajzave. Ai u premtoi të gjithëve atë që i kërkuan. I përqafonte pleqtë dhe i ledhatonte fëmijët e vegjël që filluan t'i kërkojnë prindërve që t'i vishnin si ai. Shumë shpejt djemtë dhe burrat e lagjes së armëtarëve lidhën shalle të kuq në qafë dhe filluan t'i qëndisnin këmbët me armë të vogla prej mëndafshi. Vajzat e reja shkonin në kishë dhe luteshin për Marin Kurilën. Në atë kohë, përfaqësues i lagjes së armëtarëve në këshillin e të katërbëdhjetëve ishte një tregtar i madh armësh, i cili kishte shumë miq sepse gjithmonë i kishte mbrojtur interesat e tyre dhe në saje të tij lagjja kishte përfituar shumë para për ndërtime nga arka e këshillit. Ai kishte një vajzë të bukur, së cilës thonë se Marin Kurila ia mori mendjen duke i premtuar se do martohej me të. Marini i hipte kalit, dilte jashtë Voskopojës, shkonte në livadh dhe i sillte vajzës tufa me lule të freskëta. Në mbrëmje, kur mbaronte takimet nëpër lagje, Marini e lidhte shallin e kuq te doreza prej hekuri e shtëpisë së vajzës dhe ajo dilte dhe e merrte shallin e tij, që e mbante gjithë natën poshtë jastëkut, për t'ia lënë në të njëjtin vend të nesërmen në mëngjes. Marin Kurila që kalonte netët nëpër taverna me shokët e tij, një herë shkoi në tavernën e poetëve dhe e detyroi njërin prej tyre t'i bënte një poezi për të dashurën. Nuk e kam parë kurrë atë vajzë dhe nuk e bëj dot, i tha poeti. Po ta kishe parë nuk do ishe kaq budalla, ia ktheu Marin Kurila dhe të gjithë qeshën. Po çfarë të shkruaj, e pyeti poeti i frikësuar. Marin Kurila u mendua, hipi mbi një karrige siç bënin poetët kur recitonin dhe tha: Shkruaj që shalli im do bëhet kurorë mbi kokën e nuses, kurse sytë e saj do bëhen vetulla e pisqollës time. Poeti shkroi një vjershë me tri strofa të gjata dhe i tha Marinit t'i gjente një titull. Titulli është: Marin Kurila i drejtohet së shtrenjtës vashë, tha ai dhe e firmosi në fund. Njerëzit e Kurilës ia çuan vajzës poezinë dhe ajo nuk fjeti gjithë natën duke ëndërruar.

Me ndihmën e kësaj vajze, Marin Kurila u takua një natë me babanë e saj dhe të nesërmen ky shpalli se nuk donte të zgjidhej më në këshill dhe se do të mbështeste Marinin. I ati i vajzës thirri gjithë armëtarët e tjerë dhe i bindi të bënin të njëjtën gjë. Marin Kurila u kërkoi atyre para dhe i premtoi se pasi të zgjidhej ai do të detyronte këshillin, që, duke kushtëzuar tregtinë me qytete të tjera si Korça, Janina, Berati dhe Elbasani, të nënshkruhej një pakt, sipas të cilit tregtinë e armëve në gjithë këto qytete kishin të drejtë ta kryenin vetëm tregtarët e Voskopojës. Do bashkoj gjithë bandat e Voskopojës dhe do kemi një ushtri më të pasur dhe më të fortë nga gjithë qytetet e tjera. Në qoftë se ata nuk na e japin paqen për armët tona, ne do t'ua marrim paqen me armët tona, thoshte Kurila duke i hipnotizuar tregtarët siç kishte bërë me vajzat e tyre.

Fama e Marin Kurilës së bukur dhe të fortë u përhap me shpejtësi në gjithë qytetin. Djemtë e lagjes së armëtarëve shkonin në shkollë me shallat e kuq të Kurilës në qafë dhe i mburreshin shokëve nga lagjet e tjera për forcën dhe trimërinë e tij. Burrat flisnin për Marinin dhe gratë kishin kureshtje për ta parë si vishej dhe si fliste. Marini filloi të shkonte pasditeve në lagjet e tjera dhe kur takonte njerëzit u thosh se ai ishte mbrojtësi i Voskopojës dhe se kur të zgjidhej në këshill, qyteti do ndryshonte, shkollat do shtoheshin, dhe do të kishte rregull. Do t'i përzë gjithë hajdutët, të papunët dhe dembelët nga ky qytet, tha Marin Kurila një ditë. Kush nuk është i aftë të gjejë një punë, nuk ka pse jeton këtu. Kush vjedh, dëbohet. Kush vret, shkishërohet. Në Voskopojë do jetojnë vetëm ata që dinë të lexojnë, që shkojnë në kishë dhe që punojnë. Fëmijët në shkollë, gratë në shtëpi, burrat në punë, kjo është Voskopoja ime, bërtiste Marin Kurila kur njerëzit grumbulloheshin duke dëgjuar fjalimet e tij të zjarrta që gjithmonë mbylleshin me thirrjet e shokëve të tij: Marin Kurila po vjen, Voskopoja po shkëlqen! Marini ishte bërë mjeshtër i fjalimeve përpara turmave, të cilat e dëgjonin me gojën hapur. Një ditë kur ai po fliste, një burrë, që më vonë u mor vesh se ishte vënë nga vetë Kurila dhe ishte shok bande me të, thirri: Marina Kurila duhet të bëhet kryetar i qytetit. Njerëzit e dëgjuan dhe filluan t'i kërkonin në kor Marin Kurilës që të pranonte. Perëndia vendos dhe unë bindem, tha Marin Kurila solemnisht dhe

bëri kryqin duke parë nga qielli. Njerëzit u përplotën dhe u falën bashkë me të. Të nesërmen Marin Kurila doli në qytet me një mantel të gjatë të bardhë në të cilin kishte qëndisur stemën e Voskopojës dhe një kryq të gjatë që rrethohej nga dy pisqolla të harkuara. Me hap të madh dhe duke i folur të gjithë njerëzve që i ndeshi në rrugë, ai hyri në kishë dhe mori pjesë në meshë. Njerëzit i hapnin rrugën dhe Marin Kurila u ul në vendin e parë përballë altarit, hoqi pelerinën dhe e palosi me kujdes mbi gjunjë. Kur doli nga kisha kaloi përballë ndërtesës ku mblidhej këshilli dhe u ndal duke e parë. Njerëzit rrinin rreth tij dhe prisnin se çfarë do të thoshte, por Marin Kurila vuri dorën mbi stemën që kishte në gjoks dhe nuk foli. Tri ditë me radhë nuk doli nga shtëpia dhe i kërkoi shokëve të tij t'i thërrisnin një për një përfaqësuesit e lagjeve të tjera. Pesë prej tyre erdhën në takim, por përfaqësuesi i sapunxhinjve, që ishte dhe kryetar i qytetit, i bllokoi të tjerët, mes të cilëve përfaqësuesin e lëkurëpunuesve dhe për shkak të tyre dhe atë të këpucarëve. Po ashtu përfaqësuesi i bakërxhinjve, që nuk erdhi vetë, bindi edhe atë të kazanxhinjve. Edhe jorganxhinjtë dhe rrobaqepësit nuk u dukën në shtëpinë e Marin Kurilës dhe bashkë me ta as përfaqësuesi i lagjes së të huajve, të cilët kishin frikë se Marin Kurila do t'i dëbonte ata nga Voskopoja.

Që nga koha e Johan Vulgarit, gjithë qytetin e kishin drejtuar përfaqësuesit e lagjes së sapunxhinjve, të cilët kishin aleatë të fortë në këshill ku votat ishin të lidhura sipas interesave dhe zanateve. Marin Kurila e kuptoi se me këtë ndarje votash ai nuk do mund të zgjidhej kryetar dhe shkoi në të gjitha tavernat e qytetit duke sharë kryetarin e këshillit. Voskopoja është turpëruar që kur këtë qytet e drejtojnë sapunxhinjtë, tha ai. Por mëkatet e Voskopojës nuk lahen me sapun. Voskopoja nuk mund të jetë qyteti i sapunit, por ai do të jetë qyteti i armëve dhe i burrave që dinë t'i përdorin ato. Sapunët janë për gratë dhe armët janë për burat. Jorganët janë për frikacakët dhe këpucët janë për zbatharakët. Këshilli i qytetit është kthyer në një bandë të tregtarëve të poshtër që u shesin njerëzve sapun të përdorur, jorganë të shkurtër dhe këpucë me lëkurë gomari. Do ta shkatërroj këtë këshill sepse koha është e armëtarëve dhe jo e këpucarëve, koha është e burrave trima dhe jo e jorganëve me vrima.

Marin Kurila fliste dhe manteli i tij e mbulonte gjithë tavernën e mbushur plot me burra me sy të kuq. Ai akuzonte edhe lagjen e të huajve dhe thoshte se Voskopoja ishte prishur që ditën që Johan Sapunxhiu, siç e quante ai Johan Vulgarin, i pranoi ata në këshill dhe e bëri qytetin me katërmbëdhjetë lagje. Kur erdhën ata, filluan vjedhjet dhe poshtërimet. Vajzat tona kanë frikë të dalin në rrugë nga të papunët dhe dembelët që rrinë në qoshet e rrugëve dhe u flasin me fjalë të ndyra. Qyteti e humbi bekimin e perëndisë kur prishi numrin 13 që është numri magjik, sepse 13 ishin dhe Krishti bashkë me apostujt e tij dhe 13 vjet u deshën për ndërtimin e Katedrales së Shën Mërisë. Do ta bëjmë Voskopojën prapë qytetin e numrit trembëdhjetë, thoshte Marin Kurila dhe e puthte trembëdhjetë herë kryqin e qëndisur mbi pelerinën e bardhë.

Një natë, pesë ditë para zgjedhjeve të këshillit, pas shumë fjalimeve të zjarrta ku merrnin pjesë të gjithë, shokët e përcollën Marinin në shtëpi. Pastaj u drejtuan pa zhurmë në lagjen e sapunxhinjve hapën depot e sapunit, i çanë thasët e mbushur dhe sapunin e shpërndanë nëpër kalldrëmet me gurë. Atë mëngjes ra një shi i qetë dhe kur njerëzit dolën nga shtëpitë shumë prej tyre shkanë dhe disa pleq thyen krahët dhe kërbishtet, pa e kuptuar se pse. Kur tregtarët panë depot e boshatisura dhe thasët e shqyer i kërkuan këshillit të mblidhet dhe të dënojë bandën e çobanëve, të cilën e akuzuan për grabitje.

Tri ditë para zgjedhjeve, Marin Kurila u thirr në këshill për t'u pyetur për ngjarjet. Ai shkoi me vonesë në mbledhje dhe, megjithëse i thanë të ulej, qëndroi gjithë kohën në këmbë. Kur anëtarët e këshillit flisnin, Marin Kurila qeshte dhe e shikonte kryetarin në bebe të syrit. Nga jashtë dëgjohej zhurma që bënin shokët e Marin Kurilës bashkë me dhjetëra djem të rinj, të cilët

mbanin në qafë shallin e kuqe. Kur u pyet, Marini e mohoi se banda e tij kishte gisht në hapjen e depove. Ne nuk na duhet sapun sepse nuk kemi mëkate për të larë, tha ai. Shkoni të kërkoni diku tjetër. Përfaqësuesi i këpucarëve ishte më i egri dhe e quante Marin Kurilën zatharak. Ndërsa përfaqësuesi i lagjes së të huajve i propozoi këshillit që Marin Kurila të përjashtohet nga zgjedhjet, sepse në rast se ai fitonte, paqja në qytet ishte e rrezikuar. Atë e mbështetën edhe disa anëtarë të tjerë, por aleatët e Kurilës në këshill dhe sidomos babai i vajzës kundërshtuan dhe e mbrojtën fort. Në fund, të katërmbëdhjetë ranë dakord që propozimin ta vendosnin me votë të fshehtë. Morën një gotë të madhe balte dhe aty hodhën votat një nga një. Votimi doli shtatë me shtatë dhe Marin Kurila u tall dhe tha: Ja pse duhet që ky këshill të ketë trembëdhjetë vetë. Dhe ashtu do jetë pas disa ditësh. Ai falënderoi babanë e të dashurës, hapi pelerinën, përplasi takat fort dhe doli. Jashtë u prit si një hero dhe gjithë natën festoi në tavernë duke pirë. Ndaj të gdhirë u tha shokëve se do shkonte tek e dashura dhe iku duke kënduar.

Në mëngjes e gjetën të vrarë përpara shtëpisë së vet. I kishin ngulur një thikë në ijë dhe një në zemër, aty ku mbante stemën e Voskopojës. Fytyra e tij e bukur ishte zbardhur, ndërsa shallin e kuq e kishin ngulur me thikë mbi derën e shtëpisë. Shalli lëvizte nga era, por, si një rob, nuk lirohej dot nga thika. Pelerina e bardhë e Marin Kurilës kishte mbuluar gurët e gjakosur të kalldrëmit. Shokët e tij e ngritën dhe pasi e pastruan dhe e zbukuruan e shtrinë mbi një shtrat të madh hekuri në oborrin e shtëpisë së tij. Gjithë lagjja e armëtarëve u mblodh për të parë Marin Kurilën. Gratë qanin dhe burrat shtrëngonin muskujt e qafës që i kishin lidhur me shalle të kuqe. E dashura e Marinit e kishte kapur shallin e tij me karfica mbi kokë, si një kurorë mbi flokët e saj të verdha. Pasdite, trupin e Marinit e çuan në Katedralen e Shën Mërisë jashtë dyerve të së cilës rrinin mijëra njerëz të trembur. Kur mbaroi mesha, shokët e mbajtën Marin Kurilën në krahë dhe e shëtitën nëpër të gjitha lagjet e qytetit, me përjashtim të lagjes së sapunxhinjve dhe të të huajve. Në të errur arritën në varreza. Gjithë njerëzit që shoqëruan trupin ndezën qirin dhe qyteti nga lart dukej si një kishë e madhe në natën e pashkës. Pas varrimit njerëzit nxituan të futen nëpër shtëpi dhe i shuan qirinjtë shpejt. Kur u zgjuan, mbi kryqin e madh të Katedrales së Shën Mërisë, ishte lidhur një shall i kuq, ndërsa në lagjen e të huajve u gjetën 14 të vdekur mes të cilëve edhe përfaqësuesi i tyre që kishte propozuar përjashtimin e Marin Kurilës. Kryetari i këshillit dha dorëheqjen, ndërsa tregtari i madh i armëve mori të bijën, ngarkoi karvanët dhe u largua nga qyteti.

Shokët e Marin Kurilës vunë një tra të madh në hyrje të qytetit dhe nuk lejonin asnjëri të dilte apo të hynte pa lejen e tyre. Këshilli u shpërnda dhe ata morën në dorë qytetin. Karvanët me mall që hynin në qytet kontrolloheshin një për një dhe tregtarëve u merrej një taksë në hyrje. Tregtia e sapunëve dhe lëkurëve u ndalua. Tregtarëve iu kërkua t'i hiqnin nga puna gjithë hyzmeqarët nga lagjja e të huajve dhe sidomos myslimanët. Nëpër lagje u caktuan grupe djemsh të armatosur, të cilët mbanin shalle të kuq dhe i pyesnin njerëzit ku shkonin dhe nga vinin. Burgu i qytetit u mor nën kontroll dhe për disa javë me dhjetëra të huaj, tregtarë të sapunit dhe myslimanë u mbyllën atje. Oraret e lëvizjes në qytet ndryshuan. Askush nuk lejohej të dilte nga shtëpia pas orës gjashtë të mbrëmjes. Shokët e Marin Kurilës i kërkuan Grigor Jeromonakut që të shtypte disa lajmërimi, të cilat u varën në muret e çdo lagjeje dhe që përcaktonin ndalimet që ata kishin vendosur. Grigori në fillim kundërshtoi dhe tha se mbyllja e qytetit do ta izolonte Voskopojën, por ata e kërcënuan dhe i thanë se nëse nuk bindej, shtypshkronja do të mbyllej dhe ai do burgosej. Grigori u zbut dhe për dy ditë me radhë punoi për të shtypur lajmërimet. Në to shpjegohej se masat e reja ishin vendosur pas vrasjes së Marin Kurilës për të cilën akuzohej një pjesë e këshillit të vjetër, si dhe myslimanët e lagjes së të huajve. Masat do të kishin një kohëzgjatje të papërcaktuar, siç thuhej, deri në vendosjen e qetësisë në qytet dhe ngritjen e këshillit të ri prej

trembëdhjetë anëtarësh. Në lajmërim thuhej se zgjedhjet, për vetë kushtet që ishin krijuar, pas vrasjes së Marin Kurilës ishin të pamundura. Por, derisa fajtorët të gjendeshin dhe të dënoheshin, masat e mëposhtme ishin të domosdoshme. Hartuesit shkruanin se këto masa merreshin për të mirën e qytetarëve të Voskopojës, jeta dhe pasuria e të cilëve ishte e rrezikuar nga bandat e të huajve, të cilët kishin një plan të fshehtë për të pushtuar qytetin dhe për të dëbuar të gjithë qytetarët e tij, duke iu marrë atyre shtëpitë dhe pasuritë.

Masat ishin: 1. Ndalohet dalja nga shtëpia pas orës gjashtë në mbrëmje. 2. Asnjë dyqan dhe tavernë nuk hapet pas kësaj ore. 3. Tavernat nuk mund t'u shesin klientëve të tyre verë pas orës dy të drekës. 4. Tregtia e sapunëve dhe e lëkurëve nuk lejohet. 5. Në shkolla nuk pranohen fëmijë nga lagjja e të huajve. 6. Mësuesit t'u tregojnë nxënësve se Voskopoja u sulmua nga disa të huaj dhe tregtarë të lidhur me ta, të cilët vranë pabesisht qytetarin e nderuar, mbrojtësin e Voskopojës, Marin Kurila. 7. Të gjithë nxënësit do të mbajnë, në shenjë kujtimi për Marin Kurilën, një shall të kuq të lidhur në qafë. 8. Asnjë burrë nuk lejohet të mbajë armë. 9. Këshilli i qytetit do të përbëhet nga 13 anëtarë. 10. Zgjedhjet për këshillin do të mbahen kur nëntë masat e para të jenë respektuar nga gjithë qytetarët.

Grigori u zverdh kur dëgjoi masat. Qyteti do shkatërrohet nëse këto masa zbatohen, u tha ai shokëve të Marin Kurilës dhe u kërkoi të mos i dëbonin fëmijët e lagjes së të huajve nga shkollat. Shumë shpejt nuk do ketë më lagje të të huajve, thanë ata dhe i kërkuan murgut të punonte shpejt. Megjithatë, Grigori bëri një ndryshim në masën e fundit. Djemtë i kishin diktuar të shkruante se zgjedhjet për këshillin do të mbahen kur nëntë masat e para të jenë zbatuar nga gjithë qytetarët, ndërsa Grigori e zëvendësoi fjalën *zbatuar* me *respektuar*. Shokët e Kurilës ishin gjithë kohën të zënë duke kontrolluar nëpër lagje dhe nuk e vunë re këtë ndryshim në lajmërimet që i ngjiten gjithandej brenda mënjesit. Kur e pyeta Grigorin se ku ishte ndryshimi mes zbatimit dhe respektimit, ai më tha se një masë e zbatuar është shumë më detyruese sesa një masë e respektuar. Ka njerëz që e respektojnë ortodoksinë dhe ata mbajnë kreshmë vetëm tri ditët e fundit përpara pashkës, ndërsa ata që e zbatojnë doktrinën e mbajnë kreshmën pa asnjë kompromis, për 40 ditë rresht. Ky është ndryshimi, tha Grigori. Për të parët, pashka vjen më shpejt, ndërsa për të dytët vjen më vonë.

Natën e parë të shpalljes së masave në lagjen e të huajve u dëgjuan armë dhe zjarret që dilnin nga tytat e tyre e shpuan tejprtej natën e gjatë të Voskopojës. Shokët e Marin Kurilës shkuan atje me ngut, por nuk zbuluan dot se kush kishte qëlluar. Nuk kishte të vranë dhe u tha se myslimanët kishin qëlluar për t'u thënë djemve me shall të kuq se ata nuk do t'i dorëzonin armët dhe se nuk i pranonin masat. Shokët e Marinit vunë gurë të mëdhenj në të gjitha hyrjet e lagjes së të huajve dhe disa prej tyre u caktuan të bëjnë rojë ditë e natë, duke mos lënë askënd të dilte jashtë. Por të shtënat vazhduan edhe natën tjetër si dhe shumë ditë me radhë. Thuhej se në lagjen e të huajve disa burra ishin organizuar dhe po bëheshin gati për të sulmuar. Tregtarët u frikësuan dhe shumë prej tyre filluan të mbledhin plaçkat dhe të largohen nga qyteti bashkë me familjet. Shtëpitë u mbyllën dhe magazinat me mall pothuajse u zbrazën. Kuajt e karvanëve u lanë të lirë dhe ata ishin të vetmit që bridhnin nëpër qytet pa iu bindur masave dhe orareve të ndalimit. Vdekjet u shtuan dhe doktorët, që mund t'i vizitonin të sëmurët vetëm gjatë ditës, thoshin se ishin shtuar sëmundjet e zemrës nga frika dhe pasiguria familjet i qanin të vdekurit gjithë natën me qirinjtë të vegjël dhe prisnin mënjesit për t'i varrosur. Dasmat u pakësuan dhe gjithnjë e më pak udhëtarët vinin në Voskopojë. Tavernat u mbyllën sepse askush nuk shkonte më atje. Pas ndalimit të sapunit gratë nisën t'i lajnë rrobat në lumë duke i fërkuar fort pas gurëve për t'u hequr njollat dhe erën e djersës. Fëmijëve që luanin nëpër shkolla nisën t'u hapen këpucët e përdorura, por lëkurë

për këpucë të reja nuk kishte. Këpucët e prishura i çonin te këpucarët dhe radha përpara dyqaneve të tyre u shtua. Ndërkohë, krismat në lagjen e të huajve nuk pushonin dhe armët filluan të zbrazen edhe ditën. Disa nga shokët e Marin Kurilës përfituan nga ikja e shumë tregtarëve dhe i hapën shtëpitë dhe depot e tyre dhe vodhën çfarë gjetën brenda. Duke qenë se ishin të vetmit që kishin të drejtë të lëviznin natën, ata ngarkonin sëndukë me plaçka, abazhurë të shtrenjtë, ora muri, filxhanë, pjata dhe lugë italiane që i merrnin nga shtëpitë e boshatisura duke i shpënë në shtëpinë e tyre. Bodrumet e tyre u mbushën me mall nga depot dhe kur njerëzit kishin nevojë të blinin ndonjë gjë, ata filluan të shisnin dhe të merrnin paratë.

Të ngopur me para dhe mall, djemtë kishin dëshirë të argëtoheshin. Vendosën të hapin një tavernë vetëm për vete në të cilën gjatë natës pinin verë me mish të pjekur. Vajzat, që më parë banda e sevdallinjve ua shiste udhëtarëve, i morën dhe pasi i vinin të kërcenin mbi tavolina i fusnin në një shtëpi të madhe bosh dhe flinin me to. Djemtë lodheshin gjatë ditës duke shitur mall dhe natën duke u kënaqur me vajza dhe me pije. Kontrollat nëpër qytet u zbutën dhe rojat e lodhur i zinte gjumi shpejt. Por shumë tregtarë kishin ikur dhe ushqimet në qytet u rralluan. Kripa, sheqeri, mielli e kafja u pakësuan dhe ato pak thasë që kishin vjedhur nga depot, djemtë i shisnin me çmime të larta. Nga sëmundjet dhe vdekjet e shpeshta, ilaçet mbaruan dhe myshku i thatë që përdornin plakat nuk i zëvendësonte dot. Letra e shtypshkronjës u harxhua dhe puna u ndërpre. Grigori dhe murgjit e tjerë u mbyllën në manastir dhe luteshin për ditë më të mira.

Një mëngjes, te trari në hyrje të qytetit shkuan pesë murgj. Ata i thanë djemve se donin të shkonin në Korçë për të marrë letër dhe disa ilaçe. Djemtë kërkuan t'i kontrollonin murgjit e ngarkuar me trasta të mëdha, por këta hapën pelerinat e zeza dhe nga poshtë tyre nxorën pisqolla dhe filluan të qëllonjë. Pesë shokë të Marin Kurilës mbetën të vranë dhe bashkë me ta dhe njëri nga murgjit. Katër të tjerë u zhdukën të hipur mbi kuaj. Kur kontrolluan murgun e vranë doli se ai ishte një mysliman nga lagja e të huajve që ishte maskuar me veladon. Në trup i gjetën dy pisqolla dhe tre breza me fishekë.

Atë natë, shokët e Marin Kurilës vranë dhjetë myslimanë, por nuk hynë dot në brendësi të lagjes së tyre. Myslimanët dilnin në dritaret e shtëpive të tyre, pas dyerve dhe mbi mure qëllonin si të çmendur. Për tri ditë në lagjen e të huajve u bë luftë. Qëllonin nga të gjitha anët dhe shumë njerëz u vranë sepse plumbat u hynin nga dritaret dhe i vrisnin në shtrat apo në tavolinë duke ngrënë bukë. Myslimanët ishin mbledhur dhe siç pritej kishin filluar sulmin. U mor vesh se katër murgjit e maskuar kishin zbritur në Korçë për të njoftuar turqit se një bandë kishte pushtuar Voskopojën duke dëbuar dhe duke vranë myslimanët. Disa nga shokët e Marin Kurilës u trembën kur dikush tha se pritej që turqit të vinin për të pushtuar Voskopojën. Ata morën familjet, ngarkuan kuajt me mallin që kishin vjedhur dhe ikën. Njerëzit filluan të ankohen dhe i akuzuan shokët e Marin Kurilës se pasi kishin shkatërruar qytetin tani po iknin duke i lënë në dorë të turqve. Thuhej se turqit do të vinin dhe do mbyllnin kishat, shkollat dhe shtypshkronjën dhe do caktonin një nga myslimanët si bej të Voskopojës, duke e zhdukur fare këshillin që qeveriste prej dyqind vjetësh. Paniku e rrënoi edhe më shumë Voskopojën. Me qindra njerëz u lëshuan mbi kuaj duke lënë në shtëpi vetëm pleq dhe plaka që nuk lëviznin dot. Duke ikur, ata shisnin për dy aspra shtëpitë, mobiljet, apo gjëra të tjera dhe çfarë nuk shitej, hidhej. Rrugët e lagjeve u mbushën me dërrasa, krevate, djepe, tavolina, kanistra tenxhere, pjata të thyera, dyshekë dhe rroba të palara, të cilat u bënë kopicë, duke bllokuar rrugicat. Askush nuk i pastronte më rrugët që ishin bërë pis dhe ishin mbushur me gurë dhe bajga kuajsh e kufoma qensh dhe macesh që kishin ngordhur nga uria. Myslimanët filluan të dalin nga lagja e tyre dhe bastisën shtëpitë e boshatisura, të cilat shpesh i pushtonin duke u vendosur në to. Shokët e Marin Kurilës ishin të frikësuar. Një natë, ata u mblodhën në shtëpinë e Marinit për të vendosur se çfarë do të bënin.

Atje filluan të zihen duke akuzuar njëri-tjetrin si fajtor për vjedhjet, shkatërrimet, për urinë dhe braktisjen e qytetit.

Dikur, njëri prej tyre, me shpatulla të gjera dhe shall të kuq, filloi të fliste dhe të gjithë pushuan duke e dëgjuar. Ky ishte Isaku, djali i motrës së madhe të Marin Kurilës. Isaku ishte më i gjatë dhe më i ri se Marini. Ai i mbante flokët e lëshuar mbi supe dhe mbi këmbët e bardhë bashkë me dy pisqollat kishte qëndisur dhe një K të madhe të që njerëzit thoshin se ishte në nderim të familjes së tij.

Isaku ishte një kokë më i madh se të tjerët. Kishte qenë student dhe Marin Kurila e kishte mbajtur pas kur dilte të takonte njerëzit nëpër lagje. Isaku mbante pelerinën e bardhë të Marin Kurilës, së cilës ia kishte pastruar gjakun. I ngjante dajës në bukuri, por ishte më i bardhë dhe më i qetë se ai. Që kur Marini ishte vranë, Isaku kishte drejtuar lagjen e armëtarëve dhe i kishte ndaluar shokët e tij të hapnin depot e armëve dhe të vidhnin nëpër shtëpitë e tregtarëve të lagjes. Isaku i lejonte mjekët të vizitonin pleqtë dhe të sëmurët gjatë natës dhe pastaj i shoqëronte ata deri në shtëpi për t'u siguruar se nuk i ngiste kush rrugës. Njëherë ai kishte gjetur në rrugë një mysliman të plagosur dhe e kishte çuar në shtëpi. Kur kishte hyrë në lagjen e të huajve duke e mbajtur të plagosurin në krahë, disa myslimanë i kishin drejtuar armën, por Isaku kishte vazhduar të ecte pa u trembur. Ia kishte dorëzuar djalin e përgjakur të atit të habitur dhe më vonë kishte dërguar një doktor për t'i hequr plumbat që kishte në trup. Atë natë myslimanët nuk kishin qëlluar dhe qyteti kishte qenë i qetë.

Por të nesërmen çdo gjë kishte nisur si më parë.

Kur Isaku u ngrit në këmbë, shokëve të tij iu duk sikur ishte ngjallur Marin Kurila. I kishte rënë një çehre e purpurt mbi fytyrë, ndërsa flokët e gjatë e tregonin më të vendosur dhe më trim se Marini.

Po të ishte Marin Kurila gjallë punët nuk do kishin ardhur në këtë pikë, foli ai dhe të tjerët heshtën. Marin Kurila donte të lartësonte dhe të mbronte Voskopojeën, kurse ju e përdhosët dhe sulmuat. Ai u nxitua, por ne e shtymë në greminë. Ai kishte një besim, por besimin e tij ne e përdorëm. Ai u nxitua kur vendosi të bëhej kryetar i këshillit, por ne duhet ta kishim kuptuar se zgjedhja e tij do t'i frikësonte tregtarët e sapunit dhe të huajt, siç ndodhi. Ne treguam se ishim tahmaqarë dhe nuk i folëm Marinit, i cili gaboi dhe e lexoi frikën e qytetit ndaj nesh si dashuri. Kjo i kushtoi jetën. Duhet të jemi të qartë se jo gjithë Voskopoja na ka dashur. Shumica e njerëzve na ka pasur frikë dhe nuk ka pasur besim te ne. Banditët dinë të sulmojnë dhe jo të mbrojnë, ndërsa Voskopoja kishte nevojë për mbrojtje dhe jo për sulm. Voskopoja ka qenë qyteti i diturisë. Dituria u shtua nga liria që kishin tregtarët për të blerë dhe artistët për të lexuar. Por këta i kanë frikë armët dhe qyteti mori tatëpjetën ditën që Marin Kurila tha se Voskopoja do ishte qyteti i armëve. Unë e nderoj guximin e Marin Kurilës, por ai u tregua naiv. Pasi ai vdiq, ne u bëmë të poshtër. Naivitetin e tij për një Voskopoje pa të huaj ne e kthyem në qëllim për një Voskopoje vetëm për vete. Sot, Voskopoja nuk është ajo që ishte dhe as ajo që duhej të ishte dhe, nëse vazhdon kështu, shumë shpejt do zbrazet. Myslimanët janë organizuar dhe kanë marrë zemër. Njerëzit kanë filluar të ikin të tmerruar dhe tregtia ka marrë fund. Fëmijët nuk shkojnë më në shkollë sepse prindërit nuk i lenë të dalin vetëm depot janë bosh dhe uria është në prag. Ne jemi kthyer në një tufë hajdutësh të cilët nuk beson më kush. Kemi vjedhur shtëpitë e të tjerëve, kemi shkatërruar depot dhe mallrat e tyre i kemi shitur sikur të ishin tonat. Spitali nuk ka më ilaçe dhe rrugët janë mbushur me kafshë të ngordhura. Taksat nuk mblidhen dhe këshilli nuk merr më vendime, sepse këshill nuk ka. Dhjetë masat që ne morëm nuk e ndihmuan qytetin, por ia vështirësuan jetën njerëzve. Ato duhet të ndryshojnë një orë e më parë. Këshilli duhej të ngrihej shpejt dhe qyteti të pastrohet. Duhet t'i kërkojmë myslimanëve paqe dhe t'i lejojmë

fëmijët e tyre të kthehen në shkolla. Tregtarët të fillojnë punën nga e para dhe askush nuk duhet të pengojë më tregtinë e tyre. Tavernat duhet të hapen dhe Voskopojes t'i kthehet qetësia dhe muzika. Të gjithë ne do dorëzojmë çdo gjë që kemi vjedhur dhe do t'i shpërndajmë njerëzve me racion ushqimet falas derisa të hapen dyqanet dhe depot të mbushen me mall të ri. Do t'u kërkojmë njerëzve të pastrojnë rrugët nga plehrat dhe kafshët e ngordhura. Do ta heqim trarin në hyrje të qytetit dhe të gjithë do lejohen të lëvizin të lirë. Do dorëzojmë armët dhe do t'u kërkojmë të gjithëve të bëjnë të njëjtën gjë. Do t'i dërgojmë fjalë atyre që kanë ikur, të kthehen dhe të vazhdojnë jetën qetësisht si më parë. Shumë shpejt do të bëjmë zgjedhjet dhe këshilli do të ngrihet dhe do të drejtojë qytetin. Duhet të bisedojmë me myslimanët përpara se të vijne turqit për t'i ndihmuar dhe për të na vrarë të gjithëve. Do nxjerrim nga burgu të gjithë ata që janë aty pa një vendim këshilli. Kur qetësia të jetë rikthyer ne do merremi secili me punët tona dhe banda jonë do të shpërndahet duke i bërë më në fund një nder Voskopojes.

Isaku u ul dhe pelerina e bardhë iu palos mbi gjunjët e fortë. Shokët e tij rrinin pa folur, por dukej se disave nuk i kishte pëlqyer ajo që ai kishte thënë. Ti po i kthen myslimanët në qytet, tha njëri prej tyre. Ata vranë Marinin dhe akoma nuk e kanë larë gjakun e derdhur.

Paqja e Voskopojes është më e çmuar se jeta e Marin Kurilës, tha Isaku. Në qoftë se nuk kthejmë paqen me çdo kusht, do rrezikojmë dhe jetët tona dhe jo vetëm kaq. Voskopoja do të zhduket nga faqja e dheut dhe ne nuk do jemi gjallë as për të ndezur një qiri për shpirtin e saj. Po pse duhet të bëjmë paqe me myslimanët kur mund t'i dëbojmë nga qyteti dhe të jetojmë si më parë, pyeti dikush. Isaku e pa me qetësi shokun dhe u përgjigj: Jetojmë në Perandorinë Turke dhe jo në Venedik. Kjo perandori është ngritur për të mbrojtur myslimanët dhe për t'i zgjeruar territoret e tyre siç ka ndodhur në treqind vitet e fundit. Voskopoja ka qenë e pastër për shumë vjet falë diplomacisë dhe jo luftës baballarët tanë u morën me tregti dhe me arte duke furnizuar perandorinë me mallra që turqit nuk i kishin. Kështu u pasuruan dhe e blenë me para paqen me turqit duke e mbajtur qytetin të paprekur dhe të pavarur. Por kjo paqe nuk mund të ishte e përjetshme sepse paratë nuk mjaftojnë kurrë për të blerë lirinë. Gjithë fshatrat përreth, që ishin më të varfër dhe më të paditur se ne, u kthyen në Islam dhe nga varfëria u shtuan dhe kërkuan të vijne këtu. Një ditë kjo do të ndodhte, siç ndodhi. Me luftë ne nuk i mundim dot turqit. Në qoftë se nuk duam ta humbim atë që kemi trashëguar duhet të kërkojmë paqe, duke e ndarë qytetin me ta. Përndryshe ne do të na zbojnë dhe qyteti do t'u mbetet atyre. Kush nuk do vritet do syrgjynoset dhe po të më pyesni se kë zgjedh nga të dyja, nuk e di kush është më e hidhur.

Ky është nënshtrim, u hodh njëri nga burrat. Ne jemi shumë afër fitores. Myslimanët janë akoma të dobët dhe nuk kanë shumë armë dhe ne mund t'i përzëmë nga qyteti. Marin Kurila donte t'i nxirrte ata nga këshilli dhe pastaj duke kontrolluar këshillin ne do t'ua kishim marrë atyre tokat dhe do t'i kishim dëbuar një herë e mirë nga Voskopoja. Paqja me ta nuk ka të ardhme sepse myslimanët asnjëherë nuk e kanë respektuar paqen me të krishterët, tha burri dhe disa të tjerë e përkrahën, por Isaku nuk i a të flisnin.

Ju jetoni në një ishull pa e ditur, filloi të fliste Isaku. Ishullarët janë njerëz të vetmuar dhe vetmia i ka bërë të mendojnë. Ata kanë vetëm një qëllim: sesi ta shpëtojnë ishullin e tyre nga stuhitë dhe pushtuesit. Për t'ia arritur kësaj, ata përdorin çdo dredhi dhe kur dredhitë nuk pinë më ujë përdorin luftën. Por lufta është arma e fundit që përdorin pasi i kanë ofruar të huajve paqen, qetësinë, strehimin dhe mënyrën e tyre të jetesës. Ka shumë udhëtarë që thonë se njerëzit e ishujve janë mikpritës. Në fakt, kjo është një dredhi që ata e kanë përsosur në mijëra vjet për të shpëtuar atë pak tokë që kanë nga deti dhe piratët. Ishullarët kanë një rregull. Ata i pranojnë të huajt dhe njerëzit që vijnë nga deti vetëm në qoftë se këta mësojnë notin. Pas notit ata u mësojnë të huajve peshkimin, pastaj i tregojnë si të ndërtojnë varka dhe anije, pastaj sesi të gatuajnë



peshkun, pastaj sesi të ngrenë diga për të zbutur egërsinë e detit që kafshon ishullin, pastaj sesi të presin gjatë dimrit duke u ushqyer me durim dhe pastaj sesi gjatë verës të ruajnë ushqim edhe për dimrin tjetër. Kur i huaji i ka mësuar të gjitha këto, ai pa e kuptuar është bërë një ishullar. Dhe ky ishullar i ri, pa e kuptuar, ka vetëm një qëllim: se si të ruajë të pavarur ishullin e vet duke përdorur mjeshhtërinë që të tjerët i mësuan atij. Voskopoja është një ishull i krishterë, i cili i ka shpëtuar deri sot pushtimit duke përdorur këto dredhi. Myslimanët këtu janë si të huaj. Në qoftë se i sulmon, ata do të sulmojnë sepse deti i ka hedhur në ishull dhe ata nuk mund të kthehen më pas. Luftën e fiton më kollaj ai që do të shkatërrojë, sesa ai që do të mbrojë. Të shkatërrosh është më e lehtë se të mbrosh dhe prandaj turqit deri më sot kanë pasur vetëm fitore në tokat tona. Njeriu që mbron është i kujdesshëm siç jemi ne, sepse ai nuk do që duke luftuar rrugët të prishen, shtëpitë të digjen, kishat të zbrazen dhe pasuritë të vidhen. Ai që shkatërron nuk i mendon këto sepse ai nuk ka asnjë ndjenjë për tokën që ka vendosur të pushtojë. E do me çdo kusht atë copë tokë, me shtëpi apo pa shtëpi, me kisha apo pa kisha, me njerëz apo pa njerëz. Në qoftë se ne vazhdojmë luftën, dashuria që kemi për qytetin, për çdo gur dhe sokak ku jemi rritur dhe jemi bërë burra do të na bëjë më të dobët. Myslimanët nuk kanë akoma dashuri për Voskopoje dhe ata janë gati të shkretojnë çdo gjë vetëm që të mbeten këtu. Ata e dinë se një qytet i shkatërruar është më mirë se mali apo fusha nga kanë ardhur dhe ku ata duhet të kthehen, në qoftë se humbin. Prandaj, miqtë e mi, unë them se ne duhet të sillemi si ishullarët. Duhet ta shpëtojmë ishullin tonë nga zhdukja, duke i mësuar të huajt të jetojnë dhe të sillen si ne. Duhet t'i bindim ata të besojnë se ne kemi vendosur t'i ndajmë pasuritë dhe artin tonë me ta. Në këtë mënyrë fëmijët e tyre do shkojnë në shkolla, ata do mësojnë se toka është ushqim i trupit dhe perëndia është një burim i shpirtit, do mësojnë zanatet tona, do bëhen bakërxhinj, këpucarë, sapunxhinj, jorganxhinj, kërcimtarë dhe në fund do bëhen voskopojarë. Kur t'i kenë mësuar të gjitha këto, ata nuk do kenë më interes të shkatërrojnë qytetin e tyre, por përkundrazi do luftojnë bashkë me ne për të mbrojtur sepse kështu do të mbrojnë shtëpitë dhe pasuritë e tyre.

E di që ju duket e pamundur dhe e padenjë, por unë shoh që tani ditën kur myslimanët do luftojnë për të mbrojtur kishat tona. Fëmijët e tyre do jenë ngrohur si zogjtë nën lëvozhgën e vezëve të ashkës dhe në verë kryqet e kishave do t'u bëjnë hije pleqve të përvëlur nga vapa. Le të mendojnë se Islami i tyre ngroh një jorgan, por unë jam i bindur se krishterimi ynë i begatë do t'u duket si një jastëk, mbi të cilin koka çlodhet duke parë ëndrra të bukura me bollëk dhe lumturi. Myslimanët e Voskopojes janë akoma si të huajt në ishull. Janë të egër, të hutuar dhe të uritur. Vetëm një gjë nuk mund ta pranojnë ata: të kthehen prapa duke rrezikuar të zhyten në thellësinë dhe pabesinë e detit. Në qoftë se u jep për të ngrënë, i jep një strehë dhe i mëson notin, ata do zbuten dhe do punojnë për të pasur ato që ne i kemi dhe që ata nuk i kanë, sepse nuk mund t'i sillnin me vete nëpër det.

Por ka edhe diçka tjetër. Myslimanët e Voskopojes janë shqiptarë siç jemi edhe ne. Gjyshërit e tyre kanë qenë të krishterë, por fshatrat ku ata kanë jetuar nuk kanë pasur pasurinë dhe diturinë e Voskopojes dhe prandaj ata u bënë myslimanë duke besuar se Islami do t'u jepte atë që u mungonte. Sot janë më të varfër, por nuk mund të kthehen më pas sepse Islami është shteti dhe shteti është ushtria dhe ushtria është forca dhe forca është trupi dhe trupi është shpirti dhe shpirti është Islami. Ata janë myslimanë, por akoma nuk janë turq. Në qoftë se ishullarët do t'i zbonin të huajt, ata e dinin se piratët do t'i merrnin ata dhe bashkë me ta do vinin të pushtonin ishullin. Në qoftë se ne i zbojmë shqiptarët myslimanë nga qyteti ata do shkojnë te turqit dhe të gjithë bashkë do vijnë dhe do na zbojnë ne nga Voskopoja. Kjo do të ishte një luftë e humbur. Kështu kanë gabuar shumë burra të mençur përpara nesh, pa e kuptuar se duke i quajtur turq, shqiptarët myslimanë, në fakt, i kanë hedhur ata si armë në duart e turqve. Me ato duar turqit kanë luftuar

dhe kanë pushtuar fshatrat dhe qytetet tona. Në të vërtetë shqiptarët kanë luftuar kundër shqiptarëve dhe njëra palë besonte se luftonte kundër turqve, ndërsa pala tjetër ngushëllohej se luftonte kundër grekëve. Kësisoj nuk ka mbetur asnjë pëllëmbë Shqipëri dhe kujtdo që fitonte i thuhej se fitoi si turk dhe kujtdo që humbte i thuhej se humbi ngaqë ishte grek. Voskopoja nuk është një ishull ku turqit luftojnë me grekët. Voskopoja është një tokë ku shqiptarët akoma nuk kanë arsye të luftojnë me shqiptarët. Familja ime ka pesëqind vjet që ka luftuar me turqit dhe ka mbetur shqiptare sepse ka mësuar artin e të jetuarit në ishull. Siç ju thashë, në ishull, duhet të dish të presësh të kalojë dimri duke u ushqyer me durimin tënd. Kur vjen pranvera, deti zbutet, qielli pastrohet dhe trupi i çlodhur e ushqen shpirtin e menduar. Atëherë njeriu e kupton se po të kishte dalë në det në dimër, ndoshta nuk do të ishte kthyer më në shtëpinë e tij dhe dallgët do ta kishin nxjerë në breg me sy të mbushur me rërë, që nuk e shijojnë dot diellin që shkëlqen dhe lartësohet. Ja pra, pse ia vlen të durosh, sepse turqit nuk janë një dimër i përrjeshëm. Ata kanë ndaluar përkohësisht në ishullin tonë. Do hanë, do pinë, do vjedhin, do rrëmbejnë, do mbjellin rrënjët e Islamit aty ku toka e pranon dhe pastaj do t'i hipin anijeve dhe do ikin. Rrugës do mbyten në det nga gjithë kjo peshë dhe ne do ta shijojmë këtë mrekulli në bregun e ishullit tonë. Pastaj do kthehemi në qytet dhe do pastrojmë rrugët, oborret, tavernat dhe shkollat. Tokën e shkelur do ta rimbjellim prapë, siç kemi bërë në shekuj.

Isaku pushoi, ndërsa sytë jeshilë i shkëlqenin si një gjethe në mëngjes. Burrat e tjerë nuk folën më dhe nisën të largohen një nga një. Duke dalë, njëri prej tyre, i cili ishte poet i tha: Nëse Marin Kurila ishte naiv, ti je romantik. Romantikët shkruajnë poezi në mes të luftës dhe prandaj humbin. Por unë zgjedh romantikët sepse në poezitë e tyre humbësit kanë gjithmonë të drejtë. Në qoftë se bën një poezi për mua, shkruaj që do doja të jetoja në një ishull ku njerëzit linden duke e ditur notin, siç dinë të shohin pa ua mësuar njeri, tha Isaku dhe buzëqeshi. Nuk e di a ka mbetur më letër për poezi në këtë qytet, tha poeti dhe u largua.

Isaku doli të nesërmen nga shtëpia pa pelerinën e bardhë. Pranvera kishte ardhur dhe ai ndjeu këmishën t'i largohej nga trupi si për t'i ikur nxehtësisë së mishit. Ishte një nga ato ditë të gjata pranvere që duken të shkurtra kur mendon për të punuar, por që asnjëherë nuk mjaftojnë për të mbaruar një punë. Kur filloi të ecte në rrugicën ku kishin vlarë Marin Kurilën, dielli ishte ngritur mbi pullaze dhe ai e ndjeu të nxehtë në faqe. Një djalë i vogël doli me vrap nga shtëpia dhe pas tij u duk e ëma që e thirri: Marin mos harro shallin. Është vapë, i tha djali dhe duke vazhduar të vraponte shtoi: mësuesit nuk na kërkojnë më ta mbajmë shallin të lidhur në qafë. Gruas i mbeti shalli i kuq në dorë dhe kur pa Isakun ajo e mblodhi shallin në grushtin e vet, sikur po fshihte një dëshmi. Isaku vazhdoi dhe në fund të rrugicës pa disa nga shokët e tij që po bisedonin, ndërsa shallët i vareshin mbi supe. Në Voskopojë duhet të hapen shkolla për të rriturit, mendoi ai dhe i thirri. Ata u mblodhën dhe Isaku i tha t'i grisinin shpalljet me dhjetë masat që ishin varur në të gjitha lagjet e qytetit. Djemtë panë njëri-tjetrin në sy dhe u shpërndanë duke i ndarë mes tyre lagjet ku do të shkonin. Njerëzit mblidheshin të habitur dhe djemtë me shall të kuq u thoshin se masat kanë ndryshuar dhe se në qytet mund të dilet edhe pas orës gjashtë të mbrëmjes. Shokët e Isakut morën karrocën e disa tregtarëve dhe nisën të pastrojnë rrugët nga kufomat e kafshëve, gurët dhe mobilet e hedhura nga ata që kishin ikur. Trau i madh në hyrje të qytetit u hoq dhe bashkë me të edhe pingu i gurëve që kishte bllokuar lagjen e të huajve.

Isaku shkoi te Grigor Jermonaku dhe i kërkoi të shtypte një lajmërim të ri. Nuk ka më letër për të mbuluar Voskopojën, tha murgu duke e parë Isakun me mosbesim. Më duhet letër për ta zbuluar Voskopojën, tha Isaku. Grigori nuk e kuptoi dhe Isaku i tha se ishte vendosur që dhjetë masat të ndryshonin. Shkruaj, i tha dhe filloi të fliste:

1. Voskopoja është pronë e gjithë qytetarëve të vet. 2. Të gjithë janë të lirë të dalin kur të duan dhe pa kufizim në Voskopojë. 3. Dyqanet dhe tavernat hapen për të gjithë. 4. Të gjithë fëmijët e Voskopojës pranohen në shkollë. 5. Mësuesit duhet t'i mësojnë fëmijëve se trazirat në qytet ndodhën për shkak të anulimit të zgjedhjeve. 6. Asnjë burrë nuk lejohet të dalë i armatosur në rrugë pa lejen e Këshillit të qytetit. 7. Lirohen nga burgu të gjithë ata që janë aty, pas fillimit të trazirave. 8. Në Voskopojë qytetarët janë të lirë të shesin dhe të blejnë çdo mall që u duhet. 9. Këshilli i qytetit do të përbëhet nga katërmëdhjetë anëtarë. 10. Zgjedhjet për Këshillin e qytetit do të mbahen për një muaj.

Grigor Jermonaku u ngashërye dhe ia shtrëngoi duart e ftohta Isakut. Ti i hape dyert e Voskopojës dhe tani engjëjt do kthehen prapë në qytet, tha Grigori. Mund të kthehen kur të duan madje edhe pas orës gjashtë, foli Isaku dhe iku.

Të nesërmen, dhjetë masat e reja u varën nëpër mure, aty ku masat e vjetra kishin lënë një njollë djerse. Njerëzit u mblodhën për t'i lexuar dhe fëmijët filluan të vrapojnë duke i thënë prindërve të tyre se rrugët ishin hapur dhe oraret kishin ndryshuar. Isaku doli nëpër lagje dhe i tha njerëzve se tani ata duhet t'i ktheheshin punës, kishës, shkollave dhe tregtisë dhe se mund të shkonin prapë në taverna. Furrat e bukës u hapën dhe disa tregtarë morën karvanët dhe u hodhën në Korçë për të blerë miell, kripë, verë dhe ilaçe. Rrugicat u pastruan dhe studentët nisën të mbushin tavernat pas mesnate. Krismat në qytet ishin rralluar megjithëse nga lagjja e të huajve dëgjoheshin herë pas here të shtëna gjatë natës. Isaku shkoi vetë në shkollë dhe i pyeti mësuesit nëse fëmijët e lagjes së të huajve kishin filluar të vinin. Akoma jo, i tha njëri nga mësuesit. Nuk u ka dalë frika dhe mendojnë se kjo është një hile për t'i nxjerrë ata nga lagjja dhe pastaj për t'i ndëshkuar e për t'i dëbuar fare nga qyteti. Myslimanët thonë se nuk mund t'i besojmë nipit të Marin Kurilës.

Isaku mori disa nga shokët e tij dhe shkoi në burg. Dhjetë djem me shalle të kuq rrinin te dera dhe Isaku u kërkoi çelësat. Hapi derën dhe i tha atyre që ishin brenda të dilnin. Një nga një, njerëzit e palarë dhe të pangrënë dolën në diell duke mbajtur duart mbi sytë e pamësuar nga drita. Në krye të tyre qëndronte një burrë i gjatë me flokë të verdhë të ndara në mes, i cili kur doli jashtë, zbathi këpucët, përveshi pantallonat, u ul në gjunjë dhe filloi të falej. Pas tij u falën edhe burrat e tjerë. Ndërkohë që ata faleshin, disa nga shokët e Isakut kthyen kurrizin për të mos i parë, por ai i bëri shenjë dhe ata u kthyen prapë duke dëgjuar në heshtje fjalë arabisht që nuk i kuptonin. Isaku priti sa u mbaruan dhe kur burri i gjatë u ngrit duke pastruar gjunjët ai e pyeti si quhej.

Unë jam Sali Benishi, tha burri pa e parë Isakun në sy. Je i lirë të shkosh në shtëpi, tha Isaku. Mund t'i dërgosh fëmijët e tu në shkollë dhe të punosh për të fituar bukën tënde. Askush nuk do të të burgosë, nëse nuk vjedh dhe nuk vret. Thuaji të gjithëve se në Voskopojë asnjëri nuk burgoset se është mysliman.

Burri ngriti kokën, por çehrja e tij e verdhë nuk ndryshoi. Të krishterët na burgosën, por Allahu na shpëtoi, tha Sali Benishi. Unë i falem vetëm atij. Falu, por mo sharro të punosh, në Voskopojë ka vend edhe për Zotin tënd, tha Isaku dhe u largua. Sali Benishi mbeti në këmbë dhe Isaku ndjeu mbi kurriz sytë e tij të ftohtë që iu ngulën si thikë.

U kthye dhe i tha: Do takohemi prapë Sali Benishi.

Brenda disa ditësh, Voskopoja u pastrua nga pluhurat dhe filloi të shkëlqente. Pranvera dhe masat e reja i kishin çelur njerëzit që zgjoheshin herët dhe flinin vonë. Gratë i lanë rrugicat e pista duke derdhur ujë me kova dhe vajzat i kruan një nga një gurët e ndotur të kalldrëmeve.

Një të premte në drekë, një karvan i madh me sapun mbërriti në qytet pas shumë muajsh. Gratë u sulën te depot e sapunit dhe u kthyen në shtëpi me mësallat të mbushura me kallëpe të verdhë, të prerë në formë kutish. Për disa ditë gjithë qyteti mbajti era sapun. Gratë i zhveshën burrat dhe fëmijët e tyre dhe i detyruan të rrinë në shtëpi derisa ato të lanin rrobat dhe pastaj t'i thanin, duke i nderur në diell. Burrat e zhveshur nga këmishët dhe pantallonat dilnin në dritare dhe prej andej bisedonin me njëri-tjetrin. Krahët lakuriq u vareshin në majë të avllive, ndërsa këmbët pa pantallona dukeshin më të dobëta. Megjithëse të zhveshur, ata nuk i ndërprejnë bisedat dhe duke folur me njëri-tjetrin në distancë u bërtisnin grave, të cilat ishin përkulur mbi rrobat e tyre në oborr duke hequr me sapun, me ujë dhe me shkumë djersët e thara të kohës së trazirave. Fëmijët ishin më të paturpshëm. Ata vazhduan të dilnin në rrugë me brekët e tyre të gjata, të cilat, kur rrezoheshin, u griseshin duke u nxjerrë në shesh mollaqet e kuqe të rrumbullakëta. Kur burrat dolën pas dy ditësh, këmishët, xhaketat, jelekët dhe pantallonat e tyre dukeshin si të reja. Si njerëz të etur që sapo kanë dalë nga deti, ata u sulën nëpër taverna, por, megjithatë, era e verës nuk e mundi dot erën e sapunit që vazhdoi gati për dy javë të shponte hundët e Voskopojes.

Pasi i lanë dhe i thanë burrat, gratë u lëshuan nëpër livadhe duke mbledhur myshk. E këpusnin filizin e njomë me dy gishta dhe pluhuri që ngrihej në ajër u zbriste mbi flokë dhe në gushë dhe nga larg ato dukeshin si hije bojëvjollcë. Isaku i shikonte nga dritarja e shtëpisë dhe ato i ngjanin si një pikturë me flutura që ushqehen pas gjumit të dimrit.

Qyteti ishte i qetë. Tregtarët i kishin mbushur depot me mall, ndërsa zanatçinjtë i mbushën dyqanet me njerëz. Meshat e pashkës së prillit kishin nisur dhe priftërinjtë këndonin liturgjitë duke shkundur hundët nga myshku i rrobave të grave që bënin kryq me kryet përmbysur. Shalli i kuq i marin Kurilës ishte ende i varur mbi kryqin e madh të katedrales nga ku mund të shihej prej çdo shtëpie. Të huajt dhe myslimanët i kishin kthyer fëmijët nëpër shkolla, por këta nuk i mbanin kurrë shallat e kuq në qafë. Një mik, që priste djalin te dera e shkollës, i kishte thënë Isakut se fëmijët myslimanë dalloheshin sepse ishin të gjithë pa shall. Ditën që gruaja ia lau shallin, djali i tij nuk pranoi të shkonte në shkollë. Më quajnë mysliman, i kishte thënë të atit.

Ndërkohë, shokët e Isakut i kthyen mobiliet dhe orenditë që kishin marrë nga shtëpitë e braktisura. Isaku dilte çdo ditë nëpër qytet dhe rrugët i dukeshin më të mëdha. Ai takonte njerëz, i jepte dorën grave që pastronin sokakët, bisedonte me burrat dhe luante me fëmijët. Këta e ndiqnin nga pas dhe i kërkonin t'u tregonte pishqollat. Nuk më duhen, thoshte Isaku dhe djemtë i shikonin me habi. Në Voskopoje gjahu i njerëzve është i ndaluar. Fëmijët nuk e kuptonin Isakun dhe ai përfitonte nga stepja e tyre dhe vazhdonte rrugën. Në darkë shkonte në tavernë ku mblidheshin shokët e tij, studentët dhe poetët. Riti i recitimit mbi tavolina ishte rikthyer dhe vera e bënte leximin më ritmik. Poetët ishin të vetmit që kishin përfituar nga ditët e trazirave dhe tani mbanin radhë nëpër taverna, për të lexuar vargjet që kishin shkruar kur rrugët ishin mbushur me kufoma kafshësh dhe kur qielli ndizej nga krismat e natës.

Një natë, poeti që e kishte quajtur romantik, iu afrua Isakut me një gotë verë në dorë, me këmishë të zbërthyer dhe me balluket e gjata që i mbulonin sytë. E kam bërë atë poezinë me ishull, tha ai, por e kam bërë për vete dhe jo për ty. Në ishull ka vend për të gjithë ata që dinë not, ia ktheu Isaku duke i hedhur dorën mbi sup. Ta recitoj, e pyeti poeti dhe Isaku afroi një karrige dhe i bëri shenjë shokëve që të pushonin. Poeti hipi mbi karrige dhe dikush i afroi një qiri. Taverna u errësua, ndërsa koka e poetit ndriçoi si një diell i varur në tavan. Poeti qëndroi një çast pa folur dhe diku ngriti dorën lart dhe filloi:

Jam ulur mbi diell

dhe shoh ishullin e shpirtit tim,

hëna ndriçon kur ishulli fle.  
Jam ulur mbi hënë  
dhe prek ishullin e trupit tim,  
një vashë vizaton mbi rërë një njeri që noton.  
Jam ulur mbi ishull  
dhe shquaj detin që tund veten në djep,  
dallgët ngrihen mbi hënë që mbytet  
dhe njeriu shtrihet mbi rërë si kryq.  
Jam ulur mbi kujtimet e mia  
dhe shoh veten mbi det,  
mësova notin për të ardhur në ishull,  
e harrova, për të mos ikur.  
Jam ulur mbi det  
dhe shoh ishullin tim,  
sa e pamundur të jetosh në ishull,  
sa bukur të vdesësh atje.

Poeti fshiu buzët, si për të zhdukur një gjurmë që mund të kishte lënë aty poezia, zbriti nga karrigia dhe u ul. Kishte dalë nga rrethi që ndriçonte qiriu dhe tani ishte në errësirë. Isaku ngriti dorën dhe qirinjtë u ndezën. Poeti rrinte i mbështetur në karrige dhe krahët i ishin varur poshtë si një të mbyturi. E bukur, por e dhimbshme, tha Isaku. Zbrit nga hëna se atje nuk ka vend edhe për ty edhe për Muhamedin dhe hajde të notojmë bashkë në një gotë verë. Poeti ngriti kokën dhe tha: Unë jam i mbytur, si të notoj? Ti ke shpëtuar sepse ke ardhur në ishull, u përgjigj Isaku dhe i zgjati gotën e verës. Por poeti nuk e pa gotën sepse sytë i kishte të mbuluar nga balluket ose ndoshta ngaqë nuk e kishte mendjen atje. Dora e Isakut mbeti e zgjatur në ajër dhe poeti tha: Të dy kemi ardhur në ishull, por ti ke ardhur për të jetuar, ndërsa unë për të vdekur. Isaku u ngrit, e përqafoi dhe i afroi gotën te buzët. Atë natë poeti piu deri në harrim. Kur e çuan në shtëpi duke e mbajtur në krahë, para se të flinte ai tha: Sa bukur të vdesësh në ishull.

Ato ditë shumë familje u rikthyen në qytet. Por jo të gjithëve u kishte dalë frika nga ditët e trazirave. Shumë prej tregtarëve kishin ikur në Korçë dhe atje kishin marrë shtëpi duke vazhduar tregtinë. Por Korça ishte një treg armiqësor për voskopojarët. Atje, turqit vendosnin për çdo gjë. Tregtarët që ktheheshin tregonin se Korça i ngjante Voskopojës në ditët e trazirave. Pazari ishte i mbushur me baltë ku të zhyteshin këmbët gjer në gju, ndërsa lypësit vidhnin dhe i shponin thasët me thika. Turqit zgërdheshin dhe u kërkonin tregtarëve para për çdo kafshë të ngarkuar me mall. Në mbrëmje, rrugët ishin të pasigurta dhe vajzat e gratë nuk mund të dilnin të vetme. Tregtarët që u kthyen i thanë Isakut se në Korçë flitej se turqit kishin vendosur t'i jepnin fund pavarësisë së Voskopojës dhe se ata po armatosnin fshehurazi myslimanët për t'i përgatitur për sulmin. Që kur trau në hyrje të qytetit ishte hequr, karvanët që vinin në qytet nuk kontrolltoheshin më. Djemtë me shall të kuq i kishin thënë Isakut se burrat e maskuar si murgj që kishin vrarë rojat ishin kthyer në qytet të ngarkuar me armë që i kishin shpërndarë në lagjen e re. Myslmanët po armatosen, i tha një nga djemtë Isakut. Duhet t'i mbajmë armët dhe të rinisim kontrollin në qytet.

Por Isaku kundërshtoi. Qyteti po rilind, tha ai. Kjo rilindje është fryt i besimit. Njerëzit po kthehen në punë, burat po vazhdojnë tregtinë, fëmijët shkojnë në shkollë, gratë ndjekin meshat dhe myslimanët nuk kanë frikë. Të gjithë besojnë se Voskopojës mund t'i kthehet shkëlqimi që ka pasur. Ne i kemi thënë njerëzve që Voskopoja do të jetë një qytet pa armë dhe ata na kanë

besuar. Por në qoftë se ne i ndryshojmë dhjetë masat atëherë edhe të krishterët edhe myslimanët do ta humbin besimin te ne dhe do na quajnë një bandë që kërkon të zaptojë qytetin. Duhet t'i qetësojmë njerëzit derisa të mbahen zgjedhjet dhe kur të ngrihet Këshilli i ri të gjithë do binden si më parë.

Ishte mesnatë. Isaku hodhi vështrimin nga dritarja dhe pa sesi qielli mbi lagjen e myslimanëve mbushej me zjarre, të cilat ushqeheshin me barutin që shpërndanin tytat e armëve të panjohura. Isaku nuk lëvizti, por ndjeu se ato rrufe, që vinin nga toka dhe jo nga qielli, po i vrisnin sytë. Megjithatë mbeti ashtu pa lëvizur derisa shokët e tij u larguan një nga një nëpër natë. Ai i shikonte si ecnin nëpër rrugicë, me kokat ulur dhe duart e gjata, që dukeshin si armë të pambushura.

Isakun e zgjuan në të gdhirë dhe i thanë se muret e qytetit ishin mbushur me disa vizatime të profetit Muhamed. Isaku u mbath shpejt nëpër gjumë dhe doli bashkë me diellin. Para se të nisej futi dy pisqolla në brez. Muret e bardha, afër lagjes së myslimanëve, nxinin. Ata që i kishin vizatuar duhej të kishin duar të shkathëta dhe të stërvitura me portrete njerëzish.

Fytyra e Muhamedit ishte e njëjta me të gjithë vizatimet, por pozicionet e trupit ishin të ndryshme. Flokët i kishte në ngjyrë të çelët dhe të ndara në mes, ndërsa hundën e kishte të gjatë dhe veshët të vegjël. Faqet dukeshin të mbushura, si të një njeriu të ushqyer mirë. Sytë e profetit ishin të vegjël dhe shkëlqenin si ato të dikujt që bën një pyetje duke e ditur se tjetri nuk e di përgjigjen.

Në vizatimin e parë, Muhamedi i kishte hipur mbrapsht një deveje të dobët dhe të lodhur, ndërsa në dorë mbante një gotë verë të mbushur plot. Deveja tundej, por vera nuk derdhej dhe profeti e shtrëngonte gotën fort me gishtërinjtë e tij të mbushur me unaza. Mbi kokë kishte një çallmë ngjyrëvjollcë, që ishte një bojë të cilën piktorët e qytetit e nxirrnin nga fletët e thara të myshkut. Muhamedi buzëqeshte nga muri dhe dukej sikur thoshte: Deveja tundet pa u dehur.

Disa hapa më tutje ishte një vizatim më i madh. Profeti ishte shtrirë shend e verë në kurriz dhe ishte i zhveshur nga mesi e lart. Tri gra e ledhatonin duke parë me smirë njëra-tjetrën, si rivale. Njëra prej tyre, që dukej më e re, i fërkonte barkun, tjetra i mbante me kujdes këmbët e zbatshura dhe e treta i kishte afruar gojën e hapur te veshi, sikur diçka i pëshpëriste kundër dy grave të tjera. Kjo grua dukej dhe më e lumtur dhe profeti në atë çast i ishte dedikuar asaj, por pa harruar kënaqësinë që i vinte nga fundi i barkut dhe nga këmbët. Çallma e profetit ishte po ajo, por ngjyra e saj vinte në të verdhë si ngjyra e shkretëtirës dhe nga kjo kuptohej se ngjarja zhvillohej në natyrë dhe jo brenda një shtëpie. Nga të tri gratë, ajo që i fërkonte barkun ishte më e re dhe shumë e bukur, por nuk arrinte dot të fshihte xhelozinë kur shikonte që dora e saj nuk i jepte profetit zjarminë që i jepte veshi i njomur nga gjuha e gruas tjetër. Gruaja që zgjatej te këmbët kishte një nishan në faqe dhe flokë të gjatë dhe të zinj që i derdheshin mbi trup, ndërsa e treta, ajo që i fliste në vesh kishte gjinj të mëdhenj që i kërcenin mbi këmbët e zbërthyer dhe një dorë e Muhamedit ishte drejtuar atje, por pa arritur t'i kapte dot. Muhamedi, megjithëse i shtrirë, dukej me pak bark, por shpatullat i kishte të mëdha dhe mbi gjoks qimet i ishin ngritur gjithë epsh.

Mbi një mur tjetër, në cepin e një shtëpie në të cilën banonte një kazanxhi i vjetër, profeti Muhamed ishte vizatuar duke ecur në një rrugë, nga dy anët e të cilës dalloheshin minare të vogla. Binte shi, por profeti mbante një pe të gjatë në dorë, me të cilin kishte lidhur një re të zezë që e tërhiqte nga pas, si një çadër. Poshtë minareve ishin fshehur njerëz, të cilët, duke u qullur nga rrebeshi, shikonin profetin që bënte shëtitje në shi, pa u lagur, duke e tërhequr renë pas vetes si një dele që ecën në qiell.

Vizatimi tjetër tregonte profetin duke lexuar Kuranin. Ai ishte kërrusur mbi librin dhe sytë e tij shikonin mbi kapak sikur donin t'i bënin një pyetje kalimtarësh. Muhamedi dukej i zgjuar, por dinak. Mbi kapakun e librit shkruhej: *KURANATA*, që Isaku e lexoi ngadalë si: Ku ra nata? Ne të gjithë e dimë përgjigjen, tha njëri nga shokët e Isakut pasi e lexoi pyetjen me zë. Isaku nuk fliste dhe vazhdonte të shikonte fytyrën e Muhamedit. Se me kë ngjan, mendoi dhe u kthye për të parë edhe një herë të gjithë vizatimet, por burri që lexonte Kuranin nuk i ngjante asnjërit prej Muhamedanëve të tjerë, të cilët nuk dukeshin dinakë, por të kënaqur dhe shumë të shpenguar. Kishte zbardhur dhe njerëzit kishin nisur të dalin nga shtëpitë. Disa gra u mblodhën përpara vizatimit ku Muhamedi ishte me tri gratë e tij dhe filluan të qeshnin. Isaku u largua dhe dëgjoji gratë që shikonin Muhamedin, ndërsa njëra prej tyre i tha shoqeve: Me se i ushqen kaq shumë gra?

Deri në mesditë vizatimet i kishte parë shumica e burrave dhe grave në qytet. Ata mbanin radhë dhe shtyheshin me bërryla duke hapur rrugën drejt vizatimeve. Fëmijët e vegjël futeshin në mes të të rriturve dhe pasi iknin u tregonin të tjerëve ato që ata akoma nuk i kishin parë për shkak të dyndjes. Pasdite u hap fjala se një grup myslimanësh të armatosur po vinin te vizatimet. Njerëzit vrapuan të hyjnë nëpër shtëpi dhe burrat qëndruan pas dyerve, ndërsa gratë shikonin rrugën të fshehura pas perdeve. Isaku i tha shokëve të tij t'i linin myslimanët të afroreshin, pa i penguar. Kur rruga mbeti bosh, një zhurmë hapash të rëndë u ngriti mbi lagje dhe tridhjetë burra të armatosur, në krye të të cilëve qëndronte Sali Benishi, mbushën rrugicat e ngushta.

Sali Benishi i kaloi vizatimet një nga një duke shtrënguar dhëmbët dhe në fund pështyu në tokë dhe ngriti kokën drejt qiellit. Të prishen, i tha shokëve dhe iku. Burrat morën gurë dhe hekur dhe nisën të prishin trupat dhe fytyrat. Gota me verë dhe libri i profetit u zhdukën që në fillim dhe pastaj me radhë gratë, devetë, minaret, çallmat dhe shkretëtira.

Kur ra nata, *KURANATA* nuk dukej më mbi muret e gërvishtur që ngjanin si qilima të përdorur dhe të ngrënë nga mola. Siluetat e prishura të Muhamedit ndriçoheshin nga hëna dhe dukeshin si hije të gdhendura në mur. Sali Benishi nuk doli nga shtëpia. Burrat erdhën dhe i thanë se i kishin prishur të gjitha vizatimet. Ata rrinin këmbëkryq në dhomën e madhe të shtëpisë së tij, por Sali Benishi heshte. Flokët e ndara në mes i kishin rënë mbi ballë dhe buzët e holla lëviznin vazhdimisht, sikur flisnin pa zë. Dikur ai ngriti kokën dhe tha: Nuk mjafton të vrasësh, duhet të dish pse. Burat e tjerë nuk folën dhe ai thirri dy prej tyre dhe i tha të niseshin për në Korçë për të takuar një hoxhë. Kur ata dolën, Sali Benishi mbeti vetëm.

Nata mbuloi qytetin. Nën lehjet e qenve të rrugës, Voskopoja dukej edhe më e vetmuar. Sali Benishi dëgjoji një copë herë piskamat e shpeshta që vinin nga rruga dhe qentë iu dukën më të frikësuar se në netët e tjera. Duket sikur po i ndjek hija e profetit, mendoi. Fiku qirinjtë e dhomës ku flinte dhe u shtri bashkë me hijen e tij.

Kur ishte i vogël, në fshatin e tij buzë malit kishte mësuar të zhdukte hijet.

Shtrihej në tokë dhe hija fshihej poshtë trupit të tij. Bëhej njësh me pemën dhe hija hynte në lëvoren e trashë dhe nuk dilte prej andej, derisa ai të lëvizte gishtin. Kridhej në përrua dhe hija mbytej në ujë dhe pastaj dilte e lagur dhe e mërdhirë për ta ndjekur lakuriq në kërkim të diellit. Gjatë ditës, ai priste me durim, si një orë natyrore, çastin kur dielli dhe hëna ndriçonin njëkohësisht. Atë moment në botë nuk kishte asnjë hije. Ai rrinte mbi një pllajë të vogël mbi fshat dhe shikonte oxhaqet e lartë, minaren e fshatit, kafshët që ktheheshin nga kullotat, arrat e mëdha që ngriheshin mbi muret e trashë, burrat e veshur me të zeza që dilnin për namazin e darkës dhe gratë që rrinin në oborr duke larë ploçat e verdha të pasdites. Të gjithë dukeshin të vetmuar. Hijet i kishin braktisur. Dielli dhe hëna nuk i lëshonin rrugë njëri-tjetrit dhe hija e njërit

asgjësonte hijen e tjetrit. Ai ngrinte kokën lart si një ujë që kërkon një sinjal dhe priste me durim hijen e tij. E dinte se, pas pak, ajo do të afrohej në drejtim të kundërt me hënën dhe pasi t'i hynte në trup dhe të merrte formën e tij do të dilte prej andej e hollë, opake dhe e bindur për ta ndjekur deri të nesërmen në të njëjtën orë, kur do të zhdukej prapë pasi të kalonte nga dielli te hëna.

Pse e ka bërë Zoti hijen, e kishte pyetur një ditë një shoku i tij. Që të na provojë se në botë ka dritë, i tha ai. Po si zhduket hija, kishte vazhduar shoku. Kur botën e ndriçojnë dy drita njëkohësisht atëherë hija zhduket sepse ajo nuk mund t'i shërbejë dy padronëve në të njëjtën kohë. Zoti është një dhe në botë nuk mund të ketë dy drita. Po pse kur dielli dhe hëna janë mbi qiell hijet zhduken, kishte pyetur shoku. Në këtë kohë gjithë hijet e botës shkojnë nga dielli te hëna dhe derisa vazhdon ky kalim, mbi tokë nuk ka asnjë hije, kishte thënë ai. Ka ndonjë trup pa hije në botë, kishte vazhduar shoku. Po, tha ai duke ngritur kokën lart. Tri gjëra nuk kanë hije. Zoti, të vdekurit dhe fëmijët në barkun e nënës. Po pse këta të tre nuk kanë hije, pyeti shoku. Sepse këta të tre nuk i sheh dot askush.

Dielli po binte ngadalë mbi horizont dhe ai i tha shokut të kthehej me fytyrë nga hëna. E ndien si po të hyn hija në trup, e kishte pyetur. Jo, i kishte thënë djali. Ndiej vetëm një ftohtësirë mbi lëkurë. Janë këmbët e hijes, kishte thënë ai. Ajo ecën lakuriq mbi lëkurën tënde, i merr erë, pastaj mat gjatësinë, peshën, moshën, numëron gishtat, qimet e flokëve, largësinë e veshëve nga hunda, trashësinë e qafës, gjerësinë e shpatullave dhe boshllëkun mes këmbëve dhe pasi i lexon të gjitha këto, del nga trupi pa bërë asnjë gabim. Hija është sipërfaqësore. Asaj nuk i duhet sa herë rreh zemra jote, a është i mbushur stomaku yt, a marrin frymë mushkëritë, a kanë ujë veshkat e tua dhe a mendon koka jote apo jo. Hija ka vetëm dy përmasa: gjatësi dhe gjerësi. Ajo nuk ka thellësi dhe nuk tregon nëse je i gëzuar apo i trishtuar, i kamur apo i varfër, i ngrënë apo i pangrënë, i drejtë apo i mbrapshtë, i krishterë apo mysliman, punëtor apo dembel, i mençur apo i metë, i qetë apo nevrik, i martuar apo beqar. Hija tregon vetëm nëse je i gjallë apo i vdekur. Hija është i vetmi vizatim në botë që ecën. Të gjitha vizatimet e tjera mbeten siç janë bërë, ndërsa hija lëviz dhe ndryshon, sepse hija është vizatimi që na bën Zot sa herë që na sheh. Zoti na sheh pa pushim dhe prandaj hija nuk na ndahet. Zoti nuk na sheh më kur ikim nga kjo botë dhe prandaj kur vdesim nuk kemi hije. Zoti i mjafton që jemi gjallë prandaj vizatimi i tij nuk tregon nëse jemi mirë apo keq, nëse jemi të lumtur apo të mërzitur, nëse jemi të ushqyer apo të uritur, të nginjur apo të etur, besimtarë apo të pafe. Zoti na ka sjellë në jetë, por jetën duhet ta rregullojmë vetë. Ai e ka bërë hijen tonë si një vizatim pa ngjyra, ndërsa vizatimet e tjera që bëjnë njerëzit kanë ngjyra dhe ato rrëfejnë lotët, të qeshurën, mërzinë, shpresën, varfërinë, unazat, dhëmbët, krenarinë, poshtërimin dhe besimin.

Shoku e dëgjonte me sy të mbyllur, i kthyer me fytyrë nga hëna. Hapi sytë, i tha ai. Djali hapi sytë dhe pa hijen që i rrinte pas. Fshati, poshtë këmbëve të tyre, ishte errur dhe hija e minares së gjatë përplasej mbi hënën. Dielli ishte zhdukur dhe ata zbritën në fshat.

Ai kishte mbetur jetim kur ishte shumë i vogël. Të atin nuk e kishte njohur. E ëma shkonte për dru në pyll dhe e merrte me vete. Nën zhurmën e sëpatave ai shihte të ëmën si dobësohej, si i bëheshin duart me kallo dhe flokët që i zbardheshin. Ajo vdiq në pyll. Një barë dru e zuri mbi vete dhe i mori shpirtin. Atë e rriti gjyshi që e çonte në pyll të mblidhte shkarpa dhe kur u forcua filloi t'i priste vetë drutë, t'i barabiste dhe t'i sillte në fshat, në fillim me krahë dhe pastaj me mushka. Një ditë u zu me disa djem më të rritur nga fisi më i madh i fshatit. Ata e zhveshën dhe e goditën me stape të gjatë në trup. Nga goditjet, i rrodhi gjak nga hundët dhe i mbeti një shenjë në kurriz. Kur plaga u mbyll në mes të shpatullave i mbeti një shenjë, në formë molle. Plaka që e mjekoi ia pa vrugën e tharë dhe i tha gjyshit se djali kishte në shpinë shenjën e profetit. Kur vdiq



dhe gjyshi, ai mbeti vetëm. Bënte dru për të tjerë dhe ushqejej keq. Fisi më i madh i fshatit kishte zaptuar shumicën e pyllit dhe nuk i linte të tjerët të prisnin dru.

Kur mbeti pa pyll, ai hyri në punë te Hatixheja, një grua e ve, e cila kishte trashëguar disa ngastra pyll nga i shoqi që kishte vdekur. Ai ngrihej herët, shkonte në pyll, priste dru dhe kur kthehej në fshat pastronte oborrin e shtëpisë së vejushës, ushqente kafshët dhe flinte në haur. Hatixheja bleu disa parcela dhe pylli i saj u rrit. Ajo filloi të shiste dru në qytet dhe i besoi atij karvanët me mushka. Ai mori disa djem të vegjël që bënëin dru dhe vetë shkonte në qytet hipur majë mushkave, në dimër dhe në verë. Ato vite bëri shumë ftohtë dhe çmimi i druve u rrit. Karvanët u shtuan dhe Hatixheja bëri para me të cilat e zgjeroi shtëpinë dhe i tha atij një dhomë të vogël me një mangall që ngrohte muret e bardha dhe këmbët e tij të lagura dhe të djersitura nga rruga.

Hatixheja ishte pesëmbëdhjetë vjet më e madhe se ai. Kur kishte qenë e re ishte mbajtur si një grua e bukur, e bëshme, me vithe të gjera dhe me gjinj të kërcyer. Tani flokët i ishin thinjur pak te tëmthas, por lëkura ishte ende e pastër dhe sytë e zinj e tregonin edhe më të ndjeshme. Ishte nga ato gra, të cilat e kthejnë moshën në pjekuri dhe pjekurinë në nxehtësi. Kur ai ngarkonte karvanët herët në mëngjes, Hatixheja dilte në dritare me një këmishë të bardhë, e cila i hapej pak duke i treguar qafën e bardhë dhe gjinjtë e fryrë nga vetmia. Ai e shikonte dhe fërkonte mushkat që ngroheshin nga dora e tij. Kur kthehet, pas disa ditësh, ajo e priste dhe në sytë e saj ai lexonte boshllëkun e një nate të gjatë në një krevat me dy jastëkë ku prehej vetëm një kokë.

Një natë ai erdhi vonë, i lagur dhe i lodhur nga rruga. Mangallin e gjeti të ndezur. Hoqi këpucët, çorapet e qullëta, nderi këmishën mbi stol dhe u fut në rroba. Këmbët i kishin ngrirë dhe hijet e prushit që digjej luanin si diej druri mbi tavan. Kur u hap dera, ai ishte zgjuar. Një hije e bardhë u afrua te shtrati dhe u fut brenda. Ishte Hatixheja. E ngrohtë dhe e rrumbullakët ajo iu afrua dhe ai ndjeu frymën e saj të nxehtë në qafë. Ajo nuk foli, por zgjati dorën e butë dhe ia vuri në mes të këmbëve. Sali Benishi dëgjoi gjakun e tij që nisi t'i gurgullonte në vena duke ia forcuar trupin e flashkët. E zhveshi gruan shpejt dhe futi kokën në sqetullën e saj si kaçube, plot qime të gjata dhe të lagura nga djersa. Nuk ishte shtrirë kurrë mbi një grua, por instinkti e drejtonte si një deve të etur që kërkon gjurmën e ujit nën lëkurën e shkretëtirës. Hatixheja lëvizte nën peshën e tij si një kodër rëre që ndryshon formë, derisa zbutet, drejtohet, shtrihet, derdhet, epohet, harkohet dhe pastaj humb lartësinë në një fushë të gjerë dhe të ngrohtë. Ai ecte mbi kodrat dhe fushat e trupit të Hatixhesë, gjersa, më në fund, gjeti një oazë të pyllëzuar, u ngul atje dhe piu sa u ngop. Në atë freski, trupi iu lag, e uji i rrodhi në qafë, në gjoks dhe nëpër këmbë. Hatixheja, e lëshuar, kishte hapur kanalet e saj të thara dhe të përvëlura nga vitet, si një tokë që pas shumë kohësh njomet nga shiu. Kur ritmi i valles së Sali Benishit ishte qetësuar, Hatixheja hapi gojën e dirsur dhe tha: Po digjem, por nuk dua të shuhem.

Për tri ditë nuk u ngritën nga krevati. Mangalli digjej ngadalë dhe prushi nën çarçafë ia përcëllonte kaçubën e vaditur Hatixhesë. Sali Benishi zbriste zbathur poshtë në kuzhinë dhe aty merrte turshi, djathë, qumësht, mollë dhe reçel me bajame dhe të dy hanin mbi shtresa. Ajo qëronte mollët dhe thithte turshitë që zbrazeshin si llastikë të shpuar e që pastaj Sali Benishi i kafshonte deri në rrëzë dhe farat e vogla shpërndareshin mbi jastëk. Pastaj ai e shuante djegësirën e turshive me qumësht të ftohtë që i derdhej mbi gjoksin e ashpër dhe që aty kërcente mbi gjinjtë e fortë dhe të lartë të Hatixhesë. Ai fuste gishtin në pjatën me reçel bajameje dhe ia lyente asaj buzët që shkëlqenin në errësirë si një luleshtrydhe që del nga ferra. Një natë, kur atë e kishte zënë gjumi, ajo e zgjoi dhe i tha: Nuk do t'i hipësh më mushkave se ato nuk pjellin. Tani, ti je kali im. Sali Benishi uli kokën mbi barkun lakuriq të gruas dhe iu duk sikur pa hijen e një fëmije që hante turshi.

Pas tri javësh u martuan. Fshati u habit dhe fisi më i madh u tall me Sali Benishin dhe hapën fjalë se ai e mori Hatixhenë për samar, ndërsa ajo u martua me një kalë. Por Hatixheja ishte një grua e fortë dhe e pasur dhe fshati nuk guxoi ta përfliste për një kohë të gjatë. Natën e dasmës ajo e mbajti qiriun të ndezur dhe ai e shikonte sesi ajo i hiqte një nga një tylet e bardha, këmishën, brezin, çorapet e mëndafshita dhe të brendshmet derisa tulet e saj, ende të forta dhe të disiplinuar, lëshuan një erë parfumi që e mbushi dhomën. Ai i tha ta shuante qiriun, por Hatixheja nuk pranoi dhe, kur ai u shtri mbi bark duke djersitur, ajo i kaloi dorën mbi shenjën e mollës në mes të shpatullave dhe i tha: Profeti im, deveja jote mbarsi oazën time dhe në vend të pemëve mbiu një njeri.

Pas nëntë muajsh lindi një djalë. Karvanët shkonin në qytet me dru dhe ktheheshin me para. Pylli i Hatixhesë rritej dhe ata merrnin fshatarë të tjerë që prisnin dru dhe i ngarkonin. Shtëpia u zgjerua me dhoma të mëdha dhe Sali Benishi ftonte miq, kushërinj dhe vëllezërit e tij për darka dhe ziafete. Për disa vjet lindën katër vajza dhe një djalë tjetër dhe shtëpia u mbush. Ai luante me fëmijët që kishin lindur dhe Hatixheja i kishte gjithnjë gjinjtë e fryrë nga qumështi që i linte njolla të freskëta mbi këmishë. Fisi më i madh i fshatit vazhdonte të fliste me maraz dhe karvanarët e tyre, kur ndesheshin rrugës, kthenin kokën nga ana tjetër, ndërsa mushkat, si për të respektuar të zotët, shtynin me barqe njëra-tjetrën.

Një ditë dimri, nëntë mushka të ngarkuara me dru, bashkë me dy karvanarë rrëshqitën dhe ranë në greminë. Malli i atij viti humbi dhe dy burrave dhe mushkave iu gjetën kockat vetëm kur shkriu dëbora, por ujqit i kishin copëtuar dhe askush nuk i njohu më. Sali Benishi i tha Hatixhesë se këtë punë e kishte bërë fisi më i madh për t'u prishur tregtinë e drurëve dhe për t'u marrë klientët në qytet. Një natë, Sali Benishi nuk u kthye në shtëpi dhe kur erdhi në mëngjes i tha Hatixhesë se e kishte rrëzuar në humnerë karvanin e fisit më të madh. Dymbëdhjetë mushkat ishin shtyrë njëra pas tjetrës në dëborë dhe kishin përfunduar në fund të malit. Ulërimat e kafshëve të tmerruara nuk iu shqitën nga veshët Sali Benishit për tri javë. Por fisi më i madh i kishte dalluar gjurmët e Sali Benishit në dëborë dhe pas kësaj filloi lufta. Ata ishin një fis i madh dhe bura të armatosur bllokuan rrugët që lidhnin fshatin me qytetin dhe nuk lejuan më që karvanët e Hatixhesë të kalonin. Dimri ishte i ashpër dhe stivat me dru mbushën oborrin e shtëpisë. Sali Benishi i shikonte nga dritarja e dhomës dhe shtrëngonte dhëmbët. Ishte i pafuqishëm.

Atë dimër, djali i madh u sëmur dhe vdiq nga ethet. Në fshat u hap fjala se ai kishte një sëmundje të keqe dhe askush nuk shkeli në shtëpinë e tyre për shumë kohë. Hatixheja i rrinte fëmijëve te koka dhe Sali Benishi mbushte mangallin me dru të vegjël për të ngrohur dhomat. Kur dimri iku, rrugët u hapën nga dëbora, por njerëzit e fisit të madh nuk e hoqën ndalimin. Sali Benishi mori një natë një nga mushkat e tij të forta dhe u nis. Burat e ndaluan në dalje të fshatit, por ai nuk u lëkund. Më lini të kaloj, tha dhe i grahu mushkës. Por ata e shtynë dhe ai ra nga mushka e koka iu përplas pas një guri. Kur u përmend e pa veten gjithë baltë në prehrin e Hatixhesë, e cila i vinte lecka me raki në ballë dhe këmbët ia kishte mbështjellë me velenxë të mbushur me mollë të shtypura. Sali Benishi nuk mbante mend çfarë i kishte ndodhur, por fliste në jerm dhe i thoshte Hatixhesë se kishte shumë ftohtë. Ajo i hidhte velenxa mbi trup dhe i shtrydhte raki te tëmthat e tendosur. Një natë Sali Benishi u zgjua dhe i tha Hatixhesë se ai kishte qenë në një shpellë dhe atje kishte parë një engjëll që i tregonte disa shkronja të mëdha të gdhendura në muret e saj. Por ai nuk dinte të lexonte dhe nga sikleti i kishte dalë gjumi. Hatixheja e mbuloi Sali Benishin që fjeti tri ditë rresht pa lëvizur. Herë pas here buzët e tij hapeshin dhe dukej sikur ai habitej nga diçka që shikonte në gjumë. Shtatë javë, Sali Benishi nuk doli nga shtëpia. Fliste shumë pak dhe fjalët që thoshte i kombinonte dhe ato dukeshin si porosi që nuk i drejtoheshin askujt, por nga

pak të gjithëve. Dukej sikur lexonte fjalët e engjëllit në muret e shpellës. Fliste për pyjet, për drurët, për zogjtë, për bimët, për barërat, për ujin, për erën, për dëborën, për freskinë, për hënën, për kafshët, për macet, për kuajt, për gratë dhe fëmijët. Unë jam guri që i mungon shtëpisë për të mbaruar, thoshte dhe i kërkonte Hatixhesë qumësht. Një ditë, ai kishte dalë në dritare dhe po shikonte në oborr Hatixhenë që bisedonte me një karvanar të ri, mustaqet e verdha të të cilit sapo kishin mbirë. Hatixheja iu afrua dhe karvanarit të ri i mbetën sytë te gjinjtë e saj të fryrë dhe të kërcyer. Kur ajo hyri në shtëpi, Sali Benishi i vrenjtur ishte mbuluar me një velenxë dhe tha: Ti do mbuloresh sepse sytë e zbuluar të burrave kanë lënë gjurmë në trupin tënd. Hatixheja vuri një shami në kokë dhe këmishën nuk e zërtheu më kurrë.

Drutë mbetën edhe ca kohë në oborr derisa u dogjën për të ngrohur shtëpinë. Sali Benishi nuk doli më në pyll për dru dhe në shtëpi nisën të mungojnë buka, mielli, turshitë dhe djathi. Hatixheja e mërzhitur vendosi ta shiste pyllin te fisi më i madh, por ata i thanë se nuk u duhej dhe ajo ia shiti një familje tjetër me një çmim shumë të ulët. Djali tjetër, i vogli, vdiq pas dy vjetësh nga të njëjtat ethe si djali i madh dhe Hatixheja nuk doli më nga shtëpia. Sali Benishi i tha të iknin nga fshati sepse aty nuk mund të jetonin më, por ajo nuk pranoi dhe u shtri e sëmurë derisa vdiq në krahët e tij.

Kur e varrosi gruan, Sali Benishi ia hoqi shallin nga koka, e kreu dhe ia zbuloi pak këmishën mbi gjinjtë e mëdhenj dhe të bardhë. I mori erë sqetullave të saj dhe qau. Lotët e tij të djegur ranë mbi gjoksin e Hatixhesë dhe u thanë duke nxjerrë një aromë molle të pjekur. I dërrmuar nga vetmia, me katër vajza të vogla që silleshin nëpër shtëpi duke veshur me radhë rrobat dhe këpucët e Hatixhesë, Sali Benishi ra prapë në jerm. Një shoku i tij karvanar, që i kishte qëndruar besnik familjes, Bari Bakri u kujdes për të dhe i solli ushqime dhe mollë të shtypura që ia vinte te këmbët, siç kishte bërë Hatixheja për ta sjellë në vete. Një natë, Sali Benishi u zgjua dhe u nis te shtëpia e fisit të madh. Në errësirë, turrat e druve ngriheshin mbi muret e lartë të shtëpisë. Ai ndezi zjarr duke pjekur dy gurë stralli pas një lecke të thatë dhe të vaisur dhe e hodhi mbi dru. Zjarri e mbuloi gjithë fshatin atë natë. Njerëzit dilnin nga shtëpia dhe i hidhnin velenxa dhe ujë me kazanë druve, por për dy ditë zjarri nuk u shua, duke e shkruar shtëpinë e vjetër të fisit të madh.

Sali Benishi u fsheh atë natë në shtëpinë e Bari Bakrit. Duhet të ikësh nga fshati, i tha ai. Ata do të të gjejnë dhe do të të vrasin. Të nesërmen, kur akoma hiri i shtëpisë rrinte si një re mbi fshat, ai i çoi vajzat te vëllezërit e tij dhe vetë u kthye në shtëpi për të bërë gati mushkat dhe plaçkat. Kur u ngjit në pllajë, u kthye dhe pa fshatin. Ishte pasdite dhe dielli e hëna ndriçonin njëkohësisht.

Koha më e mirë për t'u nisur. Po ta ndiqnin, nuk do t'ia gjenin dot hijen.

Pas pesë ditësh ishte në Voskopojë.

Ishte viti 1761 dhe myslimanëve u jepej strehim në qytet, sepse ata vendosnin për shumicën e votave në këshillin e të katërmbëdhjetëve. Zuri punë pranë një tregtari që shiste dru në Korçë dhe atij i eci puna dhe e ndihmoi Sali Benishin të gjente një shtëpi. Në qytet ai u miqësua me myslimanët e tjerë dhe i jepte atyre porosi, të cilat i vinin atij në gjumë nga një zë i panjohur. Ndryshe nga fshati i tij, këtu e besonin. Voskopoja ishte një qytet i krishterë dhe myslimanët jetonin me shpresën se në këtë qytet një ditë do të kishin vendin e merituar. Burat mblidheshin në darkë pas punëve dhe Sali Benishi fliste gjatë për Zotin, për engjëjt, për lumenjtë, për të mirën, për të keqen, për zakonet, për gratë dhe për veshjet.

Pas disa muajsh, në Voskopojë, erdhi miku i tij Bari Bakri që i tha se në fshat fisi i madh e kishte kërkuar për një muaj në pyll ku mendonin se ai ishte fshehur, por nuk e kishin gjetur dot dhe

kishin hapur fjalë se ai kishte rënë në humnerë dhe kishte vdekur nga e ftohta. Më mirë që besojnë se jam i vdekur, tha Sali Benishi. Sa isha gjallë nuk më besonin.

Bari Bakri kishte sjellë në Voskopojë edhe familjen e tij. Gruan, tri vajzat dhe një djalë. Pas vdekjes së Hatixhesë, Sali Benishi jetonte vetëm dhe shkonte pothuajse çdo natë në shtëpinë e Bari Bakrit ku dy burrat hanin dhe bisedonin duke djegur duhan të lirë, ndërsa fëmijët luanin.

Vajza e dytë e Bari Bakrit ishte fëmija më i dashur i shtëpisë. Quhej Aishe. Kur erdhi në Voskopojë ajo ishte dymbëdhjetë vjeç. Këshilli i të katërmbëdhjetëve, që në kohën e Johan Vulgarit, i kishte dhënë të drejtë fëmijëve myslimanë të ndiqnin shkollat dhe Aishja shkonte çdo mëngjes në klasën e vajzave. Ajo ngrihej herët, lahej, pastronte veshët, mblidhte flokët e zinj që i vinin deri në bel, ngrinte jakën e këmishës që e forconte çdo darkë me niseshte, lidhte një verore me pe jeshil dhe të verdhë në kyçin e dorës dhe nisej. Aishja ishte e zgjuar dhe shumë e bukur. Kur ecte nëpër kalldrëmet e lagjeve të krishtera djemtë mblidheshin duke e parë dhe ajo ecte ngadalë me sytë e përmbysur si për t'ua zgjatur atyre kënaqësinë. Në shkollë Aishja lexonte vjersha, mblidhte shumë shpejt numrat që pastaj i pjesëtonte, i zbriste dhe i shumëzonte.

Kur mbushi trembëdhjetë vjeç Aishja u zgjat me gati dy pëllëmbë. Nuk është më fëmijë, por një grua, i tha e shoqja Bari Bakrit. Ky e shihte vajzën, së cilës i ishin zgjatur gjymtyrët, kofshët i ishin bashkuar dhe gjinjtë e vegjël i ishin forcuar dhe i ishin kthyer në dy kodra të mbjella. Kur i lëshonte flokët e gjata, në shtëpi përhapej një erë e fortë myshku. Aishja përdorte një krem myshku bojëvjollcë, që shoqet e veta të krishtera e zienin dhe pastaj e përzienin me vezë derisa, duke u rrahur, bëhej i kaltër dhe me të lyejin flokët për t'i zbutur dhe për t'i shkëlqyer si astar. Kur Aishja lahej, të shtunave, era e myshkut dilte në oborr dhe gjithë mëhalla nuhaste vajzën që lahej. Nën sqetulla i kishin dalë ca qime të vogla të zeza si furçat që përdorte David Selenica për të ngjyrosur pranverën, ndërsa kur skuqej në faqe i nxinte një push i zi dhe shumë i ndjeshëm. Një ditë, Aishja doli nga banja lakuriq dhe kur e ëma e pa u habit dhe i tha të shoqit se vajza po rritej duke u larë dhe duke u fërkuar. Mos e lër të lahet kaq shpesh, i tha Bari Bakri.

Sali Benishi që tymoste duhan me Bari Bakrin, u deh një natë nga era e flokëve të Aishës kur kjo u solli kafënë në dhomën e bukës. Era e myshkut u përzje me erën e hidhur të kafesë dhe ai ndjeu një të prerë në stomak, pastaj djersë të ftohta i zbritën mbi mollën në mes të shpatullave dhe këmbët iu ftohën. Mbështeti kokën pas jastëkut të kadifenjtë që Bari Bakri e kishte sjellë nga fshati dhe e zuri gjumi.

Kur u zgjua, pa Bari Bakrin që i rrinte përballë me një tas të mbushur me copa mollë që pluskonin në uthull. Këpucët ia kishin zbatuar dhe tëmthat i kishte të lagur. Çfarë kam bërë, e pyeti ai Bari Bakrin që e shikonte i prekur. Ke kërkuar një grua, i tha Bari Bakri. Më ke treguar gjithë natën si flije me Hatixhenë, si e zhvishje, si haje turshi me gjizë, si pije qumësht në krevat, si ia mbuloje gruas lëkurën me ajkë të trashë dhe shumë gjëra të tjera. Sali Benishi vuri bërrylat mbi jastëk dhe u zgjat nga Bari Bakri. Po për gjinjtë e Hatixhesë të rrëfeva, e pyeti. Bari Bakri e pa në sy, uli kokën dhe i zgjati një gotë qumësht të ftohtë.

Atë ditë, Sali Benishi nuk shkoi në punë dhe për tri javë nuk u takua me Bari Bakrin. I vinte turp dhe e shmangte rrugën e shtëpisë së tij. Pas pune, endej i vetëm në rrugët e Voskopojës dhe nganjëherë afrohej te tavernat e zhurmshme të studentëve, në lagjen e kazanxhinjve. Zgjaste kokën nga dritaret e vogla dhe në mes të tymit shikonte djem me këmisha të bardha që pinin verë të kuqe me pastërma dhe hipnin mbi tavolina duke recituar. Sali Benishi nuk dëgjonte dot se çfarë thuhej brenda, por, kur dera hapej dhe ai tërhiqej në errësirë që të mos e shihnin, studentët dilnin gjithë zhurmë dhe merrnin rrugën drejt një shtëpie të veçuar në lagjen e jorganxhinjve. Sa afroheshin atje, pushonin dhe qetësonin hapat. Sali Benishi i ndiqte dhe shihte se si ata trokisnin pesë herë duke numëruar me kujdes në portën e vogël, që pas pesë trokitjesh të rregullta e hapte

një grua e bëshme dhe e shëndoshë, e veshur me tyl dhe me duart me unaza alumini. Qirinjtë e dhomave të shtëpisë fikeshin një nga një dhe kur studentët dilnin, Sali Benishi dëgjonte se si i tregonin njëri-tjetrit për gratë me të cilat kishin fjetur në shtëpinë e veçuar. Atëherë ai ndihej edhe më i vetmuar. Shkonte në shtëpi, zhvishej dhe futej në rroba. Derisa e zinte gjumi luante me hijet në tavan dhe kafshonte mollë të paqëruara.

Në një natë të tillë, u hap dera dhe në dhomë hyri Bari Bakri. Sali Benishi u ngrit dhe të dy burrat u ulën përballë njëri-tjetrit. E gjete gruan, e pyeti Bari Bakri. Nuk kam aq fat, u përgjigj Sali Benishi dhe lëvizi brenda këmishës së vet ët zhubrosur, sikur donte të ikte nga biseda. Por Bari Bakri ia nguli sytë fort dhe Sali Benishi e kuptoi se ai nuk kishte ardhur vetëm për t'i bërë një pyetje. Nganjëherë fatin e kërkojmë aty ku ai nuk është dhe harrojmë se ai ka formën e gjërave që njohim. E kërkojmë në pyll, por ai është në prush, e kërkojmë në qiell, e ai është në tokë, e kërkojmë në rrugë e ai është në shtëpi, e kërkojmë te Zoti, por ai është te njeriu, e kërkojmë te tjetri, por ai fshihet te ne. Ne mendojmë se fati është një gjë e panjohur, por në të vërtetë ai fshihet te gjërat e njohura. Ti po kërkon një grua të panjohur që të të rehatojë trupin, të të përkëdhelë barkun, të të qërojë mollën dhe të të pleqërojë duke ndezur mangallin e shpirtit tënd. Të kam parë se si endesh rrugëve i humbur duke kërkuar fatin në dyer që nuk hapen dhe që, në qoftë se hapen, janë rast, por nuk janë fat. Njerëzit e ngatërrojnë kollaj rastin me fatin. Rast është çdo grua që na del përpara në rrugë, ndërsa fat është gruaja që fusim në shtëpi dhe e mbajmë aty gjithë jetën. Rasti është një mollë që e gjejmë në shesh dhe e kafshojmë si të zilepsur për të shuar etjen që sjell rendja pa drejtim. Fati është një pemë që e mbjellim vetë, e ujisim, ia presim bistakët, e shartojmë, ia mbledhim gjethet e bardha, ia drejtojmë lastarin me një dru të fortë, ia mbledhim kokrrat me lëng, pastaj i qërojmë një nga një dhe këtë shije e kemi në gojë në fund të çdo dite, në fund të çdo viti deri në fund të jetës.

Kam ardhur të të them të martohesh me Aishen, tha Bari Bakri dhe fytyra iu bë e murrme, si një verë e vjetër që hapet para se të skuqet si uthull. Aishen, pyeti Sali Benishi dhe këmbët iu ftohën, ndërsa një erë myshku iu ngjit nga stomaku dhe i doli nga hundët. Aishja është më e vogël se vajzat e mia. Unë dua një grua, tha me gjysmë zëri dhe ndjeu që molla në mes të shpatullave iu lëngëzua. Aishja është një fëmijë që po bëhet grua, tha Bari Bakri. Ti ke rastin ta krijosh fatin tënd. Unë po të jap një pemë që e kam mbjellë vetë. Merre, mbille në bahçen tënde, krasite, drejtoje me forcë nëse të duket e shtrembër, pritja sythat që rriten si thonj të tepërt, shartoje me trungun tënd, mbuloje me lëkurën tënde nga ngrica e dimrit, mos lër njeri t'ia prekë lulet në verë dhe shumë shpejt nga degët e saj do dalin fryte të bukura që do të ta mbushin gojën me lëng kur t'i shijosh.

Aishja është bërë grua, tha Bari Bakri dhe uli kokën sikur t'i besonte tjetrit një sekret. Do bindesh kur ta lash.

Dy burrat mbetën pranë mangallit që po shuhej, deri në mesnatë. Bari Bakri fliste dhe Sali Benishi dëgjonte i mbështetur në jastëk, gjersa e zuri gjumi. Bari Bakri e mbuloi, shoi prushin e fjetur dhe iku.

Pas tri ditësh e solli Aishen në shtëpi. Sali Benishi qëndroi pas dritares dhe pa Bari Bakrin që ecte përpara dhe pas tij vinte e shoqja që mbante Aishen për dore. Këmbët e të treve ngjiteshin në shkallët e drunjtë të shtëpisë derisa në korridor u ndanë dhe vazhduan në drejtime të ndryshme. Bari Bakri hyri në dhomën e Sali Benishit, ndërsa dy gratë në dhomën tjetër. Të trashëgoheni, i tha Bari Bakri dhe e puthi në faqe. Pas pak në dhomë hyri dhe gruaja e Bari Bakrit. Sytë i kishte të skuqur dhe shamia e flokëve i kishte rënë mbi supë. Sali Benishi u ngrit

në këmbë dhe u drejtua nga ajo si një njeri që pret të mësojë se si përdoret dhurata që i kanë sjellë.

Gruaja e Bari Bakrit rregulloi shaminë dhe tha: Aishja nuk e pi qumështin. Para se të shkojë në shkollë do një vezë të zier me sheqer dhe në darkë çaj trëndafili, djathë dhe bukë misri të thekur. Kur i vijnë ato, hidhi limon në çaj dhe bëri supë me piper që t'i mblidhet barku.

Gruaja e Bari Bakrit fliste për ushqimet, për rrobat, për librat, për punët e shtëpisë, për ciklet dhe sëmundjet e Aishes dhe Sali Benishi përpiquej të tregohej i vëmendshëm, por era e kremit të myshkut që dilte nga dhoma tjetër e kishte shpërqendruar. Gruaja fliste me duart që i zgjaste nga vetja, si për të frenuar ankthin dhe kur mbaroi tha: Mos e lër të lahet shumë se do bëhet më e gjatë se ty dhe mos e prek me dorë pa u bërë katërmbëdhjetë vjeç. Sa vjeç është, e pyeti Sali Benishi duke kthyer kokën nga Bari Bakri. Para pesë muajsh mbushi trembëdhjetë, tha gruaja që i hodhi një sy dhomës, rrëmuja e së cilës nuk i pëlqeu.

Kur prindërit e Aishes ikën, Sali Benishi doli në dritare. Bari Bakri ecte përpara, ndërsa pas tij çapitej e shoqja që rregullonte shaminë që i binte vazhdimisht mbi sup. Pasi eci pak, ajo ktheu kokën dhe një lot i madh shkëlqeu në diell.

Sali Benishi u tërhoq në errësirën e dhomës së tij dhe u ul. Pas pak u ngrit dhe u afrua te dera. Zgjati veshin, por nga dhoma tjetër nuk vinte asnjë zhurmë. U kthye në shtrat dhe u mbështet mbi jastëkun e ri, të qëndisur nga Hatixheja, të cilin e kishte nxjerrë atë mëngjes nga sënduku i kujtimeve që kishte sjellë nga fshati. Vuri duart pas kokës, por i largoi prapë, se iu duk sikur i pengonin dëgjimin. U ngrit dhe shkoi te dera. E hapi ngadalë, por dhoma ngjitur ishte e shurdhët. U kthye dhe u ul prapë. Pastaj u çua dhe doli me hapa të vegjël duke ecur majë gishtave në korridor. Vuri veshin te dera e dhomës së Aishes, por përsëri nuk dëgjoji gjë. E mbështeti kokën në dërrasën e ashpër të derës, aq sa lëkura iu gërric te balli, por asnjë tingull nuk mbërriti deri te veshi i tij. Mbajti frymën dhe mbeti në majë të gishtave sa vetja iu duk si i varur në parvaz. U kthye në dhomë dhe u shtri duke e lënë derën pak të hapur. Natën lëvizte kokën mbi jastëk dhe zhurma e puplave ngrihej në tavan. Flokët e tij bënë hije të çrregullta në mur derisa atë e zuri gjumi.

Kur u gdhi, u ngrit, veshi një këmishë të pastër dhe të pazhubrosur, lau sytë, i ndau me vizë flokët në mes dhe zbriti në kuzhinë. Zjeu një vezë dhe e qëroi me kujdes lëvozhgën që e ciflosi lehtë me një majë luge. Veza e ngrohtë i djersiu në dorë kur ai ia preu pak majën dhe e kuqja doli si një kokë zoçke që ngrihet nga gjumi në mëngjes. E rregulloi vezën mbi një pjatë të pastër dhe mbushi një filxhan kafeje përgjysmë me sheqer. Nga sënduku i Hatixhesë tërhoqi një pecetë bojë rozë, të palosur katër herë dhe bashkë me pjatën dhe filxhanin i vendosi të gjitha në një tabaka prej druri. Futi dorën në xhep dhe nxori një çelës të madh që varej në një pe jeshil dhe e lëshoi në cep të tabakasë. U ngjit lart në majë të gishtave dhe e la tabakanë përpara derës së Aishes. Hyri në dhomën e vet dhe u mbështet te dera, të cilën e la të hapur aq sa dukej e kuqja e vezës që e ndriçonte korridorin si prush prej mishi.

Nga rruga vinin zërat e tregtarëve dhe zanatçinjve që niseshin për në punë dhe pak më vonë ai dëgjoji dhe fëmijët që dolën për në shkollë. Dera e dhomës u hap dhe ai pa Aishen që tërhoqi tabakanë brenda dhe pastaj doli në korridor e veshur me një këmishë nate të kaltër, që i mbulonte këmbët deri te kyçet. Ishte zbathur dhe flokët e lëshuara i dukeshin si një shall i zi. Ajo shkoi në banjë dhe ai dëgjoji një kovë me ujë që u derdh me forcë. Një erë myshku e mbushi gjithë shtëpinë dhe Sali Benishi u mbajt fort pas derës, si i dehur. Aishja u kthye në dhomë, me flokë të krehur drejt dhe këmishën të lagur pak, në mes të këmbëve. Ai dëgjoji zhurmën e një luge mbi pjatë dhe pastaj pa Aishen që doli nga dhoma dhe zbriti në rrugë. U afrua me shpejtësi te dritarja dhe e ndoqi me sy. Aishja kishte veshur një bluzë të verdhë leshi, me mëngë të gjata, një fund të

zi, çorape të kuqe dhe flokët i kishte lidhur pas koke. Në qafë, i varej çelësi i madh që lëkundej si një kryq. Dy burra që po kalonin kthyen kokën, por Aishja vazhdoi të ecte derisa u zhduk pas kthesës. Sali Benishi shkoi në dhomën e saj dhe desh u përplas pas tabakasë që ishte derdhur gjithandej. Në një cep, ishte një bocë me rroba, ndërsa mbi krevatin e prishur ai pa një palë breçka të vogla që kishin një njollë të freskët ngjyrëtrëndafili. I ngriti dhe i fshehu poshtë jastëkut. Rregulloi krevatin, mori tabakanë dhe duke zbritur e hëngri vezën e mbetur.

Kur doli në rrugë, ktheu kokën në drejtimin që kishte marrë Aishja, por pa vetëm hijen e vet të madhe që zgjatej gjithë gunga mbi kalldrëm. Kur u kthye nga puna në mbrëmje, dera e shtëpisë ishte e hapur. U ngjit lart dhe vuri veshin te dera e Aishes, por nuk dëgjoji gjë. Pasi u zhvesh, theku bukë misri, zjeu çaj, mbushi dhe një pjatë me shegë dhe i la përpara derës. Kur u shtri, dëgjoji flokët e Aishes që fërfëllinë në korridor. Tabakaja me ushqime u zvarrit dhe dera u mbyll. Në mëngjes zjeu prapë vezë me sheqer dhe qëndroi në dritare kur Aishja doli për në shkollë. Flokët i kishte lëshuar dhe kishte mbathur çorape të shkurtra. Mishi i bardhë i pulpave të mbuluara me push dukej si i lyer me sheqer.

Për një javë Sali Benishi nuk foli me Aishen. I dukej vetja si një gjahtar, i cili mban një kanarinë në kafaz duke e ditur që po i foli asaj do t'i bien pendët dhe ai ka frikë ta shohë lakuriq. Ziente çdo mëngjes vezë dhe në darkë kur kthehej thekte bukë me çaj të nxehtë. Një ditë, kur erdhi nga puna dhe u shtri në krevat, dera e dhomës së tij u shty ngadalë dhe Aishja, e veshur me rrobat e shkollës, qëndroi në prag. Ai u ngrit mbi bërryla dhe u drejtua nga vajza. Pse e zien vezën aq lluqe, i tha ajo pa hyrë brenda. Sali Benishi nuk foli, por supet e tij lëvizën dhe molla në mes të shpatullave iu mbush me djersë. Aishja nuk priti që ai të përgjigjej, por vazhdoi: Mund të më bësh një supë me piper se më dhemb barku? Ai bëri të ngrihej, por u kujtua se ishte i zhveshur dhe mbuloi këmbët me jorgan. Aishja u kthye në dhomën e saj dhe ai u vesh dhe zbriti në kuzhinë. Kur supa ishte gati ai preu një fetë limon dhe e përzjeu disa herë. Pastaj hodhi pak piper dhe e provoi hidhësirën me një majë luge. U ngjit lart dhe trokiti në derën e Aishes. Ajo e hapi dhe Sali Benishi e pa për herë të parë nga afër. Kishte veshur këmishën e kaltër të natës, poshtë së cilës gjinjtë e vegjël dukeshin si dy mollë të fshehura nën çarçaf. Faqet e ish-in skuqur dhe disa quka të kuqe i kishin mbirë si lule mbi mollëza. Sytë e Aishes ishin të zinj, ndërsa vetullat e trasha i ishin bashkuar në ballë. Veshët e bardhë i kishte shpuar dhe secili prej tyre kishte një gropë të vogël që dukej si nishan. Buzët e Aishes ishin të thara dhe Sali Benishi mendoi se vajza kishte ethe. I zgjati pjatën e supës. Ajo e mori dhe avulli iu ngjit në faqe dhe ia lëvizi pak flokët. Para se të mbyllte derën, Aishja ngriti kokën dhe tha: Nesër nuk do shkoj në shkollë.

Kur erdhi vera, Aishja i hoqi çorapet e leshit. Shkonte në shkollë me sandale dhe këmishën e mbante të zbërthyer. Një ditë, kur ai u kthye në drekë, e gjeti në oborr duke luajtur me dy shoqe. Sali Benishi i përshëndeti dhe dy vajzat e tjera filluan të qeshnin kur Aishja pëshpëriti diçka që ai nuk e dëgjoji. Maji ishte i nxehtë dhe vajzat ishin djersitur duke vrapuar dhe i kishin përveshur llërët e këmishëve të bardha të shkollës. Fundet e shkurtra iu ngriheshin lart dhe Sali Benishi rrinte pas dritares dhe shikonte kofshët e tyre të pakujdesshme që zbuloheshin duke u rritur. Kur i përcolli shoqet, Aishja u ngjit lart dhe ai dëgjoji ujin që filloi të derdhej në banjë. Doli në majë të gishtave dhe afroi kokën te dera. Një erë e mirë sapuni i erdhi në hundë, ndërsa sfungjeri shqitej me zhurmë nga lëkura e djersitur e Aishes. Kur ai e shtyu derën, Aishja lakuriq ishte ulur mbi një stol duke fshirë krahët. Ajo u ngrit në këmbë dhe u mbështet pas murit, por nuk u mbulua dhe nuk dukej e frikësuar. Uji i rridhte në të gjithë trupin, ndërsa thithkat e zeza të gjinjve i ishin fryrë nga peshqiri që sapo i kishte fërkuar. Sali Benishi ndjeu një fryrje të padurueshme në mes të këmbëve dhe, duke shkelur mbi shkumë, e kapi vajzën me një dorë nga flokët dhe dorën tjetër e futi në mes të kofshëve të lagura. Një gisht iu thith nga një sfungjer prej

mishi dhe mbeti aty. Aishja mjaulliu dhe e kafshoi fort në gjoks, por Sali Benishit kjo dhimbje iu duk si pickimi i kanarinës lakuriqe, mbi dorën e stërvitur të gjuetarit. Vajza qëndroi në ajër, me këmbë të hapura, duke u mbajtur me dhëmbë pas mishit të thatë si pastërma të Sali Benishit. Ajo nuk i shkëputi dhëmbët edhe kur Sali Benishi u fut i gjithi brenda saj dhe mbeti atje derisa një zhurmë prej veze lluqe të qëruar doli nga fundi i barkut të Aishes. Kur Sali Benishi u tërhoq, mbi lëkurën e tij të vjetër, dhëmbët e Aishes kishin vizatuar një kokërr arre. Shkuma e sapunit ishte bërë e kuqe dhe peshqiri dukej si një mjellmë e plagosur mbi ujë. Sali Benishi u fut në dhomë dhe të nesërmen iku në punë pa e zier vezën e Aishes. E ushqeva derisa u bë grua, mendoi me vete kur doli në rrugë.

Gjatë gjithë verës, Sali Benishi hynte çdo natë në banjën e Aishes kur binte mbrëmja. Vajza nuk fliste, por kafshonte kokrrën e arrës që zmadhohej dhe ngrihej si grusht mbi gjoksin e Sali Benishit. Peshqiri nuk skuqej më dhe kur Sali Benishi ikte Aishja fuste një sapun në vendin që ai kishte lënë bosh. Në mëngjes ajo zgjohej e para dhe bënte trahana me spec djegës dhe me vaj të djegur, ndërsa në darkë, pasi burri ikte nga banja, ajo vishej, zbriste në kuzhinë me shapka dhe piqte patëllxhanë me domate dhe mish viçi të grirë në një tigan balte që Sali Benishi e kishte kujtim nga Hatixheja.

Një ditë, gjatë trazirave të vitit 1764, Aishja erdhi nga shkolla me një shall të kuq në qafë. Cepat e shallit i mbulonin gjinjtë e rritur dhe Sali Benishi u vrenjt. Kush ta dha këtë shall, e pyeti duke parë nën vetulla. Ma dhanë në shkollë, tha Aishja. Është shalli i Marin Kurilës që do shpëtojë Voskopojën. Sali Benishit i ranë vetullat mbi sy. E ke takuar ti Marin Kurilën? Kaloi sot përpara shkollës dhe gjithë vajzat dolën në dritare për ta parë. Ishte shumë i bukur dhe i larë, tha Aishja dhe u fut në dhomën e saj. Në mbrëmje, kur Sali Benishi shkoi në banjë për të kryer detyrën e burrit të shtëpisë, Aishja ishte si gjithnjë lakuriq, por shallin nuk e kishte hequr nga qafa. Atë natë, Sali Benishit nuk iu përsërit fryrja e zakonshme dhe Aishja nuk e kafshoi më kokrrën e arrës.

Gjuetari dhe kanarina e kishin mendjen jashtë kafazit në rrugët e Voskopojës që kishin filluar të mbuloheshin me shalle të kuq. Aishja priti si çdo natë me këmbët hapur, por muskuli i Sali Benishit u shtri si një patëllxhan i fishkur mbi tigan. Kur u bë qull nga djersët e moshës dhe nga turpi i burrit, Sali Benishi u tendos dhe i tha Aishes: Kafsho, kafsho kanarina ime. Por Aishja nuk e kafshoi, si një kanarinë e ngopur me ushqimin e gjuetarit. Sali Benishi e shtyu dhe iku si një kafshë që i varet bishti përpara. I mbuluar me djersë, u fut në çarçafë dhe filloi të dridhej. Plaga e pangacmuar mbi gjoks i ishte ënjtur dhe ai e shtrëngonte fort, por ajo nuk dhembte dhe Sali Benishi rënkonte. Nuk fjeti gjithë natën dhe në mëngjes u ngrit dhe e priti Aishen te dera e dhomës. Kur ajo doli me shallin e kuq të lidhur në qafë, Sali Benishi e kapi fort nga flokët, i futi dorën poshtë shallit dhe ia shqeu. Aishes iu varën flokët mbi fytyrë dhe ai pa sytë e saj që shkëlqen nga egërsia. E mori shallin e grisur dhe u fut në dhomën e vet. Nga dritarja pa Aishen që ecte me kokën ulur, si një vajzë që sapo i kanë hequr perçen.

Të nesërmen nuk e la më Aishen të shkonte në shkollë. Voskopoja filloi të vlonte nga fjalime e zjarrta të Marin Kurilës dhe Sali Benishi bashkë me disa myslimanë të tjerë, mbledheshin çdo natë në shtëpinë e Bari Bakrit. Natën që u vra Marin Kurila, Sali Benishi mbylli dritaren me batanije dhe e mori Aishen në krevatin e tij për herë të parë. Pse qëllojnë kështu, e pyeti vajza. Kanë vrarë Marin Kurilën, i tha ai. Ishte shumë i bukur, tha Aishja duke lexuar si horoskop shenjën që Sali Benishi kishte në kurriz. Ishalla nuk ia kanë prishur fytyrën.

Pas dy ditësh, Sali Benishin e futën në burg dhe Aishja mbeti vetëm për disa muaj. Shkoi të flinte në shtëpinë e Bari Bakrit dhe pasi krihej në mëngjes dhe i lyente flokët me krem dilte me shoqet



në livadhet e myshqeve dhe kthehej pasdite. Ato kohë, fytyra i qeshte. Gjoksi iu rrit dhe pushi i këmbëve iu zgjat. Një natë u vonua shumë dhe Bari Bakri u nis për ta kërkuar. Muzgu i tetorit kishte rënë dhe ngjyrat e myshqeve ishin errësuar. Bari Bakri eci një copë herë, derisa në errësi të dalloi disa këmisha të bardha që lëviznin duke u përzier me njëra-tjetrën. U afrua dhe pa Aishen me dy djem më të mëdhenj se ajo me shall të kuqe. Vajza rrinte ulur dhe po puthej me njërin nga djemtë, ndërsa djali tjetër, me flokë të verdhë, kishte mbështetur kokën në prehrin e saj dhe i kishte futur një dorë poshtë fustanit. Kur Bari Bakri i thirri, djemtë u ngritën, ia dhanë vrapit dhe u zhdukën si hijet e tyre në muzg. Aishja rregulloi fustanin dhe eci në drejtim të të atit. Ç'po bëje ashtu, u çor Bari Bakri me sy të shqyer. Po mësoja fëmijët se si puthet, tha Aishja dhe mori për nga shtëpia. Mëkat, bërtiti Bari Bakri, ti je e martuar. Burri im nuk më puth, baba, tha Aishja dhe vazhdoi rrugën duke shkelur mbi myshqe. Bari Bakri nuk foli por e ndoqi nga prapa si ujku plak këlyshin e vet të pabindur.

Kur Sali Benishi doli nga burgu, e gjeti shtëpinë rrëmujë, të mbushur me pluhur dhe oborrin plot me barut të djegur. Pas një jave ai solli në shtëpi Xhuvrijen dhe dyshemetë filluan të shkëlqenin. Xhuvrija ishte një grua e krishterë në moshën e Sali Benishit. Ajo kishte qenë e martuar me një tregtar sapunësh, i cili u vra nga shokët e Marin Kurilës, i akuzuar si pjesëmarrës në vrasjen e tij. Shtëpia e saj u dogj dhe depot e sapunit të burrit u bastisën. Djali i vetëm studioi në Vjenë dhe nuk ishte kthyer më.

Sali Benishi e takoi një natë në një rrugë të errët ku ajo priste si mace e uritur një nga shokët e Marin Kurilës. Ç'po bën këtu grua, i tha. Po pres të vras vrasësin e burrit tim, tha gruaja. Jemi nisur në të njëjtën rrugë, tha Sali Benishi. Gruaja kishte flokë të zinj, qafën e kishte të zeshkët dhe në faqe i nxinte një nishan që lëshonte një hije në formë katrori. E pa Sali Benishin në sy dhe hëna e plotë ia zverdhi buzët e rreshkura. Kur i tregoi për burrin, për djalin, për djegien e shtëpisë, për vjedhjen e mallit dhe ditët që kishte kaluar duke u endur si jetime nëpër Voskopojë, Sali Benishit iu dhimbs. Plaga e Aishes mbi gjoks i ishte tharë dhe atij iu kujtua Hatixheja. Më mungon, por Zoti po ma zëvendëson, mendoi dhe nguli sytë mbi nishanin e zi që lëvizte i shqetësuar.

Si quhesh, e pyeti. Sofije, u përgjigj gruaja dhe rregulloi flokët si një pelë që ngre jelen, para se t'i vënë samarin. Hajde në shtëpinë time Xhuvrije, tha Sali Benishi dhe eci përpara. Je i martuar, e pyeti gruaja, duke e ndjekur. Jam i martuar me një fëmijë që ka nevojë për një nënë, tha Sali Benishi dhe shtoi: Unë jam mysliman Xhuvrije dhe mund të kem katër gra. Atë natë Xhuvrija fjeti në kuzhinë. Sali Benishi shkoi në dhomën e tij dhe nuk u fut në banjën e Aishes. Në mëngjes shtëpia dukej më e pastër. Xhuvrija kishte fshirë pluhurat, kishte larë tiganët dhe pjatat, i kishte hedhur ujë oborrit të djegur dhe i kishte skuqur Sali Benishit një mëlçi pule me gjalpë.

Aishja ishte zgjuar herët nga zhurmat e enëve që laheshin dhe kur pa Sali Benishin i tha: Na duhej një pastruese. Shtëpisë i duhej një grua dhe ty të duhej një nënë, tha Sali Benishi dhe zbriti shkallët duke ndjekur erën e mëlçisë. Xhuvrija solli disa mobilie që i kishin shpëtuar djegies nga shtëpia e saj. Shkallët i veshi me një qilim të gjatë me viza të kuqe dhe të zeza, mbi tavolinë vendosi një shandan argjendi dhe raftet i mbushi me enë porcelani që burri i saj i kishte blerë në Venedik. Solli dhe një sënduk të madh të mbushur me rrobat e burrit dhe ia dha Sali Benishit që i provoi një nga një, ndërsa Aishja qeshte dhe Xhuvrija i zgjaste çorapet e lara. Burri yt paska qenë i shkurtër, tha Aishja kur pa kyçet e Sali Benishit që dilnin jashtë pantallonave. Djali është më i gjatë se i ti, tha Xhuvrija dhe mbuloi nishanin me dorë.

Në darkë, Sali Benishi shkoi në takimin e zakonshëm në shtëpinë e Bari Bakrit i veshur me kostum të zi, me jakë të trashë dhe këpucë të pastra prej frëngu që kur i hoqi, lëshuan një erë të mirë që mbushi korridorin e Bari Bakrit. Pse je veshur si kaur, e pyeti gruaja e Bari Bakrit. Jam

martuar me një grua të krishterë, tha Sali Benishi dhe e puthi Bari Bakrin e skuqur në faqe. Gruaja e Bari Bakrit doli nga dhoma, tërhoqi derën me zhurmë dhe pështyu mbi këpucët që ndriçonin hajatin e errët të shtëpisë.

Kur Sali Benishi e mori Xhuvrijen në dhomën e tij, pa se gjithë trupin e kishte të mbushur me nishane. Në kurriz tre nishane të mëdhenj formonin një yllësi, por kishte dhe nishane më të vegjël që ecnin në rresht pas njëri-tjetrit, deri te horizonti i hollë i belit të saj. Gjnjtë i kishin rënë dhe kërthiza kishte humbur nën palat e barkut. Por gruaja ishte e lehtë dhe punëtore dhe Sali Benishit nuk iu duk më vetja si një mësues i punëve të trupit. Duke ndjekur kalldrëmin e nishaneve në kurrizin e saj, Sali Benishi dëgjoi një zhurmë në korridor dhe një palë qerpikë që u ngjitën pas derës. Ndaloj dhe ngriti kokën. Duhet të jetë Aishja, tha Xhuvrija që rregulloi frymëmarrjen. Po mëson duke na parë. Sali Benishi qeshi dhe vazhdoi të ecte.

I shtrirë në krevatin e tij, Sali Benishi shikonte hijet dhe kujtonte ditët kur Voskopoja ishte më e qetë dhe Aishja lante trupin, ndërsa Xhuvrija lante shtëpinë. Vizatimet e profetit i sillëshin si hije me ngjyra mbi tavan. Sidomos vizatimi ku profeti ishte i shtrirë dhe tri gra e përkëdhelnin ia kishte prishur gjumin. Ato tri gra dukeshin si gratë e tij. Hatixhja bujare me gjinj të mëdhenj, Aishja e re dhe xhelozë dhe Xhuvrija e vuajtur me nishan në faqe. Nuk kishte rëndësi kush i kishte bërë ato vizatime. Kushdo qoftë, ajo dorë nuk kishte fyer vetëm profetin dhe duhej të pritej. E zuri gjumi me ngjyrat e vizatimeve në sy. Në dhomën tjetër, Aishja flinte, ndërsa Xhuvrija ishte zgjuar për t'i skuqur një mëlçi me gjak.

Dy ditë më vonë në Voskopoje erdhi një hoxhë. Ai mbante një çallmë jeshile në kokë dhe ecte duke fshirë rrugët me xhyben që e ndiqte nga pas si bisht. Ishte një burrë i gjatë dhe i hollë dhe disa qime nën mjekër e tregonin edhe më të gjatë. Duke ecur, ai nuk i fliste askujt, por kalonte nëpër gishta një palë tespihe të verdha, rruazat e mëdha të së cilës dukeshin si hurma të vogla që lëviznin me shpejtësi.

Hoxha kaloi përpara katedrales, pastaj u fut në lagjen e armëtarëve dhe u drejtua nga lagjja e re. E dinte rrugën, a thua se kishte qenë edhe më parë në Voskopoje.

Fëmijët nuk kishin parë kurrë hoxhë. Ata e ndiqnin nga pas duke u përpjekur të gjenin sa gogla kishte tespihja e tij. Një djalë me shall të kuq i doli hoxhës përpara dhe i tha: Sa gurë ka tespihja jote? Hoxha ndaloj, ngriti tespihen mbi kokën e djalit dhe goglat u skuqën nga rrezet e diellit. Numëroji, tha hoxha duke ia afuar djalit tespihen. Ai i numëroi një nga një, por rruazat e lëmuara binin me shpejtësi mbi njëra-tjetrën dhe djali që e ndjeu se po ngatërrohej tha: Katërmbëdhjetë. Hoxha ia afroi edhe më shumë pranë fytyrës dhe duke fërkuar mjekrën e vogël tha: Numëroji prapë. Djali, që kishte nisur të djersitej nga sikleti, zgjati gishtin mbi tespihe dhe i kaloi rruazat edhe një herë duke shtrënguar mes gishtave çdo gur që numëronte, në mënyrë që ai të mos binte poshtë dhe të numërohej dy herë. Kur mbaroi, mori frymë dhe tha: Trembëdhjetë.

Po, tha hoxha, aq janë.

Pse janë trembëdhjetë, e pyeti një djalë tjetër që ishte afuar duke parë. Trembëdhjeta është numri i hurmës dhe hurma është fruti i Muhamedit, tha hoxha. Djemtë panë njëri-tjetrin në sy. Rreth tyre ishin grumbulluar shumë fëmijë të tjerë, ndërsa gratë kishin dalë nëpër dyer dhe dëgjonin. Kush është Muhamedi, pyeti një djalë i vogël të ëmën. Ai burri me tri gra që ishte vizatuar në mur, tha gruaja.

Hoxha bëri sikur nuk e dëgjoi dhe pyeti djemtë: Sa germa ka fjala hurmë? Pesë germa, u përgjigj djali me shall të kuq. Aq ka, tha hoxha dhe vazhdoi: Alfabeti juaj grek ka 24 germa dhe *h*-ja është germa e njëzetedytë, *o*-ja është germa e pesëmbëdhjetë, *r*-ja është e shtatëmbëdhjeta, *m*-ja e dymbëdhjeta dhe *a*-ja e para. Fjala hurmë shkruhet *hurma*. Sa është shuma e gjithë këtyre numrave, i pyeti hoxha djemtë. Ata filluan të numërojnë të gjithë në kor dhe kur njëri ngatërrohej

tjerët e korrigjonin. Gjashtëdhjetë e shtatë, tha pas pak njëri nga djemtë. Hoxha rrotulloi tespihet në dorë dhe tha: gjashtëdhjeteshtata formohet nga një gjashtë dhe një shtatë. Sa bëjnë gjashtë edhe shtatë? Trembëdhjetë, thanë djemtë me një zë. Prandaj tespihet e mia kanë trembëdhjetë rruaza.

Një nga shokët e Isakut që e kishte ndjekur hoxhën nëpër qytet pa u vënë re dhe që ishte afruar për të dëgjuar bisedën e tij me fëmijët tha: Tespihja ka rruaza sa ç'ka mëhalla Voskopoja.

Hoxha e dëgjoi dhe ktheu kokën. Tespihja lëvizi me shpejtësi në dorën e tij të thatë, ndërsa qimet e mjekrës iu zgjatën nga shoku i Isakut. Voskopoja ka trembëdhjetë lagje, por unë kam ardhur t'i ndërroj tespihet. Më kanë thënë se këtu ka zanatçinj të zotë që i shpojnë gurët me plumb. Do t'i shtoj edhe një gur nga Voskopoja tespihes time, tha hoxha dhe duke skërmitur dhëmbët shtoi: Do ta bëj tespihen me katërmbëdhjetë gurë.

Djemtë e vegjël me shall të kuq nuk e dëgjuan. Ata kishin mësuar nga hoxha një lojë të re dhe duke thirrur me zë të lartë emrat e njëri-tjetrit filluan t'i numërojnë geramat, sipas renditjes në alfabet.

Shoku i Isakut u afrua dhe qimet e hoxhës i prekën supin. Në Voskopoje nuk bëhen tespihe me qime, por me litar. Qimja jote është shumë e hollë dhe nuk e mban peshën e gurëve. Hoxha e pa djalin drejt e në sy, rrotulloi tespihet që kërcitën si të pickuara nga gishtat e tij dhe duke lëvizur tha: Trupi varet në litar, por shpirti varet në qime.

Djali e shoqëri me sy derisa ai u fut në lagjen e të huajve ku disa burra që po e prisnin i puthën dorën. Nga larg, kokat e tyre të përkulura dukeshin si gurë tespihe.

Atë natë, hoxha qëndroi në shtëpinë e Sali Benishit. Ky thirri dhe disa burra të tjerë, me disa prej të cilëve kishte qenë në burg, dhe dhoma u mbush plot tym dhe erë çorapësh. Burrat i kishin hequr këpucët përpara se të hynin. Në krye të dhomës ishte ulur hoxha, i cili e lëvizte me ngadalë tespihen e verdhë. Në krahun e tij të majtë qëndronte Sali Benishi, ndërsa në të djathtin Bari Bakri i menduar.

Kur u mblodhën të gjithë dhe asnjëri nuk pritej më të vinte, Sali Benishi u ngrit në këmbë dhe tha: Myslimanë të nderuar të Voskopojes. Ora jonë ka ardhur. Jemi mbledhur për të vendosur fatin tonë. Në këtë qytet deri më sot na kanë trajtuar si të huaj. Të krishterët nuk na dhanë tokë për shtëpi, na i dëbuan fëmijët nga shkollat, na burgosën dhe na vranë. Ata kanë gjithçka në Voskopoje: kanë shtëpi, kanë dyqane, kanë shkolla, kanë kisha, kanë shtypshkronjë, kanë libra, kanë armë, kanë burgje dhe kanë Këshillin. Ata kanë pasurinë e Voskopojes, ndërsa ne kemi varfërinë.

Në burg, bashkë me shumë burra të tjerë si unë, kuptova se ne myslimanët jemi fajtorë për gjendjen tonë. Ne kemi pranuar të jetojmë si kafshë shtëpiake që e puthin dorën e të zotit edhe kur ajo e rreh edhe kur ajo e lë pa bukë edhe kur ajo e dëbon nga shtëpia. Por duke u sjellë kështu nuk kemi fyer vetëm veten tonë, por kemi fyer Islamin. Duke na poshtëruar ne, të krishterët kanë poshtëruar Islamin. Ata kanë dashur t'i tregojnë botës se Islami është një farë që nuk mbin në Voskopoje. Ne kemi ulur kokën si një farë e paushqyer dhe vëllezërit tanë myslimanë në të gjithë perandorinë nuk e kanë parë vuajtjen tonë. Ne nuk kemi folur dhe prandaj nuk jemi dëgjuar. Ne nuk kemi mbirë dhe prandaj nuk jemi ushqyer. Ne nuk kemi pirë dhe prandaj nuk na kanë dhënë ujë. Ne nuk jemi ngritur dhe prandaj nuk kemi ecur. Ne nuk kemi ecur dhe prandaj kemi mbetur në vend. Ne nuk kemi qarë dhe prandaj nuk kemi lot. Ne nuk kemi luftuar dhe prandaj nuk kemi armë. Ne nuk jemi falur dhe prandaj nuk kemi xhami. Ne jemi të huaj dhe prandaj mëhalla jonë quhet mëhalla e të huajve. Ne nuk kemi tokë dhe prandaj nuk kemi qiell, nuk kemi sy prandaj nuk kemi diell, nuk kemi gojë prandaj nuk kemi ujë, nuk kemi

duar prandaj nuk kemi bukë, nuk kemi dritë dhe prandaj nuk kemi hije, nuk kemi shpirt prandaj nuk kemi zjarr. Ne thjesht nuk jemi dhe prandaj nuk kemi qytet.

Kur isha në burg në mes të natës dhe ngrohesh me frymën e shokëve dhe zgjohesha nga kambanat e kishave që ma shurdhonin shpirtin si një varr, pyesja veten: Si ka mundësi që unë kam sy dhe nuk shoh, që kam veshë dhe nuk dëgjoj, që kam gojë dhe nuk ha, që ka këmbë dhe nuk eci, që kam duar dhe nuk punoj, që kam kokë dhe nuk mendoj, që kam shpirt dhe nuk besoj, që kam gjumë dhe nuk ëndërroj, që kam uri dhe nuk ha, që kam fuqi dhe nuk lëviz, që kam zemër dhe nuk ndiej, që kam zë dhe nuk flas, që kam gjak dhe nuk luftoj. Si ka mundësi që unë jam dhe nuk jetoj?

Gjithë këto ditë e kam munduar veten time me pyetje dhe trupi im ka më shumë plagë nga brenda se nga jashtë. Zemra ime ka më shumë uri se stomaku im dhe mendja ime ka më shumë lot sesa sytë e mi. Unë e di që dhe ju të gjithë vuani si unë.

I torturuar nga pyetjet e mia, dërgova fjalë në Korçë dhe thirra një njeri që i di përgjigjet e pyetjeve tona. Me urtinë e tij ai ka shëruar qindra myslimanë të pashpresë dhe ka ngritur në qiell ëndrrat e shumë të tjerëve që, ashtu si ne, e kishin humbur shpresën. Ai iu përgjigj thirrjes sonë dhe ja ku është këtu dhe mezi pret që t'i qetësojë shpirtin tanë dhe t'i japë dritë syve tanë të mbyllur. Unë besoj se kjo ditë do të mbahet mend në historinë e Voskopojës, si dita kur myslimanët kuptuan se perëndia nuk punon vetëm për të krishterët.

Sali Benishi u ul dhe u kthye nga hoxha. Ashtu bënë dhe gjithë burrat që ishin në dhomë.

Hoxha e lëshoi tespihen në tokë, në mes të këmbëve të tij të zathura, dhe iu drejtua Sali Benishit: Mirë se të gjeta, o vëllai i vuajtjes sime!

Falë jush dhe falë Zotit jam në këtë qytet të shenjtë, të cilin perëndia ka vendosur t'ia dhurojë myslimanëve. Perëndia është atje lart dhe pret që myslimanët të marrin dhuratën që iu ka bërë.

Gjithë këto unë, bashkë me myslimanët e tjerë, poshtë në Korçë, kemi pritur që ju të zgjoheni, të hapni sytë dhe të kuptoni se dita për të marrë dhuratën që ju takon ka ardhur. Nga fusha e Korçës ne shihnim se si kryqet e të krishterëve ngriheshin mbi malet e Voskopojës dhe e dinim që një ditë Allahu i madhërishtëm do të inatosej dhe do t'u kërkonte myslimanëve që t'i jepnin fund këtij dhunimi. Allahu është i durueshëm. Ai nuk do që njerëzit të zihen për të, por kur durimi humbet dhe kur ai shikon se nuk janë myslimanët ata që gëzojnë të mirat që ai dërgoi në tokë, por përkundrazi janë të tjerët, të pafetë, atëherë ai vepron. Ajo që po ndodh në Voskopojë prej shumë muajsh është vullneti i Zotit. Dësh Zoti që drejtësia të vihej në vend dhe pushtimi i Voskopojës nga të krishterët u prish. Dësh Zoti që një bandit, i cili donte të vriste dhe të dëbonte myslimanët nga Voskopoja, të zhdukej dhe ai u mbyt në mëkatit e tij. Dësh Zoti që të krishterët të merrnin një ndëshkim për të gjitha vuajtjet dhe mizoritë që u kanë bërë myslimanëve në Voskopojë, dhe ata u gjakosën, u varfëruan, u shkatërruan dhe shumë prej tyre ikën të lebetitur duke humbur pasuritë dhe familjet e tyre. Dësh Zoti që Këshilli i qytetit, që drejtonte kundër ligjeve të kuranit famëlart, të zhbëhej për të gjitha vendimet e padrejta dhe hakmarrëse që ka marrë kundër myslimanëve, dhe këshilli u zhbë dhe nuk do të bëhet më. Dësh Zoti që librat e Voskopojës, të shkruara me shkronjat e të pafeve, të mos e shihnin më dritën e diellit, dhe ashtu u bë dhe libra nuk ka më. Dësh Zoti që pija, vera dhe dehja të dënoheshin si veprime të paturpshme që i çojnë myslimanët në tradhti dhe në pabesi dhe tavernat e fëlliqura u mbyllën he burrat nuk pinë më. Dësh Zoti që fëmijët e besimtarëve të devotshëm të dallohen nga ata të jobesimtarëve të pafe dhe këtyre të dytëve u lidhi një shall në qafë që t'ua marrë frymën sa herë t'i dallojë nga lart ku qëndron. Dësh Zoti që bijtë e tij myslimanë të torturuar, të poshtëruar, të uritur dhe të robëruar të liroheshin nga burgu dhe ata u liruan dhe ja ku janë sot duke pritur urdhrin e tij. Dësh Zoti që unë të jem këtu dhe unë ja ku jam për ta prishur vetminë tuaj, për t'i

dhënë ujë buzëve të etura, për t'i dhënë dritë syve të mbyllur, për t'i dhënë frymë zemrave të dobëta, për t'i dhënë qumësht gjinjve të tharë, për t'i dhënë gjak muskujve të lodhur, për t'i dhënë zë veshëve të shurdhët, për t'i dhënë bukë gojëve të uritura, për t'i dhënë nënë dhe baba jetimëve, për t'i dhënë shpirt të gjallëve, për t'i dhënë varr të vdekurve, për t'i dhënë duar të pambrojturve, për t'i dhënë armë të sulmuarve, për t'i dhënë tokë endacakëve, për t'i dhënë forcë luftëtarëve, për t'i dhënë dije të paditurve, për t'i dhënë një qytet myslimanëve, për t'i dhënë një Zot Voskopojës.

Vëllezër, unë dua t'ju tregoj se si mashtrimi ka nisur qysh kur Voskopojës iu ndryshua emri. Të krishterët e ndryshuan emrin e qytetit duke ia fshehur myslimanëve mesazhin e Zotit. Në kohët e lashta qyteti quhej *Moskopolis*, por të pafetë, që shkruajnë libra me germa greke, e ndryshuan emrin dhe thanë se qyteti quhej *Muskopolisi*, që do të thotë Qyteti i Myshkut. Por Zoti nuk mund t'i vinte dhuratës së vet emrin e një bime që e ka krijuar për t'i hequr erën sjetullave të grave. Nga myshku dalin parfumet që gratë e liga i përdorin kur duan t'i marrin mendjen burrave të grave të tjera. Parfumi vjen nga myshku që është një bimë mëkati sepse Zoti e ndalon çdo gjë që përdoret për të ngjallur epshin dhe dashurinë trupore ashtu siç ka ndaluar pijen që e fryn stomakun, e lodh zemrën dhe e deh trurin e njeriut. Përdorimi i parfumit duhet kontrolluar, sepse është i rrezikshëm. Moskopolis, pra, nuk mund të ishte dhe nuk është qyteti i myshkut. Moskopolis do të thotë Qyteti i Xhamive. Italianët dhe francezët në gjuhën e tyre i thonë *moschea* ose *mosquee*, pra *moske*, xhamive tona. Duke e ditur se kjo fjalë do t'i ndryshonte historinë këtij qyteti ata e ndryshuan një germë dhe nga *Moskopolis* e quajtën *Muskopolis*.

Për shkak të këtij mashtrimi, sot myslimanët trajtohen si të huaj në qytetin e tyre dhe në vend të xhamive këtu janë ngritur kishat. Nuk është hera e parë që historia ndryshon nga një germë apo nga disa germa. Në artin e ndryshimit të germave, të krishterët janë mjeshtër dhe djaj. Edhe Bibla, libri i tyre, është një bashkim djallëzor germash, i cili mund të lexohet në mënyra të ndryshme. Të krishterët kanë fshehur edhe emrin e Muhamedit, i cili del në Bibël qindra vjet përpara se Muhamedi të lindte.

Jezusi nuk ishte profeti i fundit. Zoti e dërgoi atë në tokë për të lajmëruar njerëzit për ardhjen e Muhamedit. Ky ishte qëllimi i vërtetë i profecisë së Jezu Krishtit, por sigurisht kjo e vërtetë është fshirë nga të krishterët duke ndryshuar gerrat, të cilat nëse vendosen ndryshe në radhë japin kuptime të ndryshme të fjalëve të Zotit. Përgjegjës për këtë mashtrim kanë qenë grekët, të cilët në fillim e kanë përdorur alfabetin e tyre për t'i vjedhur fenë çifutëve dhe pastaj për t'i mohuar njerëzve Islamin si të vetmen fe në të cilën dhe prej së cilës perëndia kërkon të nderohet. Fjala *islam* vjen nga fjala hebre *shalom*, që do të thotë paqe dhe prandaj dhe fjalët *selam* dhe *islam* kanë të njëjtin kuptim. Islami ka qenë feja e vërtetë e Abrahamit, babait të gjithë profetëve, i cili bashkë me të birin e tij, Ismailin kanë qenë myslimanë.

Islamin dhe ardhjen e Muhamedit e ka parashikuar në Testamentin e Vjetër edhe profeti Jeremia, të cilit Zoti iu shfaq me një degë bajameje në dorë. Jeremia parashikoi Islamin dhe ja çfarë thotë ai në vargun nëntë të kapitullit të njëzetetë të Testamentit të Vjetër: Profeti që profetizon paqen, pra *shalom*, *selam*, *islam*, kur fjala e tij të realizohet, do të njihet si një profet i vërtetë i dërguar nga Zoti.

Shalomi, selami dhe islami janë e njëjta gjë, pra kanë qenë feja e vërtetë e Zotit. E ç'mund të donte tjetër Zoti në tokë përveç paqes mes njerëzve? Por siç tha profeti Jeremia, që mbante erë bajame, ai që do të vinte do të ishte profeti i vërtetë. Në shkrimet e lashta të çifutëve është folur për Muhamedin dhe megjithëse grekët janë lodhur duke e shkruar Biblën greqisht e vërteta nuk është fshirë dot. Çifutët dhe vetë Jezu Krishti me të gjithë apostujt e ti nuk kanë folur greqisht. Shumë kohë pas vdekjes së tyre, grekët, që ishin xhelozë sepse nuk kishin një fe të tyre, i morën

librat e shenjtë dhe pasi i ndryshuan, i përkthyen siç deshën, duke zhdukur të vërtetat e shenjta. Kjo ndodhi gati treqind vjet pas Krishtit kur grekët morën Kostandinopojën dhe vendosën me shpatë dhe me ligj që ungjijtë të lexoheshin vetëm në gjuhën e tyre. Grekët janë fajtorë për ndryshimin e fjalëve të Zotit. Atëherë pse të krishterët pranojnë që librat e tyre të merren nga greqishtja që është një gjuhë në të cilën nuk ka folur asnjë prej profetëve? As Ibrahim, as Jeremia, as Musai dhe as Isai nuk kanë folur greqisht. Feja që ata kanë pasur ka qenë shalomi apo islami dhe gjuha që ata kanë folur ka qenë një rrënjë e hebraishtes nga e cila mori disa fjalë gjuha arabe që foli Muhamedi. Para Muhamedit, asnjë njeri nuk quhej kështu dhe kjo tregon se Zoti e kishte ruajtur këtë emër për profetin e fundit që ishte dhe më i dashuri. *Muhamed* do të thotë më i dashuri, më i çmuari, më i ëmbli dhe më i pranuari. Ky emër, siç thashë, del në Testamentin e Vjetër dhe vjen nga fjala hebre *hamad* që shkruhet me tri germa *h-md* dhe që do të thotë të kesh dëshirë, të duash, të dëshirosh. Një motër binjake e kësaj fjale shkruhet *mahmad* ose *mahamod* që do të thotë më i lakmuari, më i dashuri, më i çmuari dhe më i këndshmi. *Muhamed* dhe *Mahamod* është e njëjta fjalë dhe nuk tregon asgjë tjetër, përveç profetit tonë të ndritur, të cilit djallëzia e alfabetit grek nuk i ka fshirë dot origjinën e shenjtë ashtu siç ka bërë me Voskopojën.

Sot, Voskopoja është burgosur nga alfabeti grek dhe librat që shkruhen me këto germa. Grekët i kanë larguar shqiptarët nga feja e vërtetë e Zotit dhe i kanë pushtuar mendjet e fëmijëve me këto germa. Ata thonë se të gjithë shqiptarët e krishterë janë grekë dhe se të gjithë myslimanët janë turq. Duke detyruar Jezu Krishtin të fliste greqisht, treqind vjet pas vdekjes së tij, ata ndërtuan Perandorinë e Bizantit, të cilën ia morën romakëve dhe e greqizuan përmes priftërinjve dhe ungjijve që i falsifikuan për të ndryshuar historinë e Zotit dhe të njerëzve.

Kur mashtrimi i grekëve filloi të zbulohet, të krishterët u ndanë. Italianët, francezët, gjermanët dhe anglezët nuk pranuan më të drejtohen nga patriarkët grekë të Kostandinopojës dhe krijuan kishën e tyre të Romës që ata e quajnë kisha e vërtetë. Kështu Bizanti mbeti vetëm grek dhe u dobësua derisa u rrëzua si çdo shtëpi që ngrihet mbi një themel të gënjeshtërt. Por grekët nuk hoqën dorë dhe vazhduan të mbjellin farën e mashtrimit të tyre në Ballkan dhe kështu ata i ndanë kishat e shqiptarëve, bullgarëve dhe serbëve nga kishat e Evropës dhe pastaj i hodhën ato kundër myslimanëve. Grekët i urrejnë turqit jo vetë sepse ata, nën flamurin e Muhamedit, i morën Kostandinopojën, por sepse duke ditur të vërtetën e librave të shenjtë ata e dinë se Islami dhe myslimanët janë feja që kanë dashur të gjithë profetët nga Ibrahim deri tek Isai.

Historia e Kostandinopojës vërteton se në anën e kujt është perëndia. Në qoftë se perëndia do kishte marrë anën e grekëve, siç bëri në Trojë, atëherë turqit nuk do ta kishin pushtuar dot Kostandinopolin. Por perëndia ishte me turqit dhe me të gjithë myslimanët që nga dita që Muhamedi ua ndriçoi atyre mendjen dhe u hapi sytë për të parë. Që nga kjo ditë Islami nuk ndalet. Asnjë fuqi nuk e mposht dot, asnjë ushtri nuk e mund, asnjë det nuk e mbulon, asnjë sëmundje nuk e dobëson. Asnjë perandori mbi tokë nuk ka qenë më e fortë dhe më e gjerë, nga Mesdheu deri në Indi, nga Voskopoja deri në Medinë, nga shkretëtirat arabe deri në stepat ruse. Muskujt e kësaj perandorie janë popujt myslimanë, shpirti i saj është Islami, truri i saj është Kurani dhe prijësi i saj është Muhamedi. Qëllimi i kësaj perandorie është paqja mbi të gjithë popujt. Por kjo paqe nuk mund të arrihet nëse të gjithë njerëzit nuk besojnë në Islam dhe nuk i binden të njëjtit Zot. Turqit luftojnë dhe pushtojnë toka, fshatra dhe qytete në emër të këtij besimi. Ata i binden urdhrin të Muhamedit dhe sot janë vetëm shpata e tij, por synimi i tyre nuk është krijimi i një Perandorie Turke, por shtrirja e fesë së Muhamedit në çdo cep të botës. Kur kjo të ndodhë dhe gjithë bota të hyjë nën çallmën e Muhamedit, atëherë nuk do të ketë më luftë, sepse nuk do ketë më arsye për të luftuar, atëherë nuk do ketë më varfëri sepse nuk do ketë më të

pasur, atëherë nuk do ketë më sëmundje sepse nuk do të ketë më ndëshkime nga Zoti, sepse e gjithë bota do jetë Islam, pra do jetë në paqe.

Shqiptarët myslimanë ishin të parët që i ikën fesë së rreme të grekëve dhe hynë në Islam. Ata nuk janë turq dhe nuk ka pse të bëhen turq sepse Zoti nuk ua kërkon atyre këtë gjë. Kur bota të bëhet e gjitha Islam, nuk do ketë më turq, shqiptarë, grekë, arabë, serbë, italianë, rusë, gjermanë apo rumunë. Bota do të ketë vetëm një popull: Popullin mysliman, të cilin Muhamedi e drejton në rrugën e Zotit.

Kur krijoi Ademin dhe Havanë, perëndia kishte vendosur që të gjithë njerëzit të ishin pjesë e një populli. Por njerëzit filluan të mëkatonin dhe të mos e nderonin më perëndinë e tyre dhe prandaj ajo vendosi t'i ndëshkojë dhe t'i ndajë në qindra fise, gjuhë dhe fe të ndryshme për të kuptuar se kush prej tyre do ta nderonte më shumë. Bashkimi i njerëzve në një popull dhe në një gjuhë dhe fe të vetme është qëllimi i fundit. Shumë njerëz janë përpjekur ta arrijnë, por nuk ia kanë dalë dot sepse po nuk bashkove fetë nuk bashkon dot popujt. Më afër nga të gjithë është Muhamedi dhe Islami, të cilët ne i përkasim. Prandaj, duke u bërë me turqit ne jemi bërë me Muhamedin, i cili i mësoi turqit të ngrinin shtetin e tyre mbi Kuran. Duke u bërë me turqit, ne jemi më afër Islamit dhe do ta përfitojmë përpara popujve të tjerë lumturinë dhe drejtësinë që ai përcjell. Duke u bërë me turqit ne jemi më të fortë, më të pasur, më të drejtë, më të sigurt, më të ditur, më të zgjuar dhe nuk jemi vetëm. Kështu e kemi më të lehtë të zbojmë të ligën, të largojmë të keqen, të marrim toka, të fitojmë beteja dhe të drejtojmë qytetet tona.

Voskopoja është një ishull i krishterë nga i cili duan të na zbojnë. Do ta kishin bërë pa asnjë mëshirë duke i vrarë burrat myslimanë, duke i përdhunuar gratë e tyre, duke i lënë fëmijët pa prindër. Nuk e kanë bërë akoma dhe a e dini pse? Mos mendoni se janë të mëshirshëm. I krishteri nuk ka mëshirë dhe ju nuk duhet t'ia njihni për nder mbijetesën tuaj, mëshirës kristiane. Nuk ju kanë dhunuar nga frika dhe jo nga mëshira. Ata e dinë se turqit dhe perandoria e tyre ju mbron. Ata e dinë se, në rast se ju shfarosin vetëm se jeni myslimanë, turqit do vijnë dhe do hakmerren për ju duke i shfarosur ata. Ata nuk e durojnë dot erën tuaj në ishullin e tyre, por i mbyllin hundët nga frika, nuk i durojnë dot faljet në xhamitë tona dhe i mbyllin veshët nga e vërteta, nuk i durojnë dot perçet e grave tona dhe i mbyllin sytë nga virtyti.

Por në Islam nuk ka ishuj. Islami është një det i gjerë dhe i qetë në të cilin nuk mbytet ai që hyn, por ai që del jashtë. Voskopoja nuk mund të jetë një ishull në detin tonë. Në qoftë se del jashtë do të kesh fatin e të mbyturit, por ne duhet ta shpëtojmë dhe prandaj jemi këtu.

Islam do të thotë paqe, por paqja mbrohet duke luftuar. Nuk do kishte Islam nëse Muhamedi nuk do luftonte të gjithë ata që luftuan Islamin. Nuk do kishte paqe nëse myslimanët nuk do të kishin sulmuar ata që nuk e pranuan Islamin. Kur u bë mysliman, Muhamedin e dëbuan nga Meka që ishte qyteti i tij i lindjes. Ai shkoi në Medinë dhe atje ngriti xhaminë e parë, atje u martua me Aishen, gruan e tij të dashur, atje i ktheu arabët në Islam, atje mundi çifutë e mallkuar që donin ta vrisnin, atje u nis dhe fitoi luftërat me fiset kundërshtarë të Mekës, atje dhe vdiq. Voskopoja është si Medina. Një qytet ku u grumbulluan muhaxhirët e dëbuar nga të gjitha tokat arabe dhe ku të bashkuar ata i zbuar çifutët dhe e kthyen qytetin në tempullin e parë të Islamit. Por myslimanët e parë u përdoqën, u mbytën, u gjakosën, u tallën dhe u çnderuan, e megjithatë ata nuk u dorëzuan. Mendoni si myslimanët e parë dhe do të shpëtoni nga dëbimet, nga burgjet, nga talljet dhe do keni Medinën tuaj. Në Medinë, ashtu si në Voskopojë, çifutët kishin tregtinë, kishin tokat, kishin pasurinë, kishin poezinë, kishin pazarin, kishin devetë, kishin bagëtitë, kishin hurmat, kishin armët, kishin tempujt e tyre, ndërsa muhaxhirët myslimanë nuk kishin asgjë, përveç Islamit. Duke luftuar ata i morën të gjitha.

Do t'ju tregoj për historinë e një poeti çifut që e urrente Muhamedin. Ai quhej Kab dhe ishte një nga prijësit kryesorë të Medinës. Babai i tij ishte arab, ndërsa nëna çifute. Kabi ishte shumë i pasur, i zgjuar i bukur dhe shumë i njohur. Kur Muhamedi erdhi në Medinë, çifutët e kuptuan se ai do ta shkatërronte besimin e tyre. Ndërkohë, shumë arabë në Medinë e besuan Muhamedin dhe u bënë myslimanë. Me këta burra, Muhamedi filloi të rrëmbente karvanët që shkonin në Mekë dhe fuqia e tij u rrit. Muhamedi i kërkoi çifutëve të bëheshin myslimanë ose përndryshe të largoheshin nga Medina. Disa herë çifutët u përpoqën ta vrisnin Muhamedin, por gjithmonë ai shpëtoi, i lajmëruar nga Zoti. Duke parë se ishin të pafuqishëm, çifutët filluan të ngacmojnë myslimanët dhe sa herë që Muhamedi dilte në rrugë ata e shanin dhe e përqeshnin, të nxitur nga Kabi.

Kabi u thoshte njerëzve se Muhamedi ishte një mashtrues, se feja e tij ishte e rreme, se gratë myslimane ishin të papastra, se myslimanët ishin analfabetë, se ata duhej të shporreshin nga Medina. Duke u tallur me Muhamedin, Kabi u bë i famshëm dhe armiqtë e fisit të tij, të cilët e urrenin Muhamedin, e thirrën atë në Mekë. Kabi i hipi një deveje të re, të zbukuruar me copa me ngjyra dhe byzylykë të argjendta të futur në hundë. Vetë ishte veshur me një këmishë të bardhë dhe kur hyri në Mekë me kokën lart, si një profet i lumtur, paria e priti me nderime të mëdha. I bënë shumë dhurata dhe kudo ku ai ecte, gratë i hidhnin lule dhe burat shtronin qilima të thurur. Ato ditë në Mekë u bë festë dhe të gjithë mendonin se Kabi do t'i ndihmonte për të shpëtuar nga myslimanët që u vidhnin karvanët dhe që i kishin ndarë fiset e qytetit. Poeti i bukur i mblidhte të rinjtë e Mekës në shesh dhe në darkë me një gotë verë në dorë këndonte poezi të gjata kundër myslimanëve, duke i poshtëruar ata. Njerëzia mblidheshin si miza përreth tij dhe e pyesnin: Kush është më e vërtetë feja jonë, apo ajo e Muhamedit? Kabi vinte dorën e tij të bardhë mbi rërën e nxehtë dhe duke parë mbi kokat e njerëzve përgjigjej: Nëse feja e Muhamedit është e vërtetë atëherë më mirë të jetosh nën tokë se mbi tokë. Turma ulërinte nga gëzimi. Në këtë kohë, në Mekë, urrejtja për Muhamedin ishte shumë e madhe sepse ai u kishte rrëmbyer atyre disa karvanë me plaçka dhe pasuri, u kishte marrë devetë dhe shumë burra i kishte vlarë dhe gratë e djemtë i mbante rob në Medinë. Kabi, që e dinte sesa vuanin mekasit për fyerjen dhe vrasjet që kishin pësuar nga Muhamedi, i nxiste ata që të merrnin hak për të vdekurit duke recituar këto vargje që u mësuan edhe nga fëmijët e vegjël: *ai që përhap lajmin jetoi i poshtëruar, i verbër dhe shurdh.*

Gratë e Mekës tërboheshin nga fjalët e poetit dhe betoheshin se do t'i hanin mëlçitë e myslimanëve që kishin vlarë djemtë dhe burrat e tyre. Kur Kabi u kthye në Medinë ai i mblodhi fiset çifute dhe u tha se kishte biseduar me tregtarët e pasur dhe të fuqishëm të Mekës, të cilët do të vinin për të vlarë Muhamedin dhe për t'i dëbuar myslimanët.

Muhamedi, i hidhëruar nga shpifjet dhe poshtërimet e Kabit, një ditë thirri shokët e tij dhe u tha: Poeti ka shqetësuar Allahun. Kush nga ju do ta qërojë atë? Njëri nga shokët e Muhamedit u ngrit dhe e pyeti: Muhamed ti do që unë ta vras Kabin? Po, i tha Muhamedi. Atëherë tre burra u ngarkuan për vrasjen e Kabit. Njëri prej tyre i shkoi Kabit në shtëpi duke e sharë, kinse, Muhamedi si përçarës të arabëve dhe si një njeri që e merrte për vete gjithë mallin që u rrëmbehej karvanëve. Jemi të uritur, tha burri dhe i kërkoi Kabit t'i jepte pak grurë hua. Do ta jap, i tha Kabi, por duhet të më japësh një peng. Çfarë do, e pyeti shoku i Muhamedit. Më jep peng gruan tënde, tha Kabi. Shoku i Muhamedit u skuq dhe iu përgjigj: Nuk mund ta jap gruan sepse ti je shumë i bukur dhe ajo do të flinte me ty e unë do të turpërohesha. Poeti pranoi dhe më në fund ata ranë dakord që të linin armët peng. Shoku i Muhamedit mori grurin, la armët në shtëpinë e Kabit dhe iku. Pasi kishte fituar besimin e poetit, një natë ai shkoi në shtëpinë e tij dhe e thirri. Kabi u zgjua, por gruaja i tha të mos dilte. Ky ë pikon gjak, tha gruaja e frikësuar duke e



shtrënguar poetin në krahët e saj të zhveshur. Por Kabi i tha se burri që po e kërkonte ishte miku i tij që ai i kishte dhënë bukë për të ushqyer fëmijët. I kam dhënë bukë dhe nuk mund të më vrasë, tha poeti. Shoku i Muhamedit kishte ardhur bashkë me dy të tjerë, të cilëve u tha se kur ai ta kapte Kabin nga flokët kjo do ishte shenja se ata duhej të afroreshin për ta vlarë.

Burrat e tjerë u fshehën kur Kabi doli nga shtëpia. Ecim dhe bisedojmë pak, i tha shoku i Muhamedit dhe poeti pranoi. Hëna ndriçonte përgjysmë dhe një re e zezë ia fshihte fytyrën shokut të Muhamedit. Pjesa e ndritshme e hënës shkëlqente mbi kokën e bukur të poetit. Dukesh si një deve e etur, i tha Kabi, çfarë ke? Shoku i Muhamedit u përpoq të qeshte, iu afrua Kabit dhe i tha: Sa erë të mirë që mban, nuk kam ndier kurrë një parfum të tillë si ky që ke lyer kokën. Kabi qeshi dhe i tregoi se gruaja e tij i përgatiste vetë parfumet me barëra dhe me myshqe të ndryshme. A t'i marr pak erë flokëve të tu, e pyeti shoku i Muhamedit dhe poeti pranoi. Burri i mori erë kokës që shkëlqente si një diell pastaj e kapi fort nga flokët dhe thirri shokët e tij të fshehur në errësirë. Këta u turrën me vrap dhe e therën poetin me thikat e tyre. Ia prenë kokën dhe shkuan në shtëpinë e Muhamedit.

Ky po i priste dhe kur shokët ia hodhën kokën te këmbët, Muhamedi u habit nga bukuria e saj dhe dhoma u mbush me erën e parfumit. Muhamedi mbeti një copë herë duke parë kokën dhe pastaj duke i bekuar shokët e tij tha: Kjo gojë nuk e meritonte një kokë kaq të bukur.

Historia e Kabit tregon se çfarë e pret atë që tallet me profetin, se si shkurohet gjuha e atij që bën vjersha të turpshme dhe se si pritet dora e atij që vizaton ndyrësira nëpër muret e qytetit, siç ndodhi në Voskopoje. Por ndëshkimi është i domosdoshëm për t'i zbutur shpirtrat e ligj dhe kështu ndodhi në Medinë. Pas vrasjes së Kabit çifutët u frikësuan dhe nisën të ikin nga Medina që u bë përfundimisht qyteti i myslimanëve. Poetët e tjerë e mbyllën gojën dhe vargjet e kuranit ishin të vetmet që recitoheshin në qytet. Myslimanët morën shtëpitë, tregun, dhe disa çifutë u bënë myslimanë. Muhamedi vazhdoi sulmet e tij mbi të pafetë e Mekës dhe pas disa kohësh asnjë karvan nuk futej dot në qytet pa lejen e tij derisa mekasit e dobësuan e lejuan të kthehej në qytetin ku kishte lindur dhe ai bëri haxhin në vendin e shenjtë, në Qaben e ngritur nga Ibrahim i dhe Ismaili. Sakrifika, burrëria dhe durimi i Muhamedit dhe muhaxhirëve që u bashkuan në Medinë kishte triumfuar. Ata fituan sepse u bashkuan në Islam.

Unë kam ardhur sot në Medinën tuaj për t'ju thënë se sakrifika, lufta dhe gjaku i myslimanëve të parë është drita që ndriçon rrugën tuaj. Në qoftë se dorëzoheni, keni humbur. Në qoftë se luftoni, keni fituar mbi poshtërimin, mbi dhunimin, mbi tregtinë, mbi alfabetin dhe mbi poezinë e të krishterëve në Voskopoje. Voskopoja ka vetëm një fat: të bëhet Medinë. Voskopoja ka vetëm një poezi: Kuranin. Voskopoja ka vetëm një prijës: Muhamedin. Voskopoja ka vetëm një fe: Islamin. Myslimanët kanë vetëm një zgjedhje: të luftojnë. Të pafetë kanë vetëm një rrugë: të ikin. Ju keni vetëm një qytet: Voskopojen.

Kur hoxha mbaroi, ngriti tespihet lart dhe e këputi me forcë perin e bardhë që i bashkonte gurët, të cilët u derdhën nëpër dhomë dhe humbën nën këmbët e zathura të burrave. Koha e numrit trembëdhjetë ka mbaruar, tha hoxha dhe burrat u ngritën në këmbë sikur të kishin marrë një urdhër.

Në mes të natës Voskopoja u zgjua nga krismat e armëve. Flakët u ngritën nga lagjja e të huajve dhe pastaj u shpërndanë nëpër gjithë qytetin. Shokët e Isakut që dilnin të përgjumur nga shtëpitë vriteshin dhe kufomat e tyre që mbetën për disa ditë mbi kalldrëme, askush nuk i mori për t'i varrosur. Depot e tregtarëve u grabitën dhe malli u shpërnda me mushka, në shtëpitë e lagjes së të huajve. Pesë taverna u dogjën dhe vera që u gjet atje u derdh në rrugë. Fuçitë u zbrazën dhe u

shpuan. Kryqi i madh i Katedrales së Shën Mërisë u thye dhe shalli i kuq i Marin Kurilës u shtri në mes të rrugës, si një kafshë që i kanë prerë gjymtyrët.

Grigor Jeremonakut iu kërkua të shtypte dhjetë masa të reja, mes të cilave heqjen e alfabetit grek nga shkollat, shurdhimin e kambanave të kishave, ndalimin e vizatimeve me fytyrë njerëzish, anulimin e zgjedhjeve, shkarkimin e Këshillit të qytetit, veshjen e perçeve për të gjitha gratë, ndalimin e tregtisë së armëve, etj. Grigori kundërshtoi dhe pasi e varën nga këmbët e rrahën për tri ditë rresht në oborrin e Katedrales. Kur e lanë të lirë, peshonte më pak se një thes letër. Bashkë me të u rrahën dhe disa priftërinj të tjerë. Fëmijëve iu ndalua të dilnin me shall të kuq në rrugë, ndërsa grave nuk u lejohej të dilnin të pambuluar.

Poeti u gjet i vrarë në krevatin e tij. U tha se në fillim, duke u ngatërruar me balluket e tij dhe me erën e parfumit të fortë që kishte hedhur në trup, myslimanët e kishin marrë për një grua dhe kishin dashur ta zhvishnin. Kur kishin parë që ishte burrë, e kishin rrahur. Njëri prej tyre e njohu dhe tha se ai ishte poet dhe atëherë e kishin therur.

Po atë ditë, një grup burrash të armatosur me Sali Benishin në krye shkuan në shtëpinë e Isakut, shqyen derën dhe u futën brenda. Isakun e gjetën në këmbë me një këmishë të bardhë dhe me pelerinën e Marin Kurilës të hedhur mbi supe. Ishte i paarmatosur dhe kur e panë që i priste në këmbë, burat u shtangën. Të thashë që do takoheshim prapë, i foli Isaku Sali Benishit. Burrat e armatosur lëvizën dhe armët e tyre krakëllitën, por Sali Benishi i bëri shenjë dhe ata u sprapsën. Kam lënë një vend bosh në burg për ty, tha Sali Benishi duke mos e parë Isakun në sy. Akuzohesh për vrasjen e 14 myslimanëve natën që vdiq Marin Kurila si dhe për trazirat, vjedhjet, vizatimet, dëbimet e fëmijëve myslimanë nga shkolla dhe fyerje të profetit Muhamed.

Isaku u drejtua dhe i tha: Çfarë kam thënë për Muhamedin? Ke thënë se ai jeton në hënë, u përgjigj Sali Benishi. Nuk e mbaj mend, po pse ku jeton Muhamedi, vazhdoi Isaku duke tërhequr pelerinën pas trupit sikur të mbrohej nga një e ftohtë. Sali Benishi u vrenjt dhe duke i bërë shenjë shokëve u përgjigj: Këto ditë ai ka ardhur në Voskopojë.

Burrat e morën Isakun, i lidhën duart dhe e nxorën në rrugë. Kur ai ecte, me një shpurë të armatosur që e rrethonte nga të gjitha anët, njerëzit dolën në dritare dhe e panë Isakun e gjatë dhe të fortë sesi mbante kokën lart, ndërsa pelerina e bardhë zgjatej pas tij si një vijë qumështi. Sytë jeshilë binin si lule mbi kalldrëmin e ndotur.

Isakun e mbyllën në burg bashkë me shumë nga shokët e tij si dhe disa priftërinj. Hoxha qëndroi edhe disa ditë në Voskopojë dhe pastaj u largua për në Korçë.

Për gati dy muaj shumica e tregtarëve të qytetit ngarkuan karvanët me plaçka dhe para dhe ikën. Duke mbyllur dyert e shtëpive gratë qanin dhe fëmijët mbanin poshtë bluzave shalle të kuq, që të mos u dukeshin. Pleqtë, që nuk lëviznin dot, u lanë në shtëpi të vetëm, por shumë shpejt ata u dëbuan nga familje myslimane që ua zaptuan shtëpitë dhe i lanë të uritur në rrugë ku shumë prej tyre vdiqën. Shkollat u mbyllën dhe mësuesit ikën në Korçë për të gjetur punë. Një natë, në lagjen e kazanxhinjve ra një zjarr i madh që dogji dhjetë shtëpi njëherësh. Shumica e shtëpive ishin të boshatisura dhe askush nuk u kujdes të shuante zjarrin. Shokët e Sali Benishit, që erdhën për të kontrolluar vendin, nuk mundën ta shuajnë zjarrin që vazhdoi tri ditë duke e mbushur qytetin me një erë të rëndë.

Pas disa ditësh, një zjarr edhe më i madh u ngrit në lagjen e armëtarëve. Shtëpitë digjeshin një nga një dhe trarët e mëdhenj qindravjeçarë binin duke rënkuar. Ky zjarr zgjati disa ditë dhe një erë që fryu nga jugu nisi ta shtynte në drejtim të lagjeve të tjera. Dikush i tha Sali Benishit se të krishterët që iknin, u vinin zjarrin shtëpive të tyre që ato të mos pushtoheshin nga myslimanët. Zjarret vazhduan për muaj me radhë dhe një ditë lagjja e myslimanëve mbeti e rrethuar nga të katër anët me shtëpi që digjeshin. Kafshët u përcëlluan dhe një turrë me dru u dogj. Burrat dolën

duke i shuar zjarret me ujë dhe me velenxa të mëdha që ua hidhnin flakëve sipër për t'u marrë frymën.

Kur zjarret u shuan, Sali Benishi doli për të parë qytetin. Voskopoja dukej si një qytet pas lufte. Shtëpi të djegura, kryqe të rrëzuar, kafshë të ngordhura, çezma të thyera, kalldrëme të qelbur, mallra të hedhura stivë në rrugë, kuaj dhe mushka që ishin egërsuar nga uria, minj dhe miza të uritura që u hakërreheshin njerëzve. Kur u afruan te burgu, dera ishte e hapur. Brenda ishte një prift i vdekur dhe një burrë i sëmurë që po jepte shpirt. Sali Benishi e kapi burrin nga flokët dhe e pyeti për të burgosurit e tjerë, por ai nuk fliste dot. Sali Benishi doli jashtë dhe pa fushat që rrethonin Voskopojën. Dielli i pasdites ishte i dobët dhe tymrat që ngriheshin nga lagja e tij dukeshin si re të ulëta. Isak Komneni u arratis, i tha Sali Benishi shokëve. Na rrethuan me zjarr dhe e shpërthyen burgun kur ne po shuanim flakët. Të krishterët ikën siç parashikoi hoxha dhe ne na mbeti Medina. E djegur, por e jona, shtoi Sali Benishi dhe mbylli derën e burgut mbi të cilën ishte varur një shall i kuq.

Isak Komneni me disa shokë të tij iku i fundit nga Voskopoja. Tymi i mbuloi hijet e tyre si një mantel. Ne ishim larguar disa ditë përpara tij kur filluan zjarret e mëdha. Isaku është djali i Mihalit, tha Metod Antrakidi që mori një gotë ujë dhe lagu buzët e thara.

24

Syzet e Metod Antrakidit ishin mbushur me një avull të trashë që ushqej nga një zjarr që sapo ishte shuar në gojën e tij. Metodi afroi një cep të mbulesës së rrudhosur të tavolinës dhe i fshiu xhamat me të. Mihal Komnenit i ishte varur koka e madhe mbi këmishë, si një kabanë e shurdhët. Në një anë të këmishës, Sara shqoi dy pishqolla të vogla që rrethonin një K, të drejtë. U zgjat të pyeste për diçka, por Mihal ngriti kokën dhe asaj i mbeti pyetja në buzë. Pishqollat janë simboli i lagjes së armëtarëve, ndërsa K-ja, është e Komnenëve, tha Mihal Komneni.

Ana Komnena flinte si një pupël në krahët e Ibrahimit, ndërsa Aliu dhe Paridi kishin dalë disa herë jashtë duke luftuar me shpata dhe pa e dëgjuar Metod Antrakidin gjatë gjithë kohës. Muhamedi nuk kishte lëvizur nga vendi dhe herë pas here rregullonte çallmën që i binte mbi sy. Pjatat mbi tryezën e madhe ishin boshatisur, ndërsa përpara Ibrahimit shtrihej një njollë e kuqe verë që e kishte derdhur Ana, duke luajtur në gjumë.

Paridi me flokët e ngrira hyri në dhomë, i ndjekur nga shpata e Aliut dhe kur i pa të gjithë të heshtur i tha Metod Antrakidit: Kush e vrau Marin Kurilën? Po ta dija do t'ia kisha treguar Isakut, u përgjigj Metodi. Dhe Isaku do ta kishte vrarë, pyeti Paridi. Isak Komneni nuk dinte të vriste dhe prandaj Voskopoja u shkatërrua, tha Mihal. Po pse nuk dinte të vriste Isaku, tha Aliu duke ngritur shpatën në formë kryqi mbi tavolinë. Nuk ia kishte mësuar njeri, tha Hana e menduar. As gjyshi dhe as babai i tij nuk dinin të vrisnin. Mihal Komneni ktheu kokën nga Hana dhe e pa si një njeri që e takon pas shumë kohësh. Edhe babai nuk na ka mësuar të vrasim njerëz, por vetëm lepuj, tha Paridi dhe u ul në vendin e tij. Ti je frikacak dhe nuk vret dot as lepuj dhe as njerëz, tha Aliu me zë kërcënues.

Po ti, a mund të vrasësh një njeri, i tha Metod Antrakidi, Aliut dhe pa nga Ibrahimit që rrinte i heshtur. Unë mund të vras më kollaj një njeri se një lepur, tha Aliu dhe të gjithë kthyen kokën nga ai. Aliu e kuptoi që duhet të thoshte diçka më shumë dhe vazhdoi: Nuk i vras dot gjërat që ha.

Nuk do kesh nevojë të vrasësh njerëz sepse në fshatin tonë nuk ka shkolla dhe askush nuk vizaton nëpër mure, tha Muhamedi. Po nëse iki nga fshati, mund të vras njerëz, pyeti Aliu. Po ike nga fshati mund të të vrasin ty, u përgjigj Muhamedi duke parë me bisht të syrit nga Ibrahimit.

Mihal Komneni kishte mbushur gotën e verës që mbante përpara, ndërsa Metod Antrakidi u zgjat mbi tavolinë dhe tha: Muhamedi ka të drejtë. Voskopoja provoi se dija nuk mjafton për të shmangur shkatërrimin. Qyteti më i kulturuar, ku kanë jetuar shqiptarët, u dogj. Librat, kishat, priftërinjtë, shtypshkronja, vizatimet, poetët, përkthyesit, gjeografët, filozofët arkeologët dhe studentët nuk e shpëtuan dot qytetin e tyre dhe unë pyes veten: Përse na duhej gjithë ajo dituri kur nuk arritëm dot të shuajmë një zjarr që e ndezëm vetë? Si ka mundësi që shfletuam librat e gjithë botës dhe nuk gjetëm dot faqen e duhur, atë faqe e cila do na mësonte se si nuk shkatërrohet një qytet? Mos duhej të kishim studiuar Cezarin në vend të Platonit apo Aleksandrin në vend të Aristotelit për të mësuar se mirësia nuk mjafton për të ndërtuar paqen dhe paqja nuk është e përjetshme nëse nuk e mbron me luftë? Ne ndërtuam një qytet për platonë dhe aristotelë, por jo për cezare dhe aleksandër, por unë nuk jam i sigurt nëse ata mund të lindnin në Voskopoje. Qiparisi nuk mbin në shkretëtirë dhe deveja nuk ecën dot në akull. Isaku thoshte se ishullarët e zgjedhin luftën të fundit, por ai vetë e la ishullin pa luftuar dhe tani kushedi ku noton. Mihali thotë se nëse Isaku do dinte të vriste, Voskopoja do kishte shpëtuar. As kjo nuk më bind. Ka raste që mendoj se Voskopoja ishte një qytet i ngritur në vendin e gabuar. Po të kishte qenë mijëra kilometra larg prej aty ku ishte, ndoshta do kishte shpëtuar siç ka shpëtuar Vjena, Venediku apo Athina. Voskopoja ishte një qytet ir rethuar nga barbaria dhe injoranca dhe çudia nuk ishte që një ditë u prish, por çudia është se si u ndërtua, si një lule që mbin midis gurëve. Unë besoj se Voskopoja ishte një gjë e parakohshme për shqiptarët. Ajo u fshi ashtu siç fshihet çdo ëndërr e pakuptueshme në trurin e njeriut, i cili ngrihet në mëngjes dhe e vazhdon jetën aty ku e ka lënë një natë më parë. Punon tokën dhe gruan, ushqen kafshën dhe fëmijët dhe fle prapë për të parë një ëndërr që të nesërmen e harron. Prandaj ju do jetoni në paqe për sa kohë që nuk keni as libra dhe as vizatime, siç thotë Muhamedi. Libri ia shton oreksin njeriut dhe e lë më të uritur. Sa më shumë lexoj, aq më pak di.

Metod Antrakidi u mbështet në karrige dhe syzet filluan t'i vishen prapë me avull. Je shumë plak për të qenë pesimist, tha Mihal Komneni. Nuk do kesh kohë t'i provosh vetes ato që mendon. Çfarë është pesimisti, pyeti Paridi. Pesimisti është një njeri që beson se bota nuk ndryshon por rri në vend, tha Mihali. Atëherë Muhamedi qenka pesimist, tha Aliu. Po pse është Muhamedi pesimist, pyeti Hana dhe ia nguli sytë jeshilë Muhamedit që rrinte pa lëvizur me frikën se çallma mund t'i binte mbi tavolinë. Muhamedi ka një lodër prej druri në formën e botës dhe aty dielli nuk lind, lumenjtë nuk rrjedhin, nuk bie dëborë dhe njerëzit nuk ecin. Në botën e Muhamedit nuk ndodh asgjë dhe atij kjo i pëlqen, u përgjigj Aliu.

Botën e Muhamedit e kam parë unë, foli Jani duke u drejtuar. Jani është perëndia, kurse unë jam profeti, tha Muhamedi. Ku ndryshon perëndia me profetin, tha Paridi. Perëndia e krijon botën dhe njerëzit, ndërsa profeti i thotë njerëzve se çfarë duhet të bëjnë dhe në cilin vend të botës. Po të ishte ti profet në Voskopoje çfarë do t'u kishe thënë Marin Kurilës, Isakut dhe Sali Benishit, e pyeti Mihal Komneni. Unë do t'u kisha thënë atyre të bënin tamam ato që bëne, foli Muhamedi qetësisht. Ti do lije Marin Kurilën të vritej dhe Sali Benishin të martohej tri herë, pyeti Hana. Po, tha Muhamedi. Do ta lija Marin Kurilën të vritej sepse nëse ai nuk do vritej të krishterët dhe myslimanët nuk do kishin asnjë mundësi për të bërë paqe dhe Voskopoja do të digjej shumë më shpejt nga ç'u dogj. Vrasja e Marin Kurilës ishte një paralajmërim i perëndisë, e cila donte që Voskopoja të ndahej mes të krishterëve dhe myslimanëve, por kur kjo gjë nuk u arrit atëherë Sali Benishit iu dha urdhër t'i dëbonte të krishterët. Po ti mendon se perëndia ka mbajtur anën e myslimanëve në Voskopoje, pyeti Jani. Perëndia është gjithmonë me më të dobëtit, tha Muhamedi.

Nuk më the pse do ta lije Sali Benishin të martohej tri herë, u hodh Hana.

Sali Benishi u martua një herë me një grua që mund të ishte nëna e tij, pastaj me një vajzë që mund të ishte fëmija e tij dhe pastaj me një të krishterë që mund të ishte armikja e tij, sepse perëndia thotë se të martohesh, është një detyrë të cilën njeriu duhet ta kryejë me çdo kusht, pavarësisht nga moshja, bukuria apo feja. Sali Benishi e kreu këtë detyrë dhe prandaj perëndia i fali atij Voskopojën. Ai u martua me një plakë të pasur, me një fëmijë të bukur dhe me një të krishterë të tradhtuar nga Zoti i vet, u përgjigj Muhamedi.

Sara pa në drejtim të Ibrahimit, i cili e ndiqte bisedën me kureshtje duke djersirë nën peshën e Anës që flinte e pashqetësuar, që kur pjatat ishin zbrazur dhe lugët nuk përplaseshin më. Vetëm gota e mbushur e Mihal Komnenit i kishte rezistuar ngopjes duke mos qëndruar për asnjë çast e pambushur. Po të isha unë profet, do t'i kisha thënë Isakut të mos e linte hoxhën të hynte në Voskopojë sepse ai e mësoi Sali Benishin si ta digjte qytetin, tha Aliu. Çfarë do bëje, do ta vrisje apo do ta burgosje hoxhën, e pyeti Jani. Do ta mbyllja në kishë që të çmendej, u përgjigj Aliu.

Ndërsa unë, po të isha profet, do kisha bërë një gjë tjetër, foli Paridi. Të gjithë heshtën dhe ai tha: Unë do t'i kisha thënë dy djemve që putheshin me Aishen në livadhin e myshqeve që ta rrëmbenin dhe ta çonin në Korçë. Po pse duhej ta rrëmbenin Aishen e vogël, tha Hana duke parë nga Sara me keqardhje. Në qoftë se do të ishte rrëmbyer Aishja, Sali Benishi do ikte nga Voskopoja duke kërkuar dhe ndoshta nuk do të kthehej më aty për ta djegur qytetin, tha Paridi dhe ngriti flokët e ngrira lart me krenarinë e njeriut që ka gjetur përgjigjen e të gjitha pyetjeve. Po sikur ta kishte gjetur dhe të kthehej prapë në Voskopojë, i tha Aliu. Në asnjë rast nuk do të kthehej më Sali Benishi në Voskopojë, foli Paridi duke ngritur zërin. Edhe sikur ta gjente, edhe sikur të mos e gjente Aishen, ai nuk do kthehej, se do t'i vinte turp që dy djem të vegjël i kishin marrë gruan. Atëherë Sali Benishi do shkonte dhe do digjte Korçën, tha Mihal Komneni. Po të digjte Korçën, Voskopoja do kishte shpëtuar, siç shpëtoi Sparta dhe u dogj Troja, sepse gratë gjithmonë djegin pasuritë e burrave dhe jo të baballarëve. Helena ishte nga Sparta, por ky qytet nuk u dogj dhe asnjëri nuk u vra. Po ta kishin lexuar profetët historinë e Trojës do t'i gjenin aty zgjidhjet për gjërat që nuk i dinin, por me sa duket ata kanë menduar se ajo është një përrallë që nuk përsëritet.

Profetët nuk i zgjidhin grindjet e botës duke u nisur nga përrallat sepse përrallat kanë gjithmonë një fund të lumtur dhe aty askush nuk vdes, tha Muhamedi. Nëse Voskopoja do ishte një përrallë Mihali dhe Metodi mund të ktheheshin prapë atje dhe Marin Kurila me Sali Benishin do t'i prisnin duke ngrënë patëllxhanët me mish që gatuante Aishja. Nuk do ishte keq, tha Metodi, edhe mua më pëlqejnë patëllxhanët me mish dhe mund të kisha shkuar në shtëpinë e Sali Benishit. Do vija edhe unë, tha Paridi, por, kur ju të hanit patëllxhanë, unë do rrija me Aishen dhe do mësoja si puthet një grua.

Hana filloi të qeshte dhe duke i parë Mihal Komnenin, rregulloi jakën e fustanit të ngushtë dhe i tha Paridit: Pse duhet të shkosh deri në Voskopojë, mund ta mësosh këtu si puthet një grua. Paridi donte të përgjigjej, por Aliu, që lëshoi shpatën mbi tavolinë, e ndërpreu dhe tha: Aishja u puth me dy djem njëherësh, kështu që do vija edhe unë me ty në Voskopojë. Mirë, i tha Paridi, hajde, por po ia mbajte Aishes dorën poshtë fustanit nuk të marr.

Mihal Komneni e ktheu edhe një herë gotën e verës dhe u kthye nga Muhamedi. Profet, a më thua dot ku është Isak Komneni?

Muhamedi picërroi sytë ngjyrë blu, priti derisa në tavolinë u vendos qetësia dhe tha: Isaku është në një ishull ku njerëzit dinë të notojnë para se të lindin, siç tha ai vetë dhe ku duhet ta harrosh notin që të mos kthehesh më mbrapsht, siç tha poeti.

Ku është ky ishull, pyeti Mihal Komneni. Me siguri në kujtimet e familjes tuaj, u përgjigj Muhamedi. Mihal Komneni nuk foli më, por u mbështet në karrige dhe pa Sarën drejt e në sy

sikur po i kërkonte ndihmë. Sara uli kokën dhe filloi të mblidhte pjatat mbi tavolinë, si për t'i thënë të gjithëve se dreka kishte mbaruar. Pas saj u ngrit edhe Hana që mblodhi lugët, gotat, thikat dhe pecetat e shpërndara, ndërsa ushqimet që kishin tepruar i bashkoi në një pjatancë të madhe. Jani u ngrit në këmbë dhe pas tij edhe Paridi. Muhamedi rrinte ende ulur duke pritur të ngrihej Ibrahim, kurse Aliu futi shpatën në brez dhe kaloi në anën tjetër të tryezës. Metod Antrakidi dukej i lodhur dhe sytë i kishte gjysmë të mbyllur, por u përmend kur Aliu iu afrua dhe i tha: Si e gjetën djemtë me shall të kuq sa gurë kishte tespihja e hoxhës? Duke mbledhur shumën e numrave që ka çdo germë në alfabet, u përgjigj Metod Antrakidi. Fytyra e Aliut ishte e hutuar, por ai nuk e dha veten dhe pyeti prapë: Po nëse nuk di të lexosh numëron dot? Mund të numërosh pa ditur germat dhe mund të lexosh pa ditur numrat, por mirë është t'i dish të dyja se perëndia i ka vënë çdo gjëje një emër dhe nuk ka bërë asgjë që të mos përsërite. Çdo dru, çdo gur, çdo kafshë, çdo zog, çdo peshk, çdo send, çdo ditë, çdo vit, çdo njeri, çdo mal, çdo det, çdo lumë, çdo re dhe çdo gjë ka një emër që duhet shkruar dhe duhet lexuar që të dallohet nga një gjë tjetër. Por asgjë nga këto që thashë nuk është e vetme në këtë botë dhe prandaj nuk ka vetëm një gur, nuk ka vetëm një ditë, nuk ka vetëm një njeri apo vetëm një peshk dhe të gjitha këto duhen numëruar që njerëzit të dinë se janë dhe sa pasuri kanë.

Mihal Komneni, që e ndiqte bisedën duke buzëqeshur, i tha Metod Antrakidit: Pse nuk i mëson këtyre djemve të shkruajnë dhe të numërojnë, Metod? Gjimnazi i Janinës nuk ka më nevojë për ty, ndërsa shtëpia ime mund të bëhet shkollë djemsh në mëngjes dhe hotel pleqsh në mbrëmje.

Metod Antrakidit iu veshën prapë syzet me avull, ndërsa hidhësia në ngjyrë piperi iu largua ngadalë nga fytyra, si një re. Në pesëdhjetë vjet ai u kishte mësuar qindra fëmijëve se si të kuptonin botën, e cila, siç thoshte ai, ishte e mbyllur me një derë që mund të hapej njëkohësisht vetëm nga dy çelësa: nga një numër dhe nga një germë. Po t'i zotërosh këto dy çelësa hap derën dhe hyn në një tunel të pafund, ose më saktë, në fund të të cilit është vetëm perëndia. Mijëra njerëz e kanë hapur atë tunel, por askush nuk ka shkuar deri në fund sepse perëndia nuk i dha askujt një jetë aq të gjatë, i thoshte ai nxënësve që e pyesnin se si shkohet në fund të botës.

Si thua Metod, e përmendi Mihal Komneni duke e shpëputur nga tuneli i ditëve të shkuara. Metod Antrakidi ngriti supet dhe pa nga Ibrahim, i cili dukej i kënaqur. Do të të isha mirënjohës nëse do t'u mësoje djemve të mi ato që di, tha Ibrahim dhe u ngrit në këmbë me Anën në krahët e tij. Kur fillon shkolla, pyeti Muhamedi duke parë Janin nga duart si për t'i kujtuar se tokës katrore i ishte shtuar një kuti. Nesër, tha Sara. Po ne nuk kemi shall të kuq si nxënësit në Voskopojë, tha Paridi. Unë nuk mbaj shall se më merr frymën, tha Muhamedi. Hana iu afrua Mihal Komnenit, e puthi në faqe dhe doli në oborr. Pas Hanës u largua Ibrahim dhe djemtë u vunë në rresht pas tij. Sara mbeti e fundit dhe pasi dolën të gjithë iu drejtua Mihal Komnenit: Ku është Isaku, Mihal? Mihal Komnenit i lëvizi mjekra e bardhë kur u ngrit në këmbë. Nga larg dukej si një pemë që kishte mbirë mbi tavolinë pasi ishte ushqyer për një kohë të gjatë me mish. Përgjigjen e kësaj pyetje e pres nga ty, prandaj kam ardhur, tha ai. Unë nuk e di ku është Isaku, tha Sara që ndjeu një përvëlím në faqe. Fluturo që ta gjesh dallëndyshja ime. Krahët e tu janë zgjatur dhe mund ta kalojnë detin për të arritur në ishull, tha Mihali dhe këmisha iu fry në anën e zemrës, aty ku kryqëzoheshin dy pishqollat. Metod Antrakidi, që i shikonte të dy, do t'i thoshte më vonë Mihalit se Komnenët i drejtohen njëri-tjetrit si personazhe librash bizantinë, të cilët e zbukurojnë dashurinë e tyre me metafora zogjsh. Në ishull shkohet me not, por babai nuk ma mësoi, tha Sara e bindur se duke kundërshtuar mund t'i frenonte lotët që i ishin mbledhur në grykë. Notin do ta mësosh në ishull, foli Mihal Komneni dhe e puthi Sarën me dorë, sikur po përshëndeste një zog që nuk mund ta përqafosh. Sara hapi krahët dhe doli në ajër të pastër. Mbrëmja ia ftohu mollëzat e nxehta që u njomën si një lëkurë që mbështetet në re.

Ibrahimi dhe djemtë ecnin përpara dhe Sarës iu dukën si një ushtri e lodhur që kthehej nga shkolla. Në errësirë shtëpia e hapur nga lart dukej si një kazan që mblidhte ujë. Kur do pushojë ky shi, tha Ibrahimi dhe ndaloi një çast përpara shtëpisë. Muhamedi thotë se shiu do pushojë kur të fillojë shkolla, foli Jani pas kurrizit të të atit.

Djemtë u futën nëpër dhomat e shtëpisë së re dhe Muhamedi hoqi çallmën. Pse e heq çallmën, i tha Aliu që e kishte futur shpatën poshtë krevatit. Muhamedi e shtriu peshqirin e çallmës mbi jastëk dhe pasi e palosi dy herë, u shtri dhe vuri kokën mbi të. Nuk shkohet në shkollë me çallmë se nuk jemi në Voskopojë, tha dhe pas pak e zuri gjumi.

Ibrahimi u zgjua kur një rreze drite i shpoi fytyrën. Ana flinte akoma, megjithëse një diell i verdhë i ecte nëpër flokë si një karficë lulesh. Ngriti kokën në qiell, por asnjë re nuk ia zuri dritën. Pellgjet jeshile në oborr po thaheshin si një veshkë e nderur në diell. U çua pa zhurmë nga krevati dhe shkoi të zgjonte djemtë.

Paridi u zgjua i fundit me flokët e ngritur që i zbuti me ujë. Sapuni i ngrirë i rrëshqiti si shkumë mbi fytyrë dhe ai i fshiu me peshqir sytë që i digjnin. Aliu mori bishtin e lepurit e futi në xhep dhe tha se do t'ia tregonte Mihalit, ndërsa Muhamedi e palosi peshqirin si çallmë dhe e futi poshtë jastëkut. Kur u nisën, Ibrahimi dhe Sara dolën në oborr dhe i përcollën me sy. Do kthehen më të zgjuar, tha Sara dhe i shtrëngoi dorën Ibrahimit. Do kthehen të lodhur duke kërkuar çelësat e botës, tha Ibrahimi dhe u fut brenda për të fshehur sytë e përlotur.

Kur djemtë hynë në shtëpi, Mihal Komneni po thyente arra në oborr. Flokët e gjatë i kishte krehur dhe në qafë mbante një shall të kuq. Ky është shalli i Marin Kurilës, pyeti Paridi. Ky është shalli i Isakut, u përgjigj Mihal Komneni. Po pse nuk e mori Isaku shallin me vete, në ishull, pyeti Aliu. Shalli është si flamuri dhe nuk merret me vete, por ngulet mbi kështjellë, tha Mihal dhe theu një arrë mbi plloçe.

Kur hynë në dhomë, panë Metod Antrakidin që i priste në këmbë. Syzet e tij nuk kishin avull dhe sytë i dukeshin më të mëdhenj. Mbi një karrige tjetër, ishte një dërrasë e zezë që shkëlqente nga dielli që hynte nga dera e hapur. Mbylleni derën, tha Metod Antrakidi. Paridi mbylli derën dhe në errësirë dalloj disa shkronja të bardha mbi dërrasën e zezë. Aliu u ul, priti sa Metodi u kthye me kurriz nga ata dhe i tha Muhamedit në vesh: Metodit i ka ndryshuar zëri. Mësuesit e kanë zërin më të trashë se pleqtë, pëshpëriti Muhamedi.

Çfarë kam shkruar këtu, pyeti Metod Antrakidi dhe tregoi me një shkop të hollë dërrasën e zezë. Paridi ngriti supet, ndërsa Aliu bërtiti: Voskopojë. Jo, u përgjigj thatë Metod Antrakidi. Ke shkruar emrat tanë, i tha Muhamedi. Jo, tha prapë Metod Antrakidi, unë i di emrat tuaj, pse duhet t'i shkruaj. Ke shkruar që sot është e hënë, tha Aliu duke u ngritur në këmbë. Metod Antrakidi i bëri shenjë të ulej dhe tha: Jo, nuk kam shkruar që sot është e hënë. Aliu u ul duke parë me frikë nga Muhamedi që ishte ulur në karrigen e mesit. Metod Antrakidi e mbante shkopin të palëvizur në dërrasë dhe vetë dukej si një statujë që tallet me kalimtarët. Një rreze drite që hyri papritur nga fundi i derës i ra Muhamedit në gojë dhe ky tha: Ke shkruar që shtëpia e Arianit Komnenit u bë shkollë. Metod Antrakidi nuk foli, por tundi kokën duke mohuar. Rrezja e dritës kaloi nga Muhamedi te Paridi, i cili tha: Ke shkruar që shiu pushoi dhe shtëpia jonë do ndërtohet. Jo, tha Metod Antrakidi, për mua kjo nuk ka rëndësi.

Djemtë u tulatën në karrige dhe askush nuk foli. Metod Antrakidi kroi zërin dhe Aliu u afrua edhe më shumë nga Muhamedi. Kam shkruar që shkolla u hap, tha Metodi dhe hoqi shkopin nga dërrasa e zezë. Djemtë morën frymë dhe Metod Antrakidi qeshi.

Kur pellgjet jeshile u thanë, Naumi dhe Andrea erdhën në fshat. Naumi kontrollloi gropën e gëlqeres, ndërsa Andrea hoqi katramanë dhe u zhvesh në dhomën e gjumit të Sarës. Trupi i tij me muskuj dukej si një pemë brenda shtëpisë pa çati. Paska rënë shumë shi, i tha Naumi Ibrahimit duke nxjerrë një dërrasë të lagur nga gropa e gëlqeres. Kur mbaron, e pyeti Ibrahimimi që rrinte në mes të oborrit. Po hodhëm çatinë deri në fund të gushtit, në shtator i bashkojmë dy shtëpitë dhe në tetor secili nga djemtë e tu do ketë dhomën e vet.

Pas disa ditësh mbi shtëpi u dukën trarët e çatisë. Naumi i sharronte, pasi i maste me pe të kuq, kurse Andrea i ngulte mbi njëri-tjetrin. Trarët ngriheshin dhe pastaj kryqëzoheshin mbi çatinë që i ngjante një kafazi për njerëz. Kur Andrea thërriste të atin dhe i kërkonte gozhdë, honi i shtëpisë e kthente zërin në jehonë. Andrea kishte lidhur litarë të trashë me të cilët i tërhiqte trarët deri lart. Një ditë, në çati hipi dhe Jani duke u kacavjerrë me litarë. Ibrahimimi e shikonte nga poshtë djalin lakuriq, trupi i të cilit dukej si një muskul i Andreas. Jani i mbante trarët dhe Andrea i godiste fort me çekiç. Naumi i drejtonte dy djemtë nga oborri duke thirrur dhe duke lëvizur duart në erë, sikur drejtonte një orkestër. Kur trarët formuan një kasolle prej druri mbi muret e shtëpisë, Ibrahimimi thirri Sarën. Ajo nxori një stol të gjatë dhe të dy u ulën e nisën të shohin shtëpinë e tyre. Dielli hynte nëpër trarët e ngulur dhe formonte katrorë të barabartë brenda shtëpisë. Herë pas here nga katrorët dilte koka e qethur e Janit apo shpatulla e djersitur e Andreas. Kur i pa të ulur në stol, Jani nxori kokën dhe i përshëndeti me dorë. Si dukemi që atje lart, e pyeti Sara. Jani u ngrit edhe pak, vuri dorën mbi sy dhe thirri: Si dy zogj që presin të hyjnë në kafaz. Ibrahimimi qeshi, ndërsa Sara u çua dhe u fut në shtëpi. Mori Anën në krahë dhe filloi t'i tregonte shtëpinë që ndërtohej. I fliste me zë të ulët, por vajza lëvizte kokën nga ana tjetër dhe shikonte Naumin që me çekiç rumbullakoste cepat e ploçave që kishte rreshtuar në oborr. Jani e nxori prapë kokën dhe kur pa Anën i tha: Hajde dallëndyshe të shohësh si ta kam thurur folenë. Ana vazhdonte t'i mbante sytë nga Naumi dhe tingulli i rregullt që dilte nga ploçat e thyera, pas pak e vuri në gjumë. Mbështeti kokën në supin e Sarës dhe mbylli sytë. E zuri gjumi, tha Ibrahimimi. Edhe mua më flihet kur vëllai më thotë dallëndyshe, tha Sara.

Pasdite, kur djemtë u kthyen nga shkolla, ndaluan përpara shtëpisë dhe filluan të numërojnë trarët. Dyzet e tetë, tha Paridi. Jo, janë dyzet e nëntë, tha Aliu. Muhamedi, që vazhdonte të numëronte me gisht, ktheu kokën nga Aliu dhe i tha: Nuk mund të jenë dyzet e nëntë sepse numri i trarëve është çift dhe jo tek. Po pse është çift numri i trarëve, pyeti Paridi. Sepse përballë çdo trari vendoset një tra tjetër dhe pjesa e përparme është e barabartë me pjesën e prapme, ndërsa faqja e majtë është e barabartë me faqen e djathtë. Çdo faqe ka aq trarë sa ç'ka faqja përballë dhe prandaj numri në çdo rast është çift, tha Muhamedi duke e drejtuar gishtin nga koka e Janit që i shikonte nga çatia.

Numri i trarëve është tek, foli Naumi që i kishte dëgjuar duke lënë punën. Muhamedi uli gishtin në tokë dhe Aliu i shkeli syrin Paridit. Shtëpia është në formë drejtkëndëshi dhe faqet nuk janë të barabarta. Faqja ballore dhe ajo mbrapa, që janë më të mëdha, kanë nga gjashtëmbëdhjetë trarë secila. Dy faqet e tjera, njëra në lindje dhe tjetra në perëndim janë më të vogla dhe ato kanë nga dhjetë trarë. Kur vihen të gjithë trarët dhe shtrihen njëri mbi tjetrin duke u ngulur me gozhdë, në majë të çatisë, në pikën më të lartë, vendoset trari i madh, i cili i bashkon të gjitha faqet. Ky quhet trari i madh ose kulmi i shtëpisë, tha Naumi me një zë të butë si mësues.

Djemtë shikonin trarët, ndërsa Andrea me Janin i kishin lënë çekiçet dhe qeshnin nga lart. Sa trarë ka e gjithë shtëpia, pyeti Ibrahimimi djemtë, duke i bërë shenjë Naumit që të mos fliste. Paridi filloi të mblidhte me zë, ndërsa Aliu u ul në gjunjë dhe numëroi me gishta. Muhamedi qëndroi drejt duke mos i hequr sytë nga çatia. Pesëdhjetë e tre, thanë me një gojë Paridi me Aliun. Aq ka, tha Naumi.



Unë thashë që janë çift sepse trari i madh nuk është vënë akoma, u mbrojt Muhamedi duke parë drejtkëndëshin e shtëpisë, të cilit i mungonte një vizë. Kur të zgjohesh nesër në mëngjes, trarët do jenë tek, tha Naumi dhe u përkul mbi ploçë.

Dy ditë më vonë qielli u nxi dhe retë u frynë duke u varur mbi kafazin prej druri. Dielli u fsheh dhe Andrea veshi një bluzë të ngushtë dhe muskujt iu mbuluan. Ibrahim shikonte qiellin, ndërsa Naumi shtroi prapë katramanë mbi dhomën e gjumit ku flinte, bashkë me të birin. Andrea e kishte ngulur me gozhdë trarin e madh që rrinte i shtrirë si një vijë horizonti. Mbi trupin e tij të lëmuar, Jani gdhendi emrat e gjithë djemve të Ibrahimit. Thanas, Petro, Jani, Niko, Muhamed, Ali. Nuk dinte të shkruante dhe i tha Sarës t'ia vizatonte emrat në letër. Sara i shkroi një nga një në letër dhe Jani i mori me vete në lartësi. Pasi i gdhendi me radhë me një daltë të mprehtë, mori bojë të kuqe dhe filloi t'i lyente. Furça hynte në brazdat e germave si në një kanal. Ibrahim e shikonte i ulur në stol dhe i dukej sikur i biri po vizatonte në qiell. Kur mbaroi i tha: Shto edhe emrin e Ademit. Janit iu drodh dora dhe furça i ra brenda në shtëpi. Nxori kokën mbi trarë dhe pa të atin e kërrusur mbi stol, sikur po falej mbi një kujtim. Mos zbrit, i tha Sara, ta tregoj që këtu sesi shkruhet emri i Ademit. Andrea e lidhi furçën në litar dhe Jani e tërhoqi, e futi në brez dhe nxori daltën nga xhepi i pantallonave. Jam gati, i tha Sarës dhe ndjeu dorën që vazhdonte të dridhej. Vizato germën e parë të emrit të Aliut, thiri Sara dhe dëgjo çekiçin e Janit që ra mbi daltë. Jani punonte shpejt dhe kur mbaroi i fryu kanaleve që kishte hapur mbi tra dhe pa germën e parë të emrit të Aliut të gdhendur. Tani merr germën e parë të emrit të Petros dhe vizatoje me kokë mbrapsht, ndërsa barkun ktheja nga lindja, tha Sara. Jani e nguli daltën fort dhe bëri një vijë të gjatë dhe pastaj i shtoi vizatimit një bark të madh të kthyer nga shtëpia e vjetër e Mihalit. Shumë mirë, tha Sara. Tani merr edhe germën e dytë të emrit të Petros dhe vizatoje. Naumi dhe Andrea kishin lënë punën dhe po shikonin Janin që godiste me përpikëri mbi tra. Nuk e dija që historia e familjes mund të shkruhet mbi dërrasë, tha Naumi, ndërsa Jani po i frynte pluhurit të germës së tretë. Merr germën e pestë të emrit të Muhamedit dhe vëre në fund, tha Sara. Jani e punoi më gjatë këtë vizatim dhe kur mbaroi, Sara i tha Ibrahimit se germa *m* dukej si dy shtëpitë e tyre të bashkuara kurriz më kurriz. Ibrahim nuk foli dhe vazhdoi të shikonte Janin që po e lyente emrin e Ademit me ngjyrë të kuqe. Dukej i lodhur dhe i menduar. Pas pak i tha Sarës: Po unë mund të mësoj të shkruaj? Sara iu afrua dhe i lëmoi flokët që kishin nisur të thinjeshin. Ti i ke shkruar emrat e djemve në barkun e gruas tënde, ndërsa Jani po i kopjon, tha Sara. Ibrahim uli kokën dhe thinjat iu shtuan. Eh, kallamari im po zbrazet, tha me zë të mekur.

Kur tre djemtë erdhën nga shkolla, Jani ishte në oborr duke larë duart e skuqura. Ke vrarë ndonjë lepur, e ngacmoi Aliu. Jani qeshi dhe tregoi me gisht trarin e madh. Muhamedi filloi të lexonte emrat me zë, ndërsa Paridi e ndiqte me vështirësi dhe emrin e Petros e lexoi: *Detro*.

Petro nuk ka hyrë akoma në det, i tha Muhamedi që e kishte mbaruar leximin. Por Paridi nuk e dëgjo. Pse ma ke ndryshuar emrin, i bërtiti Janit kur lexoi emrin e tij të vjetër. Shtëpia filloi të ndërtohej përpara se ti të bëheshe Parid, ia ktheu Jani. Paridi mori një gur dhe e hodhi me forcë drejt shtëpisë. Guri u përplas te trari i madh dhe humbi me zhurmë në honin e shtëpisë. Niko dhe Ademi kanë vdekur, tha Paridi dhe u fut me vrap në shtëpinë e re. Jani foli me Sarën dhe hipi prapë mbi çati. Retë ishin ulur shumë poshtë atë pasdite dhe ai mezi i shquante germat. Në fillim i hoqi bojën emrit të Nikos duke e kruar si lëkurë me një thikë të vogël. Pastaj, i thelloi kanalet duke i zgatur dhe duke i shkurtuar. Emri i ri kishte një germë më shumë se i vjetri dhe Jani i bëri vizatimet më të holla. Gdhendjen e mbaroi kur u err. Zhurma që bënte dalta e tij në muzg ngjante me ecjen e një maceje të uritur mbi çati. Kur mbaroi, i leu germat me bojë, por errësira nuk e la ta shijonte vizatimin të plotë. Fjeti dhe u ngrit herët në mëngjes qielli ishte i pastër dhe retë ishin fshirë gjatë natës, si germat e emrit të Nikos. Jani i kaloi edhe një bojë germave të reja që

shkëlqyen më shumë nga dielli i freskët i agimit. Kur vëllezërit u nisën në shkollë, ai ishte akoma mbi çati. Parid, i thirri të vëllait. Paridi nguli sytë mbi shtëpi dhe lexoi ngadalë emrin e vet. Fytyra iu çel dhe flokët e tij të ngrirë dukeshin si të vaisura për pagëzim. Tani zbrit, i tha Janit, që të mos biesh edhe ti nga çatia siç ra Niko. Pse emri i Paridit shkëlqen më shumë se emri im, u ankua Aliu. Paridi ishte një djalë elegant që lyhej me parfum kurse Aliu është një luftëtar i fortë dhe i thekur në diell, tha Jani. Ç'do të thotë elegant, pyeti Aliu, që nuk ishte bindur nga përgjigjja e Janit. Elegant do të thotë t'u pëlqesh grave, tha Andrea duke nxjerrë kokën mbi kafazin e trarëve. Paridi eci përpara duke mbajtur kokën lart, ndërsa Muhamedi i tha Aliut që i mbante buzët e mbledhura: Gratë joshen me parfum, por fitohen me shpatë.

Ke një kazan të madh, e pyeti Naumi, Sarën, një mëngjes. Kam, tha Sara, pse të duhet? Për të ngritur plloçat mbi çati, tha Naumi dhe mori kazanin prej bakri. E lidhi me litar në të dy veshët dhe e mbushi me plloça. Jani zbriti nga çatia, tërhoqi kazanin e rëndë brenda shtëpisë dhe Andrea filloi ta ngrinte me litarë. Kur plloça e parë rrëzëlleu mbi çati, Ibrahim i ngazëllyer iu afrua Naumit. Po ecën shpejt, i tha. Po më fole kur punoj, do eci me ngadalë, tha Naumi dhe vuri buzën në gaz. Andrea i shtroi plloçat me kujdes duke nisur nga faqja perëndimore e shtëpisë. Kazani u boshatis dhe Jani e mbushi prapë, ndërsa Andrea e ngriti lart. Muskujt e tij dukej sikur shtronin një qilim prej guri mbi shtëpi. Në drekë, Sara gatoi mish me presh, bëri një sallatë me qepë dhe domate, preu bukë me feta të mëdha, kurse Ibrahim nxori një shishe me raki. Vuri tepsinë mbi tavolinën e madhe që rrinte në oborr dhe thirri Naumin, Andrean dhe Janin. Filluan të hanin në këmbë, ndërsa shishen e rakisë Ibrahim ia kaloi Naumit dhe ky Andreas. Rakia avullonte nga krahët e fortë të Andreas, ndërsa Naumi u ngop, shkoi të shtrihej nën hijen e katramasë ku e zuri gjumi. Kur ai u zgjua, Andrea i kishte shtuar edhe një shirit qilimit të plloçave mbi çati. Jani mbushte kazanin, ndërsa në stol ishte ulur Sara bashkë me një burrë me mjekër të bardhë dhe flokë të lëshuara mbi supe. Rrinin ngjitur me njëri-tjetrin dhe shikonin shtëpinë që rritej. Naumi fërkoj sytë e përgjumur dhe pyeti Janin. Është akoma gjallë Arianit Komneni? Nuk e di, tha Jani. Ky është i biri, Mihal Komneni, vëllai i Sarës.

E paskeni ndërtimin në gjak, tha Naumi duke u afruar . në gjak kemi padurimin, tha Mihali dhe, duke e përshëndetur, e pyeti: Kur mbaron? Një shtëpi ndërtohet më shpejt se një kishë, u përgjigj Naumi. Njerëzit janë të paduruar kurse perëndia pret. Perëndia është e përjetshme kurse ne nuk kemi shumë kohë, tha Sara. Fole si Arianit Komneni, tha Naumi. Kur u martua Ibrahim me gruan e parë, ai na tha ta mbaronim kishën një muaj përpara afatit. Filluan në qershor dhe punuan në mes të vapës, si tani, duke ngritur gurët me thonj dhe duke i veshur me vezë që të ngjiteshin fort. Ishte viti 1752 dhe Andrea nuk kishte lindur. Unë i ngrija muret vetë kurse Arianit Komneni, me këmishën të zbërthyer, më drejtonte duke i lëvizur qoshet e kishës si gurë shahu. Natën ai rrinte zgjuar dhe e maste kishën me këmbë duke pritur mëngjesin. Kur hëna ndriçonte, hija e tij e madhe zgjatej si kambanore. Unë flija i drobitur dhe kur zgjohesha në mëngjes e gjeja aty. m'i zgjaste veglat e punës sikur po më jepte armë. Më dukesh si një prift që nxjerr armët nga kisha, i thashë një herë. Mua nuk më duhen armë për t'u mbrojtur nga perëndia, thoshte ai.

Në fillim të tetorit, i gjithë fshati erdhi për të dëgjuar kambanën e parë. Arianiti e tundi kambanën fort me litar dhe i tha njerëzve duke u gajatur. E dëgjuat? Perëndia erdhi në fshat! Gratë bënë kryqin, ndërsa fëmijët mbyllën veshët nga gjëmimi. Atë natë mblodha veglat dhe u nisa. Ishte një mbrëmje e thatë dhe para kishës pashë Arianitin që ishte ulur në një gur dhe shikonte nga kisha. Ç'bën këtu, i thashë. Po pres sa të futet hëna në kambanë, më tha. Ishte një plak i çuditshëm. Fjalët që thoshte kishin gjithmonë dy kuptime dhe ai eglendisej kur të tjerët

habitëshin. Kur e ndamë më tha: Ti do vish përsëri në fshat, por unë nuk do jem këtu. Thuaji fëmijëve të mi që rruga kalon nga kisha.

Mihal Komneni dhe Sara dukeshin si dy fëmijë të vegjël që presin babanë të ulur në stol. Mjekra e Mihalit ishte zbutur, ndërsa Sara kishte mbledhur duart mbi gjunjë. Shikonin Naumin me sy të lutur, sikur i kërkonin ta vazhdonte përrallën. Nuk e dija që ti ishe vajza e Arianit Komnenit, tha Naumi. Tani e kuptoj pse shkruani emra në trarët e shtëpisë. Mihali ngriti kokën, ndërsa Sara pa Naumin e habitur. Edhe babai juaj e kishte këtë zakon. Kur mbarova kishën ai më kërkoi ta lëmoja portikun mbi derën e madhe të hyrjes. Unë e krova gjatë gurin e ashpër derisa u bë si një pjatë e pastër dhe aty Arianiti shkroi diçka. E keni parë besoj, pyeti Naumi. Sara ngriti supet, ndërsa Mihal Komneni u ngrit nga stoli dhe duke e parë Sarën në sy i tha: Fluturimi kalon nga kisha, dallëndyshe.

I rrahu shpatullat Naumit dhe u nis me hap të madh. Sara e ndoqi pas, ndërsa Naumi u kthye dhe filloi të mbushte kazanin me plloça. Ku ikën ata, e pyeti Jani. Po kërkojnë Arianit Komnenin, u përgjigj Naumi dhe tundi kokën si kabanë.

Kisha ishte e ftohtë dhe Mihal Komneni u drodh. Një merimangë e butë që varej mbi derë iu ngjiti në mjekër, por Mihali nuk e pa. këmbët e vogla të Sarës jehuan mbi altarin e zhveshur. Nga katër dritaret e vogla hynin rreze të holla drite që bashkoheshin në qendër të kishës. Mihali bëri disa hapa dhe u kthye duke parë mbi portik. Portiku ishte i mbuluar me pluhur dhe ai e fshiu me dorë. Pluhuri i ra Mihalit mbi flokë dhe disa katrorë të vegjël nxorën brinjët dhe morën frymë nën gishtat e tij të mëdhenj. Sara lëvizi për të shmangur pluhurin dhe zgjati kokën. Një katror, pak më i madh se pëllëmba e Mihalit, djersiti mbi gur. Mihali bëri një hap prapa, ngriti sytë dhe u përqendrua. Katrori ishte i rregullt dhe i ndarë në shumë katrorë të vegjël. E lexon dot çfarë shkruhet, i tha Sarës që u ngrit mbi majat e këmbëve dhe lexoi germat një nga një: *KRETA*. Natyrisht, tha Mihali dhe kaloi dorën mbi mjekër. Ka edhe një numër, tha Sara. Çfarë numri, pyeti Mihal Komneni duke picërruar sytë në errësirë. Trembëdhjetë, tha Sara. Numri është shënuar në katrorin e mesit, poshtë germës *E*.

Mihal Komneni u lëkund mbi këmbët e veta dhe Sarës iu duk sikur do rrëzohej. Rrezet e dritës i vinin nga prapa kurrizit, i hynin ndër flokë dhe fytyra iu zbeh si një ikonë. Isaku ka qenë këtu, tha dhe preku portikun me dorë duke e përkëdhelur. Sara e pa në sy, por nuk foli dot. Numri trembëdhjetë është shtuar më vonë se Kreta. Shiko kanalet e gdhendjes. Nuk janë bërë nga e njëjta dorë. Numri është më i hollë dhe më i freskët dhe duket i shkruar nga një dorë e re dhe e lehtë. Ndërsa brazdat e Kretës janë të thella, të ashpra dhe të gdhendura në gur nga një dorë e lodhur dhe e pasigurt. Naumi tha se ai pastroi gurin, ndërsa babai shkroi diçka që ai nuk kishte ditur ta lexonte. Por Naumi nuk tha nëse kishte parë ndonjë numër, që do të thotë se numri është shkruar më vonë dhe patjetër ka një kuptim. Çfarë kuptimi ka, pyeti Sara që dukej e frikësuar sikur e kishin lënë vetëm në një labirinth logjik. Iu kujtua Metod Antrakidi që thoshte se njohja e botës është e mbyllur në një derë që hapet me një numër dhe me një germë. I hodhi sytë nga katrori që djersinte i zbuluar nga pluhuri.

Kuptimi i parë që më vjen në mend është Voskopoja, foli Mihal Komneni. Isaku ka dashur të lërë një gjurmë të jetës së tij këtu, por katrorët bosh fshehin numra të tjerë që duhet të lidhen me njëri-tjetrin me një shpjegim. Po Kreta, pyeti Sara. Mihali lëvizi pak kokën si për të thënë se ky shteg mund të kalohej më lehtë. Kreta është shkruar nga babai. Ai e ndërtoi këtë kishë për heronjtë e Kretës dhe ditën që kisha u hap, këtu u mbajt një meshë për ta. Kreta ishte pjesa më e dhimbshme dhe njëkohësisht më e bukur e jetës së tij. Aty iu vra vëllai i madh, aty vdiq gruaja që dashuronte dhe aty linde ti. Por katrorët e tjerë mund të japin shpjegime të tjera dhe të

ndriçojnë gjëgjëzën e jetës së Arianit Komnenit, tha Mihali duke marrë frymë thellë. Si do t'i hapim këto kuti, e pyeti Sara. Mihal Komneni kaloi edhe një herë dorën mbi katror sikur donte të regjistronte në kujtesën relievin memec të gurit, apo sikur donte të takonte dorën që kishte qenë aty përpara dorës së tij. E afroi dorën te buzët e veta sikur maste temperaturën, pastaj i mori erë dhe tha: Metodi mund të ketë një çelës.

I hodhi një sy kishës, hapi derën me forcë dhe doli në diell. Merimanga, që i varej si një jargë e moçme në mjekër, u verbua. Mihal Komneni vrapoi si fëmijë në rrugën e shtëpisë dhe Sara e ndoqi pas. Loja filloi, mendoi me vete.

Paridin, Muhamedin dhe Aliun i gjetën të ulur në tri karrige. Përballë tyre, në këmbë, rrinte Metod Antrakidi. Shkolla mbaroi për sot, thirri Mihali kur hyri brenda. Djemtë u çuan duke parë Metod Antrakidin, por Mihali i shkeli syrin dhe ata dolën të kënaqur. Nuk pranoj pleq në shkollën time, tha Metod Antrakidi që qëndronte akoma në këmbë. Pranoj unë, tha Mihali dhe i bëri shenjë Metodit që të ulej në karriget e djemve. Pas tij u ul dhe Sara. Karrigia ishte e ngrohtë dhe ajo mblodhi këmbët. Mihali fshiu dërrasën e zezë dhe vizatoi një katror. E ndau në pesë pjesë vertikalisht dhe horizontalisht dhe në rreshtin e parë, lart shkroi: *KRETA*. Në katrorin poshtë germës së mesit vuri numrin 13.

U kthye nga Metodi dhe i tha: Ja një detyrë për ty. Gjej numrat dhe fjalët e padukshme në këta katrorë dhe të jesh i sigurt se bota do të të duket më e bukur.

K	R	E	T	A
		13		

Metod Antrakidi rregulloi syzet mbi hundë, pa katrorin dhe tha: Ky është një katror magjik. Ku e gjete?

Ma ka lënë trashëgim babai, tha Mihali dhe mori shkopin e mësuesit në cep të dërrasës. Nuk e dija që Arianit Komneni ka qenë një mason, tha Metodi. Sara ktheu kokën, por Mihali ngriti shkopin dhe ajo nuk nxori zë.

Katrorët magjikë janë shumë të hershëm dhe disa mendojnë se janë me origjinë parakristiane, filloi Metodi. Në traditat e lashta hebreje dhe greke njerëzit e ditur përdornin katrorë të tillë për të fshehur apo për të dhënë sinjale të ndryshme. Me kalimin e kohës, katrorët magjikë u shndërruan në një sport për matematicienët sofistë që luanin me to duke habitur princat dhe madje i përdornin edhe si letra dashurie, të cilat askush përveç të dashurës, nuk mund t'i lexonte. Katrorët magjikë nuk formohen vetëm me numra, por edhe me fjalë. Sekretin e katrorit magjik është ky: numrat që e përbëjnë duhet të jenë të ndryshëm, pra të mos përsëriten dy herë, të jenë të njëpasnjëshëm, pra një, dy, tre, katër, apo njëzet, njëzet e një e me radhë dhe sido që t'i mbledhësh, vertikalisht, horizontalisht apo diagonalisht ato duhet të japin të njëjtën shumë.

Ndërsa katrorët e fjalëve formohen me vështirësi për shkak të natyrës së pambledhshme që kanë fjalët, të cilat mund të kombinohen duke u lexuar vetëm nga një anë, pra ose majtas, ose djathtas, ose poshtë, ose lart, por jo edhe anasjelltas. P.sh. fjala *Kreta* në katrorin e Arianitit mund të lexohet nga e majta në të djathtë, por jo në të kundërtën. Kjo bën që katrorët e numrave të jenë shumë më të përdorur në të gjitha traditat që përpiqen të shpjegojnë botën përmes numrave.

Mjeshtri i këtyre magjive matematike ka qenë Pitagora, i cili thoshte se në këtë botë çdo gjë është një numër. Pitagora arriti të hutojë gjindjen në Italinë e Jugut, ku jetonte, që në atë kohë ishte koloni greke, aq sa rregullat e tij u kthyen në një lloj feje, e cila, nëse nuk do lindte Krishterimi, ndoshta do vazhdonte ta shpjegonte botën përmes numrave. Pitagora e quante veten një hyjni dhe një herë tha: në këtë botë ekziston Zoti, ekzistojnë njerëz, por dhe qenie si unë. Siç thashë, rregullat e tij u kthyen në normë me mbështetjen e disa princave që i besuan dhe u bënë dishepuj të tij. Pitagora thoshte: Mos hani fasule, mos kaloni mbi një kryq, mos trazohet zjarri me hekur, mos shkelen dafinat, mos hahet zemra, mos lihen dallëndyshet të ndërtojnë fole nën çati, mos u shiko në pasqyrë kur je pranë një qiriu, etj. Teoria e Pitagorës, si një kombinim i matematikës me teologjinë, ndikoi në gjithë mendimin grek parakristian, por edhe shumë më vonë. Më pas, Krishterimi e mohoi Pitagorën, sepse nuk mund të pranonte që Zoti ishte një numër dhe që pas çdo numri fshihej një sekret që duhej zbuluar nga mendja njerëzore. Unë mendoj se Pitagora do kishte qenë më i suksesshëm në rast se nuk do t'i kërkonte njerëzve që të mos hanin fasule, sepse në atë kohë fasulja përbënte ushqimin bazë të grekëve. Ai i ka përçmuar grekët dhe ka qenë cinik. Edhe unë do bëja zgjedhjen që bënë grekët: më mirë një fe që nuk më lejon të marthohem dy herë, si Krishterimi, sesa një fe që më pengon të ha fasule. Mes dy të këqijave do zgjidhja më të voglën.

Po me dallëndyshet ç'kishte Pitagora, pyeti Mihali që qeshte duke parë Sarën.

Nuk e di, tha Metodi. Grekët e lashtë ishin shumë tokësorë dhe qiellin ua kishin lënë perëndive.

Por le të kthehemi te katrorët magjikë. Nga grekët ato u morën dhe u përpunuan nga çifutët që kanë shkencën e tyre të numrave, e cila quhet Kabbala. Kabbala mendohet se është një libër që iu dha Abrahamit nga perëndia dhe që shpjegon lindjen, ndërtimin dhe ecurinë e botës përmes kombinimit të numrave dhe germave. Kabbala e ndan dijen njerëzore në pesëdhjetë shkallë inteligjence dhe thuhet se vetëm Moisiu arriti deri te shkalla e dyzetënëntë sepse tek e fundit nuk mund të arrinte, pasi ai nuk ishte profeti i fundit. Shkalla e pesëdhjetë e dijes është vetë Zoti dhe vetëm Jezu Krishti ka arritur deri aty.

Çifutët kanë një katror të dashur me 36 numra duke filluar nga njëshi. Shuma e çdo rreshti është 111 dhe shuma e të gjithë rreshtave është 666. Ka njerëz që besojnë se ky është numri i djallit, por për çifutët ai ka një kuptim mistik dhe hyjnor që lidhet me ardhjen e Mesias. Sabatai Zevi ishte kabalist dhe një nga arsyet që njerëzit e besuan ishin pikërisht tri gjashtat e vitit 1666, kur ai u shpall si Mesia.

Edhe myslimanët kanë një katror magjik me tri rreshta. Numrat e këtij katrori janë nëntë dhe fillojnë nga tetëmbëdhjeta dhe mbarojnë në njëzet e gjashtë. Shuma e tyre është 66 që përbën vlerën numerike të fjalës Zot në arabisht.

Më vonë, lojën e katrorëve magjikë e morën masonët, të cilët u shfaqën në kohën e kryqëzatave dhe fillimisht shërbyen si mbrojtës të Jerusalemit kur ai u pushtua nga myslimanët. Masonët e parë kishin gërmuar në tempujt e Jerusalemit dhe besohet se atje kanë gjetur sekrete të mëdha nën rrënoja. Disa nga kodet e tyre të fshehta ata i kaluan dorë më dorë me anë të katrorëve magjikë.

Babai nuk ka qenë mason, e ndërpreu Mihal Komneni duke drejtuar shkopin. Kur ishte në Stamboll mund të ketë njohur disa prej tyre dhe ndoshta aty ka mësuar katrorin magjik.

Nuk ka bërë keq, tha Metodi dhe i nguli sytë dërrasës. Ky katror duhet të ketë dy pjesë. Ai përbëhet edhe nga fjalë edhe nga numra. Rreshti i Kretës është me fjalë që do të thotë se edhe rreshti i parë vertikal dhe i pesti vertikal që lidhen me të, duhet të kenë fjalë të fshehura. Ndoshta edhe rreshti i fundit horizontal që lidhet me dy rreshtat anësore duhet të jetë një fjalë. Ndërsa numri trembëdhjetë është pjesë e një katrori brenda katrorit të madh. Katrori i madh ka njëzet e pesë katrorë të vegjël. Ndërsa katrori i vogël ka nëntë katrorë të mbushur me numra. Po filloj me këtë të voglin sepse është më i lehtë.

Metodi u çua dhe vizatoi një katror më të vogël se katrori i Arianitit që rrinte përbri dhe priste të zbulohej. E ndau katrorin me dy viza nga lart-poshtë dhe pastaj hoqi dhe dy viza të tjera horizontale. Dërrasa e zezë qau nga shkumësi dhe Sarës iu ngjeth mishi. Nëntë katrorët e vegjël dukeshin si nëntë gojë të hapura. Metod Antrakidi shkroi një trembëdhjetë në katrorin e mesit, në rreshtin e parë lart dhe filloi të numëronte duke lëvizur buzët. U mendua pak dhe në katrorin e parë, në të majtë të trembëdhjetës, vuri një tetë. Poshtë tetës vuri një shtatë dhe poshtë shtatës një dymbëdhjetë. Rreshti i parë vertikal u plotësua. Mihali pa nga Sara dhe filloi të qeshte. Mektodysyz Prapakidi po i hap portat e Komnenëve, tha.

Poshtë trembëdhjetës Metodi shkroi një nëntë dhe poshtë nëntës një pesë. Ndërsa në rreshtin e tretë nga lart-poshtë vuri një gjashtë, pastaj një njëmbëdhjetë dhe pastaj një dhjetë.

8	13	6
7	9	11
12	5	10

Katrorët u plotësuan dhe Metodi bëri një hap prapa duke i parë.

Mblidhi nga të duash, i tha Mihali Komnenit. Mihali filloi të numëronte duke prekur çdo numër me shkop. Shkopi u end nga e majta në të djathtë, pastaj nga poshtë-lart, dhe pastaj përshkoi ngadalë diagonalen duke filluar nga numri tetë, kaloi te nënta dhe qëndroi te dhjeta. Shuma është njëzet e shtatë, tha dhe Sarës iu kujtua Aliu që numëronte trarët e shtëpisë me gishta. Po, tha Metodi. Por t'i mbledhësh numrat është e thjeshtë. E vështirë është t'i kuptosh.

Trembëdhjeta është numri simbol i Voskopojës, që Marin Kurila thoshte se vjen nga numri i Krishtit dhe dymbëdhjetë profetëve të tij. Këtë numër, besoj se e ka shkruar Isaku sepse një gjë është e qartë: nuk ka qenë e njëjta dorë ajo që ka shkruar fjalën dhe ajo që ka shkruar numrin.

Nga e kupton ti këtë, e pyeti Metodi. E pashë gurin, e preka, e shijova dhe e nuhata. Guri kishte erën e tim biri dhe unë këtë erë nuk mund ta ngatërroj me asgjë tjetër. Sado inteligjente, e përsosur dhe e stërvitur të jetë shqisa, dëshmia e saj nuk përbën provë, tha Metodi. Aq më tepër që shqisa jote e vjetër ka qenë e djegur nga malli. Sytë e tu kanë qenë të përplotur, hunda ka qenë e zënë, gjuha e tharë dhe dora e drunjtë. Si mund t'i besoj një zemre që dridhet nga kujtimet duke prishur muzikën e shqisave që komandon?

Mihali Komneni e uli shkopin dhe Sarës iu duk si një dirigjent i plakur. Por rënia e tij zgjati vetëm një çast. Ngriti dorën dhe ia afroi Metodit në hundë. Merri erë, i tha. Mban era myshk, tha Metodi dhe teshtiu. I fshiu hundët me mëngë dhe u kthye nga Mihali. Isaku ka pasur nëntë katrorë bosh. Më thua dot pse është vënë numri trembëdhjetë pikërisht në këtë katror dhe jo diku tjetër? Mund ta kishte shkruar trembëdhjetën në rreshtin e fundit, apo në katrorin e parë lart, ose

në katrorin e mesit, ose ku të donte sepse fushën e shahut e kishte bosh dhe mund ta vendoste ku t'i pëlqente mbretin e tij trembëdhjetëvjeçar.

Kjo është çështje metode, Metod, u përgjigj Mihali dhe pa Sarën që e shikonte si një nxënëse në ditën e parë të shkollës.

Pa dyshim që është një çështje metode, përsëriti Metodi dhe vazhdoi:

Isak Komneni, gjithmonë nëse është ai që e ka mbushur këtë katror memec, ka dashur të dëshmojë diçka përmes pozicionit të numrave. Unë besoj se ai ka dashur të lërë një gjurmë dhe këtë mund ta provoj. Ja, se si. Po ta kishte vënë trembëdhjetën në katrorin e parë lart, shuma e të gjithë numrave të njëpasnjëshëm do të ishte dyzet e dy. Po ta kishte vënë numrin e tij në katrorin e mesit të rreshtit të mesit, pra në qendër, shuma e të nëntë katrorëve do ishte tridhjetë e nëntë. Mund ta kishte shkruar në katrorin e parë të rreshtit të fundit dhe mbledhja e të gjithë numrave do të ishte tridhjetë. Me pak fjalë, Isaku ka pasur nëntë mundësi për të ndërtuar një katror me numrin trembëdhjetë. Pse ka zgjedhur pikërisht këtë kombinim numrash? Pse ka kërkuar njëzeteshtatën dhe jo tridhjetën apo tridhjetenëntën apo dyzetedyshin?

Mihal Komneni mendohej duke kruar mjekrën.

Kur ka lindur Isaku, pyeti Metod Antrakidi. Në 13 janar 1742, tha Mihali. Kur iku Isaku nga Voskopoja, pyeti Metodi. Në gusht të vitit 1769, tha Mihali dhe mjekra iu drodh. Metod Antrakidi u kthye nga Sara. Kur u largua Arianit Komneni nga fshati? Në tetor 1769, tha Sara që u mblodh në karrige.

Dëshmia e shqisës së grisur të Mihal Komnenit ndoshta mund të merret si provë, shpalli Metodi dhe tha: Isaku ka qenë 27 vjeç në vitin 1769 dhe duke i kombinuar katrorët në këtë mënyrë ndoshta ka dashur të na thotë se në cilin vit ka qenë këtu. Me fjalët e numrave ai ka thënë: Kur mbusha njëzet e shtatë vjet shkova në fshat. Ose: Isha në fshat në vitin 1769. Ndërsa numri trembëdhjetë tregon se ai ka ardhur nga Voskopoja. Isaku ishte i bindur se njerëzit që do lexonin katrorin e tij do ta lidhnin simbolikën e numrit trembëdhjetë me qytetin e Voskopojës ku ai bëri histori. djalë i zgjuar, tha Metodi. I ka ngjarë më shumë gjyshit se babait. Deri tani na ka thënë se nga vjen dhe ku qëndron, por ne duhet të gjejmë se ku ka shkuar.

Po Kreta, pyeti Sara.

Nëse Kretën e ka shkruar Arianit Komneni, Isaku e ka gjetur fjalën këtu dhe është përpjekur të kombinojë numrat me fjalët e fshehura. Kjo është një teknikë e vështirë dhe unë nuk kam parë kurrë një katror magjik, ku bashkohen fjalët me numrat, tha Metodi duke bërë një hap prapa. Po nëse Isaku ka ardhur në fshat në gusht të vitit 1769 ai është takuar me Arianitin dhe ky i ka treguar sekretin e katrorit të madh. Kjo është e pamundur, tha Sara. Unë do ta kisha parë Isakun po të vinte në shtëpinë tonë atë vit. Isaku u arratis nga Voskopoja dhe turqit e kërkonin për ta burgosur, tha Mihali. Ai duhet të ketë qëndruar i fshehur që mos pikasej. Kush i mbante kyçet e kishës, pyeti Metod Antrakidi. Babai, u përgjigj Sara, ai e ndërtoi kishën. Ndoshta Isaku është fshehur në kishë sepse aty nuk hynte njeri, tha Metodi. Ndoshta, tha Sara. Kur Ibrahim i u bë mysliman prifti nuk erdhi më nga Janina dhe për shumë kohë nuk u mbajtën më mesha. Kisha rrinte e mbyllur.

Po të isha unë në vendin e Isakut nuk do gjeja strehë më të sigurt se një kishë e braktisur për t'u fshehur, foli Metodi. Ai mund të ishte fshehur edhe në shtëpinë tonë, në bodrum ose në çati, tha Sara. Arianit Komneni nuk mund të ishte kaq naiv, u përgjigj Metodi. Ai e dinte se, nëse turqit do ta kishin ndjekur Isakun, vendi i parë ku do të kërkonin do të ishte shtëpia e tij dhe ai sigurisht që nuk donte ta bënte të nipin kurban. Në këtë shtëpi, Isaku do ishte i zbuluar dhe njerëzia mund ta kishin parë.

Përpara se babai të ikte, në fshat erdhi Ali Tepelena me disa njerëz të armatosur që kontrolluan shtëpitë dhe rrahën burrat e fshatit. Ndoshta Arianiti ka menduar se Aliu erdhi në fshat për të kërkuar Isakun dhe e ka fshehur në kishë, tha Sara dhe pa nga Mihali. A erdhi Ali Tepelena në shtëpinë tuaj, e pyeti Metodi. Po, tha Sara. Ai bisedoi gjatë me babanë dhe u largua në të gdhirë. Babai u mbyll në shtëpi dhe pas tri ditësh u nis vetëm dhe më la mua në shtëpinë e Hanës.

Sekreti i Arianitit tani është më i qartë, ngriti zërin Metodi. Ai quhet Isak Komneni. Arianiti ka ikur nga fshati për të shpëtuar të nipin, të cilin e kishte fshehur në kishë. Kur ka ardhur Ali Tepelena, Arianiti ka besuar se qëllimi i tij ka qenë kapja e Isakut. Kanë ikur të dy nga fshati.

Po pse nuk më morën dhe mua me vete, pyeti Sara e mbledhur në karrige si një fëmijë. Udhëtimi i tyre duhet të ketë qenë i vështirë dhe i pasigurt. Rruga kalonte nga Janina, Voskopoja dhe Korça, të cilat kontrolloheshin nga turqit. Arianiti nuk mund të rrezikonte vajzën e vetme në këtë udhëtim, tha Metodi. Edhe unë do kisha bërë të njëjtën gjë, po të kisha një vajzë.

Po pse babai nuk donte që unë ta njihja Isakun, pyeti prapë Sara.

Ti ishe e vogël dhe nuk do ta mbaje dot sekretin e tij, tha Mihal Komneni që ishte ulur në karrige. Ata e kanë shtyrë të vërtetën në kohë, por nuk e kanë fshehur. Nëse do të donin të zhdukeshin pa lënë gjurmë, këta katrorë nuk do ekzistonin. I kanë lënë shenjat të gdhendur mbi gur, të bindur se një ditë ti do t'i zbulojë. Nuk të kanë fshehur gjë, dallëndyshe, por vetëm kanë pritur që të rritesh. Dhe të kuptosh.

Ndoshta jeta ime do ishte ndryshe po ta kisha njohur Isakun, foli Sara me zë të shuar. Babai e dinte këtë, tha Mihali. Ai ka dashur që ti të rritesh në fshat dhe të bësh gjërat që ke bërë. Ka dashur që unë të martohesha me një mysliman, pyeti Sara. Këtë ai nuk mund ta dinte, por po ta kishte mësuar do ta kishte quajtur një fat të pashmangshëm, tha Mihali dhe hodhi sytë nga katrori i madh. Po Isaku çfarë do thoshte po ta dinte se unë jam martuar me një mysliman, pyeti Sara. Mihali u mbështet në karrige dhe ngriti kokën lart sikur po lexonte në tavan. Do thoshte se, që të shpëtosh ishullin, duhet t'u mësosh të huajve notin, i tha Sarës.

Metod Antakidi rrinte në këmbë si një mësues. I bëri një shenjë Sarës dhe ajo u ngrit nga karrigia dhe u afrua te dërrasa e zezë. Pluhuri i shkumësit i mbushi flegrat. Nuk teshtiu, por bashkoi këmbët sikur donte të mbyllte gjithë vrimat e trupit.

Rruga kalon nga Kreta, tha Metod Antrakidi dhe tregoi me gisht katrorin e madh. Sara pohoi me kokë dhe ai vazhdoi. Katrori i madh ka njëzet e pesë katrorë të vegjël. Nëntë katrorët e mesit janë mbushur me numra. Në pesë katrorët e rreshtit të parë horizontal është shkruar Kreta. Mbetën edhe njëmbëdhjetë katrorë për t'u zbuluar, të cilët, meqë lidhen me rreshtin e Kretës, duhet të jenë formuar me fjalë dhe jo me numra. Në kolonën e parë vertikale duhet të jetë shkruar një fjalë, e cila fillon me germën *k*, njëlloj si Kreta sepse ky është rregulli i një katrori magjik. Të gjitha fjalët duhet të lidhen me njëra-tjetrën përmes një germe.

Më thuaj një fjalë që fillon me *k*, tha Metodi. *Koha*, tha Sara. Ka katër germa, foli Metodi. Duhet të ketë pesë. *Kaos*, tha Mihal Komneni që rrinte i ulur në karrige dhe shikonte në tavan. Të thashë që duhet të ketë pesë germa, iu kthye Metodi, por Mihali nuk e kishte mendjen.

*Krahë*, tha Sara. Ndoshta, tha Metodi dhe shkroi një *r*, poshtë *k*-së së Kretës, pastaj një *a* një *h* dhe poshtë saj në katrorin e fundit një *e*. Megjithatë nuk e kuptoj çfarë e lidh Kretën me krahun. Para së gjithash, katrori duhet të jetë logjik që të jetë magjik.

E lidh, tha Sara dhe pa nga Mihali që dukej sikur nuk ishte aty. Mihali thotë se mua më janë rritur krahët dhe duhet të fluturoj si dallëndyshe që të shkoj në Kretë. Metodi vuri buzën në gaz dhe e pa Sarën me dhimbsuri. Në ditën e parë të shkollës gjithë fëmijët tregojnë përralla, i tha. Sara u skuq dhe i mblodhi më fort këmbët. Mihali gjithmonë i ka joshur gratë duke i përshkruar si zogj. Në Voskopoje e quanin zbutësi i zogjve. Arianit Komneni nuk ka qenë një poet



melankolik, por burrë kokëfortë dhe racional. Do ishte një çudi sikur jetën e vet ta përshkruante si një letër dashurie. Ky katror magjik është një letër që i drejtohet së bijës dhe jo një gruaje çfarëdo. Nëse arsyetimi im është i drejtë, kjo do të thotë se në këto kuti fshihet një histori e vërtetë që ai ka dashur të mësohet pa gabime, por saktësisht, deri në detaje, ashtu siç ka ndodhur. Po të ishte ndryshe, do mbetesh i zhgënjyer nga një burrë që e kam adhuruar, duke i njohur të birin dhe të bijën. Megjithatë, le të fluturojmë pak në errësirë dhe të besojmë se Arianiti ka shkuar në Kretë me krahë. Kalojmë në rreshtin e fundit për së gjati, që lidhet me germën e fundit të fjalës, *Kreta*. Duhet të gjejmë një fjalë që fillon me *a*, tha Metodi.

Athos, tha Sara. Mihali thotë se babai mund të jetë nisur në malin Athos për të vdekur aty siç bënin perandorët bizantinë. Mihali ka kërkuar aty, por nuk e ka gjetur. Ndoshta babai ka ndërruar mendje rrugës dhe ka vendosur të vdesë në një vend tjetër. Katrorin e kishte shkruar në vitin 1752, kur u ndërtua kisha dhe në vitin 1769 nuk mund ta ndryshonte më.

Metod Antrakidi uli syzet dhe e pa Sarën me qetësi. Ti e ke njohur Arianitin në pleqëri kur kujtimet e lodhshme, mëkatet e shpirtit dhe dobësia e trupit, e bëjnë çdo njeri të duket si murg. Por jeta e Arianitit ishte një betejë për të gjetur paqe me njerëzit dhe jo me Zotin. Të vdesësh si murg, do të thotë t'i dorëzohesh Zotit, pasi ke dështuar me njerëzit. Por ai ka jetuar si një prijës dhe njerëzit i janë bindur. Ka folur dhe njerëzit e kanë dëgjuar. Ai ka ndërtuar dhe njerëzit kanë punuar. Ka dashuruar dhe e kanë dashuruar. Ka urreyer dhe njerëzit e kanë tradhtuar. Ka besuar dhe njerëzit janë lutur. Ka kërkuar dhe Zoti e ka ndihmuar. Arianit Komneni mendonte se Zoti i kishte ngarkuar një mision. Kur iku nga fshati, misioni i tij nuk ishte kryer dhe ai nuk mund të shkonte te Zoti e duke kërkuar falje t'i thoshte: Zoti im më fal, unë dështova. Sinqeriteti i dobët i murgut, është vetëvrasës. Arianit Komneni donte të vdiste, por nuk donte të vriste veten. Një njeri që vret veten nuk lë gjurmë. Atij i mjafton vetëvrasja për të dëshmuar dobësinë dhe dëshpërimin e tij. Nëse ti mendon se babai yt jetoi për të vdekur si murg, do të thotë se zbulimi i të fshehtave të këtij katrori, është një detyrim për t'i provuar vetes të kundërtën. Gjithmonë nëse e kundërta ekziston.

Megjithatë, ne do t'i shkojmë ushtrimit deri në fund, tha Metodi dhe mbushi katrorët e vegjël poshtë germës *a*, me tepricën e fjalës Athos. Ja ku jemi. *Kreta, Krahë, Athos*. Këto tri fjalë mund të bëjnë një magji, por së pari duhet të bëjnë një kuptim. Po të thërrisim për ndihmë poetin e Voskopojës ai do thoshte se Arianit Komneni ka fluturuar për në Kretë dhe kur krahët e thinjur i janë lodhur ka ndaluar në manastirin e malit Athos, ku dhe ka vdekur. Apo jo, pyeti Metod Antrakidi duke folur me vete.

Sara dukej e ngurtë, por e vëmendshme, si një zog që kërkon një pemë për t'u ulur.

Tani na duhet të bashkojmë me një fjalë të vetme germën *e*, të krahut të Arianitit, me germën *s*, të malit Athos, vazhdoi Metodi.

*Eros*, tha Mihal Komneni.

Sa do t'i pëlqente poetit të Voskopojës, u gajas Metod Antrakidi dhe veshët e gjatë iu afruan te buzët. Arianit Komneni fluturon nga Kreta në Athos në kërkim të dashurisë. Po ta kishte shkruar këtë varg, ndoshta myslimanët e Sali Benishit nuk do ta kishin vrarë dhe Aishja do t'i kishte gatuar patëllxhanë me mish të grirë kur ai recitonte lakuriq duke mbajtur një kurorë me lule myshqesh mbi kokë.

Sarës i doli një aromë nga sqetullat dhe hapi pak këmbët.

E përkryer, vazhdoi të fliste Metod Antrakidi që dukej si një magjistër, i cili, duke përzier barëra me shurup dhe sheqer të djegur i ndryshon jetën një njeriu. E çon në luftë, pastaj e plagos, e nis për në shtëpi, e shëron, vendos ta martojë, e ndan, bëhet pishman, pastaj e marton prapë, djeg pak sheqer, e bën me fëmijë, pastaj i hedh bar mbi kokë dhe njeriu nis për të vdekur, por ai e

kthen nga rruga dhe e mbyll në një manastir. Magjistari kënaqet kur shikon njeriun që i lutet ta lërë të vdesë, sepse është i lodhur dhe nuk ka më fuqi të jetojë, por ai pret, ndalon, vrojton, tallet dhe pi pak shurup, ndërsa njeriu vazhdon të lutet, pastaj magjistarit i mbyllen sytë nga pija dhe para se ta zërë gjumi i hedh një grusht bar mbi kokë dhe njeriu vdes nën atë peshë.

E përkryer, tha prapë Metod Antrakidi. Edhe Arianit Komneni nuk do donte një fund më të lavdishëm se ky. Të vdesësh si një murg nga dashuria. Ose të dashurosh si një murg në prag të vdekjes. Ose të fluturosh në krahët e erosit duke u nisur nga Kreta në Athos. Ose të dashurosh në ajër duke fluturuar nga Kreta në Athos. Sikur ta takoja Arianit Komnenin do t'ia kërkoja këtë katror magjik borxh për epitafin tim. Sa do doja të vdisja në një manastir, pasi ta kem kaluar gjithë jetën duke bërë dashuri në ajër. Duhet të jetë një akt fizik që nuk të lodh sepse nuk ka rëndësi. Nuk ka gravitet. Por edhe nëse ka gravitet, njeriu është i qetë sepse e di që do bjerë mbi malin Athos, në pëqi të perëndisë. E përkryer, tha Metod Antrakidi për të tretën herë dhe veshët i zvogëluan dhe morën përmasën katrore që kishin zakonisht. E përkryer, por e pamundur, sepse fjala *eros* ka katër germa dhe dashuria që kërkojmë duhet të konsumohet në pesë katrorë.

Sara ishte ende në këmbë dhe faqet i ishin ftohur. Metod Antrakidi po kënaqet duke ecur në kthesat e jetës së babait, mendoi. A nuk kishte thënë Metodi disa herë: Sikur unë të isha në vend të Arianit Komnenit, sikur të jetoja si ai, sikur të kisha një vajzë si ai, sikur të vdisja si ai? Nuk mund të jesh si babai, tha Sara me vete, sepse zgjuarsinë nuk e përdor për të zbuluar botën, por për të gjetur gabimet atyre që e kanë përkryer atë rrugë. Kjo duket sikur të kënaq, por në të vërtetë të vonon. Vonohesh duke numëruar gabimet e të tjerëve dhe nuk ecën. Jeta jote është e mbushur me vonesat e atyre që kaluan para teje. Nuk mund të jesh si babai, përsëriti Sara, pa zë. Për më tepër, je i shëmtuar.

Metod Antrakidi rrinte në këmbë dhe shikonte Mihalin. Pastaj Sarën. Asnjëri nuk e kishte mendjen. Janë lodhur duke ndjekur babanë, mendoi dhe erdhi keq.

Nuk ka asnjë fjalë që bashkon krahun me Kretën dhe me malin Athos, tha me zë të ulët dhe e fshiu katrorin me një leckë të zhubrosur. Pluhuri i shkumësit u ngrit si re dhe mbeti një copë herë mbi kokat e të treve.

Ti the se në ndryshim nga katrorët magjikë me numra, katrorët e fjalëve mund të shkruhen nga lart-poshtë ose anasjelltas, apo nga e majta në të djathtë, ose anasjelltas, por asnjëherë në të dyja drejtimet njëkohësisht, foli Mihali duke u drejtuar mbi karrige. Po, tha Metodi i përqendruar. Kreta lexohet nga e majta në të djathtë, por jo anasjelltas sepse fjala *aterk* nuk ka asnjë kuptim.

E kuptoj, u përgjigj Mihali duke e miratuar. Por kjo nuk do të thotë se fjalët e tjera, në mënyrë që të lidhen me fjalën Kretë, duhet medoemos të respektojnë këtë rregull. Nuk është e detyrueshme, tha Metodi dhe rregulloi syzet për të ndjekur shpejtësinë e buzëve të Mihalit. Dua të them se nëse një fjalë në kolonën e parë shkruhet nga poshtë-lart, magjia e katrorit nuk prishet. Edhe nëse prishet, ekuilibri logjik i fjalëve e kompenson këtë devijim nga rregulli, u përgjigj Metodi. Natyrisht, tha Mihali, ekuilibri i të kundërtave është më i përkryer se ai i të ngjashmeve. Ç'do të thuash, e pyeti Metodi dhe veshët iu ulën poshtë.

Mihali u ngrit në këmbë dhe zgjati shkopin drejt dërrasës së zezë. Trokiti lehtë sikur kërkonte t'i hapej një portë dhe tha: Ta provojmë kolonën e parë me një fjalë tjetër, të shkruar nga poshtë-lart, e cila duhet të mbarojë me germën *k*, në mënyrë që të lidhet me Kretën. Ma thuaj atë fjalë, tha Metodi dhe ngriti shkumësin.

*Isak*, tha Mihali dhe ndjeu një lëvizje ajri që erdhi nga krahët e Sarës, të cilët u hapën sikur do fluturonin. Është me katër germa, tha Metodi. Shkruaje sipas Biblës me dy *a*, u përgjigj menjëherë Mihali Komneni: *Isaak*.

Metod Antrakidi shkroi ngadalë mbi dërrasë dhe u kujdes që dy germat  $a$  të ishin sa më të ngjashme. Magjia funksionin, por logjika mbetet për t'u provuar, tha duke bërë një hap prapa dhe e pa katrorin si një pikturë që mbetet për t'u plotësuar.

Kjo do të thotë se babai dhe Isaku e kanë bërë katrorin bashkë, pyeti Sara.

Njëri ka plotësuar tjetrin, si një punë që e fillon i ati dhe e vazhdon biri, tha Mihali.

Po Naumi tha që babai e ka bërë katrorin në vitin 1752 dhe në atë kohë Arianiti nuk e dinte se Isaku do vinte në fshat në vitin 1769, tha Sara duke marrë frymë thellë sikur sa kishte nxjerrë kokën nga një tunel.

Isak do duhej të ishte emri yt, tha Mihali. Babai më ka thënë se nëna jote priste një djalë që kishte vendosur ta quante Isak, sipas djalit të Abrahamit. Djali nuk u lind kurrë dhe nëna jote vdiq duke të dhënë ty emrin e gruas së Abrahamit. Që do të thotë se Isaku, ishte një premtim i pambajtur i babait.

Po ti pse e quajte djalin Isak, e pyeti Metod Antrakidi. Mihal Komneni uli kokën dhe u mendua një copë herë. Asnjëherë nuk e kam ditur, por tani e kupto se me sa duket ka qenë një destin që unë t'i marr djalin babait tim. Nëna e Sarës e quante babanë Abraham sepse ai gjithë jetën udhëtoi duke kërkuar të zbulonte botën dhe përmes botës veten e tij. Familja e Abrahamit nuk mund të mos kishte një djalë me këtë emër.

Mihal Komneni dukej i përlotur si një plak që lexon fundin mbi dorën e një fëmije.

Nëse ecim sipas këtij arsytimi, mund ta gjejmë Abrahamin, tha Metod Antrakidi. Pra, nëse Arianiti ka shkrua emrin e djalit që nuk u lind dot, atëherë ai duhet ta ketë mbushur katrorin e dashurisë së vet me emrat e tjerë të familjes. Si quhej nëna jote? Sheba, tha Sara. Metodi nguli shkumësin e ashpër në katrorin e fundit të kolonës së pestë për së gjati dhe duke nisur nga poshtë-lart shkroi katër germat:  $s$ ,  $h$ ,  $e$ ,  $b$ . Germa  $a$  e Kretës ishte në vend dhe ai nuk kishte nevojë ta shkruante në mënyrë që emri i nënës së Sarës të plotësohej në boshllëk. Fytyra e Mihal Komnenit u ndriçua dhe gjoksi i tij energjik u fry dhe u ngrit mbi katror.

Ka mbetur edhe rreshti i fundit horizontal, tha Metodi duke lëmuar shkumësin me dorë. Po të ishe në vend të Arianit Komnenit, çfarë do shkruaje në këtë rresht, e pyeti Mihali, Metod Antrakidin. Çfarëdo që të shkruajë, ai mbetet njëlloj i shëmtuar, mendoi Sara dhe mblodhi sjetullat e lagura. Metodi pa Sarën sikur donte t'i merrte leje që të sillej si Arianit Komneni, për pak kohë dhe tha: Ky katror i përket Kretës dhe tregon familjen që Arianit Komneni do kishte pasur në atë ishull. Pra, Kreta është familja dhe ai vetë. Sheba është gruaja. Isaku është djali. Mungon vetëm vajza.

Sara u përtyp sikur kishte një lule në gojë.

Emri im ka katër germa, tha me keqardhje si ta kishin nxjerrë nga shtëpia.

Metod Antrakidit i shkëlqyen syzet dhe veshët iu skuqën. Emri yt biblik ka pesë germa dhe është Sarai, që do të thotë princeshë, tha dhe ngriti shkumësin duke e drejtuar te katrori bosh që vinte pas germës  $s$  të nënës së Sarës. Duke mbushur katrorët nga e djathta në të majtë doli Sarai dhe bashkoi Isakun me Shebën.

K	R	E	T	A
A	8	13	6	B
A	7	9	11	E

S	12	5	10	H
I	A	R	A	S

Familja ideale e Arianit Komnenit u bashkua, tha Metod Antrakidi dhe u ul në karrige. Mihali dhe Sara mbetën në këmbë me katrorin magjik në mes.

Sara shikonte numrat dhe iu kujtua dita që babai e la te shtëpia e Hanës. Do e marrësh arkën e vogël, e kishte pyetur ajo. Arianiti e kishte parë me sytë e tij të thellë ku bota dukej më e pastër. Tani nuk më nxë, i kishte thënë. Mbaje ti që kur të më gjesh, të më futësh ty. Po si do të të gjej, i kishte thënë Sara. Ka vetëm një mënyrë për të gjetur diçka, kishte thënë Arianiti. Cila është ajo mënyrë, e kishte pyetur ajo duke ngritur arkën e vogël. Njeriu e gjen një gjë në qoftë se i duhet, kishte thënë babai. Po ti mund të më duhesh më shumë tani dhe jo kur të të gjej, kishte thënë Sara. Arianiti kishte parë mbi kokën e saj, aty ku qielli takohej me tokën dhe bëhej i kuq, sikur plagosej nga ai takim. Sytë e tij kishin marrë ngjyrën e qiellit, ndërsa trupi i ishte zvogëluar sikur bëhej gati për të hyrë në arkën e vogël. Bota po ndryshon, i kishte thënë Sarës. Unë jam i vjetër dhe i ngadalhtë. Nëse rri me ty, ti do ecësh me hapin tim dhe do vonohesh. Po pse mendon se do të të gjej, e kishte pyetur ajo. Në qoftë se nuk më gjen, do të thotë se nuk të duhem, kishte thënë ai dhe ishte nisur.

Rruga ishte e shkretë, por bota nuk dukej shumë e pastër se po ndryshonte. Babai kishte të drejtë, mendoi Sara. Tani më duhet më shumë se atëherë.

Ata kanë ikur në Kretë, foli Mihali Komneni që rrinte në këmbë si një kolonë e mbetur jashtë katrorit magjik. Po pse duhet të shkonin në Kretë, pyeti Sara dhe hapi krahët. Njëri për të vdekur, tjetri për të jetuar, tha Mihali që uli kokën e bardhë dhe pyeti: Po ti, kur do fluturosh?

Kur të kem një folje të sigurt për dallëndyshen time të vogël, u përgjigj Sara dhe doli.

Kur arriti në shtëpi, ishte muzg. Plloçat në perëndim të shtëpisë ishin shtuar dhe dukeshin si një lëkurë që zgjatej duke mbuluar një skelet trarësh. Ibrahim i ishte ulur mbi krevat dhe po luante me Anën. Ku ishe, e pyeti. Sara përqafoi Anën dhe i kontrolloi kokën, pastaj barkun, pastaj këmbët dhe krahët që iu dukën më të rritura që kur ajo kishte ikur.

Isha në një botë katrore si ajo e Muhamedit, tha dhe qeshi duke ngritur lart krahët e Anës.

26

Kur Ana mbushi dhjetë vjeç, Metod Antrakidi vdiq. Muajt e fundit ishte dobësuar shumë, veshët i ishin zgjatur dhe rrudhat i kishin hipur mbi syzet e vjetra. Pothuajse nuk hante, por lëvizte buzët i shtrirë në errësirë dhe kur Mihali Komneni i afrohej ai i thoshte me një zë të fikur që mezi dilte nga labirinti i ezofagut të tij: Dedalus, a i mbarove krahët? Mihali Komneni vinte buzën në gaz, por Metod Antrakidi nuk e shihte. Do vdesë shpejt, i thoshte Mihali Sarës.

Sara gatuante gjalpë mëllage që ia sillte çdo mëngjes dhe përpiqej t'ia hidhte në gojë. Metodi nxirrte gjuhën dhe lëpinte gjalpin ngadalë, si një krokodil i dobësuar që ushqehet me jonxhë. Sara i fshinte buzët, ndërsa Ana mbyllte hundët me dorë nga era e fortë e mëllagës. Pse do vdesë, e pyeste vajza, babai më ka thënë se kush ha mëllagë jeton gjatë? Mihali Komneni shihte me qetësi nga Metodi dhe thoshte: Metodi do vdesë sepse vetëm pyet, por nuk e dëgjon përgjigjen.

Po ai është mësues, thoshte Ana duke lëvizur flokët e zinj, dhe mësuesit i bëjnë pyetje nxënësve, ndërsa përgjigjet i dinë vetë. Kur mësuesi nuk e dëgjon përgjigjen, mësimi ka mbaruar dhe mësuesi ikën, thoshte Mihali. Po ty çfarë pyetje të ka bërë, vazhdon Ana me dorën mbi hundë. Mihali shikonte Sarën të përkulur mbi Metodin dhe e nxirrte vajzën në oborr. Uleshin mbi plloça dhe dielli ia shkëlqente flokët të dyve.

Mua më pyet a i kam bërë krahët e Ikarit, i thoshte Anës që nuhaste fort nëse era e mëllagës i kishte ndjekur deri jashtë. Po Ikari zog është, pyeste Ana. Jo, thoshte Mihali, Ikari është një djalë që fluturon. Metodi e di që ai fluturon? E di, thoshte Mihali. Prandaj nuk e dëgjon përgjigjen sepse e di, thoshte Ana. Jo, thoshte Mihali Komneni. Metodi do të dije nëse krahët janë bërë gati për fluturim. Po ti çfarë i the, pyeste Ana Komnena. Unë i thashë që krahët akoma nuk janë gati, thoshte Mihali. Po ti pse nuk i ke bërë gati, e pyeste Ana. Mihali Komneni ngrinte dorën e madhe dhe e vinte mbi kokën e Anës si një çadër në diell. Pse nuk i ke bërë krahët gati, e pyeste prapë Ana duke ia larguar dorën. Po pres të rritet Ikari, përgjigjej Mihali dhe zgjaste kokën brenda shtëpisë, por hija e Sarës nuk dukej në errësirën e mbushur me erë mëllage. Çfarë është Ikari, e pyeste Ana.

Ikari ishte djali i Dedalit, tha Mihali. Kur ishte i ri, Dedali ishte shumë i zgjuar dhe jetonte në Athinë. Që i vogël, ai mësoi të ndërtonte shtëpi të mëdha dhe të bukura, të cilat i vizatonte në letër dhe pastaj punëtorët i ndërtonin. Dedali dëgjonte zogjtë që këndonin dhe bënte vegla muzikore që këndonin si zogj. Ndiqte kuajt që vraponin dhe bënte këpucë për djemtë e rinj të Athinës që ata të rendnin më shpejt. Shikonte peshqit që notonin dhe bënte varka të shpejta që çanin ujën dhe i çonin njerëzit në brigje të reja. Dedali ndërtoi ura të mëdha mbi lumë, çezma që e merrnin ujën nga thellësia e tokës dhe e nxirrnin lart, oxhakë prej balte ku piquej buka dhe ngrohej qumështi dhe duar të gjata dhe të forta prej druri dhe hekuri që i ngrinin gurët e mëdhenj dhe i sillnin nga mali në qytet.

Njëherë, Dedali hipi në anije dhe shkoi në Kretë, në ishullin më të bukur, ku mbretëronte Minosi. Pak kohë më vonë, mbretit Minos i sollën peshqesh një dem shumë të bukur, të bardhë. Njerëzit nuk kishin parë kurrë një dem të bardhë aq të bukur dhe u mblodhën në sheshin e Kretës për ta parë. Demi rrinte drejt dhe i zgjaste brirët e tij të kuq andej nga i thoshin njerëzit, sepse ai ishte një dem i zgjuar dhe i dashur. Gruaja e mbretit Minos, Pasifaja u marros pas demit, të cilin e donte shumë. Ajo e lante, e ushqente dhe e fshinte me peshqir. Por Minosi nuk donte që gruaja e tij të rrinte me demin dhe atëherë gruaja i tha Dedalit që ta ndihmonte. Dedali ndërtoi një lopë shumë të madhe prej druri, të cilën e mbuloi me lëkurë dhe aty u fsheh mbretëresha me demin. Pas disa kohësh, mbretëresha e bukur lindi një fëmijë që ishte gjysmënjeri dhe gjysmëdem dhe njerëzit u habitën dhe u frikësuan. Ky fëmijë u quajt Minotauri dhe kokën e kishte prej demi, ndërsa trupin prej njeriu. Ai ecte si njeri, por sillej si kafshë dhe ushqej me mish. Minosi e mori vesh lindjen e Minotaurit dhe i kërkoi ndihmë Dedalit për ta fshehur. Ky ndërtoi një labirinth shumë të madh nën pallatin e mbretit dhe aty futën Minotaurin. Labirinthi kishte me qindra korridore, të cilat bashkoheshin pastaj ndaheshin, pastaj bashkoheshin prapë dhe dalja e tij nuk mund të gjendej dot më. Minotauri nuk mund të dilte dhe jetonte atje. Për ta ushqyer i fusnin njerëz, të cilët ngatërroheshin dhe Minotauri i gjente dhe i hante. Por njerëzit në Kretë nuk donin që Minotauri të hante fëmijët e tyre dhe ata e morën inat mbretin, i cili u kërkoi athinasve që çdo vit t'i sillnin shtatë djem dhe shtatë vajza, të cilat do t'i hante Minotauri. Athinasit u frikësuan dhe vendosën t'ia dërgojnë Minosit shtatë vajzat dhe shtatë djemtë. Por djali i mbretit të Athinës, Tezeu, i cili ishte rritur duke ngritur shkëmbinj, tha se do shkonte në Kretë të vriste demin dhe të shpëtonte qytetin e tij nga ky dënim i tmerrshëm që i kishte caktuar mbreti Minos. Tezeu shkoi në Kretë dhe Dedali i dha një lëmsh leshi, si ato që mbajnë gratë e fshatit kur thurin triko. Ky

hyri në labirinth e vrau Minotaurin dhe pastaj doli duke ndjekur lëmshin që e kishte lëshuar kur kishte hyrë brenda.

I tërbuar nga vrasja e Minotaurit dhe ikja e vajzës, mbreti kërkoi ta vrasë Dedalin që kishte treguar sekretin e labirinthit. Dedali mori djalin e tij, Ikarin, dhe vendosi të largohej nga Kreta. Mirëpo Minosi kishte urdhëruar të gjitha varkat dhe anijet që të mos niseshin nga ishulli derisa ai të kapte Dedalin. Dedali rrinte në majë të një mali, sepse Kreta ka shumë male dhe shihnte dallëndyshtet që fluturonin mbi det dhe zhdukeshin në qiell. Disa dallëndyshe më të mëdha i ndihmonin të vegjlit e tyre që kishin krahë më të shkurtër duke i mbajtur në ajër me sqep kur ato binin. Duke parë dallëndyshtet e lumtura që iknin nga ishulli, Dedali mendoi se e vetmja rrugë për të shpëtuar djalin e tij ishte të bënte si dallëndyshtet. Ai mblodhi puplat që dallëndyshtet lëshonin në tokë, i bashkoi dhe i ngjiti me dyllë. Bëri një palë krahë për vete dhe një palë për Ikarin dhe u nisën. Fluturuan të dy të lumtur mbi det. Era i shtynte krahët e tyre dhe Ikari i vogël qeshte dhe gëzohej duke parë ishujt në det dhe peshkatarët që kapnin peshq. Dedali i tha djalit që të mos fluturonte shumë ulët që stërkalat dhe dallgët e detit të mos ia lagnin krahët dhe jo shumë lart që nxehtësia e diellit të mos e shkrinte dyllin me të cilin ishin ngjitur puplat. Mirëpo, i hutuar nga lartësia Ikari nuk e dëgjoji. Ai fluturoi lart dhe iu afrua diellit. Dylli u shkri nga nxehtësia dhe Ikari ra në det duke thirrur të atin. Baba, baba më shpëto, thërriste Ikari i ngratë duke çarë ajrin si një dallëndyshe e plagosur. Dedali e shikonte të birin e tij të dashur duke rënë, por ai nuk mund të bënte asgjë. Qante duke fluturuar dhe lotët e tij u mbytën në det bashkë me të birin.

Mihal Komneni pa Anën, e cila ishte e ftohtë si dyllë, por nuk qante. Po pse nuk e dëgjoji Ikari babanë, pyeti Ana. Jo gjithmonë fëmijët i dëgjojnë prindërit, tha Mihal Komneni. Kjo është një përrallë, pyeti Ana dhe Mihali pohoi me kokë. Muhamedi më ka thënë se në përralla nuk vdes njeri, pse vdiq atëherë djali i Dedalit?

Mihal Komneni qeshi dhe sytë i lotuan në diellin që ngrihej nga plloçat e oborrit. Përrallat e grekëve të lashtë nuk janë si gjithë përrallat e tjera. Këto janë përralla me perëndi dhe me njerëz. Perënditë sillen si njerëz dhe njerëzit sillen si perëndi. Njerëzit gjithmonë duan të bëjnë si perënditë dhe të provojnë gjëra, të cilat atyre nuk iu lejohen dhe për të cilat ata nuk janë krijuar. Perënditë greke iu japin gjithnjë dënime njerëzve. Dedali humbi djalin sepse donte të fluturonte, Paridi humbi Helenën sepse ia rrëmbeu atë një burri tjetër, Akili humbi pavdekësinë kur besoi se ishte perëndi. Ky është ndëshkimi i perëndive për njerëzit: të marrin atë që do më shumë.

Po ty, si të kanë ndëshkuar perënditë, pyeti Ana. Mua nuk më lënë të shoh djalin tim, tha Mihali dhe fytyra iu ftoh. Po pse ku është djali yt, pyeti Ana.

Në Kretë, tha Mihali, në ishullin e dallëndysheve.

Ana filloi të qeshte, u shtri mbi plloça, mbylli sytë, hapi gojën e vogël dhe me një zë të shuar si Metod Antrakidi tha: Dedalus, a i mbarove krahët? Mihal Komnenit i erdhi një shije mëllage nga stomaku dhe i mbeti në gojë. Akoma jo, tha. Ana nuk lëvizi dhe vazhdoi me zërin e Metodit: Po pse nuk i mbaron? Nuk po gjej pupla dallëndyshesh, tha Mihali. Ana lëvizi pak krahët, por sytë nuk i hapi. Era e mëllagës vërtitej në ajër, por ajo nuk e pa. Kur t'i gjesh puplat mos i ngjit me dyllë se e shkrin dielli dhe djali rrëzohet në det. Mihal Komneni u ngrit dhe iu afrua vajzës që rrinte e shtrirë mbi plloçat që digjinin. Unë jam i vjetër, tha Mihali. Edhe po t'i gjej puplat dhe t'i ngjis fort pas trupit, nuk fluturoj dot. Si thua sikur të dërgoj në Kretë një dallëndyshe tjetër?

Ana Komnena i lëvizi prapë krahët dhe u gëlltit për të qeruar zërin.

Si quhet dallëndyshja që do të çosh në Kretë, e pyeti. Mihali ktheu kokën nga dera e shtëpisë, por aty nuk kishte asnjëri. U afrua nga vajza dhe tha: Quhet Sara, është mamaja e Anës që numëron me gishta. Ana u ngrit me vrull dhe me zërin e saj tha: Pse gënjen, unë nuk numëroj me gishta.

Kështu më ka thënë Paridi, tha Mihali. Paridi u përjashtua nga shkolla për mungesa, tha Ana dhe rregulloi fustanin e zhubrosur nga plloçat.

Sara kishte dalë te porta dhe po i shikonte të dy. Mama, tha Ana Komnena, Mihali më tha se do të të çojë në Kretë që të marrësh djalin e tij. Sara pa nga Mihali që u ngrit dhe u ul në vendin e tij pranë derës. Po ti si thua të shkoj? Ana pa nga Mihali Komneni që rrinte i menduar. Kreta është në Greqi, apo jo, pyeti Sarën. Po, tha Sara, në Greqi është. Në Greqi ka perëndi të këqija, të cilat u marrin njerëzve atë që duan më shumë. Po fluturove si Dedali, kam frikë se ato do të më dënojnë mua duke të marrë ty. Kush të tha ty që unë do fluturoj si Dedali, e pyeti Sara. Ana bëri me kokë nga Mihali. Dedali humbi djalin sepse iku nga Kreta, kurse unë do shkoj në Kretë, tha Sara. Do kthehesh prapë, e pyeti Ana Komnena. Do kthehem, tha Sara duke parë Mihalin, që i lëvizi lëkura nën këmishë.

Pas një muaji, Metod Antrakidi nuk e lëpiu më gjalpin e mëllagës. Gjuha iu var në gojë dhe syzet i ranë mbi jastëk. Sytë i kishte të mbyllur, megjithatë Mihali ia mbylli, duke ia kaluar dorën mbi ballë sikur po i largonte jetën nga trupi.

E varrosën në fshat. Djemtë mbanin arkivolin, ndërsa Ibrahimimi dhe Mihali ecnin pas tyre. Kur i hodhën dhe, arkivoli prej druri kërciti dhe një erë mëllage u ngrit lart. Në Voskopojë të vdekurit mbajnë era myshk, tha Mihali Komneni. Në Voskopojë do ta kishin lënë pa varrosur, tha Muhamedi.

Kur u kthyen në shtëpi gjetën Ana Komnenën që luante me një lëmsh të madh leshi që e kishte shpërndarë në të gjitha dhomat dhe në oborrin e madh të shtruar me plloça të reja, ku Sara kishte mbjellë domate, patate, kastravecë, qepë dhe mëllaga. Filli i leshit ishte ngatërruar disa herë rreth arrës së rritur dhe që andej kishte hyrë në shtëpi. Ana ishte shtrirë në krevat dhe shikonte në tavan.

Sara filloi të mblidhte lëmshin nga dhoma në dhomë dhe kur doli në oborr ndjeu se u lodh. U ul në stolin prej dru panje që e kishte bërë Jani dhe që pastaj e kishte lyer në ngjyrë të kuqe. Hija e shtëpisë e mbulonte oborrin. Dy shtëpitë ishin bashkuar nën një çati, si dy natyra brenda trupit të një njeriu. Ato ishin fshehur qetësisht dhe pa kundërshtuar, por të gatshme për të rrëfyer të shkuarën e tyre në çdo gozhdë dhe në çdo gur. Shtëpia është bërë si ty, i kishte thënë Sara Ibrahimit kur Naumi i kishte dorëzuar çelësin në dorë: ti ke dy fe, dy emra dhe dy gra në një trup. Në mes të shtëpisë ishte një dhomë e madhe me oxhak dhe e shtruar me qilima të ndryshëm. Në çati nuk dukeshin më trarët dhe as emrat e djemve që Jani kishte gdhendur në trarin e madh. Mbi portën e rëndë të mbuluar me strehë Andrea kishte shkruar në gur vitin e ndërtimit të shtëpisë: Tetor, 1783.

Në tetë vjet Sara e kishte ndryshuar disa herë oborrin si një amvisë që e ndryshon shijen duke gatuar. Ibrahimimi kishte bërë një furrë të re me kashtë dhe baltë, në të cilën ajo piqte lakror dhe kuleç me ullinj. Muhamedi me Aliun flinin në një dhomë në pjesën e vjetër të shtëpisë. Mbi krevat Aliu kishte varur një bisht lepuri, si trofe fëmijërie, ndërsa toka e rrumbullakët kishte humbur gjatë gjurmimit të themeleve. Bota e vjetër u varros, thoshte Muhamedi. Jani me Paridin kishin rregulluar një dhomë në të cilën varej një pasqyrë e madhe me dru të gdhendur ku Paridi kalonte disa orë të ditës. Fëmijëria kishte mbetur në shtëpinë e vjetër.

Nga dhomat e djemve tani vinte erë burrash dhe këpucët ishin lënë jashtë derës së shtëpisë. Gjurmët e tyre, me baltë varrezash, dukej sikur po hynin në shtëpi dhe Sara u ngrit t'i pastronte e frikësuar. Kur hyri, pa të bijën që mbante hundët me dorë dhe faqet i ishin rrudhur nga shtrëngimi. Këtu mban era mëllagë, tha Ana.

Ditën që Petro u mbyt, Ibrahim i u thinj. Mbuloi kokën me duar sikur donte të fshihte plakjen. Djemtë u ulën rreth tij dhe Sara qau duke ndërruar qilimat e shtëpisë. Paridë ishte skuqur, kurse Aliu ishte zbehur. I thashë Petros të mos i besonte kalit të dajë Llambros, tha Muhamedi, por Jani e pa me neveri dhe ai nuk foli më. Ana luante pa zhurmë me lëmshin e leshit që i ra nga duart dhe ndaloi para këmbëve të Ibrahimit. Ibrahim i u zgjat ta merrte dhe të gjithë u habitën kur ai hoqi duart nga koka.

Koka i dukej si një velenxë.

Pse të janë zbardhur flokët baba, e pyeti Ana. Ibrahim i e shtrëngoi të bijën fort, i afroi kokën te qafa dhe e puthi. Kam një lëmsh si ky në vend të kokës, i tha Anës. Me një lëmsh si ky mund të gjesh çdo gjë që të ka humbur, i tha Ana. Ibrahim i uli kokën dhe thinjat i zbritën te vetullat. Ka disa gjëra që nuk i gjen dot më, tha dhe u përlot.

Sara mblodhi fillin e leshit dhe e çoi në dhomën e saj. Ana e ndoqi pas.

Do ta vras Ali Pashën, tha Aliu. Ibrahim i ngriti kokën dhe i tha Janit: Gjej Thanasin dhe i thuaj të më sjellë Petron në shtëpi. Nuk vdes pa varrosur djalin.

Jani i bëri shenjë Aliut dhe u nisën.

Në Janinë mbërritën në muzg. Dielli ishte ulur dhe hëna ishte ngritur. Hijet e tyre humbën në rrëmujën e qytetit. Njerëzit vraponin për t'u kthyer në shtëpi. Tregtarët po ngrinin mallrat e pashitura nga tezgat. Pazari ishte shtruar me kalldrëm, por në qytet kishte shumë baltë. Batanijet, basmat dhe pëlhurat që binin në tokë, ata i lanin me ujë liqeni, që t'i shisnin prapë të nesërmen.

Kur Ali Tepelena ishte bërë Pasha i Janinës kishte dalë në pazar për të takuar tregtarët. Shikonte çdo gjë, por pyeste vetëm për çmimin e mëndafsheve, të cilat i zinte me duart e holla dhe i afronte te faqja, sikur donte që ta puthnin. Atë ditë, kishte nisur një rrebesh dhe Pashai ishte bërë qull deri në lëkurë. Mbulojeni këtë pazar, i kishte thënë sejmëve të tij. Pas dy muajsh, pazari ishte mbuluar me tjegulla të kuqe dhe tani quhej, *kapali carshi* ose pazari i mbuluar.

Njerëzit nuk dilnin natën në Janinë. Ushtarët e Aliut kontrollonin rrugët dhe jevgjët e dehur i rrihnin. Çifutët mbylleshin herët në barakat e vogla pranë liqenit duke mbushur shishka me vaj bimësh për shërimin e ulcerës dhe duke palosur letrat e fallit. Që kur kishin ardhur në Janinë, çifutët ishin marrë vetëm me këto punë. Grekët kishin tavernat e tyre në lagjen varosh ku mblidheshin dhe pinin verë me pastërma. Liqeni ishte i pari që i ishte bindur Ali Pashës. Në dimër mbulohej me akull dhe kalamajtë rrëshqisnin mbi të me slita të vogla. Kur ndrydhnin këmbët, i çonin në lagjen e të krishterëve ku një doktor gjenovez i hutonte me një papagall memec dhe ua kthente kyçet në vend. Në verë, në breg të liqenit, gatë lanin rrobat me sapun dhe i fërkonin në govata të mëdha prej druri. Ali Pasha nuk linte njeri të peshkonte pa lejen e tij. Taksa mbi peshkun ishte e lartë dhe peshkatarët duhej ta paguanin në fillim të çdo viti. Kur ata peshkonin, njerëzit e Aliut rinin në breg dhe numëronin peshqit e vegjël që tundnin bishtin duke fryrë barkun me ajër. Peshkimi natën ishte ndaluar. Hëna ishte e vetmja që mund të zhytej në liqen pa lejen e Pashait, i cili dilte vetë në dritaret e Kastros dhe shikonte ekzekutimet që kishin urdhëruar. Natën, Pashai u thoshte ushtarëve që të ndriçonin vendin me pishtarë që ai të mund të shihte fytyrën e të dënuarit përpara vdekjes. Mbytja në ujë ishte dënimi i preferuar i Ali Tepelenës. Ka ardhur koha për barazi, qeshte Aliu. Njerëzit ushqehen me peshk, por edhe peshqit duhet të ushqehen me njerëz.



Që kur Ibrahimisi ishte bërë mysliman, në qytet ishin ngritur katërmbëdhjetë xhami. Minaret e tyre binin mbi liqen, lageshin si koka lejkësh dhe dilnin prapë duke kënduar pesë herë në ditë. Të krishterët sillnin mall nga gjithë bota dhe myslimanët e shisnin me tezga në pazar. Në Janinë kishte shumë dervishë bektashinj. Ali Tepelena nuk shkonte në xhami dhe shqiptarëve të krishterë u kërkonte të bëheshin bektashinj. Për bajram ai shpinte qengja në xhami dhe para në teqe. Kur lodhej, shtrihej në një divan të gjatë, pinte duhan me nargjile dhe thërriste dervishët që i flisnin për parajsën derisa atë e zinte gjumi. Dervishët mbushnin xhepat me duhan të shtrenjtë trëndafili dhe iknin kur Pashai fillonte të gërhiste.

Grekët e Janinës e kishin frikë Aliun. Kur ai kishte ardhur në qytet, shumë prej tyre kishin ikur. Por Aliu nuk i linte më grekët të largoheshin sepse paratë e tyre ishin burimi kryesor i pasurisë së tij. Kush donte të ikte nga qyteti duhej të linte një djalë apo një vajzë peng, në mënyrë që Pashai të ishte i bindur se ata do të ktheheshin. Taksat e mallrave ishin rritur dhjetë herë që kur ai ishte bërë Pasha.

Aliu i kishte qejf paratë. Kur nuk e zinte gjumi, zbriste në qilar dhe kalonte nëpër duar qeskat me monedha të arta. Çelësat e qilarit i mbante në brez dhe flinte duke ëndërruar male me florinj. Aliu besonte se në malet përreth Janinës kishte ar dhe argjend. Ai thirri disa gërmues nga Italia, të cilët erdhën në Janinë të pajisur me shufra të gjata, me syze të trasha, me dorëza dhe me thupra magjike, të cilat ia afronin shkëmbinjve apo i zhysnin në përrënjtë malore. Ata morën me dhjetëra fshatarë që me urdhër të pashait i detyronin të hapnin gropa të thella në formë pusi, nga të cilat shpesh shpërthenin burime ujërash që i mbysnin gërmuesit. Fjala u hap shumë dhe për disa kohë kodrat dhe malet e pashallëkut u mbushën me evropianë që kontrollonin gërxhet, grykat dhe shpellat për të gjetur ar. Ali Tepelena i paguante të gjithë, por njëherë, kur i pa që pinin në një tavernë, u mërzit, durimi i shteroi dhe i përzuri që të nesërmen me ushtarë.

Gjatë verës, kur përrënjtë zbuteshin, ai ndërtonte ura prej guri, rrugë për fshatrat e shumta të pashallëkut dhe kala me mure të trashë dhe bodrume që i mbushte me barut. Në të dalë të qytetit, ai kishte ngritur një harem me dhoma të vogla ku gratë qëndisnin dhe zbukuroheshin me bojëra dhe parfume duke pritur Pashain. Dhomat e haremit ishin plot me divane dhe jastëkë mëndafshi, ndërsa dyshemeja prej mermeri i ngjante një pylli pranveror ku kafshë dhe zogj me pupla lëpinin këmbët e zathura të grave. Në korridoret e haremit vendoseshin shporta me fiq, me rrush, me hurma dhe me pjeshkë për të ëmbëlsuar gojë e grave dhe të miqve të Pashait. Aliu organizonte aty gosti të mëdha ku ftonte tregtarë, poetë apo ushtarakë që vinin nga të gjitha viset e botës për ta takuar. Në harem kishte edhe një ndarje për djem të vegjël. Aty nuk hynte askush. Djemtë rinin në dritare si papagaj të vetmuar dhe e hapnin gojën sa herë shfaqej Pashai, i cili mendonte se duke fjetur me djem do jetonte më gjatë. Këtë ia kishte thënë njëherë një dervish që i kishte parë në filxhanin e kafesë një vijë të gjatë dhe të hollë që hynte në një bark dhe dilte prapë për t'u zgjatur deri te buza e filxhanit. Kur dervishi vdiq, Aliu qau dhe i ngriti atij një varr të bukur afër liqenit. Ali Pashai ishte i bindur se do jetonte njëqind e pesëdhjetë vjet dhe se deri atëherë sulltanët e Stambollit do ishin rrëzuar dhe ai do ngrinte një kala në Korfuz ku do të priste mbretërit e Evropës bashkë me gratë e tyre. Nuk ka perandori pa ishuj, i thoshte miqve të tij. Unë dua një ishull ku të qeveris si mysliman dhe të jetoj si i krishterë.

Ali Tepelena mbante shumë kuaj. Stallierët ishin grekë, ndërsa kuajt arabë. Një herë në vit në Janinë bëheshin gara me kuaj dhe ai rrinte në një kolltuk të gjerë dhe ndiqte kalorësit që i kapnin kafshët me thonj nga flokët. Fshatarët, e stërvitur me fustanella të shkurtra dhe këmbë të holla, vinin atë ditë në qytet, pasi i ushqenin kuajt për një muaj me tagji të mirë, dhe kush fitonte afrohej te pashai për të marrë si trofe një pisqollë argjendi apo një palë tespihe me rubin të kuq.

Kalin që fitonte, Aliu e blinte dhe stallierët ia ndërronin potkonjtë. Kuajt e garave që shëndosheshin ose plakeshin ia jepnin ushtrisë.

Shqiptarët ishin ushtarët më të mirë të Aliut, por dhe më të egrit. Ata dinin të luftonin mirë me shpata, ndërsa pisqollat i mësonin me vështirësi. Nëpër trungje pemësh oficerët varnin kuti të mbushura me kashtë dhe i mësonin shqiptarëve të qëllonin. Aliu nuk i linte ushtarët të pinin dhe pisqollat e karabinat mbaheshin të mbyllura në bodrumet e Kastros. Kur Ali Pasha bleu një top me tytë të gjatë, ushtarët e pastruan dhe e nxorën në sheshin përpara kalasë. Hija e tytës zgjatej mbi liqen dhe kalonte deri në bregun tjetër ku ishin shtëpitë e çifutëve. Burrat e Janinës u mblodhën për të parë topin, ndërsa fëmijët matnin me pëllëmbë gjatësinë e tij. Pashai kishte thirrur një kolonel anglez nga Korfuzi, për t'i mësuar ushtarëve mbushjen dhe zbrazjen e topit. Koloneli ishte një burrë i shkurtër, me bark të madh dhe me flokë të zinj kaçurrelë. Ai mbante një palë çizme të kuqe në të cilat kishte futur pantallonat e bardha që i rrinin të ngushta. Anglezi u tha ushtarëve të Pashait të ngrinin një tendë rreth pesëqind këmbë larg topit dhe filloi të rregullonte tytën, të cilën e pastroi me një leckë të kapur në një shkop me nyje. Pastaj nxori një shishe me vaj të verdhë e derdhi brenda dhe e fshiu prapë me leckë. Kur ushtarët e vendosën tendën aty ku duhej, Aliu bashkë me vezirin, disa tregtarë grekë dhe oficerët e tij shqiptarë dolën në bedenat e Kastros për të parë qitjen. Ali Pasha kishte ftuar edhe peshkopin e qytetit dhe disa dervishë të shëndoshë dhe të zhurmshëm. Kur anglezi filloi të mbushte topin me predha, pashai ngriti dorën në ajër dhe të gjithë heshtën. Predha e parë ra disa hapa larg tendës dhe zhurma e saj bëri dallgë mbi liqen. Ky top nuk të vret, por të shurdhon, tha njëri nga dervishët dhe Aliu filloi të qeshte. Anglezi nga Korfuzi e lëvizi shumë pak topin dhe u shtri mbi tytë duke parë tendën me kujdes. Barku i tij i madh u palos dhe këmbët e shkurtra dukeshin si degë të thyera mbi trungun e armës. Predha e dytë ra mu në mes të tendës, e cila u gris, u rrëzua dhe pastaj u dogj. Peshkopi duartrokiti i pari, ndërsa dervishët mbyllën veshët me duar. Atë natë Aliu e çoi anglezin në harem dhe i tha të zgjidhte kë të donte nga gratë e tij. Por anglezi mori një tas me fiq të bardhë, pastaj piu verë, hëngri prapë fiq, piu nargjile dhe e zuri gjumi. Kur u zgjua në mëngjes, takoi Aliun dhe i tha se nuk e dinte që fiqtë e Janinës të vinin në gjumë. Fiqtë e grave nuk ka nevojë t'i qërosh, i tha Aliu dhe i fali një shpatë me gurë të çmuar. Disa muaj pasi iku anglezi, ushtarët e Aliut e lyejnë vetë grykën e topit me të cilin filluan të qëllonin edhe në fund të muajit të ramazanit, por edhe për bajram. Peshkopi i kërkoi Ali Pashait ta përdorte topin edhe të dielën e pashkës, por Aliu, duke qeshur, i tha se topin nuk e kishte blerë për të thyer vezët.

Kur vendosi të pushtonte Sulin, Ali Pasha kishte një duzinë me topa, të cilëve ushtarët e tij u kishin vënë emra. Topit më të madh, që kishte një grykë të fryrë, si një fuçi hekuri, ata e kishin quajtur Sulltani, ndërsa një tjetër, gryka e të cilit zgjatej si një përkëdhelje e quanin Harem dhe kur nuk ndizej, gjë që ndodhte shpesh për shkak të lagështisë apo shiut, e thërrisnin Haram. Topin e parë që kishte ardhur në Janinë e quajtën Barku i Anglezit sepse nga pesha ai ishte varur dhe dukej sikur do prekte tokën. Topi më i bukur dhe më elegant dhe që e hidhte predhën drejt, pa bërë harqe të panevojshme, u quajt Tepelenasi, për nder të Pashait. Por kishte edhe topa të tjerë me madhësi të ndryshme të cilët u pagëzuan Gjirokastra, Korfuzi, Meka ose I vaisuri dhe të cilin grekët e Janinës e nderonin më shumë dhe në gjuhën e tyre e thërrisnin *O Kristos*. Kur topat dilnin në mëngjes nga depoja ku mbaheshin, ashtu të përgjumur e të pavajisur, ngjanin me një klasë djemsh që vihen në rresht për të larë fytyrën.

Krahina e Sulit ishte disa orë larg Janinës dhe formohej nga aleanca e trembëdhjetë fshatrave që fshiheshin në gryka të thella malesh, të cilat shikonin nga deti. Në dimër rrugët bllokoheshin nga ngricat dhe ortekët, ndërsa në verë burrat zbrisnin në fushë dhe u merrnin bagëtitë dhe ushqimet fshatarëve të varfër. Suljotët nuk kishin fusha dhe ishin të varfër. Fëmijët e tyre rriteshin me

përralla në të cilat stërgjyshërit e tyre fitonin çdo luftë me turqit, ndërsa pjesën tjetër të kohës e kalonin duke gjuajtur detin me gurë. Dita në Sul mbaronte shpejt dhe nata ishte e gjatë. Turqit nuk ishin ngjitur dot në malet e tyre të thikta dhe të gjithë suljotët kishin mbetur të krishterë. Ata nuk pranonin të bëheshin pjesë e Pashallëkut të Ali Pashës dhe nuk paguanin asnjë taksë. Luftëtarët suljotë e urrenin Ali Pashën, të cilin e quanin një hajdut mysliman.

Përpara se të niste sulmin, Aliu vendosi t'u dërgonte atyre një letër, në të cilën u kërkonte ta ndihmonin për të sulmuar Gjirokastrën. Letrën e shkroi greqisht dhe ua dërgoi dy komandantëve kryesorë Jorgo Boçarit dhe Llambro Xhavellës. Boçarët dhe Xhavellat ishin fiset më të mëdha të Sulit, por shpesh grindeshin për komandën e ushtrisë. Vitet e fundit, Xhavellat kishin marrë më shumë mbështetje nga trembëdhjetë fshatrat dhe Boçarët shfrynin duke pritur ditë më të mira. Ali Pasha e dinte se nëse do t'i drejtohej njërit, fisi tjetër do inatosej duke e prishur paktin dhe prandaj vendosi që letrën t'ua dërgonte të dyve. Kur letra mbërriti në fshat, suljotët u mblodhën dhe e lexuan në kuvendin e burrave. Ali Pashën nuk e donin, por kishin nevojë për para dhe vendosën të dërgojnë në Janinë shtatëdhjetë burra me në krye Llambro Xhavellën. Të tjerët mbetën në male duke pasur frikë nga ndonjë hile e Ali Pashës. Kur u nisën, gratë dhe fëmijët u ngjitën në majë të një kodre dhe panë karvanin e burrave që zbriste poshtë në fushë. Në krye ecte Llambro Xhavella i shëndoshë dhe qimekuq, mbi kalin e tij të bardhë dhe pas tij vinte i biri, Foto Xhavella dhe Petro, djali i Ibrahimit.

Të dy mbanin këmbë të bardha, të gjata, që e ëma e Fotos i kishte qëndisur te mëngët e hapura. Rruga ishte e shkretë dhe ata ndalonin buzë përrenjve për t'u freskuar dhe për t'u dhënë ujë kafshëve të etura. Kur mbërritën në Janinë qyteti digjej nga zhegu. Balta ishte tharë dhe pluhuri u ngrit lart deri te veshët e kuajve. Një oficer i Pashait i çoi te kazermat dhe ata u shtrinë nëpër hije dhe kërkuan bukë. Nuk ua kërkoi njeri t'i dorëzonin armët dhe fjetën duke i mbajtur poshtë kokës. Në Janinë vera ishte e lagësht dhe ata nuk i zuri gjumi duke djersitur si kuaj.

Të nesërmen, Ali Pasha e priti Llambro Xhavellën në Kastro. Ishte ulur në një divan të mbuluar me kadife dhe në dorë tundte një palë tespihe me gurë jeshilë. Afër tij gurgullonte një nargjile e vizatuar me germa arabe, ndërsa te papuçet e Ali Pashës shtrihej një mace e përgjumur. Nuk lëviz dot se zgjohet macja, tha Ali Pasha dhe i bëri shenjë të ulej, por Llambro Xhavella qëndroi në këmbë. Në fshatin tim macet flenë me gratë, i tha pashait që vuri buzën në gaz dhe fërkoj dorën e hollë mbi kadife. Lëkura iu vesh me mornica dhe papuçja iu zvogëlua në këmbën e vogël. Të kam thirrur për të kapur njerëz dhe jo mace, tha pashai dhe qeshi fort me batutën e vet. Kur i sollën duhan, Llambro Xhavella i mori erë dhe fytyra iu zbut. Ali Pasha filloi të fliste ngadalë dhe sytë e kaltër i rriteshin sa herë që Llambro Xhavella thithte çibukun e tij të shkurtër. I rrëfeu për ushtrinë e tij, për marrëdhëniet me Portën e Lartë, për planet që kishte për të sulmuar Gjirokastrën, Pargën dhe pastaj edhe Korfuzin. Nuk dua luftë me Sulin, i tha në fund. Ju jeni burra të fortë dhe ne kemi një armik të përbashkët, turqit. Kur ata të ikin unë do qeveris dhe Suli nuk do paguajë asnjë taksë. Do ju jap armë për të luftuar dhe në Sul do ngre fortesa, rrugë dhe ura. Llambro Xhavella e dëgjonte dhe kur ai mbaroi i tha: Kur do t'i biem Gjirokastrës? Shumë shpejt, tha Pashai, për disa javë jemi gati.

Llambro Xhavella u kthye vonë në kazermë dhe i gjeti burrat në gjumë. Vetëm Foto dhe Petro e prisnin zgjuar. Ata kishin dëgjuar shumë për Ali Tepelenën dhe e pyetën Llambro me një gojë: Si t'u duk Aliu?

Llambro Xhavella që përtypte duhan me dhëmbë i pa djemtë në errësirë dhe tha: Si një tigër që silllet si mace. Po Thanasin e takove, e pyeti Petro. Më mirë që nuk e pashë se do ta kisha rrahur, tha Llambro Xhavella dhe fjeti duke gërhitur si një hinkë e mbushur me oriz.

Pas dy ditësh Thanasi erdhi në kazermë dhe takoi Petron. Nuk ishin parë që kur kishin varrosur nënën e tyre. Thanasi ishte bërë një burrë i fortë me mustaqe dhe me flokë të gjata, por të drejta. Ngado e nderonin dhe pishqolla e tij ishte me dorezë fildishi që shkëlqente. Petro ishte më i gjatë dhe jeta në mal ia kishte rritur shpatullat. Rrobat e tij ishin më të vjetra se të Thanasit dhe sytë i mbyllte shpesh, si një njeri që mbrohet nga era. Thanasi i tha Petros ta linte armën në kazermë dhe e mori me vete në qytet. Ecnin të dy nëpër kalldrëme dhe hapat e tyre linin gjurmë në pluhur. Thanasi i tregoi liqenin, pazarin, Kastron dhe shtëpitë e çifutëve. Petro shikonte burrat që shisnin duke bërëtitur dhe gratë e pambuluara të grekëve që ktheheshin në shtëpi duke djersirë nën sjetulla. Petro pa një shtëpi të bardhë të lyster me gëlqere, të rrumbullakët si një kusi dhe që ndryshe nga gjithë shtëpitë e tjera kishte një oxhak të hollë dhe shumë të gjatë nga i cili nuk dilte tym. Është xhami, i tha Thanasi. Në një xhami më të vogël se kjo, në anën tjetër të qytetit, babai u bë mysliman.

Janina kishte shumë lypës. Ata i afroheshin Thanasit, të cilin dukej se e njihnin, por ai i shante dhe ata largoheshin me dorën e zgjatur. Në sheshin përpara Kastros qëndronin disa roja, të cilët lëviznin duke parë me bisht të syrit nga dritaret e kështjellës nga ku, me sa duket, dikush i vëzhgonte. Ata i mbanin karabinat mbi sup dhe mustaqet i kishin njëlloj të holla, sikur i prisnin tek i njëjti berber. Po ti si këta je, e pyeti Petro. Thanasi qeshi dhe duke vazhduar të ecte tha: Këta rrinë në diell, kurse unë jam hija e Aliut.

Në mes të oborrit të Kastros ngrihej një top i mbështetur në dy rrota dhe poshtë tij ishte një kuti druri e mbushur me predha. Gryka e tij ishte e shkurtër dhe e hollë. Është Foleja e Dallëndyshe, tha Thanasi dhe u afrua te topi. Aliu ka një kazermë plot me topa. Disa i ka rrëmbyer në beteja, por shumicën ia ka blerë turqve dhe anglezëve. Topat kanë emra të ndryshëm. Ky u quajt Foleja e Dallëndyshe sepse kur donin ta provonin, një dallëndyshe që ishte fshehur brenda tytës u ngrit në ajër dhe fluturoi, por pasi bëri disa rrotullime u fut prapë atje dhe rrinte e ulur në bisht, e frikësuar. Ushtarët e lëvizën topin që ajo të ikte, por dallëndyshja nuk dilte. Atëherë futën një shkop për ta trembur dhe dallëndyshja doli, por u kthye prapë dhe u përpoq të hynte, por ushtarët e penguan duke rrahur ajrin me shkop. E drejtuan topin, futën predhën dhe u bënë gati të qëllonin. Dallëndyshja rrotullohej bashkë me topin dhe filloi të kafshonte ajrin duke fishkëllyer si një sharrë e prishur. Kur topi u shkreh, bashkë me predhën, ra në tokë një fole e shkalafitur, kashta dhe puplat e së cilës u endën në ajër për disa minuta. Copat e folesë u shpërndanë gjithandej në oborrin e kazermës dhe ushtarët që i mblodhën thanë se ato ishin përzier me vezë dallëndysheje, të cilat, nga shpërthimi, ishin bërë si një reçel që të ngjiste duart. Dallëndyshja ulërinte duke u sjellë përreth topit të nxehtë dhe i merrte erë ajrit. Kur ia thanë këtë histori, Ali Pasha vendosi ta mbajë topin në oborrin e Kastros dhe i tha topçinjve të tij: Na duhet një fole zogjsh se e kemi mbushur kështjellën me kafshë. Petro pa topin, por tyta e tij ishte e ftohtë dhe e heshtur si një bark beronje.

Në një cep të oborrit të shtruar me gurë të dendur ishte një karrocë e mbuluar që shkëlqente në diell. Ajo qëndronte mbi dy rrota të mëdha elegante dhe dy kuaj të lartë biondë, që ishin lidhur pas saj, prisnin me kokën ulur. Është karroca e Pashait, tha Thanasi. E ka blerë në Francë. Në Janinë, përveç tij, askush nuk ka të drejtë të dalë me karrocë. Njëherë, një tregtar i pasur grek, të cilit i ishin fryrë këmbët dhe nuk ecte dot, iu lut Pashait të blinte një karrocë që të mund të dilte në qytet. Nuk më more leje kur u sëmure, iu përgjigj Aliu dhe e dëboi plakun që dy shërbëtorë e ngritën në krahë. Po ti ke hipur në karrocë, e pyeti Petro. Thanasi uli kokën dhe rregulloi brezin e kuq të pishqollës. Karroca është e vogël dhe nuk ka vend për hije, tha.

Gënjen Akuym e pyeti Petro. Ç' do të thuash, i tha Thanasi. Petro bëri disa hapa dhe ndaloi. Dajë Llambro ka frikë se Aliu po na gënjen. Na ka thirrur për të sulmuar Gjirokastrën, por daja beson se ai kërkon të sulmojë Sulin dhe duke na joshur me premtime dhe para do të na kapë në befasi. Sido që të ndodhë, do përpiqem të të shpëtoj, tha Thanasi dhe eci përpara duke fshehur sytë. Hija e tij u zvarrit në kalldrëmin e Kastros dhe u fsheh në karrocë. Kuajt lëvizën, por nuk u nisën.

Kur Thanasi i tregoi haremin Petro u ndez. Nuk hynë brenda, por ecën deri te dritaret e vogla të mbuluara me pjergull ku vajzat afroheshin sa herë që ndienin erë burrash në oborr. Ato i kishin sytë e lyer dhe flokët e lëshuar dhe të shndritshëm. Në mes të oborrit të haremit ishte një shatërvan i kuq, ndërsa uji dilte nga një çezmë në formën e një femre me gjinj të zhveshur. Ajo shihte vizitorët dhe dukej sikur i thoshte: Shuani etjen para se të vdisni. Haremi ishte një godinë me dy kate dhe me shumë ndarje, të cilat duhej të ishin dhoma. Dritaret ishin me kangjella dhe gratë dukeshin si zogj të mbyllur në kafaza. Në fund të haremit ishte dhe një pjesë me dritare më të vogla të veshura me kortinka jeshile. Ajo është pjesa e djemve, tha Thanasi, që dukej i skuqur. Petro kapërceu pështymën. Ti ke qenë atje, e pyeti. Thanasi u afrua te shatërvani, futi dorën në ujë dhe lagu qafën. Sytë e tij ishin rritur dhe shikonin me ëmbëlsi në drejtim të haremit. Kur ika nga fshati, isha një djalë i njomë dhe flija staneve bashkë me Aliun. Në dimër ishte ftohtë, por në verë lëkura të mbushej me kripë bulmeti. Ndërsa në harem është shumë fresk. Djemtë lyhen me parfum pjeshke dhe nuk mbajnë era djathë i thartuar si bagëtitë e staneve. E megjithatë aty nuk ka ditë, por vetëm net të gjata dhe të lodhshme, tha Thanasi duke parë nga dritaret me kortinka jeshile.

Në mbrëmje shkuan në tavernë. Merimangat vareshin nga trarët e thatë, ndërsa në muret me gëlqere ishin ngulur vargje me speca djegës dhe më tutje hudhra të verdha që ishin thurur si gërshet gruaje. Në një cep, varej një pikturë që tregonte liqenin dhe një djalë që bëhej gati të lahej duke parë ujin me frikë. Djali ishte i shkurtër, por fytyra e tij ishte e regjur si e një burri që mendohet. Bedenat e Kastros ishin të holla, ndërsa barakat e çifutëve ishin bërë me dy kate. Piktura ishte vizatuar me karbon dhe dielli dukej si një predhë e zezë, g ati për të rënë mbi qytet. Petro shikonte pikturën dhe Thanasit iu duk sikur ai po mendohej, ashtu si djali me fytyrë burri. po ta vizatoja unë, do bëja një kalë në breg, që djalit t'i dilte frika, tha Petro. Thanasi buzëqeshi dhe thirri kamerierin.

Taverna ishte e zhurmshme dhe pis. Aty kishte shumë grekë që pinin verë recine që mbante era rrëshirë dhe përtpynin një pastërma të djegur që ua bënte buzët të zeza. Ata morën specat të skuqur me gjizë, qofte me erëza, patate të pjekura dhe uzo. Grekët pinin dhe flisin me zë të lartë. Kamerieri, që kishte lidhur kokën me shami, vraponte në mes tavolinave dhe grekët e ngacmonin duke i pickuar të ndenjurat. Djali kërcente dhe llastohej duke lëvizur belin pastaj futej në kuzhinë dhe kthehej me pjata të tjera.

Në një tavolinë rrinte një burrë i veshur me kostum të zi, me këpucë të drejta me taka të larta dhe këmishë të bardhë në të cilën kishte lidhur një shall të kuq të gufuar me pika të arta. Herë pas here nxirrte një qostek dhe e shikonte. Të gjithë e njihnin sepse kur ai hyri grekët pushuan dhe filluan të flasin me zë të ulët. Burri ishte i gjatë, me një hundë të drejtë dhe flokët i kishte të krehura me kujdes. Porositi verë dhe peshk të fërguar me vezë. Hante duke qeruar ngadalë halat dhe herë pas here fiksohej mbi pjatë sikur zbulonte ndonjë organ të panjohur në trupin e peshkut. Ky është Tozoni, mjeku i Aliut, tha Thanasi. Nga se vuan Aliu, e pyeti Petro. Pak nga të gjitha, reumatizëm, dhimbje koke, shkurtim kockash, ujë në mushkëri, ngushtim zemre, marrje mendsh, kruarje, lemezë dhe majasëll. Më shumë se çdo gjë ka frikë kolerën dhe mban shumë mace në Kastro se Tozoni thotë që minjtë e sjellin kolerën nga kanalet. Ka frikë, e pyeti Petro duke fshirë gjizën me bukë. Ai thotë se nuk vdes njeriu as nga lemza dhe as nga majasëlli. Është i bindur që

do jetojë njëqind e pesëdhjetë vjet, tha Thanasi duke qeshur. Po ky si e shëron, pyeti Petro duke parë Tozonin që kishte mbaruar peshkun. Thanasi u ngrys dhe uli kokën mbi pjatë. Tozoni është italian, foli Thanasi. Ai ka udhëtuar shumë në Turqi, Egjipt, Maltë, More. Këtu erdhi nga Korfuzi. Njëherë e rrëmbyen piratët në Egjipt dhe e mbajtën tre vjet në anije sepse ai dinte të ndalonte rënien e dhëmbëve. Kur erdhi në Janinë u dashurua me një greke dhe mbeti. Mori një shtëpi të vjetër e rregulloi me mobilie italiane, mbolli limona në oborr dhe filloi të punonte për Aliun që e shëroi nga reumatizma. Di shumë gjuhë dhe i përkthen Pashait kur vijnë francezë, italianë ose anglezë. Tozoni është i vetmi që e pa Eminenë, gruan e Aliut, kur vdiq. Ai e di se çfarë ka thënë ajo duke dhënë shpirt. Disa thonë se e vrau Aliu me pishqollë, por disa të tjerë thonë se ajo u çmend dhe vdiq nga frika. Aliu e ka detyruar Tozonin të mos flasë për vdekjen e Eminesë dhe që ai të mos largohet nga Janina ia ka marrë gruan dhe ia ka mbyllur në harem. Një herë në muaj Tozonin e lënë të takojë gruan në një dhomë të veçantë ku ai kalon gjithë natën dhe në mëngjes ikën duke qarë. Sonte duhet të jetë nata e gruas sepse ai gjithë kohën kontrollon orë. Petro e pa Tozonin me keqardhje edhe Thanasi filloi të qeshte. Pas pak Tozoni pagoi dhe doli nga taverna. Grekët u bënë prapë të zhurmshëm ndërsa kamerieri, që ata e thërrisnin Ganimed, tundej duke shërbyer.

Kur dolën jashtë, hëna po lahej mbi liqen. Ata ecën në drejtim të kazermës duke i kthyer kurrizin liqenit. Ke qenë në fshat, pyeti Petro. Jo, u përgjigj Thanasi. Babai ka bërë një shtëpi të madhe me shumë dhoma. Ka një dhomë edhe për ne të dy. Petro ktheu kokën nga perëndimi, andej nga duhej të ishte fshati dhe hëna i ndriçoi ballin. Po shkove përpara meje mos e zër krevatin që sheh nga deti, i tha Thanasi dhe u fut në kazermë. Para se të flinte iu kujtua peshku me hala i Tozonit dhe u kollit që të mos mbytej.

Dy javë më vonë, një oficer i Ali Pashës erdhi në kazermë dhe takoi Llambro Xhavellën. Biseduan shumë pak në këmbë dhe Llambro hyri brenda dhe u tha burrave: Nisemi në të gdhirë. Bëhuni gati. Do t'i biem Gjirokastrës.

Shtatëdhjetë burrat u ngritën dhe filluan të pastrojnë armët. Kur hëna u shua, ata dolën nga kazerma. Në të dalë të Janinës i prisnin pesëqind ushtarë të Aliut, të gjithë të armatosur. Ali Pashë Tepelena nuk ishte, ndërsa Thanasi me një këmishë të kaltër rrinte në rreshtin e dytë, i hipur mbi kalë. Llambro Xhavella takoi oficerin dhe u tha shokëve të tij të ndiqnin kolonën. Dielli digjte dhe kuajt nxirrnin shkumë. Zalli i lumit të tharë anës rrugës zbardhte nga etja. Në mbrëmje, dolën dhe gryka e malit dhe fusha e zezë u hap përpara tyre si vello e vejushës. Nata ishte e pastër dhe nga larg dukeshin dritat e Gjirokastrës që fluturonin si xixëllonja mbi një shkëmb. Kolona ndaloi dhe oficeri thirri Llambro Xhavellën. Petro i pa duke biseduar në errësirë, ndërsa dhëmbët e mëdhenj të Llambros iu afruan fytyrës së oficerit. Thanasi ishte disa hapa më tutje duke dëgjuar në heshtje. Kur u ndanë, oficeri takoi Thanasin dhe të dy hynë në mes të ushtarëve që i kishin zbritur kuajve për t'u çlodhur. Qafiri më tha se do t'i biem nga një rrugë tjetër për t'i dalë Gjirokastrës nga prapa, tha Llambro Xhavella duke kapur kalin e tij fort nga kapistallet. Qimet e kuqe i ishin ngritur dhe mjekra i dridhej. Thotë se na kanë pikasur dhe nga fusha nuk mund të afrohem në qytet sepse na kanë zënë pritë më tutje. Duhet t'i dalim nga bregu, të hyjmë në luginë dhe t'i ngjitemi malit për t'i kapur në befasi. Edhe tri ditë rrugë, tha Foto Xhavella dhe i zbriti kalit. Llambro nuk foli, por lëshoi kalin dhe u ul në bar. Atë natë mbetën atje. Ushtarët nxorën bukë nga trastat, por oficeri i tha të mos ndiznin zjarr. Pa dalë dielli, u nisën. Rruga ngjitej në një mal të thatë dhe të djegur, i cili gjarpëronte duke iu shmangur një përroi të mbushur me gurë të mëdhenj që binin aty gjatë dimrit. Ecën gjithë ditën duke ndaluar shumë pak dhe fjetën vetëm në mbrëmje, në një livadh të verdhë dhe të lagur nga vesa. Të nesërmen panë detin. Më duket sikur jemi në Sul, i tha Foto Xhavella Petros që kishte ndaluar

dhe shikonte bregun nga maja e kodrës. Kali hapte hojëzat sikur thithte kripën e detit, ndërsa Llambro Xhavella ecte përpara. Nga Suli, deti duket më i pastër, tha Petro dhe vazhdoi rrugën. Disa ushtarë të Ali Pashës kishin mbetur prapa dhe po ecnin pas kurrizit të tyre. Thanasi bashkë me oficerin ishin në krye. Në drekë ndaluan afër një fshati, por nuk hynë brenda. Gjetën një burim, u freskuan dhe i vunë kuajt të pinë me radhë. Llambro Xhavella ishte zhveshur deri në brez dhe gjoksi i tij i madh nuk dukej nga qimet e kuqe që kishin nisur t'i zbardheshin. Nga aty, deti nuk dukej. Petro ngriti kokën dhe pa malin që duhej të kalonin për të dalë prapë në det. Ishte i zi dhe i mbushur me shkurre të pluhurosura. Pasdite morën rrugën dhe shumë shpejt e kapërcyen malin. Kuajt ishin të ngopur dhe u ngjitën me galop. Ushtarët e Aliut vazhduan të ecnin pas tyre dhe Petros iu duk sikur i kishin rrethuar. Dielli në perëndim i digjte qafën dhe ai u zgjat mbi det, por iu morën mendtë. Ishin shumë lart. Poshtë tyre bregu ishte plot me shkëmbinj që laheshin, si kockat në çezmë. Pas pak, lartësia u zbut dhe deti dukej më afër. Faqja e malit zbriste si thikë dhe pothuajse nuk kishte breg. Dallgët e lodhura të pasdites lëpiheshin pas malit. Kuajt ndaluan dhe Petro pa oficerin që u afrua nga Llambro Xhavella. Kur i erdhi tre hapa larg, nxori pishqollën dhe ia drejtoi në gjoks. Me urdhër të Ali Pashait, dorëzohuni, tha oficeri dhe të gjithë ushtarët i drejtuan armët drejt tyre. Llambro Xhavella nuk lëvizti dhe të shtatëdhjetë burrat u mblodhën rreth tij duke ngritur armët. Ne jemi pesëqind kundër shtatëdhjetë, tha oficeri dhe iu afrua Llambro Xhavellës që rrinte mbi kalë duke parë detin në perëndim. Ti do vdesësh i pari, bërtiti Foto Xhavella dhe e drejtoi karabinën e tij mbi oficerin. Pas tët eti, foli oficeri dhe djersa i zbriti në faqe. Mos qëlloni, tha Llambro Xhavella dhe iu drejtua oficerit. Çfarë do Ali Tepelena nga unë? Pashai më ka urdhëruar t'ju kthej në Janinë të paarmatosur, u përgjigj oficeri dhe mori frymë thellë. Kjo është pabesi, tha Foto dhe u ngrit mbi kalë, por dora e Llambros e qetësoi. Llambro Xhavella dhe oficeri u afruan duke biseduar, por askush nuk i uli armët dhe ata të dy dukeshin sikur ishin takuar në mes të kallinjve të misrit. Petro ndjeu një të dredhur në trup. Sqetullat i ishin lagur nga djersa, kurse flokët i ishin fryrë nën qeleshe. Mori frymë thellë dhe i lëshoi pak frerët e kalit. Sytë i kishte të skuqur, por deti dukej shumë afër. Pa Foto Xhavellën drejt në sy pastaj kërcëu nga kali dhe, pasi bëri një hap të gjatë, fluturoi në det. Foto Xhavellës iu duk si një zog që hidhet në det pa i lëvizur krahët. Ushtarët e Aliut u afruan dhe nisën të qëllonin. Por Thanasi i thirri dhe ata e pushuan zjarrin. Petro ishte zhytur në ujë dhe nuk dukej. Thanasi hodhi pishqollat, vrapoi si i çmendur derisa gjeti një rrëpirë dhe zbriti deri afër detit e pastaj u zhyt në ujë. Ndërsa Foto u hodh në det njëllor si Petro, dhe filloi të notonte si i marrë. Llambro Xhavella dhe oficeri u zgjatën duke parë poshtë, ndërsa ushtarët i mbanin armët të drejtuara mbi burrat nga Suli. Thanasi zhytej në ujë pastaj nxirrte kokën të merrte frymë dhe zhytej prapë derisa thirri: E gjeta.

Mbi ujë doli koka e Petros që varej si një fole zogu e braktisur. Kur e nxorën nga uji, Petro nuk merrte frymë. Në mes të shpatullave kishte një vrimë plumbi që ia kishte çarë krahërorin. Thanasi qante mbi trupin e të vëllait, ndërsa Foto Xhavella ishte ulur mbi një gur dhe shikonte nga deti. Llambro Xhavella zbriti në rrëpirë dhe oficeri e ndoqi pas duke ia mbajtur pishqollën në drejtim të kokës. Burrat nga Suli shanin ushtarët e Ali Pashës, por këta nuk flisnin dhe nuk i ulën armët.

Kali i Llambro Xhavellës ishte afruar në buzë të greminës dhe shikonte trupin e lagur të Petros. Llambro e puthi Petron në ballë dhe nuk ia hodhi sytë Thanasit, të ënjtur nga lotët. Foto thirri dy nga shokët e tij. Oficeri bëri shenjë dhe ushtarët i lejuan të lëviznin. Ata gjetën një copë tokë në mes të shkëmbinjve dhe hapën një gropë. Thanasi e ngriti të vëllanë, e futi brenda dhe e mbuloi duke i hedhur rërë të lagur me duar.

Të nesërmen mbërritën në Janinë. Llambro Xhavella ecte mbi kalë me kokën ulur dhe i paarmatosur. Thanasi kishte mbërritur një natë përpara tyre.

Jani dhe Aliu e kërkuan Thanasin në Kastro, por ai nuk ishte. U endën rrugëve të zbrazura të Janinës dhe në mesnatë e gjetën në tavernë. Kamerieri i ri që tundej si vajzë, tregoi me gisht një tavolinë në cep ku Thanasi ishte ulur me një gotë përpara. Flokët i kishin rënë mbi ballë dhe dukej sikur kishte ditë që nuk krihej. Kur pa dy vëllezërit, sytë iu thanë. Kaloi dorën mbi mustaqe dhe u mbështet në karrige. Jani dhe Aliu u ulën përballë tij dhe një copë herë nuk folën. Taverna ishte e qetë dhe Thanasi shikonte pikturën e djalit që kishte frikë të lahej në liqen. Babai kërkon trupin e Petros, i tha Jani duke u gëlltitur. Thanasi nuk lëvizi dhe vazhdoi të mbante kokën në drejtim të pikturës. Do ta vras Ali Pashën, tha Aliu dhe shtrëngoi duart mbi tavolinë. Thanasi ktheu kokën. Pse do ta vrasësh, e pyeti duke e parë në sy. Aliu më vrau vëllanë, u përgjigj Aliu. Vëllanë ta kam vvarë unë, tha Thanasi dhe ktheu kokën qetësisht nga piktura. Aliu u ngrit në këmbë me zhurmë dhe kamerieri nxori kokën nga kuzhina. Jani e kapi për dore dhe Aliu u ul prapë.

Ku është Petro, pyeti Jani. Thanasi u kthye nga vëllezërit dhe duke parë gotën që kishte përpara filloi të fliste. I tregoi për takimin me Petron, për kazermën, për shëtitjen në qytet, për haremin, për Kastron, për natën në tavernë, për Tozonin, për nisjen nga Janina, për rrugën mes maleve, për oficerin, për ushtarët, për kalin e Llambro Xhavellës dhe për fluturimin e Petros në det. Zëri i tij ishte i butë, por i lartë dhe Jani i duk sikur kamerieri i dëgjonte pas murit të kuzhinës. E dije që Ali Pasha do ta gënjente dajë Llambro? E dija, tha Thanasi, por nuk mund t'ia thosha Petros sepse ai do t'ia tregonte të gjitha Fotos dhe plani do prishej. Ti tradhtove vëllanë për Ali Tepelenën, bërtiti Aliu.

Thanasi dukej i qetë. Kishte tri ditë që mendohej në vetmi dhe në kokën e tij kishte kaluar çdo detaj i vdekjes së Petros. Ai e dinte se Aliu po e gënjente Llambro Xhavellën, por nuk kishte menduar se i vëllai do hidhej në det për t'i shpëtuar rrethimit. Kishte qenë i bindur se, pasi të shtatëdhjetë burrat të burgoseshin në Janinë, ai do arrinte ta lironte Petron dhe do ta kthente në shtëpinë e tyre të re në fshat. Babai do kënaqej dhe Petro do flinte në dhomën e madhe me krevat nga deti. Por këto nuk mund t'ia thoshte dy vëllezërve që e shihnin si një tradhtar të çmendur. Ata ishin rritur dhe e kuptonin se vdekja nuk ishte një lojë kalamajsh që mund të kthehet pas, të zhbëhet dhe të përsëritet duke ndërruar vend mes humbësit dhe fituesit. Kur ishin të vegjël, ai dhe Petro luanin luftash. Ai vritej dhe Petro fitonte, pastaj mërzhiteshin, ndërronin rolet dhe Petro vritej, ndërsa ai fitonte. Por kjo lojë kishte mbaruar kur Petro kishte vendosur të luante me Ali Pashën. Petro kishte humbur, Aliu kishte fituar, ndërsa ai ishte në mes të të dyve. Qante për të parin dhe luante me të dytin.

Iu kujtua koha kur Ali Tepelena kishte ardhur në fshat dhe e kishte marrë me vete. Aliu kishte sy të kaltër, duar të holla dhe një lëkurë vajze nën të cilën dukeshin damarët e mbushur me gjak të kuq. Njëherë, kur ishin shtrirë të dy nën një mollë me lule të bardha, ai e kishte pyetur Aliun se kush nga ata të dy do vdiste i pari. Unë, i kishte thënë Aliu. E kam parë në ëndërr. Do më presin kokën dhe ti do më marrësh për dore e do më shëtisësh nëpër Janinë. Do të të laj në liqen dhe pastaj do të të fshij me peshqir, i kishte thënë ai duke parë lulet e mollës. Aliu ishte ngrysur dhe i kishte dhënë një shpullë në kurriz. Kjo që të thashë është një ëndërr që nuk ka për të ndodhur. Gjethet e mollës i kishin rënë mbi kokë dhe Aliu i kishte larguar me bezdi.

A të duket se ai djali i ngjan Petros, pyeti Thanasi duke treguar pikturën pa ngjyra në mur.

Jani nuk e ktheu kokën dhe duke e ngritur zërin i tha: Babai pret Petron. Shkojmë ta marrim, foli Thanasi dhe u ngrit.



Lindja e diellit i kapi afër detit. Kishin udhëtuar gjithë natën pa folur. Thanasi ecte përpara mbi kalë dhe vëllezërit e ndiqnin në errësirë. Gjyokastri ishte futur në re dhe dritat nuk dukeshin. Kur u afruan te vendi nga ish hedhur Petro, i zbritën kuajve. Thanasi eci në buzë të rrëpirës dhe disa gurë ranë në det duke bërë rrathë të vegjël. Zbritën poshtë dhe filluan të gërmonin në heshtje. Aliu qante, por dallgët ishin të zhurmshme dhe ai nuk dëgjohej.

Petro doli nga toka si një kërmill pa guaskë. Ishte bërë gri dhe sytë i ishin mbushur me rërë. Jani ia pastroi me ujë deti dhe e puthi në faqe. Gjaku i ishte mpiksuar mbi këmishë dhe plaga ngjante si një mëllagë e tharë. Aliu hoqi këmishën e tij të bardhë dhe ia veshi Petros. Ta çojmë të pastër në fshat, i tha Janit. Mori këmishën e gjakosur, e futi në det dhe e shtrydhi disa herë. Duart iu skuqën dhe ai i shpëlau në det. Pastaj e tundi disa herë këmishën në ajër dhe e veshi. Trupi iu mbush me avull dhe ai ndjeu se këmisha e tërhiqte drejt detit, por këmbët i kishte të mpira dhe duart të rrudhosura nga uji. Këmisha e Petros i rrinte e madhe dhe duart nuk i dukeshin nën mëngët e gjata. Rrinte në breg dhe shikonte rrathët mbi ujë. Ato kriheshin me radhë, por kur prekeshin me njëra-tjetrën prisheshin të dyja, njëlloj si jetët e njerëzve kur takohen. Sa kohë janë të ndara, ecin secila në punë të vet. Do ta vras Ali Pashën, tha me vete Aliu dhe pa Thanasin dhe Janin që e kishin mbështjellë Petron me një çarçaf të madh dhe po e ngjisnin lart, aty ku prisnin kuajt.

Thanasi i përcolli deri afër fshatit. Gjithë rrugën nuk kishin folur. Trupi i Petros lëkundej mbi kalë dhe zgjatej nga toka. Aliu e kishte ndihmuar Janin disa herë që ta drejtonin dhe të mos i binte. Kali i Janit ecte me kujdes duke respektuar ekuilibrin e trupit të Petros. Dielli ishte i kuq dhe djersët i pikonin Janit mbi çarçaf. Kur kambanorja e fshatit u shfaq nga larg, Thanasi ndaloi dhe zbriti nga kali. Dukej si një fëmijë që ka ikur nga shtëpia. Unë e kam varrosur një herë. Tani varroseni ju, i tha Janit që e shikonte me qetësi. E hapi pak çarçafin, puthi të vëllanë dhe u zhduk pa e kthyer kokën. Ata vazhduan ngadalë dhe kur hynë në fshat ishte errur.

Ibrahimi ishte ulur në oborr dhe po i priste. Thinjat ndriçonin në errësirë. E shtrinë trupin e Petros në dhomën e madhe të djemve dhe ia hoqën çarçafin. Ibrahimi nuk fliste dhe sytë i mbante të mbyllur. Sara zjeu ujë me borzilok dhe Muhamedi me Aliun e zhveshën dhe e lanë të gjithin. I vunë gjethe sipër plagës dhe i veshën një këmishë të re të Ibrahimit. Petro dukej sikur flinte kur dielli i ra në sy në mëngjes. Para se ta fusnin në arkivol erdhi Hana dhe pastaj edhe Ana Komnena që rrinte pas kurrizit të Ibrahimit të përkulur. Petro qenka më i bukur se Muhamedi, tha Ana dhe i shtrëngoi dorën të atit. E varrosën në drekë. Jani, Paridi, Muhamedi dhe Aliu mbanin arkivolin, ndërsa Ibrahimi ecte me Anën përdore. Kur kishte gropa, Ana ndalonte dhe Ibrahimi i kalonte me mundim. Pas tyre vinin Sara, Hana dhe Mihal Komneni.

Petron e varrosën pranë të ëmës në varrezat e të krishterëve. Kur u kthyen në shtëpi, Mihal Komneni kërkoi kafe, ndërsa Ibrahimi i tha Sarës t'i ziente një çaj mali. Po Thanasi pse nuk erdhi, pyeti Hana duke i zgjatur kafën Mihalit. Jani dhe Aliu ngritën supet. Thanasi do vijë kur të vdes unë, tha Ibrahimi dhe çaji iu derdh mbi këmishë.

28

Ibrahimi qëndroi dy vjet i ulur në stolin e oborrit. Dilte në mëngjes, shikonte diellin dhe mbyllte sytë. Rrezet i ngrohnin qafën dhe flokët i zbardheshin. Lëkura e tij kishte ngjyrën e grurit në dimër, ndërsa në verë dukej si kafe e bluar. Njerëzit kalonin aty, e përshëndesnin dhe Ibrahimi buzëqeshte. Sara zgjohej pas tij, i bënte çaj dhe në drekë i jepte edhe një gotë qumësht me bukë të thekur. Jani e zmadhoi stolin, i ngriti mbështetësen dhe nguli një jastëk me gozhdë të vogla që

të mos binte. Kur binte shi, Ana dilte me vrap dhe e fuste babanë në shtëpi. Njëherë, ajo ishte me Sarën në pyll dhe kur u kthyen Ibrahimisi ishte lagur si një kalë që e kanë lidhur pas gardhit dhe nuk lëviz dot. Qeshte me vete dhe shikonte nga rruga. Uji i kishte rrjedhur në qafë dhe thinjat i ishin bërë të zeza. Jani vuri katër shkopinjtë të trashë rreth stolit dhe mbi to lidhi një çarçaf të bardhë që i rrinte Ibrahimit si një çadër mbi kokë. Dielli e zinte më pak dhe lëkura nuk i rripte më nga djegia.

Paridi sillej nëpër fshat dhe natën vonohej. Kur ndonjë vajzë nuk kthehej në shtëpi, vinin dhe e kërkonin në shtëpinë e Ibrahimit. Ky buzëqeshte dhe i tregonte burrave të fshatit historinë e Paridit, të mollës së sherrit dhe të tri perëndeshave. Burrat e dëgjonin për respekt dhe kur shkonin në shtëpi u thoshin grave se Ibrahimisi ishte çmendur. Paridi vishej me këmishë të bardhë që ia hekuroste Sara, ngrinte flokët lart me këna dhe hidhte parfum pjeshke që ia dërgonte Thanasi nga Janina. Kur Sara me Anën shkonin në pyll dhe Muhamedi lexonte, ai i ftonte vajzat në shtëpi dhe mbyllej me to në dhomën e tij. Ibrahimisi hapte sytë dhe pyeste të birin: Kush ishte kjo, Athinaja apo Afërdita? Paridi i shkelte syrin dhe rregullonte flokët e prishur.

Jani rrinte në pyll, priste drurë, i shiste në qytet dhe kur nuk kishte punë bënte stola, sëndukë, korniza, ikona dhe tavolina të vogla që Sara i vinte nëpër shtëpi. Kishte rregulluar bodrumin e shtëpisë së vjetër ku Thanasi kishte lidhur dikur Mihalin e Zoicës dhe aty punonte me sharrë dhe me çekiç. Muskujt i ishin fryrë dhe gjoksi i ishte gdhendur si Andreas, djalit të Naumit. Herë pas here shkonte në varrezat e krishtera dhe mbillte lule mbi varrin e Petros dhe të së ëmës e pastaj shkonte te varrezat e myslimanëve dhe linte një kalë druri ose një zog të gdhendur mbi varrin e Ademit.

Muhamedi lexonte librat e Arianit Komnenit dhe kur Mihali vinte në fshat, gjatë verës, bisedonin të dy. Muhamedi nuk mbante mustaqe dhe flokët i priste shkurt. Njëherë i kishte thënë Mihalit se kishte ndryshuar mendim për Voskopojën. Ç' do të thuash, e kishte pyetur Mihali, duke e parë në sy. Po ja, kishte thënë Muhamedi, nëse unë do të isha profet në Voskopojë nuk do ta kisha vrarë Marin Kurilën, por do ta kisha detyruar të martohej me Aishen. Mihali Komneni kishte ngritur vetullat. Nuk ka rrugë tjetër, kishte vazhduar Muhamedi. Fshati ynë nuk i ngjan Voskopojës, jo vetëm sepse nuk ka libra, piktorë, myshk dhe taverna, por sepse të krishterët këtu martohen me myslimanët, siç u martua babai me Sarën. Kjo është e vetmja mënyrë që grindjet mes të krishterëve dhe myslimanëve të qetësohen sepse fëmijët janë të përbashkët dhe ata e ruajnë paqen brenda shtëpisë siç kemi bërë ne. Fshati shpëtoi kur Arianit Komneni iku, sepse ai nuk do lejonte që vajzat e krishtera të martoheshin me burra myslimanë. Po të ishte ai në fshat, babai nuk do ishte martuar me Sarën dhe nuk do të ishte zbutur. Ne, djemtë e tij, do ishim myslimanë të egërsuar dhe të gatshëm për t'u hakmarrë duke menduar se po jetojmë në një fshat ku na është ndaluar ajo që i lejohet të tjerëve, siç mendonte edhe Sali Benishi. Shqiptarët kanë vetëm një zgjidhje: të martohen të krishterë me myslimanë që të shmangin Voskopojën.

Mihali e shikonte dhe e pyeste. Po ti kur do ta gesh Aishen? Nuk e di, përgjigjej Muhamedi duke fërkuar ballin. Aishet e fshatit duan mollën e Paridit.

Aliu kishte ikur në Janinë dhe i kishte thënë Janit se do kthehej kur të vriste Ali Pashën. Thanasi e kishte ndihmuar të punonte si stallier për kuajt e Aliut. Ai i lante kuajt, i ushqente dhe i ndërronte potkonjtë. Njëherë i kishte futur kalit të Aliut një gozhdë në potkua që ai të rrëzohej. Por Ali Pasha ishte shëndoshur dhe nuk i hipte më kalit, por dilte vetëm me karrocë. Kur e shikonte duke ecur nëpër kalldrëmet e qytetit, Aliu mërziqej, shkonte në tavernë, shikonte pikturën me djalin që kishte frikë të lahej dhe dehej. Atëherë, rendte përpara Kastros dhe bërtiste. Rojat që e njihnin, lajmëronin Thanasin dhe ky ia fuste kokën në liqen, pastaj e çonte në shtëpi

dhe e shtrinte në krevat. Të nesërmen kuajt rrudhnin hundët nga duhma e fortë e uzos që lëshonte goja e Aliut.

Por Thanasi nuk ishte gjithmonë në qytet. Pashai e ngarkonte me punë dhe ai rrinte me ditë në kalanë e Tepelenës, apo në Prevezë, apo duke u takuar fshehurazi me Foto Xhvellën. Pasi vdiq Petro, Ali Pasha e kishte liruar Llambro Xhvellën, por kishte mbajtur peng në Janinë, Foton, të cilin e kishte bërë oficer. Foto dhe Thanasi rrinin bashkë dhe kur dajë Llambro vdiq, Foto shkoi në fshat dhe u bë kapedan i Sulit. Ali Pasha e kishte rrethuar Sulin në një verë të nxehtë dhe i kishte lënë tre muaj pa bukë suljotët në majë të malit. Kur rrethimi u bë i egër dhe fëmijët filluan të dobësohen, ndërsa pleqtë të ënjtën nga uria, Thanasi kishte takuar Foton dhe e kishte bindur të dorëzohej duke i dhënë besën e Ali Pashës se askush nuk do vritej. Foto Xhvela ishte bindur dhe mijëra burra, gra dhe fëmijë me lot në sy dhe trasta në krahë kishin kaluar në mes të rreshtave të ushtarëve të Ali Pashës dhe kishin ikur në Korfuz e në qytete të tjera të Greqisë. Thanasi ishte ngjitur i pari në Sulin e braktisur. Nga maja e malit dukej deti dhe atij i ishte kujtuar Petro. Kishte hedhur një gur në det dhe flokët ia kishte marrë era.

Sara shihte Anën që rritej dhe ia lidhte flokët gërshet. Hunda e saj ishte e vogël dhe flokët ishin shumë të zinj. Faqet i kishte të kuqe si shegë, ndërsa këmbët të gjata si hardhi. Kur vraponte nëpër shtëpi, fustani i ngrihej deri te kofshët e ngrohta dhe gjinjte e vegjël kërcenin si kuleç me bajame. Në pranverë shkonin të dyja në pyll dhe Ana gjente breshka, ndërsa Sara lexonte në rrëzë të një molle të egër. Breshkat fusnin kokën poshtë guaskës dhe Ana i fliste derisa i zbuste, por nuk i merrte në shtëpi. Nganjëherë e lidhte fillin e leshit pas qafës së shkurtër të breshkës dhe e lëshonte në livadh. Breshka ecte ngadalë dhe filli i ngatërrohej mbi kurriz derisa ia bllokonte këmbët dhe ajo ndalonte e hutuar.

Në dimër, rrinin të dyja pranë oxhakut dhe piqnin gështenja. Ana Komnena i qëronte gështenjat me duart që i digjnin dhe i lyente me reçel për t'i ftohur. Kur binte borë dhe rruga përpara shtëpisë ngrinte, ajo dilte jashtë dhe shkiste me një slitë të vogël me dy hekura që ia kishte mbërthyer Jani. Mbante në kokë një kapuç leshi dhe gërsheti i zi e ndiqte pas nëpër dëborë. Në darkë, Ibrahim mbështillej me velenxë në dhomën me shikim nga arra e vogël, e cila mbulohej me borë dhe ia bënte atij gjumin më të rëndë. Ana ulej mbi qilim, me lëmshin në duar dhe pyeste Sarën: Pse nuk e ke njohur nënën? Sara lëvizte mashën mbi prush dhe fërkonte sytë nga tymi. Nëna ime vdiq që unë të lindja. Po sikur të mos kishte vdekur, ti do vije në fshat të më lindje mua? Nuk e di, përgjigjej Sara. Por edhe nëse nuk do të kisha ardhur në fshat prapë do të të lindja ty. Ana Komnena afrohej më shumë pranë zjarrit dhe pushi i faqeve i piquej në prush. Lëvoret e gështenjave binin përdhe e ajo i mblidhte dhe i hidhte në zjarr. Ato kërcisnin dhe flaka e tyre nxirrte xixa. Si do më lindje mua, pyeste Ana duke drejtuar gërshetin. Po të mos vije në fshat nuk do martoheshe me babanë dhe unë nuk do lindja. Sara qeshte dhe i afronte së bijës gështenja të tjera, të mëdha, të cilat i çante në mes me thikë që të mos plasnin.

Ti ke qenë brenda meje që kur unë kam lindur, thoshte Sara. Po sikur të kem qenë edhe brenda babait, ngulmonte Ana duke e parë të ëmën në sy. Sara ulej pranë së bijës dhe i fërkonte këmbët e gjata. Unë kisha një gështenjë, thoshte ajo. Gështenja ishte e njomë, e rrumbullakët dhe e shijshme. Unë lozja me gështenjën ngjyrëmjalti, por nuk dija ta qëroja. Një ditë takova babanë dhe ai më ndihmoi t'ia hiqja lëvoren. Kur u hap gështenja, dole ti.

Ana Komnena qeshte dhe sytë i shkëlqenin. Zjarri i kalonte në trup dhe e zinte gjumi në krahët e Sarës. Në mëngjes shkante te stoli i Ibrahimit. Dëbora kishte veshur oborrin, por tenda me çarçaf e kishte mbajtur stolin të thatë dhe të ngrohtë. Ibrahim pinte çaj të nxehtë dhe afër stolit, Sara

kishte sjellë një mangall plot me prushin e natës. prushi mbante era gështenjë dhe Ibrahimimi i hapte hundët fort duke thithur diellin e pastër të dimrit.

Ana Komnena ulej pranë tij në stol dhe i thoshte: Di të qërosh gështenja? Di, i thoshte Ibrahimimi me sytë e mbyllur. Po kur unë isha gështenjë si ma hoqe lëvoren? Ibrahimimi ngrinte kokën lart dhe qeshte. Thinjat i dukeshin si një kurore e mamasë, por ajo nuk e qëronte dot dhe unë e ndihmova. Po Paridi gështenjë ishte, pyeste Ana. Jo, Paridi ka qenë një mollë, përgjigjej Ibrahimimi. Po Muhamedi? Muhamedi ka qenë një hurmë. Po Aliu? Aliu ka qenë një vezë. Po Petro? Ibrahimimi i shtrëngonte pak sytë dhe dëgjonte dëborën që shkrihej nën mangall. Çaji bënte dallgë në gotën e tij, por fytyra i çelej nga një buzëqeshje e vjetër dhe e pastër. Petro ka qenë një guaskë, thoshte pa i hapur sytë. Ne e morëm nga fundi i detit dhe e hapëm. Ishte i vogël dhe nuk dinte not. Kur u rrit, u kthye prapë në det, aty ku e kishte vendin.

Ana ndiente ftohtë nga këmbët dhe shihte mangallin që ftohej. Kur shkrinte dëborë ajo merrte lëmshin dhe e lëshonte në oborr dhe nëpër dhoma. Një pasdite ia la lëmshin Ibrahimimit dhe hyri në shtëpi për të gjetur fundin e fillit. Kur u kthye, lëmshi i kishte rënë babait nga dora dhe ishte rrokullisur deri te kisha në mes të fshatit. I foli, por ai nuk u përgjigj. Hëna e re i kishte zbritur Ibrahimimit mbi thinja. Thirri Sarën që erdhi me vrap dhe pas pak filloi të qante.

Atë natë ra shi dhe stoli i vetmuar u lag. Jani e shkuli jastëkun dhe e futi në arkivolin e Ibrahimimit. Aliu erdhi në mesnatë, ndërsa Thanasi të nesërmen në mëngjes. Jani mbylli arkivolin me gozhdë dhe dëgjoi Thanasin që tha: Nuk e vrava unë Petron, baba.

E çuan te varreza e myslimanëve, ngjitur me Ademin. Binte një shi i qetë dhe Paridit i rridhte kënjaja në fytyrë. Para se ta mbulonin, Ana Komnena hodhi një gështenjë të egër që u përplas fort mbi arkivol dhe u nda në dy pjesë.

Kur u kthyen në shtëpi, Sara u ul një copë herë në stolin e Ibrahimimit. Tenda e mbante shiun që binte pa zhurmë. Arra e vogël ishte anuar pak nga dritarja dhe dukej sikur kërkonte dikë në dhomën e gjumit. Djemtë kishin hyrë në dhomat e tyre. Kali i Thanasit ishte lidhur pas gardhit dhe me veshët ngritur shikonte nga rruga. Ana Komnena iu afrua dhe mbështeti kokën në supin e saj. Flokët e lagur iu ngjitën në faqen e Sarës. Mama, çfarë do bëjmë tani që iku babai? Sara mori frymë dhe pa shtëpinë që iu duk shumë e madhe. Do shkojmë në shtëpinë tonë, u përgjigj. Ana iu ngjesh në trup dhe i tha me zë të ulët: Nuk dua ta marr lëmshin me vete. Mirë, tha Sara dhe e përqafoi.

Kur Sara i tha djemve se do kthehej në shtëpinë e Arianitit, Jani nuk foli, por zbriti në bodrum dhe bëri një krevat të gjatë me dru qershie për Ana Komnenën. Paridi u mërzi dhe u ul para pasqyrës, por Sara i tha se do t'ia hekuroste prapë këmbët e bardha me niseshte. Po kuleç me mjaltë do t'i bësh, e pyeti Ana për të qetësuar vëllezërit. Do t'i bëj dhe ti do t'ia sjellësh të ngrohtë në mëngjes, tha Sara duke mbledhur çarçafët në dhomën e gjumit. Muhamedi ishte ulur në tavolinën e madhe dhe shikonte sëndukët dhe trastat që mbusheshin me enë, peceta, mbulesa, qilima dhe kortinka. Sara mblodhi rrobat e Ibrahimimit, i palosi, i vuri çdo këmishe një gjethe arre në thile dhe i vari në dollap. Unë nuk i vesh rrobat e babait, tha Paridi. Do t'i vesh unë, tha Muhamedi dhe u ngrit të ndihmonte Sarën.

Sara dhe Ana e rregulluan shpejt dhomën e madhe të Arianit Komnenit. Mihal Komneni kishte muaj që nuk kishte ardhur në fshat dhe dhoma ishte e ftohtë. Sara e leu me gëlqere të re dhe kur u tha vari dy sixhade në mure. Krevatin e ri të Anës e vendosën afër dritares që shikonte nga oborri me plloça. Para se të flinin, Sara shoi qirinjtë mbi shandan dhe iu kujtua Ibrahimimi. Ana u zgjua vonë në mëngjes. Sara kishte bërë kuleç me mjaltë dhe me arra dhe ajo vrapoi t'ia çonte vëllezërve që po e prisnin në oborr. Muhamedi ishte ulur në stolin e Ibrahimimit, ndërsa Jani rrinte në këmbë dhe shikonte nga rruga. Si fjetët, e pyeti Muhamedi. Mirë, i tha Ana, por kam parë

gjithë natën ëndrra me numra dhe me germa. Muhamedi qeshi dhe mjalti i kulaçit i shkau nëpër gishtërinj. Kështu ndodh kur fle në shkollë, i tha.

Çdo të diel Sara i ftonte djemtë në shtëpi për drekë. Vinte dhe Hana dhe gatuanin mish me patate, lakror dhe pula të mbushura me oriz. Ditët e javës Ana i çonte vëllezërve kuleç të ngrohtë dhe një këmishë të hekurosur për Paridin që e mbante me kujdes. Jani punonte në bodrum, kurse Muhamedi rregullonte shtëpinë dhe në darkë skuqte vezë ose mbushte specia me gjizë që, kur digjeshin, e mbushnin kuzhinën me tym. Kur Paridi merrte ndonjë vajzë në shtëpi, Muhamedi vinte veshin te dera e dhomës së tij dhe harronte vezën që digjej në tigan. Çekiçi i egër i Janit, që kumbonte në bodrum, e pengonte të dëgjonte ritmin e trupit të Paridit.

Në fund të pranverës, në fshat erdhi një familje jevgjish. Ata erdhën një natë pa zhurmë ngarkuar me bohçe të mëdha dhe të nesërmen, në fushë, aty ku ishin varrosur bagëtitë që ngordhën nga kolera, u pa një tendë e ngritur mbi shkopinj, nga e cila doli një burrë i zi me flokë kaçurrela dhe me hundë të kërrusur. Trupin e kishte të fortë dhe duart e gjata i vinin deri te gjunjët. Burri quhej Bilal dhe kishte ardhur nga Janina. Për shumë vjet kishte punuar për Ali Pashën. Ai kujdesej për karrocën e Aliut dhe ushqente kuajt. I lante, i jepte tagji, i priste bishtat, i hiqte sklepat në sy dhe mbledhte bajgat që ata lëshonin në oborrin e Kastros. Bilali kruante baltën, guriçkat, apo milingonat e ngordhura në rrotat e karrocës duke i fërkuar me gur dhe me bronz, lidhte kapistallët e kuajve pas karrocës, dhe fshinte me fuqë jastëkun e atlasit të verdhë ku ulej Pashai. Nëpër rrota shpesh gjente qime kafshësh apo flokë të gjata grash, të cilat karroca i kishte sjellë me vete në kështjellë duke i shtypur. Bashkë me karrocën, nga Franca kishte ardhur edhe një bojë e zezë me të cilën Bilali lyente mushamanë e trashë të karrocës që plasaritej nga vapa dhe ngrinte nga dimri.

I kishin thënë se karroca duhej të lustruhej përditë dhe të shkëlqente njëlloj si këpucët e Tozonit, doktorit të Ali Pashës. Ai zhvishej pa gdhirë dhe e kalonte fuqën me qime dhjetëra herë në kanalet dhe gropat e padukshme të mbulesës prej mushamaje. Kur Kastro zgjohej, karroca vezullonte mbi kalldrëm. Bojën e mbante në kuti të vogla teneqeje që i mbushte sa herë zbrazeshin. Një ditë e kishte harruar kutinë mbi ndenjësën e karrocës.

Ishte një ditë e bukur prilli dhe Ali Pasha kishte dalë për të shkuar në harem. Ishte ulur në karrocë dhe teneqeja i kishte shpuar të ndenjurat. Kur kishte vënë dorën për të parë ku ishte ulur, boja i ishte derdhur mbi poturet e reja dhe e kishte ndotur të gjithin. Ushtarët e Aliut e kishin marrë Bilalin dhe e kishin rrahur me shkopinj. E mbajtën dhjetë ditë lakuriq në birucë, duke e fshikulluar pa pushim, sa lëkura i ishte bërë si kadife e zezë me vija të kuqe. Kur e kishin liruar, i kishin hedhur një kovë me ujë të përvëlur në kurriz dhe i kishin thënë se të nesërmen duhej të zhdukej nga qyteti.

Bilali kishte mbledhur plaçkat duke rënkuar, kishte marrë gruan, vajzën e madhe dhe djalin tetëvjeçar dhe kishte mbërritur pas dy ditësh në fshat. I kishte pëlqyer fusha e zbrazët dhe kishte ngritur tendën me vrime që i ngjante kurrizit të tij. Kjo fushë mban erë të mirë, i kishte thënë gruas, që ia lyente trupin me vaj dhe pastaj i vinte mbi plagë kastravec të qëruar. Kur i thanë se në atë vend ishin varrosur bagëtitë e sëmura, Bilali nuk u mërzi. Kafsha e ngordhur nuk qelbet si njeriu, kishte thënë dhe kishte shkuar në pyll për dru. Donte të ngrinte një kasolle sepse tenda ishte e shpuar dhe nuk e mbante shiun. Jani ishte i vetmi që kishte sharra dhe sëpata të mëdha për dru dhe ai kishte ardhur në shtëpi dhe e kishte takuar. Kur i tregoi se vinte nga Janina, Jani i tha se kishte dy vëllezërit aty. Thanasin e njoh, kishte thënë Bilali. Rri pas Pashait si hije. Po të ishte atë ditë në qytet do më kishte rrahur me dorën e vet dhe do ma kishte bërë lëkurën si shalqi. Ndërsa Aliu pi shumë dhe kur dehet thotë se do vrasë Ali Pashën, por askush nuk e beson. Jani i dha sëpatën me teh të mprehtë dhe një sharrë të madhe. Bilali shkoi në pyll dhe preu dru.

Një ditë, në shtëpi erdhi vajza e Bilalit dhe i kërkoi Janit gozhdë për të ndërtuar kasollen. Paridi ishte në oborr dhe kur pa gjinjtë e kërcyer të vajzës dhe belin e hollë i tha Janit: Po të ishte më e bardhë do ta kisha marrë në dhomën time. Jani mori gozhdët në bodrum dhe ia dha vajzës së Bilalit. Kur ajo iku, ai pa fustanin e shkurtër që i ngrihej mbi gju dhe sytë i shkëlqyen. Të nesërmen, vajza erdhi prapë që në mëngjes dhe i kërkoi Janit gozhdë të tjera. Jani ia dha duke parë lëkurën kafe të duarve të saj, ndërsa Paridi i tha Muhamedit në oborr: Jevgjit ushqehen me gozhdë.

Jani punonte në bodrum, por mendjen e kishte te duart e vajzës së Bilalit. E la punën dhe shkoi te kasollja që po ngrihej në fushën e bagëtime. Bilali punonte duke kënduar dhe djersët i binin mbi kanalet e thella që kishte në kurriz. I qëllonte gozhdët fort dhe kur ato thyeshin i hidhte dhe merrte të tjera. Gozhdët vallëzonin në ajër dhe binin si gjymtyrë të këputura në tokë. Në drekë u ulën të dy nën tendën me vrime, ndërsa gruaja i gatoi musaka me kunguj dhe piperka të pjekura. Vajza e Bilalit solli ujë dhe Jani u gëlltiti. Ajo kishte duar të gjata si i ati dhe lëkura e zeshkët mbante një erë rrëshire të fortë dhe avulluese. Flokët i kishte të shkurtër, kaçurrelë dhe në kokë mbante një rreth të kuq. Hodhi ujë në gotën e Bilalit dhe e pa Janin në sy. Jani qeshi dhe vajza uli sytë, por e skuqura u fsheh nën lëkurë dhe nuk iu duk.

Ditën tjetër, kur vajza solli ujë, Jani ia preku gishtat duke i marrë gotën e mbushur. Piu ujin dhe u ngjit në majë të çatisë duke rregulluar dërrasat. Që atje dukej fusha e shkretë rrëzë fshatit dhe atij iu kujtua Muhamedi që kur kishte parë tokën në formë katrori kishte thënë se në atë vend do të ndërtohej një shtëpi nga disa njerëz me çanta dhe ai do shkonte aty.

Kishte hequr këmishën dhe punonte lakuriq, ndërsa Bilali ishte futur brenda tendës dhe gruaja po i vinte copa kastravec mbi kurrizin e djegur nga dielli. Vajza ishte ulur në tokë dhe po e shikonte duke punuar. Këmbët i kishte hapur dhe në mes të tyre Jani pa një mish të fortë ngjyrë kafe që vinte duke u zbardhur aty ku bashkoheshin kofshët. Vajza qeshte, por nuk i mbyllte këmbët. Jani ia bëri me dorë, ajo u ngrit dhe u afrua. Si e ke emrin, e pyeti. Fatime, tha vajza me zë të ulët duke parë nga tenda ku ishin prindërit. Janit iu forcuan muskujt në trup, por goja iu zgjidh. Fatime, do të vish në shtëpinë time? Dua, tha Fatimja duke qeshur dhe dhëmbët e bardhë i ndriçuan fytyrën si një filxhan i qëndisur. Jani qëllloi fort me çekiç mbi çati dhe ofshamat e Bilalit të mbuluar me kastravec nuk u dëgjuan gjithë pasditen.

Kur ra muzgu, shkoi në shtëpi, mbushi një kazan me ujë të ngratë dhe u la. U fut në dhomën e Paridit, hodhi nën sqetulla parfumin e pjeshkës dhe hapi sëndukun të merrte një këmishë të pastër. Këmishët ishin të gjitha të pahekurosur dhe Jani hapi dollapin me rrobat e Ibrahimit. Pa një këmishë bojë rozë të qëndisur te qafa, në thilenë e së cilës ishte një gjethe e tharë që ra përtokë. E veshi dhe shkoi përpara pasqyrës. Iu duk vetja si babai ditën që ishte martuar me Sarën dhe ai bashkë me Thanasin tundnin kambanën e kishës, ndërsa Paridi me Muhamedin mbanin fustanin e nusërisë së Sarës. Doli jashtë dhe u ul te stoli në errësirë. Ishte fresk, megjithatë djersiti në tëmtha, duke pritur. Dëgjoi një hap të lehtë dhe ktheu kokën nga rruga. Fatimja ecte në majë të gishtave. Kishte krehur flokët dhe i kishte kapur me karfica në dy anët e kokës, ndërsa buzët i kishte lyster dhe Janit iu duk si një kukull me dru arre të errët. Nuk kishte bërë kurrë kukulla të veshura si vajza dhe nuk e dinte si dukeshin të zhveshura.

Kur u futën në dhomë, ai shoi qirinjtë. Fatimja u zhvesh shpejt dhe trupi i saj u bë një me errësirën, por në mes të këmbëve ai dalloj një shegë të kuqe me lëng dhe u drejtua atje duke mbajtur duart përpara si i verbër. Rrëshira e Fatimes iu ngjit në të gjithë trupin, ndërsa duart e saj iu kapën me thonj pas kurrizit. Iu kujtua shpina e vizatuar e Bilalit dhe bërtiti nga dhimbja. Muhamedi, që po lexonte në dhomën tjetër, ndjeu zhurmë dhe u afrua te dhoma e Paridit, por

dera ishte e hapur dhe aty nuk kishte njeri. Një erë e fortë rrëshire i erdhi në hundë dhe mendoi se Jani po lyente dërrasa poshtë në bodrum. U kthye të lexonte dhe e zuri gjumi.

Jani doli nga dhoma të nesërmen në drekë. Sytë i kishte të ënjtur dhe nuk i pa kuleçtë e Sarës që ishin ftohur duke pritur. Paridi me Muhamedin ishin në oborr. Do martohem, tha Jani duke fërkuar sytë. Muhamedi rrudhi buzët dhe i tha: U mërzi me kukullat prej druri? Me kë do martohesh? Me vajzën e Bilalit, tha Jani. Paridi u afrua dhe filloi të qeshte. Po të ishte e bardhë do kishte pritur sa të dilte nga dhoma ime, tha dhe i shkeli syrin Muhamedit. Jani bëri sikur nuk e dëgjoji dhe ktheu kokën nga dera e shtëpisë. Fatimja rrinte në këmbë dhe flokët e shkurtër i kishte pa karfica. Kaçurrelat i ishin prishur. Duart e gjata i mbante mbi bel dhe fustani i ishte rrudhosur. Dua një fshesë të pastroj dhomën, tha Fatimja dhe qeshi. E ke pas derës së kuzhinës, i tha Muhamedi. Paridi iu afrua Janit dhe i tha: Vajzat e bardha nuk ma pastrojnë dhomën.

Jani dhe Fatimja u martuan pas dy javësh. Kasollja e re e Bilalit kishte mbaruar dhe Sara me Muhamedin shkuan aty për të kërkuar dorën e nuses. Bilali qeshte, ndërsa gruaja e tij nxori një reçel me manaferra të egra që i kishte këputur në fushë në mëngjes. Kur e sollën Fatimen në shtëpi, Bilali dhe e shoqja hodhën oriz mbi kokën e Janit dhe të Fatimes. Gruaja qante me lot, ndërsa Fatimja qeshte. Sara e kishte rregulluar dhomën e tyre në anën e re të shtëpisë dhe kishte sjellë një palë çarçafë të rinj ngjyrë ari. Jani kishte marrë krevatin e madh ku kishte fjetur Ibrahim me Sarën. Ia kishte ndërruar kokën dhe aty kishte gdhendur disa fruta me gjethe që bashkoheshin si një kurorë.

Ana Komnena e shikonte Fatimen pa ia ndarë sytë dhe para se të iknin e puthi Janin dhe doli në oborr. Nuk kishte parë kurrë një jevg. Sara e gjeti në stol me sytë nga dhoma e ndriçuar e Fatimes. Pse ka njerëz të zinj në botë, e pyeti Ana. Ka të bardhë, të verdhë, të kuq, ka dhe të zinj, tha Sara. Po pse nuk janë të gjithë njerëzit njëlloj ose të bardhë, ose të zinj, pyeti prapë Ana Komnena. Po të ishin të gjithë njëlloj bota do ishte shumë e varfër dhe e mërziqshme, tha Sara. Po fëmijët e Janit do jenë të bardhë apo të zinj, e pyeti Ana duke mbledhur këmbët e gjata mbi krevat. Sara e pa në sy dhe gërsheti i së bijës iu duk se ishte zgjatur. Nuk e di, tha, por fëmijët janë gjithnjë të bukur, edhe kur janë të bardhë, edhe kur janë të zinj. Ndoshta, tha Ana, por mua më duket se pleqtë e zinj janë më të shëmtuar se pleqtë e bardhë. Babai ishte i bukur kurse Bilali është i shëmtuar. Sara nuk foli, por hapi dritaren e dhomës.

Bënte vapë dhe yjet dukeshin sikur kishin zbritur në oborr dhe ishin shtrirë për t'u freskuar mbi plloça. Ngjyrat e lëkurës së njerëzve u ndanë nga bijtë e Noes, tha. Ana Komnena e shikonte dhe era që frynte nga dritarja ia kishte ftohur faqet e kuqe. Noeja kishte tre djem, të cilët shpëtuan bashkë me të nga përmbytja. Ata ishin Semi, Hami dhe Jafeti. Sipas Biblës së vjetër nga Semi kanë rrjedhur çifutët dhe arabët që quhen semitë. Nga Hami kanë ardhur lëkurëzintjët, jevgjit egjiptianë dhe zezakët e Afrikës dhe këta quhen hamite. Kurse nga trugu i Jafetit rrjedhin gjithë njerëzit me ngjyrë të bardhë, shqiptarët, grekët dhe gjithë evropianët që quhen jafetike. Në fillim perëndia bëri burrin dhe gruan, Adamin dhe Evën, pastaj ndau racat me tre djemtë e Noes që ishte pasardhësi i Adamit dhe pastaj ndau fetë me djemtë e Abrahamit, Isakun dhe Ismailin që ishin pasardhës të Noes.

Noeja i paska ndarë djemtë si babai, tha Ana duke luajtur me gërshetin. Sara qeshi dhe e pyeti pse. Jani është si Hami, Muhamedi si Semi dhe Paridi si Jafeti, tha Ana dhe u shtri në krevat duke parë tavanin. Yjet kishin hyrë në dhomë dhe i ishin ngatërruar nëpër flokë.

Pas një viti, Fatimja lindi një djalë të zeshkët me sy të kaltër dhe me flokë kaçurrelë. Jani e mori djalin në krahë dhe e ngriti në diell. Lëkura mbante erë rrëshirë dhe ai e puthi në ballë. Do ta quajmë Ibrahim, i tha Fatimes që qeshte e shtrirë në krevat. Ana Komnena iu afrua Sarës dhe i

tha: Pse i vunë emrin e babait? Ky e ka lëkurën si breshkë dhe është me flokë kaçurrelë, ndërsa babai ishte me flokë të drejtë dhe nuk mbante era rrëshirë. Sytë i kanë njëlloj, i tha Sara duke luajtur me Ibrahimin e vogël. Kur gruaja e Bilalit i preu Ibrahimit kërthizën, që dukej si një shkop i shtrembër me nyje të vogla, Jani e mori duke e mbajtur me kujdes e mos thyhej dhe zbriti në bodrum. Preu disa dërrasa dhe bëri një kuti të vogël që e veshi nga brenda me atllas të verdhë që Bilali e kishte sjellë nga Janina. Futi kërthizën në kuti dhe ia dha Fatimes që e preku lehtë me gisht dhe e vuri mbi boro.

29

Ibrahimi i vogël eci shpejt. Pinte shumë qumësht duke kafshuar gjinjte e fryrë të Fatimes. Këmbët e shkurtra i ishin bërë me vija, ndërsa kaçurrelat i ishin zgjatur mbi supe sepse Bilali thoshte që foshnjave nuk duhet t'i priten flokët derisa të bëhen tre vjeç. Bilali dhe e shoqja vinin çdo pasdite dhe rrinin në dhomën e Fatimes. Gruaja i sillte vajzës kabuni me sheqer, ndërsa Bilali merrte Ibrahimin dhe e shëtiste në oborr. Kur vinte Bilali shtëpia kumbonte. Zëri i tij ishte i fortë dhe çdo gjë e thoshte me të bërtitur, aq sa Paridi besonte se ai nuk dëgjonte mirë nga veshët. Jani shkonte në bodrum dhe priste dru sikur donte t'i shpëtonte zërit të Bilalit.

Një ditë, Bilali solli një iriq për Ibrahimin. Iriqi i kishte gjembat e zinj dhe turirin e kuq. Nuhaste tokën dhe kërkonte të hynte në mes të plloçave. Bilali e kapte nga gjembat dhe ia vinte përpara Ibrahimit, që e prekte dhe pastaj qante nga dhimbja. Pas disa ditësh, iriqi u zbut dhe sa herë që dilte Bilali me Ibrahimin në oborr drejtohej nga ata dhe rrinte pa lëvizur, si një kukull e bindur. Kur Bilali ikte, iriqi ndihej i lirë dhe fillonte të gërmonte në oborr. Hynte nën plloça dhe hante barëra me krimba që i gjente me shumicë. Një natë, Paridi erdhi vonë në mesnatë dhe nuk e pa iriqin që rrinte përballë derës me kokën të fshehur nën gjemba. E shkeli dhe ndjeu një therje të fortë në gishtin e madh të këmbës. Këmba i rridhte gjak dhe ai nuk ecte dot. Një javë qëndroi në shtëpi i shtrirë, duke mbajtur këmbën lart mbi krevat. Gruaja e Bilalit i solli një përzierje hithrash dhe lule basami që i kishte shtypur në havan dhe i kishte bërë si pure. Paridi lyente këmbën dhe shikonte rrugën nga dritarja.

Kur Bilali luante me Ibrahimin në oborr, Muhamedi ulej në stol dhe i shikonte. Kur keni ardhur nga Egjipti, e pyeste Bilalin që ndiqte iriqin duke bërtitur. Nuk e di, thoshte Bilali. Stërgjyshi im ka lindur këtu. Mblidhte hekurishte dhe gjëra të hedhura dhe i shiste. Gruaja e tij hidhte fall dhe shikonte filxhan. Njëherë ajo i pa filxhanin pashait turk të Janinës dhe i tha se liqeni do thahej kur pashait të Janinës t'i prisnin kokën.

Kur jeni bërë myslimanë, e pyeste Muhamedi. Bilali ulej pranë tij në stol dhe i thoshte: Jevgjit u bënë myslimanë përpara Muhamedit. Në Jerusalem kishte shumë jevgj që vinin nga Egjipti dhe mblidhnin hekurishte, i drejtonin, i prisnin, i shkurtonin, bënë shufra, thika të vogla, hekura parvazesh dhe gozhdë për të ndërtuar shtëpitë. Ata bënë edhe gozhdët me të cilat kryqëzoheshin njerëzit. Këto gozhdë ishin të ndryshme nga ato që përdoren për shtëpitë dhe vetëm jevgjit mund ta bënin këtë zanat të vështirë. Gozhdët e kryqëzimit kanë kokë të madhe, që çekiçi t'i gjejë dhe të mos dalë huq, janë të gjata dhe shumë të drejta, me majë të mprehtë sepse ato duhet të hyjnë menjëherë në mish dhe nga mishi në dru. Maja e gozhdës bëhet me kanale të holla, që gjaku të kalojë nëpër to dhe të dalë jashtë pa bllokuar çarjen e lëkurës. Gozhdët nuk duhet të thyhen apo të shtrembërohen sepse kjo i sjell shumë dhimbje njeriut dhe i lodh ushtarët. Romakët i rrihnin jevgjit sa herë që gozhdët shtrembëroeshin nga goditjet dhe ata u bënë mjeshtër të këtij zanati nga frika. Përpara kryqëzimit, jevgjit i lyenin këto gozhdë me një vaj të veçantë prej ulliri të verdhë, i cili nuk hahej në atë kohë nga çifutët.



Kur u kryqëzua Jezu Krishti, romakët urdhëruan jevgjijt e Jerusalemit të bënin gati gozhdët për ta shpuar. Një jevg punoi gjithë ditën, por kur i thanë se pse duheshin ai e fshehu gozhdën e katërt dhe u zhduk nga qyteti. Bashkë me Krishtin, atë ditë u kryqëzuan për vjedhje edhe dy çifutë të tjerë, por vetëm ai u shpua me tri gozhdë. Që atëherë të gjithë na kanë poshtëruar padrejtësisht. Ne i kemi kursyer dhimbjen Jezu Krishtit sepse po të mos zhdukej një nga gozhdët, ai do të ishte shpuar katër herë dhe jo tre. Të krishterët thonë se ne nuk duhet të kishim bërë asnjë gozhdë, ndërsa çifutët thonë se ne nuk duhet ta mëshironim Jezu Krishtin.

Që nga ajo kohë populli ynë është shpërndarë si rëra në shkretëtirë duke kërkuar gozhdën e katërt, e cila nuk u gjet kurrë. Romakët e kërkuan për disa orë dhe prandaj kryqëzimi i Krishtit u bë të premtën në muzg, kur duhej të ishte bërë të paktën në drekë. Unë i kam parë ikonat e kryqëzimit në kishat e Janinës. Të gjitha e vizatojnë Krishtin mbi kryq me duar të hapura dhe me këmbë të mbledhura dhe asnjëri nuk e di se atij ia mbloodhën dy këmbët bashkë, sepse kishin vetëm tri gozhdë. Nga një për secilën dorë dhe vetëm një për të dy këmbët. Kurse dy të kryqëzuarit e tjerë, që i rrinë Krishtit majtas dhe djathtas, i kanë këmbët e hapura dhe të varura në gozhdë të ndryshme. Kemi qenë gjithmonë të dhembshur, thoshte Bilali dhe mbante Ibrahimin në prehër.

Muhamedi e shikonte duke buzëqeshur dhe e pyeste: Po pastaj si u bëtë myslimanë? Nuk kishim rrugë tjetër, thoshte Bilali duke kaluar dorën e gjatë mbi flokë. Kur na përndoqën nga Jerusalemi, shumë nga ne u shpërndanë në shkretëtirë dhe shkuaam në Arabi. Edhe aty kishte çifutë, por ne u shtuam më shumë se ata sepse lëkura jonë e duron diellin dhe vapën pasi është më e trashë se ajo e të bardhëve. Muhamedi ka qenë i zeshkët si ne. Në qoftë se jevgu nuk do ta kishte fshehur gozhdën e Krishtit bota nuk do të kishte myslimanë, e ne do ishim bërë të krishterë siç u bënë romakët. Por unë them se më mirë që u bë kështu pasi edhe ne duhej të kishim fenë tonë, e cila e ndalon kryqëzimin e njeriut me gozhdë dhe nuk e pranon kryqin si shenjë.

Muhamedi shikonte Bilalin dhe mendonte se që kur kishte ardhur ai fshati ishte bërë më i zhurmshëm, por edhe më i pasur. Një fshat pa myslimanë dhe pa jevgj do ishte shumë monoton. Paridit i ishte shëruar plaga, por megjithatë ecte duke çaluar me një palë pantofla të leshta nëpër shtëpi. Fatimja pastronte shtëpinë me fshesë dhe në drekë gatuate musaka pa mish dhe sallatë me karota të ziera. Jani mbante Ibrahimin dhe kur vinte Bilali shkonte në bodrum. Sara i hekuroste këmishët Paridit, ndërsa Ana shikonte Ibrahimin e vogël dhe i thoshte Muhamedit: Ky i ngjan më shumë Bilalit se babait. Muhamedi qeshte dhe duke ngritur kokën nga qielli i thoshte: Jo të gjitha degët e arrës janë njëlloj të gjata.

Në darkë, shtëpia ishte e qetë. Jani dhe Fatimja flinin herët, ndërsa Bilali merrte gruan dhe shkonte në kasolle.

Një natë, Paridi trokiti fort në shtëpinë e Arianit Komnenit dhe Sara u zgjua nëpër gjumë. Këtu është Muhamedi, e pyeti. Jo, tha Sara. Ka dalë që në drekë dhe nuk është kthyer, tha Paridi duke djersitur në këmishë.

Muhamedi nuk u duk në shtëpi as të nesërmen. Jani me Paridin shkuan në pyll, por nuk e gjetën. Bilali doli në fushë dhe e thirri fort. Zëri i tij mbuloi hapësirën, u përplas në pemë dhe u kthye prapë. Muhamedi nuk u përgjigj, ndërsa Paridi nuk fjeti gjithë natën. Rrinte ulur në stil dhe shikonte nga rruga. Sa herë lëvizte ndonjë hije, ngrihej në këmbë. Kur u gdhi, shkoi të flinte dhe Ana Komnena e zgjoi afër drekës kur i solli kulaçin me mjaltë dhe një këmishë të pastër. Paridi ishte i uritur dhe hëngri edhe kulaçin e Muhamedit. Ana Komnena e shikonte nga pasqyra duke i varur këmishën në karrige. Pse e hëngre kulaçin e Muhamedit, e pyeti. Paridi hante pa e pasur mendjen. Edhe po të vijë sot do jetë i lodhur dhe nuk do ketë fuqi të hajë, i tha dhe u afrua te

pasqyra. Muhamedi nuk erdhi as të nesërmen. Paridi dukej i këputur dhe flokët i ishin bërë si gjambat e iriqit kur bie shi.

Bilali erdhi në shtëpi pasdite, mori Ibrahimin në prehër dhe u ul në stolin ku rrinte Muhamedi. Dielli i binte në kurriz dhe lëkura shpërndante erën e thartë të rrëshirës. Ku mund të jetë Muhamedi, e pyeti Paridi duke u afruar. Fytyra e tij ishte e verdhë dhe dukej si një njeri që i bën të njëjtën pyetje kujtdo që takon. Në moshën e tij, përveç vdekjes, vetëm një grua mund të të largojë nga shtëpia, i tha Bilali me zë të ulët. Paridi e pa i habitur. Ibrahimin nuk donte të rrinte në prehrin e Bilalit dhe vrapoi mbi plloça kur pa turirin e iriqit që doli duke nuhatur. Bilali e ndoqi nga pas duke bërë titur me zërin e tij të zakonshëm dhe Paridi u fut në shtëpi.

Në mbrëmje, shtëpia u qetësua. Ai doli në oborr dhe u ul në stol. Fshati flinte dhe asnjë hije nuk kalonte përpara shtëpisë. Iriqi vrapoi ngadalë nëpër plloça, i mori erë këmbës së Paridit që nuk lëvizte dhe pastaj shkoi tek arra e vogël dhe fjeti duke mbuluar turirin e kuq në tokë. Paridi mbështolli këmbët në stol dhe u fsheh në errësirë. Iu kujtua se si numëronte me gishta duke pritur babanë dhe Aliun, ditën që kishin vajtur në pyll për të kapur lepuj. Po të vijë Muhamedi do t'i dukem si një iriq që numëron gjambat e veta, mendoi dhe ndjeu këmbishën e lagur nga vesa.

Në mëngjes, Jani e gjeti atje. Sytë i kishte të mbyllur dhe i ngjante Ibrahimit në vitet e fundit. Dukej i bardhë dhe i menduar. Shko të flesh, tha Jani, do ta pres unë Muhamedin. Paridi nuk i hapi sytë, por lëvizi këmbët e mpira dhe i shtriu në tokë. Ti beson se do të vijë, e pyeti. Jani ngriti kokën nga rruga. Ana Komnena po vinte me një trastë me kuleç dhe një këmbishë të pastër që e mbante me kujdes. Jam i bindur që do të vijë, foli Jani. Ka thënë se do të ndërtojë një xhami për babanë dhe nuk mund të zhduket pa mbajtur premtimin. Paridi hapi sytë kur ndjeu erën e kulaçit që afrohej. Mua nuk ma ka thënë këtë, por e besoj, tha Paridi. Muhamedi është marrë gjithnjë me gjëra të panevojshme. Jani u ul pranë tij në stol dhe trupat e tyre u prekën. Muhamedi e dinte që unë do martohesha me një jevgë, tha me zë të ulët. Paridi ktheu kokën. Kur bëra ushtarin prej druri që doje ti dhe një Skënderbe për Aliun, ai më kërkoi një tokë të rumbullakët, së cilës unë i dhashë formën e fshatit. Ai e pa gjatë fshatin e gdhendur, pastaj e ktheu nga të gjitha anët dhe më tha se disa njerëz të zinj me çanta të mëdha do të ngrinin shtëpi te fusha e bagëtive dhe unë do të shkoja atje, siç shkova. Jani e kishte zërin të shuar dhe gryka i ngjante me një ibrik të bllokuar. Po tjetër çfarë të tha, e pyeti Paridi. Më tha se shtëpia jonë do bashkohej me shtëpinë e Mihalit, se shtëpia e Arianitit do bëhej shkollë dhe se Petro do mbytej në det.

Paridi pa shtëpinë e madhe dhe ndjeu trupin e Janit që po djersinte shumë dhe u ngrit. Djersa rridhte si një rrëshirë nga një trung i vetmuar. Donte ta pyeste Janin akoma për Muhamedin dhe tokën e rumbullakët, por Ana Komnena ishte afruar dhe po hynte në oborr. Iriqi që kishte dalë në diell ngriti kokën, kur Ana e puthi Janin në faqe. Mban era rrëshirë, tha ajo dhe rrudhi hundët. Jani qeshi, ndërsa Paridi mori kulaçin dhe filloi të hante. Mos e ha më kulaçin e Muhamedit, i tha Ana dhe hyri në shtëpi të varte këmbishën e ngrirë.

Në drekë, Hana shkoi te shtëpia e Arianitit. Sytë jeshilë i shkëlqenin. Kishte veshur një fund të gjatë dhe të ngushtë dhe flokët i kishte krehur me kujdes. Në vesh kishte varur dy vathë të vegjël ngjyrë ulliri, të cilët e tregonin më të dobët, por dhe më të zbehtë. Sara po priste trëndafilat në oborr. Duart i kishte mbathur me leckë që të mos ia shponin gishtat. Hana i rrinte pas kurrizit duke ngritur nga toka degët e këputura të trëndafilatit dhe Sara ndjeu që ajo donte t'i thoshte diçka. Pse je veshur kështu, e pyeti duke i parë vathët. Hana u skuq dhe ktheu kokën nga dera sikur donte të sigurohej se asnjëri nuk po i dëgjonte.

Muhamedi është në shtëpinë time dhe do të martohet me mua. Sarës iu dobësuan duart dhe ndjeu një gjemb që i shpoi gishtin. Je çmendur, e pyeti duke hapur sytë. Muhamedi është njëzet vjet më

i vogël se ty. Edhe ti ishe njëzet e pesë vjet më e vogël se Ibrahim i kur u martove, tha Hana duke folur shpejt. Sara thithi gishtin e gjakosur dhe u ul në oborr, aty ku rrinte Mihal Komneni dhe përpara tij edhe Arianiti. Hana mbeti në këmbë si një nxënëse që mezi pret të largohet me vrap për në shtëpi, pasi t'i kenë dhënë leje. Jakën e këmishës e kishte të ngrirë dhe në qafë i shtrëngohej një shall i hollë, i tejdukshëm. Damarët i ishin fryrë, ndërsa sytë jeshilë i ishin errësuar si një pyll në një ditë pa diell.

Muhamedi është nipi i burrit tënd, tha Sara dhe kjo e bën këtë martesë edhe më të papranueshme. Hana u ul dhe sytë iu varën nga ënjtja. Ti ke jetuar shumë vjet me mua dhe me Vasilin dhe e di shumë mirë se sa kam vuajtur për të pasur një fëmijë. Vasilit i vinte turp që nuk më mbarste dot, ndërkohë që i vëllai i tij u bë me shtatë djem. Muhamedi më tha se ai do martohet me mua dhe në moshën time kjo është mundësia e fundit për të pasur një familje. Sara e shikonte se si i dridhej qafa nën shall dhe ndjeu që u përlot.

Kur babai kishte ikur ajo kishte jetuar mbi dhjetë vjet në një shtëpi me Hanën dhe Vasilin. Dashuria e tyre, nëse kishte ekzistuar, ishte shuar qetësisht si një mangall në dhomën e një të sëmuri të pashpresë. Mungesa e fëmijës i kishte bërë si një vëlla dhe një motër që jetonin nën një çati duke pritur një kukull për të shtyrë kohën. Vasili kishte shkuar disa herë në Janinë për të takuar një doktor dhe gjithmonë kthehej me fytyrë të çelur, mbyllej në dhomë me Hanën dhe numëronte ditët. Kur Hana kontrollonte të brendshmet në fillim të muajit, ai e priste pas derës, si një fajtor dhe pastaj shkonte në pyll nga ku kthehej i shkatërruar. Shija e vezëve të prishura të Hanës i rrinte gjithë kohën në gjuhë. Hana qante në dhomën e saj, ndërsa Sara lexonte në kuzhinë duke bërë sikur nuk kuptonte. Njëherë Vasili i tha Hanës se kishte vendosur të bëhej mysliman sepse ndoshta kjo e ndihmonte të pille si gjithë burrat e tjerë, por pastaj kishte ndërruar mendje dhe kishte thënë se perëndia është një dhe jo dy, prandaj, nëse ajo e kishte ndëshkuar, ai nuk kishte shpëtim, pavarësisht se do falej nga perëndimi apo nga lindja e shpirtit. Fetë janë pozicionet që zgjedhin njerëzit për të parë perëndinë, i kishte thënë Hanës. Të krishterët i rrinë perëndisë në perëndim, myslimanët në lindje. Ç'ndryshim ka nëse ne të dy bashkohemi në dhomë apo në qilar? Pulën dhe gjelin lëri në rrugë apo shtrijë në krevat njëlloj do ta bëjnë vezën. Çoji në kishë apo mbylli në xhami prapë njëlloj do ta bëjnë atë që kanë për të bërë. gruaja e Ibrahimit donte një vajzë, por Ibrahim i bëri vetëm djem edhe si i krishterë, edhe si mysliman.

Vasili vdiq përpara se të lindte Ana dhe ndoshta kishte të drejtë, mendoi Sara duke shtrënguar gishtin që i rridhte. Ibrahim i bëri një vajzë, por jo kur ndërroi fenë, por kur ndërroi gruan.

Hana ishte ulur në gjunjë dhe priste. Ishte tre vjet më e madhe se Sara, por vetmia ia kishte mbushur cepat e syve me rrudha të imëta, të cilat ajo i fshinte me pudër. Megjithatë ishte akoma e bukur dhe e freskët, ndonëse fliste pak dhe sillej si një mobilie, siç thoshte Komneni. Sara qeshi me vete duke menduar se, po të martoheshin, Hana do dukej si një mobilie dhe Muhamedi do t'i rrinte sipër si një tas me hurma. Hana ishte halla e saj, por atë ditë dukej si një çupëlinë që kërkon leje të martohet.

I vuri dorën mbi kokë dhe e pyeti: Ia kërkove ti Muhamedit të martoheshit? Jo, tha Hana. Ai erdhi në shtëpinë time një pasdite. Ka ardhur Bilali në shtëpi, më tha, dhe dola se ai bën shumë zhurmë. Biseduam derisa u err, por ai nuk po lëvizte dhe më pyeti nëse mund të flinte në shtëpinë time. Ai është nipi i Vasilit dhe unë nuk mund t'i thoshja jo. mirë, i thashë, por a i ke lajmëruar vëllezërit. Nuk e kanë mendjen tek unë, më tha, njëri ngrohet me Fatimen, tjetri me vajzat e fshatit. Fillova të qesh dhe i rregullova krevatin. Natën m'u duk sikur dikush m'u fut në dhomë dhe po më shihte.

Në mëngjes, Muhamedi ishte zgjuar përpara meje dhe e gjeta duke parë nga dritarja. I bëra për të ngrënë dhe pimë kafe me sheqer. Mendova se në drekë do ikte, por ai mori një nga librat e Arianitit dhe filloi të lexonte i ulur në divan. Unë fshija shtëpinë dhe herë pas here hyja në dhomë. Ai ngrinte kokën, më buzëqeshte dhe lexonte prapë. Mendova se do hante drekë dhe pastaj do ikte dhe bëra fasule me pastërma dhe një kek me mollë. Kur u ulëm në tavolinë, Muhamedi hante ngadalë dhe më shikonte në sy. Unë ngrija sytë dhe ai qeshte. Gjithmonë e kisha parë si një fëmijë të çuditshëm dhe të urtë, por atë ditë m'u duk si një burrë dhe u skuqa duke menduar. Kur mbaruam drekën, Muhamedi u ul prapë në divan dhe mori librin. Unë shkova në dhomë dhe dëgjoja pas derës fletët e librit që lëviznin në heshtje. Lëvizja e fletëve nuk ishte rregullt dhe dora e Muhamedit më dukej e shqetësuar. Qëndrova në dhomë deri në muzg. U veshja dhe shkova te Muhamedi, i cili rrinte në errësirë me librin në prehër. Do dal pak, i thashë duke menduar se edhe ai do ikte. Muhamedi ngriti kokën dhe më tha: Unë do lexoj edhe pak. Ndeza qirinjtë një nga një dhe e afrova shandanin pranë tij. Sytë e kaltër të Muhamedit më shikonin, por unë u përpoqa të tregohem e sigurt dhe i thashë duke qeshur: Vajti vonë, edhe ty të presin në shtëpi. Në këtë fshat njeriun e pret vetëm gruaja ose fëmijët, tha Muhamedi qetësisht. Unë nuk kam as grua, as fëmijë. Unë u skuqa, por qirinjtë ishin larg meje dhe ai nuk e shikonte pështjellimin tim.

Dola dhe erdha deri afër shtëpisë tënde. Doja të hyja brenda, por nuk ndihesha mirë dhe e dija që fytyra do më tradhtonte. Kisha pranuar në shtëpi një fëmijë dhe tani atje më priste një burrë. E ndieja që kur të kthehesha diçka do të ndodhte dhe kisha frikë. Më dukej sikur për herë të parë në jetën time kisha lënë takim me një burrë. Me Vasilin nuk e kisha provuar këtë dobësim të trupit sepse ne na martuan familjet dhe u takuam vetëm në dhomën e gjumit ku ai më priste duke u dridhur nga turpi dhe unë u zhvesha siç më kishin mësuar. Çdo gjë që kam bërë me Vasilin ma kishte mësuar nëna më parë, por askush nuk më kishte thënë si duhet të sillesh me një burrë që të vjen në shtëpi. Mbete një copë herë përpara derës, por nuk trokita. Ishte errësuar dhe hëna ecte si një hap mbi kalldrëm. Edhe unë eca, pa e ditur se ku po shkoja. Kalova nga kisha dhe pushë kambanën që ishte mbushur me yje. Kur u afrova te shtëpia e Ibrahimit, në oborr dallova Paridin, i cili ishte ulur në stol dhe kishte mbledhur këmbët poshtë vetes. Oborri ishte i qetë, ndërsa Paridi priste në errësirë. Pret Muhamedin, mendova dhe u fsheha pas një muri duke e parë. Herë pas here Paridi kthente kokën dhe unë i shikoja fytyrën e zbehtë dhe të lodhur. Flokët i kishte të pakrehur dhe mjekra kishte nisur t'i nxinte. Një herë vendosa t'i afrohem dhe t'i them se Muhamedi ishte në shtëpinë time, por kjo m'u duk si tradhti. Nuk isha mësuar të tradhtoja një burrë që ditën e parë. Kisha pak ftohtë dhe u ngjesha pas gëlqeres së murit për t'u ngrohur. Kur qirinjtë në dhomën e Janit dhe të Fatimes u shuan, Paridi u ngrit dhe shkoi tek arra e vogël. Zgjati dorën dhe që aty lëvizi diçka. Ishte iriqi. Paridi ia ngacmonte turirin me një degë të thyer dhe iriqi ngrihej në të dy këmbët si një lepur i uritur. Kafshonte degën dhe përplaste kokën pas gjembave kur e kuptonte se dega nuk hahej. Paridi ia afroi degën disa herë, por më në fund iriqi u struk dhe nuk u zgjat më nga gënjeshtra e tij. E kuptova se Paridi donte të vriste kohën dhe vendosa të kthehem në shtëpi.

Muhamedi ishte në divan dhe kur unë hyra ai u ngrit dhe më tha: Mirë se erdhe. Mua m'u duk e pasjellshme që ai më uronte mirëseardhjen në shtëpinë time dhe i thashë se kisha parë Paridin që po priste në oborr i shqetësuar. I the që unë jam këtu, më pyeti Muhamedi që dukej sikur kishte shtatë hije pas degëve të shandanit. I tregova që nuk i kisha thënë, por ai duhej të ikte sepse unë nuk mund të bëja sikur nuk dija gjë, ndërkohë që të gjithë ishin në merak. Muhamedi afroi kokën te shandani dhe sytë e tij të kaltër morën shkëlqim prej guri. Unë kam ardhur për të mos ikur, më tha. Unë qesha si një njeri që nuk e kupton atë që ka dëgjuar, por me sa duket e qeshura ime atij

iu duk si shprehje kënaqësie dhe i dha më shumë siguri. Por, tani që e mendoj, atë çast më duket sikur Muhamedi nuk kishte nevojë për guxim sepse ai kishte ardhur të më thoshte diçka që e dinte prej kohësh. Dua të martohem me ty, më tha dhe unë pashë flakët e qirinjve që ngatërroheshin me njëra-tjetrën si gishta që më mbulonin fytyrën. Mbeta pa frymë dhe i thashë: Je çmendur, unë nuk martohem me kalamaj.

Muhamedi filloi të qeshte dhe u ul në divan. Unë për këtë kam ardhur. Kam vite që pres të rritem dhe nuk jam më një kalama, siç nuk je ti një plakë. Unë jam burrë dhe ti je një grua që duhet t'i japësh fund vetmisë dhe të kesh familjen që të është mohuar nga fati. Unë ndjeva një të skuqur në faqe dhe në sqetulla dhe m'u duk sikur ai po tallej me jetën time. U afrova dhe i bërtita të dilte jashtë, por Muhamedi nuk lëvizi. Më shikonte qetësisht dhe unë u ndjeva shumë e dobët. Shkova në dhomë dhe u shtriva në krevat. Hijet e qirinjve më ndoqën nga pas duke hyrë nën derë. Fillova të qaj sepse m'u duk vetja një plaçkë e lagur që e kanë varur në mes të fshatit për t'i treguar kalimtarëve se vetmia është një sëmundje që nuk shërohet në diell. Gjithë jeta ime më kaloi përpara syve. Kisha menduar gjithmonë të martohesha, por vitet kishin ikur pa kuptuar dhe unë e kisha humbur besimin se fshati mund të më jepte një burrë, i cili ishte shfaqur atëherë kur ndoshta nuk më duhej më. Trupi im ishte flashkur si një i zier gjatë dhe ndoshta aftësinë për të bërë fëmijë e kisha humbur, si një gjë të panevojshme. Përse mund të më duhej një burrë, përveçse për të kaluar ditët e mbetura?

Shkova te dritarja dhe pashë rrugën. Nga dhoma tjetër nuk dëgjohej asgjë, por fryma e Muhamedit i lëvizte qirinjtë që hynin në dhomën time, duke u lëkundur. U afrova te pasqyra dhe pashë veten. Në errësirë rrudhat përreth syve dukeshin më të thella. Flokët më ishin hapur si leshterikë të tharë dhe pa e pasur mendjen mora një krehër dhe nisa t'i rregulloj. Pastaj u shtriva dhe më zuri gjumi duke mos menduar.

Sot në mëngjes ndihesha më mirë. Lëkurën e kisha më të qetë dhe rrudhat kishin humbur lartësinë. Nuk ia vlen të mërzitesh, thashë me vete. Pavarësisht se Muhamedi është njëzet vjet më i vogël, prapë është një burrë. M'u kujtua nëna ime që thoshte se një grua nuk plaket deri ditën që djemtë e vegjël në rrugë kthejnë kokën për ta parë.

U veshja shpejt dhe dola. Muhamedin e gjeta atje ku e kisha lënë. Fytyra e tij ishte e bardhë, por nuk dukej i lodhur. Nuk e pyeta nëse kishte fjetur, por bëra mëngjesin me çaj dhe e shtrova në tavolinë. Hëngrëm të dy pa folur. Nuk e shikoja në sy, ndërsa ai pinte çajin ngadalë si një njeri që nuk e pret asgjë jashtë shtëpisë.

Kur do ikësh, i thashë. Muhamedi dukej edhe më i qetë dhe nuk u ngut të përgjigjej. Kur të martohem me ty, më tha. Vendosa ta përballoja atë bisedë qetësisht, pa u skuqur dhe pa u nervozuar si një grua e pjekur, e cila duhet të arsyetojë propozimet që i vijnë. Pse do të martohesh me mua, e pyeta. Muhamedi la gotën e çajit dhe kaloi dorën mbi mbulesë sikur donte të më tërhiqte vëmendjen për ato që do të thoshte. Unë nuk kam më një familje, më tha. Jani u martua, dy vëllezër kanë vdekur dhe dy të tjerë ikën në Janinë. Babai vdiq, ndërsa Paridi jeton në legjendat greke. Ditën që Sara iku nga shtëpia e kuptova se isha rritur dhe duhet të krijoja familjen time. Ti më ke pëlqyer që kur kam qenë i vogël. Një ditë, kur po hanim drekë me Mihalini dhe Metodin në shtëpinë e Arianitit ti u mërzite kur unë thashë se ditën që njerëzit nuk do mund të lindin më njerëz, si ti, atëherë nuk do ketë më as njerëz dhe as perëndi sepse perëndia nuk jeton dot pa njerëzit kurse njerëzit jetojnë pa perëndinë, por jo pa njëri-tjetrin. Ti u ngrite nga tavolina dhe më the se ti nuk kishe lindur për faj të Vasilit, xhaxhait tim, por me një burrë tjetër ndoshta do të lindje. Që atë ditë kam menduar se ai burri tjetër duhet të isha unë. Kishe veshur një fustan të ngushtë ngjyrë vishnje që të tregonte të qartë dhe hyjnore si një perëndeshë e palumtur me njerëzit. Dole jashtë duke fshirë lotët dhe unë të ndoqa me sy. Kanë kaluar shumë

vjet që atëherë dhe bukuria jote është pasuruar. Tani je e bukur si një grua dhe e pjekur si një nënë. Unë e njoh veten time. Grave në moshën tënde mund t'u ngjaj i vogël, por vajzave të reja i dukem si një plak që rri në stolin e shtëpisë dhe lexon qiellin si një filxhan. Nuk dua të marthohem si një plak, por si një fëmijë që rritet në krevatin e gruas së vet.

Muhamedi pushoi dhe unë kalova dorën mbi rrudhat e mia, por nuk i gjeta. Ai më kishte përkëdhelur me fjalë dhe vajza që jetonte brenda së kaluarës sime u ngrit nga tavolina dhe shkoi në dhomë të provonte fustanin ngjyrë vishnje që kisha vite pa e veshur. U zhvesha, dola lakuriq përpara pasqyrës, pashë gjinjtë e mi të fryrë me një thith të zi në mes, lëshova flokët mbi supe, pashë një nishan në supin e majtë, këmbët e bashkuara te kofshët e forta dhe u ngopa me erën e freskët të sqetullave të mia me push të zi. Vështa fustanin dhe kuptova se trupi im nuk kishte marrë ujë të tepërt, si një barkë që kalon rininë duke u endur nëpër një det të vetmuar. Isha e re dhe e bukur si një mobilie që zbukuron shtëpinë e kujtimeve të veta. Sytë jeshilë rrinin mbi trup si mbi një livadh dhe isha gati të dilja në rrugë që të gjithë ta shijonin rininë time.

Sigurisht që nuk i bëra të gjitha këto marrëzi në prani të një burri që donte të më bindte se nuk ishte një fëmijë, por imagjinoja veten time me fustanin vishnje, ndërkohë që Muhamedi më shikonte me sy të hapur si një gotë profetike e mbushur me qiell. Sikur të ishte aty, do të dukeshja si një nuse që e kanë mbajtur për pesëmbëdhjetë vjet nën duvak dhe që më në fund ia heqin për t'ia çuar burrit në dhomën ngjitur. Plakat e shtëpisë e kontrollojnë dhe habiten kur shohin se duvaku ia ka mbajtur fytyrën të paprekur nga pluhuri i viteve. Unë u skuqa mbi tavolinë siç do skuqej çdo nuse që pret ta zbulojnë dhe pastaj ta përdorin. U drodha lehtë dhe mora ngjyrën e çajit në gotën e Muhamedit. Megjithatë, e ndalova të skuqurën që më vinte nga këmbët dhe e kuptova se Muhamedi kishte të drejtë kur thoshte se mund të isha një nënë e pjekur. Të ndalosh të skuqurën kërkon një teknikë të caktuar, e cila fitohet vetëm me përvojë.

Ti je nipi i burrit tim, i thashë Muhamedit dhe kjo quhet një martesë brenda familjes që askush nuk e pranon. Muhamedi qeshi sepse e kuptoi që kisha filluar të shoshitja anët e bardha dhe të zeza të martesës, si një jelek, i cili në stinë të ndryshme mund të vishet nga të dyja anët. Kisha tradhtuar veten, gjë që më pëlqeu, sepse kjo mungesë përvojë më bënte të ndihesha më e re.

Në këtë fshat kanë ndodhur çudi më të mëdha se kjo, tha Muhamedi. Babai yt u martua me hallën e vet, ndërsa Sara u martua me babanë tim që ishte njëzet e pesë vjet më i madh se ajo dhe kishte gjashtë djem. unë ula sytë dhe flokët më shpuan kokën. Muhamedi kishte të drejtë, por fataliteti i asaj që tha më ngurtësoi. M'u duk vetja si një kukull, e cila imiton kukulla të tjera që janë kalbur në bodrum. Pse ndodh kjo me ne, e pyeta Muhamedin. Ai më pa gjatë në sy dhe e ngrohu dorën mbi gotën e çajit. Vijat e pëllëmbës iu veshën me avull që ai e fshiu sikur po largonte një mjegull. Ne të gjithë jetojmë si heronj të fantazisë njerëzore, më tha. Unë jetoj si profet, Arianiti besonte se ishte Abraham, Isak Komnenit i dukej vetja si Jezu Krishti, Sali Benishi besonte se Aishja e tij i ngjante gruas së Muhamedit, Bilalit i duket vetja si jevgu që vodhi gozhdën e kryqëzimit, Ana është e bindur se do bëhet princeshë si Ana Komnena e vërtetë dhe Niko ndryshoi emrin që të jetojë si Paridi. Bota rri në vend sepse ne besojmë se shpirti i dikujt tjetër jeton në trupin tonë dhe kjo na bën dembelë. Bota ka mijëra vjet që nuk ndryshon sepse secili nga ne kujton se një shpirt më i ndritur do t'i tregojë rrugën e duhur. Na duket sikur ecim, por në fakt ndjekim hapat e dikujt që ka kaluar përpara nesh dhe kthehem aty ku u nisëm. Por fshati ynë është i vogël për të mbajtur gjithë këta heronj dhe disa duhet të ikin që të vijnë disa të tjerë. Arianiti iku që babai im të bëhej Ibrahim, pastaj iku Isaku që të vinte Bilali me gozhdën e tij. Edhe martesë jonë është pjesë e këtij cikli, prandaj është e paarsyeshme ta shmangim, tha Muhamedi që dukej sikur po lexonte në fytyrën time. Unë nuk e mbajta dot të skuqurën që më doli mbi lëkurë dhe u ngrita nga tavolina. Doja të qaja dhe shkova në dhomë, por

nuk nxora lot. Avulli i çajit më kishte veshur faqet. U kreha dhe vura vathët e ullirit që më freskuan trupin. Qafën e kisha qull dhe vura një shall. Dola nga dhoma. Muhamedi ishte në tavolinë. Çfarë do për drekë, e pyeta. Ai më pa me ëmbëlsi dhe sytë e tij m'u dukën si dy hurma. Oriz me kanellë si ai që bën Sara, më tha. Unë u ftoha, si një nuse e re pa duvak dhe erdha te ti të pyes si bëhet orizi me kanellë.

Sara qëndronte në diell dhe lëkura i ishte thekur, ndërsa Hanës i ishte hapur shalli duke folur dhe i kishin dalë damarët që zgjateshin nën mjekër duke u zgjeruar dhe zbrisnin poshtë në kraharor. Sara kishte mbetur pa frymë duke lexuar hartën e zemrës së saj të ftohtë. Kishin jetuar bashkë për një kohë të gjatë dhe ajo kishte menduar se Hana e kishte humbur ndjeshmërinë. Por me sa duket vetëm e kishte fshehur ashtu siç bën një mobilie, që tregon lustrën, por jo drurin që e ka bërë. I kujtohej dita kur Hana ishte martuar me Vasilin. Ajo rrinte në krah të nuses, ndërsa Thanasi në krah të dhëndrit. Kur kishin dalë nga kisha, Arianit Komneni ishte afruar, e kishte puthur Hanën dhe i kishte thënë diçka në vesh. Gjergji që vinte pas çiftit kishte ndalur hapat dhe Arianiti kishte ikur duke parë Vasilin. Çfarë i the Hanës në vesh, e kishte pyetur ajo në mbrëmje. I thashë që ishte e bukur si një hënë që ndriçon ditën, kishte thënë babai. E si ndriçon hëna ditën, e kishte pyetur Sara. Hëna ndriçon kur dielli që i rri përballë është i dobët, kishte thënë babai duke parë Vasilin.

Hana rrinte në oborr dhe rrezatonte mbi plloçat e verdhë të mesditës. Ç' do bësh, e pyeti Sara. Do bëj oriz me kanellë, u përgjigj Hana. Sara qeshi dhe mendoi se nuk kishte më arsye ta pyeste se ç' do bënte me martesën. Hana mezi priste të kthehej në shtëpi duke i çuar Muhamedit pajën me oriz në një pjatë të zbukuruar me kanellë.

Thirri Ana Komnenën që erdhi duke tërhequr gërshetin e zi nëpër shtëpi. Shko thuaji Paridit se Muhamedi është në shtëpinë e Hanës dhe nuk do vonohet. Çfarë bën Muhamedi në shtëpinë tënde, pyeti Ana duke parë vathët prej ulliri. Hana u përtyp, por Sara nuk e la të fliste. Muhamedi është kthyer në tokën katrore, it ha Sara. Ana u nis me vrap duke e parë Hanën me bisht të syrit.

Muhamedi shkoi në shtëpi të nesërmen. Dukej i menduar dhe ecte ngadalë. Paridi i kishte krehur flokët dhe mbante një këmishë të hekurosur. Iriqi kishte dalë në oborr, ndërsa kokën pa qafë e mbante të zgjatur nga rruga. Bilali sapo kishte ardhur. Kur pa Muhamedin, doli nga shtëpia dhe thirri me zë të lartë: Muhamed, të trashëgohesh! Muhamed, të trashëgohesh! Iriqi u shurdhua nga zëri i tij i lartë dhe gjembat iu shkurtuan, ndërsa Muhamedi u ul në stol. Jani dhe Paridi erdhën ta takonin. Jani kishte përveshur mëngët duke punuar në bodrum, ndërsa Paridi ishte i zbehtë dhe i ftohtë. E shikonin Muhamedin në sy dhe prisnin. Pse nuk na the ku do shkoje, e pyeti Paridi. Muhamedi vuri duart mbi gjunjë dhe shikoi thonjtë, siç bënte kur ishte i vogël. Po t'u kisha thënë se ku do shkoja nuk do më linit të martohesha. Po Hana ka pranuar të martohet me ty, vazhdoi Paridi që rrinte në këmbë. Hana do vijë të jetojë në shtëpinë tonë, u përgjigj Muhamedi. Jani pa Paridin dhe i bëri shenjë të qetësohej, por ai dukej si një kalë që nuk ndalon dot. Pse nuk jetoni në shtëpinë e Hanës, e pyeti. Muhamedi ngriti kokën dhe pa Janin në sy. Shtëpia e Hanës do shembet dhe do bëhet xhami. Paridi u ngurtësua, iu afrua stolit dhe i tha Muhamedit: Kjo është një lloj sikur të ndërtohet shtëpi në det. Kjo është një lloj sikur të mos ndërtohet një varkë në det, tha Muhamedi. Bilali që dëgjonte pas kurrizit të tyre erdhi dhe e puthi Muhamedin në faqe. Do më lësh mua të këndoj ezanin e parë, e pyeti me sytë që i ndrisnin. Muhamedi e pa me qetësi dhe duke u ngritur i tha: Pse jo? Zëri yt është më i fortë se kambana e kishës. U fut në shtëpi, ndërsa Bilali i shkoi pas, deri te dera. Jani me Paridin mbetën në këmbë duke e ndjekur Muhamedin me sy. Ai dukej si një pemë që shëtiste në oborr. Iriqi ishte afruar te stoli dhe i merrte erë vendit ku ishte ulur Muhamedi. Paridi uli kokën dhe flokët i ranë mbi sy. Po iki, i tha të vëllait, nuk ka më

vend për mua këtu. Jani i hodhi dorën në sup, por nuk foli. Fatimja kishte dalë në oborr me një pjtë kabuni që ia dha Bilalit dhe ky ia çoi Muhamedit duke kënduar, sikur po bënte prova.

Kur Hana erdhi në shtëpi, Paridi iku të jetonte në shtëpinë e Arianitit. Sara dhe Ana Komnena u gëzuan që ai vendosi të jetonte me to dhe në darkë e prisnin të dyja në oborr, ndërsa çdo mëngjes i bënë kulaç me mjaltë. Sara i tha se mund të kthehej kur të donte në shtëpi, por nuk duhej të sillte vajzat e fshatit aty. Paridi pranoi. Nganjëherë shkante në pyll dhe kur kthehej, Sara ia pastronte pantallonat e mbushura me gjethe.

Hana solli në shtëpi krevatin e madh ku kishte fjetur me Vasilin dhe bashkë me Sarën e vunë në dhomën që shikonte nga arra e vogël. Hana kishte sjellë me vete edhe një palë perde të rënda që e mbulonin dritaren dhe degët e arrës binin aty duke vizatuar hije. Bilali bashkë me djalin e tij ngarkuan të gjitha plaçkat dhe sëndukët e mbushura me enë, me qirinj e peceta dhe shtëpia e Hanës u boshatis për disa ditë.

Natën e parë që Hana dhe Muhamedi fjetën bashkë, Fatimja dëgjoi një zhurmë dhe doli në oborr. Muhamedi rrinte i ulur në stol dhe shikonte hënën. Ishte i mbuluar me djersë dhe dukej sikur qante. Iriqi ishte zgjatur nga ai duke lëpirë buzët. Pas pak, Hana doli me një këmishë nate të bardhë dhe e thirri Muhamedin që u ngrit dhe i shkoi pas duke e mbajtur kokën nga rruga. Ajo i kishte lëshuar flokët dhe dukej e ashpër, si një nënë që thërret djalin në shtëpi. Fatimja u kthye në dhomë dhe i tha Janit: Muhamedi po qante në oborr. Jani i vuri dorën mbi bark dhe e afroi nga vetja. Ngrohtësia e trupit të Fatimes ia fryu lëkurën. Burri e kupton moshën e gruas në krevat, i tha dhe ia kaloi dorën poshtë barkut të freskët dhe të lagur.

Pas disa javësh, Muhamedi thirri Andrean, djalin e Naumit që erdhi duke djersitur. Tëmthat i ishin thinjur, ndërsa muskujt i ishin shëndoshur. Muhamedi e priti në oborr. Andrea shikonte shtëpinë që kishte ndërtuar me të atin duke e matur me sy. Më duket më e vogël, i tha Muhamedit duke ecur përmbi plloça. Është ndërtuar për një familje, tani jemi dy, tha Muhamedi. Kur u afruan te shtëpia e Hanës, Andrea ndaloi. Shtëpia ishte shumë afër kishës dhe ai e mati largësinë me hapa. Muhamedi rrinte në diell dhe shikonte hapat e gjatë të Andreas, i cili pasi ecte pak, ngrinte kokën nga kambanorja dhe pastaj nga çatia e shtëpisë së Hanës.

Nuk kam ndërtuar kurrë një xhami përballë kishës, sesi më duket, tha Andrea duke u futur nën hijen e kambanores sikur donte të mbrohej. Si të duket, e pyeti Muhamedi. Andrea u mendua dhe ngjeshi shpinën pas murit të kishës duke e parë Muhamedin në sy. Më duket sikur po e ndajmë fshatin në mes si një bukë misri, i tha.

Drita i hyn njeriut nga dy sytë dhe zëri nga dy veshët. Edhe Zoti kërkon dy dyer për të ardhur në fshat, tha Muhamedi. Andrea tundi kokën dhe doli nga hija e kishës. E kujt është kjo shtëpi, e pyeti. E gruas time, u përgjigj Muhamedi. Andrea ngriti vetullat dhe i erdhi afër. Çfarë i ke premtuar që ta dha për xhami? Muhamedi shtyu derën e shtëpisë dhe dhoma e madhe e oxhakut u hap përpara tij si një bark gruaje i boshatisur. Eci dhe hapat ngritën pluhur mbi çimento. I kam premtuar një fëmijë, i tha Andreas duke hapur dritaren. Andrea, që ishte pas kurrizit të Muhamedit, ndali hapat dhe qetësia doli nga dritarja në rrugë. Po nëse nuk lind ai fëmijë? Nuk e di, foli Muhamedi. Nuk ka profet që nuk gënjen.

Andrea u zgjat nga dritarja dhe kambanorja e kishës iu duk shumë afër, aq sa hijen e saj prej peme nuk e nxinte dhoma. Babai i kishte thënë se ajo kambanore nuk ngjante me asgjë tjetër sepse kishte përmasat e trupit të Arianit Komnenit. Zakonisht Naumi i bënte kambanoret dy herë më të larta se kisha, por Arianit Komneni nuk bindej. Ai kishte vizatuar disa lloj kambanorësh, të gjata dhe të holla, pastaj më të ulëta dhe të trasha, me zgavër të rrumbullakët ose katrore, me



shkallë nga jashtë dhe nga brenda, derisa kishte gjetur një të mesme, e cila besonte se do t'i pëlqente Arianitit dhe që mund të ndërtohej duke hipur në skela jo shumë të larta, si ato që përdorte David Selenica në Voskopojë. Ia kishte vënë Arianitit përpara, por ai kruante mjekrën dhe nuk vendoste. Për disa ditë punimet u ndërprejnë. Arianiti ecte me hapa të mëdha përpara mureve të pambaruara të kishës, e cila i ngjante një beli pa trup. Naumi e shikonte dhe thyente gurë nga mërzia.

Një natë, Arianiti i kishte thënë Naumit se e kishte gjetur formulën e gjatësisë së kambanores. Ma thuaj, kishte pritur Naumi. Mendo sikur kambana të jetë një shishe me ujë e kthyer nga toka. Po e mendoj, i tha Naumi duke parë poshtë. Në qoftë se shishen e lidhim si kambanë, por me grykën poshtë dhe pastaj e tundim majtas-djathtas, atëherë uji do të derdhet nga të dy anët duke u hapur si krahë në ajër. Lartësia e kambanores duhet të jetë sa largësia mes pikës së fundit të ujit nga e djathta dhe pikës së fundit nga e majta. Bukur, tha Naumi, por nuk e provojmë dot sepse duhet të ngremë një skelë dhe të derdhim ujë, duke mos pasur një pikë në ajër ku të lidhim shishen. Por edhe nëse vendosim ta bëjmë këtë eksperiment, sa e lartë do të jetë skela?

Arianit Komneni kishte kaluar dorën mbi flokët e bardhë siç bënte zakonisht kur donte të thoshte diçka që e kishte vendosur me kohë. Bëjmë një provë në përmasa më të vogla, tha. Skela do jetë e gjatë sa unë.

Të nesërmen ndërtuan një skelet dërrasash në lartësinë e Arianit Komnenit dhe duke i hapur një vrimë lart kaluan aty një litar në të cilën lidhën një shishe. Grykën e shishes e lidhën me spango dhe kur Arianiti bëri shenjë Naumi filloi ta tundte. Uji u derdh majtas, pastaj djathtas duke bërë pellgje të vogla në tokë. Arianit Komneni mati largësinë mes dy pellgjeve dhe duke e mbledhur me gjatësinë e trupit të vet dhe pastaj duke i shumëzuar të dyja bashkë, me disa herë i dha Naumit lartësinë e kambanores.

Kur kambanorja mbaroi, Naumi i tha Arianitit: Kjo kishë ka përmasat e tua. Arianiti Komneni hapi krahët në ajër dhe tha: Po ta mbushnim shishen me verë, kambana do tundej si e dehur dhe kisha do ishte më e madhe.

Andrea doli jashtë dhomës dhe Muhamedi e ndoqi. Sa të lartë ta bëj minaren, e pyeti. Muhamedi tregoi kambanoren me gisht dhe tha: Aq sa ajo aty. Andreas i kaloi një buzëqeshje mbi fytyrë. Ti je më i shkurtër se Arianit Komneni, i tha. Ç'do të thuash, e pyeti Muhamedi që nuk e dinte historinë e ndërtimit të kambanores. Andrea ngriti kokën lart dhe tëmthat e thinjur u zverdhën në diell. Kjo kishë është bërë si një kostum, i tha. Babai mati përmasat e trupit të Arianit Komnenit dhe e ndërtoi kishën duke qepur gurë me gozhdë. Asnjëri nuk mund ta bëjë dot më këtë ndërtim sepse formulën e ekuilibrit mes lartësisë, gjatësisë dhe gjerësisë e dinë vetëm ata të dy. Muhamedi u afrua dhe filloi të shikonte kishën. Kambanorja kishte një kupolë të rrumbullakët që dukej si kokë njeriu. Suvaja kishte rënë vende-vende edhe trarët skeletikë kishin dalë në diell si damarë që ngrohen.

Bëje me përmasat e trupit tim, tha Muhamedi pa e parë Andream në sy. Andrea u afrua dhe i vuri dorën në gjoks. Zemra e Muhamedit nuk ndihej. E rrotulloi duke e parë nga koka te këmbët dhe duke e vendosur në drejtim të kambanores, e cila i dilte Muhamedit mbi kokë. Ti i ke këmbët e shkurtra dhe minareja do duket si një burrë i parritur, tha Andrea. Kam lindur gjashtëqind vjet më vonë prandaj dukem më i vogël, tha Muhamedi duke i kthyer shpinën kishës.

Andrea e shembi shumë shpejt shtëpinë e Hanës. Bilali dhe i biri mblodhën gurët në një cep dhe trarët e thyer i dogjën. Fshati u mbush me hi dhe era e djegur hyri në çdo shtëpi. Kur dolën themelet, djali i Bilalit filloi të gërmonte me duar dhe gjeti një unazë të vjetër që ia dha Muhamedit, por atij nuk i pëlqeu dhe Bilali e vuri në gisht. Andrea vendosi t'i forcojë themelet dhe ditën që u vu guri i parë i xhamisë Bilali theri një qengj. Gjakun e shpërndau nëpër themele

duke kënduar me zë të lartë. I biri mbante nga këmbët e lidhura qengjin që jepte shpirt, ndërsa Muhamedi u zverdh dhe shkoi në shtëpi. Çfarë ke, i tha Hana. Muhamedi u ul në stol dhe shtriu trupin. Sytë i ishin zmadhuar dhe ishte mbushur me djersë të ftohta. Më vjen për të vjellë, tha. Hana i solli një limon të prerë dhe ia vuri në hundë. Muhamedi teshtiu fort dhe iriqi u fsheh nën stol. Bilali që punonte me Andrean nuk vinte më pasditeve dhe shtëpia ishte më e qetë.

Hana gatuate, lante, hekuroste, spërkaste oborrin dhe ndryshonte vendin e plaçkave të veta në sënduk. Kur i mbaronte të gjitha, ulej mbi krevat dhe thurte rroba fëmijësh. Në darkë vishte këmishën e natës dhe e priste Muhamedin me qirinj të fikur. Sa herë që bashkoheshin, nën çarçafë, ajo shikonte në ëndërr një djalë të vogël me sy të kaltër, i cili rrinte i ulur në stol dhe numëronte gjembat e një iriqi prej druri. Muhamedi ishte i imët, me këmbë të holla, të cilat ishin gjithmonë të ftohta. Hana ia vinte dorën mbi bark dhe gjurma e gishtave të saj mbetej aty, si një njollë e kuqe. Edhe kur Hana e puthte ai mbushej me pulla të kuqe dhe e lyente lëkurën me një vaj karote që ia sillte gruaja e Bilalit. Kam frikë ta puth se bëhet si domate, i thoshte Hana Sarës që qeshte. Unë do doja ta kisha burrin kastravec, por jo domate, thoshte Sara duke e ngacmuar. Domatja nuk po mbin akoma, thoshte Hana dhe sytë i fryheshin duke pritur me barkun bosh.

Natën, Muhamedi ngrihej dhe shkonte te xhamia. Hëna hynte në themele dhe dilte prej andej vetëm në mëngjes, kur ai ishte në gjumë. Ibrahim i vogël luante në oborr duke ndjekur iriqin që ishte plakur dhe gjembat i ishin thinjur.

Një mëngjes, Ibrahim u përplas në stol dhe vetulla iu çka mbi sy. Fatimja erdhi me vrap duke bërtitur, ndërsa Muhamedi u zverdh dhe shkoi të villote tek arra e vogël. Fytyra e Ibrahimit ishte mbushur me gjak. E pastruan, i vunë duhan, ia lidhën kokën me beze dhe djali u bë si një hoxhë i vogël. Kur ia hoqën leckën, mbi ballë i kishte mbetur një shenjë që dukej si një rrudhë me buzë të holla. Fatimja nuk e la më djalin të luante në oborr. Jani ndërtoi një gardh me dru për të ndarë oborrin dhe iriqin e mori në pjesën e tij. Stoli i mbeti Muhamedit. Shtëpia u nda në dysh si në kohën kur Ibrahim u bë mysliman.

Kur pa gardhin, Paridit iu mor fryma dhe i tha Sarës: Babai e bashkoi shtëpinë, ndërsa Muhamedi e ndau. Ana Komnena i zgjati Paridit kulaçin e vet të pambaruar dhe tha: Nuk ka faj Muhamedi. Shtëpinë që bashkoi babai e ndau Ibrahim.

Sara u ul në oborr dhe një pupël dallëndysheje i ra në pëqi. E mori në dorë dhe ngriti kokën nga qielli sikur ta kish thirrur dikush. Erdhën dallëndyshet, i tha së bijës që e kishte gojën të mbushur me kulaç dhe nuk fliste dot.

30

Sara vendosi të nisej në Kretë kur minareja filloi të ngrihej.

Hana numëronte ditët e muajt duke thurur me grep, ndërsa Muhamedi gdhihej nën muret e xhamisë që i maste çdo ditë me pëllëmbë. Ana ishte rritur dhe gërsheti i dukej më i shkurtër. Ibrahim i afrohej gardhit dhe zgjaste kokën me kaçurrela sa herë që vinte Ana. Fatimja e thërriste dhe ai hynte në shtëpi duke u tundur si Bilali. Ana shikonte rrobat e fëmijës që qepte Hana dhe i thoshte: Po nuk linde, do m'i japësh mua rrobat për djalin tim? Hana ulte sytë jeshilë dhe psherëtinte. Zbrazëtia që kishte në bark i peshonte si një barrë.

Pasditet në fshat ishin të qeta dhe vetëm çekiçi i Andreas i trembte zogjtë që sapo kishin ardhur. Dallëndyshet i ktheheshin foleve të vjetra nën çati, por shpesh ato i gjenin të prishura nga dimri, ose të zëna nga dallëndyshe të tjera dhe pa u mërzhitur bënin fole të reja, që i thurnin me sqep. Të vegjlit, që kishin lindur në udhëtim i fushin aty dhe pastaj ngriheshin në ajër për t'u gjetur ushqim. Foshnjat prisnin me gojën hapur duke parë qiellin me durim.

Kur Sara i tha Ana Komnenës se do ikte, ajo u ul në krevat dhe mbuloi këmbët me duar. Faqet e kuqe iu mbushën me quka, ndërsa gërsheti iu mblodh si bisht. Do kthehesh prapë, e pyeti me sytë e përlotur. Do kthehem shumë shpejt, i tha Sara, do kthehem përpara dimrit.

Atë natë fjetën të dyja të përqafluara. Ana Komnena kishte mbështetur kokën në supin e Sarës dhe qukat i vallëzonin në tavan. Dritarja ishte hapur, ndërsa qielli varej si një perde. Sara nuk flinte. Kishte pesëmbëdhjetë vjet që e shtynte nisjen. Mihal Komneni që vinte gati çdo vit në fshat, i kujtonte katrorin magjik, historinë e Isakut dhe krahët e Dedalit duke e parë me sytë e tij me cepa që kishin filluar t'i ngjanin syzeve të Metod Antrakidit. Herën e fundit kishte ardhur pas vdekjes së Ibrahimit dhe i kishte thënë: Dallëndyshja ime tani është më e lirë. Sa ishte Ibrahim gjallë, ajo nuk mund të nisej dhe Mihali e dinte këtë ngërç. Nganjëherë Sara mendonte se Mihal Komneni priste që Ibrahim të vdiste dhe ajo të çlirohej, si një dallëndyshe që e mbajnë peng në tokë duke ia lidhur krahët pas stolit të oborrit.

Ishte e vërtetë se qysh kur Ibrahim kishte vdekur ajo mendonte gati çdo ditë për Kretën. Shikonte Anën që zgjatej duke u holluar dhe kujtonte të ëmën që nuk e kishte parë kurrë. Babai i kishte thënë se Sheba kishte sy të zinj dhe flokë të thurur dhe e shikonte botën nga lart si një zog që jeton në lartësi. Kur kishin ardhur në fshat, Arianiti i kishte thënë se aty do gjenin një pyll të mbushur me zogj dhe në mes tyre do ishte dhe Sheba. Në fshat kishte pyll, por ajo kishte gjetur aty Ana Komnenën që flinte dhe merrte frymë si një pupël.

Arianiti e kishte sjellë në fshat, por po të mos kishte vdekur nëna, ndoshta, as ai nuk do kthehej. Do kishin jetuar të tre në Kretë ose në Selanik, ose në një ishull tjetër të rrethuar me det ku babai do t'i mësonte notin. Arianit Komneni do mbante kockat e babait të vet në arkën e vogël, duke pritur që turqit të ktheheshin në shkretëtirë, ndërsa Ana Komnena nuk do kishte lindur. Ose ndoshta do kishte lindur për t'i ngjarë një burri tjetër dhe jo Ibrahimit. Mund të kishte flokë të verdhë, sy jeshilë dhe këmbë të shëndosha dhe çdo mëngjes do ngrihej nëpër gjumë për të shkuar në shkollën e vajzave. Nuk do kishte gjashtë vëllezër dhe Sheba që do ishte një gjyshe me flokë të bardha dhe me gushë të mbuluar me shall mëndafshi, do t'i fliste për Testamentin e Vjetër duke i treguar historinë e vërtetë të Abrahamit dhe të Shebës, që ishte një princeshë biblike e dashuruar dhe me lëkurë të zeshkët.

Mihal Komneni nuk do vinte në fshat bashkë me Metod Antrakidin dhe djemtë e Ibrahimit nuk do dinin të lexonin. Ata do ishin martuar qetësisht me gratë e fshatit dhe do kishin më pak ankthe. Higjiena injorancës do t'i kishte shpëtuar nga nevoja për të krahasuar fshatin me botën. Të gjithë do kishin zgjedhur fshatin përpara botës dhe Ibrahim do ishte akoma i ulur në stolin e tij, ndërsa gratë e djemve do t'i zienin çaj dhe qumësht.

Isaku do ishte duke u endur nëpër botë si një anije që nuk gjen dot një breg, ose ndoshta do ishte fshehur në fshat derisa Thanasi apo dikush tjetër t'ia kishte dorëzuar Ali Pashës. Mihal Komneni do ta nxiste të nisej në Kretë, por Isaku do të ishte bërë baba dhe do hezitonte. Katrori magjik do ishte i paplotë, pa numra dhe Mihal Komneni nuk do ta bindte dot Isakun, por do ulej në oborr dhe do t'i tregonte përralla fëmijëve të tij.

Po ajo pse duhej të nisej në Kretë?

Edhe ajo kishte një fëmijë që duhej ta linte disa kohë vetëm, në një moshë kur vajzave të vogla u shfaqen sëmundjet e grave nëpër trup. Arianit Komneni tani duhet të kishte vdekur, sepse po të ishte gjallë, do duhej të ishte 120 vjeç, gjë që ishte e pamundur sado që t'i ngjante Abrahamit të vërtetë. Isaku, nëse akoma ishte në Kretë, duhet të ishte një burrë pesëdhjetë e pesë vjeç. Tiparet prej djaloshi endacak të Marin Kurilës do ishin plakur në fytyrën e tij dhe Isaku duhej t'i ngjante më shumë Mihal Komnenit, ditën që ajo e kishte njohur. Në qoftë se babai kishte vdekur ajo

duhej ta kthente në fshat duke ia futur kockat në arkën e vogël siç kishte bërë Arianiti me të atin kur e kishte marrë në Stamboll.

Po Shebën? A duhej ta sillte edhe Shebën në fshat dhe t'i varroste të dy pranë e pranë në varrezat e krishtera, ngjitur me pyllin ku zogjtë do t'i zgjonin çdo mëngjes? Apo duhej t'i linte të dy atje, në breg të detit ku dhe ishin njohur dhe ku lindja e saj i kishte ndarë si një perde? Sepse ata ishin ndarë që ajo të lindte. Ndoshta nëna nuk do kish vdekur nëse ajo nuk do lindte, ose nuk do kishte vdekur nëse lindte një djalë siç shpresonte. Sara nuk kishte qenë qëllimi i dashurisë së prindërve, por pa dyshim kishte qenë mjeti për t'i dhënë fund asaj. Arianiti dhe Sheba nuk ishin dashuruar për të bërë një fëmijë, por ishin ndarë kur ajo kishte vendosur të lindte. Kthimi në Kretë asaj i dukej si kthim në djep. Një djep, të cilin Arianiti dhe Sheba e përkundnin pa pushim sikur kishin frikë se ajo do t'i harronte po ta zinte gjumi. Ja pse duhej të shkonte në Kretë. T'i thoshte prindërve se nuk kishin pse ta tundnin më djepin sepse kështu nuk po e linin të rritej dhe sigurisht që ata do ta dëgjonin. Ata do qetësoheshin kur të shihnin se nga djepi do dilte një grua dhe jo një fëmijë. Arianiti do ecte përpara me flokët si dallgë dhe Sheba me këmbë të vogla do ta ndiqte pas në breg të detit. Kur era e detit të rritej, ajo do ndalonte, do mbulonte flokët e zinj me një shall mëndafshi dhe Arianiti do ta priste pa lëvizur derisa të bashkoheshin prapë duke u ngjitur, siç ngjitet një gjysmëportokalli me një gjysmëlimoni duke formuar një diell të nxehtë në perëndim.

Sara i mendonte të gjitha këto dhe faqja e nxehtë e Ana Komnenës i digjte mbi faqen e saj. Para se ta zinte gjumi, futi dorën poshtë krevatit dhe preku arkën e vogël të babait. Ajo ishte e ftohtë dhe e hapur si një varr që priste të mbyllej. E hoqi dorën dhe kur e zuri gjumi nata po mbaronte.

Kur u zgjua p Ana Komnenën që rrinte në këmbë dhe e shikonte. Sytë e zinj i ishin skuqur dhe dukej sikur kishte qarë. Kishte nxjerrë arkën e vogël poshtë krevatit dhe e mbante te këmbët. Do ta marrësh me vete, pyeti. Do ta marr, tha Sara që iu duk sikur e bija e kishte përgjuar gjatë natës. Këtu do ta futësh Arianitin? Sara pohoi me kokë. Po ku do ta varrosësh? Aty ku ai ka varrosur babanë e tij, tha Sara, në varrezat e krishtera, ku kemi çuar Petron dhe Metodin. Ana kapi gërshetin me gishta dhe ngriti arkën e vogël për ta nxjerrë në oborr. Sikur ta varrosnim afër babait, tha duke ecur. Ata kanë qenë të dy Abrahamë.

Sara u ngrit nga krevati dhe bëri gati plaçkat. Kur dolën nga shtëpia Ana mbante arkën e vogël. Kaluan te kisha dhe dielli që sapo kishte lindur u fsheh pas minares së shkurtër. Andrea që ishte ngjitur në majë i përshëndeti me dorë. Hana kishte dalë në oborr dhe po i priste, ndërsa nga ana tjetër e gardhit kaçurrelat e Ibrahimit dukeshin si një ferrë që lëvizte. Hana u përlot kur i pa të dyja në oborr dhe i rregulloi gërshetin Ana Komnenës. Kthehem shpejt, tha Sara dhe iu kujtua dita kur babai e kishte lënë në shtëpinë e Hanës. Atë ditë frynte një erë e kuqe, ndërsa sot ishte një ditë e bukur dhe e qetë. Ajo po bënte të njëjtën gjë si Arianit Komneni, por me një ndryshim të vogël: Ana Komnena do ta priste, ndërsa ajo e kishte ditur se Arianiti nuk do kthehej dhe nuk e kishte pritur. Hana e puthi dhe lotët i ranë mbi gjoks. Do të të presim të dyja duke thurur rroba kalamajsh, i tha. Sara e përqafoi dhe i vuri dorën te barku sikur donte t'ia ngrohte. Kur të kthehem do jetë rritur, i tha. Hana ktheu kokën nga Muhamedi që rrinte i ulur në stol duke parë tri gratë që ngjanin si kukullat e Janit të bëra nga i njëjti dru, por në kohë të ndryshme. Edhe minareja do jetë rritur kur të kthehet Sara, tha Muhamedi duke u ngritur.

E përcollën të gjithë deri në të dalë të fshatit. Hana mbante Ana Komnenën për dore, ndërsa Muhamedi ecte pas tyre me Janin dhe Paridin. Nga larg ata dukeshin më të vegjël, ndërsa fshati dukej më i lartë. Minareja ishte ngritur si një shenjë në qiell. Sara ecte në drejtim të babait me arkën e vogël në dorë.

Ashtu kishte ardhur në fshat përpara dyzet vjetësh.

Selaniku ishte i nxehtë dhe deti digjte tokën. Rrugët e ngushta të qytetit zbrisnin nga kodra në formë portokalli duke derdhur njerëzit në breg. Ata ngarkoheshin aty me peshq dhe mallra dhe ktheheshin prapë në kodër më të pasur, por më të plakur. Ajo mbante mend vetëm një dyqan librash të vjetër ku për herë të parë kishte dëgjuar babanë të thoshte se ajo kishte një nënë, se nëna quhej Sheba dhe se Sheba kishte vdekur. Dyqani ishte afër portit, në mes të një lagjeje çifutësh, të cilët ecnin shpejt duke iu fshehur diellit.

Selaniku kishte sinagoga, kisha dhe xhami që dukeshin nga deti si pemë të ardhura nga toka të ndryshme. Çifutët kishin mallrat, grekët kishin anijet, ndërsa turqit kishin portin. Grekët mbanin këmisha të gjera, ndërsa çifutët me rrobat e tyre gjysmë otomane dukeshin të gjithë si Sabatai Zevi. Ata kishin ardhur nga Spanja përpara treqind vjetësh dhe verandat e shtëpive të tyre mbi det i quanin *varandado*. Librat e vjetër thoshin se Selaniku ishte toka që mbreti Solomon i Izraelit i dhuroi mbretëreshës babilonase Sheba, derisa qytetin e mori Aleksandri dhe i vuri emrin e gjyshes së vet. Mbretëresha u mahnit nga bukuria e gjirit të Selanikut dhe ngriti aty një fortesë verore të veshur me pëlhura të freskëta mbi krevate që shikonin nga deti. Fortesa ishte akoma aty, por turqit e përdornin si një fjetore. Në drekë, kur bënte shumë vapë, ata zhvisheshin lakuriq dhe i fusnin shpatat në det për t'i ftohur.

Sara ecte në breg të detit që nuk lëvizte dhe merrte frymë me vështirësi. Hundët i ishin mbushur me një përzierje kripe, peshku dhe ulliri, të cilat krijonin një aromë që ajo e kishte humbur përpara dyzet vjetësh. Nuk do ta merrte vesh kurrë nëse rridhte vërtet nga Sabatai Zevi, siç thoshte Mihal Komneni, por Selaniku i dukej një vend i njohur, qoftë edhe për këtë arsye. Selaniku ishte si një trup me skelet grek, me mish turk dhe me gjak çifut, i cili endej nëpër Mesdhe dhe provonte të gjitha gjellët, kryqëzohej me të gjitha racat dhe i falej të gjitha feve. Çdo perandori e kishte dashur dhe ai trup i ishte dhënë. Kur perandoritë kishin ikur, Selaniku kishte mbajtur mallrat dhe kishte dhënë armët. Sara ndihej mirë në këtë qytet që nuk luftonte.

Dyqani i librave dukej i errët dhe kur ajo u afrua, një turk i shëndoshë me çallmë nxori kokën. Sara ishte djersitur dhe kishte hequr bluzën. Llerët e bardha i ishin zbuluar dhe poshtë sqetullave i dukeshin disa qime të lagura si leshterikë. Kur e pa të zbuluar, turku mbylli derën duke folur me vete. Pas kokës së tij vareshin disa qilima të mëdhenj dhe nuk kishte libra. Sarës iu duk sikur fëmijëria nuk do dilte më nga ai dyqan. Turqit e kishin mbyllur brenda dhe ajo duhet të vazhdonte rrugën për të kërkuar më tutje.

Hoteli ishte afër. Dhoma e saj shikonte nga deti dhe prandaj ishte gjithë kohën e nxehtë. Sara futi arkën e vogël poshtë krevatit dhe doli në ballkon. Anijet prisnin si kuaj të rreshtuar mbi një qilim. Kur vinin, a to sillnin botën në qytet, ndërsa kur iknin e shpërndanin qytetin nëpër botë.

Me njërën prej tyre u nis një mëngjes, pasi kishte ecur gjithë javën në rrugët ku ishte rritur e ëma. Ishujt e vegjël ngriheshin mbi dallgë, ndërsa anija lundronte ngadalë në një rrugë të njohur. Koha ishte e qetë dhe peshkatarët nëpër ishuj ishin shtuar. Varkat e tyre të vogla e rrethonin anijen si peshq, ndërsa peshkatarët lëviznin duart dhe këmbët për t'i treguar kapitenit se po ecte mbi rrjetat e tyre. Por anija nuk ngecte nëpër rrjeta dhe kapiteni e dinte. Ai i binte borisë për t'i përshëndetur peshkatarët dhe dallgët shtoheshin nga uturima e saj.

Sara rrinte në kuvertë dhe kujtonte Arianitin. Kur e kishin bërë këtë udhëtim të dy bashkë, koka e saj nuk dilte mbi parmakun e anijes dhe babai e mbante në krahë për t'i treguar ishujt dhe peshqit. Natën, hëna kërcente mbi anije dhe vazhdonte udhëtimin me ta, duke nxjerrë kokën nga çarçafi i qiellit. Selaniku ishte zhdukur pas kurrizit të anijes dhe Azia turke që sa kishte nisur të dukej e skuqte natën si një zjarr. Ai zjarr i kishte ndryshuar jetën detit, peshkatarëve, brigjeve dhe tokës që kishin lënë pas. Që kur turqit kishin zbritur në det, çdo gjë ishte më e nxehtë dhe

shpesh ishte edhe përvëluese. Botës do t'i duhej kohë t ftohej dhe Sara mendonte se, edhe kur ai zjarr të shuhej, gjurmët e tij do t'i dilnin njerëzve në fytyrë, si qukat e Ana Komnenës sa herë që mërzhitej.

Një mëngjes, në mes të atij zjarri, u shfaq një njollë dhe kapiteni tha se ajo ishte Kreta. Dukej si një dru që nuk donte të digjej. Sara mblodhi plaçkat, mori arkën e vogël dhe u zgjat mbi det. Anija ngadalësoi lëvizjen dhe brigjet e ishullit u rritën. Kreta u zmadhua. Kapiteni doli në bashin e anijes për të kontrolluar bregun, pastaj hodhi spirancën në det duke lëvizur krahët me kujdes sikur donte të ndalonte lëkundjen e një djepi. Kur vuri këmbën në tokë, Sarës iu duk sikur po kthehej në shtëpi pasi kishte jetuar disa kohë në një pyll me zogj, ku e kishin çuar që të mos merrte pjesë në vdekjen e prindërve. Kishte menduar gjithë jetën për këtë ditë dhe ndoshta prandaj ishte e qetë. Babai thoshte se Kreta ishte një vend i shkëlqyer për të lindur dhe për të vdekur. Ajo kishte lindur këtu dhe nuk mund të ngatërrohej. Porti, rrugët, ullinjët, turqit dhe grekët që shkëmbenin mallra duke bërë titur, rëra e përvëlur dhe era e peshkut të djersitur ishin aty ku i kishte lënë. Shtëpia e Terezës po ashtu.

Kur u afrua, pa arrën e madhe që e kishte mbuluar shtëpinë sikur donte ta mbronte nga zjarri që vinte nga deti. Sara trokiti dhe arra u gërvisht pas murit. Një grua me flokë të bardha hapi derën duke mbyllur pak sytë nga dielli. Duhej të ishte Tereza. Sytë i kishte të pastër dhe trupin të fortë dhe të rregullt. Sara nuk e mbante mend, por, në qoftë se kishte qenë e bukur, tani pleqëria ia kishte hequr çdo gjurmë duke ia mbuluar fytyrën me një kurorë rrudhash katrore, të cilat e tregonin të vetmuar. Kur i tha kush ishte, Tereza u përlot. E puthi disa herë në faqe, ia ktheu kokën nga dielli sikur donte të bindej që ishte ajo dhe duke e shtyrë, sikur po e mbante në krahë, e ngjiti në një dhomë të madhe që shikonte nga deti. Këtu ke lindur, i tha dhe e puthi prapë. Sara futi arkën e vogël poshtë krevatit dhe qëndroi ulur mbi shtrat, ndërsa Tereza sillej nëpër dhomë duke e parë si një kukull që e kishte humbur para shumë vitesh.

Pas pak Tereza doli. Sara hapi dritaren, por deti mezi shquhej. Gjethet e arrës ngjanin si plloça jeshile të shtruara mbi ujë. Zhurmat e portit vinin të dobëta dhe anija që e kishte sjellë nuk dukej më. Kreta peshkonte ushqimin e vet të përditshëm, ndërsa në anën tjetër të horizontit, Azia dukej si një tigan i uritur. Tereza i solli një pjatë të vogël me reçel arre dhe u ul pranë saj. Rrudhat zbrisnin mbi çarçaf dhe Sarës iu duk sikur po e preknin. Provoi reçelin duke e lëpirë lugën me gjuhë dhe një pikë ra mbi krevat. E kuptoi se po i dridheshin duart. Qetësia që kishte ndier në anije kishte mbetur po aty dhe nuk kishte zbritur bashkë me mallrat e tjera. Tereza fshiu reçelin me dorë dhe qeshi.

Ku është babai, pyeti Sara. Tereza pa nga dritarja dhe sytë i lëngëzuan si reçeli që kishte mbetur në pjatë. Mori nënën dhe iku në mal, tha duke u ngritur. Sara ndjeu një të ftohtë që vinte nga hija e arrës. Dontë ta pyeste Terezën se ç' do të thotë që babai kishte ikur në mal, në cilin mal, pse e kishte marrë nënën me vete aty lart dhe ku ishin tani, nëse ishin të dy bashkë. Imagjinoi babanë me një arkë tjetër, si ajo që kishte poshtë krevatit, duke u ngjitur në mal ngadalë, ndërsa deti poshtë shtrihej nën këmbët e tij si një qilim dasme. Arianiti ecte mbi qilim duke çuar nusen në shtëpinë e tij të fundit. Tereza iu afrua sikur donte ta uronte për martesën e prindërve. E mori me vete që të varroseshin të dy në një vend, tha. Babai erdhi në Kretë për të vdekur pranë nënës tënde, të cilën e dashuronte. Para se të vdiste na tha se donte të varrosej në mal, aty ku ishte edhe varri i vëllait të tij që kishte luftuar në Kretë. Do ta mbledh gjithë familjen në një vend, thoshte. Tani janë aty lart, të dy. Bashkë me vëllanë dhe shokët e tij.

Sara nuk kishte dëgjuar njeri t'i fliste për vdekjen si për një bashkim. Tereza ia kishte treguar bashkimin e prindërve si një martesë që bëhet pas vdekjes dhe ku ajo kishte qenë dëshmitare. U mbështet në krevat dhe mbështolli këmbët siç bënte Ana Komnena. Kur vdiq babai, e pyeti.

Tereza rrinte në këmbë, ndërsa hijet e gjetheve të arrës i kishin mbirë si gjurmë në faqe. Vdiq një vit pasi erdhi këtu, tha Tereza. Jetoj në këtë dhomë dhe ditën merrte një stol të vogël dhe rrinte poshtë arrës në oborr. Një herë në javë shkonte te varri i nënës tënde dhe i çonte lule. Do kishte vdekur më herët, por priti sa u martua Isaku.

Sara mori lugën me reçel dhe e lëpiu sikur kishte ardhur nga një varrim që ia kishte lënë gojën të hidhur. Tereza nuk lëvizte. Rrudhat e saj dukeshin si rrugë në të cilat kishte kaluar babai, nëna, ajo vetë, por me sa duket edhe Isaku. Ishin të vetmet rrugë që kishin mbetur për të takuar familjen që i kishte humbur. Sara e shikonte duke ia lexuar fytyrën si një letër që babai ia kishte lënë para vdekjes. Rrudhat e saj janë pjesë e katrorit magjik, mendoi. Tereza kishte thënë se babai do kishte vdekur më përpara nëse nuk do priste martesën e Isakut dhe kjo nuk e habiti. Përkundrazi. Ishte mësuar që e vogël me zakonin që kishte i ati për të parashikuar çdo gjë, përfshi edhe vdekjen e vet. Vetëm dashuria me Shebën kishte dalë jashtë parashikimit të tij prej profeti, që nuk merret me gjëra të vogla, por të cilin gjërat e vogla e kthejnë nga rruga, për ta çuar në një botë që ai nuk e njeh. Kështu i kishte ndodhur Arianit Komnenit. Hunda e vogël e gruas që njohu në Stamboll, shalli i saj i lidhur fort në qafë, gjellët me erëza që gatuante, vetmia e saj në Lesbos, arra e shtëpisë në Kretë dhe vdekja e Shebës, ishin disa gjëra të vogla, të cilat i kishin shmangur Arianitin nga rruga. I kishte marrë në dorë, si një plak që gjen disa lodra në mes të rrugës dhe ishte hutuar pas tyre kur kishte kuptuar se ato i kishin ndryshuar jetën. Duke bërë një përpjekje për të mos iu bindur rastësisë, që shkon në të kundërt me natyrën e profetit, i kishte lënë aty ku i kishte gjetur duke i mbuluar me dhe, q ë të mos ia merrnin dhe kishte ikur në fshat për të mbaruar rrugën për ku ishte nisur para se të gjente lodrat. Por dashuria, duke qenë një rastësi e paparashikueshme, ishte po aq e papërballueshme, prandaj ai ishte nisur prapë në drejtim të atyre gjërave të vogla, të cilat i kishte zhvarrosur dhe i kishte marrë me vete në varr. Rrugën për atje e dinte Tereza.

Po Isaku ku është, pyeti Sara. Isaku u martua me motrën tënde, tha Tereza, duke e ditur se ajo që po i thoshte do ta kishte hutuar Sarën, së cilës iu njomën sytë si një reçel arre. Tereza nuk e la të pikonte dhe vazhdoi. Kur nëna jote vdiq, ti kishe nevojë për gji. Unë gjeta një vajzë të re dhe të shëndetshme nga familjet e vjetra veneciane që kishin mbetur akoma në Kretë pas pushtimit. Ajo vinte çdo ditë dhe të jepte gji. Ti e shtrëngoje fort sikur e kishe nënë dhe pije me etje nga qumështi i saj. Kur fole për herë të parë, the emrin e saj. Ajo u mallëngjye dhe që nga ajo ditë të thoshte: Vajza ime. Ato kohë ajo kishte shumë qumësht sepse kishte lindur një vajzë disa muaj përpara se të lindje ti. Vajza e saj quhet Marina dhe është martuar me Isakun. Është e gjatë, me flokë të verdhë dhe me sy të kaltër si deti i Kretës. Nuk ngjan me ty, por mua më duket sikur buzët i keni njëlloj sepse kanë marrë formën e të njëjtit gji. Arianit Komneni kur erdhi këtu në vitin 1769 dhe pa Marinën të rritur, i kërkoi së ëmës që Isaku dhe ajo të martoheshin. Nëna e Marinës pranoi duke thënë se kështu vajza e saj do martohet në familjen e motrës së vet të gjirit. Isaku dhe Marina u dashuruan që ditën që u njohën dhe tani jetojnë në shtëpinë e tyre, në anën tjetër të qytetit. Arianiti erdhi vetë në kishë ditën e dasmës dhe mua m'u duk më i bukur se kurrë. Flokët e bardhë i kishte lidhur pas kokës dhe fytyra e tij ishte e lëmuar si e një njeriu që e ka mundur kohën. Qeshte, ngacmonte priftin, i hidhte Marinës lule mbi kokë dhe i thoshte Isakut se ai dinte një sekret, se si ngjizen djemtë që natën e parë të dasmës. Nuk e kisha parë aq të qeshur as ditën që doli nga burgu. Pas disa kohësh i tha Isakut se do vdiste. Mori nënën tënde, u ngjit në mal dhe nuk u kthye më.

Sara, që e dinte si sillej Arianiti nëpër dasma, dëgjonte duke qeshur, por kur Tereza përmendi burgun u ngrysi si një perçe.

Çfarë burgu, pyeti duke u nderuar mbi krevat. Nuk të ka treguar babai për burgun, e pyeti Tereza. Jo, tha Sara, nuk më ka folur kurrë. Tereza që rrinte në këmbë u mbështet pas dritares dhe dhoma u errësua. Rrudhat katrore lëvizën dhe ajo mori frymë thellë para se të fliste. Nuk ishte e lehtë t'i thoshte një vajze që adhuronte babanë e vet, se disa ditë të jetës ai i kishte kaluar në burg dhe Tereza filloi të fliste ngadalë sikur po shtrydhte një ilaç të hidhur në gotën e Sarës.

Pak javë pasi linde ti, Arianitin e arrestuan për vrasjen e burrit të nënës tënde, Jorgo Mavromatisit. Jorgo ishte tregtar dhe kishte blerë një ngarkesë me verë që në atë kohë ishte një pije e ndaluar nga sulltani. Anija me të cilën ata udhëtonin për në Selanik ndaloi në Lesbos për shkak të kohës së keqe. Turqit kontrolluan anijen, morën verën dhe e futën Jorgon në burg. Duke pritur që ai të lirohej, nëna jote dhe Arianiti u dashuruan. Por Lesbosi është një ishull i vogël dhe njerëzit aty nuk i duan të huajt. Një burrë i thinjur dhe një grua tridhjetë vjet më e re se ai që dashurohen nuk është një ngjarje që ndodh çdo ditë në një ishull të vogël si Lesbosi, ku gratë në atë moshë mbyllen në shtëpi, ndërsa burrat vdesin shpejt. Ata duheshin si dy fëmijë dhe ecnin përdore në breg të detit. Ishulli i shikonte me zili. Kur barku i nënës tënde u rrit dikush që e dinte se Arianiti dhe Sheba nuk ishin të martuar i çoi fjalë në burg Jorgo Mavromatisit. Babai e mori vesh dhe i tha Shebës se duhej të iknin sa më parë nga Lesbosi. Morën një anije dhe erdhën në Kretë fshehurazi. Nëna jote e vuajti shumë rrugën e gjatë nëpër det dhe kur erdhi këtu ndenji gjithë kohën e shtrirë në këtë shtrat. Ishte në një moshë të madhe dhe trupi i saj i pamësuar nuk e mbante dot barrën. Jorgo Mavromatisi, që kishte paguar njerëz për t'i ndjekur, e mori vesh dhe u bë si i çmendur. Pas disa kohësh, u pagoi turqve shumë para, u lirua nga burgu dhe erdhi në Kretë pak pasi nëna jote kishte vdekur. E gjeti Arianitin dhe e akuzoi se ai i kishte vranë gruan që t'i merrte pasurinë dhe se vajza që kishte lindur ishte e tij. Arianiti i tha se ai dhe Sheba ishin dashuruar duke pritur që ai të lirohej dhe vajza ishte e tyre, por Jorgo, i cili kishte gjithë pasurinë nga familja e Shebës, nuk donte të bindej. Arianiti kërkoi t'ia zbuste marrëzinë dhe i tha se ai nuk kishte asnjë pretendim për pasurinë dhe pronat e Shebës në Selanik dhe se Jorgo mund t'i mbante të gjitha, por ai prapë nuk u bind duke e ditur se pasuria do trashëgohej nga ty si vajzë e vetme. Rrinte në tavernë duke pirë dhe pasi dehej vinte përpara shtëpisë dhe i thoshte Arianitit se do ta vriste. Babai yt dilte në këtë dritare dhe shikonte të dehurin pa iu përgjigjur, ndërsa ti flije si një foshnjë e paditur. Unë e kaloja natën tek arra e madhe, duke u dridhur. Nganjëherë Arianiti më thoshte se në fillim kishte ndier një brerje ndërgegje, kur i kishte marrë gruan një burri që e njihte, por tani ishte bindur se Jorgo e donte Shebën vetëm për paratë. Ndoshta Sheba e dinte këtë dhe prandaj nuk bënte fëmijë me Jorgon, më tha njëherë, por pastaj ndërroi temë dhe më pyeti se ç'mendoja unë për pushtimin e Kostandinopojës, sepse, sipas tij, edhe nëse nuk do ishte pushtuar nga turqit, Kostandinopoja do të ishte rrëzuar nga mëkati i vet për shkak të mohimit që i bëri Romës dhe sidomos Greqisë së lashtë. Kostandinopoja gaboi kur e ndau krishterimin në dy pjesë dhe prandaj dështoi. Jezu Krishti nuk vdiq në Jerusalem, por në Kostandinopojë, thoshte duke parë nga deti, pasi aty mori fund ëndrra e tij për një botë të krishterë.

Pas vdekjes së Shebës ai rrinte shumë në shtëpi dhe mua më dukej si një njeri që vdekja e detyron të ndryshojë mendim për botën. Kur Jorgo vinte në mbrëmje, ai rrinte pas dritares dhe mendohej gjatë duke të ruajtur, si një ujk që nuk do të rrezikojë asnjë qime në një betejë të panjohur që mund ta lërë foshnjën e vet jetime. Jam i bindur se po të mos ishe ti, ai kishte dalë në rrugë dhe do ta kishte vranë Jorgo Mavromatisin. Dhe Jorgo nuk ia kurseu këtë mundësi.

Një natë ai shtyu fort derën e shtëpisë dhe hyri me forcë. U ngjit nëpër shkallë duke mbajtur në dorë një thikë të gjatë dhe duke sharë Arianitin si vrasës. Mbante erë të keqe dhe sytë i kishte të skuqur si gjak. Arianiti doli dhe u përpoq ta qetësonte, por ai i drejtonte thikën dhe i thoshte se kishte ardhur për të marrë vajzën e tij. Unë hyra në mes të të dyve për t'i ndarë, por Jorgo



shkalloi edhe më keq. Një çast, pashë që ngriti dorën për ta goditur Arianitin dhe e shtyva me sa fuqi kisha. Ai ra nga shkallët dhe pas një ore dha shpirt në oborr. Vdekja e tij nuk mund të fshihej sepse, nga zhurma e madhe dhe të thirrurat, komshinjtë kishin dalë nëpër dyer dhe kishin dëgjuar çdo gjë. Njerëzit u mblodhën përpara shtëpisë dhe pas pak erdhën edhe ushtarët turq. Unë qaja, por Arianiti nuk më la të flisja. I doli ushtarëve përpara dhe tha se e kishte vrarë ai Jorgo Mavromatisin. Unë nuk qava më, por atë natë u plaka dhe lotët m'u bënë rrudha.

Turqit e morën Arianitin dhe e mbajtën dy vjet në burg derisa të gjithë komshinjtë dëshmuar se ai ishte i pafajshëm, pasi Jorgo kishte dashur ta vraste. Arianiti pranoi se e kishte shtyrë Jorgon në fund të shkallëve, duke më mbuluar mua që isha vrasësja e vërtetë. Ato dy vjet që ai qëndroi në burg, unë dhe nëna e Marinës të ushqyem derisa babai u lirua, të mori ty dhe të çoi në fshat. Kur u nis më tha: Do kthehem prapë. Unë e prita duke numëruar rrudhat përpara pasqyrës.

Kur Tereza fliste, Sara ishte shtrirë në krevat nga pesha e fjalëve që dëgjonte. Jastëku ishte i ftohtë dhe i lagur. Ajo dëgjonte dhe qante pa zë. Në atë dhomë kishte jetuar një baba që ajo nuk e kishte njohur. Rrudhat katrore në fytyrën e Terezës ishin të thella dhe të dhimbshme. Po të mos kishte ardhur Arianiti në Kretë ndoshta fytyra e saj do kishte më pak rrudha, mendoi Sara dhe ktheu kokën nga muri që të thante lotët. Babai dhe nëna ishin ndarë që ajo të lindte, por jo vetëm kaq. Në fillim nëna ishte ndarë nga një burrë tjetër që kujtonte se ajo ishte vajza e tij e ligjshme. Babai i kishte thënë se ata të dy ishin dashuruar si dy zogj që dimri i ka braktisur në një ishull të vetmuar, por nuk i kishte folur për xhelozinë vrasëse të Jorgo Mavromatisit. Mihal Komneni, që gjithnjë i justifikonte sekretet e Arianitit, do thoshte se ajo nuk ishte një histori që i duhet treguar një fëmije. Por Mihali nuk i kishte parë rrudhat e Terezës mbi të cilat historia kalonte nga një brez në tjetrin. Tereza rrinte në këmbë si një dëshmi, ndërsa ajo ishte shtrirë në krevatin ku kishte lindur, gjë që e kishte çuar nënën në varr dhe babanë në burg. Nuk ndihej fajtoresh, por e pafuqishme, si një fëmijë që vret për të lindur, sepse zgjidhje tjetër nuk mund të kishte. Çdo fëmijë do ta bënte këtë i shtyrë nga nevoja për të lindur. Pafajësia e saj mund të ishte vrasëse por, para së gjithash, ishte njerëzore. Sara e dinte që kur u nis se Kreta do t'i mësonte një sekret, por jo në këto përmasa. Katrori magjik tani i dukej si një lule e vizatuar me shkumës, përpara pemës së rrudhave të egra që ajo dhe babai i saj kishin vizatuar në kokën e Terezës.

Ndjeu keqardhje për këtë grua, së cilës ata ia kishin ndryshuar jetën. Ajo nuk kishte krijuar dot një familje të vetën, por kishte mbajtur një derë hapur në ishull, që Arianiti të kthehej dhe të vdiste, në paqe. Por edhe pas vdekjes së tij, Tereza nuk e kishte mbyllur derën e shtëpisë. Kishte pritur me durim që ajo të rritej, atje larg në fshat dhe që një ditë të vinte dhe ajo t'i tregonte se babai i kishte fituar betejat e jetës së vet duke humbur njerëzit e dashur herë pas here. Tereza ishte një prej tyre. Ajo kishte humbur jetën e vet duke pritur që Arianiti të vendoste të vdiste. Ajo ndoshta e kishte dashur Arianit Komnenin, por edhe nëse nuk e kishte dashur si një grua, nuk i kishte rezistuar dot magnetit të tij. Nuk ishte e para dhe as e fundit. Sheba kishte vdekur e tërhequr nga ai magnet, ndërsa Sara rrinte shtrirë në krevat dhe ndiente kokën që i rrotullohej si një planet rreth yllit të Arianit Komnenit që shkëlqente akoma mbi malet e Kretës.

Ishte errësuar dhe yjet kishin çelur mbi gjethet e arrës. Tereza rrinte si një hije që pret ta shohin. Sara u ngrit dhe e përqafoi. Nuk mund t'i jepte më shumë sepse Tereza nuk kërkonte më shumë. Kishte dyzet vjet që e priste. E shtrëngonte me rrudhat e saj dhe Sarës i dukej sikur po ecte në një pyll, e mbështjellë me lëvore pemësh. Nata kishte dalë nga deti dhe Kreta ishte e errësuar. E zuri gjumi dhe ndjeu Terezën që e mbuloi me çarçaf, pastaj mori pjatën me reçel dhe iku. Luga, që ishte ngjitur në pjatë nga lotët e saj, nuk lëvizti. Dritarja ishte e hapur dhe dallgët që vinin deri tek arra nuk ngjiteshin dot lart. Sara pa në ëndërr Isakun që i mësonte notin duke e mbajtur nga

krahët. Ajo zhytej në det dhe Isaku e ngrinte, pastaj zhytej prapë dhe Isaku nuk e ngrinte. Arianiti rrinte në breg dhe i thoshte Isakut: Është akoma e vogël, mos e lër vetëm.

Kur u zgjua në mëngjes, pjata e reçelit ishte e mbushur. Sara e kishte gojën të ëmbël nga ëndrra. U zgjat në dritare dhe pa detin ku kishte notuar gjatë natës. Kreta kishte dalë në port duke pritur botën që vinte me anije. Tereza hyri në dhomë dhe i solli një gotë ujë. Rrudhat e saj ishin më të çlodhura dhe ngjanin si rrugë, të cilat mbyllen pasi kalon njeriu i fundit. Dielli që hynte nga dritarja ngjitej nëpër ato rrugë për t'i shkuar në sy.

Kam lajmëruar Isakun, foli Tereza, duhet të jetë duke ardhur. Sara pa fytyrën e saj dhe ndjeu lëkurën që iu mblodh si një rrudhë. Dalim ta presim, i tha Terezës. Zbritën të dyja në oborr dhe u ulën nën hijen e arrës. Tereza e hapi derën e shtëpisë dhe nga rruga dukeshin fëmijët që shkonin në det. Të gjithë dinin not dhe Sara u ndie e plakur.

Isaku erdhi në drekë. Kishte veshur një këmishë të bardhë me jakë të gjatë dhe pantallona të zeza që shkëlqenin si luspa peshku. Ngjante si Mihal Komneni, por sytë jeshilë i lëviznin shpejt si kapriciot e Marin Kurilës.

Sara u ngrit në këmbë dhe mbeti pa lëvizur nën hijen e arrës, si një fëmijë i turpëruar. Isaku u afrua dhe e përqafoi. Mbetën ashtu të dy, ndërsa Tereza i shikonte dhe po të mos kishte rrudha do t'i dukeshin lotët. Isaku e largoi Sarën nga vetja dhe i pa fytyrën në diell. Nuk ke ndryshuar, i tha dhe e përqafoi prapë.

Kur u ngjitën në dhomë hapat e mëdhenj të Isakut shkundën pluhurin e shkallëve të vjetra. Tereza solli reçel dhe i la vetëm. Isaku hante reçelin duke mos ia hequr sytë Sarës.

Nuk ke ndryshuar fare, tha për herë të dytë dhe Sarës iu duk sikur i tha: Të kam parë. Zgjati kokën nga ai duke mbledhur buzët dhe Isaku filloi të qeshte. Buzët i ke si të Marinës. Besoj se të ka thënë Tereza se unë jam martuar me Marinën, motrën tënde të gjirit. Edhe ajo i mbledh buzët si ty kur habitet. Kur isha në fshat nuk më bënë përshtypje buzët e tua, por tani që i krahasoj me ato të Marinës bindem se e keni pirë qumështin nga një shishe. Sara u ndie edhe më e vogël. Gjithë ditën kishte pasur ndjesinë që po plakej, por ardhja e Isakut ia kishte hequr si me dorë. Ky njeri është pjesë e fëmijërisë sime, mendoi, prandaj ndihem e vogël.

E di që ke qenë në fshat, i tha Isakut, por pse nuk më ke takuar? Nuk donte Arianiti, tha Isaku që filloi të fliste ngadalë dhe sytë e lëvizshëm të Marin Kurilës iu errësuan pak. Mua më ndiqnin turqit pasi ika nga Voskopoja dhe erdha në fshat për t'u fshehur. Arianiti më mbajti në bodrumin e shtëpisë dhe kur ti luaje në oborr, unë dilja në dritaret e dhomave dhe të shikoja. Kishe një gërshet të gjatë, sy të zinj dhe faqe të kuqe. Doja të të takoja, por Arianiti nuk më la. Po e takove nuk do ikësh dot, më tha, por unë besoj se ai e dinte se nëse unë do lidhesha me ty dhe me fshatin as ai nuk do ikte dot, siç e kishte vendosur.

Pse e kishte vendosur, pyeti Sara. Isaku u mbështet fort në karrige dhe këmisha e bardhë iu mbush me hijet e gjelbra të gjetheve të arrës. Donte të vdiste në Kretë, pranë nënës tënde. Ardhja ime në fshat e shpejtoi këtë gjë sepse ndoshta ai do kishte ikur më vonë, kur ti të rriteshe edhe pak. Ato ditë Gjergji u bë mysliman dhe Arianiti e lexoi këtë si një shenjë se koha për të ikur kishte ardhur. Më bindi që të niseshim të dy, megjithëse ishte i dyzuar për të të marrë me vete apo jo. por rruga ishte e vështirë dhe ai kishte frikë se mua mund të më arrestonin turqit duke kaluar nga Janina në Selanik. Nëse ty të arrestojnë, më tha, kur unë të vdes Sara do mbetet vetëm. U mendua dy ditë. Erdhi në bodrum dhe mua m'u duk si një gjeneral që jepte urdhrat e fundit. Nisemi nesër në mëngjes, më tha. Sara do rrijë me Hanën. Ti hajde me mua. E pyeta se ku do shkonim dhe ai më pa i çuditur. Në Kretë, tha, ku tjetër. Do më varrosësh mua dhe do jetosh i lirë.

Unë dola nga fshati natën dhe e prita pas kodrës. Atë ditë frynte një erë e kuqe. Arianiti të mori për dore dhe të la te shtëpia e Hanës. Kur erdhi, ishte i bardhë në fytyrë, por i vendosur. Do ecim shpejt, tha, dua të vdes. Unë e shikoja dhe habitesha se si ai mbante hapin tim. Kaluam në Janinë dhe pas dy javësh gjetëm një anije në Selanik. Kur hipëm në anije, ndryshoi. Fytyra iu çel dhe rrinte në kuvertë sikur numëronte ishujt. Tek ai ishulli aty, më thoshte duke treguar një copë tokë të vogël dhe të shkretë, i mësova Sarës notin. Tek ai ishulli tjetër me pemë të larta, që duket si një kokë njeriu e paqethur, i thashë Sarës se do shkonim në pyll të takonim nënën. Kurse atë ishullin atje larg, që duket si një kuti e mbushur me arra, Sara nuk e pa se e kishte zënë gjumi në krahët e mia. E lidhte gjithë udhëtimin me ty. Edhe po të m'i mbyllin sytë, më thoshte, e gjej rrugën nëpër këto ishuj si Minotauri në labirintet e Kretës.

Natën, kur ishujt humbnin në errësi, më tregonte historinë e jetës së vet. Udhëtimet në Stamboll, kryengritjen e Halil Patronës dhe njohjen me Shebën në Lesbos. Nuk e donte Lesbosin dhe thoshte se, në qoftë se nuk do kishin ndaluar në atë ishull, Sheba nuk do kishte vdekur. Por as Sara nuk do kishte lindur, thoshte, dhe unë nuk di kë të zgjedh mes të dyjave. Kur erdhëm këtu ndryshoi mendje dhe mua m'u duk se iu kthye dëshira për të jetuar. Do pres sa të martohesh ti, më tha kur e pyeta.

Marina në atë kohë ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. Nuk kishte nevojë që ai të më bindte sepse unë u marrosa kur e pashë dhe ia thashë Arianitit. Në këtë ishull ose vdes, ose lind, më tha. Ai priti sa u martuam dhe ditën e dasmës sonë qeshte si një fëmijë. Trupi i ishte dobësuar, por këmbët e gjata e mbanin dhe dukej sikur ecte mbi dy pemë që i kishte sjellë nga fshati. Pas një viti lindi djali im dhe unë i thashë se doja ta quaja Arianit. Babai yt nuk foli, por unë e ndjeva se kjo gjë i pëlqeu. Nuk ka vend në Kretë për dy Arianitë, më tha duke qeshur. Është koha për të vdekur.

Arianiti i vogël lindi me flokë të zinj dhe këmbë të gjata. Sot është njëzet e shtatë vjeç sa ç'isha unë kur erdha në Kretë. I mban flokët e gjata dhe Tereza thotë se i ngjan babait tënd sepse nuk di vetëm atë që do bëjë vetë, por di edhe atë që do bëjnë të tjerët. Kur Arianiti e pa të mbështjellë me pelena e puthi dhe tha: Arianit Komneni do jetojë deri ditën që turqit do kthehen andej nga kanë ardhur. Të nesërmen më thirri dhe më tha: Erdhi koha. Ishte veshur me rroba të reja dhe flokët i kishte lidhur me një fill të zi.

Shkuam te varrezat ku ishte nëna jote dhe e morëm. U ngjitëm në mal. Poshtë nesh deti dukej si një gjithësi dhe askund nuk dukej tokë. Në majë të malit ishte një fshat i braktisur dhe afër tij ishte një pllajë mbi të cilën ishin disa gurë varresh. Ishin njëmbëdhjetë shqiptarët që babai i Arianitit kishte dërguar në Kretë për të ndaluar pushtimin e turqve. Mes tyre, e dija që ishte edhe vëllai i tij, që i kishte pasur sytë jeshilë si unë dhe si babai i Arianitit. Kur shkuam në fund të pllajës, Arianiti ndaloi dhe më tha: Këtu do më varrosësh bashkë me Shebën. U ul në gjunjë dhe pastroi një nga një dhjetë gurët e varreve që ishin aty. Ia kalonte dorën sipër dhe dukej sikur u fliste të gjithëve. Njëlloj si ditën e fundit në fshat, m'u duk si një gjeneral që ka ardhur të takojë ushtarët e vet. Unë rrija në këmbë si i ngrirë dhe ai më tha: Njëri nga këta është vëllai im. Qeshi pak me vete dhe shtoi: Pati dy herë më shumë fat se unë. I kishte sytë jeshilë dhe vdiq duke luftuar.

Unë mora lopatën që kisha marrë me vete dhe hapa një gropë të vogël për eshtrat e Shebës dhe pastaj edhe një gropë më të madhe për trupin e Arianitit. Ai shikonte detin, ndërsa unë djersija në diell dhe qaja. Nuk e kuptoja nëse po bëja një mëkat apo një detyrë. Sido që të ishte, nuk mund të kundërshtoja sepse për këtë gjë më kishte marrë me vete. E kundërta do ishte një tradhti. Kurrë nuk e kisha menduar se do hapja varrin e gjyshit tim që rrinte i qetë duke më pritur dhe herë pas here kthente kokën nga unë sikur maste përmasat e gropës me sy. Po priste të mbaroja unë që të vdiste.

Unë punova një kohë të gjatë dhe më dukej sikur çdo vonesë ia zgjaste atij jetën. Kur mbarova, u ula në buzë të greminës. Nuk ishte lartësia, por ankthi i asaj që po bëja që ma mori mendjen dhe sytë m'u errësuan aq sa për një çast m'u duk sikur do bija në fund të detit. Arianiti kishte marrë eshtrat e Shebës të futura në një thes dhe po i vendoste qetësisht në gropën e vogël. Unë shikoja detin poshtë këmbëve që vareshin në ajër dhe nuk e ktheja kokën. Kisha turp, si një njeri që përgjon një takim dashurie. Dëgjoja lëvizjen e duarve të Arianitit që pasi kalonin mbi trupin e Shebës, i ngrinin eshtrat, një nga një. Duart e tyre bashkoheshin si në një përqafim. Kur e mbuloi varrin e saj më thirri. Ishte i qetë dhe i heshtur si çdo njeri që vdes kur të dojë. Tani ik, më tha, dhe eja nesër të më mbulosh.

Unë i putha duart, por nuk ika. U fsheha në një nga shtëpitë e braktisura dhe fillova ta shihja. Arianiti qëndroi gjatë në buzë të greminës. Trupi i thatë i lëkundej nga era dhe unë mendova se do hidhej në det. Dikur lëvizi dhe eci nëpër pllajë sikur kërkonte diçka. Gjeti një gur të madh gjithë nyje, e këqyri nga të katër anët, e ngriti dhe e vuri mbi varrin e mbuluar të Shebës.

Pastaj mori një gur tjetër dhe e afroi te varri i tij. U mendua një copë herë duke parë detin. Një tufë dallëndyshesh kaluan mbi mal. Arianiti ngriti kokën dhe mua m'u duk sikur qeshi. Dallëndyshet u rrotulluan disa herë dhe pastaj u sulën në drejtim të detit duke u ndarë si copat e një pasqyre. Ai mori një gur të vogël me majë dhe filloi të shkruante diçka mbi gurin e Shebës. E mbaroi, i kaloi dorën sipër për t'i hequr pluhurin dhe shkroi diçka edhe mbi gurin e tij.

Kur ra muzgu, u ngrit në këmbë dhe qëndroi disa çaste pa lëvizur. M'u duk sikur po falej. Dielli ishte ulur shumë në perëndim dhe një hënë e pastër si një pjatë me qumësht po ngrihej mbi greminë. Arianiti eci në drejtim të varrit të vet dhe u shtri aty bashkë me diellin që u zhyt në det. Unë u rrëqetha. Doja të ulërija, por kisha frikë mos e ngrija nga varri. E dija që po të më dëgjonte do dilte që andej dhe do më qetësonte. Mund ta bëja, por nuk kisha guxim t'ia prishja vdekjen. Mbete gjithë natën në shtëpinë e braktisur. Që aty, deti shihej pjesërisht, ndërsa hëna e kuqe dukej si një mollë e kafshuar.

Kur zbardhi, prita sa dielli u ngrit plotësisht dhe u afrova me hapa të vegjël drejt gropës së Arianitit. Ai kishte kryqëzuar duart mbi gjoks, ndërsa sytë i kishte mbyllur. I vura dorën mbi ballë, por ai nuk lëvizi. Edhe nëse ishte gjallë nuk do t'i hapte sytë. Mora dhe me duar dhe ia hodha sipër me kujdes duke i mbuluar në fillim trupin dhe pastaj fytyrën. Ai nuk i lëvizi qepallat as kur dheu i kaloi mbi sy. Unë nuk qaja dot. Duhet ta mbaroja detyrën time deri në fund. Ai varrim kishte qenë i tmerrshëm, por Arianiti e kishte parashikuar deri në detaje dhe prandaj ishte i përsosur. Po të ishte gjallë në ato çaste, ndoshta tallej me mua kur ndiente dorën që më dridhej duke kaluar ngadalë mbi trupin e tij. Ndoshta thoshte me vete: Pse e mora me vete këtë frikacak? Pasi e mbuloja, ngrita gurin që ai kishte zgjedhur dhe që rrinte aty duke më pritur. Sipër tij shkruhej: 1770. Ishte viti që kishte zgjedhur Arianiti për të vdekur. Në varrin ngjitur me të kisha parë një numër të ngjashëm. I hodha një sy. Aty shkruhej: 1670. ishte viti i vdekjes së të vëllait dhe dhjetë burrave të tjerë që kishin vdekur njëqind vjet përpara në Kretë. Pranë varrit të Arianitit ishte varri i vogël i Shebës që dukej sikur kishte mbështetur kokën tek ai. Lexova atë që kishte shkruar: *ti më jep nxehtësi*. Dukej si një letër dashurie dhe unë e dija ç'do të thoshte. Ishte një varg i Safos që Sheba ia recitonte Arianitit kur dashuroheshin në Lesbos. Qëndrova dhe pak në majë të pllajës derisa dielli filloi të më digjte kurrizin.

Arrita në shtëpi pasdite. U shtriva në dhomë dhe fillova të qaja me vete. Marina më pyeste, por unë nuk dija si t'ia tregoja atë që kisha bërë në mal. Një muaj nuk dola nga shtëpia. Sytë e palëvizur të Arianitit me dilnin çdo çast përpara. Po sikur të ishte gjallë kur unë e mbuloja me dhe?

Isaku mbaroi dhe futi në gojë një lugë reçel. Ishte i qetë, megjithëse sytë i mbante në tokë sikur kishte frikë të shikonte Sarën. Ia kishte varrosur babanë, por nuk ia kishte vrrarë. Cili djalë apo nip nuk do ta kishte bërë atë që bëri ai? Në atë rast, detyrën dhe mëkatën i ndante një fill shumë i hollë si ai që kishte lidhur Arianiti te flokët, por pesha e detyrës ishte më e rëndë se pesha e mëkatit dhe ajo e kishte shtyrë Isakun të hapte varrin e gjyshit të gjallë me lopatë. Ai shkonte një herë në vit në mal dhe pastronte varrin duke fshirë me dorë pluhurin që ngjitej nga gremina dhe duke këputur barin që dilte mbi tokë si flokët e gjatë të Arianitit. Ai nuk besonte se i ngjante gjyshit dhe kur mbushi pesëdhjetë vjeç iu duk vetja i vjetër. Po të vdiste ai, varri i Arianit Komnenit do harrohej. Mendoi t'i bënte një pllakë të madhe guri dhe t'ia shkruante emrin sipër, siç bënin të gjithë me njerëzit e vdekur, por hoqi dorë.

Arianiti kishte zgjedhur të varrosej në majë të malit, jo rastësisht. Mund të varrosej me Shebën në çdo varrezë të Kretës dhe të rrinin aty sa të donin pranë qindra grekësh apo venecianësh që shekujt ia kishin caktuar si komshinj. Mes tyre mund të kishte të varfër, të pasur, të rinj, pleq, fëmijë, gra, marinarë, tregtarë, poetë, princa, luftëtarë apo tradhtarë. Këtë short e hidhte perëndia dhe të gjithë e pranonin. Por pikërisht këtë gjë nuk donte Arianiti. Perëndia nuk mund t'i caktonte ditën e vdekjes dhe aq më pak shokët e varrezës. Ai donte t'i zgjidhte të vdekurit me të cilët do të kalonte pjesën tjetër të jetës. Dhe i zgjodhi. Zgjodhi njëmbëdhjetë shqiptarët që mbetën në ishull duke mbrojtur krishterimin nga turqit. Koha dhe fati i kishin lënë ata anonimë dhe Arianiti ishte pajtuar me këtë harrim. Nuk kishte rrugë tjetër për të ndenjtur me ata burra në përjetësi. Ata e pranonin, por pa emër. Arianiti kishte marrë me vete Shebën dhe kishte lënë emrin. Harresa do ishte më e ëmbël dhe më e durueshme me Shebën aty afër. I kishte vënë vetes një numër njëqind vjet më të madh se numrin që kishin varret e atyre burrave, si për të thënë se lufta e tyre e përbashkët kishte zgjatur njëqind vjet.

Arianit Komneni donte që bota ta dinte këtë detaj të jetës së vet. Bora, që kalonte çdo ditë poshtë varrit të tij hipur në anijet që vinin dhe iknin në Kretë, dikur do ndalej aty, ndoshta kur turqit të iknin. Nuk ishte pak po t'i nderonin si njerëz që luftuan njëqind vjet si të ishin profetë sepse vetëm profetët bënin luftëra aq të gjata.

Ndërsa Isakun e kishte marrë atje lart për diçka tjetër. Kishte një njeri që ai duhej ta priste në ishull dhe t'i tregonte varrin. Bota mund ta harronte profetin, por ajo nuk mund ta harronte babanë. Kjo ishte Sara dhe ajo kishte ardhur.

Tani rrinte përballë tij me këmbët mbledhur dhe me faqet e skuqura siç e kishte parë për herë të fundit në oborrin e shtëpisë, duke pritur që Arianit Komneni dhe Ali Tepelena të ndanin fshatin me marrëveshje mes Krishterimit dhe Islamit. I mungonte vetëm gërsheti i zi që duhej ta kishte lënë në shtëpi.

Sara lëvizi dhe mori një lugë reçel. Duhej të ishte e hutuar sepse kishte marrë lugën e tij. Fytyra i ndriçohej nga dielli i fortë i drekës aq sa Isaku mezi e dallonte. E dija që do vdiste kështu, foli Sara me buzët e ngjitura me reçel. Isaku e pa me habi dhe iu duk se ajo kishte qenë në mendimet e tij. Babai nuk erdhi rastësisht në Kretë, vazhdoi Sara. Edhe sikur ti të mos vije në fshat nga Voskopoja, ai do të ikte një ditë për të varrosur veten dhe nënën në atë vend. Bashkë me Mihalin i kemi bashkuar me dhjetëra herë copat e katrorit të jetës së tij për të kuptuar magjinë e Arianit Komnenit. Kur babai iku nga fshati unë mbeta në mjegull. Ai nuk më tha ku do shkonte dhe unë nuk e dija nëse do isha e aftë ta gjeja se ku kishte shkuar. Në qoftë se një ditë do të më gjesh do të thotë se do të të duhem. Kaq më tha dhe iku. Unë u martova, linda një vajzë dhe babai u largua edhe më shumë nga unë. Kujtimi i tij filloi të dilte ngadalë nga jeta ime si një hije që del nga dhoma kur hyn dielli. Vajza, familja dhe fshati e mbushnin gjithë ditën dhe natën time. Por, pasi erdhi Mihali, filloi të kuptoj se kisha mbetur si një pemë, e cila ushqen gjethet e veta duke

harruar se ushqimi i vjen nga rrënjët. Mihali më fliste për babanë dhe mua m'u duk se në të vërtetë ai zë vinte nga rrënjët, duke më kujtuar se nga kishte ardhur në fshat trangu i pemës sime. Mihali më shtynte dhe unë ndihesha e pasigurt deri ditën që zbuluam katrorin magjik që ti dhe babai kishit vizatuar në kishë. E ndërtuam atë katror duke bashkuar të vërtetat e pjesshme që dinim dhe çdo gjë u bë e qartë. Ju ishit në Kretë dhe kishit ikur bashkë. Unë zbulova babanë, ndërsa Mihali zbuloi djalin.

Isaku lëvizi në karrigen ku rrinte. Për cilin katror flet, e pyeti Sarën duke e ndërprerë. Për katrorin magjik që kishte gdhendur babai në murin e kishës, tha Sara. Na e tregoi ustai që kishte thirrur babai për të ndërtuar kishën. E kam parë, tha Isaku. Një natë shkuam bashkë me Arianitin në kishë dhe ai ma tregoi duke e ndriçuar me qiri. Por aty nuk kishte katror. Kishte vetëm një fjalë, *Kreta*, që Arianiti e kishte shkruar me dorën e vet për të nderuar kujtimin e burrave të fshatit që vdiqën këtu. Ai më tha se kishën ia kishte dedikuar atyre burrave si një monument që fshati ua kishte borxh. Katror nuk kishte deri ditën kur ne ikëm dhe unë nuk kam shtuar asnjë presje në atë gur.

Sara ndjeu këmbët t'i ftohen kur kujtoi Metodin dhe Mihalin që mbushnin katrorët magjikë duke plotësuar njëri-tjetrin. Sa herë që bllokohej Metodi, leximin e fjalëve të padukshme e vazhdonte Mihali dhe anasjelltas. Metodi kishte zërthyer logjikën e numrave, ndërsa Mihali kishte gjetur enigmën e emrave të shkruar nga poshtë-lart dhe nga e djathta në të majtë. Në fund të fundit pse duhej që babai të vizatonte një katror misterioz duke i lënë fjalët bosh sikur donte ta torturonte? Ndërsa Isaku kishte thënë se ai kishte qëndruar i fshehur në bodrumin e shtëpisë dhe jo në kishë. Kishën e kishte parë vetëm një natë kur aty e kishte çuar Arianiti për t'ia treguar si një statujë nderi që e kishte ndërtuar me duart e tij.

Mihali dhe Metodi e kishin mbushur katrorin shpejt pavarësisht se, ndërsa ata flisnin, asaj i ishte dukur sikur po i kalonte gjithë jeta përpara. Ata ishin sjellë si dy magjistare që bënë të njëjtin numër në çdo qytet, përballë fëmijëve që ktheheshin në shtëpi dhe nuk i zinte gjumi nga magjia. Është e pamundur, tha Sara që dukej sikur foli me vete. Çfarë është e pamundur, e pyeti Isaku që nuk po e kuptonte. Sara u ngrit dhe shikoi nga dritarja. Mblodhi si në një shportë udhëtimi copat e kujtesës së saj, duke filluar me fjalët e Naumit, ecjen e shpejtë drejt kishës, pastaj dorën e dridhur të Mihal Komnenit mbi portik, merimangën që iu ngjiti atij pas mjekrës, pastaj katrorët e vegjël brenda katrorit të madh, fjalët dhe numrat që shkruante dhe fshinte Metodi mbi dërrasën e zezë dhe drita që vinte nga dritarja ia ndriçoi kokën si një diell. Filloi të qeshte me vete dhe u kthye nga Isaku që e shikonte i hutuar.

Katrorin e ka vizatuar Mihali me Metod Antrakidin, tha dhe qeshi me zë të lartë. Iu duk vetja e tallur nga ata dy pleq që me sa duket kishin ardhur në fshat për t'i mësuar asaj rrugën drejt babait. Por ajo nuk bindej dhe ata ishin sjellë me të si me çdo fëmijë tjetër. Kishin gjetur një lodër për ta joshur që ajo t'i ndiqte pas. Katrori ishte një lodër. Magjia e tij ishte e vërteta. Mihali dhe Metodi ia kishin thënë të vërtetën duke luajtur. Por kjo ishte një lojë e domosdoshme dhe Sara ndjeu që i donte të dy edhe më shumë. Po të ishin aty do t'i kishte puthur dhe syzet e Metodit me siguri do ishin mbushur me avull. Janë tallur me mua, i tha Isakut dhe filloi t'i tregonte katrorin me numrin trembëdhjetë që Mihali thoshte se e kishte ndërtuar ai. Sara fliste me pasion duke lëvizur duart mbi dritaren e hapur që dukej si një katror i mbushur me gjethe arre.

Isaku e dëgjoi deri në fund duke qeshur. Nuk mund të ishte ndryshe, tha kur Sara mbaroi. Metodi ishte matematicien dhe katrorët e tij në Voskopojë ishin të famshëm. Ai imitonte Pitagorën dhe i çonte grave katrorë magjikë të mbushur me fjalë dashurie që burat e tyre të mos i zbulonin dot. Kur isha i vogël, ai vinte në shtëpinë tonë dhe më mësonte katrorë me numra. Katrori me numrin trembëdhjetë është nga më të thjeshtët dhe besoj se ai dhe babai, nuk janë lodhur shumë për të

përshtatur *Kretën* me datat dhe emrat e familjes. Kur kanë parë se ti ishe e pavendosur janë menduar derisa kanë gjetur mënyrën për të të bindur. Kanë ndërtuar katrorin dhe pastaj e kanë gdhendur mbi portikun e kishës duke e futur fjalën që kishte shkruar Arianiti brenda tij dhe duke shtuar vetëm numrin 13. këtë gjë e kanë sajuar që të dukej si e vërtetë dhe kur ti ke ikur e hutuar, duke besuar se kishe zbuluar testamentin e babait tënd, me siguri kanë qeshur, por njëkohësisht janë çliruar si të kishin përmbushur një detyrë fisnike.

Megjithatë, Mihali e dinte ku ishim ne. Kur ikën nga fshati, ne ndaluam në Korçë natën duke u fshehur. Unë e dija që do ta gjenim aty dhe Arianiti i tha se do shkonim në Kretë. Atë natë unë fjeta dhe ata të dy folën gjatë. Ndoshta Arianiti i ka thënë se ai duhej të kthehej në fshat dhe të vigjilonte rritjen tënde. Ose, ndoshta, Mihali ka ardhur vetë duke besuar se kështu po çonte deri në fund dëshirën e babait. Në Voskopojë ai njihej për humorin e tij dhe nuk çuditëm që është sjellë kështu duke ta bërë jetën më të lehtë. Kur bënte shaka të rrezikshme merrte syzet e Metodit që të mos njihej, derisa gjakrat të zbuteshin.

Sara vuri buzën në gaz dhe u kujtua që për shkak të Mihalit, gratë e Voskopojës i quanin të dashurit e tyre Mektosyçka. Tani ndihej e çliruar. Reçeli ia kishte ëmbëlsuar gojën njësoj si Mihali jetën në fshat. Po të mos ishte Mihali ndoshta nuk do vinte kurrë këtu. Në Kretë kishte zbuluar katrorin e vërtetë. Arianit Komneni, Mihali, Isaku dhe Arianit Komneni i ri ishin brinjët e të njëjtit katror që qëndronin të bashkuara në një trup, si dy duar dhe dy këmbë. Ata ishin katër brinjët e një familjeje. I kishte njohur tre prej tyre dhe tani mbetej i katërti. Vështroi Isakun që rrinte i ulur me këmishën e bardhë si një kujtim nga Voskopoja. Sytë e tij jeshilë ishin çelur prapë dhe ndriçonin rrugën nga një brinjë e katrorit te tjetra.

Kur do më çosh te babai, e pyeti Sara. Kur të duash, u përgjigj Isaku. Por më parë duhet të takosh Marinën dhe Arianitin. Ata kanë kohë që të presin. Sara pohoi me kokë. Dielli ngrohte rrugën, ndërsa Kreta po kthehej nga porti. Njerëzit ktheheshin të ngarkuar dhe Sara mendoi se secili prej tyre kishte marrë një copë të botës dhe po e çonte në shtëpi. Ndërsa ajo, kur të kthehej, do merrte copat e humbura të familjes dhe do t'i çonte në fshat.

Kur ata dolën, Tereza ishte ulur tek arra e madhe. Dera e shtëpisë ishte e hapur dhe mbrëmja hyri brenda si një zonjë e veshur me të zeza. Isaku përqafoi Terezën dhe faqet iu ngjitën pas buzëve të saj me reçel. Ajo nxori një arrë nga përparësja me shumë xhepa dhe ia dha Sarës që e mbajti në dorë deri në shtëpinë e Isakut buzë detit.

Shtëpia kishte një verandë të madhe që Marina e kishte mbushur me lule. Në vjeshtë kur lulet thaheshin fletët e tyre binin mbi det dhe shkëlqenin si luspa peshku. Marina ishte e bukur siç kishte thënë Tereza. Sytë e saj ishin të kaltër, ndërsa vetullat e holla ngjanin si kurora gruri. Megjithëse ishte disa muaj më e madhe se Sara, buzët i kishte akoma të fryra dhe dukej sikur që andej rridhte qumështi. Unë nuk i kam më buzët kaq të freskëta, mendoi Sara kur era e qumështit i mbeti në faqen që puthi Marina. Ishte e gjatë dhe mbante një fund të shkurtër nga i cili dilnin dy këmbë të drejta me mish.

Ndërsa Arianit Komneni ishte një gjë tjetër dhe Sara mendoi se po të kishte qenë vajzë nuk do të ishte aq i bukur sepse në përgjithësi Komnenët i bënin djemtë më të bukur se vajzat. Flokët e zeza i kishte zgjatur deri te supet dhe shpatullat e gjera e mbulonin detin kur ai dilte në ballkon. Era që vinte nga deti i hynte në këmishë dhe gjoksi i tij i fryhej si një mushkëri delfini. Arianiti ngrihej çdo mëngjes dhe shkonte në det. Sara e shikonte nga ballkoni sesi zhdukej, pastaj duart e tij dilnin dhe kapeshin fort pas ujit duke e ngritur të gjithin lart. Unaza e Halil Patronës, që Arianiti ia kishte dhënë Isakut dhe ky Arianitit, dilte mbi ujë dhe hurma e saj shkëlqente si një guaskë prej dielli. Sara kishte parë peshkatarët që notonin në ishujt përreth anijes së Kretës, por

ajo që bënte Arianiti nuk ishte not. Babai i kishte thënë se të notosh do të thotë të puthësh detin dhe pikërisht këtë bënte Arianit Komneni. Deti pranonte që ai ta puthte dhe përkëdhelej duke u tundur dhe duke nxjerrë dallgët në breg. Isaku që rrinte në ballkon me Sarën, humbte duke ndjekur të birin me sy dhe i thoshte Sarës së mrekulluar: E ka mësuar notin para se të lindte. Sara kthente kokën dhe i dukej sikur zëri i Isakut vinte nga Voskopoja. Kur Arianiti dilte në breg, uji që i rridhte në trup pikonte mbi gurët e plazhit që shndrisnin si diamante. Ai hynte në shtëpi dhe Marina i jepte një peshqir, që dukej gjithmonë i vogël, për të tharë detin që ai sillte me vete. Në mbrëmje uleshin në karriget e verandës. Isaku pinte verë të bardhë, ndërsa Sara hante pjepër të verdhë që Marina e spërkaste me sheqer. Arianiti rrinte përballë tyre me fytyrën të kthyer nga deti. Herë pas here shikonte andej, sikur priste të kalonte diçka dhe i thoshte Isakut: Kur turqit të ikin nga ishulli, do kemi më shumë det për t'u larë dhe për të zënë peshq.

Isaku pinte pak verë nga gota e gjatë si këmbët e Marinës dhe i thoshte: Kështu mendoja edhe unë kur isha sa ty. Voskopoja më dukej si një ishull që do ta kisha të gjithin për vete kur të iknin turqit. Por turqit po rrinë shumë gjatë dhe nuk ka shenja se do ikin shpejt. Gjithandej njerëzit janë lodhur dhe i kanë pushuar luftërat, ndërsa luftëtarët janë rralluar. Shqiptarët, që nuk kanë më shpresë, po bëhen myslimanë, ndërsa grekët jetojnë duke u shitur turqve peshk. Kam frikë se turqit nuk do ikin më kurrë sepse tani ne i kemi brenda vetes tonë. Ata na e kanë futur Islamin në krevat, në shtëpi dhe në shpirt. Si mund të ndahet Sara nga e bija që është vajza e një myslimani, apo babai im nga i vëllai që u bë mysliman për t'u hakmarrë ndaj babait të vet? Jemi shumë vonë për t'u ndarë. Ata na kanë futur një kafshë të panjohur brenda në trup dhe ne nuk mund ta vrasim dot sepse kështu plagosim veten. Jemi të detyruar të gjejmë paqe me trupin që të shpëtojmë shpirtin. E në qoftë se duam të jetojmë në paqe duhet ta zbusim egërsinë e kafshës duke e ushqyer me mishin e shpirtit tonë prej Krishti.

Isaku pushonte dhe vera e bardhë ia qetësonte gojën. Marina afronte pjepër me sheqer për të ëmbëlsuar kujtimet por Arianiti nuk tërhiqej.

Voskopoja nuk kishte det si Kreta dhe prandaj nuk shpëtoi, i thoshte të atit. Turqit nuk kishin nga të iknin dhe u bënë një me shqiptarët dhe sot nuk e di çfarë race jeton aty.

Isaku skuqej dhe damari i Marin Kurilës i dilte në qafë dhe ir rrotullohej si një shall i kuq. Voskopoja nuk kishte det, por kishte libra, thoshte Isaku. Deti nuk e ka forcën e librit. Libri mbetet ndërsa deti ikën. Deti është i të gjithëve, ndërsa libri është i më të diturve, që zakonisht janë dhe më të fortët. Ne e kishim rrethuar Voskopojen me një ushtri librash dhe besonim se ajo ushtri do t'i mundte të paditurit, jo duke i vrarë, por duke i bërë të ditur. Në Kretë njerëzit janë të egër. Ata lindin dhe plaken duke menduar ditën kur do t'i hedhin turqit në det, pasi t'i kenë therur si bagëti. Ndërsa në Voskopoje ne mendonim se si do t'i mësonim myslimanët të jetonin si ne.

E di që ka shumë njerëz që thonë se, në qoftë se unë do kisha zgjedhur luftën para paqes, Voskopoja do shpëtonte. Nuk do pendohem derisa të vdes dhe sikur të kem njëqind jetë do bëj prapë të njëjtën gjë. Voskopoja nuk do shpëtonte siç nuk shpëton një libër që bie në fund të detit. Por turqit nuk janë një dimër i përjetshëm dhe ia vlen të durosh duke përsosur artin e të jetuarit në ishull. Kur ata të ikin ne do ta shkruajmë prapë librin që na humbi, por aty do të ketë edhe disa faqe për turqit që nuk do vdesin më kurrë në kujtesën tonë.

Marina e priste pjeprin në copa të vogla që dukeshin si ishuj në pjatë. Sara shikonte qiellin me yje dhe mendonte për Ana Komnenën. Ajo duhet të ishte akoma në oborrin e shtëpisë duke numëruar të njëjtët yje. Hana qepte rroba fëmijësh, ndërsa Muhamedi me siguri po maste me pëllëmbë rritjen e minares. Xhamia dhe kisha rrinin përballë si një trup dhe një shpirt. Rruga e fshatit kalonte midis tyre. Sa herë që njerëzit faleshin, ato merrnin frymë si dy deve me qafa të



zgjatura mbi shkretëtirë. Disa faleshin duke u kthyer nga perëndimi, të tjerët nga lindja dhe devetë nuk mërzhiteshin. Ato do bënin çdo gjë që të mbeteshin në shkretëtirë, sepse askund tjetër nuk mund të jetonin. Duke përcjellë në shtëpi ndonjë vajzë nga fshati, Paridi kalonte aty çdo natë, pa e pasur mendjen. Ana Komnena rrinte në oborr duke pritur Sarën. Kur të lodhej do ulej në stolin e Ibrahimit dhe kur të vinte Muhamedi do ta pyeste për lartësinë e xhamisë, ndërsa Hana do bënte kryqin mbi barkun që nuk i rritej.

Në Kretë, anijet po kalonin mbi ballkonin e shtëpisë dhe pjeprat e prerë e kishin thithur sheqerin si sfungjer. Marina ishte e lodhur dhe nuk do ngrihej më t'i spërkaste pjeprat. Isaku e kishte mbaruar verën e bardhë, ndërsa Arianit Komneni ishte ngritur në këmbë dhe kontrollonte detin sikur priste një sinjal. Përballë tyre, brigjet e Azisë ndizeshin si flakë dhe ai i mbyllte sytë që i digjinin. Kur Sara shkonte në dhomë dëgjonte Marinën që i thoshte Isakut: Pse i the djalit që turqit nuk do ikin. Ti e di që ai mërzhitet. Isaku lëvizte nëpër dhomë duke parë Azinë nga dritarja, siç bënte në Voskopojë kur filluan zjarret e mëdha dhe thoshte: Është akoma i ri dhe nuk ka hyrë në moshën kur burrat fillojnë të mërzhiten. Sara shtrihej dhe duke menduar për Ana Komnenën e zinte gjumi. Nata e saj në Kretë kalonte shpejt sepse ëndrrat ishin të gjata. Ajo shkonte në breg duke ecur me hapa të vegjël dhe futej në ujë. Në fillim, deti i arrinte deri te gjunjët pastaj ngrihej mbi kraharor derisa i prekte mjekrën. Pas saj vinte Isaku me këmishën e bardhë që i ngjitej pas trupit. Sara hapte krahët sikur po fluturonte dhe kur binte ndiente dorën e madhe të Isakut që e mbante mbi ujë, si një varkë. Në breg, Arianit Komneni qeshte dhe thoshte: Lëre të notojë vetë se tani është rritur. Sara habitej që babai i kishte thënë Isakut ta linte vetëm në mes të detit dhe dilte me vrap në breg duke përplasur këmbët pas dallgëve si një fëmijë i llastuar. Por, kur afrohej, kuptonte se babai nuk ishte aty dhe ai që kishte folur ishte Arianit Komneni i ri që zhdukej si dallgë, në drejtim të anijeve. Atëherë asaj i dilte gjumi, por mëngjesi nuk kishte ardhur ende.

Sara doli në verandë dhe priti Isakun. Kur ai u ngrit nga gjumi, ajo i tha: Pashë babanë në ëndërr, po na pret. Isaku veshi këmishën e bardhë dhe pantallonat e zeza, ndërsa Sara mori arkën e vogël që e mbante poshtë krevatit dhe u nisën.

Deti ishte i qetë sepse qielli ishte i qetë. Rruga për në mal dukej si një litar që i mbante bashkë. Po të pritej ai litar, bota do ishte një shtëpi pa tavan dhe pa themel.

Isaku ngjitej përpara dhe Sara e ndiqte. Poshtë tyre, Kreta peshkonte në det.

Ishte një ditë e nxehtë dhe njerëzve nuk u hahej peshk. Megjithatë, peshkatarët dilnin në det sepse nuk mund të bënin ndryshe. Ata jetonin për të peshkuar dhe peshkonin për të jetuar. Ata që nuk peshkonin, laheshin, sepse në ishull të gjithë dinin not. Sara kaloi arkën e vogël në dorën tjetër. Arka tundej nga lindja në perëndim dhe peshonte, megjithëse ishte bosh.

Mali ishte i mbushur me pupla dallëndyshesh dhe Sarës iu duk sikur po shkonin në vendin ku Dedali mblodhi puplat për krahët e të birit. Kur u afruan te pllaja, Isaku ndaloi. Nga humnera vinte një erë e lehtë që fishkëllente si muzikë meshe. Një tufë dallëndyshesh që kishin ndaluar aty kërcyen dhe zbritën në det duke i lënë vetëm. Ajo eci me hapa të vegjël në drejtim të varreve. Prindërit ishin aty, të rrethuar me bar. Sara u ul në gjunjë dhe fshiu pluhurin mbi fytyrat e tyre prej guri. E kishte marrë malli për babanë, ndërsa nënën nuk e kishte parë kurrë kaq afër. Pa shkrimin e babait mbi trupin e nënës dhe ndjeu një nxehtësi që i vinte nga sytë. Kishte ardhur t'i fuste të dy në arkën e vogël, por katër numrat mbi varrin e babait dukej sikur i thoshin të kundërtën. Jo pa qëllim, mbi varrin e tij, ai kishte shkruar një datë që lidhej, si qielli me detin, me një datë tjetër. Po të mos ishin katër numrat mbi barin anonim, lufta e Kretës nuk do kishte fillim, sepse nuk ka lindje pa një datë. Por po të mos ishin katër numrat mbi varrin e babait lufta

nuk do kishte fund sepse nuk ka mbarim pa një datë. Midis atyre dy datave shtrihej Arianit Komneni. Ai kishte vdekur duke besuar se lufta me turqit do kishte një fund, siç kishte pasur një fillim.

Sara lëvizi mbi gjunjë dhe pastroi pluhurin e kohës edhe nga varret e tjerë. Luftëtarët nga fshati kishin qenë njëmbëdhjetë dhe bashkë me nënën dhe babanë bëheshin trembëdhjetë. Ajo ndjeu Isakun që merrte frymë pas kurrizit të saj dhe iu kujtua trembëdhjeta e katrorit magjik. Sekretin e atij numri ishte aty. Ndoshta, nga poshtë tokës, babai e shikonte dhe qeshte si një Krisht i lumtur, i rrethuar nga dymbëdhjetë apostujt e tij. Po ta merrte në fshat do duhej ta ndante nga ata. Ajo do rrinte me babanë, por apostujt do mbeteshin pa Krishtin e tyre, si luftëtarë pa një prijës. Ktheu kokën nga Isaku dhe e pa gjatë në sy. Ai shkuli një tufë me bar mbi varrin e Arianit Komnenit dhe e hodhi në humnerë. Fijet e bari u shpërndanë në ajër dhe Sarës iu duk sikur ato ishin trembëdhjetë. Ajo ishte mësuar të numëronte dallëndyshet që fluturonin, por jo fijet e barit që binin në det. Qëndroi edhe pak e ulur në gjunjë, pastaj mori arkën e vogël dhe shkoi në buzë të humnerës. Isaku e pa dhe fytyra i shkëlqeu. Sara zgjati dorën mbi humnerë dhe kur e lëshoi arkën u ndie më e lehtë, si një njeri që ka humbur një peshë të tepërt. Arka u rrotullua disa herë në ajër sikur ishte çliruar nga një dorë që e kishte mbajtur njëqind vjet me vete.

Sara mori frymë thellë dhe pa horizontin që lidhte lindjen me perëndimin. Zjarret në brigjet e Azisë turke iu dukën më të vogla, sikur po shuheshin. U kthye nga ana tjetër dhe pa një varkë të vogël që kishte ndaluar në mes të detit. Në atë drejtim ishte perëndimi dhe fshati. Kur të kthehej në fshat, Ana Komnena do qeshte kur t'i thoshte se e kishte humbur arkën e vogël. Po ta pyeste, Sara do t'i thoshte se e kishte humbur ngaqë nuk i duhej. Por Ana Komnena nuk do ta pyeste.

FUND

BEN BLUSHI

## Të jetosh në ishull

roman



BOTIMET TOENA  
[www.albemigrant.com](http://www.albemigrant.com)

1

Ishte një ditë e nxehtë dhe njerëzve nuk u hahej mish. Pazari ishte zgjuar i pari dhe pas tij ishte zgjuar qyteti. Zakonisht, qyteti lodhej në pazar dhe çlodhej në kishë. Por ishte e diel dhe jo të gjithë punonin. Ishte një ditë pazar dhe jo të gjithë shkonin në kishë. Fshatarët kishin ditën e tyre të punës. Qytetarët kishin ditën e kishës dhe të pazarit. Gratë dilnin nga mesha e mëngjesit, shkonin në pazar, ku i frynin trastat si gjinj, dhe pastaj ktheheshin në shtëpi. Kur ato vonoheshin pas gjërave të panevojshme, fëmijët i prisnin me gojë hapur. Burrat pinin duhan në hije dhe shikonin gratë. Kafshët rrinin në diell dhe, duke pritur të shiteshin, shikonin burrat. Ata që kishin vapë freskoheshin në liqen. Por qyteti ishte në mes të maleve dhe jo të gjithë dinin not.

Deri kur u mbyll pazari ai nuk i shiti dot dy delet e tij. Mblodhi paratë që kishte fituar dhe u nis. Xhamia ishte në të dalë të qytetit. Në dimër ajo rrugë ishte e pushtuar nga balta, por atë ditë bënte zheg dhe toka digjte mbi kokë dhe nën këmbë. Dera e xhamisë ishte e mbyllur. Ai trokiti me një gur mbi portën e vogël. Imami u shfaq pas pak duke lidhur tyrben mbi kokën e rruar. Alekum Selam. Mirëdita, i tha ai. Dua të bëhem mysliman. Urdhëro, e ftoi imami. Je i pari që vjen sot. Të krishterët merren me tregti të dielave. U fut brenda dhe pati ftohtë. U ulën të dy përballë njëri-tjetrit mbi një rrogoz, i cili në anën e tij dukej më pak i përdorur. Xhamia ishte bosh. Dielli hynte me zor nga katër kamare të vogla, të shpërndara nga një në çdo faqe muri. Në

një cep të errët mezi dukej një tenxhere e madhe dhe pranë saj bukë dhe disa kokrra ullinj. Je në shtëpinë e Zotit, i tha imami, si për t'i thënë mos u habit. A ha Zoti ullinj, qeshi ai duke u përpjekur ta ngrohte xhaminë me shaka. Imamit nuk i lëvizi asnjë muskul. Ullinj të i ha unë. Doktorët thonë se bëjnë mirë për veshkat.

Pse do të vish në Islam, e pyeti thatë imami, pa e lënë të vazhdonte udhëtimin e tij nëpër muret bosh të xhamisë. Aliu iu përgjigj se nuk kishte ndonjë shkak, por mendonte se Islami është një gjë që duhet provuar. Unë fitoj sa për t'u ushqyer, nisi të shpjegonte. Nuk kam ndonjë arsye të veçantë. Islami është feja e Perandorisë dhe unë e respektoj si një shtetas i rregullt. Nga Islami vijne ligjet, taksat, ushtria dhe drejtësia. E këto nuk mund t'i zbatosh si duhet po nuk njohe burimin e tyre të vërtetë. Shpejt ose vonë, të gjithë do të bëhen myslimanë. Babai më ka thënë që punën e sotme mos e lër për nesër. Unë zgjohem herët në mëngjes, si kafshët që shes dhe shëroj, prandaj nuk e kam vështirë të falem në oraret që përcakton feja juaj. Njoh shumë të tjerë që do të ishin bërë myslimanë në qoftë se do të kishin regjimin e bagëtive.

Sa vjeç je? Tridhjetë e nëntë i mbusha në korrik. Ka myslimanë të tjerë në fshatin tënd? Jo, tha ai, unë do të jem i pari. Njeh ndonjë mysliman tjetër? Kroi kokën dhe u kujtua. Njoh Ali Tepelenën. Ç'është ky, tha imami. Aliu është kusar. I zë pritë karvanëve dhe grabit ushqime, mallra dhe kafshë, që pastaj i shet. Kohët e fundit ka marrë një titull nga Stambolli dhe trimat e tij e thërrasin dervexhi. Tani kontrollon rrugët dhe grykat nga kalojnë karvanët dhe i ka bërë zap gjithë kusarët e tjerë. Askush nuk vjedh dot pa lejen e tij. Para disa muajsh u fsheh në shtëpinë time se e ndiqnin ushtarët e Kurt Pashës për ta vlarë. Kuajt i sjell tek unë për t'i shëruar dhe prandaj jemi njohur. A të ka folur Aliu për Islamin? Po. Njëherë ai më tha se sikur Muhamedi të ishte shqiptar, grekët do ta kishin vlarë atë. Imami nuk lëvizi, por diçka mërmëriti. Në qoftë se Muhamedi do të ishte shqiptar, grekët do të ishin çifutë dhe çifutët nuk e vranë dot Muhamedin. Megjithatë, Muhamedi nuk mund të ishte shqiptar. Të gjithë profetët kanë lindur në shkretëtirë aty ku nuk ka ujë dhe nuk ka dimër. Ne kemi shumë ujë dhe shumë dimër.

Imami futi dorën poshtë rrogosit dhe nxori një libër të verdhë me shkronja të mëdha arabe. Ky është Kurani. Është libri me porosi që Allahu i dha Muhamedit përmes të dërguarit të tij, engjëllit Xhebrail. Këtu tregohet se çfarë duhet të bëjë një mysliman. Dhe po ashtu se çfarë nuk duhet të bëjë. Mos harro se gjërat që nuk duhet të bësh, janë më të rëndësishme se ato që duhet të bësh. Kurani është libri i ndalimit dhe jo i lejimit. Ti nuk mund ta lexosh Kuratin, por unë do të të them disa gjëra, të cilat, nëse i pranon, do të të dallojnë ty nga të tjerët, nga të pafetë.

Islam do të thotë paqe. Paqja mund të mbretërojë mes njerëzve nëse ata i dedikohen Allahut dhe ndjekin rregullat që ai ka përcaktuar. Këto rregulla Zoti ia tha Muhamedit që ky t'ia thoshte njerëzve. Muhamedi shkroi Kuratin, megjithëse deri 40 vjeç nuk dinte as shkrim, as këndim, njësoj si ti sot. Kjo është një nga dëshmitë se ai ishte i dërguar i Allahut, porositi e të cilit për herë të parë i erdhën rreth vitit 610 kur ai jetonte në Mekë, me gruan e tij Hatixhe. Gjatë jetës së tij Muhamedi pati shumë gra të tjera. Kur ai vdiq, në prehrin e gruas së tij më të dashur Aishes, Meka, Medina dhe shumica e Arabisë kishin pranuar Islamin. Kurani i ka njohur të gjithë profetët e tjerë përpara Muhamedit, përfshi Musain, profetin e çifutëve dhe Isain e të krishterëve. Por Muhamedi është profeti i fundit. Prandaj dhe Islami është feja e vetme e Allahut. Qëllimi i profetëve të tjerë ka qenë të paralajmëronin dhe të bënin gati botën për misionin e Muhamedit, kështu që të krishterët e kanë detyrim që të kthejnë fenë e tyre në Islam. Jezu Krishti po të ishte gjallë do t'i bashkohej fesë së Muhamedit.

Imami ndaloi dhe e futi Kuratin nën rrogos. Këto që po them duhet t'i dish sepse të krishterët e fshatit do të të prozvalin dhe do përpiqen të të poshtërojnë kur t'u thuash se je mysliman. Mos u

mërzit. Të gjithë profetët janë sharë nga fshati i vet. Ti më the se do të bëhesh mysliman. Unë të pyeta pse. Më the se Islami është një gjë që duhet provuar sepse herët apo vonë të gjithë do të vijnë në Islam. Kjo është e vërtetë. Një ditë, të gjithë do të bëhen myslimanë. Por jo për arsyet që the ti. Unë do të t'i jap arsyet, ti do t'i jetosh dhe më pas do t'ia japësh të tjerëve.

Islami ka pesë kushte. Nëse ti i pranon, atëherë je mysliman. I pranoj, tha ai me një frymë. Ishte ftohtë dhe drita e diellit nga kamaret e xhamisë kishte nisur të dobësohej. Duro, i tha imami. Do të t'i them një nga një. Ngrihu në këmbë.

Ai u ngrit dhe pas tij u ngrit dhe imami. Gjysma e fytyrës i ndriçohej akoma nga drita e pasdites. Gjysma tjetër po kridhej gradualisht në errësirë. Islami dhe Krishterimi janë si hëna dhe dielli, mendoi ai. Të dyja kanë marrë përsipër të ndriçojnë botën, por kur njëri ikën vjen dita dhe kur ikën tjetri vjen nata. Tani jam në muzg. Dielli me hënën po ndërrojnë vendet si Krishterimi me Islamin në shpirtin tim. Deri në fund të jetës do të përpiqem të kuptoj kush është dielli dhe kush është hëna nga të dy, u zotua ai me vete dhe u përqendrua prapë tek imami, fytyra e të cilit kishte hyrë në hije.

A pranon se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i tij?

Bota është më e qetë tani që e udhëheq vetëm një Zot. Në kohën e grekëve të lashtë kishte shumë zota që bëheshin xhelozë për njëri-tjetrin dhe bota ishte lëmsh. E pranoj, tha ai.

A pranon t'i falesh Allahut, pesë herë në ditë namaz? E pranoj, por ç'më ndodh nëse falem gjashtë herë? Nuk të ndodh gjë, i tha imami, por nuk duhet ta bësh. Në fillim Zoti i tha Muhamedit se myslimanët duhet të faleshin pesëdhjetë herë në ditë, por Musai, profeti i çifutëve i tha Muhamedit t'i kërkonte më pak falje sepse kjo do të ishte e lodhshme për besimtarët. Pas shumë kërkesave që bëri Muhamedi, numri i faljeve u vendos të ishte pesë. Kjo në saje të çifutëve që bëjnë tregti edhe me faljet për Zotin. Ka pasur të drejtë Musai, i tha ai. Pesëdhjetë herë në ditë do të thotë që mos bënim asgjë tjetër, por veç të faleshim. Allahu na i njeh dobësitë tona, prandaj korrigjon ndëshkimet, sqaroi imami dhe vazhdoi.

A pranon të mbash ramazan? Ç'është ramazani, pyeti ai. Ramazani është muaji i nëntë i vitit. Është muaji kur Muhamedit iu shfaq për herë të parë engjëlli me porositë e Allahut. Ky është dhe muaji i agjërimit, muaji kur myslimanët i dedikohen Zotit të tyre, duke mos ngrënë, duke mos pirë dhe duke mos i prekur me dorë gratë e tyre. Ramazani përbën agjërimit kryesor, ndërsa gjatë vitit Islami ka edhe shumë lloje të tjera agjërimesh, si agjërimi i muajit të shabanit, agjërimi i gjashtë ditëve të muajit sherval, që është muaji që vjen pas ramazanit, agjërimi i ditës së ashures, agjërimi i xhumasë, i ditës së premtë etj. këto do t'i mësosh me kohë dhe unë do të të kujtoj herë pas here, por mos harro se agjërimi i ramazanit është kusht për ty si për çdo mysliman tjetër. Gjatë ramazanit as duhet të shash, as të bërtasësh, as të zihesh, as të shpifësh apo të theshmosësh. Nëse të godasin, mos u kthe dorë dhe thuaju se je në agjërimit. Agjërimit është shkëputja e njeriut nga kërkesat e trupit, nga stomaku dhe epshet që ndjellin gratë. Ramazanin do ta nisësh pas disa ditësh, sapo të shikosh hënën e re të muajit shtator. Po në qoftë se ka re si ta dalloj hënën, pyeti ai. Asnjë re nuk mund të ndalojë takimin e një myslimani me Zotin e vet, u përgjigj imami. Të krishterët hanë diçka kur agjërojnë, pyeti prapë ai. Si mund të duroj një muaj pa ngrënë? Të krishterët agjërojnë 40 ditë rresht përpara Pashkës dhe po ashtu gjatë vitit kanë agjërime të tjera. Megjithatë, ti mund të hash dy herë në ditë. Do hash diçka të ëmbël, mundësisht hurma me ujë kur perëndon dielli, dhe ky është iftari. Pastaj do falësh namazin e mbrëmjes. Ndërsa në mëngjes, kur fillon agimi, gjithnjë përpara namazit të parë, mund të fusësh një kafshatë në gojë dhe ky është syfyri. Agjërimit është sakrifica më e madhe që një mysliman bën për të respektuar Zotin e vet. Kur agjëron, ti i thua Allahut se nuk ke ardhur në jetë vetëm për të mbushur stomakun tënd me mish kafshe dhe për të fryrë barkun e sat shoqeje me mish

njeriu. Po lopët, viçat, delet dhe qengjat e mi a duhet t'i detyroj të mbajnë ramazan, tha ai pafajësisht. Imami bëri një ngërdheshje si i bezdisur e megjithatë vazhdoi. Agjërimi është një sakrificë e ndërgjegjshme. Ty nuk të kontrollon kush nëse ha, nëse pi apo nëse kënaq gruan tënde. Gjatë agjërimit je përballë Zotit dhe ndërgjegjes tënde. Kafsha ka shpirt, por nuk ka ndërgjegje, prandaj vetësakrificimi i saj nuk parashikohet në Kuran. As Muhamedi nuk e detyronte devenë e tij, Kasun që të agjëronte. Kafshët e tua nuk do të bëhen myslimane sepse edhe para kësaj dite nuk janë të krishtera, shtoi imami. E pranoj, tha ai. E pranoj ramazanin. Kur t'i them gruas se është një kusht ajo do të më kuptojë, kurse kafshët e mia nuk do kuptojnë asgjë dhe do vazhdojnë të më duan njëlloj. Vazhdojmë, nxitoi imami duke parë diellin që fshihej pas dritareve. Pas pak duhet të jap ezanin.

Kushti i katërt i islamit është dhënia e zekatit. Zekat do të thotë që t'u japësh të varfërve ushqim, rroba dhe t'i ndihmosh. Zekati nuk është lëmoshë, por është ndarje pasurie. Muhamedi mendonte se i varfri ka të drejtë të përfitojë nga pasuria e të kamurit. Zakonisht zekati shpërndahet pas sakrificës, pas agjërimit, pra në fund të ramazanit. Mund të japësh edhe para. Ai u mendua një copë herë dhe tha: Në fshat ka shumë të varfër. Nëse unë u jap të gjithëve zekat ç'më mbetet për vete? Ramazani më duket më i arsyeshëm se të detyron të kursesh, kurse zekati paska shumë harxhe. Po a nuk do varfërohesh unë një ditë duke i falur vazhdimisht të tjerëve pjesë nga pasuria ime? Atëherë ti do të jetosh duke u ushqyer nga zekati që do të shpërndajnë të tjerët, u përgjigj imami. Ky është Islami. Jep pasuri që të marrësh paqe. A e pranon këtë kusht? Imami po humbte durimin. Atij iu duk se, sikur të rezistonte dhe pak imami do ta nxirrte jashtë duke mos e përzgjedhur si mysliman. Megjithatë, vendosi të bëjë edhe një përpjekje. Përmbushja e këtij kushti, siç ia kishte përshkruar imami, nuk e bindte. Si mund të falte nga një dele, apo një viç në fund të çdo agjërimi? Ti më the se që të bëhem mysliman duhet të plotësoj kushtet e Islamit, guxoi ai të pyeste imamin. Po, i tha imami, ashtu është. Që unë të bëhem mysliman duhet të jap zekat, apo jo? po, tha imami i çuditur nga ngulmimi. Po ai që përfiton zekat a duhet të jetë mysliman? Besoj se po, u përgjigj imami i hutuar. Në fshat unë jam myslimani i vetëm dhe nuk e di sa kohë do të vazhdojë të jetë kështu. Të gjithë të varfrit e fshatit janë të krishterë. A duhet t'i fal pasurinë që Allahu ma dha mua atyre që nuk i falen Allahut? Imami nuk foli, pro instinktivisht vuri dorën mbi Kuranin e mbuluar me rrogoz. A duhet të përfitojnë zekat të krishterët, këtë dua të them, përfundoi ai kur kuptoi se kishte fituar superioritet logjik që në ditën e parë të abetares islame. Këtë nuk e di, i tha imami që u ndie keq. Ndoshta duhet të presësh derisa në fshat të vijnë myslimanët e tjerë. E pranoj, shpejtoi ai. Pranoj se do filloj të jap zekat ditën që në fshat një i varfër do të bëhet mysliman. E pranoj kushtin. Ka akoma? Edhe një, u çlirua imami.

Duhet të shkosh të paktën një herë në jetë në Mekë dhe të rrotullohesh shtatë herë rreth gurit të Qabesë. Sa larg është Meka, pyeti ai. Meka është në Arabi, tha imami. Ky udhëtim zgjat një muaj, duke kaluar nëpër Stamboll. Çdo mysliman duhet të shkojë një herë atje, në Gurin e Qabesë, që është vend i shenjtë për myslimanët. Ai gur është adhuruar që në kohët e lashta, por Muhamedi e ktheu atë në kërthizën e botës islame. Muhamedi u përzu nga Meka prej çifutëve dhe arabëve paganë dhe atij iu deshën disa luftëra, në të cilat u derdh gjak myslimani, për t'u rikthyer në mekë me kokë të rruar siç duhet të bësh edhe ti kur të shkosh. Kur duhet të nisem? Këtë e vendos ti, tha imami. Para se të vdesësh duhet të shkosh. E pranoj, u qetësua ai. Paskam edhe tridhjetë vjet kohë për të shkuar.

Pas kushtit të pestë ndihej më i sigurt. Xhamia ishte pothuajse e errët dhe jashtë zhurmat e qytetit ishin dobësuar. Ai i kishte pranuar të pesë kushtet dhe po priste që imami ta shpallte vendimin e tij. Ka dhe diçka tjetër, u kujtua imami. Çfarë, u acarua ai. Më the se ishin pesë kushte për t'u

bërë mysliman dhe unë i pranova. Imami dukej i lehtësuar, si një mami. Sot është dita e parë e lindjes së një myslimani dhe ti duhet të kesh një emër që mund ta zgjedhësh vetë. Nuk ka rëndësi, tha ai. Më thirr si të duash ti imam. Ibrahim, tha imami. Do quhesh Ibrahim. Ibrahim nuk ka qenë as i krishterë, as çifut dhe as mysliman. Ai është një nga profetët e mëdhenj që Zoti i mësoi të parashikonte të ardhmen. Në kohën e Ibrahimit, njerëzit jetonin më shumë se sot. Ibrahim rrjedh nga fara e Noes dhe ky rrjedh nga Ademi, që ishte njeriu i parë që Zoti krijoi mbi dhe nga dheu. Nga një brinjë e Ademit Zoti krijoi Havane që është gruaja e parë në këtë botë. Ademi dhe Havaja patën në fillim dy djem Kainin dhe Abelin. Kaini e vrau Abelin dhe kjo është vrasja e parë e njeriut nga njeriu. Më vonë pema e Kainit u shua nga mëkati i tmerrshëm i vëllavrasjes. Ademi dhe Havaja patën një djalë të tretë Sethin, nga trangu i të cilit buron gjithë njerëzimi. Ibrahim është degë e këtij trangu. Nga fara e Ibrahimit rrjedhin myslimanët, çifutët dhe të krishterët. Kurani thotë se Ibrahim pati një fëmijë me skllaven e tij Hagar dhe ky fëmijë u quajt Ismail, që do të thotë i egër dhe fortë. Mirëpo gruaja e tij Sara, që më vonë lindi Isakun, që i dha farë Moisit të çifutëve dhe Jezuit të kaurëve, e zoi skllaven me gjithë Ismailin dhe këta jetuan në shkretëtirë. Ismaili u rrit si njeri i egër në mes të rërës dhe urisë. Dikur, Ibrahim shkoi në shkretëtirë, takoi të birin dhe të dy ngritën Gurin e Qabesë ku u themelua Meka, vendi ku lindi Muhamedi. Sot, ne myslimanët jemi pasues të kësaj fare. Historinë e Ibrahimit e njohin edhe të krishterët nga Bibla. Ata i thonë Ademit, Adam, Havasë, Eva dhe Ibrahimit, Abraham. Më pëlqen, tha ai. Bukur, tha imami. Mirë se erdhe në islam, Ibrahim i Abdullahut. Çfarë është Abdullahu, u nxi ai. Pranova emrin tim të ri, por im atë ka vdekur dhe unë nuk mund t'ia ndërroj emrin pas vdekjes, ndjesë pastë. Abdullah do të thotë rob i Zotit dhe ky mbiemër i jepet gjithë myslimanëve të rinj si ti, baballarët e të cilëve kanë mbiemra të krishterë që Islami nuk i pranon. Jo, tha Ibrahim duke e parë imamin në sy. Pranova emrin tim të ri, por mbiemrin nuk e ndërroj. Abdullah duket si budalla dhe nuk mund t'ia lë peshqesh këtë tallje fëmijëve të mi. Nuk e pranoj sikur ta di se kthehem i krishterë siç isha sot në mëngjes. Imami buzëqeshi, por nuk këmbënguli. Iu afrua dhe e puthi në të dy faqet. Paqja qoftë me ty Ibrahim. Shpresoj të jesh një mysliman i mirë. Do përpiqem, tha Ibrahim dhe u drejtua nga dera e xhamisë. Pa kapërcyer pragun, imami e thirri nga errësira: Ibrahim, ti mund të marrësh deri në katër gra sepse kjo i lejohet çdo myslimani. Është një kusht, pyeti Ibrahim pa u kthyer. Nuk është kusht, por në qoftë se ty të pëlqejnë gratë Islami ta lejon. Do mendohem, tha Ibrahim duke dalë. Natën e mirë imam. Mirupafshim, tha imami. Mos harro të bëhesh synet Ibrahim. Kishte dalë nga xhamia. Nata ishte e gjitha përpara tij.

2

Ibrahimi arriti në të gdhirë në fshat. Gruaja flinte dhe ai nuk e zgjoi. Pranë vatrës gjeti darkën që ajo i kishte lënë gati. Mishi ishte akoma i ngrohtë. E zbrazti shpejt kusinë dhe doli jashtë të pinte ujë pusi. Agimi ishte i freskët. Ngriti kokën lart dhe hëna iu duk si një sy deleje i mbyllur. Pasi piu ujë hoqi këmbishën dhe lau sqetullat e barkun. Pastaj zbathi opingat dhe fërkoj këmbët me ujë. Bagëtia ishte zgjuar dhe delet lëvizën nën zhurmën e ujit që derdhej. Ai u afrua te vatha dhe ato u gjallëruan. Një shqerrë ende e përgjumur ishte ulur në gjuhë me kokën përmbys dhe atij iu duk sikur po falej. Iu kujtua imami dhe pesë porositë e tij. Ishte dita e tij e parë si mysliman. U fut brenda në shtëpi dhe u ul në gjuhë të falej, por u kujtua se imami nuk i kishte mësuar asnjë lutje. Ndenji ashtu për pak kohë. Duhet të thoshte diçka. Mblodhi fort gjuhët poshtë barkut dhe me fytyrë të kthyer nga vatra tha me zë të ulët, por të plotë: Zoti im i vetëm. Dje isha pa ty. Sot jam me ty. Nesër do të jem te ty. Dje nuk të dëgjoja. Sot të dëgjoj. Nesër më dëgjo. Unë të zgjodha ty

para të tjerëve dhe kërkoj që ti të më zgjedhësh mua mes të tjerëve. Më bëj mua më të mirin që unë t'i bind të gjithë se ti je më i miri. Jepi ushqim, shëndet dhe bollëk familjes sime. Sa të më japësh do t'i shumoj dhe do t'i kthej prapë ty, se ti je burimi dhe unë jam uji. Ashtu si uji edhe unë kam vetëm një qëllim, që të kthehem prapë në burim më i pastër dhe më i rëndë.

E përsëriti tri herë lutjen që kishte krijuar vetë. Kur pushoi, fytin e kishte të thatë. Ishte lutja e parë dhe atij i ishte dukur shumë e gjatë. Besoj se mjafton, mendoi dhe lëvizi gjunjët për të qarkulluar këmbët e mpira. Nga pas i erdhi një zhurmë e butë. Çfarë të ka ndodhur, i tha e shoqja. Ai u ngrit, u afrua afër vatrës dhe u shtriq. U bëra mysliman, tha. Ajo hapi gojën sikur të përjetonte një mynxyrë, por nuk foli dot. Ta shpjegoj kur të zgjohem, i tha ai. Tani më sill një jastëk se dua të fle. Gruaja ia solli jastëkun dhe para se të mbyllte sytë ai pa qerpikët e saj që dridheshin.

Gjatë gjithë natës kishte ndjesinë se po flinte nën shi. Kur u zgjua kuptoi se kokën dhe qafën e kishte të qullur. Balli i pikonte pa pushim dhe hunda ishte kthyer në një trampolinë nga ku uji i derdhej në gjoks. Gruaja me sy të skuqur e shikonte me pikëllim. Ç'po bën këtu, e pyeti Ibrahimimi. Je sëmurë, iu përgjigj ajo me zë të fikur. Të kam vënë gjithë natën lecka me ujë dhe uthull në kokë për të të qetësuar ethet. Mos lëviz. Do një çaj trëndafili? Jo, i tha ai, dua qumësht. Gruaja u çel dhe nxitoi drejt sepetit. Dora i dridhej kur i dha qumështin. Ai ktheu një gllënjë dhe mbështeti kokën në jastëk. Gruaja e përpinte me sy. Nuk e beson dot e shkreta, mendoi ai. Si mund ta besonte?

E shoqja ishte nga fisi i krishterë i Xhavellave të Sulit. Këta malësorë kishin luftuar prej shekujsh me turqit dhe nuk e kishin pranuar Kuranin as me shpatë, as me ofiqe. Suljotët ishin krenarë për fenë e tyre dhe besonin se ishin garda e krishterë e shqiptarëve. Ata kishin vrarë në disa raste shqiptarë që kishin ndërruar fenë dhe këtë e bënin për të frikësuar të gjithë ata që, sipas tyre, shisnin fenë të turqit. Ekspeditat e këtyre malësorëve në fshatrat e fushës ishin gjithnjë e më të dhunshme. Herën e fundit, përpara disa muajsh, daja i gruas, Llambro Xhavella, në krye të 100 trimave, kishte djegur dhjetë shtëpi myslimanësh të rinj dhe i kishte detyruar ata që ose të mohonin fenë e re, ose çdo shtëpie do t'i rrëmbehej nga një mashkull. Llambro kishte bindur familjet e mëdha të Sulit që të strehonin djem të vegjël të krishterë, të cilët, sipas tij, duhet t'i shpëtonin nga pabesia e baballarëve frikacakë. Djemtë e Ibrahimit shkonin çdo vit për verim te dajat, në malet e Sulit dhe kur ktheheshin tregonin se kolonia e vogëlushëve të rrëmbyer bëhej çdo vit e më e madhe. Dhe janë çdo vit e më të egër, i kishte thënë një herë i biri, a thua se dajë Llambro i ushqen me barut. Nuk mund ta bëjë këtë dhe me fëmijët e mbesës, mendoi dhe pa gruan që nuk ia ndante sytë duke pritur që ai të fliste. Piu dhe pak qumësht, zgjati dorën dhe e afroi gruan nga vetja.

Nuk jam sëmurë, i tha, jam mysliman. E shoqja nuk lëvizi, por ai ndjeu një ngurtësim në lëkurën e saj. Ajo ishte ftohur papritmas dhe Ibrahimimi iu duk sikur po përqafohej me një skelet. Nuk ke pse idhnosesh me mua, vazhdoi të fliste ai. Nuk do ndryshojë asgjë në jetën tonë. Ti je gruaja ime dhe unë do vazhdoj të kujdesem dhe të të mbaj si më parë. Katandia jonë do të shtohet sepse unë besoj se disiplina e Islamit do t'i sjellë mbarësi kafshëve tona. Fshatit do t'i dal për zot vetë dhe ty nuk ka pse të të vijë turp nga unë. Sot, unë jam myslimani i parë në fshat, por do ta shohësh se shpejt shumë të tjerë do të bëjnë si unë. Të krishterët dhe myslimanët kanë një mijë vjet që jetojnë bashkë dhe ne të dy nuk jemi të vetmit që flemë bashkë, por lutemi veç e veç. Kur ika dje në qytet nuk e kisha vendosur dhe prandaj nuk të thashë gjë. U binda kur isha në pazar duke shitur. Shikoja burra dhe gra të krishterë që blinin dhe shisnin me nxitim, a thua se ishin në ditën e fundit të jetës së tyre. Aty pata një ndjenjë përkohshmërie që nuk e kisha provuar kurrë më parë. Këta njerëz e ndiejnë se ajo që po jetojnë është shumë e përkohshme dhe duan ta



shijojnë atë që kanë përpara se bota të ndryshojë. Ata e dinë se era që po fryn nga Lindja do ndryshojë jetët e tyre. Veç t'i kishe parë dje gratë që dilnin nga kishat. Dukeshin si në ditën e tyre të fundit të lirisë. Islami po afron dhe era që fryn mbi qytet po sjell rërë shkretëtire. Islami ka rregulla të tjera për burrat, për gratë dhe në përgjithësi për lirinë. Kjo fe vjen si një ushtri që ka ndërtuar perandorinë më të madhe të botës në Stamboll dhe forca e saj është vetëm në fillimet e veta. Në qoftë se nuk e pranon duhet ta luftosh dhe në qoftë se vendos të luftosh mund edhe të humbësh, e në qoftë se humb ke vdekur. Ne shqiptarët e fshatrave të varfër, nuk i rezistojmë dot asnjë ushtrie, sepse në mijëra vjet kurrë nuk kemi pasur ushtrinë tonë që të na mbrojë nga fetë e ushtrive të tjera. Fati ynë dihet. Ne kemi lindur për t'i shërbyer ushtrive dhe feve që kalojnë nëpër tokat tona. Krishterimi ka mijëra vjet që i ka mësuar shqiptarët me rregullat dhe zakonet e veta. Mos kujton se të gjithë shqiptarët u bënë të krishterë duke qeshur në këto 1700 vjet? Jo. me hell dhe me shpatë janë bërë pagëzimet e para. Sa familje janë shkatërruar dhe janë ndarë kur krishterimi erdhi me ushtritë e veta pushtuese. Ne nuk kemi qenë gjithmonë të krishterë dhe nuk kemi pse të jemi të tillë deri në fund të kohës. Tani është koha e Islamit. Paratë, fuqia dhe shteti e kanë qendrën në Stamboll. Kjo u vendos qysh se turqit pushtuan Kostandinopojën në kohën e katragjyshit tim. Që atëherë Islami nuk është ndalur. Edhe grekët do ishin bërë myslimanë nga frika. Por ata kanë një pakt me turqit, sepse kur i dorëzuan Kostandinopojën u vendos që grekët të ishin kombi më i preferuar pas myslimanëve dhe kështu është akoma. Turqit kanë nevojë për artet dhe dijen e grekëve, ndërsa nga ne nuk kanë çfarë të përfitojnë dhe prandaj do të na detyrojnë me hir apo me pahir të marrim fenë e tyre. Në qytet takova një imam, i cili më shpjegoi islamit. Krishterimi dhe Islami, sipas tij, burojnë nga i njëjti trung. Mijëra vjet më parë dy vëllezër, Ismaili, i madhi dhe Isaku, i vogli, u ndanë sepse nënat e tyre ishin të ndryshme. Babai i tyre zgjodhi të jetonte me gruan e tij të ligjshme dhe me djalin e saj, Isakun. Ismaili jetoj me të ëmën skllave në shkretëtirat e Arabisë, aty ku më pas lindi Islami. Nga pasuesit e Isakut lindi Krishti, ndërsa nga pasuesit e Ismailit lindi Muhamedi. Porositë që Zoti i dha Muhamedit dallojnë myslimanët nga të krishterët. Imami m'i tha të pesë porositë dhe unë i pranova sepse m'u dukën të lehta, të shëndetshme dhe pa harxhe. Unë duhet të falem pesë herë në ditë, duhet të agjëroj më shumë se një muaj në vit, duhet t'i jap ushqim dhe veshje të varfërve dhe në qoftë se kam mundësi të shkoj para se të vdes një herë në Mekë ku është vendi i shenjtë i myslimanëve. E ç'bën tjetër një burrë i krishterë, përveçse falet më pak, agjëron më shumë dhe nuk është i detyruar të shkojë në Mekë. Unë mund të kem edhe tri gra të tjera nëse dua. Ti nuk duhet të kesh turp nga unë. Shpejt do bindesh se unë kam bërë zgjedhjen e duhur. Ndoshta zgjedhja ime nuk sjell më shumë lumturi, por unë besoj se ajo sjell më pak dhimbje. Do isha një njeri me fat sikur babai im të ishte bërë mysliman për të mos ma lënë mua barrën e zgjedhjes. Djemtë tanë do ta kenë jetën më të lehtë, ta dish. Kjo sepse babai i tyre mori përsipër ta përballojë vetë sikletin e ndryshimit të fesë duke mos ia lënë atyre.

Kur foli për djemtë, gruaja nisi të merrte frymë. Skeleti i saj u ngroh dhe ai ndiente se si gjaku i saj gurgullonte nëpër kocka si uji i mëngjesit nëpër tubat e çezmës. Pas pak gruaja lëvizti këmbët e ftohta. U shkëput nga ai dhe u ngrit. Sytë i kishte të fryrë, por të thatë dhe pa lot. Më vjen turp nga fshati, tha ajo. Njerëzit e mi në Sul do të më mohojnë dhe ne do të mbetemi fillikat. As do na hyjë njeri në derë dhe as do na pranojnë nëpër dasma dhe morte. Nuk do na shesin më kripë, as bukë, as vaj dhe do na i helmojnë bagëtitë. Gratë do ndërrojnë rrugën kur ti t'u dalësh përpara, burrat do pështyjnë në tokë kur t'i takosh. Më vjen të vdes, rënkoi ajo. Të kishe pritur dhe pak. Kisha dëgjuar se Mihali i Zoicës do bëhej mysliman sepse kadiu i qytetit që ai e furnizon me

bulmet ia kishte vënë kusht. Të kishim parë ç' do t'i thoshte fshati Mihalit pastaj të vendosje. Pse duhet të ishe ti i pari?

Ai e piu deri në fund qumështin që ishte ftohur dhe mendoj se ndoshta gruaja kishte të drejtë. Kishte bërë një kapërcim ylberi, por tani nuk mund të kthehej më pas. Nuk e di a duhej të isha i pari, por nuk mund të isha i dyti, tha ai duke u çuar. Atëherë gruaja iu afrua dhe iu ngjiti për trupi. Unë jam martuar me një të krishterë dhe do vdes me një mysliman, u zotua ajo duke ia hedhur krahët rreth belit. M'u beto për Krisht që nuk do t'i bësh djemtë myslimanë dhe nuk do marrësh gra të tjera, siç thotë feja jote. Gruaja i kishte mbështetur kokën në sup dhe atij iu dhimbs. Në fund të fundit ajo ishte si gjithë gratë e tjera, myslimane apo të krishtera. Skeleti i saj ishte dashuria, mishi i saj ishte xhelozia. Vetëm vdekja mund të ndajë xhelozinë nga dashuria, mendoj ai dhe u ndie më i qetë. Sikur gruaja të mos ishte xheloze do ta kisha jetën më të vështirë, ngushëlloi veten. Ta premtoj, i tha ai duke e shtrënguar pas kurmit të vet dhe shtoi: Djemtë që kanë lindur nuk do bëhen myslimanë dhe unë nuk do marr grua tjetër deri ditën që ti do lindësh një vajzë.

Nuk do t'i gëzohem asaj dite, tha gruaja dhe vuri dorën mbi bark sikur po i jepte një urdhër mitrës së vet.

Më quaj Ibrahim, i tha ai. Është emri i profetit të parë që ishte babai i Ismailit dhe i Isakut. Ti mund të më thërrasësh Abraham.

3

Kur prifti hyri në fshat pas tri ditësh, pleqësia e priste e mbledhur. Kolera islame ju hyri në shtëpi, i tha burrave të fshatit pa i përshëndetur. Në qoftë se nuk e izoloni, do t'ju përprijë të gjithëve një nga një.

Lajmi se një nga burrat ishte bërë mysliman e tronditi fshatin.

Gratë ndezën qirin që nuk u shuan për shtatë ditë me radhë. Burrat, të cilët ndiheshin më fajtorë për tradhtinë e një anëtari të gjinisë së tyre, e mbytën hidhërimin e ditëve të para me raki. Dikush betohej se, nëse pleqësia e lejonte, ai do shkonte natën dhe do ta vriste Ibrahimin. Një tjetër tha që shtëpia e myslimanit të rrethohej me një kanal të lartë dhe kështu ai do jetonte në një ishull të pakalueshëm brenda fshatit. Të thërrasim priftin, propozoi një tjetër. Atij i takon të na thotë se çfarë duhet të bëjmë kur delet braktisin vathën e Zotit dhe shkojnë të ushqehen me dorën e turkut.

Kur prifti, që u bënte mesha një herë në katër të diela, erdhi nga qyteti, i lodhur dhe i pluhurosur, shumicën e burrave e gjeti të pirë. Ata filluan të flisnin të gjithë njëherësh dhe në atë rrëmujë priftit iu desh të ndërhynte disa herë për të shuar zënkat mes tyre. E tregonin në mënyra të ndryshme historinë e Ibrahimit, pastaj kundërshtonin versionet e njëri-tjetrit, bërtisnin, akuzonin shoku-shokun dhe pastaj priftin se indiferenca e tij ndaj fshatit do t'i joshte njerëzit avash-avash drejt fesë tjetër.

Pushoni kaurë të dehur, bërtiti prifti që kishte humbur durimin. Një ditë kjo do të ndodhte e ju nuk mund të bënit përjashtim. Islami është një kolerë që ka një mijë vjet që përhapet me majën e shpatës. Miliona njerëz në Lindje jetojnë nën këtë epidemi, por duke qenë të gjithë njëllor të sëmurë nuk kuptojnë se nga se vuajnë dhe as nuk përpiqen ta shërojnë veten. Fshati juaj është një pikë uji në oqeanet e feve të mëdha. Zoti përcaktoi kufijtë mes këtyre oqeanëve dhe ky kufi ishte Kostandinopoja. Myslimanët e shkelën kufirin që Zoti kishte vendosur mes territoreve fetare kur pushtuan këtë qytet grek aty ku takohen oqeanet. Qysh nga ajo ditë ujërat e papastra të Islamit

derdhen në oqeanin tonë dhe sot ato ndotën dhe fshatin tuaj. Kur linda unë, vetëm një në dhjetë shqiptarë ishte mysliman. Tani që jam në mes të jetës, myslimanët bëjnë tre shqiptarë në dhjetë. Shpresoj që kur të vdes të mos e kenë kaluar gjysmën e dhjetës.

Prifti ndaloi dhe mori frymë thellë. Burrat dukeshin më të vegjël nën mjegullën e duhanit që pinin pa pushim.

Ju e dini se çfarë i tha Jezu Krishti Pjetrit natën e fundit, vazhdoi ai. Kur gjeli të këndojë tri herë do më kesh mohuar tri herë. Edhe unë shoh mohues midis jush. Shumë shpejt në këtë fshat do ketë myslimanë të tjerë dhe unë dua të kuptoj pse. Pse, o shqiptarë, e keni kaq të lehtë të mohoni fenë e parë? Mohoni për para, apo mohoni nga frika? Mohoni nga padija, apo mohoni nga varfëria? A e keni pyetur veten pse nuk keni pasur kurrë shtetin tuaj, pse nuk keni pasur kurrë shenjtorët tuaj, pse nuk keni akoma libra në gjuhën tuaj, pse nuk keni shkollat tuaja dhe pse nuk keni flamurin tuaj? Jua them unë pse. Sepse ju nuk e keni besuar Krishtin. Atë e keni pranuar si një nënshtrim ndaj perandorive që ju kanë qeverisur. E keni pranuar fenë si të ishte një taksë shpirtërore, së cilës mund t'i shmangesh me dredhi. Perandoritë, deri ditën kur ra Kostandinopoli, ishin të krishtera dhe ju ishit të krishterë. Tani perandoria juaj është myslimane dhe ju po mbani radhë në Islam. Ju bëheni me fenë e pushtuesit tuaj dhe prandaj nuk do keni kurrë shtetin tuaj sepse kur pushtuesit të ikën, ju do të bëheni me pushtuesin e ri.

Burrat ishin lëshuar në stolat e tyre. Ligjërata e priftit i kishte bërë esëll. Mos na fyej, o grek, i tha dikush. Ne të kemi thirrur të na ndihmosh. Ti po na thua që të bëhemi grekë që të mos bëhemi myslimanë?

Ishe shumë i hidhur hirësi, foli burri më i moshuar që ishte dhe kryetari i pleqësisë. Dhoma ra në qetësi. Zotrote na the se shqiptari nuk është një i krishterë i pastër dhe një ditë mëkati do ta çojë atë në Islam. Unë kam vendosur të jem edhe pak kohë në këtë botë. Gjithë jetën time i jam lutur Zotit që t'i jepte paqe dhe bukë fëmijëve të mi dhe fëmijëve të fëmijëve të mi dhe Zoti shpesh më është përgjigjur. Sa jam gjallë kam pasur bukë, por kurrë nuk kam pasur paqe. Bukën e kam fituar vetë, paqen ma kanë marrë një herë grekët dhe një herë turqit. Ne jemi të krishterë, grekët janë të krishterë dhe paqe nuk ka. Tani po vijmë turqit që thonë se bukën duhet ta sigurojmë vetë, ndërsa paqen do të na e sjellin ata. Turqit thonë se, nëse nuk e pranojmë paqen e tyre, do të na e marrin dhe bukën dhe tokën. E ata me paqe kuptojnë Islamin, apo jo? unë sa të vdes do mbetem i krishterë, siç kam lindur. Turqit thonë se toka është e perandorisë, ndërsa ju grekët thoni se feja jonë është feja juaj sepse ungjijtë janë shkruar në greqisht. Unë nuk do jem gjallë, por di që një ditë stërnipërit e mi do t'i kenë të dya dhe askush nuk do mund t'ua marrë më, as fenë, as tokën dhe as gratë. Prandaj të kemi thirrur, të na thuash se ç'duhet të bëjmë që myslimani i fshatit tonë mos shumohet me vajzat tona dhe mos ushqehet me bukën tonë, megjithëse ti nuk beson se Krishti dhe shqiptari mund të jetojnë në të njëjtin trup, pa e tradhtuar njëri-tjetrin. Plaku pushoi nën vështrimin admirues të burrave të tjerë.

Prifti u mendua një copë herë dhe foli. The atë që mendoj prej disa kohësh, i tha plakut. Shqiptari dhe Krishti nuk jetojnë dot bashkë përjetësisht. Shqiptari beson se është i varfër sepse Krishti nuk kujdeset për të siç kujdeset për grekët dhe prandaj ai e tradhton Krishtin sepse ndihet i tradhtuar. Koha do na e thotë se kush ka tradhtuar i pari ndër të dy dhe atë ditë ky gjykim do jetë ose një ngushëllim i madh, ose një pikëllim i madh për shumë myslimanë shqiptarë. Por sot ne kemi shumë pak fakte për të provuar çka po them. Tradhtia është në ditët e saj të para. Megjithatë, detyra ma do që unë të përpiqem që ajo që besoj të mos ndodhë. Prandaj kam ardhur. Në qytet ka shumë shqiptarë që janë bërë myslimanë. Ne vendosëm që t'i izolojmë dhe prandaj të krishterët nuk janë më gjitonë me myslimanët. Ata jetojnë në një lagje të veçantë, e cila po rritet përditë. Kanë çezmat dhe dyqanet e tyre. Të krishterët po ashtu. Takohen vetëm të dielave

në ditën e pazarit. Fise të tëra janë ndarë sepse një vëlla është bërë mysliman dhe të tjerët kanë mbetur të krishterë. Martesat mes fëmijëve të dy feve nuk lejohen më. Ju thashë se kjo do të ndodhë edhe në fshatin tuaj sepse myslimani ka pas tij kadiun, asqerin, dervexhiun dhe pashain. Sot, ata janë më të fortë. Por ju duhet të jeni më të zgjuar. Turqit kanë shpatën, por të krishterët kanë mendjen. Ky ballafaqim mes shpatës dhe mendjes do bëjë që ju të mbeteni shumicë në fshatin tuaj. Duhet ta izoloni Ibrahimin që të gjithë të kuptojnë se në këtë fshat nuk mund të jetosh dot si mysliman. Por edhe në qoftë se të tjerë do t'i bashkohen Islamit, shumë shpejt ata do kacafyten. Turqit janë si ujçit. Pasi shumohen vrasin njëri-tjetrin. Ju duhet ta ushqeni zjarrin që ata kanë në shpirt. Kjo është dredhia që duhet të përdorni.

Do t'ju rrëfej një histori për fëlliqësitë e tyre, tha prifti. Përpara njëqind e tridhjetë vitesh, të parët e fesë myslimane në Stamboll dërguan një dervish për të përhapur islamin ndër shqiptarë. Pasi mori fermanin e Sulltanit, ky u nis për në Berat. Qëndroi një kohë aty, mësoi shqip dhe më pas u vendos në Tepelenë. Aty filloi të ndihmonte jetimët, sakatët dhe të varfrit. Shpërndante ushqim dhe ndihma që turqit ia dërgonin nga Stambolli për të joshur të krishterët. Shumë shpejt emri i Demir Hanit u përhap në të gjithë zonën dhe njerëzit filluan ta besojnë si të ishte shenjt. Madje, ndjekësit e tij, që ai i kishte kthyer në myslimanë, hapën fjalë se Demir Hani bënte mrekullira dhe kishte aftësi të shëronte njerëz, vetëm duke i prekur. Të sëmurë, të gjymtuar dhe gra gdhieshin në radhë që Demir Hani t'i prekte me dorë dhe t'i nxirrte xhindet nga trupat e tyre, siç thoshte ai vetë. Dikur, një bajraktar mysliman, gruaja e të cilit nuk pillte, vendosi të dërgojë të shoqen te Demir Hani. Ajo ishte e re dhe shumë e bukur. Demiri e mbajti gruan një muaj dhe përditë mbyllej me të në dhomat e veta larg syve të dervishëve të tjerë. Pas një muaji, e dërgoi në shtëpi dhe i tha burrit të saj se e shoqja ishte shëruar. Burri i gëzuar ra me gruan e vet dhe pas nëntë muajsh lindi një djalë. E ëma dhe babai kishin qëlluar të dy të verdhë, të gjatë dhe me sy blu si gjithë malësorët shqiptarë, ndërsa djali doli i shkurtër dhe pis i zi. Fshati filloi të përqueshte bajraktarin. Gruaja u shastis, ndërsa burri e rrahu dhe e la pa bukë që t'i tregonte të vërtetën. Pas tri javësh pa bukë dhe pa ujë, e rrahur dhe e poshtëruar gruaja tregoi se kur ishte në Tepelenë Demir Hani e kishte detyruar të binte me të duke i thënë se ky është vullneti i Zotit dhe asgjë e keqe nuk do t'i ndodhte asaj. Bajraktari i çnderuar u nis në Tepelenë për të vrarë Demir Hanin. E rrethoi teqenë dhe i bëri thirrje të dilte jashtë që të merte ndëshkimin e merituar. Për dhjetë ditë Demir Hani rezistoi. Teqeja ishte e mbushur me ushqimet që ai ua shpërndante njerëzve. Një natë, Demir Hani e ftoi bajraktarin të takoheshin që t'i shpjegonte çfarë i kishte ndodhur gruas së tij. I përvëlur për të marrë vesh të vërtetën bajraktari u fut në teqe dhe aty Demir Hani e vrau me sëpatë. Viktima ishte njeri me influencë dhe gjithë tepelenasit filluan të flisnin kundër Demir Hanit. Po ashtu gra dhe vajza të tjera, e madje dhe djem të vegjël rrëfyen se kur ata shkonin për t'u shëruar, Demir Hani i prekte me dorë në vende të ndaluara dhe disa prej tyre i kish fëlliçur. Fjala shkoi deri në Stamboll dhe paria myslimane u ankua te Sulltani se Demir Hani po përdhoste Islamit me veprime, të cilat i trembnin shqiptarët që donin të bëheshin myslimanë. Për shkak të turpeve të Demir Hanit shumë myslimanë e braktisën Islamit. Fshati i bajraktarit u mblodh dhe më shumë se 50 burra myslimanë dogjën Kuranin dhe u betuan se kurrë më nuk do tradhtonin Jezu Krishtin. Pas disa kohësh, Sulltani dërgoi një ferman ku ngarkohej një nga dervishët e afërt të Demir Hanit që t'i priste atij kokën. Ky e zbatoi. Thonë se atë ditë Demir Hani vrapoi nëpër teqe deri në mbrëmje duke mbajtur kokën e tij në duar. Muaj më vonë edhe dervishit që vrau Demir Hanin iu pre koka po me urdhër të Sulltanit. U tha se ishte ky që kishte sajuar dhe shpifur gjithë ato histori të fëlliçura që t'i zinte vendin Demirit dhe t'i rrëmbente pasurinë që kishte fituar.

Kur prifti pushoi, burrat dukeshin të lodhur. Kishin tri ditë pa gjumë dhe prifti akoma nuk po iu thoshte se ç' duhej të bënin me Ibrahimin.

Gjatë tri ditëve që ata rrekeshin të gjenin një mënyrë për të përballuar bashkëjetesën me të, Ibrahim vazhdonte jetën e tij qetësisht sikur asgjë të mos kishte ndryshuar. Çdo mëngjes herët ai shtronte një rrogë në oborrin e shtëpisë, ulej në gjunjë dhe falej. Ata që e kishin parë këtë rit tregonin se myslimani falej pa zë. Lutja e tij ishte shumë e shkurtër. Më pas, Ibrahim merrej me kafshët e veta. Ditën e dytë ai kishte shkuar të shihte vëllanë e tij, Vasilin. Ky, në mungesë të një vendimi të pleqësisë, i kishte hapur derën e shtëpisë dhe e kishte pritur. Vasili iu tha burrave të pleqësisë se Ibrahim dukej i qetë dhe në humor. Qetësia e tij e kishte shpërqendruar Vasilin, i cili priste që i vëllai të shfaqësohej për damkën që i kishte vënë familjes. Për një kohë të gjatë, të dy kishin biseduar për thatësinë e gjatë të atij gushti dhe për asgjë tjetër. Pastaj Ibrahim e kishte pyetur se çfarë vendimi kishte marrë pleqësia. Vasili ishte bërë nervoz dhe i kishte thënë se shumë anëtarë të pleqësisë donin ta dëbonin nga fshati. Ibrahim rinte përballë të vëllait dhe nuk fliste. I qetë dhe pa e ngritur zërin i tha: Ti je mbyllur në fshat dhe nuk di ku po shkon bota Vasil. Turqit janë sot fuqia më e madhe që ka parë njerëzia. Shumë shpejt dallga e Islamit do të mbysë fshatrat tona. Ata kanë para dhe asnjë ushtri nuk mund t'iu bëjë ballë. Në Janinë të gjithë e dinë se herët apo vonë turqit do të kenë gjithçka në dorë. Shqiptarët atje çdo ditë bëhen myslimanë. Për ne shqiptarët Islami është e vetmja rrugë për të na dalluar nga grekët. Turqit na kanë me sy të mirë dhe unë besoj se ata do të na e lënë ne në dorë këtë vend, për inat të grekëve. Por që kjo të ndodhë ne duhet të marrim fenë e tyre. Është e vetmja mundësi që ne të bëjmë prokopi dhe pas qindra vjetësh të qeverisim veten tonë dhe grekët. Ky fat nuk troket çdo ditë në derë. Asnjë shqiptar me mend në kokë nuk duhet ta humbë këtë mundësi.

Vasili nuk fliste, por e shihte vëllanë si i ndërkryer. Koha do tregojë nëse kam pasur të drejtë, kishte vazhduar Ibrahim. Ti je vëllai im e unë jam vëllai yt dhe feja nuk mund të na ndajë. Megjithatë, unë jam i vendosur të pranoj çdo vendim që do të marrë pleqësia, por nëse dikush prek familjen time, apo më kërkon të iki nga fshati, ta dini se unë do luftoj. Nuk mund ta shkulësh rrapin nga rrënjët pa gjakosur dorën. Ti mund të vish kur të duash në shtëpinë time dhe unë do të vij nëse më pranon.

Kështu ishin ndarë dy vëllezërit. Kur Vasili ia tregoi priftit dhe pleqësisë së fshatit takimin me Ibrahimin, burrat u xhindosën dhe thanë se ata nuk mund të pranonin kërcënimet e një myslimani prandaj vendimi duhej marrë një orë e më parë. Vasili nuk fliste, por dukej se e vuante gjyqin që fshati po i bënte të vëllait.

Mëkat, tha prifti, pasi dëgjoi shpjegimet e Ibrahimit. Më i zgjuari prej jush qenka bërë mysliman. Nuk do ta keni kollaj ta thjeni këtë njeri. Ç' duhet të bëjmë, e pyeti Vasili që rrinte në këmbë sikur priste një urdhër. Ky njeri nuk mund të mposhtë një fshat, foli prifti. Fuqia e tij qëndron te dobësia juaj. Ju e keni dashur dhe e keni respektuar prandaj sot jeni të përçarë dhe të pavendosur. Betejën e parë me ju sapo e ka fituar. Jam i bindur që ai fle tani i qetë me Zotin e tij të ri, ndërsa ju keni tri ditë që nuk dini çfarë të bëni për të mbrojtur Zotin tuaj. Fol, i thanë burrat priftit. Ç'të bëjmë?

Si në një sallë gjyqi, prifti u çua në këmbë dhe ashtu bënë të gjithë burrat pas tij, përveç kryetarit të pleqësisë.

Ibrahim duhet të vuajë për fyerjen që i ka bërë fshatit, shpalli prifti. Atij as nuk do t'i shitet, as nuk do t'i falet grurë, kripë, bukë, miell, vaj dhe asgjë tjetër që hahet. Askush nuk do të prekë mish nga kafshët e Ibrahimit. Askush nuk do të çojë kafshët e veta për t'i shëruar tek Ibrahim. Askush nuk do të martojë vajzat e veta me djemtë e Ibrahimit. Askush nuk do të ngrejë shtëpi pranë Ibrahimit. Gjithonët do t'i mbyllin dritaret që shohin nga shtëpia e tij. Rruga përpara

shtëpisë së Ibrahimit nuk do të shkelet nga asnjë i krishterë. Atij do t'i mbyllet dera e shtëpisë së të krishterit, përveçse kur ka morte. Gratë e krishtera nuk do t'i japin dorën Ibrahimit. Burrat do ta qëllonjë Ibrahimin vetëm nëse ai do të hyjë në kishë apo në qoftë se ai sulmon një të krishterë. Nëse Ibrahim vdes, ai nuk do të varroset bashkë me të krishterët. Vajzat e Ibrahimit, të krishterët do t'i respektojnë sepse ato janë viktima të tradhtisë së babait. Djemtë e tij do vuajnë ndëshkimin njëjloj si i ati i tyre. Ata zhvishen nga të drejtat për t'u zgjedhur në pleqësi dhe për të ndjekur meshat dhe shkollat e krishtera. Duke filluar nga sot, për dyzet ditë, asnjë i krishterë nuk do t'i thotë Ibrahimit mirëmëngjesi dhe natën e mirë dhe po ashtu askush nuk do t'i flasë gjatë kreshmës. Nuk ka urim për myslimanin.

Kur prifti mbaroi, burrat u panë në sy. Ata prisnin ndëshkime më të rënda. Ishin përgatitur ta dëbonin dhe disa do ishin të gatshëm ta vrisnin myslimanin. Por i vëllai i Ibrahimit ishte aty dhe ata nuk folën për ndëshkime më të ashpra. Prifti e ndjeu se pleqësia mbeti e pakënaqur. Kur njëri prej tyre tha nëpër dhëmbë se kisha po toleronte Islam, prifti i tha: Biri im, myslimanin po e vrave, të vret; po e le pa bukë, të vjedh; po nuk i fole, çmendet. Më mirë një i çmendur se një mysliman.

Duke dalë, Vasili iu afrua priftit. Babai na la një tokë mua dhe vëllait. Ne e kemi punuar bashkë dhe familjet tona kanë ndarë të korrat përgjysmë. Si thua a duhet ta punoj tokën me Ibrahimin tani që ai është mysliman? Prifti ndaloi dhe u përgjigj: Babai juaj e kishte përfutur atë tokë si i krishterë. Ju e keni trashëguar si të bijtë e një të krishterë. Vëllai yt nuk është më i krishterë dhe ajo tokë është e jotja, sa kohë që ti nuk je mysliman.

4

Pleqësia u shpërnda menjëherë dhe prifti e la fshatin. Kjo është nata e tyre e fundit në paqe, mendoi. Çdo gjë do jetë ndryshe nesër. Mbi qytet hëna e re shtrihej si një kumbull mbi një kadife blu. Kur prifti hyri në shtëpi imami kishte filluar të këndonte majë xhamisë. Ishte dita e parë e ramazanit. Ibrahim nuk kishte fjetur gjithë natën duke pritur që Vasili të vinte për t'i treguar vendimin e pleqësisë së fshatit. Por i vëllai nuk u duk. Ulur në oborr vështronte hënën e re. Ishte shenja që lajmëronte ramazanin siç i kishte thënë imami. U ul në gjuhë dhe u fal, pastaj shkoi të flinte vetëm pranë vatrës. Kur u zgjua, e shoqja e pyeti se pse nuk kishte ardhur në shtrat dhe ai i tha se kishte filluar ramazani dhe gjatë këtij muaji myslimani nuk ha, nuk pi dhe nuk e prek gruan me dorë. I mjeri ti, i tha gruaja. Ku e gjete këtë fe që të ndalon gjërat që do më shumë në jetë?

Kur dielli u ngrit mbi çati, një zhurmë e madhe dërrasash dhe gozhdësh që nguleshin mbi to e nxori Ibrahimin me nxitim në oborr. Gjtoni i tij, Mihali i Zoicës bashkë me të vëllanë dhe dy të tjerë kishin marrë disa dërrasa të mëdha dhe po ia vinin dritares. Mirëmëngjesi, i tha Ibrahim dhe u afrua. Asnjëri prej tyre nuk u përgjigj. Mirëmëngjesi, i tha ai prapë, ku i keni lënë veshët, or miq? Sërish as Mihali dhe as të tjerët nuk reagues. Ç'ju kam bërë, u çor Ibrahim, ju kam ngrënë bukën? Katër burrat vazhdonin punën. Ibrahim rrinte pa lëvizur dhe i shikonte. Pas pak dritarja e Mihalit ishte e mbyllur. Atë ditë, gjashtë dritare të fshatit që shikonin shtëpinë e Ibrahimit u zhdukën. Nga rruga e tij nuk kaloi askush.

Pasdite, Ibrahim, i lodhur nga agjërimi dhe i mërzhitur nga poshtërimi, doli të bëjë një shëtitje nëpër fshat. Kushdo që rastisi as e pa në sy dhe as i foli. Dy djem të vegjël që luanin cinglash sa e panë, hodhën shkopinjtë dhe hynë në shtëpi duke thirrur në panik: Nënë myslimani, erdhi myslimani. Dera u mbyll me forcë.

Kur u kthye në shtëpi, e shoqja po qante. Çfarë ke, pyeti ai. Shkova të marr kripë, nuk më dhanë. Kërkova miell për bukë, nuk më dhanë. Kërkova vaj, po ashtu. Ç'po ndodh me ne Ibrahim? Të folën, i tha ai. Më nxinë, jo më folën, rënkoj gruaja. Më thanë se nuk ka bukë dhe vaj për familjen e myslimanit. Renda te Hana, gruaja e tët vëllai dhe më nxori me duar bosh. Yt shoq na ka turpëruar, më tha. Për ju nuk ka ushqim në fshatin tonë. Asnjë vajzë nuk do t'i jepet djemve të tu. Tani toka i përket Vasilit sepse burri yt ka humbur të drejtën e trashëgimisë. Kur e pyeta se kush i ka vendosur gjithë këto, më tha se këtë vendim e ka marrë pleqësia dhe gjithë fshati e ka pranuar.

Ibrahimi mbylli derën e shtëpisë me shul dhe i kërkoi gruas një lugë sheqer. Ka dhe pak për nesër, i tha ajo duke i dhënë sheqerin. Është koha e iftarit dhe imami më tha se duhet të fus në gojë diçka të ëmbël, u justifikua ai. Lëpiu buzët dhe u ul për t'u falur në sy të gruas që e shikonte me dhimbje.

Atë natë i vunë fëmijët për të fjetur më herët dhe secili u shtri në dhomën e vet. Kur u zgjua në mes të natës për t'u bërë gati për syfyrin, ndjeu në hundë erën e diçkaje që digjej. Vatra ishte e pandezur dhe ai hapi portën e shtëpisë. Disa metra jashtë oborrit, në mes të rrugës, digjej një kryq i madh i ngulur vertikalisht në tokë. Ibrahim i frikësua se mos zjarri i merrte drutë që kishte në cep të oborrit dhe u afrua. Katër burra që ishin fshehur pas zjarrit ia dhanë vrapit. Kur u larguan, në një distancë që ai nuk mund t'i shquante, njëri prej tyre ndaloi dhe i thirri: *Ibrahim, o derr, Muhamedi të pret në ferr*. Tre të tjerët e përsëritën si refren disa herë dhe të gjithë bashkë u zhdukën, pas një muri. Ibrahim i u avit kryqit, që kërcente pa ritëm mbi kokën e tij. Mendoj ta shkulte nga toka dhe ta shuante zjarrin, por e tërhoqi dorën dhe nuk e preku. Tymi ngrihej lart dhe pas pak e mbuloi hënën si një perçe gri. Kryqi u dogj i patrazuar deri në mesditë. Kur u zgjuan, djemtë filluan të loznin rreth kryqit. Ibrahim i ndiqte rrotullimet e tyre dhe mendonte me vete se jeta e njeriut duhet të ishte si kjo lojë kalamajsh. I vjen rrotull kryqit gjithë jetës që të mos digjesh në zjarr.

Kur djemtë u futën në shtëpi e pyetën Ibrahim se kush e kishte ngulur kryqin e djegur para shtëpisë së tyre. Fshati, u përgjigj Ibrahim. Djemtë panë njëri-tjetrin të hutuar. Ishte përgjigjja që prisnin më pak. E ka ngulur fshati që të ruhet nga rrufetë e Zotit, shtoi i ati.

Për një javë Ibrahim nuk doli nga shtëpia. Falej në orët e caktuara, nuk hante, nuk pinte, merrej me kafshët e veta dhe kalonte kohën duke biseduar me djemtë. E shoqja shkoi dhe një herë tek e kunata, por ajo sërish e nxori me duar bosh. Fshati i mbeti besnik vendimit të pleqësisë. Askush nuk kaloi përpara shtëpisë së Ibrahimit. Në kohën që Ibrahim falej, kambana e kishës së vogël gjëmonte pa pushim. Çdo natë, katër burrat shfaqeshin përpara shtëpisë, ngulnin një kryq të ri që shkëlqente në errësirë dhe pastaj i vinin flakën. Pas një jave, rruga përpara shtëpisë dukej si varrezë me kryqe të rrëzuar. Ushqimet e tyre pothuajse kishin mbaruar. Gruaja i dha djemve kos dhie dhe mollë të pjekura nga të shtëpisë dhe filloi të qante. Do iki në qytet, tha Ibrahim. Do gjej diçka për të ngrënë. Kthehem në darkë. Thirri djemtë dhe i porositi se pa ardhur ai askush nuk duhej të dilte nga shtëpia. Do vij me ty, i tha djali i madh. Jo, i tha Ibrahim. Sa kohë nuk jam unë, ti je i zoti i shtëpisë, por mos e kalo derën e oborrit pa u kthyer unë. Po nëse ti nuk kthehesh, e pyeti i biri. Ibrahim bëri sikur nuk e dëgjoi dhe u nis.

Kur hyri në qytet, dielli po perëndonte. Frymën e mbajti te xhamia. Imamin e gjeti të ulur mbi rrogos me një tas hurma përpara. Selam Alekum, Ibrahim. Bujrum në iftarin tim. Ibrahim u ul mori një hurmë dhe goja e tharë nga rruga iu ndez më keq. Fëmijët e mi janë pa bukë, i tha Ibrahim dhe i tregoi javën e tij të tmerrshme. Jam gati të vras për të shuar urinë e tyre. Imami e dëgjoi deri në fund dhe kur mbaroi i tha: Zoti po të vë në provë. Të ka lënë pa bukë, pa miq dhe

pa vëlla që të kuptojë se sa mund të sakrifikosh për të fituar dashurinë e tij të mëshirshme. Muhamedi vuajti 20 vjet, më keq se ti, që të fitonte emrin që i njohim sot. Mbaje ramazanin deri në fund që të pastrosh shpirtin tënd nga urrejtja dhe mëkati. Mos harro se gjatë këtij muaji të shenjtë nuk duhet të mallkosh dhe as të vrasësh njeri. Zoti ka gjithmonë bukë për robtë e tij. Imami u ngrit, shkoi në cep të xhamisë dhe i mbushi një torbë me miell, sheqer, vaj, kripë dhe ullinj. Merri dhe këto hurma që aq shumë i pëlqenin profetit dhe çoja fëmijëve të ëmbëlsohen. Po si mund të vazhdoj kështu, i tha Ibrahimimi. Këto ushqime nuk zgjasin më shumë se disa ditë dhe djemtë do të m'i marrë prapë uria. Duro, i tha imami. Kur t'i mbarosh këto, Zoti do të të dërgojë një shenjë. Nisu tani se vajti vonë dhe të presin.

Ibrahimimi u përshëndet me imamin dhe doli nga xhamia. Pas pak u errësua. Dielli perëndoi dhe u fut në torbën e tij të mbushur. Rrugën e bëri thuajse me vrap.

Në mesnatë, arriti në fshat i rraskapitur, por i çliruar. Një turmë me burra dhe gra ulërinin përpara shtëpisë. Sapo panë Ibrahimimin u bënë si të tërbuar. Gratë filluan ta shanin, burrat e shtynë dhe e goditën. Ibrahimimi nuk ktheu dorë, por shtrëngoi torbën fort dhe eci drejt shtëpisë. Nuk po kuptonte gjë, por mendonte për djemtë dhe për gruan. Duke ecur mes grushteve të burrave dhe mallkimeve të grave i doli përpara i vëllai, Vasili. Edhe ti Vasil, e pyeti Ibrahimimi. Unë po i mbaj, u përgjigj i vëllai duke mos e parë në sy. Do ishte bërë hataja. Yt bir është çmendur. Thuaji të lirojë Mihalin se ka gjithë natën që e mban brenda dhe thotë se do ta vrasë. Ibrahimimi nuk donte të dëgjonte më dhe u sul drejt shtëpisë. Gruaja e kishte parë dhe i hapi derën. Pa e lënë të fliste, i tregoi me zë të fikur ç'kishte ndodhur. Katër burrat kishin ardhur në mes të natës për të djegur kryqin. Atë natë, ata duket se kishin pirë sepse qeshnin dhe shanin me të madhe dhe duke bërë shenja në drejtim të shtëpisë këndonin me sa kishin në kokë: *Ibrahim, o qafir, do të zhdukim me pahir, mysliman nga taksirati, nuk ka vend për ty fshati, Muhamedi është synet, Ibrahimimi është lanet*. Kur kryqi filloi të digjej deri në majë, burrat u larguan si përherë dhe unë u shtriva të fle, tha gruaja. Pas pak, dëgjova të bërtitura në oborr dhe kur dola pushë tët bir, që mbante për zverku njërin nga burrat dhe e tërhiqte për nga shtëpia. Duhet të ketë dalë nga dritarja dhe i është vënë pas nëpër fshat derisa e ka zënë, shtoi ajo. Ku është futur, e pyeti Ibrahimimi. Në qilar i ke të dy, bëri me kokë ajo.

Kur Ibrahimimi hyri në qilar, i biri me një thikë në dorë ishte ulur në shesh. Në fund të qilarit, në errësirë, Mihali i Zoicës ishte i lidhur si bagëti nga këmbët. Gomar, i thirri të birit, të thashë të mos dilje nga shtëpia pa ardhur unë. Djali u ngrit në këmbë dhe faqja e njomë iu djersit. I ati e kishte fyer në sy të presë së tij dhe kjo e kishte zhburrëuar. Ibrahimimi e kuptoi dhe iu drejtua Mihalit. Ç'pate me familjen time, o bukëshkalë? Më liro, iu lut Mihali. Për atë Zot nuk kam më punë me ty. Edhe dritaren që zura me dru do ta hap, le të thotë ç'të dojë pleqësia. Mos e beso baba, i foli i biri nga prapa. Po e lirove, ata do të vijnë prapë nesër të djegin kryqin dhe do të të shajnë ty. Ky të ka sharë qafir në mes të fshatit. Unë nuk duroj dot të më thonë djalë qafiri. Po e lirove ti, unë do ta vras nesër, siç na kanë vrarë këta.

Ibrahimimi u ftoh. Kur kishte ikur, djali ishte një kalama, ndërsa tani ai kishte përpara një burrë, i cili i vinte kushte. Ma jep thikën, i tha të birit. I biri rezistoi një çast dhe pastaj, duke e parë në sy të atin, i tha: Po e lirove fshati do mendojë se jemi frikësuar. Ma lër ta ruaj unë këtë kërmë dhe shko të bisedosh me pleqësinë. Në qoftë se ata duan që të na ngordhin për bukë le të vdesë ky para nesh. Ibrahimimi nuk i besonte veshëve. Nga jashtë të thirrurat e turmës po shtoheshin dhe ai nuk kishte kohë të arsyetonte nëse pjekuria e të birit ishte fryt i moshës apo i urisë së ditëve të fundit. Pemët piqen duke u ushqyer, mendoj, njerëzit piqen nga uria. Më jep thikën dhe shko lart, i thirri. Djali i zgjati thikën. Merre, i tha, kryqe dhe thika gjen sa të duash në fshat. Ibrahimimi iu afrua Mihalit dhe ia liroi pak litarët. Sonte do flesh këtu, i tha. Liria jote nuk varet më nga unë.



Mos luaj me zjarrin dhe më lër të shkoj në shtëpi, u përpoq ta bindte Mihali. Ka kohë për të ikur, iu përgjigj Ibrahimimi që shoi qiririn dhe e la tjetrin në errësirë.

Doli në oborr dhe të bërtiturat e njerëzve që e prisnin pushuan për një çast, por kur e panë vetëm, familjarët e Mihalit nuk u përmbajtën dot. Ibrahimimi ngriti dorën, për t'i lënë të kuptonin se kishte për të thënë diçka, dhe ata pushuan. Mihali do të rrijë në shtëpinë time. Dua të flas me pleqësinë dhe ta zgjidhim gjithçka në paqe, si vëllezër të një fshati.

Turmën e përshkoi një mërmërimë, por askush nuk e sulmoi Ibrahimimin. Qetësia e tij i kishte ngurtësuar të gjithë. Çfarë do nga pleqësia, pyeti dikush nga turma. Unë nuk ika nga fshati dhe djemtë e mi meritojnë të hanë dhe të martohen aty ku kanë lindur. Iknë në shtëpi dhe mos kini merak. Mihalit nuk e gjen gjë në shtëpinë time, por jeta e tij varet nga ju, më shumë se nga unë. Pleqësia të ndryshojë vendimin dhe ne mbetemi gjithonë siç ishim më parë.

Kaq tha Ibrahimimi dhe u drejtua nga shtëpia. Turma mbeti jashtë si e ngrirë. Myslimani po i vinte kushte fshatit dhe kjo ishte një situatë që askush nuk mund ta përtypte. Vëllai i Mihalit nuk e mbajti dot zemërimin dhe thirri: *Ibrahim, o derr, me dorën time do të ther.* Por të tjerët iu hodhën, e kapën nga krahët dhe e detyruan të pushojë. Mendo për të vëllat, i thanë. Ik qetësohu sonte, nesër mblidhemi në pleqësi. Turma u shpërnda në errësirë dhe atë natë fshati nuk fjeti duke menduar për të nesërmen.

Pleqësia u mblodh në mëngjes. Burrat dukeshin të dërrmuar. Plani i tyre nuk kishte ecur. Vëllai i Mihalit i kishte sytë e kuq. Ai u thërriste të gjithëve dhe kundërshtonte çdo propozim që i dukej se e vononte lirin e Mihalit. Të shkojmë tani, ta nxjerrim me forcë. Ibrahimimi dhe kalamajtë e tij nuk mund t'i bëjnë ballë njëzet burrave të armatosur. Burrat dukeshin të heshtur. Frikacakë, i kthehej ai. Im vëllat e ka kokën nën thikë, ju turrni lesh këtu. Menduat se do ta qëronit Ibrahimimin duke e lënë pa bukë dhe pa kripë. Por ai shkoi në qytet dhe myslimanët e tjerë ia mbushën torbën. Por derri nuk zbutet nga uria. Kur ju gërhisnit çdo natë, unë dhe im vëllat shkonim dhe e kërcënonim me zjarr. Ibrahimimi do dorëzohej po të mos e zinte ai kalama Mihalit në mes të natës. i zuri pusi, njëlloj si xhaxhai i të atit atëherë. E priti te dera e shtëpisë dhe i vuri thikën në fytyrë. Do ta vras atë bir bushtre. Vasili, që deri atë kohë nuk e kishte hapur gojën, nuk duroi dhe kërcëu nga vendi. Mos i hap plagët e vjetra se nuk ndahemi mirë, iu hakërrye ai. Të dy burrat u shanë dhe desh nxorën thikat, për të tjerët ndërhyjnë për t'i ndarë.

Kryetari i pleqësisë u çua në këmbë dhe mjekra e tij e moçme i bëri të gjithë të heshtin. Ti dhe Mihali nuk keni respektuar vendimin e pleqësisë, tha ai. Ne nuk ju thamë që të digjnit kryeqe në oborrin e Ibrahimimit. Tani, ai ta ka marrë vëllanë dhe ti na kërkon ne ta lirojmë sepse e di që vetë nuk ia del dot. Por, edhe sikur t'ia dalësh, ne nuk do të lëmë sepse në fund të këtij shërrri ka gjak. Nuk duhet të derdhim gjak në fshat sepse hasmëria do të zgjerohet si rrathët e ujit dhe pastaj fshati do të priset. Vasil, shko fol me të vëllat dhe na thuaj çfarë kërkon që të lirojmë Mihalin që fshati të qetësohet. Çfarë t'i premtoj, pyeti Vasili. Thuaji se do t'ia falim rrëmbimin e Mihalit. Ai është i lirë të lëvizë nëpër fshat dhe askush nuk do ta prekë me dorë atë dhe familjen e tij. Po bukë, tha Vasili. Ai do kërkohet që fshati t'i shesë bukë si më parë. Nuk kemi bukë të tepërt, u hodhën burrat, por ai mund të shkojë sa herë të dojë në qytet të mbushë torbën e tij dhe ne nuk do ta pengojmë. Po nëse nuk pranon? Nëse nuk e dorëzon Mihalin deri nesër, shtëpia e tij do rrethohet dhe as miza nuk do të hyjë më në atë xhami. Ai nuk do lejohet të shkojë në qytet për ushqim dhe bagëti e tij do ngordhin se ne nuk do t'i lëmë të kullotin. Po qe se nuk pranon, rrethimi fillon nesër në mëngjes dhe ai do dorëzohet që të mos vdesë urie.

Vetëm kaq, pyeti Vasili që nuk dukej i bindur. Premtoji edhe tokën që i ke marrë, tha kryetari i vendosur. Vasili donte të thoshte diçka, por ata nuk e lanë dhe ai u nis. Jashtë kishte zënë shi. Kur hyri në oborr, thirri të vëllanë. Ibrahimimi hapi derën dhe e ftoi brenda. Je lagur, Vasil, tha ai

dhe i kërkoi të shoqes një peshqir. Vasili e mori, fshiu kokën dhe filloi të fliste. Duhet ta liroshe Mihalin, ndryshe ata do të të rrethojnë shtëpinë derisa të dorëzohesh nga uria. Po dole, do të të rrëmbejnë dhe do të të lidhin ty dhe fëmijët. Bagëtinë nuk do ta lënë të kullosë. Duhet ta liroshe deri sot natën. Kaq, pyeti Ibrahim qe rrinte me kokën ulur, ndërsa e shoqja i solli të dyve nga një kafe. Nëse liron Mihalin, pleqësia do të lejojë të lëvizësh nëpër fshat dhe të shkosh në qytet sa herë të duash. Askush nuk ka punë me ty dhe djemtë e tu dhe kurrkush nuk do të djegë më kryqe natën. Nuk mjafton, tha Ibrahim. Ky fshat nuk do gjejë qetësi në qoftë se çdo gjë nuk kthehet si më parë. Im bir, i madhi është rritur për një ditë. Ai nuk harron fyerjen që na kanë bërë dhe unë kam frikë se ai do vrasë këdo që nuk i jep bukë dhe nuk i flet të atit. Në qoftë se ai vret do ta vrasin, tha Vasili. Në qoftë se ata vrasin dhe unë do të vras. Edhe ty do të të vrasin Ibrahim, i tha i vëllai. Po ti Vasili, iu kthye Ibrahim me inat. Do shohësh se si unë dhe djemtë e mi themi si kafshë pa i bërë keq askujt? Unë nuk kam vjedhur dhe nuk kam vvarë, dhe nuk i kërkoi gjë njeriu. Dua të jetoj si gjithë të tjerët. Po ti je mysliman, i tha Vasili dhe kjo i frikëson të gjithë. Priti thotë se nëse ne lejojmë që djemtë e tu të martohen me vajzat tona, atëherë fara jote do ta kthejë siç ishe më parë, i krishterë? Të gjithë do të ta falin dhe çdo gjë do të kthehet si më parë. Mendohu, i tha Vasili dhe i vuri dorën mbi sup.

E shoqja, që e ndiqte bisedën pa folur, lëvizi për herë të parë dhe Ibrahimit iu duk sikur ajo po e miratonte Vasilin. Ai e pa ashpër në sy dhe ajo nuk e hapi gojën. Gjërat kanë shkuar larg, Vasil. Unë nuk jam më ai që isha dhe fshati nuk është më i pari. Kam një muaj që unë i lutem Zotit tim të ri. Nëse unë kthehem i krishterë siç isha as Zoti i parë që e tradhtova dhe as i dyti që ti më kërkon ta tradhtoj nuk do jenë më me mua. Fshati do të tallet njëllor dhe unë nuk mund t'u lë këtë turp djemve të mi. I thuaj fshatit që Mihali do të lirohet vetëm nëse vendimi i pleqësisë ndryshon. Kush nuk do të më flasë le mos më flasë, por pleqësia nuk duhet të detyrojë askënd të mos më thotë mirëmëngjes. Djemtë e mi do të martohen në fshat aty ku një ditë bashkë me fëmijët e tyre do nderojnë varrin tim. Unë kam lindur shqiptar dhe jo mysliman. Dua që fshati të më respektojë siç kam lindur dhe jo si do vdes.

Vasili dukej i përbotur. Ata nuk do pranohet, tha ai. Mos i bjer murit me kokë, Ibrahim. Do të të kthejë edhe tokën që na la babai. Mos m'u lut, i tha prerë Ibrahim. Thuaj këto që të thashë, përndryshe Mihali do të vdesë këtu bashkë me ne të tjerët. Sa për tokën, nuk po të them faleminderit sepse më ke kthyer atë që e kam pasur. Edhe kur të vdes toka nuk do të jetë e jotja.

Vasili u ngrit të dilte, ndërsa e shoqja kishte mbuluar sytë me duar. Djali i madh, që kishte dëgjuar të gjithë bisedën mes vëllezërve, hyri në dhomë dhe i përqafoi këmbët Ibrahimit.

Pleqësia e priti Vasilin e mbledhur. Nuk pranon, tha ai sa u duk te dera. Ç'të tha, e pyetën burrat. Do që çdo gjë të kthehet siç ishte. Ai ju jep mish dhe fshati duhet t'i japë bukë. Kush do t'i flasë le t'i flasë, por pleqësia nuk duhet të detyrojë askënd që të mos e përsëndesë rrugës. Kërkon po ashtu që mos ndalojmë vajzat të martohen me djemtë e tij. Përndryshe, më tha që Mihali do të vdesë bashkë me të, sepse ai nuk dorëzohet. Burrat rënduan më shumë mbi jastëkët ku ishin ulur. Ata e ndienin se vendimi i tyre tani do të ishte edhe më i rëndë për fshatin.

Nuk kemi rrugë tjetër, tha kryetari duke u ngritur dorën sikur po shpallte luftë. Ibrahim zgjodhi më të keqen. Bëhuni gati për rrethimin. Asnjëri të mos hyjë me forcë në shtëpinë e tij. Nëse Ibrahim apo dikush del nga shtëpia do ta marrim dhe do ta lidhim derisa të lirohet Mihali. Bagëtinë po ashtu.

Burrat nuk pritën të nesërmen, por e rrethuan shtëpinë e Ibrahimit që në mbrëmje. Shiu nuk kish pushuar gjithë ditën dhe ata kërkuan velenxa të mëdha nën të cilat u shtrinë gjatë natës. gratë u

çonin për të ngrënë dhe burrat pinin raki që të duronin lagështinë që i kishte mbërthyer gjymtyrët. Shiu vazhdoi pa pushim.

Të nesërmen në mëngjes burrat dukeshin të lodhur, por të vendosur ta vazhdonin rrethimin. Ibrahim i shikonte nga brenda shtëpisë. I shikonte ashtu të shtrirë në shi dhe mendonte se si i kishte ndryshuar jeta, pasi hyri në Islam. Njerëz me të cilët familja e tij kishte jetuar për qindra vjet, duke ndarë lindje dhe varrime, tani torturoheshin në shi, duke uruar që ai të vdiste sa më shpejt për t'i lënë rehat të ktheheshin në shtëpitë e tyre të ngrohta.

Ditën e tretë të rrethimit shumë nga burrat filluan të kolliteshin dhe të teshtinin. Ibrahim shikonte gratë që vinin dhe i sillnin burrave kupa të nxehura me raki që ata i përpinin për të ngrohur barqet e plevitosura. Shumica ishin ftohur e megjithatë asnjëri nuk e kishte lënë rrethimin.

Ditën e gjashtë shiu vazhdonte. Burrat kishin ndërtuar një tendë me kashtë dhe ishin futur poshtë saj për t'u mbrojtur nga uji që derdhej nga qielli me ibrik. Tenda ishte e vogël dhe nuk i nxinte të gjithë burrat. Ata kishin vendosur ta bënin rrethimin me turne. Kur disa shtriheshin nën tendë, të tjerët i vinin rrotull shtëpisë duke parë me inat nga dritaret e Ibrahimit. Natën ndiznin zjarr, mbi të cilin piqnin gështenja që i pinin me raki. Një natë, Ibrahim hapi derën e shtëpisë dhe burrat brofën në këmbë të alarmuar. Po del, thirrën ata. Kujdes ta kapim. U vunë në pozicion sulmi dhe pritën gjahun. Pas pak një domate kërceu në errësirë dhe u zgërlaq në këmbët e njërit prej burrave. I zënë në befasi, burri u tremb dhe ra përmbys mbi purenë e kuqe të domates. Ibrahim me të birin filluan të qeshin nga brenda. Le të mendojmë se kemi ushqim më shumë se ç'kanë ata durim, i tha Ibrahim të birit që rritej çdo ditë. Po tallet me ne myslimani, thanë burrat dhe filluan të këndojnë për të nxjerrë dufin dhe të ftohtin: *Ibrahim, o lamash, sot ti qesh, nesër do qash. Ibrahim ha domate, je i skuqur me mëkate.*

5

Ditën e dhjetë të rrethimit Ibrahim ra më herët për të fjetur. Ishte dita e fundit e ramazanit dhe ushqimet pothuajse kishin mbaruar. Edhe sikur të mos agjëroja për ramazan përsëri nuk do të kisha ngrënë këtë muaj, mendoi ai para se ta zinte gjumi.

Nga mesi i natës i biri e tundi fort. Ngrihu, i tha, se ç'po ndodh aty jashtë. U afruan të dy te dritarja dhe panë burat që po flisnin me një djalë të ri të armatosur, i cili tundte një kërbaç. Pas tij, dhjetëra burra të hipur në kuaj kishin mbushur rrugën përpara shtëpisë. Zjarret nuk ishin shuar ende dhe djaloshit i dukeshin flokët e verdhë.

Kush është ky, e pyeti i biri. Është Ali Tepelena, tha Ibrahim. Megjithëse binte shi, Aliu rrinte serbes majë kalit. Burrat e pleqësisë e kishin rrethuar dhe duke i bërë shenja me duar nga shtëpia e Ibrahimit diçka mundoheshin t'i shpjegonin. Pa i dëgjuar, Aliu i grahu kalit dhe hyri në oborr. Shokët e tij, në fillim i shtynë, pastaj i goditën burrat, të cilët pa kundërshtuar vrapuan dhe humbën në errësirën e fshatit.

Ibrahim hapi derën dhe doli përpara. Mirë se erdhe në shtëpinë time Ali Tepelena. Pa ia kthyer përshëndetjen Aliu i tha; Ç'donin këta burra nga ty? Duan të më zbojnë nga fshati. Kanë dhjetë ditë që më kanë rrethuar. As më flasin dhe as më japin bukë. E ka vendosur pleqësia.

Ke vrarë njërin prej tyre, pyeti Aliu. Jo, jo, i tha Ibrahim duke e ftuar brenda. Jam bërë mysliman. Aliu u drejtua dhe e pa në sy. Nuk e meriton ky fshat këtë nder, tha. Kush të detyroi? Askush, tha Ibrahim. Bashkë me dimrin po vjen Islami, kjo dihet. Për t'u mbrojtur nga dimri kam dru. Por për t'u mbrojtur nga Islami pyeta imamin. Pranova kushtet e tij dhe u bëra mysliman. Ibrahim u habit dhe vetë nga shpjegimi që i bëri Ali Tepelenës. Gjatë ramazanit ai

ishite menduar shumë të kuptonte se çfarë e kishte shtyrë të shkonte në Islam. Herë pas here mendonte se ditën që ishte bërë mysliman shpirti i tij i rrumbullakët ishte palosur në dysh dhe kishte marrë formën e një gjysmëhëne, që tani varej e paushqyer brenda kafazit të brinjëve të tij. Të kërkoj para imami kur hyre në Islam? Ibrahimimi u habit nga pyetje e Ali Tepelenës. Jo, i tha. Po ti i dhe para imamit? As unë nuk i dhashë. Ai më dha një tas me hurma për kalamajtë. Pse më pyet, Ali? Duhet të kisha paguar para që të hyja në Islam? Nuk ma tha njeri.

Aliu filloi të qeshte. Islami nuk është cirk jevgjitësh, tha ai. Nuk ka nevojë të paguash për të hyrë atje. Kam dëgjuar se imamët u marrin para shqiptarëve që t'i pranojnë në Islam, ndaj të pyeta. Të dy burrat ishin ulur dhe dukeshin më të shpenguar. Ibrahimimi e shikonte. Aliu ishte ulur mbi fustanellë, kindat e së cilës ishin nxirë nga balta. Hoqi shapkën e kuqe që mbante në kokë dhe flokët e lagur iu derdhën mbi jelek. Kur shtriu këmbët, Ibrahimimi pa që mbi kundrat e tij të zeza shkëlqente një kopsë argjendi. I paskan vajtur mbarë kusaritë, mendoi.

Jashtë, në oborr, kuajt dhe shokët e Aliut lageshin në shi. Sonte do të rri këtu, i tha Aliu. Kuajt janë të lodhur. Hoqi jelekun dhe u mbështet pas murit. Këmisha e lagur i ishte ngjitur pas trupit. Ashtu i zhveshur dukej si një fëmijë. Ibrahimimi e shikonte dhe rrinte gojëkyçur. Kam ditë që nuk flas me njeri, i tha si për t'u shfajësuar. Burrat e fshatit nuk më flasin dhe po të rrija dhe ca vetëm, do harroja të bëja muhabet. Ata më thanë se ti ke marrë peng një të krishterë dhe nuk e dorëzon, tha Aliu. Ibrahimimi u skuq dhe filloi të tregonte. Kur e morën vesh se isha bërë mysliman u tërbuan. Pleqësia vendosi që fshati mos më jepte më bukë dhe ushqim. Unë shes mish, por ata nuk e pranojnë më mishin e kafshëve të mia. Kur mbeta pa gjë, shkova në qytet dhe mora ushqim tek imami. Natën që u ktheva në shtëpi im bir nuk i kishte duruar sharjet e tyre, e kishte zënë për gryke njërin, që e kemi dhe gjiton, dhe ata vendosën të më rrethojnë derisa ta liroj. Ka dhjetë ditë që flenë jashtë shtëpisë dhe presin që të dorëzohem kur të më mbarojnë ushqimet. Ke më ushqime, pyeti Aliu. Shumë pak miell për bukë ka mbetur. Nuk kam marrë dot as qumësht nga delet e mia, se po të dilja do më kishin qëlluar. Pse nuk e liron të krishterin? Nuk e liroj nëse pleqësia nuk nderon vendimin që kam marrë. Je bërë pishman? Përse, pyeti Ibrahimimi. Që u bërë mysliman. Ibrahimimi u mendua pak. Akoma, tha. Por më duket se fshatin e kam humbur. Asgjë nuk do jetë më siç ka qenë edhe nëse pleqësia e ndryshon vendimin. Nuk je i pari dhe nuk do jesh i fundit, kërkoj ta qetësonte Aliu. Shumë shqiptarë po bëhen myslimanë. Mua më duket se shqiptarët tani e kanë kuptuar se ata nuk mund të jenë në një shtet me grekët dhe që të ndajnë shtetin duhet në fillim të ndajnë fenë dhe pastaj tokat dhe pasuritë. Aliu, i mbështetur pas murit, dukej sikur fliste me vete. Megjithatë, ne shqiptarët duhet të dimë të zgjedhim. Jo çdo lloj islami i shkon shqiptarëve. Ne nuk jemi as turq dhe as arabë, prandaj duhet të gjejmë islamin që na rëndon më pak dhe na kënaq më shumë. Mushka dhe kali janë nga një familje. Por mushka ngarkohet me dru, ndërsa kali ngarkohet me njerëz. Ibrahimimi e shikonte dhe dukej gjithmonë e më i hutuar.

Ç'të tha imami për Islamin? Më tha se që të jem mysliman duhet të falem pesë herë në ditë, të mbaj ramazan, të jap zekat dhe të shkoj në Mekë. Jam falur çdo ditë dhe kam agjëruar. Kafshët nuk duhet të mbajnë ramazan, më tha imami. Mushka dhe kali nuk kanë detyrime përballë Islamit. Të pyeta nëse imami të rrëfeu për historinë e Islamit, u nxeh Aliu. Ibrahimimi mblodhi supet dhe Ali Tepelena vazhdoi:

Islami ka 12 degë që quhen tarikate. Dega më e madhe është ajo e sunitëve. Por mes tyre më e veçanta është dega e bektashinjve. Islam, vërtet do të thotë paqe, por myslimanët nuk e kanë zbatuar kurrë një lloj Islamit dhe për këtë shkak mes tyre nuk ka pasur kurrë paqe. Bektashizmi ka lindur si një degë e jeniçerëve myslimanë. Më shumë se njëqind vjet përpara pushtimit të Kostandinopojës, që është vepër e jeniçerëve, Sulltan Orhani themeloi urdhrin e jeniçerëve. Këta

u betuan se do ishin besnikë deri në vdekje ndaj sulltanit dhe u bekuan nga Haxhi Bektashi, i cili në atë kohë ishte një nga krerët e Islamit. Që nga ajo kohë bektashizmi ka lindur dhe ka udhëtuar nëpër botë bashkë me jeniçerët, të cilët e kanë mbrojtur dhe e kanë ushqyer këtë tarikat. Jeniçerët nuk ishin të gjithë djem të lindur myslimanë. Shumica e tyre ishin fëmijë që turqit ia rrëmbenin familjeve të krishtera ruse, greke, armene apo dhe çifute. Por shumë prej tyre ishin shqiptarë. Ti e di që turqit na quajnë arnaut? A e di ç' do të thotë arnaut? Arnaut, osmanët quanin dikë që nuk di të kthehet prapa. Meqë radhët e jeniçerëve ishin të mbushur me shqiptarë të paepur, të cilët nuk ktheheshin të gjallë pa fitore, ata u quajtën arnautë. Siç të thashë, këta djem edukoheshin për t'u vrarë dhe prandaj trajtimi që u bëhej atyre ishte i ndryshëm. Ata toleroheshin më shumë dhe kishin më tepër liri se gjithë ushtarët e tjerë. Por këta djem kishin nevojë për një besim të ri. Plaçka e luftës dhe besnikëria ndaj Sulltanit nuk u mjaftonte më atyre. Haxhi Bektashi e kuptoi këtë dhe mënyra se si ai e lexonte Islamin u kthye në frymëzim për jeniçerët. Ata mendonin se ishin të ndryshëm në gjithçka në krahasim me njerëzit e tjerë dhe feja e tyre e re e shprehte këtë ndryshim. Kur Haxhi Bektashi iu kaloi atyre bekimin, ai ishte 80 vjeç. Jeniçerët besonin se ai rridhte nga Fatimja, që ishte vajza e Muhamedit dhe kjo i dha më shumë forcë bektashizmit. Kudo ku shkonin jeniçerët merrnin me vete edhe dervishët bektashinj. Në pushimet mes betejave ata ndërtonin teqe. Teqetë e bektashinjve janë gjithnjë 6 orë larg njëra-tjetrës në mënyrë që në fund të çdo rruge udhëtari të çlodhej në një vend që e mban gjithmonë derën hapur. Bektashinjët janë të butë dhe mikpritës. Turqit e sotëm janë të egër dhe mizorë. Ata janë sunitë dhe nuk i pranojnë bektashinjët. Por frika që kanë në Stamboll nga jeniçerët i ka detyruar të heshtin dhe të mos i sikterisin dervishët. Jam i bindur se bektashizmi është myslimanizmi që i shkon më shumë shqiptarëve dhe sidomos atyre që kanë qenë të krishterë. Bektashinjët mund të pinë dhe gratë e tyre mund të dalin zbuluar përpara burrave. Ata besojnë se Jezu Krishti ka qenë i pari që ka predikuar Islamin, dhe, po të mos ishin jeniçerët vetëm për këtë mendim ata do të ishin shkuar të gjithë në hell. Turqit e quajnë bektashizmin si një islam i krishterë dhe prandaj e luftojnë. Skënderbeu ka qenë bektashi dhe prandaj u bë aq kollaj i krishterë për së dyti, megjithëse kishte jetuar shumë vjet si mysliman. Nastradini që tregon histori për të qeshur nga Persia, po ashtu. I pari që e solli bektashizmin ndër shqiptarë ishte Demir Hani. Ky ishte dervish dhe ngrit në Tepelenë teqenë e parë përpara njëqind e kusur vjetësh. Bëri shumë të mira: ndihmoi jetimët, shpërndau para, shëroi njerëz dhe qindra shqiptarë i ktheu në myslimanë. Njerëzit besonin se ai ishte njeri i shenjtë dhe tregonin se e kishin parë që shëronte të sëmurët vetëm duke i prekur. Demir Hani grumbulloi dhe shumë pasuri nga dhuratat që i vinin prej shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë që ai ndihmonte. Pasuria e tij u bë aq e madhe, sa që një dervish tjetër, njeriu që Demir Hani i besonte më shumë, u bë lakmitar dhe mendoi t'i zinte vendin. Ai hapi fjalë se Demir Hani ngacmonte gratë dhe fëmijët dhe se natën merrte djem të rinj ën dyshekët e tij. Me një ferman të Sulltanit Demir Hani u dënua me vdekje. Sulltani ngarkoi dervishin që e spiunoi t'i priste atij kokën dhe ky zbatoi fermanin. Ky dervish ishte vëllai i stërgjyshit tim, Hysenit. Më vonë edhe vëllanë e Hysenit e vranë, por që nga ajo kohë ne trashëguam pak pasuri dhe emër në Tepelenë.

Aliu pushoi pak dhe kontrolloi këmishën me duar. Më është tharë, tha dhe vazhdoi.

Ne shqiptarët nuk besojmë sa duhet, sepse mendojmë më shumë për sot se për nesër. Ne i duam gjërat sot dhe na duket pa kuptim që të falemi gjithë jetën për t'u shpërblyer kur të vdesim. Një fe që të lodh ne e braktisim. Zoti na ka lënë mes grekëve dhe turqve. Këta i vodhën fenë të tjerëve. Grekët ia morën çifutëve dhe turqit ia morën arabëve. Pastaj të dy ngritën perandori për të sunduar popujt e tjerë. Grekët e mbajtën Bizantin një mijë vjet dhe pushtuan turqit, shqiptarët dhe arabët. Tani turqit kanë gati 500 vjet që me perandorinë e tyre po qeverisin grekët, arabët

dhe ne shqiptarët. Shumë shqiptarë bëhen myslimanë se nuk duan të kenë fenë e grekëve. Por ata nuk pranojnë kur grekët u thonë se duke u bërë myslimanë në të vërtetë janë bërë turq. Dhe kanë të drejtë. Shqiptarët nuk e njohin mirë Islamin. Islami është një pjatë ku mund zgjedhësh. Unë kam zgjedhur bektashizmin. Jam shqiptar dhe nuk jam grek. Jam bektashi dhe nuk jam turk. Imami nuk t'i ka thënë gjithë këto, sepse ai nuk i pranon bektashinjtë. Por duke mos të treguar të vërtetën mbi Islamin ai nuk të ka dhënë mundësi të zgjedhësh atë që do. Pa e kuptuar ti ke bërë zgjedhjen që ka dashur imami. Të dha një emër? Si quhesh tani? Ibrahim, u përgjigj ai. E zgjedhe ti apo ta dha ai? Ma dha imami. Do ta mbash? Ibrahim nuk dinte ç'të thoshte. Mbaje, iu përgjigj Aliu. Nuk të beson njeri po të ndërrosh emrin tri herë në muaj.

Të dy mbetën gjatë duke u menduar. Nuk kishin gjumë. Para se të flinin Aliu e pyeti se çfarë do të bënte me të krishterin. Kur të iki unë, i tha, ata do ta rrethojnë prapë shtëpinë po nuk e lirove. Nuk e liroj nëse fshati nuk ndryshon vendimin, iu përgjigj Ibrahim. Mirë, i tha Aliu, nesër njofto pleqësinë. Do shkoj vetë t'i takoj.

Kur u zgjua të nesërmen dhe hyri në dhomën e oxhakut, Ibrahim gjeti aty të birin dhe Aliun. Ky ishte gjysmë i zhveshur dhe kofshët e bardha i kishin dalë nga velenxa. I kishte vënë dorën djalit mbi flokë dhe ky e shikonte si i magjepsur. Djalë trim, i tha Ibrahim. Më tregoi si e kishte zënë për gryke kaurin që të kishte sharë ty. Thanasi u ngrit në këmbë kur hyri i ati dhe mbeti ashtu, pa ia ndarë sytë Aliut që nuk po vishej. Dërgoje Thanasin të lajmërojë pleqësinë. Ata janë shpërndarë, tha Ibrahim, ku t'i gjej? Kush është i pari i tyre, pyeti Aliu. Arianit Komneni, u përgjigj Ibrahim dhe i bëri shenjë djalit. Thuaji që e pret Ali Tepelena, beu i Tepelenës. Thanasi fluturoi. Mbiemër i dëgjuar ky, tha Aliu duke veshur fustanellën. Ibrahim kishte kthyer kokën nga muri që të mos e shihte lakuriqësinë e Aliut. Thonë që familja e tyre është shquar që në kohën e Skënderbeut. Këtu ku jemi sot, të parët e tij kanë pasur zotërimet e veta që ia kanë marrë turqit. Plaku thotë se kur të ikin turqit, atij do t'i kthehen tokat dhe nderet. Pse është kryetar i pleqësisë, pyeti Aliu. Edhe babai i tij, edhe i gjyshi kanë drejtuar pleqësinë. Fshati i ka respektuar dhe u ka njohur drejtimin, tha Ibrahim.

Kur Ibrahim ktheu kokën, Aliu i veshur kishte dalë jashtë. Shiu kishte pushuar pas më shumë se një jave dhe dielli i mëngjesit po i thante pellgjet në oborr. Aliu iu afrua kalit të tij të bardhë që ishte lidhur pranë plevicës dhe nisi t'i shkundte jelet e lagura. Kali llastohej nga dora e të zotit dhe tundte bishtin. Qimet e tij të gjata që bëheshin blu nga dielli i mëngjesit i rrethonin supet e Aliut, si një shall. Aliu nuk ishte i gjatë. Koka e tij mbaronte aty ku niste hunda e kalit. Kur kali nxirrte frymë nga hojëzat, flokët e verdhë të Aliut hapeshin në ajër dhe po të mos kishte mustaqe, ai do dukej si një vajzë. Pasi rregulloi shalën prej lëkure, Aliu i kërceu kalit dhe me shpejtësi doli nga oborri dhe u zhduk pas shtëpisë së Mihalit. Rrugët ishin bosh dhe trokitja e potkonjve të kalit ngjante si një muzikë e luajtur mbi kalldrëm.

Fshatit akoma nuk i kishte dalë frika nga prishja e dhunshme e rrethimit të një nate më parë. Burrat tymosnin nëpër shtëpi pa folur, gratë gatuanin në heshtje, fëmijët luanin pa zhurmë. Pas shumë ditësh, Ibrahim dhe e shoqja dolën të lirë në oborr. Rruga e shtëpisë ishte e mbushur me kryqe të djegur dhe me mbeturinat e burrave që kishin rendur nëpër natë. Gruaja filloi të pastronte. Mblodhi mbetjet e bukëve, kuleçve dhe lakorëve që ishin shpërndarë dhe shkelur nga kuajt e njerëzit dhe ua hodhi bagëtive të uritura. Pastaj thirri Ibrahim dhe të dy bashkë mblodhën kryqet e djegur. Njëri prej tyre nuk ishte shkatërruar dhe gruaja me kujdes ia pastroi blozën që e kishte nxirë deri në majë dhe e mbështeti në murin e shtëpisë. Pjesët e mbetura Ibrahim i mori dhe i hodhi në vatër dhe ndezi zjarr. Gruaja po e shihte nga prapa kurrizit të përkulur mbi vatër sesi i rregullonte copat e druve duke i kryqëzuar njërin mbi tjetrin. Ibrahim e

ndjeu, u kthye nga ajo dhe me ëmbëlsi i tha: Ata për t'i djegur i prunë këta kryqe. Do e ushqejnë mirë zjarrin. Gruaja nuk foli dhe vazhdoi të pastronte oborrin e lagështitur. Balta ishte e butë dhe e mbushur me gjurmë njerëzish. Po t'i ndiqje ato nuk shkoje asgjëkund. Njëloj si jeta, mendoi gruaja dhe u lut pa zë, ndërsa një kalë i bardhë po afrohej me shpejtësi në drejtim të shtëpisë.

Dita ishte e bardhë dhe gruaja hapi sytë për të kuptuar kush po vinte. Nga larg dukeshin dy figura që kalëronin bashkë. Si dielli dhe hëna mbi kalë, mendoi ajo, kur kali hyri në oborr, gruaja pa të birin që mbante në dorë kapistallet dhe pas tij kokën e verdhë të Aliut që varej mbi supin e Thanasit. Flokët e tyre ishin ngatërruar. Të dy qeshnin dhe Aliu e shtrëngonte Thanasin fort për beli. E gjeta rrugës dhe e mora, i tha ai gruas që vrapoi të ndihmonte të birin për të zbritur.

Pleqësia nuk mblidhet, i tha Aliu Ibrahimit kur hyri brenda. Arianit Komneni i tha tët biri se është i sëmurë dhe nuk mund të ngrihet sot nga shtrati. Burrat e tjerë nuk kanë dalë nga shtëpia. I kemi tmerruar Ibrahim. Janë zhdukur kaurët.

Ibrahimi nuk tha gjë. Thanasi kishte hyrë brenda në shtëpi dhe duke parë të atin sikur të merrte leje iu drejtua Aliut: Ali bej do ikësh? Aliu iu afrua aq shumë Thanasit, saqë dukej sikur po i merrte erë, dhe tha: Nuk shkoj pa u mbledhur pleqësia. Do pres sa t'i thahen kockat e lagura Arianit Komnenit. Shko prapë në shtëpinë e tij dhe i thuaj që dua ta takoj me çdo kusht. Pyete kur më pret në shtëpi.

6

Arianit Komneni e priti Ali Tepelenën të nesërmen. Gjatë ditës, Aliu kishte dërguar shokët e tij nëpër fshat dhe këta kishin marrë bukë, vaj, kripë, sheqer dhe fruta. Burrat e krishterë nuk kundërshtuan dhe shtëpia e Ibrahimit u mbush me ushqime. Pasi kishin ngrënë e kishin pirë, Aliu i tha Ibrahimit se donte të takonte Mihalin në qilarin e shtëpisë. Kur zbritën, Mihali po rrinte i kërrusur. Duart i kishte të lidhura dhe fytyrën shumë të zbehtë. Ngriti kokën dhe pa Aliun drejt në sy. Të ka vënë poshtë mëkati, i tha Aliu. Mihali nuk foli, por dha të kuptonte se nuk e njihte. Aliu u afrua, e zuri nga flokët dhe i tha: Jam Ali Tepelena. Ibrahimi është miku im. Ka qenë miku im edhe kur ishte i krishterë, por tani e kam dy herë mik sepse ka ardhur në rrugën time. Unë do shkoj të takoj pleqësinë. Ata kërkojnë që ti të lirohesh, por, pa ndryshuar vendimin që kanë marrë, ti nuk do dalësh nga ky qilar. Çfarë do t'i them atyre në emrin tënd?

Mihali dukej i pashpresë, por ndiqte me kujdes çdo fjalë të Aliut. U thuaj që në qoftë se nuk ndryshojnë çka kanë vendosur unë do vdes këtu. Jam shumë keq. Më ka hyrë pleviti në palcë dhe këmbët nuk më mbajnë më. Bota ka myslimanë në çdo cep. Edhe nëse unë vdes, prapë do ketë myslimanë. Ndoshta edhe më shumë. Vdekja ime nuk e ndryshon dot përhapjen e Islamit në Shqipëri dhe prandaj do ishte e kotë. Nuk dua të vdes, tha Mihali dhe filloi të qante. Ibrahimit iu dhimbs.

Nuk është e nevojshme të bëhesh mysliman, tha vrazhdë Aliu. Të paktën jo sot. Unë dua që ky fshat të mësohet t'i pranojë myslimanët sepse kështu respekton ekuilibrat e botës. Kjo botë ka të bardhë dhe të zinj, ka të drejtë dhe të shtrembër, ka të djathtë dhe të mëngjër, ka lindje dhe perëndim, ka dimër dhe verë, ka femra dhe meshkuj dhe ka kaurë e myslimanë. Fshati do ishte i pajetueshëm sikur të kishte veç meshkuj që kishin vetëm dorën e djathtë, të kishte vetëm dimër, të kishte vetëm desh dhe të gjithë këta të ishin të zinj. E kupton ç'po të them? Mihali vari kokën dhe tha: Po kush na thotë çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe? E mirë është çdo gjë që na shërben për t'u bërë më të fortë se të tjerët. Po të mos kishte krishterim nuk do kishte myslimanë. Ibrahimi u bë mysliman sepse u ndie i kotë kur shkoi në Pazar dhe pa sesi të gjithë fitonin, por ai jo. sikur në këtë fshat të gjithë të bëhen myslimanë, atëherë punët do jenë më zi se sot. Kjo do të

ndodhë dikur, por ti nuk do t'ia arrish asaj dite, tha Aliu duke dalë. Kali e priste jashtë, por ai vazhdoi në këmbë.

Dielli i pasdites i hynte në kraharor duke e ngrohur të gjithin. Stomaku i mbushur, i shpërndante fuqi kockave të tij të reja, ndërsa zemra i rrihte si një daulle bajrami që lajmëron besimtarët se ka ardhur ora për të shijuar të mirat e kësaj bote. A do bëja të njëjtën gjë, për të mbrojtur një të krishterë nga myslimanët, mendoi me vete dhe i dha vetes përgjigjen që i kishte thënë Mihalit. Ia vlen të bësh çdo gjë që të bën më të fortë se të tjerët.

Ali Tepelena shihte larg. Deri para disa vitesh, ishte një kusar që vidhte bagëti nëpër fshatra dhe sulmonte karvanët. Në qoftë se nuk sulmon, të sulmojnë. Ky ishte predikimi që ai mbante mend nga e ëma, të cilën për këtë arsye e konsideronte si të vetmin profet të dobishëm të jetës së vet. Duke sulmuar, kishte bërë emër dhe pasuri dhe kjo ishte një rrugë nga e cila ai besonte, se mund ta ndalte vetëm vdekja. Vetëm një herë ishte tërhequr Aliu. Në atë kohë nuk ishte më shumë se dhjetë vjeç. Sipas zakonisht, djemtë e vegjël në fshatin e tij luftonin se cila familje do të merrte dashin e madh të ngjyer me bojë të kuqe, të pashkës. Ai i mundi një nga një të gjithë moshatarët e vet, të cilëve ua vinte shqelmin në fyt, derisa ata dorëzoheshin nga mungesa e frymës. Kur të gjithë prisnin që të njëjtën gjë t'i bënte edhe kundërshtarit të fundit ai e fali, i hoqi këmbën nga zverku dhe pastaj djali tjetër e shtriu dhe e poshtëroi në mes të fshatit. Familja e tij e humbi dashin e pashkës atë vit. E ëma e rrahu në shtëpi kur ai i tha se nuk e kishte mundur djalin sepse ishte shumë i bukur dhe atij i kishte ardhur keq. Më vinte ta puthja dhe jo t'i merrja firohen, i tha Hankos që e shikonte si egërsirë. Vish një nga fustanet e sat motre dhe futu në harem, e kishte përqeshur ajo.

Aliu ia njihte këtë dobësi vetes. Atë e ndalte vetëm bukuria. Pushteti dhe paraja e joshnin dhe e ndërsonin. Ku po shkoj kështu, tha me vete të mbroj një mysliman? A kishte vërtet rëndësi për të fati i një myslimani në një fshat të humbur si ky? Iu kujtua Demir Hani që para njëqind vjetësh bridhte fshatrave të Shqipërisë për t'i bërë të krishterët t'i faleshin Muhamedit. Sa pa kuptim e kishte harxhuar jetën Demir Hani. A ia vlen të vdesësh për t'i kthyer njerëzit nga Jezu Krishti te Muhamedi dhe anasjelltas? Dy profetët ishin në qiell: njëri me një gotë qumësht e tjetri me një gotë verë, ndërsa shqiptarët grinden se gota e secilit prej të dyve zbrazet e para. Grinden sepse u mungon dikush, dikush prej mishi dhe kocke, dikush që të mund t'i drejtojë dhe që ata ta shohin me sy dhe ta prekin me dorë. Profetët janë të dobët sa janë mes njerëzve, por ata forcohen kur ngrihen në qiell. E kundërta ndodh me prijësit. Kur janë në tokë ata janë zot, kur ngrihen në qiell, harrohen. Sidomos myslimanët i harrojnë shpejt prijësit e tyre. Kjo sepse fuqia e tyre nuk trashëgohet, por jepet ose merret nga Porta e Lartë. Të krishterët e trashëgojnë pushtetin nga baballarët te bijtë dhe kjo i lidh njerëzit me emrin e të parit të tyre.

Teksa përsiatej kështu i doli përpara një vajzë e vogël me sy të zinj dhe faqe të kuqe. Gërsheti i zi pas koke i varej deri te beli. Rruga ishte bosh dhe vajza nuk po luante me asnjëri.

Si të quajnë, iu përkul Aliu. Sara, u përgjigj vajza. E kujt je ti Sara? Jam e Arianit Komnenit, tha vajza dhe tundi gërshetin siç tundte kalë bishtin kur i kujtohej i zoti. Aliu u ngurtësua në fytyrë dhe vajza i tha: Mysliman je ti? Pa kuptuar, Aliu u skuq dhe ndoshta kjo ishte e para dhe e fundit herë në jetë që i erdhi turp të pohonte se ishte mysliman. Sara nuk priti që ai t'i thoshte po. u zhduk pas një dere të madhe druri që dukej si derë kisha. Gërsheti e tërhiqte vajzën si një litar, të cilin Aliu e ndoqi pas. Duke ecur nëpër oborrin e gjatë të shtëpisë iu duk vetja si një njeri që kërkon të lidhë hënën me litar, për ta futur në trup.



Arianit Komneni i mbuluar me një velenxë të kuqe dhe të trashë nuk u ngrit nga vendi kur Ali Tepelena u fut në dhomën e tij. Mjekra e tij e bardhë zgjatej si një njollë qumështi mbi të kuqen e velenxës. Kur Aliu u afrua për ta takuar, Arianiti u kollit fort. Aliu mendoi se plaku u kollit për të mos i uruar mirëseardhjen. Poshtë velenxës fshihej trupi i një burri të gjatë dhe kockëmadh, të cilin pleqëria e tregonte edhe më të madh. Flokët e bardhë dhe të lëshuar i binin mbi fytyrën pa rrudha gjë që të krijonte përshtypjen e një njeriu që mendohet në errësirë. Këtë fytyrë do desha të kem në moshën e tij, mendoi Aliu dhe vendosi të flasë i pari.

Kam ardhur të flasim për Ibrahimin, i tha. Ai është bërë mysliman pa e detyruar kush. Pleqësia ka vendosur ta zhburrërojë ose ta detyrojë të largohet nga fshati. Ai nuk do të largohet sepse këtu ka gjithçka. Ju duhet ta pranoni myslimanin siç e pranon gjithë bota.

Arianit Komneni nuk lëvizti, por velenxa e kuqe u duk sikur u fry kur ai u përgjigj. Pleqësia ka vendosur atë që gjykoji se ishte e drejtë, tha ai dhe u kollit prapë. Fshati nuk i do myslimanët. Ne kemi katërqind vjet që nuk pranojmë Islamin. Burra e gra janë therur nga turqit dhe nuk kanë pranuar të ndërrojnë fenë. Ibrahim i nuk mund të ndryshojë drejtimin e varreve tona. Në qoftë se do të jetojë si mysliman të gjejë një vend tjetër.

Ali Tepelena e kishte menduar më të lehtë bisedën me Arianit Komnenin dhe kur e dëgjoi që foli ashtu ndjeu një flakë që i dogji gjoks. E nxori pa zhurmë frymën që i digjte kraharorin, por në vend të tij, u kollit Arianiti.

Islami ka një mijë vjet që pushton fshatra dhe qytete dhe miliona burra dhe ushtri janë përpjekur, por të gjithë kanë dështuar ta ndalin, tha Aliu. Mos mendo se je më i fortë se ata Arianit. Një pikë ujë nuk e kthen dot drejtimin e dallgës Skënderbeu i rezistoi Islamit 25 vjet dhe në fund dështoi dhe ai. Jam i bindur që ka vdekur duke menduar se sakrifica e tij ishte e kotë sepse jo vetëm që shumë shqiptarë vdiqën, por se lufta e tij i nxiti turqit të mendojnë se shqiptarët nuk i duan dhe prandaj kemi qindra vjet që përpëlitemi pa ushtri dhe pa shtetin tonë. Në qoftë se Skënderbeu do t'i ishte bindur turqve, shqiptarët nuk do kishin humbur kaq kohë dhe në paqe me islamin do kishin shtetin e tyre tri herë më të madh dhe më të fortë. Në fund të fundit ç'ëndësi ka nëse je mysliman apo i krishterë. Rëndësi ka si jeton. Më mirë një i krishterë i varfër dhe i mjerë apo një mysliman i pasur dhe i fortë? Unë zgjedh të dytën dhe këtë duhet të kishte zgjedhur dhe Skënderbeu e pas tij të gjithë ne të tjerët. Ne shqiptarët nuk kemi ditur të bëjmë paqe me kushtet tona me perandoritë, por si një tufë e përçarë dhe pa bari kemi pranuar një nga një zakonet dhe fenë e tyre. Këtë nuk e kemi bërë me marrëveshje dhe prandaj perandoritë, përfshi dhe Turqinë nuk na e kanë njohur nënshtrimin si pranim të arsyeshëm, por si detyrim të shkaktuar nga frika dhe varfëria.

Arianiti po e ndiqte me të njëjtën qetësi, por Aliu e kuptoi se kjo temë i kishte prekur një tel të fshehtë të shpirtit të tij që ashtu si pamja e tij profetike jetonte në historitë e lashta.

Skënderbeu nuk luftoi Islamin dhe kjo është një nga mashtrimet më të mëdha të historisë sonë, tha plaku qetësisht. Dikur e ka pohuar dhe vetë se nuk luftonte Islamin, por turqit. Duhet të dish se ai luftoi për pushtet, jo për besim. Gjatë gjithë jetës ëndërroi të ishte mbret i Shqipërisë dhe në qoftë se turqit do t'ia kishin njohur mbretërimin ai do të ishte bërë prapë mysliman siç ishte gjatë gjithë rinisë së tij. Skënderbeu, si gjithë shqiptarët deri më sot, besonte se mund të krijonte perandorinë e tij të vogël brenda perandorisë së madhe, por kjo ishte dhe është e pamundur dhe kushdo që do të përpiqet do të dështojë njëlloj si ai. Dështimi i Skënderbeut ishte dështim i racës sonë, e cila për fat të keq beson se mund të pasurohesh si turk duke jetuar si i krishterë. Shqiptarët e kanë të vështirë të zgjedhin dhe këtu u ngatërrua edhe Skënderbeu. Ai donte të kishte mbretërinë e tij brenda Islamit, por me kusht që atë ta qeveriste në stilin e evropianëve të krishterë, të cilët i trashëgojnë mbretëritë e tyre brez pas brezi. Por kjo është e pamundur, sepse

Islami nuk ia njuh të drejtën e trashëgimisë njeriut. Islami beson se gjithçka ta jep dhe ta merr Zoti ose ai që përfaqëson Zotin mbi tokë dhe kësisoj shuan çdo ambicie të njeriut për të ndërtuar diçka që ia vlen ta lësh pas vdekjes, që njerëzit ta kujtojnë dhe ta nderojnë, kur ti të mos jesh më mes tyre. Islami e mëson njeriun të mendojë se në këtë tokë ai ka ardhur vetëm për të nderuar Allahun dhe për asgjë tjetër dhe prandaj myslimanët nuk punojnë, nuk pikturojnë dhe nuk kanë art, si të krishterët. Nga myslimanët, vetëm Muhamedi trashëgoi te pasardhësit e tij pushtet dhe pas tij edhe sulltanët e askush tjetër. Skënderbeu e kuptoi me vonesë se kjo e drejtë atij nuk do t'i njihej. Ambicien e tij prej të krishterit të dështuar e kuptuan shpejt edhe venecianët dhe me gjithë lutjet e tij, ata nuk e ndihmuan të krijonte një mbretëri të krishterë në Shqipëri. Venecianët kuptuan se shqiptarët nuk e kanë shqisën e të jetuarit nën një zot dhe nën një mbret të vetëm, të cilit i binden etër e bij. Këtë ata e kishin mësuar nga bizantinët dhe ata e kishin mësuar nga romakët. Më thuaj, çfarë mbretërisht kemi pasur në Bizantin e krishterë, i cili ishte e vetmja perandori e madhe e botës që i lejonte popujt e saj të krijonin mbretëritë e tyre të pavarura. Grekët i patën perandorët e tyre në Bizant. Bullgarët dhe serbët po ashtu. Hungarezët dhe rusët natyrisht. Po shqiptarët pse nuk ndërtuan dot mbretëri gjatë një mijë vjetëve bizantine? Kam gjithë jetën që e mendoj atë që të thashë: shqiptarët nuk dinë të zgjedhin dhe ç'është më e keqja nuk dinë të mbrojnë atë që zgjedhin dhe akoma më keq ata e tradhetojnë shpejt atë që zgjedhin. Ibrahim është një shqiptar i vërtetë, por historia më thotë se duke qenë kaq i vërtetë, ai është i padobishëm dhe madje është i dëmshëm. Prandaj nuk mund ta pranoj në fshat sepse nuk dua që historia të përsëritet duke e shkatërruar fshatin tim. Jetoj me shpresën se derisa të vdes nuk do të lejoj që Skënderbeu të lindë në këtë fshat.

Ali Tepelena u ndie i dobët kur kuptoi se nuk dinte se si ta kundërshtonte Arianit Komnenin. Ai nuk i njihte si plaku historitë e vjetra dhe gjithnjë kishte menduar se sa më pak prej tyre të dinte aq më të lehtë do ta kishte jetën. Nëna i thoshte gjithnjë se historia e jetës së tij duhej të ishte krejtësisht e ndryshme nga historia e jetës së të atit. Por me kalimin e viteve Aliu ishte bindur se nuk mjafton të bësh pikë për pikë të kundërtën e babait për të qenë i pasur dhe i pushtetshëm. Po qe se ky rregull do të ishte i vlefshëm, historia e njerëzimit do të kishte mbetur në vend si një kalë, të cilit i janë lidhur këmbët. Një hap para dhe pastaj një hap prapa dhe nuk shkon asgjekund. Tani që Arianiti e kishte lidhur edhe atë pas fijeve të historisë Aliut iu kujtua e ëma. Ndryshe nga Arianiti ai kishte arsye të mendonte se e vërteta e jetës së njeriut nuk mund të gjendet në të vërtetën e jetës së dikujt tjetër, por ndoshta është më lehtë të tentosh të kundërtën e jetës së dikujt, për të arritur tek e vërteta dhe suksesi. Këtë ia tha edhe Arianitit, i cili e shijonte me modestinë e një ikone të varur në mur habinë që i kishte shkaktuar vizitorit të vet.

Dikush duhet të përpiqet të bëjë të kundërtën e Skënderbeut. Përderisa ti mendon se ai dështoi, dikush që bën të kundërtën e tij mund të ketë sukses. Në qoftë se njëri prej nesh bën paqe pa kushte me Islamin në emër të gjithë myslimanëve shqiptarë atëherë mund të arrijmë atë që nuk e kemi pasur kurrë, shtetin tonë, tha ai duke mbyllur sytë kur fliste.

Gabohesh, foli Arianiti. Njeriu nuk e ndryshon dot historinë siç nuk mund të ndryshojë fytyrën e vet. Qindra burra kanë menduar si ti, përfshi edhe Ibrahimin, i cili beson se duke u bërë mysliman mund të mbetet një shqiptar qe e fiton bukën e përditshme në paqe me pushtuesin e vet. Kjo është një paqe e gënjeshtërt që nuk i jep njeriut lumturi, as në këtë botë dhe as në tjetrën, nëse ajo ekziston. Skënderbeu e humbi paqen me veten kur u bë mysliman që i vogël, në oborrin e Sulltanit dhe vuajti edhe më shumë kur u kthye në Shqipëri dhe u bë prapë i krishterë për të bindur shqiptarët e tjerë ta pranonin si mbretin e tyre. Skënderbeu e ndiente se shqiptarët nuk e besonin megjithëse ata iu bindën dhe luftuan bashkë me të duke shpresuar më kot në triumfin e një turku mbi turqit e tjerë. Shqiptarët e kanë parë gjithmonë Skënderbeun si turk prandaj kurrë

nuk e besuan me të vërtetë. Por as turqit nuk e besuan Skënderbeun. Të parët sepse ai u bë mysliman dhe të dytët sepse ai u bë i krishterë. Duke kaluar ylberin e Zotit, Skënderbeu u bë i pabesueshëm. Shqiptarët e dinin se ai luftonte për pushtet dhe kjo është një ambicie që ata i lodh dhe nuk i inkurajon për një kohë të gjatë. Prandaj, qëllimi i tij mbaroi ditën që ai vdiq, sepse nuk kishte krijuar një bindje të trashëgueshme. Sot, shqiptarët mund ta duan paqen me turqit, por turqit nuk e duan më këtë sepse ata e dinë që shqiptarët mund t'i nënshtrosh më kollaj pa iu dhënë favoret që garanton paqja. Për faj të Skënderbeut, sot as turqit dhe as evropianët nuk i besojnë më shqiptarët. Në rrugët e historisë sonë gjithmonë kanë ecur burra, të cilët nuk kanë ditur ku shkojnë. Unë mendoj se këtu ka një dorë hyjnore, e cila vendos që shqiptarët të udhëhiqen nga njerëz, të cilët në fund munden nga dilemat e tyre. Ka popuj, të cilëve Zoti nuk i ka dhënë akoma asnjë rrugë, siç janë çifutët. Ka të tjerë, të cilëve ai ua ka përcaktuar rrugën, siç janë të krishterët dhe turqit. Por ka raste kur Zoti vendos të luajë me njerëzit sepse kjo me sa duket i shërben si çlodhje në mes të punëve të shumta që ka.

Kur isha i vogël, unë merrja dy milingona që i vija një hap larg një copë bukë për të kuptuar se kush prej tyre dhe pse do ta gjente rrugën drejt ushqimit. Për çudinë time, të dyja e gjenin bukën me të njëjtën shpejtësi dhe në të njëjtën kohë dhe kurrë nuk më ka qëlluar ndryshe. Milingonat janë një racë, së cilës Zoti i ka dhënë vetëm një drejtim. Por ky nuk është rasti i shqiptarëve. Milingonat kanë më shumë fat se shqiptarët sepse janë më të vendosura. Zoti ka vendosur t'i lërë shqiptarëve dy rrugë dhe argëtohet kur sheh që atje lart se si ata lodhen dhe nuk e zgjedhin dot rrugën që duhet. Deri më sot të gjithë kanë zgjedhur rrugën e gabuar.

Kështu i ndodhi edhe Skënderbeut. Historia do të kishte ecur ndryshe në qoftë se në vend të Skënderbeut do të kishte qenë dikush tjetër, i cili nuk vinte nga oborri i Sulltanit dhe të cilit shqiptarët do t'i kishin besuar bashkë me pushtetin dhe fenë e tyre, deri në atë kohë të papërlyer. Siç tregon historia, edhe venecianët dhe Papa në Romë këtij njeriu i besonin më shumë dhe do ta kishin ndihmuar të krijonte një mbretëri të krishterë, e cila mund t'i rezistonte kohës jo vetëm si kujtim, por si një gjë e gjallë.

Aliu kroi kokën dhe iu duk sikur milingonat e historisë po i vraponin nëpër flokë. Kush ishte ky njeri, pyeti ai.

Ky ishte Arianit Komneni, tha Arianit Komneni. Unë kam emrin e tij. Atij i thoshin edhe Gjergji, por këtë emër e mban im bir i madhi. Aliu nuk pati nevojë t'i kërkojë plakut më shumë sepse ky filloi t'i tregonte për historinë e familjes së vet. Duke dëgjuar, Aliu pati ndjesinë se po jetonte në një kohë tjetër, e cila e ndriçonte kohën e tij ashtu si dielli ndriçon hënën duke perënduar.

Kommenët e kanë qeverisur Perandorinë e Bizantit për më shumë se njëqind e pesëdhjetë vjet. Grekët thonë se ata janë grekë, por unë dua të besoj se janë një racë me shqiptarët që jetojnë sot në Voskopojë. Ata kanë folur dhe kanë shkruar greqisht pa dyshim dhe e kanë drejtuar perandorinë deri kur Kostandinopoja u pushtua dhe u përdhunua nga kryqëzata e krishterë dhe kur Komnenët ikën të përndjekur nga qyteti. Njëri prej tyre, Mihali, i cili ishte nip i Teodorës, vajzës së perandorit të parë Komnen, erdhi në vitin 1204 në Shqipëri dhe u vendos në Janinë. Për shkak të emrit të madh që kishte familja e tij ai u bë princ dhe Janina ishte kryeqytet i kësaj principate dhe unë dua të besoj se kjo është e para mbretëri e pavarur e shqiptarëve. Komnenët e mbajtën principatën e Janinës deri në vitin 1318 me princin e fundit Thoma Komneni, i cili u vra nga djali i motrës së tij. Thoma Komneni, la pas një djalë, i cili, për t'i shpëtuar hakmarrjes së kushërinjve të tij, u fsheh në malësitë që ndajnë Vlorën me Gjirokastrën, në një fshat që quhej Arianit. Aty u martua me një shqiptare nga një derë e mirë e fshatit dhe jetoi pa kërkuar ofiq dhe pushtet derisa vdiq.

Djali i tij, që trashëgoi emrin Arianit, si dhe emrin e fisit, ishte Arianit Komneni, i cili lindi ndoshta në vitin 1400. Ky bëri krushqi me një nga vajzat e familjes së madhe të Muzakajve, të cilët i shtrinin zotërimet e tyre nga Korça deri në Gjirokastrë.

Arianit Komneni ishte prijësi i munguar i shqiptarëve. Në qoftë se Skënderbeu nuk do ta kishte mashtruar me mënyrën tipike turke, shqiptarët do të kishin gjetur tek ai mbretin e tyre, me prejardhje nga perandorët e Bizantit dhe kjo lidhje nuk do t'i kishte ndarë më ata nga krishterimi evropian dhe sot ne do të jetonim në një mbretëri të krishterë. Arianiti ishte një luftëtar i madh. Ai filloi i pari luftën kundër turqve në vitin 1432, dhjetë vjet përpara se Skënderbeu të kthehej si mysliman në Shqipëri për të ndërruar rrjedhën e gjërave. Arianiti nuk humbi asnjë nga betejat e tij me turqit dhe kryengritjet e tij vazhduan gati gjashtë vjet me radhë nga Voskopoja në Tepelenë, nga Gjirokastra në Elbasan, derisa Sulltan Murati u detyrua t'i njohë zotërimet e tij përgjatë lumenjve të Shkumbinit dhe të Vjosës. Kur Skënderbeu erdhi në Shqipëri, Arianit Komneni ishte kryezoti i Shqipërisë dhe pa dyshim princi, të cilin shqiptarët respektonin më shumë. Skënderbeu e kuptoi se pa mbështetjen e tij nuk mund të kishte sukses dhe në fillim ai u vu nën urdhrat e Arianit Komnenit, i cili vendoste për gjithçka. Arianiti besoi se Skënderbeu mund t'i printe luftërave kundër turqve duke qenë i stërvitur prej tyre si një ushtarak i zoti. Besimi që kishte ndaj tij si luftëtar e bindi ta mbështeste si kapedan të parë, kur në Lezhë u mblodhën gjithë princat e Shqipërisë në vitin 1444. Në të vërtetë kjo ishte besëlidhja e Arianitit. Përfaqësuesit e familjeve të mëdha shqiptare erdhën për të shpallur Arianit Komnenin si sundimtar dhe mbrojtës të tyre dhe kërkuan që nën flamurin e tij të luftonin të gjithë bashkë kundër turqve. Por Skënderbeu iu lut Arianitit t'ia ngarkonte atij këtë mision duke i premtuar se në qoftë se do t'i mundnin turqit dhe Shqipëria do të shpallej shtet i pavarur, Arianiti do të ishte mbret i saj. Arianiti pranoi dhe bindi edhe princat e tjerë të vendit, të cilët nuk donin të pranonin një mysliman si Skënderbeu për të parin e tyre. Me ndihmën e ushtrisë që kishte krijuar Arianiti dhe që tani e drejtonte ai, Skënderbeu filloi t'u merrte turqve territore, të cilat më parë kishin qenë në zotërimin e Arianit Komnenit. Ky i kërkoi që këto toka t'i ktheheshin, por Skënderbeu nuk pranoi dhe filloi t'i qeveriste vetëm. Kur Skënderbeu u rrethua herën e parë në Krujë në vitin 1450, ai i kërkoi ndihmë Arianitit. Gjyshi im thoshte se kur të dy burrat u takuan në Durrës, Skënderbeu i kërkoi falje Arianit Komnenit duke i thënë se do t'ia kthente të gjithë tokat dhe sapo të iknin turqit ai do thërriste gjithë princat siç kishin vepruar në Lezhë për ta shpallur Arianit Komnenin mbret të Shqipërisë. Arianiti nuk e besoi Skënderbeun, por megjithatë i premtoi ta ndihmonte me para dhe ushtarë për të përballuar rrethimin. Arianit Komneni në atë kohë nuk kishte djem nga martesat e tij me Maria Muzakën dhe kishte frikë se nëse vdiste apo e vrisnin, askush nuk do të trashëgonte emrin dhe pronat e tij të shumta. Skënderbeu ia dinte këtë dobësi dhe e shfrytëzoi bukur duke i kërkuar dorën e së bijës, Donikës me qëllim që ta zbuste dhe të garantonte aleancën me të. Arianit Komneni i mençur pranoi dhe i tha Skënderbeut: Edhe në qoftë se unë nuk bëhem mbret i Shqipërisë një ditë nipi im do të bëhet. Skënderbeu djallëzor, për shkak të edukatës turke që kishte marrë, ia ktheu: Në qoftë se ti më pengon mua të bëhem Mbret i Shqipërisë djalin tim nuk e pengon dot.

Rrethimi i Krujës u thye dhe po atë vit Skënderbeu u martua me Donikën, por marrëdhëniet me vjehrrin e tij të fuqishëm nuk i përmirësoi. Arianiti e humbi përfundimisht besimin te Skënderbeu kur më vonë mori vesh se ky i kishte ofruar Krujën Venedikut duke kërcënuar se në rast se ata nuk e ndihmonin, ai do t'ua linte atë turqve pa bërë asnjë rezistencë. Ftohja e tyre e dobësoi Skënderbeun, i cili filloi të humbte disa betejat ndaj turqve. Më e rënda ishte ajo e Beratit për të cilën ai akuzoi Moisi Golemin, luftëtarin më të shquar të asaj kohe që ishte nipi i Arianitit dhe që ky e mbante pas dhe e thërriste djalë. Moisiu, që kishte në zotërim Dibrën, i la turqit të

kalonin nëpër tokat e tij dhe këta i ranë pas shpine mbrojtësve të kalasë së Beratit duke e shkatërruar ushtrinë e Skënderbeut. Im gjysh thoshte se Arianit Komneni donte t'i jepte një mësim Skënderbeut, i cili në fund të jetës kishte pranuar se prishja e aleancës me vjehrrin kishte shënuar fillimin e rënies së tij. Por Skënderbeu ishte edukuar si mysliman dhe unë nuk besoj se atë e ka vrarë ndërgjegjja, por është e vërtetë se në qoftë se do t'ia kish mbajtur fjalën Arianit Komnenit, ne sot do të jetonim ndryshe.

7

Ndërsa Arianit Komneni rrëfente historitë e tij, Ali Tepelena nuk kishte lëvizur nga vendi duke menduar se ky plak i krishterë kishte vendosur t'i tregonte rrënjët e familjes së tij njëlloj si një rrap i moçëm që i nxjerr rrënjët mbi tokë pas tërmetit. Ndoshta mendon se madhështia e emrit të tij do të më bindë ta lë të qetë për të zotëruar fshatin, siç kishte bërë me sa duket në gjithë këto vite. Arianit Komneni ishte shumë i zgjuar, por vitet ia kishin humbur prakticitetin. Megjithatë, ky arsytim nuk e ngopi Aliun. Nuk është llafazan, mendoi, diku do të dalë. Ali Tepelenës i kishin bërë përshtypje sidomos historitë mbi Janinën, një qytet që ai e kishte për zemër. Duke u rropatur të nguliste në mendjen e tij të re ato që kishte dëgjuar nga Arianiti, dera u hap dhe vajza e vogël me gërshet të zi u afrua tek i ati dhe i zgjati një enë të mbushur me arra të mëdha bojëkafe. Vajza doli pa ia hedhur sytë, por Aliut iu duk sikur gërsheti i saj filloi t'ia lidhte jetën me historinë e Arianitëve dhe sidomos me Janinën nga ku e kishte zanafillën historia shqiptare e Komnenëve.

Arianit Komneni e tërhoqi nga këto mendime kur i tha: Jam nëntëdhjetë e dy vjeç. Kam tre djem. I madhi quhet Gjergj si Arianit Komneni i madh. I dyti quhet Mihal si Mihali që ngriti të parën principatë shqiptare të krishterë në Janinë. I treti quhet Gjon dhe ka marrë emrin e djalit të Skënderbeut, nipit të Arianitit dhe që përbën të vetmen lidhje mes dy burrave, të cilët Islami i ndau në fe dhe krishterimi nuk i bashkoi dot në pushtet. Sara është vajza ime e vetme. Është pesëmbëdhjetë vjeç dhe besoj se pas saj nuk do kem më fëmijë.

Mori një arrë të madhe dhe, duke e shtyrë me një thikë të vogël që nxori nga poshtë velenxës, filloi ta hapte pa u ngutur. Merr dhe ti një, i tha Aliut. Arianit Komneni i Madh i kishte qejf dhe luante shumë me to. Një herë hapi një arrë më të madhe se kjo, shumë më të madhe, në dysh dhe duke lexuar fletët dhe rrudhat e saj të njoma i tregoi Skënderbeut se njëlloj si arra edhe truri i njeriut formohet nga dy pjesë. Në qoftë se nuk e di ato quhen hemisfera, i tha me modesti Aliut, i cili nuk bëri asnjë shenjë. As Skënderbeu nuk e dinte, por i tha Komnenit se kur kishte vrarë njerëz gjatë betejave shpesh i kishte rastisur të shihte tru të ndarë më dysh që i ngjanin kësaj arre. Arianiti kishte qeshur dhe i kishte thënë: Ja pra, ky është ndryshimi mes ne të dyve. Ti do ta ndash trurin në dysh, kurse unë dua ta lexoj.

Aliu sërisht nuk lëvizi dhe Arianiti vazhdoi:

Arianit Komneni nuk pati asnjë djalë me Maria Muzakën dhe kjo e mërziti shumë derisa u tërhoq nga luftërat, të cilat nuk i jepnin më kënaqësi. Besoj se përveç zhgënjimeve familjare dhe ato që gati nga gënjeshttrat e Skënderbeut, ai nuk besonte më se Shqipëria mund t'i rezistonte pushtimit turk. Me Maria Muzakën u mundua, por ajo i dha njëra pas tjetrës nëntë vajza. Kur humbi shpresat, iku në Itali dhe u martua me një italiane, e cila i dha atij tre djem. Por djemtë lindën kur Arianiti ishte në fund të jetës dhe kur mundësitë për të rivendosur pushtetin që kishte ishin zvogëluar sa nga turqit, po aq edhe nga Skënderbeu. Krushqitë që ai bëri për vajzat e tij tregojnë se ishte jo vetëm një strateg i madh, i cili synonte të zbuste gjithë pretendimet për territore që vinin nga brenda dhe nga jashtë Shqipërisë.

Siç të thashë, njëren vajzë, të madhen, ia dha Skënderbeut. Vajzën e dytë, Vojsavën e martoi me princin e Malit të Zi, Ivan Cernojeviçin, i cili ishte një nga njerëzit më të shquar të kohës së tij. Tri vajza të tjera i martoi në derën e Dukagjinëve, princave të veriut të Shqipërisë duke forcuar kështu aleancën me një nga familjet më të mëdha shqiptare me të cilat nuk kishte lidhje gjaku. Një vajzë tjetër e martoi me Gojko Balshën, edhe ky nip i Gjergj Stres Balshës së madh. Tre të tjera i dha në Itali kryesisht në Venedik dhe Napoli nëpër dyer të mëdha me lidhje politike. Ndërsa Angjelinën, vajzën e tij më të dashur që ai thoshte se i ngjante gjyshes së tij, ia dha Stefan Brankoviçit princit të Serbisë dhe stërnipit të Stefan Dushanit të madh. Kur Stefani u martua, ai sapo ishte qorruar nga Sulltani, të cilin e kishte kunat dhe thonë se Angelina qau kur e pa ashtu dhe deri në fund të jetës e mbajti për dore.

Krushqitë e Arianit Komnenit ishin krushqi me shije perandori siç ishte në të vërtetë ai. Siç të thashë, vetëm gruaja italiane i dha atij djemtë që i kishin munguar për të mbretëruar Shqipërinë. Ata ishin Kostandini, të cilit Mbreti i Francës i fali një dukat në veri të Italisë, Arianit dhe Thomai. Ky i fundit ishte i vetmi që u kthye në Shqipëri. Me sa duket çdo derë e madhe ka tradhtarët e vet dhe Thomai qëllon plëngprishësi i Arianitëve sepse u vu në shërbim të turqve, të cilëve u kërkoi pjesë nga zotërimet e shumta që ata i kishin marrë babait të tij. Për t'u bërë më i besueshëm, Thomai u bë mysliman dhe turqit i dhanë Himarën ku ai u bë një sundimtar mizor. Thonë se Thomai natën shkante dhe i merrte me forcë gratë dhe vajzat fshatarëve të bregut dhe pastaj i ndante ato me ushtarët e tij. Një ditë, fshatarët u mblodhën dhe e vranë. Kjo ndodhi në vitin 1486. Djali i vogël i Thoma Komnenit ishte stërgjyshi im.

Ai bashkë me farefisën dhe të ëmën u fshehën për pak kohë sa të harroheshin zullumet e babait dhe më pas u vendosën këtu ku ngritën këtë fshat, të cilin stërgjyshi e zgjodhi pranë Janinës, duke jetuar me shpresën se kur të ikin turqit ne do t'i kthehemi historisë së Komnenëve shqiptarë, aty ku ajo nisi: në Janinë. Unë nuk e besoj më këtë ëndërr të plakur dhe jam i sigurt se as djemtë e mi nuk do t'ia arrijnë asaj dite. Islami sapo ka ardhur në këto troje dhe dita kur ai të ikë është akoma shumë larg.

Arianit Komneni pushoi, por nuk dukej i lodhur. Pas historive që kishte dëgjuar Ali Tepelena dukej më miqësor se në fillim. Tani ai e shikonte plakun si një libër me shumë faqe dhe me sa duket kjo e zbuti, siç zbutet çdo njeri që lexon mes dy betejave. Kur kishte ardhur ta takonte, Ali Tepelena mendonte se nëse pleqësia do ta kundërshtonte, ai do ta zgjidhte çështjen e Ibrahimit me ndihmën e trimave të tij, të cilët ishin të gatshëm në çdo kohë të masakronin një fshat të krishterë. Por tani Aliu që e kishte ndjekur me vëmendje Arianitin, mendonte se duke e zbutur plakun marrëveshja e tij me fshatin do të mund të ishte më e plotë dhe më e respektueshme nga të gjithë.

Duke marrë arrën e fundit që kishte mbetur, Aliu e pyeti: Po ti Arianit si i ke jetuar këta 92 vjet? Arianiti që duket se e priste këtë pyetje u përgjigj pa u menduar: Kam jetuar si një Komnen dhe po mendoj se si do të vdes si i tillë.

Kur linda unë, fshati kishte dy herë më pak shtëpi sesa sot. Babai drejtonte pleqësinë, e cila kryesisht përbëhej nga kushërinj ose krushqi të tij sepse siç e thashë, ky fshat u themelua nga stërgjyshi im dhe njerëzit e afërt të tij, prandaj shumica këtu jemi të një gjaku. Por babai vuajti gjithë jetën nga frika e shuarjes së fisit tonë, i cili sipas tij do rrezikohej një ditë në qoftë se ne vazhdonim të jetonim të izoluar në këtë vend. Ai pati pesë djem dhe unë isha më i vogli prej tyre. Im atë jetonte gjithë kohën me lajmet që vinin nga betejat mes të krishterëve dhe turqve, por ato vite ishin kohët kur turqit u forcuan shumë dhe pothuajse e pushtuan gjithë Greqinë, Serbinë, Hungarinë dhe shkuan deri në Vjenë falë Kara Mustafa Pashës që ishte shqiptar nga dera e

qyprillinjve. Zoti e desh që ky u mund me turp në Vjenë dhe Sulltani ia preu kokën. Mos ishte për meritë të kryevezirëve shqiptarë qyprillinj Perandoria Turke do të kishte marrë tatëpjetën me kohë e me vakt. Historia do shpjegojë se pse shqiptarët e kanë mbajtur në këmbë Turqinë me jeniçerë dhe vezirë të mëdhenj, të cilët kurrë nuk kuptuan se ky përbindësh me trupin në Azi kishte ardhur të ushqehet në Evropë duke mbajtur me thonj vendin e tyre, pa e lënë të rritej.

Siç të thashë, babai jetonte në fshat, por mendjen e kishte gjetkë. Kur turqit filluan luftën për pushtimin e Kretës, të cilën e mbajtën të rrethuar për 25 vjet, babai mendoi se nëse thyhej ky front, turqit nuk do të ndaleshin më siç po ndodh në të vërtetë edhe sot. Ai ishte i bindur se krishterimi dhe sidomos Venediku, nuk do ta linte Kretën të binte në duar të turqve dhe kërkoi të kishte pjesën e vet në këtë fitore, prandaj dërgoi atje vëllanë tim të madh në krye të dhjetë burrave nga fshati. Asnjëri prej tyre nuk u kthye i gjallë pasi Kreta u pushtua nga turqit në vitin 1669, njëqind vjet përpara. Si për të bindur tim atë se shqiptarët vrasin shqiptarët për një copë dhe të huaj, Kretën e pushtoi një qyprilli tjetër, Fazil Pashai. Im vëlla atë kohë ishte 18 vjeç dhe bashkë me të në Kretë u vra edhe gjyshi i Ibrahimit që sot është bërë mysliman dhe që nuk kupton se eshtrat e të ndjerit, gjyshit të tij, tani po lëvizin atje ku dergjen. Babai u trishtua nga vdekja e vëllait tonë të madh, por besimi se aleanca e krishterimit mund ta detyronte Islamin të tërhiqej në Azi, aty ku Zoti ka parashikuar territoret e tij, nuk iu venit për asnjë çast.

Në vitin 1704 babai vendosi të shkojë në Turqi. Ne nuk e kishim ditur se ai mbante lidhje me një degë tjetër të Komnenëve në Itali. Ata e lajmëruan se në përkujtim të pesëqindvjetorit të rënies së dinastisë Komnene që ndodhi në vitin 1204, të gjithë trashëgimtarët e tyre të shpërndarë nëpër botë kishin vendosur të mblihdeshin në Stamboll. Do nisem të takoj kushërinjtë e mi, të cilët, kur turqit të thyhen një ditë, do qeverisin prapë Evropën, thoshte babai dhe kjo ia ktheu gëzimin që kishte humbur prej vitesh. Mirëpo kur po nisej, ai i kishte kaluar shtatëdhjetë vjeç dhe nuk kishte fuqinë e rinisë për të kryer një udhëtim aq të gjatë dhe të vështirë. Nëna këmbënguli që ai të merrte një nga djemtë me vete për ta ndihmuar dhe ai më zgjodhi mua.

Pas dy muajsh arritëm në Stamboll pasi u hodhëm nga Janina në Voskopojë e Kostur dhe prej andej përfunduam në Selanik ku i hipëm një anije tregtare që na çoi në qytetin e shenjtë. Kur anija jonë iu afrua portit, mbi të cilin xhamitë e Stambollit ngriheshin si direkë, sytë jeshilë të babait u errën. Kam ardhur të ta heq perçen e dashur, pëshpëriti babai me vete, sikur t'i drejtohej një gruajë që e kishte thirrur për ndihmë.

Takimin e Komnenëve e kishte organizuar Gjergj Brankoviçi, i cili punonte si agjent tregtar në një shoqëri angleze, por që në fakt ishte shumë i lidhur me perandorët e Austrisë. Brankoviçi ishte pinjoll i sundimtarëve të Serbisë, të cilët kishin lidhur krushqi me Komnenët, gjë që e bën krushk me ne, por dhe me Skënderbeun, i cili martoi djalin e tij me Irenën, vajzën e princit Llazar Brankoviç. Kur babai ia shpjegoi këtë lidhje, Gjergj Brankoviçi u mrekullua dhe e quajti babanë një vëlla të rigjetur në mes të detit. Është koha për t'u rikthyer në lavdinë tonë, tha ai në fjalimin që mbajti gjatë meshës së kujtimit të Komnenëve në një kishë të vogël greke që shikonte nga deti. Krishterimi humbi përballë turqve për shkak të përçarjeve të veta, por tani ne duhet të bashkohemi nën një flamur të krishterë pavarësisht se jemi shqiptarë apo serbë, apo grekë. Ky ka qenë ideali i Komnenëve të mëdhenj, të cilët ngritën Perandorinë më të madhe dhe më të ndritur të botës. Perandoria e Bizantit ishte e tillë sepse arriti të bashkojë nën një pushtet tre elementë që në rast se pajtohen prodhojnë qenien perfekte: një shpirt grek, një mendje romake dhe një trup mysliman. Ky është ekuilibri më i përsosur që ka parë historia. Çfarë nuk mund të arrijë një njeri që është i fortë si mysliman, i ndjeshëm si grek dhe i mençur si romak? Gjithçka motra dhe vëllezër, kushërinj dhe pinjollë Komnenë. Me këtë koktej pushtetesh, racash dhe dijesh do të ndërtohet Bizanti i ri, themeli i të cilit pa dyshim do të jetë Ballkani dhe çatia e tij do të jetë

Evropa. Ne sot jemi mbledhur këtu në Kostandinopojë për të nisur mbledhjen e gurëve të këtij themeli. Le t'i marrim gurët nga Serbia, nga Moreja dhe Rusia, nga Vjena dhe Venecia, nga Jerusalemi dhe Parisi, nga Athina dhe Janina e t'i bëjmë bashkë sepse kështu shtëpia jonë do ketë vend për të gjithë. Komnenët e mbledhur nga gjithë këto vende u frymëzuan dhe e mbështetën një nga një Gjergj Brankoviçin.

Babai i përlotur tha vetëm dy fjalë: Komnenë të nderuar, mirë se erdhët në ëndrrën time!

Më vonë, Gjergj Brankoviçi na shpjegoi se me ndihmën e perandorëve habsburgë po mendohej organizimi i një kryengritje të madhe të të krishterëve në Serbi, Greqi, Shqipëri dhe Bullgari, e cila duke u mbështetur nga Austria, Venediku dhe më pas edhe nga Rusia, do të synonte rënien e perandorisë së lodhur turke në pak kohë. Në fakt kjo ishte arsyeja e vërtetë e këtij takimi në Stamboll. Të gjithë mendonin se forcimi i Austrisë dhe Ruisë si Fuqi të Mëdha dhe luftërat e brendshme në Perandorinë Osmane e favorizonin ringritjen e krishterimit. Komnenët nisën t'i japin informacione për mundësitë që kishin për të mbledhur para dhe njerëz, ndërsa Gjergj Brankoviçi me një hartë të Ballkanit përpara caktonte me ngjyrë të kuqe pikat ku fillimisht do të ndizeshin zjarret.

Ato kohë në Stamboll takuan Komnenë nga të gjitha vendet përfshi edhe një stërnip të Skënderbeut, i cili quhej Anton Kastrioti që ishte një burrë i shkurtër dhe i hollë dhe që jetonte në Itali. Edhe Skënderbeu ka qenë i shkurtër, i tha ai babait kur u takuan. Por si ai, thirrjes së Brankoviçit i ishin përgjigjur edhe shumë kontë italianë dhe dukësha bullgare, pasanike greke dhe princa rusë, pinjollë të familjeve mbretërore transilvane, krushq të familjeve mbretërore franceze dhe suedeze si dhe një dukë i gjatë dhe bukurosh, i cili na tha se rridhte nga Huniadi, mbreti i Hungarisë dhe që megjithëse nuk kishte lidhje me Komnenët kishte ardhur të ndihmonte krishterimin. Kur rrinim me këta njerëz, të cilët kishin humbur lavdinë e dikurshme, por sidoqoftë kishin ruajtur pasuritë dhe pronat që i lejonin ta shijonin luksin e Stambollit, mendoja për fshatin tonë të varfër. Po ne pse nuk jemi me tituj si gjithë këta Komnenët e tjerë, pyeta babanë. Në tokën tonë nuk mbin fisnikëria, m'u përgjigj ai, por dukej se kjo diferencë me kushërinjtë e tij nuk e shqetësonte shumë.

Përgjatë një viti, Gjergj Brankoviçi bëri plane për të filluar kryengritjen e tij dhe ndihmat e Austrisë dukej se nuk i mungonin. Në gazetata austriake Brankoviçi ishte shpallur Kont i Perandorisë së Shenjtë. Ai na tregonte se si njerëz të caktuar nga vetë Perandori po rekrutonin me para luftëtarë në gjithë Ballkanin dhe pritej vetëm të ndizej fitili nga Vjena. Atëherë, i thoshte ai babait me sytë që i shkëlqenin, do të nisemi dhe ne dhe ti do të drejtosh kryengritjen në Shqipëri. Disa muaj më parë kishte ardhur në krye të Turqisë Sulltan Ahmeti, i cili njihej si një njeri që harxhonte shumë para për të zbukuruar xhamitë dhe pallatet e tij në stilin francez. Stambolli ndihej më i lirë nga dhuna e sulltanëve të mëparshëm dhe artistë evropianë me gjithë gratë e tyre të pambuluara bridhnin lirshëm nëpër qytet. Nuk e kam parë kurrë tim atë më të qeshur se ato kohë. Stambolli po kthehej në Kostandinopojë, më thoshte dhe pothuajse përditë shkonte në kishë ku lutej për fatin tonë. Por atë vit bëri një dimër i tmerrshëm dhe Stambolli u mbulua nga dëbora dhe ngricat. Duke mos hequr dorë nga rituali i tij i lutjeve në kishë babai mori një plevit. Gjatë një muaji të vështirë unë i shërbeja dhe i jepja çaj të nxehtë, ndërsa ai fliste për betejat e mëdha të Arianitëve dhe më tregonte vende me emra malesh në Shqipëri, në të cilat fillimisht duhet të shiheshin kryengritësit e Gjergj Brankoviçit sipas planeve që ai hartonte nga krevati i Stambollit. Ai ishte një muaj gjeografie për mua. Mësova me dhjetëra emra malesh, luginash, kodrash, lumenjsh dhe fshattrash, të cilat babai më detyronte t'i përsërisja në formën e një itinerari ushtarak. Shqipëria e vogël m'u duk si një dhomë e madhe në të cilën unë dhe babai i zhvendosnim si mobilie malet dhe kodrat e shumta. Shqipëria është e vogël, por është krijuar



për të fshehur ushtri, thoshte babai, sytë e çuditshëm jeshilë të të cilit filluan të ngatërronin gjeografinë e mobilieve nga fundi i muajit. Unë nuk kisha ndenjur kurrë aq shumë me tim atë. Besoj se edhe ai zbuloi ato ditë tek unë një djalë, të cilin ëndrrat e tij nuk i kishin dhënë mundësi ta njihje. Sikur të kisha pasur një vajzë do doja ta martoja me një djalë si ty, më tha para se të vdiste. E varrosa me ndihmën e disa grekëve në varrezat e krishtera të lagjes Fanar të Stambollit. Kur mbeta vetëm, Gjergj Brankoviçi, i cili kish shumë miq me influencë në Stamboll më ndihmoi të punoja si pastrues në shtëpinë e Dragomanit të Madh. Dragomanët janë përkthyesit zyrtarë të Portës së Lartë dhe këtë titull gjithnjë e kanë mbajtur grekët. Ky ishte njeri me influencë dhe me sa duket ishte i përfshirë në heshtje, për shkak të frikës nga turqit në komplotin që Gjergj Brankoviçi donte të organizonte në Ballkan. Aty punova dy vjet dhe mësova turqisht, por arrita të shkruaj edhe greqishten, të cilën e dija shumë pak kur u nisa nga fshati. Ndërkohë, shpresat për t'u kthyer në Shqipëri po më linin. Nuk kisha asnjë lajm nga fshati dhe nuk dija si të lajmëroja vëllezërit dhe nënën për vdekjen e babait. Gjergj Brankoviçi më thoshte se gjërat po vonoheshin për shkak se Rusia, që kishte bërë paqe me Turqinë në dëm të Austrisë, po i sabotonte përpjekjet e tij kryengritëse në Ballkan. Një natë, në shtëpinë e Dragomanit u mbledhën në mënyrë sekrete Gjergj Brankoviçi, disa grekë si dhe ambasadori rus, i cili donte të informohej për mundësitë dhe seriozitetin e lëvizjes së Brankoviçit. Paqja mes Ruisë dhe Turqisë ishte vënë në dyshim në Krime dhe rusët kishin nisur të sabotonin stabilitetin e Portës së Lartë. Mirëpo Gjergji, i cili besonte se mund të manovronte mes interesave të Fuqive të Mëdha u gënjye. Rusët e tradhtuan atë te turqit dhe Gjergji u arrestua për gjashtë muaj. Kur u lirua, u kërkuan të largohej si i padëshirueshëm për të mos u kthyer më në Stamboll. Para se të ikte, më tha se rrugës për në Serbi ai mund të kalonte nga Shqipëria dhe në qoftë se doja mund të shkoja me të. Natyrisht që nuk kishte rast më të mirë për mua për t'u kthyer në fshat. U nisëm një ditë të përvëlur korriku kur hurmat djersinin dhe rrushi digjej në pazarin e Stambollit. Unë kisha qarë gjithë natën mbi varrin e babait tim, të cilit i premtova se do të kthehesha ta merrja sa më shpejt. Gjergj Brankoviçi nuk mund të kalonte nëpër territoret e Perandorisë Turke që shtriheshin në tokë nëpër gjithë Greqinë Veriore. Vetëm gadishulli i Moresë ishte akoma nën sundimin venecian dhe fillimisht shkuam atje me një galerë që transportonte pambuk. Brankoviçi kishte miq në More, të cilët i thanë se mund ta ndihmonin të kthehej, por vetëm duke kaluar nëpër Itali pasi rrugët e tjera mund të ishin të pasigurta për një njeri të arrestuar për komplot dhe të padëshirueshëm për turqit. Ballkani i jugut ishte i pasigurt për një komplotist. Kështu që pas disa javësh në More gjetëm një anije që shkonte në Napoli, i hipëm dhe u nisëm. Napoli sapo ishte pushtuar nga austriakët, të cilët kishin ndihmuar Brankoviçin dhe ky u ndie më i qetë nga kjo rrugë. Komandanti i trupave austriake të Napolit e priti mirë Brankoviçin dhe i ha një letër me anë të së cilës ai mund të kalonte territorin italian për të mbërritur në Vjenë. Napoli ishte një qytet që nuk flinte ose më saktë ditën flinin marinarët dhe punonin napolitanët, natën këta flinin, ndërsa marinarët pinin dhe gëzonin.

Në Napoli rashë me një grua për herë të parë. Një natë, Gjergj Brankoviçi u zhduk nga hoteli ku ne flinim dhe në të gdhirë u shfaq i dehur bashkë me një grua rreth të dyzetave, e cila e mbante për krahu. Gruaja i kishte lyer sytë me ngjyrë blu dhe mbante një fund të gjerë që e tregonte shumë të shëndoshë. Këtu te ne kësaj femre nuk do ia hidhte njeri sytë, por në Italinë e Jugut kanë shije tjetër për gratë. Ata i duan gratë të shëndosha, me vithe të dala dhe me pak bark mbi të cilin burrat ndihen si mbi një dyshek. Kjo grua, pasi vuri Gjergj Brankoviçin në gjumë në krevatin ngjitur me timin, hoqi fundin e saj të gjerë dhe u fut në krevatin tim. Atë natë m'u duk sikur më doli një zog nga barku dhe puplat e tij më mbuluan të tërin dhe më vunë në gjumë. Një prift që takova njëherë në More më ka thënë se njerëzit përpara se të vdesin kujtojnë ditën e parë

që kanë hyrë në kishë sepse ky imazh i afron ata me Zotin. Nuk e di sa është e vërtetë, por di që para se të vdes do doja ta kujtoja edhe një herë ngritjen e fundit të asaj gruaje.

Pasi ikëm nga Napoli, unë dhe Brankoviçi kemi fjetur nëpër hanet e Italisë ngarkuar me plaçkat dhe kujtimet e ditëve në Stamboll. Rruga jonë kaloi nëpër Romë dhe duke u endur nëpër kalldrëmet e këtij qyteti kuptova se çfarë e kishte yshtur Arianit Komnenin dhe familjen e tij të linte Shqipërinë dhe të vinin në Itali. Nuk besoj se ishte vetëm frika nga turqit. Italia, dhe mbi të gjitha Roma, është ndoshta i vetmi vend ku mund të jetosh duke ndjekur gjurmët e veprave të mëdha të lashtësisë, por dhe të krishterimit. Natyrisht edhe ato të ndjekin ty. Në Romë mund të kuptosh se si krishterimi ishte lindur për të çuar më tej oreksin për drejtësi të Perandorisë Romake dhe se si kjo perandori nuk do mund të bashkohej me krishterimin në qoftë se nuk do të ishte ushqyer nga pasioni për të bukurën, që kishin grekët e lashtë.

Kur arritëm në Italinë e Veriut, Gjergj Brankoviçi trokiti te disa miq, të cilët na ndihmuan të kalojmë kufirin pasi pritëm tre muaj të shkrinte bora mes alpeve të Italisë dhe Austrisë. Disa ditë i kaluam në Milano në qiellin e së cilës nuk pashë asnjë ditë me diell, por në këtë vend pashë një pikturë për herë të parë në jetën time. Ishte një beze e madhe e vendosur në një kornizë druri të trashë dhe me brazda. Tregonte predikimin e Shën Markut në Aleksandri. Shën Marku ka qenë njëri nga apostujt besnikë të Krishtit dhe ndoshta i vetmi që nuk e vuri në diskutim natyrën e tij hyjnore. Pas vdekjes së Jezuit ai shkroi ungjillin e tij dhe themeloi krishterimin në Aleksandri. Në pikturë ai është gjysmë i zhveshur me flokë të verdhë dhe me një hundë të gjatë dhe flet i hipur mbi një shkallare në mes të një sheshi të madh. Pas tij ka disa burra të heshtur dhe të veshur me kapela të zeza që duhet të jenë grekë, çifutë ose romakë. Ndërsa përpara tij qëndrojnë arabë me çallma të bardha dhe mjekra të gjata. Arabët diskutojnë me njëri-tjetrin me sa duket për ato që thotë shenjti. Në mes të këtij sheshi të gjerë ngrihet madhërisht një tempull i rrumbullakët që i ngjan kishave të sotme, ndërsa pas saj është qyteti i ndërtuar nga arabët e i mbushur me minare të larta. Në cep të sheshit një deve mban kokën lart duke parë nga Shën Marku. E gjithë piktura kishte një ngjyrë pjeshkë, por pasi e pashë me kujdes kuptova se e vetmja ngjyrë që i mungon është jeshilja. Sa do të doja ta kishte parë im atë. Me siguri do ta kishte quajtur: Bota siç duhet të jetë. Myslimanët dhe kafshët mësojnë krishterimin.

Pasi shtymë dimrin atje, arritëm në Vjenë në prillin e vitit 1708, por gjërat kishin ndryshuar. Austria nuk kishte më nevojë për Brankoviçin dhe askush nuk denjoi ta priste. Kërkesave të shumta të Gjergj Brankoviçit për të ngjallur interesin e një lëvizjeje ballkanike, e cila do t'i merrte turqve territoret e pushtuara në favor të tyre, austriakët iu përgjigjën me një fletë arresti. Gjergj Brankoviçi mundi ta zbuste arrestin pasi takoi një kushëri të largët të perandorit, i cili kishte ndërmjetësuar përpara dhjetë vjetësh mes tij dhe austriakëve. Arresti u anulua, por jo dëbimi nga Vjena. Përfunduam në një fshat të humbur të Austrisë ku, pas disa muajsh, Gjergj Brankoviçi dha shpirt i zhgënjyer nga lojërat e Fuqive të Mëdha, të cilat ishin tallur me kryengritjen e tij.

Gjatë kësaj kohe unë kisha mësuar pak gjuhën gjermane dhe duke u njohur me fshatarët, i punova tokën për gati një vit një familjeje, së cilës i kishte ikur djali në ushtri. Ky ishte kapiten këmbësorie në Bosnjë dhe i binte violinës që unë e pashë për herë të parë kur ai erdhi në shtëpi për pak kohë. I ati i mbyllte veshët kur i biri i binte violinës, ndërsa mua ato tinguj m'u dukën si e qara e djalit tim që nuk kishte lindur akoma, por që me sa duket ishte gati në barkun tim. Kapiteni, kur u kthye në shërbim më mori me vete.

Bashkë me ushtrinë austriake u afrova deri në Raguzë. Gjatë ditëve që qëndrova atje mësova notin. Ushtarët austriakë dilnin në breg të detit dhe një peshkatar tullac u mësonte atyre si të

notonin. Kur më tregonte se si t'i përplasja krahët dhe këmbët dhe si të nxirrja frymën mbi ujë për të mos u mbytur, peshkatari më pyeti se nga isha dhe kur i thashë se jam nga Shqipëria më tha: Do ta mësoj notin se ju keni det dhe ju duhet, por ti mos ia mëso këtë gjë gruas dhe as vajzës tënde sepse në qoftë se ato lahen njerëzit do t'i quajnë të përdala. Në Raguzë gratë nuk laheshin. Kur i pyeta ushtarët austriakë ata më thanë se peshkatari nuk ua kishte thënë atyre të njëjtën gjë. Ndoshta ai mendonte se gratë e tyre duhej ta mësonin notin.

Pas disa javësh në Raguzë, më hipën në një anije, e cila më solli në Shkodër. Atje desh vdiqa nga uria sepse nuk gjeta as punë dhe as strehë për një muaj rresht. Shkodra ishte një vend ku turqit i trajtonin të krishterët si skllëvër dhe ku unë pata shumë ftohtë atë dimër.

Që të mos zgjatem, në 1709 përfundova në Janinë dhe erdha në fshat ku të gjithë e kishin humbur shpresën se do të kthehesha. Nëna ishte plakur dhe tre vëllezërit e mi ishin martuar dhe kishin bërë fëmijë. Ashtu bëra dhe unë. U martova me Hënë, një vajzë shumë të bukur, por të imët dhe të dobët, stërgjyshi i të cilës kishte ardhur bashkë me stërgjyshin tim nga bregdeti dhe bashkë kishin ngritur fshatin. Ata nuk ishin Komnenë, por gjithmonë kishin jetuar besnikërisht nën hijen e madhështisë së fisit tonë. Është e bukur si diell, por nuk ka shumë mish dhe do të ketë gjithmonë ftohtë si hëna, thoshte nëna për gruan time. Atë vit lindi Gjergji dhe brenda dhjetë vjetësh Hëna lindi dhe dy djem të tjerë, por ajo thoshte se ne duhet të kishim nëntë djem siç kishte Arianiti i Madh nëntë vajza. Nuk mund t'i ngaj kaq shumë Arianitit, i thosha unë. Fshati ynë është i vogël dhe nuk do gjejmë nuse për kaq shumë burra. Fshati ishte i qetë në ato vite dhe ne kishim ujë, bukë dhe të mbjellat nuk munguan. Unë i gëzohesha familjes sime që shtoej, ndërkohë që nëna ime zvogëlohej nga mosha dhe hidhërimi i humbjes së babait. Para se të vdiste, ime më më tha se e vetmja gjë që do të donte ishte të shtrihet në një varr me babanë, që unë e kisha varrosur në Stamboll.

Në vitin 1730, kur djemtë ishin rritur, vendosa të kthehem në Stamboll për të sjellë eshtrat e babait në fshat. Shko merre, më tha Hëna, sepse nëna e pret.

U nisa në verë dhe duke kaluar gjithë rrugën që kishim bërë bashkë me babanë përpara 25 vjetësh arrita në Stamboll në shtator, pa e ditur se ç'po ndodhte aty.

Stambolli ishte një ferr. Kishte shpërthyer një kryengritje jeniçerësh dhe gjithë qyteti ishte në flakë. Jeniçerët që ishin rebeluar kundër vezirit të madh vidhnin, përdhunonin gra dhe masakronin nëpunësit e shtetit. Në krye të tyre ishte Halil Patrona, një shqiptar. Halil Patrona që kishte punuar disa kohë në një banjë turke si masazhier, sepse i kishte duart e forta, kishte hyrë në ushtri dhe ishte bërë i pari i jeniçerëve për shkak të egërsisë dhe oratorisë së tij të ashpër frymëzuese. Ditët e para, duke përfituar nga fakti që njihja Stambollin ku kisha ndenjur gati pesë vjet, u fsheha te një familje greke që bashkë me mua kishte punuar për Dragomanin. Një natë jeniçerët e bastisën lagjen dhe na rrahën të gjithëve si të dehur. Unë i thashë se nuk isha grek, por kisha ardhur rastësisht në Stamboll nga Shqipëria dhe kështu më shpunë te Halil Patrona në të gdhirë. Në vitin 1730 unë isha një burrë mbi të pesëdhjetat, i gjatë, me shpatulla të gjera dhe me mjekër të errët dhe shumë të dendur. Halil Patrona ishte më i ri se unë, por dukej shumë më i madh. Ishte i shkurtër, por këmbët e tij të trasha dhe të forta e tregonin më të gjatë. Kokën e kishte të rruar, por ngjyra e mjekrës tregonte se qimja e tij duhej të ishte e kuqe. Halil Patrona ishte kuq. I thanë se i kishin sjellë një shqiptar dhe më priti në bodrumin e një taverne të madhe nga ku drejtonte gjithë bastisjen e Stambollit që ai e quante revolucion. Çdo minutë atje vinin jeniçerë të zbatuar që sillnin ora muri si dhe argjend e bizhuteri grash që i shtrinin mbi tavolina në mënyrë që Halili të mund t'i shijonte. Më pyeti turqisht në ishte e vërtetë që isha shqiptar dhe i thashë po. nga cili vend je, më tha. I tregova se isha nga një fshat afër Janinës. Unë jam nga

Vlora, më tha. Kam ardhur i vogël në Stamboll. Patrona që ishte tmerri i Stambollit, kishte dy sy të vegjël, por të ëmbël. Mua m'u duk njerëzor kur po fliste për origjinën e tij dhe e pyeta shqip nëse ishte mysliman apo i krishterë. Unë jam jeniçer, ma ktheu turqisht dhe pastaj më pyeti se pse isha në Stamboll. Kur i thashë se unë jetoja në Shqipëri, por kisha ardhur për të marrë trupin e tim eti më tha se edhe ai kishte një djalë, por nuk e dinte nëse i biri do arrinte t'ia gjente trupin kur të vdiste, sepse jeniçerët, tha, nuk kanë varr si gjithë të tjerët, ata ose copëtohen, ose mbeten në fushë të luftës dhe ushtria nuk mund t'i tërheqë dot sepse kur vdes jeniçeri, betejën e ka fituar armiku.

Unë mbeta gati dy javë në bodrumin e Halil Patronës. Megjithëse ishte zot i atij kaosi më tha se nëse dilja në qytet ndoshta nuk do të kthehesha dot i gjallë. As që bëhej fjalë për të zhvarrosur trupin e babait dhe për ta transportuar nga varrezat në port. Ato ditë, duke fjetur mbi një tavolinë të vogël prej druri kuptova se sa e kalbur ishte nga brenda karrigia e Islamit turk, këmbët e së cilës megjithatë kishin qindra vite që na shtypnin. Halil Patrona dhe shokët e tij, kur u lodhën duke grabitur dhe vrarë kaluan në kërkesa të forta ndaj Sulltanit, të nxitur edhe nga disa islamistë fanatikë, të cilët kishin qenë gjatë gjithë kohës kundër stilit evropian dhe artistik të qeverisjes që kishte ushtruar Sulltan Ahmeti. Vitet e fundit, Ahmeti III, siç e quanin, i kishte shtuar shpenzimet për zbukurimin e Stambollit dhe kishte nisur madje të vizatonte portretet e sulltanëve në muret e xhamive, gjë që islamistët e konsideronin një blasfemi të rrezikshme. Ahmeti ishte i dashuruar me lulet dhe për t'u tallur me jeniçerët, të cilët i urrente, i vuri ata të mbillnin kopshtet e Stambollit me tulipanë që ishte lulja që ai dashuronte dhe e quante simbol të sulltanatit të tij gjithë ngjyra. Do t'ia shkull fletët atij tulipani pederast, bërtiste Halil Patrona, sa herë që i thoshin se trupat e qeverisë kishin marrë lagje të ndryshme të Stambollit nën kontroll. Një natë, kur nuk e zinte gjumi, më tregoi se familja e tij kishte qenë e krishterë dhe Halilin e vogël e kishin marrë turqit si devshirme, siç kishin bërë me qindra djem që i marrin dhe sot si taksë nga familjet e krishtera. Atij i kujtohej deti i Vlorës dhe thoshte se ai ishte më i pastër se deti që lagte Stambollin. Llagapin Patrona ai e kishte marrë kur i kishte shërbyer një gjenerali francez, i cili kishte jetuar shumë vjet në Stamboll duke ndihmuar sulltanin të ngrinte armatën e bombardierëve. Ai më mësoi t'i drejtohesha patron dhe kështu më mbeti ky llagap, tha Halili. Ky njeri u soll shumë mirë me mua deri në fund. Nga dita në ditë unë e shihja sesi egërsohej sepse me sa duket po kuptonte se revolta e tij nuk do mund ta rrëzonte shtetin. Vazhdimisht i vinin habere për marrëveshje nga Sulltani, por Halil Patrona i kërkonte shkarkimin e vezirit të madh, të cilin e konsideronte si armik të perandorisë dhe si një njeri të dështuar.

Një ditë në mëngjes më zgjoi nga gjumi dhe më tha të bëhem gati për t'u nisur. Ku të shkoj, i thashë unë. Nisu për Shqipëri, tha ai. Kemi lejuar një anije greke bashkë me konsullin grek që të dalë nga porti, shko dhe ti me ta. Dua të marr eshtrat e tim eti, i thashë, nuk mund të iki duarbosh në fshat. Ik sa nuk është vonë, më tha. Porti do mbyllet dhe unë nuk mund të të strehoj më se duhet të dal dhe të rregulloj ca punë dhe nuk e di a do kthehem më. Kur u ndamë, më dha një nga unazat që jeniçerët e tij kishin vjedhur ato ditë nëpër shtëpitë e qytetit. Unaza ishte shumë e madhe, me fushë të bardhë mbi të cilën skuqte një hurmë prej rubini. Merre këtë, tha, sepse dua që diçka nga unë të kthehej andej nga kam ardhur. Ma futi në gisht dhe iku. Njerëzit e tij më shpunë deri në port dhe pas dy muajsh u ktheva në fshat nga Selaniku dhe Voskopoja. Sulltan Ahmeti dha dorëheqjen për shkak të Halil Patronës pas 27 vjet qeverisje. Sulltani i ri, që erdhi në krye të Perandorisë, në fillim e mashtroi dhe në nëntor të atij viti ia preu kokën Halil Patronës. Por këto unë i mësova kur shkova në Stamboll për herë të tretë.

Kur u ktheva në fshat, njëri nga vëllezërit kishte vdekur. Djemtë m'u dukën më të mëdhenj dhe në mungesën time kishin nisur të punonin tokat tona. Fshati më zgjodhi kryetar të pleqësisë jo vetëm sepse ne e kishim traditë familjare, por edhe sepse si një njeri që kisha parë botën dhe kisha mësuar gjuhë, besonin se unë mund ta drejtoja me urtësi në trazirat që vinin nga të katër anët. Siç të thashë, gjatë udhëtimeve të mia, kisha ndaluar në Voskopojë, ku kisha zënë miq. Në Voskopojë, bashkë me babanë, kishim fjetur në një manastir dhe atje ishim miqësuar me murgun Grigor, i cili më vonë u bë tipografi i parë i shtypshkronjës. Shtypshkronjën unë e pashë vetë kur u nisa për në Stamboll për herë të dytë më 1730. Ajo ishte një makinë e madhe e zezë që Grigori mezi e komandonte me duart e tij të dobëta. Kur fletët me bojë të zezë dilnin prej andej, Grigori dhe ndihmësi i frynin derisa thaheshin dhe pastaj i prisnin me disa thika të posaçme, gjersa ato vinin në madhësinë e një libri. Shtypshkronjën e kishin blerë në Venedik disa pasanikë voskopojarë, për të shtypur librat e Akademisë së tyre. Mirëpo rrugët e tregtisë së Voskopojës, nga Selaniku dhe Rumania filluan të bllokoheshin nga bandat myslimane të Korçës dhe Beratit, të cilat e plaçkitnin herë pas here qytetin, duke grabitur tregtarët dhe karvanët e tyre. Shtypshkronja u bllokua për gjashtë muaj sepse karvanët që sillnin letër nga Rumania u vodhën dhe letra u dogj. Grigori më dërgoi fjalë dhe më kërkoi ta ndihmoja për të sjellë letër nga rruga e Janinës, e cila ishte më e sigurt. Për shumë vjet porosisja letër, e cila vinte nga Venediku në Raguzë dhe prej andej në Durrës nga ku ne e merrnim dhe e nisnim në Voskopojë.

Kur shkova në Raguzë takova në breg të detit sërish peshkatarin që më mësoi notin dhe për disa vjet ai punoi për ne, si agjent në Raguzë, ku siguronte shkarkimin dhe nisjen e letrës prej liri dhe pambuku, të cilën e ruante si shamë nga uji. Për gati dhjetë vjet u mora vetë duke ndjekur karvanët që shpesh vidheshin nga kaçakët, por po aq shpesh edhe kuajt ngordhnin apo shkisnin nëpër humnerat e ngrira.

Kur Hëna u sëmur, unë i lashë karvanët dhe me to filloi të merrej im bir Gjoni, që ka një aftësi të madhe për t'u marrë vesh me tregtarët e letrës në Venedik si dhe për të bërë miqësi me hajdutët e rrugëve. Djalin e dytë, kur u ktheva nga Stambolli, e çova në Akademinë e Voskopojës. Ai është akoma atje.

Hëna lëngoi dy vjet në shtrat dhe Gjergji, që gjithmonë kishte qëndruar me të, i shërbeu si një vajzë. E lante, e ushqente, e krihte, e zbukuronte për festa dhe e ledhatonte, por një natë nga ethet e saj, Hëna i thirri: bir kam ftohtë. Djali iu shtri te këmbët për ta ngrohur, por e ëma nuk u kthye më. Kur e varrosëm binte shi. Gjergji nuk qau, por që atë ditë ndryshoi dhe u ftoh me botën sikur të kishte trashëguar dimrin nga trupi i së ëmës. Shkoi në pyll, rrethoi një vend me gurë dhe ndezi një zjarr të madh me shkarpa të thata, sikur donte të thante lotët. Zjarri vazhdoi tri ditë dhe Gjergji duke parë zjarrin qante për të ëmën. Hiri i drurëve të djegur u rrit deri në lartësinë e gurëve dhe atje ka mbetur edhe sot e prandaj atë vend e quajnë Guri i Hirit.

Pasi vdiq Hëna, unë iu kushtova. Drejtua vijën e ujit, ndërtaam disa çezma, shtruam kalldrëm dhe ngritëm një kishë të vogël që prifti e vizitonte një herë në muaj, por që ne na mjaftonte për t'u lutur, për pagëzime, për dasma dhe morte. Gjoni ndiqte karvanët e letrës, Mihali jetonte në Voskopojë, ndërsa Gjergji ngrysej dhe gdhihej duke punuar tokën, si i marrë. U martua me Kostandinën, vajzën jetime me sy jeshilë, që ishte lindur dhe rritur në shtëpinë tonë pasi edhe babai i saj u vra në Kretë. Por as gruaja dhe as toka nuk e ngrohën dhe tim bir dhe vetëm pas shumë vitesh martesë atij i lindi një vajzë që ia vuri emrin Hana në kujtim të nënës që e kishte dashur aq shumë. Vajza që tani është gruaja e Vasilit, vëllait të Ibrahimit, i kishte sytë jeshilë si e ëma dhe flokët e zinj si i ati. Kur shikoja sytë e saj jeshilë mua më kujtohej babai.

Kur Hana mbushi dy vjeç, u nisa për herë të tretë në Stamboll, në vitin 1753. Megjithëse isha gati 76 vjeç ndihesha i fortë dhe besoja se do t'ia dilja një aventure të re sepse Turqia ishte qetësuar në ato vite dhe unë isha më i pjekur dhe më i pasur. Mendoja, pra, se me përvojë dhe me para mund t'i kapërcejja rreziqet që kisha hasur në dy udhëtimet e mia të para.

Në Stamboll qeveriste Osmani III, të cilin njerëzit e konsideronin si një Sulltan të ngathët dhe dembel që i kishte kufizuar liritë e të krishterëve, por edhe ato të myslimanëve. Osmani i kishte ndaluar gratë të dilnin në shëtitorët dhe lulishtet e qytetit dhe Stambolli në ato kohë ishte një qytet i zymtë burrash. Po ashtu, me një ferman të veçantë ishte ndaluar pirja dhe tregtimi i verës për të gjithë. Mirëpo pranë portit në Stamboll, aty ku mblidheshin marinarët, tregtarët dhe kontrabandistët, mund të gjejë nën banakë verë sa të doje dhe pronarët e tavernave i blinin me bakshishe të mira kontrollat e rrepta të qeverisë. Taverna nga ku, përpara njëzet vjetësh, Halil Patrona drejtoi bastisjen e qytetit, ishte nga më të zhurmshmet. Hija e Halilit të tmerrshëm që rrëzoi Sulltanin e Tulipanëve ishte zhdukur dhe pronari i ri nuk kishte aspak qejf t'ia kujtoje ato ditë terrori. Aty gjeje verë, femra, duhan dhe mund të takoje tregtarë dhe nëpunës të korruptuar me të cilët mund të zgjidhje çdo hall. Një të diel pasdite, me ndihmën e një mbikëqyrësi të varrezave dhe dy turqve të vegjël që pagova për zhvarrosjen, nxora eshtrat e babait, të cilat i pastruam një nga një nga dheu dhe krimbat e viteve. Babai kishte qenë një burrë shtatlartë dhe kockat e tij të gjata mezi u futën në një arkë të vogël të dyllosur dhe të lyer nga brenda me qirinj të shkrirë, të cilën e mbaja poshtë krevatit ku flija. Pa vështirësi, mora një dokument me emrin dhe datën e vdekjes së babait që ishte i domosdoshëm për të kaluar doganën turke. Tani më duhej të gjeja një anije për t'u kthyer. Por Stambolli ishte një qytet që mund t'i falte akoma kënaqësi një shtatëdhjetegjashëtvjeçari të mbajtur dhe të fortë si unë, që e dinte mirë se kjo ishte hera e fundit që vinte në këtë qytet. Prandaj nuk kisha ngut dhe ditën shëtisja në rrugët dhe lagjet e Stambollit, ndërsa natën i jepesha verës së ndaluar dhe miqësive të shpejta, si të gjitha miqësitë që ngjizen në pranverë.

Një nga këto net të gëzueshme u njoha me një tregtar grek, Jorgon Mavromatisin, i cili më tha se kishte ardhur të blinte verë në Stamboll dhe për disa ditë do të nisej bashkë me ngarkesën për në Selanik. Pavarësisht nga konsumi i tavernave të natës, fermani i Sulltanit e kishte kufizuar shumë shitjen e verës dhe tregtarëve të Stambollit i kishin mbetur mijëra fuçi, të cilat kishin nisur t'i shisnin badihava për të zbratur magazinat. Ky ishte një rast i mirë për të udhëtuar aq më tepër që unë kisha lidhur miqësi me grekun dhe gruan e tij çifute Sheba që ai e kishte marrë me vete në një udhëtim që ajo e konsideronte turistik.

U nisëm më 29 maj 1753.

Pikërisht atë ditë, treqind vjet më parë turqit kishin pushtuar Kostandinopojën.

Të tre: unë, greku dhe e shoqja ishim mbi kuvertë kur anija u shkëput nga porti i Stambollit. Shtëpitë e bardha, të shtrira në të dy kodrat mbi Bosfor filluan të zvogëlohen ndërsa minaret e shumta holloheshin në largësi, aq sa dukeshin si shtiza, të cilat gratë i ngulin mbi qëndisjet e tyre, që të mos humbnin nëpër shtëpi.

Çfarë do të mund ta kishte ndaluar Sulltan Mehmetin të mos e pushtonte këtë qytet para treqind vjetësh, thoshte Jorgo, duke parë në horizont. Asgjë, përgjigjej Sheba, që dukej sikur fliste me vete. Kostandinopoja kishte rënë shumë vjet përpara se të vinin turqit, që kur perandorët e saj kuptuan se krishterimi ishte një farë që nuk mund të hidhte rrënjë në Azi. Ata u dembelosën derisa hoqën dorë, siç bën çdo njeri që provon më kot të mbjellë një qiparis në shkretëtirë. Myslimanët, të cilët nuk kërkojnë diell, por vetëm hije, e mbuluan shkretëtirën me çallmën e tyre

dhe një cep i saj kaloi detin dhe mbeti këtu. Në përgjithësi, Sheba i jepte një shpjegim poetik historisë gjë që nuk e bindte burrin e saj, i cili, për shkak të natyrës së tij tregtare, besonte se çdo dështim e ka burimin në paaftësinë për t'i ofruar dikujt një marrëveshje të leverdishme shkëmbimi. Krishterimi dhe Islami mund ta kishin ndarë botën me marrëveshje, këmbëngulte Jorgo, por pas një mijë vjetësh kaluar në qejf dhe intriga, bizantinët ishin aq të lodhur sa ç'është një tregtar, i cili, pas një nate të gjatë me verë dhe femra, në mëngjes ia këput gjumit dhe nuk shkon në Pazar. Po të ishin vendosur fatet e botës në Pazar, siç thua ti, çifutët do kishin një perandori të përjetshme, thoshte Sheba duke psherëtirë dhe rregullonte shallin e verdhë që ia merrte era. Udhëtuam kështu për gati një javë nga Bosfori në Canakala. Deti ishte i qetë dhe brigjet që shtriheshin në të dy anët e anijes sonë të krijonin përshtypjen sikur po lundronin në një lumë të shurdhët. Natën nxirrnim karriget mbi kuvertë dhe pinim verë me havjar dhe fruta të thata dhe arra të vogla të lyera me bojë që Sheba i kishte blerë në Stamboll.

Jorgo dhe Sheba kishin pesë vjet që ishin martuar, por muaji i mjaltit, siç thoshin ata, akoma nuk kishte mbaruar. Ai kishte pasur një histori të shëmtuar me gruan e parë me të cilën ishte ndarë. Jorgo ishte pesëdhjetë e pesë vjeç, ndërsa Sheba i kishte kaluar të dyzetat, por lëkura e saj e zeshkët dhe hunda e vogël e tregonin më të re. Nuk kishin fëmijë dhe vazhdimisht Sheba bëhej nervoze kur i shoqi, për ta qetësuar, thoshte se zakonisht fëmijët lindin pas muajit të mjaltit. Kur të arrijmë në Selanik kjo fara e hurmës do të ketë mbirë në barkun tënd, i thoshte Jorgo duke ndarë një hurmë përgjysmë që ia afronte asaj te goja.

Sa kaluam ngushticën e Canakalasë qielli u prish. Dallgët mbushën kuvertën dhe fuçitë e verës ulërinin si të dehura nga era e tyre. Kapiteni tha se anija ishte shumë e ngarkuar dhe se duhej të ndalonim diku për të pritur përmirësimin e motit. Ishulli më i afërt ishte Lesbosi dhe në mëngjes, pasi kishim lodhur zorrët gjithë natën, ankoruam me vështirësi në qytetin e Mitilinës. Në mes të shiut dhe vetëtimave të Egjeut zbritëm nga anija, të lagur deri në mish. Sheba dhe Jorgo futën paratë e tyre në një qese të vogël, por plaçkat dhe dhuratat që kishin psonisur në Stamboll i rregulluan me kujdes dhe i lanë në anije. Edhe unë e lashë baulen time me të tyret, ndërsa arkën me eshtrat e tim eti e mora me vete. Pasi gjetëm një hotel të vogël, kapiteni i anijes erdhi dhe kërkoi Jorgon. Të duan në port, i tha. Doganierët po kontrollojnë anijen. Jorgo u nis me të shpejtë dhe pasdite Sheba erdhi e irnosur në fytyrë dhe më tha se i shoqi kishte përfunduar në burgun e qytetit. Gjatë kontrollit të anijes, doganierët kishin gjetur ngarkesën e verës. Lesbosi ishte ishull i pushtuar nga turqit dhe fermani i Sulltan Osmanit, që më kishte njohur me Jorgo Mavromatisin, në një tavernë ku pihej verë kontrabandë, ishte në fuqi. Për Jorgon, kapitenin dhe tetë marinarët u lëshuan urdhër arrestet që u zbatuan menjëherë. Anija dhe vera u sekuestruan. Shebën nuk e lanë të merrte as baulët e veta me rroba dhe unë falënderova Zotin që kisha marrë me vete arkën ku prehej babai im. Kur ajo u përpoq t'i bindte autoritetet e limanit se vera ishte nisur për në Selanik dhe jo për në Lesbos ata i thanë se kjo e bënte njëloj fajtor burrin e saj, sepse edhe Selaniku ishte nën hyqmin e Portës së Lartë dhe fermani i Sulltanit vepronte dhe atje. Jorgo Mavromatisi u dënua me tre vjet burg për shkelje të fermanit si dhe për mashtrim me dashje të doganës turke. Të tjerët morën dënime më të vogla pasi dëshmuuan se Jorgo nuk u kishte treguar se fuçitë ishin të mbushura me verë, por me vaj ulliri.

Mitilina ishte një qytet i vogël që shihte nga brigjet aziatike dhe grekët që ishin aty prej kohësh kishin humbur njerëzillëkun dhe ishin bërë mizorë si turqit që i mbanin ata të robëruar. Sheba u trondit nga burgosja e Jorgos, por si një çifute e shkathët, e ushqueu veten me shpresën se do të mund ta blinte lirin e tij me para. Pas disa ditësh në hotel, ne vendosëm të banojmë në një shtëpi, në të cilën zumë me qira dy dhomat e katit të dytë, ndërsa të zotët u ngushtuan në të parin.

Për dy muaj, pa u lodhur, Sheba harxhoi një pjesë të parave që kishte, me dhurata dhe bakshishe për të gjithë turqit dhe grekët që ajo mendonte se mund të ndikonin në uljen e dënimit të Jorgos. Grekët i merrnin paratë duke i thënë se ato ia jepnin turqve, ndërsa turqit i thoshin Shebës se ajo duhej të priste dhe pak që fermani i verës të anulohet, pasi edhe në Stamboll ai kishte krijuar shumë pakënaqësi. Bashkë me të, prisja dhe unë, duke fjetur mbi eshtrat e babait që i mbaja poshtë shtratit. Sheba nuk ma kërkoi kurrë, por unë mendoja se do të ishte poshtërsi që ta lija atë grua vetëm në një ishull armiqësor që i kishte marrë burrin. Kur ajo shkonte të takonte Jorgon, të cilit i thoshte se duhej të bënte pak durim sepse fermani mund të zhbëhej nga dita në ditë, unë shkoja buzë detit dhe shikoja anijet që kalonin përballë. Në këtë ishull nuk mund të bëje miq, por mua më dukej se grekët aty ishin mësuar me njerëz si ne, që shpenzonin para duke pritur lirimin e të burgosurve dhe kjo i kishte bërë ata më të pashpirt.

Lesbosi është ishulli i parë, pasi kalon ngushticën e Canakalasë për të dalë në Egje. Edhe Bizanti, edhe Perandoria Turke e kishin përdorur shpesh ishullin si vend internimi. Perandorë të mundur dhe sulltanë të rrëzuar ishin sjellë në Lesbos gjatë shekujve dhe shumë kishin vdekur atje në mjerim dhe harresë. Unë nuk dija asgjë për historinë e këtij vendi. Një natë të nxehtë korriku, duke shëtitur përgjatë bregut të mbushur me gurë të bardhë dhe leshterikë, Sheba më tregoi për Safon, poeteshën e shquar të Greqisë së lashtë, e cila e kishte bërë të njohur Lesbosin. Safoja dashuronte gratë dhe prej emrit të këtij ishulli, një grua që dashuron një grua, quhet lezbike. Pas dy muajsh që kaluam bashkë Sheba ishte më e çlirët. Për shkak të moshës dhe pa e kuptuar, unë kisha fituar aftësinë për të dëgjuar gjë që nuk e kam pasur në rininë time. Sheba më tha se aftësia për të dëgjuar, sipas çifutëve, ishte cilësi e njerëzve që duan të njohin botën. Edhe unë këtë kam bërë, i thashë. Kam njohur botën duke ndjekur babanë tim. I tregova Shebës historinë e familjes sime. I thashë sesi u vendosën Komnenët e parë në Shqipëri, pastaj sesi emigroi Arianit Komneni në Itali bashkë me nëntë vajzat dhe djemtë e tij, pastaj sesi babai im u nis në kërkim të Komnenëve në Stamboll dhe në fund sesi unë vetë u nisa në kërkim të tij. Kur unë flisja, sytë e zinj të Shebës nguleshin fort mbi ballin tim, sikur aty ajo donte të gjente një arsye të veprimeve të mia. Më ndërpriste vazhdimisht dhe më pyeste:

Pse Arianit Komneni i dha Skënderbeut për grua Donikën dhe jo një nga vajzat e tjera, pse njëri nga djemtë e Arianitit u kthye prapë në Shqipëri, pse babai më mori mua me vete në Stamboll dhe jo një nga vëllezërit e tjerë, pse unë nuk i mora eshtrat e babait që kur lashë Stambollin për herë të parë me Gjergj Brankoviçin? Unë nuk kisha përgjigje për pyetjet e saj, por fillova të mendoj seriozisht se sikur Komnenët të mos ishin vendosur në Janinë, por diku tjetër para pesëqind vjetësh, se sikur Skënderbeu të ishte martuar me një nga vajzat e tjera të Arianitit të madh, sikur babai të mos më kishte marrë mua me vete në Stamboll, por një nga vëllezërit e mi, se sikur unë ta kisha kthyer babanë e vdekur në varrezat e fshatit, ndoshta historia ime do të kishte qenë ndryshe. Mund t'i kisha kursyer vetes shumë dhimbje dhe fatkeqësi, i thashë Shebës. Aspak, tha ajo. Mos e ngushëllo veten. Madje edhe takimin me mua nuk do ta kishte shmangur dot edhe sikur në vendin tënd të ishte njëri nga vëllezërit e tu. Besoj se historia është një kalë i bardhë që e zbrit çdo njeri atje ku e ka marrë, por për shkak të shpejtësisë njeriut i duket sikur ndërrohet vend. Ty akoma nuk të ka zbritur dhe unë shpresoj të takohemi një ditë që të më tregosh se ku të la, më tha Sheba duke buzëqeshur me dinakëri si një njeri që di fundin e një përralle dhe që e shtyn një fëmijë që ta gjejë vetë atë duke i bërë pyetje të vështira. Po më fsheh fundin e përrallës sime, i thashë, duke iu përgjigjur edhe unë me një vështrim të ëmbël mosbesues. Fundin duhet ta gjesht ti vetë, m'u përgjigj. Por unë besoj se në tregimet çifute të Testamentit të Vjetër gjendet kuptimi i asaj çfarë po jeton bota sot. Testamenti i Vjetër është një histori që tregon sesi janë ndarë popujt e botës dhe që atëherë nuk janë bashkuar dot më. Ndërsa Testamenti i Ri është



një përpjekje naive për ta bashkuar botën, por në të vërtetë, ai e ndan më keq se i pari, pasi përfundon me një vrasje të papritur, të cilën po e vuajmë të gjithë.

Sikur unë të kisha shkruar Testamentet, nuk do t'i shtoja asgjë tjetër përveç një shënimi në fund: këto përralla i tregohen njerëzve jo për t'i vënë në gjumë, por për t'i zgjuar nga gjumi, më tha ajo një ditë, kur, duke u endur nëpër plazhin e Lesbosit, më tregoi sesi familja e saj kishte ikur nga Spanja në vitet 1400 kur inkuizicioni i krishterë atje masakroi me mijëra çifutë. Ata që nuk pranuan të bëhen të krishterë u larguan dhe familja ime që ishte një nga këto u vendos në Selanik.

Gjyshi i saj kishte qenë rabin në sinagogën e Selanikut, ndërsa i ati ishte marrë me tregti. Të dy kishin vuajtur nga një dobësim i trashëguar kockash që kthehet në paralizë kronike dhe ajo si vajzë e vetme i kishte shërbyer të dyve për shumë vjet në shtëpi, duke u privuar nga miqësitë e rinisë që mund t'i jepnin një martesë me dashuri. Jorgo Mavromatisi kishte shërbyer si ndihmës i të atit dhe pas vdekjes së tij kishte ndjekur biznesin e familjes. Për shkak të udhëtimeve tregtare, Jorgo nuk rrinte shumë në Selanik. Një ditë kur ishte kthyer, pa lajmëruar, kishte gjetur në shtëpi gruan e tij greke me vëllanë e tij dhe ishte ndarë. Ai i kërkoi Shebës të martoheshin dhe ajo e vetme, në moshën tridhjeteshtatëvjeçare, nuk kishte pasur zgjidhje më të mirë. Kur e pyeta nëse kishte qenë e lumtur nga martesa me Jorgon, ajo më tha se po të kishin pasur një fëmijë do të kishte qenë edhe më e lumtur. Por në qoftë se Jorgo nuk lirohet shpejt, fëmija im nuk ka për të lindur kurrë, tha ajo, duke fshehur sytë nga unë.

Mbrëmjet tona në Lesbos ngryseshin me biseda për historinë, fetë dhe vendet që kishim parë, ndërsa mëngjeset ishin të mbushura me takimet që Sheba kishte nëpër zyrat e turqve dhe kafenetë e ndërmjetësve grekë. Shpresat për lirinë e Jorgo Mavromatisit sa vinin e zbeheshin, por kjo nuk e plogështoi Shebën, të cilën ky qëllim e bëri edhe më të devotshme. Nga fundi i tetorit, në ishull zbarkoi dimri. Dallgët nazelie të Egjeut përplaseshin në liman dhe stërkalat e tyre vishnin xhamat e shtëpisë ku banonim. Shëtitjet tona në breg u rralluan, për t'iu kushtuar darkës së thjeshtë që Sheba e gatuante duke fshehur nën leshterikë të pastruar dhe gjethe limoni kufizimet e tepruara të kuzhinës së fesë së vet. Pastaj rrinim ulur të dy, me karriget nga deti, dhe kalkulonim të ardhmen e jetëve tona. Në një nga këto net, ajo mbështeti kokën mbi supin tim dhe për një kohë mbeti ashtu me sy mbyllur. Aty e kuptova se marrëdhënia me këtë grua ishte një ishull ku Zoti më kishte ndaluar për të pasuruar jetën time. Për dhjetë ditë rresht ne e përsëritëm këtë skenë çdo natë dhe në çdo detaj të saj pa ndryshuar asgjë, aq sa një ditë Sheba më tha se po e përsërisnim veten si në lutjen e mbrëmjes. Ndoshta ajo dhe lutej ashtu, ndërsa unë mendohesha nën dritën e një qiriu të vendosur mbi dritare, i cili shpesh më dukej si një fanar mbi det. Shikoja dritën e qiriut që zgjatej mbi dallgë dhe përpiqesha të gjeja se në cilin vend do të ndalonte.

I ftohti i nëntorit kapërceu nga deti dhe hyri në dhomën tonë, gjë që na afrooi më shumë dhe kur, duke e mbështjellë Shebën me krahun tim, e putha në buzë ajo reagoi siç reagon çdo njeri ndaj një gjëje që e pret prej kohësh.

Atë ditë bëmë dashuri në qetësinë tonë.

Bashkimi i një burri shtatëdhjetegjashtëvjeçar me një grua dyzetetrevjeçare nuk është si bashkimi i zakonshëm dhe i përditshëm i çdo burri dhe çdo gruaje tjetër. Ai i ngjet bashkimit të një gjysme limoni të tharë me një gjysmë portokalli të pjekur, të cilët, pasi ngjiten për një kohë të gjatë nga lëngjet e tyre, nga një anë duken si një diell i kuq në perëndim dhe nga ana tjetër si një hënë e verdhë në agim. Por ngado që ta kthesh këtë rruzull ai fal ngrohtësi. Një varg i pashpjegueshëm i Safos që Sheba e kishte shumë të dashur thoshte: *ti më jep nxehtësi*. Këtë kishim bërë unë dhe Sheba në acarin e jetës sonë. Kishim kërkuar nxehtësi te njëri-tjetri. Kjo nxehtësi po e ngroh akoma dhe sot jetën time.

Natën e krishtlindjeve Lesbosi u zbardh nga dëbora. Unë kisha blerë peshk, karkaleca, zogj deti dhe mish qengji. Sheba më kishte thënë se atë natë do gatuante si greke dhe tavolina jonë ishte më e pasur se kurrë. Po pinim verë me arra duke shijuar dëborën që shkrihej mbi det, kur Sheba më tha se priste një fëmijë. Qau derisa e zuri gjumi, por kur ajo fjeti, pashë që fytyra e saj ishte kredhur në paqe. Unë mbeta zgjuar deri kur u zgjua dhe ajo. E pyeta se çfarë mendonte të bënte me barrën e saj, por ajo ishte e vendosur dhe më tha se nuk e çonte ndër mend të hiqte nga trupi i saj një krijesë, të cilën kishte vite që e priste. Nuk guxova t'i kujtoj rrezikun e martesës së saj me Jorgon, për shkak të fëmijës, sepse ajo më tha se gjithnjë kishte dashur një fëmijë dhe jo një martesë jetime. Jorgo nuk do të lirohet edhe për disa vjet dhe unë nuk mund ta shtyj jetën time duke e pritur e vetme. Kur të lirohet do t'ia shpjegoj dhe ai le të vendosë si të dojë, më tha. Ç'do t'i thuash, e pyeta. Do t'i them se fjala e tij shkoi në vesh të perëndisë. Një farë hurme mbiu në barkun tim, siç e parashikoi Jorgo kur u nisëm nga Stambolli.

Në fund të janarit barku i Shebës filloi të rritej dhe faqet e zeshkëta iu skuqën. I nisën të vjellat dhe për disa ditë nuk u ngrit dot nga shtrati. Pas disa javësh ajo do të dukej edhe më e shëndoshë dhe barra e saj nuk do mund të fshihej më. Ndoshta duhet të ikim nga Lesbosi, i thashë. Njerëzit këtu e dinë që ne nuk jemi të martuar dhe lidhjen tonë do ta quajnë një turp, gjë që mund të ndikojë edhe në sjelljen ndaj Jorgos. Në Lesbos e dinin se Sheba priste të shoqin e burgosur, ndërsa unë isha prezantuar si xhaxhai i saj. Qyteti i Mitilinës ishte shumë i vogël dhe pa dyshim që fjala do t'i arrinte një ditë Jorgos në burg çka do të ishte një tragjedi e re për të. Për këtë arsye nuk mund të thërrisnim një doktor, i cili mund të kujdesej për barrën e Shebës. Shkojmë në Selanik, i thashë, por ajo më kundërshtoi. Nuk mund të shkoj në Selanik në këtë gjendje në mes të dimrit. Do rrezikoja veten dhe fëmijën. Udhëtimi në det do të më vdesë. Shkojmë në Kretë, i thashë. Është ishulli më i afërt dhe udhëtimi deri atje në mot të mirë nuk mban më shumë se një ditë. Atje kam dhe eshtrat e vëllait të madh. Sheba nuk u mendua shumë. Shkojmë, më tha, atje ka kohë që të presin.

Pas disa ditësh ajo e mori veten dhe koha u përmirësua. Gjeta një anije, mora Shebën dhe arkën me babanë tim dhe u nisëm. Deti nuk e mundoi shumë Shebën, e cila atë ditë ishte e qeshur dhe më tha se me siguri do të lindte një djalë. Nga e kupton, e pyeta. Nga ty, m'u përgjigj me ledhati. Ti i ngjan Abrahamit me këta flokë të bardhë, me trup të drejtë dhe sy të mëdhenj që nguleshin në vendet ku ai u end deri në fund të jetës për të kërkuar një copë tokë për varr. Abrahami në fillim pati vetëm djem. Gruaja e tij Sara vuajti shumë vjet dhe u mbars në moshë të thyer atëherë kur i kishte humbur shpresat. Ti je Abrahami im dhe djalin tonë do ta quajmë Isak si djalin e tij, thoshte Sheba e lumtur duke mbushur flegrat dhe barkun e saj me ajrin e pastër të Egjeut. E di ç'do të thotë Isak? Mbylla sytë për t'i thënë jo. Isak do të thotë i qeshur, në gjuhën që fliste Abrahami, i cili e quajti të birin kështu sepse ditën që mori vesh që mund të lindte një fëmijë, gruaja e tij qeshi shumë gjatë.

Pasdite ullinj të zinj të Kretës u ngritën mbi det. Kreta konsiderohej si Ishulli i Madh dhe askund më shumë se këtu nuk ishin përplasur në shekuj grekët me turqit. Kreta iu mor bizantinëve grekë nga venecianët latinë që në vitin 1204, vit kur Komnenët lanë skeptrin e tyre dhe ikën nga Kostandinopoja. Kreta është vendosur mbi det, në një mënyrë të tillë sa që duket sikur thotë: Nga unë kalon rruga për në perëndim. Turqit e kuptuan se duhej ta pushtonin me çdo çmim për të ecur më tutje. Ata vuajtën njëzetepesë vjet në rrethimin e Kretës, por në vitin 1669 gjetën një Sulltan të zgjuar dhe mizor, që e pushtoi. Ky ishte një shqiptar, Fazil Pasha Qyprilliu. Vëllai im vdiq në mbrojtjen e këtij ishulli sepse babai besonte se rënia e Kretës nuk do t'i ndalte më turqit dhe pati të drejtë. Im vëlla vdiq kur ishte tetëmbëdhjetë vjeç dhe unë nuk kisha lindur

akoma. Ia thosha të gjitha këto Shebës, e cila më ndiqte me vëmendje. Kur mbarova, më kapi dorën dhe më tha: Këtu ke humbur një Komnen, por do të gjesh një Komnen tjetër. Ia afrova dorën te barku dhe m'u duk sikur fëmija lëvizi për të më përshëndetur.

Në kryeqytetin e Kretës, në Kandi, hymë kur dielli po binte në det. Atë natë fjetëm në një hotel pranë portit dhe të nesërmen gjetëm një shtëpi të bardhë me një oborr të mbushur me limona, të cilëve një arrë e madhe ua jepte diellin me kursim. Sheba e rregulloi dhomën tonë, ndërsa unë e futa babanë tim poshtë krevatit prej hekuri, ku flinim.

Ato shtatë muaj ajo ndenji më shumë shtrirë në atë krevat dhe unë blija ushqime dhe gatuaja shpesh për të dy. Grekët e Kretës ishin shumë më miqësorë se në Lesbos dhe Tereza, e zonja e shtëpisë, u kujdes me pasion për Shebën. Ne u deklarua si të martuar dhe ajo bëri kryqin kur i thamë se prisnim një fëmijë pas shumë vjetësh. Doktor i që thirra për të vizituar Shebën më tha se ajo nuk duhej të lëvizte shumë pasi për shkak të moshës, barra e saj nuk ishte ngjitur siç duhet. Sheba nuk u trishtua për asnjë çast e bindur të duronte çdo sakrificë për fëmijën tonë. Kur unë dilja, ajo qëndiste rrobat e djalit me shtizat dhe pëlhurat që ia kishte gjetur Tereza dhe hante arra të thata me mjaltë nga pema e shtëpisë. Këto janë arrat e vjetshme, thoshte Tereza, por kur të lindësh do pikojnë arrat e njoma dhe unë do t'i bëj reçel.

Për gati tri javë unë u enda nga mëngjesi në mbrëmje duke pyetur në qytet dhe në fshatrat rrotull tij për vëllanë tim. Askush nuk dinte se disa shqiptarë kishin ardhur për të luftuar në ishull, derisa një ditë në një kafene afër portit më thanë të takoja një plak, i cili mund të kujtonte ndonjë gjë. E gjeta kollaj shtëpinë e tij që duhej të ishte shumë më e vjetër se i zoti. Plaku më tha se kishte dëgjuar për disa ushtarë shqiptarë që kishin ardhur gjatë luftës në Kretë, por unë duhet të shkoja në një fshat malor nja dy orë nga qyteti me kalë. Një mëngjes e lashë Shebën me qëndisjet e saj dhe u nisa. Mali për ku isha drejtuar ishte një vend i tharë nga dielli aziatik që e rrihte përjetësisht dhe nuk kishte shumë ujë. Nga lartësia deti dukej si gjithësi sepse askund nuk shihje tokë. Fshati kishte pak shtëpi dhe ishte shumë i varfër. Atje më thanë se në një pllajë që binte mbi det ishin disa varre, të cilave askush nuk i kishte dalë për zot. E sigurt ishte se nuk ishin të fshatit. Një nga burrat e paktë që takova erdhi me mua për të më treguar rrugën. Në një cep të pllajës afër një greminë që binte si një vetëtimë mbi det ishin disa gurë për të cilët burri më tha se ishin varre. Ishin dhjetë gurë të zinj që të vendosur një nga një formonin një gjysmëharku si në një valle. Shqiptarët kishin qenë njëmbëdhjetë. Mbi gurin e fundit dalloheshin disa numra të shkruar keq në madhësi të ndryshme, të cilat dukej sikur i kishte gërvishtur shpejt e shpejt një dorë që dridhej në panik, 1670. Këto ishin numrat. Gurët e tjerë ishin memecë. Hodha sytë përreth sikur kërkoja një shenjë të vëllait tim, por humnera ishte e shurdhët. Duhet të jetë një datë, foli burri pas kurrizit tim. Ashtu duket i thashë. Por Kreta u pushtua në vitin 1669 nga turqit dhe në 1670-n lufta kishte mbaruar. Ndoshta këto janë varrë të fundit, tha burri.

E vërteta ishte më e frikshme se humnera që kisha afër. Me sa duket grupin e shqiptarëve të ardhur vullnetarisht në ndihmë të Kretës e kishin sjellë të ruante mbi këtë mal, që në atë kohë duhet të ketë qenë pikë strategjike, sepse nga këtu mund të kontrollojë gjithë detin. Në qoftë se turqit do të vinin nga lindja, shqiptarët do përballeshin të parët me ta. Por turqit erdhën nga perëndimi dhe humnera nuk i la të ngjiteshin mbi pllajë për t'i dalë qytetit të Kandisë nga prapa. Që këtu shqiptarët kanë parë anijet turke poshtë në det, por nuk kanë mundur të kuptojnë se kush po e fitonte luftën atje poshtë pasi kur është rrethuar qyteti ata duhet ta kenë humbur lidhjen me grekët. Kandija u pushtua më 1669-n dhe grekët që nuk u vranë, u dorëzuan. Ndoshta dikush prej tyre u tregoi osmanëve se një grup shqiptarësh i priste lart në mal. Lufta mbaroi me kapitullim, por shqiptarët nuk e mësuan dot as kur vdiqën. Ata kanë qëndruar këtu nuk di se sa kohë në acar, në erë, në shi dhe nën zheg duke pritur të bënin atë për të cilën kishin ardhur: të luftonin. Kur

turqit janë ngjitur nëpër mal për t'i kapur dhe i kanë rrethuar nga të tre anët, përveç humnerës, ata e kanë kuptuar se ishin të pashpresë dhe duke luftuar, kanë varrosur njëri-tjetrin ndërsa gurët duhet t'i kishin bërë gati paraprakisht. Asnjëri prej tyre nuk dinte të shkruante dhe prandaj varret i lanë pa gojë. I fundit që ka mbetur prej tyre dhe që nuk mund të varroste dot veten është hedhur në det pasi ka shkarravitur katër numra si për të dëshmuar se shokët e tij u vranë nga turqit, pasi u lanë të vetëm nga grekët. Ku ta dish nëse do të dorëzoheshin po të mësonin se lufta kishte mbaruar, mendova dhe ula kokën. Si ta merrja vesh se cili nga këta të dhjetë ishte vëllai im? Kishte vdekur i pari? Apo i dyti? Apo ishte i gjashti, guri i të cilit ishte më i vogël sepse edhe vëllai kishte qenë më i vogli nga burrat? Apo ishte i dhjeti, ai mbi gurin e të cilit katër numrat ishin shtrirë siç shtrihet çdo ditë veriu, jugu, lindja dhe perëndimi mbi horizontin e botës. Apo ishte vëllai ai që e kishte lënë këtë gjurmë mbi librin e pambaruar të luftërave mes krishterimit dhe islamit, dhe pastaj ishte hedhur në humnerë? Kushdo qoftë prej tyre unë nuk mund ta ndaja nga shokët. I putha gurët një nga një dhe u çova në këmbë si në një varrim. Shkula një grusht bar të njomë dhe e hodha mbi humnerë. Fijet e barit ranë ngadalë në boshllëk dhe mua m'u duk sikur ato ishin njëmbëdhjetë.

Kur mbërrita në shtëpi, në darkë, Sheba po më priste. I tregova i ngashëryer historinë e vëllait tim. Nga të gjithë djemtë vetëm ai kishte trashëguar sytë jeshilë të babait dhe ndoshta prandaj ky e donte mbi të tjerët. Sa do të doja t'i merrja të dy bashkë në fshat, i thashë Shebës. Nuk mund t'i merrje të dy, më tha ajo, duke më përçafuar. Arka që ke poshtë krevatit është e ngushtë për dy burra të mëdhenj. Kur po më mbylleshin sytë nga gjumi mendova se Sheba kishte të drejtë. Arka ishte e vogël për dy burra, fshati ishte i vogël për Komnenët, Shqipëria ishte e vogël për shumë fe dhe bota ishte edhe më e vogël për kaq shumë luftëra.

Doktori na tha se Sheba duhej të lindte në korrik.

Ky muaj në Kretë është një torturë. Deti qëndron me javë pa asnjë dallgë dhe qielli të rri mbi kokë si një çallmë e përvëlur. Megjithëse i mbanim dritaret hapur, Sheba djersinte dhe mezi e rrotullonte barkun e madh në krevat. Një ditë në drekë ajo filloi të bërtiste nga dhimbjet dhe Tereza vrapoi të lajmëronte doktorin, i cili erdhi duke dihatur nga vapa. Të dy, me Terezën u futën në dhomë, ndërsa mua më nxorën jashtë. Një burrë në moshën time i humb emocionet e një babai nervoz dhe e përjeton lindjen e një fëmije si një gjysh i heshtur. Unë u futa poshtë hijes së arrës dhe që atje dëgjoja përgatitjet e doktorit dhe përplasjet e enëve prej bakri që Tereza kishte sjellë nga kuzhina e shtëpisë. Megjithëse nuk kishte erë, klithmat e Shebës arrinin t'i lëviznin gjethet e arrës. Gati një orë mbeta ashtu ngurtë, ndërsa djersa më rridhte si rrëshirë nga trangu im i vjetër. Nuk lëviza as kur një piskamë fëmije zbriti deri tek unë nga dritarja e hapur e dhomës. Fëmija qante shtruar, duke përmbushur me korrektesë detyrën e parë që kishte në këtë botë: të qante. Por zhurmat që vinin nga dhoma nuk pushuan. Dëgjoja doktorin që thërriste fort, lëvizte akoma më fort dhe shtypte shumë më fort sikur donte të disiplinonte lëvizjet e gjymtyrëve të Shebës.

Pastaj u bë qetësi.

Mua m'u duk sikur zhurma e madhe që dëgjoja kapërceu dritaren, rrëshqiti nëpër lëkurën e arrës, kaloi rrugën dhe u zhyt në det pa më folur. Pak më vonë pati prapë një zhurmë, por kjo ishte e qara e fëmijës. Ishte e vetmja zhurmë që mbeti brenda në shtëpi. U ngjita lart dhe trokita në derë me dorën time prej gjyshi. Tereza doli me një fëmijë në krahë që e kishte mbështjellë me një çarçaf rozë. Është vajzë, tha. Të të rrojë. Po e ëma, pyeta unë. Tereza u kthye nga foshnja dhe uli kokën. Pas saj doli doktori, i cili më tha se Sheba kishte vdekur gjatë lindjes. Gruaja jote bëri një sakrificë, më tha. Ishte në një moshë delikate.

Duke varrosur Shebën, mendoja e të gjithë ata që kishin udhëtuar me mua kishin vdekur dhe kjo nuk mund të ishte një rastësi. Kishte vdekur babai që erdhi me mua deri në Stamboll, pastaj Gjergj Brankoviçi, me të cilin shkova deri në Vjenë, më pas gruaja ime që erdhi me mua deri në fshat për të më sjellë tre djem dhe tani Sheba me të cilën erdha në Kretë, te vajza ime. Me sa duket Zoti kishte vendosur që unë ta vazhdoja i vetëm udhëtimin tim, që nuk kishte mbaruar. Sheba e dinte fundin e përrallës sime. Para se të vdiste ajo kishte parë vajzën e saj dhe në mes të kllapisë i kishte thënë Terezës: Abrahami dhe Sara tani janë bashkë.

Sara është vajza që solli arrat, tha Arianit Komneni. U ushqye nëntë muaj me arra në barkun e të ëmës dhe vazhdon t'i ketë qejf. Kur Sheba vdiq, unë vazhdova të rrija në shtëpinë e Terezës. Nuk mund të lëvizja nga ishulli me një foshnjë të sapolindur. Sara kishte nevojë për një nënë, të cilën unë nuk mund t'ia zëvendësoja. Tereza gjeti një vajzë të re, e cila sapo kishte lindur dhe që pranoi t'i jepte qumësht Sarës nga gjiri i vet. Babai i saj ishte venecian i mbetur në Kretë, ndërsa e ëma greke. Vajza vinte çdo ditë dhe ushqente Sarën. Kur ajo ikte, unë e vija në gjumë. Kur qante, e tundja në krahë. Tereza kujdesej për ta pastruar dhe për ta larë gjë që unë nuk e mësova dot. Në shtator, kur era e vjeshtës u kthye në Kretë, e nxorëm për herë të parë Sarën nga shtëpia. Por bota nuk i pëlqeu fare sime bije, e cila filloi të qante e zhgënjyer. E vura nën hijen e arrës ku u qetësua dhe fjeti shumë gjatë. Kur mbushi nëntë muaj Sara filloi të fliste. U lidh shumë me venecianen e re që i jepte sisë dhe një ditë e thirri me emrin e saj. Kur u bë dy vjeç kishte muaj që ecte nëpër shtëpi dhe zbriti vetë në oborr, shkoi tek arra dhe atje e zuri prapë gjumi.

Ndërkohë, unë kisha nisur të mendoja për t'u kthyer në fshat. Vajza ishte rritur aq sa të përballonte udhëtimin nëpër detet e pabesë të Greqisë. Fillova të përgatitem dhe në shtator zura një anije që nisej për Selanik. I shpjegova vajzës se do të hipnim në anijen që ajo shikonte çdo ditë nga dritarja dhe do shkonim në një vend shumë të bukur me pyje dhe zogj. Sarës kjo i pëlqeu dhe natën ëndërronte sikur po nisej në një përrallë. Mblodha plaçkat tona dhe disa nga gjërat më të dashura të Shebës, mes të cilave një çantë të vogël lëkure ku futa një lodër të Sarës, disa arra, si dhe ndërresa për të. Tereza na dha një reçel me arra të njoma që ishte akoma i ngrohtë kur u fut në kutinë e teneqesë. Ia kisha premtuar Shebës, tha ajo, dhe përqafoi vajzën. Kur mora arkën e babait, e cila prej tre vjetësh rrinte poshtë krevatit, Sara më tha: Baba pse nuk më fut mua brenda në arkë dhe kur të shkojmë në pyll ta hapësh që gjithë zogjtë të tremben. Zogjtë nuk frikësohen nga kukullat, i thashë. Po pse do e marrësh me vete arkën atëherë, vazhdoi ajo. Që kur ti të rritesh të më fusësh mua këtu brenda dhe të më marrësh kudo me vete, i thashë. Aaa, u llastua ime bijë. Ti e do arkën për vete prandaj nuk ma jep mua.

U nisëm në fund të shtatorit dhe era e shtyu anijen tonë ngadalë nëpër Mesdhe deri në Selanik. Rrugës, Sara më pyeste për peshqit, për pëllumbat, për dallgët dhe për ishujt e vegjël që takonim rrugës. Natën flinte pranë meje duke shtrënguar një kokërr arre nga të Kretës në grushtin e saj të njomë. Kur kaluam pranë një ishulli shkëmbor, pamë disa njerëz që po laheshin në breg. Ata i gëzoheshin dallgëve, të cilat i ngrinin lart dhe pastaj i zhysnin aq sa Sara frikësohej se mos nuk dilnin më nga deti. Nuk kanë frikë ata se i merr deti baba, më pyeti pa i hequr sytë nga kokat e vogla që dilnin mbi dallgë. Nuk kanë frikë sepse po bëjnë not, i thashë. Çfarë do të thotë not? Not do të thotë të puthesh detin. Po ti di not, ngulmoi ime bijë. Di, i thashë unë. Do ma mësosh dhe mua notin baba? M'u kujtua peshkatari tullac i Raguzës dhe për herë të parë pas katër vjetësh fshati m'u duk më afër se kurrë. Do ta mësoj, i thashë. Do ta mësoj patjetër.

Në Selanik ndenjëm dy javë. Sheba më kishte folur për një kushërirën e vet të afërt, të cilën e gjeta në një dyqan librash të vjetër. Kur dëgjoi për vdekjen e Shebës dhe gjithë historinë tonë ajo

filloi të qante. Nuk mund të ikja pa ju lajmëruar, i thashë dhe i tregova vendin ku e kisha varrosur në Kretë. Gruaja puthi Sarën dhe ne ikëm. Por vajza e kishte dëgjuar gjithë bisedën time duke bërë sikur luante me librat, poshtë një tavoline të madhe me këmbë hekuri. Rrugës më pyeti se kush ishte Sheba. Është mamaja jote, i thashë. Po pse nuk erdhi me ne në pyll, tha vajza. Ajo në pyll është, iu përgjigja unë dhe një lëmsh m'u ngjit në fyt dhe më mori frymën. Sheba është në pyll, i thashë, por asnjëri nuk e di se ku. Do pyesim zogjtë dhe do ta gjejmë. Po si do ta njoh unë mamanë, tha Sara. Do ta njohësh se edhe ajo ashtu si ty, mban në dorë një kokërr arë, i thashë dhe nuk fola më.

Kur arrita në fshat unë isha tetëdhjetë vjeç ndërsa Sara tre. Kur më panë pas katër vjetësh burra, gra dhe fëmijë dolën nëpër rrugët e fshatit për të më përshëndetur. Unë i flisja të gjithëve, por nuk mund t'i takoja dot sepse duart i kisha të zëna. Me një dorë shtrëngoja Sarën që çapitej e hutuar pas meje, ndërsa me dorën tjetër mbaja babanë tim, i cili po kthehej në fshat pas gjysmëshekulli. Askush nuk më pyeti për arkën, por të gjithë shikonin Sarën e vogël me faqe të kuqe dhe flokë të zinj. Është vajza ime, i thosha unë dhe njerëzit qeshnin për të mos më vënë në vështirësi, por me siguri mendonin se unë po tallesha. Sara nuk kishte parë ndonjëherë fshat dhe kur më pyeti se ku ishim i thashë se kishim arritur në pyll. Të nesërmen e nxora babanë nga arka dhe e varrosa pranë nënës sime. Rrini vetëm, u thashë. Unë po iki. Keni kohë të çmalleni derisa të kthehem. Pastaj kalova te varri i Hanës. I vura dorën sipër sikur doja ta ngrohja dhe qëndrova pa lëvizur për një kohë të gjatë. Pas shumë vjetësh e kisha bashkuar familjen time.

Për një javë rresht gjithë fshati erdhi në shtëpi për të uruar kthimin tim. Sara rrinte në dhomë bashkë me mua dhe nuk i fliste askujt, megjithatë të gjithë e përkëdhelnin dhe i jepnin sheqerka që ajo i hidhte në arkën bosh të gjyshit, të cilën unë ia kisha dhënë sipas premtimit. Vetëm një njeri nuk erdhi ta shikonte Sarën, Gjergji, djali im i madh. Kur i thanë se unë u ktheva në fshat me një vajzë të vogël që e kisha lindur me një grua tjetër, ai mori familjen dhe iku nga shtëpia. Sara tani është 15 vjeç, por Gjergji akoma nuk na flet.

9

Arianit Komneni pushoi, mori frymë thellë dhe kaloi dorën mbi mjekrën e zbardhur, sikur kishte harruar diçka pa thënë.

Histori e bukur, por e trishtuar, i tha Ali Tepelena. Sikur ta shkruaje çdo ditë të jetës, fletët do arrinin deri në Stamboll. Disa fletë janë lagur dhe nuk mund të lexohen më, tha Komneni i menduar. Edhe kaq sa lexohet mjafton për të kuptuar se nuk ke lënë gjë pa bërë në këtë jetë.

Kam lënë, u përgjigj qetësisht Arianiti. Nuk kam vrarë.

Ndoshta ke vrarë, por nuk ma tregon mua, e shpëtoi Aliu. Jo, përsëriti Arianiti duke e parë në sy, nuk kam vrarë njeri. Aliut në ato momente plaku iu duk kërcënues dhe e ktheu bisedën me shaka. Ku i dihet! Ti je akoma i fortë dhe jetën e ke përpara. Këtë gjë e di, u përgjigj Arianiti serioz. Jeta më ka mësuar t'i zgjidh gjërat ndryshe dhe prandaj nuk kam nevojë të vras.

Po ti ke vrarë, e pyeti Arianiti. Aliu nuk u zverdh nga frika, por nga mënyra se si e pyeti njeriu që kishte përballë e që atij iu duk tallëse. Vras kur nuk më binden, i tha duke ngritur zërin. Ke ngatërruar fshat, tha Arianiti. Këtu nuk ka burra për të vrarë. Do të thuash që fshati do të më bindet, u përpoq Aliu të kapej pas fjalëve dhe sytë i shndritën. Aspak, vazhdoi Arianiti i përqendruar duke e hequr velenxën e kuqe. Kjo çështje do të zgjidhet në mënyrën time. Pa vrarë. Edhe ti e ke pranuar se vetëm kështu mund të zgjidhet, ndryshe do ta kishe zgjidhur duke vrarë

dhe nuk do kishe ardhur të më takojë. Bukur, tha Aliu i dorëzuar. Kthejini Ibrahimit të drejtat që i hoqi pleqësia dhe le ta quajmë se kjo punë u zgjidh me mënyrën tënde.

Arianit Komneni u mendua pak dhe filloi të fliste. Ky fshat ka pasur sherre gjithmonë, por unë dhe përpara meje babai im, si kryetarë të pleqësisë, i kemi zgjidhur me qetësi duke u përpjekur t'i pajtonim njerëzit. Babai më thoshte se më mirë një fshat i varfër, se një fshat në gjak. Prandaj ka më shumë se gjashtëdhjetë e pesë vjet që këtu nuk ka vrasje. Vrasja e fundit ndodhi, kur xhaxhai i Mihalit vrau vëllanë e vogël të gjyshit të Ibrahimit, sepse të dy donin të martoheshin me të njëjtën grua. Ndoshta unë jam i vetmi që kam parë një vrasje sepse shumica nuk kishin lindur në atë kohë. Që hasmëria të mos vazhdonte, babai vendosi që xhaxhai i Mihalit të dëbohej nga fshati dhe kështu u bë. Dy familjet u qetësuan, por, me sa duket, nuk e harruan gjakun. Për këtë arsye Mihali dhe vëllai i tij e tejkaluan vendimin e pleqësisë dhe, si të shtyrë nga hakmarrja, shkonin çdo natë në shtëpinë e Ibrahimit duke djegur kryqe. Ata gjetën ditën kur i gjithë fshati ishte kundër Ibrahimit dhe e sulmuan. Por djali i Ibrahimit, Thanasi, nuk është i butë si i ati. Ai ka lindur për të luftuar tamam si stërgjyshi i tij, që ishte i egër dhe i fortë dhe që nuk i bënte syri dritë, arsye për të cilën, babai e nisi në Kretë në krah të vëllait tim. Në qoftë se ai do ishte kthyer gjallë nga lufta, asnjë vendim pleqësie nuk do mund ta ndalonte që të mos i merrte hakun të vëllait dhe unë them se fshati e pati një të mirë nga kjo vdekje. Siç kanë rrjedhur ngjarjet kam frikë se, nëse kjo punë nuk mbyllet me urtësi, Thanasi mund ta vrasë Mihalin, jo vetëm se ky i ka fyer babanë, por edhe për t'i marrë hakun e shtëpisë. Jam menduar gjithë këto ditë dhe prandaj nuk doja ta mblidhja pleqësinë sepse mendjet aty janë ende të nxehta dhe një vendim i shpejtuar mund të jetë i pafrytshëm.

Nuk ta tregova kot historinë time. Besoj se e ke kuptuar se gjithë jetën unë, ashtu si babai im, kam menduar se paqja dhe qetësia do të vinin për ne, ditën që Islami do të zbythej në Azi duke ia lënë krishterimit këtë copë qiell ku ne jetojmë prej shekujsh. Mirëpo, kjo nuk ndodhi dhe ne duhet ta pranojmë qiellin që kemi, megjithëse, në më të shumtën, ai është i mbuluar nga retë e Islamit që na e zënë diellin. Bota do vazhdojë të përgjaket si më parë, por unë dua t'ia kursej fshatit këtë sherr, që as perënditë nuk po e zgjidhin dot. Prandaj Ibrahimit dhe ne duhet të jetojmë nën të njëjtin qiell. Ai le të numërojë retë, ndërsa ne do presim me durim kur të dalë dielli.

Dua të them se kam vendosur t'i kërkoj pleqësisë që Ibrahimin ta pranojmë si mysliman në fshatin tonë. Ne do t'i flasim dhe do ta respektojmë. Do t'i japim bukë dhe do t'i blejmë mish. Ne do t'i çojmë bagëtitë tona që ai t'i shërojë, do t'i shkojmë në shtëpi për gëzime dhe do ta ftojme në dasmat tona. Fshati do ketë dy varreza. Një për të krishterët dhe një për myslimanët. Çdo gjë do jetë si më parë me përjashtim të njëres.

Çfarë, tha Aliu që gjithë kohën kishte pritur që plaku dinak të kishte një kusht.

Vajzat e krishtera nuk do martohen me djemtë e Ibrahimit, foli prerë Arianit Komneni, si një gjykatës. Ali Tepelena u përtyp, ngriti dorën dhe tha: kjo është e padrejtë. Ti po i jep bukën, por nuk po i jep gjakun. Kjo është një hile dhe Ibrahimit nuk mund ta pranojë. Ai mezi pret t'i martojë djemtë. Nuk thashë që djemtë e Ibrahimit të mos martohen. Ata mund të marrin gra myslimane nga fshatra të tjera dhe t'i sjellin këtu dhe ne do gëzojmë në dasmën e tyre, u përgjigj Arianiti. Po djemtë e Ibrahimit janë të krishterë dhe gruaja e tij po ashtu, u kujtua Aliu që i erdhi turp nga vetja kur iu duk se po lutej, gjë që nuk e kishte zakon. Megjithëse djemtë mund të mbeten të krishterë çka do të jetë në nderin e tyre, fakti që i ati është mysliman i bën ata njëloj të padëshirueshëm për vajzat e këtij fshati. Ata mund të marrin vajza të krishtera në fshatra të tjerë, në qoftë se ua japin. Por çfarë ndodh jashtë këtij fshati nuk varet nga unë.

Arianit ishte bërë cinik sepse e dinte që në këtë lojë fjalësh, Aliu ishte më i dobët se ai. Ali Tepelena e kuptoi se me marrëveshjen që i kishte afruar, Arianit Komneni kishte pranuar të

shkrinte kufij të tokësorë dhe ata të hapësirës me myslimanët, por këtë lëshim e kishte bërë për të ndaluar çdo përzjerje të gjakut dhe farës së tij të krishterë me femra apo meshkuj të fesë islame. Me pak fjalë, Komneni i propozonte myslimanëve që tokë dhe qiellin ta ndanin bashkë, por jo trupin dhe shpirtin. Ai donte ta mbante të pastër qelizën e riprodhimit të racës së tij dhe mundësisht ta fuste në arkën e të atit, për ta marrë me vete kur të ikte nga kjo botë. Arianit Komneni vazhdonte luftën e Arianit Komnenit. Por me sa duket ai ndihej më i fortë se binjaku i tij, që kishte lindur treqind vjet përpara. Arianiti i parë kishte lënë tokat dhe kalatë dhe kishte ikur, ndërsa Arianiti i dytë, duke e trajtuar si kala të krishterë historinë dhe emrin e familjes, megjithëse kishte pasur mundësi të ikte, ishte kthyer për ta ruajtur atë të paprekur deri ditën e fundit. Ja pse i kishte treguar historinë e gjatë të jetës së vet dhe, ashtu siç kishte bërë Sheba, me të, ai kishte bërë me Aliun, duke i treguar të gjithë përrallën, përveç fundit.

Ky është i marrë, mendoi Ali Tepelena. Sa të jetë gjallë nuk e lëshon kalanë e racës së vet. Çdo shartim të një trupi të krishterë me një trup mysliman ai do ta konsideronte një pushtim. Por ndërkohë që ky sheh nga qielli, pushtimi ka nisur nga toka.

Si një pushtues i regjur që përpara shpatës provon dredhinë, Ali Tepelena mendoi se duhet të bënte edhe një përpjekje të fundit. Ibrahim i nuk është një mysliman si gjithë të tjerët, tha. Atë nuk e detyroi askush të kthente fenë. Shkoi vetë dhe foli me imamin dhe pasi u bind vendosi.

Arianit Komneni, i cili deri në atë çast kishte qenë i qetë dhe madje, disa herë i ftohtë në cinizmin e tij, u përflak në fytyrë si velenxa e kuqe që mbante te këmbët.

Kujt i thua ti që Ibrahim i nuk e detyroi kush të bëhej mysliman, iu kthye ai me një zë të fortë prehistorik Ali Tepelena. Kush mund t'i besojë këto dokrra? Ka treqind vjet që turqit i detyrojnë shqiptarët me shpatë dhe me taksa që të tradhtojnë krishterimin. Sa familje shqiptarësh kanë paguar taksën e gjakut, devshirmen dhe i kanë nisur djemtë e mitur jeniçerë në ushtrinë osmane? Sa familje të tjera detyrohen sot e mot të paguajnë një të dhjetën e të korrave të tyre haraç, që të mos bëhen turq? Sa të tjerë paguajnë taksën e tokës, xhizven, të cilën taksidarët ua rrjepin të krishterëve? A mund ta mohosh se të krishterëve nuk u merret parasysh padija te kadiu mysliman? A mund ta mohosh se familjet e krishtera detyrohen të japin fëmijët peng, që turqit t'i besojnë atyre dhe kjo quhet taksa e sinqeritetit? A mund ta mohosh se në gjithë vendin, nga Shkodra deri në Elbasan, tregtarët e krishterë nuk lejohen të hapin dyqane në pazarin e qytetit? A mund ta mohosh ti, se fshatarëve të krishterë në Vlorë u grabiten tokat nga bejlerët myslimanë? A mund ta mohosh se vajzat e krishtera detyrohen të vënë ferexhenë që dhjetë vjeç ndryshe nuk i lejojnë të dalin në rrugë? A e di se në Berat një grua e krishterë që nuk mban perçe dhe që nuk i mban duart e mbledhura kur ecën, dënohet si e përdalë nga burrat myslimanë? A e di ti se titujt dhe gradat i jepen vetëm myslimanëve, megjithëse të krishterët jetojnë në të njëjtën perandori me ta? A e di ti se sa familje të mëdha shqiptare në këto dyqind vjet u detyruan të ndërronin fenë se ndryshe do t'i kishin humbur gradat dhe ofiqet e tyre bashkë me pronat? A e di ti se pas vdekjes së Skënderbeut Sulltan Murati nxori një dekret që i detyronte gjithë shqiptarët të bëheshin synet me pahir, për të larë, sipas tij, tradhtinë e Skënderbeut? A e di që para disa vitesh një prift në Mirditë u kap dhe kur nuk pranoi të bëhej mysliman u dënua me vdekje? a e di ti se turqit i japin të drejtë vetes ta shajnë si të duan Krishtin, por po u shave Muhamedin të djegin të gjallë siç bëjnë me një të krishterë në Korçë?

A e di se çfarë i ndodhi Gjergjit në Janinë? Ta them unë që të kuptosh se pse Ibrahim i u bë mysliman.

Gjergji ishte shërbëtor te një efendi i pasur. Puna e tij ishte që t'i mbante të zotit çibukun dhe rrogozin e faljes. Kur i zoti shkante në xhami të falej, Gjergji e priste te dera sepse si i krishterë atij nuk i lejohej të hynte në xhami. Efendiu, që e thërriste Gjergjin Mustafa, në sy të



muslimanëve të tjerë, një ditë i kërkoi që ta fuste në xhami. Gjergji nuk pranoi, por efendiu e futi me forcë duke e kërcënuar se do ta hiqte nga puna. Kur e morën vesh muslimanët e tjerë, u bënë si të tërbuar sepse e quajtën këtë si fyerje ndaj Islamit. Gjergjin e burgosën dhe duke e torturuar i kërkuan të bëhej musliman. Mirëpo, djali nuk pranoi dhe vdiq gjatë torturave. Por dhimbja e tij nuk mbaroi këtu, sepse turqit kërkuan që fëmijët e tij të bëheshin muslimanë. Por gruaja e Gjergjit nuk pranoi dhe që t'i shpëtonte, deklaroi se fëmijët nuk i kishte me Gjergjin. Dhe natyrisht kopilët nuk meritojnë të bëhen muslimanë, apo jo? kështu shpëtuan fëmijët e shkretë që për të ruajtur fenë e tyre humbën babanë, por dhe nderin e nënës së papërlyer.

Ja, pra, pse u bë Ibrahim musliman. Sot, çdo burrë i krishterë jeton me frikën e Gjergjit, çdo grua e krishterë jeton me tmerrin e gruas së Gjergjit dhe gjithë fëmijët tanë janë të rrezikuar njëjloj si fëmijët e tyre. Kjo është Shqipëria muslimane. Ibrahimin e ka bërë musliman ankthi se një ditë do t'i merrnin tokën, pastaj se do t'ia nisnin fëmijët ushtarë dhe pastaj se do t'ia vishnin gruan me ferexhe. E megjithatë asgjë nuk e justifikon atë.

Gjithë sa të thashë mund të harroheshin, në qoftë se do ishin raste të veçuara. Por e keqja është se islamizimi është kthyer në detyrim në Perandorinë Osmane. Kjo nisi që në vitin 638 me kushtetutën që Kalifi Omar i dha qytetarëve jomuslimanë të Jerusalemit dhe që sot është kthyer në themel të rendit të ri islamik që po vendoset me dhunë. Ja se çfarë thoshte qitapi i tij: Arianiti zgjati dorën dhe mori një libër të verdhë dhe të hollë, që ishte aty afër bashkë me disa libra të tjerë në përmasa të ndryshme, por që deri në atë çast Aliu nuk i kishte vënë re. Po të ishin armë do ta kisha pikasur më shpejt, mendoi dhe u përqendrua te plaku që kishte nisur të lexonte normën muslimane të Omarit.

Të krishterët nuk duhet të ndërtojnë kisha në territor musliman. Të krishterët duhet t'i mbajnë dyert hapur për muslimanët dhe t'i strehojnë ata falas në shtëpi deri në tri ditë. Të krishterët duhet t'u lirojnë vendin muslimanëve kur këta janë të pranishëm. Ata nuk duhet të mbajnë rroba apo zbukurime të ngjashme me ato të muslimanëve. Ata nuk duhet të përdorin emra muslimanë. Ata nuk duhet të ecin mbi kuaj me shalë dhe me kapistër. Nuk duhet të mbajnë shpata, shigjeta, harqe apo armë të tjera. Nuk duhet të mbajnë kurrë në gisht një unazë me gur të çmuar. Nuk duhet të shesin verë dhe të mos e pinë atë në mexhli. Nuk duhet të blejnë shtëpi në lagjet e muslimanëve. Nuk duhet t'i varrosin të vdekurit në varrezat muslimane. Të krishterët nuk duhet të ankohen kur kanë fatkeqësi apo të derdhi lot kur u vdesin të afërmit. Ata duhet të rrinë në këmbë kur i paguajnë taksat, ndërsa taksidari duhet të rrijë ulur. Rruga e lagjes së të krishterit duhet të jetë e ngushtë. I krishteri duhet të bëjë një shenjë në derën e shtëpisë, në mënyrë që njerëzit ta njohin dhe të mos luten për të. Kalifi nuk u mjaftua me kaq, por ai i dha të drejtë çdo muslimani që të vriste të krishterin që sipas tij i kishte shkelur këto rregulla.

Pse nuk bëhesh një ditë i krishterë që ta shijosh parajsën e Kalifit, Omar? Nejse, ti nuk ke kaq shumë shije. Por më thuaj a e kupton tani se pse u bë Ibrahim musliman?

Arianit Komneni kishte folur gjatë dhe zëri i ishte ngjitur. Fyti i tij digjte si një muskul i zhveshur nga lëkura. Gjatë atyre orëve, Aliu kishte parë sesi ai ishte shndërruar nga një luan i plakur që ushqehet me kujtimet e gjuetive të veta në një tigër të plagosur që është gati të përdorë thonjtë për të mbrojtur të vegjlit e vet. Duke folur, Arianiti kishte nxjerrë nga poshtë velenxës edhe dorën tjetër dhe Ali Tepelena pa unazën e Halil Patronës që ia shtypte rrudhat mbi lëkurën e gishtit.

Sot, gjërat nuk janë siç thua ti, tha Aliu. Ndoshta muslimanët kanë më shumë të drejta, por të krishterët e kanë rrëzuar prej vitesh kodin e vjetër të Kalifit. Omari ka një mijë vjet që ka vdekur,

por ai jeton në frikën tënde. Për më tepër ti ke marrë rregullat e tij dhe i përdor tani kundër myslimanëve. Je një mijë vjet prapa, Arianit.

Po të ishte kështu, ti nuk do rrije dot ulur në praninë time, tha Arianiti dhe u ngrit në këmbë si për të thënë se biseda kishte mbaruar. Ali Tepelena u drejtua nga dera pa i dhënë dorën.

Kur doli në oborr pa një arkë të vogël në të cilën si në një arkivol, shtrihej një kukull me flokë të bardha që atij iu duk si Arianit Komneni. I ka ardhur dita, mendoi.

Kishte zbardhur, por qielli nuk ishte i pastër. Dielli ishte fshehur pas një reje dhe dukej sikur kishte turp të dilte.

10

Kur arriti në shtëpi, gjeti Ibrahimin që po e shikonte sikur priste ndonjë lajm. Do të t'i kthejnë të gjitha, foli Aliu. Do të të respektojnë, do të japin bukë dhe vend për varr. Do blejnë dhe mish nga kafshët e tua, por me një kusht. Nuk pranojnë që vajzat e tyre të martohen me djemtë e tu. Ibrahim i donte të thoshte diçka që Aliut iu duk si një pranim, por nuk e la të vazhdonte dhe i tha se do flisnin kur të zgjohej.

Ali Tepelena fjeti shumë dhe pa një ëndërr të gjatë në të cilën, Arianiti ecte nëpër Stamboll dhe me një dorë mbante arkën e të atit dhe me tjetrën shtrëngonte nga flokët kokën e tij të verdhë, që ua tregonte kalimtarëve. Ndërsa ai vetë shëtiste nëpër Janinë, pa kokë, kurse Thanasi, djali i Ibrahimit, e mbante për dore dhe i tregonte rrugën. U zgjua i lodhur dhe doli në oborr ku Thanasi po krihte jelet e kalit. Hajde të të mësoj kalin, i tha djalit dhe e mori për dore, si në ëndrrën e tij.

Thanasi ishte dhjetë vjet më i ri se Aliu, por nga shtati vinte i gjatë dhe duart e tij të njoma e mbani kalin fort. Kur u lodhën, u shtrinë të dy pranë e pranë poshtë hijes së një molle të egër dhe Aliut iu faneps fytyra e djalit që kishte dashur ta puthte, kur ishte në fshat. Çfarë të tha Arianiti, e pyeti Thanasi. Më tha që ti nuk do martohesh me vajzë të fshatit. Thanasi qeshi dhe Aliut iu duk sikur djali i kishte pëlqyer ky vendim, a thua se e kishte shpëtuar nga një detyrim. Unë nuk dua të martohem. Dua të luftoj, tha Thanasi. As Sara nuk do të martohet. Ajo thotë se martesë të pengon të luash. Ti luan me Sarën, e pyeti Aliu. Thanasi i tha po dhe i tregoi se kur ata loznin, Arianiti rrinte në oborr dhe lexonte libra të vjetër. Kur ai e kishte pyetur një herë Sarën se çfarë kishte në ato libra, ajo i kishte thënë se babai aty lexonte se si do ishte fshati pas njëqind vjetësh. Unë i besoj Arianitit, tha djali, sepse ai i ka lexuar të gjitha ato që ndodhin. Njëherë ai më tha se një ditë do të vinte një djalë trim hipur mbi kalë, dhe do më merrte me vete në luftë, siç mori vëllai i Arianitit stërgjyshin tim në Kretë. Kur e pyeta se si do vdes, ai më tha se këtë e kisha në dorë vetë dhe librat nuk mund ta shkruanin. Aliu ngriti kokën lart për të fshehur sytë e tij të habitur nga Thanasi. Dy mollë të egra që ushqeheshin nga e njëjta degë, rrinin ngjitur sikur nuk donin të ndaheshin. Po t'i ndaje, secila do vishkej në vetmi.

Në drekë u kthyen në shtëpi. Ibrahim i ishte në oborr bashkë me një burrë që Aliu nuk e njohte. Burri kishte një mjekër të dendur, por të shkurtër dhe të zezë dhe një trup mesatar. Dorën e kishte shumë të ftohtë dhe Aliu u pendua që ia dha të vetën. Është Gjergj Komneni, i tha Ibrahim, ka ardhur të bisedojë diçka me ty.

U futën brenda, por burri rrinte i heshtur si një mur. Përse doje të më takoje, e pyeti Aliu. Për tokat e mia, tha Gjergji. Ky fshat është ngritur nga stërgjyshi im. Kur ai erdhi këtu kjo tokë nuk i përkiste askujt. Atij i pëlqeu ky vend sepse ka ujë dhe nuk është shumë larg qytetit. Pjesën më të madhe të tokës e mbajti për vete dhe pjesën tjetër ia ndau në mënyrë të barabartë burrave që erdhën bashkë me të nga bregdeti. Kur turqit bënë regjistrimin, pas vitit 1600, familja ime e pagoi rregullisht taksën e tokës. Por tani kam dëgjuar se turqit kanë filluar t'i marrin tokat dhe

t'ia japin bejlerëve dhe pashallarëve të rinj që ndihmuan me ushtarë dhe para nëpër luftërat e shumta. Në shumë fshatra të tjerë shqiptarëve iu janë marrë tokat dhe ata punojnë si hyzmeqarë në tokat e tyre. Kam dëgjuar se ti je bej në Tepelenë dhe se ke krushqi me Pashallarët e Delvinës dhe të Beratit. Unë dua të më ndihmosh që mos ma marrin tokën. Nuk kam pasuri tjetër dhe jam gati të bëj çdo gjë që mos humb atë që kam.

Gjergj Komneni pushoi dhe ngriti kokën në pritje të Ali Tepelenës. Dukej i qetë dhe nuk i lëvizte asnjë muskul. Nuk i ngjan fare të atit nga fytyra, por përpiqet ta imitojë në burrëri, mendoi Aliu. Babai yt nuk e kishte fare këtë shqetësim, i tha ai Gjergjit. Ai më foli për punë të tjera. E ke takuar tim atë, pyeti Gjergj Komneni si i zënë në befasi. Deri sot në të gdhirë isha në shtëpinë e tij, tha Aliu. E çfarë të tha? Biseduam për shumë gjëra. Pleqësia e ka ndëshkuar Ibrahimin me që u bë mysliman dhe unë shkova t'i kërkoj që ai vendim të ndryshojë. Por ai më foli për udhëtimet e tij të shpeshta si dhe për historinë e Komnenëve që nga koha e Skënderbeut. Më tregoi dhe për historinë e familjes suaj, për vëllanë e vranë në Kretë, për të atin dhe për gjithë fëmijët e tij. Më tha që ti nuk i flet që kur ai u kthye në fshat me vajzën e tij, që nuk është vajza e nënës tënde.

Gjergj Komneni lëvizi kokën dhe sytë i shkëlqyen mbi ballin e tij të errët. Të ka gënjyer, tha. Unë nuk flisja me të edhe përpara se të lindte Sara. Që para vdekjes së nënës. Ai më ka martuar me motrën e vet, por unë këtë e mora vesh shumë vonë. Aliu u habit, por nuk e ndërpreu. Gjyshi im jetonte me idenë se familja jonë, si degë e Komnenëve bizantinë, duhet të merrte pjesë në fitoret e të krishterëve mbi turqit. Ai nisi djalin e vet të madh bashkë me dhjetë burra të tjerë nga fshati në luftën e Kretës, por asnjëri nuk u kthye i gjallë. Mes tyre ishte dhe një burë, i cili la në shtëpi gruan dhe vajzën e tij të vogël. Pas disa kohësh, nëna e kësaj vajze vdiq dhe ajo mbeti e vetme. Vajza ishte pesë vjeç dhe nuk kishte kush kujdesej për të. Gjyshi e mori në shtëpi, në nderim të babait të vranë në luftë dhe vajza u rrit atje. Kur u bë për t'u martuar e kërkuar njëkohësisht dy djem nga fshati. Këta ishin xhaxhai i Mihalit dhe vëllai i gjyshit të Ibrahimit, i cili gjithashtu ishte vranë në Kretë. I takonte gjyshit tim të vendoste se kujt do t'ia jepte dorën e vajzës. Dy djemtë pritën një kohë të gjatë, por gjyshi e shtynte nga viti në vit vendimin, por asnjëri nga djemtë nuk hoqi dorë, përkundrazi rivaliteti i bëri edhe më kërkues. Tani më shumë se dashuri ishte një garë mes të dyve. Dikur në fshat u hap fjala se njëri nga dy djemtë futej natën në dhomën e vajzës, por askush nuk e dinte se cili ishte nga këta të dy. Fjalët i bënë xhelozë të dy djemtë sepse secili mendonte se tjetri po i vidhte të dashurën me pabesi. Një ditë, dy djemtë u ndeshën dhe xhaxhai i Mihalit e vrau vëllanë e vogël të gjyshit të Ibrahimit. Dy familjet u bënë gati për gjakmarrje, por gjyshi, si kryetar i pleqësisë ndërhyri dhe i bindi që shërbimet të mbylleshin dhe xhaxhai i Mihalit të dëbohej nga fshati për mos shkelur më kurrë këtu. Familjet ranë dakord dhe xhaxhai i Mihalit u largua duke qarë, por njëkohësisht i lumtur që iu kursye jeta.

Ishte viti 1704. disa javë pas ikjes së xhaxhait të Mihalit, gjyshi vendosi të shkonte në Stamboll ku mori me vete dhe babanë tim që ishte djali më i vogël. Pas shtatë muajsh, vajza lindi një vajzë. Ajo nuk e tregoi kurrë se me kë e kishte pasur fëmijën dhe për shkak të historisë së saj të dhimbshme, fshati e mbylli njërin sy. Gjyshja ime e mbajti në shtëpi foshnjën ashtu siç e kishte bërë me nënën e saj. Gjyshi vdiq në Stamboll dhe babai u kthye në vitin 1709, dhe pak më vonë lindi unë. Që kur fillova të kuptoj u lidha me Kostandinën jetime që ishte pesë vjet më e madhe se unë. Ajo më mbante pas dhe unë nuk i ndahesha. Kur u rritëm, të dy e kuptuam se nuk mund të ndaheshim më. U dashuruam dhe vendosëm të martohemi. Nëna ime nuk donte, por unë i thashë se në qoftë se do më ndalonin të martohesha me Kostandinën do ikja bashkë me të nga fshati dhe nuk do shkelja më kurrë këtu. Për gjashtë muaj babai nuk më foli, ndërsa unë prisja miratimin e tij për t'u martuar. Një ditë e nxora Kostandinën jashtë fshatit dhe e zhvirgjërova në pyll. Kur nëna e mori vesh, i tha babait dhe ky e lejoi martesën tonë. Ato vite babai pothuajse

nuk ishte në shtëpi sepse merrej me tregtinë e letrës. Vëllezërit e mi po ashtu kishin ikur, njëri në Voskopojë dhe tjetri pas babait. Unë mbeta me nënën, të cilën e doja shumë. Para se të vdiste e pyeta se pse nuk kishte dashur që unë të martohesha me Kostandinën dhe ajo më tregoi për dyshimet e saj për të cilat tani jam bindur edhe unë. Kostandina lindi me sy jeshilë, por të tillë nuk i kishte pasur as nëna e saj jetime dhe asnjëri prej dy djemve që ishin dashuruar me të. Sy jeshilë në fshat kishte vetëm gjyshi im dhe asnjë burrë tjetër. Kur fillova të interesohem, i shtyrë nga dyshimet e mia përvëluese, mësova se xhaxhai i Mihalit, megjithëse ishte martuar dy herë, nuk kishte pasur fëmijë. Vëllai i gjyshit të Ibrahimit, kishte qenë i shkurtër dhe e shkurtër kishte qenë edhe nëna e Kostandinës, ndërsa kjo u bë e gjatë dhe kockëmadhe. Duke e ndjekur nga pas këtë ngjarje, kuptova se pse im gjysh nuk kishte dashur t'ia jepte askujt për grua, nënën e Kostandinës. Ai, me sa duket, e kishte dashur jetimen. Kur ajo u mbars, duke mos pasur mundësi të dështonte fëmijën, sepse kështu do të merrej vesh, si dhe për të mbuluar gjurmët e mëkatit të vet, duhet të ketë qenë gjyshi im që hapi fjalët se njëri nga djemtë e vizitonte të dashurën natën. Nuk e di a është penduar në fund të jetës për këtë krim. Nëna e Kostandinës vdiq pas gjyshes sime dhe e mori të vërtetën me vete në varr. Babai nuk foli kurrë me njeri për këtë gjë. Ai nuk foli as me nënën time, por unë jam i sigurt se ai e ka kuptuar të vërtetën dhe prandaj hezitoi ta miratonte dasmën time. Ndoshta, po të më kishte thënë se Kostandina ishte halla ime unë nuk do dashurohesha me të, por për këtë nuk jam shumë i bindur. Edhe ime bijë, Hana, i ka sytë jeshilë si nëna e saj dhe si askush tjetër në fshat. Tani ajo është martuar me Vasilin, vëllanë e Ibrahimit dhe akoma nuk kanë fëmijë.

Gjergj Komneni pushoi. Fytyra tregonte pamjen e një njeriu të çliruar Aliu nuk e shikonte dot në sy, por duke lidhur ngjarjet mendonte se si në këtë fshat të vogël ishte përsëritur historia e botës. Dhe akoma nuk ka mbaruar, tha me vete dhe iu kujtua Arianiti që përpara disa orësh i kishte thënë, se disa fletë nga historia e tij ishin lagur dhe nuk mund të lexoheshin. E ka lexuar Gjergji, mendoi dhe duke iu drejtuar e pyeti se kush e dinte tjetër të vërtetën. Unë, Kostandina dhe im atë. Po pse ma tregove mua? Nuk erdha të të them këtë gjë, por kur më the se im atë të kishte treguar historinë e familjes e ndjeva se duhej ta plotësoja gënjeshtrenë e tij. Ti je kalimtar në këtë fshat dhe nuk ke kohë t'ia tregosh njeriu. Tani që më njeh siç jam mendoj se do të më ndihmosh të mos humb tokat që më takojnë. Përpara se të jenë të tuat ato janë tokat e babait tënd, tha Aliu. Duhet t'ia kërkosh atij jo mua. Gjergj Komneni u errësua, por nuk e dha veten. Pas atyre që kishte dëgjuar, Aliu e kuptoi se sa më shumë e shtynte drejt të atit, aq më i egër bëhej i biri. Nuk ishte hera e parë që e bënte këtë lojë me njerëz nevojtarë si Gjergj Komneni. Nuk kam ndër mend t'i flas tim ati derisa të vdes, tha Gjergji. Dhe në qoftë se unë nuk pajtohem me të, të gjitha pasuritë ai do t'ia lërë Sarës. Im atë është njeriu më dinak që mund të njohësh dhe duke e ditur se toka është gjithçka që kam, më mban të lidhur me këtë kërcënim. Atëherë bëj një djalë dhe martoje me Sarën, që të trashëgosh tokat, u tall Aliu.

Gjergj Komneni u çua në këmbë dhe mjekra e tij e shkurtër filloi të dridhej aq sa Aliut iu kujtua tërbimi i të atit një natë më parë. Unë nuk jam Arianit Komneni që marton djalin me motrën e vet. Jetojmë nën të njëjtin qiell dhe do jemi mbi të njëjtën tokë edhe për pak kohë. por mëkati i tij nuk ka Zot dhe Zoti im nuk i fal mëkatet e tij. Duke u dridhur në këmbë, Gjergj Komneni pështyu përtokë, por Aliu ia bëri me dorë si për t'i thënë se ishte një shaka dhe u përpoq ta qetësonte. Në qoftë se nuk pranon t'i trashëgosh tokat nga dora e babait tënd atëherë unë besoj se ke vetëm një rrugë, foli Aliu prerë dhe seriozisht. Po të dëgjoj, tha Gjergji dhe ia nguli sytë. Ndiq rrugën e Ibrahimit dhe bëhu mysliman, i tha duke menduar, se Gjergj Arianiti do të tërbohej më keq dhe do zhdukej duke sharë. Por Gjergji nuk lëvizti nga vendi dhe nuk i ndau sytë nga të tija sikur donte të lexonte fundin e fjalisë që kishte dëgjuar. Nëse bëhem mysliman a do

m'i japin turqit tokat e mia, e pyeti me qetësi. Pa dyshim. Turqve do t'u vinte mirë që një djalë i një dere të madhe të krishterë merr fenë e tyre, pa ia kërkuar kush. Unë do t'i bind se tokat e Komnenëve të takojnë ty dhe askujt tjetër. Do të më besojnë po t'u them se kur yt atë dhe vëllezërit e tu ikën nga fshati, ti i punove tokat e tyre për gjithë këto vjet dhe duke qenë se familja juaj ka drejtuar gjithmonë fshatin mund të të bëjnë bej.

Në qoftë se ti më jep fjalën se do më ndihmosh e pranoj. Në qoftë se nuk ka rrugë tjetër për t'u shkëputur nga im atë e pranoj dy herë. Në qoftë se Zoti im i ri nuk i fal mëkatet që fal Zoti i tim ati, e pranoj tri herë, tha Gjergj Komneni sikur po betohej dhe sytë që iu lagën, iu thanë prapë, në çast.

Aliu iu afrua, e puthi në dy faqet dhe doli jashtë. Thirri një nga trimat e tij, it ha diçka që Gjergji nuk e dëgjoi dhe hyri prapë brenda në shtëpi. Nisu tani, i tha. Imami do të të presë. Thuaj që të kam dërguar unë. Gjergj Komneni i dha dorën dhe u nis. Ftohtësia e asaj dore e përcëllloi Ali Tepelenën. Pasi i tregoi Ibrahimit bisedën me Gjergjin dhe Arianit Komnenin, Aliu u shtri të flinte herët dhe ëndrra e një nate më parë iu përsërit. Kur u zgjua, pa Gjergj Komnenin që bashkë me Ibrahimin ishin ulur në oborr duke ngrënë hurma. Gjergji dukej si një njeri tjetër. Ishte më i zbutur, por dora e tij ishte njëllor e ftohtë. Si ta vunë emrin, e pyeti Aliu. Ismail, tha ai, Ismail Abdullahu. Po pse pranove të bëhesh Abdulla, o budalla, e ngacmoi Ibrahim duke i treguar se si e kishte refuzuar të njëjtin mbiemër. Nuk ka nevojë ta ndërrosh mbiemrin, qeshi Aliu. Do quhesh Ismail Bej Komneni. Është më bukur.

Kur Arianit Komneni mësoi se i biri ishte bërë mysliman, mbylli derën e shtëpisë dhe thirri Sarën. Dy ditë ata nuk dolën nga shtëpia. Ditën e tretë, duke u mbështetur në një shkop me gunga, bashkë me Sarën, që mbante arkën e mbushur me libra, shkuan te shtëpia e Hanës. Pavarësisht nga marrëdhëniet mes babait dhe tij, Hana gjithmonë e kishte adhuruar gjyshin e saj. Hapi derën dhe Arianit Komneni iu duk si një profet që ishte nisur për të vdekur. Duhet të iki Hanë, tha ai. Zoti nuk ka dashur që Abrahami dhe Ismaili të rrinë në një fshat. Sara e di ku po shkoj dhe kupton se nuk mund të vijë me mua atje ku do shkoj. Sara do rrijë këtu me ty. Martoje me një njeri të mirë, por vetëm në qoftë se ajo e pranon. I puthi të dyja dhe u nis. Hana qau, ndërsa halla e saj, Sara, filloi të lexonte.

Atë ditë, një erë e kuqe shkretëtire e dogji fshatin. Njerëzit u mbyllën brenda dhe nuk e panë se nga iku Arianit Komneni. Pleqësia nuk u mblodh më dhe të gjitha vendimet që kishte marrë u harruan. Ibrahim e liroi Mihaln e Zoicës dhe ky, pasi hëngri, fjeti tri ditë. Ali Tepelena ishte nisur për në Janinë duke marrë Thanasin me vete.

11

Kur u bë mysliman, Ibrahim kishte katër djem. Thanasi që ishte më i madhi, ishte 15 vjet, ndërsa më i vogli ishte 15 muaj. E shoqja nuk pranoi të ndërronte fenë dhe as t'ia ndryshonte emrat të bijve apo t'i bënte ata synet. Kështu që djemtë vazhduan të thirreshin me emrat e pagëzimit Thanasi, Petro, Jani dhe Niko. Kur imami erdhi në fshat për bajramin e parë dhe dëgjoi emrat e djemve, e pyeti: Sa myslimanë ka kjo familje e krishterë Ibrahim? Megjithëse ai i tha se i kishte bërë një premtim të shoqes dhe nuk mund ta thyente, imami nuk u bind. Në bajramin e dytë, imami ia përsëriti pyetjen dhe Ibrahim i dha të njëjtën përgjigje. Por imami u nxe dhe për ta vënë në sedër i tha se kjo ishte hera e fundit që vinte në një shtëpi, të cilën e komandonte një grua dhe jo një burrë. Pas ramazanit të tij të dytë, gruaja mbeti shtatzënë. Mrekulli, i tha ai, do lindësh një mysliman. Ajo i kujtoi premtimin, por ai i tha se premtimi ishte dhënë për të gjithë

fëmijët që kishin lindur para se ai të bëhej mysliman, ndërsa për të palindurit, ai nuk ishte në fuqi. Pesë ditë e pesë net e shoqja as piu, as hëngri. Gratë q e vizitonin i thanë se ajo ishte dobësuar dhe kjo nuk i bënte mirë, madje mund t'i rrezikonte jetën.

Ditën e gjashtë ai dërgoi në qytet Vasilin që të thërriste priftin. Çfarë t'i them, it ha Vasili, ti e di që ai nuk të do. Thuaji se duhet të vijë patjetër për t'i shpëtuar jetën një gruaja të krishterë. Në qoftë se nuk vjen kjo do të vdesë, kështu thuaji.

Prifti erdhi të nesërmen dhe ai i tha: Imzot unë u bëra mysliman, por gruaja dhe katër djemtë e mi mbetën të krishterë. Tani ajo është rëndë prapë. Unë i thashë që fëmija që do të lindë do të jetë mysliman, si babai i vet. Por ajo nuk pranon dhe ka shtatë ditë që nuk fut gjë në gojë dhe unë nuk duroj dot që të vdesë bashkë me fëmijën tim në bark. Fol me të dhe i thuaj që unë i dua njëlloj fëmijët e mi qofshin të krishterë apo myslimanë. Por nuk mund të pranoj që të jemi i vetmi mysliman në një familje të krishterë. Fol me të dhe më ndihmo, u lut Ibrahimimi.

Prifti u ngrit dhe u fut në shtëpi. Nuk kaloi shumë dhe doli. Rasa e tij e zezë nuk shquhej fare natën. Ai e kuptoi që prifti po afrohej, vetëm kur një duhmë e rëndë prej njeriu që ka ngrënë me tepricë, ia bllokoi hundët. Ajo do vazhdojë të mos hajë dhe të mos pijë në qoftë se ti nuk bën një zotim të ri, tha prifti. Jam gati, tha Ibrahimimi. Do mbaj çdo premtim siç kam bërë deri më sot.

Prifti ngriti kokën dhe tha: Gruaja jote do vazhdojë të jetojë si e krishterë. Katër djemtë e tu po ashtu. Ata do të shkojnë në kishë, do ngjyjnë vezë pashke dhe do hanë mish derri. Askush nuk do t'i shtrëngojë ata të ndryshojnë fenë dhe nëse dikush tenton, ti do ta ndalosh. Ti duhet t'i duash njëlloj fëmijët që ke apo ata që do lindin. Pasuria jote do të ndahet në barazi mes djemve të krishterë dhe myslimanë. Gruaja jote do t'i respektojë pa u ankuar të gjitha detyrimet që Islami të ngarkon ty qofshin në ushqim, në udhëtim, në ramazan apo në shtrat. Por ajo nuk detyrohet të mbajë ferexhe apo të ndajë shtratin me gra të tjera. Fëmijët që do lindin pas këtij zotimi do të jenë myslimanë, si ai ati, nëse janë djem dhe të krishtera si e ëma nëse janë vajza.

Prifti uli kokën dhe shtoi: kaq kërkon që të mos vdesë. Atij i ishin mbushur sytë. Kurrë në jetën e vet nuk kishte përjetuar një solemnitë të tillë. Gjatë gjithë këtyre viteve, duke u marrë me kafshët dhe Islamin, nuk kishte kuptuar dot se e shoqja kishte fituar pjekurinë për t'ia disiplinuar jetën njëlloj si një institucion, si kadiu, si imami apo si Arianit Komneni në kohën kur ishte kryetar i pleqësisë. E shoqja kishte vendosur barazi mes dy feve nën një çati, gjë që profetët, bashkë me gjithë të urtët e të fortët e botës, nuk ia kishin arritur dot akoma. Ajo e dinte sa e vuante ai që asnjë nga djemtë nuk e kishte ndjekur në Islam. Edhe djemtë ndiheshin keq kur fshati i thërriste: Thanasi i Anës, apo Nikoja i Anës. E si mund t'i quanin ndryshe: Thanasi i Ibrahimit? Shpesh atij i dukej vetja si një deve që ushqehet me vezë pashke. Po mendonte për të gjitha këto, kur prifti e përmendi. Nuk më the a e pranon zotimin? E pse jo, tha ai qetësisht. Që sot nuk do jem myslimani i vetëm në familjen time.

Në majin e vitit 1771 lindi një djalë që ai e quajti Muhamed, me emrin e profetit të tij. Muhamedi lindi synet dhe gjithë fshati u shkul për të parë këtë çudi. Natyrisht që kështu do të ndodhte, thoshte Ibrahimimi duke mbajtur djalin e zhveshur në krahë. Muhamedi është myslimani i parë i vërtetë në këtë fshat dhe nuk mund të pranonte të bëhej synet nga një baba që ka lindur i krishterë. Dy vjet pas Muhamedit lindi një djalë tjetër që Ibrahimimi e quajti Ali, për nder të Ali Tepelenës, ndërsa katër pas tij, u lind Ademi, që megjithëse ishte djali i shtatë i Ibrahimit, mori emrin e njeriut të parë, Adamit, siç i kishte treguar imami.

Bashkë me fëmijët u shtuan dhe kafshët. Pas kafshëve edhe paratë. Ai e zgjeroi shtëpinë nga prapa dhe ndërtoi një dhomë të madhe gjumi për vete dhe gruan. Oborri e zhveshur e mbolli me mollë, ndërsa pranë dritares së dhomës së re mbolli një arrë. Kur ne të plakemi arra do jetë

fëmijë, kur ne të vdesim ajo do jetë bërë grua dhe do mbushet me kokrra, i tha Ibrahimimi së shoqes. Rrugën përpara shtëpisë e shtroi me gurë kalldrëmi të bardhë duke i varrosur një herë e mirë gropat që kishin lënë kryqet e djegur. I nxori të gjitha kafshët nga shtëpia dhe ndërtoi një stallë të madhe me kallama dhe qerpiç jashtë fshatit. Sëmundjet ngjitëse në kafshë u përhapën shumë ato vite, por vetëm Ibrahimimi dukej i kënaqur. Atij i vinin me dhjetëra kuaj, lopë, dhi e dele në javë për të kuruar dhe fshati dukej shumë më i madh, sa herë që tufat e kafshëve të shëruara parakalonin nëpër rrugët e tij, si ushtri. Asnjë ushtri tjetër, që kishte kaluar në fshat, nuk kishte qenë më paqësore.

12

Kur Ibrahimimi mbushi 50 vjeç në fshat ra kolera.

Në qershor, disa ushtarë turq që vinin nga larg për të shkuar në Janinë, ndaluan disa orë për t'u çlodhur. Ata u lanë dhe pinë ujë, duke futur gojët e etura në çezmat prej guri që kishte ngritur Arianit Komneni, në mes të fshatit. Njëri prej tyre e kishte sjellë sëmundjen nga shkretëtira dhe pa e ditur ia kaloi çezmës së Arianitit. Një djali të vogël, që lagu buzët atje, iu fry barku si kacek dhe etet e padurueshme ia shkatërruan sytë dhe veshët derisa vdiq. Tek e njëjta çezmë ishte freskuar edhe Vasili, i cili duke bërëtitur nga dhimbjet i kërkoi Hanës që ta mbështillte me batanije dhe ta digjte të gjallë, për të mbytur mikrobin. Por Hana nuk pranoi dhe Vasili doli në oborr dhe u ngul mbi një sfurk. Pas tij dha shpirt mbesa e vogël e Mihalit dhe e Zoicës, e cila nuk vuajti gjatë, por vdiq në gjumë e mbuluar me të vjellat e veta. Pas saj u shuan me radhë kuantat e vëllait të Mihalit dhe vetë Zoica.

Ashtu si Mihali përpara njëmbëdhjetë vjetësh, kolera kapërceu gardhin që ndante dy oborret dhe hyri në shtëpinë e Ibrahimimit. Ibrahimimi luftoi për shumë ditë duke përdorur gjithë dijen që kishte mësuar nga sëmundjet e kafshëve të tij dhe për pak kohë e zbuti kolerën. Por një natë, pabesisht, kolera u zgjua më e uritur se në fillim dhe, para se të linte shtëpinë e Ibrahimimit, mori me vete Ademin trevjeçar dhe Anën. Ibrahimimi bashkë me djemtë formuan një vig me drurë, e veshën gruan me rroba të bardha dhe i bënë një shëtitje nëpër fshatin e sëmurë, përpara se ta varrosnin në varrezat e të krishterëve. Pastaj morën Ademin e vogël, që nuk kishte nevojë për vig, dhe e varrosën në një vend tjetër jashtë fshatit, aty ku, që nga kohë e Arianitit, ishte caktuar varreza e myslimanëve. Ademi shkoi i pari në atë varrezë siç kishte ardhur i pari në jetë Adami, që i kishte dhënë emrin.

Pas tij vdiq Ismail Komneni që kur e kuptoi se nuk kishte shpëtim shkoi tek e bija Hana dhe pa i dhënë dorën nga frika e kolerës, tha se ia linte asaj gjithë tokat trashëgim. Hana e ndoqi nga pas të atin dhe pa sesi ai shkoi në pyll dhe aty ku ishte bashkuar me gruan e tij, duke u dridhur nga të ftohtët, hapi një gropë të cekët dhe u fut brenda. Hana nuk duroi dot dhe nxitoi ta mbulonte.

Për tre muaj fshati i ngjau një spitali lufte. Dyert e shtëpive rrinin hapur, rrugët mbetën të papastruara, të sëmurët dergjeshin nëpër oborre, varrezat ishin mbushur me gropa bosh që njerëzit i bënë gati për vete dhe të afërmit, çezmat e rrugëve u mbyllën, ndërsa uji i pakët nuk përdorej pa u zier në zjarr. Qentë, macet dhe minjtë e ngordhur shtriheshin të lirë në diell për të ushqyer mizat e pangopura.

Turqit e mbyllën fshatin në karantinë, si në një çark dhe askush nuk hyri dhe nuk doli edhe tre muaj pas kolerës. Kur filluan të mbarojnë ushqimet, të afërm dhe krushq të fshatrave fqinjë i linin ato në një vend të caktuar gjysmë ore larg në këmbë ku, pasi ata iknin, shkante i merrte Petro, djali i Ibrahimimit dhe Aleks, djali i Mihalit. Ushqimet ndaheshin me racion nga Mihali, që

duke qenë më i moshuari në fshat, mori rolin e kryetarit të pleqësisë pas vdekjes së Ismail Komnenit, ndërsa ilaçet jepeshin vetëm me urdhër të Ibrahimit që ishte bërë doktori i fshatit. Karantinën e çau vetëm Thanasi, i cili nuk ishte parë në fshat që kur kishte ikur me Ali Tepelenën. Ai bëri kryqin mbi varrin e së ëmës, por nuk shkoi te varrezat myslimane dhe tha që më mirë që nuk e kishte njohur Ademin, se do qante. Thanasi organizoi një grup djemsh me Petron, Aleksin dhe disa të tjerë dhe iu vu punës për të pastruar fshatin. Larguan kufomat e qenve dhe maceve nga rrugët, vunë regjim për përdorimin e çezmave dhe hapën disa gropa të mëdha në të cilat groposën me dhjetëra kokë bagëti të ngordhura. Thanasi e rregulloi vetë kabanën e kishës që dukej sikur ishte ndryshkur nga kolera dhe filloi ta tundte pas çdo vdekjeje. Ibrahim i rrinte te koka të sëmurëve duke u bërë lavazh me çaj mali dhe raki.

Pas dy muajsh, kolera ishte dobësuar, por nuk ishte zhdukur. Nuk kishte asnjë familje pa një apo dy të vdekur dhe ata që mbetën gjallë ishin aq sa burrat dhe gratë që themeluan fshatin dyqind vjet më parë, me në krye stërgjyshin e Arianit Komnenit. Ibrahim i tha Thanasit se nëse vazhdonte kështu, fshati do të shuhej ngadalë për disa muaj. Nuk e besoj, i tha i biri, ky është një mallkim i shkurtër, por po të ishte Arianiti gjallë do të na e thoshte si mbaron kjo histori.

Të nesërmen që pa gdhirë, Thanasi shkoi të takonte Sarën dhe i tha të kërkonte nëpër librat e të atit se çfarë shkruhej për kolerën. I kam parë, tha Sara dhe i tregoi me dhjetëra raste kolerash që kishin shfarosur myslimanë dhe të krishterë në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Mesdheut. Kolera është si era, tha Sara. Të kap në gjumë, e shton vrullin për të mbyllur nga frika në shtëpi, spastron çdo gjë që gjen në rrugë, pastaj futet tinëz nëpër oxhaqe, shuan zjarrin dhe ikën. Duhet të presim edhe pak, sa të ndizen oxhaqet, tha ajo. Edhe sa njerëz do vdesin, e pyeti Thanasi i zhgënjyer nga mënyra poetike me të cilën vajza përshkroi tekat e sëmundjes. Nuk e di, tha Sara, babai e mori me vete librin e vdekjeve.

Pas disa ditësh, qielli u nxi dhe një dëborë e zezë e mbuloi një pëllëmbë fshatin. Por ishte fundi i shtatorit dhe dëborë e parakohshme nuk mbajti gjatë. Kur rrugët u hapën, Ibrahim i kontrolloi një për një të gjitha shtëpitë që i kishin ndezur oxhaqet për t'u ngrohur, por askund nuk pa shenjë kolere. Të sëmurëve u ishin skuqur faqet e zbehta dhe barqet me lëngje u ishin shfryrë. U kthye në shtëpi i gëzuar dhe pranë arrës së vogël pa Thanasin dhe Sarën që bisedonin në këmbë. Më duket se shpëtuam, tha dhe u fut brenda.

Sara ishte rritur dhe gërsheti i zi i dukej më i vogël. Thanasi po i tregonte sesi kishte jetuar mbi kalë, për dhjetë vjet duke ndjekur Ali Tepelenën, i cili e kishte zgjeruar pushtetin e tij në të gjitha fshatrat rreth Janinës. Po ti ç'ke bërë gjithë këto vite, e pyeti ai. Kam lexuar, tha vajza, por kur erdhi kolera librat më mbaruan. Po çfarë pret atëherë? Pse nuk martohesh, i tha Thanasi duke i prekur gërshetin. Mund të martohesha me ty, por ti ke qejf burrat më shumë se gratë, u përgjigj Sara duke qeshur. Martohu me babanë tim. Ai është njeri i mirë dhe është akoma i ri, tha Thanasi pa u skuqur.

Kjo nuk mjafton. Ai është mysliman, tha Sara dhe u largua duke tërhequr gërshetin, në një syth të të cilit kishte ngecur një gjethe e vockël arre.

Thanasi e kishte dashur shumë të ëmën, por kur pa se familja e tij ishte shtuar me tre djem, nga të cilët dy ishin shumë të vegjël, mendoi se i ti do ta kishte të pamundur t'i rriste ata, pa ndihmën e një gruaje. Thanasi vendosi të mos largohej nga fshati pa i gjetur një grua Ibrahimit. Shkoi të bisedonte me të dhe i foli për Sarën. Me vajzën e Arianit Komnenit, pyeti Ibrahim i çuditur. Arianit Komneni ishte një burrë kokëfortë dhe i padurueshëm që nuk pyeste për njeri. Sa ishte gjallë, bëri çfarë deshë dhe i trajtoi më mirë kalldrëmet se njerëzit. Kishte dëshirë të ndërtonte



dhe ngriti çezma, hapi rrugë, thelloi kanale dhe ndërtoi kishën. Po të ishte grua, do kishte qenë një amvisë e shkëlqyer. Nuk e di si mund të jetë një Komnene femër. Ta mendoj, tha Ibrahim.

Thanasi e ndjeu se babai mund të pranonte dhe vendosi të takonte prapë Sarën. Për një muaj rresht vajza kundërshtoi. Thanasi u përpoq ta bindte përmes Hanës, të cilën e kishte pasur gruan e xhaxhait, por ajo i tha se Arianiti i kishte lënë porosi që vajza do martohej vetëm po t'i mbushej mendja. Thanasi nuk hoqi dorë dhe shkante përditë në shtëpinë e tyre.

Një ditë, Sara i tha se mund të pranonte të martohej me Ibrahimin, por vetëm me një kusht. Fol, i tha Thanasi duke e parë me dyshim. Pasi vdiq vëllai im Ismaili, që ishte babai i Hanës, nuk kanë mbetur më Komnenë meshkuj në fshat. Unë jam Komnenia e fundit, por, po të martohej, duhet të mbaj mbiemrin e burrit dhe Komnenët do zhduken. Do pranoj të martohej me babanë tënd vetëm në qoftë se ai pranon që fëmijët e mi të mbajnë mbiemrin tim. Nuk dua të jem Komnenia e fundit, tha Sara. Ky ishte një kusht që Thanasi nuk e kishte pritur. Nuk e di, tha ai i ngrysur, do flas me babanë. Vrapoi në shtëpi dhe ia tha babait. Mendova se do të ishte ndryshe, por nuk i paska lënë gjë të atit, tha Ibrahim. Megjithatë e pranoi. Unë kam gjashtë djem dhe mbiemri im nuk ka rrezik të shuhet.

Ibrahimi dhe Sara u martuan në fillim të nëntorit. Thanasi e tundi trembëdhjetë herë kabanën e kishës atë ditë. Nikoja dhe Muhamedi e mbajtën fustanin e bardhë të Sarës nga kisha deri në shtëpi. Kur pa çiftin e zbukuruar, Hana u përplot. Sara dhe Abrahami tani janë bashkë, tha me vete. Nusja dhe dhëndri fjetën në dhomën e madhe, mbi të cilën arra e re nuk bënte akoma hije.

Për krishtlindje, Sara i tha Ibrahimit se priste një fëmijë, që ajo e lindi në korrik të vitit 1781. ishte vajzë dhe Ibrahim kërkonte që ajo të quhej Ana, si nëna e djemve të tij. Sara pranoi. Sipas premtimit, Ana Komnena mori mbiemrin e nënës.

13

Djemtë e Ibrahimit nuk u mësuan dot shpejt me Sarën, e cila, kur erdhi, e ndryshoi gjithë shtëpinë. Ajo e leu dhomën e oxhakut me ngjyrë rozë dhe i kërkonte Ibrahimit që nga ana tjetër e shtëpisë, aty ku, deri përpara disa vitesh kishin qëndruar bagëtitë, të ndërtonin një dhomë të madhe për djemtë, në të cilën u vunë pesë krevate prej druri me jastëkë të mëdhenj dhe çarçafë të rinj që ajo i qëndisi me ngjyra të ndryshme kur ishte shtatzënë. Dhomën e saj, Sara e veshi me perde të thurura me grep dhe e shtroi me qilima të punuar me dorë, ndërsa nëpër mure vendosi rafte të vogla që i mbushi me libra. Nga shtëpia e Arianit Komnenit solli një krevat të madh prej hekuri me këmbë të vardha, në të cilin kishte fjetur Arianiti me Hënë. Po ashtu, ajo solli sëndukë, qëndisma të vjetra, kortinka të bardha leshi, një orë të vjetër muri, jorganë, velenxa, filxhanë, ibrikë prej bakri dhe shumë enë, të cilat Arianiti i kishte blerë gjatë udhëtimeve të tij.

Në fillim, djemtë u argëtuan me gjërat e rralla që vinin nga shtëpia e Arianit Komnenit, por, kur ajo e hodhi krevatin e nënës së tyre në oborr, ata u ftohën dhe iu duk se Sara nuk pranoi të flinte në krevatin ku ata kishin lindur.

Sara ndryshoi dhe regjimin e djemve. Ajo i detyronte të lanin këmbët përpara se të flinin dhe nuk i linte të hynin në shtëpi pa pastruar këpucët nga balta e fshatit, apo e arave ku vraponin. Djemtë, të mësuar të bridhnin gjithë ditën nëpër fshat, tani nuk mund të rrinin jashtë kur errej dhe kjo ishte më e rëndë, sidomos për Petron që ishte gati njëzet vjeç kur Ibrahim u martua. Petro iu afrua një ditë Ibrahimit dhe i tha se nuk i pëlqente që Sara e detyronte të vinte në shtëpi kur donte ajo dhe po ashtu nuk i pëlqente shtëpia e zbukuruar me perde dhe porcelane për shkak të të cilave nuk vrapoje dot si më parë. Një ditë, Sara kishte dënuar të mbyllej gjithë ditën në dhomë Muhamedi, që, duke lozur, kishte thyer një nga filxhanët e Stambollit. Por Ibrahim nuk mërzitej

dhe mendonte se disiplina e Sarës do t'u bënte mirë djemve të tij. Kur Petro u ankua, ai e pa duke qeshur dhe i tha se kur të rritej do ta kuptonte se çdo grua jeton për të rregulluar shtëpinë dhe sidomos krevatin që është themeli i familjes së saj. Kur të martohesh do ta kuptosh, tha Ibrahim. Këto janë huqe qyteti, ia ktheu Petro i mërzhitur që i ati nuk e mbështeti. Ne jetojmë në fshat dhe jo në Janinë.

Sara ndryshoi dhe mënyrën e gatimit. Në familjen e Ibrahimit ushqimi shërbehej në një magje të rrumbullakët e të nxirë vende-vende nga enët e djegura, e cila shtrohej përtokë dhe djemtë bashkë me babanë hanin aty me radhë. Ajo i tha Ibrahimit të gjente një tavolinë druri për dhjetë veta. Por dhoma ishte e vogël dhe kur e kuptoi se nuk do ta nxinte një tavolinë aq të madhe Sara porositi një më të vogël për gjashtë veta. Ibrahim nuk kishte parë ndonjëherë tavolinë dhe Sara e çoi në shtëpinë e Arianitit ku i tregoi një të tillë të zezë, me këmbë të gdhendura, mbi të cilin rrinte një vazo jeshile me lule të thara. Kështu e dua, i tha Sara, duke marrë lulet e thara që i hodhi jashtë, pasi e lau vazon dhe e mbushi me ujë të pastër për ta kthyer prapë aty ku e gjeti. Ibrahim u ul në një karrige dhe ndenji një copë herë me duart nën tavolinë, duke mos ditur ku duhet t'i vinte. Por Sara hapi një sënduk dhe mori një pjatë me lules si dhe një lugë të bardhë alumini që ia vuri përpara dhe duke qeshur i tha: Ha tani. Ibrahim mori lugën e afroi te pjata, por dorën tjetër e mbante gjithnjë poshtë tavolinës. Se si më duket, i tha i hutuar. Sikur jam në kishë. Aty nuk halet, buzëqeshi Sara. Era e temjanit ta pret oreksin.

Të nesërmen, Ibrahim mori një sëpatë dhe bashkë me Petron dhe Janin shkuan në pyll për të bërë dru për tavolinën e re. Zgjodhi një panjë të kuqe, jo shumë të madhe dhe e preu në mes. Panja ishte e bardhë nga brenda dhe përshkohej nga fillimi në fund nga vija të kuqe që dukeshin si enë gjaku. Në qendër të trupit kishte një sy të rrumbullakët, por sy më të vegjël kishte gjithandej. Sikur ndava një njeri në mes, mendoi Ibrahim kur e preu pemën vertikalisht, ndërsa djemtë e ngarkuan dhe e sollën në shtëpi. Në fillim, ai bëri katër këmbët e tavolinës që, pasi i sharroi në mënyrë të barabartë, djemtë i fërkuan me gur duke i rrumbullakosur. Fërkojini derisa të lëmohen si këmbë njeriu, i thoshte i ati. Ndërsa ashklat e panjës fluturonin si re pluhuri mbi kokat e tyre. Por disa prej ashklave ishin të gjata dhe të ashpra dhe ia gjakosën djemve duart e pastërvitura. Petro, që e bënte këtë punë pa qejf, i tha një ditë të vëllait se tavolina ishte shumë e vogël dhe nuk do ta nxinte të gjithë familjen. Ndoshta, dikush nga ne nuk do jetë kur ajo të mbarojë, tha Jani.

Ibrahim, në krahun tjetër të oborrit, punonte për të bërë syprinën. Ai e preu panjën në gjashtë pjesë të njëjta, nga një pëllëmbë të gjerë secilën, dhe i vuri në tokë ngjitur e ngjitur, për t'i parë. Thirri dhe Sarën, e cila kur i pa ashtu tha se tavolina nuk mund të përbëhej nga gjashtë copa, të cilat do fillonin të lëviznin pas pak kohësh dhe nuk ishin të rehatshme gjatë ngrënies. Ti më the se duhej një tryezë për gjashtë veta dhe unë e ndava në gjashtë pjesë, tha ai i nxehur dhe hodhi sharrën përtokë. Po, iu përgjigj Sara, por ti ke bërë gjashtë stola dhe jo një tryezë për gjashtë njerëz.

Ibrahim shkoi për herë të dytë në pyll dhe ia filloi nga e para. Por Sara e ktheu prapë kur pa se njëra nga këmbët kishte dalë më e shkurtër se tre të tjerat.

Ibrahim shkoi për herë të tretë në pyll dhe zgjodhi një panjë më të madhe dhe më të vjetër se dy të parat. Panja ishte shumë e rëndë dhe meqë nuk mund ta transportonin dot Ibrahim vendosi të punonte në pyll. Për tre javë, bashkë me djemtë shkonin në pyll në mëngjes dhe ktheheshin në mbrëmje. Një ditë ra shi dhe Ibrahim mori çarçaf nga shtëpia dhe i mbuloi drunjtë e prerë me sy të kuq. Kur filluan të ngulnin gozhdët e para, për të bashkuar këmbët me syprinën, pylli ushtoi

dhe zogjtë u trembën. Kur nguli gozhdën e fundit, Ibrahimimi e pa drejt në sy tavolinën e kuqe dhe tha: Do Zoti të jesh gjithmonë e ngopur.

Tre burrat e ngritën tavolinën dhe kur kaluan nëpër fshat, gratë dhe fëmijët dolën duke i hedhur sheqer dhe oriz, siç ia hidhnin nuseve për bereqet. Sheqeri dhe orizi u ra të treve mbi kokë dhe mbi supe dhe e mbushi tavolinën plot. Paskeni sjellë sytë, tha Sara dhe hapi derën e shtëpisë që të fusnin tavolinën brenda, por, pasi e provuan, kuptuan se tavolina ishte e madhe dhe dera nuk e nxinte. E rrotulluan nga të gjitha anët, por nuk hynte. Atëherë Ibrahimimi mori një çekiç dhe e prishi qerpiçin anës derës. Kashta e tharë në baltë ra bashkë me derën. Me këtë rast do bëjmë një derë të re, tha Ibrahimimi dhe vazhdoi punën. Pasi e futën tryezën në dhomë dhe e vendosën aty ku e caktoi Sara, kjo i vuri një qëndismë përsipër dhe i tha Ibrahimimit që ishte mbuluar me djersë: Tani duhet të bëni edhe gjashtë karrige.

Ndërsa Ibrahimimi dhe djemtë punonin në pyll për tavolinën dhe pastaj për derën e re dhe karriget, Sara merrej me oborrin. Në fillim i përzuri pulat nga shtëpia dhe e pastroi oborrin nga ndotjet dhe puplat e tyre. Pastaj shkuli gjithë barërat, hithrat, lulet e deles, mëllagat e egra, spërëngat dhe jonxhën që kishin mbirë në liri të plotë. Më pas, hoqi katër rreshta me plloça që i kishte shtruar Ibrahimimi vite më parë dhe dheun e lagësht që doli poshtë tyre e mbolli me majdanoz, me dafina, me borzilok, me xhenxhefil dhe me sherbelë. Ndërsa në një pjesë tjetër të veçuar, ajo mbolli domate, kastravecë, patate, patëllxhanë dhe qepë të gjata. Kur Ibrahimimi erdhi në mbrëmje nga pylli dhe e gjeti akoma në oborr me duart me baltë e pyeti se çfarë po bënte. Po shtroj tavolinën, i tha Sara dhe vazhdoi punën.

14

Të nesërmen ishte duke mbjellë kur dëgjoji një zë të fortë që thërriste: Ana, Ana. U ngrit dhe pa në rrugë një burrë të shkurtër të shëndoshë, me mjekër të kuqe dhe të veshur si malësor. Në kokë kishte një qeleshe të gjatë me majë, dhe nën jelekun e qëndisur pa mëngë, dalloheshin dy pisqolla të bardha. Fustanella e gjatë nuk ia fshihte dot këmbët e trasha gjithë nyje. Ana po fle, i tha Sara duke mbajtur një rrënjë patëllxhani në dorë. Mos është gjë sëmurë, e pyeti burri. Jo, i tha Sara, nuk është zgjuar akoma. Ishte mesditë dhe burrit i lëvizi fustanella, sikur po kërcente nga habia. Po ti kush je, i tha. Jam gruaja e Ibrahimimit, u përgjigj Sara. Mos kam ngatërruar gjë shtëpi, pyeti burri dhe ktheu kokën nga rruga si një njeri që ka humbur adresën. Po zotrote kush je, pyeti Sara. Jam Llambro Xhavella, daja i Anës, tha burri duke u drejtuar. Nuk je ngatërruar, i tha Sara dhe e ftoi të hynte në shtëpinë pa derë. Burri u ul dhe Sara i tha: Ngushëllime, të rroni vetë. Ana ka dy vjet që ka vdekur.

Llambro Xhavella mori frymë thellë dhe mustaqet e kuqe i lëvizën, por nuk foli. Hoqi qeleshen dhe dy pisqollat dhe i la mbi tavolinën e re. Sa i ngjan Halil Patronës, mendoi Sara kur pa kokën e tij të rruar, pas së cilës zgjatej një gërshet i kuq që kishte filluar të thinjej. I dha një gotë ujë dhe i tregoi për kolerën, për humbjet e fshatit, për urinë dhe etjen e atyre ditëve, për vdekjen e Vasilit, të fëmijëve, të bagëtive dhe për Anën dhe djalin e saj të vogël, Ademin që vdiqën njëri pas tjetrit. Pastaj i tregoi sesi pas vdekjes së Anës ajo ishte martuar me Ibrahimimin, por Llambro Xhavella, që rrinte mbështetur pas murit, e ndërpreu dhe i tha se nuk e kishte martuar mbesën me ndonjë Ibrahim. Kur Sara i tregoi se si Ibrahimimi ishte bërë mysliman qysh se Ana ishte gjallë, Llambro tha se jo vetëm mbesa, por dhe i shoqi paskan vdekur. Ku janë djemtë, t'i ngushëlloj për humbjen e prindërve, tha dhe kërkoi me sy nëpër shtëpi. Janë me të atin në pyll, po bëjnë derën e shtëpisë, tha Sara. Një copë herë mbetën të dy në heshtje pa ditur ç'të thoshin. Sara kishte dëgjuar pak për Llambro Xhavellën. Ibrahimimi nuk fliste për të, por Petro i kujtonte me mall ditët

kur e ëma e çonte në Sul, te daja i vet. Që atje lart dukej deti, thoshte Petro, që i mburrej vëllezërve më të vegjël, të cilët nuk e kishin parë kurrë detin.

Njëherë, Llambro kishte marrë Petron dhe Foton, djalin e tij të madh, dhe i kishte çuar në det. Vetë rrinte në breg dhe lante me sfungjer kalin e tij, ndërsa djemve u tha t'i hiqnin rrobat dhe të futeshin në ujë. Nuk dimë not, i kishte thënë i biri, do mbytemi. Futuni, i kishte urdhëruar Llambro Xhavella, suljoti mbytet vetëm me thikë. Duke ecur në majë të gishtave për të shmangur gurët e bregut, dy djemtë ishin hedhur në ujë. Pas disa metrave, aty ku jeshilja bëhej blu, kishin zgjatur këmbët, por në atë thellësi nuk kishte më tokë për t'u mbështetur. Djemtë filluan të bërtisnin dhe të mbaheshin te njëri-tjetri, por kjo i tmerroi edhe më shumë sepse sa herë që njëri rëndonte, tjetri zhytej. Llambro i shihte nga bregu dhe duke qeshur mjekra e kuqe i lëvizte si sfungjer. Pasi i la dhe pak ashtu, të kapur si leshterikë pas flokëve të njëri-tjetrit, Llambro Xhavella i ra kalit fort në ije dhe ky u nis në drejtim të djemve. Kali notonte sikur vraponte dhe u afrua shumë shpejt te djemtë. Ata e kapën fort nga bishti, e pastaj i hipën sikur po e kalëronin. Kur dolën në breg, kali i Llambro Xhavellës u ul dhe dy djemtë zbritën si nga një shkallë anijeje. Kur u qetësuan, Petro e pyeti Llambro Xhavellën: Po ti dajë, a di not? Llambro ktheu kurrizin dhe, duke e fshirë kalin me sfungjer, tha: Unë nuk jam kalë, o biri i Anës.

Po ty si të quajnë, e pyeti pas pak Llambro Xhavella, Sarën. Më quajnë Sara, tha ajo. E kujt je ti Sara? Jam e Arianit Komnenit, tha ajo dhe vuri dorën te gërsheti i zi, siç kishte bërë edhe në vitin 1769 kur kishte takuar Ali Tepelenën, i cili i kishte bërë të njëjtën pyetje.

Llambro Xhavellës i shkëlqyen sytë. E kam njohur Arianitin, tha ai dhe u zgjat për të folur. Kur Martuam Anën, mua më dërgoi babai në këtë fshat për të biseduar me familjen e Ibrahimit. Pasi ramë dakord për datën dhe ceremoninë, unë doja të njoftohej pleqësia për të marrë masa, sepse ne do vinim me shumë krushq nga Suli. Suljotët shkojnë nëpër dasma të armatosur dhe unë kërkova të bisedoj me kryetarin e fshatit për ta lajmëruar dhe për t'i thënë që të mos shqetësohej kur të shikonte një ushtri me krushq të mbathur si për luftë. Pyeta dhe më çuan tek yt atë.

Në vitin 1752 unë isha një djalë 28 vjeç, ndërsa ai një burrë i madh me flokë të bardhë, të cilët atë ditë i kishte mbledhur pas koke dhe mua m'u duk si një prift që drejton një kryengritje. Edhe kur e kam takuar herën e dytë, Arianit Komneni më është dukur sikur bëhej gati për kryengritje, sepse sytë e tij të mëdhenj, shihnin sipër kokës sime dhe fjalët e tij dukeshin si urdhra. Atë ditë, Arianiti ishte në mes të fshatit dhe po i jepte dorën e fundit ndërtimit të kishës. Duart i kishte me pluhur dhe nuk më takoi. I thashë se vija nga Suli për të martuar mbesën time gjashtëmbëdhjetëvjeçare. E di, më tha, keni zgjedhur një fshat të ngrohtë për t'u martuar. Kur i thashë se për dasmë do vinin shumë krushq nga Suli dhe ata do ishin të armatosur, më pa nga koka te këmbët dhe duke qeshur më tha: Në qoftë se i lini armët këtu kur të ikni, ejani sa të doni. Unë doja ta kundërshtoja, por Arianiti më tha se kishte bërë shaka dhe se fshati kishte armë, por, duke qenë i vogël, nuk kishte shumë burra. Uroj që mbesa jote të jetë e shëndetshme dhe t'i shtojë djemtë e këtij fshati, më tha duke më parë me bisht të syrit si çdo njeri që flet për punë grash. Unë e pyeta se kur mbaronte kisha dhe kur më tha se donte dhe nja dy muaj i thashë, si me të lutur, se a mund të shpejtohej pak puna në mënyrë që mbesa ime të martohej në kishë. Nëse ti i sjell krushqit nesër që të punojnë me mua, kisha mbaron për dhjetë ditë, tha Arianiti. Ishte fundi i qershorit dhe ne kishim rënë dakord që dasma të mbahej të dielën e parë të shtatorit. Po nëse e shtyjmë dasmën një muaj, a mund ta mbarosh kishën, e pyeta unë. Besoj se po, tha Arianiti duke parë qiellin e pastër. Të dielën e parë të tetorit kambanorja është gati.

Unë bisedova me familjen e dhëndrit dhe dasma e Anës u shty në tetor. Kur u ndamë Arianiti më pyeti se nga cila familje e Sulit isha. Kur i thashë se isha nga Xhevallat, ai më mori në qafë dhe më puthi. Rron gjyshi, më pyeti. Jo, i thashë, na la, ka pesë vjet. I çuditur, unë e pyeta se a e

kishte njohur gjyshin, por Arianit Komneni më tha që babai i tij e kishte pasur mik dhe më tregoi një histori nga e cila unë dija shumë pak.

Babai i Arianitit, gjyshi yt, vuante sa herë që dëgjonte se turqit pushtonin fshatra dhe shqiptarët ktheheshin në myslimanë. Ai besonte se nëse të gjithë të krishterët grekë, shqiptarë, sllavë, bullgarë dhe të tjerë bashkoheshin, turqit do të thyheshin dhe do zbrapseshin duke e lënë Ballkanin të krishterë. Kur filloi lufta e Kretës, gjyshi yt mendoi se ky ishte rasti për t'i mundur turqit. Rrethimi i Kretës zgjati 25 vjet dhe një herë fitonin turqit e një herë grekët. Nga vitet e fundit, lajmet që vinin nga Kreta thoshin se grekëve po u mbaronin burrat dhe fuqitë e tyre po shteronin. Babai i Arianitit vendosi t'i shkojë në ndihmë të krishterëve atje dhe mblodhi disa djem nga fshati me në krye djalin e tij. Meqë fshati juaj nuk ishte shumë i madh dhe nuk kishte shumë burra, siç thoshte Arianit Komneni, yt gjysh vendosi të thërriste djem edhe nga fshatra të tjerë. Ai shkoi vetë gjithandej, por shumë pak iu përgjigjën sepse fshatrat e fushës kishin shumë frikë nga turqit në atë kohë. Një ditë, ai erdhi në Sul dhe takoi gjyshin tim që sa ishte bërë kryetar i pleqësisë. Gjyshi im i tha gjyshit tënd se fitorja e Kretës duhej të ishte një fitore e krishterimit dhe se Suli, i cili për qindra vjet i kishte luftuar turqit, nuk mund të mos merrte pjesë në këtë betejë. Gjyshi ishte rreth tridhjetë vjeç në atë kohë, por, meqë ishte i martuar dhe ishte zgjedhur kryetar i fshatit, vëllezërit e tij nuk e lanë. Gjyshi kishte dy vëllezër më të vegjël beqarë, të cilët ishin binjakë. Ata i kërkuan që ai të rrinte në fshat, ndërsa ata do shkonin në luftë në emër të Sulit. Bashkë me ta kërkoi të shkonte edhe gjyshi i Ibrahimit, i cili ishte vëlla me njërin nga binjakët dhe nuk donte ta linte atë vetëm. Babai i Arianitit u nis nga Suli një ditë të akullt nëntori të vitit 1667, bashkë me tre djemtë, që gjithë fshati doli t'i përcjellë. Gratë qanin, por acari ua ngriu lotët. Dimri i atij viti bëri shumë i ashpër dhe rrugët u bllokuan gjithandej. Deri në mars, djemtë nuk u nisën dot në Kretë. Ata katër muaj gjyshi yt i mbajti tre djemtë në shtëpinë e tij. Dy binjakët ishin të urtë dhe të heshtur, por gjyshi i Ibrahimit ishte një djalë i hedhur dhe i gojës. Shumë shpejt ai e njohu fshatin dhe ra në dashuri me një vajzë, e cila, duke qenë komshie me familjen e Arianitit, hynte dhe dilte në shtëpinë ku ai rrinte. Djali dhe vajza u dashuruan dhe gjyshi i Ibrahimit i premtoi vajzës se do martoheshin sapo ai të kthehej nga Kreta. Edhe familja e vajzës u bind dhe për disa javë e mbajtën djalin në shtëpinë e tyre, si dhëndër. U nisën në fillim të prillit, por asnjëri nuk u kthye. Vajza kishte mbetur me barrë dhe pas disa muajsh lindi babanë e Ibrahimit. Familja e tyre në Sul e mori vesh disa muaj më vonë që djali ishte vlarë dhe kishte lënë një djalë në fshatin tuaj. Kur mori vesh lajmin, nëna e gjyshit të Ibrahimit erdhi duke ulëritur në shtëpinë tonë dhe e akuzoi gjyshin tim si fajtor për humbjen e të birit. Dy familjet tona u ftohën për disa kohë. Gjyshi ishte kryetar i pleqësisë dhe fshati mori anën e tij. Atëherë stërgjyshi i Ibrahimit mori gruan dhe një vajzë më të vogël dhe erdhi në fshatin tuaj ku ai kishte nipin e sapolindur. Mori gruan e pamartuar të të birit të vlarë, bashkë me nipin që ishte babai i Ibrahimit. Në këtë fshat ai ndërtoi një shtëpi në të cilën shumë vonë atij i lindi një djalë tjetër që edhe ai u vra, siç më kanë thënë. Shtëpia e tyre është kjo dhe këtu ka lindur edhe Ibrahim, ta Llambro Xhavella dhe pasi i hodhi një sy mureve rozë, vazhdoi:

Babai jetim i Ibrahimit u martua shumë vonë, këtu në fshat, por para se të vdiste e ëma i tha se ajo donte që në qoftë se atij do t'i lindnin djem, ata t'i martonte me vajza nga Suli, sepse kështu raca do të vazhdonte. Babai i Ibrahimit ia mbajti amanetin të ëmës dhe një ditë erdhi në Sul dhe kërkoi nuse te babai im. Im atë donte që prishja mes dy familjeve të mbyllej dhe prandaj duke i dhënë dorën e mbesës së vet, Anës, që është vajza e vogël e vëllait tim. Në dasmën e Anës, ne erdhëm me njëqind krushq të veshur bukur, me fustanella dhe jelekë të zinj. Kisha kishte përfunduar. Në krye të dasmës qëndronte babai i Ibrahimit, babai im dhe babai yt. Pasi morën bekimin në kishën e re, që mbante era dru të njomë, Arianit Komneni e nxori Anën dhe

Ibrahimin jashtë, ndërsa ne të tjerëve na tha të mos lëviznim. Ne u hutuam sepse nuk po e kuptonim, por kur pamë Arianitin që ndezi një qiri dhe u ngjit mbi altar nuk folëm. Ju kërkoj të gjithëve të ndizni një qiri dhe të luteni për shpirtrat e djemve që luftuan dhe vdiqën në Kretë, tha ai me një zë të fortë që akoma më bën të dridhem. Ai nuk ishte prift dhe ne nuk ishim kryengritës, por me një fjalë të tij, jam i sigurt se të gjithë do e linim dasmën dhe do niseshim për në Kretë. Por Arianiti nuk dha asnjë urdhër. Ai e ngriti qiriun e tij lart dhe ne të gjithë thamë një lutje pas tij dhe i mbajtëm qirinjtë për një kohë të gjatë mbi kokat tona. Kisha e re rënkoj si njeri. amin, tha Arianit Komneni. Amin, thamë të gjithë pas tij. Tani vazhdojmë dasmën, tha ai dhe filloi të qeshte me babanë tim. Atë natë, gjithë fshati mori pjesë në dasmën e Ibrahimit dhe të Anës. Suljotët qëllonin me pistoleta dhe kërcenin me opingat e tyre të bukura, duke i ngritur xhufkat mbi qeleshet e shokëve. Kur e pyeta Arianit Komnenin për përsheptjen e shkurtër në kishë, ai më tha se që në fillim kishte menduar ta përuronte Kishën e re, me një meshë për të rënë e Kretës. Ata janë dëshmorët e parë të fshatit dhe kjo dasmë nuk do ishte ngjizur pa trimërinë e tyre. Por ti m'i ngatërrove gjërat, tha Arianiti duke pirë raki. Vure dasmën para meshës dhe mirë bëre, se unë kisha vënë dhjetorin para gushtit. Tani jam më i qetë, më tha, gushti mbaroi dhe unë po pres dhjetorin. M'u duk sikur më tha se po bëhej gati të shkonte në Kretë, si një prift që bekon heronjtë pas vdekjes, përfundoi Llambro Xhavella, duke parë nga Sara.

Babai shkoi në Kretë dy vjet më vonë dhe atje lindi unë, tha Sara dhe i tregoi për Shebën dhe për udhëtimin me Arianitin, i cili i tha se do shkonin në pyll të kërkonin nënën, për ishujt që shihnin nga anija, për Selanikun dhe mbërritjen në fshat. Llambro Xhavella dukej i mallëngjyer, por ai burrë nuk dinte të qante dhe emocionet i dilnin si djersë mbi mustaqet e kuqe. Kur Sara mbaroi, ai i fshiu mustaqet dhe e pyeti: Kur vdiq babai? Ndoshta nuk ka vdekur, akoma, tha Sara duke ulur sytë. Ai iku nga fshati ditën që vëllai im, Gjergji, u bë mysliman. Llambro Xhavella u zgjat nga Sara sikur donte ta pyeste se ku kishte ikur Arianiti, por ajo nuk e la të vazhdonte, e kapi nga dora dhe i tha: Eja të shohësh Anën, duhet të jetë zgjuar.

Kur Ibrahimimi me djemtë erdhën në shtëpi, Sara dhe Llambro Xhavella po loznin me Ana Komnenën. Llambro i vuri vajzës dorën te koka dhe i preku flokët e dendur dhe të zinj. M'i jep një palë balluke t'i çoj në fshat te njerëzit e mi, i tha Sarës, e cila mori një gërshërë, i preu vajzës disa flokë mbi ballë dhe ia dha Llambros. Ky, pasi i mori erë, e futi cullufen në një xhep të jelekut. Ana filloi të qante kur pa që i morën diçka nga koka, ndërsa Llambro doli jashtë si fajtor dhe u ul përballë tavolinës, në kohën që hyri Ibrahimimi.

Mirë se erdhe, iu drejtua Ibrahimimi i habitur kur e pa, ndërsa Petro dhe Jani iu hodhën në qafë. Djemtë e tjerë nuk e kishin parë kurrë Llambro Xhavellën dhe filluan të hapin sytë nga pisqollat që rrinin si të papuna mbi tavolinë.

Unë kam ardhur për gëzim, por mora vesh se i zoti dhe e zonja e kësaj shtëpie paskan vdekur, tha Llambro Xhavella. Ngushëllime. Unë jam Llambro Xhavella, daja i Anës, zonjës së shtëpisë. Ju kush jeni, iu drejtua ai Ibrahimit duke ngritur mjekrën e kuqe si një sqep kërcënues. Llambro Xhavella ishte i ftohtë, sikur kishte takuar një njeri të panjohur në majë të malit. Ibrahimimi u step dhe pa Sarën në sy si të kërkonte ndihmë. Djemtë rrinin në këmbë të shushatur dhe nuk kuptonin në ishte koha e përshtatshme për ta pyetur Llambro, për Sulin, për Foton, për kushërinjtë, për kuajt dhe për detin. Është babai, dajë Llambro, foli Petro me zë të ulët, siç i flitet një njeriu që do ta zgjosh nga gjumi pa e trembur. Derisa në këtë shtëpi shpjegimet i jep i biri, do të thotë që unë kam të drejtë të besoj se babai ka vdekur, përsëriti Llambro Xhavella duke lëvizur pak mjekrën

në drejtim të Petros, si dikush që noton dhe herë pa shere kthen pak kokën për të parë shokun që e ndjek.

Jam unë, foli Ibrahimimi. Nuk mund të mos më njohësh. Ti ke qenë krushk i parë në dasmën time dhe të Anës. Unë doja të martohesha në shtator, por ti e shtyve dasmën në tetor dhe më the se Ana nuk i kishte mbushur akoma 16 vjeç. Nuk mbaj mend t'ju kem takuar në atë dasmë, por mund të më thuash si quhesh, se mbase kujtohem. Unë jam Ibrahimimi, tha Ibrahimimi. Të thashë që nuk njihemi, tha Llambro Xhavella duke parë si fitimtar nga Sara. Në dasmën e mbesës sime nuk u ftua asnjë mysliman. Vajza e mikut tim, Arianit Komnenit më tregoi me shumë dhimbje se si vdiq mbesa ime e shtrenjtë. Por në qoftë se ti Ibrahim do të më tregosh se si vdiq burri i krishterë i Anës unë jam gati të të dëgjoj. Jam bërë mysliman dhe kam ndërruar emrin. Ana e pranoi kur i thashë se nuk do merrja gra të tjera siç thotë Islami, tha Ibrahimimi.

Unë e martova mbesën me një të krishterë dhe djemtë e saj lindën të krishterë, u kthye me një zë të fortë Llambro dhe duke parë nga Petro e pyeti: Ku është Thanasi? Petro pa nga Ibrahimimi de ky e miratoi me kokë, si për t'i dhënë leje. Thanasi ka ikur me Ali Tepelenën në Janinë, tha Petro. Llambro Xhavellës iu fry mjekra dhe koka e tij e rruar u skuq si një domate e plasarit. U ngrit në këmbë, mori pisqollat, i futi në brez dhe tha: Po ta kishte babanë gjallë, ai djalë nuk do shkonte pas një kusari mysliman që vjedh bagëti dhe përdhunon gra të krishtera. Ti paske dëbuar një jetim nga shtëpia dhe ky është mëkat, iu drejtua Ibrahimimi me zë të çjerrë dhe pastaj duke parë nga Petro tha me ton urdhërues: Vishu ti djalë, do vish me mua që mos përfundosh dylber i ndonjë kusari tjetër. Petro nuk lëvizi nga vendi, por pa nga i ati, i cili dukej i humbur. Nisemi, tha Llambro Xhavella, por u kthye dhe iu drejtua Sarës që rrinte si e ngrirë: Babai yt ka qenë njeri i besës. Të lutem t'i mbash këta jetimë si të ishin djemtë e tu. Ndoshta, vij vitin tjetër dhe i marr edhe këta. Llambro Xhavella doli dhe pas tij edhe Petro, të cilit i foli vetëm Muhamedi. Kujdes kur të notosh Petro, se kali i dajë Llambros m'u duk i plakur. Petro kapërceu pragun pa derë, ndërsa Ibrahimimi, i cili gjithë kohën kishte qëndruar në këmbë, u afrua te tavolina dhe mbështeti duart. Mbi syprinën e saj të shkëlqyer vetja iu duk si një njeri tjetër.

Karriget dhe dera e re u bënë pas disa javësh. Ibrahimimi dhe Jani punonin me ngadalë, pasi Petro iku me Llambro Xhavellën. Ibrahimimi sharronte në pjesë të vogla drurët e panjës, ndërsa Jani i fërkonte me shtuf. Niko, Muhamedi dhe Aliu luanin në pyll dhe numëronin këmbët e karrigeve. Derën Ibrahimimi e bëri me dru të fortë lisi. E mban lagështirën, i tha të birin. Shpatullat iu mavijosën të dyve duke sharruar lisin e gjatë me lëkurë të ashpër, që nuk donte të binte dhe prandaj ata thirrën disa burra nga fshati, për ta rrëzuar. Jani i qëroi si peshk luspat e mëdha të lisit dhe ndezi zjarr për të tharë njomësinë që avullonte si frymë njeriu.

Kur karriget rrethuan tavolinën e re dhe Ibrahimimi mbylli derën e shtëpisë, Sara i tha djemve të laheshin dhe filloi të bënte darkën. Preu marule dhe i mbushi me gjizë, poqi patëllxhanë që pastaj i futi në vaj ulliri, ndau në mes gjashtë patate të mëdha dhe i mbushi me mish, zieu oriz që e zbukuroi me pluhur kanelle dhe përgatiti një tavë balte me mëlçi dhe zorrë të grira që kur e pyeti Ibrahimimi ajo i tha se quhej koranik. Sara rrahu kos dhe kur ky u bë si krem ajo i hodhi sipër mjaltë, pastaj preu në feta të vogla gjithë lëng disa hurma, mollë dhe dardha dhe i leu me sheqer e i poqi dhe ato. Nga sëndukët e Arianitit, Sara nxori një takëm me lugë të dredhura dhe thika të gjata, të cilat Ibrahimimi i mprehu duke i fërkuar me ujë dhe me gur, sepse vitet ua kishin thinjur tehun. Ajo pastroi një shandan të pluhurosur me shtatë krahë që Arianitit ia kishte dhënë Sheba dhe në secilën prej kupave të vogla nguli një qiri. Shtëpia nuk kishte qenë kurrë më e ndriçuar. Sara nuk e vuri Anën në gjumë dhe e mori djepin e saj në dhomën e bukës. Ana nuk ia ndante sytë flakës së qirinjve dhe qeshte. Ibrahimimi u ul në krye të tryezës dhe Sara në fund, përballë tij.

Jani dhe Niko u ulën majtas, ndërsa Muhamedi dhe Aliu djathtas. Përpara se të fillonin, Sara tha amen dhe ashtu bënë edhe Jani me Nikon, por dhe Aliu që i imitoi. Ibrahimimi uroi me një gotë raki, ndërsa Muhamedi futi një hurmë të pjekur në gojë. Në fillim nuk folën sepse të gjithë e kishin mendjen tek ushqimet, një pjesë e të cilave ishin të panjohura për ta. Ibrahimimi pinte raki dhe i gëzohej tavolinës e karrigeve të reja dhe u fliste djemve sa herë që këta rrëzonin pilaf dhe copa mishi mbi syprinën e kuqe. Mendova se nuk do na nxinte, tha Ibrahimimi. Po të ishte Petro do dukej më e vogël, tha Jani duke provuar orizin me kanellë dhe mendoi se Sara kishte pasur të drejtë kur kishte porositur një tavolinë për gjashtë veta. Djemtë i zuri gjumi menjëherë, sapo tavolina u zbraz nga ushqimet. Ibrahimimi vazhdoi të pinte raki dhe kur Sara iu afrua për të mbledhur enët, ai e kapi për beli dhe e puthi. Duro të marr shandanin, i tha Sara dhe të dy shkuan në dhomën e gjumit. Ibrahimimi mbante era kanellë, ndërsa Sara e kishte gojën të mbushur me lëng hurme. Qirinjtë u lëngëzuan mbi shandan deri në mëngjes. Para se ta zinte gjumi, Sara mendoi se dhe e ëma duhej ta mbante ndezur atë shandan kur bënte dashuri me Arianitin.

Djemve iu shijoi kuzhina e Sarës dhe çdo ditë i kërkonin gjëra të reja. Ajo piqte bukë dhe kuleç të vegjël që i mbushte me arra dhe i spërkaste me mjaltë ose me reçel. Dhoma e oxhakut mbushej me tym kur kuleçtë digjeshin dhe Sara i tha Ibrahimimit se duhej të bënin një furrë të madhe jashtë shtëpisë. Ibrahimimi pyeti nëpër fshat dhe një ditë filloi të ndërtonte skeletin e furrës në oborr. Mori disa drurë që pasi i kryqëzoi si një kube, i veshi nga lart me baltë dhe i la disa kohë të thaheshin. Balta u forcua dhe u kap fort pas drurëve që mos binte. Por Ibrahimimi i vuri flakën dhe drurët u dogjën të parët dhe ranë si prush në folenë e furrës. Balta u bë si kërcu dhe mbeti aty lart si një tavan i ngrirë. E ke gati, it ha Sarës. Në furrën e re kuleçtë dilnin më të fryrë dhe Sara filloi t'i priste ato në forma të ndryshme që djemve u dukeshin si lodra. Një herë nga furra dilte një ushtri me kuaj, pastaj dilte një tavë me zogj prej brumi, pastaj disa dele apo edhe katrorë e diej të rrumbullakët. Djemtë ia bënin sytë kafshëve me lajthi dhe bajame dhe kur i vinin kafshët të ziheshin me njëra-tjetrën askush nuk fitonte, sepse zënka përfundonte në thërrime të verdha prej gruri. Jani i bëri Sarës një okllai të re dhe të lëmuar me të cilën ajo e shtypte fort miellin dhe pastaj i jepte formën e lodrës, me një thikë të mprehtë. Niko kërkonte vetëm kuaj, Aliu donte katrorë, ndërsa Muhamedi pëlqente kuleç në formë hëne, të cilat i ngjyente në reçel kumbulle. Pas kuleçve të mëngjesit dreka hahej me lakror që Sara e mbushte me gjizë, me vezë dhe me presh. Ibrahimimi donte lakror me petë të holla dhe të mbushur me pllaqi, ndërsa Jani ngrihej herët në mëngjes, shkonte në pyll dhe sillte një thes me hitra që ia përcëllonin duart. Djali i lante hitrat vetë dhe i thoshte Sarës t'ia mbushte me to, pjesën e tij të lakrorit.

Një ditë, kur Ibrahimimi u nis në qytet për të marrë paratë e disa bagëtive që kishte shitur, Sara i tha të blinte peshk. Peshk, pyeti Ibrahimimi i habitur, nuk kam ngrënë kurrë peshk. As unë, tha Sara, por ta provojmë. Pyet si pastrohët.

Ibrahimimi solli tre peshq të mëdhenj që gjithë rrugës kishin rrjedhur gjak dhe i vuri mbi tavolinë. Era e peshkut e mbushi shtëpinë dhe djemtë dolën jashtë duke mbyllur hundët. Edhe Ibrahimimit i vinte ndot duke i treguar Sarës se si pastroheshin. Në Pazar më thanë se i pritët koka, pastaj hapen nga barku dhe i hiqen të gjitha rropullitë. Mbaji në ujë të zier sa t'u dalë era dhe pastaj shtroi në tavë të piqen, tha ai dhe doli nga dhoma. Peshqit rrinin të shtrirë mbi tavolinë dhe kur Sara i ngriti për t'i nxjerrë në oborr, tre gjurmë uji të kuq mbetën mbi syprinë. I preu kokat dhe i pastroi, siç i kishte thënë Ibrahimimi. Pastaj i shtroi në tavë, i mbushi me majdanos dhe i bëri secilit një kurorë me domate dhe qepë. Djemtë vuajtën shumë me halat e peshkut dhe Ibrahimimi mezi e nxori një halë të vogël që i mbeti Aliut në fyt. Muhamedi nuk e preku peshkun, ndërsa Jani, pasi



i qëroi halat një nga një, e hëngri me bukë. Është shumë i mirë, tha Sara, por herën tjetër do t'ia pastroj halat dhe do t'ia mbush barkun me patate dhe oriz.

15

Kur Ana mbushi një vjeç e çuan në pyll. Korriku ishte i nxehtë, por pylli ishte i freskët. Sara bëri bukë të bardhë dhe kulaç me reçel, mbushi çantat me mish të pjekur me pllaqi, vuri djathë, domate të reja, kastravecë, mollë dhe limona dhe u nisën. Ibrahim mbante Anën në krahë, ndërsa Jani dhe djemtë e tjerë ushqimet. Sara ecte pas tyre me rrobat e Anës. Rugës, Muhamedi, që tërhiqte një trastë me domate, iu afrua, i dha dorën dhe i tha: Kam bërë një vjershë, por mos i thuaj babait. Nuk i them, i tha Sara, po mua do ma thuash? Po, tha Muhamedi dhe ia tha: *Dua hurma dhe në pyll shkoj, Ana rritet, unë fluturoj.*

Sara e pa duke qeshur dhe Muhamedi u skuq. Faqja e tij ishte e zbehtë dhe sytë i dukeshin edhe më të kaltër. Pse do të fluturosh e pyeti Sara. Dua të shoh botën, u përgjigj Muhamedi. Toka është e rumbullakët si një hurmë dhe nuk e shikon dot të gjithën vetëm duke ecur. Po të ecësh nuk rrëzohesh, ia ktheu Sara duke i shtrënguar dorën. Kush fluturon bie prandaj njerëzit kanë vendosur të ecin.

Si arritën në pyll, zgjodhën një kumbull të egër të mbushur me lule të bardha, që sa kishin çelur, dhe u ulën rrëzë saj. Sara shtroi një çarçaf dhe vuri aty Anën. Djemtë vrapuan duke u fshehur pas drurëve, ndërsa Ibrahim filloi të hapte ushqimet. Anën e zuri gjumi dhe lulet e kumbullës ia veshën flokët si një kurorë. Kur u zgjua, Jani i solli një breshkë me kurriz të verdhë, e cila i rrinte Anës përballë, si e trullësuar. Vajza nuk fliste, por përplaste dorën mbi kurrizin e breshkës dhe përpiqej ta ngrinte lart. Kur breshka e kuptoi se fëmija nuk mund t'i bënte keq, filloi të lëvizë nëpër bar dhe Ana e ndiqte duke ecur me duar. Djemtë u lëshuan nëpër pyll dhe erdhën secili me nga një breshkë të vetën. Do bëjmë një garë me breshka, i tha Jani tre djemve më të vegjël. Numëroi dhjetë hapa dhe duke futur një shkop në tokë shënoi një vizë mbi dheun e shkrifët. Breshka e kujt vjen këtu e para ai fiton, tha Jani. Tre djemtë kërkuan pak kohë për t'u përgatitur, këputën bar dhe filluan t'i ushqejnë breshkat që nga frika nuk e nxirrnin fare kokën jashtë guaskës. Aliu u ankua se breshka e Nikos ishte më e madhe se e tij dhe kështu ai do të fitonte, por Ibrahim e qetësoi kur i tha se breshka e vogël do ecte më shpejt sepse ishte më e lehtë. Por Aliu nuk u bind dhe filloi të qante. Kush vrapon më shpejt një derr apo një viç, e pyeti Ibrahim. Viçi, u përgjigj Aliu duke fshirë lotët. Po pra, i tha i ati, sepse viçi është më i lehtë se derri. Ndërkohë, Nikoja e mori breshkën e tij të madhe, u fsheh pas një peme dhe filloi t'i fliste në vesh. Nuk lejohet t'i flasësh breshkës, i bërtiti Aliu dhe u mërziu prapë. Lejohet, i tha Jani, por varet se çfarë i thua. E çfarë t'i them, pyeti Aliu duke u afruar që të tjerët mos dëgjonin. Thuaji që nëse fiton do ta marrësh në shtëpi. Aliu u fut pas një peme dhe nisi t'i fliste breshkës.

Pasi i ngopën breshkat me fjalë djemtë ishin gati për të filluar, por Muhamedi tha se pavarësisht se breshka e Nikos dukej më e madhe, ato të gjitha ishin njëllor dhe mund të ngatërroheshin rrugës. Mund të fitojë breshka ime dhe do duket sikur ishte breshka e Aliut, tha djali. E rregulloj unë, tha Sara dhe u ngrit duke e lënë Anën të ndiqte breshkën e vet. Mori nga trasta një domate, e ndau në mes dhe e fërkoj fort pas kurrizit të breshkës së Nikos. Kurrizi u skuq dhe breshka ngriti kokën si e plagosur. Pastaj Sara mbledhi disa luledele të verdha i fërkoj në duart e veta dhe ato lëshuan një pluhur të verdhë, që ajo e shpërndau gjithandej mbi kurrizin e breshkës së Aliut. Breshka teshtiu sikur t'i kishte hyrë pluhur në hundë dhe Aliu tha: Fillojmë se po më ftohet breshka. Breshkat nuk sëmuren, tha Sara që këputi një degë të njomë kumbulle mbi të cilën kishte çelur një lule e bardhë dhe ia futi breshkës së Muhamedit poshtë guaskës. Lulja i rrinte

breshkës si një dantellë dhe Muhamedi tha se nuk donte që breshka e tij të ishte femër. Femër është breshka e Anës, i tha Jani që priste me shkop në vijën e garës. Breshka jote është një burrë që ka veshur një këmishë me lulka si ajo e dajë Llambros. Muhamedi nuk foli dhe djemtë i vunë breshkat në një rresht. Nikoja i pari, Aliu i treti dhe në mes lulja e Muhamedit.

Gati, thirri Jani dhe numëroi deri në tre. Nisu. Por asnjëra nga breshkat nuk lëvizi. Djemtë filluan t'i ndërsejnë tre kafshët e tyre, u fishkëllenin, i gjuanin mbi kurriz me thupra, u vinin bar përpara gojës, por ato prapë nuk bënë përpara. Vazhduan kështu për një kohë derisa Aliu i futi gishtin poshtë guaskës breshkës së tij të verdhë, e cila u drodh dhe filloi të ecte. Ashtu bënë edhe Niko me Muhamedin dhe të tre breshkat filluan të zvarriten, por vija e garës dukej shumë larg. Ibrahimimi me Sarën ishin bashkuar me djemtë dhe ngushëllonin me radhë secilin që vraponte i djesitur, rreth breshkës së vet. Në mes të rrugës breshka e Aliut ishte një kumbull përpara dy breshkave të tjera. Aliu filloi t'i thoshte fjalë të ëmbla breshkës së tij që e ruante distancën, ndërsa Nikoja i fuste vazhdimisht gishtin nga prapa breshkës së tij të kuqe. Muhamedi ia hoqi fare lulen e bardhë breshkës nga qafa dhe i tha Sarës se ndoshta ajo e pengonte që të gjente rrugën. Djemtë i rrinin breshkave nga prapa dhe pas tyre edhe Ibrahimimi me Sarën dhe askush nuk e pa Anën që, duke ecur këmbadoras, kaloi përpara breshkave dhe kur arriti te vija e garës u kthye me fytyrë nga ata dhe filloi të qeshte duke përplasur duart. Breshkat u frikësuan nga vajza që u doli përpara, futën kokat nën guaskë dhe asnjëra nuk lëvizi më. Mbaroi, tha Jani, garën e fitoi Ana.

Hëngrën bukë dhe pasdite u kthyen në shtëpi. Ibrahimimi eci përpara me Anën në krahë, ndërsa Sara vinte e fundit me Muhamedin që e pyeste pse toka ishte e rrumbullakët dhe jo katrore. Aliu e mori me vete breshkën e tij dhe tha se kur gara u mbyll, ajo ishte e para. Niko zihej me Janin që e kishte mbyllur garën kur breshka e Aliut ishte pak përpara së tijës dhe nuk pranoi të mbante asnjë nga trastat me ushqimet që tepruan. Para se të shtrihej, Aliu e futi breshkën poshtë krevatit të tij dhe i hodhi bar. Fli, i tha, se do ketë gara të tjera. Ndërsa Ana Komnena sillej me duar e me këmbë mbi shtratin e madh të prindërve dhe nuk fjeti deri vonë, duke e lënë dhe Ibrahimimin pa gjumë. Po iki të fle nga djemtë, i tha Ibrahimimi Sarës dhe u shtri në krevatin që kishte lënë bosh Petro. Shko, i tha Sara, po kujdes mos zgjosh breshkën.

16

Gara e breshkave u përsërit disa të diela. Aliu merrte breshkën e vet shtëpiake, ndërsa Niko me Muhamedin vërtiteshin nëpër pyll dhe sillnin breshka të reja. Një ditë ata u mërzitën nga loja dhe thanë se nuk gjetën më breshka, por Aliu tha se breshka e tij i kishte mundur të gjitha breshkat dhe ato nuk dilnin më nga frika. Ana çapitej nëpër bar, ndërsa Sara ndryshonte format e kuleçve. Kur ktheheshin, Jani merrte dru në pyll, të cilët i përzgjidhte duke i parë lulen dhe lëkurën dhe kur shkonte në shtëpi i kthente në zburime. Ai filloi të bënte enë druri, shishe për raki, gota, okllai me përmasa të ndryshme, kanistra, rosa, pata dhe trekëndësha të vegjël për Anën.

Një ditë, Jani i thirri tre vëllezërit e tij dhe i tha se do t'u bënte atyre nga një lodër druri, por ata duhet të vendosnin se çfarë donin. Niko i kërkoi një ushtar, megjithëse nuk kishte parë kurrë ushtar me sy. Çfarë ushtari do, e pyeti Jani. Do një turk me çallmë dhe me jatagan në brez, apo një grek me kapelë të vogël dhe me këpucë me xhufka. Niko u mendua dhe i tha se donte një ushtar me jelek dhe me dy pishqolla në brez si Llambro Xhavella. Por nuk e dua tullac. Dua që ushtari im të jetë më i ri se dajë Llambro. E do me çallmë apo me qeleshe, e pyeti Jani prapë. E dua me flokë të gjata që ia merr era, tha Niko.

Aliu që e dëgjoi të vëllanë tha se ai donte një luftëtar mbi kalë si Skënderbeu. Skënderbeu kishte një përkrenare me bri dhie mbi kokë, i tha Jani dhe shpatën e kishte më të gjatë se kalin. Skënderbeu nuk i donte dhitë se ato nuk bëjnë qumësht të mirë më ka thënë babai, u përgjigj i nxehur Aliu. Unë dua që Skënderbeu im të mbajë mbi kokë jo dy, por vetëm një bri të trashë demi që i thyen parzmoret e turqve. Po shpatën, e pyeti Jani. Shpatën e dua të drejtë, por jo më të gjatë se kalin, tha Aliu.

Ndërsa Muhamedi pasi dëgjoi i qetë dy vëllezërit tha se ai donte dy lodra. Jo, i thanë vëllezërit, pse ti dy lodra kur ne do kemi vetëm nga një. Po ato janë pjesë e së njëjtës lodër, u përgjigj Muhamedi, por vëllezërit nuk po e kuptonin. Unë dua një gjë të rrumbullakët në qoftë se toka është e rrumbullakët dhe një katror në qoftë se toka është katror. Është njëlloj si ushtari yt që duket edhe nga përpara, edhe nga prapa, i tha ai Nikos. Mirë, i tha Jani, do ta bëj, se lodrat e tua janë më të thjeshta dhe gdhenden shpejt. Po unë dua që t'i bësh me pyje, me lumenj, me dete, me male dhe me fshatra, i tha Muhamedi. Po njerëz nuk do, e pyeti Jani. Jo nuk dua, tha Muhamedi. Njerëzit janë të vegjël dhe nga lart nuk duken.

Jani punoi një muaj për kukullat e vëllezërve. Shkoi në pyll dhe zgjodhi lis për ushtarin e Nikos dhe Skënderbeun e Aliut, ndërsa tokat e Muhamedit vendosi t'i bënte me qershë sepse ajo vinte si e murrme dhe ai mendoi se toka e parë nga lart kishte atë ngjyrë. Preu me kujdes katër kuti të vogla të barabarta, në madhësinë e një ikone, por u kujtua se shpata e Skënderbeut do të dilte mbi lartësinë e lodrave të tjera dhe preu një kuti më të gjatë. Vizatoi me brisk hekuri mbi secilën kuti, format e tyre të përafërta dhe filloi t'i priste trashë. Ashtu, lodrat dukeshin si gurë që koha dhe erërat i kishin gdhendur rastësisht, pa asnjë qëllim. Pastaj, me një daltë të vogël filloi të nxirrte ngadalë ashklat e drurëve derisa koka e ushtarit të Nikos u duk si një kokë ariu, pa faqe dhe pa hundë. Jani e la ushtarin e Nikos dhe kaloi te Skënderbeu i Aliut derisa edhe ky u duk si një ari i paushqyer. E la dhe atë dhe filloi të merret me kalin. Faqet dhe hundët e ushtarit dhe të Skënderbeut do t'i bëj në fund, tha me vete duke menduar se duhet t'i bënte të dukeshin si njerëz të ndryshëm sepse përndryshe vëllezërit do të ziheshin. Aliu nuk mund të pranojë që Skënderbeu të ketë fytyrë ushtari, qeshi Jani dhe vazhdoi të rrumbullakoste tokën e Muhamedit. Jani nuk kishte parë ndonjë det dhe nuk dinte nëse ai ishte më i madh dhe apo më i vogël se lumi. Në darkë pyeti Sarën dhe ajo i tha se bota kishte më shumë dete sesa pyje dhe lumenj dhe se çdo lumë bashkohej me detin dhe çdo det bashkohej me një det tjetër. Po pyll në mes të detit ka, e pyeti Jani. Ka, tha Sara. Janë ishujt, por ata janë të vegjël dhe nuk duken nga lart. Me përjashtim të Kretës, tha ajo dhe pa nga Ibrahim i që nuk po e dëgjonte.

Jani i gdhendi imët pishqollat e ushtarit, por megjithatë njëra doli pak më e gjatë se tjetra. Ndërsa shpata e Skënderbeut u thye pak në majë dhe Jani ia shkurtoi këmbët e kalit, që t'i sillte në proporcion. Pastaj thelloi lumenjtë që dukeshin si gishta mbi tokën e Muhamedit dhe duke e futur daltën thellë në dru bëri nga të gjitha anët pyje që dukeshin si gjilpëra të ngulura mbi një top leshi. Në mes të një deti të madh, ngriti një gungë të vogël si nishan, që ishte Kreta. Kur mbaroi faqet, hundën dhe sytë e ushtarit dhe të Skënderbeut, njëri dukej si një burrë i hollë me faqe të verdha, ndërsa tjetri si një bullafiqi nën peshën e të cilit kali me këmbë të shkurtra po jepte shpirt.

I pastroi nga pluhuri dhe i hodhi pak ujë që të shkëlqenin. Thirri tre vëllezërit dhe ua tregoi. Në fillim ata u habitën, por pastaj filluan të shikonin me qetësi dhe të krahasonin secili kukullën e tij me dy të tjerat. Pse njëra pishqollë është më e gjatë se tjetra, u hodh Niko. Sepse ushtari yt njërin ia ka marrë një turku dhe tjetrën një greku, tha Jani. Po pse ushtari im është më i dobët se Skënderbeu, vazhdoi Niko. Sepse ushtari shkon në luftë dhe nuk ka kohë të hajë, ndërsa Skënderbeu rri majë kalit dhe nuk lodhet. Skënderbeu ka kalë sepse është komandant, tha Aliu

duke mbrojtur kukullën e tij. Por pasi e pa mirë u hodh dhe ai. Kali i ka këmbët e shkurtra dhe duket si mushkë. Kali i Skënderbeut ishte ndryshe nga të tjerët, tha Jani. Ai ishte shumë i shpejtë dhe prandaj i ka këmbët më të shkurtra. Çfarë është kjo, pyeti Muhamedi duke treguar ishullin me gisht. Kjo është Kreta, tha Jani. Është një ishull. Po pse ma ke vënë Kretën, unë nuk ta kërkoja, tha Muhamedi. Këtë ma kërkoi Sara, tha Jani duke parë nga ajo. Muhamedi u kthye nga Sara, si për t'i thënë se nuk kishte punë me lodrën e tij, por Ibrahim i ndërhyri dhe i tha: Në Kretë është vrarë gjyshi im dhe stërgjyshi yt. Është mirë që e ke futur në botën tënde. Muhamedi nuk foli, por Aliut iu duk se heroizmi kaloi nga shpata e Skënderbeut te bota e Muhamedit dhe duke iu afruar Ibrahimit e pyeti: Me shpatë ka luftuar gjyshi? Po, i tha Ibrahim. Po pisqollë ka pasur, tha Nikoja. Nuk e di, tha Ibrahim, por ndoshta e kanë vrarë me pisqollë.

Kaq duhej që dy djemtë të fillonin luftën. I afruan kukullat e tyre dhe, duke i ngjitur me njëra-tjetrën, i shtynin fort. Ushtari yt nuk i nxjerr dot pisqollat nga brezi, thoshte Aliu dhe i fuste shpatën ushtarit në sy. As shpata jote nuk ia pret dot kokën ushtarit tim, bërtiste Niko duke shtyrë Skënderbeun e shëndoshë. Në fillim u thye briri i përkrenares së Skënderbeut, pastaj ushtari mbeti me një krah dhe me krahun tjetër u hakmor duke i thyer Skënderbeut shpatën. Kështu janë më të bukur, tha Sara, duken si statuja antike.

Djemtë fjetën atë natë duke e futur secili poshtë krevatit heroin e vet të plagosur. Ushtari me një krah humbi ekuilibrin dhe u rrëzua, ndërsa Skënderbeu rezistoi, por breshka e lëpiu gjithë natën. Muhamedi e futi tokën e tij të rrumbullakët poshtë jastëkut, por ashtu nuk mund të flinte sepse koka i dhembte mbi drurin e fortë. E mori dhe e vuri dhe ai poshtë krevatit, tokën e vet. Para se të flinte i tha Janit: Po të ma kishe bërë tokën katrore tani do më kishte zënë gjumi.

Kur u zgjuan në mëngjes, asnjëri nuk e gjeti lodrën poshtë krevatit. Kontrolluan nëpër shtëpi, hapën sirtarët, shkuan në qilar, por nuk i panë kund. Shkuan te dhoma e prindërve, por aty Ana po flinte me një patë në dorë. Dolën në oborr dhe panë që Sara i kishte rreshtuar tre kukullat mbi një plloçe dhe po i shihte. Do t'i lyej, tha ajo kur djemtë e pyetën.

Në fillim Sara leu me të kaltër detet, pastaj i dha një jeshile të errët pyjeve, nxiu lumenjtë dhe malet i bëri me bojë kafe. Po Kretën si do e lyesh, e pyeti Muhamedi. Me të kuq, u përgjigj Sara. Aty është derdhur shumë gjak. Me ngjyrë të kuqe u lye dhe fustanella e ushtarit, ndërsa këmisha e tij dhe kali i Skënderbeut u bënë të bardha. Pisqollat dhe përkrenarja e Skënderbeut u lye me ngjyrë të zezë, ndërsa pjesa e mbetur e shpatës u vesh me një të verdhë ngjyrë ari. Fytyra e shëndetshme e Skënderbeut u lye me rozë, ndërsa pelerina ngjyrë vjollcë. Flokët e gjata të ushtarit u zverdhën, ndërsa faqet dhe hunda u lye me bojë kafe. Ushtari është nxirë nga dielli nëpër luftëra, tha Sara duke lyer me gri shtëpitë e vogla të botës së Muhamedit. Si mbaroi, i vuri mbi plloçe që të thahen. Ushtarin dhe Skënderbeun përballë njëri-tjetrit, ndërsa tokën e Muhamedit në mes të të dyve. Tani kanë arsye të luftojnë për një copë tokë, tha Sara dhe i mori djemtë për t'u dhënë mëngjes.

17

Në dimër ra dëborë. Oborri u zbardh dhe pylli dukej më i zi. Kukullave u ishin zbehur ngjyrat dhe ushtari i Nikos ishte thinjur nga luftërat. Lumenjtë e tokës së Muhamedit ishin tharë, kurse Skënderbeu i kishte zbritur kalit dhe ngruhej si ulok pranë vatrës.

Ibrahimi mbushte oxhakun me dru, ndërsa Sara gatante trahana për djemtë. Muhamedi u ftoh dhe derisa shkriu bora nuk u ngrit nga krevati. Sara e mbështolli me batanije, por ai prapë dridhej nga ethet. Ibrahim flinte në dhomën e djemve dhe natën i vinte leckë me dëborë në kokë. Muhamedi u dobësua dhe sytë e kaltër nuk i shkëlqenin më. Një natë filloi të fliste përçart nëpër

ethe dhe Ibrahimimi zgjoi Sarën dhe i tha se kishte dëgjuar Muhamedin që thoshte: Po fluturoj, po fluturoj. Pastaj pushoi dhe pas pak tha: Nuk ka nevojë të fluturosh, mund të vish tek unë duke ecur.

Sara i hodhi një batanije tjetër Muhamedit dhe i tha Ibrahimimit të merrte një grusht me dëborë të pastër. Ibrahimimi u kthye në çast dhe Sara i mori borën nga duart e tij dhe ia futi Muhamedit në gojë. Muhamedi u gëlltit disa herë në gjumë, ndërsa bora shkrihej ngadalë në fytin e tij të zjarrtë. Të nesërmen ishte më i qetë. Sara e pyeti se a mbante mend ndonjë ëndërr dhe ai i tha jo. kujtohu, i tha Sara, ti flisje me vete sikur po takoje një njeri në pyll. Nuk ishte zëri im, tha Muhamedi dhe u kthye nga ana tjetër e fjeti.

Kur u zgjua, mori tokën e rrumbullakët dhe filloi t'ia hiqte bojën e tharë që dimri e kishte plasaritur. Hoqi në fillim të kuqen e Kretës dhe pastaj me radhë blunë, jeshilen e pyjeve dhe grinë e pisët mbi fshatra. Bojërat e ngrira binin si lëkurë mbi çarçaf. Pse po e zhvesh tokën, e pyeti Jani. Kur fluturon lart e gjithë toka ka një ngjyrë, tha Muhamedi. Po ti nuk ke fluturuar, i tha Jani, por Muhamedi nuk u përgjigj dhe vazhdoi të qëronte tokën me thonj. Janit iu duk sikur i vëllai ishte mërztitur me lodrën dhe i tha se do t'i bënte tokën katrore që i kishte premtuar në vjeshtë. Bëje pa det dhe pa ishuj, i tha Muhamedi. Jani shkoi në qilar ku mbante disa drurë që herë pas here i kthente në pjata për Sarën dhe trekëndësha për Anën. Zgjodhi një copë qershi, e preu në formë drejtkëndëshi dhe filloi ta gdhendte vetëm në pjesën e sipërme. Bota katrore duhet të jetë si plis, mendoi, nuk duket nga tri anët e tjera. Nuk bëri dete, as lumenj, por gdhendi një pyll me dru të gjatë dhe të shtrembër dhe buzë tij, një fshat me shtëpi të çrregullta. Në mes të fshatit sajoi një kishë që nga lart dukej si tavolinë e vogël me pikë në mes. Rreth kishës ndërtoi shtëpi dhe të gjitha i bëri më të ulëta se kisha. Punoi gjithë ditën në qilar megjithëse duart i dridheshin nga i ftohti. Kur u err, i kërkoi Sarës shandanin me shtatë krahë dhe vazhdoi duke punuar nën qirinjtë që shkriheshin ngadalë. Njëri nga qirinjtë kulloi mbi fshat dhe Jani i veshi gjithë çatitë e shtëpive me dyllin e bardhë që ngriu menjëherë. Në mëngjes ia dha Muhamedit. Pse i ke veshur çatitë me qiri, e pyeti Muhamedi. Është dimër dhe ka rënë borë në fshat, tha Jani. Po pse ky është fshati ynë, pyeti Muhamedi duke e parë me kujdes. Po, tha Jani. Ja ku është pylli, kisha, ja dhe shtëpia jonë, shtëpia e Arianitit dhe me radhë. I ngjan, tha Muhamedi dhe sytë e kaltër i shkëlqyen prapë. Por jo edhe për shumë kohë, se fshati do ndryshojë. E si do ndryshojë, i tha Jani duke buzëqeshur.

Muhamedi e rrotulloi fshatin nga të gjitha anët sikur po shihte fundin e një filxhani, pastaj e ktheu nga i vëllai dhe duke treguar një shtëpi me gisht i tha: Kjo është shtëpia jonë dhe këtu është shtëpia e Mihalit, apo jo? Jani tundi kokën për ta miratuar. Këto dy shtëpi do bashkohen. Këtu ku duket një vend bosh duhet të jetë fusha ku janë varrosur bagëtitë që vdiqën gjatë kolerës. Po, tha Jani. Këtu do ndërtohet një shtëpi dhe ti do shkosh aty, tha Muhamedi. Edhe po të ngjallen bagëtitë nuk do ta ndërtojnë shtëpinë aty ku kanë ngordhur, tha Jani që po i shijonte fshati i ri, sipas Muhamedit. Nuk do jenë bagëti, por disa njerëz të zinj me çanta do vijnë në fshat dhe do ta ndërtojnë shtëpinë aty, tha Muhamedi i përqendruar dhe vazhdoi:

Kjo kutia e vogël këtu është shtëpia e Hanës, mbesës së Sarës. Kjo shtëpi do shembet dhe këtu do ndërtohet një xhami. Sa do gëzohej babai, tha Jani duke vazhduar lojën. Kurse kjo është shtëpia e madhe e Arianitit, apo jo? po, tha Jani, ajo është. Kjo do bëhet shkollë, tha Muhamedi dhe pastaj do zbrazet. Tani e besoj që paske fluturuar, u tall Jani dhe u çua duke drejtuar jastëkun ku mbështetej i vëllai që i mbante sytë në tavan sikur shikonte fundin e një filxhani.

Pas tri ditësh, Muhamedit iu rritën prapë ethet, por Sara ia mbushi gojën me borë dhe ai u qetësua. Nikoja me Aliun që luanin në oborr një mëngjes panë mbi dëborë disa hapa të vegjël që

nuk i ngjanin hapave të tyre. Na ka ardhur një lepur në shtëpi, tha Ibrahimimi kur djemtë e pyetën. Ku rrinë lepujt, pyeti Aliu. Në pyll, tha i ati, dalin në dimër se i merr uria, kurse në verë ushqehen. Sikur të isha lepur do bëja të kundërtën, tha Niko, do ushqehesha në dimër dhe do luaja në verë.

Në darkë Ibrahimimi i tha Sarës se do dilte për gjah. Kafshët janë të uritura dhe i bien kollaj lakut, tha ai dhe zbriti në qilar për të marrë ç' i duhej. Sara u ngrit herët në mëngjes poqi kuleç, bukë dhe zjeu patate. Mbushi me raki një shishe të vogël druri që e kishte gdhendur Jani dhe i futi të gjitha në një trastë. Do vij dhe unë me ty, i tha Jani të atit. Ti rri në shtëpi, tha Ibrahimimi. Do marr Nikon dhe Aliun se ata nuk kanë parë lepuj. Sara i veshi djemtë trashë, u dha nga një kapuç leshi për të mbuluar veshët dhe u nisën. Ibrahimimi ecte para dhe çante dëborën, ndërsa dy djemtë shkelnin mbi gjurmët e tij të mëdha dhe bora u vinte deri në gju.

Kur shkuan në pyll, aty kishin bërë garën e breshkave, Ibrahimimi nxori dy çarqe të mëdhenj nga trasta dhe filloi t' i rregullonte duke i vënë pak mish të thatë, bukë dhe patate që i kishte marrë me vete. Ha lepurin mish, e pyeti Aliu. Jo, tha Ibrahimimi, por nga era mund të gënjejhet dhe i bie çarkut. Po pse e harxhon mishin, vazhdoi Niko. Mund të zëmë ndonjë dhelpër, tha Ibrahimimi. Unë dua lepur, tha Aliu. Mirë, tha Niko, unë po marr dhelpërën se ajo e ha lepurin. Ndërkohë, Ibrahimimi mori njërin çark dhe, duke e mbajtur me kujdes, i tha Aliut ta ndiqte. Ti rri këtu, i tha Nikos, dhe ruaj trastat, nuk vonohemi. Po pe ndonjë dhelpër, më thirr. U nisën duke e çarë me hapa të vegjël dëborën e pashkelur dhe pas pak Niko nuk i pa më. Dielli ishte i fortë atë ditë, por djali i kishte këmbët deri në gju në dëborë dhe nuk ngrohej dot. Filloi të rrotullohej rreth trastave duke numëruar me zë për t' u ngrohur. Kur arriti deri në njëqind ndaloi se nuk dinte të numëronte më tepër. Filloi nga e para, por dëgjoi një zhurmë dhe e ndërpreu numërimin. Po vjen dhelpëra, mendoi dhe u ul mbi trasta, sikur kishte frikë. Ktheu kokën andej nga kishte ardhur zhurma dhe pa një degë të vogël që, duke u thyer nga pesha, ra në këmbët e pemës së kumbullës. U çua prapë dhe vazhdoi të rrotullohej duke numëruar. Kur kishte arritur shtatëdhjetë e gjashtë dëgjoi prapë një zhurmë më të fortë dhe u ul instinktivisht. Ktheu kokën dhe pa Ibrahimimin me Aliun që po vinin duke qeshur. Kishte frikë, i tha Aliu, të pamë. Faqet e Nikos ishin të kuqe nga të ftohtët dhe e skuqura nuk iu duk. U ula që mos më shikonte dhelpëra, tha ai. Po ju a e kapët lepurin? Do ta kapim, tha Aliu. Andej kishte shumë gjurmë dhe patatja do t' i mbledhë lepujt. Ibrahimimi mori çarkun tjetër dhe, pasi e mbushi me mish dhe me patate si të parin, i tha Aliut të qëndronte aty dhe mori Nikon me vete. Morën drejtimin e kundërt me të parin, nga ku pylli ishte më i dendur dhe dëborë më e trashë. Ibrahimimi ecte përpara dhe Niko mezi i ngrinte këmbët për t' i futur në gjurmët e thella të të atit. Aliu hapi trastën dhe nxori një kulaç që filloi ta hante. Kulaçi ishte i ftohtë, por Aliu kafshonte pa e pasur mendjen. Nga pas i erdhi një zhurmë e butë si një peshqir që fërkohej pas trupit. Ktheu kokën dhe pa një lepur të bardhë me bisht të zi që i merrte erë borës. Kur Aliu lëvizti, lepurin ngriti kokën dhe e shikoi nga dora. Sytë i kishte të kuq si xham. Aliu këputi një copë kulaç dhe ia hodhi te këmbët. Lepuri i mori erë dhe pastaj e kafshoi me dhëmbët e vegjël duke lëpirë buzët me gjuhë. Dëborë u mbush me thërrime që lepurin i ndoqi një nga një duke lëvizur vetëm kokën. Do ta kap, mendoi Aliu dhe iu hodh sipër, por lepurin i shkau nën bark dhe vrapoi. Aliu u ngrit dhe filloi ta ndiqte. Lepuri vraponte shpejt mbi dëborë, ndërsa ai zhytej deri në gju dhe mezi ngrinte këmbët. Aliu nuk u dorëzua dhe duke rendur mendonte fytyrën e habitur të Nikos kur t' i tregonte lepurin, që ai do ta mbante nga veshët. Lepuri u fut në pyll dhe ndaloi. Aliu iu afrua, por kafsha kërceu dhe u fut pas një peme. Veshët e gjatë i dilnin jashtë dhe dukeshin si dy gishta që e thërrisnin Aliun, i cili çau nëpër dëborë dhe iu afrua lepurit që kërceu dhe u fsheh pas një peme tjetër. Djali nuk lodhej, ndërsa lepurin, i ngopur me kulaç, luante.

Kur Ibrahimimi u kthye te trasta u frikësua kur nuk e pa të birin. Mos e ka ngrënë ndonjë ujë, tha Niko dhe filloi të dridhej. Ujqit rrinë në male, i tha Ibrahimimi dhe filloi të kontrollonte gjurmët mbi dëborë. Dy herë u rrotullua pas gjurmëve që kishte lënë Nikoja kur numëronte, por pastaj pa disa gjurmë më të freskëta që merrnin andej nga kishte lënë çarkun e parë dhe u nis. Prit këtu dhe mos ki frikë, i tha Nikos. U fut në pyll duke ndjekur gjurmët që kalonin nga një pemë te tjetra, pastaj ktheheshin prapë dhe vazhdonin më thellë nëpër pyll. Duke ecur pas tyre, si pas një gjahu, pa Aliun të ulur në gjunjë, ndërsa dy hapa larg tij rrinte një lepuri me bisht të zi. Aliu i fliste dhe lepuri tundte kokën sikur e kundërshtonte. Pastaj lepuri kërcëu dhe Aliu e ndoqi. Ibrahimimi filloi të qeshte dhe duke ecur shkeli pa e parë mbi një degë të hollë, e cila kërcëti dhe u thye me zhurmë nën këmbën e tij. Aliu ktheu kokën, ndërsa lepuri u zhduk pas një peme dhe nuk doli më. Ma trembe lepurin, i bërtiti Aliu duke hequr kapuçin që i ishte lagur nga djersët. Nuk kapet lepuri me vrap, i tha Ibrahimimi. Kapet që ç'ke me të, këmbënguli i biri me inat. Unë sa po e bindja. E çfarë i the, e pyeti Ibrahimimi. I thashë të vinte me mua në shtëpi se do t'i jepja kulaç sa të donte. Ibrahimimi qeshi dhe ia mbathi kapuçin e lagur.

Morën për nga fusha e breshkave, ndërsa Aliu ecte përpara dhe gjithë kohën kontrollonte pas pemëve. Kur u afruan, Ibrahimimi pa që Nikoja nuk ishte aty ku e kishte lënë. Trasta nxinte e vetmuar mbi dëborë. Paskam ardhur për të gjuajtur djemtë e mi dhe jo lepuj, mendoi, dhe gjaku i zjeu në tëmthat e ftohtë. Kontrollloi gjurmët e Nikos, siç kishte bërë herën e parë dhe u nis në atë drejtim. Hajde me mua shpejt, i tha Aliut dhe eci me hapa të mëdhenj. Gjurmët e çuan te çarku. Nikoja ishte përkulur mbi të dhe nuk lëvizte. Kur u afrua, Ibrahimimi pa disa njolla gjaku mbi dëborë, ndërsa patatja ishte ngrënë përgjysmë dhe kishte përfunduar jashtë dërrasës së çarkut. Në thikën e shkrehur varej jetim një bisht i zi. Ishte një lepuri, tha Niko i penduar, por e lëshova. Frikacak, i tha Ibrahimimi që nxori thikën dhe e ndau bishtin nga çarku. Është lepuri im, tha Aliu duke marrë bishtin e zi. Dontë të hante kulaç dhe jo patate. Nuk ishte lepuri yt, tha Nik dhe i tregoi të atit se si kishte vrapuar në drejtim të çarkut kur dëgjoi një zë kafshe që rënkonte nga dhimbjet. Më erdhi keq kur e pashë që qante si njeri, tha Niko me sytë e lagur. Aliu futi bishtin e zi në xhep dhe i tha të vëllait: Herë tjetër mos i ndiq më lepujt e mi.

Hëngrën kuleçtë që kishte gatuar Sara dhe shkuan dy herë të kontrollonin çarçet, por derisa u errato nuk u mbushën. U kthyen në fshat kur Anën sapo e kishte zënë gjumi. Nikoja fjeti pa i folur askujt, ndërsa Aliu i tregoi Janit për lepurin duke fërkuar bishtin pas faqes. Do ta kisha kapur, i tha, por e trembi babai. Lepuri nuk është breshkë, tha Jani. Ai nuk mund të rrinte poshtë krevatit. Kur u shtrinë, Ibrahimimi i tregoi Sarës se si kishte humbur njërin pas tjetrit, djemtë në pyll. Shkova për kafshë, por zura gjah djemtë e mi, i tha duke parë shandanin që digjej. Tani je bërë një Abraham i vërtetë, tha Sara. Ibrahimimi mblodhi supet nën velenxë për t'i thënë se nuk e kishte kuptuar. Errësira e kishte bërë dhomën më të ftohtë dhe Sara i zgjati këmbët nga Ibrahimimi. Nuk e gjej veten në historinë e Abrahamit, tha Ibrahimimi. Unë shkova të vras kafshë, jo njerëz, ndërsa Abrahami shkoi të vriste djalin e tij dhe vrau një kafshë. Ti je mijëra vjet pas Abrahamit dhe nuk je profet, tha Sara. Perëndia i ka lënë njerëzit të lirë dhe nuk u thotë më se kë duhet të vrasin apo se kë nuk duhet të vrasin. Prandaj bota është bërë kaq e ngatërruar. Por, megjithatë, ti ke edhe një ngjashmëri tjetër me Abrahamin. Çfarë kam tjetër, pyeti Ibrahimimi me zë të butë, i ngrohur nga këmbët e Sarës. Abrahami kishte dy djem me dy gra të ndryshme dhe për shkak të këtyre dy grave bota u nda në të krishterë dhe myslimanë. Të dy palët mendojnë se ishte profeti i tyre ai që Abrahami mori me vete në pyll, për ta vranë. Myslimanët thonë se Abrahami mori për të flijuar Ismailin, ndërsa të krishterët thonë se ai zgjodhi Isakun. Edhe çifutët, që e kanë shkruar të parët këtë histori në librat e tyre, mbështesin variantin e të krishterëve, për Isakun. Myslimanët thonë se përderisa perëndia i kërkoi Abrahamit të flijonte djalin e tij të vetëm, do të thotë se ky djalë

ishte Ismaili, sepse ai ishte i vetëm derisa lindi Isaku. Ndërsa të krishterët thonë se sipas ligjit të perëndisë, Abrahami njihte djalë të vetëm Isakun që e kishte pasur me gruan e tij të ligjshme. Kjo histori e ka përçarë botën për mijëra vjet duke futur në luftë të krishterët me myslimanët. Të dy palët besojnë se feja e djalit të flijuar është feja e vërtetë e perëndisë. Por unë besoj se të dy palët janë të pashpirt, sepse do të donin që profeti i tyre të vuante siç duhet të ketë vuajtur ai djalë kur ka parë thikën e babait të ngritur, mbi kokën e vet. Sikur Abrahami ta kishte vrarë vërtet njërin nga djemtë, e vërteta do ishte e pastër dhe nuk do kishim dy fe, por vetëm një. Ose, sikur Abrahami t'i kishte marrë të dy djemtë në pyll, siç bëre ti, ndoshta bota do ishte më e qetë. Ndoshta kështu do ishte, tha Ibrahimimi dhe u ngjesh më shumë nga këmbët e Sarës. Në këtë pikë ndryshon pak ti nga Abrahami, sepse i more të dy djemtë me vete në pyll. Por, njëllonj si ai, ti ke ndarë djemtë në të krishterë dhe myslimanë. Ibrahimimi nuk foli dhe pas pak Sara ndjeu që e kishte zënë gjumi dhe këmbët e tij ishin ftohur.

Ibrahimimi u ngrit përpara Sarës dhe u nis në pyll. Edhe djemtë flinin, por ai nuk i zgjoi. Kishte rënë dëborë gjatë gjithë natës dhe gjurmët e këmbëve të tij ishin fshirë. Kur arriti në fushën e breshkave, la trastën, ngrehu çarqet dhe i vuri aty ku i kishte vënë të djeshmen. Gjaku i lepurit kishte humbur nën dëborë. U kthye dhe ul mbi trastë duke i mbajtur veshët e gatshëm për të kapur britmën e ndonjë kafshe të zënë në grackë. Retë kishin zbritur mbi majat e pemëve dhe dukeshin sikur shkundnin dëborën. Ai priste dhe mendonte. Jeta e tij kishte ndryshuar që kur ishte bërë mysliman. Ishte më i pasur dhe kishte më shumë djem. Sara i kishte dhënë një vajzë që nuk e kishte pasur dhe ai ishte i lumtur. Megjithatë, shumë vdekje kishte parë që nga ajo ditë. Kishte vdekur gruaja dhe djali i vogël. Kishte vdekur vëllai dhe dhjetëra kokë bagëti. Kolera kishte ardhur si një mallkim. Bota kishte ndryshuar. Njerëzit varfëroheshin njëllonj si më parë, por disa edhe pasuroheshin. Shumë shqiptarë ishin bërë myslimanë. Turqit ishin gjithmonë e më të egër. Ata fitonin, pushtonin dhe i merrnin toka të tjerëve. Por ndoshta të gjitha këto do të ndodhnin edhe nëse ai nuk bëhej mysliman. Të afërmit e tij kishin vdekur për arsye të tjera, nga kolera apo nga plakja, sëmundje që i preknin të gjithë, pavarësisht nga feja. Turqit do ishin njëllonj të egër. Por ndoshta nuk do ishin kaq të fortë sikur ai dhe shumë të tjerë mos bëheshin myslimanë. Ndoshta, mendoi dhe iu kujtua Sara që në krevat i kishte thënë se ai i kishte ndarë djemtë në të krishterë dhe myslimanë. Kishte bërë sikur e kishte zënë gjumi sepse nuk kishte përgjigje për Sarën. Shumë gjëra që ndodhnin në botë ai nuk do mund t'ua ndryshonte drejtimin edhe sikur të kishte mbetur i krishterë.

Por një gjë ishte e sigurt dhe ai nuk mund t'ia fshihte vetes. Djemtë e tij ishin ndarë në të krishterë dhe myslimanë për një dash që nuk ishte shitur të dielën në pazarin e qytetit. Edhe djemtë e Abrahamit ishin ndarë për një dash. Historinë e djemve të Abrahamit ndoshta e kishte caktuar Zoti, por fatin e djemve të tij e kishte vendosur ai vetë. Iu kujtua dita e dasmës me Anën. Krushqit nga Suli deheshin dhe kërcenin. Gratë shihnin nga nusja, ndërsa burrat pinin me dolli. Në mes të asaj rrëmuje ai kishte takuar Arianit Komnenin, i cili pinte dhe këmisha e bardhë i ishte hapur në gjoks. Flokët i kishte të lëshuara, ndërsa gjoksin e thinjur dhe me kocka të forta. Je bërë gati, e kishte pyetur Arianiti duke parë nga nusja. Për çfarë, e kishte pyetur ai. Arianiti kishte qeshur dhe gjithmonë duke parë nusen i kishte thënë: Sonte duhet t'ia heqësh bërthamën kësaj kumbulle. Ai kishte mbledhur supet i turpëruar, ndërsa Ana ishte skuqur nën vello. Do djem apo vajza, e kishte pyetur Arianiti. Djem, i kishte thënë ai. Atëherë Arianit Komneni e kishte tërhequr dhe i kishte thënë në vesh: Në qoftë se do djem, kur ta hapësh kumbullën mos i shuaj qirinjtë.



Ana nuk e dëgjoi, ndërsa Arianiti vazhdoi të pinte. Kur ishte mbyllur dasma ai dhe Ana ishin futur vetëm në dhomë. Ai ishte zhveshur dhe pastaj kishte zhveshur dhe nusen. Shuaj qirinjtë se më vjen turp, i kishte thënë ajo duke u mbuluar. Jo, i kishte thënë ai, se ndryshe do lindësh vajza. I mbajti qirinjtë ndezur dhe iu ngjiti trupit të njomë të gruas. Ajo u mblodh dhe lëkura iu bë si peshqir, por mishi në mes të këmbëve të tij mbeti i varur gjatë gjithë natës. gratë i kontrolluan çarçafët të nesërmen dhe Ana i tha se kishte qenë e sëmurë. Një javë rresht gishti i tij i qullët që varej në mes të këmbëve, nuk hyri dot në kumbullën e gruas që shikonte hijet e qirinjve në tavan. Një natë, kur ai ishte shtrirë i djersitur dhe i pashpresë në cep të krevatit, Ana u çua dhe i shoi qirinjtë. Në errësirë ai ndjeu një trup lakuriq që u mbështet pas tij dhe ia thau djersët. Lëkura iu freskua dhe qimet iu rritën. Gruaja ishte hapur dhe ai e mbushi me muskuj boshllëkun që i ndante prej një jave. Muskuli u shty me zor dhe dhimbja e Anës ra si një bërthamë kumbulle nga krevati. Pas nëntë muajsh lindi një djalë. Dhe pastaj lindën edhe gjashtë të tjerë, sa herë që Ana i fikte qirinjtë.

Sara bënte dashuri me qirinj të ndezur dhe atyre i kishte lindur një vajzë. Arianiti ishte tallur dhe shtatë djem ishin rreshtuar pas asaj talljeje. Tani secili pre tyre vraponte si lepur në drejtime të ndryshme. Por në fund të rrugës secilin e priste i njëjti çark, siç i kishte ndodhur lepurit me bisht të zi.

Ibrahimi dëgjoi një britmë dhe ktheu kokën. Ishte një zë kafshe që përpëlitej në dëborë. Nuk donte të mendonte më. U çua dhe vrapoi drejt çarkut. Kur hyri në shtëpi shtriu mbi tavolinë dy lepuj dhe një dhelpter të vogël. Jani ua zhveshi lëkurët të treve, ndërsa Sara e gatoi me uthull dhe pilaf njërin nga lepujt. Kur e provoi, Aliu tha se mishi i lepurit të tij ishte më i shijshëm se lepurit që kishte përpara. Muhamedi nuk u çua nga krevati, ndërsa Nikoja futi bishtin e dhelptës poshtë jastëkut dhe nuk e preku lepurin me dorë.

18

Në fund të dhjetorit bëri stuhi. Dëbora e mbuloi furrën në oborr dhe Jani i pastroi ploçat me lopatë që të hapte derën e shtëpisë. Rrugët e fshatit u zunë dhe Ibrahimi nuk doli më për gjah. Natën e Vitit të Ri Sara gatoi lepurin tjetër që, pasi e kishte mbushur me kripë, e kishte mbuluar me lëkurën e vet dhe e mbante në qilar duke i hedhur akull sipër. U ulën të gjithë të hanin, ndërsa Ana Komnena rrinte poshtë duke luajtur me këmbët e tyre nën tavolinë.

Gëzuar Vitin e Ri, tha Sara. Një vit i mbarë, tha Ibrahimi dhe i dha Janit një gotë raki që ai e piu me një frymë për t'i treguar të atit se ishte bërë burrë. Por fyti i dogji aq shumë, saqë sytë iu skuqën dhe iu mor fryma. I dhanë një gotë ujë dhe u qetësua, por oreksi iu pre dhe u zverdh. Nikoja hëngri vetëm petanik me fasule dhe nuk e preku lepurin, ndërsa Aliu e uli Skënderbeun në tavolinë dhe i uroi Vitin e Ri. Muhamedi hante ngadalë, i mbështjellë me batanije. E ftohura e kishte bërë më të menduar dhe tokën e rrumbullakët e mbante në mes të këmbëve të mbuluar me batanije. Natën e Vitit të Ri ka lindur toka, e pyeti ai Sarën. Toka duhet të ketë lindur në verë, tha Niko, sepse në dimër nuk mbijnë pemët dhe lulet. Lumenjtë ngrijnë dhe kafshët flenë e nuk lindin fëmijë. Toka ka lindur në rrëmujë dhe data e lindjes nuk dihet, tha Sara. E si lindi toka në rrëmujë, pyeti Aliu. Në fillim bota ishte si shtëpia jonë para se ta rregullonim, tha Sara. Krevati, sëndukët, qilimat, pjatat, tavolina dhe qirinjtë nuk ishin aty ku janë tani, por prisnin në oborr që ne t'i vinim në vendin e tyre.

Djemtë nuk po kuptonin dhe Sara filloi të tregonte.

Për shumë kohë, bota jetoi në rrëmujë dhe grekët këtë kohë e quajtën Kaos që do të thotë rrëmujë. Nga Kaosi lindi Gjea që do të thotë tokë dhe nga Gjea lindi Urani që është qielli. Nga

Urani lindi Kronosi që do të thotë kohë dhe i cili luftoi me babanë e tij siç bëjnë të gjithë perënditë. Lufta mes Uranit dhe Kronit vazhdoi gjatë, aq sa nuk mund të matet, por Kroni fitoi dhe u bë Zot i botës.

Atij i lindën tre djem: Zeusi, Poseidoni dhe Hadi. Por Kronosit i kishin thënë se koha e tij nuk do të ishte shumë e gjatë sepse njëri nga djemtë e tij do ta vriste për t'i zënë vendin. Kronosi vendosi të vriste fëmijët e tij, të cilët i hante një nga një. Por gruaja e tij e fshehu Zeusin në ishullin e Kretës dhe në vend të tij i dha Kronosit një gur të mbështjellë me pelena dhe ai e hëngri. Pa e ditur, Kronosi e mori Zeusin si shërbëtor në shtëpinë e tij dhe një ditë ky e helmoi duke i hedhur një bar të keq në gotën e verës. Kronosi u shtri i pafuqishëm dhe Zeusi e sulmoi. Lufta ishte e ashpër dhe bota ishte prapë në buzë të Kaosit, por Zeusi thirri në ndihmë të tij dy vëllezërit e vet, Hadin dhe Poseidonin dhe të tre e mundën babanë. Kur fituan, tre vëllezërit e ndanë botën në tre pjesë: Zeusi u bë perëndia e njerëzve dhe zot i rrufeve, i stuhive, i bubullimave, i nxehtësisë dhe i dritës. Poseidoni u bë mbret i detit dhe ishte shumë hakmarrës. Sa herë që nuk i pëlqente ndonjë gjë ai i përmbyste fshatrat dhe qytetet. Vëllai i tretë Hadi mori mbretërinë e të vdekurve dhe u bë perëndia e vdekjes. Kur Zeusi dhe Poseidoni vendosnin të vrisnin njerëz, ata i merrte vëllai tjetër, Hadi. Kështu që Zeusi mbretëronte në qiell, Poseidoni në det dhe Hadi nën tokë.

Sara nuk kishte mbaruar kur Nikoja, për të mos i lënë vëllezërit të zgjidhnin para tij, tha: Unë jam Zeusi, e zgjodha i pari, dhe pa nga Ibrahim i që po shikonte në fund të gotës së rakisë, sikur maste kohën. Unë jam Poseidoni, tha Aliu, e shkatërroj fshatin kur të dua. Po ti Muhamed çfarë do, e pyeti Jani. Muhamedi që e kishte dëgjuar Sarën duke u dridhur, rregulloi velenxën mbi supe dhe tha: Të gjithë njerëzit do vdesin një ditë dhe do vinë në mbretërinë time. Unë jam Hadi. Po nëse njerëzit sillen mirë do t'i lësh të dalin nga mbretëria jote, e pyeti Sara. Anën do ta lë, u përgjigj Muhamedi, ndërsa për ju të tjerët do mendojem. Mihalit, gjitonit tonë dhe dajë Llambros nuk do t'i jap leje sepse ata janë zënë me babanë. Petro iku pa leje nga shtëpia, por në mbretërinë time ka një derë shumë më të madhe se dera e shtëpisë sonë. Çelësat e kësaj dëre unë i mbaj vetë dhe Petro nuk do largohet më pa lajmëruar. Ali Tepelenën do ta mbaj përgjithmonë në Had, ndërsa Thanasit do t'i them që, nëse do të kthehet mbi tokë gjatë verës, të ndahet nga Ali Tepelena.

Që kur ishte bërë Had, Muhamedi kishte drejtuar trupin dhe nuk shikonte asnjëri në sy, por shtrëngonte fort tokën e rrumbullakët se mos i ikte nga duart. Po Krishtin pse e le të dilte nga Hadi, e ngacmoi Ibrahim duke qeshur. Muhamedi pa nga Sara i hutuar, sepse nuk dinte si të përgjigjej. Një ditë, ajo i kishte thënë se Krishtin e kishin vrarë në kryq dhe pas tri ditësh ai ishte ngjallur prapë dhe asnjëri nuk e dinte ku kishte shkuar. Krishti iku pa leje sepse e ndihmoi Zeusi, por pas tri ditësh e gjeta dhe e futa prapë në Had, tha Muhamedi. Po çfarë bëri Krishti për tri ditë, pyeti Aliu. Ndoshta u kthye të takojë gruan, tha Niko. Krishti nuk ishte i martuar, tha Jani duke e parë Nikon me inat. Ndoshta ishte, tha Sara, por kjo nuk dihet mirë sepse historitë e jetës së tij janë shkruar shumë vjet pasi ai u zhduk dhe ata që i shkruan nuk i dinin të gjitha ose nuk kanë dashur t'i tregojnë të gjitha. Pse nuk kanë dashur t'i tregojnë të gjitha, pyeti Niko. Sara pa nga Ibrahim i që rrinte i menduar në krye të tavolinës dhe shtrëngonte gotën e rakisë në dorë. Sepse po t'i tregonin të gjitha, Krishti do t'i ngjante gjithë burrave të tjerë që lindin nga martesat e prindërve të tyre, martohen me gra, bëjnë fëmijë me to dhe kur vdesin e kanë një varr. Ata donin që Krishti të mos i ngjante asnjë burri përpara tij dhe prandaj ai nuk ka lindur nga babai i tij, nuk është martuar, nuk ka fëmijë dhe nuk ka varr, tha Sara, e cila fliste ngadalë sikur po bënte një meshë. Në qoftë se këto janë të vërteta, Krishti duhet të ketë qenë një njeri shumë i vetmuar, tha Muhamedi, sepse një njeri që nuk ka fëmijë nuk ka si e shtyn kohën. Krishti nuk ishte një njeri si

ne të tjerët, ai ishte biri i Zotit, ndërhyri Jani me zë të rreptë. Zoti e solli në tokë që t'i tregonte njerëzve se çfarë duhet të bënin duke ndjekur rrugën e Krishtit dhe ne duhet ta nderojmë sakrificën e tij. Po, nëse martohesh, nuk je në rrugën e Krishtit, pyeti Niko. Jo, tha Sara, Krishti nuk i tha askujt që nuk duhet të martohet. Edhe unë do martohem, tha Niko, sepse gratë duhen për të bërë bukë dhe fëmijë. Sara qeshi dhe Ibrahim i ktheu pak raki. Djemtë rrinin të menduar, ndërsa Ana i mori Muhamedit tokën e rrumbullakët dhe ai nuk e kundërshtoi.

Po Muhamedi ka qenë i martuar, pyeti Jani duke parë nga Ibrahim. Muhamedi ka pasur shumë gra dhe sillej mirë me to, tha Ibrahim. Shokët e Muhamedit paskan qenë spiunë, tha Aliu. Ata i treguan njerëzve që Muhamedi kishte shumë gra, kurse shokët e Krishtit nuk i thanë njeriu. Muhamedi nuk ishte djali i Zotit, tha Sara dhe atij i lejohej të bënte si gjithë njerëzit e tjerë. Atij i fliste Zoti në vesh dhe i thoshte se çfarë duhet të bëjë një njeri që të quhet i mirë dhe çfarë nuk duhet të bëjë që të mos quhet i keq. Po fëmijë kishte Muhamedi, pyeti Aliu. Kishte dhe djem dhe vajza, u përgjigj Ibrahim. Po varr ka, ngulmoi Aliu. Ka varr si gjithë të tjerët dhe vdiq nga pleqëria, tha Ibrahim duke parë në sy Muhamedin që e kishte mendjen tek Ana, e cila e përplasi fort tokën përtokë. Zoti paska dashur më shumë Muhamedin se Krishtin, tha Niko, sepse Muhamedi ia paska dhënë të gjitha: edhe gra, edhe fëmijë, edhe një varr ku ta qajnë, kurse Krishtin e paska torturuar. Nuk e ka torturuar, por e ka marrë pranë vetes, ndërsa Muhamedin e la në tokë për t'i treguar njerëzve se atë nuk e do sa Krishtin, tha Jani. Përderisa ka një varr dhe ka jetuar si gjithë njerëzit e tjerë Muhamedi nuk e provon dot se Zoti i fliste në vesh dhe i jepte urdhra, tha Muhamedi duke parë nga i ati. Edhe unë mund të bëj sikur dikush më flet në vesh dhe t'ju urdhëroj ju që të më bindeni në emër të Zotit. Ti nuk je gënjeshtar, bëri shaka Ibrahim.

Muhamedit dikush i flet në gjumë, tha Aliu duke u ngritur në këmbë sikur po thoshte diçka me rëndësi. Të gjithë panë nga Muhamedi që nuk u duk i mërzhitur nga fjalët e të vëllait. Kush të flet në gjumë Muhamed, e pyeti Sara. Jam në gjumë dhe nuk ia kam parë fytyrën, tha Muhamedi, por nuk besoj se është Zoti se kur ai më flet unë nuk kam frikë. Edhe në qoftë se është Zoti, nuk duhet të kesh frikë, tha Ibrahim që po e shikonte të birin me sy të ngulur. Njerëzit e kanë frikë Zotin se po të mos e kishin frikë nuk do ta dëgjonin, u përgjigj Muhamedi dhe ul nën tavolinë dhe mori tokën e rrumbullakët. Anën e kishte zënë gjumi mbi qilim. Sara e mori në krahë dhe e çoi në krevat.

Të gjithë në gjumë, tha Ibrahim duke u çuar nga tavolina. Është vonë dhe ka ardhur Viti i Ri. Shkojmë të çlodhemi, tha Muhamedi, këtë vit do ndërtojmë shtëpi. Jani e pa si i hutuar, i tha natën e mirë Ibrahimit dhe shkoi në shtrat duke i marrë vëllezërit me vete. Kur u shtri, Ibrahim e pyeti Sarën se pse i kishte thënë djemve se Krishti mund të kishte qenë i martuar. Ata po rriten dhe nuk kanë pse besojnë çdo përrallë që dëgjojnë, tha Sara. Shuaji qirinjtë, i tha Ibrahim duke qeshur. Nuk të mjaftojnë gjashtë djem, ia ktheu Sara duke e parë me bisht të syrit. U fut nën velenxë dhe trupi i Ibrahimit e ngrohu menjëherë. Qirinjtë u dogjën duke parë njëri-tjetrin, deri në mëngjes.

19

Dëbora e mbajti fshatin të pushtuar deri në fund të shkurtit. Ibrahim shkoi edhe dy herë për gjah, por kafshët ishin mësuar me hilet e çarkut të tij dhe nuk i afroreshin më patateve dhe mishit të ftohtë. Gjatë ditës, djemtë luanin në dhomën e tyre dhe në darkë i kërkonin Sarës t'i tregonte histori me perëndi. Sara i tregoi për Akilin e pavdekshëm që kishte mundur trojanët dhe që ishte vlarë nga një shigjetë në thembër. Po ai ishte i pavdekshëm, pyeti Niko, si iu ngul shigjeta në thembër? Akili ishte bir i perëndisë dhe kur lindi ai e ëma, që e donte shumë, vendosi ta bënte të

pavdekshëm. E çoi në Had dhe e futi në ujërat e lumit të Hijeve, por, kur e zhyti, e mbajti nga thembra që djalin të mos e merrte lumi. Trojanët e dinin që ai mund të vritej vetëm në thembër dhe aty ia ngulën shigjetën.

Akili duhet të ketë qenë me sandale ditën që e vranë, tha Niko. Troja është një vend i nxehtë dhe aty nuk ka dimër si këtu te ne, tha Sara. Dua të jem Akili, thoshte Aliu, por nuk do vesh asnjëherë sandale. Kush e vrau Akilin, pyeti Niko, Akili u vra nga Paridi, u përgjigj Sara, e cila duhet të fillonte një rrëfim të ri sa herë që në rrëfimin e mëparshëm dilte emri i një heroji të ri. Paridi ishte djali i mbretit të Trojës. Para se të lindte, e ëma pa në ëndërr sikur djali që do të lindte do ta shkatërronte Trojën. Kur lindi Paridi, i ati, që e kishte besuar ëndërrën, e dëboi nga qyteti dhe djali u rrit në pyll dhe u bë shumë i bukur. Një ditë tre perëndeshat kryesore greke: Athina – perëndesha e drejtësisë, Afërdita – perëndesha e bukurisë dhe Hera – perëndesha e fuqisë bënë një garë bukurie. Zeusi që i kishte vajza, Athinën dhe Afërditën dhe grua Herën nuk donte të zgjidhte vetë dhe vendosi që burri më i bukur në tokë të përcaktonte kush ishte më e bukura mes perëndive. Burri më i bukur ishte Paridi, të cilit Zeusi i dha një mollë të kuqe.

Kështu, një ditë, të tre perëndeshat shkuan te Paridi dhe i kërkuan mollën. Athina i premtoi se në qoftë se do t'ia jepte asaj atëherë Paridi do t'i fitonte të gjitha luftërat. Hera i premtoi ta bënte mbretin më të madh të botës, ndërsa Afërdita i premtoi gruan më të bukur të botës. Paridit i pëlqeu premtimi i Afërditës dhe ia dha asaj mollën, kurse ajo e martoi me Helenën. Kjo mollë u quajt molla e shërrit sepse pas saj filloi lufta e trojanëve me grekët.

Unë dua të jem Paridi, tha Niko. Do marr gruan më të bukur në fshat dhe do vras Akilin. Aliu, i nxehur, shkoi në dhomë, e mbështolli thembrën e tij me lecka dhe dy djemtë filluan të luftojnë. Ana luante me trekëndësha, ndërsa Muhamedi i mbuluar me batanije rrinte pranë zjarrit. Po Ana ka qenë perëndeshë, pyeti ai Sarën. Ana Komnena ka qenë princeshë, tha Sara. Djemtë i kërkuan t'i tregonte historinë e Anës dhe Sara, pasi i hodhi dru zjarrit, filloi të fliste. Jani zbriti në qilar, ndërsa Ibrahim i u ul në krye të tavolinës dhe dëgjonte.

Ana Komnena ka jetuar në Bizant. Bizanti ishte perandoria më e madhe në botë për një mijë vjet. Bizanti shtrihej në të gjitha tokat e grekëve dhe të shqiptarëve, por edhe në Afrikë dhe Azi. Perandorët e Bizantit në fillim qëndruan në Romë dhe ishin romakë. Por Roma sulmohej nga fise njerëzish të pafe dhe Kostandini, një perandor që kishte lindur në Shqipërinë e asaj kohe, vendosi të ndërtonte një qytet të madh larg Italisë, ku të pafetë nuk shkonin dot. Ai zgjodhi një vend shumë të bukur mbi det ku themeloi qytetin e tij që u quajt Kostandinopojë. Ky qytet tani është Stambolli, sepse turqit kur e pushtuan ia ndryshuan emrin. Përpara një beteje të madhe, Kostandini pa në ëndërr një kryq dhe ai vendosi të bëhet i krishterë dhe pas tij i gjithë Bizanti u bë i krishterë derisa erdhën turqit. Pas Kostandinit, perandoria pati shumë luftëtarë dhe shumë perandorë, Ana Komnena ishte vajza e perandorit dhe ka lindur shtatëqind vjet më parë në vitin 1083, dy vjet pasi babai i saj Aleks Komneni u shpall perandor. Ana mori emrin e gjyshes së saj Ana Dalasena.

Qysh kur lindi, nëna e saj tha se Ana duhej të bëhej perandoreshë e Bizantit. Kur ishte katërmbëdhjetë vjeç prindërit e martuan Anën me një gjeneral të shquar. Ana Komnena e vogël nuk donte të martohej dhe një muaj nuk doli nga dhoma e saj ku qante dhe urrente të atin që e martoi me një plak. Kur babai i saj, Aleks Komneni u sëmur, perandoresha bashkë me Anën menduan të merrnin fronin, mirëpo vëllai i Anës, Jani, u tregua më i zgjuar dhe shkoi në shtratin e babait ku i mori unazën perandorake dhe bekimin për t'u bërë perandor. Ana dhe e ëma u mbyllën në një manastir ku mbetën deri në fund të jetës ku ajo filloi të shkruajë historinë e luftërave të babait të saj dhe ky libër u quajt Aleksjada, sipas emrit të Aleks Komnenit. Ana

Komnena vdiq në ishullin Lesbos, por varri i saj nuk dihet me saktësi. Pesëdhjetë vjet më vonë, Komnenët u larguan nga Kostandinopoja dhe qyteti u pushtua nga kryqtarët në kohën kur perandori ishte një nip i saj. Një Komnen tjetër, nip i Ana Komnenës, shpëtoi nga vdekja në Kostandinopojë dhe erdhi në Janinë ku u bë princ i madh. Nga kjo degë e Komnenëve është Arianit Komneni i Madh, i cili luftoi turqit në vitet 1400 dhe pastaj martoi vajzën e tij Donikën me Skënderbeun. Babai im, Arianit Komneni është stërnip i Arianit Komnenit të Madh.

Unë e mbaj mend Arianit Komnenin, tha Jani që i kishte hedhur dru zjarrit që digjej në flakën e vet. Si ishte, e pyeti Niko. Ishte i madh dhe me flokë të bardha të gjata, tha Jani. Një ditë, Thanasi më mori me vete te shtëpia e tij dhe Arianiti që hante arra të thata në oborr më dha një arrë. Por unë nuk e çaja dot dhe Arianiti e vuri mbi një pllloçe dhe e çau duke i rënë me dorë. Po ti baba e ke njohur Arianit Komnenin, pyeti Muhamedi. E kam njohur, tha Ibrahimimi që rrinte i menduar. Po ty çfarë të tha, pyeti prapë Muhamedi. Ibrahimimi pa Sarën në sy sikur ta pyeste në duhej ta vazhdonte këtë bisedë apo jo. mua më mësoi si bëhen djemtë, tha Ibrahimimi. Po pse ti nuk e dije, pyeti Niko. Ibrahimimi vuri buzën në gaz dhe iu kujtua nata e parë e dasmës. Nuk e dija mirë se isha i ri, tha, por Arianiti kishte tre djem dhe e dinte më mirë se unë. E si bëhen djemtë, pyeti Muhamedi. Po ta thashë tani, do ta harrosh. Kur të rritesh do ta mësoj, i tha Ibrahimimi, por Muhamedi u mbështoll fort me batanije dhe tha: Unë e di si bëhen, por mësoja Aliut. Aliu dëgjonte bisedën me vëmendje dhe kur iu përmend emri ngriti kokën drejt Ibrahimimit sikur priste të dëgjonte formulën mashkullore të Arianit Komnenit. Por Ibrahimimi nuk foli dhe Aliu i tha: Po kur lindi Ana ti e kishe harruar atë që të mësoi Arianiti?

Sara filloi të qeshte dhe mori Anën në prehër. Nuk e kam harruar, tha Ibrahimimi. Kur lindi Ana unë kisha gjashtë djem dhe doja një vajzë. Po si bëhen vajzat, kush ta mësoi, vazhdoi Aliu. Nuk ia mësoi asnjëri, tha Sara. Kur do vajza duhet të bësh të kundërtën e asaj që tha Arianiti. Jani rrinte i ngrysur. Ishte më i madhi nga djemtë dhe dinte më shumë nga ata. Biseda po e vinte në siklet sepse Ibrahimimi dhe Sara e dinin që ai nuk bindej nga formula e Arianitit. Ana e ka marrë emrin e nënës sonë, tha Jani duke ndërruar bisedën. Jo, tha Muhamedi, Ana ka marrë emrin e Ana Komnenës sepse edhe ajo quhet Ana Komnena. Të gjithë ne kemi mbiemrin e babait, ndërsa Ana ka mbiemrin e Sarës. Ibrahimimi lëvizi këmbët nën tavolinë. Mbiemri i vajzës gjithmonë e kishte vënë në vështirësi. Kur Ana lindi dhe u regjistrua në kishë, prifti e kishte pyetur për mbiemrin dhe Sara i kishte thënë se vajza quhej Ana Komnena. Nuk do marë mbiemrin e të atit, kishte pyetur prifti me zë të ulët, që dukej se kjo gjë i pëlqente. Ibrahimimi nuk kishte folur dhe prifti e kishte shkruar mbiemrin sipas Sarës. Familja ime nuk po ndahet vetëm në myslimanë dhe të krishterë, por edhe në emra, mendoi me vete, ndërsa djemtë prisnin një përgjigje. Ata e dinin që motra e tyre kishte një mbiemër tjetër, por kurrë nuk e kishin pyetur Ibrahimimin se pse ishte kshtu. Ibrahimimi e pa Sarën me inat dhe iu duk sikur ajo e kishte treguar historinë e Ana Komnenës së Bizantit për ta vënë në vështirësi përpara djemve. Ana ka emrin e nënës suaj, ndjesë pastë, foli Sara duke i parë djemtë me qetësi. Sytë e zinj i shkëlqenin nga zjarri, por Ibrahimimi mendoi se historia e familjes e kishte ndezur edhe më tepër. Nëna juaj ka qenë një grua shumë e mirë dhe e dashur, e cila rriti shtatë djem, por gjithmonë kishte dashur të kishte edhe një vajzë. Ajo u sëmur dhe nuk lindi më dhe unë besoj se ka ikur nga kjo botë duke pasur një brengë, që nuk solli dot në jetë një motër për djemtë e saj. Babai e ka dashur shumë atë dhe kur lindi Ana më kërkoi që ajo të merrte emrin e nënës suaj. Unë pranova sepse edhe unë e kisha njohur Anën. Kur isha e vogël dhe rrija në shtëpinë e Hanës dhe të xhaxhait tuaj Vasilit, ajo vinte shpesh dhe më mësonte si të qëndisja me grep. Po Ana pse mori mbiemrin Komnena, pyeti Aliu. Kur babai im iku nga fshati unë mbeta e vetmja Komnenë nga dega jonë. Dy vëllezërit e mi kanë ikur dhe

nuk e di në do kthehen më. Unë i thashë babait tuaj se fëmija që do lindë duhet të marrë mbiemrin tim në mënyrë që dera jonë të mos shuhet. Babai pranoi dhe ju sot keni një motër të vogël, tha Sara duke parë Ibrahimin në sy. Po në qoftë se babai nuk pranonte, pyeti Niko. Unë nuk do martohesha me babanë tuaj, tha Sara, dhe tani do kisha ikur të gjeja babanë tim. Po babai do martohet me një grua tjetër, pyeti Aliu, por Sara ngriti supet dhe buzëqeshi. Kur nëna vdiq, ju ishit të vegjël dhe kishit nevojë për një grua që t'ju rriste dhe t'ju ushqente, foli Ibrahim, me sytë ulur mbi tavolinë. Thanasi erdhi një ditë në fshat dhe më kërkoi të martohesha me Sarën, që ai e kishte pasur shoqe kur ishin të vegjël. Unë nuk ia prisha Thanasit dhe ju u bëtë me një nënë dhe me një motër që nuk i kishit. Jani u ngrit të rregullonte zjarrin, ndërsa Aliu iu afrua Ibrahimit dhe iu ul në peqi. Mirë bëre, tha Muhamedi. Sara gatuan shumë mirë dhe na tregon histori që asnjë grua tjetër në fshat nuk i di, sepse gratë nuk lexojnë. Po babai yt ku ka shkuar, pyeti Niko duke u afruar nga Sara. Babai iku nga fshati kur Ali Tepelena mori Thanasin dhe ia ndryshoi emrin vëllait tim Gjergjit që e quajti Ismail. Ai nuk tha ku do shkonte, por më tha që kur të rritesha unë do ta kuptoja vetë se ku ka shkuar dhe do ta gjeja një ditë.

Po tani që je rritur e ke kuptuar, pyeti Muhamedi. Nuk jam rritur akoma aq sa duhet, tha Sara dhe shkoi në dhomë për të vënë në gjumë Ana Komnenën që po kotej në duart e saj. Ibrahim dhe djemtë mbetën vetëm. Baba a do iki Sara të gjejë Arianitin kur të rritet, e pyeti Niko, me zë të ulët që Sara mos ta dëgjonte. Ajo nuk do të iki pa u rritur Ana dhe ju, tha Ibrahim. Por edhe në qoftë se do të iki do të kthehet prapë. Kur djemtë shkuan të flenë, një copë herë nuk i zuri gjumi. Aliu nuk pranoi ta zgjidhte leckën që kishte lidhur pas thembrës, ndërsa Muhamedi tha: Sara do iki sepse ajo e di ku është babai i saj. Do ta marrë dhe Anën me vete, e pyeti Niko.

Jo, tha ai, Ana Komnena do rrijë këtu.

20

Në fillim të marsit dëborë nisi të shkrinte. Akujt u lëngëzuan mbi çatitë që kullonin si çezma. Fshati u mbush me baltë e megjithatë Aliu nuk e hoqi leckën e Akilit nga thembra. Kur hynte në shtëpi, lecka linte një gjurmë kafe pas vetes dhe ai e afronte këmbën pas vatrës që balta të thahej. Sara mezi e bindi një ditë që ta hiqte leckën duke i thënë se Akili i hiqte pajimet e luftës kur flinte. Rrugët u hapën dhe Ibrahim shkoi në qytet për të shitur bagëti. Ai merrte me vete edhe Janin, i cili një ditë i tregoi se në Janinë kishte takuar Thanasin, i cili mbante një pishqollë në brez dhe kur ecte njerëzit e kishin frikë. Pylli ishte kthyer prapë në ngjyrën e tij jeshile dhe zogjtë kishin nisur të zgjonin Anën që në mëngjes. Një natë, kur ata kishin rënë për të fjetur, dera e shtëpisë trokiti fort dhe Ibrahim u ngrit të shihte. Kur u kthye, i tha Sarës se Mihali, komshiu i tyre, kishte vdekur. Qysh se i vdiq gruaja Zoica, Mihali nuk dilte shumë nga shtëpia. I biri i tij, Aleks, merrej me tokat, blinte ushqime dhe Mihali gatuante për të dy. Gjatë muajve të dëborës, Mihali nuk ishte parë fare. Aleks që lajmëroi fshatin për vdekjen e të atit tha se ai kishte marrë një të ftohtë dhe javën e fundit villte gjak. Ditën që Mihali u varros, Aleks dhe thirri Ibrahimin në oborr dhe i tha se ai donte të ikte në qytet dhe ta shiste shtëpinë. Nuk kam çfarë të bëj më këtu, i tha Aleks Ibrahimit që e shikonte i çuditur. Do shes shtëpinë dhe do shkoj në Janinë të zë një punë dhe një grua. Ibrahim u fut brenda dhe pyeti Sarën. Blije, tha Sara, djemtë po rriten dhe kur të martohen këtu nuk ka vend për katër nuse. I bashkojmë dy shtëpitë dhe bëjmë një shtëpi më të madhe. Pas disa ditësh, Ibrahim u mor vesh me Aleksin për çmimin. Ky mori paratë, bëri të shtatat e Mihalit dhe iku.

Kur hyri në shtëpinë e Mihalit, Sara i mori çarçafët, jastëkët, perdet, rrogzat dhe rrobat e vjetra të Mihalit dhe Zoicës dhe i dogji në oborr. Një qilim të madh që Zoica e shtronte për pashkë në

dhomën e bukës dhe që kishte disa katrorë të verdhë të mbushur me katrorë më të vegjël me ngjyra të tjera, Sara e lau dhe, pasi e shkundi fort me okllai, e nderi të thahej mbi plloça. Ibrahimimi e prishi gardhin që ndante dy shtëpitë dhe dy oborret u bashkuan.

Shtëpia e Mihalit ishte e para shtëpi që shitej në fshat. Familja e Ibrahimit dhe ajo e Mihalit kishin jetuar si gjitonë qysh se stërgjyshi i Ibrahimit erdhi në fshat nga Suli. Ndërsa familja e Mihalit kishte ardhur në fshat nga një fshat tjetër nga i cili i kishin përzënë kur stërgjyshi i Mihalit kishte rrëmbyer një vajzë, me të cilën pastaj ishte martuar. Pleqësia e fshatit tjetër iu lut babait të Arianit Komnenit që të mos e pranonte në fshatin e tij stërgjyshin e Mihalit. Por ishte koha e Kretës dhe babait të Arianitit iu deshën burra për në luftë. Stërgjyshi i Mihalit kishte një vëlla më të vogël që babai i Arianitit ia kërkoi për ta nisur në Kretë. Ai pranoi dhe babai i Arianitit i dha një copë tokë nga të tizat në gjysmën e së cilës stërgjyshi i Mihalit ndërtoi shtëpinë. Aty kishin lindur babai i Mihalit, një vëlla më i vogël dhe një motër. Kur familja e Ibrahimit erdhi nga Suli, stërgjyshit i pëlqeu ai vend në cep të fshatit ngjitur me shtëpinë e Mihalit. Ia kërkoi tokën ngjitur stërgjyshit të Mihalit, por ai nuk deshë t'ia jepte. Babai i Arianitit i thirri të dy dhe i tha se, meqë djemtë e të dyve kishin vdekur në Kretë, ata duhej të ishin gjitonë, në kujtim të tyre. Stërgjyshi i Mihalit nuk u bind dhe babai i Arianit Komnenit i kujtoi se tokën ia kishte dhënë ai dhe po ashtu mund t'ia merrte. Megjithatë, stërgjyshi i Mihalit i kërkoi para stërgjyshit të Ibrahimit. Ky ia dha dhe aty ndërtoi shtëpinë. Familjet ishin të ftohura, por kur xhaxhai i Mihalit vrau vëllanë e gjyshit të Ibrahimit, sepse të dy u dashuruan me gjyshen e Hanës, për pak kaluan në gjak. Ndërhyri prapë babai i Arianitit dhe i pajtoi duke e dëbuar përgjithnjë nga fshati xhaxhanë e Mihalit. Gjakrat u ftohën, por nuk u harruan. Familjet nuk shkonin dhe nuk vinin te njëra-tjetra. Pasi Ibrahimimi e liroi Mihalin, ata nuk folën, megjithëse e ndihmuan njëri-tjetrin gjatë muajve të kolerës. Ibrahimimi e kishte ndihmuar Mihalin kur u sëmur Zoica, por nuk pranoi të mjekonte familjen e vëllait të Mihalit, i cili kishte dashur ta vriste kur ai u bë mysliman. Pasi vdiq Zoica, djali i madh i Mihalit, të cilit i kishte vdekur vajza e sapolindur, iku nga fshati. Bashkë me të shkoi edhe vëllai i Mihalit, të cilit i kishte vdekur gruaja dhe jetonte vetëm.

Ibrahimimi nuk kishte hyrë më në atë shtëpi që kur kuronte Zoicën nga kolera. Kur hyri në shtëpinë që kishte blerë, ajo iu duk e vjetër. Ka tre vjet që këtu nuk ka pasur dorë gruaje, i tha Sara që po shkundte gjithë shtëpinë nga pluhurat dhe pezhishkat. Ibrahimimi mori dru, ndezi vatrën dhe u ul përballë zjarrit. Pse e ndeze atë zjarr, e pyeti Sara. Të djeg sëmundjet e kësaj shtëpie, tha Ibrahimimi dhe filloi të mendohej përballë zjarrit që lëpihej mbi muret e ftohta. E kemi blerë dy herë këtë shtëpi, i tha Sarës, një herë stërgjyshi dhe tani unë.

Shtëpia kishte një dhomë buke dhe tre dhoma më të vogla. Sara i pastroi të gjitha dhe i tha Ibrahimit se shtëpitë duhej të bashkoheshin që të dukej si një shtëpi e madhe. Po kur të martohen djemtë, si do t'i ndajnë, e pyeti Ibrahimimi. Do prishim derën që i bashkon dhe do bëjmë një mur, por shtëpia do mbetet një dhe kjo do t'i mbajë vëllezërit të bashkuar, tha Sara. Kur djemtë erdhën të shikonin shtëpinë e re, Aliu i tha Ibrahimit se kjo shtëpi nuk i pëlqente dhe se ai do rrinte gjithmonë në shtëpinë e vjetër. Do t'i bashkojmë, tha Ibrahimimi dhe do bëjmë një shtëpi më të madhe me një dhomë për secilin nga ju. Nuk do kemi dy shtëpi, por një shtëpi të madhe. Unë e dua dhomën time të shtëpia e vjetër, këmbënguli Aliu. Si do t'i bashkosh baba, e pyeti Niko. Do afrojmë pullazet dhe do shtojmë një dhomë në mes të dy shtëpive, tha Ibrahimimi. Atëherë do ketë një dhomë edhe për Thanasin, tha Niko. Unë dua të rri në një dhomë me Thanasin dhe kur ai të flejë unë do mbaj pisqollat poshtë jastëkut. Shtëpia do ketë shumë dhoma dhe ka vend për të gjithë, edhe për Petron, edhe për Thanasin, tha Jani. Të thashë se këto dy shtëpi do bashkohen, i tha Muhamedi. Jani e shikoi me sy të shuar dhe doli jashtë.

Në prill, Ibrahimimi shkoi në një fshat disa orë larg dhe foli me usta Naumin për shtëpinë e re. Naumi kishte punuar me Arianit Komnenin për ndërtimin e kishës së fshatit. Ai i tha Ibrahimimit se deri në fund të majit nuk mund të vinte sepse po punonte në Janinë për të zgjeruar një kishë, buzë liqenit. Unë bëj kisha, i tha Naumi, por tani ndërtohen më shumë xhami dhe puna ka rënë. Ne e kemi një kishë në fshat dhe na duhen shtëpi, i tha Ibrahimimi.

Në fund të majit, Naumi erdhi në fshat bashkë me djalin e tij Andrean. Ibrahimimi i tregoi dy shtëpitë dhe i tha se donte t'i bashkonte për të bërë një shtëpi më të madhe. Kjo shtëpi është më e lartë se shtëpia jote, tha Naumi duke mbledhur një spango me të cilin i biri kishte matur murin, nga rrëza deri në majë të plloçave të çatisë. Duhet ta shkurtoj njërën ose të zgjas tjetrën që të duket si një shtëpi. Ibrahimimi pa nga Sara. Ne duam ta zmadhojmë shtëpinë dhe jo ta zvogëlojmë. Mbaj lartësinë e shtëpisë së re dhe zgjat shtëpinë tonë, tha Sara. Bëhet, por ka më shumë punë, foli ustai duke parë Ibrahimimin. Sa kohë do, pyeti Ibrahimimi. Në qoftë se nuk bien shira, në shtator mbaron, tha Naumi.

Të nesërmen, Sara i mblodhi të gjitha plaçkat. Sëndukët, qilimat, perdet dhe enët i çoi në shtëpinë e re, ku u vendos të rrinin përkohësisht. Tavolinën e madhe të bukës, dera e shtëpisë së re nuk e nxinte dhe Ibrahimimi me Janin e vunë në oborr dhe Sara e mbuloi me rrogoza të vjetër. Krevatet e djemve u hoqën dhe u futën në dy dhoma, ndërsa në dhomën tjetër Sara solli krevatin e saj të hekurit bashkë me perdet dhe qilimat. Niko tha se donte të flinte me Janin, ndërsa Aliu me Muhamedin morën Skënderbeun, breshkën dhe tokën katrore dhe i strehuan në dhomën tjetër. Oborri filloi të mbushej me plloçat që Andrea dhe Jani i hoqën një nga një nga shtëpia e Ibrahimimit dhe i rreshtuan përtokë. Duhet ta prishim furrën, i tha Naumi, Ibrahimimit, sepse është në mes të dy oborreve dhe na pengon. Andrea i ra me qysqi furrës dhe ajo u thërrmua, si bukë e thekur. Do bëjmë një të re, mendoi Ibrahimimi dhe në hundë i erdhi era e lakrorit me fasule që Sara kishte pjekur atë mëngjes. Naumi dhe Andrea rregulluan një qoshe në dhomën e Sarës dhe Ibrahimimit që shikonte nga arra e vogël dhe fjetën atje. Ata punonin gjithë ditën duke rrëzuar mure, duke matur, dhe duke thyer gurë që Andrea i fuqishëm i mbante me lehtësi në majë të shkallëve, aq sa djemtë habiteshin. Kush është më i fortë, Andrea apo Thanasi, pyeti Niko. Thanasi i përdor muskujt për njerëzit, ndërsa Andrea për gurët, tha Jani duke hipur në majë të çatisë.

Qershori ishte i nxehtë dhe Andrea punonte i zhveshur. Djersët i binin mbi lëkurën e nxirë nga dielli dhe trupi i tij dukej si një statujë bronzi mbi shtëpi. Naumi e drejtonte nga poshtë dhe i thoshte ku duhet të ngulte trarët e rinj, mbi të cilat më pas do viheshin plloçat. Në mes të oborrit, Naumi gërmoi me lopatë një gropë të madhe ku ziente gurë të thërrmuar që i bënte gëlqere. Jani i merrte me një kovë, hipte mbi shkallë dhe Andrea i lyente gurët dhe mbi ta vinte gurë të tjerë.

Perimet që Sara kishte mbjellë një vit më parë në një pjesë të oborrit ishin shkelur dhe Sara i tha Ibrahimimit ta rrethonte me plloça bahçen e saj të vogël që domatet, patatet, qepët dhe kastravecët që mos prisheshin. Kur muri filloi të ngrihej nga perëndimi, një gur i ra Andreas nga dora dhe i theu arrës së vogël një degë të njomë. Ibrahimimi e ngriti si një foshnjë dhe Sara i tha ta vinte në një vazo që kur të mbaronte shtëpia të mbillnin një arrë tjetër në pjesën e djemve. Ibrahimimi mori një enë të madhe balte, e mbushi me dhe, nguli degën e thyer dhe e la në diell.

Në fillim të korrikut muret e dy shtëpive ishin në një lartësi. Ibrahimimi e shikonte shtëpinë si rritej çdo ditë nga pak dhe i tha Sarës se kur të mbaronte kjo do ishte shtëpia më e madhe në fshat. Ke gjashtë djem dhe një vajzë, tha Sara, gjithmonë do të të duket e vogël. Nuk jemi gjashtë djem, tha Muhamedi. Petro nuk do të kthehet se këtu nuk ka det. I ati nuk e dëgjoji, ndërsa Niko e pa



me inat dhe i tha: Ti do që të gjithë ne të ikim dhe shtëpinë ta kesh për vete. Jo, iu përgjigj Muhamedi, ti do ikësh vetë nga kjo shtëpi.

Kur Andrea vendosi plloçat e para mbi skeletin e trarëve, filloi shiu. Sara me Ibrahimin e mbuluan tavolinën me plloça të mëdha, të cilat i shtrinë mbi rrogoz, ndërsa Naumi me Andream u futën në shtëpi dhe mbuluan me katrama vendin ku flinin. Shirat vazhduan dhe të nesërmen dhe puna u ndërpre. Nuk do ta kapim dot shtatorin, tha Ibrahim dhe shkoi të bisedonte me Naumin. Po shkojmë disa ditë në fshat. Kthehemi sa të pushojë shiu, tha Naumi dhe bashkë me Andream u nisën që pa gdhirë. Shtëpia pa çati e fuste ujin nga të gjitha anët dhe natën kur frynte erë, muret ia përcillnin zhurmën njëri-tjetrit si një kor kishe. Oborri, i mbushur me plloça, drurë, gurë të thyer, çekiçë, vegla, mistri, shkallë dhe plot mbeturina që kishin mbetur nga ndërtimi, i ngjante legjendës së Kaosit që Sara u kishte treguar djemve. Shiu u plotësoi rrëmujën e oborrit duke hapur gropa me baltë gjithandej. Ibrahim u mbyll në dhomë dhe prej andej shikonte retë e zeza mbi shtëpi që dukeshin sikur mbanin radhë për t'u hedhur në një pus. Jani shkoi në qilarin e shtëpisë së vjetër, mori një copë dru dhe filloi të gdhendë një shtëpi të madhe që do t'i ngjante dy shtëpive kur ato të bashkoheshin. Shtëpinë e re ktheje nga dielli, i tha Niko. Do ta kthej nga deti që ta shohë Petro, i tha Jani dhe e futi daltën thellë në dru, sikur po kërkonte ujë në tokë. Para se të flinin, Aliu e pyeti Muhamedin se kur do të mbaronte shiu sepse ai donte të kthehej në shtëpinë e vjetër. Shiu do pushojë kur të fillojë shkolla, tha Muhamedi dhe u kthye nga muri duke e lënë Aliun të çuditur. Muhamedi ka filluar të flasë prapë me vete, mendoi Aliu dhe fjeti.

21

Sara u zgjua herët në mëngjes sepse iu duk sikur po e thërrisnin. Hapi derën e shtëpisë dhe pa dy burra që po rrinin nën shi. Ishin lagur dhe rrobat i ishin ngjitur pas trupit. Njëri prej tyre ishte i gjatë, me shpatulla të gjera dhe flokë të bardha, saqë Sarës i kujtoi Arianit Komnenin. Tjetri ishte më i vjetër, i dobët dhe supet i kishin rënë edhe më poshtë nga pesha e shiut. Kur e panë, ata nuk lëvizën dhe Sara u afrua. Ti je Sara, e pyeti burri me flokë të bardha. Po, tha Sara, duke e parë në sy. Unë jam Mihal Komneni, vëllai yt, tha burri dhe duke qeshur i afroi kokën e lagur.

Kur hynë brenda, Sara i dha të dy burrave një peshqir për të fshirë flokët. Mihali ia dha peshqirin burrit tjetër dhe i tha Sarës: Është mësuesi im, Metod Antrakidi. I kanë mbetur pak flokë dhe do ma kthejë peshqirin të thatë. Metodi e mbështolli kokën me peshqir dhe mbeti për një çast i mbuluar, si një grua në xhami. Kur hoqi peshqirin, Sarës iu duk si një njeri tjetër. Sytë i kishte bojë qielli dhe rrudhat e shumta i dukeshin si kanale të gjata mbi një bukë të pjekur fort. Lëkurën e kishte të verdhë dhe flegrat e hundës të mëdha dhe të mbushura me qime të bardha. Pasi fshiu kokën, teshtiu fort për të nxjerrë ujin nga hundët dhe i tha Mihalit: Sara duket sikur është vajza jote. Mihali qeshi i përkëdhelur, por Metod Antrakidi ngërdheshi fytyrën sikur ia kishte hedhur tjetrit dhe shtoi: Në të vërtetë i ngjan më shumë gruas tënde. Por Mihal Komneni nuk u mërzi dhe vazhdoi të qeshte duke parë pa pushim Sarën që i rrinte përballë.

Sara nuk e kishte takuar Mihal Komnenin. Kur ajo kishte ardhur në fshat, ai jetonte në Voskopojë. Arianit Komneni thoshte se Mihali ishte djali që i ngjante më shumë, por, ndryshe nga ai, ishte dembel dhe nuk udhëtonte. Mihali e njihte botën nga leximet në Akademinë e Voskopojës ku kishte ikur kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. Pse jeni futur në shtëpinë e Mihalit, e pyeti ai Sarën. Duhet ta dijë që jam martuar prandaj m'u drejtua në shumë, mendoi Sara. E blemë këtë shtëpi dhe vendosëm ta bashkojmë me shtëpinë tonë. Mihali vdiq dhe i biri e shiti se i duheshin para. Metodit i dhembnin kockat dhe kjo do të thotë se shiu do vazhdojë edhe disa kohë. Nuk do hyni dot në shtëpinë e re përpara tetorit, tha Mihali duke parë rreth e rrotull. Kam qenë

në këtë shtëpi. Herën e fundit kam qenë këtu disa ditë përpara se Mihali të martohej me Zoicën. Po Zoica si vdiq, pyeti Mihali. Vdiq nga kolera që ra para tre vjetësh, tha Sara. Në atë kohë vdiq edhe Gjergji. E kam marrë vesh, tha Mihali ftohtë. Do kisha ardhur para tre vjetësh, po të mos mbylleshit në karantinë. I keni gproposur thellë bagëtitë që ngordhën nga kolera, pyeti Metodi Antrakidi. Besoj se po, tha Sara. Burrat e fshatit hapën një gropë të madhe, e spërkatën me disa pluhura, e lyeën me gëlqere dhe atje i hodhën kafshët. Mihali shikonte Sarën dhe ajo priste që ai ta pyeste për Ibrahimin dhe Anën. Përderisa e di që ka vdekur Gjergji duhet të dijë edhe ç'ka ndodhur më pas, mendonte ajo. Por Mihali kishte mbështetur kokën pas murit dhe dukej sikur nuk ishte në dhomë. Metodi Antrakidi, që nuk fliste, rrotulloi sytë nëpër shtëpi dhe pa një kanistër të mbushur me libra. U afrua dhe ngriti njërin. Nxori një palë syze nga xhepi i setrës dhe kur i vuri tha: Aleksia e Ana Komnenës. Di të lexosh, pyeti Sarën. Po, tha Sara. Ka shkollë në fshat, u habit Metodi duke ngritur vetullat mbi syzet e rrumbullakëta. Jo, tha Sara, mua më ka mësuar im atë të lexoj.

Mihali ngriti kokën dhe u përqendrua.

Të tha babai se ku do shkonte, pyeti Sarën me një fytyrë që dukej krejt tjetër nga ajo e mëngjesit. Jo, tha Sara, nuk më tha. Nuk besoj të ketë shkuar në ndonjë manastir megjithëse gjithnjë thoshte se do donte të vdiste në manastir, siç bënin shumica e perandorëve të Bizantit. Babai u hidhërua shumë kur Gjergji u bë mysliman dhe ndoshta ndërroi mënyrën e vdekjes, tha Sara. Arianit Komneni nuk ishte nga ata që ndërronte mendje nga myslimanët, tha Mihali. Edhe po të mos bëhej Gjergji mysliman, ai do gjente një vend të panjohur për të vdekur. Besoj se nuk ka dashur ta shihnin se si do vdiste. Momentet e dobëta të jetës së vet nuk i ka ndarë me asnjëri dhe vdekjen ai e quante një dobësi të pashmangshme. Po ti, e pyeti Sara sikur donte t'i thoshte, a ke ardhur për të vdekur në fshat, por e la pyetjen në mes, sepse Mihali e kuptoi dhe i tha: Unë dhe Metodi kemi ardhur për verim në fshat. Në Janinë bënte vapë dhe erdhëm këtu për t'u freskuar, por nuk e dinim se binte shi. Kur u dogj Voskopoja në 1769, ne ikëm të fundit kur humbën shpresën se do mund ta ringrinim Akademinë dhe mund të rifillonim shtypjen e librave. Nxënësit nuk vinin më në shkollë nga frika dhe tregtarët e pasur firaksën sa në Korçë sa në Rumani dhe Vjenë. Para se të iknim, Metodi ishte i vetmi mësues dhe, kur mërzitej duke folur me vete, më ulte në bankë si para dyzet vjetësh. Ai më pyeste dhe unë përgjigjesha. Për ca kohë shkuam në Korçë, pastaj në Rumani dhe katër vitet e fundit u vendosëm në Janinë. Deri para disa muajsh, Metodi jepte mësim në gjimnazin e qytetit, por e pushuan se u plak.

Fshati nuk ka ndryshuar shumë. Kishën nuk e kisha parë. Sot në mëngjes shkova në shtëpi, por dera ishte e mbyllur. Shkova në shtëpinë e Gjergjit të kërkoja Hanën, por edhe atje nuk kishte njeri. Hana ishte në shtëpinë e burrit. Ajo më tha se kyçet e shtëpisë sonë i mban ti. Do rrini aty, e pyeti Sara. Prandaj kam ardhur, tha Mihal Komneni.

Sara u ngrit e shkoi në dhomën e gjumit. Hapi një nga sëndukët që kishte marrë nga shtëpia e Arianit dhe mori tre kyçe, të cilët, nga vapa, ishin ngjitur. Kur Sara i nxori në dritë, ata u ndanë nga njëri-tjetri dhe u lëshuan si të çliruar. Ibrahim i që ishte zgjuar, po luante me Ana Komnenën. Ka ardhur njeri, e pyeti. Ka ardhur im vëlla, Mihali. Ibrahim i e pa sikur ta pyeste çne, por Sara i tha të rrinte shtrirë se Mihali do ikte pas pak në shtëpinë e Arianit. Janë shumë tre kyçe për një shtëpi të braktisur, tha Mihali kur mori kyçet që i dërsitën dorën. I pari është i derës së jashtme, i dyti i derës së brendshme dhe i treti i dhomës së babait, tha Sara. Zgjidh njërin nga të tre, i tha Mihali Metodi Antrakidit, duke ia afruar kyçet në fytyrë. Metodi vuri syzet e rrumbullakëta dhe preku të parin. Të kisha thënë se do flesh në oborr, i tha Mihali dhe filloi të qeshte.

Sara i përcolli deri te gardhi. Metodi eci përpara, ndërsa Mihali ndali hapat dhe i tha Sarës: Nuk e pashë tët bijë. Sarës iu duk sikur fliste me Arianit Komnenin dhe një lëmsh iu mblodh në grykë.

Do vij më vonë t'ju sjell drekën dhe Anën, tha dhe i kapi dorën të vëllait. Mihali i buzëqeshi dhe vazhdoi pas Metodit që ecte ngadalë nëpër kalldrëmin e lagur. Sara i ndoqi me sy derisa iu afruan kishës. Nga larg iu dukën si dy ikona që po dilnin nga kisha për të vizituar fshatin. Kur u kthye në shtëpi, Ibrahim i po e priste. Mihali ka ardhur me mësuesin e vet nga Voskopoja, i tha ajo. Të pyeti për mua, tha Ibrahim. Jo, tha Sara, më pyeti për Anën.

Në drekë Sara mori Anën dhe një trastë ku futi lakror, mish të pjekur me pilaf dhe u nis. Shiu vazhdonte dhe dera e madhe e shtëpisë mjaulliu kur ajo e shtyu dhe u fut brenda. Mihali Komneni ishte shtrirë pranë vatrës i mbuluar me një velenxë të kuqe. Flokët e bardhë dhe të lëshuar ishin përzier me thekët e velenxës.

Po të prisja, i tha dhe e mori Anën e ngriti në ajër dhe filloi ta shikonte si një pikturë. Vajza u frikësua nga lartësia dhe e kapi Mihalin fort nga flokët. Është e pasigurt si një çifute dhe e kujdeshme si një myslimane, tha Mihali dhe i puthi hundën. Po unë si jam, e pyeti Sara duke qeshur. Mihali uli Anën në tokë dhe e pa të motrën si një libër. Ti je e heshtur si një e krishterë dhe djallëzore si një Komnene. Kurse ti je cinik si një arianit dhe i dashur si një refugjat, tha Sara dhe filloi të shtronte tryezën e madhe me këmbë të gdhendura.

Më kishte marrë uria, tha Mihali. Metodi po fle në dhomën e babait dhe unë do ha sa të dua. Ka për të dy, tha Sara. Mihali filloi të hante ngadalë dhe shikonte Anën që fshihej e turpëruar pas këmbëve të tryezës. Pilaf i shkëlqyer me erëza, tha Mihali duke shijuar gjellën. Gatuan si nëna jote. Babai më shkruante se u dashurua me atë grua kur e pa si gatuante. Por unë besoj se ai do ta dashuronte njëloj edhe sikur ajo mos gatuante. Më thoshte ashtu sepse kishte qejf t'i gjente një motiv artistik gjërave që bënte. Një herë më tha se fjeti me një grua në Napoli vetëm se fundi i saj me bojëra iu duk si bisht palloi. Gjente arsye të vogla sa herë bënte punë të mëdha. Nuk e kam njohur nënën, tha Sara, por Mihali nuk dëgjoi. Kur më mori me vete në Berat, te Sabatai Zevi, më tha: Hajde të shikosh sesi vdiq si mysliman një profet çifut. Të ka folur për Sabatai Zevin? Jo, tha Sara, nuk më ka përmendur këtë njeri. Mihali la pjatën, u shtri pranë vatrës dhe u mbulua me velenxën e kuqe. Duhet ta dish këtë histori sepse kështu do kuptosh pse babai nuk u dashurua me nënën tënde vetëm kur provoi gjellët e saj. Sarës iu bashkuan vetullat e errëta, por Mihali kishte filluar.

Ti je gjysmë çifute dhe duhet ta dish se çifutët janë një popull që e lexojnë të ardhmen në të shkuarën e tyre. Me Testamentin e vjetër ata i kanë dhënë botës djepin e të gjitha feve të mëdha, por jo vetëm kaq. Testamenti është një hartë e ndarjes së botës nga profetët dhe për shkak se njerëzit i besuan shumicës së tyre, kjo ndarje vazhdon edhe sot.

Sabatai Zevi ishte një çifut që bindi miliona njerëz se ai ishte profet, por meqë koha kur ai jetoi nuk ishte si ajo e mijëra vjetëve më parë besimi tek ai nuk solli ndonjë ndarje të madhe, por solli një mënyrë jetese nën një regjim të ashpër islamik. Ai mund të ishte vërtet profet, por kur ai lindi koha e profetëve kishte mbaruar.

Sabatai Zevi lindi në ditën e nëntë të muajit të nëntë çifut në vitin 1626 në Izmir të Turqisë. Që këtu, unë besoj se fati i tij i keq ishte i shkruar sepse Turqia e sotme nuk është një tokë që pjell profetë. Kur ishte i ri, Sabatai jetoi i izoluar dhe pati çrregullime të shpeshta psikike për shkak të të cilave u konsiderua një njeri i çuditshëm dhe po aq i frikshëm. Sidoqoftë, ai duhet të ketë qenë një djalë shumë i bukur, orator i përkryer me një zë të fortë muzikor, të cilin e përdorte për të fanepsur vajzat dhe djemtë e moshës së tij. Në shkollë Sabatai Zevi udhëhiqte shokët e tij çifutë në rituale të disiplinuar fizike të frymëzuara nga Libri i Toras së lashtë siç ishin larjet kolektive në det gjatë dimrit, ecje lakuriq në fushat përreth qytetit, këngë mistike etj. Kur mbushi 18 vjeç, Sabatai Zevi u bë rabin. Deri në moshën 24 vjeçare u martua dy herë dhe të dy herët u nda. Për

disa vjet udhëtoi në Egjipt, Palestinë dhe sidomos në Greqi e më së shumti jetoi në Selanik ku që nga viti 1400 më shumë se gjysma e qytetit ishin çifutë. Në Selanik ai gjeti një bashkësi çifute të trembur nga të krishterët, por edhe nga myslimanët dhe shumë shpejt u bë frymëzues i tyre. Në vitin 1664 Sabatai u martua me një vajzë jetime që quhej Sara. Sara ishte më pak se 20 vjeç dhe prindërit e saj ishin vrarë në masakrën e vitit 1648 në Ukrainë. Duke qenë jetime, vajza kishte udhëtuar nëpër Evropë ku e kishin rritur bashkësitë e ndryshme çifute dhe për këtë shkak ishte e njohur për lirinë e saj seksuale. Sabatai Zevi kishte dëgjuar se Sara kishte thënë se ishte e shkruar se ajo do martohej me Mesian. Dërgoi njerëz në Itali ku ajo jetonte në atë kohë dhe u martua me të në Kajro. Dasma e tij me Sarën bëri zhurmë, por Sabatai Zevi tha se ai kishte vepruar si profeti Osea, i cili shtatëqind vjet para Krishtit ishte martuar me urdhër të Zotit me një vajzë të përdalë. Bashkimi me Sarën e qetësoi për disa kohë Sabata Zevin nga çrregullimet mendore që i përsëriteshin vazhdimisht dhe ai vendosi ta kuronte marrëzinë e tij. Shkoi në Palestinë për të takuar Natanin, që ishte një rabin i njohur për ritet e tij kabalistike, si dhe për të çliruar shpirtrat e njerëzve përmes praktikave të çuditshme mistike. Kur u takuan, Natani i Gazës pa një ëndërr në të cilën Sabatai Zevi ishte Mesia që prej mijëra vitesh priste populli çifut. Natani i tha Sabatait se ai nuk vuante nga ndonjë sëmundje njerëzore krizat e së cilës mund të kurohen me ilaçe, por shenjat që ai shfaqte ishin cilësi të një vullneti hyjnor. Natani shpalli se Sabatai Zevi ishte Mesia dhe duke qenë një njeri me influencë njerëzite e besuan. Në maj të vitit 1665 Sabatai Zevi, me bekimin e Natanit, u shpall zyrtarisht Mesia dhe zgjodhi 12 apostujt e tij, të cilët përfaqësonin 12 popujt e Izraelit. Ai shkoi në Jerusalem dhe njëlloj si Jezu Krishti i hipi një gomari mbrapsht dhe u rrotullua shtatë herë për qark mureve të qytetit. Fjalët u hapën në gjithë Evropën për një profet që bënte mrekulli dhe i cili do drejtonte çifutët të përbërë nga tributë e humbura të Izraelit. Rabinët e Jerusalemit u shqetësuan, e shanë dhe e kundërshtuan Sabatai Zevin duke e quajtur një profet të rremë. Pas disa ditësh e dëbuan dhe Sabatai u rikthye në Izmir, në qytetin e tij të lindjes, ku njerëzit ia kishin falur marrëzitë e rinisë. Aty ai u prit si një mbret shpëtimtar dhe dalja e njerëzve në rrugë për të parë Sabatain shkaktoi rrëmujë dhe eksitim kolektiv.

Sabatai Zevi, i ekzaltuar, e udhëhoqi turmën e mijëra çifutëve drejt një sinagoge dhe aty ai filloi të sillej si Mesia duke ia shpërndarë mbretëritë e botës pasuesve të tij. Sabatai caktoi Ditën e Shpëtimit, e cila do të ishte 18 qershori i vitit 1666. tri gjashtat në traditën e krishterë që rrjedh nga hebraizmi janë konsideruar si numri i djallit dhe i shkatërrimit të botës, apokalipsit. Por Sabatai Zevi bënte një interpretim tjetër duke i bindur pasuesit e tij se dita e tri gjashtave ishte dita e madhe e ndryshimit të botës. Ai zgjodhi muajin qershor që është muaji i gjashtë dhe datën 18 që është shuma e tri gjashtave të vitit 1666. në 1 janar 1666 u nis nga Izmiri me një anije në të cilën kishin hipur qindra dishepuj të tij. Udhëtimi i një anijeje me çifutë, kryetari i marrë i të cilëve thoshte se do t'i merrte kurorën sulltanit dhe se do shkatërronte Perandorinë Otomane, natyrisht që i acaroi turqit. Kur anija u afrua në ngushticën e Dardaneleve, turqit e ndaluan dhe e arrestuan Sabatai Zevin. Atë ditë në Stamboll pati përleshje. Mijëra çifutë, kryesisht gra, që kishin dalë në port për të pritur Sabatain u goditën nga turqit. Gratë ulërinin dhe thoshin se ato ishin thirrur nga një zë hyjnor, i cili kishte muaj që u fliste për mbërritjen e Mesias. Asnjë çifut tjetër që nga koha e Moisiut nuk i kishte frymëzuar aq shumë çifutët që sipas Testamentit ëndërronin prej shekujsh shpëtimtarin e Izraelit. Në vitin 1666, kryevezir i Perandorisë Turke ishte një shqiptar, Fazil Qyprilliu, i cili më vonë pushtoi edhe Kretën. Fazil Pasha nuk ishte aq i egër sa i ati, Mehmet Qyprilliu dhe ishte tolerant ndaj arteve dhe lirive fetare. Fazili u mor vetë me çështjen e Sabatai Zevit, të cilin fillimisht e burgosi në Edrene bashkë me pasuesit e tij. Në burg, Sabatait iu la liri e plotë dhe aty ai vazhdonte të predikonte misionin e tij. Në shtator të atij viti, Fazil Qyprilliu e nxori Sabatai Zevin përpara një gjykate perandorake në Edrene duke e

akuzuar për kërcënim të rendit otoman. Me urdhër të Fazil Pasha Qyprilliu, Sabatait iu tha se kishte dy mundësi: ose të vdiste si çifut, ose të jetonte si mysliman. Sabatai Zevi pranoi të dytën. E dërguan përpara Sulltanit dhe u bë mysliman, vuri një çallmë në kokë dhe u quajt Aziz Mehmet Efendi. Dragomani i Madh, në shtëpinë e të cilit jetoi babai kur ishte në Stamboll, i kishte treguar atij se në atë ceremoni konvertimi merrte pjesë edhe Fazil Qyprilliu. Fazili duke qeshur i kishte thënë Sabatai Zevit: Islami e mësoi synetllëkun nga çifutët, kështu që ti u bërë mysliman pa dhimbje. Kishte të drejtë, sepse Sabatai Zevi, si gjithë çifutët, ishte synet dhe prerja e lëkurës iu kursye.

Lajmi se Sabatai Zevi u bë mysliman i tronditi pasuesit e tij në gjithë botën. Shumë prej tyre e mohuan dhe rabinët që e kishin luftuar në Jerusalem, në Selanik dhe Izmir thanë se kjo provoi se Sabatai ishte një mashtrues.

Mirëpo Sabatai nuk hoqi dorë. Ai tha se kishte marrë një porosi hyjnore për të ndërruar identitetin e tij dhe se tani ai do të vazhdonte misionin duke vepruar në zemrën e armikut. Sabatai Zevi, megjithëse mysliman, vazhdonte të shkonte nëpër sinagoga ku ai ndiqte ritet e tij fetare siç kishte bërë gjithmonë. Shumë çifutë që jetonin nën Perandorinë Turke e besuan dhe ndoqën shembullin e tij. Në Selanik, qytet që Sabatai e kishte shpallur të shenjtë, të paktën 400 familje çifute u bënë myslimane. Shumë shpejt lindi një sekt i ri çifutësh të konvertuar, të cilët u quajtën Dönme, që në shqip do të thotë “ata që u kthyen”. Për shumë vjet Sabatai Zevi udhëtoi me çallmë në kokë duke vizituar bashkësitë çifute në shumë qytete të Perandorisë. Ai hiqej si mysliman, por zhvillonte një aktivitet prej çifuti heretik. Sabatai e ktheu në një fe të re Dönmen e tij. Ai i ndryshoi dhjetë urdhëresat e librit të Moisiut, të shenjta për çifutët dhe ndërtoi një urdhër që bazohej në 18 rregulla. Këto rregulla i përfshijnë dhjetë urdhëresat bazë, por disa prej tyre i zbusin si dhe shtojnë disa norma që rregullojnë bashkëjetesën mes sabatistëve, turqve dhe çifutëve. Sabatai Zevi kishte praktikuar gjithmonë praktika seksuale të lira gjatë jetës së vet, për të cilat ai ishte i famshëm. Ndryshe nga dhjetë urdhëresat e ashpra të librit, në rregullat e tij ai nuk e konsideronte tradhtinë bashkëshortore një mëkat që duhej ndaluar. Në Selanik, ku Sabatai ndenji disa vjet pasi u bë mysliman, ai krijoi festën e qengjit, e cila, sipas riteve të lashta, mbahej në pranverë. Në këtë ditë, dy ose më shumë çifte të martuara hanin mish qengji dhe pastaj zhvisheshin dhe përziheshin pa dallim me njëri-tjetrin duke bërë dashuri. Fëmijët që lindnin nga këto bashkime të panjohura konsideroheshin të shenjtë. Në Selanik shumë fëmijë janë ngjizur nëpër këto mbrëmje dhe kur më vonë disa prej tyre kërkuan të bëheshin prapë çifutë, rabinët i kundërshtuan sepse atësia e tyre ishte e pasigurt.

Shumë shpejt Sabatai Zevi u bë i padëshirueshëm për turqit dhe i urryer për çifutët. Të parët e kuptuan se ai nuk e praktikoi dhe nuk e besoi kurrë Islamin, ndërsa të dytët Sabatai i fyente vazhdimisht duke i rekrutuar me praktika të padenja. Turqit dhe çifutët i kërkuan Portës së Lartë të ndalonte veprimtarinë e Sabatait dhe Fazil Qyprilliu e internoi atë në Berat ku dhe vdiq më 1676. Në Berat kishte një bashkësi shumë të vogël çifute, por babai thoshte se Fazil Qyprilliu e degdisi Sabatain në Berat për ta shpëtuar. Shqiptarët nuk ishin as të krishterë dhe as myslimanë të devotshëm dhe asnjëra palë nuk do t’ia kishte kërcënuar jetën Sabatai Zevit. Por në Turqi Sabatai u kthye në një mit, sidomos për të rinjtë e shkolluar myslimanë, të cilët besonin te një shoqëri më e lirë. Për shumë turq të rinj sabatizmi ishte një islam i reformuar, që mund ta ndryshonte shpejt Perandorinë e ndryshkur, duke e afruar me Evropën e kulturuar. Këto rrethe ishin të forta dhe të organizuara në formën e shoqërive të fshehta në Stamboll, kur babai shkoi në vitin 1704. Ai u njoh me disa turq sabatistë që ishin miq të Dragomanit të Madh, në shtëpinë e të cilit ai qëndroi. Dragomani i Madh e kishte takuar vetë Sabatai Zevin dhe njihte shumë nga pasuesit e tij. Arianiti besonte se Sabatai Zevi, në fund të fundit, ishte përpjekur për rrëzimin e

rendit islamik dhe në qoftë se kjo realizohej bota do të ishte më e qetë me një ndarje mes çifutëve dhe të krishterëve, fetë e të cilëve kishin rrënjë të njëjta. Babai tregonte se në ato vite Stambolli ishte një qytet i mbushur me shoqëri të fshehta që frekuentoheshin nga të rinj myslimanë, por edhe nga artistë evropianë dhe çifutë, nga shkrimtarë dhe teologë gjithfarësh. Dragomani e kishte prezantuar babanë si pasardhës të një familjeje fisnike shqiptare dhe kjo i dha atij mundësi të njihej me kapriciot fetaro-kulturore të Stambollit. Njëherë ai ishte ftuar në një prej takimeve të fshehta të sabatistëve, të cilët bënë plane për të rekrutuar sa më shumë myslimanë turq që punonin në administratë dhe sidomos në ushtri. Arianit Komneni u bë edhe më interesant kur sabatistët morën vesh se ai ishte nga Shqipëria, vend në të cilin kishte vdekur Mesia i tyre. Ata i kërkuan babait që kur të shkonte në Shqipëri t'i dërgonte të dhëna për ditët e fundit të Sabatai Zevit në Berat si dhe të pyeste nëse dorëshkrime të tij kishin mbetur gjëkund. Në një nga këto takime, Arianit Komneni duhet të ketë takuar edhe nipin e Sabatai Zevit që jetonte në Selanik, por vinte shpesh në Stamboll i ftuar nga ithtarët e gjyshit të tij. Siç të thashë, Sabatai u martua me Sarën dhe patën një djalë. Kur Sabatai u bë mysliman ai jetoi pjesën më të madhe të kohës në Selanik, ku u rrit i biri. Pas vdekjes së të atit, ai u martua me një çifute greke dhe patën dy djem. Arianiti ka njohur më të madhin prej tyre që nuk ishte bërë rabin si gjyshi, por merrej me tregti. Ky i kërkoi Arianitit që ta ndihmonte për të marrë eshtrat e gjyshit në Berat dhe për ta varrosur atë në Izmir ku varri i tij do të kthehej në një qendër pelegrinazhi për gjithë sabatistët e Perandorisë. Shoqëria sabatiste e Stambollit, me lidhje të forta në shtetin turk, i përkrahte këto plane sepse mendonte se rikthimi i Sabatai Zevit në Turqi do t'i shtonte radhët e sabatistëve. Në këtë mënyrë babai u bë pjesë e dy grupeve të fshehta që vepronin në Stamboll në atë kohë. Njëri ishte një grup Komnenësh me në krye Gjergj Brankoviçin, të cilët kishin shpresë në një kryengritje antiotomane në Ballkan. Shumica e Komnenëve të ardhur nga Evropa ishin nga familje fisnikësh nga Italia dhe Franca dhe një pjesë prej tyre, bashkë me Gjergj Brankoviçin, ishin masonë të rregullt që besonin se bota duhej të drejtohej nga një rreth familjesh të mëdha që kishin lidhje gjaku me njëra-tjetrën.

Grupi tjetër ishin sabatistët, të cilët ishin myslimanë turq dhe çifutë që donin një Turqi më të fortë dhe më tolerante të ngritur mbi normat e Sabatai Zevit. Babai thoshte se këta të dytët ishin më të organizuar, ndërsa të parët ishin më romantikë.

Por të dy grupet ishin kundër Islamizmit të ashpër dhe kjo duhet t'i ketë shijuar Arianit Komnenit. Kur iku nga Stambolli dhe erdhi në fshat, babai duhet të ketë shkuar në Berat dhe ka mbajtur lidhje me sabatistët e Stambollit dhe sidomos me nipin e Sabatai Zevit që jetonte në Selanik. Herën e dytë që babai shkoi në Stamboll ka qenë i ftuar në një mbledhje sabatistësh, e cila nuk u bë për shkak të rebelimit të Halil Patronës. Shumë sabatistë atëherë u burgosën dhe u vranë dhe shoqëria u shpërbë pasi me rënien e Ahmetit III, radikalët islamikë u forcuan dhe vepruan kundër shoqërive të fshehta që kërkonin një islam më tolerant. Gjëja e parë që bënë ata ishte shkulja e tulipanëve që kishte mbjellë në kopshtet e Stambollit, Ahmeti III, për të cilat besohej se ishin një simbol sabatist. Sabatistët e konsideronin veten si masonë myslimanë dhe mënyrën e organizimit dhe simbolet i kishin përshtatur nga ata, duke i ndryshuar. Masonët kishin si simbol të tyre trëndafilin, ndërsa sabatistët zgjodhën tulipanin. Thonë se kishte qenë një këshilltar çifut i Sulltanit, ai që e kishte bindur ta zbukuronte qytetin me tulipanë. Kur u nis në vitin 1730, babai kaloi nga Selaniku dhe bashkë me nipin e Sabatait udhëtuan të dy në Stamboll. Kryengritja e Halil Patronës i kapi në befasi dhe babai shpëtoi duke i thënë jeniçerëve se ishte shqiptar, ndërsa nipi i Sabatait humbi dhe duhet të jetë vlarë në ato ditë rrëmuje.

Ky çifut ishte babai i Shebës, të cilën Arianit Komneni e kishte takuar kur shkoi në Selanik në shtëpinë e mikut të tij, nipit të Sabatai Zevit. Sheba, nëna jote është stërmbesa e Sabatai Zevit.

Velenxa e kuqe i kishte rënë Mihal Komnenit te këmbët dhe kur pushoi ai e ngriti pak. Vetullat e zeza të Sarës ishin kryqëzuar dhe sytë i ishin skuqur. Kur Mihali fliste, ajo mendonte se pse po ia tregonte ai atë histori, por kurrë nuk kishte besuar se fundi i saj ishte ajo vetë.

Nuk e besoj dot, tha Sara, babai do ma kishte treguar. Mihal Komneni buzëqeshi, largoi velenxën dhe u afrua tek ajo. Fytyra e tij ishte e qetë dhe e bardhë. Babai nuk të ka fshehur gjë. Ai të ka thënë se është dashuruar me nënën tënde në Stamboll dhe se babai i saj ishte një tregtar çifut nga Selaniku. Kjo është e vërtetë. Sa të thashë, babai m'i ka treguar kur shkuam bashkë në Berat për të gjetur varrin e Sabatai Zevit. Por kjo ndodhi përpara se ai të shkonte në Stamboll për herë të tretë në 1753. ndoshta, kur u kthyem nga Berati ai mund t'i ketë shkruar Shebës, vajzës së mikut të tij, për t'i thënë se nuk arritëm dot ta gjenim varrin mbi të cilin ishin ndërtuar shtëpi dhe shumë pak ishin ata që e mbanin mend, ku ishte varrosur Sabatai përpara shtatëdhjetë vjetësh. Sabatai kishte jetuar në një shtëpi jashtë qytetit, sepse si një i internuar nuk ishte pranuar brenda në Berat. Fshati i tij quhej Bilce dhe ishte pas një kodre që ngrihet mbi lumin që ndan të krishterët me myslimanët e Beratit. Ne nuk e gjetëm dot varrin, por babai mendoi se fshatarët nuk donin të na e tregonin. Myslimanët e Beratit nuk e kishin gëlltitur kurrë faktin që një heretik si Sabatai ishte internuar në qytetin e tyre, i cili gjithmonë kishte pasur grindje fetare. Disa vjet para se të shkonim në Berat, ishte vrarë një murg, i cili më parë kishte qenë mysliman dhe pastaj ishte bërë prapë i krishterë. Të krishterët e konsideronin shenjt Shën Nikodhimin, të cilit iu pre koka pasi refuzoi të mohonte Krishtin. Disa të krishterë thoshin se çifutët donme të Beratit kishin folur kundër tij dhe se Nikodhimi kishte qenë për vete një donme gjatë kohës që ishte një mysliman i martuar me një grua nga fshati ku kish jetuar Sabatai. Edhe të krishterët, edhe myslimanët nuk i honepsnin donmet, të cilët ishin izoluar pas vdekjes së Sabatait. Një plak na tha se Sabatai disa kohë kishte udhëtuar deri në Ulqin, por gjatë kohës që qëndroi në Berat rrinte në shtëpi dhe shkruante. Kur mësuan se ne ishim të krishterë donmet e Bilces u frikësuan dhe nuk na lejuan të hyjmë në shtëpinë ku kishte jetuar Sabatai dhe ku besohet se kanë mbetur disa dorëshkrime si dhe sende të tij. Për të gjitha këto babai duhet ta ketë njoftuar Shebën me letra dhe ajo duhet t'i jetë përgjigjur.

Por siç të thashë, kur ne shkuam në Berat, ai nuk kishte asnjë marrëdhënie me Shebën përveçse e kishte parë në shtëpinë e babait të saj në Selanik. Çfarë do ndodhte më vonë ai nuk e dinte. Pasi linde ti, unë bëra lidhjen me ato që dija. Kur e pyeta se si dhe pse u dashura me Shebën, ai më tha se ajo i kishte kërkuar atij ta ndihmonte për të gjetur eshtrat e humbura të babait të saj në Stamboll. Edhe vetë Arianiti e kishte amanet nga nëna e tij, që të sillte në fshat eshtrat e babait të vet dhe kështu vendosi të shkonte me vajzën e mikut të tij. Ajo shkoi në Stamboll bashkë me burrin e saj, i cili administronte biznesin e familjes, gjë që provon se babai dhe Sheba nuk kanë pasur asnjë lidhje mes tyre përpara këtij udhëtimi. Në kohën që ai dhe Sheba kërkonin eshtrat e baballarëve nëpër Stamboll, Jorgo Mavromatisi, burri i saj, u njoh me disa tregtarë turq, të cilët i ofruan atij verë me çmim shumë të lirë. Shitja e verës në atë kohë ishte e ndaluar me një ferman të Sulltanit dhe magazinat e Stambollit ishin plot. Babai i mori eshtrat e gjyshit tonë, ndërsa Sheba nuk gjeti asnjë gjurmë të babait të vet të humbur gjatë revoltës së Halil Patronës. Kur u kthyen, pas disa muajsh, për në Selanik, Jorgon e arrestuan për kontrabandë pijesh të ndaluara në Lesbos dhe atje babai qëndroi me Shebën për të mos e lënë vetëm. Duke pritur lirimin e Jorgos, ata u dashuruan dhe shkuan në Kretë ku linde ti. Aty vdiq dhe nëna jote. Ti i di të gjitha këto me siguri. Babai nuk ta ka treguar prejardhjen e Shebës duke e ditur se ti do ta gjeje vetë një ditë, kur të kërkoje rrënjët e tij. Megjithatë, kjo pjesë nuk ishte shumë e rëndësishme sepse ai nuk u dashurua me stërmbesën e Sabatai Zevit, por me një grua që i pëlqeu, në një ishull ku nuk njihje

asnjeri tjetër. Pavarësisht se mua më tha se u dashurua me një grua që gatuante shumë mirë, ai u dashurua me një grua të palumtur nga martesja e saj, e cila, me sa duket, e gjykonte botën njëlloj si ai. Kur babai iku nga fshati, ti ishe jo më shumë se pesëmbëdhjetë vjeç dhe ai nuk donte të të tregonte anët e errëta, të cilat, vetëm rastësisht, ushqyen dashurinë e tij me nënën tënde. Hija e Sabatai Zevit do ta kishte prishur shijen e asaj dashurie njëlloj si një piper që prish shijen e një ëmbëlsire. Po ashtu babai nuk të tha se ku do shkonte të vdiste, duke qenë i bindur se kur të rriteshe, ti do të ndiqje udhëtimin e fundit të tij, siç bëri edhe ai me gjyshin tonë dhe siç bëri nëna jote me babanë e saj.

Po nëse nëna ime rrjedh nga Sabatai Zevi, pse nuk duhej të ma tregonte ai këtë gjë, ngulmoi Sara që fliste shpejt duke pritur arsytimin e Mihalit. Sepse ajo nuk është një histori për fëmijë, e dashur motër, tha Mihali. Megjithëse në rininë e tij Arianiti, nën ndikimin e shokëve të tij, mund të jetë ngazëllyer nga aventura e Sabatait, ai mendonte se në fund të fundit Sabatai Zevi ishte një mashtrues dhe nuk donte që ti të ngrije botën tënde mbi këtë model marrëzie. Unë nuk gjej një arsye tjetër. Ose ndoshta babai e ka ditur që një ditë ne do takoheshim dhe unë, si i vetmi njeri që dija lidhjen e tij me sabatistët dhe për shkak të tyre edhe me Shebën, do ta ballafaqoja pjesën time të së vërtetës me tënden.

Ndoshta e ka menduar kështu, tha Mihali Komneni që pushoi pak sikur po mendohej. Kur ta takosh Sarën do kuptosh se një Komnene e mbjellë në një vazo hebraike, del më e bukur se fara që e mbolli. Kështu më thoshte para se të nisej. Tani më duket sikur babai më shtynte drejt një qëllimi: se si të takohesha me ty kur ai të mos ishte më. Ja pse erdha tani. Prita, sa u rrite, sepse doja të shihja një Komnene që ka çelur, pasi im atë e mbolli në një vazo çifute. Tani ke çelur, tha Mihali dhe i vuri Anës dorën mbi kokë, sikur po e ujiste. Po ti ke ardhur ta krisësh këtë vazo, e pyeti Sara që i kishte sytë e përplotur. Aspak, tha Mihali me zë të ëmbël, kam ardhur të të them se nga cila farë ke mbirë. Duke e ditur, do rritesh më e fortë dhe do jesh gati për të ndjekur rrënjët e tua.

Më duket sikur ti e di ku është babai, e pyeti Sara që ishte ngurtësuar dhe kishte mbledhur duart mbi kraharor. Jo, tha Mihali. Ndoshta ai nuk do që ne ta marrim vesh se ku ka shkuar, tha Sara. Mihali Komneni ngriti kokën dhe e pa Sarën sikur donte t'i vidhte një sekret. Erdha mbrëmë në fshat, foli ai. Shtëpia ishte e mbyllur dhe shkova te Hana. Ajo më tha se çelësat e shtëpisë Arianiti t'i kishte lënë ty. Doja të vija që mbrëmë t'i merrja, por kur ajo më tha se yt shoq është bërë mysliman, ndërrova mendje dhe fjeta tek ajo.

Unë nuk e kisha parë kurrë Hanën. Babai e donte shumë dhe luante me të. Por ai thoshte se ndryshe nga gjithë Komnenet, kur ajo humbte, e linte lojën pa u ankuar. Ashtu m'u duk dhe mua. Është shumë e bukur, si nëna e vet, por është pa humor, si i ati. M'u duk sikur e përdor bukurinë që ka si një mobilie për të dekoruar shtëpinë. Nuk mendon shumë dhe kjo e mban ende të freskët. Flet shkurt dhe përgjigjet vetëm kur e pyesin. Kur e pyeta për babanë ajo më tha se ditën që iku ai kishte thënë se ti e dije se ku do të shkonte. Hana është e bindur se ti e di, por nuk e thua. Por ajo beson ato që dëgjon pa u përpjekur të gjejë kuptimin e vërtetë të fjalëve. Hana ka luajtur, por nuk ka biseduar me Arianitin dhe prandaj nuk mund ta kuptoj se çfarë ka thënë ai.

Sipas teje, çfarë ka thënë babai, pyeti Sara. Ka thënë që ti duhet ta zbulosh se ku ka shkuar, duke ecur mbi gjurmët e jetës së tij. Ti më provove se unë nuk i di të gjitha gjurmët, tha Sara. Unë të dhashë një gjurmë dhe ato që kanë mbetur duhet t'i gjesh duke ndjekur shenjat. Unë jam një shenjë, por nuk jam e vetmja dhe as e fundit, tha Mihali. Cilat shenja, pyeti Sara. Shenjat që ai ka lënë mbi njerëzit dhe veprat që krijoi, ia ktheu Mihali. Po më thua të lexoj një nga një gurët e kalldrëmeve që shtroi në fshat, apo të shikoj si rrjedh uji në çezmat pre guri që ndërtoi dhe të përpiqem të kuptoj se në cilin breg të botës mbaroi udhëtimi i Arianit Komnenit, pyeti Sara me



nerv dhe iu kujtua Ibrahim, që thoshte se Arianiti i kishte trajtuar më mirë kalldrëmet se njerëzit. Kaq shpejt u lodhe, e cty Mihali që kishte marrë pamjen e një njeriu që e ka tërhequr gjahun aty ku do. babai të ka treguar për prejardhjen e Komnenëve dhe dashurinë e tij me nënën tënde, por kjo është njësoj si të kënaqesh me rrotullimin e dallëndyshes në një ditë vere, pa e kuptuar se sa shumë rrugë ka bërë për të ardhur mbi qiellin tënd, se nga cilët dimra ka ikur, se si ka humbur shoqet nëpër cikna, se si i ka shpëtuar rrebesheve mbi oqeanë, se si ka plagosur krahët në stuhi, se si i ka dredhuar zogjve grabitqarë, se si në lartësi është dashuruar, duke harruar se mund t'i merreshin mendtë, se si është çlodhur nga dashuria duke u mbështetur mbi krahët e të dashurit, se si e ka ngritur folenë e vet duke i ngjitur tullat e saj me gojë, se si i ka ushqyer të vegjlit duke këputur mish nga mishi i saj, se si ka rënë, është ngritur dhe prapë ka rënë dhe prapë është ngritur, derisa ka vendosur të niset për udhëtimin e fundit, pasi mjeshtërinë e jetës ia ka mësuar edhe foshnjave të veta. Dallëndyshja e di që nuk mund të vdesë pa i rritur fëmijët e vet dhe kur është e sigurt se kjo ka ndodhur zgjedh një vend për të vdekur, të cilin askush nuk e di. Kush më thotë ku është varri i dallëndyshes? Askush. Vetëm të vegjlit mund ta gjejnë atë nga shenjat që ka lënë në ajër, nga aroma e kashtës së folesë, nga puçlat që kanë rënë rrugës, nga drejtimi i erës, nga gjethet e pyllit që imitojnë krahun e nënës së tyre dhe pa dyshim nga nevoja që ka çdo qenie e gjallë për të kuptuar se aty ku mbaron udhëtimi i prindit fillon udhëtimi yt, sepse bota jeton përmes vazhdimësisë së trashëgueshme. Unë erdha që në mëngjes për të fjetur këtu por nuk më lanë shenjat e tij. Hija e babait, gjurma e tij në oborr, shija e arrave që hante, flokët e bardhë mbi velenxë, një cep i përthyer libri, palosja e çarçafit dhe plloça e ciflosur nga këmba e tij nuk më lanë të flija. I ndoqa gjithë ditën për të kuptuar më shumë. Nuhata, shijova, preka, pashë dhe dëgjova. Do isha nisur duke ecur pas këtyre shenjave deri në fund të botës, po të mos e kuptoja se Arianit Komneni nuk më pret mua, por ty. Ai të pret ty, sepse ti i ndryshove drejtimin jetës së tij dhe ai ka vazhduar në atë drejtim, si një dallëndyshe që e di se, po ndryshoi rrugën, të vegjlit që i vijnë pas, do ngatërrohen. Kam kohë që e mendoj, por sot, kur shtriva trupin tim aty ku babai është shtrirë për herë të fundit, kuptova se unë nuk jam udhëtari, por jam shenja. Kam ardhur si një shenjë që ti të më lexosh dhe të vazhdosh rrugën, dallëndyshja ime.

Mihal Komneni kishte marrë një ngjyrë purpuri dhe flokët i ishin shpupuritur, si në një fluturim. I rregulloi me ngadalë me dorën e madhe si krehër dhe e pa Sarën me sy të çmallur. Babai më mësoi të eci, ti po më mëson të fluturoj, tha Sara dhe u ngrit. Do donte të rrinte akoma me të vëllanë, ta përqafohte ashtu siç nuk kishte pasur rast ta bënte kur ishte e vogël, por e dinte që në krahët e tij do qante duke derdhur lotët e gjithë fëmijërisë së vet që kishte kaluar shumë shpejt, duke u mbajtur në krahët e babait që fluturonte nga dimri në verë dhe nga furtuna ën qetësi. Mori Anën për dore dhe, duke dalë, iu duk sikur dëgjoi zërin e Mihalit që thoshte: Dallëndyshja i lë shenjat në ajër. Ngriti kokën lart, por shiu i rrëshqiti mbi faqe. Si lot. Duke ecur, këmba iu pengua në një gur kalldrëmi që ishte më i madh se të tjerët. Nuk jam akoma gati t'i ndjek të gjitha shenjat, tha Sara me vete dhe shtrëngoi fort dorën e Anës që ishte zgjuar drejt saj në errësirë.

Në fillim të korrikut, Ana mbushi dy vjeç. Shiu vazhdonte prej dy javësh dhe oborri ishte mbushur me pellgje jeshile. Shtëpia e tyre dukej si një kazan i hapur nga lart që priste të mbyllje, ndërsa shtëpia e re ishte e çrregullt. Për shkak të shiut, djemtë luanin gjithë ditën brenda dhe

dhomat i ngjanin një depoje në të cilën një herë sënduku fshihej poshtë krevatit dhe pastaj qilimi e mbulonte krevatin si çarçaf. Ta festojmë ditëlindjen e vajzës, tha Ibrahimimi. Këtu është e pamundur, tha Sara që përpiquej më kot të vinte rregull. E festojmë të dielën në shtëpinë e babait. Ftojme Hanën, Mihalin dhe Metodin. Duket si një meshë Komnenësh, tha Ibrahimimi. Kur u martova, Arianiti më nxori jashtë nga mesha e Kretës, por tani nuk më zbon dot më. Do t'i them Mihalit që të mos vishet me rrobat e babait që të të dalë frika, ia ktheu Sara. Po ne si do vishemi, pyeti Aliu. Unë do vishem si Paridi, tha Niko dhe pyeti Sarën: Si vishej Paridi? Në kohët e lashta ishte ngrohtë dhe njerëzit visheshin lehtë, me një këmishë linoje dhe me sandale. Paridi i kishte flokët e gjatë dhe i mbante të kapura me një lidhëse të kaltër. Sandalet i kam, por flokët si t'i zgjas, pyeti Niko duke i ngritur balluket përpjetë. Lyeji me ujë me sheqer dhe do të ngrijnë e do duken më të gjata, i tha Jani duke qeshur. Do t'i lyej, tha Niko, dhe pastaj nuk do t'i pres derisa të më zgjaten si të Paridit. Po ti Muhamed si do vishesh, e pyeti Ibrahimimi. Muhamedi uli kokën dhe duke parë thonjtë e vegjël dhe të bardhë tha: Unë do vë një çallmë që t'i ngjaj Muhamedit. Ibrahimimi pa Sarën në sy, por nuk foli. Ti nuk mund të jesh Muhamedi sepse ai u bë mysliman kur u bë burrë. Sa ishte i vogël ai nuk mbante çallmë, foli Jani duke iu drejtuar Ibrahimimit, sikur i kërkonte të ndërhynte. Kur ishte i vogël Muhamedi nuk e dinte që do bëhej mysliman dhe prandaj nuk mbante çallmë. Unë kam lindur mysliman dhe do sillem si një Muhamed i rritur, tha Muhamedi. Po pse zgjedh Muhamedin që nuk dinte të luftonte si gjithë burrat e tjerë. Po deshe të jap unë Skënderbeun ose Akilin që kanë bërë luftëra dhe jo muhabet si Muhamedi, tha Aliu. Tani nuk kam ç't'i bëj, tha Muhamedi që ngriti kokën dhe pa nga Ibrahimimi. Këtë e ka vendosur babai kur më vuri emrin. Babai ju ka vënë të gjithëve emra shumë të bukur, por ju nuk mund të jetoni si njerëzit që ju keni marrë emrin, tha Sara. Edhe Ana ka emrin e nënës suaj, por kur ajo të rritet njerëzit do ta kenë gjetur ilaçin e kolerës. Edhe unë kështu dua, tha Aliu. Babai më ka thënë se unë kam emrin e Ali Tepelenës, po unë nuk dua t'i ngjaj atij, se dajë Llambro thotë se ai vjedh bagëti dhe gra. Unë dua të kem edhe dele, edhe gra, por duke luftuar, jo duke vjedhur. Po ti baba emrin e kujt ke, pyeti Niko. Ibrahimimi vuri buzën në gaz dhe tha: Unë kam emrin e një burri të mençur, i cili gjithë jetën eci nëpër fusha dhe male duke kërkuar tokë për të ngritur një fshat, për popullin e vet. Po ti nuk ke ecur nëpër male dhe fusha për të gjetur një fshat për ne, sepse fshatin e kishte ngritur babai i Sarës, tha Aliu. Prandaj unë nuk jam ai që më dha emrin dhe po ashtu edhe ju nuk jeni si ata që ju dhanë emrat, tha Ibrahimimi. Megjithatë vishuni si të doni sepse është festa e Anës. Kur u bë kisha e fshatit ishte një ditë feste dhe unë u veshja si dhëndër. Po tani që nuk je dhëndër, nuk shkon më në kishë, pyeti Niko duke parë Sarën. Babai shkon prapë në kishë, por vetëm kur vdesin njerëz, tha Muhamedi dhe doli nga dhoma.

Të dielën që pa gdhirë, Ibrahimimi theri një qengj, i ndau veç këmbët dhe lëkurën, i hoqi të përbrendshmet dhe e shpoi tejprtej me hell. Binte shi dhe ai i tha Janit ta ndizte prushin brenda shtëpisë, aty ku Naumi dhe Andrea kishin sajuar një si kolibe të mbuluar për të fjetur. Jani rrotullonte hellin, ndërsa tymi fluturonte si i çmendur mbi shtëpinë pa çati.

Nga dreka, mishi i qengjit ishte skuqur në hell dhe kishte nisur të pikonte. Është gati, tha Ibrahimimi. Sara i futi ushqimet e ngrohta nëpër trasta që ua dha djemve, Jani mori qengjin që Ibrahimimi e ndau në copa të mëdha dhe u nisën.

Nikoja kishte ngrirë flokët që i mbante me një pe të kaltër, Muhamedi kishte vënë një peshqir mbi kokë që e kishte lidhur si çallmë, ndërsa Aliu me këpucë të zeza, për të mbrojtur thembrën, mbante në brez një shpatë pa majë që Jani ia kishte sajuar duke kryqëzuar dy dërrasa. Djemtë, të ngarkuar, ecnin përpara, ndërsa pas tyre vinte Sara dhe Ibrahimimi që mbanin Ana Komnenën për

dore. Duken sikur po shkojnë në luftë, tha Ibrahim duke i parë. Ashtu duken, tha Sara, princi, hoxha dhe ushtari. Një ushtri e kompletuar që lufton pa shkak dhe fiton pa pasoja.

Kur hynë brenda, tryeza ishte shtruar dhe Mihal Komneni, që kishte veshur një këmishë të bardhë të qëndisur, ishte ulur në krye, me një gotë verë përpara. Mirë se erdhët, tha Mihal. Ka pesëdhjetë vjet që Komnenët nuk mblidhen as për ditëlindje, as për vdekje. Hana filloi të qeshte kur pa djemtë, ndërsa Metodi vuri syzet e rumbullakëta dhe i drejtoi nga çallma e Muhamedit.

U ulën. Mihal në krye dhe Sara përballë tij, në fund të tavolinës. Në të djathtë Ibrahim, Hana, Jani dhe Metodi, ndërsa majtas, Niko, Muhamedi, Aliu dhe Ana që mori një pirun dhe filloi ta përplaste mbi pjatë. Gëzuar, tha Ibrahim.

Filluan të hanin dhe Mihal i tha Ibrahimit: Ushqimi është feja më e bukur sepse nuk ka kufizime. Të lashtët thoshin se fetë kanë lindur në tavolinë, pasi njerëzit hanin dhe fillonin të bisedonin, tha Metodi. Por meqë njerëzit kishin shije të ndryshme, lindën fe të ndryshme. Dikush nuk e donte mishin, dikush donte vetëm një lloj mishi, dikush donte edhe mishin, edhe verën, dikush nuk donte verën, por donte mishin. Kësisoj, fetë që lindën, kufizuan ushqimin sipas shijeve të njerëzve që i krijuan ato dhe njerëzit u ndanë fillimisht nga ushqimi. Po unë që i dua të gjitha, qeshi Mihal duke ngritur një gotë verë, në cilën fe futem unë? Ty nuk do të të kishin pranuar në atë tavolinë sepse ti do t'i kishe ngrënë të gjitha dhe sot do kishim vetëm një fe, tha Metodi. Sikur t'ia kishin lënë këtë gjë në dorë Mihalit, sot nuk do kishim as kisha, as xhami, por do faleshim në kuzhinë përpara një pjate mish dhe një gotë me verë, tha Sara duke ushqyer Anën. Sa mirë do ishte, tha Hana, ndërsa djemtë filluan të qeshnin.

Si i kanë emrat këta djem, pyeti Mihal. Ky është Jani, tha Ibrahim. Ky këtu ngjitur me ty është Niko, ai është Muhamedi dhe ai është Aliu. Emra të denjë për një tavolinë ku ka çdo gjë, por ku jo çdo gjë mund të hahet, tha Mihal dhe pyeti: Nga i kanë marrë këta emra? Jani ka emrin e babait tim, tha Ibrahim. E kam njohur Janin, tha Mihal. Ai u lind në fshat dhe nuk e njohu babanë e tij që u vra në Kretë. Niko ka emrin e vëllait të gjyshit tim, vazhdoi Ibrahim. Nuk e kam njohur, por thonë se ai ishte një djalë i hedhur që i kishte qejf vajzat dhe prandaj u vra, tha Mihal me një zë të qetë. Unë nuk e kam më emrin Niko, tani quhem Parid, tha Niko që u skuq dhe pa nga Sara. Mihal qeshi fort, ndërsa Metodi picërroi sytë pas xhamave që ishin veshur me avull ushqimesh të ngrohta. Po pse e ke ndërruar emrin Niko, e pyeti Hana. Unë jam Paridi që vrau Akilin, tha Niko. Ai ishte djali më i bukur që caktonte se kush nga perëndeshat ishte më e bukura. Paridi ishte frikacak dhe për një grua e shkatërroi Trojën. Ti je i gatshëm ta shkatërrosh fshatin për një grua, pyeti Mihal. Niko dukej i hutuar, ndërsa Aliu filloi të qeshte. Babai më ka thënë se ne nuk do bëjmë ato që kanë bërë njerëzit që na dhanë emrat, tha Niko. Këtu nuk kanë mbetur më gra për të cilat ia vlen kjo sakrificë, tha Hana duke parë nga Muhamedi që e mbante çallmën të ulur dhe shikonte gishtat e vet. Po ti, Muhamed, kujt ia ke marrë emrin, pyeti Metod Antrakidi. Unë kam emrin e profetit, tha Muhamedi pa e ngritur çallmën. Muhamedi e dinte se çfarë do bënin njerëzit në të ardhmen. Ti çfarë di për ne, e pyeti Mihal. Unë di që Sara do të iki për të gjetur varrin e babait, tha Muhamedi me një zë të ngadaltë që i bëri të gjithë të lënë ushqimin në mes për ta dëgjuar. Dhe ti beson se do ta gjejë, e pyeti Metodi. Një grua që e ka fytyrën të mbushur me rrudha e di dhe ajo do t'ia tregojë Sarës, tha Muhamedi. Të gjithë heshtën, ndërsa Mihal psherëtiu. Në qoftë se kjo është e vërtetë, unë do të të blej një çallmë të re me gurë të çmuar, tha Hana. Nuk dua çallmë, foli Muhamedi duke parë Hanën me sytë e kaltër. M'i jep paratë për të ndërtuar një xhami për babanë. Xhamia do ta lërë gjithë fshatin pa gjumë se myslimanët falen pesë herë në ditë, tha Metodi. Po të jetë pesë herë në ditë unë nuk do shkoj se duhet të ushqej breshkën, tha Aliu dhe ngriti mbi tavolinë dorezën e shpatës që dukej si kryq. Po ti, shpatar i vogël, emrin e kujt ke marrë, iu drejtua Mihal duke parë nga Ibrahim. Ka emrin e

Ali Tepelenës, që më ndihmoi kur u bëra mysliman, tha Ibrahimimi dhe e pa Mihalini drejt e në sy. Si të ndihmoi, pyeti Metodi që kishte filluar të hante kuleç me djathë. Ibrahimimi u bë gati të përgjigjej, por Mihal Komneni foli i pari. Kur Ibrahimimi u bë mysliman, fshati nuk e pranoi dhe pleqësia vendosi ta dëbonte. Do t'ia kishin arritur, po të mos vinte Ali Tepelena që i rrahu burrat e fshatit dhe e prishi rrethimin që ata i kishin bërë Ibrahimimit. Ali Tepelena bisedoi me babanë, që në atë kohë ishte kryetar i pleqësisë dhe pothuajse ranë dakord që Ibrahimimi të qëndronte në fshat, por me kusht që djemtë e tij të mos merrnin vajza të krishtera për gra. Por të nesërmen Ali Tepelena mashtroi babanë e Hanës, që u bë edhe ai mysliman. Arianit Komneni iku nga fshati dhe pleqësia nuk u mblodh më. Më vonë, Ibrahimimi u martua me Sarën. Apo jo Ibrahim, e pyeti Mihal duke përfunduar. Po, tha Ibrahimimi, kështu është. Ali Tepelena më ndihmoi në një ditë të vështirë dhe unë i vura emrin djalit për nder të tij. Hakmarrje e zgjuar, tha Metodi duke parë nga Sara, i more Arianit Komnenit atë që nuk donte të a jepte. Po pse nuk donte babai i Sarës që ne të martoheshim në fshat, pyeti Paridi. Arianit Komneni mendonte se myslimanët duhet të martohen me myslimanët dhe të krishterët me të krishterët, tha Ibrahimimi. Nuk e kishte keq, foli Mihal Komneni. Pulat martohen me gjelat dhe jo me patat. Po pse gjeli që bëhet mysliman quhet patë, pyeti Aliu.

Të gjithë qeshën dhe Muhamedi tha: Kafshët nuk janë as myslimane, as të krishtera sepse ato nuk flasin. Po memecët çfarë janë, tha Paridi. Memecët janë si një orë që e mat kohën, por i mungon akrepi për ta treguar, tha Metodi. Ndërsa kafshët nuk flasin sepse nuk mendojnë. Perëndia e ka shtëpinë në kokat tona. Në qoftë se ne nuk mendojmë, nuk ka perëndi dhe nuk ka fe. Babai thotë se perëndia është shumë e madhe dhe koka ime nuk e nxë, tha Aliu që dukej i hutuar. Perëndia rri në kokën e çdo njeriu. Po të mos ishin njerëzit, nuk do kishte perëndi, tha Sara që gjithë kohën shikonte Mihal Komnenin që argëtohej me pyetjet e djemve. Njerëzit e kanë krijuar perëndinë apo perëndia ka krijuar njerëzit, pyeti Paridi. Pyetje e vështirë, tha Metod Antrakidi dhe u mbështet në karrige. Kush gjen përgjigjen e pyetjes tënde ka zbuluar kuptimin e botës. Të gjithë njerëzit besojnë se ka perëndi, por askush nuk e di ku është, si është, sa e madhe është, si e ka trupin, a ka trup, a ka flokë, sy, veshë, këmbë dhe duar si ne, ku jeton, me se ushqehet, ku fle dhe a fle. Asnjëri nuk e ka parë perëndinë dhe prandaj shumë njerëz besojnë se perëndia jeton në mendimet e tyre dhe në qoftë se ata nuk mendojnë, nuk ka perëndi. Po në qoftë se unë nuk mendoj, atëherë perëndia vdes, pyeti Aliu. Këtë nuk e bën dot sepse edhe kur nuk mendon, ti mendon se si të mos mendosh, tha Muhamedi. Sara i bëri shenjë Mihal Komnenit, si për t'i thënë se kjo nuk ishte një bisedë që duhej vazhduar, por ai dukej më i përqendruar se djemtë.

Përgjigjja e pyetjes së Paridit është shumë e thjeshtë Metod, tha Mihal duke qeshur. Njeriu dhe perëndia janë si pula me vezën. Veza bën pulën dhe pula bën vezën. Në qoftë se ke njëjërën, i ke të dyja, në qoftë se nuk ke njëjërën, nuk ke as tjetrën. Njeriu është si pula sepse ai ka sy, gojë dhe ecën, tha Aliu. Jo, tha Paridi. Njeriu është si veza, ndërsa perëndia është si pula, sepse veza bën vetëm një pulë, ndërsa pula bën shumë vezë dhe perëndia ka bërë shumë njerëz.

Perëndia nuk është as pulë, as vezë, tha Muhamedi, fytyra e të cilit ishte bërë rozë. Perëndia është vetë njeriu. Njeriu mund të bëjë çdo gjë, ndërsa perëndia nuk bën dot çdo gjë që bën njeriu. Njeriu lind njeriun. Në qoftë se gjithë njerëzit nuk lindin më njerëz të tjerë, si Hana, atëherë një ditë nuk do ketë më njerëz dhe nuk do ketë më as perëndi. Perëndia nuk jeton dot pa njerëz, ndërsa njerëzit jetojnë pa perëndinë. Sara thotë se grekët e lashtë kishin shumë perëndi. Myslimanët dhe të krishterët thonë se ka vetëm një perëndi, por ka edhe njerëz që thonë se nuk ka fare perëndi dhe ata jetojnë si gjithë ne të tjerët dhe nuk iu ndodh asgjë.

Hana ishte ngurtësuar në karrigen e vet dhe duke iu drejtuar Muhamedit i tha: Xhaxhai yt nuk bënte fëmijë, ndërsa unë mund të bëj po të martohem me një burrë tjetër. Edhe Muhamedi këtë tha. Ti nuk je një pulë pa vezë, por je një pulë pa gjel, tha Mihal Komneni për të qetësuar mbesën. Nuk ka më gjela në këtë fshat, tha Hana dhe u çua e doli në oborr. Fustani i bukur vishnjë i rrinte ngushtë dhe format e drejta të trupit të saj u holluan, pas syzeve miope të Metodit. T'i lëmë të vdekurit në punën e tyre, foli Ibrahim. Metod Antrakidi e shihte Muhamedin me kureshtje, ndërsa Sara kishte marrë Anën në prehër dhe po i jepte një copë kek.

Sa vjeç janë djemtë, pyeti Mihal Komneni. Ibrahim rrinte i menduar dhe nuk e dëgjoi. Unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç, tha Jani. Niko është pesëmbëdhjetë, Muhamedi dymbëdhjetë dhe Aliu dhjetë vjeç. Nuk jam Niko, jam Paridi, tha Niko, ta thashë një herë. Jani nuk foli, por e pa të vëllanë me inat, ndërsa Ibrahim u përmend dhe u kthye nga i biri. Ti nuk bëhesh dot Parid, po u solle si Niko. Kur njeriu ndërron emrin, ndërron edhe sjelljen, tha Ibrahim. Unë do ta ndryshoj sjelljen, siç ndryshove ti baba, kur u bëre Ibrahim. Tani je më i urtë dhe e dëgjon Sarën më shumë se nënën tonë. Ibrahim pa Mihal Komnenin që buzëqeshte nga fjalët e Paridit dhe tha: Djemtë na futën në lojërat e tyre dhe tani nuk dalim dot. Edhe ne i kemi futur në lojërat tona dhe ata nuk do dalin dot asnjëherë, ia ktheu Mihali. Ç' do të thuash, e pyeti Ibrahim duke mbledhur vetullat. Dua të them se kur ti u bëre mysliman, solle në fshat një lodër të ngatërruar që i zëvendësoi gjithë lodrat e kalamajve, siç e pe dhe sot, tha Mihal Komneni. Këtë lodër nuk e solla unë. Atë e sollu Turqia, siç sollu ushtrinë, taksat dhe ligjet. Edhe vëllai yt u bë mysliman dhe për këtë nuk e kam fajin unë, tha Ibrahim. Gjergji nuk besonte në Islam. Ai do të bëhej edhe indian sikur ta dinte se kjo e torturonte babanë e vet. Ai kishte arsye të tjera dhe unë besoj se ai u bë mysliman vetëm për t'u hakmarrë ndaj babait, tha Mihali po pse duhej të hakmerrej yt vëlla ndaj Arianit Komnenit, pyeti Metodi. Histori e gjatë, tha Mihali që u shtriq në karrige, ndërsa këmisha e qëndisur i lëvizi si gjethe në trup.

Gjergj Komneni dyshonte se gruaja e tij ishte motra e Arianit Komnenit, tha Jani me zë të ulët. Ibrahim e pa Janin vëngër, ndërsa Sara e lëshoi Anën mbi qilim dhe, duke u zgjatur mbi tavolinë, e pyeti: Kush ta ka thënë ty këtë? Ma ka treguar Thanasi, tha Jani. Atij ia kishte treguar Ali Tepelena, të cilit ia kishte thënë vetë Gjergji, ditën që ata u takuan në shtëpinë tonë. Ali Tepelena është një mashtrues, tha Sara. Po atëherë vajzë e kujt ishte nëna e Hanës, pyeti Jani. Kjo nuk dihet, por tani nuk ka më asnjë rëndësi, tha Mihal Komneni duke dashur ta mbyllte bisedën.

Kjo dihet, tha Hana dhe të gjithë kthyen kokën.

Hana ishte futur në shtëpi dhe askush nuk e kishte parë. Ajo e ndiqte bisedën në këmbë, ndërsa fustani i lagur i ishte ngjitur në trup dhe flokët i pikonin mbi qafën e bardhë dhe të gjatë. Nëna ime ishte vajza e gjyshit të babait tim. Ai e mësoi këtë gjë pasi ata u martuan dhe pasi linda unë. Ditën që vdiq, babai erdhi në shtëpi dhe ma tha duke u dridhur nga etet e kolerës. Ai u martua me hallën e vet dhe këtë nuk ia fali kurrë Arianitit, i cili e dinte por nuk ia kishte thënë. Është e pamundur, foli Sara dhe pa me ngulm nga Mihal Komneni duke pritur që edhe ai të kundërshtonte. Por Mihali ishte mbështetur fort në karrige dhe nuk fliste. Koka i ishte varur mbi qëndisma dhe flokët e bardhë e kishin humbur krehjen. Është e vërtetë, tha Hana dhe u ul në vendin e saj, përballë Muhamedit. Ngriti kokën lart dhe i drejtoi sytë nga Sara. Në këtë fshat vetëm tre veta i kanë pasur sytë jeshilë. Babai i Arianit Komnenit, nëna ime dhe unë. Nëna nuk mund të ishte vajza e xhaxhait të Mihalit sepse ai ishte shterpë. Por ajo nuk ishte as vajza e vëllait të gjyshit të Ibrahimit sepse përndryshe im atë, që e dinte të vërtetën, nuk do më kishte

lënë të martohesha me Vasilin që ishte nip i tij. Unë jam një Komnene edhe nga babai, edhe nga nëna dhe për këtë më vjen mirë.

Sara nuk fliste dhe e mbante kokën mbi pjatë ku sytë jeshilë të Hana Komnenës mbinin si një gjethe maruleje. Ibrahim kishte afruar Anën pas vetes dhe mendonte se si fatet e dy familjeve ishin pleksur për të mos u ndarë më. Lindja e Anës ishte një fryt i përbashkët i dy pemëve, që prej shekujsh rrinin pranë e pranë, derisa një ditë kishin vendosur të përqafoheshin, për t'u ngrohur nga acari.

Ti je një grua e bukur që nuk duhet të plakesh duke kthyer kokën prapa, tha në mes të heshtjes Mihal Komneni duke e parë me qetësi mbesën e vet. Gratë nuk i plak e shkuara, por mungesa e burrit, tha Hana dhe u përlot. Ti je e re dhe e bukur, tha Sara për ta ngushëlluar dhe e largoi marulen nga pjata e vet. Po të kisha një fëmijë, jeta ime do ishte ndryshe, tha Hana, por me sa duket pulat jeshile të racës sonë nuk bëjnë vezë me gjelat e shtëpisë së Ibrahimit. E provoi nëna ime, e provova dhe unë, por më kot. Ku i dihet, tha Metod Antrakidi dhe Mihal Komneni filloi të qeshte fort dhe u çua nga karrigia e shkoi të përqafonte Hanën. U gabova kur thashë se ti je një grua pa humor, por një Komnene nuk mund të jetë kurrë e mërzitshme, tha ai dhe iu drejtua Ibrahimit: Gëzuar Ibrahim! Mëkatet e tua u lanë ditën që lindi një Komnene, e cila sot u bë dy vjeç. Gëzuar, tha Ibrahim duke ngritur gotën e verës mbi kokën e Anës. Mëkatet tona janë si gurë kalldrëmi, po i shkele të tregojnë rrugën. Gëzuar, tha dhe Sara që shkoi të përqafonte Hana Komnenën, e cila e mbante dorën e Mihalit si një gjerdan mbi qafë. Metod Antrakidi hoqi syzet, i la mbi tavolinë dhe i foli Ibrahimit. Urim i mençur, por jo gjithmonë i vërtetë. Rrugët e Voskopojës ishin të gjitha të shtruara dhe aty ku mbaronte kalldrëmi fillonte balta. Por një ditë balta u fut në qytet dhe e mbuloi kalldrëmin. Ne ikëm dhe balta mbeti e mbushur me gjurmët e mëkatit. Po t'i ndjekësh ato gjurmë, vetëm rrugën e barbarisë mund të gjesh.

Çfarë është Voskopoja, pyeti Paridi. Metodit i doli frymë nga gjoksi dhe zhurma e firomës së tij i ngjau një guri që shkëputet nga balta. Ngriti kokën nga Mihal Komneni dhe e pa në sy sikur po i merre te leje. Tregoja, ia bëri Mihali me kokë.

23

Voskopoja ishte një qytet i bukur jo shumë larg fshatit tuaj. Voskopoja ishte një botë e vogël e mbledhur në një dorë malesh. Aty kishte çdo gjë. Kishte ditë, kishte natë, kishte diell, kishte hënë, kishte qetësi, kishte fllad, kishte lule, kishte livadhe, kishte ketra, kishte lepuj, kishte zjarr, kishte vjeshtë, kishte pranverë, kishte pyll, kishte yll, kishte eklips, kishte zogj, kishte dashuri, kishte paqe, kishte nder, kishte falje, kishte ëmbëlsi, kishte jetë, kishte muzikë, kishte violinë, kishte martesë, kishte vdekje, kishte lindje, kishte djem, kishte vajza, kishte mësues, kishte nxënës, kishte shkollë, kishte dyqane, kishte drita, kishte rrugë, kishte hane, kishte kuaj, kishte shtëpi, kishte kisha, kishte priftërinj, kishte kambana, kishte mesha, kishte manastir, kishte libra, kishte germa, kishte shtypshkronja, kishte bibliotekë, kishte ikona, kishte piktura, kishte pemë, kishte dëborë, kishte lugina, kishte kroje, kishte ujë, kishte çezma, kishte pragje, kishte oborre, kishte lulishte, kishte shatërvanë, kishte mullinj, kishte qelq, kishte basma, kishte sëndukë, kishte flori, kishte para, kishte fëmijë, kishte lodra, kishte monumente, kishte mermer, kishte arkitektë, kishte ura, kishte kanale, kishte azil, kishte spital, kishte jetimore, kishte tregtarë, kishte punishte, kishte magazina, kishte pëlhura, kishte mëndafshe, kishte kafe, kishte sheqer, kishte kallaj, kishte xham, kishte kadife, kishte hekur, kishte bakër, kishte plumb, kishte pambuk, kishte atllas, kishte pasqyra, kishte gota, kishte porcelan, kishte lëkurë, kishte ilaçe, kishte tekstile, kishte armë,

kishte pishqolla, kishte vaj, kishte miell, kishte lesh, kishte velenxa, kishte duhan, kishte turistë, kishte marangozë, kishte druvarë, kishte fajdexhinj, kishte shkrimtarë, kishte këngëtarë, kishte bujq, kishte kovaçë, kishte samarxhinj, kishte kallajxhinj, kishte jorganxhinj, kishte bravapunues, kishte thikëpunues, kishte oxhakpunues, kishte berber, kishte xherahe, kishte barinj, kishte rrobaqepës, kishte kazanxhinj, kishte bojaxhinj, kishte qemerxhinj, kishte muratorë, kishte gurskalitës, kishte opingar, kishte armëtarë, kishte liri, kishte veri, kishte perëndim, kishte rregull, kishte ligje, kishte shqiptarë, kishte grekë, kishte jevgj, kishte të krishterë dhe prandaj kishte dhe alfabet.

Na lodhe, i tha Sara, më mirë na thuaj se çfarë nuk kishte. Metod Antrakidi mori frymë dhe pa nga Ibrahim sikur t'i kërkonte falje. Nuk kishte myslimanë, tha. Nuk gënjen, ndërhyri Mihal Komneni që rrinte në këmbë duke numëruar sendet e Metodit, por ka harruar të thotë se në Voskopojë kishte edhe Komnenë.

Po syzet e tua kush i bëri, kazanxhiu apo muratori, pyeti Aliu dhe Ibrahim qeshi. Syzet i kam blerë në Venedik dhe kur i vura për herë të parë nxënësit në Voskopojë më quajtën Mektodysyz Prapakidi. Kurse unë do të të quaja Me-kto-syz-ëndrra-kishi, tha Hana.

Ti nuk ndryshon shumë nga gratë e Voskopojës që u dashuruan me syzet e Metodit, foli Mihali. Aq sukses patën syzet e tij në qytet, sa që gratë filluan t'u kërkonin burrave apo të dashurve të tyre tregtarë të vinin syze sepse kështu dukeshin më të rinj dhe më të zgjuar. Burrat që filluan të mbanin syze quheshin nga të dashurat me përkëdheli mektosyçka. Njëherë i shkova një zonje të re në shtëpi kur burri tregtar kishte ikur në Rumani. Për t'ia bërë qejfin i mora syzet Metodit. Ajo u kënaq sepse e quajti këtë një shenjë respekti dhe atë natë e ndau vetminë me mua. Ndërsa njëherë tjetër që Metodit i duheshin syzet, unë shkova pa to dhe ajo më zboi dhe më tha: Ik Paktosyçka. Por dikush që më kishte parë i tha burrit të saj se një burrë me syze ia vizitonte gruan kur ai nuk ishte. burri i zuri pritë Metodit në shkollë dhe e rrahu në sy të nxënësve. Faqet iu ënjtën dhe syzet iu thyen derisa i porositëm një palë të tjera pas dy muajsh. Por, kur erdhën syzet, faqet e Metodit ishin akoma të nxira.

Djemtë qeshën dhe Hana e zuri Mihal Komnenin lehtë nga flokët sikur po e dënonte. Mihali gjithmonë i ka gjetur gratë me sytë e të tjerëve, tha Metodi. Po, tha Ibrahim, kur ishte i ri Mihali shikonte Zoicën me sytë e Mihalit. Hana dhe Sara panë nga Ibrahim për të kuptuar se ç'donte të thoshte, por Mihal Komneni i ra Metodit lehtë në sup dhe i tha: Çfarë the se nuk kishte në Voskopojë?

Harrova të them se në Voskopojë kishte shumë myshk. Në pranverë kur shkrinte dëborë livadhet përreth qytetit mbusheshin me një myshk bojë vjollcë që kur dielli e zinte në perëndim dukej blu. Gratë e mblidhnin myshkun dhe bënin parfume për vete dhe ilaçe për fëmijët. Në këtë stinë Voskopoja mbante era myshk dhe gratë mbarseshin duke e mbledhur. Gjnjtë, flokët, sqetullat dhe gjithë trupi ua thithte këtë aromë, që i dehte burrat e tyre. Shumica e fëmijëve të Voskopojës janë zënë në pranverë kur myshku ngrinte petalet e veta të vogla mbi tokë dhe kanë lindur në dimër kur, nën dëborë, myshku ushqehet me lagështi për të nxjerrë prapë kokën në pranverë. Myshku ia lidh barrën grave të dobëta dhe ia qetëson qarkullimin e gjakut burrave të lodhur. Nga myshku i është vënë emri Voskopojës që në kohët e lashta latinët e quajtën Muskopolis, ose Qyteti i Myshkut. Disa të mençur thonë se myshku, përveç aftësive shëronjëse, i dikto trurit të njeriut një dashuri më të madhe për natyrën, për artet, për të bukurën dhe për veten. Kjo mund të jetë e vërtetë sepse voskopojarët kanë qenë artistë të lindur dhe narcizistë të marrë dhe kjo dashuri për veten e ka zbukuruar qytetin. Por, vitet e fundit, tregtarët e mëdhenj, që financonin shkollat dhe librat, nuk pranonin që fëmijëve dhe të huajve t'u mësohej se Voskopoja ishte qyteti i arteve. Ata kërkonin që Voskopoja të mbahej mend si një qytet i ngritur nga tregtarët dhe

kështu vendosi edhe këshilli i të katërmbëdhjetëve, i cili jepte leje për botimet tona. Këshilli përbëhej nga përfaqësues të tregtarëve dhe kur këta u ankuan për një botim të Akademisë që quhej Voskopoja-Qyteti i artit kishtar, libri u ndalua të shitej dhe nuk u fut në bibliotekë. Këshilli vendosi që libri të rishkruhej dhe ai doli pas një viti me titullin Voskopoja, Tregtia, Arti dhe Kishat. Ambroz Gusta, që shkroi këtë histori të shkurtër të Voskopojes, gjeti një të mesme midis tregtarëve dhe priftërinjve dhe kështu libri u shtyp.

Por është e vërtetë se tregtarët kanë dhënë shumë për qytetin. Në qoftë se Voskopoja ishte si një trup i gjallë, tregtarët dhe zanatçinjtë ishin duart dhe këmbët, artistët ishin sytë dhe veshët, ndërsa priftërinjtë ishin truri. Pjesa tjetër ishin gojë që hanin dhe flisnin për tre të parët.

Voskopoja është në mes të udhës që shkon nga Adriatiku në Selanik dhe në Stamboll. Duke qenë midis maleve, ajo i ngjan një magazine natyrore ku karvanët pushonin, mallrat shkëmbeheshin dhe kuajt ndërroheshin. Tregtarët vendosën rregulla të forta për sigurinë e magazinave të tyre, të cilat ruheshin me burra të armatosur që paguheshin shtrenjtë. Mallrat që shkarkoheshin në portet e Adriatikut, tregtarët e Voskopojes i merrnin dhe i shpërndanin në të gjithë Perandorinë Turke dhe prej andej sillnin mallra që i duheshin hungarezëve, austriakëve dhe venedikasve. Tregtarët rrinin gjithë kohën nëpër rrugë dhe nëpër porte e dogana, ndërsa me paratë e tyre zanatçinjtë ndërtonin shtëpi të mëdha, rrugë, ujësjellës, shkolla, kisha dhe lulishte. Gjatë dimrit, kur rrugët bllokoheshin nga dëbora, tregtarët rrinin në qytet me gratë e tyre dhe me fëmijët, duke iu rrëfyer për qytetet që kishin parë dhe për madhësinë e tyre. Fëmijët donin të mësonin më shumë se baballarët dhe këta mblodhën para dhe ngritën shkollat, ku në fillim priftërinjtë u bënë mësues. Por kur fëmijët mbaruan shkollat ata nuk deshën të bëhen të gjithë priftërinj dhe disa u bënë tregtarë si etërit, disa ikën për të vazhduar studimet në shkolla të mëdha në Itali dhe Austri dhe disa mbetën duke u bërë mësues të fëmijëve të tjerë.

Voskopoja u rrit dhe qyteti u nda në trembëdhjetë lagje. Zanatçinjtë u grumbulluan në lagje sipas zanateve të tyre dhe kështu u formua lagjja e bakërxhinjve, arpunuesve, armëtarëve, këpucarëve, bojaxhinjve, ndërtuesve, kazanxhinjve, jorganxhinjve, sapunxhinjve, rrobaqepësve, samarxhinjve, lëkurxhinjve dhe artistëve. Secila nga trembëdhjetë lagjet zgjidhte një herë në vit një përfaqësues në këshillin e të trembëdhjetëve që drejtonte qytetin dhe vendoste për rregullin, për oraret e punës, për ndërtimet e reja, si dhe jepte leje për të ardhurit në Voskopoje. Qyteti u pasurua dhe mjaft fshatarë nga viset përreth, por edhe grekë që vinin për të gjetur punë atje. Në qoftë se këshilli i të trembëdhjetëve nuk e pranonte, të huajt nuk i jepej tokë për të ndërtuar shtëpi dhe lagjet nuk kishin të drejtë ta strehonin. Këshilli zgjidhte një kryetar, i cili drejtonte punimet e tij dhe vuloste vendimet që merrte këshilli.

Në vitin 1712 kryetar i Këshillit të të trembëdhjetëve ishte Johan Vulgari, babai i Eugjen Vulgarit të ndritur që përktheu Volterin dhe që u bë mësues në të gjitha shkollat e mëdha greke nga Kostandinopoja në More. Johan Vulgari vinte nga lagjja e sapunxhinjve. Ai kishte qëndruar dhjetë vjet kryetar i këshillit të të trembëdhjetëve dhe mendonte se ishte i pazëvendësueshëm. Ishte bërë fodull dhe i pasjellshëm. Nuk pyeste shumë për këshillin dhe kishte filluar t'i merrte vendimet në kokë të tij. Në vitin 1706 disa tregtarëve të lëkurëve u ishin mbytur dy anije të mëdha me mall në Durrës. Ata i kishin kërkuar ndihmë Johan Vulgarit që të shkonte bashkë me ta në Durrës për t'u kërkuar autoriteteve të portit që t'u paguanin atyre paratë për dëmin. Por Johan Vulgari nuk shkoi në Durrës dhe tregtarët i humbën paratë e tyre. Në qytet u hap fjala se një natë, duke pirë me shokët e tij Johan Vulgari kishte thënë: Më mirë që u mbyt lëkura në det se era e saj na qelbte qytetin. Që atëherë tregtarët e lëkurës ishin në hasmëri me Johanin dhe votonin gjithnjë kundër tij.



Në 1712 do të bëheshin zgjedhjet për këshillin dhe për kryetarin e ri. Tregtarët e lëkurës u lidhën me përfaqësues të tjerë në këshill dhe arritën të bënin aleatë edhe gjashtë prej tyre. Johan Vulgari e mori vesh se kundërshtarët e tij kishin mbledhur shtatë vota në këshill dhe ai nuk mund të zgjidhej më kryetar i të trembëdhjetëve vetëm me gjashtë votat që kishte. Atëherë, pa pyetur këshillin, Johani vendosi që në Voskopojë të ngrihej një lagje e re me të huaj, e cila do të ishte lagjja e katërbëdhjetëve. Ai firmosi menjëherë kërkesat e shumë fshatarëve që prisnin prej vitesh të bëheshin qytetarë të Voskopojës dhe i dha atyre të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Këshill. Shumica e tyre ishin myslimanë të ardhur nga fshatrat e Kolonjës, Devollit dhe Beratit, të cilët deri atëherë nuk ishin pranuar në qytet. Kundërshtarët në këshill bënë zhurmë dhe u ankuan se Johan Vulgari po ngrinte një lagje me të huaj dhe me myslimanë në Voskopojë dhe çështja i shkoi kadiut të Korçës. Kadiu i dha të drejtë Johan Vulgarit duke thënë se Voskopoja ishte një qytet në Perandorinë Turke dhe myslimanët nuk mund të përjashtoheshin nga asnjë vend dhe se çdo vendim, që nuk i lejonte ata të jetonin ku të donin nuk do të ishte i vlefshëm. Kështu, këshilli i të trembëdhjetëve u bë me katërbëdhjetë vetë dhe kur u votua, Johan Vulgari mori shtatë vota pro dhe shtatë kundër dhe vazhdoi të qëndronte kryetar, por kishte humbur mbështetjen e shumicës së qytetit dhe sidomos të priftërinjve, të cilët u acaruan nga ardhja e myslimanëve. Për t'i zbutur, Johan Vulgari, që ishte një i krishterë dinak i dha atyre para, nga arka e këshillit, për mbaruar katedralen e madhe të Shën Mërisë në qendër të Voskopojës, e cila kishte filluar prej 1696 dhe ende nuk kishte përfunduar. Muret dhe dhomat e katedrales ishin ngritur, por ajo kishte mbetur bosh nga brenda, si një haur i madh. Njerëzit që i zinte nata në Voskopojë e përdornin ndërtesën për të fjetur dhe për të çlodhur kuajt. Johan Vulgari thirri piktorët më të mirë nga Korça dhe Berati dhe këta pikturuan afreske dhe ikona të shkëlqyera dhe të ndritshme me luspa, të cilët e habitën gjithë qytetin. Njëri prej tyre ishte David Selenica. Kur ai pikturonte, hipur mbi skelat e larta, fëmijë, pleq dhe gra mblidheshin duke e kundëruar dhe harronin se bojërat e tij u pikonin mbi rroba. Një mëngjes, dy gra që erdhën nga fushat, pasi kishin mbledhur myshk, u ndalën duke parë piktorin që ishte përlyer i gjithi me bojëra dhe dukej si një ylber. Ju pëlqen, i pyeti Davidi që e kishte zakon të fliste me njerëzit kur punonte. E bukur, por e ftohtë, tha njëra nga gratë. Një kishë pa lule është si një shtëpi pa grua. David Selenica e la punën për tri ditë dhe u mendua gjatë për fjalët e gruas. Kur u kthye mbi skelë, sytë i kishin marrë ngjyrë livadhi dhe në thilenë e këmishës kishte vënë një gjethe myshku. Atë ditë, për herë të parë, David Selenica pikturoi në muret e një kishë rrush, grurë, bukë, hardhi, lule me shumë ngjyra dhe myshk bojëvjollce. Murgjit e ngurtë të Voskopojës shkuan te Davidi dhe e pyetën se pse kishte dalë nga korniza e rreptë e piktores kishtare dhe ai duke qeshur i tha: Engjëjt dhe shenjtorët kanë jetuar në natyrë. Ata janë ushqyer me rrush dhe janë shëruar me myshk prandaj jetojnë akoma.

Katedralja e Shën mërisë përfundoi atë vit, pas trembëdhjetë vite pritje dhe Johan Vulgari i tha këshillit se po të mos ishte zgjedhur kryetar ajo nuk do të mbaronte kurrë. Për të përjetësuar vitin e zgjedhjes së tij Johani i kërkoi gurgdhendësve që në portën e madhe të hyrjes të shënonin vitin 1712 si vit i ndërtimit të katedrales. Për t'i bërë qejfin edhe priftërinjve, por edhe myslimanëve që e ndihmuan të zgjidhej, Johan Vulgari vendosi që data e ndërtimit të gdhendej edhe sipas kalendarit grek edhe sipas atij arab, dhe kështu u bë.

Katedralja u përrua të dielën më datë 2 tetor 1712 dhe më shumë se një mijë veta morën pjesë në meshën e madhe. Kur njerëzit dilnin të mahnitur nga bukuria e katedrales, djem dhe vajza të vogla, të porositur nga Johan Vulgari, i gostitnin besimtarët me rrush dhe kumbulla, të cilat i mbanin në shporta prej kashte.

Por, siç thashë, që nga viti 1712, Voskopoja u bë me katërbëdhjetë lagje, por tani ishin të huaj ata që vendosnin për punët e këshillit. Johan Vulgari u lëshoi të huajve toka të reja për shtëpi dhe iu dha të drejtë fëmijëve të tyre të studionin në shkollat e Voskopojës. Në lagjen e tyre të re u ndërtua edhe jetimorja e Voskopojës ku strehoheshin fëmijët jetimë të ushtarëve të vrarë apo fëmijë të gjetur që filluan të vinin edhe nga Korça dhe fshatrat përreth. Disa nga këta fëmijë, kur u rritën, krijuan më pas banda të armatosura që kërcënonin tregtarët dhe në qoftë se këta nuk u jepnin para ata u merrnin mallin, por edhe i vrisnin. Disa vjet më vonë kur lagja e të huajve u zmadhua, përfaqësuesi i tyre në këshill kërkoi që të ndërtohej një xhami. Johan Vulgari, duke qenë peng i tyre hezitoi, por këtu humbi mbështetjen e përfaqësuesve të tjerë, të cilët u bashkuan dhe e shkarkuan Johanin si kryetar. Këshilli u bë një dhe vendimi për ngritjen e xhamisë nuk u mor kurrë. Për të zbutur myslimanët që ishin shtuar në numër, tregtarët vendosën t'i jepnin atyre para për të rregulluar lagjen me rrugë, me kalldrëme, me çezma dhe mjaft prej tyre i morën në punë për të shoqëruar karvanët.

Në 1730 shkollat e Voskopojës kishin nxjerrë mjaft të rinj të etur për të mësuar dhe disa prej tyre ishin kthyer nga shkollat që kishin bërë në perëndim. Ata kishin studiuar artin dhe filozofinë e italianëve, francezëve dhe gjermanëve dhe kishin mësuar të bënin libra. Por librat e tyre nuk mund t'i shtypnin në Evropë sepse kjo kushtonte, prandaj ata i kërkuan këshillit para për ngritjen e një shtypshkronje, e cila u ble në Venedik dhe shtypi për shumë vjet me dhjetëra libra dhe përkthime dhiatash nga autorët voskopojarë. Ditën që shtypshkronja erdhi me karvanë në Voskopojë, fëmijë, pleq, burra dhe gra, të krishterë e myslimanë, u grumbulluan në sheshin e qytetit duke parë sesi shkarkoheshin nga samarët e kuajve pjesët dhe rrotat e zeza prej hekuri. Ato u morën një nga një dhe u vendosën në një bodrum në themelet e Katedrales së Shën Mërisë. Dy italianë erdhën nga Venediku dhe i bënë pjesët bashkë. Ata sollën bojë dhe letër dhe ditën që nga makina doli faqja e parë në Voskopojë u bë festë.

Kryetari i Këshillit doli përpara njerëzve dhe tha: Voskopojarë, tregtarë, priftërinj dhe zanatçinj, shkrimtarë, nxënës dhe mësues, burra dhe gra. Të gjithë ju tani mund të flini të qetë. Edhe sikur qyteti ynë të digjet dhe të harrohet, kjo shtypshkronjë do t'u tregojë brezave lavdinë tonë. Njerëzit gëzonin dhe fëmijët fusnin kokën nëpër të çarat e bodrumit të kishës për të parë shtypshkronjën që bënte zhurmë, si një kafshë e uritur që përtyt letër. Pasi italianët u larguan, punët në shtypshkronjë i drejtoi Grigor Jeromonaku, një murg i ri i cili flinte në katedrale natë ditë dhe vajrat që i derdheshin në kokë dhe copat e letrës prej pambuku që i mbushnin flokët, bënë që fëmijët ta kishin frikë, sepse dukej gjithnjë si një fantazmë. Grigori i rregullonte fletët prej pambuku dhe i priste, e pastaj murgjit e tjerë i lidhnin me kujdes duke shpuar faqet një nga një me disa thika dhe gërshërë që i kishin sjellë italianët. Grigori i vizatonte kapakët e librave dhe i mbushte me figura shenjtorësh dhe fëmijësh të rrethuar me fletë si dhe kafshë biblike, por shpesh edhe pagane. Kur u shtyp libri i parë që ishte një alokuthi për Teodorën, ose një libër shërbesash, Grigori e zbukuroi kapakun me një vizatim të kalit Pegasus që fluturonte mbi Voskopojë. Kur e pyetën se pse zgjodhi Pegasin, ai tha se dituria është një gjë që vjen dhe ikën njëlloj si ai kalë i bardhë që askush nuk e mban dot, nëse nuk ia pret krahët.

Kur në vitin 1750 u formua Akademia në Voskopojë erdhën shumë të rinj nga qytete të tjera për të studiuar. Ato ishin ditët më të ëmbla të qytetit. Studentë të rinj, të veshur me këmbishe të bardha dhe flokë të gjata, ecnin rrugëve të qytetit me libra në duar duke folur për filozofët dhe për letërsinë. Vajzat e Voskopojës dilnin në dyert e shtëpive dhe shikonin djemtë. Këta u flisnin dhe u kërkonin takime. Shumë të rinj u afruan dhe në mbrëmje Voskopoja i ngjante një biblioteke të madhe, ku njerëzit mësonin të lexonin libra për të shkruar pusulla dashurie. Baballarët tregtarë ktheheshin nga udhëtimet e tyre dhe i gjenin vajzat ose djemtë të fejuar.

Tavernat ishin të mbushura me ceremoni fejesash dhe dasmash, kremtimi i të cilave nuk bëhej më vetëm nëpër shtëpi. Krushqitë mbylleshin nëpër këto taverna që në darkë jehonin nga këngët, urimet dhe shkëmbimet e pajave. Studentët kishin vendet e tyre ku plekseshin me njëri-tjetrin në netët e gjata të dimrit dhe pinin duhan që e përzienin me pak myshk të thatë që ta merrte mendjen de që plakat e qytetit zakonisht e përdornin për të nxjerrë një çaj që i qetëson stomakët e lodhur. Në këto taverna, në mbrëmje, mblidheshin këngëtarë, piktorë dhe poetë, të cilët pasi pinin, recitonin poezitë e tyre me vargje të lehta dhe ritmike duke hipur majë karrigeve. Kur poezia pëlqehet, studentët i përplasin gotat e drunjta mbi tavolinë. Këto taverna ishin nëpër rrugicat e ngushta të qytetit dhe shpesh njerëzit ankoheshin nga zhurma e studentëve dhe poetëve të dehur. Njëherë, në një tavernë në lagjen e kazanxhinjve, njëri prej poetëve po festonte ditëlindjen me shokët e tij. Poeti kishte marrë disa muzikantë që i ranë violinave dhe buzukëve deri në mëngjes. Aq zhurmë dhe potere u bë atë natë, sa që kazanxhinjtë dolën nga shtëpitë dhe i kërkuan djemve ta ndalnin festën, por këta u tallën dhe vazhduan të këndojnë. Atëherë kazanxhinjtë morën kazanët e tyre, shkuan te dera e tavernës dhe filluan t'i binin kazanëve me shufra hekuri. Djemtë u shurdhuan dhe ikën me vrap, ndërsa kazanxhinjtë i ndiqnin nga pas duke i sharë dhe duke i rënë kazanëve si daulle. Që atëherë doli fjala se kazanxhinjtë e Voskopojës rrahin kazanët e tyre.

Por jo gjithmonë Voskopoja ishte kaq e virtytshme dhe idilike. Pasuria u shtua, por bashkë me të u rrit edhe zilia. Turqia kishte marrë nën kontroll shumicën e porteve të Adriatikut dhe mjaft tregtarëve iu mbyllën rrugët për në Venedik. Vetë Venediku ishte dobësuar pas luftërave të gjata me turqit dhe porte të tjera si Gjenova, Napoli apo Trieste kishin marrë fuqi në det duke përfutur nga armiqësia e venedikasve me Portën e Lartë. Konkurrenca e fortë që tregtarët kishin me njëri-tjetrin kishte nxitur hasmërinë mes tyre dhe shumë prej tregtarëve mbetën pa punë. Fshatarët, jetimë, myslimanë, çobanë, karvanarë të liruar dhe njerëz të papunë e dembelë kishte plot nëpër qytet. Disa prej tyre kishin krijuar banda të rrezikshme dhe të mëdha siç ishte banda e çobanëve, banda e myslimanëve dhe banda e sevdallinjve që rrëmbente vajza të varfra dhe shiste me para tek udhëtarët e uritur. Zakonisht, bandat krijoreshin mbi bazën e lagjeve dhe në mes të viteve gjashtëdhjetë pothuajse çdo lagje kishte bandën e vet që e mbronte nga bandat e lagjes tjetër. Këta burra të ashpër i zinin pusë njëri-tjetrit natën dhe në Voskopojë njerëzit filluan të kenë frikë dhe të mbyllën në shtëpi pa u ngrysur. Tregtarët detyroheshin t'i paguanin bandat që të mos u grabisnin depot dhe natën, nëpër taverna, banditët pinin dhe ndanin paratë. Zënkat që kishin mes tyre tregtarët e dobësuan këshillin e të katërmëdhjetëve, i cili e mbyllte njërin sy përballë fuqisë së bandave sepse pa ndihmën e tyre ishte bërë e vështirë të fitoje vota për t'u zgjedhur sërish. Një djalë i fortë dhe qejfi që ishte kryetar i bandës së çobanëve dhe kishte shumë armë sepse ishte formuar në lagjen e armëtarëve, mendoi se kishte ardhur dita që ai të zgjidhej anëtar i këshillit të të katërmëdhjetëve.

Kur u bënë zgjedhjet në vitin 1764, ai doli nëpër lagje dhe u tha njerëzve se nëse zgjidhej në këshill ai do t'i hiqte taksat për të varfrit dhe do t'i detyronte tregtarët të paguanin më shumë para për të ndërtuar azile për pleqtë dhe spitale të reja për të sëmurët. Marin Kurila ishte i gjatë, i bukur dhe një orator i shkëlqyer. Ai kishte mësuar të lexonte dhe historitë e tij të dashurisë e kishin bërë të famshëm. Kur vendosi të zgjidhej në këshill, Marin Kurila i shkurtoi flokët e zinj, mbathi një palë pantallona shajaku me rrip të trashë, qëndisi dy pisqolla të arta që kryqëzoheshin në këmbë të tij, vari një kryq të bardhë në kyçin e dorës së majtë, lidhi një shall të kuq në qafë dhe shkoi derë më derë të takonte njerëzit. Burrat e kishin frikë, por gratë hutoheshin nga bukuria e tij. Kur ai dilte nëpër lagje në pranverë, njerëzia dilnin nëpër sokakë. Përpara tij ecte një djalë i vogël që e kishin mësuar të bërtiste: Marin Kurila, mbrojtësi i Voskopojës. Marini ndalonte dhe

bisedonte me burrat dhe i hidhte vështrime të ëmbla grave dhe vajzave. Ai u premtoi të gjithëve atë që i kërkuan. I përqafonte pleqtë dhe i ledhatonte fëmijët e vegjël që filluan t'i kërkojnë prindërve që t'i vishnin si ai. Shumë shpejt djemtë dhe burrat e lagjes së armëtarëve lidhën shalle të kuq në qafë dhe filluan t'i qëndisnin këmbët me armë të vogla prej mëndafshi. Vajzat e reja shkonin në kishë dhe luteshin për Marin Kurilën. Në atë kohë, përfaqësues i lagjes së armëtarëve në këshillin e të katërbëdhjetëve ishte një tregtar i madh armësh, i cili kishte shumë miq sepse gjithmonë i kishte mbrojtur interesat e tyre dhe në saje të tij lagjja kishte përfituar shumë para për ndërtime nga arka e këshillit. Ai kishte një vajzë të bukur, së cilës thonë se Marin Kurila ia mori mendjen duke i premtuar se do martohej me të. Marini i hipte kalit, dilte jashtë Voskopojës, shkonte në livadh dhe i sillte vajzës tufa me lule të freskëta. Në mbrëmje, kur mbaronte takimet nëpër lagje, Marini e lidhte shallin e kuq te doreza prej hekuri e shtëpisë së vajzës dhe ajo dilte dhe e merrte shallin e tij, që e mbante gjithë natën poshtë jastëkut, për t'ia lënë në të njëjtin vend të nesërmen në mëngjes. Marin Kurila që kalonte netët nëpër taverna me shokët e tij, një herë shkoi në tavernën e poetëve dhe e detyroi njërin prej tyre t'i bënte një poezi për të dashurën. Nuk e kam parë kurrë atë vajzë dhe nuk e bëj dot, i tha poeti. Po ta kishe parë nuk do ishe kaq budalla, ia ktheu Marin Kurila dhe të gjithë qeshën. Po çfarë të shkruaj, e pyeti poeti i frikësuar. Marin Kurila u mendua, hipi mbi një karrige siç bënin poetët kur recitonin dhe tha: Shkruaj që shalli im do bëhet kurorë mbi kokën e nuses, kurse sytë e saj do bëhen vetulla e pisqollës time. Poeti shkroi një vjershë me tri strofa të gjata dhe i tha Marinit t'i gjente një titull. Titulli është: Marin Kurila i drejtohet së shtrenjtës vashë, tha ai dhe e firmosi në fund. Njerëzit e Kurilës ia çuan vajzës poezinë dhe ajo nuk fjeti gjithë natën duke ëndërruar.

Me ndihmën e kësaj vajze, Marin Kurila u takua një natë me babanë e saj dhe të nesërmen ky shpalli se nuk donte të zgjidhej më në këshill dhe se do të mbështeste Marinin. I ati i vajzës thirri gjithë armëtarët e tjerë dhe i bindi të bënin të njëjtën gjë. Marin Kurila u kërkoi atyre para dhe i premtoi se pasi të zgjidhej ai do të detyronte këshillin, që, duke kushtëzuar tregtinë me qytete të tjera si Korça, Janina, Berati dhe Elbasani, të nënshkruhej një pakt, sipas të cilit tregtinë e armëve në gjithë këto qytete kishin të drejtë ta kryenin vetëm tregtarët e Voskopojës. Do bashkoj gjithë bandat e Voskopojës dhe do kemi një ushtri më të pasur dhe më të fortë nga gjithë qytetet e tjera. Në qoftë se ata nuk na e japin paqen për armët tona, ne do t'ua marrim paqen me armët tona, thoshte Kurila duke i hipnotizuar tregtarët siç kishte bërë me vajzat e tyre.

Fama e Marin Kurilës së bukur dhe të fortë u përhap me shpejtësi në gjithë qytetin. Djemtë e lagjes së armëtarëve shkonin në shkollë me shallat e kuq të Kurilës në qafë dhe i mburreshin shokëve nga lagjet e tjera për forcën dhe trimërinë e tij. Burrat flisnin për Marinin dhe gratë kishin kureshtje për ta parë si vishej dhe si fliste. Marini filloi të shkonte pasditeve në lagjet e tjera dhe kur takonte njerëzit u thosh se ai ishte mbrojtësi i Voskopojës dhe se kur të zgjidhej në këshill, qyteti do ndryshonte, shkollat do shtoheshin, dhe do të kishte rregull. Do t'i përzë gjithë hajdutët, të papunët dhe dembelët nga ky qytet, tha Marin Kurila një ditë. Kush nuk është i aftë të gjejë një punë, nuk ka pse jeton këtu. Kush vjedh, dëbohet. Kush vret, shkishërohet. Në Voskopojë do jetojnë vetëm ata që dinë të lexojnë, që shkojnë në kishë dhe që punojnë. Fëmijët në shkollë, gratë në shtëpi, burrat në punë, kjo është Voskopoja ime, bërtiste Marin Kurila kur njerëzit grumbulloheshin duke dëgjuar fjalimet e tij të zjarrta që gjithmonë mbylleshin me thirrjet e shokëve të tij: Marin Kurila po vjen, Voskopoja po shkëlqen! Marini ishte bërë mjeshtër i fjalimeve përpara turmave, të cilat e dëgjonin me gojën hapur. Një ditë kur ai po fliste, një burrë, që më vonë u mor vesh se ishte vënë nga vetë Kurila dhe ishte shok bande me të, thirri: Marina Kurila duhet të bëhet kryetar i qytetit. Njerëzit e dëgjuan dhe filluan t'i kërkonin në kor Marin Kurilës që të pranonte. Perëndia vendos dhe unë bindem, tha Marin Kurila solemnisht dhe

bëri kryqin duke parë nga qielli. Njerëzit u përplotën dhe u falën bashkë me të. Të nesërmen Marin Kurila doli në qytet me një mantel të gjatë të bardhë në të cilin kishte qëndisur stemën e Voskopojës dhe një kryq të gjatë që rrethohej nga dy pisqolla të harkuara. Me hap të madh dhe duke i folur të gjithë njerëzve që i ndeshi në rrugë, ai hyri në kishë dhe mori pjesë në meshë. Njerëzit i hapnin rrugën dhe Marin Kurila u ul në vendin e parë përballë altarit, hoqi pelerinën dhe e palosi me kujdes mbi gjunjë. Kur doli nga kisha kaloi përballë ndërtesës ku mblidhej këshilli dhe u ndal duke e parë. Njerëzit rrinin rreth tij dhe prisnin se çfarë do të thoshte, por Marin Kurila vuri dorën mbi stemën që kishte në gjoks dhe nuk foli. Tri ditë me radhë nuk doli nga shtëpia dhe i kërkoi shokëve të tij t'i thërrisnin një për një përfaqësuesit e lagjeve të tjera. Pesë prej tyre erdhën në takim, por përfaqësuesi i sapunxhinjve, që ishte dhe kryetar i qytetit, i bllokoi të tjerët, mes të cilëve përfaqësuesin e lëkurëpunuesve dhe për shkak të tyre dhe atë të këpucarëve. Po ashtu përfaqësuesi i bakërxhinjve, që nuk erdhi vetë, bindi edhe atë të kazanxhinjve. Edhe jorganxhinjtë dhe rrobaqepësit nuk u dukën në shtëpinë e Marin Kurilës dhe bashkë me ta as përfaqësuesi i lagjes së të huajve, të cilët kishin frikë se Marin Kurila do t'i dëbonte ata nga Voskopoja.

Që nga koha e Johan Vulgarit, gjithë qytetin e kishin drejtuar përfaqësuesit e lagjes së sapunxhinjve, të cilët kishin aleatë të fortë në këshill ku votat ishin të lidhura sipas interesave dhe zanateve. Marin Kurila e kuptoi se me këtë ndarje votash ai nuk do mund të zgjidhej kryetar dhe shkoi në të gjitha tavernat e qytetit duke sharë kryetarin e këshillit. Voskopoja është turpëruar që kur këtë qytet e drejtojnë sapunxhinjtë, tha ai. Por mëkatet e Voskopojës nuk lahen me sapun. Voskopoja nuk mund të jetë qyteti i sapunit, por ai do të jetë qyteti i armëve dhe i burrave që dinë t'i përdorin ato. Sapunët janë për gratë dhe armët janë për burat. Jorganët janë për frikacakët dhe këpucët janë për zbatharakët. Këshilli i qytetit është kthyer në një bandë të tregtarëve të poshtër që u shesin njerëzve sapun të përdorur, jorganë të shkurtër dhe këpucë me lëkurë gomari. Do ta shkatërroj këtë këshill sepse koha është e armëtarëve dhe jo e këpucarëve, koha është e burrave trima dhe jo e jorganëve me vrima.

Marin Kurila fliste dhe manteli i tij e mbulonte gjithë tavernën e mbushur plot me burra me sy të kuq. Ai akuzonte edhe lagjen e të huajve dhe thoshte se Voskopoja ishte prishur që ditën që Johan Sapunxhiu, siç e quante ai Johan Vulgarin, i pranoi ata në këshill dhe e bëri qytetin me katërmbëdhjetë lagje. Kur erdhën ata, filluan vjedhjet dhe poshtërimet. Vajzat tona kanë frikë të dalin në rrugë nga të papunët dhe dembelët që rrinë në qoshet e rrugëve dhe u flasin me fjalë të ndyra. Qyteti e humbi bekimin e perëndisë kur prishi numrin 13 që është numri magjik, sepse 13 ishin dhe Krishti bashkë me apostujt e tij dhe 13 vjet u deshën për ndërtimin e Katedrales së Shën Mërisë. Do ta bëjmë Voskopojën prapë qytetin e numrit trembëdhjetë, thoshte Marin Kurila dhe e puthte trembëdhjetë herë kryqin e qëndisur mbi pelerinën e bardhë.

Një natë, pesë ditë para zgjedhjeve të këshillit, pas shumë fjalimeve të zjarrta ku merrnin pjesë të gjithë, shokët e përcollën Marinin në shtëpi. Pastaj u drejtuan pa zhurmë në lagjen e sapunxhinjve hapën depot e sapunit, i çanë thasët e mbushur dhe sapunin e shpërndanë nëpër kalldrëmet me gurë. Atë mëngjes ra një shi i qetë dhe kur njerëzit dolën nga shtëpitë shumë prej tyre shkanë dhe disa pleq thyen krahët dhe kërbishtet, pa e kuptuar se pse. Kur tregtarët panë depot e boshatisura dhe thasët e shqyer i kërkuan këshillit të mblidhet dhe të dënojë bandën e çobanëve, të cilën e akuzuan për grabitje.

Tri ditë para zgjedhjeve, Marin Kurila u thirr në këshill për t'u pyetur për ngjarjet. Ai shkoi me vonesë në mbledhje dhe, megjithëse i thanë të ulej, qëndroi gjithë kohën në këmbë. Kur anëtarët e këshillit flisnin, Marin Kurila qeshte dhe e shikonte kryetarin në bebe të syrit. Nga jashtë dëgjohej zhurma që bënin shokët e Marin Kurilës bashkë me dhjetëra djem të rinj, të cilët

mbanin në qafë shallin e kuqe. Kur u pyet, Marini e mohoi se banda e tij kishte gisht në hapjen e depove. Ne nuk na duhet sapun sepse nuk kemi mëkate për të larë, tha ai. Shkoni të kërkoni diku tjetër. Përfaqësuesi i këpucarëve ishte më i egri dhe e quante Marin Kurilën zbatharak. Ndërsa përfaqësuesi i lagjes së të huajve i propozoi këshillit që Marin Kurila të përjashtohet nga zgjedhjet, sepse në rast se ai fitonte, paqja në qytet ishte e rrezikuar. Atë e mbështetën edhe disa anëtarë të tjerë, por aleatët e Kurilës në këshill dhe sidomos babai i vajzës kundërshtuan dhe e mbrojtën fort. Në fund, të katërmbëdhjetë ranë dakord që propozimin ta vendosnin me votë të fshehtë. Morën një gotë të madhe balte dhe aty hodhën votat një nga një. Votimi doli shtatë me shtatë dhe Marin Kurila u tall dhe tha: Ja pse duhet që ky këshill të ketë trembëdhjetë vetë. Dhe ashtu do jetë pas disa ditësh. Ai falënderoi babanë e të dashurës, hapi pelerinën, përplasi takat fort dhe doli. Jashtë u prit si një hero dhe gjithë natën festoi në tavernë duke pirë. Ndaj të gdhirë u tha shokëve se do shkonte tek e dashura dhe iku duke kënduar.

Në mëngjes e gjetën të vrarë përpara shtëpisë së vet. I kishin ngulur një thikë në ijë dhe një në zemër, aty ku mbante stemën e Voskopojës. Fytyra e tij e bukur ishte zbardhur, ndërsa shallin e kuq e kishin ngulur me thikë mbi derën e shtëpisë. Shalli lëvizte nga era, por, si një rob, nuk lirohej dot nga thika. Pelerina e bardhë e Marin Kurilës kishte mbuluar gurët e gjakosur të kalldrëmit. Shokët e tij e ngritën dhe pasi e pastruan dhe e zbukuruan e shtrinë mbi një shtrat të madh hekuri në oborrin e shtëpisë së tij. Gjithë lagjja e armëtarëve u mblodh për të parë Marin Kurilën. Gratë qanin dhe burrat shtrëngonin muskujt e qafës që i kishin lidhur me shalle të kuqe. E dashura e Marinit e kishte kapur shallin e tij me karfica mbi kokë, si një kurorë mbi flokët e saj të verdha. Pasdite, trupin e Marinit e çuan në Katedralen e Shën Mërisë jashtë dyerve të së cilës rrinin mijëra njerëz të trembur. Kur mbaroi mesha, shokët e mbajtën Marin Kurilën në krahë dhe e shëtitën nëpër të gjitha lagjet e qytetit, me përjashtim të lagjes së sapunxhinjve dhe të të huajve. Në të errur arritën në varreza. Gjithë njerëzit që shoqëruan trupin ndezën qirin dhe qyteti nga lart dukej si një kishë e madhe në natën e pashkës. Pas varrimit njerëzit nxituan të futen nëpër shtëpi dhe i shuan qirinjtë shpejt. Kur u zgjuan, mbi kryqin e madh të Katedrales së Shën Mërisë, ishte lidhur një shall i kuq, ndërsa në lagjen e të huajve u gjetën 14 të vdekur mes të cilëve edhe përfaqësuesi i tyre që kishte propozuar përjashtimin e Marin Kurilës. Kryetari i këshillit dha dorëheqjen, ndërsa tregtari i madh i armëve mori të bijën, ngarkoi karvanët dhe u largua nga qyteti.

Shokët e Marin Kurilës vunë një tra të madh në hyrje të qytetit dhe nuk lejonin asnjëri të dilte apo të hynte pa lejen e tyre. Këshilli u shpërnda dhe ata morën në dorë qytetin. Karvanët me mall që hynin në qytet kontrolloheshin një për një dhe tregtarëve u merrej një taksë në hyrje. Tregtia e sapunëve dhe lëkurëve u ndalua. Tregtarëve iu kërkua t'i hiqnin nga puna gjithë hyzmeqarët nga lagjja e të huajve dhe sidomos myslimanët. Nëpër lagje u caktuan grupe djemsh të armatosur, të cilët mbanin shalle të kuq dhe i pyesnin njerëzit ku shkonin dhe nga vinin. Burgu i qytetit u mor nën kontroll dhe për disa javë me dhjetëra të huaj, tregtarë të sapunit dhe myslimanë u mbyllën atje. Oraret e lëvizjes në qytet ndryshuan. Askush nuk lejohej të dilte nga shtëpia pas orës gjashtë të mëngjes. Shokët e Marin Kurilës i kërkuan Grigor Jeromonakut që të shtypte disa lajmërimi, të cilat u varën në muret e çdo lagjeje dhe që përcaktonin ndalimet që ata kishin vendosur. Grigori në fillim kundërshtoi dhe tha se mbyllja e qytetit do ta izolonte Voskopojën, por ata e kërcënuan dhe i thanë se nëse nuk bindej, shtypshkronja do të mbyllej dhe ai do burgosej. Grigori u zbut dhe për dy ditë me radhë punoi për të shtypur lajmërimet. Në to shpjegohej se masat e reja ishin vendosur pas vrasjes së Marin Kurilës për të cilën akuzohej një pjesë e këshillit të vjetër, si dhe myslimanët e lagjes së të huajve. Masat do të kishin një kohëzgjatje të papërcaktuar, siç thuhej, deri në vendosjen e qetësisë në qytet dhe ngritjen e këshillit të ri prej

trembëdhjetë anëtarësh. Në lajmërim thuhej se zgjedhjet, për vetë kushtet që ishin krijuar, pas vrasjes së Marin Kurilës ishin të pamundura. Por, derisa fajtorët të gjendeshin dhe të dënoheshin, masat e mëposhtme ishin të domosdoshme. Hartuesit shkruanin se këto masa merreshin për të mirën e qytetarëve të Voskopojës, jeta dhe pasuria e të cilëve ishte e rrezikuar nga bandat e të huajve, të cilët kishin një plan të fshehtë për të pushtuar qytetin dhe për të dëbuar të gjithë qytetarët e tij, duke iu marrë atyre shtëpitë dhe pasuritë.

Masat ishin: 1. Ndalohet dalja nga shtëpia pas orës gjashtë në mbrëmje. 2. Asnjë dyqan dhe tavernë nuk hapet pas kësaj ore. 3. Tavernat nuk mund t'u shesin klientëve të tyre verë pas orës dy të drekës. 4. Tregtia e sapunëve dhe e lëkurëve nuk lejohet. 5. Në shkolla nuk pranohen fëmijë nga lagja e të huajve. 6. Mësuesit t'u tregojnë nxënësve se Voskopoja u sulmua nga disa të huaj dhe tregtarë të lidhur me ta, të cilët vranë pabesisht qytetarin e nderuar, mbrojtësin e Voskopojës, Marin Kurila. 7. Të gjithë nxënësit do të mbajnë, në shenjë kujtimi për Marin Kurilën, një shall të kuq të lidhur në qafë. 8. Asnjë burrë nuk lejohet të mbajë armë. 9. Këshilli i qytetit do të përbëhet nga 13 anëtarë. 10. Zgjedhjet për këshillin do të mbahen kur nëntë masat e para të jenë respektuar nga gjithë qytetarët.

Grigori u zverdh kur dëgjoi masat. Qyteti do shkatërrohet nëse këto masa zbatohen, u tha ai shokëve të Marin Kurilës dhe u kërkoi të mos i dëbonin fëmijët e lagjes së të huajve nga shkollat. Shumë shpejt nuk do ketë më lagje të të huajve, thanë ata dhe i kërkuan murgut të punonte shpejt. Megjithatë, Grigori bëri një ndryshim në masën e fundit. Djemtë i kishin diktuar të shkruante se zgjedhjet për këshillin do të mbahen kur nëntë masat e para të jenë zbatuar nga gjithë qytetarët, ndërsa Grigori e zëvendësoi fjalën *zbatuar* me *respektuar*. Shokët e Kurilës ishin gjithë kohën të zënë duke kontrolluar nëpër lagje dhe nuk e vunë re këtë ndryshim në lajmërimet që i ngjiten gjithandej brenda mungjesit. Kur e pyeta Grigorin se ku ishte ndryshimi mes zbatimit dhe respektimit, ai më tha se një masë e zbatuar është shumë më detyruese sesa një masë e respektuar. Ka njerëz që e respektojnë ortodoksinë dhe ata mbajnë kreshmë vetëm tri ditët e fundit përpara pashkës, ndërsa ata që e zbatojnë doktrinën e mbajnë kreshmën pa asnjë kompromis, për 40 ditë rresht. Ky është ndryshimi, tha Grigori. Për të parët, pashka vjen më shpejt, ndërsa për të dytët vjen më vonë.

Natën e parë të shpalljes së masave në lagjen e të huajve u dëgjuan armë dhe zjarret që dilnin nga tytat e tyre e shpuan tejprtej natën e gjatë të Voskopojës. Shokët e Marin Kurilës shkuan atje me ngut, por nuk zbuluan dot se kush kishte qëlluar. Nuk kishte të vranë dhe u tha se myslimanët kishin qëlluar për t'u thënë djemve me shall të kuq se ata nuk do t'i dorëzonin armët dhe se nuk i pranonin masat. Shokët e Marinit vunë gurë të mëdhenj në të gjitha hyrjet e lagjes së të huajve dhe disa prej tyre u caktuan të bëjnë rojë ditë e natë, duke mos lënë askënd të dilte jashtë. Por të shtënat vazhduan edhe natën tjetër si dhe shumë ditë me radhë. Thuhej se në lagjen e të huajve disa burra ishin organizuar dhe po bëheshin gati për të sulmuar. Tregtarët u frikësuan dhe shumë prej tyre filluan të mbledhin plaçkat dhe të largohen nga qyteti bashkë me familjet. Shtëpitë u mbyllën dhe magazinat me mall pothuajse u zbrazën. Kuajt e karvanëve u lanë të lirë dhe ata ishin të vetmit që bridhnin nëpër qytet pa iu bindur masave dhe orareve të ndalimit. Vdekjet u shtuan dhe doktorët, që mund t'i vizitonin të sëmurët vetëm gjatë ditës, thoshin se ishin shtuar sëmundjet e zemrës nga frika dhe pasiguria familjet i qanin të vdekurit gjithë natën me qirinjtë të vegjël dhe prisnin mëngjesin për t'i varrosur. Dasmat u pakësuan dhe gjithnjë e më pak udhëtarët vinin në Voskopojë. Tavernat u mbyllën sepse askush nuk shkonte më atje. Pas ndalimit të sapunit gratë nisën t'i lajnë rrobat në lumë duke i fërkuar fort pas gurëve për t'u hequr njollat dhe erën e djersës. Fëmijëve që luanin nëpër shkolla nisën t'u hapen këpucët e përdorura, por lëkurë

për këpucë të reja nuk kishte. Këpucët e prishura i çonin te këpucarët dhe radha përpara dyqaneve të tyre u shtua. Ndërkohë, krismat në lagjen e të huajve nuk pushonin dhe armët filluan të zbrazen edhe ditën. Disa nga shokët e Marin Kurilës përfituan nga ikja e shumë tregtarëve dhe i hapën shtëpitë dhe depot e tyre dhe vodhën çfarë gjetën brenda. Duke qenë se ishin të vetmit që kishin të drejtë të lëviznin natën, ata ngarkonin sëndukë me plaçka, abazhurë të shtrenjtë, ora muri, filxhanë, pjata dhe lugë italiane që i merrnin nga shtëpitë e boshatisura duke i shpënë në shtëpinë e tyre. Bodrumet e tyre u mbushën me mall nga depot dhe kur njerëzit kishin nevojë të blinin ndonjë gjë, ata filluan të shisnin dhe të merrnin paratë.

Të ngopur me para dhe mall, djemtë kishin dëshirë të argëtoheshin. Vendosën të hapin një tavernë vetëm për vete në të cilën gjatë natës pinin verë me mish të pjekur. Vajzat, që më parë banda e sevdallinjve ua shiste udhëtarëve, i morën dhe pasi i vinin të kërcenin mbi tavolina i fusnin në një shtëpi të madhe bosh dhe flinin me to. Djemtë lodheshin gjatë ditës duke shitur mall dhe natën duke u kënaqur me vajza dhe me pije. Kontrollat nëpër qytet u zbutën dhe rojat e lodhur i zinte gjumi shpejt. Por shumë tregtarë kishin ikur dhe ushqimet në qytet u rralluan. Kripa, sheqeri, mielli e kafja u pakësuan dhe ato pak thasë që kishin vjedhur nga depot, djemtë i shisnin me çmime të larta. Nga sëmundjet dhe vdekjet e shpeshta, ilaçet mbaruan dhe myshku i thatë që përdornin plakat nuk i zëvendësonte dot. Letra e shtypshkronjës u harxhua dhe puna u ndërpre. Grigori dhe murgjit e tjerë u mbyllën në manastir dhe luteshin për ditë më të mira.

Një mëngjes, te trari në hyrje të qytetit shkuan pesë murgj. Ata i thanë djemve se donin të shkonin në Korçë për të marrë letër dhe disa ilaçe. Djemtë kërkuan t'i kontrollonin murgjit e ngarkuar me trasta të mëdha, por këta hapën pelerinat e zeza dhe nga poshtë tyre nxorën pisqolla dhe filluan të qëllonjë. Pesë shokë të Marin Kurilës mbetën të vranë dhe bashkë me ta dhe njëri nga murgjit. Katër të tjerë u zhdukën të hipur mbi kuaj. Kur kontrolluan murgun e vranë doli se ai ishte një mysliman nga lagja e të huajve që ishte maskuar me veladon. Në trup i gjetën dy pisqolla dhe tre breza me fishekë.

Atë natë, shokët e Marin Kurilës vranë dhjetë myslimanë, por nuk hynë dot në brendësi të lagjes së tyre. Myslimanët dilnin në dritaret e shtëpive të tyre, pas dyerve dhe mbi mure qëllonin si të çmendur. Për tri ditë në lagjen e të huajve u bë luftë. Qëlllohej nga të gjitha anët dhe shumë njerëz u vranë sepse plumbat u hynin nga dritaret dhe i vrisnin në shtrat apo në tavolinë duke ngrënë bukë. Myslimanët ishin mbledhur dhe siç pritej kishin filluar sulmin. U mor vesh se katër murgjit e maskuar kishin zbritur në Korçë për të njoftuar turqit se një bandë kishte pushtuar Voskopojën duke dëbuar dhe duke vranë myslimanët. Disa nga shokët e Marin Kurilës u trembën kur dikush tha se pritej që turqit të vinin për të pushtuar Voskopojën. Ata morën familjet, ngarkuan kuajt me mallin që kishin vjedhur dhe ikën. Njerëzit filluan të ankohen dhe i akuzuan shokët e Marin Kurilës se pasi kishin shkatërruar qytetin tani po iknin duke i lënë në dorë të turqve. Thuhej se turqit do të vinin dhe do mbyllnin kishat, shkollat dhe shtypshkronjën dhe do caktonin një nga myslimanët si bej të Voskopojës, duke e zhdukur fare këshillin që qeveriste prej dyqind vjetësh. Paniku e rrënoi edhe më shumë Voskopojën. Me qindra njerëz u lëshuan mbi kuaj duke lënë në shtëpi vetëm pleq dhe plaka që nuk lëviznin dot. Duke ikur, ata shisnin për dy aspra shtëpitë, mobiljet, apo gjëra të tjera dhe çfarë nuk shitej, hidhej. Rrugët e lagjeve u mbushën me dërrasa, krevate, djepe, tavolina, kanistra tenxhere, pjata të thyera, dyshekë dhe rroba të palara, të cilat u bënë kopicë, duke bllokuar rrugicat. Askush nuk i pastronte më rrugët që ishin bërë pis dhe ishin mbushur me gurë dhe bajga kuajsh e kufoma qensh dhe macesh që kishin ngordhur nga uria. Myslimanët filluan të dalin nga lagja e tyre dhe bastisën shtëpitë e boshatisura, të cilat shpesh i pushtonin duke u vendosur në to. Shokët e Marin Kurilës ishin të frikësuar. Një natë, ata u mblodhën në shtëpinë e Marinit për të vendosur se çfarë do të bënin.



Atje filluan të zihen duke akuzuar njëri-tjetrin si fajtor për vjedhjet, shkatërrimet, për urinë dhe braktisjen e qytetit.

Dikur, njëri prej tyre, me shpatulla të gjera dhe shall të kuq, filloi të fliste dhe të gjithë pushuan duke e dëgjuar. Ky ishte Isaku, djali i motrës së madhe të Marin Kurilës. Isaku ishte më i gjatë dhe më i ri se Marini. Ai i mbante flokët e lëshuar mbi supe dhe mbi këmbët e bardhë bashkë me dy pisqollat kishte qëndisur dhe një K të madhe të që njerëzit thoshin se ishte në nderim të familjes së tij.

Isaku ishte një kokë më i madh se të tjerët. Kishte qenë student dhe Marin Kurila e kishte mbajtur pas kur dilte të takonte njerëzit nëpër lagje. Isaku mbante pelerinën e bardhë të Marin Kurilës, së cilës ia kishte pastruar gjakun. I ngjante dajës në bukuri, por ishte më i bardhë dhe më i qetë se ai. Që kur Marini ishte vranë, Isaku kishte drejtuar lagjen e armëtarëve dhe i kishte ndaluar shokët e tij të hapnin depot e armëve dhe të vidhnin nëpër shtëpitë e tregtarëve të lagjes. Isaku i lejonte mjekët të vizitonin pleqtë dhe të sëmurët gjatë natës dhe pastaj i shoqëronte ata deri në shtëpi për t'u siguruar se nuk i ngiste kush rrugës. Njëherë ai kishte gjetur në rrugë një mysliman të plagosur dhe e kishte çuar në shtëpi. Kur kishte hyrë në lagjen e të huajve duke e mbajtur të plagosurin në krahë, disa myslimanë i kishin drejtuar armën, por Isaku kishte vazhduar të ecte pa u trembur. Ia kishte dorëzuar djalin e përgjakur të atit të habitur dhe më vonë kishte dërguar një doktor për t'i hequr plumbat që kishte në trup. Atë natë myslimanët nuk kishin qëlluar dhe qyteti kishte qenë i qetë.

Por të nesërmen çdo gjë kishte nisur si më parë.

Kur Isaku u ngrit në këmbë, shokëve të tij iu duk sikur ishte ngjallur Marin Kurila. I kishte rënë një çehre e purpurt mbi fytyrë, ndërsa flokët e gjatë e tregonin më të vendosur dhe më trim se Marini.

Po të ishte Marin Kurila gjallë punët nuk do kishin ardhur në këtë pikë, foli ai dhe të tjerët heshtën. Marin Kurila donte të lartësonte dhe të mbronte Voskopojeën, kurse ju e përdhosët dhe sulmuat. Ai u nxitua, por ne e shtymë në greminë. Ai kishte një besim, por besimin e tij ne e përdorëm. Ai u nxitua kur vendosi të bëhej kryetar i këshillit, por ne duhet ta kishim kuptuar se zgjedhja e tij do t'i frikësonte tregtarët e sapunit dhe të huajt, siç ndodhi. Ne treguam se ishim tahmaqarë dhe nuk i folëm Marinit, i cili gaboi dhe e lexoi frikën e qytetit ndaj nesh si dashuri. Kjo i kushtoi jetën. Duhet të jemi të qartë se jo gjithë Voskopoja na ka dashur. Shumica e njerëzve na ka pasur frikë dhe nuk ka pasur besim te ne. Banditët dinë të sulmojnë dhe jo të mbrojnë, ndërsa Voskopoja kishte nevojë për mbrojtje dhe jo për sulm. Voskopoja ka qenë qyteti i diturisë. Dituria u shtua nga liria që kishin tregtarët për të blerë dhe artistët për të lexuar. Por këta i kanë frikë armët dhe qyteti mori tatëpjetën ditën që Marin Kurila tha se Voskopoja do ishte qyteti i armëve. Unë e nderoj guximin e Marin Kurilës, por ai u tregua naiv. Pasi ai vdiq, ne u bëmë të poshtër. Naivitetin e tij për një Voskopojeë pa të huaj ne e kthyem në qëllim për një Voskopojeë vetëm për vete. Sot, Voskopoja nuk është ajo që ishte dhe as ajo që duhej të ishte dhe, nëse vazhdon kështu, shumë shpejt do zbrazet. Myslimanët janë organizuar dhe kanë marrë zemër. Njerëzit kanë filluar të ikin të tmerruar dhe tregtia ka marrë fund. Fëmijët nuk shkojnë më në shkollë sepse prindërit nuk i lenë të dalin vetëm depot janë bosh dhe uria është në prag. Ne jemi kthyer në një tufë hajdutësh të cilët nuk beson më kush. Kemi vjedhur shtëpitë e të tjerëve, kemi shkatërruar depot dhe mallrat e tyre i kemi shitur sikur të ishin tonat. Spitali nuk ka më ilaçe dhe rrugët janë mbushur me kafshë të ngordhura. Taksat nuk mblidhen dhe këshilli nuk merr më vendime, sepse këshill nuk ka. Dhjetë masat që ne morëm nuk e ndihmuan qytetin, por ia vështirësuan jetën njerëzve. Ato duhet të ndryshojnë një orë e më parë. Këshilli duhej të ngrihej shpejt dhe qyteti të pastrohet. Duhet t'i kërkojmë myslimanëve paqe dhe t'i lejojmë

fëmijët e tyre të kthehen në shkolla. Tregtarët të fillojnë punën nga e para dhe askush nuk duhet të pengojë më tregtinë e tyre. Tavernat duhet të hapen dhe Voskopojes t'i kthehet qetësia dhe muzika. Të gjithë ne do dorëzojmë çdo gjë që kemi vjedhur dhe do t'i shpërndajmë njerëzve me racion ushqimet falas derisa të hapen dyqanet dhe depot të mbushen me mall të ri. Do t'u kërkojmë njerëzve të pastrojnë rrugët nga plehrat dhe kafshët e ngordhura. Do ta heqim trarin në hyrje të qytetit dhe të gjithë do lejohen të lëvizin të lirë. Do dorëzojmë armët dhe do t'u kërkojmë të gjithëve të bëjnë të njëjtën gjë. Do t'i dërgojmë fjalë atyre që kanë ikur, të kthehen dhe të vazhdojnë jetën qetësisht si më parë. Shumë shpejt do të bëjmë zgjedhjet dhe këshilli do të ngrihet dhe do të drejtojë qytetin. Duhet të bisedojmë me myslimanët përpara se të vijmë turqit për t'i ndihmuar dhe për të na vrarë të gjithëve. Do nxjerrim nga burgu të gjithë ata që janë aty pa një vendim këshilli. Kur qetësia të jetë rikthyer ne do merremi secili me punët tona dhe banda jonë do të shpërndahet duke i bërë më në fund një nder Voskopojes.

Isaku u ul dhe pelerina e bardhë iu palos mbi gjunjët e fortë. Shokët e tij rrinin pa folur, por dukej se disave nuk i kishte pëlqyer ajo që ai kishte thënë. Ti po i kthen myslimanët në qytet, tha njëri prej tyre. Ata vranë Marinin dhe akoma nuk e kanë larë gjakun e derdhur.

Paqja e Voskopojes është më e çmuar se jeta e Marin Kurilës, tha Isaku. Në qoftë se nuk kthejmë paqen me çdo kusht, do rrezikojmë dhe jetët tona dhe jo vetëm kaq. Voskopoja do të zhduket nga faqja e dheut dhe ne nuk do jemi gjallë as për të ndezur një qiri për shpirtin e saj. Po pse duhet të bëjmë paqe me myslimanët kur mund t'i dëbojmë nga qyteti dhe të jetojmë si më parë, pyeti dikush. Isaku e pa me qetësi shokun dhe u përgjigj: Jetojmë në Perandorinë Turke dhe jo në Venedik. Kjo perandori është ngritur për të mbrojtur myslimanët dhe për t'i zgjeruar territoret e tyre siç ka ndodhur në treqind vitet e fundit. Voskopoja ka qenë e pastër për shumë vjet falë diplomacisë dhe jo luftës baballarët tanë u morën me tregti dhe me arte duke furnizuar perandorinë me mallra që turqit nuk i kishin. Kështu u pasuruan dhe e blenë me para paqen me turqit duke e mbajtur qytetin të paprekur dhe të pavarur. Por kjo paqe nuk mund të ishte e përjetshme sepse paratë nuk mjaftojnë kurrë për të blerë lirinë. Gjithë fshatrat përreth, që ishin më të varfër dhe më të paditur se ne, u kthyen në Islam dhe nga varfëria u shtuan dhe kërkuan të vijmë këtu. Një ditë kjo do të ndodhte, siç ndodhi. Me luftë ne nuk i mundim dot turqit. Në qoftë se nuk duam ta humbim atë që kemi trashëguar duhet të kërkojmë paqe, duke e ndarë qytetin me ta. Përndryshe ne do të na zbojnë dhe qyteti do t'u mbetet atyre. Kush nuk do vritet do syrgjynoset dhe po të më pyesni se kë zgjedh nga të dyja, nuk e di kush është më e hidhur.

Ky është nënshtrim, u hodh njëri nga burrat. Ne jemi shumë afër fitores. Myslimanët janë akoma të dobët dhe nuk kanë shumë armë dhe ne mund t'i përzëmë nga qyteti. Marin Kurila donte t'i nxirrte ata nga këshilli dhe pastaj duke kontrolluar këshillin ne do t'ua kishim marrë atyre tokat dhe do t'i kishim dëbuar një herë e mirë nga Voskopoja. Paqja me ta nuk ka të ardhme sepse myslimanët asnjëherë nuk e kanë respektuar paqen me të krishterët, tha burri dhe disa të tjerë e përkrahën, por Isaku nuk i a të flisnin.

Ju jetoni në një ishull pa e ditur, filloi të fliste Isaku. Ishullarët janë njerëz të vetmuar dhe vetmia i ka bërë të mendojnë. Ata kanë vetëm një qëllim: sesi ta shpëtojnë ishullin e tyre nga stuhitë dhe pushtuesit. Për t'ia arritur kësaj, ata përdorin çdo dredhi dhe kur dredhitë nuk pinë më ujë përdorin luftën. Por lufta është arma e fundit që përdorin pasi i kanë ofruar të huajve paqen, qetësinë, strehimin dhe mënyrën e tyre të jetesës. Ka shumë udhëtarë që thonë se njerëzit e ishujve janë mikpritës. Në fakt, kjo është një dredhi që ata e kanë përsosur në mijëra vjet për të shpëtuar atë pak tokë që kanë nga deti dhe piratët. Ishullarët kanë një rregull. Ata i pranojnë të huajt dhe njerëzit që vijnë nga deti vetëm në qoftë se këta mësojnë notin. Pas notit ata u mësojnë të huajve peshkimin, pastaj i tregojnë si të ndërtojnë varka dhe anije, pastaj sesi të gatujnë

peshkun, pastaj sesi të ngrenë diga për të zbutur egërsinë e detit që kafshon ishullin, pastaj sesi të presin gjatë dimrit duke u ushqyer me durim dhe pastaj sesi gjatë verës të ruajnë ushqim edhe për dimrin tjetër. Kur i huaji i ka mësuar të gjitha këto, ai pa e kuptuar është bërë një ishullar. Dhe ky ishullar i ri, pa e kuptuar, ka vetëm një qëllim: se si të ruajë të pavarur ishullin e vet duke përdorur mjeshhtërinë që të tjerët i mësuan atij. Voskopoja është një ishull i krishterë, i cili i ka shpëtuar deri sot pushtimit duke përdorur këto dredhi. Myslimanët këtu janë si të huaj. Në qoftë se i sulmon, ata do të sulmojnë sepse deti i ka hedhur në ishull dhe ata nuk mund të kthehen më pas. Luftën e fiton më kollaj ai që do të shkatërrojë, sesa ai që do të mbrojë. Të shkatërrosh është më e lehtë se të mbrosh dhe prandaj turqit deri më sot kanë pasur vetëm fitore në tokat tona. Njeriu që mbron është i kujdesshëm siç jemi ne, sepse ai nuk do që duke luftuar rrugët të prishen, shtëpitë të digjen, kishat të zbrazen dhe pasuritë të vidhen. Ai që shkatërron nuk i mendon këto sepse ai nuk ka asnjë ndjenjë për tokën që ka vendosur të pushtojë. E do me çdo kusht atë copë tokë, me shtëpi apo pa shtëpi, me kisha apo pa kisha, me njerëz apo pa njerëz. Në qoftë se ne vazhdojmë luftën, dashuria që kemi për qytetin, për çdo gur dhe sokak ku jemi rritur dhe jemi bërë burra do të na bëjë më të dobët. Myslimanët nuk kanë akoma dashuri për Voskopoje dhe ata janë gati të shkretojnë çdo gjë vetëm që të mbeten këtu. Ata e dinë se një qytet i shkatërruar është më mirë se mali apo fusha nga kanë ardhur dhe ku ata duhet të kthehen, në qoftë se humbin. Prandaj, miqtë e mi, unë them se ne duhet të sillemi si ishullarët. Duhet ta shpëtojmë ishullin tonë nga zhdukja, duke i mësuar të huajt të jetojnë dhe të sillen si ne. Duhet t'i bindim ata të besojnë se ne kemi vendosur t'i ndajmë pasuritë dhe artin tonë me ta. Në këtë mënyrë fëmijët e tyre do shkojnë në shkolla, ata do mësojnë se toka është ushqim i trupit dhe perëndia është një burim i shpirtit, do mësojnë zanatet tona, do bëhen bakërxhinj, këpucarë, sapunxhinj, jorganxhinj, kërcimtarë dhe në fund do bëhen voskopojarë. Kur t'i kenë mësuar të gjitha këto, ata nuk do kenë më interes të shkatërrojnë qytetin e tyre, por përkundrazi do luftojnë bashkë me ne për të mbrojtur sepse kështu do të mbrojnë shtëpitë dhe pasuritë e tyre.

E di që ju duket e pamundur dhe e padenjë, por unë shoh që tani ditën kur myslimanët do luftojnë për të mbrojtur kishat tona. Fëmijët e tyre do jenë ngrohur si zogjtë nën lëvozhgën e vezëve të ashkës dhe në verë kryqet e kishave do t'u bëjnë hije pleqve të përvëlur nga vapa. Le të mendojnë se Islami i tyre ngroh një jorgan, por unë jam i bindur se krishterimi ynë i begatë do t'u duket si një jastëk, mbi të cilin koka çlodhet duke parë ëndrra të bukura me bollëk dhe lumturi. Myslimanët e Voskopojes janë akoma si të huajt në ishull. Janë të egër, të hutuar dhe të uritur. Vetëm një gjë nuk mund ta pranojnë ata: të kthehen prapa duke rrezikuar të zhyten në thellësinë dhe pabesinë e detit. Në qoftë se u jep për të ngrënë, i jep një strehë dhe i mëson notin, ata do zbuten dhe do punojnë për të pasur ato që ne i kemi dhe që ata nuk i kanë, sepse nuk mund t'i sillnin me vete nëpër det.

Por ka edhe diçka tjetër. Myslimanët e Voskopojes janë shqiptarë siç jemi edhe ne. Gjyshërit e tyre kanë qenë të krishterë, por fshatrat ku ata kanë jetuar nuk kanë pasur pasurinë dhe diturinë e Voskopojes dhe prandaj ata u bënë myslimanë duke besuar se Islami do t'u jepte atë që u mungonte. Sot janë më të varfër, por nuk mund të kthehen më pas sepse Islami është shteti dhe shteti është ushtria dhe ushtria është forca dhe forca është trupi dhe trupi është shpirti dhe shpirti është Islami. Ata janë myslimanë, por akoma nuk janë turq. Në qoftë se ishullarët do t'i zbonin të huajt, ata e dinin se piratët do t'i merrnin ata dhe bashkë me ta do vinin të pushtonin ishullin. Në qoftë se ne i zbojmë shqiptarët myslimanë nga qyteti ata do shkojnë te turqit dhe të gjithë bashkë do vijnë dhe do na zbojnë ne nga Voskopoja. Kjo do të ishte një luftë e humbur. Kështu kanë gabuar shumë burra të mençur përpara nesh, pa e kuptuar se duke i quajtur turq, shqiptarët myslimanë, në fakt, i kanë hedhur ata si armë në duart e turqve. Me ato duar turqit kanë luftuar

dhe kanë pushtuar fshatrat dhe qytetet tona. Në të vërtetë shqiptarët kanë luftuar kundër shqiptarëve dhe njëra palë besonte se luftonte kundër turqve, ndërsa pala tjetër ngushëllohej se luftonte kundër grekëve. Kësisoj nuk ka mbetur asnjë pëllëmbë Shqipëri dhe kujtdo që fitonte i thuhej se fitoi si turk dhe kujtdo që humbte i thuhej se humbi ngaqë ishte grek. Voskopoja nuk është një ishull ku turqit luftojnë me grekët. Voskopoja është një tokë ku shqiptarët akoma nuk kanë arsye të luftojnë me shqiptarët. Familja ime ka pesëqind vjet që ka luftuar me turqit dhe ka mbetur shqiptare sepse ka mësuar artin e të jetuarit në ishull. Siç ju thashë, në ishull, duhet të dish të presësh të kalojë dimri duke u ushqyer me durimin tënd. Kur vjen pranvera, deti zbutet, qielli pastrohet dhe trupi i çlodhur e ushqen shpirtin e menduar. Atëherë njeriu e kupton se po të kishte dalë në det në dimër, ndoshta nuk do të ishte kthyer më në shtëpinë e tij dhe dallgët do ta kishin nxjerë në breg me sy të mbushur me rërë, që nuk e shijojnë dot diellin që shkëlqen dhe lartësohet. Ja pra, pse ia vlen të durosh, sepse turqit nuk janë një dimër i përvetshëm. Ata kanë ndaluar përkohësisht në ishullin tonë. Do hanë, do pinë, do vjedhin, do rrëmbejnë, do mbjellin rrënjët e Islamit aty ku toka e pranon dhe pastaj do t'i hipin anijeve dhe do ikin. Rrugës do mbyten në det nga gjithë kjo peshë dhe ne do ta shijojmë këtë mrekulli në bregun e ishullit tonë. Pastaj do kthehemi në qytet dhe do pastrojmë rrugët, oborret, tavernat dhe shkollat. Tokën e shkelur do ta rimbjellim prapë, siç kemi bërë në shekuj.

Isaku pushoi, ndërsa sytë jeshilë i shkëlqenin si një gjethe në mëngjes. Burrat e tjerë nuk folën më dhe nisën të largohen një nga një. Duke dalë, njëri prej tyre, i cili ishte poet i tha: Nëse Marin Kurila ishte naiv, ti je romantik. Romantikët shkruajnë poezi në mes të luftës dhe prandaj humbin. Por unë zgjedh romantikët sepse në poezitë e tyre humbësit kanë gjithmonë të drejtë. Në qoftë se bën një poezi për mua, shkruaj që do doja të jetoja në një ishull ku njerëzit lindin duke e ditur notin, siç dinë të shohin pa ua mësuar njeri, tha Isaku dhe buzëqeshi. Nuk e di a ka mbetur më letër për poezi në këtë qytet, tha poeti dhe u largua.

Isaku doli të nesërmen nga shtëpia pa pelerinën e bardhë. Pranvera kishte ardhur dhe ai ndjeu këmbishën t'i largohej nga trupi si për t'i ikur nxehtësisë së mishit. Ishte një nga ato ditë të gjata pranvere që duken të shkurtra kur mendon për të punuar, por që asnjëherë nuk mjaftojnë për të mbaruar një punë. Kur filloi të ecte në rrugicën ku kishin vrarë Marin Kurilën, dielli ishte ngritur mbi pullaze dhe ai e ndjeu të nxehtë në faqe. Një djalë i vogël doli me vrap nga shtëpia dhe pas tij u duk e ëma që e thirri: Marin mos harro shallin. Është vapë, i tha djali dhe duke vazhduar të vraponte shtoi: mësuesit nuk na kërkojnë më ta mbajmë shallin të lidhur në qafë. Gruas i mbeti shalli i kuq në dorë dhe kur pa Isakun ajo e mblodhi shallin në grushtin e vet, sikur po fshihte një dëshmi. Isaku vazhdoi dhe në fund të rrugicës pa disa nga shokët e tij që po bisedonin, ndërsa shallët i vareshin mbi supe. Në Voskopoje duhet të hapen shkolla për të rriturit, mendoi ai dhe i thirri. Ata u mblodhën dhe Isaku i tha t'i grisinin shpalljet me dhjetë masat që ishin varur në të gjitha lagjet e qytetit. Djemtë panë njëri-tjetrin në sy dhe u shpërndanë duke i ndarë mes tyre lagjet ku do të shkonin. Njerëzit mblidheshin të habitur dhe djemtë me shall të kuq u thoshin se masat kanë ndryshuar dhe se në qytet mund të dilet edhe pas orës gjashtë të mbrëmjes. Shokët e Isakut morën karrocën e disa tregtarëve dhe nisën të pastrojnë rrugët nga kufomat e kafshëve, gurët dhe mobilet e hedhura nga ata që kishin ikur. Trau i madh në hyrje të qytetit u hoq dhe bashkë me të edhe pingu i gurëve që kishte bllokuar lagjen e të huajve.

Isaku shkoi te Grigor Jermonaku dhe i kërkoi të shtypte një lajmërim të ri. Nuk ka më letër për të mbuluar Voskopojen, tha murgu duke e parë Isakun me mosbesim. Më duhet letër për ta zbuluar Voskopojen, tha Isaku. Grigori nuk e kuptoi dhe Isaku i tha se ishte vendosur që dhjetë masat të ndryshonin. Shkruaj, i tha dhe filloi të fliste:

1. Voskopoja është pronë e gjithë qytetarëve të vet. 2. Të gjithë janë të lirë të dalin kur të duan dhe pa kufizim në Voskopoje. 3. Dyqanet dhe tavernat hapen për të gjithë. 4. Të gjithë fëmijët e Voskopojës pranohen në shkollë. 5. Mësuesit duhet t'i mësojnë fëmijëve se trazirat në qytet ndodhën për shkak të anulimit të zgjedhjeve. 6. Asnjë burrë nuk lejohet të dalë i armatosur në rrugë pa lejen e Këshillit të qytetit. 7. Lirohen nga burgu të gjithë ata që janë aty, pas fillimit të trazirave. 8. Në Voskopoje qytetarët janë të lirë të shesin dhe të blejnë çdo mall që u duhet. 9. Këshilli i qytetit do të përbëhet nga katërmëdhjetë anëtarë. 10. Zgjedhjet për Këshillin e qytetit do të mbahen për një muaj.

Grigor Jermonaku u ngashërye dhe ia shtrëngoi duart e ftohta Isakut. Ti i hape dyert e Voskopojës dhe tani engjëjt do kthehen prapë në qytet, tha Grigori. Mund të kthehen kur të duan madje edhe pas orës gjashtë, foli Isaku dhe iku.

Të nesërmen, dhjetë masat e reja u varën nëpër mure, aty ku masat e vjetra kishin lënë një njollë djerse. Njerëzit u mblodhën për t'i lexuar dhe fëmijët filluan të vrapojnë duke i thënë prindërve të tyre se rrugët ishin hapur dhe oraret kishin ndryshuar. Isaku doli nëpër lagje dhe i tha njerëzve se tani ata duhet t'i ktheheshin punës, kishës, shkollave dhe tregtisë dhe se mund të shkonin prapë në taverna. Furrat e bukës u hapën dhe disa tregtarë morën karvanët dhe u hodhën në Korçë për të blerë miell, kripë, verë dhe ilaçe. Rrugicat u pastruan dhe studentët nisën të mbushin tavernat pas mesnate. Krismat në qytet ishin rralluar megjithëse nga lagjja e të huajve dëgjoheshin herë pas here të shtëna gjatë natës. Isaku shkoi vetë në shkollë dhe i pyeti mësuesit nëse fëmijët e lagjes së të huajve kishin filluar të vinin. Akoma jo, i tha njëri nga mësuesit. Nuk u ka dalë frika dhe mendojnë se kjo është një hile për t'i nxjerrë ata nga lagjja dhe pastaj për t'i ndëshkuar e për t'i dëbuar fare nga qyteti. Myslimanët thonë se nuk mund t'i besojmë nipit të Marin Kurilës.

Isaku mori disa nga shokët e tij dhe shkoi në burg. Dhjetë djem me shalle të kuq rrinin te dera dhe Isaku u kërkoi çelësat. Hapi derën dhe i tha atyre që ishin brenda të dilnin. Një nga një, njerëzit e palarë dhe të pangrënë dolën në diell duke mbajtur duart mbi sytë e pamësuar nga drita. Në krye të tyre qëndronte një burrë i gjatë me flokë të verdhë të ndara në mes, i cili kur doli jashtë, zbathte këpucët, përveshi pantallonat, u ul në gjuhë dhe filloi të falej. Pas tij u falën edhe burrat e tjerë. Ndërkohë që ata faleshin, disa nga shokët e Isakut kthyen kurrizin për të mos i parë, por ai i bëri shenjë dhe ata u kthyen prapë duke dëgjuar në heshtje fjalë arabisht që nuk i kuptonin. Isaku priti sa u mbaruan dhe kur burri i gjatë u ngrit duke pastruar gjuhët ai e pyeti si quhej.

Unë jam Sali Benishi, tha burri pa e parë Isakun në sy. Je i lirë të shkosh në shtëpi, tha Isaku. Mund t'i dërgosh fëmijët e tu në shkollë dhe të punosh për të fituar bukën tënde. Askush nuk do të të burgosë, nëse nuk vjedh dhe nuk vret. Thuaji të gjithëve se në Voskopoje asnjëri nuk burgoset se është mysliman.

Burri ngriti kokën, por çehrja e tij e verdhë nuk ndryshoi. Të krishterët na burgosën, por Allahu na shpëtoi, tha Sali Benishi. Unë i falem vetëm atij. Falu, por mo sharro të punosh, në Voskopoje ka vend edhe për Zotin tënd, tha Isaku dhe u largua. Sali Benishi mbeti në këmbë dhe Isaku ndjeu mbi kurriz sytë e tij të ftohtë që iu ngulën si thikë.

U kthye dhe i tha: Do takohemi prapë Sali Benishi.

Brenda disa ditësh, Voskopoja u pastrua nga pluhurat dhe filloi të shkëlqente. Pranvera dhe masat e reja i kishin çelur njerëzit që zgjoheshin herët dhe flinin vonë. Gratë i lanë rrugicat e pista duke derdhur ujë me kova dhe vajzat i kruan një nga një gurët e ndotur të kalldrëmeve.

Një të premte në drekë, një karvan i madh me sapun mbërriti në qytet pas shumë muajsh. Gratë u sulën te depot e sapunit dhe u kthyen në shtëpi me mësallat të mbushura me kallëpe të verdhë, të prerë në formë kutish. Për disa ditë gjithë qyteti mbajti era sapun. Gratë i zhveshën burrat dhe fëmijët e tyre dhe i detyruan të rrinë në shtëpi derisa ato të lanin rrobat dhe pastaj t'i thanin, duke i nderur në diell. Burrat e zhveshur nga këmishët dhe pantallonat dilnin në dritare dhe prej andej bisedonin me njëri-tjetrin. Krahët lakuriq u vareshin në majë të avllive, ndërsa këmbët pa pantallona dukeshin më të dobëta. Megjithëse të zhveshur, ata nuk i ndërprejnë bisedat dhe duke folur me njëri-tjetrin në distancë u bërtisnin grave, të cilat ishin përkulur mbi rrobat e tyre në oborr duke hequr me sapun, me ujë dhe me shkumë djersët e thara të kohës së trazirave. Fëmijët ishin më të paturpshëm. Ata vazhduan të dilnin në rrugë me brekët e tyre të gjata, të cilat, kur rrezoheshin, u griseshin duke u nxjerrë në shesh mollaqet e kuqe të rrumbullakëta. Kur burrat dolën pas dy ditësh, këmishët, xhaketat, jelekët dhe pantallonat e tyre dukeshin si të reja. Si njerëz të etur që sapo kanë dalë nga deti, ata u sulën nëpër taverna, por, megjithatë, era e verës nuk e mundi dot erën e sapunit që vazhdoi gati për dy javë të shponte hundët e Voskopojes.

Pasi i lanë dhe i thanë burrat, gratë u lëshuan nëpër livadhe duke mbledhur myshk. E këpusnin filizin e njomë me dy gishta dhe pluhuri që ngrihej në ajër u zbriste mbi flokë dhe në gushë dhe nga larg ato dukeshin si hije bojëvjollcë. Isaku i shikonte nga dritarja e shtëpisë dhe ato i ngjanin si një pikturë me flutura që ushqehen pas gjumit të dimrit.

Qyteti ishte i qetë. Tregtarët i kishin mbushur depot me mall, ndërsa zanatçinjtë i mbushën dyqanet me njerëz. Meshat e pashkës së prillit kishin nisur dhe priftërinjtë këndonin liturgjitë duke shkundur hundët nga myshku i rrobave të grave që bënin kryq me kryet përmbysur. Shalli i kuq i marin Kurilës ishte ende i varur mbi kryqin e madh të katedrales nga ku mund të shihej prej çdo shtëpie. Të huajt dhe myslimanët i kishin kthyer fëmijët nëpër shkolla, por këta nuk i mbanin kurrë shallat e kuq në qafë. Një mik, që priste djalin te dera e shkollës, i kishte thënë Isakut se fëmijët myslimanë dalloheshin sepse ishin të gjithë pa shall. Ditën që gruaja ia lau shallin, djali i tij nuk pranoi të shkonte në shkollë. Më quajnë mysliman, i kishte thënë të atit.

Ndërkohë, shokët e Isakut i kthyen mobiliet dhe orenditë që kishin marrë nga shtëpitë e braktisura. Isaku dilte çdo ditë nëpër qytet dhe rrugët i dukeshin më të mëdha. Ai takonte njerëz, i jepte dorën grave që pastronin sokakët, bisedonte me burrat dhe luante me fëmijët. Këta e ndiqnin nga pas dhe i kërkonin t'u tregonte pishqollat. Nuk më duhen, thoshte Isaku dhe djemtë i shikonin me habi. Në Voskopoje gjahu i njerëzve është i ndaluar. Fëmijët nuk e kuptonin Isakun dhe ai përfitonte nga stepja e tyre dhe vazhdonte rrugën. Në darkë shkonte në tavernë ku mblidheshin shokët e tij, studentët dhe poetët. Riti i recitimit mbi tavolina ishte rikthyer dhe vera e bënte leximin më ritmik. Poetët ishin të vetmit që kishin përfituar nga ditët e trazirave dhe tani mbanin radhë nëpër taverna, për të lexuar vargjet që kishin shkruar kur rrugët ishin mbushur me kufoma kafshësh dhe kur qielli ndizej nga krismat e natës.

Një natë, poeti që e kishte quajtur romantik, iu afrua Isakut me një gotë verë në dorë, me këmishë të zbërthyer dhe me balluket e gjata që i mbulonin sytë. E kam bërë atë poezinë me ishull, tha ai, por e kam bërë për vete dhe jo për ty. Në ishull ka vend për të gjithë ata që dinë not, ia ktheu Isaku duke i hedhur dorën mbi sup. Ta recitoj, e pyeti poeti dhe Isaku afroi një karrige dhe i bëri shenjë shokëve që të pushonin. Poeti hipi mbi karrige dhe dikush i afroi një qiri. Taverna u errësua, ndërsa koka e poetit ndriçoi si një diell i varur në tavan. Poeti qëndroi një çast pa folur dhe diku ngriti dorën lart dhe filloi:

Jam ulur mbi diell  
dhe shoh ishullin e shpirtit tim,

hëna ndriçon kur ishulli fle.  
Jam ulur mbi hënë  
dhe prek ishullin e trupit tim,  
një vashë vizaton mbi rërë një njeri që noton.  
Jam ulur mbi ishull  
dhe shquaj detin që tund veten në djep,  
dallgët ngrihen mbi hënë që mbytet  
dhe njeriu shtrihet mbi rërë si kryq.  
Jam ulur mbi kujtimet e mia  
dhe shoh veten mbi det,  
mësova notin për të ardhur në ishull,  
e harrova, për të mos ikur.  
Jam ulur mbi det  
dhe shoh ishullin tim,  
sa e pamundur të jetosh në ishull,  
sa bukur të vdesësh atje.

Poeti fshiu buzët, si për të zhdukur një gjurmë që mund të kishte lënë aty poezia, zbriti nga karrigia dhe u ul. Kishte dalë nga rrethi që ndriçonte qiriu dhe tani ishte në errësirë. Isaku ngriti dorën dhe qirinjtë u ndezën. Poeti rrinte i mbështetur në karrige dhe krahët i ishin varur poshtë si një të mbyturi. E bukur, por e dhimbshme, tha Isaku. Zbrit nga hëna se atje nuk ka vend edhe për ty edhe për Muhamedin dhe hajde të notojmë bashkë në një gotë verë. Poeti ngriti kokën dhe tha: Unë jam i mbytur, si të notoj? Ti ke shpëtuar sepse ke ardhur në ishull, u përgjigj Isaku dhe i zgjati gotën e verës. Por poeti nuk e pa gotën sepse sytë i kishte të mbuluar nga balluket ose ndoshta ngaqë nuk e kishte mendjen atje. Dora e Isakut mbeti e zgjatur në ajër dhe poeti tha: Të dy kemi ardhur në ishull, por ti ke ardhur për të jetuar, ndërsa unë për të vdekur. Isaku u ngrit, e përqafoi dhe i afroi gotën te buzët. Atë natë poeti piu deri në harrim. Kur e çuan në shtëpi duke e mbajtur në krahë, para se të flinte ai tha: Sa bukur të vdesësh në ishull.

Ato ditë shumë familje u rikthyen në qytet. Por jo të gjithëve u kishte dalë frika nga ditët e trazirave. Shumë prej tregtarëve kishin ikur në Korçë dhe atje kishin marrë shtëpi duke vazhduar tregtinë. Por Korça ishte një treg armiqësor për voskopojarët. Atje, turqit vendosnin për çdo gjë. Tregtarët që ktheheshin tregonin se Korça i ngjante Voskopojës në ditët e trazirave. Pazari ishte i mbushur me baltë ku të zhyteshin këmbët gjer në gju, ndërsa lypësit vidhnin dhe i shponin thasët me thika. Turqit zgërdheshin dhe u kërkonin tregtarëve para për çdo kafshë të ngarkuar me mall. Në mbrëmje, rrugët ishin të pasigurta dhe vajzat e gratë nuk mund të dilnin të vetme. Tregtarët që u kthyen i thanë Isakut se në Korçë flitej se turqit kishin vendosur t'i jepnin fund pavarësisë së Voskopojës dhe se ata po armatosnin fshehurazi myslimanët për t'i përgatitur për sulmin. Që kur trau në hyrje të qytetit ishte hequr, karvanët që vinin në qytet nuk kontrolloheshin më. Djemtë me shall të kuq i kishin thënë Isakut se burrat e maskuar si murgj që kishin varë rojat ishin kthyer në qytet të ngarkuar me armë që i kishin shpërndarë në lagjen e re. Myslimanët po armatosen, i tha një nga djemtë Isakut. Duhet t'i mbajmë armët dhe të rinisim kontrollin në qytet.

Por Isaku kundërshtoi. Qyteti po rilind, tha ai. Kjo rilindje është fryt i besimit. Njerëzit po kthehen në punë, burat po vazhdojnë tregtinë, fëmijët shkojnë në shkollë, gratë ndjekin meshat dhe myslimanët nuk kanë frikë. Të gjithë besojnë se Voskopojës mund t'i kthehet shkëlqimi që ka pasur. Ne i kemi thënë njerëzve që Voskopoja do të jetë një qytet pa armë dhe ata na kanë

besuar. Por në qoftë se ne i ndryshojmë dhjetë masat atëherë edhe të krishterët edhe myslimanët do ta humbin besimin te ne dhe do na quajnë një bandë që kërkon të zaptojë qytetin. Duhet t'i qetësojmë njerëzit derisa të mbahen zgjedhjet dhe kur të ngrihet Këshilli i ri të gjithë do binden si më parë.

Ishte mesnatë. Isaku hodhi vështrimin nga dritarja dhe pa sesi qielli mbi lagjen e myslimanëve mbushej me zjarre, të cilat ushqeheshin me barutin që shpërndanin tytat e armëve të panjohura. Isaku nuk lëvizti, por ndjeu se ato rrufe, që vinin nga toka dhe jo nga qielli, po i vrisnin sytë. Megjithatë mbeti ashtu pa lëvizur derisa shokët e tij u larguan një nga një nëpër natë. Ai i shikonte si ecnin nëpër rrugicë, me kokat ulur dhe duart e gjata, që dukeshin si armë të pambushura.

Isakun e zgjuan në të gdhirë dhe i thanë se muret e qytetit ishin mbushur me disa vizatime të profetit Muhamed. Isaku u mbath shpejt nëpër gjumë dhe doli bashkë me diellin. Para se të nisej futi dy pisqolla në brez. Muret e bardha, afër lagjes së myslimanëve, nxinin. Ata që i kishin vizatuar duhej të kishin duar të shkathëta dhe të stërvitura me portrete njerëzish.

Fytyra e Muhamedit ishte e njëjta me të gjithë vizatimet, por pozicionet e trupit ishin të ndryshme. Flokët i kishte në ngjyrë të çelët dhe të ndara në mes, ndërsa hundën e kishte të gjatë dhe veshët të vegjël. Faqet dukeshin të mbushura, si të një njeriu të ushqyer mirë. Sytë e profetit ishin të vegjël dhe shkëlqenin si ato të dikujt që bën një pyetje duke e ditur se tjetri nuk e di përgjigjen.

Në vizatimin e parë, Muhamedi i kishte hipur mbrapsht një deveje të dobët dhe të lodhur, ndërsa në dorë mbante një gotë verë të mbushur plot. Deveja tundej, por vera nuk derdhej dhe profeti e shtrëngonte gotën fort me gishtërinjtë e tij të mbushur me unaza. Mbi kokë kishte një çallmë ngjyrëvjollcë, që ishte një bojë të cilën piktorët e qytetit e nxirrnin nga fletët e thara të myshkut. Muhamedi buzëqeshte nga muri dhe dukej sikur thoshte: Deveja tundet pa u dehur.

Disa hapa më tutje ishte një vizatim më i madh. Profeti ishte shtrirë shend e verë në kurriz dhe ishte i zhveshur nga mesi e lart. Tri gra e ledhatonin duke parë me smirë njëra-tjetrën, si rivale. Njëra prej tyre, që dukej më e re, i fërkonte barkun, tjetra i mbante me kujdes këmbët e zbathura dhe e treta i kishte afruar gojën e hapur te veshi, sikur diçka i pëshpëriste kundër dy grave të tjera. Kjo grua dukej dhe më e lumtur dhe profeti në atë çast i ishte dedikuar asaj, por pa harruar kënaqësinë që i vinte nga fundi i barkut dhe nga këmbët. Çallma e profetit ishte po ajo, por ngjyra e saj vinte në të verdhë si ngjyra e shkretëtirës dhe nga kjo kuptohej se ngjarja zhvillohej në natyrë dhe jo brenda një shtëpie. Nga të tri gratë, ajo që i fërkonte barkun ishte më e re dhe shumë e bukur, por nuk arrinte dot të fshihte xhelozinë kur shikonte që dora e saj nuk i jepte profetit zjarminë që i jepte veshi i njomur nga gjuha e gruas tjetër. Gruaja që zgjatej te këmbët kishte një nishan në faqe dhe flokë të gjatë dhe të zinj që i derdheshin mbi trup, ndërsa e treta, ajo që i fliste në vesh kishte gjinj të mëdhenj që i kërcenin mbi këmbët e zbërthyer dhe një dorë e Muhamedit ishte drejtuar atje, por pa arritur t'i kapte dot. Muhamedi, megjithëse i shtrirë, dukej me pak bark, por shpatullat i kishte të mëdha dhe mbi gjoks qimet i ishin ngritur gjithë epsh.

Mbi një mur tjetër, në cepin e një shtëpie në të cilën banonte një kazanxhi i vjetër, profeti Muhamed ishte vizatuar duke ecur në një rrugë, nga dy anët e të cilës dalloheshin minare të vogla. Binte shi, por profeti mbante një pe të gjatë në dorë, me të cilin kishte lidhur një re të zezë që e tërhiqte nga pas, si një çadër. Poshtë minareve ishin fshehur njerëz, të cilët, duke u qullur nga rrebeshi, shikonin profetin që bënte shëtitje në shi, pa u lagur, duke e tërhequr renë pas vetes si një dele që ecën në qiell.



Vizatimi tjetër tregonte profetin duke lexuar Kuranin. Ai ishte kërrusur mbi librin dhe sytë e tij shikonin mbi kapak sikur donin t'i bënin një pyetje kalimtarësh. Muhamedi dukej i zgjuar, por dinak. Mbi kapakun e librit shkruhej: *KURANATA*, që Isaku e lexoi ngadalë si: Ku ra nata? Ne të gjithë e dimë përgjigjen, tha njëri nga shokët e Isakut pasi e lexoi pyetjen me zë. Isaku nuk fliste dhe vazhdonte të shikonte fytyrën e Muhamedit. Se me kë ngjan, mendoi dhe u kthye për të parë edhe një herë të gjithë vizatimet, por burri që lexonte Kuranin nuk i ngjante asnjërit prej Muhamedanëve të tjerë, të cilët nuk dukeshin dinakë, por të kënaqur dhe shumë të shpenguar. Kishte zbardhur dhe njerëzit kishin nisur të dalin nga shtëpitë. Disa gra u mblodhën përpara vizatimit ku Muhamedi ishte me tri gratë e tij dhe filluan të qeshnin. Isaku u largua dhe dëgjoji gratë që shikonin Muhamedin, ndërsa njëra prej tyre i tha shoqeve: Me se i ushqen kaq shumë gra?

Deri në mesditë vizatimet i kishte parë shumica e burrave dhe grave në qytet. Ata mbanin radhë dhe shtyheshin me bërryla duke hapur rrugën drejt vizatimeve. Fëmijët e vegjël futeshin në mes të të rriturve dhe pasi iknin u tregonin të tjerëve ato që ata akoma nuk i kishin parë për shkak të dyndjes. Pasdite u hap fjala se një grup myslimanësh të armatosur po vinin te vizatimet. Njerëzit vrapuan të hyjnë nëpër shtëpi dhe burrat qëndruan pas dyerve, ndërsa gratë shikonin rrugën të fshehura pas perdeve. Isaku i tha shokëve të tij t'i linin myslimanët të afroreshin, pa i penguar. Kur rruga mbeti bosh, një zhurmë hapash të rëndë u ngriti mbi lagje dhe tridhjetë burra të armatosur, në krye të të cilëve qëndronte Sali Benishi, mbushën rrugicat e ngushta.

Sali Benishi i kaloi vizatimet një nga një duke shtrënguar dhëmbët dhe në fund pështyu në tokë dhe ngriti kokën drejt qiellit. Të prishen, i tha shokëve dhe iku. Burrat morën gurë dhe hekur dhe nisën të prishin trupat dhe fytyrat. Gota me verë dhe libri i profetit u zhdukën që në fillim dhe pastaj me radhë gratë, devetë, minaret, çallmat dhe shkretëtira.

Kur ra nata, *KURANATA* nuk dukej më mbi muret e gërvishtur që ngjanin si qilima të përdorur dhe të ngrënë nga mola. Siluetat e prishura të Muhamedit ndriçoheshin nga hëna dhe dukeshin si hije të gdhendura në mur. Sali Benishi nuk doli nga shtëpia. Burrat erdhën dhe i thanë se i kishin prishur të gjitha vizatimet. Ata rrinin këmbëkryq në dhomën e madhe të shtëpisë së tij, por Sali Benishi heshte. Flokët e ndara në mes i kishin rënë mbi ballë dhe buzët e holla lëviznin vazhdimisht, sikur flisnin pa zë. Dikur ai ngriti kokën dhe tha: Nuk mjafton të vrasësh, duhet të dish pse. Burat e tjerë nuk folën dhe ai thirri dy prej tyre dhe i tha të niseshin për në Korçë për të takuar një hoxhë. Kur ata dolën, Sali Benishi mbeti vetëm.

Nata mbuloi qytetin. Nën lehjet e qenve të rrugës, Voskopoja dukej edhe më e vetmuar. Sali Benishi dëgjoji një copë herë piskamat e shpeshta që vinin nga rruga dhe qentë iu dukën më të frikësuar se në netët e tjera. Duket sikur po i ndjek hija e profetit, mendoi. Fiku qirinjtë e dhomës ku flinte dhe u shtri bashkë me hijen e tij.

Kur ishte i vogël, në fshatin e tij buzë malit kishte mësuar të zhdukte hijet.

Shtrihej në tokë dhe hija fshihej poshtë trupit të tij. Bëhej njësh me pemën dhe hija hynte në lëvoren e trashë dhe nuk dilte prej andej, derisa ai të lëvizte gishtin. Kridhej në përrua dhe hija mbytej në ujë dhe pastaj dilte e lagur dhe e mërdhirë për ta ndjekur lakuriq në kërkim të diellit. Gjatë ditës, ai priste me durim, si një orë natyrore, çastin kur dielli dhe hëna ndriçonin njëkohësisht. Atë moment në botë nuk kishte asnjë hije. Ai rrinte mbi një pllajë të vogël mbi fshat dhe shikonte oxhaqet e lartë, minaren e fshatit, kafshët që ktheheshin nga kullotat, arrat e mëdha që ngriheshin mbi muret e trashë, burrat e veshur me të zeza që dilnin për namazin e darkës dhe gratë që rrinin në oborr duke larë pllaçat e verdha të pasdites. Të gjithë dukeshin të vetmuar. Hijet i kishin braktisur. Dielli dhe hëna nuk i lëshonin rrugë njëri-tjetrit dhe hija e njërit

asgjësonte hijen e tjetrit. Ai ngrinte kokën lart si një ujk që kërkon një sinjal dhe priste me durim hijen e tij. E dinte se, pas pak, ajo do të afrohej në drejtim të kundërt me hënën dhe pasi t'i hynte në trup dhe të merrte formën e tij do të dilte prej andej e hollë, opake dhe e bindur për ta ndjekur deri të nesërmen në të njëjtën orë, kur do të zhdukej prapë pasi të kalonte nga dielli te hëna.

Pse e ka bërë Zoti hijen, e kishte pyetur një ditë një shoku i tij. Që të na provojë se në botë ka dritë, i tha ai. Po si zhduket hija, kishte vazhduar shoku. Kur botën e ndriçojnë dy drita njëkohësisht atëherë hija zhduket sepse ajo nuk mund t'i shërbejë dy padronëve në të njëjtën kohë. Zoti është një dhe në botë nuk mund të ketë dy drita. Po pse kur dielli dhe hëna janë mbi qiell hijet zhduken, kishte pyetur shoku. Në këtë kohë gjithë hijet e botës shkojnë nga dielli te hëna dhe derisa vazhdon ky kalim, mbi tokë nuk ka asnjë hije, kishte thënë ai. Ka ndonjë trup pa hije në botë, kishte vazhduar shoku. Po, tha ai duke ngritur kokën lart. Tri gjëra nuk kanë hije. Zoti, të vdekurit dhe fëmijët në barkun e nënës. Po pse këta të tre nuk kanë hije, pyeti shoku. Sepse këta të tre nuk i sheh dot askush.

Dielli po binte ngadalë mbi horizont dhe ai i tha shokut të kthehej me fytyrë nga hëna. E ndien si po të hyn hija në trup, e kishte pyetur. Jo, i kishte thënë djali. Ndiej vetëm një ftohtësirë mbi lëkurë. Janë këmbët e hijes, kishte thënë ai. Ajo ecën lakuriq mbi lëkurën tënde, i merr erë, pastaj mat gjatësinë, peshën, moshën, numëron gishtat, qimet e flokëve, largësinë e veshëve nga hunda, trashësinë e qafës, gjerësinë e shpatullave dhe boshllëkun mes këmbëve dhe pasi i lexon të gjitha këto, del nga trupi pa bërë asnjë gabim. Hija është sipërfaqësore. Asaj nuk i duhet sa herë rreh zemra jote, a është i mbushur stomaku yt, a marrin frymë mushkëritë, a kanë ujë veshkat e tua dhe a mendon koka jote apo jo. Hija ka vetëm dy përmasa: gjatësi dhe gjerësi. Ajo nuk ka thellësi dhe nuk tregon nëse je i gëzuar apo i trishtuar, i kamur apo i varfër, i ngrënë apo i pangrënë, i drejtë apo i mbrapshtë, i krishterë apo mysliman, punëtor apo dembel, i mençur apo i metë, i qetë apo nevrrik, i martuar apo beqar. Hija tregon vetëm nëse je i gjallë apo i vdekur. Hija është i vetmi vizatim në botë që ecën. Të gjitha vizatimet e tjera mbeten siç janë bërë, ndërsa hija lëviz dhe ndryshon, sepse hija është vizatimi që na bën Zot sa herë që na sheh. Zoti na sheh pa pushim dhe prandaj hija nuk na ndahet. Zoti nuk na sheh më kur ikim nga kjo botë dhe prandaj kur vdesim nuk kemi hije. Zoti i mjafton që jemi gjallë prandaj vizatimi i tij nuk tregon nëse jemi mirë apo keq, nëse jemi të lumtur apo të mërziur, nëse jemi të ushqyer apo të uritur, të nginjur apo të etur, besimtarë apo të pafe. Zoti na ka sjellë në jetë, por jetën duhet ta rregullojmë vetë. Ai e ka bërë hijen tonë si një vizatim pa ngjyra, ndërsa vizatimet e tjera që bëjnë njerëzit kanë ngjyra dhe ato rrëfejnë lotët, të qeshurën, mërzinë, shpresën, varfërinë, unazat, dhëmbët, krenarinë, poshtërimin dhe besimin.

Shoku e dëgjonte me sy të mbyllur, i kthyer me fytyrë nga hëna. Hapi sytë, i tha ai. Djali hapi sytë dhe pa hijen që i rrinte pas. Fshati, poshtë këmbëve të tyre, ishte errur dhe hija e minares së gjatë përplasej mbi hënën. Dielli ishte zhdukur dhe ata zbritën në fshat.

Ai kishte mbetur jetim kur ishte shumë i vogël. Të atin nuk e kishte njohur. E ëma shkonte për dru në pyll dhe e merrte me vete. Nën zhurmën e sëpatave ai shihte të ëmën si dobësohej, si i bëheshin duart me kallo dhe flokët që i zbardheshin. Ajo vdiq në pyll. Një barë dru e zuri mbi vete dhe i mori shpirtin. Atë e rriti gjyshi që e çonte në pyll të mblidhte shkarpa dhe kur u forcua filloi t'i priste vetë drutë, t'i barabiste dhe t'i sillte në fshat, në fillim me krahë dhe pastaj me mushka. Një ditë u zu me disa djem më të rritur nga fisi më i madh i fshatit. Ata e zhveshën dhe e goditën me stape të gjatë në trup. Nga goditjet, i rrodhi gjak nga hundët dhe i mbeti një shenjë në kurriz. Kur plaga u mbyll në mes të shpatullave i mbeti një shenjë, në formë molle. Plaka që e mjekoi ia pa vrangën e tharë dhe i tha gjyshit se djali kishte në shpinë shenjën e profetit. Kur vdiq

dhe gjyshi, ai mbeti vetëm. Bënte dru për të tjerë dhe ushqejej keq. Fisi më i madh i fshatit kishte zaptuar shumicën e pyllit dhe nuk i linte të tjerët të prisnin dru.

Kur mbeti pa pyll, ai hyri në punë te Hatixheja, një grua e ve, e cila kishte trashëguar disa ngastra pyll nga i shoqi që kishte vdekur. Ai ngrihej herët, shkonte në pyll, priste dru dhe kur kthehej në fshat pastronte oborrin e shtëpisë së vejushës, ushqente kafshët dhe flinte në haur. Hatixheja bleu disa parcela dhe pylli i saj u rrit. Ajo filloi të shiste dru në qytet dhe i besoi atij karvanët me mushka. Ai mori disa djem të vegjël që bënëin dru dhe vetë shkonte në qytet hipur majë mushkave, në dimër dhe në verë. Ato vite bëri shumë ftohtë dhe çmimi i druve u rrit. Karvanët u shtuan dhe Hatixheja bëri para me të cilat e zgjeroi shtëpinë dhe i tha atij një dhomë të vogël me një mangall që ngrohte muret e bardha dhe këmbët e tij të lagura dhe të djersitura nga rruga.

Hatixheja ishte pesëmbëdhjetë vjet më e madhe se ai. Kur kishte qenë e re ishte mbajtur si një grua e bukur, e bëshme, me vithe të gjera dhe me gjinj të kërcyer. Tani flokët i ishin thinjur pak te tëmthas, por lëkura ishte ende e pastër dhe sytë e zinj e tregonin edhe më të ndjeshme. Ishte nga ato gra, të cilat e kthejnë moshën në pjekuri dhe pjekurinë në nxehtësi. Kur ai ngarkonte karvanët herët në mëngjes, Hatixheja dilte në dritare me një këmbishë të bardhë, e cila i hapej pak duke i treguar qafën e bardhë dhe gjinjtë e fryrë nga vetmia. Ai e shikonte dhe fërkonte mushkat që ngroheshin nga dora e tij. Kur kthehet, pas disa ditësh, ajo e priste dhe në sytë e saj ai lexonte boshllëkun e një nate të gjatë në një krevat me dy jastëkë ku prehej vetëm një kokë.

Një natë ai erdhi vonë, i lagur dhe i lodhur nga rruga. Mangallin e gjeti të ndezur. Hoqi këpucët, çorapet e qullëta, nderi këmbishën mbi stol dhe u fut në rroba. Këmbët i kishin ngrirë dhe hijet e prushit që digjej luanin si diej druri mbi tavan. Kur u hap dera, ai ishte zgjuar. Një hije e bardhë u afrua te shtrati dhe u fut brenda. Ishte Hatixheja. E ngrohtë dhe e rrumbullakët ajo iu afrua dhe ai ndjeu frymën e saj të nxehtë në qafë. Ajo nuk foli, por zgjati dorën e butë dhe ia vuri në mes të këmbëve. Sali Benishi dëgjoi gjakun e tij që nisi t'i gurgullonte në vena duke ia forcuar trupin e flashkët. E zhveshi gruan shpejt dhe futi kokën në sqetullën e saj si kaçube, plot qime të gjata dhe të lagura nga djersa. Nuk ishte shtrirë kurrë mbi një grua, por instinkti e drejtonte si një deve të etur që kërkon gjurmën e ujit nën lëkurën e shkretëtirës. Hatixheja lëvizte nën peshën e tij si një kodër rëre që ndryshon formë, derisa zbutet, drejtohet, shtrihet, derdhet, epohet, harkohet dhe pastaj humb lartësinë në një fushë të gjerë dhe të ngrohtë. Ai ecte mbi kodrat dhe fushat e trupit të Hatixhesë, gjersa, më në fund, gjeti një oazë të pyllëzuar, u ngul atje dhe piu sa u ngop. Në atë freski, trupi iu lag, e uji i rrodhi në qafë, në gjoks dhe nëpër këmbë. Hatixheja, e lëshuar, kishte hapur kanalet e saj të thara dhe të përvëlura nga vitet, si një tokë që pas shumë kohësh njomet nga shiu. Kur ritmi i valles së Sali Benishit ishte qetësuar, Hatixheja hapi gojën e dirsur dhe tha: Po digjem, por nuk dua të shuhem.

Për tri ditë nuk u ngritën nga krevati. Mangalli digjej ngadalë dhe prushi nën çarçafë ia përcëllonte kaçubën e vaditur Hatixhesë. Sali Benishi zbriste zbathur poshtë në kuzhinë dhe aty merrte turshi, djathë, qumësht, mollë dhe reçel me bajame dhe të dy hanin mbi shtresa. Ajo qëronte mollët dhe thithte turshitë që zbrazeshin si llastikë të shpuar e që pastaj Sali Benishi i kafshonte deri në rrëzë dhe farat e vogla shpërndareshin mbi jastëk. Pastaj ai e shuante djegësirën e turshive me qumësht të ftohtë që i derdhej mbi gjoksin e ashpër dhe që aty kërcente mbi gjinjtë e fortë dhe të lartë të Hatixhesë. Ai fuste gishtin në pjatën me reçel bajameje dhe ia lyente asaj buzët që shkëlqenin në errësirë si një luleshtrydhe që del nga ferra. Një natë, kur atë e kishte zënë gjumi, ajo e zgjoi dhe i tha: Nuk do t'i hipësh më mushkave se ato nuk pjellin. Tani, ti je kali im. Sali Benishi uli kokën mbi barkun lakuriq të gruas dhe iu duk sikur pa hijen e një fëmije që hante turshi.

Pas tri javësh u martuan. Fshati u habit dhe fisi më i madh u tall me Sali Benishin dhe hapën fjalë se ai e mori Hatixhenë për samar, ndërsa ajo u martua me një kalë. Por Hatixheja ishte një grua e fortë dhe e pasur dhe fshati nuk guxoi ta përfliste për një kohë të gjatë. Natën e dasmës ajo e mbajti qiriun të ndezur dhe ai e shikonte sesi ajo i hiqte një nga një tylet e bardha, këmishën, brezin, çorapet e mëndafshita dhe të brendshmet derisa tulet e saj, ende të forta dhe të disiplinuar, lëshuan një erë parfumi që e mbushi dhomën. Ai i tha ta shuante qiriun, por Hatixheja nuk pranoi dhe, kur ai u shtri mbi bark duke djersitur, ajo i kaloi dorën mbi shenjën e mollës në mes të shpatullave dhe i tha: Profeti im, deveja jote mbarsi oazën time dhe në vend të pemëve mbiu një njeri.

Pas nëntë muajsh lindi një djalë. Karvanët shkonin në qytet me dru dhe ktheheshin me para. Pylli i Hatixhesë rritej dhe ata merrnin fshatarë të tjerë që prisnin dru dhe i ngarkonin. Shtëpia u zgjerua me dhoma të mëdha dhe Sali Benishi ftonte miq, kushërinj dhe vëllezërit e tij për darka dhe ziafete. Për disa vjet lindën katër vajza dhe një djalë tjetër dhe shtëpia u mbush. Ai luante me fëmijët që kishin lindur dhe Hatixheja i kishte gjithnjë gjinjtë e fryrë nga qumështi që i linte njolla të freskëta mbi këmishë. Fisi më i madh i fshatit vazhdonte të fliste me maraz dhe karvanarët e tyre, kur ndesheshin rrugës, kthenin kokën nga ana tjetër, ndërsa mushkat, si për të respektuar të zotët, shtynin me barqe njëra-tjetrën.

Një ditë dimri, nëntë mushka të ngarkuara me dru, bashkë me dy karvanarë rrëshqitën dhe ranë në greminë. Malli i atij viti humbi dhe dy burrave dhe mushkave iu gjetën kockat vetëm kur shkriu dëbora, por ujqit i kishin copëtuar dhe askush nuk i njohu më. Sali Benishi i tha Hatixhesë se këtë punë e kishte bërë fisi më i madh për t'u prishur tregtinë e drurëve dhe për t'u marrë klientët në qytet. Një natë, Sali Benishi nuk u kthye në shtëpi dhe kur erdhi në mëngjes i tha Hatixhesë se e kishte rrëzuar në humnerë karvanin e fisit më të madh. Dymbëdhjetë mushkat ishin shtyrë njëra pas tjetrës në dëborë dhe kishin përfunduar në fund të malit. Ulërimat e kafshëve të tmerruara nuk iu shqitën nga veshët Sali Benishit për tri javë. Por fisi më i madh i kishte dalluar gjurmët e Sali Benishit në dëborë dhe pas kësaj filloi lufta. Ata ishin një fis i madh dhe bura të armatosur bllokuan rrugët që lidhnin fshatin me qytetin dhe nuk lejuan më që karvanët e Hatixhesë të kalonin. Dimri ishte i ashpër dhe stivat me dru mbushën oborrin e shtëpisë. Sali Benishi i shikonte nga dritarja e dhomës dhe shtrëngonte dhëmbët. Ishte i pafuqishëm.

Atë dimër, djali i madh u sëmur dhe vdiq nga ethet. Në fshat u hap fjala se ai kishte një sëmundje të keqe dhe askush nuk shkeli në shtëpinë e tyre për shumë kohë. Hatixheja i rrinte fëmijëve te koka dhe Sali Benishi mbushte mangallin me dru të vegjël për të ngrohur dhomat. Kur dimri iku, rrugët u hapën nga dëbora, por njerëzit e fisit të madh nuk e hoqën ndalimin. Sali Benishi mori një natë një nga mushkat e tij të forta dhe u nis. Burat e ndaluan në dalje të fshatit, por ai nuk u lëkund. Më lini të kaloj, tha dhe i grahu mushkës. Por ata e shtynë dhe ai ra nga mushka e koka iu përplas pas një guri. Kur u përmend e pa veten gjithë baltë në prehrin e Hatixhesë, e cila i vinte lecka me raki në ballë dhe këmbët ia kishte mbështjellë me velenxë të mbushur me mollë të shtypura. Sali Benishi nuk mbante mend çfarë i kishte ndodhur, por fliste në jerm dhe i thoshte Hatixhesë se kishte shumë ftohtë. Ajo i hidhte velenxa mbi trup dhe i shtrydhte raki te tëmthat e tendosur. Një natë Sali Benishi u zgjua dhe i tha Hatixhesë se ai kishte qenë në një shpellë dhe atje kishte parë një engjëll që i tregonte disa shkronja të mëdha të gdhendura në muret e saj. Por ai nuk dinte të lexonte dhe nga sikleti i kishte dalë gjumi. Hatixheja e mbuloi Sali Benishin që fjeti tri ditë rresht pa lëvizur. Herë pas here buzët e tij hapeshin dhe dukej sikur ai habitej nga diçka që shikonte në gjumë. Shtatë javë, Sali Benishi nuk doli nga shtëpia. Fliste shumë pak dhe fjalët që thoshte i kombinonte dhe ato dukeshin si porosi që nuk i drejtoheshin askujt, por nga

pak të gjithëve. Dukej sikur lexonte fjalët e engjëllit në muret e shpellës. Fliste për pyjet, për drurët, për zogjtë, për bimët, për barërat, për ujin, për erën, për dëborën, për freskinë, për hënën, për kafshët, për macet, për kuajt, për gratë dhe fëmijët. Unë jam guri që i mungon shtëpisë për të mbaruar, thoshte dhe i kërkonte Hatixhesë qumësht. Një ditë, ai kishte dalë në dritare dhe po shikonte në oborr Hatixhenë që bisedonte me një karvanar të ri, mustaqet e verdha të të cilit sapo kishin mbirë. Hatixheja iu afrua dhe karvanarit të ri i mbetën sytë të gjinjte e saj të fryrë dhe të kërcyer. Kur ajo hyri në shtëpi, Sali Benishi i vrenjtur ishte mbuluar me një velenxë dhe tha: Ti do mbuloresh sepse sytë e zbuluar të burrave kanë lënë gjurmë në trupin tënd. Hatixheja vuri një shami në kokë dhe këmishën nuk e zbërtheu më kurrë.

Drutë mbetën edhe ca kohë në oborr derisa u dogjën për të ngrohur shtëpinë. Sali Benishi nuk doli më në pyll për dru dhe në shtëpi nisën të mungojnë buka, mielli, turshitë dhe djathi. Hatixheja e mërzhitur vendosi ta shiste pyllin të fisi më i madh, por ata i thanë se nuk u duhej dhe ajo ia shiti një familje tjetër me një çmim shumë të ulët. Djali tjetër, i vogli, vdiq pas dy vjetësh nga të njëjtat ethe si djali i madh dhe Hatixheja nuk doli më nga shtëpia. Sali Benishi i tha të iknin nga fshati sepse aty nuk mund të jetonin më, por ajo nuk pranoi dhe u shtri e sëmurë derisa vdiq në krahët e tij.

Kur e varrosi gruan, Sali Benishi ia hoqi shallin nga koka, e kreu dhe ia zbuloi pak këmishën mbi gjinjtë e mëdhenj dhe të bardhë. I mori erë sqetullave të saj dhe qau. Lotët e tij të djegur ranë mbi gjoksin e Hatixhesë dhe u thanë duke nxjerrë një aromë molle të pjekur. I dërrmuar nga vetmia, me katër vajza të vogla që silleshin nëpër shtëpi duke veshur me radhë rrobat dhe këpucët e Hatixhesë, Sali Benishi ra prapë në jerm. Një shoku i tij karvanar, që i kishte qëndruar besnik familjes, Bari Bakri u kujdes për të dhe i solli ushqime dhe mollë të shtypura që ia vinte te këmbët, siç kishte bërë Hatixheja për ta sjellë në vete. Një natë, Sali Benishi u zgjua dhe u nis te shtëpia e fisit të madh. Në errësirë, turrat e druve ngriheshin mbi muret e lartë të shtëpisë. Ai ndezi zjarr duke pjekur dy gurë stralli pas një lecke të thatë dhe të vaisur dhe e hodhi mbi dru. Zjarri e mbuloi gjithë fshatin atë natë. Njerëzit dilnin nga shtëpia dhe i hidhnin velenxa dhe ujë me kazanë druve, por për dy ditë zjarri nuk u shua, duke e shkruar shtëpinë e vjetër të fisit të madh.

Sali Benishi u fsheh atë natë në shtëpinë e Bari Bakrit. Duhet të ikësh nga fshati, i tha ai. Ata do të të gjejnë dhe do të të vrasin. Të nesërmen, kur akoma hiri i shtëpisë rrinte si një re mbi fshat, ai i çoi vajzat te vëllezërit e tij dhe vetë u kthye në shtëpi për të bërë gati mushkat dhe plaçkat. Kur u ngjit në pllajë, u kthye dhe pa fshatin. Ishte pasdite dhe dielli e hëna ndriçonin njëkohësisht.

Koha më e mirë për t'u nisur. Po ta ndiqnin, nuk do t'ia gjenin dot hijen.

Pas pesë ditësh ishte në Voskopojë.

Ishte viti 1761 dhe myslimanëve u jepej strehim në qytet, sepse ata vendosnin për shumicën e votave në këshillin e të katërmbëdhjetëve. Zuri punë pranë një tregtari që shiste dru në Korçë dhe atij i eci puna dhe e ndihmoi Sali Benishin të gjente një shtëpi. Në qytet ai u miqësua me myslimanët e tjerë dhe i jepte atyre porosi, të cilat i vinin atij në gjumë nga një zë i panjohur. Ndryshe nga fshati i tij, këtu e besonin. Voskopoja ishte një qytet i krishterë dhe myslimanët jetonin me shpresën se në këtë qytet një ditë do të kishin vendin e merituar. Burat mblidheshin në darkë pas punëve dhe Sali Benishi fliste gjatë për Zotin, për engjëjt, për lumenjtë, për të mirën, për të keqen, për zakonet, për gratë dhe për veshjet.

Pas disa muajsh, në Voskopojë, erdhi miku i tij Bari Bakri që i tha se në fshat fisi i madh e kishte kërkuar për një muaj në pyll ku mendonin se ai ishte fshehur, por nuk e kishin gjetur dot dhe

kishin hapur fjalë se ai kishte rënë në humnerë dhe kishte vdekur nga e ftohta. Më mirë që besojnë se jam i vdekur, tha Sali Benishi. Sa isha gjallë nuk më besonin.

Bari Bakri kishte sjellë në Voskopojë edhe familjen e tij. Gruan, tri vajzat dhe një djalë. Pas vdekjes së Hatixhesë, Sali Benishi jetonte vetëm dhe shkonte pothuajse çdo natë në shtëpinë e Bari Bakrit ku dy burrat hanin dhe bisedonin duke djegur duhan të lirë, ndërsa fëmijët luanin.

Vajza e dytë e Bari Bakrit ishte fëmija më i dashur i shtëpisë. Quhej Aishe. Kur erdhi në Voskopojë ajo ishte dymbëdhjetë vjeç. Këshilli i të katërmbëdhjetëve, që në kohën e Johan Vulgarit, i kishte dhënë të drejtë fëmijëve myslimanë të ndiqnin shkollat dhe Aishja shkonte çdo mëngjes në klasën e vajzave. Ajo ngrihej herët, lahej, pastronte veshët, mblidhte flokët e zinj që i vinin deri në bel, ngrinte jakën e këmishës që e forconte çdo darkë me niseshte, lidhte një verore me pe jeshil dhe të verdhë në kyçin e dorës dhe nisej. Aishja ishte e zgjuar dhe shumë e bukur. Kur ecte nëpër kalldrëmet e lagjeve të krishtera djemtë mblidheshin duke e parë dhe ajo ecte ngadalë me sytë e përmbysur si për t'ua zgjatur atyre kënaqësinë. Në shkollë Aishja lexonte vjersha, mblidhte shumë shpejt numrat që pastaj i pjesëtonte, i zbriste dhe i shumëzonte.

Kur mbushi trembëdhjetë vjeç Aishja u zgjat me gati dy pëllëmbë. Nuk është më fëmijë, por një grua, i tha e shoqja Bari Bakrit. Ky e shihte vajzën, së cilës i ishin zgjatur gjymtyrët, kofshët i ishin bashkuar dhe gjinjtë e vegjël i ishin forcuar dhe i ishin kthyer në dy kodra të mbjella. Kur i lëshonte flokët e gjata, në shtëpi përhapej një erë e fortë myshku. Aishja përdorte një krem myshku bojëvjollcë, që shoqet e veta të krishtera e zienin dhe pastaj e përzienin me vezë derisa, duke u rrahur, bëhej i kaltër dhe me të lyejin flokët për t'i zbutur dhe për t'i shkëlqyer si astar. Kur Aishja lahej, të shtunave, era e myshkut dilte në oborr dhe gjithë mëhalla nuhaste vajzën që lahej. Nën sqetulla i kishin dalë ca qime të vogla të zeza si furçat që përdorte David Selenica për të ngjyrosur pranverën, ndërsa kur skuqej në faqe i nxinte një push i zi dhe shumë i ndjeshëm. Një ditë, Aishja doli nga banja lakuriq dhe kur e ëma e pa u habit dhe i tha të shoqit se vajza po rritej duke u larë dhe duke u fërkuar. Mos e lër të lahet kaq shpesh, i tha Bari Bakri.

Sali Benishi që tymoste duhan me Bari Bakrin, u deh një natë nga era e flokëve të Aishës kur kjo u solli kafënë në dhomën e bukës. Era e myshkut u përzje me erën e hidhur të kafesë dhe ai ndjeu një të prerë në stomak, pastaj djersë të ftohta i zbritën mbi mollën në mes të shpatullave dhe këmbët iu ftohën. Mbështeti kokën pas jastëkut të kadifenjtë që Bari Bakri e kishte sjellë nga fshati dhe e zuri gjumi.

Kur u zgjua, pa Bari Bakrin që i rrinte përballë me një tas të mbushur me copa mollë që pluskonin në uthull. Këpucët ia kishin zbatuar dhe tëmthat i kishte të lagur. Çfarë kam bërë, e pyeti ai Bari Bakrin që e shikonte i prekur. Ke kërkuar një grua, i tha Bari Bakri. Më ke treguar gjithë natën si flije me Hatixhenë, si e zhvishje, si haje turshi me gjizë, si pije qumësht në krevat, si ia mbuloje gruas lëkurën me ajkë të trashë dhe shumë gjëra të tjera. Sali Benishi vuri bërrylat mbi jastëk dhe u zgjat nga Bari Bakri. Po për gjinjtë e Hatixhesë të rrëfeva, e pyeti. Bari Bakri e pa në sy, uli kokën dhe i zgjati një gotë qumësht të ftohtë.

Atë ditë, Sali Benishi nuk shkoi në punë dhe për tri javë nuk u takua me Bari Bakrin. I vinte turp dhe e shmangte rrugën e shtëpisë së tij. Pas pune, endej i vetëm në rrugët e Voskopojës dhe nganjëherë afrohej te tavernat e zhurmshme të studentëve, në lagjen e kazanxhinjve. Zgjaste kokën nga dritaret e vogla dhe në mes të tymit shikonte djem me këmisha të bardha që pinin verë të kuqe me pastërma dhe hipnin mbi tavolina duke recituar. Sali Benishi nuk dëgjonte dot se çfarë thuhej brenda, por, kur dera hapej dhe ai tërhiqej në errësirë që të mos e shihnin, studentët dilnin gjithë zhurmë dhe merrnin rrugën drejt një shtëpie të veçuar në lagjen e jorganxhinjve. Sa afroheshin atje, pushonin dhe qetësonin hapat. Sali Benishi i ndiqte dhe shihte se si ata trokisnin pesë herë duke numëruar me kujdes në portën e vogël, që pas pesë trokitjesh të rregullta e hapte

një grua e bëshme dhe e shëndoshë, e veshur me tyl dhe me duart me unaza alumini. Qirinjtë e dhomave të shtëpisë fikeshin një nga një dhe kur studentët dilnin, Sali Benishi dëgjonte se si i tregonin njëri-tjetrit për gratë me të cilat kishin fjetur në shtëpinë e veçuar. Atëherë ai ndihej edhe më i vetmuar. Shkonte në shtëpi, zhvishej dhe futej në rroba. Derisa e zinte gjumi luante me hijet në tavan dhe kafshonte mollë të paqëruara.

Në një natë të tillë, u hap dera dhe në dhomë hyri Bari Bakri. Sali Benishi u ngrit dhe të dy burrat u ulën përballë njëri-tjetrit. E gjete gruan, e pyeti Bari Bakri. Nuk kam aq fat, u përgjigj Sali Benishi dhe lëvizi brenda këmishës së vet ët zhubrosur, sikur donte të ikte nga biseda. Por Bari Bakri ia nguli sytë fort dhe Sali Benishi e kuptoi se ai nuk kishte ardhur vetëm për t'i bërë një pyetje. Nganjëherë fatin e kërkojmë aty ku ai nuk është dhe harrojmë se ai ka formën e gjërave që njohim. E kërkojmë në pyll, por ai është në prush, e kërkojmë në qiell, e ai është në tokë, e kërkojmë në rrugë e ai është në shtëpi, e kërkojmë te Zoti, por ai është te njeriu, e kërkojmë te tjetri, por ai fshihet te ne. Ne mendojmë se fati është një gjë e panjohur, por në të vërtetë ai fshihet te gjërat e njohura. Ti po kërkon një grua të panjohur që të të rehatojë trupin, të të përkëdhelë barkun, të të qërojë mollën dhe të të pleqërojë duke ndezur mangallin e shpirtit tënd. Të kam parë se si endesh rrugëve i humbur duke kërkuar fatin në dyer që nuk hapen dhe që, në qoftë se hapen, janë rast, por nuk janë fat. Njerëzit e ngatërrojnë kollaj rastin me fatin. Rast është çdo grua që na del përpara në rrugë, ndërsa fat është gruaja që fusim në shtëpi dhe e mbajmë aty gjithë jetën. Rasti është një mollë që e gjejmë në shesh dhe e kafshojmë si të zilepsur për të shuar etjen që sjell rendja pa drejtim. Fati është një pemë që e mbjellim vetë, e ujisim, ia presim bistakët, e shartojmë, ia mbledhim gjethet e bardha, ia drejtojmë lastarin me një dru të fortë, ia mbledhim kokrrat me lëng, pastaj i qërojmë një nga një dhe këtë shije e kemi në gojë në fund të çdo dite, në fund të çdo viti deri në fund të jetës.

Kam ardhur të të them të martohesh me Aishen, tha Bari Bakri dhe fytyra iu bë e murrme, si një verë e vjetër që hapet para se të skuqet si uthull. Aishen, pyeti Sali Benishi dhe këmbët iu ftohën, ndërsa një erë myshku iu ngjit nga stomaku dhe i doli nga hundët. Aishja është më e vogël se vajzat e mia. Unë dua një grua, tha me gjysmë zëri dhe ndjeu që molla në mes të shpatullave iu lëngëzua. Aishja është një fëmijë që po bëhet grua, tha Bari Bakri. Ti ke rastin ta krijosh fatin tënd. Unë po të jap një pemë që e kam mbjellë vetë. Merre, mbille në bahçen tënde, krasite, drejtoje me forcë nëse të duket e shtrembër, pritja sythat që rriten si thonj të tepërt, shartoje me trungun tënd, mbuloje me lëkurën tënde nga ngrica e dimrit, mos lër njeri t'ia prekë lulet në verë dhe shumë shpejt nga degët e saj do dalin fryte të bukura që do të ta mbushin gojën me lëng kur t'i shijosh.

Aishja është bërë grua, tha Bari Bakri dhe uli kokën sikur t'i besonte tjetrit një sekret. Do bindesh kur ta lash.

Dy burrat mbetën pranë mangallit që po shuhej, deri në mesnatë. Bari Bakri fliste dhe Sali Benishi dëgjonte i mbështetur në jastëk, gjersa e zuri gjumi. Bari Bakri e mbuloi, shoi prushin e fjetur dhe iku.

Pas tri ditësh e solli Aishen në shtëpi. Sali Benishi qëndroi pas dritares dhe pa Bari Bakrin që ecte përpara dhe pas tij vinte e shoqja që mbante Aishen për dore. Këmbët e të treve ngjiteshin në shkallët e drunjtë të shtëpisë derisa në korridor u ndanë dhe vazhduan në drejtime të ndryshme. Bari Bakri hyri në dhomën e Sali Benishit, ndërsa dy gratë në dhomën tjetër. Të trashëgoheni, i tha Bari Bakri dhe e puthi në faqe. Pas pak në dhomë hyri dhe gruaja e Bari Bakrit. Sytë i kishte të skuqur dhe shamia e flokëve i kishte rënë mbi supe. Sali Benishi u ngrit

në këmbë dhe u drejtua nga ajo si një njeri që pret të mësojë se si përdoret dhurata që i kanë sjellë.

Gruaja e Bari Bakrit rregulloi shaminë dhe tha: Aishja nuk e pi qumështin. Para se të shkojë në shkollë do një vezë të zier me sheqer dhe në darkë çaj trëndafili, djathë dhe bukë misri të thekur. Kur i vijnë ato, hidhi limon në çaj dhe bëri supë me piper që t'i mblidhet barku.

Gruaja e Bari Bakrit fliste për ushqimet, për rrobat, për librat, për punët e shtëpisë, për ciklet dhe sëmudjet e Aishes dhe Sali Benishi përpiquej të tregohej i vëmendshëm, por era e kremit të myshkut që dilte nga dhoma tjetër e kishte shpërqendruar. Gruaja fliste me duart që i zgjaste nga vetja, si për të frenuar ankthin dhe kur mbaroi tha: Mos e lër të lahet shumë se do bëhet më e gjatë se ty dhe mos e prek me dorë pa u bërë katërmbëdhjetë vjeç. Sa vjeç është, e pyeti Sali Benishi duke kthyer kokën nga Bari Bakri. Para pesë muajsh mbushi trembëdhjetë, tha gruaja që i hodhi një sy dhomës, rrëmuja e së cilës nuk i pëlqeu.

Kur prindërit e Aishes ikën, Sali Benishi doli në dritare. Bari Bakri ecte përpara, ndërsa pas tij çapitej e shoqja që rregullonte shaminë që i binte vazhdimisht mbi sup. Pasi eci pak, ajo ktheu kokën dhe një lot i madh shkëlqeu në diell.

Sali Benishi u tërhoq në errësirën e dhomës së tij dhe u ul. Pas pak u ngrit dhe u afrua te dera. Zgjati veshin, por nga dhoma tjetër nuk vinte asnjë zhurmë. U kthye në shtrat dhe u mbështet mbi jastëkun e ri, të qëndisur nga Hatixheja, të cilin e kishte nxjerrë atë mëngjes nga sënduku i kujtimeve që kishte sjellë nga fshati. Vuri duart pas kokës, por i largoi prapë, se iu duk sikur i pengonin dëgjimin. U ngrit dhe shkoi te dera. E hapi ngadalë, por dhoma ngjitur ishte e shurdhët. U kthye dhe u ul prapë. Pastaj u çua dhe doli me hapa të vegjël duke ecur majë gishtave në korridor. Vuri veshin te dera e dhomës së Aishes, por përsëri nuk dëgjoji gjë. E mbështeti kokën në dërrasën e ashpër të derës, aq sa lëkura iu gërric te balli, por asnjë tingull nuk mbërriti deri te veshi i tij. Mbajti frymën dhe mbeti në majë të gishtave sa vetja iu duk si i varur në parvaz. U kthye në dhomë dhe u shtri duke e lënë derën pak të hapur. Natën lëvizte kokën mbi jastëk dhe zhurma e puplave ngrihej në tavan. Flokët e tij bënë hije të çrregullta në mur derisa atë e zuri gjumi.

Kur u gdhi, u ngrit, veshi një këmishë të pastër dhe të pazhubrosur, lau sytë, i ndau me vizë flokët në mes dhe zbriti në kuzhinë. Zjeu një vezë dhe e qëroi me kujdes lëvozhgën që e ciflosi lehtë me një majë luge. Veza e ngrohtë i djersiu në dorë kur ai ia preu pak majën dhe e kuqja doli si një kokë zoçke që ngrihet nga gjumi në mëngjes. E rregulloi vezën mbi një pjatë të pastër dhe mbushi një filxhan kafeje përgjysmë me sheqer. Nga sënduku i Hatixhesë tërhoqi një pecetë bojë rozë, të palosur katër herë dhe bashkë me pjatën dhe filxhanin i vendosi të gjitha në një tabaka prej druri. Futi dorën në xhep dhe nxori një çelës të madh që varej në një pe jeshil dhe e lëshoi në cep të tabakasë. U ngjit lart në majë të gishtave dhe e la tabakanë përpara derës së Aishes. Hyri në dhomën e vet dhe u mbështet te dera, të cilën e la të hapur aq sa dukej e kuqja e vezës që e ndriçonte korridorin si prush prej mishi.

Nga rruga vinin zërat e tregtarëve dhe zanatçinjve që niseshin për në punë dhe pak më vonë ai dëgjoji dhe fëmijët që dolën për në shkollë. Dera e dhomës u hap dhe ai pa Aishen që tërhoqi tabakanë brenda dhe pastaj doli në korridor e veshur me një këmishë nate të kaltër, që i mbulonte këmbët deri te kyçet. Ishte zbathur dhe flokët e lëshuara i dukeshin si një shall i zi. Ajo shkoi në banjë dhe ai dëgjoji një kovë me ujë që u derdh me forcë. Një erë myshku e mbushi gjithë shtëpinë dhe Sali Benishi u mbajt fort pas derës, si i dehur. Aishja u kthye në dhomë, me flokë të krehur drejt dhe këmishën të lagur pak, në mes të këmbëve. Ai dëgjoji zhurmën e një luge mbi pjatë dhe pastaj pa Aishen që doli nga dhoma dhe zbriti në rrugë. U afrua me shpejtësi te dritarja dhe e ndoqi me sy. Aishja kishte veshur një bluzë të verdhë leshi, me mëngë të gjata, një fund të



zi, çorape të kuqe dhe flokët i kishte lidhur pas koke. Në qafë, i varej çelësi i madh që lëkundej si një kryq. Dy burra që po kalonin kthyen kokën, por Aishja vazhdoi të ecte derisa u zhduk pas kthesës. Sali Benishi shkoi në dhomën e saj dhe desh u përplas pas tabakasë që ishte derdhur gjithandej. Në një cep, ishte një bocë me rroba, ndërsa mbi krevatin e prishur ai pa një palë breçka të vogla që kishin një njollë të freskët ngjyrëtrëndafili. I ngriti dhe i fshehu poshtë jastëkut. Rregulloi krevatin, mori tabakanë dhe duke zbritur e hëngri vezën e mbetur.

Kur doli në rrugë, ktheu kokën në drejtimin që kishte marrë Aishja, por pa vetëm hijen e vet të madhe që zgjatej gjithë gunga mbi kalldrëm. Kur u kthye nga puna në mbrëmje, dera e shtëpisë ishte e hapur. U ngjit lart dhe vuri veshin te dera e Aishes, por nuk dëgjoi gjë. Pasi u zhvesh, theku bukë misri, zjeu çaj, mbushi dhe një pjatë me shegë dhe i la përpara derës. Kur u shtri, dëgjoi flokët e Aishes që fërfëllinë në korridor. Tabakaja me ushqime u zvarrit dhe dera u mbyll. Në mëngjes zjeu prapë vezë me sheqer dhe qëndroi në dritare kur Aishja doli për në shkollë. Flokët i kishte lëshuar dhe kishte mbathur çorape të shkurtra. Mishi i bardhë i pulpave të mbuluara me push dukej si i lyer me sheqer.

Për një javë Sali Benishi nuk foli me Aishen. I dukej vetja si një gjahtar, i cili mban një kanarinë në kafaz duke e ditur që po i foli asaj do t'i bien pendët dhe ai ka frikë ta shohë lakuriq. Ziente çdo mëngjes vezë dhe në darkë kur kthehej thekte bukë me çaj të nxehtë. Një ditë, kur erdhi nga puna dhe u shtri në krevat, dera e dhomës së tij u shty ngadalë dhe Aishja, e veshur me rrobat e shkollës, qëndroi në prag. Ai u ngrit mbi bërriyla dhe u drejtua nga vajza. Pse e zien vezën aq lluqe, i tha ajo pa hyrë brenda. Sali Benishi nuk foli, por supet e tij lëvizën dhe molla në mes të shpatullave iu mbush me djersë. Aishja nuk priti që ai të përgjigjej, por vazhdoi: Mund të më bësh një supë me piper se më dhemb barku? Ai bëri të ngrihej, por u kujtua se ishte i zhveshur dhe mbuloi këmbët me jorgan. Aishja u kthye në dhomën e saj dhe ai u vesh dhe zbriti në kuzhinë. Kur supa ishte gati ai preu një fetë limon dhe e përzjeu disa herë. Pastaj hodhi pak piper dhe e provoi hidhësirën me një majë luge. U ngjit lart dhe trokiti në derën e Aishes. Ajo e hapi dhe Sali Benishi e pa për herë të parë nga afër. Kishte veshur këmishën e kaltër të natës, poshtë së cilës gjinjtë e vegjël dukeshin si dy mollë të fshehura nën çarçaf. Faqet e ish-in skuqur dhe disa quka të kuqe i kishin mbirë si lule mbi mollëza. Sytë e Aishes ishin të zinj, ndërsa vetullat e trasha i ishin bashkuar në ballë. Veshët e bardhë i kishte shpuar dhe secili prej tyre kishte një gropë të vogël që dukej si nishan. Buzët e Aishes ishin të thara dhe Sali Benishi mendoi se vajza kishte ethe. I zgjati pjatën e supës. Ajo e mori dhe avulli iu ngjit në faqe dhe ia lëvizi pak flokët. Para se të mbyllte derën, Aishja ngriti kokën dhe tha: Nesër nuk do shkoj në shkollë.

Kur erdhi vera, Aishja i hoqi çorapet e leshit. Shkonte në shkollë me sandale dhe këmishën e mbante të zbërthyer. Një ditë, kur ai u kthye në drekë, e gjeti në oborr duke luajtur me dy shoqe. Sali Benishi i përshëndeti dhe dy vajzat e tjera filluan të qeshnin kur Aishja pëshpëriti diçka që ai nuk e dëgjoi. Maji ishte i nxehtë dhe vajzat ishin djersitur duke vrapuar dhe i kishin përveshur llërët e këmishëve të bardha të shkollës. Fundet e shkurtra iu ngriheshin lart dhe Sali Benishi rrinte pas dritares dhe shikonte kofshët e tyre të pakujdesshme që zbuloheshin duke u rritur. Kur i përcolli shoqet, Aishja u ngjit lart dhe ai dëgjoi ujin që filloi të derdhej në banjë. Doli në majë të gishtave dhe afroi kokën te dera. Një erë e mirë sapuni i erdhi në hundë, ndërsa sfungjeri shqitej me zhurmë nga lëkura e djersitur e Aishes. Kur ai e shtyu derën, Aishja lakuriq ishte ulur mbi një stol duke fshirë krahët. Ajo u ngrit në këmbë dhe u mbështet pas murit, por nuk u mbulua dhe nuk dukej e frikësuar. Uji i rridhte në të gjithë trupin, ndërsa thithkat e zeza të gjinjve i ishin fryrë nga peshqiri që sapo i kishte fërkuar. Sali Benishi ndjeu një fryrje të padurueshme në mes të këmbëve dhe, duke shkelur mbi shkumë, e kapi vajzën me një dorë nga flokët dhe dorën tjetër e futi në mes të kofshëve të lagura. Një gisht iu thith nga një sfungjer prej

mishi dhe mbeti aty. Aishja mjaulliu dhe e kafshoi fort në gjoks, por Sali Benishit kjo dhimbje iu duk si pickimi i kanarinës lakuriqe, mbi dorën e stërvitur të gjuetarit. Vajza qëndroi në ajër, me këmbë të hapura, duke u mbajtur me dhëmbë pas mishit të thatë si pastërma të Sali Benishit. Ajo nuk i shkëputi dhëmbët edhe kur Sali Benishi u fut i gjithi brenda saj dhe mbeti atje derisa një zhurmë prej veze lluqe të qëruar doli nga fundi i barkut të Aishes. Kur Sali Benishi u tërhoq, mbi lëkurën e tij të vjetër, dhëmbët e Aishes kishin vizatuar një kokërr arre. Shkuma e sapunit ishte bërë e kuqe dhe peshqiri dukej si një mjellmë e plagosur mbi ujë. Sali Benishi u fut në dhomë dhe të nesërmen iku në punë pa e zier vezën e Aishes. E ushqeva derisa u bë grua, mendoi me vete kur doli në rrugë.

Gjatë gjithë verës, Sali Benishi hynte çdo natë në banjën e Aishes kur binte mbrëmja. Vajza nuk fliste, por kafshonte kokrrën e arrës që zmadhohej dhe ngrihej si grusht mbi gjoksin e Sali Benishit. Peshqiri nuk skuqej më dhe kur Sali Benishi ikte Aishja fuste një sapun në vendin që ai kishte lënë bosh. Në mëngjes ajo zgjohej e para dhe bënte trahana me spec djegës dhe me vaj të djegur, ndërsa në darkë, pasi burri ikte nga banja, ajo vishej, zbriste në kuzhinë me shapka dhe piqte patëllxhanë me domate dhe mish viçi të grirë në një tigan balte që Sali Benishi e kishte kujtim nga Hatixheja.

Një ditë, gjatë trazirave të vitit 1764, Aishja erdhi nga shkolla me një shall të kuq në qafë. Cepat e shallit i mbulonin gjinjtë e rritur dhe Sali Benishi u vrenjt. Kush ta dha këtë shall, e pyeti duke parë nën vetulla. Ma dhanë në shkollë, tha Aishja. Është shalli i Marin Kurilës që do shpëtojë Voskopojën. Sali Benishit i ranë vetullat mbi sy. E ke takuar ti Marin Kurilën? Kaloi sot përpara shkollës dhe gjithë vajzat dolën në dritare për ta parë. Ishte shumë i bukur dhe i larë, tha Aishja dhe u fut në dhomën e saj. Në mbrëmje, kur Sali Benishi shkoi në banjë për të kryer detyrën e burrit të shtëpisë, Aishja ishte si gjithnjë lakuriq, por shallin nuk e kishte hequr nga qafa. Atë natë, Sali Benishit nuk iu përsërit fryrja e zakonshme dhe Aishja nuk e kafshoi më kokrrën e arrës.

Gjuetari dhe kanarina e kishin mendjen jashtë kafazit në rrugët e Voskopojës që kishin filluar të mbuloheshin me shalle të kuq. Aishja priti si çdo natë me këmbët hapur, por muskuli i Sali Benishit u shtri si një patëllxhan i fishkur mbi tigan. Kur u bë qull nga djersët e moshës dhe nga turpi i burrit, Sali Benishi u tendos dhe i tha Aishes: Kafsho, kafsho kanarina ime. Por Aishja nuk e kafshoi, si një kanarinë e ngopur me ushqimin e gjuetarit. Sali Benishi e shtyu dhe iku si një kafshë që i varet bishti përpara. I mbuluar me djersë, u fut në çarçafë dhe filloi të dridhej. Plaga e pangacmuar mbi gjoks i ishte ënjtur dhe ai e shtrëngonte fort, por ajo nuk dhembte dhe Sali Benishi rënkonte. Nuk fjeti gjithë natën dhe në mëngjes u ngrit dhe e priti Aishen te dera e dhomës. Kur ajo doli me shallin e kuq të lidhur në qafë, Sali Benishi e kapi fort nga flokët, i futi dorën poshtë shallit dhe ia shqeu. Aishes iu varën flokët mbi fytyrë dhe ai pa sytë e saj që shkëlqen nga egërsia. E mori shallin e grisur dhe u fut në dhomën e vet. Nga dritarja pa Aishen që ecte me kokën ulur, si një vajzë që sapo i kanë hequr perçen.

Të nesërmen nuk e la më Aishen të shkonte në shkollë. Voskopoja filloi të vlonte nga fjalime e zjarra të Marin Kurilës dhe Sali Benishi bashkë me disa myslimanë të tjerë, mbledheshin çdo natë në shtëpinë e Bari Bakrit. Natën që u vra Marin Kurila, Sali Benishi mbylli dritaren me batanije dhe e mori Aishen në krevatin e tij për herë të parë. Pse qëllojnë kështu, e pyeti vajza. Kanë vrarë Marin Kurilën, i tha ai. Ishte shumë i bukur, tha Aishja duke lexuar si horoskop shenjën që Sali Benishi kishte në kurriz. Ishalla nuk ia kanë prishur fytyrën.

Pas dy ditësh, Sali Benishin e futën në burg dhe Aishja mbeti vetëm për disa muaj. Shkoi të flinte në shtëpinë e Bari Bakrit dhe pasi krihej në mëngjes dhe i lyente flokët me krem dilte me shoqet

në livadhet e myshqeve dhe kthehej pasdite. Ato kohë, fytyra i qeshte. Gjoksi iu rrit dhe pushi i këmbëve iu zgjat. Një natë u vonua shumë dhe Bari Bakri u nis për ta kërkuar. Muzgu i tetorit kishte rënë dhe ngjyrat e myshqeve ishin errësuar. Bari Bakri eci një copë herë, derisa në errësi të dalloi disa këmisha të bardha që lëviznin duke u përzier me njëra-tjetrën. U afrua dhe pa Aishen me dy djem më të mëdhenj se ajo me shall të kuqe. Vajza rrinte ulur dhe po puthej me njërin nga djemtë, ndërsa djali tjetër, me flokë të verdhë, kishte mbështetur kokën në prehrin e saj dhe i kishte futur një dorë poshtë fustanit. Kur Bari Bakri i thirri, djemtë u ngritën, ia dhanë vrapit dhe u zhdukën si hijet e tyre në muzg. Aishja rregulloi fustanin dhe eci në drejtim të të atit. Ç'po bëje ashtu, u çor Bari Bakri me sy të shqyer. Po mësoja fëmijët se si puthet, tha Aishja dhe mori për nga shtëpia. Mëkat, bërtiti Bari Bakri, ti je e martuar. Burri im nuk më puth, baba, tha Aishja dhe vazhdoi rrugën duke shkelur mbi myshqe. Bari Bakri nuk foli por e ndoqi nga prapa si ujku plak këlyshin e vet të pabindur.

Kur Sali Benishi doli nga burgu, e gjeti shtëpinë rrëmujë, të mbushur me pluhur dhe oborrin plot me barut të djegur. Pas një jave ai solli në shtëpi Xhuvrijen dhe dyshemetë filluan të shkëlqenin. Xhuvrija ishte një grua e krishterë në moshën e Sali Benishit. Ajo kishte qenë e martuar me një tregtar sapunësh, i cili u vra nga shokët e Marin Kurilës, i akuzuar si pjesëmarrës në vrasjen e tij. Shtëpia e saj u dogj dhe depot e sapunit të burrit u bastisën. Djali i vetëm studioi në Vjenë dhe nuk ishte kthyer më.

Sali Benishi e takoi një natë në një rrugë të errët ku ajo priste si mace e uritur një nga shokët e Marin Kurilës. Ç'po bën këtu grua, i tha. Po pres të vras vrasësin e burrit tim, tha gruaja. Jemi nisur në të njëjtën rrugë, tha Sali Benishi. Gruaja kishte flokë të zinj, qafën e kishte të zeshkët dhe në faqe i nxinte një nishan që lëshonte një hije në formë katrori. E pa Sali Benishin në sy dhe hëna e plotë ia zverdhi buzët e rreshkura. Kur i tregoi për burrin, për djalin, për djegien e shtëpisë, për vjedhjen e mallit dhe ditët që kishte kaluar duke u endur si jetime nëpër Voskopojë, Sali Benishit iu dhimbs. Plaga e Aishes mbi gjoks i ishte tharë dhe atij iu kujtua Hatixheja. Më mungon, por Zoti po ma zëvendëson, mendoi dhe nguli sytë mbi nishanin e zi që lëvizte i shqetësuar.

Si quhesh, e pyeti. Sofije, u përgjigj gruaja dhe rregulloi flokët si një pelë që ngre jelen, para se t'i vënë samarin. Hajde në shtëpinë time Xhuvrije, tha Sali Benishi dhe eci përpara. Je i martuar, e pyeti gruaja, duke e ndjekur. Jam i martuar me një fëmijë që ka nevojë për një nënë, tha Sali Benishi dhe shtoi: Unë jam mysliman Xhuvrije dhe mund të kem katër gra. Atë natë Xhuvrija fjeti në kuzhinë. Sali Benishi shkoi në dhomën e tij dhe nuk u fut në banjën e Aishes. Në mëngjes shtëpia dukej më e pastër. Xhuvrija kishte fshirë pluhurat, kishte larë tiganët dhe pjatat, i kishte hedhur ujë oborrit të djegur dhe i kishte skuqur Sali Benishit një mëlçi pule me gjalpë.

Aishja ishte zgjuar herët nga zhurmat e enëve që laheshin dhe kur pa Sali Benishin i tha: Na duhej një pastruese. Shtëpisë i duhej një grua dhe ty të duhej një nënë, tha Sali Benishi dhe zbriti shkallët duke ndjekur erën e mëlçisë. Xhuvrija solli disa mobilie që i kishin shpëtuar djegies nga shtëpia e saj. Shkallët i veshi me një qilim të gjatë me viza të kuqe dhe të zeza, mbi tavolinë vendosi një shandan argjendi dhe raftet i mbushi me enë porcelani që burri i saj i kishte blerë në Venedik. Solli dhe një senduk të madh të mbushur me rrobat e burrit dhe ia dha Sali Benishit që i provoi një nga një, ndërsa Aishja qeshte dhe Xhuvrija i zgjaste çorapet e lara. Burri yt paska qenë i shkurtër, tha Aishja kur pa kyçet e Sali Benishit që dilnin jashtë pantallonave. Djali është më i gjatë se i ti, tha Xhuvrija dhe mbuloi nishanin me dorë.

Në darkë, Sali Benishi shkoi në takimin e zakonshëm në shtëpinë e Bari Bakrit i veshur me kostum të zi, me jakë të trashë dhe këpucë të pastra prej frëngu që kur i hoqi, lëshuan një erë të mirë që mbushi korridorin e Bari Bakrit. Pse je veshur si kaur, e pyeti gruaja e Bari Bakrit. Jam

martuar me një grua të krishterë, tha Sali Benishi dhe e puthi Bari Bakrin e skuqur në faqe. Gruaja e Bari Bakrit doli nga dhoma, tërhoqi derën me zhurmë dhe pështyu mbi këpucët që ndriçonin hajatin e errët të shtëpisë.

Kur Sali Benishi e mori Xhuvrijen në dhomën e tij, pa se gjithë trupin e kishte të mbushur me nishane. Në kurriz tre nishane të mëdhenj formonin një yllësi, por kishte dhe nishane më të vegjël që ecnin në rresht pas njëri-tjetrit, deri te horizonti i hollë i belit të saj. Gjnjtë i kishin rënë dhe kërthiza kishte humbur nën palat e barkut. Por gruaja ishte e lehtë dhe punëtore dhe Sali Benishit nuk iu duk më vetja si një mësues i punëve të trupit. Duke ndjekur kalldrëmin e nishaneve në kurrizin e saj, Sali Benishi dëgjoi një zhurmë në korridor dhe një palë qerpikë që u ngjiten pas derës. Ndaloj dhe ngriti kokën. Duhet të jetë Aishja, tha Xhuvrija që rregulloi frymëmarrjen. Po mëson duke na parë. Sali Benishi qeshi dhe vazhdoi të ecte.

I shtrirë në krevatin e tij, Sali Benishi shikonte hijet dhe kujtonte ditët kur Voskopoja ishte më e qetë dhe Aishja lante trupin, ndërsa Xhuvrija lante shtëpinë. Vizatimet e profetit i silleshin si hije me ngjyra mbi tavan. Sidomos vizatimi ku profeti ishte i shtrirë dhe tri gra e përkëdhelnin ia kishte prishur gjumin. Ato tri gra dukeshin si gratë e tij. Hatixhja bujare me gjinj të mëdhenj, Aishja e re dhe xhelozë dhe Xhuvrija e vuajtur me nishan në faqe. Nuk kishte rëndësi kush i kishte bërë ato vizatime. Kushdo qoftë, ajo dorë nuk kishte fyer vetëm profetin dhe duhej të pritej. E zuri gjumi me ngjyrat e vizatimeve në sy. Në dhomën tjetër, Aishja flinte, ndërsa Xhuvrija ishte zgjuar për t'i skuqur një mëlçi me gjak.

Dy ditë më vonë në Voskopoje erdhi një hoxhë. Ai mbante një çallmë jeshile në kokë dhe ecte duke fshirë rrugët me xhyben që e ndiqte nga pas si bisht. Ishte një burrë i gjatë dhe i hollë dhe disa qime nën mjekër e tregonin edhe më të gjatë. Duke ecur, ai nuk i fliste askujt, por kalonte nëpër gishta një palë tespihe të verdha, rruazat e mëdha të së cilës dukeshin si hurma të vogla që lëviznin me shpejtësi.

Hoxha kaloi përpara katedrales, pastaj u fut në lagjen e armëtarëve dhe u drejtua nga lagjja e re. E dinte rrugën, a thua se kishte qenë edhe më parë në Voskopoje.

Fëmijët nuk kishin parë kurrë hoxhë. Ata e ndiqnin nga pas duke u përpjekur të gjenin sa gogla kishte tespihja e tij. Një djalë me shall të kuq i doli hoxhës përpara dhe i tha: Sa gurë ka tespihja jote? Hoxha ndaloj, ngriti tespihen mbi kokën e djalit dhe goglat u skuqën nga rrezet e diellit. Numëroji, tha hoxha duke ia afruar djalit tespihen. Ai i numëroi një nga një, por rruazat e lëmuara binin me shpejtësi mbi njëra-tjetrën dhe djali që e ndjeu se po ngatërrohej tha: Katërmbëdhjetë. Hoxha ia afroi edhe më shumë pranë fytyrës dhe duke fërkuar mjekrën e vogël tha: Numëroji prapë. Djali, që kishte nisur të djersitej nga sikleti, zgjati gishtin mbi tespihe dhe i kaloi rruazat edhe një herë duke shtrënguar mes gishtave çdo gur që numëronte, në mënyrë që ai të mos binte poshtë dhe të numërohej dy herë. Kur mbaroi, mori frymë dhe tha: Trembëdhjetë.

Po, tha hoxha, aq janë.

Pse janë trembëdhjetë, e pyeti një djalë tjetër që ishte afruar duke parë. Trembëdhjeta është numri i hurmës dhe hurma është fruti i Muhamedit, tha hoxha. Djemtë panë njëri-tjetrin në sy. Rreth tyre ishin grumbulluar shumë fëmijë të tjerë, ndërsa gratë kishin dalë nëpër dyer dhe dëgjonin. Kush është Muhamedi, pyeti një djalë i vogël të ëmën. Ai burri me tri gra që ishte vizatuar në mur, tha gruaja.

Hoxha bëri sikur nuk e dëgjoi dhe pyeti djemtë: Sa germa ka fjala hurmë? Pesë germa, u përgjigj djali me shall të kuq. Aq ka, tha hoxha dhe vazhdoi: Alfabeti juaj grek ka 24 germa dhe *h*-ja është germa e njëzetedytë, *o*-ja është germa e pesëmbëdhjetë, *r*-ja është e shtatëmbëdhjeta, *m*-ja e dymbëdhjeta dhe *a*-ja e para. Fjala hurmë shkruhet *hurma*. Sa është shuma e gjithë këtyre numrave, i pyeti hoxha djemtë. Ata filluan të numërojnë të gjithë në kor dhe kur njëri ngatërrohej

tjerët e korrigjonin. Gjashtëdhjetë e shtatë, tha pas pak njëri nga djemtë. Hoxha rrotulloi tespihet në dorë dhe tha: gjashtëdhjeteshtata formohet nga një gjashtë dhe një shtatë. Sa bëjnë gjashtë edhe shtatë? Trembëdhjetë, thanë djemtë me një zë. Prandaj tespihet e mia kanë trembëdhjetë rruaza.

Një nga shokët e Isakut që e kishte ndjekur hoxhën nëpër qytet pa u vënë re dhe që ishte afruar për të dëgjuar bisedën e tij me fëmijët tha: Tespihja ka rruaza sa ç'ka mëhalla Voskopoja.

Hoxha e dëgjoi dhe ktheu kokën. Tespihja lëvizi me shpejtësi në dorën e tij të thatë, ndërsa qimet e mjekrës iu zgjatën nga shoku i Isakut. Voskopoja ka trembëdhjetë lagje, por unë kam ardhur t'i ndërroj tespihet. Më kanë thënë se këtu ka zanatçinj të zotë që i shpojnë gurët me plumb. Do t'i shtoj edhe një gur nga Voskopoja tespihes time, tha hoxha dhe duke skërmitur dhëmbët shtoi: Do ta bëj tespihen me katërbëdhjetë gurë.

Djemtë e vegjël me shall të kuq nuk e dëgjuan. Ata kishin mësuar nga hoxha një lojë të re dhe duke thirrur me zë të lartë emrat e njëri-tjetrit filluan t'i numërojnë geramat, sipas renditjes në alfabet.

Shoku i Isakut u afrua dhe qimet e hoxhës i prekën supin. Në Voskopoje nuk bëhen tespihe me qime, por me litar. Qimja jote është shumë e hollë dhe nuk e mban peshën e gurëve. Hoxha e pa djalin drejt e në sy, rrotulloi tespihet që kërcitën si të pickuara nga gishtat e tij dhe duke lëvizur tha: Trupi varet në litar, por shpirti varet në qime.

Djali e shoqëri me sy derisa ai u fut në lagjen e të huajve ku disa burra që po e prisnin i puthën dorën. Nga larg, kokat e tyre të përkulura dukeshin si gurë tespihe.

Atë natë, hoxha qëndroi në shtëpinë e Sali Benishit. Ky thirri dhe disa burra të tjerë, me disa prej të cilëve kishte qenë në burg, dhe dhoma u mbush plot tym dhe erë çorapësh. Burrat i kishin hequr këpucët përpara se të hynin. Në krye të dhomës ishte ulur hoxha, i cili e lëvizte me ngadalë tespihen e verdhë. Në krahun e tij të majtë qëndronte Sali Benishi, ndërsa në të djathtin Bari Bakri i menduar.

Kur u mblodhën të gjithë dhe asnjëri nuk pritej më të vinte, Sali Benishi u ngrit në këmbë dhe tha: Myslimanë të nderuar të Voskopojes. Ora jonë ka ardhur. Jemi mbledhur për të vendosur fatin tonë. Në këtë qytet deri më sot na kanë trajtuar si të huaj. Të krishterët nuk na dhanë tokë për shtëpi, na i dëbuan fëmijët nga shkollat, na burgosën dhe na vranë. Ata kanë gjithçka në Voskopoje: kanë shtëpi, kanë dyqane, kanë shkolla, kanë kisha, kanë shtypshkronjë, kanë libra, kanë armë, kanë burgje dhe kanë Këshillin. Ata kanë pasurinë e Voskopojes, ndërsa ne kemi varfërinë.

Në burg, bashkë me shumë burra të tjerë si unë, kuptova se ne myslimanët jemi fajtorë për gjendjen tonë. Ne kemi pranuar të jetojmë si kafshë shtëpiake që e puthin dorën e të zotit edhe kur ajo e rreh edhe kur ajo e lë pa bukë edhe kur ajo e dëbon nga shtëpia. Por duke u sjellë kështu nuk kemi fyer vetëm veten tonë, por kemi fyer Islamin. Duke na poshtëruar ne, të krishterët kanë poshtëruar Islamin. Ata kanë dashur t'i tregojnë botës se Islami është një farë që nuk mbin në Voskopoje. Ne kemi ulur kokën si një farë e paushqyer dhe vëllezërit tanë myslimanë në të gjithë perandorinë nuk e kanë parë vuajtjen tonë. Ne nuk kemi folur dhe prandaj nuk jemi dëgjuar. Ne nuk kemi mbirë dhe prandaj nuk jemi ushqyer. Ne nuk kemi pirë dhe prandaj nuk na kanë dhënë ujë. Ne nuk jemi ngritur dhe prandaj nuk kemi ecur. Ne nuk kemi ecur dhe prandaj kemi mbetur në vend. Ne nuk kemi qarë dhe prandaj nuk kemi lot. Ne nuk kemi luftuar dhe prandaj nuk kemi armë. Ne nuk jemi falur dhe prandaj nuk kemi xhami. Ne jemi të huaj dhe prandaj mëhalla jonë quhet mëhalla e të huajve. Ne nuk kemi tokë dhe prandaj nuk kemi qiell, nuk kemi sy prandaj nuk kemi diell, nuk kemi gojë prandaj nuk kemi ujë, nuk kemi

duar prandaj nuk kemi bukë, nuk kemi dritë dhe prandaj nuk kemi hije, nuk kemi shpirt prandaj nuk kemi zjarr. Ne thjesht nuk jemi dhe prandaj nuk kemi qytet.

Kur isha në burg në mes të natës dhe ngrohesh me frymën e shokëve dhe zgjohesha nga kambanat e kishave që ma shurdhonorin shpirtin si një varr, pyesja veten: Si ka mundësi që unë kam sy dhe nuk shoh, që kam veshë dhe nuk dëgjoj, që kam gojë dhe nuk ha, që ka këmbë dhe nuk eci, që kam duar dhe nuk punoj, që kam kokë dhe nuk mendoj, që kam shpirt dhe nuk besoj, që kam gjumë dhe nuk ëndërroj, që kam uri dhe nuk ha, që kam fuqi dhe nuk lëviz, që kam zemër dhe nuk ndiej, që kam zë dhe nuk flas, që kam gjak dhe nuk luftoj. Si ka mundësi që unë jam dhe nuk jetoj?

Gjithë këto ditë e kam munduar veten time me pyetje dhe trupi im ka më shumë plagë nga brenda se nga jashtë. Zemra ime ka më shumë uri se stomaku im dhe mendja ime ka më shumë lot sesa sytë e mi. Unë e di që dhe ju të gjithë vuani si unë.

I torturuar nga pyetjet e mia, dërgova fjalë në Korçë dhe thirra një njeri që i di përgjigjet e pyetjeve tona. Me urtinë e tij ai ka shëruar qindra myslimanë të pashpresë dhe ka ngritur në qiell ëndrrat e shumë të tjerëve që, ashtu si ne, e kishin humbur shpresën. Ai iu përgjigj thirrjes sonë dhe ja ku është këtu dhe mezi pret që t'i qetësojë shpirtin tanë dhe t'i japë dritë syve tanë të mbyllur. Unë besoj se kjo ditë do të mbahet mend në historinë e Voskopojës, si dita kur myslimanët kuptuan se perëndia nuk punon vetëm për të krishterët.

Sali Benishi u ul dhe u kthye nga hoxha. Ashtu bënë dhe gjithë burrat që ishin në dhomë.

Hoxha e lëshoi tespihen në tokë, në mes të këmbëve të tij të zbatuara, dhe iu drejtua Sali Benishit: Mirë se të gjeta, o vëllai i vuajtjes sime!

Falë jush dhe falë Zotit jam në këtë qytet të shenjtë, të cilin perëndia ka vendosur t'ia dhurojë myslimanëve. Perëndia është atje lart dhe pret që myslimanët të marrin dhuratën që iu ka bërë.

Gjithë këto unë, bashkë me myslimanët e tjerë, poshtë në Korçë, kemi pritur që ju të zgjoheni, të hapni sytë dhe të kuptoni se dita për të marrë dhuratën që ju takon ka ardhur. Nga fusha e Korçës ne shihnim se si kryqet e të krishterëve ngriheshin mbi malet e Voskopojës dhe e dinim që një ditë Allahu i madhërishtëm do të inatosej dhe do t'u kërkonte myslimanëve që t'i jepnin fund këtij dhunimi. Allahu është i durueshëm. Ai nuk do që njerëzit të zihen për të, por kur durimi humbet dhe kur ai shikon se nuk janë myslimanët ata që gëzojnë të mirat që ai dërgoi në tokë, por përkundrazi janë të tjerët, të pafetë, atëherë ai vepron. Ajo që po ndodh në Voskopojë prej shumë muajsh është vullneti i Zotit. Dësh Zoti që drejtësia të vihej në vend dhe pushtimi i Voskopojës nga të krishterët u prish. Dësh Zoti që një bandit, i cili donte të vriste dhe të dëbonte myslimanët nga Voskopoja, të zhdukej dhe ai u mbyt në mëkatën e tij. Dësh Zoti që të krishterët të merrnin një ndëshkim për të gjitha vuajtjet dhe mizoritë që u kanë bërë myslimanëve në Voskopojë, dhe ata u gjakosën, u varfëruan, u shkatërruan dhe shumë prej tyre ikën të lebetitur duke humbur pasuritë dhe familjet e tyre. Dësh Zoti që Këshilli i qytetit, që drejtonte kundër ligjeve të kuranit famëlart, të zhbëhej për të gjitha vendimet e padrejta dhe hakmarrëse që ka marrë kundër myslimanëve, dhe këshilli u zhbë dhe nuk do të bëhet më. Dësh Zoti që librat e Voskopojës, të shkruara me shkronjat e të pafeve, të mos e shihnin më dritën e diellit, dhe ashtu u bë dhe libra nuk ka më. Dësh Zoti që pija, vera dhe dehja të dënoheshin si veprime të paturpshme që i çojnë myslimanët në tradhti dhe në pabesi dhe tavernat e fëlliqura u mbyllën he burrat nuk pinë më. Dësh Zoti që fëmijët e besimtarëve të devotshëm të dallohen nga ata të jobesimtarëve të pafe dhe këtyre të dytëve u lidhi një shall në qafë që t'ua marrë frymën sa herë t'i dallojë nga lart ku qëndron. Dësh Zoti që bijtë e tij myslimanë të torturuar, të poshtëruar, të uritur dhe të robëruar të liroheshin nga burgu dhe ata u liruan dhe ja ku janë sot duke pritur urdhrin e tij. Dësh Zoti që unë të jem këtu dhe unë ja ku jam për ta prishur vetminë tuaj, për t'i

dhënë ujë buzëve të etura, për t'i dhënë dritë syve të mbyllur, për t'i dhënë frymë zemrave të dobëta, për t'i dhënë qumësht gjinjve të tharë, për t'i dhënë gjak muskujve të lodhur, për t'i dhënë zë veshëve të shurdhët, për t'i dhënë bukë gojëve të uritura, për t'i dhënë nënë dhe baba jetimëve, për t'i dhënë shpirt të gjallëve, për t'i dhënë varr të vdekurve, për t'i dhënë duar të pambrojturve, për t'i dhënë armë të sulmuarve, për t'i dhënë tokë endacakëve, për t'i dhënë forcë luftëtarëve, për t'i dhënë dije të paditurve, për t'i dhënë një qytet myslimanëve, për t'i dhënë një Zot Voskopojës.

Vëllezër, unë dua t'ju tregoj se si mashtrimi ka nisur qysh kur Voskopojës iu ndryshua emri. Të krishterët e ndryshuan emrin e qytetit duke ia fshehur myslimanëve mesazhin e Zotit. Në kohët e lashta qyteti quhej *Moskopolis*, por të pafetë, që shkruajnë libra me germa greke, e ndryshuan emrin dhe thanë se qyteti quhej *Muskopolisi*, që do të thotë Qyteti i Myshkut. Por Zoti nuk mund t'i vinte dhuratës së vet emrin e një bime që e ka krijuar për t'i hequr erën sqetullave të grave. Nga myshku dalin parfumet që gratë e liga i përdorin kur duan t'i marrin mendjen burrave të grave të tjera. Parfumi vjen nga myshku që është një bimë mëkati sepse Zoti e ndalon çdo gjë që përdoret për të ngjallur epshin dhe dashurinë trupore ashtu siç ka ndaluar pijen që e fryn stomakun, e lodh zemrën dhe e deh trurin e njeriut. Përdorimi i parfumit duhet kontrolluar, sepse është i rrezikshëm. Moskopolis, pra, nuk mund të ishte dhe nuk është qyteti i myshkut. Moskopolis do të thotë Qyteti i Xhamive. Italianët dhe francezët në gjuhën e tyre i thonë *moschea* ose *mosquee*, pra *moske*, xhamive tona. Duke e ditur se kjo fjalë do t'i ndryshonte historinë këtij qyteti ata e ndryshuan një germë dhe nga *Moskopolis* e quajtën *Muskopolis*.

Për shkak të këtij mashtrimi, sot myslimanët trajtohen si të huaj në qytetin e tyre dhe në vend të xhamive këtu janë ngritur kishat. Nuk është hera e parë që historia ndryshon nga një germë apo nga disa germa. Në artin e ndryshimit të germave, të krishterët janë mjeshtër dhe djaj. Edhe Bibla, libri i tyre, është një bashkim djallëzor germash, i cili mund të lexohet në mënyra të ndryshme. Të krishterët kanë fshehur edhe emrin e Muhamedit, i cili del në Bibël qindra vjet përpara se Muhamedi të lindte.

Jezusi nuk ishte profeti i fundit. Zoti e dërgoi atë në tokë për të lajmëruar njerëzit për ardhjen e Muhamedit. Ky ishte qëllimi i vërtetë i profecisë së Jezu Krishtit, por sigurisht kjo e vërtetë është fshirë nga të krishterët duke ndryshuar gerrat, të cilat nëse vendosen ndryshe në radhë japin kuptime të ndryshme të fjalëve të Zotit. Përgjegjës për këtë mashtrim kanë qenë grekët, të cilët në fillim e kanë përdorur alfabetin e tyre për t'i vjedhur fenë çifutëve dhe pastaj për t'i mohuar njerëzve Islamin si të vetmen fe në të cilën dhe prej së cilës perëndia kërkon të nderohet. Fjala *islam* vjen nga fjala hebre *shalom*, që do të thotë paqe dhe prandaj dhe fjalët *selam* dhe *islam* kanë të njëjtin kuptim. Islami ka qenë feja e vërtetë e Abrahamit, babait të gjithë profetëve, i cili bashkë me të birin e tij, Ismailin kanë qenë myslimanë.

Islamin dhe ardhjen e Muhamedit e ka parashikuar në Testamentin e Vjetër edhe profeti Jeremia, të cilit Zoti iu shfaq me një degë bajameje në dorë. Jeremia parashikoi Islamin dhe ja çfarë thotë ai në vargun nëntë të kapitullit të njëzetetë të Testamentit të Vjetër: Profeti që profetizon paqen, pra *shalom*, *selam*, *islam*, kur fjala e tij të realizohet, do të njihet si një profet i vërtetë i dërguar nga Zoti.

Shalomi, selami dhe islami janë e njëjta gjë, pra kanë qenë feja e vërtetë e Zotit. E ç'mund të donte tjetër Zoti në tokë përveç paqes mes njerëzve? Por siç tha profeti Jeremia, që mbante erë bajame, ai që do të vinte do të ishte profeti i vërtetë. Në shkrimet e lashta të çifutëve është folur për Muhamedin dhe megjithëse grekët janë lodhur duke e shkruar Biblën greqisht e vërteta nuk është fshirë dot. Çifutët dhe vetë Jezu Krishti me të gjithë apostujt e ti nuk kanë folur greqisht. Shumë kohë pas vdekjes së tyre, grekët, që ishin xhelozë sepse nuk kishin një fe të tyre, i morën

librat e shenjtë dhe pasi i ndryshuan, i përkthyen siç deshën, duke zhdukur të vërtetat e shenjta. Kjo ndodhi gati treqind vjet pas Krishtit kur grekët morën Kostandinopojën dhe vendosën me shpatë dhe me ligj që ungjijtë të lexoheshin vetëm në gjuhën e tyre. Grekët janë fajtorë për ndryshimin e fjalëve të Zotit. Atëherë pse të krishterët pranojnë që librat e tyre të merren nga greqishtja që është një gjuhë në të cilën nuk ka folur asnjë prej profetëve? As Ibrahim, as Jeremia, as Musai dhe as Isai nuk kanë folur greqisht. Feja që ata kanë pasur ka qenë shalomi apo islami dhe gjuha që ata kanë folur ka qenë një rrënjë e hebraishtes nga e cila mori disa fjalë gjuha arabe që foli Muhamedi. Para Muhamedit, asnjë njeri nuk quhej kështu dhe kjo tregon se Zoti e kishte ruajtur këtë emër për profetin e fundit që ishte dhe më i dashuri. *Muhamed* do të thotë më i dashuri, më i çmuari, më i ëmbli dhe më i pranuari. Ky emër, siç thashë, del në Testamentin e Vjetër dhe vjen nga fjala hebre *hamad* që shkruhet me tri germa *h-md* dhe që do të thotë të kesh dëshirë, të duash, të dëshirosh. Një motër binjake e kësaj fjale shkruhet *mahmad* ose *mahamod* që do të thotë më i lakmuari, më i dashuri, më i çmuari dhe më i këndshmi. *Muhamed* dhe *Mahamod* është e njëjta fjalë dhe nuk tregon asgjë tjetër, përveç profetit tonë të ndritur, të cilit djallëzia e alfabetit grek nuk i ka fshirë dot origjinën e shenjtë ashtu siç ka bërë me Voskopojën.

Sot, Voskopoja është burgosur nga alfabeti grek dhe librat që shkruhen me këto germa. Grekët i kanë larguar shqiptarët nga feja e vërtetë e Zotit dhe i kanë pushtuar mendjet e fëmijëve me këto germa. Ata thonë se të gjithë shqiptarët e krishterë janë grekë dhe se të gjithë myslimanët janë turq. Duke detyruar Jezu Krishtin të fliste greqisht, treqind vjet pas vdekjes së tij, ata ndërtuan Perandorinë e Bizantit, të cilën ia morën romakëve dhe e greqizuan përmes priftërinjve dhe ungjijve që i falsifikuan për të ndryshuar historinë e Zotit dhe të njerëzve.

Kur mashtrimi i grekëve filloi të zbulohet, të krishterët u ndanë. Italianët, francezët, gjermanët dhe anglezët nuk pranuan më të drejtohen nga patriarkët grekë të Kostandinopojës dhe krijuan kishën e tyre të Romës që ata e quajnë kisha e vërtetë. Kështu Bizanti mbeti vetëm grek dhe u dobësua derisa u rrëzua si çdo shtëpi që ngrihet mbi një themel të gënjeshtërt. Por grekët nuk hoqën dorë dhe vazhduan të mbjellin farën e mashtrimit të tyre në Ballkan dhe kësaj ata i ndanë kishat e shqiptarëve, bullgarëve dhe serbëve nga kishat e Evropës dhe pastaj i hodhën ato kundër myslimanëve. Grekët i urrejnë turqit jo vetë sepse ata, nën flamurin e Muhamedit, i morën Kostandinopojën, por sepse duke ditur të vërtetën e librave të shenjtë ata e dinë se Islami dhe myslimanët janë feja që kanë dashur të gjithë profetët nga Ibrahim deri tek Isai.

Historia e Kostandinopojës vërteton se në anën e kujt është perëndia. Në qoftë se perëndia do kishte marrë anën e grekëve, siç bëri në Trojë, atëherë turqit nuk do ta kishin pushtuar dot Kostandinopolin. Por perëndia ishte me turqit dhe me të gjithë myslimanët që nga dita që Muhamedi ua ndriçoi atyre mendjen dhe u hapi sytë për të parë. Që nga kjo ditë Islami nuk ndalet. Asnjë fuqi nuk e mposht dot, asnjë ushtri nuk e mund, asnjë det nuk e mbulon, asnjë sëmundje nuk e dobëson. Asnjë perandori mbi tokë nuk ka qenë më e fortë dhe më e gjerë, nga Mesdheu deri në Indi, nga Voskopoja deri në Medinë, nga shkretëtirat arabe deri në stepat ruse. Muskujt e kësaj perandorie janë popujt myslimanë, shpirti i saj është Islami, truri i saj është Kurani dhe prijësi i saj është Muhamedi. Qëllimi i kësaj perandorie është paqja mbi të gjithë popujt. Por kjo paqe nuk mund të arrihet nëse të gjithë njerëzit nuk besojnë në Islam dhe nuk i binden të njëjtit Zot. Turqit luftojnë dhe pushtojnë toka, fshatra dhe qytete në emër të këtij besimi. Ata i binden urdhrat të Muhamedit dhe sot janë vetëm shpata e tij, por synimi i tyre nuk është krijimi i një Perandorie Turke, por shtrirja e fesë së Muhamedit në çdo cep të botës. Kur kjo të ndodhë dhe gjithë bota të hyjë nën çallmën e Muhamedit, atëherë nuk do të ketë më luftë, sepse nuk do ketë më arsye për të luftuar, atëherë nuk do ketë më varfëri sepse nuk do ketë më të



pasur, atëherë nuk do ketë më sëmundje sepse nuk do të ketë më ndëshkime nga Zoti, sepse e gjithë bota do jetë Islam, pra do jetë në paqe.

Shqiptarët myslimanë ishin të parët që i ikën fesë së rreme të grekëve dhe hynë në Islam. Ata nuk janë turq dhe nuk ka pse të bëhen turq sepse Zoti nuk ua kërkon atyre këtë gjë. Kur bota të bëhet e gjitha Islam, nuk do ketë më turq, shqiptarë, grekë, arabë, serbë, italianë, rusë, gjermanë apo rumunë. Bota do të ketë vetëm një popull: Popullin mysliman, të cilin Muhamedi e drejton në rrugën e Zotit.

Kur krijoi Ademin dhe Havanë, perëndia kishte vendosur që të gjithë njerëzit të ishin pjesë e një populli. Por njerëzit filluan të mëkatonin dhe të mos e nderonin më perëndinë e tyre dhe prandaj ajo vendosi t'i ndëshkojë dhe t'i ndajë në qindra fise, gjuhë dhe fe të ndryshme për të kuptuar se kush prej tyre do ta nderonte më shumë. Bashkimi i njerëzve në një popull dhe në një gjuhë dhe fe të vetme është qëllimi i fundit. Shumë njerëz janë përpjekur ta arrijnë, por nuk ia kanë dalë dot sepse po nuk bashkove fetë nuk bashkon dot popujt. Më afër nga të gjithë është Muhamedi dhe Islami, të cilët ne i përkasim. Prandaj, duke u bërë me turqit ne jemi bërë me Muhamedin, i cili i mësoi turqit të ngrinin shtetin e tyre mbi Kuran. Duke u bërë me turqit, ne jemi më afër Islamit dhe do ta përfitojmë përpara popujve të tjerë lumturinë dhe drejtësinë që ai përcjell. Duke u bërë me turqit ne jemi më të fortë, më të pasur, më të drejtë, më të sigurt, më të ditur, më të zgjuar dhe nuk jemi vetëm. Kështu e kemi më të lehtë të zbojmë të ligën, të largojmë të keqen, të marrim toka, të fitojmë beteja dhe të drejtojmë qytetet tona.

Voskopoja është një ishull i krishterë nga i cili duan të na zbojnë. Do ta kishin bërë pa asnjë mëshirë duke i vrarë burrat myslimanë, duke i përdhunuar gratë e tyre, duke i lënë fëmijët pa prindër. Nuk e kanë bërë akoma dhe a e dini pse? Mos mendoni se janë të mëshirshëm. I krishteri nuk ka mëshirë dhe ju nuk duhet t'ia njihni për nder mbijetesën tuaj, mëshirës kristiane. Nuk ju kanë dhunuar nga frika dhe jo nga mëshira. Ata e dinë se turqit dhe perandoria e tyre ju mbron. Ata e dinë se, në rast se ju shfarosin vetëm se jeni myslimanë, turqit do vijnë dhe do hakmerren për ju duke i shfarosur ata. Ata nuk e durojnë dot erën tuaj në ishullin e tyre, por i mbyllin hundët nga frika, nuk i durojnë dot faljet në xhamitë tona dhe i mbyllin veshët nga e vërteta, nuk i durojnë dot perçet e grave tona dhe i mbyllin sytë nga virtyti.

Por në Islam nuk ka ishuj. Islami është një det i gjerë dhe i qetë në të cilin nuk mbytet ai që hyn, por ai që del jashtë. Voskopoja nuk mund të jetë një ishull në detin tonë. Në qoftë se del jashtë do të kesh fatin e të mbyturit, por ne duhet ta shpëtojmë dhe prandaj jemi këtu.

Islam do të thotë paqe, por paqja mbrohet duke luftuar. Nuk do kishte Islam nëse Muhamedi nuk do luftonte të gjithë ata që luftuan Islamin. Nuk do kishte paqe nëse myslimanët nuk do të kishin sulmuar ata që nuk e pranuan Islamin. Kur u bë mysliman, Muhamedin e dëbuan nga Meka që ishte qyteti i tij i lindjes. Ai shkoi në Medinë dhe atje ngriti xhaminë e parë, atje u martua me Aishen, gruan e tij të dashur, atje i ktheu arabët në Islam, atje mundi çifutë e mallkuar që donin ta vrisnin, atje u nis dhe fitoi luftërat me fiset kundërshtarë të Mekës, atje dhe vdiq. Voskopoja është si Medina. Një qytet ku u grumbulluan muhaxhirët e dëbuar nga të gjitha tokat arabe dhe ku të bashkuar ata i zbuar çifutët dhe e kthyen qytetin në tempullin e parë të Islamit. Por myslimanët e parë u përdoqën, u mbytën, u gjakosën, u tallën dhe u çnderuan, e megjithatë ata nuk u dorëzuan. Mendoni si myslimanët e parë dhe do të shpëtoni nga dëbimet, nga burgjet, nga talljet dhe do keni Medinën tuaj. Në Medinë, ashtu si në Voskopojë, çifutët kishin tregtinë, kishin tokat, kishin pasurinë, kishin poezinë, kishin pazarin, kishin devetë, kishin bagëtitë, kishin hurmat, kishin armët, kishin tempujt e tyre, ndërsa muhaxhirët myslimanë nuk kishin asgjë, përveç Islamit. Duke luftuar ata i morën të gjitha.

Do t'ju tregoj për historinë e një poeti çifut që e urrente Muhamedin. Ai quhej Kab dhe ishte një nga prijësit kryesorë të Medinës. Babai i tij ishte arab, ndërsa nëna çifute. Kabi ishte shumë i pasur, i zgjuar i bukur dhe shumë i njohur. Kur Muhamedi erdhi në Medinë, çifutët e kuptuan se ai do ta shkatërronte besimin e tyre. Ndërkohë, shumë arabë në Medinë e besuan Muhamedin dhe u bënë myslimanë. Me këta burra, Muhamedi filloi të rrëmbente karvanët që shkonin në Mekë dhe fuqia e tij u rrit. Muhamedi i kërkoi çifutëve të bëheshin myslimanë ose përndryshe të largoheshin nga Medina. Disa herë çifutët u përpoqën ta vrisnin Muhamedin, por gjithmonë ai shpëtoi, i lajmëruar nga Zoti. Duke parë se ishin të pafuqishëm, çifutët filluan të ngacmojnë myslimanët dhe sa herë që Muhamedi dilte në rrugë ata e shanin dhe e përqeshnin, të nxitur nga Kabi.

Kabi u thoshte njerëzve se Muhamedi ishte një mashtrues, se feja e tij ishte e rreme, se gratë myslimane ishin të papastra, se myslimanët ishin analfabetë, se ata duhej të shporreshin nga Medina. Duke u tallur me Muhamedin, Kabi u bë i famshëm dhe armiqtë e fisit të tij, të cilët e urrenin Muhamedin, e thirrën atë në Mekë. Kabi i hipi një deveje të re, të zbukuruar me copa me ngjyra dhe byzylykë të argjendta të futur në hundë. Vetë ishte veshur me një këmishë të bardhë dhe kur hyri në Mekë me kokën lart, si një profet i lumtur, paria e priti me nderime të mëdha. I bënë shumë dhurata dhe kudo ku ai ecte, gratë i hidhnin lule dhe burat shtronin qilima të thurur. Ato ditë në Mekë u bë festë dhe të gjithë mendonin se Kabi do t'i ndihmonte për të shpëtuar nga myslimanët që u vidhnin karvanët dhe që i kishin ndarë fiset e qytetit. Poeti i bukur i mblidhte të rinjtë e Mekës në shesh dhe në darkë me një gotë verë në dorë këndonte poezi të gjata kundër myslimanëve, duke i poshtëruar ata. Njerëzia mblidheshin si miza përreth tij dhe e pyesnin: Kush është më e vërtetë feja jonë, apo ajo e Muhamedit? Kabi vinte dorën e tij të bardhë mbi rërën e nxehtë dhe duke parë mbi kokat e njerëzve përgjigjej: Nëse feja e Muhamedit është e vërtetë atëherë më mirë të jetosh nën tokë se mbi tokë. Turma ulërinte nga gëzimi. Në këtë kohë, në Mekë, urrejtja për Muhamedin ishte shumë e madhe sepse ai u kishte rrëmbyer atyre disa karvanë me plaçka dhe pasuri, u kishte marrë devetë dhe shumë burra i kishte vrasur dhe gratë e djemtë i mbante rob në Medinë. Kabi, që e dinte sesa vuanin mekasit për fyerjen dhe vrasjet që kishin pësuar nga Muhamedi, i nxiste ata që të merrnin hak për të vdekurit duke recituar këto vargje që u mësuan edhe nga fëmijët e vegjël: *ai që përhap lajmin jetoi i poshtëruar, i verbër dhe shurdh.*

Gratë e Mekës tërboheshin nga fjalët e poetit dhe betoheshin se do t'i hanin mëllçitë e myslimanëve që kishin vrasur djemtë dhe burrat e tyre. Kur Kabi u kthye në Medinë ai i mblodhi fiset çifute dhe u tha se kishte biseduar me tregtarët e pasur dhe të fuqishëm të Mekës, të cilët do të vinin për të vrasur Muhamedin dhe për t'i dëbuar myslimanët.

Muhamedi, i hidhëruar nga shpifjet dhe poshtërimet e Kabit, një ditë thirri shokët e tij dhe u tha: Poeti ka shqetësuar Allahun. Kush nga ju do ta qërojë atë? Njëri nga shokët e Muhamedit u ngrit dhe e pyeti: Muhamed ti do që unë ta vras Kabin? Po, i tha Muhamedi. Atëherë tre burra u ngarkuan për vrasjen e Kabit. Njëri prej tyre i shkoi Kabit në shtëpi duke e sharë, kinse, Muhamedi si përçarës të arabëve dhe si një njeri që e merrte për vete gjithë mallin që u rrëmbehej karvanëve. Jemi të uritur, tha burri dhe i kërkoi Kabit t'i jepte pak grurë hua. Do ta jap, i tha Kabi, por duhet të më japësh një peng. Çfarë do, e pyeti shoku i Muhamedit. Më jep peng gruan tënde, tha Kabi. Shoku i Muhamedit u skuq dhe iu përgjigj: Nuk mund ta jap gruan sepse ti je shumë i bukur dhe ajo do të flinte me ty e unë do të turpërohesha. Poeti pranoi dhe më në fund ata ranë dakord që të linin armët peng. Shoku i Muhamedit mori grurin, la armët në shtëpinë e Kabit dhe iku. Pasi kishte fituar besimin e poetit, një natë ai shkoi në shtëpinë e tij dhe e thirri. Kabi u zgjua, por gruaja i tha të mos dilte. Ky ë pikon gjak, tha gruaja e frikësuar duke e

shtrënguar poetin në krahët e saj të zhveshur. Por Kabi i tha se burri që po e kërkonte ishte miku i tij që ai i kishte dhënë bukë për të ushqyer fëmijët. I kam dhënë bukë dhe nuk mund të më vrasë, tha poeti. Shoku i Muhamedit kishte ardhur bashkë me dy të tjerë, të cilëve u tha se kur ai ta kapte Kabin nga flokët kjo do ishte shenja se ata duhej të afroreshin për ta vlarë.

Burrat e tjerë u fshehën kur Kabi doli nga shtëpia. Ecim dhe bisedojmë pak, i tha shoku i Muhamedit dhe poeti pranoi. Hëna ndriçonte përgjysmë dhe një re e zezë ia fshihte fytyrën shokut të Muhamedit. Pjesa e ndritshme e hënës shkëlqente mbi kokën e bukur të poetit. Dukesh si një deve e etur, i tha Kabi, çfarë ke? Shoku i Muhamedit u përpoq të qeshte, iu afrua Kabit dhe i tha: Sa erë të mirë që mban, nuk kam ndier kurrë një parfum të tillë si ky që ke lyer kokën. Kabi qeshi dhe i tregoi se gruaja e tij i përgatiste vetë parfumet me barëra dhe me myshqe të ndryshme. A t'i marr pak erë flokëve të tu, e pyeti shoku i Muhamedit dhe poeti pranoi. Burri i mori erë kokës që shkëlqente si një diell pastaj e kapi fort nga flokët dhe thirri shokët e tij të fshehur në errësirë. Këta u turrën me vrap dhe e therën poetin me thikat e tyre. Ia prenë kokën dhe shkuan në shtëpinë e Muhamedit.

Ky po i priste dhe kur shokët ia hodhën kokën te këmbët, Muhamedi u habit nga bukuria e saj dhe dhoma u mbush me erën e parfumit. Muhamedi mbeti një copë herë duke parë kokën dhe pastaj duke i bekuar shokët e tij tha: Kjo gojë nuk e meritonte një kokë kaq të bukur.

Historia e Kabit tregon se çfarë e pret atë që tallet me profetin, se si shkurohet gjuha e atij që bën vjersha të turpshme dhe se si pritet dora e atij që vizaton ndyrësira nëpër muret e qytetit, siç ndodhi në Voskopoje. Por ndëshkimi është i domosdoshëm për t'i zbutur shpirtrat e ligj dhe kështu ndodhi në Medinë. Pas vrasjes së Kabit çifutët u frikësuan dhe nisën të ikin nga Medina që u bë përfundimisht qyteti i myslimanëve. Poetët e tjerë e mbyllën gojën dhe vargjet e kuranit ishin të vetmet që recitoheshin në qytet. Myslimanët morën shtëpitë, tregun, dhe disa çifutë u bënë myslimanë. Muhamedi vazhdoi sulmet e tij mbi të pafetë e Mekës dhe pas disa kohësh asnjë karvan nuk futej dot në qytet pa lejen e tij derisa mekasit e dobësuan e lejuan të kthehej në qytetin ku kishte lindur dhe ai bëri haxhin në vendin e shenjtë, në Qaben e ngritur nga Ibrahim i dhe Ismaili. Sakrifika, burrëria dhe durimi i Muhamedit dhe muhaxhirëve që u bashkuan në Medinë kishte triumfuar. Ata fituan sepse u bashkuan në Islam.

Unë kam ardhur sot në Medinën tuaj për t'ju thënë se sakrifika, lufta dhe gjaku i myslimanëve të parë është drita që ndriçon rrugën tuaj. Në qoftë se dorëzoheni, keni humbur. Në qoftë se luftoni, keni fituar mbi poshtërimin, mbi dhunimin, mbi tregtinë, mbi alfabetin dhe mbi poezinë e të krishterëve në Voskopoje. Voskopoja ka vetëm një fat: të bëhet Medinë. Voskopoja ka vetëm një poezi: Kuranin. Voskopoja ka vetëm një prijës: Muhamedin. Voskopoja ka vetëm një fe: Islamin. Myslimanët kanë vetëm një zgjedhje: të luftojnë. Të pafetë kanë vetëm një rrugë: të ikin. Ju keni vetëm një qytet: Voskopojen.

Kur hoxha mbaroi, ngriti tespihet lart dhe e këputi me forcë perin e bardhë që i bashkonte gurët, të cilët u derdhën nëpër dhomë dhe humbën nën këmbët e zathura të burrave. Koha e numrit trembëdhjetë ka mbaruar, tha hoxha dhe burrat u ngritën në këmbë sikur të kishin marrë një urdhër.

Në mes të natës Voskopoja u zgjua nga krismat e armëve. Flakët u ngritën nga lagjja e të huajve dhe pastaj u shpërndanë nëpër gjithë qytetin. Shokët e Isakut që dilnin të përgjumur nga shtëpitë vriteshin dhe kufomat e tyre që mbetën për disa ditë mbi kalldrëme, askush nuk i mori për t'i varrosur. Depot e tregtarëve u grabitën dhe malli u shpërnda me mushka, në shtëpitë e lagjes së të huajve. Pesë taverna u dogjën dhe vera që u gjet atje u derdh në rrugë. Fuçitë u zbrazën dhe u

shpuan. Kryqi i madh i Katedrales së Shën Mërisë u thye dhe shalli i kuq i Marin Kurilës u shtri në mes të rrugës, si një kafshë që i kanë prerë gjymtyrët.

Grigor Jeremonakut iu kërkua të shtypte dhjetë masa të reja, mes të cilave heqjen e alfabetit grek nga shkollat, shurdhimin e kambanave të kishave, ndalimin e vizatimeve me fytyrë njerëzish, anulimin e zgjedhjeve, shkarkimin e Këshillit të qytetit, veshjen e perçeve për të gjitha gratë, ndalimin e tregtisë së armëve, etj. Grigori kundërshtoi dhe pasi e varën nga këmbët e rrahën për tri ditë rresht në oborrin e Katedrales. Kur e lanë të lirë, peshonte më pak se një thes letër. Bashkë me të u rrahën dhe disa priftërinj të tjerë. Fëmijëve iu ndalua të dilnin me shall të kuq në rrugë, ndërsa grave nuk u lejohej të dilnin të pambuluar.

Poeti u gjet i vrarë në krevatin e tij. U tha se në fillim, duke u ngatërruar me balluket e tij dhe me erën e parfumit të fortë që kishte hedhur në trup, myslimanët e kishin marrë për një grua dhe kishin dashur ta zhvishnin. Kur kishin parë që ishte burrë, e kishin rrahur. Njëri prej tyre e njohu dhe tha se ai ishte poet dhe atëherë e kishin therur.

Po atë ditë, një grup burrash të armatosur me Sali Benishin në krye shkuan në shtëpinë e Isakut, shqyen derën dhe u futën brenda. Isakun e gjetën në këmbë me një këmishë të bardhë dhe me pelerinën e Marin Kurilës të hedhur mbi supe. Ishte i paarmatosur dhe kur e panë që i priste në këmbë, burat u shtangën. Të thashë që do takoheshim prapë, i foli Isaku Sali Benishit. Burrat e armatosur lëvizën dhe armët e tyre krakëllitën, por Sali Benishi i bëri shenjë dhe ata u sprapsën. Kam lënë një vend bosh në burg për ty, tha Sali Benishi duke mos e parë Isakun në sy. Akuzohesh për vrasjen e 14 myslimanëve natën që vdiq Marin Kurila si dhe për trazirat, vjedhjet, vizatimet, dëbimet e fëmijëve myslimanë nga shkolla dhe fyerje të profetit Muhamed.

Isaku u drejtua dhe i tha: Çfarë kam thënë për Muhamedin? Ke thënë se ai jeton në hënë, u përgjigj Sali Benishi. Nuk e mbaj mend, po pse ku jeton Muhamedi, vazhdoi Isaku duke tërhequr pelerinën pas trupit sikur të mbrohej nga një e ftohtë. Sali Benishi u vrenjt dhe duke i bërë shenjë shokëve u përgjigj: Këto ditë ai ka ardhur në Voskopojë.

Burrat e morën Isakun, i lidhën duart dhe e nxorën në rrugë. Kur ai ecte, me një shpurë të armatosur që e rrethonte nga të gjitha anët, njerëzit dolën në dritare dhe e panë Isakun e gjatë dhe të fortë sesi mbante kokën lart, ndërsa pelerina e bardhë zgjatej pas tij si një vijë qumështi. Sytë jeshilë binin si lule mbi kalldrëmin e ndotur.

Isakun e mbyllën në burg bashkë me shumë nga shokët e tij si dhe disa priftërinj. Hoxha qëndroi edhe disa ditë në Voskopojë dhe pastaj u largua për në Korçë.

Për gati dy muaj shumica e tregtarëve të qytetit ngarkuan karvanët me plaçka dhe para dhe ikën. Duke mbyllur dyert e shtëpive gratë qanin dhe fëmijët mbanin poshtë bluzave shalle të kuq, që të mos u dukeshin. Pleqtë, që nuk lëviznin dot, u lanë në shtëpi të vetëm, por shumë shpejt ata u dëbuan nga familje myslimane që ua zaptuan shtëpitë dhe i lanë të uritur në rrugë ku shumë prej tyre vdiqën. Shkollat u mbyllën dhe mësuesit ikën në Korçë për të gjetur punë. Një natë, në lagjen e kazanxhinjve ra një zjarr i madh që dogji dhjetë shtëpi njëherësh. Shumica e shtëpive ishin të boshatisura dhe askush nuk u kujdes të shuante zjarrin. Shokët e Sali Benishit, që erdhën për të kontrolluar vendin, nuk mundën ta shuajnë zjarrin që vazhdoi tri ditë duke e mbushur qytetin me një erë të rëndë.

Pas disa ditësh, një zjarr edhe më i madh u ngrit në lagjen e armëtarëve. Shtëpitë digjeshin një nga një dhe trarët e mëdhenj qindravjeçarë binin duke rënkuar. Ky zjarr zgjati disa ditë dhe një erë që fryu nga jugu nisi ta shtynte në drejtim të lagjeve të tjera. Dikush i tha Sali Benishit se të krishterët që iknin, u vinin zjarrin shtëpive të tyre që ato të mos pushtoheshin nga myslimanët. Zjarret vazhduan për muaj me radhë dhe një ditë lagjja e myslimanëve mbeti e rrethuar nga të katër anët me shtëpi që digjeshin. Kafshët u përcëlluan dhe një turrë me dru u dogj. Burrat dolën

duke i shuar zjarret me ujë dhe me velenxa të mëdha që ua hidhnin flakëve sipër për t'u marrë frymën.

Kur zjarret u shuan, Sali Benishi doli për të parë qytetin. Voskopoja dukej si një qytet pas lufte. Shtëpi të djegura, kryqe të rrëzuar, kafshë të ngordhura, çezma të thyera, kalldrëme të qelbur, mallra të hedhura stivë në rrugë, kuaj dhe mushka që ishin egërsuar nga uria, minj dhe miza të uritura që u hakërreheshin njerëzve. Kur u afruan te burgu, dera ishte e hapur. Brenda ishte një prift i vdekur dhe një burrë i sëmurë që po jepte shpirt. Sali Benishi e kapi burrin nga flokët dhe e pyeti për të burgosurit e tjerë, por ai nuk fliste dot. Sali Benishi doli jashtë dhe pa fushat që rrethonin Voskopojën. Dielli i pasdites ishte i dobët dhe tymrat që ngriheshin nga lagja e tij dukeshin si re të ulëta. Isak Komneni u arratis, i tha Sali Benishi shokëve. Na rrethuan me zjarr dhe e shpërthyen burgun kur ne po shuanim flakët. Të krishterët ikën siç parashikoi hoxha dhe ne na mbeti Medina. E djegur, por e jona, shtoi Sali Benishi dhe mbylli derën e burgut mbi të cilën ishte varur një shall i kuq.

Isak Komneni me disa shokë të tij iku i fundit nga Voskopoja. Tymi i mbuloi hijet e tyre si një mantel. Ne ishim larguar disa ditë përpara tij kur filluan zjarret e mëdha. Isaku është djali i Mihalit, tha Metod Antrakidi që mori një gotë ujë dhe lagu buzët e thara.

24

Syzet e Metod Antrakidit ishin mbushur me një avull të trashë që ushqej nga një zjarr që sapo ishte shuar në gojën e tij. Metodi afroi një cep të mbulesës së rrudhosur të tavolinës dhe i fshiu xhamat me të. Mihal Komnenit i ishte varur koka e madhe mbi këmishë, si një kambanë e shurdhët. Në një anë të këmishës, Sara shqoi dy pishqolla të vogla që rrethonin një K, të drejtë. U zgjat të pyeste për diçka, por Mihal ngriti kokën dhe asaj i mbeti pyetja në buzë. Pishqollat janë simboli i lagjes së armëtarëve, ndërsa K-ja, është e Komnenëve, tha Mihal Komneni.

Ana Komnena flinte si një pupël në krahët e Ibrahimit, ndërsa Aliu dhe Paridi kishin dalë disa herë jashtë duke luftuar me shpata dhe pa e dëgjuar Metod Antrakidin gjatë gjithë kohës. Muhamedi nuk kishte lëvizur nga vendi dhe herë pas here rregullonte çallmën që i binte mbi sy. Pjatat mbi tryezën e madhe ishin boshatisur, ndërsa përpara Ibrahimit shtrihej një njollë e kuqe verë që e kishte derdhur Ana, duke luajtur në gjumë.

Paridi me flokët e ngrira hyri në dhomë, i ndjekur nga shpata e Aliut dhe kur i pa të gjithë të heshtur i tha Metod Antrakidit: Kush e vrau Marin Kurilën? Po ta dija do t'ia kisha treguar Isakut, u përgjigj Metodi. Dhe Isaku do ta kishte vrarë, pyeti Paridi. Isak Komneni nuk dinte të vriste dhe prandaj Voskopoja u shkatërrua, tha Mihal. Po pse nuk dinte të vriste Isaku, tha Aliu duke ngritur shpatën në formë kryqi mbi tavolinë. Nuk ia kishte mësuar njeri, tha Hana e menduar. As gjyshi dhe as babai i tij nuk dinin të vrisnin. Mihal Komneni ktheu kokën nga Hana dhe e pa si një njeri që e takon pas shumë kohësh. Edhe babai nuk na ka mësuar të vrasim njerëz, por vetëm lepuj, tha Paridi dhe u ul në vendin e tij. Ti je frikacak dhe nuk vret dot as lepuj dhe as njerëz, tha Aliu me zë kërcënues.

Po ti, a mund të vrasësh një njeri, i tha Metod Antrakidi, Aliut dhe pa nga Ibrahimit që rrinte i heshtur. Unë mund të vras më kollaj një njeri se një lepur, tha Aliu dhe të gjithë kthyen kokën nga ai. Aliu e kuptoi që duhet të thoshte diçka më shumë dhe vazhdoi: Nuk i vras dot gjërat që ha.

Nuk do kesh nevojë të vrasësh njerëz sepse në fshatin tonë nuk ka shkolla dhe askush nuk vizaton nëpër mure, tha Muhamedi. Po nëse iki nga fshati, mund të vras njerëz, pyeti Aliu. Po ike nga fshati mund të të vrasin ty, u përgjigj Muhamedi duke parë me bisht të syrit nga Ibrahimit.

Mihal Komneni kishte mbushur gotën e verës që mbante përpara, ndërsa Metod Antrakidi u zgjat mbi tavolinë dhe tha: Muhamedi ka të drejtë. Voskopoja provoi se dija nuk mjafton për të shmangur shkatërrimin. Qyteti më i kulturuar, ku kanë jetuar shqiptarët, u dogj. Librat, kishat, priftërinjtë, shtypshkronja, vizatimet, poetët, përkthyesit, gjeografët, filozofët arkeologët dhe studentët nuk e shpëtuan dot qytetin e tyre dhe unë pyes veten: Përse na duhej gjithë ajo dituri kur nuk arritëm dot të shuajmë një zjarr që e ndezëm vetë? Si ka mundësi që shfletuam librat e gjithë botës dhe nuk gjetëm dot faqen e duhur, atë faqe e cila do na mësonte se si nuk shkatërrohet një qytet? Mos duhej të kishim studiuar Cezarin në vend të Platonit apo Aleksandrin në vend të Aristotelit për të mësuar se mirësia nuk mjafton për të ndërtuar paqen dhe paqja nuk është e përjetshme nëse nuk e mbron me luftë? Ne ndërtuam një qytet për platonë dhe aristotelë, por jo për cezare dhe aleksandër, por unë nuk jam i sigurt nëse ata mund të lindnin në Voskopoje. Qiparisi nuk mbin në shkretëtirë dhe deveja nuk ecën dot në akull. Isaku thoshte se ishullarët e zgjedhin luftën të fundit, por ai vetë e la ishullin pa luftuar dhe tani kushedi ku noton. Mihali thotë se nëse Isaku do dinte të vriste, Voskopoja do kishte shpëtuar. As kjo nuk më bind. Ka raste që mendoj se Voskopoja ishte një qytet i ngritur në vendin e gabuar. Po të kishte qenë mijëra kilometra larg prej aty ku ishte, ndoshta do kishte shpëtuar siç ka shpëtuar Vjena, Venediku apo Athina. Voskopoja ishte një qytet ir rethuar nga barbaria dhe injoranca dhe çudia nuk ishte që një ditë u prish, por çudia është se si u ndërtua, si një lule që mbin midis gurëve. Unë besoj se Voskopoja ishte një gjë e parakohshme për shqiptarët. Ajo u fshi ashtu siç fshihet çdo ëndërr e pakuptueshme në trurin e njeriut, i cili ngrihet në mëngjes dhe e vazhdon jetën aty ku e ka lënë një natë më parë. Punon tokën dhe gruan, ushqen kafshën dhe fëmijët dhe fle prapë për të parë një ëndërr që të nesërmen e harron. Prandaj ju do jetoni në paqe për sa kohë që nuk keni as libra dhe as vizatime, siç thotë Muhamedi. Libri ia shton oreksin njeriut dhe e lë më të uritur. Sa më shumë lexoj, aq më pak di.

Metod Antrakidi u mbështet në karrige dhe syzet filluan t'i vishen prapë me avull. Je shumë plak për të qenë pesimist, tha Mihal Komneni. Nuk do kesh kohë t'i provosh vetes ato që mendon. Çfarë është pesimisti, pyeti Paridi. Pesimisti është një njeri që beson se bota nuk ndryshon por rri në vend, tha Mihali. Atëherë Muhamedi qenka pesimist, tha Aliu. Po pse është Muhamedi pesimist, pyeti Hana dhe ia nguli sytë jeshilë Muhamedit që rrinte pa lëvizur me frikën se çallma mund t'i binte mbi tavolinë. Muhamedi ka një lodër prej druri në formën e botës dhe aty dielli nuk lind, lumenjtë nuk rrjedhin, nuk bie dëborë dhe njerëzit nuk ecin. Në botën e Muhamedit nuk ndodh asgjë dhe atij kjo i pëlqen, u përgjigj Aliu.

Botën e Muhamedit e kam parë unë, foli Jani duke u drejtuar. Jani është perëndia, kurse unë jam profeti, tha Muhamedi. Ku ndryshon perëndia me profetin, tha Paridi. Perëndia e krijon botën dhe njerëzit, ndërsa profeti i thotë njerëzve se çfarë duhet të bëjnë dhe në cilin vend të botës. Po të ishte ti profet në Voskopoje çfarë do t'u kishe thënë Marin Kurilës, Isakut dhe Sali Benishit, e pyeti Mihal Komneni. Unë do t'u kisha thënë atyre të bënin tamam ato që bëjnë, foli Muhamedi qetësisht. Ti do lije Marin Kurilën të vritej dhe Sali Benishin të martohej tri herë, pyeti Hana. Po, tha Muhamedi. Do ta lija Marin Kurilën të vritej sepse nëse ai nuk do vritej të krishterët dhe myslimanët nuk do kishin asnjë mundësi për të bërë paqe dhe Voskopoja do të digjej shumë më shpejt nga ç'u dogj. Vrasja e Marin Kurilës ishte një paralajmërim i perëndisë, e cila donte që Voskopoja të ndahej mes të krishterëve dhe myslimanëve, por kur kjo gjë nuk u arrit atëherë Sali Benishit iu dha urdhër t'i dëbonte të krishterët. Po ti mendon se perëndia ka mbajtur anën e myslimanëve në Voskopoje, pyeti Jani. Perëndia është gjithmonë me më të dobëtit, tha Muhamedi.

Nuk më the pse do ta lije Sali Benishin të martohej tri herë, u hodh Hana.

Sali Benishi u martua një herë me një grua që mund të ishte nëna e tij, pastaj me një vajzë që mund të ishte fëmija e tij dhe pastaj me një të krishterë që mund të ishte armikja e tij, sepse perëndia thotë se të martohesh, është një detyrë të cilën njeriu duhet ta kryejë me çdo kusht, pavarësisht nga moshja, bukuria apo feja. Sali Benishi e kreu këtë detyrë dhe prandaj perëndia i fali atij Voskopojën. Ai u martua me një plakë të pasur, me një fëmijë të bukur dhe me një të krishterë të tradhtuar nga Zoti i vet, u përgjigj Muhamedi.

Sara pa në drejtim të Ibrahimit, i cili e ndiqte bisedën me kureshtje duke djersirë nën peshën e Anës që flinte e pashqetësuar, që kur pjatat ishin zbrazur dhe lugët nuk përplaseshin më. Vetëm gota e mbushur e Mihal Komnenit i kishte rezistuar ngopjes duke mos qëndruar për asnjë çast e pambushur. Po të isha unë profet, do t'i kisha thënë Isakut të mos e linte hoxhën të hynte në Voskopojë sepse ai e mësoi Sali Benishin si ta digjte qytetin, tha Aliu. Çfarë do bëje, do ta vrisje apo do ta burgosje hoxhën, e pyeti Jani. Do ta mbyllja në kishë që të çmendej, u përgjigj Aliu.

Ndërsa unë, po të isha profet, do kisha bërë një gjë tjetër, foli Paridi. Të gjithë heshtën dhe ai tha: Unë do t'i kisha thënë dy djemve që putheshin me Aishen në livadhin e myshqeve që ta rrëmbenin dhe ta çonin në Korçë. Po pse duhej ta rrëmbenin Aishen e vogël, tha Hana duke parë nga Sara me keqardhje. Në qoftë se do të ishte rrëmbyer Aishja, Sali Benishi do ikte nga Voskopoja duke kërkuar dhe ndoshta nuk do të kthehej më aty për ta djegur qytetin, tha Paridi dhe ngriti flokët e ngrira lart me krenarinë e njeriut që ka gjetur përgjigjen e të gjitha pyetjeve. Po sikur ta kishte gjetur dhe të kthehej prapë në Voskopojë, i tha Aliu. Në asnjë rast nuk do të kthehej më Sali Benishi në Voskopojë, foli Paridi duke ngritur zërin. Edhe sikur ta gjente, edhe sikur të mos e gjente Aishen, ai nuk do kthehej, se do t'i vinte turp që dy djem të vegjël i kishin marrë gruan. Atëherë Sali Benishi do shkonte dhe do digjte Korçën, tha Mihal Komneni. Po të digjte Korçën, Voskopoja do kishte shpëtuar, siç shpëtoi Sparta dhe u dogj Troja, sepse gratë gjithmonë djegin pasuritë e burrave dhe jo të baballarëve. Helena ishte nga Sparta, por ky qytet nuk u dogj dhe asnjëri nuk u vra. Po ta kishin lexuar profetët historinë e Trojës do t'i gjenin aty zgjidhjet për gjërat që nuk i dinin, por me sa duket ata kanë menduar se ajo është një përrallë që nuk përsëritet.

Profetët nuk i zgjidhin grindjet e botës duke u nisur nga përrallat sepse përrallat kanë gjithmonë një fund të lumtur dhe aty askush nuk vdes, tha Muhamedi. Nëse Voskopoja do ishte një përrallë Mihali dhe Metodi mund të ktheheshin prapë atje dhe Marin Kurila me Sali Benishin do t'i prisnin duke ngrënë patëllxhanët me mish që gatuante Aishja. Nuk do ishte keq, tha Metodi, edhe mua më pëlqejnë patëllxhanët me mish dhe mund të kisha shkuar në shtëpinë e Sali Benishit. Do vija edhe unë, tha Paridi, por, kur ju të hanit patëllxhanë, unë do rrija me Aishen dhe do mësoja si puthet një grua.

Hana filloi të qeshte dhe duke i parë Mihal Komnenin, rregulloi jakën e fustanit të ngushtë dhe i tha Paridit: Pse duhet të shkosh deri në Voskopojë, mund ta mësosh këtu si puthet një grua. Paridi donte të përgjigjej, por Aliu, që lëshoi shpatën mbi tavolinë, e ndërpreu dhe tha: Aishja u puth me dy djem njëherësh, kështu që do vija edhe unë me ty në Voskopojë. Mirë, i tha Paridi, hajde, por po ia mbajte Aishes dorën poshtë fustanit nuk të marr.

Mihal Komneni e ktheu edhe një herë gotën e verës dhe u kthye nga Muhamedi. Profet, a më thua dot ku është Isak Komneni?

Muhamedi picërroi sytë ngjyrë blu, priti derisa në tavolinë u vendos qetësia dhe tha: Isaku është në një ishull ku njerëzit dinë të notojnë para se të lindin, siç tha ai vetë dhe ku duhet ta harrosh notin që të mos kthehesh më mbrapsht, siç tha poeti.

Ku është ky ishull, pyeti Mihal Komneni. Me siguri në kujtimet e familjes tuaj, u përgjigj Muhamedi. Mihal Komneni nuk foli më, por u mbështet në karrige dhe pa Sarën drejt e në sy

sikur po i kërkonte ndihmë. Sara uli kokën dhe filloi të mblidhte pjatat mbi tavolinë, si për t'i thënë të gjithëve se dreka kishte mbaruar. Pas saj u ngrit edhe Hana që mblodhi lugët, gotat, thikat dhe pecetat e shpërndara, ndërsa ushqimet që kishin tepruar i bashkoi në një pjatancë të madhe. Jani u ngrit në këmbë dhe pas tij edhe Paridi. Muhamedi rrinte ende ulur duke pritur të ngrihej Ibrahim, kurse Aliu futi shpatën në brez dhe kaloi në anën tjetër të tryezës. Metod Antrakidi dukej i lodhur dhe sytë i kishte gjysmë të mbyllur, por u përmend kur Aliu iu afrua dhe i tha: Si e gjetën djemtë me shall të kuq sa gurë kishte tespihja e hoxhës? Duke mbledhur shumën e numrave që ka çdo germë në alfabet, u përgjigj Metod Antrakidi. Fytyra e Aliut ishte e hutuar, por ai nuk e dha veten dhe pyeti prapë: Po nëse nuk di të lexosh numëron dot? Mund të numërosh pa ditur germat dhe mund të lexosh pa ditur numrat, por mirë është t'i dish të dyja se perëndia i ka vënë çdo gjëje një emër dhe nuk ka bërë asgjë që të mos përsërite. Çdo dru, çdo gur, çdo kafshë, çdo zog, çdo peshk, çdo send, çdo ditë, çdo vit, çdo njeri, çdo mal, çdo det, çdo lumë, çdo re dhe çdo gjë ka një emër që duhet shkruar dhe duhet lexuar që të dallohet nga një gjë tjetër. Por asgjë nga këto që thashë nuk është e vetme në këtë botë dhe prandaj nuk ka vetëm një gur, nuk ka vetëm një ditë, nuk ka vetëm një njeri apo vetëm një peshk dhe të gjitha këto duhen numëruar që njerëzit të dinë se janë dhe sa pasuri kanë.

Mihal Komneni, që e ndiqte bisedën duke buzëqeshur, i tha Metod Antrakidit: Pse nuk i mëson këtyre djemve të shkruajnë dhe të numërojnë, Metod? Gjimnazi i Janinës nuk ka më nevojë për ty, ndërsa shtëpia ime mund të bëhet shkollë djemsh në mëngjes dhe hotel pleqsh në mbrëmje.

Metod Antrakidit iu veshën prapë syzet me avull, ndërsa hidhësia në ngjyrë piperi iu largua ngadalë nga fytyra, si një re. Në pesëdhjetë vjet ai u kishte mësuar qindra fëmijëve se si të kuptonin botën, e cila, siç thoshte ai, ishte e mbyllur me një derë që mund të hapej njëkohësisht vetëm nga dy çelësa: nga një numër dhe nga një germë. Po t'i zotërosh këto dy çelësa hap derën dhe hyn në një tunel të pafund, ose më saktë, në fund të të cilit është vetëm perëndia. Mijëra njerëz e kanë hapur atë tunel, por askush nuk ka shkuar deri në fund sepse perëndia nuk i dha askujt një jetë aq të gjatë, i thoshte ai nxënësve që e pyesnin se si shkohet në fund të botës.

Si thua Metod, e përmendi Mihal Komneni duke e shkëputur nga tuneli i ditëve të shkuara. Metod Antrakidi ngriti supet dhe pa nga Ibrahim, i cili dukej i kënaqur. Do të të isha mirënjohës nëse do t'u mësoje djemve të mi ato që di, tha Ibrahim dhe u ngrit në këmbë me Anën në krahët e tij. Kur fillon shkolla, pyeti Muhamedi duke parë Janin nga duart si për t'i kujtuar se tokës katrore i ishte shtuar një kuti. Nesër, tha Sara. Po ne nuk kemi shall të kuq si nxënësit në Voskopojë, tha Paridi. Unë nuk mbaj shall se më merr frymën, tha Muhamedi. Hana iu afrua Mihal Komnenit, e puthi në faqe dhe doli në oborr. Pas Hanës u largua Ibrahim dhe djemtë u vunë në rresht pas tij. Sara mbeti e fundit dhe pasi dolën të gjithë iu drejtua Mihal Komnenit: Ku është Isaku, Mihal? Mihal Komnenit i lëvizi mjekra e bardhë kur u ngrit në këmbë. Nga larg dukej si një pemë që kishte mbirë mbi tavolinë pasi ishte ushqyer për një kohë të gjatë me mish. Përgjigjen e kësaj pyetje e pres nga ty, prandaj kam ardhur, tha ai. Unë nuk e di ku është Isaku, tha Sara që ndjeu një përvëlím në faqe. Fluturo që ta gjesh dallëndyshja ime. Krahët e tu janë zgjatur dhe mund ta kalojnë detin për të arritur në ishull, tha Mihali dhe këmisha iu fry në anën e zemrës, aty ku kryqëzoheshin dy pishqollat. Metod Antrakidi, që i shikonte të dy, do t'i thoshte më vonë Mihalit se Komnenët i drejtohen njëri-tjetrit si personazhe librash bizantinë, të cilët e zbukurojnë dashurinë e tyre me metafora zogjsh. Në ishull shkohet me not, por babai nuk ma mësoi, tha Sara e bindur se duke kundërshtuar mund t'i frenonte lotët që i ishin mbledhur në grykë. Notin do ta mësosh në ishull, foli Mihal Komneni dhe e puthi Sarën me dorë, sikur po përshëndeste një zog që nuk mund ta përfaqosh. Sara hapi krahët dhe doli në ajër të pastër. Mbrëmja ia ftohu mollëzat e nxehta që u njomën si një lëkurë që mbështetet në re.



Ibrahimi dhe djemtë ecnin përpara dhe Sarës iu dukën si një ushtri e lodhur që kthehej nga shkolla. Në errësirë shtëpia e hapur nga lart dukej si një kazan që mblidhte ujë. Kur do pushojë ky shi, tha Ibrahimi dhe ndaloi një çast përpara shtëpisë. Muhamedi thotë se shiu do pushojë kur të fillojë shkolla, foli Jani pas kurrizit të të atit.

Djemtë u futën nëpër dhomat e shtëpisë së re dhe Muhamedi hoqi çallmën. Pse e heq çallmën, i tha Aliu që e kishte futur shpatën poshtë krevatit. Muhamedi e shtriu peshqirin e çallmës mbi jastëk dhe pasi e palosi dy herë, u shtri dhe vuri kokën mbi të. Nuk shkohet në shkollë me çallmë se nuk jemi në Voskopojë, tha dhe pas pak e zuri gjumi.

Ibrahimi u zgjua kur një rreze drite i shpoi fytyrën. Ana flinte akoma, megjithëse një diell i verdhë i ecte nëpër flokë si një karficë lulesh. Ngriti kokën në qiell, por asnjë re nuk ia zuri dritën. Pellgjet jeshile në oborr po thaheshin si një veshkë e nderur në diell. U çua pa zhurmë nga krevati dhe shkoi të zgjonte djemtë.

Paridi u zgjua i fundit me flokët e ngritur që i zbuti me ujë. Sapuni i ngrirë i rrëshqiti si shumë mbi fytyrë dhe ai i fshiu me peshqir sytë që i digjnin. Aliu mori bishtin e lepurit e futi në xhep dhe tha se do t'ia tregonte Mihalit, ndërsa Muhamedi e palosi peshqirin si çallmë dhe e futi poshtë jastëkut. Kur u nisën, Ibrahimi dhe Sara dolën në oborr dhe i përcollën me sy. Do kthehen më të zgjuar, tha Sara dhe i shtrëngoi dorën Ibrahimit. Do kthehen të lodhur duke kërkuar çelësat e botës, tha Ibrahimi dhe u fut brenda për të fshehur sytë e përlotur.

Kur djemtë hynë në shtëpi, Mihal Komneni po thyente arra në oborr. Flokët e gjatë i kishte krehur dhe në qafë mbante një shall të kuq. Ky është shalli i Marin Kurilës, pyeti Paridi. Ky është shalli i Isakut, u përgjigj Mihal Komneni. Po pse nuk e mori Isaku shallin me vete, në ishull, pyeti Aliu. Shalli është si flamuri dhe nuk merret me vete, por ngulet mbi kështjellë, tha Mihal dhe theu një arrë mbi plloçe.

Kur hynë në dhomë, panë Metod Antrakidin që i priste në këmbë. Syzet e tij nuk kishin avull dhe sytë i dukeshin më të mëdhenj. Mbi një karrige tjetër, ishte një dërrasë e zezë që shkëlqente nga dielli që hynte nga dera e hapur. Mbylleni derën, tha Metod Antrakidi. Paridi mbylli derën dhe në errësirë dalloj disa shkronja të bardha mbi dërrasën e zezë. Aliu u ul, priti sa Metodi u kthye me kurriz nga ata dhe i tha Muhamedit në vesh: Metodit i ka ndryshuar zëri. Mësuesit e kanë zërin më të trashë se pleqtë, pëshpëriti Muhamedi.

Çfarë kam shkruar këtu, pyeti Metod Antrakidi dhe tregoi me një shkop të hollë dërrasën e zezë. Paridi ngriti supet, ndërsa Aliu bërtiti: Voskopojë. Jo, u përgjigj thatë Metod Antrakidi. Ke shkruar emrat tanë, i tha Muhamedi. Jo, tha prapë Metod Antrakidi, unë i di emrat tuaj, pse duhet t'i shkruaj. Ke shkruar që sot është e hënë, tha Aliu duke u ngritur në këmbë. Metod Antrakidi i bëri shenjë të ulej dhe tha: Jo, nuk kam shkruar që sot është e hënë. Aliu u ul duke parë me frikë nga Muhamedi që ishte ulur në karrigen e mesit. Metod Antrakidi e mbante shkopin të palëvizur në dërrasë dhe vetë dukej si një statujë që tallet me kalimtarët. Një rreze drite që hyri papritur nga fundi i derës i ra Muhamedit në gojë dhe ky tha: Ke shkruar që shtëpia e Arianit Komnenit u bë shkollë. Metod Antrakidi nuk foli, por tundi kokën duke mohuar. Rrezja e dritës kaloi nga Muhamedi te Paridi, i cili tha: Ke shkruar që shiu pushoi dhe shtëpia jonë do ndërtohet. Jo, tha Metod Antrakidi, për mua kjo nuk ka rëndësi.

Djemtë u tulatën në karrige dhe askush nuk foli. Metod Antrakidi kroi zërin dhe Aliu u afrua edhe më shumë nga Muhamedi. Kam shkruar që shkolla u hap, tha Metodi dhe hoqi shkopin nga dërrasa e zezë. Djemtë morën frymë dhe Metod Antrakidi qeshi.

Kur pellgjet jeshile u thanë, Naumi dhe Andrea erdhën në fshat. Naumi kontrollloi gropën e gëlqeres, ndërsa Andrea hoqi katramanë dhe u zhvesh në dhomën e gjumit të Sarës. Trupi i tij me muskuj dukej si një pemë brenda shtëpisë pa çati. Paska rënë shumë shi, i tha Naumi Ibrahimit duke nxjerrë një dërrasë të lagur nga gropa e gëlqeres. Kur mbaron, e pyeti Ibrahimimi që rrinte në mes të oborrit. Po hodhëm çatinë deri në fund të gushtit, në shtator i bashkojmë dy shtëpitë dhe në tetor secili nga djemtë e tu do ketë dhomën e vet.

Pas disa ditësh mbi shtëpi u dukën trarët e çatisë. Naumi i sharronte, pasi i maste me pe të kuq, kurse Andrea i ngulte mbi njëri-tjetrin. Trarët ngriheshin dhe pastaj kryqëzoheshin mbi çatinë që i ngjante një kafazi për njerëz. Kur Andrea thërriste të atin dhe i kërkonte gozhdë, honi i shtëpisë e kthente zërin në jehonë. Andrea kishte lidhur litarë të trashë me të cilët i tërhiqte trarët deri lart. Një ditë, në çati hipi dhe Jani duke u kacavjerrë me litarë. Ibrahimimi e shikonte nga poshtë djalin lakuriq, trupi i të cilit dukej si një muskul i Andreas. Jani i mbante trarët dhe Andrea i godiste fort me çekiç. Naumi i drejtonte dy djemtë nga oborri duke thirrur dhe duke lëvizur duart në erë, sikur drejtonte një orkestër. Kur trarët formuan një kasolle prej druri mbi muret e shtëpisë, Ibrahimimi thirri Sarën. Ajo nxori një stol të gjatë dhe të dy u ulën e nisën të shohin shtëpinë e tyre. Dielli hynte nëpër trarët e ngulur dhe formonte katrorë të barabartë brenda shtëpisë. Herë pas here nga katrorët dilte koka e qethur e Janit apo shpatulla e djersitur e Andreas. Kur i pa të ulur në stol, Jani nxori kokën dhe i përshëndeti me dorë. Si dukemi që atje lart, e pyeti Sara. Jani u ngrit edhe pak, vuri dorën mbi sy dhe thirri: Si dy zogj që presin të hyjnë në kafaz. Ibrahimimi qeshi, ndërsa Sara u çua dhe u fut në shtëpi. Mori Anën në krahë dhe filloi t'i tregonte shtëpinë që ndërtohej. I fliste me zë të ulët, por vajza lëvizte kokën nga ana tjetër dhe shikonte Naumin që me çekiç rumbullakoste cepat e ploçave që kishte rreshtuar në oborr. Jani e nxori prapë kokën dhe kur pa Anën i tha: Hajde dallëndyshe të shohësh si ta kam thurur folenë. Ana vazhdonte t'i mbante sytë nga Naumi dhe tingulli i rregullt që dilte nga ploçat e thyera, pas pak e vuri në gjumë. Mbështeti kokën në supin e Sarës dhe mbylli sytë. E zuri gjumi, tha Ibrahimimi. Edhe mua më flihet kur vëllai më thotë dallëndyshe, tha Sara.

Pasdite, kur djemtë u kthyen nga shkolla, ndaluan përpara shtëpisë dhe filluan të numërojnë trarët. Dyzet e tetë, tha Paridi. Jo, janë dyzet e nëntë, tha Aliu. Muhamedi, që vazhdonte të numëronte me gisht, ktheu kokën nga Aliu dhe i tha: Nuk mund të jenë dyzet e nëntë sepse numri i trarëve është çift dhe jo tek. Po pse është çift numri i trarëve, pyeti Paridi. Sepse përballë çdo trari vendoset një tra tjetër dhe pjesa e përparme është e barabartë me pjesën e prapme, ndërsa faqja e majtë është e barabartë me faqen e djathtë. Çdo faqe ka aq trarë sa ç'ka faqja përballë dhe prandaj numri në çdo rast është çift, tha Muhamedi duke e drejtuar gishtin nga koka e Janit që i shikonte nga çatia.

Numri i trarëve është tek, foli Naumi që i kishte dëgjuar duke lënë punën. Muhamedi uli gishtin në tokë dhe Aliu i shkeli syrin Paridit. Shtëpia është në formë drejtkëndëshi dhe faqet nuk janë të barabarta. Faqja ballore dhe ajo mbrapa, që janë më të mëdha, kanë nga gjashtëmbëdhjetë trarë secila. Dy faqet e tjera, njëra në lindje dhe tjetra në perëndim janë më të vogla dhe ato kanë nga dhjetë trarë. Kur vihen të gjithë trarët dhe shtrihen njëri mbi tjetrin duke u ngulur me gozhdë, në majë të çatisë, në pikën më të lartë, vendoset trari i madh, i cili i bashkon të gjitha faqet. Ky quhet trari i madh ose kulmi i shtëpisë, tha Naumi me një zë të butë si mësues.

Djemtë shikonin trarët, ndërsa Andrea me Janin i kishin lënë çekiçet dhe qeshnin nga lart. Sa trarë ka e gjithë shtëpia, pyeti Ibrahimimi djemtë, duke i bërë shenjë Naumit që të mos fliste. Paridi filloi të mblidhte me zë, ndërsa Aliu u ul në gjunjë dhe numëroi me gishta. Muhamedi qëndroi drejt duke mos i hequr sytë nga çatia. Pesëdhjetë e tre, thanë me një gojë Paridi me Aliun. Aq ka, tha Naumi.

Unë thashë që janë çift sepse trari i madh nuk është vënë akoma, u mbrojt Muhamedi duke parë drejtkëndëshin e shtëpisë, të cilit i mungonte një vizë. Kur të zgjohesh nesër në mëngjes, trarët do jenë tek, tha Naumi dhe u përkul mbi ploçë.

Dy ditë më vonë qielli u nxi dhe retë u frynë duke u varur mbi kafazin prej druri. Dielli u fsheh dhe Andrea veshi një bluzë të ngushtë dhe muskujt iu mbuluan. Ibrahim shikonte qiellin, ndërsa Naumi shtroi prapë katramanë mbi dhomën e gjumit ku flinte, bashkë me të birin. Andrea e kishte ngulur me gozhdë trarin e madh që rrinte i shtrirë si një vijë horizonti. Mbi trupin e tij të lëmuar, Jani gdhendi emrat e gjithë djemve të Ibrahimit. Thanas, Petro, Jani, Niko, Muhamed, Ali. Nuk dinte të shkruante dhe i tha Sarës t'ia vizatonte emrat në letër. Sara i shkroi një nga një në letër dhe Jani i mori me vete në lartësi. Pasi i gdhendi me radhë me një daltë të mprehtë, mori bojë të kuqe dhe filloi t'i lyente. Furça hynte në brazdat e germave si në një kanal. Ibrahim e shikonte i ulur në stol dhe i dukej sikur i biri po vizatonte në qiell. Kur mbaroi i tha: Shto edhe emrin e Ademit. Janit iu drodh dora dhe furça i ra brenda në shtëpi. Nxori kokën mbi trarë dhe pa të atin e kërrusur mbi stol, sikur po falej mbi një kujtim. Mos zbrit, i tha Sara, ta tregoj që këtu sesi shkruhet emri i Ademit. Andrea e lidhi furçën në litar dhe Jani e tërhoqi, e futi në brez dhe nxori daltën nga xhepi i pantallonave. Jam gati, i tha Sarës dhe ndjeu dorën që vazhdonte të dridhej. Vizato germën e parë të emrit të Aliut, thiri Sara dhe dëgjoi çekiçin e Janit që ra mbi daltë. Jani punonte shpejt dhe kur mbaroi i fryu kanaleve që kishte hapur mbi tra dhe pa germën e parë të emrit të Aliut të gdhendur. Tani merr germën e parë të emrit të Petros dhe vizatoje me kokë mbrapsht, ndërsa barkun ktheja nga lindja, tha Sara. Jani e nguli daltën fort dhe bëri një vijë të gjatë dhe pastaj i shtoi vizatimit një bark të madh të kthyer nga shtëpia e vjetër e Mihalit. Shumë mirë, tha Sara. Tani merr edhe germën e dytë të emrit të Petros dhe vizatoje. Naumi dhe Andrea kishin lënë punën dhe po shikonin Janin që godiste me përpikëri mbi tra. Nuk e dija që historia e familjes mund të shkruhet mbi dërrasë, tha Naumi, ndërsa Jani po i frynte pluhurit të germës së tretë. Merr germën e pestë të emrit të Muhamedit dhe vëre në fund, tha Sara. Jani e punoi më gjatë këtë vizatim dhe kur mbaroi, Sara i tha Ibrahimit se germa *m* dukej si dy shtëpitë e tyre të bashkuara kurriz më kurriz. Ibrahim nuk foli dhe vazhdoi të shikonte Janin që po e lyente emrin e Ademit me ngjyrë të kuqe. Dukej i lodhur dhe i menduar. Pas pak i tha Sarës: Po unë mund të mësoj të shkruaj? Sara iu afrua dhe i lëmoi flokët që kishin nisur të thinjeshin. Ti i ke shkruar emrat e djemve në barkun e gruas tënde, ndërsa Jani po i kopjon, tha Sara. Ibrahim uli kokën dhe thinjat iu shtuan. Eh, kallamari im po zbrazet, tha me zë të mekur.

Kur tre djemtë erdhën nga shkolla, Jani ishte në oborr duke larë duart e skuqura. Ke vrarë ndonjë lepur, e ngacmoi Aliu. Jani qeshi dhe tregoi me gisht trarin e madh. Muhamedi filloi të lexonte emrat me zë, ndërsa Paridi e ndiqte me vështirësi dhe emrin e Petros e lexoi: *Detro*.

Petro nuk ka hyrë akoma në det, i tha Muhamedi që e kishte mbaruar leximin. Por Paridi nuk e dëgjoi. Pse ma ke ndryshuar emrin, i bërtiti Janit kur lexoi emrin e tij të vjetër. Shtëpia filloi të ndërtohej përpara se ti të bëheshe Parid, ia ktheu Jani. Paridi mori një gur dhe e hodhi me forcë drejt shtëpisë. Guri u përplas te trari i madh dhe humbi me zhurmë në honin e shtëpisë. Niko dhe Ademi kanë vdekur, tha Paridi dhe u fut me vrap në shtëpinë e re. Jani foli me Sarën dhe hipi prapë mbi çati. Retë ishin ulur shumë poshtë atë pasdite dhe ai mezi i shquante germat. Në fillim i hoqi bojën emrit të Nikos duke e kruar si lëkurë me një thikë të vogël. Pastaj, i thelloi kanalet duke i zgjatur dhe duke i shkurtuar. Emri i ri kishte një germë më shumë se i vjetri dhe Jani i bëri vizatimet më të holla. Gdhendjen e mbaroi kur u err. Zhurma që bënte dalta e tij në muzg ngjante me ecjen e një maceje të uritur mbi çati. Kur mbaroi, i leu germat me bojë, por errësira nuk e la ta shijonte vizatimin të plotë. Fjeti dhe u ngrit herët në mëngjes qielli ishte i pastër dhe retë ishin fshirë gjatë natës, si germat e emrit të Nikos. Jani i kaloi edhe një bojë germave të reja që

shkëlqyen më shumë nga dielli i freskët i agimit. Kur vëllezërit u nisën në shkollë, ai ishte akoma mbi çati. Parid, i thirri të vëllait. Paridi nguli sytë mbi shtëpi dhe lexoi ngadalë emrin e vet. Fytyra iu çel dhe flokët e tij të ngrirë dukeshin si të vaisura për pagëzim. Tani zbrit, i tha Janit, që të mos biesh edhe ti nga çatia siç ra Niko. Pse emri i Paridit shkëlqen më shumë se emri im, u ankua Aliu. Paridi ishte një djalë elegant që lyhej me parfum kurse Aliu është një luftëtar i fortë dhe i thekur në diell, tha Jani. Ç'është do të thotë elegant, pyeti Aliu, që nuk ishte bindur nga përgjigjja e Janit. Elegant do të thotë t'u pëlqesh grave, tha Andrea duke nxjerrë kokën mbi kafazin e trarëve. Paridi eci përpara duke mbajtur kokën lart, ndërsa Muhamedi i tha Aliut që i mbante buzët e mbledhura: Gratë joshen me parfum, por fitohen me shpatë.

Ke një kazan të madh, e pyeti Naumi, Sarën, një mëngjes. Kam, tha Sara, pse të duhet? Për të ngritur plloçat mbi çati, tha Naumi dhe mori kazanin prej bakri. E lidhi me litar në të dy veshët dhe e mbushi me plloça. Jani zbriti nga çatia, tërhoqi kazanin e rëndë brenda shtëpisë dhe Andrea filloi ta ngrinte me litarë. Kur plloça e parë rrëzëlleu mbi çati, Ibrahim i ngazëllyer iu afrua Naumit. Po ecën shpejt, i tha. Po më fole kur punoj, do eci me ngadalë, tha Naumi dhe vuri buzën në gaz. Andrea i shtroi plloçat me kujdes duke nisur nga faqja perëndimore e shtëpisë. Kazani u boshatis dhe Jani e mbushi prapë, ndërsa Andrea e ngriti lart. Muskujt e tij dukej sikur shtronin një qilim prej guri mbi shtëpi. Në drekë, Sara gatoi mish me presh, bëri një sallatë me qepë dhe domate, preu bukë me feta të mëdha, kurse Ibrahim nxori një shishe me raki. Vuri tepsinë mbi tavolinën e madhe që rrinte në oborr dhe thirri Naumin, Andrean dhe Janin. Filluan të hanin në këmbë, ndërsa shishen e rakisë Ibrahim ia kaloi Naumit dhe ky Andreas. Rakia avullonte nga krahët e fortë të Andreas, ndërsa Naumi u ngop, shkoi të shtrihej nën hijen e katramasë ku e zuri gjumi. Kur ai u zgjua, Andrea i kishte shtuar edhe një shirit qilimit të plloçave mbi çati. Jani mbushte kazanin, ndërsa në stol ishte ulur Sara bashkë me një burrë me mjekër të bardhë dhe flokë të lëshuara mbi supe. Rrinin ngjitur me njëri-tjetrin dhe shikonin shtëpinë që rritej. Naumi fërkoj sytë e përgjumur dhe pyeti Janin. Është akoma gjallë Arianit Komneni? Nuk e di, tha Jani. Ky është i biri, Mihal Komneni, vëllai i Sarës.

E paskeni ndërtimin në gjak, tha Naumi duke u afruar . në gjak kemi padurimin, tha Mihali dhe, duke e përshëndetur, e pyeti: Kur mbaron? Një shtëpi ndërtohet më shpejt se një kishë, u përgjigj Naumi. Njerëzit janë të paduruar kurse perëndia pret. Perëndia është e përjetshme kurse ne nuk kemi shumë kohë, tha Sara. Fole si Arianit Komneni, tha Naumi. Kur u martua Ibrahim me gruan e parë, ai na tha ta mbaronim kishën një muaj përpara afatit. Filluam në qershor dhe punuam në mes të vapës, si tani, duke ngritur gurët me thonj dhe duke i veshur me vezë që të ngjiteshin fort. Ishte viti 1752 dhe Andrea nuk kishte lindur. Unë i ngrija muret vetë kurse Arianit Komneni, me këmishën të zbërthyer, më drejtonte duke i lëvizur qoshet e kishës si gurë shahu. Natën ai rrinte zgjuar dhe e maste kishën me këmbë duke pritur mëngjesin. Kur hëna ndriçonte, hija e tij e madhe zgjatej si kabanore. Unë flija i drobitur dhe kur zgjohesha në mëngjes e gjeja aty. m'i zgjaste veglat e punës sikur po më jepte armë. Më dukesh si një prift që nxjerr armët nga kisha, i thashë një herë. Mua nuk më duhen armë për t'u mbrojtur nga perëndia, thoshte ai.

Në fillim të tetorit, i gjithë fshati erdhi për të dëgjuar kabanën e parë. Arianiti e tundi kabanën fort me litar dhe i tha njerëzve duke u gajasur. E dëgjuat? Perëndia erdhi në fshat! Gratë bënë kryqin, ndërsa fëmijët mbyllën veshët nga gjëmimi. Atë natë mblodha veglat dhe u nisa. Ishte një mbrëmje e thatë dhe para kishës pashë Arianitin që ishte ulur në një gur dhe shikonte nga kisha. Ç'bën këtu, i thashë. Po pres sa të futet hëna në kabanë, më tha. Ishte një plak i çuditshëm. Fjalët që thoshte kishin gjithmonë dy kuptime dhe ai eglendisej kur të tjerët

habitëshin. Kur e ndamë më tha: Ti do vish përsëri në fshat, por unë nuk do jem këtu. Thuaji fëmijëve të mi që rruga kalon nga kisha.

Mihal Komneni dhe Sara dukeshin si dy fëmijë të vegjël që presin babanë të ulur në stol. Mjekra e Mihalit ishte zbutur, ndërsa Sara kishte mbledhur duart mbi gjunjë. Shikonin Naumin me sy të lutur, sikur i kërkonin ta vazhdonte përrallën. Nuk e dija që ti ishe vajza e Arianit Komnenit, tha Naumi. Tani e kuptoj pse shkruani emra në trarët e shtëpisë. Mihali ngriti kokën, ndërsa Sara pa Naumin e habitur. Edhe babai juaj e kishte këtë zakon. Kur mbarova kishën ai më kërkoi ta lëmoja portikun mbi derën e madhe të hyrjes. Unë e krova gjatë gurin e ashpër derisa u bë si një pjatë e pastër dhe aty Arianiti shkroi diçka. E keni parë besoj, pyeti Naumi. Sara ngriti supet, ndërsa Mihal Komneni u ngrit nga stoli dhe duke e parë Sarën në sy i tha: Fluturimi kalon nga kisha, dallëndyshe.

I rrahu shpatullat Naumit dhe u nis me hap të madh. Sara e ndoqi pas, ndërsa Naumi u kthye dhe filloi të mbushte kazanin me plloça. Ku ikën ata, e pyeti Jani. Po kërkojnë Arianit Komnenin, u përgjigj Naumi dhe tundi kokën si kabanë.

Kisha ishte e ftohtë dhe Mihal Komneni u drodh. Një merimangë e butë që varej mbi derë iu ngjiti në mjekër, por Mihal nuk e pa. Këmbët e vogla të Sarës jehuan mbi altarin e zhveshur. Nga katër dritaret e vogla hynin rreze të holla drite që bashkoheshin në qendër të kishës. Mihal bëri disa hapa dhe u kthye duke parë mbi portik. Portiku ishte i mbuluar me pluhur dhe ai e fshiu me dorë. Pluhuri i ra Mihalit mbi flokë dhe disa katrorë të vegjël nxorën brinjët dhe morën frymë nën gishtat e tij të mëdhenj. Sara lëvizi për të shmangur pluhurin dhe zgjati kokën. Një katror, pak më i madh se pëllëmba e Mihalit, djersiti mbi gur. Mihal bëri një hap prapa, ngriti sytë dhe u përqendrua. Katrori ishte i rregullt dhe i ndarë në shumë katrorë të vegjël. E lexon dot çfarë shkruhet, i tha Sarës që u ngrit mbi majat e këmbëve dhe lexoi germat një nga një: *KRETA*. Natyrisht, tha Mihal dhe kaloi dorën mbi mjekër. Ka edhe një numër, tha Sara. Çfarë numri, pyeti Mihal Komneni duke picërruar sytë në errësirë. Trembëdhjetë, tha Sara. Numri është shënuar në katrorin e mesit, poshtë germës *E*.

Mihal Komneni u lëkund mbi këmbët e veta dhe Sarës iu duk sikur do rrëzohej. Rrezet e dritës i vinin nga prapa kurrizit, i hynin ndër flokë dhe fytyra iu zbeh si një ikonë. Isaku ka qenë këtu, tha dhe preku portikun me dorë duke e përkëdhelur. Sara e pa në sy, por nuk foli dot. Numri trembëdhjetë është shtuar më vonë se Kreta. Shiko kanalet e gdhendjes. Nuk janë bërë nga e njëjta dorë. Numri është më i hollë dhe më i freskët dhe duket i shkruar nga një dorë e re dhe e lehtë. Ndërsa brazdat e Kretës janë të thella, të ashpra dhe të gdhendura në gur nga një dorë e lodhur dhe e pasigurt. Naumi tha se ai pastroi gurin, ndërsa babai shkroi diçka që ai nuk kishte ditur ta lexonte. Por Naumi nuk tha nëse kishte parë ndonjë numër, që do të thotë se numri është shkruar më vonë dhe patjetër ka një kuptim. Çfarë kuptimi ka, pyeti Sara që dukej e frikësuar sikur e kishin lënë vetëm në një labirinth logjik. Iu kujtua Metod Antrakidi që thoshte se njohja e botës është e mbyllur në një derë që hapet me një numër dhe me një germë. I hodhi sytë nga katrori që djersinte i zbuluar nga pluhuri.

Kuptimi i parë që më vjen në mend është Voskopoja, foli Mihal Komneni. Isaku ka dashur të lërë një gjurmë të jetës së tij këtu, por katrorët bosh fshehin numra të tjerë që duhet të lidhen me njëri-tjetrin me një shpjegim. Po Kreta, pyeti Sara. Mihal lëvizi pak kokën si për të thënë se ky shteg mund të kalohej më lehtë. Kreta është shkruar nga babai. Ai e ndërtoi këtë kishë për heronjtë e Kretës dhe ditën që kisha u hap, këtu u mbajt një meshë për ta. Kreta ishte pjesa më e dhimbshme dhe njëkohësisht më e bukur e jetës së tij. Aty iu vra vëllai i madh, aty vdiq gruaja që dashuronte dhe aty lindi ti. Por katrorët e tjerë mund të japin shpjegime të tjera dhe të

ndriçojnë gjëgjëzën e jetës së Arianit Komnenit, tha Mihali duke marrë frymë thellë. Si do t'i hapim këto kuti, e pyeti Sara. Mihal Komneni kaloi edhe një herë dorën mbi katror sikur donte të regjistronte në kujtesën relievin memec të gurit, apo sikur donte të takonte dorën që kishte qenë aty përpara dorës së tij. E afroi dorën te buzët e veta sikur maste temperaturën, pastaj i mori erë dhe tha: Metodi mund të ketë një çelës.

I hodhi një sy kishës, hapi derën me forcë dhe doli në diell. Merimanga, që i varej si një jargë e moçme në mjekër, u verbua. Mihal Komneni vrapoi si fëmijë në rrugën e shtëpisë dhe Sara e ndoqi pas. Loja filloi, mendoi me vete.

Paridin, Muhamedin dhe Aliun i gjetën të ulur në tri karrige. Përballë tyre, në këmbë, rrinte Metod Antrakidi. Shkolla mbaroi për sot, thirri Mihali kur hyri brenda. Djemtë u çuan duke parë Metod Antrakidin, por Mihali i shkeli syrin dhe ata dolën të kënaqur. Nuk pranoj pleq në shkollën time, tha Metod Antrakidi që qëndronte akoma në këmbë. Pranoj unë, tha Mihali dhe i bëri shenjë Metodit që të ulej në karriget e djemve. Pas tij u ul dhe Sara. Karrigia ishte e ngrohtë dhe ajo mblodhi këmbët. Mihali fshiu dërrasën e zezë dhe vizatoi një katror. E ndau në pesë pjesë vertikalisht dhe horizontalisht dhe në rreshtin e parë, lart shkroi: *KRETA*. Në katrorin poshtë germës së mesit vuri numrin 13.

U kthye nga Metodi dhe i tha: Ja një detyrë për ty. Gjej numrat dhe fjalët e padukshme në këta katrorë dhe të jesh i sigurt se bota do të të duket më e bukur.

K	R	E	T	A
		13		

Metod Antrakidi rregulloi syzet mbi hundë, pa katrorin dhe tha: Ky është një katror magjik. Ku e gjete?

Ma ka lënë trashëgim babai, tha Mihali dhe mori shkopin e mësuesit në cep të dërrasës. Nuk e dija që Arianit Komneni ka qenë një mason, tha Metodi. Sara ktheu kokën, por Mihali ngriti shkopin dhe ajo nuk nxori zë.

Katrorët magjikë janë shumë të hershëm dhe disa mendojnë se janë me origjinë parakristiane, filloi Metodi. Në traditat e lashta hebreje dhe greke njerëzit e ditur përdornin katrorë të tillë për të fshehur apo për të dhënë sinjale të ndryshme. Me kalimin e kohës, katrorët magjikë u shndërruan në një sport për matematicienët sofistë që luanin me to duke habitur princat dhe madje i përdornin edhe si letra dashurie, të cilat askush përveç të dashurës, nuk mund t'i lexonte. Katrorët magjikë nuk formohen vetëm me numra, por edhe me fjalë. Sekretin e katrorit magjik është ky: numrat që e përbëjnë duhet të jenë të ndryshëm, pra të mos përsëriten dy herë, të jenë të njëpasnjëshëm, pra një, dy, tre, katër, apo njëzet, njëzet e një e me radhë dhe sido që t'i mbledhësh, vertikalisht, horizontalisht apo diagonalisht ato duhet të japin të njëjtën shumë.

Ndërsa katrorët e fjalëve formohen me vështirësi për shkak të natyrës së pambledhshme që kanë fjalët, të cilat mund të kombinohen duke u lexuar vetëm nga një anë, pra ose majtas, ose djathtas,

ose poshtë, ose lart, por jo edhe anasjelltas. P.sh. fjala *Kreta* në katrorin e Arianitit mund të lexohet nga e majta në të djathtë, por jo në të kundërtën. Kjo bën që katrorët e numrave të jenë shumë më të përdorur në të gjitha traditat që përpiqen të shpjegojnë botën përmes numrave.

Mjeshtri i këtyre magjive matematike ka qenë Pitagora, i cili thoshte se në këtë botë çdo gjë është një numër. Pitagora arriti të hutojë gjindjen në Italinë e Jugut, ku jetonte, që në atë kohë ishte koloni greke, aq sa rregullat e tij u kthyen në një lloj feje, e cila, nëse nuk do lindte Krishterimi, ndoshta do vazhdonte ta shpjegonte botën përmes numrave. Pitagora e quante veten një hyjni dhe një herë tha: në këtë botë ekziston Zoti, ekzistojnë njerëz, por dhe qenie si unë. Siç thashë, rregullat e tij u kthyen në normë me mbështetjen e disa princave që i besuan dhe u bënë dishepuj të tij. Pitagora thoshte: Mos hani fasule, mos kaloni mbi një kryq, mos trazohet zjarri me hekur, mos shkelen dafinat, mos hahet zemra, mos lihen dallëndyshet të ndërtojnë fole nën çati, mos u shiko në pasqyrë kur je pranë një qiri, etj. Teoria e Pitagorës, si një kombinim i matematikës me teologjinë, ndikoi në gjithë mendimin grek parakristian, por edhe shumë më vonë. Më pas, Krishterimi e mohoi Pitagorën, sepse nuk mund të pranonte që Zoti ishte një numër dhe që pas çdo numri fshihej një sekret që duhej zbuluar nga mendja njerëzore. Unë mendoj se Pitagora do kishte qenë më i suksesshëm në rast se nuk do t'i kërkonte njerëzve që të mos hanin fasule, sepse në atë kohë fasulja përbënte ushqimin bazë të grekëve. Ai i ka përçmuar grekët dhe ka qenë cinik. Edhe unë do bëja zgjedhjen që bënë grekët: më mirë një fe që nuk më lejon të marthohem dy herë, si Krishterimi, sesa një fe që më pengon të ha fasule. Mes dy të këqijave do zgjidhja më të voglën.

Po me dallëndyshet ç'kishte Pitagora, pyeti Mihali që qeshte duke parë Sarën.

Nuk e di, tha Metodi. Grekët e lashtë ishin shumë tokësorë dhe qiellin ua kishin lënë perëndive.

Por le të kthehemi te katrorët magjikë. Nga grekët ato u morën dhe u përpunuan nga çifutët që kanë shkencën e tyre të numrave, e cila quhet Kabbala. Kabbala mendohet se është një libër që iu dha Abrahamit nga perëndia dhe që shpjegon lindjen, ndërtimin dhe ecurinë e botës përmes kombinimit të numrave dhe germave. Kabbala e ndan dijen njerëzore në pesëdhjetë shkallë inteligjence dhe thuhet se vetëm Moisiu arriti deri te shkalla e dyzetënëntë sepse tek e fundit nuk mund të arrinte, pasi ai nuk ishte profeti i fundit. Shkalla e pesëdhjetë e dijes është vetë Zoti dhe vetëm Jezu Krishti ka arritur deri aty.

Çifutët kanë një katror të dashur me 36 numra duke filluar nga njëshi. Shuma e çdo rreshti është 111 dhe shuma e të gjithë rreshtave është 666. Ka njerëz që besojnë se ky është numri i djallit, por për çifutët ai ka një kuptim mistik dhe hyjnor që lidhet me ardhjen e Mesias. Sabatai Zevi ishte kabalist dhe një nga arsyet që njerëzit e besuan ishin pikërisht tri gjashtat e vitit 1666, kur ai u shpall si Mesia.

Edhe myslimanët kanë një katror magjik me tri rreshta. Numrat e këtij katrori janë nëntë dhe fillojnë nga tetëmbëdhjeta dhe mbarojnë në njëzet e gjashtë. Shuma e tyre është 66 që përbën vlerën numerike të fjalës Zot në arabisht.

Më vonë, lojën e katrorëve magjikë e morën masonët, të cilët u shfaqën në kohën e kryqëzatave dhe fillimisht shërbyen si mbrojtës të Jerusalemit kur ai u pushtua nga myslimanët. Masonët e parë kishin gërmuar në tempujt e Jerusalemit dhe besohet se atje kanë gjetur sekrete të mëdha nën rrënoja. Disa nga kodet e tyre të fshehta ata i kaluan dorë më dorë me anë të katrorëve magjikë.

Babai nuk ka qenë mason, e ndërpreu Mihal Komneni duke drejtuar shkopin. Kur ishte në Stamboll mund të ketë njohur disa prej tyre dhe ndoshta aty ka mësuar katrorin magjik.

Nuk ka bërë keq, tha Metodi dhe i nguli sytë dërrasës. Ky katror duhet të ketë dy pjesë. Ai përbëhet edhe nga fjalë edhe nga numra. Rreshti i Kretës është me fjalë që do të thotë se edhe

rreshti i parë vertikal dhe i pesti vertikal që lidhen me të, duhet të kenë fjalë të fshehura. Ndoshta edhe rreshti i fundit horizontal që lidhet me dy rreshtat anësore duhet të jetë një fjalë. Ndërsa numri trembëdhjetë është pjesë e një katrori brenda katrorit të madh. Katrori i madh ka njëzet e pesë katrorë të vegjël. Ndërsa katrori i vogël ka nëntë katrorë të mbushur me numra. Po filloj me këtë të voglin sepse është më i lehtë.

Metodi u çua dhe vizatoi një katror më të vogël se katrori i Arianitit që rrinte përbri dhe priste të zbulohej. E ndau katrorin me dy viza nga lart-poshtë dhe pastaj hoqi dhe dy viza të tjera horizontale. Dërrasa e zezë qau nga shkumësi dhe Sarës iu ngjeth mishi. Nëntë katrorët e vegjël dukeshin si nëntë gojë të hapura. Metod Antrakidi shkroi një trembëdhjetë në katrorin e mesit, në rreshtin e parë lart dhe filloi të numëronte duke lëvizur buzët. U mendua pak dhe në katrorin e parë, në të majtë të trembëdhjetës, vuri një tetë. Poshtë tetës vuri një shtatë dhe poshtë shtatës një dymbëdhjetë. Rreshti i parë vertikal u plotësua. Mihali pa nga Sara dhe filloi të qeshte. Mektodysyz Prapakidi po i hap portat e Komnenëve, tha.

Poshtë trembëdhjetës Metodi shkroi një nëntë dhe poshtë nëntës një pesë. Ndërsa në rreshtin e tretë nga lart-poshtë vuri një gjashtë, pastaj një njëmbëdhjetë dhe pastaj një dhjetë.

8	13	6
7	9	11
12	5	10

Katrorët u plotësuan dhe Metodi bëri një hap prapa duke i parë.

Mblidhi nga të duash, i tha Mihali Komnenit. Mihali filloi të numëronte duke prekur çdo numër me shkop. Shkopi u end nga e majta në të djathtë, pastaj nga poshtë-lart, dhe pastaj përshkoi ngadalë diagonalen duke filluar nga numri tetë, kaloi te nënta dhe qëndroi te dhjeta. Shuma është njëzet e shtatë, tha dhe Sarës iu kujtua Aliu që numëronte trarët e shtëpisë me gishta. Po, tha Metodi. Por t'i mbledhësh numrat është e thjeshtë. E vështirë është t'i kuptosh.

Trembëdhjeta është numri simbol i Voskopojës, që Marin Kurila thoshte se vjen nga numri i Krishtit dhe dymbëdhjetë profetëve të tij. Këtë numër, besoj se e ka shkruar Isaku sepse një gjë është e qartë: nuk ka qenë e njëjta dorë ajo që ka shkruar fjalën dhe ajo që ka shkruar numrin.

Nga e kupton ti këtë, e pyeti Metodi. E pashë gurin, e preka, e shijova dhe e nuhata. Guri kishte erën e tim biri dhe unë këtë erë nuk mund ta ngatërroj me asgjë tjetër. Sado inteligjente, e përsosur dhe e stërvitur të jetë shqisa, dëshmia e saj nuk përbën provë, tha Metodi. Aq më tepër që shqisa jote e vjetër ka qenë e djegur nga malli. Sytë e tu kanë qenë të përлотur, hunda ka qenë e zënë, gjuha e tharë dhe dora e drunjte. Si mund t'i besoj një zemre që dridhet nga kujtimet duke prishur muzikën e shqisave që komandon?

Mihali Komneni e uli shkopin dhe Sarës iu duk si një dirigjent i plakur. Por rënia e tij zgjati vetëm një çast. Ngriti dorën dhe ia afroi Metodit në hundë. Merri erë, i tha. Mban era myshk, tha Metodi dhe teshtiu. I fshiu hundët me mëngë dhe u kthye nga Mihali. Isaku ka pasur nëntë katrorë bosh. Më thua dot pse është vënë numri trembëdhjetë pikërisht në këtë katror dhe jo diku tjetër? Mund ta kishte shkruar trembëdhjetën në rreshtin e fundit, apo në katrorin e parë lart, ose në katrorin e mesit, ose ku të donte sepse fushën e shahut e kishte bosh dhe mund ta vendoste ku t'i pëlqente mbretin e tij trembëdhjetëvjeçar.



Kjo është çështje metode, Metod, u përgjigj Mihali dhe pa Sarën që e shikonte si një nxënëse në ditën e parë të shkollës.

Pa dyshim që është një çështje metode, përsëriti Metodi dhe vazhdoi:

Isak Komneni, gjithmonë nëse është ai që e ka mbushur këtë katror memec, ka dashur të dëshmojë diçka përmes pozicionit të numrave. Unë besoj se ai ka dashur të lërë një gjurmë dhe këtë mund ta provoj. Ja, se si. Po ta kishte vënë trembëdhjetën në katrorin e parë lart, shuma e të gjithë numrave të njëpasnjëshëm do të ishte dyzet e dy. Po ta kishte vënë numrin e tij në katrorin e mesit të rreshtit të mesit, pra në qendër, shuma e të nëntë katrorëve do ishte tridhjetë e nëntë. Mund ta kishte shkruar në katrorin e parë të rreshtit të fundit dhe mbledhja e të gjithë numrave do të ishte tridhjetë. Me pak fjalë, Isaku ka pasur nëntë mundësi për të ndërtuar një katror me numrin trembëdhjetë. Pse ka zgjedhur pikërisht këtë kombinim numrash? Pse ka kërkuar njëzeteshtatën dhe jo tridhjetën apo tridhjetenëntën apo dyzetedyshin?

Mihal Komneni mendohej duke kruar mjekrën.

Kur ka lindur Isaku, pyeti Metod Antrakidi. Në 13 janar 1742, tha Mihali. Kur iku Isaku nga Voskopoja, pyeti Metodi. Në gusht të vitit 1769, tha Mihali dhe mjekra iu drodh. Metod Antrakidi u kthye nga Sara. Kur u largua Arianit Komneni nga fshati? Në tetor 1769, tha Sara që u mblodh në karrige.

Dëshmia e shqisës së grisur të Mihal Komnenit ndoshta mund të merret si provë, shpalli Metodi dhe tha: Isaku ka qenë 27 vjeç në vitin 1769 dhe duke i kombinuar katrorët në këtë mënyrë ndoshta ka dashur të na thotë se në cilin vit ka qenë këtu. Me fjalët e numrave ai ka thënë: Kur mbusha njëzet e shtatë vjet shkova në fshat. Ose: Isha në fshat në vitin 1769. Ndërsa numri trembëdhjetë tregon se ai ka ardhur nga Voskopoja. Isaku ishte i bindur se njerëzit që do lexonin katrorin e tij do ta lidhnin simbolikën e numrit trembëdhjetë me qytetin e Voskopojes ku ai bëri histori. djalë i zgjuar, tha Metodi. I ka ngjarë më shumë gjyshit se babait. Deri tani na ka thënë se nga vjen dhe ku qëndron, por ne duhet të gjejmë se ku ka shkuar.

Po Kreta, pyeti Sara.

Nëse Kretën e ka shkruar Arianit Komneni, Isaku e ka gjetur fjalën këtu dhe është përpjekur të kombinojë numrat me fjalët e fshehura. Kjo është një teknikë e vështirë dhe unë nuk kam parë kurrë një katror magjik, ku bashkohen fjalët me numrat, tha Metodi duke bërë një hap prapa. Po nëse Isaku ka ardhur në fshat në gusht të vitit 1769 ai është takuar me Arianitin dhe ky i ka treguar sekretin e katrorit të madh. Kjo është e pamundur, tha Sara. Unë do ta kisha parë Isakun po të vinte në shtëpinë tonë atë vit. Isaku u arratis nga Voskopoja dhe turqit e kërkonin për ta burgosur, tha Mihali. Ai duhet të ketë qëndruar i fshehur që mos pikasej. Kush i mbante kyçet e kishës, pyeti Metod Antrakidi. Babai, u përgjigj Sara, ai e ndërtoi kishën. Ndoshta Isaku është fshehur në kishë sepse aty nuk hynte njeri, tha Metodi. Ndoshta, tha Sara. Kur Ibrahim i u bë mysliman prifti nuk erdhi më nga Janina dhe për shumë kohë nuk u mbajtën më mesha. Kisha rrinte e mbyllur.

Po të isha unë në vendin e Isakut nuk do gjeja strehë më të sigurt se një kishë e braktisur për t'u fshehur, foli Metodi. Ai mund të ishte fshehur edhe në shtëpinë tonë, në bodrum ose në çati, tha Sara. Arianit Komneni nuk mund të ishte kaq naiv, u përgjigj Metodi. Ai e dinte se, nëse turqit do ta kishin ndjekur Isakun, vendi i parë ku do të kërkonin do të ishte shtëpia e tij dhe ai sigurisht që nuk donte ta bënte të nipin kurban. Në këtë shtëpi, Isaku do ishte i zbuluar dhe njerëzia mund ta kishin parë.

Përpara se babai të ikte, në fshat erdhi Ali Tepelena me disa njerëz të armatosur që kontrolluan shtëpitë dhe rrahën burrat e fshatit. Ndoshta Arianiti ka menduar se Aliu erdhi në fshat për të kërkuar Isakun dhe e ka fshehur në kishë, tha Sara dhe pa nga Mihali. A erdhi Ali Tepelena në

shtëpinë tuaj, e pyeti Metodi. Po, tha Sara. Ai bisedoi gjatë me babanë dhe u largua në të gdhirë. Babai u mbyll në shtëpi dhe pas tri ditësh u nis vetëm dhe më la mua në shtëpinë e Hanës.

Sekreti i Arianitit tani është më i qartë, ngriti zërin Metodi. Ai quhet Isak Komneni. Arianiti ka ikur nga fshati për të shpëtuar të nipin, të cilin e kishte fshehur në kishë. Kur ka ardhur Ali Tepelena, Arianiti ka besuar se qëllimi i tij ka qenë kapja e Isakut. Kanë ikur të dy nga fshati.

Po pse nuk më morën dhe mua me vete, pyeti Sara e mbledhur në karrige si një fëmijë. Udhëtimi i tyre duhet të ketë qenë i vështirë dhe i pasigurt. Rruga kalonte nga Janina, Voskopoja dhe Korça, të cilat kontrolloheshin nga turqit. Arianiti nuk mund të rrezikonte vajzën e vetme në këtë udhëtim, tha Metodi. Edhe unë do kisha bërë të njëjtën gjë, po të kisha një vajzë.

Po pse babai nuk donte që unë ta njihja Isakun, pyeti prapë Sara.

Ti ishe e vogël dhe nuk do ta mbaje dot sekretin e tij, tha Mihal Komneni që ishte ulur në karrige. Ata e kanë shtyrë të vërtetën në kohë, por nuk e kanë fshehur. Nëse do të donin të zhdukeshin pa lënë gjurmë, këta katrorë nuk do ekzistonin. I kanë lënë shenjat të gdhendur mbi gur, të bindur se një ditë ti do t'i zbulojë. Nuk të kanë fshehur gjë, dallëndyshe, por vetëm kanë pritur që të rritesh. Dhe të kuptosh.

Ndoshta jeta ime do ishte ndryshe po ta kisha njohur Isakun, foli Sara me zë të shuar. Babai e dinte këtë, tha Mihal. Ai ka dashur që ti të rritesh në fshat dhe të bësh gjërat që ke bërë. Ka dashur që unë të martohesha me një mysliman, pyeti Sara. Këtë ai nuk mund ta dinte, por po ta kishte mësuar do ta kishte quajtur një fat të pashmangshëm, tha Mihal dhe hodhi sytë nga katrori i madh. Po Isaku çfarë do thoshte po ta dinte se unë jam martuar me një mysliman, pyeti Sara. Mihal u mbështet në karrige dhe ngriti kokën lart sikur po lexonte në tavan. Do thoshte se, që të shpëtosh ishullin, duhet t'u mësosh të huajve notin, i tha Sarës.

Metod Antakidi rrinte në këmbë si një mësues. I bëri një shenjë Sarës dhe ajo u ngrit nga karrigia dhe u afrua te dërrasa e zezë. Pluhuri i shkumësit i mbushi flegrat. Nuk teshtiu, por bashkoi këmbët sikur donte të mbyllte gjithë vrimat e trupit.

Rruga kalon nga Kreta, tha Metod Antrakidi dhe tregoi me gisht katrorin e madh. Sara pohoi me kokë dhe ai vazhdoi. Katrori i madh ka njëzet e pesë katrorë të vegjël. Nëntë katrorët e mesit janë mbushur me numra. Në pesë katrorët e rreshtit të parë horizontal është shkruar Kreta. Mbetën edhe njëmbëdhjetë katrorë për t'u zbuluar, të cilët, meqë lidhen me rreshtin e Kretës, duhet të jenë formuar me fjalë dhe jo me numra. Në kolonën e parë vertikale duhet të jetë shkruar një fjalë, e cila fillon me germën *k*, njëlloj si Kreta sepse ky është rregulli i një katrori magjik. Të gjitha fjalët duhet të lidhen me njëra-tjetrën përmes një germe.

Më thuaj një fjalë që fillon me *k*, tha Metodi. *Koha*, tha Sara. Ka katër germa, foli Metodi. Duhet të ketë pesë. *Kaos*, tha Mihal Komneni që rrinte i ulur në karrige dhe shikonte në tavan. Të thashë që duhet të ketë pesë germa, iu kthye Metodi, por Mihal nuk e kishte mendjen.

*Krahë*, tha Sara. Ndoshta, tha Metodi dhe shkroi një *r*, poshtë *k*-së së Kretës, pastaj një *a* një *h* dhe poshtë saj në katrorin e fundit një *e*. Megjithatë nuk e kuptoj çfarë e lidh Kretën me krahun. Para së gjithash, katrori duhet të jetë logjik që të jetë magjik.

E lidh, tha Sara dhe pa nga Mihal që dukej sikur nuk ishte aty. Mihal thotë se mua më janë rritur krahët dhe duhet të fluturoj si dallëndyshe që të shkoj në Kretë. Metodi vuri buzën në gaz dhe e pa Sarën me dhimbsuri. Në ditën e parë të shkollës gjithë fëmijët tregojnë përralla, i tha. Sara u skuq dhe i mblodhi më fort këmbët. Mihal gjithmonë i ka joshur gratë duke i përshkruar si zogj. Në Voskopoje e quanin zbutësi i zogjve. Arianit Komneni nuk ka qenë një poet melankolik, por burrë kokëfortë dhe racional. Do ishte një çudi sikur jetën e vet ta përshkruante si një letër dashurie. Ky katror magjik është një letër që i drejtohet së bijës dhe jo një gruaje çfarëdo. Nëse arsyetimi im është i drejtë, kjo do të thotë se në këto kuti fshihet një histori e

vërtetë që ai ka dashur të mësohet pa gabime, por saktësisht, deri në detaje, ashtu siç ka ndodhur. Po të ishte ndryshe, do mbetesh i zhgënjyer nga një burrë që e kam adhuruar, duke i njohur të birin dhe të bijën. Megjithatë, le të fluturojmë pak në errësirë dhe të besojmë se Arianiti ka shkuar në Kretë me krahë. Kalojmë në rreshtin e fundit për së gjati, që lidhet me germën e fundit të fjalës, *Kreta*. Duhet të gjejmë një fjalë që fillon me *a*, tha Metodi.

Athos, tha Sara. Mihali thotë se babai mund të jetë nisur në malin Athos për të vdekur aty siç bënin perandorët bizantinë. Mihali ka kërkuar aty, por nuk e ka gjetur. Ndoshta babai ka ndërruar mendje rrugës dhe ka vendosur të vdesë në një vend tjetër. Katrorin e kishte shkruar në vitin 1752, kur u ndërtua kisha dhe në vitin 1769 nuk mund ta ndryshonte më.

Metod Antrakidi uli syzet dhe e pa Sarën me qetësi. Ti e ke njohur Arianitin në pleqëri kur kujtimet e lodhshme, mëkatet e shpirtit dhe dobësia e trupit, e bëjnë çdo njeri të duket si murg. Por jeta e Arianitit ishte një betejë për të gjetur paqe me njerëzit dhe jo me Zotin. Të vdesësh si murg, do të thotë t'i dorëzohesh Zotit, pasi ke dështuar me njerëzit. Por ai ka jetuar si një prijës dhe njerëzit i janë bindur. Ka folur dhe njerëzit e kanë dëgjuar. Ai ka ndërtuar dhe njerëzit kanë punuar. Ka dashuruar dhe e kanë dashuruar. Ka urryer dhe njerëzit e kanë tradhtuar. Ka besuar dhe njerëzit janë lutur. Ka kërkuar dhe Zoti e ka ndihmuar. Arianit Komneni mendonte se Zoti i kishte ngarkuar një mision. Kur iku nga fshati, misioni i tij nuk ishte kryer dhe ai nuk mund të shkante te Zoti e duke kërkuar falje t'i thoshte: Zoti im më fal, unë dështova. Singëriteti i dobët i murgut, është vetëvrasës. Arianit Komneni donte të vdiste, por nuk donte të vriste veten. Një njeri që vret veten nuk lë gjurmë. Atij i mjafton vetëvrasja për të dëshmuar dobësinë dhe dëshpërimin e tij. Nëse ti mendon se babai yt jetoi për të vdekur si murg, do të thotë se zbulimi i të fshehtave të këtij katrori, është një detyrim për t'i provuar vetes të kundërtën. Gjithmonë nëse e kundërta ekziston.

Megjithatë, ne do t'i shkojmë ushtrimit deri në fund, tha Metodi dhe mbushi katrorët e vegjël poshtë germës *a*, me tepricën e fjalës Athos. Ja ku jemi. *Kreta, Krahë, Athos*. Këto tri fjalë mund të bëjnë një magji, por së pari duhet të bëjnë një kuptim. Po të thërrisim për ndihmë poetin e Voskopojës ai do thoshte se Arianit Komneni ka fluturuar për në Kretë dhe kur krahët e thinjur i janë lodhur ka ndaluar në manastirin e malit Athos, ku dhe ka vdekur. Apo jo, pyeti Metod Antrakidi duke folur me vete.

Sara dukej e ngurtë, por e vëmendshme, si një zog që kërkon një pemë për t'u ulur.

Tani na duhet të bashkojmë me një fjalë të vetme germën *e*, të krahut të Arianitit, me germën *s*, të malit Athos, vazhdoi Metodi.

*Eros*, tha Mihal Komneni.

Sa do t'i pëlqente poetit të Voskopojës, u gajas Metod Antrakidi dhe veshët e gjatë iu afruan te buzët. Arianit Komneni fluturon nga Kreta në Athos në kërkim të dashurisë. Po ta kishte shkruar këtë varg, ndoshta myslimanët e Sali Benishit nuk do ta kishin vrarë dhe Aishja do t'i kishte gatuar patëllxhanë me mish të grirë kur ai recitonte lakuriq duke mbajtur një kurorë me lule myshqesh mbi kokë.

Sarës i doli një aromë nga sjetullat dhe hapi pak këmbët.

E përkryer, vazhdoi të fliste Metod Antrakidi që dukej si një magjistar, i cili, duke përzier barëra me shurup dhe sheqer të djegur i ndryshon jetën një njeriu. E çon në luftë, pastaj e plagos, e nis për në shtëpi, e shëron, vendos ta martojë, e ndan, bëhet pishman, pastaj e marton prapë, djeg pak sheqer, e bën me fëmijë, pastaj i hedh bar mbi kokë dhe njeriu nis për të vdekur, por ai e kthen nga rruga dhe e mbyll në një manastir. Magjistari kënaqet kur shikon njeriun që i lutet ta lërë të vdesë, sepse është i lodhur dhe nuk ka më fuqi të jetojë, por ai pret, ndalon, vrojton, tallet

dhe pi pak shurup, ndërsa njeriu vazhdon të lutet, pastaj magjistarit i mbyllen sytë nga pija dhe para se ta zërë gjumi i hedh një grusht bar mbi kokë dhe njeriu vdes nën atë peshë.

E përkryer, tha prapë Metod Antrakidi. Edhe Arianit Komneni nuk do donte një fund më të lavdishëm se ky. Të vdesësh si një murg nga dashuria. Ose të dashurosh si një murg në prag të vdekjes. Ose të fluturosh në krahët e erosit duke u nisur nga Kreta në Athos. Ose të dashurosh në ajër duke fluturuar nga Kreta në Athos. Sikur ta takoja Arianit Komnenin do t'ia kërkoja këtë katror magjik borxh për epitafin tim. Sa do doja të vdisja në një manastir, pasi ta kem kaluar gjithë jetën duke bërë dashuri në ajër. Duhet të jetë një akt fizik që nuk të lodh sepse nuk ka rëndësi. Nuk ka gravitet. Por edhe nëse ka gravitet, njeriu është i qetë sepse e di që do bjerë mbi malin Athos, në pëqi të perëndisë. E përkryer, tha Metod Antrakidi për të tretën herë dhe veshët iu zvogëluan dhe morën përmasën katrorë që kishin zakonisht. E përkryer, por e pamundur, sepse fjala *eros* ka katër germa dhe dashuria që kërkojmë duhet të konsumohet në pesë katrorë.

Sara ishte ende në këmbë dhe faqet i ishin ftohur. Metod Antrakidi po kënaqet duke ecur në kthesat e jetës së babait, mendoi. A nuk kishte thënë Metodi disa herë: Sikur unë të isha në vend të Arianit Komnenit, sikur të jetoja si ai, sikur të kisha një vajzë si ai, sikur të vdisja si ai? Nuk mund të jesh si babai, tha Sara me vete, sepse zgjuarsinë nuk e përdor për të zbuluar botën, por për të gjetur gabimet atyre që e kanë përshkruar atë rrugë. Kjo duket sikur të kënaq, por në të vërtetë të vonon. Vonohesh duke numëruar gabimet e të tjerëve dhe nuk ecën. Jeta jote është e mbushur me vonesat e atyre që kaluan para teje. Nuk mund të jesh si babai, përsëriti Sara, pa zë. Për më tepër, je i shëmtuar.

Metod Antrakidi rrinte në këmbë dhe shikonte Mihalin. Pastaj Sarën. Asnjëri nuk e kishte mendjen. Janë lodhur duke ndjekur babanë, mendoi dhe erdhi keq.

Nuk ka asnjë fjalë që bashkon krahun me Kretën dhe me malin Athos, tha me zë të ulët dhe e fshiu katrorin me një leckë të zhubrosur. Pluhuri i shkumësit u ngrit si re dhe mbeti një copë herë mbi kokat e të treve.

Ti the se në ndryshim nga katrorët magjikë me numra, katrorët e fjalëve mund të shkruhen nga lart-poshtë ose anasjelltas, apo nga e majta në të djathtë, ose anasjelltas, por asnjëherë në të dyja drejtimet njëkohësisht, foli Mihali duke u drejtuar mbi karrige. Po, tha Metodi i përqendruar. Kreta lexohet nga e majta në të djathtë, por jo anasjelltas sepse fjala *aterk* nuk ka asnjë kuptim. E kuptoj, u përgjigj Mihali duke e miratuar. Por kjo nuk do të thotë se fjalët e tjera, në mënyrë që të lidhen me fjalën Kretë, duhet medoemos të respektojnë këtë rregull. Nuk është e detyrueshme, tha Metodi dhe rregulloi syzet për të ndjekur shpejtësinë e buzëve të Mihalit. Dua të them se nëse një fjalë në kolonën e parë shkruhet nga poshtë-lart, magjia e katrorit nuk prishet. Edhe nëse prishet, ekuilibri logjik i fjalëve e kompenson këtë devijim nga rregulli, u përgjigj Metodi. Natyrisht, tha Mihali, ekuilibri i të kundërtave është më i përkryer se ai i të ngjashmeve. Ç' do të thuash, e pyeti Metodi dhe veshët iu ulën poshtë.

Mihali u ngrit në këmbë dhe zgjati shkopin drejt dërrasës së zezë. Trokiti lehtë sikur kërkonte t'i hapej një portë dhe tha: Ta provojmë kolonën e parë me një fjalë tjetër, të shkruar nga poshtë-lart, e cila duhet të mbarojë me germën *k*, në mënyrë që të lidhet me Kretën. Ma thuaj atë fjalë, tha Metodi dhe ngriti shkumësin.

*Isak*, tha Mihali dhe ndjeu një lëvizje ajri që erdhi nga krahët e Sarës, të cilët u hapën sikur do fluturonin. Është me katër germa, tha Metodi. Shkruaje sipas Biblës me dy *a*, u përgjigj menjëherë Mihali Komneni: *Isaak*.

Metod Antrakidi shkroi ngadalë mbi dërrasë dhe u kujdes që dy gerrat *a* të ishin sa më të ngjashme. Magjia funksionin, por logjika mbetet për t'u provuar, tha duke bërë një hap prapa dhe e pa katrorin si një pikturë që mbetet për t'u plotësuar.

Kjo do të thotë se babai dhe Isaku e kanë bërë katrorin bashkë, pyeti Sara.

Njëri ka plotësuar tjetrin, si një punë që e fillon i ati dhe e vazhdon biri, tha Mihali.

Po Naumi tha që babai e ka bërë katrorin në vitin 1752 dhe në atë kohë Arianiti nuk e dinte se Isaku do vinte në fshat në vitin 1769, tha Sara duke marrë frymë thellë sikur sa kishte nxjerrë kokën nga një tunel.

Isak do duhej të ishte emri yt, tha Mihali. Babai më ka thënë se nëna jote priste një djalë që kishte vendosur ta quante Isak, sipas djalit të Abrahamit. Djali nuk u lind kurrë dhe nëna jote vdiq duke të dhënë ty emrin e gruas së Abrahamit. Që do të thotë se Isaku, ishte një premtim i pambajtur i babait.

Po ti pse e quajte djalin Isak, e pyeti Metod Antrakidi. Mihali Komneni uli kokën dhe u mendua një copë herë. Asnjëherë nuk e kam ditur, por tani e kupto se me sa duket ka qenë një destin që unë t'i marr djalin babait tim. Nëna e Sarës e quante babanë Abraham sepse ai gjithë jetën udhëtoi duke kërkuar të zbulonte botën dhe përmes botës veten e tij. Familja e Abrahamit nuk mund të mos kishte një djalë me këtë emër.

Mihali Komneni dukej i përlotur si një plak që lexon fundin mbi dorën e një fëmije.

Nëse ecim sipas këtij arsytimi, mund ta gjejmë Abrahamin, tha Metod Antrakidi. Pra, nëse Arianiti ka shkrua emrin e djalit që nuk u lind dot, atëherë ai duhet ta ketë mbushur katrorin e dashurisë së vet me emrat e tjerë të familjes. Si quhej nëna jote? Sheba, tha Sara. Metodi nguli shkumësin e ashpër në katrorin e fundit të kolonës së pestë për së gjati dhe duke nisur nga poshtë-lart shkroi katër germa: *s*, *h*, *e*, *b*. Germa *a* e Kretës ishte në vend dhe ai nuk kishte nevojë ta shkruante në mënyrë që emri i nënës së Sarës të plotësohej në boshllëk. Fytyra e Mihali Komnenit u ndriçua dhe gjoksi i tij energjik u fry dhe u ngrit mbi katror.

Ka mbetur edhe rreshti i fundit horizontal, tha Metodi duke lëmuar shkumësin me dorë. Po të ishte në vend të Arianit Komnenit, çfarë do shkruaje në këtë rresht, e pyeti Mihali, Metod Antrakidin. Çfarëdo që të shkruajë, ai mbetet njëlloj i shëmtuar, mendoi Sara dhe mblodhi sqetullat e lagura. Metodi pa Sarën sikur donte t'i merrte leje që të sillej si Arianit Komneni, për pak kohë dhe tha: Ky katror i përket Kretës dhe tregon familjen që Arianit Komneni do kishte pasur në atë ishull. Pra, Kreta është familja dhe ai vetë. Sheba është gruaja. Isaku është djali. Mungon vetëm vajza.

Sara u përtyp sikur kishte një lule në gojë.

Emri im ka katër germa, tha me keqardhje si ta kishin nxjerrë nga shtëpia.

Metod Antrakidit i shkëlqyen syzet dhe veshët iu skuqën. Emri yt biblik ka pesë germa dhe është Sarai, që do të thotë princeshë, tha dhe ngriti shkumësin duke e drejtuar te katrori bosh që vinte pas germës *s* të nënës së Sarës. Duke mbushur katrorët nga e djathta në të majtë doli *Sarai* dhe bashkoi Isakun me Shebën.

K	R	E	T	A
A	8	13	6	B
A	7	9	11	E
S	12	5	10	H
I	A	R	A	S

Familja ideale e Arianit Komnenit u bashkua, tha Metod Antrakidi dhe u ul në karrige. Mihali dhe Sara mbetën në këmbë me katrorin magjik në mes.

Sara shikonte numrat dhe iu kujtua dita që babai e la te shtëpia e Hanës. Do e marrësh arkën e vogël, e kishte pyetur ajo. Arianiti e kishte parë me sytë e tij të thellë ku bota dukej më e pastër. Tani nuk më nxë, i kishte thënë. Mbaje ti që kur të më gjesh, të më futësh ty. Po si do të të gjej, i kishte thënë Sara. Ka vetëm një mënyrë për të gjetur diçka, kishte thënë Arianiti. Cila është ajo mënyrë, e kishte pyetur ajo duke ngritur arkën e vogël. Njeriu e gjen një gjë në qoftë se i duhet, kishte thënë babai. Po ti mund të më duhesh më shumë tani dhe jo kur të të gjej, kishte thënë Sara. Arianiti kishte parë mbi kokën e saj, aty ku qielli takohej me tokën dhe bëhej i kuq, sikur plagosej nga ai takim. Sytë e tij kishin marrë ngjyrën e qiellit, ndërsa trupi i ishte zvogëluar sikur bëhej gati për të hyrë në arkën e vogël. Bota po ndryshon, i kishte thënë Sarës. Unë jam i vjetër dhe i ngadaltë. Nëse rri me ty, ti do ecësh me hapin tim dhe do vonohesh. Po pse mendon se do të të gjej, e kishte pyetur ajo. Në qoftë se nuk më gjen, do të thotë se nuk të duhem, kishte thënë ai dhe ishte nisur.

Rruga ishte e shkretë, por bota nuk dukej shumë e pastër se po ndryshonte. Babai kishte të drejtë, mendoi Sara. Tani më duhet më shumë se atëherë.

Ata kanë ikur në Kretë, foli Mihal Komneni që rrinte në këmbë si një kolonë e mbetur jashtë katrorit magjik. Po pse duhet të shkonin në Kretë, pyeti Sara dhe hapi krahët. Njëri për të vdekur, tjetri për të jetuar, tha Mihali që uli kokën e bardhë dhe pyeti: Po ti, kur do fluturosh?

Kur të kem një folje të sigurt për dallëndyshen time të vogël, u përgjigj Sara dhe doli.

Kur arriti në shtëpi, ishte muzg. Plloçat në perëndim të shtëpisë ishin shtuar dhe dukeshin si një lëkurë që zgjatej duke mbuluar një skelet trarësh. Ibrahim i ishte ulur mbi krevat dhe po luante me Anën. Ku ishte, e pyeti. Sara përqafoi Anën dhe i kontrolloi kokën, pastaj barkun, pastaj këmbët dhe krahët që iu dukën më të rritura që kur ajo kishte ikur.

Isha në një botë katrore si ajo e Muhamedit, tha dhe qeshi duke ngritur lart krahët e Anës.

26

Kur Ana mbushi dhjetë vjeç, Metod Antrakidi vdiq. Muajt e fundit ishte dobësuar shumë, veshët i ishin zgjatur dhe rrudhat i kishin hipur mbi syzet e vjetra. Pothuajse nuk hante, por lëvizte buzët i shtrirë në errësirë dhe kur Mihal Komneni i afrohej ai i thoshte me një zë të fikur që mezi dilte nga labirinti i ezofagut të tij: Dedalus, a i mbarove krahët? Mihal Komneni vinte buzën në gaz, por Metod Antrakidi nuk e shihte. Do vdesë shpejt, i thoshte Mihali Sarës.

Sara gatuante gjalpë mëllage që ia sillte çdo mëngjes dhe përpiqej t'ia hidhte në gojë. Metodi nxirrte gjuhën dhe lëpinte gjalpin ngadalë, si një krokodil i dobësuar që ushqehet me jonxhë. Sara i fshinte buzët, ndërsa Ana mbyllte hundët me dorë nga era e fortë e mëllagës. Pse do vdesë, e pyeste vajza, babai më ka thënë se kush ha mëllagë jeton gjatë? Mihal Komneni shihte me qetësi nga Metodi dhe thoshte: Metodi do vdesë sepse vetëm pyet, por nuk e dëgjon përgjigjen. Po ai është mësues, thoshte Ana duke lëvizur flokët e zinj, dhe mësuesit i bëjnë pyetje nxënësve, ndërsa përgjigjet i dinë vetë. Kur mësuesi nuk e dëgjon përgjigjen, mësimi ka mbaruar dhe mësuesi ikën, thoshte Mihali. Po ty çfarë pyetje të ka bërë, vazhdon Ana me dorën mbi hundë.

Mihali shikonte Sarën të përkulur mbi Metodin dhe e nxirrte vajzën në oborr. Uleshin mbi plloça dhe dielli ia shkëlqente flokët të dyve.

Mua më pyet a i kam bërë krahët e Ikarit, i thoshte Anës që nuhaste fort nëse era e mëllagës i kishte ndjekur deri jashtë. Po Ikari zog është, pyeste Ana. Jo, thoshte Mihali, Ikari është një djalë që fluturon. Metodi e di që ai fluturon? E di, thoshte Mihali. Prandaj nuk e dëgjion përgjigjen sepse e di, thoshte Ana. Jo, thoshte Mihali Komneni. Metodi do të dije nëse krahët janë bërë gati për fluturim. Po ti çfarë i the, pyeste Ana Komnena. Unë i thashë që krahët akoma nuk janë gati, thoshte Mihali. Po ti pse nuk i ke bërë gati, e pyeste Ana. Mihali Komneni ngrinte dorën e madhe dhe e vinte mbi kokën e Anës si një çadër në diell. Pse nuk i ke bërë krahët gati, e pyeste prapë Ana duke ia larguar dorën. Po pres të rritet Ikari, përgjigjej Mihali dhe zgjaste kokën brenda shtëpisë, por hija e Sarës nuk dukej në errësirën e mbushur me erë mëllage. Çfarë është Ikari, e pyeste Ana.

Ikari ishte djali i Dedalit, tha Mihali. Kur ishte i ri, Dedali ishte shumë i zgjuar dhe jetonte në Athinë. Që i vogël, ai mësoi të ndërtonte shtëpi të mëdha dhe të bukura, të cilat i vizatonte në letër dhe pastaj punëtorët i ndërtonin. Dedali dëgjonte zogjtë që këndonin dhe bënte vegla muzikore që këndonin si zogj. Ndiqte kuajt që vraponin dhe bënte këpucë për djemtë e rinj të Athinës që ata të rendnin më shpejt. Shikonte peshqit që notonin dhe bënte varka të shpejta që çanin ujin dhe i çonin njerëzit në brigje të reja. Dedali ndërtoi ura të mëdha mbi lumë, çezma që e merrnin ujin nga thellësia e tokës dhe e nxirrnin lart, oxhakë prej balte ku piqej buka dhe ngrohej qumështi dhe duar të gjata dhe të forta prej druri dhe hekuri që i ngrinin gurët e mëdhenj dhe i sillnin nga mali në qytet.

Njëherë, Dedali hipi në anije dhe shkoi në Kretë, në ishullin më të bukur, ku mbretëronte Minosi. Pak kohë më vonë, mbretit Minos i sollën peshqesh një dem shumë të bukur, të bardhë. Njerëzit nuk kishin parë kurrë një dem të bardhë aq të bukur dhe u mblodhën në sheshin e Kretës për ta parë. Demi rrinte drejt dhe i zgjaste brirët e tij të kuq andej nga i thoshin njerëzit, sepse ai ishte një dem i zgjuar dhe i dashur. Gruaja e mbretit Minos, Pasifaja u marros pas demit, të cilin e donte shumë. Ajo e lante, e ushqente dhe e fshinte me peshqir. Por Minosi nuk donte që gruaja e tij të rrinte me demin dhe atëherë gruaja i tha Dedalit që ta ndihmonte. Dedali ndërtoi një lopë shumë të madhe prej druri, të cilën e mbuloi me lëkurë dhe aty u fsheh mbretëresha me demin. Pas disa kohësh, mbretëresha e bukur lindi një fëmijë që ishte gjysmënjeri dhe gjysmëdem dhe njerëzit u habitën dhe u frikësuan. Ky fëmijë u quajt Minotauri dhe kokën e kishte prej demi, ndërsa trupin prej njeriu. Ai ecte si njeri, por sillej si kafshë dhe ushqej me mish. Minosi e mori vesh lindjen e Minotaurit dhe i kërkoi ndihmë Dedalit për ta fshehur. Ky ndërtoi një labirinth shumë të madh nën pallatin e mbretit dhe aty futën Minotaurin. Labirinthi kishte me qindra korridore, të cilat bashkoheshin pastaj ndaheshin, pastaj bashkoheshin prapë dhe dalja e tij nuk mund të gjendej dot më. Minotauri nuk mund të dilte dhe jetonte atje. Për ta ushqyer i fushnin njerëz, të cilët ngatërroheshin dhe Minotauri i gjente dhe i hante. Por njerëzit në Kretë nuk donin që Minotauri të hante fëmijët e tyre dhe ata e morën inat mbretin, i cili u kërkoi athinasve që çdo vit t'i sillnin shtatë djem dhe shtatë vajza, të cilat do t'i hante Minotauri. Athinasit u frikësuan dhe vendosën t'ia dërgojnë Minosit shtatë vajzat dhe shtatë djemtë. Por djali i mbretit të Athinës, Tezeu, i cili ishte rritur duke ngritur shkëmbinj, tha se do shkonte në Kretë të vriste demin dhe të shpëtonte qytetin e tij nga ky dënim i tmerrshëm që i kishte caktuar mbreti Minos. Tezeu shkoi në Kretë dhe Dedali i dha një lëmsh leshi, si ato që mbajnë gratë e fshatit kur thurin triko. Ky hyri në labirinth e vrau Minotaurin dhe pastaj doli duke ndjekur lëmshin që e kishte lëshuar kur kishte hyrë brenda.

I tërbuar nga vrasja e Minotaurit dhe ikja e vajzës, mbreti kërkoi ta vrasë Dedalin që kishte treguar sekretin e labirinthit. Dedali mori djalin e tij, Ikarin, dhe vendosi të largohej nga Kreta. Mirëpo Minosi kishte urdhëruar të gjitha varkat dhe anijet që të mos niseshin nga ishulli derisa ai

të kapte Dedalin. Dedali rrinte në majë të një mali, sepse Kreta ka shumë male dhe shihte dallëndyshtet që fluturonin mbi det dhe zhdukeshin në qiell. Disa dallëndyshe më të mëdha i ndihmonin të vegjlit e tyre që kishin krahë më të shkurtër duke i mbajtur në ajër me sqep kur ato binin. Duke parë dallëndyshtet e lumtura që iknin nga ishulli, Dedali mendoi se e vetmja rrugë për të shpëtuar djalin e tij ishte të bënte si dallëndyshtet. Ai mblodhi puplat që dallëndyshtet lëshonin në tokë, i bashkoi dhe i ngjiti me dyllë. Bëri një palë krahë për vete dhe një palë për Ikarin dhe u nisën. Fluturuan të dy të lumtur mbi det. Era i shtynte krahët e tyre dhe Ikari i vogël qeshte dhe gëzohej duke parë ishujt në det dhe peshkatarët që kapnin peshq. Dedali i tha djalit që të mos fluturonte shumë ulët që stërkalat dhe dallgët e detit të mos ia lagnin krahët dhe jo shumë lart që nxehtësia e diellit të mos e shkrinte dyllin me të cilin ishin ngjitur puplat. Mirëpo, i hutuar nga lartësia Ikari nuk e dëgjoi. Ai fluturoi lart dhe iu afrua diellit. Dylli u shkri nga nxehtësia dhe Ikari ra në det duke thirrur të atin. Baba, baba më shpëto, thërriste Ikari i ngratë duke çarë ajrin si një dallëndyshe e plagosur. Dedali e shikonte të birin e tij të dashur duke rënë, por ai nuk mund të bënte asgjë. Qante duke fluturuar dhe lotët e tij u mbytën në det bashkë me të birin.

Mihal Komneni pa Anën, e cila ishte e ftohtë si dyllë, por nuk qante. Po pse nuk e dëgjoi Ikari babanë, pyeti Ana. Jo gjithmonë fëmijët i dëgjojnë prindërit, tha Mihal Komneni. Kjo është një përrallë, pyeti Ana dhe Mihali pohoi me kokë. Muhamedi më ka thënë se në përralla nuk vdes njeri, pse vdiq atëherë djali i Dedalit?

Mihal Komneni qeshi dhe sytë i lotuan në diellin që ngrihej nga plloçat e oborrit. Përrallat e grekëve të lashtë nuk janë si gjithë përrallat e tjera. Këto janë përralla me perëndi dhe me njerëz. Perënditë sillen si njerëz dhe njerëzit sillen si perëndi. Njerëzit gjithmonë duan të bëjnë si perënditë dhe të provojnë gjëra, të cilat atyre nuk iu lejohen dhe për të cilat ata nuk janë krijuar. Perënditë greke iu japin gjithnjë dënime njerëzve. Dedali humbi djalin sepse donte të fluturonte, Paridi humbi Helenën sepse ia rrëmbeu atë një burri tjetër, Akili humbi pavdekësinë kur besoi se ishte perëndi. Ky është ndëshkimi i perëndive për njerëzit: të marrin atë që do më shumë.

Po ty, si të kanë ndëshkuar perënditë, pyeti Ana. Mua nuk më lënë të shoh djalin tim, tha Mihali dhe fytyra iu ftoh. Po pse ku është djali yt, pyeti Ana.

Në Kretë, tha Mihali, në ishullin e dallëndysheve.

Ana filloi të qeshte, u shtri mbi plloça, mbylli sytë, hapi gojën e vogël dhe me një zë të shuar si Metod Antrakidi tha: Dedalus, a i mbarove krahët? Mihal Komnenit i erdhi një shije mëllage nga stomaku dhe i mbeti në gojë. Akoma jo, tha. Ana nuk lëvizi dhe vazhdoi me zërin e Metodit: Po pse nuk i mbaron? Nuk po gjej pupla dallëndyshesh, tha Mihali. Ana lëvizi pak krahët, por sytë nuk i hapi. Era e mëllagës vërtitej në ajër, por ajo nuk e pa. Kur t'i gjesh puplat mos i ngjit me dyllë se e shkrin dielli dhe djali rrëzohet në det. Mihal Komneni u ngrit dhe iu afrua vajzës që rrinte e shtrirë mbi plloçat që digjin. Unë jam i vjetër, tha Mihali. Edhe po t'i gjej puplat dhe t'i ngjis fort pas trupit, nuk fluturoj dot. Si thua sikur të dërgoj në Kretë një dallëndyshe tjetër?

Ana Komnena i lëvizi prapë krahët dhe u gëlltit për të qeruar zërin.

Si quhet dallëndyshja që do të çosh në Kretë, e pyeti. Mihali ktheu kokën nga dera e shtëpisë, por aty nuk kishte asnjëri. U afrua nga vajza dhe tha: Quhet Sara, është mamaja e Anës që numëron me gishta. Ana u ngrit me vrull dhe me zërin e saj tha: Pse gënjen, unë nuk numëroj me gishta. Kështu më ka thënë Paridi, tha Mihali. Paridi u përjashtua nga shkolla për mungesa, tha Ana dhe rregulloi fustanin e zhubrosur nga plloçat.

Sara kishte dalë te porta dhe po i shikonte të dy. Mama, tha Ana Komnena, Mihali më tha se do të të çojë në Kretë që të marrësh djalin e tij. Sara pa nga Mihali që u ngrit dhe u ul në vendin e tij pranë derës. Po ti si thua të shkoj? Ana pa nga Mihal Komneni që rrinte i menduar. Kreta është në Greqi, apo jo, pyeti Sarën. Po, tha Sara, në Greqi është. Në Greqi ka perëndi të këqija, të cilat



u marrin njerëzve atë që duan më shumë. Po fluturove si Dedali, kam frikë se ato do të më dënojnë mua duke të marrë ty. Kush të tha ty që unë do fluturoj si Dedali, e pyeti Sara. Ana bëri me kokë nga Mihali. Dedali humbi djalin sepse iku nga Kreta, kurse unë do shkoj në Kretë, tha Sara. Do kthehesh prapë, e pyeti Ana Komnena. Do kthehem, tha Sara duke parë Mihalin, që i lëvizi lëkura nën këmishë.

Pas një muaji, Metod Antrakidi nuk e lëpiu më gjalpin e mëllagës. Gjuha iu var në gojë dhe syzet i ranë mbi jastëk. Sytë i kishte të mbyllur, megjithatë Mihali ia mbylli, duke ia kaluar dorën mbi ballë sikur po i largonte jetën nga trupi.

E varrosën në fshat. Djemtë mbanin arkivolin, ndërsa Ibrahimimi dhe Mihali ecnin pas tyre. Kur i hodhën dhe, arkivoli prej druri kërciti dhe një erë mëllage u ngrit lart. Në Voskopojë të vdekurit mbajnë era myshk, tha Mihal Komneni. Në Voskopojë do ta kishin lënë pa varrosur, tha Muhamedi.

Kur u kthyen në shtëpi gjetën Ana Komnenën që luante me një lëmsh të madh leshi që e kishte shpërndarë në të gjitha dhomat dhe në oborrin e madh të shtruar me plloça të reja, ku Sara kishte mbjellë domate, patate, kastravecë, qepë dhe mëllaga. Filli i leshit ishte ngatërruar disa herë rreth arrës së rritur dhe që andej kishte hyrë në shtëpi. Ana ishte shtrirë në krevat dhe shikonte në tavan.

Sara filloi të mblidhte lëmshin nga dhoma në dhomë dhe kur doli në oborr ndjeu se u lodh. U ul në stolin prej dru panje që e kishte bërë Jani dhe që pastaj e kishte lyer në ngjyrë të kuqe. Hija e shtëpisë e mbulonte oborrin. Dy shtëpitë ishin bashkuar nën një çati, si dy natyra brenda trupit të një njeriu. Ato ishin fshehur qetësisht dhe pa kundërshtuar, por të gatshme për të rrëfyer të shkuarën e tyre në çdo gozhdë dhe në çdo gur. Shtëpia është bërë si ty, i kishte thënë Sara Ibrahimit kur Naumi i kishte dorëzuar çelësin në dorë: ti ke dy fe, dy emra dhe dy gra në një trup. Në mes të shtëpisë ishte një dhomë e madhe me oxhak dhe e shtruar me qilima të ndryshëm. Në çati nuk dukeshin më trarët dhe as emrat e djemve që Jani kishte gdhendur në trarin e madh. Mbi portën e rëndë të mbuluar me strehë Andrea kishte shkruar në gur vitin e ndërtimit të shtëpisë: Tetor, 1783.

Në tetë vjet Sara e kishte ndryshuar disa herë oborrin si një amvisë që e ndryshon shijen duke gatuar. Ibrahimimi kishte bërë një furrë të re me kashtë dhe baltë, në të cilën ajo piqte lakror dhe kuleç me ullinj. Muhamedi me Aliun flinin në një dhomë në pjesën e vjetër të shtëpisë. Mbi krevat Aliu kishte varur një bisht lepuri, si trofe fëmijërie, ndërsa toka e rrumbullakët kishte humbur gjatë gjurmimit të themeleve. Bota e vjetër u varros, thoshte Muhamedi. Jani me Paridin kishin rregulluar një dhomë në të cilën varej një pasqyrë e madhe me dru të gdhendur ku Paridi kalonte disa orë të ditës. Fëmijëria kishte mbetur në shtëpinë e vjetër.

Nga dhomat e djemve tani vinte erë burrash dhe këpucët ishin lënë jashtë derës së shtëpisë. Gjurmët e tyre, me baltë varrezash, dukej sikur po hynin në shtëpi dhe Sara u ngrit t'i pastronte e frikësuar. Kur hyri, pa të bijën që mbante hundët me dorë dhe faqet i ishin rudhur nga shtrëngimi. Këtu mban era mëllagë, tha Ana.

27

Ditën që Petro u mbyt, Ibrahimimi u thinj. Mbuloi kokën me duar sikur donte të fshihte plakjen. Djemtë u ulën rreth tij dhe Sara qau duke ndërruar qilimat e shtëpisë. Paridi ishte skuqur, kurse Aliu ishte zbehur. I thashë Petros të mos i besonte kalit të dajë Llambros, tha Muhamedi, por Jani

e pa me neveri dhe ai nuk foli më. Ana luante pa zhurmë me lëmshin e leshit që i ra nga duart dhe ndaloi para këmbëve të Ibrahimit. Ibrahim i u zgjat ta merrte dhe të gjithë u habitën kur ai hoqi duart nga koka.

Koka i dukej si një velenxë.

Pse të janë zbardhur flokët baba, e pyeti Ana. Ibrahim i shtrengoi të bijën fort, i afroi kokën te qafa dhe e puthi. Kam një lëmsh si ky në vend të kokës, i tha Anës. Me një lëmsh si ky mund të gjesh çdo gjë që të ka humbur, i tha Ana. Ibrahim i uli kokën dhe thinjat i zbritën te vetullat. Ka disa gjëra që nuk i gjen dot më, tha dhe u përlot.

Sara mblodhi fillin e leshit dhe e çoi në dhomën e saj. Ana e ndoqi pas.

Do ta vras Ali Pashën, tha Aliu. Ibrahim i ngriti kokën dhe i tha Janit: Gjej Thanasin dhe i thuaj të më sjellë Petron në shtëpi. Nuk vdes pa varrosur djalin.

Jani i bëri shenjë Aliut dhe u nisën.

Në Janinë mbërritën në muzg. Dielli ishte ulur dhe hëna ishte ngritur. Hijet e tyre humbën në rrëmujën e qytetit. Njerëzit vraponin për t'u kthyer në shtëpi. Tregtarët po ngrinin mallrat e pashitura nga tezgat. Pazari ishte shtruar me kalldrëm, por në qytet kishte shumë baltë. Batanijet, basmat dhe pëlhurat që binin në tokë, ata i lanin me ujë liqeni, që t'i shisnin prapë të nesërmen.

Kur Ali Tepelena ishte bërë Pasha i Janinës kishte dalë në pazar për të takuar tregtarët. Shikonte çdo gjë, por pyeste vetëm për çmimin e mëndafsheve, të cilat i zinte me duart e holla dhe i afronte te faqja, sikur donte që ta puthnin. Atë ditë, kishte nisur një rrebesh dhe Pashai ishte bërë qull deri në lëkurë. Mbulojeni këtë pazar, i kishte thënë sejmënëve të tij. Pas dy muajsh, pazari ishte mbuluar me tjegulla të kuqe dhe tani quhej, *kapali carshi* ose pazari i mbuluar.

Njerëzit nuk dilnin natën në Janinë. Ushtarët e Aliut kontrollonin rrugët dhe jevgjit e dehur i rrihnin. Çifutët mbylleshin herët në barakat e vogla pranë liqenit duke mbushur shishka me vaj bimësh për shërimin e ulcerës dhe duke palosur letrat e fallit. Që kur kishin ardhur në Janinë, çifutët ishin marrë vetëm me këto punë. Grekët kishin tavernat e tyre në lagjen varosh ku mblidheshin dhe pinin verë me pastërma. Liqeni ishte i pari që i ishte bindur Ali Pashës. Në dimër mbulohej me akull dhe kalamajtë rrëshqisnin mbi të me slita të vogla. Kur ndrydhnin këmbët, i çonin në lagjen e të krishterëve ku një doktor gjenovez i hutonte me një papagall memec dhe ua kthente kyçet në vend. Në verë, në breg të liqenit, gatë lanin rrobat me sapun dhe i fërkonin në govata të mëdha prej druri. Ali Pasha nuk linte njeri të peshkonte pa lejen e tij. Taksa mbi peshkun ishte e lartë dhe peshkatarët duhej ta paguanin në fillim të çdo viti. Kur ata peshkonin, njerëzit e Aliut rinin në breg dhe numëronin peshqit e vegjël që tundnin bishtin duke fryrë barkun me ajër. Peshkimi natën ishte ndaluar. Hëna ishte e vetmja që mund të zhytej në liqen pa lejen e Pashait, i cili dilte vetë në dritaret e Kastros dhe shikonte ekzekutimet që kishin urdhëruar. Natën, Pashai u thoshte ushtarëve që të ndriçonin vendin me pishtarë që ai të mund të shihte fytyrën e të dënuarit përpara vdekjes. Mbytja në ujë ishte dënimi i preferuar i Ali Tepelenës. Ka ardhur koha për barazi, qeshte Aliu. Njerëzit ushqehen me peshk, por edhe peshqit duhet të ushqehen me njerëz.

Që kur Ibrahim i ishte bërë mysliman, në qytet ishin ngritur katërmbëdhjetë xhami. Minaret e tyre binin mbi liqen, lageshin si koka lejlekësh dhe dilnin prapë duke kënduar pesë herë në ditë. Të krishterët sillnin mall nga gjithë bota dhe myslimanët e shisnin me tezgat në pazar. Në Janinë kishte shumë dervishë bektashinj. Ali Tepelena nuk shkonte në xhami dhe shqiptarëve të krishterë u kërkonte të bëheshin bektashinj. Për bajram ai shpinte qengja në xhami dhe para në teqe. Kur lodhej, shtrihej në një divan të gjatë, pinte duhan me nargjile dhe thërriste dervishët që

i flisnin për parajsën derisa atë e zinte gjumi. Dervishët mbushnin xhepat me duhan të shtrenjtë trëndafili dhe iknin kur Pashai fillonte të gërhiste.

Grekët e Janinës e kishin frikë Aliun. Kur ai kishte ardhur në qytet, shumë prej tyre kishin ikur. Por Aliu nuk i linte më grekët të largoheshin sepse paratë e tyre ishin burimi kryesor i pasurisë së tij. Kush donte të ikte nga qyteti duhej të linte një djalë apo një vajzë peng, në mënyrë që Pashai të ishte i bindur se ata do të ktheheshin. Taksat e mallrave ishin rritur dhjetë herë që kur ai ishte bërë Pasha.

Aliu i kishte qejf paratë. Kur nuk e zinte gjumi, zbriste në qilar dhe kalonte nëpër duar qeskat me monedha të arta. Çelësat e qilarit i mbante në brez dhe flinte duke ëndërruar male me florinj. Aliu besonte se në malet përreth Janinës kishte ar dhe argjend. Ai thirri disa gërmues nga Italia, të cilët erdhën në Janinë të pajisur me shufra të gjata, me syze të trasha, me dorëza dhe me thupra magjike, të cilat ia afronin shkëmbinjve apo i zhysnin në përrrenjtë malore. Ata morën me dhjetëra fshatarë që me urdhër të pashait i detyronin të hapnin gropa të thella në formë pusi, nga të cilat shpesh shpërthenin burime ujërash që i mbysnin gërmuesit. Fjala u hap shumë dhe për disa kohë kodrat dhe malet e pashallëkut u mbushën me evropianë që kontrollonin gërxhet, grykat dhe shpellat për të gjetur ar. Ali Tepelena i paguante të gjithë, por njëherë, kur i pa që pinin në një tavernë, u mërzit, durimi i shteroi dhe i përzuri që të nesërmen me ushtarë.

Gjatë verës, kur përrrenjtë zbuteshin, ai ndërtonte ura prej guri, rrugë për fshatrat e shumta të pashallëkut dhe kala me mure të trashë dhe bodrume që i mbushte me barut. Në të dalë të qytetit, ai kishte ngritur një harem me dhoma të vogla ku gratë qëndisnin dhe zbukuroheshin me bojëra dhe parfume duke pritur Pashain. Dhomat e haremit ishin plot me divane dhe jastëkë mëndafshi, ndërsa dyshemeja prej mermeri i ngjante një pylli pranveror ku kafshë dhe zogj me pupla lëpinin këmbët e zbathura të grave. Në korridoret e haremit vendoseshin shporta me fiq, me rrush, me hurma dhe me pjeshkë për të ëmbëlsuar gojë të grave dhe të miqve të Pashait. Aliu organizonte aty gosti të mëdha ku ftonte tregtarë, poetë apo ushtarakë që vinin nga të gjitha viset e botës për ta takuar. Në harem kishte edhe një ndarje për djem të vegjël. Aty nuk hynte askush. Djemtë rinin në dritare si papagaj të vetmuar dhe e hapnin gojën sa herë shfaqej Pashai, i cili mendonte se duke fjetur me djem do jetonte më gjatë. Këtë ia kishte thënë njëherë një dervish që i kishte parë në filxhanin e kafesë një vijë të gjatë dhe të hollë që hynte në një bark dhe dilte prapë për t'u zgjatur deri te buza e filxhanit. Kur dervishi vdiq, Aliu qau dhe i ngriti atij një varr të bukur afër liqenit. Ali Pashai ishte i bindur se do jetonte njëqind e pesëdhjetë vjet dhe se deri atëherë sulltanët e Stambollit do ishin rrëzuar dhe ai do ngrinte një kala në Korfuz ku do të priste mbretërit e Evropës bashkë me gratë e tyre. Nuk ka perandori pa ishuj, i thoshte miqve të tij. Unë dua një ishull ku të qeveris si mysliman dhe të jetoj si i krishterë.

Ali Tepelena mbante shumë kuaj. Stallierët ishin grekë, ndërsa kuajt arabë. Një herë në vit në Janinë bëheshin gara me kuaj dhe ai rrinte në një kolltuk të gjerë dhe ndiqte kalorësit që i kapnin kafshët me thonj nga flokët. Fshatarët, e stërvitur me fustanella të shkurtra dhe këmbë të holla, vinin atë ditë në qytet, pasi i ushqenin kuajt për një muaj me tagji të mirë, dhe kush fitonte afrohej te pashai për të marrë si trofe një pisqollë argjendi apo një palë tespihe me rubin të kuq. Kalin që fitonte, Aliu e blinte dhe stallierët ia ndërronin potkonjtë. Kuajt e garave që shëndosheshin ose plakeshin ia jepnin ushtrisë.

Shqiptarët ishin ushtarët më të mirë të Aliut, por dhe më të egrit. Ata dinin të luftonin mirë me shpata, ndërsa pisqollat i mësonin me vështirësi. Nëpër trungje pemësh oficerët varnin kuti të mbushura me kashtë dhe i mësonin shqiptarëve të qëllonin. Aliu nuk i linte ushtarët të pinin dhe pisqollat e karabinat mbaheshin të mbyllura në bodrumet e Kastros. Kur Ali Pasha bleu një top me tytë të gjatë, ushtarët e pastruan dhe e nxorën në sheshin përpara kalasë. Hija e tytës zgjatej

mbi liqen dhe kalonte deri në bregun tjetër ku ishin shtëpitë e çiftutëve. Burrat e Janinës u mblodhën për të parë topin, ndërsa fëmijët matnin me pëllëmbë gjatësinë e tij. Pashai kishte thirrur një kolonel anglez nga Korfuzi, për t'i mësuar ushtarëve mbushjen dhe zbrazjen e topit. Koloneli ishte një burrë i shkurtër, me bark të madh dhe me flokë të zinj kaçurrelë. Ai mbante një palë çizme të kuqe në të cilat kishte futur pantallonat e bardha që i rrinin të ngushta. Anglezi u tha ushtarëve të Pashait të ngrinin një tendë rreth pesëqind këmbë larg topit dhe filloi të rregullonte tytën, të cilën e pastroi me një leckë të kapur në një shkop me nyje. Pastaj nxori një shishe me vaj të verdhë e derdhi brenda dhe e fshiu prapë me leckë. Kur ushtarët e vendosën tendën aty ku duhej, Aliu bashkë me vezirin, disa tregtarë grekë dhe oficerët e tij shqiptarë dolën në bedenat e Kastros për të parë qitjen. Ali Pasha kishte ftuar edhe peshkopin e qytetit dhe disa dervishë të shëndoshë dhe të zhurmshëm. Kur anglezi filloi të mbushte topin me predha, pashai ngriti dorën në ajër dhe të gjithë heshtën. Predha e parë ra disa hapa larg tendës dhe zhurma e saj bëri dallgë mbi liqen. Ky top nuk të vret, por të shurdhon, tha njëri nga dervishët dhe Aliu filloi të qeshte. Anglezi nga Korfuzi e lëvizi shumë pak topin dhe u shtri mbi tytë duke parë tendën me kujdes. Barku i tij i madh u palos dhe këmbët e shkurtra dukeshin si degë të thyera mbi trungun e armës. Predha e dytë ra mu në mes të tendës, e cila u gris, u rrëzua dhe pastaj u dogj. Peshkopi duartrokiti i pari, ndërsa dervishët mbyllën veshët me duar. Atë natë Aliu e çoi anglezin në harem dhe i tha të zgjidhte kë të donte nga gratë e tij. Por anglezi mori një tas me fiq të bardhë, pastaj piu verë, hëngri prapë fiq, piu nargjile dhe e zuri gjumi. Kur u zgjua në mëngjes, takoi Aliun dhe i tha se nuk e dinte që fiqtë e Janinës të vinin në gjumë. Fiqtë e grave nuk ka nevojë t'i qërosh, i tha Aliu dhe i fali një shpatë me gurë të çmuar. Disa muaj pasi iku anglezi, ushtarët e Aliut e lyejnë vetë grykën e topit me të cilin filluan të qëllonin edhe në fund të muajit të ramazanit, por edhe për bajram. Peshkopi i kërkoi Ali Pashait ta përdorte topin edhe të dielën e pashkës, por Aliu, duke qeshur, i tha se topin nuk e kishte blerë për të thyer vezët.

Kur vendosi të pushtonte Sulin, Ali Pasha kishte një duzinë me topa, të cilëve ushtarët e tij u kishin vënë emra. Topit më të madh, që kishte një grykë të fryrë, si një fuçi hekuri, ata e kishin quajtur Sulltani, ndërsa një tjetër, gryka e të cilit zgjatej si një përkëdhelje e quanin Harem dhe kur nuk ndizej, gjë që ndodhte shpesh për shkak të lagështisë apo shiut, e thërrisnin Haram. Topin e parë që kishte ardhur në Janinë e quajtën Barku i Anglezit sepse nga pesha ai ishte varur dhe dukej sikur do prekte tokën. Topi më i bukur dhe më elegant dhe që e hidhte predhën drejt, pa bërë harqe të panevojshme, u quajt Tepelenasi, për nder të Pashait. Por kishte edhe topa të tjerë me madhësi të ndryshme të cilët u pagëzuan Gjyrokastri, Korfuzi, Meka ose I vaisuri dhe të cilin grekët e Janinës e nderonin më shumë dhe në gjuhën e tyre e thërrisnin *O Kristos*. Kur topat dilnin në mëngjes nga depoja ku mbaheshin, ashtu të përgjumur e të pavajisur, ngjanin me një klasë djemsh që vihen në rresht për të larë fytyrën.

Krahina e Sulit ishte disa orë larg Janinës dhe formohej nga aleanca e trembëdhjetë fshatrave që fshiheshin në gryka të thella malesh, të cilat shikonin nga deti. Në dimër rrugët bllokoheshin nga ngricat dhe ortekët, ndërsa në verë burrat zbrisnin në fushë dhe u merrnin bagëtitë dhe ushqimet fshatarëve të varfër. Suljotët nuk kishin fusha dhe ishin të varfër. Fëmijët e tyre rriteshin me përralla në të cilat stërgjyshërit e tyre fitonin çdo luftë me turqit, ndërsa pjesën tjetër të kohës e kalonin duke gjuajtur detin me gurë. Dita në Sul mbaronte shpejt dhe nata ishte e gjatë. Turqit nuk ishin ngjitur dot në malet e tyre të thikta dhe të gjithë suljotët kishin mbetur të krishterë. Ata nuk pranonin të bëheshin pjesë e Pashallëkut të Ali Pashës dhe nuk paguanin asnjë taksë. Luftëtarët suljotë e urrenin Ali Pashën, të cilin e quanin një hajdut mysliman.

Përpara se të niste sulmin, Aliu vendosi t'u dërgonte atyre një letër, në të cilën u kërkonte ta ndihmonin për të sulmuar Gjyrokastren. Letrën e shkroi greqisht dhe ua dërgoi dy komandantëve

kryesorë Jorgo Boçarit dhe Llambro Xhavellës. Boçarët dhe Xhavellat ishin fiset më të mëdha të Sulit, por shpesh grindeshin për komandën e ushtrisë. Vitet e fundit, Xhavellat kishin marrë më shumë mbështetje nga trembëdhjetë fshatrat dhe Boçarët shfrynin duke pritur ditë më të mira. Ali Pasha e dinte se nëse do t'i drejtohej njërit, fisi tjetër do inatosej duke e prishur paktin dhe prandaj vendosi që letrën t'ua dërgonte të dyve. Kur letra mbërriti në fshat, suljotët u mblodhën dhe e lexuan në kuvendin e burrave. Ali Pashën nuk e donin, por kishin nevojë për para dhe vendosën të dërgojnë në Janinë shtatëdhjetë burra me në krye Llambro Xhavellën. Të tjerët mbetën në male duke pasur frikë nga ndonjë hile e Ali Pashës. Kur u nisën, gratë dhe fëmijët u ngjitën në majë të një kodre dhe panë karvanin e burrave që zbriste poshtë në fushë. Në krye ecte Llambro Xhavella i shëndoshë dhe qimekuq, mbi kalin e tij të bardhë dhe pas tij vinte i biri, Foto Xhavella dhe Petro, djali i Ibrahimit.

Të dy mbanin këmisha të bardha, të gjata, që e ëma e Fotos i kishte qëndisur te mëngët e hapura. Rruga ishte e shkretë dhe ata ndalonin buzë përrenjve për t'u freskuar dhe për t'u dhënë ujë kafshëve të etura. Kur mbërritën në Janinë qyteti digjej nga zhegu. Balta ishte tharë dhe pluhuri u ngrit lart deri te veshët e kuajve. Një oficer i Pashait i çoi te kazermat dhe ata u shtrinë nëpër hije dhe kërkuan bukë. Nuk ua kërkoi njeri t'i dorëzonin armët dhe fjetën duke i mbajtur poshtë kokës. Në Janinë vera ishte e lagësht dhe ata nuk i zuri gjumi duke djersitur si kuaj.

Të nesërmen, Ali Pasha e priti Llambro Xhavellën në Kastro. Ishte ulur në një divan të mbuluar me kadife dhe në dorë tundte një palë tespihe me gurë jeshilë. Afër tij gurgullonte një nargjile e vizatuar me germa arabe, ndërsa te papuçet e Ali Pashës shtrihej një mace e përgjumur. Nuk lëviz dot se zgjohet macja, tha Ali Pasha dhe i bëri shenjë të ulej, por Llambro Xhavella qëndroi në këmbë. Në fshatin tim macet flenë me gratë, i tha pashait që vuri buzën në gaz dhe fërkoj dorën e hollë mbi kadife. Lëkura iu vesh me mornica dhe papuçja iu zvogëlua në këmbën e vogël. Të kam thirrur për të kapur njerëz dhe jo mace, tha pashai dhe qeshi fort me batutën e vet. Kur i sollën duhan, Llambro Xhavella i mori erë dhe fytyra iu zbut. Ali Pasha filloi të fliste ngadalë dhe sytë e kaltër i rriteshin sa herë që Llambro Xhavella thithte çibukun e tij të shkurtër. I rrëfeu për ushtrinë e tij, për marrëdhëniet me Portën e Lartë, për planet që kishte për të sulmuar Gjirokastrën, Pargën dhe pastaj edhe Korfuzin. Nuk dua luftë me Sulin, i tha në fund. Ju jeni burra të fortë dhe ne kemi një armik të përbashkët, turqit. Kur ata të ikin unë do qeveris dhe Suli nuk do paguajë asnjë taksë. Do ju jap armë për të luftuar dhe në Sul do ngre fortesa, rrugë dhe ura. Llambro Xhavella e dëgjonte dhe kur ai mbaroi i tha: Kur do t'i biem Gjirokastrës? Shumë shpejt, tha Pashai, për disa javë jemi gati.

Llambro Xhavella u kthye vonë në kazermë dhe i gjeti burrat në gjumë. Vetëm Foto dhe Petro e prisnin zgjuar. Ata kishin dëgjuar shumë për Ali Tepelenën dhe e pyetën Llambro me një gojë: Si t'u duk Aliu?

Llambro Xhavella që përtypte duhan me dhëmbë i pa djemtë në errësirë dhe tha: Si një tigër që silllet si mace. Po Thanasin e takove, e pyeti Petro. Më mirë që nuk e pashë se do ta kisha rrahur, tha Llambro Xhavella dhe fjeti duke gërhitur si një hinkë e mbushur me oriz.

Pas dy ditësh Thanasi erdhi në kazermë dhe takoi Petron. Nuk ishin parë që kur kishin varrosur nënën e tyre. Thanasi ishte bërë një burrë i fortë me mustaqe dhe me flokë të gjata, por të drejta. Ngado e nderonin dhe pisqolla e tij ishte me dorezë fildishi që shkëlqente. Petro ishte më i gjatë dhe jeta në mal ia kishte rritur shpatullat. Rrobat e tij ishin më të vjetra se të Thanasit dhe sytë i mbyllte shpesh, si një njeri që mbrohet nga era. Thanasi i tha Petros ta linte armën në kazermë dhe e mori me vete në qytet. Ecnin të dy nëpër kalldrëme dhe hapat e tyre linin gjurmë në pluhur. Thanasi i tregoi liqenin, pazarin, Kastron dhe shtëpitë e çifutëve. Petro shikonte burrat që shisnin duke bërëtitur dhe gratë e pambuluara të grekëve që ktheheshin në shtëpi duke djersirë nën

sqetulla. Petro pa një shtëpi të bardhë të lyster me gëlqere, të rrumbullakët si një kusi dhe që ndryshe nga gjithë shtëpitë e tjera kishte një oxhak të hollë dhe shumë të gjatë nga i cili nuk dilte tym. Është xhami, i tha Thanasi. Në një xhami më të vogël se kjo, në anën tjetër të qytetit, babai u bë mysliman.

Janina kishte shumë lypës. Ata i afroreshin Thanasit, të cilin dukej se e njihnin, por ai i shante dhe ata largoheshin me dorën e zgjatur. Në sheshin përpara Kastros qëndronin disa roja, të cilët lëviznin duke parë me bisht të syrit nga dritaret e kështjellës nga ku, me sa duket, dikush i vëzhgonte. Ata i mbanin karabinat mbi sup dhe mustaqet i kishin njëlluj të holla, sikur i prisnin tek i njëjti berber. Po ti si këta je, e pyeti Petro. Thanasi qeshi dhe duke vazhduar të ecte tha: Këta rrinë në diell, kurse unë jam hija e Aliut.

Në mes të oborrit të Kastros ngrihej një top i mbështetur në dy rrota dhe poshtë tij ishte një kuti druri e mbushur me predha. Gryka e tij ishte e shkurtër dhe e hollë. Është Foleja e Dallëndyshe, tha Thanasi dhe u afrua te topi. Aliu ka një kazermë plot me topa. Disa i ka rrëmbyer në beteja, por shumicën ia ka blerë turqve dhe anglezëve. Topat kanë emra të ndryshëm. Ky u quajt Foleja e Dallëndyshe sepse kur donin ta provonin, një dallëndyshe që ishte fshehur brenda tytës u ngrit në ajër dhe fluturoi, por pasi bëri disa rrotullime u fut prapë atje dhe rrinte e ulur në bisht, e frikësuar. Ushtarët e lëvizën topin që ajo të ikte, por dallëndyshja nuk dilte. Atëherë futën një shkop për ta trembur dhe dallëndyshja doli, por u kthye prapë dhe u përpoq të hynte, por ushtarët e penguan duke rrahur ajrin me shkop. E drejtuan topin, futën predhën dhe u bënë gati të qëllonin. Dallëndyshja rrotullohej bashkë me topin dhe filloi të kafshonte ajrin duke fishkëllyer si një sharrë e prishur. Kur topi u shkreh, bashkë me predhën, ra në tokë një fole e shkalafitur, kashta dhe puplat e së cilës u endën në ajër për disa minuta. Copat e folesë u shpërndanë gjithandej në oborrin e kazermës dhe ushtarët që i mblodhën thanë se ato ishin përzier me vezë dallëndysheje, të cilat, nga shpërthimi, ishin bërë si një reçel që të ngjiste duart. Dallëndyshja ulërinte duke u sjellë përreth topit të nxehtë dhe i merrte erë ajrit. Kur ia thanë këtë histori, Ali Pasha vendosi ta mbajë topin në oborrin e Kastros dhe i tha topçinjve të tij: Na duhet një fole zogjsh se e kemi mbushur kështjellën me kafshë. Petro pa topin, por tyta e tij ishte e ftohtë dhe e heshtur si një bark beronje.

Në një cep të oborrit të shtruar me gurë të dendur ishte një karrocë e mbuluar që shkëlqente në diell. Ajo qëndronte mbi dy rrota të mëdha elegante dhe dy kuajt të lartë biondë, që ishin lidhur pas saj, prisnin me kokën ulur. Është karroca e Pashait, tha Thanasi. E ka blerë në Francë. Në Janinë, përveç tij, askush nuk ka të drejtë të dalë me karrocë. Njëherë, një tregtar i pasur grek, të cilit i ishin fryrë këmbët dhe nuk ecte dot, iu lut Pashait të blinte një karrocë që të mund të dilte në qytet. Nuk më more leje kur u sëmure, iu përgjigj Aliu dhe e dëboi plakun që dy shërbëtorë e ngritën në krahë. Po ti ke hipur në karrocë, e pyeti Petro. Thanasi uli kokën dhe rregulloi brezin e kuq të pisqollës. Karroca është e vogël dhe nuk ka vend për hije, tha.

Gënjen Akuym e pyeti Petro. Ç'do të thuash, i tha Thanasi. Petro bëri disa hapa dhe ndaloi. Dajë Llambro ka frikë se Aliu po na gënjen. Na ka thirrur për të sulmuar Gjirokastrën, por daja beson se ai kërkon të sulmojë Sulin dhe duke na joshur me premtime dhe para do të na kapë në befasi. Sido që të ndodhë, do përpiqem të të shpëtoj, tha Thanasi dhe eci përpara duke fshehur sytë. Hija e tij u zvarrit në kalldrëmin e Kastros dhe u fsheh në karrocë. Kuajt lëvizën, por nuk u nisën.

Kur Thanasi i tregoi haremin Petro u ndez. Nuk hynë brenda, por ecën deri te dritaret e vogla të mbuluara me pjergull ku vajzat afroreshin sa herë që ndienin erë burrash në oborr. Ato i kishin sytë e lyster dhe flokët e lëshuar dhe të shndritshëm. Në mes të oborrit të haremit ishte një shatërvan i kuq, ndërsa uji dilte nga një çezmë në formën e një femre me gjinj të zhveshur. Ajo

shihte vizitorët dhe dukej sikur i thoshte: Shuani etjen para se të vdisni. Haremi ishte një godinë me dy kate dhe me shumë ndarje, të cilat duhej të ishin dhoma. Dritaret ishin me kangjella dhe gratë dukeshin si zogj të mbyllur në kafaza. Në fund të haremit ishte dhe një pjesë me dritare më të vogla të veshura me kortinka jeshile. Ajo është pjesa e djemve, tha Thanasi, që dukej i skuqur. Petro kapërceu pështymën. Ti ke qenë atje, e pyeti. Thanasi u afrua te shatërvani, futi dorën në ujë dhe lagu qafën. Sytë e tij ishin rritur dhe shikonin me ëmbëlsi në drejtim të haremit. Kur ika nga fshati, isha një djalë i njomë dhe flija staneve bashkë me Aliun. Në dimër ishte ftohtë, por në verë lëkura të mbushej me kripë bulmeti. Ndërsa në harem është shumë fresk. Djemtë lyhen me parfum pjeshke dhe nuk mbajnë era djathë i thartuar si bagëtitë e staneve. E megjithatë aty nuk ka ditë, por vetëm net të gjata dhe të lodhshme, tha Thanasi duke parë nga dritaret me kortinka jeshile.

Në mbrëmje shkuan në tavernë. Merimangat vareshin nga trarët e thatë, ndërsa në muret me gëlqere ishin ngulur vargje me speca djegës dhe më tutje hudhra të verdha që ishin thurur si gërshet gruaje. Në një cep, varej një pikturë që tregonte liqenin dhe një djalë që bëhej gati të lahej duke parë ujin me frikë. Djali ishte i shkurtër, por fytyra e tij ishte e regjur si e një burri që mendohet. Bedenat e Kastros ishin të holla, ndërsa barakat e çifutëve ishin bërë me dy kate. Piktura ishte vizatuar me karbon dhe dielli dukej si një predhë e zezë, gati për të rënë mbi qytet. Petro shikonte pikturën dhe Thanasit iu duk sikur ai po mendohej, ashtu si djali me fytyrë burri. po ta vizatoja unë, do bëja një kalë në breg, që djalit t'i dilte frika, tha Petro. Thanasi buzëqeshi dhe thirri kamerierin.

Taverna ishte e zhurmshme dhe pis. Aty kishte shumë grekë që pinin verë recine që mbante era rrëshirë dhe përtypnin një pastërma të djegur që ua bënte buzët të zeza. Ata morën specat të skuqur me gjizë, qofte me erëza, patate të pjekura dhe uzo. Grekët pinin dhe flisin me zë të lartë. Kamerieri, që kishte lidhur kokën me shami, vraponte në mes tavolinave dhe grekët e ngacmonin duke i pickuar të ndenjurat. Djali kërcente dhe llastohej duke lëvizur belin pastaj futej në kuzhinë dhe kthehej me pjata të tjera.

Në një tavolinë rrinte një burrë i veshur me kostum të zi, me këpucë të drejta me taka të larta dhe këmbë të bardhë në të cilën kishte lidhur një shall të kuq të gufuar me pika të arta. Herë pas here nxirrte një qostek dhe e shikonte. Të gjithë e njihnin sepse kur ai hyri grekët pushuan dhe filluan të flasin me zë të ulët. Burri ishte i gjatë, me një hundë të drejtë dhe flokët i kishte të krehura me kujdes. Porositi verë dhe peshk të fërguar me vezë. Hante duke qeruar ngadalë halat dhe herë pas here fiksohej mbi pjatë sikur zbulonte ndonjë organ të panjohur në trupin e peshkut. Ky është Tozoni, mjeku i Aliut, tha Thanasi. Nga se vuan Aliu, e pyeti Petro. Pak nga të gjitha, reumatizëm, dhimbje koke, shkurtim kockash, ujë në mushkëri, ngushtim zemre, marrje mendsh, kruarje, lemezë dhe majasëll. Më shumë se çdo gjë ka frikë kolerën dhe mban shumë mace në Kastro se Tozoni thotë që minjtë e sjellin kolerën nga kanalet. Ka frikë, e pyeti Petro duke fshirë gjizën me bukë. Ai thotë se nuk vdes njeriu as nga lemza dhe as nga majasëlli. Është i bindur që do jetojë njëqind e pesëdhjetë vjet, tha Thanasi duke qeshur. Po ky si e shëron, pyeti Petro duke parë Tozonin që kishte mbaruar peshkun. Thanasi u ngrys dhe uli kokën mbi pjatë. Tozoni është italian, foli Thanasi. Ai ka udhëtuar shumë në Turqi, Egjipt, Maltë, More. Këtu erdhi nga Korfuzi. Njëherë e rrëmbyen piratët në Egjipt dhe e mbajtën tre vjet në anije sepse ai dinte të ndalonte rënien e dhëmbëve. Kur erdhi në Janinë u dashurua me një greke dhe mbeti. Mori një shtëpi të vjetër e rregulloi me mobilie italiane, mbolli limona në oborr dhe filloi të punonte për Aliun që e shëroi nga reumatizma. Di shumë gjuhë dhe i përkthen Pashait kur vijnë francezë, italianë ose anglezë. Tozoni është i vetmi që e pa Eminenë, gruan e Aliut, kur vdiq. Ai e di se çfarë ka thënë ajo duke dhënë shpirt. Disa thonë se e vrau Aliu me pisqollë, por disa të tjerë

thonë se ajo u çmend dhe vdiq nga frika. Aliu e ka detyruar Tozonin të mos flasë për vdekjen e Eminesë dhe që ai të mos largohet nga Janina ia ka marrë gruan dhe ia ka mbyllur në harem. Një herë në muaj Tozonin e lënë të takojë gruan në një dhomë të veçantë ku ai kalon gjithë natën dhe në mëngjes ikën duke qarë. Sonte duhet të jetë nata e gruas sepse ai gjithë kohën kontrollon orë. Petro e pa Tozonin me keqardhje edhe Thanasi filloi të qeshte. Pas pak Tozoni pagoi dhe doli nga taverna. Grekët u bënë prapë të zhurmshëm ndërsa kamerieri, që ata e thërrisnin Ganimed, tundej duke shërbyer.

Kur dolën jashtë, hëna po lahej mbi liqen. Ata ecën në drejtim të kazermës duke i kthyer kurrizin liqenit. Ke qenë në fshat, pyeti Petro. Jo, u përgjigj Thanasi. Babai ka bërë një shtëpi të madhe me shumë dhoma. Ka një dhomë edhe për ne të dy. Petro ktheu kokën nga perëndimi, andej nga duhej të ishte fshati dhe hëna i ndriçoi ballin. Po shkove përpara meje mos e zër krevatin që sheh nga deti, i tha Thanasi dhe u fut në kazermë. Para se të flinte iu kujtua peshku me hala i Tozonit dhe u kollit që të mos mbytej.

Dy javë më vonë, një oficer i Ali Pashës erdhi në kazermë dhe takoi Llambro Xhavellën. Biseduan shumë pak në këmbë dhe Llambro hyri brenda dhe u tha burrave: Nisemi në të gdhirë. Bëhuni gati. Do t'i biem Gjirokastrës.

Shtatëdhjetë burrat u ngritën dhe filluan të pastrojnë armët. Kur hëna u shua, ata dolën nga kazerma. Në të dalë të Janinës i prisnin pesëqind ushtarë të Aliut, të gjithë të armatosur. Ali Pashë Tepelena nuk ishte, ndërsa Thanasi me një këmishë të kaltër rrinte në rreshtin e dytë, i hipur mbi kalë. Llambro Xhavella takoi oficerin dhe u tha shokëve të tij të ndiqnin kolonën. Dielli digjte dhe kuajt nxirrnin shkumë. Zalli i lumit të tharë anës rrugës zbardhte nga etja. Në mbrëmje, dolën dhe gryka e malit dhe fusha e zezë u hap përpara tyre si vello e vejushës. Nata ishte e pastër dhe nga larg dukeshin dritat e Gjirokastrës që fluturonin si xixëllonja mbi një shkëmb. Kolona ndaloi dhe oficeri thirri Llambro Xhavellën. Petro i pa duke biseduar në errësirë, ndërsa dhëmbët e mëdhenj të Llambros iu afruan fytyrës së oficerit. Thanasi ishte disa hapa më tutje duke dëgjuar në heshtje. Kur u ndanë, oficeri takoi Thanasin dhe të dy hynë në mes të ushtarëve që i kishin zbritur kuajve për t'u çlodhur. Qafiri më tha se do t'i biem nga një rrugë tjetër për t'i dalë Gjirokastrës nga prapa, tha Llambro Xhavella duke kapur kalin e tij fort nga kapistallet. Qimet e kuqe i ishin ngritur dhe mjekra i dridhej. Thotë se na kanë pikasur dhe nga fusha nuk mund të afrohem në qytet sepse na kanë zënë pritë më tutje. Duhet t'i dalim nga bregu, të hyjmë në luginë dhe t'i ngjitemi malit për t'i kapur në befasi. Edhe tri ditë rrugë, tha Foto Xhavella dhe i zbriti kalit. Llambro nuk foli, por lëshoi kalin dhe u ul në bar. Atë natë mbetën atje. Ushtarët nxorën bukë nga trastat, por oficeri i tha të mos ndiznin zjarr. Pa dalë dielli, u nisën. Rruga ngjitej në një mal të thatë dhe të djegur, i cili gjarpëronte duke iu shmangur një përroi të mbushur me gurë të mëdhenj që binin aty gjatë dimrit. Ecën gjithë ditën duke ndaluar shumë pak dhe fjetën vetëm në mbrëmje, në një livadh të verdhë dhe të lagur nga vesa. Të nesërmen panë detin. Më duket sikur jemi në Sul, i tha Foto Xhavella Petros që kishte ndaluar dhe shikonte bregun nga maja e kodrës. Kali hapte hojëzat sikur thithte kripën e detit, ndërsa Llambro Xhavella ecte përpara. Nga Suli, deti duket më i pastër, tha Petro dhe vazhdoi rrugën. Disa ushtarë të Ali Pashës kishin mbetur prapa dhe po ecnin pas kurrizit të tyre. Thanasi bashkë me oficerin ishin në krye. Në drekë ndaluan afër një fshati, por nuk hynë brenda. Gjetën një burim, u freskuan dhe i vunë kuajt të pinë me radhë. Llambro Xhavella ishte zhveshur deri në brez dhe gjoksi i tij i madh nuk dukej nga qimet e kuqe që kishin nisur t'i zbardheshin. Nga aty, deti nuk dukej. Petro ngriti kokën dhe pa malin që duhej të kalonin për të dalë prapë në det. Ishte i zi dhe i mbushur me shkurre të pluhurosura. Pasdite morën rrugën dhe shumë shpejt e kapërcyen malin. Kuajt ishin të ngopur dhe u ngjitën me galop. Ushtarët e Aliut vazhduan të



ecnin pas tyre dhe Petros iu duk sikur i kishin rrethuar. Dielli në perëndim i digjte qafën dhe ai u zgjat mbi det, por iu morën mendtë. Ishin shumë lart. Poshtë tyre bregu ishte plot me shkëmbinj që laheshin, si kockat në çezmë. Pas pak, lartësia u zbut dhe deti dukej më afër. Faqja e malit zbriste si thikë dhe pothuajse nuk kishte breg. Dallgët e lodhura të pasdites lëpiheshin pas malit. Kuajt ndaluan dhe Petro pa oficerin që u afrua nga Llambro Xhavella. Kur i erdhi tre hapa larg, nxori pishqollën dhe ia drejtoi në gjoks. Me urdhër të Ali Pashait, dorëzohuni, tha oficeri dhe të gjithë ushtarët i drejtuan armët drejt tyre. Llambro Xhavella nuk lëvizi dhe të shtatëdhjetë burrat u mbledhën rreth tij duke ngritur armët. Ne jemi pesëqind kundër shtatëdhjetë, tha oficeri dhe iu afrua Llambro Xhavellës që rrinte mbi kalë duke parë detin në perëndim. Ti do vdesësh i pari, bërtiti Foto Xhavella dhe e drejtoi karabinën e tij mbi oficerin. Pas tët eti, foli oficeri dhe djersa i zbriti në faqe. Mos qëlloni, tha Llambro Xhavella dhe iu drejtua oficerit. Çfarë do Ali Tepelena nga unë? Pashai më ka urdhëruar t'ju kthej në Janinë të paarmatosur, u përgjigj oficeri dhe mori frymë thellë. Kjo është pabesi, tha Foto dhe u ngrit mbi kalë, por dora e Llambros e qetësoi. Llambro Xhavella dhe oficeri u afruan duke biseduar, por askush nuk i uli armët dhe ata të dy dukeshin sikur ishin takuar në mes të kallinjve të misrit. Petro ndjeu një të dredhur në trup. Sqetullat i ishin lagur nga djersa, kurse flokët i ishin fryrë nën qeleshe. Mori frymë thellë dhe i lëshoi pak frerët e kalit. Sytë i kishte të skuqur, por deti dukej shumë afër. Pa Foto Xhavellën drejt në sy pastaj kërcëu nga kali dhe, pasi bëri një hap të gjatë, fluturoi në det. Foto Xhavellës iu duk si një zog që hidhet në det pa i lëvizur krahët. Ushtarët e Aliut u afruan dhe nisën të qëllonin. Por Thanasi i thirri dhe ata e pushuan zjarrin. Petro ishte zhytur në ujë dhe nuk dukej. Thanasi hodhi pishqollat, vrapoi si i çmendur derisa gjeti një rrëpirë dhe zbriti deri afër detit e pastaj u zhyt në ujë. Ndërsa Foto u hodh në det njëlloj si Petro, dhe filloi të notonte si i marrë. Llambro Xhavella dhe oficeri u zgjatën duke parë poshtë, ndërsa ushtarët i mbanin armët të drejtuara mbi burrat nga Suli. Thanasi zhytej në ujë pastaj nxirrte kokën të merrte frymë dhe zhytej prapë derisa thirri: E gjeta.

Mbi ujë doli koka e Petros që varej si një fole zogu e braktisur. Kur e nxorën nga uji, Petro nuk merrte frymë. Në mes të shpatullave kishte një vrimë plumbi që ia kishte çarë kraharorin. Thanasi qante mbi trupin e të vëllait, ndërsa Foto Xhavella ishte ulur mbi një gur dhe shikonte nga deti. Llambro Xhavella zbriti në rrëpirë dhe oficeri e ndoqi pas duke ia mbajtur pishqollën në drejtim të kokës. Burrat nga Suli shanin ushtarët e Ali Pashës, por këta nuk flisnin dhe nuk i ulën armët.

Kali i Llambro Xhavellës ishte afruar në buzë të greminës dhe shikonte trupin e lagur të Petros. Llambro e puthi Petron në ballë dhe nuk ia hodhi sytë Thanasit, të ënjtur nga lotët. Foto thirri dy nga shokët e tij. Oficeri bëri shenjë dhe ushtarët i lejuan të lëviznin. Ata gjetën një copë tokë në mes të shkëmbinjve dhe hapën një gropë. Thanasi e ngriti të vëllanë, e futi brenda dhe e mbuloi duke i hedhur rërë të lagur me duar.

Të nesërmen mbërritën në Janinë. Llambro Xhavella ecte mbi kalë me kokën ulur dhe i paarmatosur. Thanasi kishte mbërritur një natë përpara tyre.

Jani dhe Aliu e kërkuan Thanasin në Kastro, por ai nuk ishte. U endën rrugëve të zbrazura të Janinës dhe në mesnatë e gjetën në tavernë. Kamerieri i ri që tundej si vajzë, tregoi me gisht një tavolinë në cep ku Thanasi ishte ulur me një gotë përpara. Flokët i kishin rënë mbi ballë dhe dukej sikur kishte ditë që nuk krihej. Kur pa dy vëllezërit, sytë iu thanë. Kaloi dorën mbi mustaqe dhe u mbështet në karrige. Jani dhe Aliu u ulën përballë tij dhe një copë herë nuk folën. Taverna ishte e qetë dhe Thanasi shikonte pikturën e djalit që kishte frikë të lahej në liqen. Babai kërkon trupin e Petros, i tha Jani duke u gëlltitur. Thanasi nuk lëvizi dhe vazhdoi të mbante

kokën në drejtim të pikturës. Do ta vras Ali Pashën, tha Aliu dhe shtrëngoi duart mbi tavolinë. Thanasi ktheu kokën. Pse do ta vrasësh, e pyeti duke e parë në sy. Aliu më vrau vëllanë, u përgjigj Aliu. Vëllanë ta kam vrasë unë, tha Thanasi dhe ktheu kokën qetësisht nga piktura. Aliu u ngrit në këmbë me zhurmë dhe kamerieri nxori kokën nga kuzhina. Jani e kapi për dore dhe Aliu u ul prapë.

Ku është Petro, pyeti Jani. Thanasi u kthye nga vëllezërit dhe duke parë gotën që kishte përpara filloi të fliste. I tregoi për takimin me Petron, për kazermën, për shëtitjen në qytet, për haremin, për Kastionin, për natën në tavernë, për Tozonin, për nisjen nga Janina, për rrugën mes maleve, për oficerin, për ushtarët, për kalin e Llambro Xhavellës dhe për fluturimin e Petros në det. Zëri i tij ishte i butë, por i lartë dhe Jani iu duk sikur kamerieri i dëgjonte pas murit të kuzhinës. E dije që Ali Pasha do ta gënjente dajë Llambro? E dija, tha Thanasi, por nuk mund t'ia thosha Petros sepse ai do t'ia tregonte të gjitha Fotos dhe plani do prishej. Ti tradhtove vëllanë për Ali Tepelenën, bërtiti Aliu.

Thanasi dukej i qetë. Kishte tri ditë që mendohej në vetmi dhe në kokën e tij kishte kaluar çdo detaj i vdekjes së Petros. Ai e dinte se Aliu po e gënjente Llambro Xhavellën, por nuk kishte menduar se i vëllai do hidhej në det për t'i shpëtuar rrethimit. Kishte qenë i bindur se, pasi të shtatëdhjetë burrat të burgoseshin në Janinë, ai do arrinte ta lironte Petron dhe do ta kthente në shtëpinë e tyre të re në fshat. Babai do kënaqej dhe Petro do flinte në dhomën e madhe me krevat nga deti. Por këto nuk mund t'ia thoshte dy vëllezërve që e shihnin si një tradhtar të çmendur. Ata ishin rritur dhe e kuptonin se vdekja nuk ishte një lojë kalamajsh që mund të kthehet pas, të zhbëhet dhe të përsëritet duke ndërruar vend mes humbësit dhe fituesit. Kur ishin të vegjël, ai dhe Petro luanin luftash. Ai vritej dhe Petro fitonte, pastaj merrte humbeshin, ndërronin rolet dhe Petro vritej, ndërsa ai fitonte. Por kjo lojë kishte mbaruar kur Petro kishte vendosur të luante me Ali Pashën. Petro kishte humbur, Aliu kishte fituar, ndërsa ai ishte në mes të të dyve. Qante për të parin dhe luante me të dytin.

Iu kujtua koha kur Ali Tepelena kishte ardhur në fshat dhe e kishte marrë me vete. Aliu kishte sy të kaltër, duar të holla dhe një lëkurë vajze nën të cilën dukeshin damarët e mbushur me gjak të kuq. Njëherë, kur ishin shtrirë të dy nën një mollë me lule të bardha, ai e kishte pyetur Aliun se kush nga ata të dy do vdiste i pari. Unë, i kishte thënë Aliu. E kam parë në ëndërr. Do më presin kokën dhe ti do më marrësh për dore e do më shëtisësh nëpër Janinë. Do të të laj në liqen dhe pastaj do të të fshij me peshqir, i kishte thënë ai duke parë lulet e mollës. Aliu ishte ngrysur dhe i kishte dhënë një shpullë në kurriz. Kjo që të thashë është një ëndërr që nuk ka për të ndodhur. Gjethet e mollës i kishin rënë mbi kokë dhe Aliu i kishte larguar me bezdi.

A të duket se ai djali i ngjan Petros, pyeti Thanasi duke treguar pikturën pa ngjyra në mur.

Jani nuk e ktheu kokën dhe duke e ngritur zërin i tha: Babai pret Petron. Shkojmë ta marrim, foli Thanasi dhe u ngrit.

Lindja e diellit i kapi afër detit. Kishin udhëtuar gjithë natën pa folur. Thanasi ecte përpara mbi kalë dhe vëllezërit e ndiqnin në errësirë. Gjyrykastra ishte futur në re dhe dritat nuk dukeshin. Kur u afruan te vendi nga ish hedhur Petro, i zbritën kuajve. Thanasi eci në buzë të rrëpirës dhe disa gurë ranë në det duke bërë rrathë të vegjël. Zbritën poshtë dhe filluan të gërmonin në heshtje. Aliu qante, por dallgët ishin të zhurmshme dhe ai nuk dëgjohej.

Petro doli nga toka si një kërmill pa guaskë. Ishte bërë gri dhe sytë i ishin mbushur me rërë. Jani ia pastroi me ujë deti dhe e puthi në faqe. Gjaku i ishte mpiksuar mbi këmishë dhe plaga ngjante si një mëllagë e tharë. Aliu hoqi këmishën e tij të bardhë dhe ia veshi Petros. Ta çojmë të pastër në fshat, i tha Jani. Mori këmishën e gjakosur, e futi në det dhe e shtrydhi disa herë. Duart iu

skuqën dhe ai i shpëlau në det. Pastaj e tundi disa herë këmishën në ajër dhe e veshi. Trupi iu mbush me avull dhe ai ndjeu se këmisha e tërhiqte drejt detit, por këmbët i kishte të mpira dhe duart të rrudhosura nga uji. Këmisha e Petros i rrinte e madhe dhe duart nuk i dukeshin nën mëngët e gjata. Rrinte në breg dhe shikonte rrathët mbi ujë. Ato kriheshin me radhë, por kur prekeshin me njëra-tjetrën prisheshin të dyja, njëlloj si jetët e njerëzve kur takohen. Sa kohë janë të ndara, ecin secila në punë të vet. Do ta vras Ali Pashën, tha me vete Aliu dhe pa Thanasin dhe Janin që e kishin mbështjellë Petron me një çarçaf të madh dhe po e ngjisnin lart, aty ku prisnin kuajt.

Thanasi i përcolli deri afër fshatit. Gjithë rrugën nuk kishin folur. Trupi i Petros lëkundej mbi kalë dhe zgjatej nga toka. Aliu e kishte ndihmuar Janin disa herë që ta drejtonin dhe të mos i binte. Kali i Janit ecte me kujdes duke respektuar ekuilibrin e trupit të Petros. Dielli ishte i kuq dhe djersët i pikonin Janit mbi çarçaf. Kur kambanorja e fshatit u shfaq nga larg, Thanasi ndaloi dhe zbriti nga kali. Dukej si një fëmijë që ka ikur nga shtëpia. Unë e kam varrosur një herë. Tani varroseni ju, i tha Janit që e shikonte me qetësi. E hapi pak çarçafin, puthi të vëllanë dhe u zhduk pa e kthyer kokën. Ata vazhduan ngadalë dhe kur hynë në fshat ishte errur.

Ibrahimi ishte ulur në oborr dhe po i priste. Thinjat ndriçonin në errësirë. E shtrinë trupin e Petros në dhomën e madhe të djemve dhe ia hoqën çarçafin. Ibrahimi nuk fliste dhe sytë i mbante të mbyllur. Sara zjeu ujë me borzilok dhe Muhamedi me Aliun e zhveshën dhe e lanë të gjithin. I vunë gjethe sipër plagës dhe i veshën një këmishë të re të Ibrahimit. Petro dukej sikur flinte kur dielli i ra në sy në mëngjes. Para se ta fusnin në arkivol erdhi Hana dhe pastaj edhe Ana Komnena që rrinte pas kurrizit të Ibrahimit të përkulur. Petro qenka më i bukur se Muhamedi, tha Ana dhe i shtrëngoi dorën të atit. E varrosën në drekë. Jani, Paridi, Muhamedi dhe Aliu mbanin arkivolin, ndërsa Ibrahimi ecte me Anën përdore. Kur kishte gropa, Ana ndalonte dhe Ibrahimi i kalonte me mundim. Pas tyre vinin Sara, Hana dhe Mihal Komneni.

Petron e varrosën pranë të ëmës në varrezat e të krishterëve. Kur u kthyen në shtëpi, Mihal Komneni kërkoi kafe, ndërsa Ibrahimi i tha Sarës t'i ziente një çaj mali. Po Thanasi pse nuk erdhi, pyeti Hana duke i zgjatur kafën Mihalit. Jani dhe Aliu ngritën supet. Thanasi do vijë kur të vdes unë, tha Ibrahimi dhe çaji iu derdh mbi këmishë.

28

Ibrahimi qëndroi dy vjet i ulur në stolin e oborrit. Dilte në mëngjes, shikonte diellin dhe mbyllte sytë. Rrezet i ngrohnin qafën dhe flokët i zbardheshin. Lëkura e tij kishte ngjyrën e grurit në dimër, ndërsa në verë dukej si kafe e bluar. Njerëzit kalonin aty, e përshëndesnin dhe Ibrahimi buzëqeshte. Sara zgjohej pas tij, i bënte çaj dhe në drekë i jepte edhe një gotë qumësht me bukë të thekur. Jani e zmadhoi stolin, i ngriti mbështetësen dhe nguli një jastëk me gozhdë të vogla që të mos binte. Kur binte shi, Ana dilte me vrap dhe e fuste babanë në shtëpi. Njëherë, ajo ishte me Sarën në pyll dhe kur u kthyen Ibrahimi ishte lagur si një kalë që e kanë lidhur pas gardhit dhe nuk lëviz dot. Qeshte me vete dhe shikonte nga rruga. Uji i kishte rrjedhur në qafë dhe thinjat i ishin bërë të zeza. Jani vuri katër shkopinjtë të trashë rreth stolit dhe mbi to lidhi një çarçaf të bardhë që i rrinte Ibrahimit si një çadër mbi kokë. Dielli e zinte më pak dhe lëkura nuk i rripej më nga djegia.

Paridi sillej nëpër fshat dhe natën vonohej. Kur ndonjë vajzë nuk kthehej në shtëpi, vinin dhe e kërkonin në shtëpinë e Ibrahimit. Ky buzëqeshte dhe i tregonte burrave të fshatit historinë e Paridit, të mollës së sherrit dhe të tri perëndeshave. Burrat e dëgjonin për respekt dhe kur shkonin në shtëpi u thoshin grave se Ibrahimi ishte çmendur. Paridi vishej me këmishë të bardhë

që ia hekuroste Sara, ngrinte flokët lart me këna dhe hidhte parfum pjeshke që ia dërgonte Thanasi nga Janina. Kur Sara me Anën shkonin në pyll dhe Muhamedi lexonte, ai i ftonte vajzat në shtëpi dhe mbyllej me to në dhomën e tij. Ibrahim hapte sytë dhe pyeste të birin: Kush ishte kjo, Athinaja apo Afërdita? Paridi i shkelte syrin dhe rregullonte flokët e prishur.

Jani rrinte në pyll, priste drurë, i shiste në qytet dhe kur nuk kishte punë bënte stola, sëndukë, korniza, ikona dhe tavolina të vogla që Sara i vinte nëpër shtëpi. Kishte rregulluar bodrumin e shtëpisë së vjetër ku Thanasi kishte lidhur dikur Mihalin e Zoicës dhe aty punonte me sharrë dhe me çekiç. Muskujt i ishin fryrë dhe gjoksi i ishte gdhendur si Andreas, djalit të Naumit. Herë pas here shkonte në varrezat e krishtera dhe mbillte lule mbi varrin e Petros dhe të së ëmës e pastaj shkonte te varrezat e myslimanëve dhe linte një kalë druri ose një zog të gdhendur mbi varrin e Ademit.

Muhamedi lexonte librat e Arianit Komnenit dhe kur Mihali vinte në fshat, gjatë verës, bisedonin të dy. Muhamedi nuk mbante mustaqe dhe flokët i priste shkurt. Njëherë i kishte thënë Mihalit se kishte ndryshuar mendim për Voskopojën. Ç' do të thuash, e kishte pyetur Mihali, duke e parë në sy. Po ja, kishte thënë Muhamedi, nëse unë do të isha profet në Voskopojë nuk do ta kisha vrarë Marin Kurilën, por do ta kisha detyruar të martohej me Aishen. Mihal Komneni kishte ngritur vetullat. Nuk ka rrugë tjetër, kishte vazhduar Muhamedi. Fshati ynë nuk i ngjan Voskopojës, jo vetëm sepse nuk ka libra, piktorë, myshk dhe taverna, por sepse të krishterët këtu martohen me myslimanët, siç u martua babai me Sarën. Kjo është e vetmja mënyrë që grindjet mes të krishterëve dhe myslimanëve të qetësohen sepse fëmijët janë të përbashkët dhe ata e ruajnë paqen brenda shtëpisë siç kemi bërë ne. Fshati shpëtoi kur Arianit Komneni iku, sepse ai nuk do lejonte që vajzat e krishtera të martohehin me burra myslimanë. Po të ishte ai në fshat, babai nuk do ishte martuar me Sarën dhe nuk do të ishte zbutur. Ne, djemtë e tij, do ishim myslimanë të egërsuar dhe të gatshëm për t'u hakmarrë duke menduar se po jetojmë në një fshat ku na është ndaluar ajo që i lejohet të tjerëve, siç mendonte edhe Sali Benishi. Shqiptarët kanë vetëm një zgjidhje: të martohen të krishterë me myslimanë që të shmangin Voskopojën.

Mihali e shikonte dhe e pyeste. Po ti kur do ta gesh Aishen? Nuk e di, përgjigjej Muhamedi duke fërkuar ballin. Aishet e fshatit duan mollën e Paridit.

Aliu kishte ikur në Janinë dhe i kishte thënë Janit se do kthehej kur të vriste Ali Pashën. Thanasi e kishte ndihmuar të punonte si stallier për kuajt e Aliut. Ai i lante kuajt, i ushqente dhe i ndërronte potkonjtë. Njëherë i kishte futur kalit të Aliut një gozhdë në potkua që ai të rrëzohej. Por Ali Pasha ishte shëndoshur dhe nuk i hipte më kalit, por dilte vetëm me karrocë. Kur e shikonte duke ecur nëpër kalldrëmet e qytetit, Aliu mërzitej, shkonte në tavernë, shikonte pikturën me djalin që kishte frikë të lahej dhe dehej. Atëherë, rendte përpara Kastros dhe bërtiste. Rojat që e njihnin, lajmëronin Thanasin dhe ky ia fuste kokën në liqen, pastaj e çonte në shtëpi dhe e shtrinte në krevat. Të nesërmen kuajt rrudhnin hundët nga duhma e fortë e uzos që lëshonte goja e Aliut.

Por Thanasi nuk ishte gjithmonë në qytet. Pashai e ngarkonte me punë dhe ai rrinte me ditë në kalanë e Tepelenës, apo në Prevezë, apo duke u takuar fshehurazi me Foto Xhavellën. Pasi vdiq Petro, Ali Pasha e kishte liruar Llambro Xhavellën, por kishte mbajtur peng në Janinë, Foton, të cilin e kishte bërë oficer. Foto dhe Thanasi rrinin bashkë dhe kur dajë Llambro vdiq, Foto shkoi në fshat dhe u bë kapedan i Sulit. Ali Pasha e kishte rrethuar Sulin në një verë të nxehtë dhe i kishte lënë tre muaj pa bukë suljotët në majë të malit. Kur rrethimi u bë i egër dhe fëmijët filluan të dobësohen, ndërsa pleqtë të ënjtën nga uria, Thanasi kishte takuar Foton dhe e kishte bindur të dorëzohej duke i dhënë besën e Ali Pashës se askush nuk do vritej. Foto Xhavella ishte bindur

dhe mijëra burra, gra dhe fëmijë me lot në sy dhe trasta në krahë kishin kaluar në mes të rreshtave të ushtarëve të Ali Pashës dhe kishin ikur në Korfuz e në qytete të tjera të Greqisë. Thanasi ishte ngjitur i pari në Sulin e braktisur. Nga maja e malit dukej deti dhe atij i ishte kujtuar Petro. Kishte hedhur një gur në det dhe flokët ia kishte marrë era.

Sara shihte Anën që rritej dhe ia lidhte flokët gërshet. Hunda e saj ishte e vogël dhe flokët ishin shumë të zinj. Faqet i kishte të kuqe si shegë, ndërsa këmbët të gjata si hardhi. Kur vraponte nëpër shtëpi, fustani i ngrihej deri te kofshët e ngrohta dhe gjinjtë e vegjël kërcenin si kuleç me bajame. Në pranverë shkonin të dyja në pyll dhe Ana gjente breshka, ndërsa Sara lexonte në rrëzë të një molle të egër. Breshkat fusnin kokën poshtë guaskës dhe Ana i fliste derisa i zbuste, por nuk i merrte në shtëpi. Nganjëherë e lidhte fillin e leshit pas qafës së shkurtër të breshkës dhe e lëshonte në livadh. Breshka ecte ngadalë dhe filli i ngatërrohej mbi kurriz derisa ia bllokonte këmbët dhe ajo ndalonte e hutuar.

Në dimër, rrinin të dyja pranë oxhakut dhe piqnin gështenja. Ana Komnena i qëronte gështenjat me duart që i digjnin dhe i lyente me reçel për t'i ftohur. Kur binte borë dhe rruga përpara shtëpisë ngrinte, ajo dilte jashtë dhe shkiste me një slitë të vogël me dy hekura që ia kishte mbërthyer Jani. Mbante në kokë një kapuç leshi dhe gërsheti i zi e ndiqte pas nëpër dëborë. Në darkë, Ibrahim mbështillej me velenxë në dhomën me shikim nga arra e vogël, e cila mbulohej me borë dhe ia bënte atij gjumin më të rëndë. Ana ulej mbi qilim, me lëmshin në duar dhe pyeste Sarën: Pse nuk e ke njohur nënën? Sara lëvizte mashën mbi prush dhe fërkonte sytë nga tymi. Nëna ime vdiq që unë të lindja. Po sikur të mos kishte vdekur, ti do vije në fshat të më lindje mua? Nuk e di, përgjigjej Sara. Por edhe nëse nuk do të kisha ardhur në fshat prapë do të të lindja ty. Ana Komnena afrohej më shumë pranë zjarrit dhe pushi i faqeve i piquej në prush. Lëvoret e gështenjave binin përdhe e ajo i mbliidhte dhe i hidhte në zjarr. Ato kërcisnin dhe flaka e tyre nxirrte xixa. Si do më lindje mua, pyeste Ana duke drejtuar gërshetin. Po të mos vije në fshat nuk do martoheshe me babanë dhe unë nuk do lindja. Sara qeshte dhe i afronte së bijës gështenja të tjera, të mëdha, të cilat i çante në mes me thikë që të mos plasnin.

Ti ke qenë brenda meje që kur unë kam lindur, thoshte Sara. Po sikur të kem qenë edhe brenda babait, ngulmonte Ana duke e parë të ëmën në sy. Sara ulej pranë së bijës dhe i fërkonte këmbët e gjata. Unë kisha një gështenjë, thoshte ajo. Gështenja ishte e njomë, e rrumbullakët dhe e shijshme. Unë lozja me gështenjën ngjyrmjalti, por nuk dija ta qëroja. Një ditë takova babanë dhe ai më ndihmoi t'ia hiqja lëvoren. Kur u hap gështenja, dole ti.

Ana Komnena qeshte dhe sytë i shkëlqenin. Zjarri i kalonte në trup dhe e zinte gjumi në krahët e Sarës. Në mëngjes shkonte te stoli i Ibrahimit. Dëbora kishte veshur oborrin, por tenda me çarçaf e kishte mbajtur stolin të thatë dhe të ngrohtë. Ibrahim pinte çaj të nxehtë dhe afër stolit, Sara kishte sjellë një mangall plot me prushin e natës. prushi mbante era gështenjë dhe Ibrahim i hapte hundët fort duke thithur diellin e pastër të dimrit.

Ana Komnena ulej pranë tij në stol dhe i thoshte: Di të qërosh gështenja? Di, i thoshte Ibrahim me sytë e mbyllur. Po kur unë isha gështenjë si ma hoqe lëvoren? Ibrahim ngrinte kokën lart dhe qeshte. Thinjat i dukeshin si një kurorë e mamasë, por ajo nuk e qëronte dot dhe unë e ndihmova. Po Paridi gështenjë ishte, pyeste Ana. Jo, Paridi ka qenë një mollë, përgjigjej Ibrahim. Po Muhamedi? Muhamedi ka qenë një hurmë. Po Aliu? Aliu ka qenë një vezë. Po Petro? Ibrahim i shtrëngonte pak sytë dhe dëgjonte dëborën që shkrihej nën mangall. Çaji bënte dallgë në gotën e tij, por fytyra i çelej nga një buzëqeshje e vjetër dhe e pastër. Petro ka qenë një guaskë, thoshte pa i hapur sytë. Ne e morëm nga fundi i detit dhe e hapëm. Ishte i vogël dhe nuk dinte not. Kur u rrit, u kthye prapë në det, aty ku e kishte vendin.

Ana ndiente ftohtë nga këmbët dhe shihte mangallin që ftohej. Kur shkrinte dëbora ajo merrte lëmshin dhe e lëshonte në oborr dhe nëpër dhoma. Një pasdite ia la lëmshin Ibrahimit dhe hyri në shtëpi për të gjetur fundin e fillit. Kur u kthye, lëmshi i kishte rënë babait nga dora dhe ishte rrokullisur deri te kisha në mes të fshatit. I foli, por ai nuk u përgjigj. Hëna e re i kishte zbritur Ibrahimit mbi thinja. Thirri Sarën që erdhi me vrap dhe pas pak filloi të qante.

Atë natë ra shi dhe stoli i vetmuar u lag. Jani e shkuli jastëkun dhe e futi në arkivolin e Ibrahimit. Aliu erdhi në mesnatë, ndërsa Thanasi të nesërmen në mëngjes. Jani mbylli arkivolin me gozhdë dhe dëgjoi Thanasin që tha: Nuk e vrava unë Petron, baba.

E çuan te varreza e myslimanëve, ngjitur me Ademin. Binte një shi i qetë dhe Paridit i rridhte kënjaja në fytyrë. Para se ta mbulonin, Ana Komnena hodhi një gështenjë të egër që u përplas fort mbi arkivol dhe u nda në dy pjesë.

Kur u kthyen në shtëpi, Sara u ul një copë herë në stolin e Ibrahimit. Tenda e mbante shiun që binte pa zhurmë. Arra e vogël ishte anuar pak nga dritarja dhe dukej sikur kërkonte dikë në dhomën e gjumit. Djemtë kishin hyrë në dhomat e tyre. Kali i Thanasit ishte lidhur pas gardhit dhe me veshët ngritur shikonte nga rruga. Ana Komnena iu afrua dhe mbështeti kokën në supin e saj. Flokët e lagur iu ngjitën në faqen e Sarës. Mama, çfarë do bëjmë tani që iku babai? Sara mori frymë dhe pa shtëpinë që iu duk shumë e madhe. Do shkojmë në shtëpinë tonë, u përgjigj. Ana iu ngjesh në trup dhe i tha me zë të ulët: Nuk dua ta marr lëmshin me vete. Mirë, tha Sara dhe e përqafoi.

Kur Sara i tha djemve se do kthehej në shtëpinë e Arianitit, Jani nuk foli, por zbriti në bodrum dhe bëri një krevat të gjatë me dru qershie për Ana Komnenën. Paridi u mërzit dhe u ul para pasqyrës, por Sara i tha se do t'ia hekuroste prapë këmbët e bardha me niseshte. Po kuleç me mjaltë do t'i bësh, e pyeti Ana për të qetësuar vëllezërit. Do t'i bëj dhe ti do t'ia sjellësh të ngrohtë në mëngjes, tha Sara duke mbledhur çarçafët në dhomën e gjumit. Muhamedi ishte ulur në tavolinën e madhe dhe shikonte sëndukët dhe trastat që mbusheshin me enë, peceta, mbulesa, qilima dhe kortinka. Sara mbledhi rrobat e Ibrahimit, i palosi, i vuri çdo këmishe një gjethe arre në thile dhe i vari në dollap. Unë nuk i vesh rrobat e babait, tha Paridi. Do t'i vesh unë, tha Muhamedi dhe u ngrit të ndihmonte Sarën.

Sara dhe Ana e rregulluan shpejt dhomën e madhe të Arianit Komnenit. Mihal Komneni kishte muaj që nuk kishte ardhur në fshat dhe dhoma ishte e ftohtë. Sara e leu me gëlqere të re dhe kur u tha vari dy sixhade në mure. Krevatin e ri të Anës e vendosën afër dritares që shikonte nga oborri me plloça. Para se të flinin, Sara shoi qirinjtë mbi shandan dhe iu kujtua Ibrahimit. Ana u zgjua vonë në mëngjes. Sara kishte bërë kuleç me mjaltë dhe me arra dhe ajo vrapoi t'ia çonte vëllezërve që po e prisnin në oborr. Muhamedi ishte ulur në stolin e Ibrahimit, ndërsa Jani rrinte në këmbë dhe shikonte nga rruga. Si fjetët, e pyeti Muhamedi. Mirë, i tha Ana, por kam parë gjithë natën ëndrra me numra dhe me germa. Muhamedi qeshi dhe mjalti i kulaçit i shkau nëpër gishtërinj. Kështu ndodh kur fle në shkollë, i tha.

Çdo të diel Sara i ftonte djemtë në shtëpi për drekë. Vinte dhe Hana dhe gatuanin mish me patate, lakror dhe pula të mbushura me oriz. Ditët e javës Ana i çonte vëllezërve kuleç të ngrohtë dhe një këmbë të hekurosur për Paridin që e mbante me kujdes. Jani punonte në bodrum, kurse Muhamedi rregullonte shtëpinë dhe në darkë skuqte vezë ose mbushte specat me gjizë që, kur digjeshin, e mbushnin kuzhinën me tym. Kur Paridi merrte ndonjë vajzë në shtëpi, Muhamedi vinte veshin te dera e dhomës së tij dhe harronte vezën që digjej në tigan. Çekiçi i egër i Janit, që kumbonte në bodrum, e pengonte të dëgjonte ritmin e trupit të Paridit.

Në fund të pranverës, në fshat erdhi një familje jevgjish. Ata erdhën një natë pa zhurmë ngarkuar me bohçe të mëdha dhe të nesërmen, në fushë, aty ku ishin varrosur bagëtisë që ngordhën nga

kolera, u pa një tendë e ngritur mbi shkopinj, nga e cila doli një burrë i zi me flokë kaçurrela dhe me hundë të kërrusur. Trupin e kishte të fortë dhe duart e gjata i vinin deri te gjunjët. Burri quhej Bilal dhe kishte ardhur nga Janina. Për shumë vjet kishte punuar për Ali Pashën. Ai kujdesej për karrocën e Aliut dhe ushqente kuajt. I lante, i jepte tagji, i priste bishtat, i hiqte sklepat në sy dhe mbliidhte bajgat që ata lëshonin në oborrin e Kastros. Bilali kruante baltën, guriçkat, apo milingonat e ngordhura në rrotat e karrocës duke i fërkuar me gur dhe me bronz, lidhte kapistallët e kuajve pas karrocës, dhe fshinte me furçë jastëkun e atllasit të verdhë ku ulej Pashai. Nëpër rrota shpesh gjente qime kafshësh apo flokë të gjata grash, të cilat karroca i kishte sjellë me vete në kështjellë duke i shtypur. Bashkë me karrocën, nga Franca kishte ardhur edhe një bojë e zezë me të cilën Bilali lyente mushamanë e trashë të karrocës që plasaritej nga vapa dhe ngrinte nga dimri.

I kishin thënë se karroca duhej të lastrohej përditë dhe të shkëlqente njëlloj si këpucët e Tozonit, doktorit të Ali Pashës. Ai zhvishej pa gdhirë dhe e kalonte furçën me qime dhjetëra herë në kanalet dhe gropat e padukshme të mbulesës prej mushamaje. Kur Kastro zgjohej, karroca vezullonte mbi kalldrëm. Bojën e mbante në kuti të vogla teneqeje që i mbushte sa herë zbrazeshin. Një ditë e kishte harruar kutinë mbi ndenjësën e karrocës.

Ishte një ditë e bukur prilli dhe Ali Pasha kishte dalë për të shkuar në harem. Ishte ulur në karrocë dhe teneqeja i kishte shpuar të ndenjurat. Kur kishte vënë dorën për të parë ku ishte ulur, boja i ishte derdhur mbi poturet e reja dhe e kishte ndotur të gjithin. Ushtarët e Aliut e kishin marrë Bilalin dhe e kishin rrahur me shkopinj. E mbajtën dhjetë ditë lakuriq në birucë, duke e fshikulluar pa pushim, sa lëkura i ishte bërë si kadife e zezë me vija të kuqe. Kur e kishin liruar, i kishin hedhur një kovë me ujë të përvëlur në kurriz dhe i kishin thënë se të nesërmen duhej të zhdukej nga qyteti.

Bilali kishte mbledhur plaçkat duke rënkuar, kishte marrë gruan, vajzën e madhe dhe djalin tetëvjeçar dhe kishte mbërritur pas dy ditësh në fshat. I kishte pëlqyer fusha e zbrazët dhe kishte ngritur tendën me vrma që i ngjante kurrizit të tij. Kjo fushë mban erë të mirë, i kishte thënë gruas, që ia lyente trupin me vaj dhe pastaj i vinte mbi plagë kastravec të qëruar. Kur i thanë se në atë vend ishin varrosur bagëtitë e sëmura, Bilali nuk u mërzi. Kafsha e ngordhur nuk qelbet si njeriu, kishte thënë dhe kishte shkuar në pyll për dru. Donte të ngrinte një kasolle sepse tenda ishte e shpuar dhe nuk e mbante shiun. Jani ishte i vetmi që kishte sharra dhe sëpata të mëdha për dru dhe ai kishte ardhur në shtëpi dhe e kishte takuar. Kur i tregoi se vinte nga Janina, Jani i tha se kishte dy vëllezërit aty. Thanasin e njoh, kishte thënë Bilali. Rri pas Pashait si hije. Po të ishte atë ditë në qytet do më kishte rrahur me dorën e vet dhe do ma kishte bërë lëkurën si shalqi. Ndërsa Aliu pi shumë dhe kur dehet thotë se do vrasë Ali Pashën, por askush nuk e beson. Jani i dha sëpatën me teh të mprehtë dhe një sharrë të madhe. Bilali shkoi në pyll dhe preu dru.

Një ditë, në shtëpi erdhi vajza e Bilalit dhe i kërkoi Janit gozhdë për të ndërtuar kasollen. Paridi ishte në oborr dhe kur pa gjinjtë e kërcyer të vajzës dhe belin e hollë i tha Janit: Po të ishte më e bardhë do ta kisha marrë në dhomën time. Jani mori gozhdët në bodrum dhe ia dha vajzës së Bilalit. Kur ajo iku, ai pa fustanin e shkurtër që i ngrihej mbi gju dhe sytë i shkëlqyen. Të nesërmen, vajza erdhi prapë që në mëngjes dhe i kërkoi Janit gozhdë të tjera. Jani ia dha duke parë lëkurën kafe të duarve të saj, ndërsa Paridi i tha Muhamedit në oborr: Jevgjit ushqehen me gozhdë.

Jani punonte në bodrum, por mendjen e kishte te duart e vajzës së Bilalit. E la punën dhe shkoi te kasollja që po ngrihej në fushën e bagëtive. Bilali punonte duke kënduar dhe djersët i binin mbi kanalet e thella që kishte në kurriz. I qëllonte gozhdët fort dhe kur ato thyheshin i hidhte dhe mernte të tjera. Gozhdët vallëzonin në ajër dhe binin si gjymtyrë të këputura në tokë. Në drekë u

ulën të dy nën tendën me vrima, ndërsa gruaja i gatoi musaka me kunguj dhe piperka të pjekura. Vajza e Bilalit solli ujë dhe Jani u gëlltit. Ajo kishte duar të gjata si i ati dhe lëkura e zeshkët mbante një erë rrëshire të fortë dhe avulluese. Flokët i kishte të shkurtër, kaçurrelë dhe në kokë mbante një rreth të kuq. Hodhi ujë në gotën e Bilalit dhe e pa Janin në sy. Jani qeshi dhe vajza uli sytë, por e skuqura u fsheh nën lëkurë dhe nuk iu duk.

Ditën tjetër, kur vajza solli ujë, Jani ia preku gishtat duke i marrë gotën e mbushur. Piu ujin dhe u ngjiti në majë të çatisë duke rregulluar dërrasat. Që atje dukej fusha e shkretë rrëzë fshatit dhe atij iu kujtua Muhamedi që kur kishte parë tokën në formë katrori kishte thënë se në atë vend do të ndërtohej një shtëpi nga disa njerëz me çanta dhe ai do shkonte aty.

Kishte hequr këmishën dhe punonte lakuriq, ndërsa Bilali ishte futur brenda tendës dhe gruaja po i vinte copa kastravec mbi kurrizin e djegur nga dielli. Vajza ishte ulur në tokë dhe po e shikonte duke punuar. Këmbët i kishte hapur dhe në mes të tyre Jani pa një mish të fortë ngjyrë kafe që vinte duke u zbardhur aty ku bashkoheshin kofshët. Vajza qeshte, por nuk i mbyllte këmbët. Jani ia bëri me dorë, ajo u ngrit dhe u afrua. Si e ke emrin, e pyeti. Fatime, tha vajza me zë të ulët duke parë nga tenda ku ishin prindërit. Jani iu forcuan muskujt në trup, por goja iu zgjidh. Fatime, do të vish në shtëpinë time? Dua, tha Fatimja duke qeshur dhe dhëmbët e bardhë i ndriçuan fytyrën si një filxhan i qëndisur. Jani qëlloi fort me çekiç mbi çati dhe ofshamat e Bilalit të mbuluar me kastravec nuk u dëgjuan gjithë pasditen.

Kur ra muzgu, shkoi në shtëpi, mbushi një kazan me ujë të ngrohtë dhe u la. U fut në dhomën e Paridit, hodhi nën sjetulla parfumin e pjeshkës dhe hapi sëndukun të merrte një këmishë të pastër. Këmishët ishin të gjitha të pahekurosur dhe Jani hapi dollapin me rrobat e Ibrahimit. Pa një këmishë bojë rozë të qëndisur te qafa, në thilenë e së cilës ishte një gjethe e tharë që ra përtokë. E veshi dhe shkoi përpara pasqyrës. Iu duk vetja si babai ditën që ishte martuar me Sarën dhe ai bashkë me Thanasin tundnin kambanën e kishës, ndërsa Paridi me Muhamedin mbanin fustanin e nusërisë së Sarës. Doli jashtë dhe u ul te stoli në errësirë. Ishte fresk, megjithatë djersiti në tëmtha, duke pritur. Dëgjoi një hap të lehtë dhe ktheu kokën nga rruga. Fatimja ecte në majë të gishtave. Kishte krehur flokët dhe i kishte kapur me karfica në dy anët e kokës, ndërsa buzët i kishte lyster dhe Jani iu duk si një kukull me dru arre të errët. Nuk kishte bërë kurrë kukulla të veshura si vajza dhe nuk e dinte si dukeshin të zhveshura.

Kur u futën në dhomë, ai shoi qirinjtë. Fatimja u zhvesh shpejt dhe trupi i saj u bë një me errësirën, por në mes të këmbëve ai dalloj një shëgë të kuqe me lëng dhe u drejtua atje duke mbajtur duart përpara si i verbër. Rrëshira e Fatimes iu ngjiti në të gjithë trupin, ndërsa duart e saj iu kapën me thonj pas kurrizit. Iu kujtua shpina e vizatuar e Bilalit dhe bërtiti nga dhimbja. Muhamedi, që po lexonte në dhomën tjetër, ndjeu zhurmë dhe u afrua te dhoma e Paridit, por dera ishte e hapur dhe aty nuk kishte njeri. Një erë e fortë rrëshire i erdhi në hundë dhe mendoi se Jani po lyente dërrasa poshtë në bodrum. U kthye të lexonte dhe e zuri gjumi.

Jani doli nga dhoma të nesërmen në drekë. Sytë i kishte të ënjtur dhe nuk i pa kuleçtë e Sarës që ishin ftohur duke pritur. Paridi me Muhamedin ishin në oborr. Do martohem, tha Jani duke fërkuar sytë. Muhamedi rrudhi buzët dhe i tha: U mërzi me kukullat prej druri? Me kë do martohesh? Me vajzën e Bilalit, tha Jani. Paridi u afrua dhe filloi të qeshte. Po të ishte e bardhë do kishte pritur sa të dilte nga dhoma ime, tha dhe i shkeli syrin Muhamedit. Jani bëri sikur nuk e dëgjoi dhe ktheu kokën nga dera e shtëpisë. Fatimja rrinte në këmbë dhe flokët e shkurtër i kishte pa karfica. Kaçurrelat i ishin prishur. Duart e gjata i mbante mbi bel dhe fustani i ishte rrudhosur. Dua një fshesë të pastroj dhomën, tha Fatimja dhe qeshi. E ke pas derës së kuzhinës, i tha Muhamedi. Paridi iu afrua Janit dhe i tha: Vajzat e bardha nuk ma pastrojnë dhomën.



Jani dhe Fatimja u martuan pas dy javësh. Kasollja e re e Bilalit kishte mbaruar dhe Sara me Muhamedin shkuan aty për të kërkuar dorën e nuses. Bilali qeshte, ndërsa gruaja e tij nxori një reçel me manaferra të egra që i kishte këputur në fushë në mëngjes. Kur e sollën Fatimen në shtëpi, Bilali dhe e shoqja hodhën oriz mbi kokën e Janit dhe të Fatimes. Gruaja qante me lot, ndërsa Fatimja qeshte. Sara e kishte rregulluar dhomën e tyre në anën e re të shtëpisë dhe kishte sjellë një palë çarçafë të rinj ngjyrë ari. Jani kishte marrë krevatin e madh ku kishte fjetur Ibrahimimi me Sarën. Ia kishte ndërruar kokën dhe aty kishte gdhendur disa fruta me gjethe që bashkoheshin si një kurorë.

Ana Komnena e shikonte Fatimen pa ia ndarë sytë dhe para se të iknin e puthi Janin dhe doli në oborr. Nuk kishte parë kurrë një jevg. Sara e gjeti në stol me sytë nga dhoma e ndriçuar e Fatimes. Pse ka njerëz të zinj në botë, e pyeti Ana. Ka të bardhë, të verdhë, të kuq, ka dhe të zinj, tha Sara. Po pse nuk janë të gjithë njerëzit njëlloj ose të bardhë, ose të zinj, pyeti prapë Ana Komnena. Po të ishin të gjithë njëlloj bota do ishte shumë e varfër dhe e mërzitshme, tha Sara. Po fëmijët e Janit do jenë të bardhë apo të zinj, e pyeti Ana duke mbledhur këmbët e gjata mbi krevat. Sara e pa në sy dhe gërsheti i së bijës iu duk se ishte zgjatur. Nuk e di, tha, por fëmijët janë gjithnjë të bukur, edhe kur janë të bardhë, edhe kur janë të zinj. Ndoshta, tha Ana, por mua më duket se pleqtë e zinj janë më të shëmtuar se pleqtë e bardhë. Babai ishte i bukur kurse Bilali është i shëmtuar. Sara nuk foli, por hapi dritaren e dhomës.

Bënte vapë dhe yjet dukeshin sikur kishin zbritur në oborr dhe ishin shtrirë për t'u freskuar mbi plloça. Ngjyrat e lëkurës së njerëzve u ndanë nga bijtë e Noes, tha. Ana Komnena e shikonte dhe era që frynte nga dritarja ia kishte ftohur faqet e kuqe. Noeja kishte tre djem, të cilët shpëtuan bashkë me të nga përmbytja. Ata ishin Semi, Hami dhe Jafeti. Sipas Biblës së vjetër nga Semi kanë rrjedhur çifutët dhe arabët që quhen semitë. Nga Hami kanë ardhur lëkurëzinjtë, jevgjit egjiptianë dhe zezakët e Afrikës dhe këta quhen hamite. Kurse nga trugu i Jafetit rrjedhin gjithë njerëzit me ngjyrë të bardhë, shqiptarët, grekët dhe gjithë evropianët që quhen jafetike. Në fillim perëndia bëri burrin dhe gruan, Adamin dhe Evën, pastaj ndau racat me tre djemtë e Noes që ishte pasardhësi i Adamit dhe pastaj ndau fetë me djemtë e Abrahamit, Isakun dhe Ismailin që ishin pasardhës të Noes.

Noeja i paska ndarë djemtë si babai, tha Ana duke luajtur me gërshetin. Sara qeshi dhe e pyeti pse. Jani është si Hami, Muhamedi si Semi dhe Paridi si Jafeti, tha Ana dhe u shtri në krevat duke parë tavanin. Yjet kishin hyrë në dhomë dhe i ishin ngatërruar nëpër flokë.

Pas një viti, Fatimja lindi një djalë të zeshkët me sy të kaltër dhe me flokë kaçurrelë. Jani e mori djalin në krahë dhe e ngriti në diell. Lëkura mbante erë rrëshirë dhe ai e puthi në ballë. Do ta quajmë Ibrahim, i tha Fatimes që qeshte e shtrirë në krevat. Ana Komnena iu afrua Sarës dhe i tha: Pse i vunë emrin e babait? Ky e ka lëkurën si breshkë dhe është me flokë kaçurrelë, ndërsa babai ishte me flokë të drejtë dhe nuk mbante era rrëshirë. Sytë i kanë njëlloj, i tha Sara duke luajtur me Ibrahimin e vogël. Kur gruaja e Bilalit i preu Ibrahimit kërthizën, që dukej si një shkop i shtrembër me nyje të vogla, Jani e mori duke e mbajtur me kujdes e mos thyhej dhe zbriti në bodrum. Preu disa dërrasa dhe bëri një kuti të vogël që e veshi nga brenda me atlas të verdhë që Bilali e kishte sjellë nga Janina. Futi kërthizën në kuti dhe ia dha Fatimes që e preku lehtë me gisht dhe e vuri mbi boro.

Ibrahimimi i vogël eci shpejt. Pinte shumë qumësht duke kafshuar gjinjte e fryrë të Fatimes. Këmbët e shkurtra i ishin bërë me vija, ndërsa kaçurrelat i ishin zgjatur mbi supe sepse Bilali

thoshte që foshnjave nuk duhet t'i priten flokët derisa të bëhen tre vjeç. Bilali dhe e shoqja vinin çdo pasdite dhe rrinin në dhomën e Fatimes. Gruaja i sillte vajzës kabuni me sheqer, ndërsa Bilali merrte Ibrahimin dhe e shëtiste në oborr. Kur vinte Bilali shtëpia kumbonte. Zëri i tij ishte i fortë dhe çdo gjë e thoshte me të bërtitur, aq sa Paridi besonte se ai nuk dëgjonte mirë nga veshët. Jani shkante në bodrum dhe priste dru sikur donte t'i shpëtonte zërit të Bilalit.

Një ditë, Bilali solli një iriq për Ibrahimin. Iriqi i kishte gjembat e zinj dhe turirin e kuq. Nuhaste tokën dhe kërkonte të hynte në mes të plloçave. Bilali e kapte nga gjembat dhe ia vinte përpara Ibrahimit, që e prekte dhe pastaj qante nga dhimbja. Pas disa ditësh, iriqi u zbut dhe sa herë që dilte Bilali me Ibrahimin në oborr drejtohej nga ata dhe rrinte pa lëvizur, si një kukull e bindur. Kur Bilali ikte, iriqi ndihej i lirë dhe fillonte të gërmonte në oborr. Hynte nën plloça dhe hante barëra me krimba që i gjente me shumicë. Një natë, Paridi erdhi vonë në mesnatë dhe nuk e pa iriqin që rrinte përballë derës me kokën të fshehur nën gjemba. E shkeli dhe ndjeu një therje të fortë në gishtin e madh të këmbës. Këmba i rridhte gjak dhe ai nuk ecte dot. Një javë qëndroi në shtëpi i shtrirë, duke mbajtur këmbën lart mbi krevat. Gruaja e Bilalit i solli një përzierje hitrash dhe lule basami që i kishte shtypur në havan dhe i kishte bërë si pure. Paridi lyente këmbën dhe shikonte rrugën nga dritarja.

Kur Bilali luante me Ibrahimin në oborr, Muhamedi ulej në stol dhe i shikonte. Kur keni ardhur nga Egjipti, e pyeste Bilalin që ndiqte iriqin duke bërtitur. Nuk e di, thoshte Bilali. Stërgjyshi im ka lindur këtu. Mblidhte hekurishte dhe gjëra të hedhura dhe i shiste. Gruaja e tij hidhte fall dhe shikonte filxhan. Njëherë ajo i pa filxhanin pashait turk të Janinës dhe i tha se liqeni do thahej kur pashait të Janinës t'i prisnin kokën.

Kur jeni bërë myslimanë, e pyeste Muhamedi. Bilali ulej pranë tij në stol dhe i thoshte: Jevgjit u bënë myslimanë përpara Muhamedit. Në Jerusalem kishte shumë jevgj që vinin nga Egjipti dhe mblidhnin hekurishte, i drejtonin, i prisnin, i shkurtonin, bënë shufra, thika të vogla, hekura parvazesh dhe gozhdë për të ndërtuar shtëpitë. Ata bënë edhe gozhdët me të cilat kryqëzoheshin njerëzit. Këto gozhdë ishin të ndryshme nga ato që përdoren për shtëpitë dhe vetëm jevgjit mund ta bënin këtë zanat të vështirë. Gozhdët e kryqëzimit kanë kokë të madhe, që çekiçi t'i gjejë dhe të mos dalë huq, janë të gjata dhe shumë të drejta, me majë të mprehtë sepse ato duhet të hyjnë menjëherë në mish dhe nga mishi në dru. Maja e gozhdës bëhet me kanale të holla, që gjaku të kalojë nëpër to dhe të dalë jashtë pa bllokuar çarjen e lëkurës. Gozhdët nuk duhet të thyhen apo të shtrembërohen sepse kjo i sjell shumë dhimbje njeriut dhe i lodh ushtarët. Romakët i rrihnin jevgjit sa herë që gozhdët shtrembëroheshin nga goditjet dhe ata u bënë mjeshtër të këtij zanati nga frika. Përpara kryqëzimit, jevgjit i lyenin këto gozhdë me një vaj të veçantë prej ulliri të verdhë, i cili nuk hahej në atë kohë nga çifutët.

Kur u kryqëzua Jezu Krishti, romakët urdhëruan jevgjit e Jerusalemit të bënin gati gozhdët për ta shpuar. Një jevg punoi gjithë ditën, por kur i thanë se pse duheshin ai e fshehu gozhdën e katërt dhe u zhduk nga qyteti. Bashkë me Krishtin, atë ditë u kryqëzuan për vjedhje edhe dy çifutë të tjerë, por vetëm ai u shpua me tri gozhdë. Që atëherë të gjithë na kanë poshtëruar padrejtësisht. Ne i kemi kursyer dhimbjen Jezu Krishtit sepse po të mos zhdukej një nga gozhdët, ai do të ishte shpuar katër herë dhe jo tre. Të krishterët thonë se ne nuk duhet të kishim bërë asnjë gozhdë, ndërsa çifutët thonë se ne nuk duhet ta mëshironim Jezu Krishtin.

Që nga ajo kohë populli ynë është shpërndarë si rëra në shkretëtirë duke kërkuar gozhdën e katërt, e cila nuk u gjet kurrë. Romakët e kërkuan për disa orë dhe prandaj kryqëzimi i Krishtit u bë të premtën në muzg, kur duhej të ishte bërë të paktën në drekë. Unë i kam parë ikonat e kryqëzimit në kishat e Janinës. Të gjitha e vizatojnë Krishtin mbi kryq me duar të hapura dhe me këmbë të mblodhura dhe asnjëri nuk e di se atij ia mblodhën dy këmbët bashkë, sepse kishin

vetëm tri gozhdë. Nga një për secilën dorë dhe vetëm një për të dy këmbët. Kurse dy të kryqëzuarit e tjerë, që i rrinë Krishtit majtas dhe djathtas, i kanë këmbët e hapura dhe të varura në gozhdë të ndryshme. Kemi qenë gjithmonë të dhembshur, thoshte Bilali dhe mbante Ibrahimin në prehër.

Muhamedi e shikonte duke buzëqeshur dhe e pyeste: Po pastaj si u bëtë myslimanë? Nuk kishim rrugë tjetër, thoshte Bilali duke kaluar dorën e gjatë mbi flokë. Kur na përndoqën nga Jerusalemi, shumë nga ne u shpërndanë në shkretëtirë dhe shkuam në Arabi. Edhe aty kishte çifutë, por ne u shtuam më shumë se ata sepse lëkura jonë e duron diellin dhe vapën pasi është më e trashë se ajo e të bardhëve. Muhamedi ka qenë i zeshkët si ne. Në qoftë se jevgu nuk do ta kishte fshehur gozhdën e Krishtit bota nuk do të kishte myslimanë, e ne do ishim bërë të krishterë siç u bënë romakët. Por unë them se më mirë që u bë kështu pasi edhe ne duhej të kishim fenë tonë, e cila e ndalon kryqëzimin e njeriut me gozhdë dhe nuk e pranon kryqin si shenjë.

Muhamedi shikonte Bilalin dhe mendonte se që kur kishte ardhur ai fshati ishte bërë më i zhurmshtëm, por edhe më i pasur. Një fshat pa myslimanë dhe pa jevgj do ishte shumë monoton. Paridit i ishte shëruar plaga, por megjithatë ecte duke çaluar me një palë pantofla të leshta nëpër shtëpi. Fatimja pastronte shtëpinë me fshesë dhe në drekë gatante musaka pa mish dhe sallatë me karota të ziera. Jani mbante Ibrahimin dhe kur vinte Bilali shkonte në bodrum. Sara i hekuroste këmishët Paridit, ndërsa Ana shikonte Ibrahimin e vogël dhe i thoshte Muhamedit: Ky i ngjan më shumë Bilalit se babait. Muhamedi qeshte dhe duke ngritur kokën nga qielli i thoshte: Jo të gjitha degët e arrës janë njëlloj të gjata.

Në darkë, shtëpia ishte e qetë. Jani dhe Fatimja flinin herët, ndërsa Bilali merrte gruan dhe shkonte në kasolle.

Një natë, Paridi trokiti fort në shtëpinë e Arianit Komnenit dhe Sara u zgjua nëpër gjumë. Këtu është Muhamedi, e pyeti. Jo, tha Sara. Ka dalë që në drekë dhe nuk është kthyer, tha Paridi duke djersitur në këmishë.

Muhamedi nuk u duk në shtëpi as të nesërmen. Jani me Paridin shkuan në pyll, por nuk e gjetën. Bilali doli në fushë dhe e thirri fort. Zëri i tij mbuloi hapësirën, u përplas në pemë dhe u kthye prapë. Muhamedi nuk u përgjigj, ndërsa Paridi nuk fjeti gjithë natën. Rrinte ulur në stil dhe shikonte nga rruga. Sa herë lëvizte ndonjë hije, ngrihej në këmbë. Kur u gdhi, shkoi të flinte dhe Ana Komnena e zgjoi afër drekës kur i solli kulaçin me mjaltë dhe një këmishë të pastër. Paridi ishte i uritur dhe hëngri edhe kulaçin e Muhamedit. Ana Komnena e shikonte nga pasqyra duke i varur këmishën në karrige. Pse e hëngre kulaçin e Muhamedit, e pyeti. Paridi hante pa e pasur mendjen. Edhe po të vijë sot do jetë i lodhur dhe nuk do ketë fuqi të hajë, i tha dhe u afrua te pasqyra. Muhamedi nuk erdhi as të nesërmen. Paridi dukej i këputur dhe flokët i ishin bërë si gjambat e iriqit kur bie shi.

Bilali erdhi në shtëpi pasdite, mori Ibrahimin në prehër dhe u ul në stolin ku rrinte Muhamedi. Dielli i binte në kurriz dhe lëkura shpërndante erën e thartë të rrëshirës. Ku mund të jetë Muhamedi, e pyeti Paridi duke u afruar. Fytyra e tij ishte e verdhë dhe dukej si një njeri që i bën të njëjtën pyetje kujtdo që takon. Në moshën e tij, përveç vdekjes, vetëm një grua mund të të largojë nga shtëpia, i tha Bilali me zë të ulët. Paridi e pa i habitur. Ibrahimin nuk donte të rrinte në prehrin e Bilalit dhe vrapoi mbi plloça kur pa turirin e iriqit që doli duke nuhatur. Bilali e ndoqi nga pas duke bërë titur me zërin e tij të zakonshëm dhe Paridi u fut në shtëpi.

Në mbrëmje, shtëpia u qetësua. Ai doli në oborr dhe u ul në stol. Fshati flinte dhe asnjë hije nuk kalonte përpara shtëpisë. Iriqi vrapoi ngadalë nëpër plloça, i mori erë këmbës së Paridit që nuk lëvizte dhe pastaj shkoi tek arra e vogël dhe fjeti duke mbuluar turirin e kuq në tokë. Paridi

mbështolli këmbët në stol dhe u fsheh në errësirë. Iu kujtua se si numëronte me gishta duke pritur babanë dhe Aliun, ditën që kishin vajtur në pyll për të kapur lepuj. Po të vijë Muhamedi do t'i dukem si një iriq që numëron gjambat e veta, mendoj dhe ndjeu këmishën e lagur nga vesa. Në mëngjes, Jani e gjeti atje. Sytë i kishte të mbyllur dhe i ngjante Ibrahimit në vitet e fundit. Dukej i bardhë dhe i menduar. Shko të flesh, tha Jani, do ta pres unë Muhamedin. Paridi nuk i hapi sytë, por lëvizi këmbët e mpira dhe i shtriu në tokë. Ti beson se do të vijë, e pyeti. Jani ngriti kokën nga rruga. Ana Komnena po vinte me një trastë me kuleç dhe një këmishë të pastër që e mbante me kujdes. Jam i bindur që do të vijë, foli Jani. Ka thënë se do të ndërtojë një xhami për babanë dhe nuk mund të zhduket pa mbajtur premtimin. Paridi hapi sytë kur ndjeu erën e kulaçit që afrohej. Mua nuk ma ka thënë këtë, por e besoj, tha Paridi. Muhamedi është marrë gjithnjë me gjëra të panevojshme. Jani u ul pranë tij në stol dhe trupat e tyre u prekën. Muhamedi e dinte që unë do martohesha me një jevgë, tha me zë të ulët. Paridi ktheu kokën. Kur bëra ushtarin prej druri që doje ti dhe një Skënderbe për Aliun, ai më kërkoi një tokë të rrumbullakët, së cilës unë i dhashë formën e fshatit. Ai e pa gjatë fshatin e gdhendur, pastaj e ktheu nga të gjitha anët dhe më tha se disa njerëz të zinj me çanta të mëdha do të ngrinin shtëpi te fusha e bagëtive dhe unë do të shkoja atje, siç shkova. Jani e kishte zërin të shuar dhe gryka i ngjante me një ibrik të bllokuar. Po tjetër çfarë të tha, e pyeti Paridi. Më tha se shtëpia jonë do bashkohej me shtëpinë e Mihalit, se shtëpia e Arianitit do bëhej shkollë dhe se Petro do mbytej në det. Paridi pa shtëpinë e madhe dhe ndjeu trupin e Janit që po djersinte shumë dhe u ngrit. Djersa rridhte si një rrëshirë nga një trung i vetmuar. Donte ta pyeste Janin akoma për Muhamedin dhe tokën e rrumbullakët, por Ana Komnena ishte afruar dhe po hynte në oborr. Iriqi që kishte dalë në diell ngriti kokën, kur Ana e puthi Janin në faqe. Mban era rrëshirë, tha ajo dhe rrudhi hundët. Jani qeshi, ndërsa Paridi mori kulaçin dhe filloi të hante. Mos e ha më kulaçin e Muhamedit, i tha Ana dhe hyri në shtëpi të varte këmishën e ngrirë.

Në drekë, Hana shkoi te shtëpia e Arianitit. Sytë jeshilë i shkëlqenin. Kishte veshur një fund të gjatë dhe të ngushtë dhe flokët i kishte krehur me kujdes. Në vesh kishte varur dy vathë të vegjël ngjyrë ulliri, të cilët e tregonin më të dobët, por dhe më të zbehtë. Sara po priste trëndafilat në oborr. Duart i kishte mbathur me lecka që të mos ia shponin gishtat. Hana i rrinte pas kurrizit duke ngritur nga toka degët e këputura të trëndafilit dhe Sara ndjeu që ajo donte t'i thoshte diçka. Pse je veshur kështu, e pyeti duke i parë vathët. Hana u skuq dhe ktheu kokën nga dera sikur donte të sigurohej se asnjeri nuk po i dëgjonte.

Muhamedi është në shtëpinë time dhe do të martohet me mua. Sarës iu dobësuan duart dhe ndjeu një gjemb që i shpoi gishtin. Je çmendur, e pyeti duke hapur sytë. Muhamedi është njëzet vjet më i vogël se ty. Edhe ti ishe njëzet e pesë vjet më i vogël se Ibrahimit kur u martove, tha Hana duke folur shpejt. Sara thithi gishtin e gjakosur dhe u ul në oborr, aty ku rrinte Mihal Komneni dhe përpara tij edhe Arianiti. Hana mbeti në këmbë si një nxënëse që mezi pret të largohet me vrap për në shtëpi, pasi t'i kenë dhënë leje. Jakën e këmishës e kishte të ngrirë dhe në qafë i shtrëngohej një shall i hollë, i tejdukshëm. Damarët i ishin fryrë, ndërsa sytë jeshilë i ishin errësuar si një pyll në një ditë pa diell.

Muhamedi është nipi i burrit tënd, tha Sara dhe kjo e bën këtë martesë edhe më të papranueshme. Hana u ul dhe sytë iu varën nga ënjtja. Ti ke jetuar shumë vjet me mua dhe me Vasilin dhe e di shumë mirë se sa kam vuajtur për të pasur një fëmijë. Vasilit i vinte turp që nuk më mbarste dot, ndërkohë që i vëllai i tij u bë me shtatë djem. Muhamedi më tha se ai do martohet me mua dhe në moshën time kjo është mundësia e fundit për të pasur një familje. Sara e shikonte se si i dridhej qafa nën shall dhe ndjeu që u përlot.

Kur babai kishte ikur ajo kishte jetuar mbi dhjetë vjet në një shtëpi me Hanën dhe Vasilin. Dashuria e tyre, nëse kishte ekzistuar, ishte shuar qetësisht si një mangall në dhomën e një të sëmuri të pashpresë. Mungesa e fëmijës i kishte bërë si një vëlla dhe një motër që jetonin nën një çati duke pritur një kukull për të shtyrë kohën. Vasili kishte shkuar disa herë në Janinë për të takuar një doktor dhe gjithmonë kthehej me fytyrë të çelur, mbyllej në dhomë me Hanën dhe numëronte ditët. Kur Hana kontrollonte të brendshmet në fillim të muajit, ai e priste pas derës, si një fajtor dhe pastaj shkonte në pyll nga ku kthehej i shkatërruar. Shija e vezëve të prishura të Hanës i rrinte gjithë kohën në gjuhë. Hana qante në dhomën e saj, ndërsa Sara lexonte në kuzhinë duke bërë sikur nuk kuptonte. Njëherë Vasili i tha Hanës se kishte vendosur të bëhej mysliman sepse ndoshta kjo e ndihmonte të pillte si gjithë burrat e tjerë, por pastaj kishte ndërruar mendje dhe kishte thënë se perëndia është një dhe jo dy, prandaj, nëse ajo e kishte ndëshkuar, ai nuk kishte shpëtim, pavarësisht se do falej nga perëndimi apo nga lindja e shpirtit. Fetë janë pozicionet që zgjedhin njerëzit për të parë perëndinë, i kishte thënë Hanës. Të krishterët i rrinë perëndisë në perëndim, myslimanët në lindje. Ç'ndryshim ka nëse ne të dy bashkohemi në dhomë apo në qilar? Pulën dhe gjelin lëri në rrugë apo shtriji në krevat njëlloj do ta bëjnë vezën. Çoji në kishë apo mbylli në xhami prapë njëlloj do ta bëjnë atë që kanë për të bërë. gruaja e Ibrahimit donte një vajzë, por Ibrahim i bëri vetëm djem edhe si i krishterë, edhe si mysliman.

Vasili vdiq përpara se të lindte Ana dhe ndoshta kishte të drejtë, mendoi Sara duke shtrënguar gishtin që i rridhte. Ibrahim bëri një vajzë, por jo kur ndërroi fenë, por kur ndërroi gruan.

Hana ishte ulur në gjunjë dhe priste. Ishte tre vjet më e madhe se Sara, por vetmia ia kishte mbushur cepat e syve me rrudha të imëta, të cilat ajo i fshinte me pudër. Megjithatë ishte akoma e bukur dhe e freskët, ndonëse fliste pak dhe sillej si një mobilie, siç thoshte Komneni. Sara qeshi me vete duke menduar se, po të martoheshin, Hana do dukej si një mobilie dhe Muhamedi do t'i rrinte sipër si një tas me hurma. Hana ishte halla e saj, por atë ditë dukej si një çupëlinë që kërkon leje të martohet.

I vuri dorën mbi kokë dhe e pyeti: Ia kërkoje ti Muhamedit të martoheshit? Jo, tha Hana. Ai erdhi në shtëpinë time një pasdite. Ka ardhur Bilali në shtëpi, më tha, dhe dola se ai bën shumë zhurmë. Biseduam derisa u err, por ai nuk po lëvizte dhe më pyeti nëse mund të flinte në shtëpinë time. Ai është nipi i Vasilit dhe unë nuk mund t'i thoshja jo. mirë, i thashë, por a i ke lajmëruar vëllezërit. Nuk e kanë mendjen tek unë, më tha, njëri ngrohet me Fatimen, tjetri me vajzat e fshatit. Fillova të qesh dhe i rregullova krevatin. Natën m'u duk sikur dikush m'u fut në dhomë dhe po më shihte.

Në mëngjes, Muhamedi ishte zgjuar përpara meje dhe e gjeta duke parë nga dritarja. I bëra për të ngrënë dhe pimë kafe me sheqer. Mendova se në drekë do ikte, por ai mori një nga librat e Arianitit dhe filloi të lexonte i ulur në divan. Unë fshija shtëpinë dhe herë pas here hyja në dhomë. Ai ngrinte kokën, më buzëqeshte dhe lexonte prapë. Mendova se do hante drekë dhe pastaj do ikte dhe bëra fasule me pastërma dhe një kek me mollë. Kur u ulëm në tavolinë, Muhamedi hante ngadalë dhe më shikonte në sy. Unë ngrija sytë dhe ai qeshte. Gjithmonë e kisha parë si një fëmijë të çuditshëm dhe të urtë, por atë ditë m'u duk si një burrë dhe u skuqa duke menduar. Kur mbaruam drekën, Muhamedi u ul prapë në divan dhe mori librin. Unë shkova në dhomë dhe dëgjoja pas derës fletët e librit që lëviznin në heshtje. Lëvizja e fletëve nuk ishte rregullt dhe dora e Muhamedit më dukej e shqetësuar. Qëndrova në dhomë deri në muzg. U veshja dhe shkova te Muhamedi, i cili rrinte në errësirë me librin në prehër. Do dal pak, i thashë duke menduar se edhe ai do ikte. Muhamedi ngriti kokën dhe më tha: Unë do lexoj edhe pak. Ndeza qirinjtë një nga një dhe e afrova shandanin pranë tij. Sytë e kaltër të Muhamedit më

shikonin, por unë u përpoqa të tregohem e sigurt dhe i thashë duke qeshur: Vajti vonë, edhe ty të presin në shtëpi. Në këtë fshat njeriun e pret vetëm gruaja ose fëmijët, tha Muhamedi qetësisht. Unë nuk kam as grua, as fëmijë. Unë u skuqa, por qirinjtë ishin larg meje dhe ai nuk e shikonte pëstjellimin tim.

Dola dhe erdha deri afër shtëpisë tënde. Doja të hyja brenda, por nuk ndihesha mirë dhe e dija që fytyra do më tradhtonte. Kisha pranuar në shtëpi një fëmijë dhe tani atje më priste një burrë. E ndieja që kur të kthehesha diçka do të ndodhte dhe kisha frikë. Më dukej sikur për herë të parë në jetën time kisha lënë takim me një burrë. Me Vasilin nuk e kisha provuar këtë dobësim të trupit sepse ne na martuan familjet dhe u takuam vetëm në dhomën e gjumit ku ai më priste duke u dridhur nga turpi dhe unë u zhvesha siç më kishin mësuar. Çdo gjë që kam bërë me Vasilin ma kishte mësuar nëna më parë, por askush nuk më kishte thënë si duhet të silllesh me një burrë që të vjen në shtëpi. Mbeta një copë herë përpara derës, por nuk trokita. Ishte errësuar dhe hëna ecte si një hap mbi kalldrëm. Edhe unë eca, pa e ditur se ku po shkoja. Kalova nga kisha dhe pashë kabanën që ishte mbushur me yje. Kur u afrova te shtëpia e Ibrahimit, në oborr dallova Paridin, i cili ishte ulur në stol dhe kishte mbledhur këmbët poshtë vetes. Oborri ishte i qetë, ndërsa Paridi priste në errësirë. Pret Muhamedin, mendova dhe u fsheha pas një muri duke e parë. Herë pas here Paridi kthente kokën dhe unë i shikoja fytyrën e zbehtë dhe të lodhur. Flokët i kishte të pakrehur dhe mjekra kishte nisur t'i nxinte. Një herë vendosa t'i afrohem dhe t'i them se Muhamedi ishte në shtëpinë time, por kjo m'u duk si tradhti. Nuk isha mësuar të tradhtoja një burrë që ditën e parë. Kisha pak ftohtë dhe u ngjesha pas gëlqeres së murit për t'u ngrohur. Kur qirinjtë në dhomën e Janit dhe të Fatimes u shuan, Paridi u ngrit dhe shkoi tek arra e vogël. Zgjati dorën dhe që aty lëvizi diçka. Ishte iriqi. Paridi ia ngacmonte turirin me një degë të thyer dhe iriqi ngrihej në të dy këmbët si një lepur i uritur. Kafshonte degën dhe përplaste kokën pas gjembave kur e kuptonte se dega nuk hahej. Paridi ia afroi degën disa herë, por më në fund iriqi u struk dhe nuk u zgjat më nga gënjeshtra e tij. E kuptova se Paridi donte të vriste kohën dhe vendosa të kthehem në shtëpi.

Muhamedi ishte në divan dhe kur unë hyra ai u ngrit dhe më tha: Mirë se erdhe. Mua m'u duk e pasjellshme që ai më uronte mirëseardhjen në shtëpinë time dhe i thashë se kisha parë Paridin që po priste në oborr i shqetësuar. I the që unë jam këtu, më pyeti Muhamedi që dukej sikur kishte shtatë hije pas degëve të shandanit. I tregova që nuk i kisha thënë, por ai duhej të ikte sepse unë nuk mund të bëja sikur nuk dija gjë, ndërkohë që të gjithë ishin në merak. Muhamedi afroi kokën te shandani dhe sytë e tij të kaltër morën shkëlqim prej guri. Unë kam ardhur për të mos ikur, më tha. Unë qesha si një njeri që nuk e kupton atë që ka dëgjuar, por me sa duket e qeshura ime atij iu duk si shprehje kënaqësie dhe i dha më shumë siguri. Por, tani që e mendoj, atë çast më duket sikur Muhamedi nuk kishte nevojë për guxim sepse ai kishte ardhur të më thoshte diçka që e dinte prej kohësh. Dua të martohem me ty, më tha dhe unë pashë flakët e qirinjve që ngatërroheshin me njëra-tjetrën si gishta që më mbulonin fytyrën. Mbeta pa frymë dhe i thashë: Je çmendur, unë nuk martohem me kalamaj.

Muhamedi filloi të qeshte dhe u ul në divan. Unë për këtë kam ardhur. Kam vite që pres të rritem dhe nuk jam më një kalama, siç nuk je ti një plakë. Unë jam burrë dhe ti je një grua që duhet t'i japësh fund vetmisë dhe të kesh familjen që të është mohuar nga fati. Unë ndjeva një të skuqur në faqe dhe në sqetulla dhe m'u duk sikur ai po tallej me jetën time. U afrova dhe i bërtita të dilte jashtë, por Muhamedi nuk lëvizi. Më shikonte qetësisht dhe unë u ndjeva shumë e dobët. Shkova në dhomë dhe u shtriva në krevat. Hijet e qirinjve më ndoqën nga pas duke hyrë nën derë. Fillova të qaj sepse m'u duk vetja një plaçkë e lagur që e kanë varur në mes të fshatit për t'i treguar kalimtarëve se vetmia është një sëmundje që nuk shërohet në diell. Gjithë jeta ime më kaloi

përpara syve. Kisha menduar gjithmonë të martohesha, por vitet kishin ikur pa kuptuar dhe unë e kisha humbur besimin se fshati mund të më jepte një burrë, i cili ishte shfaqur atëherë kur ndoshta nuk më duhej më. Trupi im ishte flashkur si një i zier gjatë dhe ndoshta aftësinë për të bërë fëmijë e kisha humbur, si një gjë të panevojshme. Përse mund të më duhej një burrë, përveçse për të kaluar ditët e mbetura?

Shkova te dritarja dhe pashë rrugën. Nga dhoma tjetër nuk dëgjohej asgjë, por fryma e Muhamedit i lëvizte qirinjtë që hynin në dhomën time, duke u lëkundur. U afrova te pasqyra dhe pashë veten. Në errësirë rrudhat përreth syve dukeshin më të thella. Flokët më ishin hapur si leshterikë të tharë dhe pa e pasur mendjen mora një krehër dhe nisa t'i rregulloj. Pastaj u shtriva dhe më zuri gjumi duke mos menduar.

Sot në mëngjes ndihesha më mirë. Lëkurën e kisha më të qetë dhe rrudhat kishin humbur lartësinë. Nuk ia vlen të mërzitesh, thashë me vete. Pavarësisht se Muhamedi është njëzet vjet më i vogël, prapë është një burrë. M'u kujtua nëna ime që thoshte se një grua nuk plakët deri ditën që djemtë e vegjël në rrugë kthejnë kokën për ta parë.

U veshja shpejt dhe dola. Muhamedin e gjeta atje ku e kisha lënë. Fytyra e tij ishte e bardhë, por nuk dukej i lodhur. Nuk e pyeta nëse kishte fjetur, por bëra mëngjesin me çaj dhe e shtrova në tavolinë. Hëngrëm të dy pa folur. Nuk e shikoja në sy, ndërsa ai pinte çajin ngadalë si një njeri që nuk e pret asgjë jashtë shtëpisë.

Kur do ikësh, i thashë. Muhamedi dukej edhe më i qetë dhe nuk u ngut të përgjigjej. Kur të martohem me ty, më tha. Vendosa ta përballoja atë bisedë qetësisht, pa u skuqur dhe pa u nervozuar si një grua e pjekur, e cila duhet të arsyetojë propozimet që i vijnë. Pse do të martohesh me mua, e pyeta. Muhamedi la gotën e çajit dhe kaloi dorën mbi mbulesë sikur donte të më tërhiqte vëmendjen për ato që do të thoshte. Unë nuk kam më një familje, më tha. Jani u martua, dy vëllezër kanë vdekur dhe dy të tjerë ikën në Janinë. Babai vdiq, ndërsa Paridi jeton në legjendat greke. Ditën që Sara iku nga shtëpia e kuptova se isha rritur dhe duhet të krijoja familjen time. Ti më ke pëlqyer që kur kam qenë i vogël. Një ditë, kur po hanim drekë me Mihalini dhe Metodin në shtëpinë e Arianitit ti u mërzite kur unë thashë se ditën që njerëzit nuk do mund të lindin më njerëz, si ti, atëherë nuk do ketë më as njerëz dhe as perëndi sepse perëndia nuk jeton dot pa njerëzit kurse njerëzit jetojnë pa perëndinë, por jo pa njëri-tjetrin. Ti u ngrite nga tavolina dhe më the se ti nuk kishe lindur për faj të Vasilit, xhaxhait tim, por me një burrë tjetër ndoshta do të lindje. Që atë ditë kam menduar se ai burri tjetër duhet të isha unë. Kishe veshur një fustan të ngushtë ngjyrë vishnje që të tregonte të qartë dhe hyjnore si një perëndeshë e palumtur me njerëzit. Dole jashtë duke fshirë lotët dhe unë të ndoqa me sy. Kanë kaluar shumë vjet që atëherë dhe bukuria jote është pasuruar. Tani je e bukur si një grua dhe e pjekur si një nënë. Unë e njoh veten time. Grave në moshën tënde mund t'u ngjaj i vogël, por vajzave të reja i dukem si një plak që rri në stolin e shtëpisë dhe lexon qiellin si një filxhan. Nuk dua të martohem si një plak, por si një fëmijë që rritet në krevatin e gruas së vet.

Muhamedi pushoi dhe unë kalova dorën mbi rrudhat e mia, por nuk i gjeta. Ai më kishte përkëdhelur me fjalë dhe vajza që jetonte brenda së kaluarës sime u ngrit nga tavolina dhe shkoi në dhomë të provonte fustanin ngjyrë vishnje që kisha vite pa e veshur. U zhvesha, dola lakuriq përpara pasqyrës, pashë gjinjtë e mi të fryrë me një thith të zi në mes, lëshova flokët mbi supë, pashë një nishan në supin e majtë, këmbët e bashkuara te kofshët e forta dhe u ngopa me erën e freskët të sqetullave të mia me push të zi. Veshja fustanin dhe kuptova se trupi im nuk kishte marrë ujë të tepërt, si një barkë që kalon rininë duke u endur nëpër një det të vetmuar. Isha e re dhe e bukur si një mobilie që zbukuron shtëpinë e kujtimeve të veta. Sytë jeshilë rrinin mbi trup si mbi një livadh dhe isha gati të dilja në rrugë që të gjithë ta shijonin rininë time.

Sigurisht që nuk i bëra të gjitha këto marrëzi në prani të një burri që donte të më bindte se nuk ishte një fëmijë, por imagjinoja veten time me fustanin vishnje, ndërkohë që Muhamedi më shikonte me sy të hapur si një gotë profetike e mbushur me qiell. Sikur të ishte aty, do të dukesh si një nuse që e kanë mbajtur për pesëmbëdhjetë vjet nën duvak dhe që më në fund ia heqin për t'ia çuar burrit në dhomën ngjitur. Plakat e shtëpisë e kontrollojnë dhe habiten kur shohin se duvaku ia ka mbajtur fytyrën të paprekur nga pluhuri i viteve. Unë u skuqa mbi tavolinë siç do skuqej çdo nuse që pret ta zbulojnë dhe pastaj ta përdorin. U drodha lehtë dhe mora ngjyrën e çajit në gotën e Muhamedit. Megjithatë, e ndalova të skuqurën që më vinte nga këmbët dhe e kuptova se Muhamedi kishte të drejtë kur thoshte se mund të isha një nënë e pjekur. Të ndalosh të skuqurën kërkon një teknikë të caktuar, e cila fitohet vetëm me përvojë.

Ti je nipi i burrit tim, i thashë Muhamedit dhe kjo quhet një martesë brenda familjes që askush nuk e pranon. Muhamedi qeshi sepse e kuptoi që kisha filluar të shoshitja anët e bardha dhe të zeza të martesës, si një jelek, i cili në stinë të ndryshme mund të vishet nga të dyja anët. Kisha tradhtuar veten, gjë që më pëlqeu, sepse kjo mungesë përvoje më bënte të ndihesha më e re.

Në këtë fshat kanë ndodhur çudi më të mëdha se kjo, tha Muhamedi. Babai yt u martua me hallën e vet, ndërsa Sara u martua me babanë tim që ishte njëzet e pesë vjet më i madh se ajo dhe kishte gjashtë djem. unë ula sytë dhe flokët më shpuan kokën. Muhamedi kishte të drejtë, por fataliteti i asaj që tha më ngurtësoi. M'u duk vetja si një kukull, e cila imiton kukulla të tjera që janë kalbur në bodrum. Pse ndodh kjo me ne, e pyeta Muhamedin. Ai më pa gjatë në sy dhe e ngrohu dorën mbi gotën e çajit. Vijat e pëllëmbës iu veshën me avull që ai e fshiu sikur po largonte një mjegull. Ne të gjithë jetojmë si heronj të fantazisë njerëzore, më tha. Unë jetoj si profet, Arianiti besonte se ishte Abraham, Isak Komnenit i dukej vetja si Jezu Krishti, Sali Benishi besonte se Aishja e tij i ngjante gruas së Muhamedit, Bilalit i duket vetja si jevgu që vodhi gozhdën e kryqëzimit, Ana është e bindur se do bëhet princeshë si Ana Komnena e vërtetë dhe Niko ndryshoi emrin që të jetojë si Paridi. Bota rri në vend sepse ne besojmë se shpirti i dikujt tjetër jeton në trupin tonë dhe kjo na bën dembelë. Bota ka mijëra vjet që nuk ndryshon sepse secili nga ne kujton se një shpirt më i ndritur do t'i tregojë rrugën e duhur. Na duket sikur ecim, por në fakt ndjekim hapat e dikujt që ka kaluar përpara nesh dhe kthehemi aty ku u nisëm. Por fshati ynë është i vogël për të mbajtur gjithë këta heronj dhe disa duhet të ikin që të vijnë disa të tjerë. Arianiti iku që babai im të bëhej Ibrahim, pastaj iku Isaku që të vinte Bilali me gozhdën e tij. Edhe martesë jonë është pjesë e këtij cikli, prandaj është e paarsyeshme ta shmangim, tha Muhamedi që dukej sikur po lexonte në fytyrën time. Unë nuk e mbajta dot të skuqurën që më doli mbi lëkurë dhe u ngrita nga tavolina. Doja të qaja dhe shkova në dhomë, por nuk nxora lot. Avulli i çajit më kishte veshur faqet. U kreha dhe vura vathët e ullirit që më freskuan trupin. Qafën e kisha qull dhe vura një shall. Dola nga dhoma. Muhamedi ishte në tavolinë. Çfarë do për drekë, e pyeta. Ai më pa me ëmbëlsi dhe sytë e tij m'u dukën si dy hurma. Oriz me kanellë si ai që bën Sara, më tha. Unë u ftoha, si një nuse e re pa duvak dhe erdha te ti të pyes si bëhet orizi me kanellë.

Sara qëndronte në diell dhe lëkura i ishte thekur, ndërsa Hanës i ishte hapur shalli duke folur dhe i kishin dalë damarët që zgjatëshin nën mjekër duke u zgjeruar dhe zbrisnin poshtë në kraharor. Sara kishte mbetur pa frymë duke lexuar hartën e zemrës së saj të ftohtë. Kishin jetuar bashkë për një kohë të gjatë dhe ajo kishte menduar se Hana e kishte humbur ndjeshmërinë. Por me sa duket vetëm e kishte fshehur ashtu siç bën një mobilie, që tregon lustrën, por jo drurin që e ka bërë. i kujtohej dita kur Hana ishte martuar me Vasilin. Ajo rrinte në krah të nuses, ndërsa Thanasi në krah të dhëndrit. Kur kishin dalë nga kisha, Arianit Komneni ishte afruar, e kishte puthur Hanën dhe i kishte thënë diçka në vesh. Gjergji që vinte pas çiftit kishte ndalur hapat dhe



Arianiti kishte ikur duke parë Vasilin. Çfarë i the Hanës në vesh, e kishte pyetur ajo në mbrëmje. I thashë që ishte e bukur si një hënë që ndriçon ditën, kishte thënë babai. E si ndriçon hëna ditën, e kishte pyetur Sara. Hëna ndriçon kur dielli që i rri përballë është i dobët, kishte thënë babai duke parë Vasilin.

Hana rrinte në oborr dhe rrezatonte mbi plloçat e verdhë të mesditës. Ç' do bësh, e pyeti Sara. Do bëj oriz me kanellë, u përgjigj Hana. Sara qeshi dhe mendoi se nuk kishte më arsye ta pyeste se ç' do bënte me martesën. Hana mezi priste të kthehej në shtëpi duke i çuar Muhamedit pajën me oriz në një pjatë të zbukuruar me kanellë.

Thirri Ana Komnenën që erdhi duke tërhequr gërshetin e zi nëpër shtëpi. Shko thuaji Paridit se Muhamedi është në shtëpinë e Hanës dhe nuk do vonohet. Çfarë bën Muhamedi në shtëpinë tënde, pyeti Ana duke parë vathët prej ulliri. Hana u përtyp, por Sara nuk e la të fliste. Muhamedi është kthyer në tokën katrore, it ha Sara. Ana u nis me vrap duke e parë Hanën me bisht të syrit. Muhamedi shkoi në shtëpi të nesërmen. Dukej i menduar dhe ecte ngadalë. Paridi i kishte krehur flokët dhe mbante një këmishë të hekurosur. Iriqi kishte dalë në oborr, ndërsa kokën pa qafë e mbante të zgjatur nga rruga. Bilali sapo kishte ardhur. Kur pa Muhamedin, doli nga shtëpia dhe thirri me zë të lartë: Muhamed, të trashëgohesh! Muhamed, të trashëgohesh! Iriqi u shurdhua nga zëri i tij i lartë dhe gjembat iu shkurtuan, ndërsa Muhamedi u ul në stol. Jani dhe Paridi erdhën ta takonin. Jani kishte përveshur mëngët duke punuar në bodrum, ndërsa Paridi ishte i zbehtë dhe i ftohtë. E shikonin Muhamedin në sy dhe prisnin. Pse nuk na the ku do shkoje, e pyeti Paridi. Muhamedi vuri duart mbi gjunjë dhe shkoi thonjtë, siç bënte kur ishte i vogël. Po t'u kisha thënë se ku do shkoja nuk do më linit të martohesha. Po Hana ka pranuar të martohet me ty, vazhdoi Paridi që rrinte në këmbë. Hana do vijë të jetojë në shtëpinë tonë, u përgjigj Muhamedi. Jani pa Paridin dhe i bëri shenjë të qetësohej, por ai dukej si një kalë që nuk ndalon dot. Pse nuk jetoni në shtëpinë e Hanës, e pyeti. Muhamedi ngriti kokën dhe pa Janin në sy. Shtëpia e Hanës do shembet dhe do bëhet xhami. Paridi u ngurtësua, iu afrua stolit dhe i tha Muhamedit: Kjo është një lloj sikur të ndërtohet shtëpi në det. Kjo është një lloj sikur të mos ndërtohet një varkë në det, tha Muhamedi. Bilali që dëgjonte pas kurrizit të tyre erdhi dhe e puthi Muhamedin në faqe. Do më lësh mua të këndoj ezanin e parë, e pyeti me sytë që i ndrisnin. Muhamedi e pa me qetësi dhe duke u ngritur i tha: Pse jo? Zëri yt është më i fortë se kambana e kishës. U fut në shtëpi, ndërsa Bilali i shkoi pas, deri te dera. Jani me Paridin mbetën në këmbë duke e ndjekur Muhamedin me sy. Ai dukej si një pemë që shëtiste në oborr. Iriqi ishte afruar te stoli dhe i merrte erë vendit ku ishte ulur Muhamedi. Paridi uli kokën dhe flokët i ranë mbi sy. Po iki, i tha të vëllait, nuk ka më vend për mua këtu. Jani i hodhi dorën në sup, por nuk foli. Fatimja kishte dalë në oborr me një pjatë kabuni që ia dha Bilalit dhe ky ia çoi Muhamedit duke kënduar, sikur po bënte prova.

Kur Hana erdhi në shtëpi, Paridi iku të jetonte në shtëpinë e Arianitit. Sara dhe Ana Komnena u gëzuan që ai vendosi të jetonte me to dhe në darkë e prisnin të dyja në oborr, ndërsa çdo mëngjes i bënin kulaç me mjaltë. Sara i tha se mund të kthehej kur të donte në shtëpi, por nuk duhej të sillte vajzat e fshatit aty. Paridi pranoi. Nganjëherë shkonte në pyll dhe kur kthehej, Sara ia pastronte pantallonat e mbushura me gjethe.

Hana solli në shtëpi krevatin e madh ku kishte fjetur me Vasilin dhe bashkë me Sarën e vunë në dhomën që shikonte nga arra e vogël. Hana kishte sjellë me vete edhe një palë perde të rënda që e mbulonin dritaren dhe degët e arrës binin aty duke vizatuar hije. Bilali bashkë me djalin e tij ngarkuan të gjitha plaçkat dhe sëndukët e mbushura me enë, me qirinj e peceta dhe shtëpia e Hanës u boshatis për disa ditë.

Natën e parë që Hana dhe Muhamedi fjetën bashkë, Fatimja dëgjoi një zhurmë dhe doli në oborr. Muhamedi rrinte i ulur në stol dhe shikonte hënën. Ishte i mbuluar me djersë dhe dukej sikur qante. Iriqi ishte zgjatur nga ai duke lëpirë buzët. Pas pak, Hana doli me një këmishë nate të bardhë dhe e thirri Muhamedin që u ngrit dhe i shkoi pas duke e mbajtur kokën nga rruga. Ajo i kishte lëshuar flokët dhe dukej e ashpër, si një nënë që thërret djalin në shtëpi. Fatimja u kthye në dhomë dhe i tha Janit: Muhamedi po qante në oborr. Jani i vuri dorën mbi bark dhe e afroi nga vetja. Ngrohtësia e trupit të Fatimes ia fryu lëkurën. Burri e kupton moshën e gruas në krevat, i tha dhe ia kaloi dorën poshtë barkut të freskët dhe të lagur.

Pas disa javësh, Muhamedi thirri Andrean, djalin e Naumit që erdhi duke djersitur. Tëmthat i ishin thinjur, ndërsa muskujt i ishin shëndoshur. Muhamedi e priti në oborr. Andrea shikonte shtëpinë që kishte ndërtuar me të atin duke e matur me sy. Më duket më e vogël, i tha Muhamedit duke ecur përmbi plloça. Është ndërtuar për një familje, tani jemi dy, tha Muhamedi. Kur u afruan te shtëpia e Hanës, Andrea ndaloi. Shtëpia ishte shumë afër kishës dhe ai e mati largësinë me hapa. Muhamedi rrinte në diell dhe shikonte hapat e gjatë të Andreas, i cili pasi ecte pak, ngrinte kokën nga kambanorja dhe pastaj nga çatia e shtëpisë së Hanës.

Nuk kam ndërtuar kurrë një xhami përballë kishës, sesi më duket, tha Andrea duke u futur nën hijen e kambanores sikur donte të mbrohej. Si të duket, e pyeti Muhamedi. Andrea u mendua dhe ngjeshi shpinën pas murit të kishës duke e parë Muhamedin në sy. Më duket sikur po e ndajmë fshatin në mes si një bukë misri, i tha.

Drita i hyn njeriut nga dy sytë dhe zëri nga dy veshët. Edhe Zoti kërkon dy dyer për të ardhur në fshat, tha Muhamedi. Andrea tundi kokën dhe doli nga hija e kishës. E kujt është kjo shtëpi, e pyeti. E gruas time, u përgjigj Muhamedi. Andrea ngriti vetullat dhe i erdhi afër. Çfarë i ke premtuar që ta dha për xhami? Muhamedi shtyu derën e shtëpisë dhe dhoma e madhe e oxhakut u hap përpara tij si një bark gruaje i boshatisur. Eci dhe hapat ngritën pluhur mbi çimento. I kam premtuar një fëmijë, i tha Andreas duke hapur dritaren. Andrea, që ishte pas kurrizit të Muhamedit, ndali hapat dhe qetësia doli nga dritarja në rrugë. Po nëse nuk lind ai fëmijë? Nuk e di, foli Muhamedi. Nuk ka profet që nuk gënjen.

Andrea u zgjat nga dritarja dhe kambanorja e kishës iu duk shumë afër, aq sa hijen e saj prej peme nuk e nxinte dhoma. Babai i kishte thënë se ajo kambanore nuk ngjante me asgjë tjetër sepse kishte përmasat e trupit të Arianit Komnenit. Zakonisht Naumi i bënte kambanoret dy herë më të larta se kisha, por Arianit Komneni nuk bindej. Ai kishte vizatuar disa lloj kambanoresh, të gjata dhe të holla, pastaj më të ulëta dhe të trasha, me zgavër të rrumbullakët ose katrore, me shkallë nga jashtë dhe nga brenda, derisa kishte gjetur një të mesme, e cila besonte se do t'i pëlqente Arianitit dhe që mund të ndërtohej duke hipur në skela jo shumë të larta, si ato që përdorte David Selenica në Voskopojë. Ia kishte vënë Arianitit përpara, por ai kruante mjekrën dhe nuk vendoste. Për disa ditë punimet u ndërpre. Arianiti ecte me hapa të mëdha përpara mureve të pambaruara të kishës, e cila i ngjante një beli pa trup. Naumi e shikonte dhe thyente gurë nga mërzia.

Një natë, Arianiti i kishte thënë Naumit se e kishte gjetur formulën e gjatësisë së kambanores. Ma thuaj, kishte pritur Naumi. Mendo sikur kambana të jetë një shishe me ujë e kthyer nga toka. Po e mendoj, i tha Naumi duke parë poshtë. Në qoftë se shishen e lidhim si kambanë, por me grykën poshtë dhe pastaj e tundim majtas-djathtas, atëherë uji do të derdhet nga të dy anët duke u hapur si krahë në ajër. Lartësia e kambanores duhet të jetë sa largësia mes pikës së fundit të ujit nga e djathta dhe pikës së fundit nga e majta. Bukur, tha Naumi, por nuk e provojmë dot sepse

duhet të ngremë një skelë dhe të derdhim ujë, duke mos pasur një pikë në ajër ku të lidhim shishen. Por edhe nëse vendosim ta bëjmë këtë eksperiment, sa e lartë do të jetë skela?

Arianit Komneni kishte kaluar dorën mbi flokët e bardhë siç bënte zakonisht kur donte të thoshte diçka që e kishte vendosur me kohë. Bëjmë një provë në përmasa më të vogla, tha. Skela do jetë e gjatë sa unë.

Të nesërmen ndërtuan një skelet dërrasash në lartësinë e Arianit Komnenit dhe duke i hapur një vrimë lart kaluan aty një litar në të cilën lidhën një shishe. Grykën e shishes e lidhën me spango dhe kur Arianiti bëri shenjë Naumi filloi ta tundte. Uji u derdh majtas, pastaj djathtas duke bërë pellgje të vogla në tokë. Arianit Komneni mati largësinë mes dy pellgjeve dhe duke e mbledhur me gjatësinë e trupit të vet dhe pastaj duke i shumëzuar të dyja bashkë, me disa herë i dha Naumit lartësinë e kambanores.

Kur kambanorja mbaroi, Naumi i tha Arianitit: Kjo kishë ka përmasat e tua. Arianiti Komneni hapi krahët në ajër dhe tha: Po ta mbushim shishen me verë, kambana do tundej si e dehur dhe kisha do ishte më e madhe.

Andrea doli jashtë dhomës dhe Muhamedi e ndoqi. Sa të lartë ta bëj minaren, e pyeti. Muhamedi tregoi kambanoren me gisht dhe tha: Aq sa ajo aty. Andreas i kaloi një buzëqeshje mbi fytyrë. Ti je më i shkurtër se Arianit Komneni, i tha. Ç'do të thuash, e pyeti Muhamedi që nuk e dinte historinë e ndërtimit të kambanores. Andrea ngriti kokën lart dhe tëmthat e thinjur u zverdhën në diell. Kjo kishë është bërë si një kostum, i tha. Babai mati përmasat e trupit të Arianit Komnenit dhe e ndërtoi kishën duke qepur gurë me gozhdë. Asnjëri nuk mund ta bëjë dot më këtë ndërtim sepse formulën e ekuilibrit mes lartësisë, gjatësisë dhe gjerësisë e dinë vetëm ata të dy. Muhamedi u afrua dhe filloi të shikonte kishën. Kambanorja kishte një kupolë të rumbullakët që dukej si kokë njeriu. Suvaja kishte rënë vende-vende edhe trarët skeletikë kishin dalë në diell si damarë që ngrohen.

Bëje me përmasat e trupit tim, tha Muhamedi pa e parë Andream në sy. Andrea u afrua dhe i vuri dorën në gjoks. Zemra e Muhamedit nuk ndihej. E rrotulloi duke e parë nga koka te këmbët dhe duke e vendosur në drejtim të kambanores, e cila i dilte Muhamedit mbi kokë. Ti i ke këmbët e shkurtra dhe minareja do duket si një burrë i parritur, tha Andrea. Kam lindur gjashtëqind vjet më vonë prandaj dukem më i vogël, tha Muhamedi duke i kthyer shpinën kishës.

Andrea e shembi shumë shpejt shtëpinë e Hanës. Bilali dhe i biri mbledhën gurët në një cep dhe trarët e thyer i dogjën. Fshati u mbush me hi dhe era e djegur hyri në çdo shtëpi. Kur dolën themelet, djali i Bilalit filloi të gërmonte me duar dhe gjeti një unazë të vjetër që ia dha Muhamedit, por atij nuk i pëlqeu dhe Bilali e vuri në gisht. Andrea vendosi t'i forcojë themelet dhe ditën që u vu guri i parë i xhamisë Bilali theri një qengj. Gjakun e shpërndau nëpër themele duke kënduar me zë të lartë. I biri mbante nga këmbët e lidhura qengjin që jepte shpirt, ndërsa Muhamedi u zverdh dhe shkoi në shtëpi. Çfarë ke, i tha Hana. Muhamedi u ul në stol dhe shtriu trupin. Sytë i ishin zmadhuar dhe ishte mbushur me djersë të ftohta. Më vjen për të vjellë, tha. Hana i solli një limon të prerë dhe ia vuri në hundë. Muhamedi teshtiu fort dhe iriqi u fsheh nën stol. Bilali që punonte me Andream nuk vinte më pasditeve dhe shtëpia ishte më e qetë.

Hana gatante, lante, hekuroste, spërkaste oborrin dhe ndryshonte vendin e plaçkave të veta në sënduk. Kur i mbaronte të gjitha, ulej mbi krevat dhe thurte rroba fëmijësh. Në darkë vishte këmishën e natës dhe e priste Muhamedin me qirinj të fikur. Sa herë që bashkoheshin, nën çarçafë, ajo shikonte në ëndërr një djalë të vogël me sy të kaltër, i cili rrinte i ulur në stol dhe numëronte gjembat e një iriqi prej druri. Muhamedi ishte i imët, me këmbë të holla, të cilat ishin gjithmonë të ftohta. Hana ia vinte dorën mbi bark dhe gjurma e gishtave të saj mbetej aty, si një njollë e kuqe. Edhe kur Hana e puthte ai mbushej me pulla të kuqe dhe e lyente lëkurën me një

vaj karote që ia sillte gruaja e Bilalit. Kam frikë ta puth se bëhet si domate, i thoshte Hana Sarës që qeshte. Unë do doja ta kisha burrin kastravec, por jo domate, thoshte Sara duke e ngacmuar. Domatja nuk po mbin akoma, thoshte Hana dhe sytë i fryheshin duke pritur me barkun bosh.

Natën, Muhamedi ngrihej dhe shkante te xhamia. Hëna hynte në themele dhe dilte prej andej vetëm në mëngjes, kur ai ishte në gjumë. Ibrahim i vogël luante në oborr duke ndjekur iriqin që ishte plakur dhe gjembat i ishin thinjur.

Një mëngjes, Ibrahim u përplas në stol dhe vetulla iu çua mbi sy. Fatimja erdhi me vrap duke bërtitur, ndërsa Muhamedi u zverdh dhe shkoi të villte tek arra e vogël. Fytyra e Ibrahimit ishte mbushur me gjak. E pastruan, i vunë duhan, ia lidhën kokën me beze dhe djali u bë si një hoxhë i vogël. Kur ia hoqën leckën, mbi ballë i kishte mbetur një shenjë që dukej si një rrudhë me buzë të holla. Fatimja nuk e la më djalin të luante në oborr. Jani ndërtoi një gardh me dru për të ndarë oborrin dhe iriqin e mori në pjesën e tij. Stoli i mbeti Muhamedit. Shtëpia u nda në dysh si në kohën kur Ibrahim u bë mysliman.

Kur pa gardhin, Paridit iu mor fryma dhe i tha Sarës: Babai e bashkoi shtëpinë, ndërsa Muhamedi e ndau. Ana Komnena i zgjati Paridit kulaçin e vet të pambaruar dhe tha: Nuk ka faj Muhamedi. Shtëpinë që bashkoi babai e ndau Ibrahim.

Sara u ul në oborr dhe një pupël dallëndysheje i ra në pëqi. E mori në dorë dhe ngriti kokën nga qielli sikur ta kish thirrur dikush. Erdhën dallëndyshet, i tha së bijës që e kishte gojën të mbushur me kulaç dhe nuk fliste dot.

30

Sara vendosi të nisej në Kretë kur minareja filloi të ngrihej.

Hana numëronte ditët e muajt duke thurur me grep, ndërsa Muhamedi gdhiehej nën muret e xhamisë që i maste çdo ditë me pëllëmbë. Ana ishte rritur dhe gërsheti i dukej më i shkurtër. Ibrahim i afrohej gardhit dhe zgjaste kokën me kaçurrela sa herë që vinte Ana. Fatimja e thërriste dhe ai hynte në shtëpi duke u tundur si Bilali. Ana shikonte rrobat e fëmijës që qepte Hana dhe i thoshte: Po nuk linde, do m'i japësh mua rrobat për djalin tim? Hana ulte sytë jeshilë dhe psherëtinte. Zbrazëtia që kishte në bark i peshonte si një barrë.

Pasditet në fshat ishin të qeta dhe vetëm çekiçi i Andreas i trembte zogjtë që sapo kishin ardhur. Dallëndyshet i ktheheshin foleve të vjetra nën çati, por shpesh ato i gjenin të prishura nga dimri, ose të zëna nga dallëndyshe të tjera dhe pa u mërzhitur bënë fole të reja, që i thurnin me sqep. Të vegjlit, që kishin lindur në udhëtim i fushin aty dhe pastaj ngriheshin në ajër për t'u gjetur ushqim. Foshnjat prisnin me gojën hapur duke parë qiellin me durim.

Kur Sara i tha Ana Komnenës se do ikte, ajo u ul në krevat dhe mbuloi këmbët me duar. Faqet e kuqe i mbushën me quka, ndërsa gërsheti iu mblodh si bisht. Do kthehesh prapë, e pyeti me sytë e përplotur. Do kthehem shumë shpejt, i tha Sara, do kthehem përpara dimrit.

Atë natë fjetën të dyja të përqafulara. Ana Komnena kishte mbështetur kokën në supin e Sarës dhe qukat i vallëzonin në tavan. Dritarja ishte hapur, ndërsa qielli varej si një perde. Sara nuk flinte. Kishte pesëmbëdhjetë vjet që e shtynte nisjen. Mihal Komneni që vinte gati çdo vit në fshat, i kujtonte katrorin magjik, historinë e Isakut dhe krahët e Dedalit duke e parë me sytë e tij me cepa që kishin filluar t'i ngjanin syzeve të Metod Antrakidit. Herën e fundit kishte ardhur pas vdekjes së Ibrahimit dhe i kishte thënë: Dallëndyshja ime tani është më e lirë. Sa ishte Ibrahim gjallë, ajo nuk mund të nisej dhe Mihali e dinte këtë ngërç. Nganjëherë Sara mendonte se Mihal Komneni priste që Ibrahim të vdiste dhe ajo të çlirohej, si një dallëndyshe që e mbajnë peng në tokë duke ia lidhur krahët pas stolit të oborrit.

Ishte e vërtetë se qysh kur Ibrahim kishte vdekur ajo mendonte gati çdo ditë për Kretën. Shikonte Anën që zgjatej duke u holluar dhe kujtonte të ëmën që nuk e kishte parë kurrë. Babai i kishte thënë se Sheba kishte sy të zinj dhe flokë të thurur dhe e shikonte botën nga lart si një zog që jeton në lartësi. Kur kishin ardhur në fshat, Arianiti i kishte thënë se aty do gjenin një pyll të mbushur me zogj dhe në mes tyre do ishte dhe Sheba. Në fshat kishte pyll, por ajo kishte gjetur aty Ana Komnenën që flinte dhe merrte frymë si një pupël.

Arianiti e kishte sjellë në fshat, por po të mos kishte vdekur nëna, ndoshta, as ai nuk do kthehej. Do kishin jetuar të tre në Kretë ose në Selanik, ose në një ishull tjetër të rrethuar me det ku babai do t'i mësonte notin. Arianit Komneni do mbante kockat e babait të vet në arkën e vogël, duke pritur që turqit të ktheheshin në shkretëtirë, ndërsa Ana Komnena nuk do kishte lindur. Ose ndoshta do kishte lindur për t'i ngjarë një burri tjetër dhe jo Ibrahimit. Mund të kishte flokë të verdhë, sy jeshilë dhe këmbë të shëndosha dhe çdo mëngjes do ngrihej nëpër gjumë për të shkuar në shkollën e vajzave. Nuk do kishte gjashtë vëllezër dhe Sheba që do ishte një gjyshe me flokë të bardha dhe me gushë të mbuluar me shall mëndafshi, do t'i fliste për Testamentin e Vjetër duke i treguar historinë e vërtetë të Abrahamit dhe të Shebës, që ishte një princeshë biblike e dashuruar dhe me lëkurë të zeshkët.

Mihal Komneni nuk do vinte në fshat bashkë me Metod Antrakidin dhe djemtë e Ibrahimit nuk do dinin të lexonin. Ata do ishin martuar qetësisht me gratë e fshatit dhe do kishin më pak ankthe. Higjiena injorancës do t'i kishte shpëtuar nga nevoja për të krahasuar fshatin me botën. Të gjithë do kishin zgjedhur fshatin përpara botës dhe Ibrahim do ishte akoma i ulur në stolin e tij, ndërsa gratë e djemve do t'i zienin çaj dhe qumësht.

Isaku do ishte duke u endur nëpër botë si një anije që nuk gjen dot një breg, ose ndoshta do ishte fshehur në fshat derisa Thanasi apo dikush tjetër t'ia kishte dorëzuar Ali Pashës. Mihal Komneni do ta nxiste të nisej në Kretë, por Isaku do të ishte bërë baba dhe do hezitonte. Katrori magjik do ishte i paplotë, pa numra dhe Mihal Komneni nuk do ta bindte dot Isakun, por do ulej në oborr dhe do t'i tregonte përralla fëmijëve të tij.

Po ajo pse duhej të nisej në Kretë?

Edhe ajo kishte një fëmijë që duhej ta linte disa kohë vetëm, në një moshë kur vajzave të vogla u shfaqen sëmundjet e grave nëpër trup. Arianit Komneni tani duhet të kishte vdekur, sepse po të ishte gjallë, do duhej të ishte 120 vjeç, gjë që ishte e pamundur sado që t'i ngjante Abrahamit të vërtetë. Isaku, nëse akoma ishte në Ketë, duhet të ishte një burrë pesëdhjetë e pesë vjeç. Tiparet prej djaloshi endacak të Marin Kurilës do ishin plakur në fytyrën e tij dhe Isaku duhej t'i ngjante më shumë Mihal Komnenit, ditën që ajo e kishte njohur. Në qoftë se babai kishte vdekur ajo duhej ta kthente në fshat duke ia futur kockat në arkën e vogël siç kishte bërë Arianiti me të atin kur e kishte marrë në Stamboll.

Po Shebën? A duhej ta sillte edhe Shebën në fshat dhe t'i varroste të dy pranë e pranë në varrezat e krishtera, ngjitur me pyllin ku zogjtë do t'i zgjonin çdo mëngjes? Apo duhej t'i linte të dy atje, në breg të detit ku dhe ishin njohur dhe ku lindja e saj i kishte ndarë si një perde? Sepse ata ishin ndarë që ajo të lindte. Ndoshta nëna nuk do kish vdekur nëse ajo nuk do lindte, ose nuk do kishte vdekur nëse lindte një djalë siç shpresonte. Sara nuk kishte qenë qëllimi i dashurisë së prindërve, por pa dyshim kishte qenë mjeti për t'i dhënë fund asaj. Arianiti dhe Sheba nuk ishin dashuruar për të bërë një fëmijë, por ishin ndarë kur ajo kishte vendosur të lindte. Kthimi në Kretë asaj i dukej si kthim në djep. Një djep, të cilin Arianiti dhe Sheba e përkundnin pa pushim sikur kishin frikë se ajo do t'i harronte po ta zinte gjumi. Ja pse duhej të shkonte në Kretë. T'i thoshte prindërve se nuk kishin pse ta tundnin më djepin sepse kështu nuk po e linin të rritej dhe sigurisht që ata do ta dëgjonin. Ata do qetësoheshin kur të shihnin se nga djepi do dilte një grua

dhe jo një fëmijë. Arianiti do ecte përpara me flokët si dallgë dhe Sheba me këmbë të vogla do ta ndiqte pas në breg të detit. Kur era e detit të rritej, ajo do ndalonte, do mbulonte flokët e zinj me një shall mëndafshi dhe Arianiti do ta priste pa lëvizur derisa të bashkoheshin prapë duke u ngjitur, siç ngjitet një gjysmëportokalli me një gjysmëlimoni duke formuar një diell të nxehtë në perëndim.

Sara i mendonte të gjitha këto dhe faqja e nxehtë e Ana Komnenës i digjte mbi faqen e saj. Para se ta zinte gjumi, futi dorën poshtë krevatit dhe preku arkën e vogël të babait. Ajo ishte e ftohtë dhe e hapur si një varr që priste të mbyllej. E hoqi dorën dhe kur e zuri gjumi nata po mbaronte.

Kur u zgjua p Ana Komnenën që rrinte në këmbë dhe e shikonte. Sytë e zinj i ishin skuqur dhe dukej sikur kishte qarë. Kishte nxjerrë arkën e vogël poshtë krevatit dhe e mbante te këmbët. Do ta marrësh me vete, pyeti. Do ta marr, tha Sara që iu duk sikur e bija e kishte përgjuar gjatë natës. Këtu do ta futësh Arianitin? Sara pohoi me kokë. Po ku do ta varrosësh? Aty ku ai ka varrosur babanë e tij, tha Sara, në varrezat e krishtera, ku kemi çuar Petron dhe Metodin. Ana kapi gërshetin me gishta dhe ngriti arkën e vogël për ta nxjerrë në oborr. Sikur ta varrosnim afër babait, tha duke ecur. Ata kanë qenë të dy Abrahamë.

Sara u ngrit nga krevati dhe bëri gati plaçkat. Kur dolën nga shtëpia Ana mbante arkën e vogël. Kaluan te kisha dhe dielli që sapo kishte lindur u fsheh pas minares së shkurtër. Andrea që ishte ngjitur në majë i përshëndeti me dorë. Hana kishte dalë në oborr dhe po i priste, ndërsa nga ana tjetër e gardhit kaçurrelat e Ibrahimit dukeshin si një ferrë që lëvizte. Hana u përlot kur i pa të dyja në oborr dhe i rregulloi gërshetin Ana Komnenës. Kthehem shpejt, tha Sara dhe iu kujtua dita kur babai e kishte lënë në shtëpinë e Hanës. Atë ditë frynte një erë e kuqe, ndërsa sot ishte një ditë e bukur dhe e qetë. Ajo po bënte të njëjtën gjë si Arianit Komneni, por me një ndryshim të vogël: Ana Komnena do ta priste, ndërsa ajo e kishte ditur se Arianiti nuk do kthehej dhe nuk e kishte pritur. Hana e puthi dhe lotët i ranë mbi gjoks. Do të të presim të dyja duke thurur rroba kalamajsh, i tha. Sara e përqafoi dhe i vuri dorën te barku sikur donte t'ia ngrohte. Kur të kthehem do jetë rritur, i tha. Hana ktheu kokën nga Muhamedi që rrinte i ulur në stol duke parë tri gratë që ngjanin si kukullat e Janit të bëra nga i njëjti dru, por në kohë të ndryshme. Edhe minareja do jetë rritur kur të kthehet Sara, tha Muhamedi duke u ngritur.

E përcollën të gjithë deri në të dalë të fshatit. Hana mbante Ana Komnenën për dore, ndërsa Muhamedi ecte pas tyre me Janin dhe Paridin. Nga larg ata dukeshin më të vegjël, ndërsa fshati dukej më i lartë. Minareja ishte ngritur si një shenjë në qiell. Sara ecte në drejtim të babait me arkën e vogël në dorë.

Ashtu kishte ardhur në fshat përpara dyzet vjetësh.

Selaniku ishte i nxehtë dhe deti digjte tokën. Rrugët e ngushta të qytetit zbrisnin nga kodra në formë portokalli duke derdhur njerëzit në breg. Ata ngarkoheshin aty me peshq dhe mallra dhe ktheheshin prapë në kodër më të pasur, por më të plakur. Ajo mbante mend vetëm një dyqan librash të vjetër ku për herë të parë kishte dëgjuar babanë të thoshte se ajo kishte një nënë, se nëna quhej Sheba dhe se Sheba kishte vdekur. Dyqani ishte afër portit, në mes të një lagjeje çifutësh, të cilët ecnin shpejt duke iu fshehur diellit.

Selaniku kishte sinagoga, kisha dhe xhami që dukeshin nga deti si pemë të ardhura nga toka të ndryshme. Çifutët kishin mallrat, grekët kishin anijet, ndërsa turqit kishin portin. Grekët mbanin këmisha të gjera, ndërsa çifutët me rrobat e tyre gjysmë otomane dukeshin të gjithë si Sabatai Zevi. Ata kishin ardhur nga Spanja përpara treqind vjetësh dhe verandat e shtëpive të tyre mbi det i quanin *varandado*. Librat e vjetër thoshin se Selaniku ishte toka që mbreti Solomon i Izraelit i dhuroi mbretëreshës babilonase Sheba, derisa qytetin e mori Aleksandri dhe i vuri

emrin e gjyshes së vet. Mbretëresha u mahnit nga bukuria e gjirit të Selanikut dhe ngriti aty një fortesë verore të veshur me pëlhura të freskëta mbi krevate që shikonin nga deti. Fortesa ishte akoma aty, por turqit e përdornin si një fjetore. Në drekë, kur bënte shumë vapë, ata zhvisheshin lakuriq dhe i fusnin shpatat në det për t'i ftohur.

Sara ecte në breg të detit që nuk lëvizte dhe merrte frymë me vështirësi. Hundët i ishin mbushur me një përzierje kripe, peshku dhe ulliri, të cilat krijonin një aromë që ajo e kishte humbur përpara dyzet vjetësh. Nuk do ta merrte vesh kurrë nëse rridhte vërtet nga Sabatai Zevi, siç thoshte Mihal Komneni, por Selaniku i dukej një vend i njohur, qoftë edhe për këtë arsye. Selaniku ishte si një trup me skelet grek, me mish turk dhe me gjak çifut, i cili endej nëpër Mesdhe dhe provonte të gjitha gjellët, kryqëzohej me të gjitha racat dhe i falej të gjitha feve. Çdo perandori e kishte dashur dhe ai trup i ishte dhënë. Kur perandoritë kishin ikur, Selaniku kishte mbajtur mallrat dhe kishte dhënë armët. Sara ndihej mirë në këtë qytet që nuk luftonte.

Dyqani i librave dukej i errët dhe kur ajo u afrua, një turk i shëndoshë me çallmë nxori kokën. Sara ishte djersitur dhe kishte hequr bluzën. Llërët e bardha i ishin zbuluar dhe poshtë sqetullave i dukeshin disa qime të lagura si leshterikë. Kur e pa të zbuluar, turku mbylli derën duke folur me vete. Pas kokës së tij vareshin disa qilima të mëdhenj dhe nuk kishte libra. Sarës iu duk sikur fëmijëria nuk do dilte më nga ai dyqan. Turqit e kishin mbyllur brenda dhe ajo duhet të vazhdonte rrugën për të kërkuar më tutje.

Hoteli ishte afër. Dhoma e saj shikonte nga deti dhe prandaj ishte gjithë kohën e nxehtë. Sara futi arkën e vogël poshtë krevatit dhe doli në ballkon. Anijet prisnin si kuaj të rreshtuar mbi një qilim. Kur vinin, a to sillnin botën në qytet, ndërsa kur iknin e shpërndanin qytetin nëpër botë.

Me njërën prej tyre u nis një mëngjes, pasi kishte ecur gjithë javën në rrugët ku ishte rritur e ëma. Ishujt e vegjël ngriheshin mbi dallgë, ndërsa anija lundronte ngadalë në një rrugë të njohur. Koha ishte e qetë dhe peshkatarët nëpër ishuj ishin shtuar. Varkat e tyre të vogla e rrethonin anijen si peshq, ndërsa peshkatarët lëviznin duart dhe këmbët për t'i treguar kapitenit se po ecte mbi rrjetat e tyre. Por anija nuk ngecte nëpër rrjeta dhe kapiteni e dinte. Ai i binte borisë për t'i përshëndetur peshkatarët dhe dallgët shtoheshin nga uturima e saj.

Sara rrinte në kuvertë dhe kujtonte Arianitin. Kur e kishin bërë këtë udhëtim të dy bashkë, koka e saj nuk dilte mbi parmakun e anijes dhe babai e mbante në krahë për t'i treguar ishujt dhe peshqit. Natën, hëna kërcente mbi anije dhe vazhdonte udhëtimin me ta, duke nxjerrë kokën nga çarçafi i qiellit. Selaniku ishte zhdukur pas kurrizit të anijes dhe Azia turke që sa kishte nisur të dukej e skuqte natën si një zjarr. Ai zjarr i kishte ndryshuar jetën e detit, peshkatarëve, brigjeve dhe tokës që kishin lënë pas. Që kur turqit kishin zbritur në det, çdo gjë ishte më e nxehtë dhe shpesh ishte edhe përvëluese. Botës do t'i duhej kohë t'ftohej dhe Sara mendonte se, edhe kur ai zjarr të shuhej, gjurmët e tij do t'i dilnin njerëzve në fytyrë, si qukat e Ana Komnenës sa herë që mërzitej.

Një mëngjes, në mes të atij zjarri, u shfaq një njollë dhe kapiteni tha se ajo ishte Kreta. Dukej si një dru që nuk donte të digjej. Sara mblodhi plaçkat, mori arkën e vogël dhe u zgjat mbi det. Anija ngadalësoi lëvizjen dhe brigjet e ishullit u rritën. Kreta u zmadhua. Kapiteni doli në bashin e anijes për të kontrolluar bregun, pastaj hodhi spirancën në det duke lëvizur krahët me kujdes sikur donte të ndalonte lëkundjen e një djepi. Kur vuri këmbën në tokë, Sarës iu duk sikur po kthehej në shtëpi pasi kishte jetuar disa kohë në një pyll me zogj, ku e kishin çuar që të mos merrte pjesë në vdekjen e prindërve. Kishte menduar gjithë jetën për këtë ditë dhe ndoshta prandaj ishte e qetë. Babai thoshte se Kreta ishte një vend i shkëlqyer për të lindur dhe për të vdekur. Ajo kishte lindur këtu dhe nuk mund të ngatërrohej. Porti, rrugët, ullinjat, turqit dhe

grekët që shkëmbejnë mallra duke bërë titull, rëra e përvëlur dhe era e peshkut të djersitur ishin aty ku i kishte lënë. Shtëpia e Terezës po ashtu.

Kur u afrua, pa arrën e madhe që e kishte mbuluar shtëpinë sikur donte ta mbronte nga zjarri që vinte nga deti. Sara trokiti dhe arra u gërvisht pas murit. Një grua me flokë të bardha hapi derën duke mbyllur pak sytë nga dielli. Duhej të ishte Tereza. Sytë i kishte të pastër dhe trupin të fortë dhe të rregullt. Sara nuk e mbante mend, por, në qoftë se kishte qenë e bukur, tani pleqëria ia kishte hequr çdo gjurmë duke ia mbuluar fytyrën me një kurorë rrudhash katrore, të cilat e tregonin të vetmuar. Kur i tha kush ishte, Tereza u përlot. E puthi disa herë në faqe, ia ktheu kokën nga dielli sikur donte të bindej që ishte ajo dhe duke e shtyrë, sikur po e mbante në krahë, e ngjiti në një dhomë të madhe që shikonte nga deti. Këtu ke lindur, i tha dhe e puthi prapë. Sara futi arkën e vogël poshtë krevatit dhe qëndroi ulur mbi shtrat, ndërsa Tereza sillej nëpër dhomë duke e parë si një kukull që e kishte humbur para shumë vitesh.

Pas pak Tereza doli. Sara hapi dritaren, por deti mezi shquhej. Gjethet e arrës ngjanin si plloça jeshile të shtruara mbi ujë. Zhurmat e portit vinin të dobëta dhe anija që e kishte sjellë nuk dukej më. Kreta peshkonte ushqimin e vet të përditshëm, ndërsa në anën tjetër të horizontit, Azia dukej si një tigan i uritur. Tereza i solli një pjatë të vogël me reçel arre dhe u ul pranë saj. Rrudhat zbrisnin mbi çarçaf dhe Sarës iu duk sikur po e preknin. Provoi reçelin duke e lëpirë lugën me gjuhë dhe një pikë ra mbi krevat. E kuptoi se po i dridheshin duart. Qetësia që kishte ndier në anije kishte mbetur po aty dhe nuk kishte zbritur bashkë me mallrat e tjera. Tereza fshiu reçelin me dorë dhe qeshi.

Ku është babai, pyeti Sara. Tereza pa nga dritarja dhe sytë i lëngëzuan si reçeli që kishte mbetur në pjatë. Mori nënën dhe iku në mal, tha duke u ngritur. Sara ndjeu një të ftohtë që vinte nga hija e arrës. Donte ta pyeste Terezën se ç'do të thotë që babai kishte ikur në mal, në cilin mal, pse e kishte marrë nënën me vete aty lart dhe ku ishin tani, nëse ishin të dy bashkë. Imagjinoi babanë me një arkë tjetër, si ajo që kishte poshtë krevatit, duke u ngjitur në mal ngadalë, ndërsa deti poshtë shtrihej nën këmbët e tij si një qilim dasme. Arianiti ecte mbi qilim duke çuar nusen në shtëpinë e tij të fundit. Tereza iu afrua sikur donte ta uronte për martesën e prindërve. E mori me vete që të varroseshin të dy në një vend, tha. Babai erdhi në Kretë për të vdekur pranë nënës tënde, të cilën e dashuronte. Para se të vdiste na tha se donte të varrosej në mal, aty ku ishte edhe varri i vëllait të tij që kishte luftuar në Kretë. Do ta mbledh gjithë familjen në një vend, thoshte. Tani janë aty lart, të dy. Bashkë me vëllanë dhe shokët e tij.

Sara nuk kishte dëgjuar njeri t'i fliste për vdekjen si për një bashkim. Tereza ia kishte treguar bashkimin e prindërve si një martesë që bëhet pas vdekjes dhe ku ajo kishte qenë dëshmitare. U mbështet në krevat dhe mbështolli këmbët siç bënte Ana Komnena. Kur vdiq babai, e pyeti. Tereza rrinte në këmbë, ndërsa hijet e gjetheve të arrës i kishin mbirë si gjurmë në faqe. Vdiq një vit pasi erdhi këtu, tha Tereza. Jetoj në këtë dhomë dhe ditën merrte një stol të vogël dhe rrinte poshtë arrës në oborr. Një herë në javë shkonte te varri i nënës tënde dhe i çonte lule. Do kishte vdekur më herët, por priti sa u martua Isaku.

Sara mori lugën me reçel dhe e lëpiu sikur kishte ardhur nga një varrim që ia kishte lënë gojën të hidhur. Tereza nuk lëvizte. Rrudhat e saj dukeshin si rrugë në të cilat kishte kaluar babai, nëna, ajo vetë, por me sa duket edhe Isaku. Ishin të vetmet rrugë që kishin mbetur për të takuar familjen që i kishte humbur. Sara e shikonte duke ia lexuar fytyrën si një letër që babai ia kishte lënë para vdekjes. Rrudhat e saj janë pjesë e katrorit magjik, mendoj. Tereza kishte thënë se babai do kishte vdekur më përpara nëse nuk do priste martesën e Isakut dhe kjo nuk e habiti. Përkundrazi. Ishte mësuar që e vogël me zakonin që kishte i ati për të parashikuar çdo gjë, përfshi edhe vdekjen e vet. Vetëm dashuria me Shebën kishte dalë jashtë parashikimit të tij prej



profeti, që nuk merret me gjëra të vogla, por të cilin gjërat e vogla e kthejnë nga rruga, për ta çuar në një botë që ai nuk e njeh. Kështu i kishte ndodhur Arianit Komnenit. Hunda e vogël e gruas që njohu në Stamboll, shalli i saj i lidhur fort në qafë, gjellët me erëza që gatuante, vetmia e saj në Lesbos, arra e shtëpisë në Kretë dhe vdekja e Shebës, ishin disa gjëra të vogla, të cilat i kishin shmangur Arianitin nga rruga. I kishte marrë në dorë, si një plak që gjen disa lodra në mes të rrugës dhe ishte hutuar pas tyre kur kishte kuptuar se ato i kishin ndryshuar jetën. Duke bërë një përpjekje për të mos iu bindur rastësisë, që shkon në të kundërt me natyrën e profetit, i kishte lënë aty ku i kishte gjetur duke i mbuluar me dhe, që të mos ia merrnin dhe kishte ikur në fshat për të mbaruar rrugën për ku ishte nisur para se të gjente lodrat. Por dashuria, duke qenë një rastësi e paparashikueshme, ishte po aq e papërballueshme, prandaj ai ishte nisur prapë në drejtim të atyre gjërave të vogla, të cilat i kishte zhvarrosur dhe i kishte marrë me vete në varr. Rrugën për atje e dinte Tereza.

Po Isaku ku është, pyeti Sara. Isaku u martua me motrën tënde, tha Tereza, duke e ditur se ajo që po i thoshte do ta kishte hutuar Sarën, së cilës iu njomën sytë si një reçel arre. Tereza nuk e la të pikonte dhe vazhdoi. Kur nëna jote vdiq, ti kishe nevojë për gji. Unë gjeta një vajzë të re dhe të shëndetshme nga familjet e vjetra veneciane që kishin mbetur akoma në Kretë pas pushtimit. Ajo vinte çdo ditë dhe të jepte gji. Ti e shtrëngoje fort sikur e kishe nënë dhe pije me etje nga qumështi i saj. Kur fole për herë të parë, the emrin e saj. Ajo u mallëngjye dhe që nga ajo ditë të thoshte: Vajza ime. Ato kohë ajo kishte shumë qumësht sepse kishte lindur një vajzë disa muaj përpara se të lindje ti. Vajza e saj quhet Marina dhe është martuar me Isakun. Është e gjatë, me flokë të verdhë dhe me sy të kaltër si deti i Kretës. Nuk ngjan me ty, por mua më duket sikur buzët i keni njëlloj sepse kanë marrë formën e të njëjtit gji. Arianit Komneni kur erdhi këtu në vitin 1769 dhe pa Marinën të rritur, i kërkoi së ëmës që Isaku dhe ajo të martoheshin. Nëna e Marinës pranoi duke thënë se kështu vajza e saj do martohet në familjen e motrës së vet të gjirit. Isaku dhe Marina u dashuruan që ditën që u njohën dhe tani jetojnë në shtëpinë e tyre, në anën tjetër të qytetit. Arianiti erdhi vetë në kishë ditën e dasmës dhe mua m'u duk më i bukur se kurrë. Flokët e bardhë i kishte lidhur pas kokës dhe fytyra e tij ishte e lëmuar si e një njeriu që e ka mundur kohën. Qeshte, ngacmonte priftin, i hidhte Marinës lule mbi kokë dhe i thoshte Isakut se ai dinte një sekret, se si ngjizen djemtë që natën e parë të dasmës. Nuk e kisha parë aq të qeshur as ditën që doli nga burgu. Pas disa kohësh i tha Isakut se do vdiste. Mori nënën tënde, u ngjiti në mal dhe nuk u kthye më.

Sara, që e dinte si sillej Arianiti nëpër dasma, dëgjonte duke qeshur, por kur Tereza përmendi burgun u ngrys si një perçe.

Çfarë burgu, pyeti duke u nderuar mbi krevat. Nuk të ka treguar babai për burgun, e pyeti Tereza. Jo, tha Sara, nuk më ka folur kurrë. Tereza që rrinte në këmbë u mbështet pas dritares dhe dhoma u errësua. Rrudhat katrore lëvizën dhe ajo mori frymë thellë para se të fliste. Nuk ishte e lehtë t'i thoshte një vajze që adhuronte babanë e vet, se disa ditë të jetës ai i kishte kaluar në burg dhe Tereza filloi të fliste ngadalë sikur po shtrydhte një ilaç të hidhur në gotën e Sarës.

Pak javë pasi lindi ti, Arianitin e arrestuan për vrasjen e burrit të nënës tënde, Jorgo Mavromatisit. Jorgo ishte tregtar dhe kishte blerë një ngarkesë me verë që në atë kohë ishte një pije e ndaluar nga sulltani. Anija me të cilën ata udhëtonin për në Selanik ndaloi në Lesbos për shkak të kohës së keqe. Turqit kontrolluan anijen, morën verën dhe e futën Jorgon në burg. Duke pritur që ai të lirohej, nëna jote dhe Arianiti u dashuruan. Por Lesbosi është një ishull i vogël dhe njerëzit aty nuk i duan të huajt. Një burrë i thinjur dhe një grua tridhjetë vjet më e re se ai që dashurohen nuk është një ngjarje që ndodh çdo ditë në një ishull të vogël si Lesbosi, ku gratë në atë moshë mbyllen në shtëpi, ndërsa burrat vdesin shpejt. Ata duheshin si dy fëmijë dhe ecnin

përdore në breg të detit. Ishulli i shikonte me zili. Kur barku i nënës tënde u rrit dikush që e dinte se Arianiti dhe Sheba nuk ishin të martuar i çoi fjalë në burg Jorgo Mavromatisit. Babai e mori vesh dhe i tha Shebës se duhej të iknin sa më parë nga Lesbosi. Morën një anije dhe erdhën në Kretë fshehurazi. Nëna jote e vuajti shumë rrugën e gjatë nëpër det dhe kur erdhi këtu ndenji gjithë kohën e shtrirë në këtë shtrat. Ishte në një moshë të madhe dhe trupi i saj i pamësuar nuk e mbante dot barrën. Jorgo Mavromatisi, që kishte paguar njerëz për t'i ndjekur, e mori vesh dhe u bë si i çmendur. Pas disa kohësh, u pagoi turqve shumë para, u lirua nga burgu dhe erdhi në Kretë pak pasi nëna jote kishte vdekur. E gjeti Arianitin dhe e akuzoi se ai i kishte vlarë gruan që t'i merrte pasurinë dhe se vajza që kishte lindur ishte e tij. Arianiti i tha se ai dhe Sheba ishin dashuruar duke pritur që ai të lirohej dhe vajza ishte e tyre, por Jorgo, i cili kishte gjithë pasurinë nga familja e Shebës, nuk donte të bindej. Arianiti kërkoi t'ia zbuste marrëzinë dhe i tha se ai nuk kishte asnjë pretendim për pasurinë dhe pronat e Shebës në Selanik dhe se Jorgo mund t'i mbante të gjitha, por ai prapë nuk u bind duke e ditur se pasuria do trashëgohej nga ty si vajzë e vetme. Rrinte në tavernë duke pirë dhe pasi dehej vinte përpara shtëpisë dhe i thoshte Arianitit se do ta vriste. Babai yt dilte në këtë dritare dhe shikonte të dehurin pa iu përgjigjur, ndërsa ti flije si një foshnjë e paditur. Unë e kaloja natën tek arra e madhe, duke u dridhur. Nganjëherë Arianiti më thoshte se në fillim kishte ndier një brerje ndërgegje, kur i kishte marrë gruan një burri që e njihte, por tani ishte bindur se Jorgo e donte Shebën vetëm për paratë. Ndoshta Sheba e dinte këtë dhe prandaj nuk bënte fëmijë me Jorgon, më tha njëherë, por pastaj ndërroi temë dhe më pyeti se ç'mendoja unë për pushtimin e Kostandinopojës, sepse, sipas tij, edhe nëse nuk do ishte pushtuar nga turqit, Kostandinopoja do të ishte rrëzuar nga mëkati i vet për shkak të mohimit që i bëri Romës dhe sidomos Greqisë së lashtë. Kostandinopoja gaboi kur e ndau krishterimin në dy pjesë dhe prandaj dështoi. Jezu Krishti nuk vdiq në Jerusalem, por në Kostandinopojë, thoshte duke parë nga deti, pasi aty mori fund ëndrra e tij për një botë të krishterë.

Pas vdekjes së Shebës ai rrinte shumë në shtëpi dhe mua më dukej si një njeri që vdekja e detyron të ndryshojë mendim për botën. Kur Jorgo vinte në mbrëmje, ai rrinte pas dritares dhe mendohej gjatë duke të ruajtur, si një ujk që nuk do të rrezikojë asnjë qime në një betejë të panjohur që mund ta lërë foshnjën e vet jetime. Jam i bindur se po të mos ishe ti, ai kishte dalë në rrugë dhe do ta kishte vlarë Jorgo Mavromatisin. Dhe Jorgo nuk ia kurseu këtë mundësi.

Një natë ai shtyu fort derën e shtëpisë dhe hyri me forcë. U ngjit nëpër shkallë duke mbajtur në dorë një thikë të gjatë dhe duke sharë Arianitin si vrasës. Mbante erë të keqe dhe sytë i kishte të skuqur si gjak. Arianiti doli dhe u përpoq ta qetësonte, por ai i drejtonte thikën dhe i thoshte se kishte ardhur për të marrë vajzën e tij. Unë hyra në mes të të dyve për t'i ndarë, por Jorgo shkalloi edhe më keq. Një çast, pashë që ngriti dorën për ta goditur Arianitin dhe e shtyva me sa fuqi kisha. Ai ra nga shkallët dhe pas një ore dha shpirt në oborr. Vdekja e tij nuk mund të fshihej sepse, nga zhurma e madhe dhe të thirrurat, komshinjtë kishin dalë nëpër dyer dhe kishin dëgjuar çdo gjë. Njerëzit u mblodhën përpara shtëpisë dhe pas pak erdhën edhe ushtarët turq. Unë qaja, por Arianiti nuk më la të flisja. I doli ushtarëve përpara dhe tha se e kishte vlarë ai Jorgo Mavromatisin. Unë nuk qava më, por atë natë u plaka dhe lotët m'u bënë rrudha.

Turqit e morën Arianitin dhe e mbajtën dy vjet në burg derisa të gjithë komshinjtë dëshmuar se ai ishte i pafajshëm, pasi Jorgo kishte dashur ta vriste. Arianiti pranoi se e kishte shtyrë Jorgon në fund të shkallëve, duke më mbuluar mua që isha vrasësja e vërtetë. Ato dy vjet që ai qëndroi në burg, unë dhe nëna e Marinës të ushqyem derisa babai u lirua, të mori ty dhe të çoi në fshat. Kur u nis më tha: Do kthehem prapë. Unë e prita duke numëruar rrudhat përpara pasqyrës.

Kur Tereza fliste, Sara ishte shtrirë në krevat nga pesha e fjalëve që dëgjonte. Jastëku ishte i ftohtë dhe i lagur. Ajo dëgjonte dhe qante pa zë. Në atë dhomë kishte jetuar një baba që ajo nuk e

kishte njohur. Rrudhat katrore në fytyrën e Terezës ishin të thella dhe të dhimbshme. Po të mos kishte ardhur Arianiti në Kretë ndoshta fytyra e saj do kishte më pak rrudha, mendoi Sara dhe ktheu kokën nga muri që të thante lotët. Babai dhe nëna ishin ndarë që ajo të lindte, por jo vetëm kaq. Në fillim nëna ishte ndarë nga një burrë tjetër që kujtonte se ajo ishte vajza e tij e ligjshme. Babai i kishte thënë se ata të dy ishin dashuruar si dy zogj që dimri i ka braktisur në një ishull të vetmuar, por nuk i kishte folur për xhelozinë vrasëse të Jorgo Mavromatisit. Mihal Komneni, që gjithnjë i justifikonte sekretet e Arianitit, do thoshte se ajo nuk ishte një histori që i duhet treguar një fëmije. Por Mihali nuk i kishte parë rrudhat e Terezës mbi të cilat historia kalonte nga një brez në tjetrin. Tereza rrinte në këmbë si një dëshmi, ndërsa ajo ishte shtrirë në krevatin ku kishte lindur, gjë që e kishte çuar nënën në varr dhe babanë në burg. Nuk ndihej fajtoresh, por e pafuqishme, si një fëmijë që vret për të lindur, sepse zgjidhje tjetër nuk mund të kishte. Çdo fëmijë do ta bënte këtë i shtyrë nga nevoja për të lindur. Pafajësia e saj mund të ishte vrasëse por, para së gjithash, ishte njerëzore. Sara e dinte që kur u nis se Kreta do t'i mësonte një sekret, por jo në këto përmasa. Katrori magjik tani i dukej si një lule e vizatuar me shkumës, përpara pemës së rrudhave të egra që ajo dhe babai i saj kishin vizatuar në kokën e Terezës.

Ndjeu keqardhje për këtë grua, së cilës ata ia kishin ndryshuar jetën. Ajo nuk kishte krijuar dot një familje të vetën, por kishte mbajtur një derë hapur në ishull, që Arianiti të kthehej dhe të vdiste, në paqe. Por edhe pas vdekjes së tij, Tereza nuk e kishte mbyllur derën e shtëpisë. Kishte pritur me durim që ajo të rritej, atje larg në fshat dhe që një ditë të vinte dhe ajo t'i tregonte se babai i kishte fituar betejat e jetës së vet duke humbur njerëzit e dashur herë pas here. Tereza ishte një prej tyre. Ajo kishte humbur jetën e vet duke pritur që Arianiti të vendoste të vdiste. Ajo ndoshta e kishte dashur Arianit Komnenin, por edhe nëse nuk e kishte dashur si një grua, nuk i kishte rezistuar dot magnetit të tij. Nuk ishte e para dhe as e fundit. Sheba kishte vdekur e tërhequr nga ai magnet, ndërsa Sara rrinte shtrirë në krevat dhe ndiente kokën që i rrotullohej si një planet rreth yllit të Arianit Komnenit që shkëlqente akoma mbi malet e Kretës.

Ishte errësuar dhe yjet kishin çelur mbi gjethet e arrës. Tereza rrinte si një hije që pret ta shohin. Sara u ngrit dhe e përqafoi. Nuk mund t'i jepte më shumë sepse Tereza nuk kërkonte më shumë. Kishte dyzet vjet që e priste. E shtrëngonte me rrudhat e saj dhe Sarës i dukej sikur po ecte në një pyll, e mbështjellë me lëvore pemësh. Nata kishte dalë nga deti dhe Kreta ishte e errësuar. E zuri gjumi dhe ndjeu Terezën që e mbuloi me çarçaf, pastaj mori pjatën me reçel dhe iku. Luga, që ishte ngjitur në pjatë nga lotët e saj, nuk lëvizi. Dritarja ishte e hapur dhe dallgët që vinin deri tek arra nuk ngjiteshin dot lart. Sara pa në ëndërr Isakun që i mësonte notin duke e mbajtur nga krahët. Ajo zhytej në det dhe Isaku e ngrinte, pastaj zhytej prapë dhe Isaku nuk e ngrinte. Arianiti rrinte në breg dhe i thoshte Isakut: Është akoma e vogël, mos e lër vetëm.

Kur u zgjua në mëngjes, pjata e reçelit ishte e mbushur. Sara e kishte gojën të ëmbël nga ëndrra. U zgjat në dritare dhe pa detin ku kishte notuar gjatë natës. Kreta kishte dalë në port duke pritur botën që vinte me anije. Tereza hyri në dhomë dhe i solli një gotë ujë. Rrudhat e saj ishin më të çlodhura dhe ngjanin si rrugë, të cilat mbyllën pasi kalon njeriu i fundit. Dielli që hynte nga dritarja ngjitej nëpër ato rrugë për t'i shkuar në sy.

Kam lajmëruar Isakun, foli Tereza, duhet të jetë duke ardhur. Sara pa fytyrën e saj dhe ndjeu lëkurën që iu mblodh si një rrudhë. Dalim ta presim, i tha Terezës. Zbritën të dyja në oborr dhe u ulën nën hijen e arrës. Tereza e hapi derën e shtëpisë dhe nga rruga dukeshin fëmijët që shkonin në det. Të gjithë dinin not dhe Sara u ndie e plakur.

Isaku erdhi në drekë. Kishte veshur një këmishë të bardhë me jakë të gjatë dhe pantallona të zeza që shkëlqenin si luspa peshku. Ngjante si Mihal Komneni, por sytë jeshilë i lëviznin shpejt si kapriciot e Marin Kurilës.

Sara u ngrit në këmbë dhe mbeti pa lëvizur nën hijen e arrës, si një fëmijë i turpëruar. Isaku u afrua dhe e përqafoi. Mbetën ashtu të dy, ndërsa Tereza i shikonte dhe po të mos kishte rrudha do t'i dukeshin lotët. Isaku e largoi Sarën nga vetja dhe i pa fytyrën në diell. Nuk ke ndryshuar, i tha dhe e përqafoi prapë.

Kur u ngjitën në dhomë hapat e mëdhenj të Isakut shkundën pluhurin e shkallëve të vjetra. Tereza solli reçel dhe i la vetëm. Isaku hante reçelin duke mos ia hequr sytë Sarës.

Nuk ke ndryshuar fare, tha për herë të dytë dhe Sarës iu duk sikur i tha: Të kam parë. Zgjati kokën nga ai duke mbledhur buzët dhe Isaku filloi të qeshte. Buzët i ke si të Marinës. Besoj se të ka thënë Tereza se unë jam martuar me Marinën, motrën tënde të gjirit. Edhe ajo i mbledh buzët si ty kur habitet. Kur isha në fshat nuk më bënë përshtypje buzët e tua, por tani që i krahasoj me ato të Marinës bindem se e keni pirë qumështin nga një shishe. Sara u ndie edhe më e vogël. Gjithë ditën kishte pasur ndjesinë që po plakej, por ardhja e Isakut ia kishte hequr si me dorë. Ky njeri është pjesë e fëmijërisë sime, mendoi, prandaj ndihem e vogël.

E di që ke qenë në fshat, i tha Isakut, por pse nuk më ke takuar? Nuk donte Arianiti, tha Isaku që filloi të fliste ngadalë dhe sytë e lëvizshëm të Marin Kurilës iu errësuan pak. Mua më ndiqnin turqit pasi ika nga Voskopoja dhe erdha në fshat për t'u fshehur. Arianiti më mbajti në bodrumin e shtëpisë dhe kur ti luaje në oborr, unë dilja në dritaret e dhomave dhe të shikoja. Kishe një gërshet të gjatë, sy të zinj dhe faqe të kuqe. Doja të të takoja, por Arianiti nuk më la. Po e takove nuk do ikësh dot, më tha, por unë besoj se ai e dinte se nëse unë do lidhesha me ty dhe me fshatin as ai nuk do ikte dot, siç e kishte vendosur.

Pse e kishte vendosur, pyeti Sara. Isaku u mbështet fort në karrige dhe këmisha e bardhë iu mbush me hijet e gjelbra të gjetheve të arrës. Donte të vdiste në Kretë, pranë nënës tënde. Ardhja ime në fshat e shpejtoi këtë gjë sepse ndoshta ai do kishte ikur më vonë, kur ti të rriteshe edhe pak. Ato ditë Gjergji u bë mysliman dhe Arianiti e lexoi këtë si një shenjë se koha për të ikur kishte ardhur. Më bindi që të niseshim të dy, megjithëse ishte i dyzuar për të të marrë me vete apo jo. por rruga ishte e vështirë dhe ai kishte frikë se mua mund të më arrestonin turqit duke kaluar nga Janina në Selanik. Nëse ty të arrestojnë, më tha, kur unë të vdes Sara do mbetet vetëm. U mendua dy ditë. Erdhi në bodrum dhe mua m'u duk si një gjeneral që jepte urdhrat e fundit. Nisemi nesër në mëngjes, më tha. Sara do rrijë me Hanën. Ti hajde me mua. E pyeta se ku do shkonim dhe ai më pa i çuditur. Në Kretë, tha, ku tjetër. Do më varrosësh mua dhe do jetosh i lirë.

Unë dola nga fshati natën dhe e prita pas kodrës. Atë ditë frynte një erë e kuqe. Arianiti të mori për dore dhe të la te shtëpia e Hanës. Kur erdhi, ishte i bardhë në fytyrë, por i vendosur. Do ecim shpejt, tha, dua të vdes. Unë e shikoja dhe habitesha se si ai mbante hapin tim. Kaluam në Janinë dhe pas dy javësh gjetëm një anije në Selanik. Kur hipëm në anije, ndryshoi. Fytyra iu çel dhe rrinte në kuvertë sikur numëronte ishujt. Tek ai ishulli aty, më thoshte duke treguar një copë tokë të vogël dhe të shkretë, i mësova Sarës notin. Tek ai ishulli tjetër me pemë të larta, që duket si një kokë njeriu e paqethur, i thashë Sarës se do shkonim në pyll të takonim nënën. Kurse atë ishullin atje larg, që duket si një kuti e mbushur me arra, Sara nuk e pa se e kishte zënë gjumi në krahët e mia. E lidhte gjithë udhëtimin me ty. Edhe po të m'i mbyllin sytë, më thoshte, e gjej rrugën nëpër këto ishuj si Minotauri në labirintet e Kretës.

Natën, kur ishujt humbnin në errësirë, më tregonte historinë e jetës së vet. Udhëtimet në Stamboll, kryengritjen e Halil Patronës dhe njohjen me Shebën në Lesbos. Nuk e donte Lesbosin

dhe thoshte se, në qoftë se nuk do kishin ndaluar në atë ishull, Sheba nuk do kishte vdekur. Por as Sara nuk do kishte lindur, thoshte, dhe unë nuk di kë të zgjedh mes të dyjave. Kur erdhëm këtu ndryshoi mendje dhe mua m'u duk se iu kthye dëshira për të jetuar. Do pres sa të martohesh ti, më tha kur e pyeta.

Marina në atë kohë ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. Nuk kishte nevojë që ai të më bindte sepse unë u marroza kur e pashë dhe ia thashë Arianitit. Në këtë ishull ose vdes, ose lind, më tha. Ai priti sa u martuam dhe ditën e dasmës sonë qeshte si një fëmijë. Trupi i ishte dobësuar, por këmbët e gjata e mbanin dhe dukej sikur ecte mbi dy pemë që i kishte sjellë nga fshati. Pas një viti lindi djali im dhe unë i thashë se doja ta quaja Arianit. Babai yt nuk foli, por unë e ndjeva se kjo gjë i pëlqeu. Nuk ka vend në Kretë për dy Arianitë, më tha duke qeshur. Është koha për të vdekur.

Arianiti i vogël lindi me flokë të zinj dhe këmbë të gjata. Sot është njëzet e shtatë vjeç sa ç'isha unë kur erdha në Kretë. I mban flokët e gjata dhe Tereza thotë se i ngjan babait tënd sepse nuk di vetëm atë që do bëjë vetë, por di edhe atë që do bëjnë të tjerët. Kur Arianiti e pa të mbështjellë me pelena e puthi dhe tha: Arianit Komneni do jetojë deri ditën që turqit do kthehen andej nga kanë ardhur. Të nesërmen më thirri dhe më tha: Erdhi koha. Ishte veshur me rroba të reja dhe flokët i kishte lidhur me një fill të zi.

Shkuam te varrezat ku ishte nëna jote dhe e morëm. U ngjitëm në mal. Poshtë nesh deti dukej si një gjithësi dhe askund nuk dukej tokë. Në majë të malit ishte një fshat i braktisur dhe afër tij ishte një pllajë mbi të cilën ishin disa gurë varresh. Ishin njëmbëdhjetë shqiptarët që babai i Arianitit kishte dërguar në Kretë për të ndaluar pushtimin e turqve. Mes tyre, e dija që ishte edhe vëllai i tij, që i kishte pasur sytë jeshilë si unë dhe si babai i Arianitit. Kur shkuam në fund të pllajës, Arianiti ndaloi dhe më tha: Këtu do më varrosësh bashkë me Shebën. U ul në gjunjë dhe pastroi një nga një dhjetë gurët e varreve që ishin aty. Ia kalonte dorën sipër dhe dukej sikur u fliste të gjithëve. Njëlloj si ditën e fundit në fshat, m'u duk si një gjeneral që ka ardhur të takojë ushtarët e vet. Unë rrija në këmbë si i ngrirë dhe ai më tha: Njëri nga këta është vëllai im. Qeshi pak me vete dhe shtoi: Pati dy herë më shumë fat se unë. I kishte sytë jeshilë dhe vdiq duke luftuar.

Unë mora lopatën që kisha marrë me vete dhe hapa një gropë të vogël për eshtrat e Shebës dhe pastaj edhe një gropë më të madhe për trupin e Arianitit. Ai shikonte detin, ndërsa unë djersija në diell dhe qaja. Nuk e kuptoja nëse po bëja një mëkat apo një detyrë. Sido që të ishte, nuk mund të kundërshtoja sepse për këtë gjë më kishte marrë me vete. E kundërta do ishte një tradhti. Kurrë nuk e kisha menduar se do hapja varrin e gjyshit tim që rrinte i qetë duke më pritur dhe herë pas here kthente kokën nga unë sikur maste përmasat e gropës me sy. Po priste të mbaroja unë që të vdiste.

Unë punova një kohë të gjatë dhe më dukej sikur çdo vonesë ia zgjaste atij jetën. Kur mbarova, u ula në buzë të greminës. Nuk ishte lartësia, por ankthi i asaj që po bëja që ma mori mendjen dhe sytë m'u errësuan aq sa për një çast m'u duk sikur do bija në fund të detit. Arianiti kishte marrë eshtrat e Shebës të futura në një thes dhe po i vendoste qetësisht në gropën e vogël. Unë shikoja detin poshtë këmbëve që vareshin në ajër dhe nuk e ktheja kokën. Kisha turp, si një njeri që përgjon një takim dashurie. Dëgjoja lëvizjen e duarve të Arianitit që pasi kalonin mbi trupin e Shebës, i ngrinin eshtrat, një nga një. Duart e tyre bashkoheshin si në një përqafim. Kur e mbuloi varrin e saj më thirri. Ishte i qetë dhe i heshtur si çdo njeri që vdes kur të dojë. Tani ik, më tha, dhe eja nesër të më mbulosh.

Unë i putha duart, por nuk ika. U fsheha në një nga shtëpitë e braktisura dhe fillova ta shihja. Arianiti qëndroi gjatë në buzë të greminës. Trupi i thatë i lëkundej nga era dhe unë mendova se

do hidhej në det. Dikur lëvizi dhe eci nëpër pllajë sikur kërkonte diçka. Gjeti një gur të madh gjithë nyje, e këqyri nga të katër anët, e ngriti dhe e vuri mbi varrin e mbuluar të Shebës.

Pastaj mori një gur tjetër dhe e afroi te varri i tij. U mendua një copë herë duke parë detin. Një tufë dallëndyshesh kaluan mbi mal. Arianiti ngriti kokën dhe mua m'u duk sikur qeshi. Dallëndyshet u rrotulluan disa herë dhe pastaj u sulën në drejtim të detit duke u ndarë si copat e një pasqyre. Ai mori një gur të vogël me majë dhe filloi të shkruante diçka mbi gurin e Shebës. E mbaroi, i kaloi dorën sipër për t'i hequr pluhurin dhe shkroi diçka edhe mbi gurin e tij.

Kur ra muzgu, u ngrit në këmbë dhe qëndroi disa çaste pa lëvizur. M'u duk sikur po falej. Dielli ishte ulur shumë në perëndim dhe një hënë e pastër si një pjatë me qumësht po ngrihej mbi greminë. Arianiti eci në drejtim të varrit të vet dhe u shtri aty bashkë me diellin që u zhyt në det. Unë u rrëqetha. Doja të ulërija, por kisha frikë mos e ngrija nga varri. E dija që po të më dëgjonte do dilte që andej dhe do më qetësonte. Mund ta bëja, por nuk kisha guxim t'ia prishja vdekjen. Mbete gjithë natën në shtëpinë e braktisur. Që aty, deti shihej pjesërisht, ndërsa hëna e kuqe dukej si një mollë e kafshuar.

Kur zbardhi, prita sa dielli u ngrit plotësisht dhe u afrova me hapa të vegjël drejt gropës së Arianitit. Ai kishte kryqëzuar duart mbi gjoks, ndërsa sytë i kishte mbyllur. I vura dorën mbi ballë, por ai nuk lëvizi. Edhe nëse ishte gjallë nuk do t'i hapte sytë. Mora dhe me duar dhe ia hodha sipër me kujdes duke i mbuluar në fillim trupin dhe pastaj fytyrën. Ai nuk i lëvizi qepallat as kur dheu i kaloi mbi sy. Unë nuk qaja dot. Duhet ta mbaroja detyrën time deri në fund. Ai varrim kishte qenë i tmerrshëm, por Arianiti e kishte parashikuar deri në detaje dhe prandaj ishte i përsosur. Po të ishte gjallë në ato çaste, ndoshta tallej me mua kur ndiente dorën që më dridhej duke kaluar ngadalë mbi trupin e tij. Ndoshta thoshte me vete: Pse e mora me vete këtë frikacak? Pasi e mbulovala, ngrita gurin që ai kishte zgjedhur dhe që rrinte aty duke më pritur. Sipër tij shkruhej: 1770. Ishte viti që kishte zgjedhur Arianiti për të vdekur. Në varrin ngjitur me të kisha parë një numër të ngjashëm. I hodha një sy. Aty shkruhej: 1670. ishte viti i vdekjes së të vëllait dhe dhjetë burrave të tjerë që kishin vdekur njëqind vjet përpara në Kretë. Pranë varrit të Arianitit ishte varri i vogël i Shebës që dukej sikur kishte mbështetur kokën tek ai. Lexova atë që kishte shkruar: *ti më jep nxehtësi*. Dukej si një letër dashurie dhe unë e dija ç'do të thoshte. Ishte një varg i Safos që Sheba ia recitonte Arianitit kur dashuroheshin në Lesbos. Qëndrova dhe pak në majë të pllajës derisa dielli filloi të më digjte kurrizin.

Arrita në shtëpi pasdite. U shtriva në dhomë dhe fillova të qaja me vete. Marina më pyeste, por unë nuk dija si t'ia tregoja atë që kisha bërë në mal. Një muaj nuk dola nga shtëpia. Sytë e palëvizur të Arianitit me dilnin çdo çast përpara. Po sikur të ishte gjallë kur unë e mbulovala me dhe?

Isaku mbaroi dhe futi në gojë një lugë reçel. Ishte i qetë, megjithëse sytë i mbante në tokë sikur kishte frikë të shikonte Sarën. Ia kishte varrosur babanë, por nuk ia kishte vrarë. Cili djalë apo nip nuk do ta kishte bërë atë që bëri ai? Në atë rast, detyrën dhe mëkatin i ndante një fill shumë i hollë si ai që kishte lidhur Arianiti te flokët, por pesha e detyrës ishte më e rëndë se pesha e mëkatit dhe ajo e kishte shtyrë Isakun të hapte varrin e gjyshit të gjallë me lopatë. Ai shkonte një herë në vit në mal dhe pastronte varrin duke fshirë me dorë pluhurin që ngjitej nga gremina dhe duke këputur barin që dilte mbi tokë si flokët e gjatë të Arianitit. Ai nuk besonte se i ngjante gjyshit dhe kur mbushi pesëdhjetë vjeç iu duk vetja i vjetër. Po të vdiste ai, varri i Arianit Komnenit do harrohej. Mendoi t'i bënte një pllakë të madhe guri dhe t'ia shkruante emrin sipër, siç bënin të gjithë me njerëzit e vdekur, por hoqi dorë.

Arianiti kishte zgjedhur të varrosej në majë të malit, jo rastësisht. Mund të varrosej me Shebën në çdo varrezë të Kretës dhe të rrinin aty sa të donin pranë qindra grekësh apo venecianësh që shekujt ia kishin caktuar si komshinj. Mes tyre mund të kishte të varfër, të pasur, të rinj, pleq, fëmijë, gra, marinarë, tregtarë, poetë, princa, luftëtarë apo tradhtarë. Këtë short e hidhte perëndia dhe të gjithë e pranonin. Por pikërisht këtë gjë nuk donte Arianiti. Perëndia nuk mund t'i caktonte ditën e vdekjes dhe aq më pak shokët e varrezës. Ai donte t'i zgjidhte të vdekurit me të cilët do të kalonte pjesën tjetër të jetës. Dhe i zgjodhi. Zgjodhi njëmbëdhjetë shqiptarët që mbetën në ishull duke mbrojtur krishterimin nga turqit. Koha dhe fati i kishin lënë ata anonimë dhe Arianiti ishte pajtuar me këtë harrim. Nuk kishte rrugë tjetër për të ndenjtur me ata burra në përjetësi. Ata e pranonin, por pa emër. Arianiti kishte marrë me vete Shebën dhe kishte lënë emrin. Harresa do ishte më e ëmbël dhe më e durueshme me Shebën aty afër. I kishte vënë vetes një numër njëqind vjet më të madh se numrin që kishin varret e atyre burrave, si për të thënë se lufta e tyre e përbashkët kishte zgjatur njëqind vjet.

Arianit Komneni donte që bota ta dinte këtë detaj të jetës së vet. Bora, që kalonte çdo ditë poshtë varrit të tij hipur në anijet që vinin dhe iknin në Kretë, dikur do ndalej aty, ndoshta kur turqit të iknin. Nuk ishte pak po t'i nderonin si njerëz që luftuan njëqind vjet si të ishin profetë sepse vetëm profetët bënin luftëra aq të gjata.

Ndërsa Isakun e kishte marrë atje lart për diçka tjetër. Kishte një njeri që ai duhej ta priste në ishull dhe t'i tregonte varrin. Bota mund ta harronte profetin, por ajo nuk mund ta harronte babanë. Kjo ishte Sara dhe ajo kishte ardhur.

Tani rrinte përballë tij me këmbët mbledhur dhe me faqet e skuqura siç e kishte parë për herë të fundit në oborrin e shtëpisë, duke pritur që Arianit Komneni dhe Ali Tepelena të ndanin fshatin me marrëveshje mes Krishterimit dhe Islamit. I mungonte vetëm gërsheti i zi që duhej ta kishte lënë në shtëpi.

Sara lëvizi dhe mori një lugë reçel. Duhej të ishte e hutuar sepse kishte marrë lugën e tij. Fytyra i ndriçohej nga dielli i fortë i drekës aq sa Isaku mezi e dallonte. E dija që do vdiste kështu, foli Sara me buzët e ngjitura me reçel. Isaku e pa me habi dhe iu duk se ajo kishte qenë në mendimet e tij. Babai nuk erdhi rastësisht në Kretë, vazhdoi Sara. Edhe sikur ti të mos vije në fshat nga Voskopoja, ai do të ikte një ditë për të varrosur veten dhe nënën në atë vend. Bashkë me Mihalin i kemi bashkuar me dhjetëra herë copat e katrorit të jetës së tij për të kuptuar magjinë e Arianit Komnenit. Kur babai iku nga fshati unë mbeta në mjegull. Ai nuk më tha ku do shkonte dhe unë nuk e dija nëse do isha e aftë ta gjeja se ku kishte shkuar. Në qoftë se një ditë do të më gjesh do të thotë se do të të duhem. Kaq më tha dhe iku. Unë u martova, linda një vajzë dhe babai u largua edhe më shumë nga unë. Kujtimi i tij filloi të dilte ngadalë nga jeta ime si një hije që del nga dhoma kur hyn dielli. Vajza, familja dhe fshati e mbushnin gjithë ditën dhe natën time. Por, pasi erdhi Mihali, filloi të kuptoj se kisha mbetur si një pemë, e cila ushqen gjethet e veta duke harruar se ushqimi i vjen nga rrënjët. Mihali më fliste për babanë dhe mua m'u duk se në të vërtetë ai zë vinte nga rrënjët, duke më kujtuar se nga kishte ardhur në fshat trunq i pemës sime. Mihali më shtynte dhe unë ndihesha e pasigurt deri ditën që zbuluam katrorin magjik që ti dhe babai kishit vizatuar në kishë. E ndërtuam atë katror duke bashkuar të vërtetat e pjesshme që dinim dhe çdo gjë u bë e qartë. Ju ishit në Kretë dhe kishit ikur bashkë. Unë zbulova babanë, ndërsa Mihali zbuloi djalin.

Isaku lëvizi në karrigen ku rrinte. Për cilin katror flet, e pyeti Sarën duke e ndërprerë. Për katrorin magjik që kishte gdhendur babai në murin e kishës, tha Sara. Na e tregoi ustai që kishte thirrur babai për të ndërtuar kishën. E kam parë, tha Isaku. Një natë shkuam bashkë me Arianitin në kishë dhe ai ma tregoi duke e ndriçuar me qiri. Por aty nuk kishte katror. Kishte vetëm një

fjalë, *Kreta*, që Arianiti e kishte shkruar me dorën e vet për të nderuar kujtimin e burrave të fshatit që vdiqën këtu. Ai më tha se kishën ia kishte dedikuar atyre burrave si një monument që fshati ua kishte borxh. Katror nuk kishte deri ditën kur ne ikëm dhe unë nuk kam shtuar asnjë presje në atë gur.

Sara ndjeu këmbët t'i ftohen kur kujtoi Metodin dhe Mihalin që mbushnin katrorët magjikë duke plotësuar njëri-tjetrin. Sa herë që bllokohej Metodi, leximin e fjalëve të padukshme e vazhdonte Mihali dhe anasjelltas. Metodi kishte zbërthyer logjikën e numrave, ndërsa Mihali kishte gjetur enigmën e emrave të shkruar nga poshtë-lart dhe nga e djathta në të majtë. Në fund të fundit pse duhej që babai të vizatonte një katror misterioz duke i lënë fjalët bosh sikur donte ta torturonte? Ndërsa Isaku kishte thënë se ai kishte qëndruar i fshehur në bodrumin e shtëpisë dhe jo në kishë. Kishën e kishte parë vetëm një natë kur aty e kishte çuar Arianiti për t'ia treguar si një statujë nderi që e kishte ndërtuar me duart e tij.

Mihali dhe Metodi e kishin mbushur katrorin shpejt pavarësisht se, ndërsa ata flisnin, asaj i ishte dukur sikur po i kalonte gjithë jeta përpara. Ata ishin sjellë si dy magjistarë që bënë në njëntin numër në çdo qytet, përballë fëmijëve që ktheheshin në shtëpi dhe nuk i zinte gjumi nga magjia. Është e pamundur, tha Sara që dukej sikur foli me vete. Çfarë është e pamundur, e pyeti Isaku që nuk po e kuptonte. Sara u ngrit dhe shikoi nga dritarja. Mblodhi si në një shportë udhëtimi copat e kujtesës së saj, duke filluar me fjalët e Naumit, ecjen e shpejtë drejt kishës, pastaj dorën e dridhur të Mihali Komnenit mbi portik, merimangën që iu ngjiti atij pas mjekrës, pastaj katrorët e vegjël brenda katrorit të madh, fjalët dhe numrat që shkruante dhe fshinte Metodi mbi dërrasën e zezë dhe drita që vinte nga dritarja ia ndriçoi kokën si një diell. Filloi të qeshte me vete dhe u kthye nga Isaku që e shikonte i hutuar.

Katrorin e ka vizatuar Mihali me Metod Antrakidin, tha dhe qeshi me zë të lartë. Iu duk vetja e tallur nga ata dy pleq që me sa duket kishin ardhur në fshat për t'i mësuar asaj rrugën drejt babait. Por ajo nuk bindej dhe ata ishin sjellë me të si me çdo fëmijë tjetër. Kishin gjetur një lodër për ta joshur që ajo t'i ndiqte pas. Katrori ishte një lodër. Magjia e tij ishte e vërteta. Mihali dhe Metodi ia kishin thënë të vërtetën duke luajtur. Por kjo ishte një lojë e domosdoshme dhe Sara ndjeu që i donte të dy edhe më shumë. Po të ishin aty do t'i kishte puthur dhe syzet e Metodit me siguri do ishin mbushur me avull. Janë tallur me mua, i tha Isakut dhe filloi t'i tregonte katrorin me numrin trembëdhjetë që Mihali thoshte se e kishte ndërtuar ai. Sara fliste me pasion duke lëvizur duart mbi dritaren e hapur që dukej si një katror i mbushur me gjethe arre.

Isaku e dëgjoi deri në fund duke qeshur. Nuk mund të ishte ndryshe, tha kur Sara mbaroi. Metodi ishte matematicien dhe katrorët e tij në Voskopojë ishin të famshëm. Ai imitonte Pitagorën dhe i çonte grave katrorë magjikë të mbushur me fjalë dashurie që burat e tyre të mos i zbulonin dot. Kur isha i vogël, ai vinte në shtëpinë tonë dhe më mësonte katrorë me numra. Katrori me numrin trembëdhjetë është nga më të thjeshtët dhe besoj se ai dhe babai, nuk janë lodhur shumë për të përshtatur *Kretën* me datat dhe emrat e familjes. Kur kanë parë se ti ishe e pavendosur janë menduar derisa kanë gjetur mënyrën për të të bindur. Kanë ndërtuar katrorin dhe pastaj e kanë gdhendur mbi portikun e kishës duke e futur fjalën që kishte shkruar Arianiti brenda tij dhe duke shtuar vetëm numrin 13. këtë gjë e kanë sajuar që të dukej si e vërtetë dhe kur ti ke ikur e hutuar, duke besuar se kishe zbuluar testamentin e babait tënd, me siguri kanë qeshur, por njëkohësisht janë çliruar si të kishin përmbushur një detyrë fisnike.

Megjithatë, Mihali e dinte ku ishim ne. Kur ikën nga fshati, ne ndaluam në Korçë natën duke u fshehur. Unë e dija që do ta gjenim aty dhe Arianiti i tha se do shkonim në Kretë. Atë natë unë fjeta dhe ata të dy folën gjatë. Ndoshta Arianiti i ka thënë se ai duhej të kthehej në fshat dhe të vigjilonte rritjen tënde. Ose, ndoshta, Mihali ka ardhur vetë duke besuar se kështu po çonte deri



në fund dëshirën e babait. Në Voskopojë ai njihej për humorin e tij dhe nuk çuditëm që është sjellë kështu duke ta bërë jetën më të lehtë. Kur bënte shaka të rrezikshme merrte syzet e Metodit që të mos njihej, derisa gjakrat të zbuteshin.

Sara vuri buzën në gaz dhe u kujtua që për shkak të Mihalit, gratë e Voskopojës i quanin të dashurit e tyre Mektosyçka. Tani ndihej e çliruar. Reçeli ia kishte ëmbëlsuar gojën njësoj si Mihali jetën në fshat. Po të mos ishte Mihali ndoshta nuk do vinte kurrë këtu. Në Kretë kishte zbuluar katrorin e vërtetë. Arianit Komneni, Mihali, Isaku dhe Arianit Komneni i ri ishin brinjët e të njëjtit katror që qëndronin të bashkuara në një trup, si dy duar dhe dy këmbë. Ata ishin katër brinjët e një familjeje. I kishte njohur tre prej tyre dhe tani mbetej i katërti. Vështroi Isakun që rrinte i ulur me këmbëshën e bardhë si një kujtim nga Voskopoja. Sytë e tij jeshilë ishin çelur prapë dhe ndriçonin rrugën nga një brinjë e katrorit te tjetra.

Kur do më çosh te babai, e pyeti Sara. Kur të duash, u përgjigj Isaku. Por më parë duhet të takosh Marinën dhe Arianitin. Ata kanë kohë që të presin. Sara pohoi me kokë. Dielli ngrohte rrugën, ndërsa Kreta po kthehej nga porti. Njerëzit ktheheshin të ngarkuar dhe Sara mendoi se secili prej tyre kishte marrë një copë të botës dhe po e çonte në shtëpi. Ndërsa ajo, kur të kthehej, do merrte copat e humbura të familjes dhe do t'i çonte në fshat.

Kur ata dolën, Tereza ishte ulur tek arra e madhe. Dera e shtëpisë ishte e hapur dhe mbrëmja hyri brenda si një zonjë e veshur me të zeza. Isaku përqafoi Terezën dhe faqet iu ngjitën pas buzëve të saj me reçel. Ajo nxori një arrë nga përparësja me shumë xhepa dhe ia dha Sarës që e mbajti në dorë deri në shtëpinë e Isakut buzë detit.

Shtëpia kishte një verandë të madhe që Marina e kishte mbushur me lule. Në vjeshtë kur lulet thaheshin fletët e tyre binin mbi det dhe shkëlqenin si luspa peshku. Marina ishte e bukur siç kishte thënë Tereza. Sytë e saj ishin të kaltër, ndërsa vetullat e holla ngjanin si kurora gruri. Megjithëse ishte disa muaj më e madhe se Sara, buzët i kishte akoma të fryra dhe dukej sikur që andej rridhte qumështi. Unë nuk i kam më buzët kaq të freskëta, mendoi Sara kur era e qumështit i mbeti në faqen që puthi Marina. Ishte e gjatë dhe mbante një fund të shkurtër nga i cili dilnin dy këmbë të drejta me mish.

Ndërsa Arianit Komneni ishte një gjë tjetër dhe Sara mendoi se po të kishte qenë vajzë nuk do të ishte aq i bukur sepse në përgjithësi Komnenët i bënë djemtë më të bukur se vajzat. Flokët e zeza i kishte zgjatur deri te supet dhe shpatullat e gjera e mbulonin detin kur ai dilte në ballkon. Era që vinte nga deti i hynte në këmbëshë dhe gjoksi i tij i fryhej si një mushkëri delfini. Arianiti ngrihej çdo mëngjes dhe shkonte në det. Sara e shikonte nga ballkoni sesi zhdukej, pastaj duart e tij dilnin dhe kapeshin fort pas ujit duke e ngritur të gjithin lart. Unaza e Halil Patronës, që Arianiti ia kishte dhënë Isakut dhe ky Arianitit, dilte mbi ujë dhe hurma e saj shkëlqente si një guaskë prej dielli. Sara kishte parë peshkatarët që notonin në ishujt përreth anijes së Kretës, por ajo që bënte Arianiti nuk ishte not. Babai i kishte thënë se të notosh do të thotë të puthësh detin dhe pikërisht këtë bënte Arianit Komneni. Deti pranonte që ai ta puthte dhe përkëdhej duke u tundur dhe duke nxjerrë dallgët në breg. Isaku që rrinte në ballkon me Sarën, humbte duke ndjekur të birin me sy dhe i thoshte Sarës së mrekulluar: E ka mësuar notin para se të lindte. Sara kthente kokën dhe i dukej sikur zëri i Isakut vinte nga Voskopoja. Kur Arianiti dilte në breg, uji që i rridhte në trup pikonte mbi gurët e plazhit që shndrisnin si diamante. Ai hynte në shtëpi dhe Marina i jepte një peshqir, që dukej gjithmonë i vogël, për të tharë detin që ai sillte me vete. Në mbrëmje uleshin në karriget e verandës. Isaku pinte verë të bardhë, ndërsa Sara hante pjepër të verdhë që Marina e spërkaste me sheqer. Arianiti rrinte përballë tyre me fytyrën të kthyer nga

deti. Herë pas here shikonte andej, sikur priste të kalonte diçka dhe i thoshte Isakut: Kur turqit të ikën nga ishulli, do kemi më shumë det për t'u larë dhe për të zënë peshq.

Isaku pinte pak verë nga gota e gjatë si këmbët e Marinës dhe i thoshte: Kështu mendoja edhe unë kur isha sa ty. Voskopoja më dukej si një ishull që do ta kisha të gjithin për vete kur të iknin turqit. Por turqit po rrinë shumë gjatë dhe nuk ka shenja se do ikën shpejt. Gjithandej njerëzit janë lodhur dhe i kanë pushuar luftërat, ndërsa luftëtarët janë rralluar. Shqiptarët, që nuk kanë më shpresë, po bëhen myslimanë, ndërsa grekët jetojnë duke u shitur turqve peshk. Kam frikë se turqit nuk do ikën më kurrë sepse tani ne i kemi brenda vetes tonë. Ata na e kanë futur Islamin në krevat, në shtëpi dhe në shpirt. Si mund të ndahet Sara nga e bija që është vajza e një myslimani, apo babai im nga i vëllai që u bë mysliman për t'u hakmarrë ndaj babait të vet? Jemi shumë vonë për t'u ndarë. Ata na kanë futur një kafshë të panjohur brenda në trup dhe ne nuk mund ta vrasim dot sepse kështu plagosim veten. Jemi të detyruar të gjejmë paqe me trupin që të shpëtojmë shpirtin. E në qoftë se duam të jetojmë në paqe duhet ta zbusim egërsinë e kafshës duke e ushqyer me mishin e shpirtit tonë prej Krishti.

Isaku pushonte dhe vera e bardhë ia qetësonte gojën. Marina afronte pjepër me sheqer për të ëmbëlsuar kujtimet por Arianiti nuk tërhoqej.

Voskopoja nuk kishte det si Kreta dhe prandaj nuk shpëtoi, i thoshte të atit. Turqit nuk kishin nga të iknin dhe u bënë një me shqiptarët dhe sot nuk e di çfarë race jeton aty.

Isaku skuqej dhe damari i Marin Kurilës i dilte në qafë dhe ir rrotullohej si një shall i kuq. Voskopoja nuk kishte det, por kishte libra, thoshte Isaku. Deti nuk e ka forcën e librit. Libri mbetet ndërsa deti ikën. Deti është i të gjithëve, ndërsa libri është i më të diturve, që zakonisht janë dhe më të fortët. Ne e kishim rrethuar Voskopojeën me një ushtri librash dhe besonim se ajo ushtri do t'i mundte të paditurit, jo duke i vrarë, por duke i bërë të ditur. Në Kretë njerëzit janë të egër. Ata lindin dhe plaken duke menduar ditën kur do t'i hedhin turqit në det, pasi t'i kenë therur si bagëti. Ndërsa në Voskopojeë ne mendonim se si do t'i mësonim myslimanët të jetonin si ne.

E di që ka shumë njerëz që thonë se, në qoftë se unë do kisha zgjedhur luftën para paqes, Voskopoja do shpëtonte. Nuk do pendohem derisa të vdes dhe sikur të kem njëqind jetë do bëj prapë të njëjtën gjë. Voskopoja nuk do shpëtonte siç nuk shpëton një libër që bie në fund të detit. Por turqit nuk janë një dimër i përjetshëm dhe ia vlen të durosh duke përsosur artin e të jetuarit në ishull. Kur ata të ikën ne do ta shkruajmë prapë librin që na humbi, por aty do të ketë edhe disa faqe për turqit që nuk do vdesin më kurrë në kujtesën tonë.

Marina e priste pjeprin në copa të vogla që dukeshin si ishuj në pjatë. Sara shikonte qiellin me yje dhe mendonte për Ana Komnenën. Ajo duhet të ishte akoma në oborrin e shtëpisë duke numëruar të njëjtët yje. Hana qepte rroba fëmijësh, ndërsa Muhamedi me siguri po maste me pëllëmbë rritjen e minares. Xhamia dhe kisha rrinin përballë si një trup dhe një shpirt. Rruga e fshatit kalonte midis tyre. Sa herë që njerëzit faleshin, ato merrnin frymë si dy deve me qafa të zgjatura mbi shkretëtirë. Disa faleshin duke u kthyer nga perëndimi, të tjerët nga lindja dhe devetë nuk mërzhiteshin. Ato do bënin çdo gjë që të mbeteshin në shkretëtirë, sepse askund tjetër nuk mund të jetonin. Duke përcjellë në shtëpi ndonjë vajzë nga fshati, Paridi kalonte aty çdo natë, pa e pasur mendjen. Ana Komnena rrinte në oborr duke prituri Sarën. Kur të lodhej do ulej në stolin e Ibrahimit dhe kur të vinte Muhamedi do ta pyeste për lartësinë e xhamisë, ndërsa Hana do bënte kryqin mbi barkun që nuk i rritej.

Në Kretë, anijet po kalonin mbi ballkonin e shtëpisë dhe pjeprat e prerë e kishin thithur sheqerin si sfungjer. Marina ishte e lodhur dhe nuk do ngrihej më t'i spërkaste pjeprat. Isaku e kishte mbaruar verën e bardhë, ndërsa Arianiti Komneni ishte ngritur në këmbë dhe kontrollonte detin

sikur priste një sinjal. Përballë tyre, brigjet e Azisë ndizeshin si flakë dhe ai i mbyllte sytë që i digjnin. Kur Sara shkante në dhomë dëgjonte Marinën që i thoshte Isakut: Pse i the djalit që turqit nuk do ikin. Ti e di që ai mërzhitet. Isaku lëvizte nëpër dhomë duke parë Azinë nga dritarja, siç bënte në Voskopoje kur filluan zjarret e mëdha dhe thoshte: Është akoma i ri dhe nuk ka hyrë në moshën kur burrat fillojnë të mërzhiten. Sara shtrihej dhe duke menduar për Ana Komnenën e zinte gjumi. Nata e saj në Kretë kalonte shpejt sepse ëndrrat ishin të gjata. Ajo shkante në breg duke ecur me hapa të vegjël dhe futej në ujë. Në fillim, deti i arrinte deri te gjuhët pastaj ngrihej mbi krahë derisa i prekte mjekrën. Pas saj vinte Isaku me këmbët e bardhë që i ngjitej pas trupit. Sara hapte krahët sikur po fluturonte dhe kur binte ndiente dorën e madhe të Isakut që e mbante mbi ujë, si një varkë. Në breg, Arianit Komneni qeshte dhe thoshte: Lëre të notojë vetë se tani është rritur. Sara habitej që babai i kishte thënë Isakut ta linte vetëm në mes të detit dhe dilte me vrap në breg duke përplasur këmbët pas dallgëve si një fëmijë i llastuar. Por, kur afrohej, kuptonte se babai nuk ishte aty dhe ai që kishte folur ishte Arianit Komneni i ri që zhdukej si dallgë, në drejtim të anijeve. Atëherë asaj i dilte gjumi, por mëngjesi nuk kishte ardhur ende.

Sara doli në verandë dhe priti Isakun. Kur ai u ngrit nga gjumi, ajo i tha: Pashë babanë në ëndërr, po na pret. Isaku veshi këmbët e bardhë dhe pantallonat e zeza, ndërsa Sara mori arkën e vogël që e mbante poshtë krevatit dhe u nisën.

Deti ishte i qetë sepse qielli ishte i qetë. Rruga për në mal dukej si një litar që i mbante bashkë. Po të pritej ai litar, bota do ishte një shtëpi pa tavan dhe pa themel.

Isaku ngjitej përpara dhe Sara e ndiqte. Poshtë tyre, Kreta peshkonte në det.

Ishte një ditë e nxehtë dhe njerëzve nuk u hahej peshk. Megjithatë, peshkatarët dilnin në det sepse nuk mund të bënin ndryshe. Ata jetonin për të peshkuar dhe peshkonin për të jetuar. Ata që nuk peshkonin, laheshin, sepse në ishull të gjithë dinin not. Sara kaloi arkën e vogël në dorën tjetër. Arka tundej nga lindja në perëndim dhe peshonte, megjithëse ishte bosh.

Mali ishte i mbushur me pupla dallëndyshesh dhe Sarës iu duk sikur po shkonin në vendin ku Dedali mblodhi puplat për krahët e të birit. Kur u afruan te pllaja, Isaku ndaloi. Nga humnera vinte një erë e lehtë që fishkëllente si muzikë meshe. Një tufë dallëndyshesh që kishin ndaluar aty kërcyen dhe zbritën në det duke i lënë vetëm. Ajo eci me hapa të vegjël në drejtim të varreve. Prindërit ishin aty, të rrethuar me bar. Sara u ul në gjuhë dhe fshiu pluhurin mbi fytyrat e tyre prej guri. E kishte marrë malli për babanë, ndërsa nënën nuk e kishte parë kurrë kaq afër. Pa shkrimin e babait mbi trupin e nënës dhe ndjeu një nxehtësi që i vinte nga sytë. Kishte ardhur t'i fuste të dy në arkën e vogël, por katër numrat mbi varrin e babait dukej sikur i thoshin të kundërtën. Jo pa qëllim, mbi varrin e tij, ai kishte shkruar një datë që lidhej, si qielli me detin, me një datë tjetër. Po të mos ishin katër numrat mbi varrin anonim, lufta e Kretës nuk do kishte fillim, sepse nuk ka lindje pa një datë. Por po të mos ishin katër numrat mbi varrin e babait lufta nuk do kishte fund sepse nuk ka mbarim pa një datë. Midis atyre dy datave shtrihej Arianit Komneni. Ai kishte vdekur duke besuar se lufta me turqit do kishte një fund, siç kishte pasur një fillim.

Sara lëvizi mbi gjuhë dhe pastroi pluhurin e kohës edhe nga varret e tjerë. Luftëtarët nga fshati kishin qenë njëmbëdhjetë dhe bashkë me nënën dhe babanë bëheshin trembëdhjetë. Ajo ndjeu Isakun që merrte frymë pas kurrizit të saj dhe iu kujtua trembëdhjeta e katrorit magjik. Sekretin e tij kishte marrë aty. Ndoshta, nga poshtë tokës, babai e shikonte dhe qeshte si një Krisht i lumtur, i rrethuar nga dymbëdhjetë apostujt e tij. Po ta merrte në fshat do duhej ta ndante nga ata. Ajo do rrinte me babanë, por apostujt do mbeteshin pa Krishtin e tyre, si luftëtarë pa një prijës. Ktheu

kokën nga Isaku dhe e pa gjatë në sy. Ai shkuli një tufë me bar mbi varrin e Arianit Komnenit dhe e hodhi në humnerë. Fijet e bari u shpërndanë në ajër dhe Sarës iu duk sikur ato ishin trembëdhjetë. Ajo ishte mësuar të numëronte dallëndyshet që fluturonin, por jo fijet e barit që binin në det. Qëndroi edhe pak e ulur në gjuhë, pastaj mori arkën e vogël dhe shkoi në buzë të humnerës. Isaku e pa dhe fytyra i shkëlqeu. Sara zgjati dorën mbi humnerë dhe kur e lëshoi arkën u ndie më e lehtë, si një njeri që ka humbur një peshë të tepërt. Arka u rrotullua disa herë në ajër sikur ishte çliruar nga një dorë që e kishte mbajtur njëqind vjet me vete.

Sara mori frymë thellë dhe pa horizontin që lidhte lindjen me perëndimin. Zjarret në brigjet e Azisë turke iu dukën më të vogla, sikur po shuheshin. U kthye nga ana tjetër dhe pa një varkë të vogël që kishte ndaluar në mes të detit. Në atë drejtim ishte perëndimi dhe fshati. Kur të kthehej në fshat, Ana Komnena do qeshte kur t'i thoshte se e kishte humbur arkën e vogël. Po ta pyeste, Sara do t'i thoshte se e kishte humbur ngaqë nuk i duhej. Por Ana Komnena nuk do ta pyeste.

FUND